DOCUMENT RESUME

ED 195 133 FL 011 859

AUTHOR	Newmark, Leonard: And Others
TITLE	Readings in Albanian. Part 1.
INSTITUTION	Spoken Language Services, Inc., Ithaca, N.Y.
SPONS AGENCY	Bureau of Postsecondary Education (DHEW/OE), Washington, D.C. Div. of International Education.
PUB DATE	79
GRANT	300-76-0136
NOTE	914p.: For related document, see FL 011 849.
AVAILABLE FROM	Spoken Language Services, Inc., P.O. Box 783, Ithaca, NY 14850
LANGUAGE	Albanian: English
EDRS PRICE	MF06/PC37 Plus Postage.
DESCRIPTORS	*Albanian: *Grammar: Independent Study: Postsecondary Education: Reading Instruction: *Reading Materials: Second Language Learning: *Vocabulary Development

ABSTRACT

This text is designed to enable a student who knows English to gain reading proficiency in Albanian. Part One, which is presented here, includes the first 30 of the 100 units in the complete course. The units include texts from various periods of Albanian writing and include a variety of contents and styles: folklore, biography, news articles, literary works, art, history, archeology, humor, and allegory. Each unit has been provided with glosses for the lexical items that appear in the reader for the first time. Also included in the text is a short reference grammar. (Author/AMH)

****
* Reproductions supplied by EDRS are the best that can be made *
* from the original document. *
****

ED195133

Contract No. 300 - 76 - 0136
(Authority: Title VI, Section 602, NDEA)

Readings in Albanian

Part I

Leonard Newmark

Peter Prifti

Philip Hubbard

FL 011859

U.S. DEPARTMENT OF HEALTH, EDUCATION & WELFARE
NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION

THIS DOCUMENT HAS BEEN REPRODUCED EXACTLY AS RECEIVED FROM THE PERSON OR ORGANIZATION ORIGINATING IT. POINTS OF VIEW OR OPINIONS STATED DO NOT NECESSARILY REPRESENT OFFICIAL NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION POSITION OR POLICY

"PERMISSION TO REPRODUCE THIS MATERIAL HAS BEEN GRANTED BY
U.S. Office of Education
TO THE EDUCATIONAL RESOURCES INFORMATION CENTER (ERIC)."

INTRODUCTION

Readings in Albanian is designed to enable a student who knows English to gain reading proficiency in Albanian. There is a need for a book of this kind because of the nearly total absence or unavailability of systematic materials for learning to read Albanian. The premises of this book are that one learns to read a language by reading, and that reading requires the student to experience Albanian texts with some understanding. Given these premises, confirmed by experiments with various kinds of reading programs, this book offers a large amount of reading material, with enough aids to understanding--by use of running vocabulary glosses--to enable the student to undergo considerable practice in reading without the frustrating interruptions required by constant use of a dictionary.

Inasmuch as learning is a cumulative process, increasing gradually by stages, so also the size of the units in this reader grows progressively by small increments. As he progresses in his study, the diligent student should find that each unit can be read and partially assimilated in little more than an hour. The best plan is to spend an hour reading through a unit several times, remembering as much as possible in that time. Then the student should proceed to the next unit, even though much of the material in the previous chapter is still not totally assimilated. Important vocabulary items will come up again, exactly because they are important; unimportant ones will be forgotten because they are unimportant. As the student progresses through the book, he will find more and more words that he has seen before. As words reappear, they may be looked up in a dictionary, but the learner is warned not to attempt to understand each word in every unit, since that attempt is eventually slower than the procedure of learning imperfectly but in large amounts. Of course, there is little benefit in running one's eyes over a page without any understanding of what is being said; to improve reading skill, the student reader must experience some comprehension, at least in a general way, of the material read. The trick in learning to read is to pay just enough attention to detail at each point to gain some new information, and not so much attention to detail as to lose sense of what one is reading, and thus lose the essence of the experience. The value of going over the same material several times is that each time new details may be noticed because the base of what is already understood has become broader.

Readings in Albanian comprises 100 units in all. Part I includes the first 30 of those units, a size deemed practical for a student in the early stages of studying the language. A student who completes all 100 units will have gained reading proficiency equivalent to two years of college level work in the language.

Although *Readings in Albanian* includes texts from various periods of Albanian writing, it is not intended as an introduction to Albanian literature. The selections include a variety of contents and styles: folklore, biography, news articles, literary works, art, history, archeology, humor and allegory. This makes it possible for the student to familiarize himself with a wide range of printed matter, representing many genres and aspects of Albanian society.

Each of the units has been provided with glosses for the lexical items that are appearing in the reader for the first time. For the first ten units the words are glossed as they actually appear in the text. For example, **punova** 'I worked' and **mbuluar** 'covered' are glossed as such. However, beginning with unit eleven, and through unit thirty, only the citation forms of words glossed are given. For example, the word **punova** is now glossed as **punoj** 'I work', while **mbuluar** is glossed as **mbuloj** 'I cover'. Most words are glossed only once, namely the first time they appear in the text. However, common words that take on new meanings in different contexts have been glossed more than once.

JUL 2 9 1980

Readings in Albanian includes a short reference grammar. This section is intended as a supplementary aid to which the student can turn to clarify and strengthen his understanding of the texts in the reader. The authors recommend that the student scan the grammar quickly upon beginning his study of the language, just to make himself aware of the kinds of grammatical distinctions the language uses; as his study continues, the curious student will refer back to the grammar to check his own theories and discoveries about the language in detail.

The usefulness of *Readings in Albanian* depends to a great extent on just how it is used. The student who applies himself to regular and careful study of all the units can expect to reap the full benefits of the book.

This work was produced under contract number 300-76-0136 with the International Studies Branch, Division of International Education, of the United States Office of Education.

Peter Prifti
Philip Hubbard
Leonard Newmark
University of California, San Diego
La Jolla, California

June 30, 1979

REFERENCE GRAMMAR

This is a special type of grammar de[illegible] short reference work to help a student of Albanian learn to read the language w[illegible] nding. It was designed for use with the particular reading materials in this book, [illegible] with a good dictionary it should be useful with other Albanian reading materials [illegible] rough the presentation of Albanian inflectional morphology and certain syntactic [illegible] the grammar provides an analytic framework for recognizing the elements of a w[illegible] nce and assigning them a proper meaning. This framework, however, should be con[illegible] only the barest skeleton of a full linguistic description, a simple reading tool. [For a m[illegible] ailed reference work, see Leonard Newmark, Philip Hubbard, and Peter Prifti, *Standard Al[illegible] an: A Reference Grammar for Students.*]

The present grammar is divided into a number of sections which together will cover the fundamental points of Albanian grammar that are n[illegible] obvious to the English speaker. It is our feeling that this sketchy description, in conjunctio[illegible] th the English glosses in the text, is adequate for the beginning student to derive the essential meaning of the Albanian in the chapters of the reader that follow.

1. Citation forms. The citation form of a word is the form that appears as the head entry of a dictionary, and the form that will normally appear in the running glossary in this reader ater the first ten units. The citation form for nouns is masculine, singular, nominative, indefinite. The citation form for verbs is first person singular present indicative active, with two exceptions: non-active verbs which appear only in a non-active form are cited in the non-active first person singular present indicative form (e.g., **dukem** 'I appear'); and impersonal verbs which appear only in third person singular are cited in the third person singular present indicative form (e.g., **gjumon** 'it thunders'). The citation form for adjectives and pronouns is the same as for nouns. Forms not obviously derivable by regular processes from the citation form will be glossed separately.

2. Phonology. In learning to read a language, accuracy in pronunciation is not necessary. However, to enhance his general knowledge of the language, a reader may refer to the table below, which gives rough correspondences between Albanian and English sounds. Such correspondences provide an approximation of Albanian pronunciation for the reader to use in subvocalization while reading to oneself.

The Albanian alphabet has 36 representational units, or letters. Unlike English, each letter consistently maintains a fundamental sound in every word in which it appears, although there are minor variations in sound depending on the context. In the following list of approximate sound equivalents, a "-" after the letter means that its value in Albanian is quite similar to its to its usual value in English.

a like *a* in 'father'
b -
c like *ts* in 'cats'
ç like *ch* in 'child'
d -
dh like *th* in 'then'
e like *e* in 'best'
ë unstressed like *a* in 'align' or stressed like *u* in 'bun'
f -
g like *g* in 'go'

gj	like *g* in 'argue'
h	-
i	like *i* in 'police'
j	like *y* in 'yellow'
k	-
l	(light l) like *l* in 'believe'
ll	(dark l) like *l* in 'call'
m	-
n	-
nj	like *ny* in 'canyon'
o	like *o* in 'hotel'
p	-
q	like *c* in 'cute'
r	(tongue flap) like *d* in American pronunciation of 'modify'
rr	(tongue trill) try imitating sound of motorboat
s	like *s* in 'sing'
t	-
th	like *th* in 'thin'
u	like *oo* in 'roof'
v	-
x	like *ds* in 'pads'
xh	like *j* in 'job'
y	(u umlaut) like fast pronunciation of *u* in 'cumulative'
z	-
zh	like *z* in 'azure'

As far as stress is concerned, most Albanian words get primary stress on the last syllable of the stem; since many words end in a suffix, this means that the stress is often on the next to last vowel of the word. In word groups and compound words, the last word of the sequence normally gets the major stress, while the other words are reduced in the degree of stress they receive.

3. Abbreviations. There are a number of abbreviations used in this grammar, and while most are fairly transparent, a comprehensive list is provided below to eliminate possible confusion.

Ab. - ablative Ac. - accusative C - consonant D - dative def. - definite f - feminine
G - genitive imperf. - imperfect indef. - indefinite irreg. - irregular m - masculine
N - nominative part. - participle pers. - person pl. - plural pres. - present pst. def.
-past definite sg. - singular V - vowel

0.1 VERBS

0. The Albanian verbal system makes distinctions of tense and aspect, mood, and voice. For tense and aspect, present, imperfect, past definite, future, and present, past, and future perfect are morphologically distinguished. In terms of mood, different forms are seen for the indicative, subjunctive, imperative, admirative and optative. Active and non-active conjugations exist for each mood and tense.

1.0 The Verbal Stem. The stem is the base of the verb to which the endings are added. For the majority of verbs, the stem is either identical to the citation form or is derivable from it by subtracting the final **-j**:

hap 'I open'--stem = **hap-**
shkoj 'I go'--stem = **shko-**

For a fair number of verbs, however, the stem for the past definite and the participle is unpredictable given just the citation form and for a few verbs there are three quite distinct stems. For such verbs, the unpredicatable forms are individually glossed in the reading passages: e.g., **ha** 'I eat', **hëngr-a** 'I ate (pst. def.)', **ngrënë** 'eaten (part.)'. For reading, one must recognize what verb a given verbal form represents, but need not know how to construct the form oneself.

1.1 Stem Vowel Changes. There are several fairly regular vowel alternations that will be mentioned here without giving the actual rules. A citation form stem vowel **-e-** often becomes **-i-** before 2nd. pers. pl. **-ni**, before the endings of the imperfect tense, and before the non-active marker **-(h)e-**. Similarly, a citation form stem vowel **-o-** or **-e-** often alternates with **-ua-** and **-ye-**, respectively, in various forms of a given verb: e.g., **shkova** 'I went' (pst. def.), **shkuam** 'we went' (pst. def.).

1.2 Stem Consonant changes. The most common consonant change is an alternation between stem final **-t** and **-s** **shes** 'I sell', **shitni** 'you (pl.) sell'.

Verb forms that reflect changes other than these or that are generally irregular will be individually glossed.

2. Verb forms

2.1 Simple forms.

2.1.1 Present tense. The exact form of the present tense endings of regular verbs depends on whether the verb has a vowel stem whose citation form ends in **-j**, a consonant stem, or a bare vowel stem.

[V(j)]	I	**-j**	we	**-jmë**	(go)	**shkoj**	**shkojmë**
	you	**-n**	you	**-ni**		**shkon**	**shkoni**
	he, she, it	**-n**	they	**-jnë**		**shkon**	**shkojnë**

(Note: hereafter verb paradigms will always appear in this order, without accompanying pronouns)

(C)	**-Ø**	**-im**	(sew)	**qep**	**qepim**
	-Ø	**-ni**		**qep**	**qepni**
	-Ø	**-in**		**qep**	**qepin**
(V)	**-Ø**	**-më**	(eat)	**ha**	**hamë**
	-Ø	**-ni**		**ha**	**hani**
	-Ø	**-në**		**ha**	**hanë**

2.1.2 Imperfect. The imperfect endings are essentially the same for C and V stems, with the initial **n** obligatory for V-stem forms in the 3rd person singular.

-ja	**-nim**	**shkoja**	**shkonim**
-je	**-nit**	**shkoje**	**shkonit**
-(n)te	**-nin**	**shkonte (qepte)**	**shkonin**

2.1.3 Past definite. The stem to which the past definite endings are added is often related to the participle (see above). For C-stem verbs, the endings are:

-a	**-ë̄m**	**qepa**	**qepë̄m**
-e	**-ë̄t**	**qepe**	**qepë̄t**
-i	**-ë̄n**	**qepi**	**qepë̄n**

For V-stems:

-va	**-m(ë̄)**	(drank)	**piva**	**pimë̄**
-ve	**-t(ë̄)**		**pive**	**pitë̄**
-vu	**-n(ë̄)**		**piu**	**pinë̄**

V-stems ending in **-o** change **-o** to **-ua** in the plural forms. Finally there is another set of perfect endings added to stems formed from participles ending in **-ë̄n.** These stems end in **-a** and the following endings are added (Note that in all these forms the sequence **ae** becomes **e.**):

-shë̄	**-më̄**	(said)	**thashë̄**	**thamë̄**
-e	**-të̄**		**the**	**thatë̄**
-ø	**-në̄**		**tha**	**thanë̄**

2.1.4 Non-active present. The non-active present is identified most easily by the **-e-** which occurs in all of its forms. The endings are the same for C and V stems except that an **-h** precedes a V-stem ending.

-(h)em	**-(h)emi**	(be opened)	**hapem**	**hapemi**
-(h)esh or (h)e	**-(h)eni**		**hapesh**	**hapeni**
-(h)et	**-(h)en**		**hapet**	**hapen**

2.1.5 Non-active imperfect. The non-active imperfect is easily identified by the **-esh** appearing in all forms (except the 3rd person singular. Again, **-h** occurs after V-stems.

-(h)esha	**-(h)eshim**	(returned)	**kthehesha**	**kthe-heshim**
-(h)eshe	**-(h)eshit**		**kthehesheshe**	**kthe-heshit**
-(h)ej	**-(h)eshin**		**kthehej**	**kthe-heshin**
or **-(h)esh**			or **kthehesh**	

2.1.6 Non-active past definite. The non-active past definite is recognized by the presence of the passive-reflexive particle **u** directly before the active form of the past definite. Note that the third person form is simply **u** plus the bare past definite stem.

(held) I	**mbajta**	**u mbajta**	
he	**mbajti**	**u mbajt**	etc.

2.1.7 Optative. For most verbs the optative forms are built on the stem of the participle. For V-stems (with **-rë** or **-uar** participles) the optative stem adds **-f**. C-stems (**-ur** participles) have the optative endings added directly.

-(f)sha	**(f)shim**	**shkofsha**	**shkofshim**	**hapsha**	**hapshim**
-(f)sh	**-(f)shit**	**shkofsh**	**shkofshit**	**hapsh**	**hapshit**
-(f)t	**-(f)shin**	**shkoftë**	**shkofshin**	**haptë**	**hapshin**

A few irregular verbs with a participle ending in **-ënë** drop the final **-ë** and add the optative endings to the remaining stem: **thënë** 'said' **thënshafR (or fBthënça)**, etc.

2.1.8 Non-active optative. The non-active optative is recognized by the presence of the passive-reflexive particle **u** before an optative form: **u haptë** 'may it be opened'.

2.1.9 Admirative. The admirative is recognized by a form of **kam** 'I have' (sometimes slightly modified) attached to a participial stem (see 5.1 for the conjugation of **kam**).

present-	**qenë** 'been'	**qenkam**	**qenkemi**
		qenke	**qenkeni**
		qenka	**qenkan**
imperfect-	qenkësha	**qenkëshim**	
		qenkëshe	**qenkëshit**
		qenkej	**qenkëshin**

2.1.10 Non-active admirative. A **u** before the active form indicates the non-active admirative.

Pres.: **u qenkam**

Imperf.: **u qenkësha**

2.1.11 The imperative. The imperative form is usually recognizable from context, almost always appearing in direct quotes. For citation forms that end in **-j**, the imperative in the singular is the bare stem: **shko** 'go!' For verbs whose citation forms end in a vowel or consonant, the imperative singular is identical to that form in most cases: **ha** 'eat!'; **hap** 'open!' Any exceptions to this will be individually glossed. The plural imperative is almost always identical to the 2nd person plural of the present. It is negated with the particle **mos**: **Mos shkoni!** 'Don't go!'.

2.1.12 Non-active imperative. These forms are recognized by the presence of the passive-reflexive marker **u**. It is placed directly after the stem, before the **-ni** ending in the plural, and is preceded by **-h-** in vowel final stems: **lahu, lahuni** 'wash yourself!'; **hapu, hapuni** 'open yourself up)!' When negated with **mos**, however, the **u** precedes the imperative form of the verb as a separate word. **Mos u laj!** 'Don't wash yourself!'

2.2 The Participle. With few exceptions, a participle in Albanian has one of the endings **ur**, **-r(ë)** **(-uar -yer)** or **-ënë**: **hap--hapur** 'opened' **pi--pirë** 'drank' **shkoj--shkuar** 'gone' (irreg.), **them--thënë** 'said'. Most participles are formed according to two simple rules. For C-stem verbs, add **-ur**, for V-stem verbs add **-r(ë)** and if the stem ends in **o** this becomes **ua.**

The past definite and optative stems are often related to each other and the participle. Consequently, a form which may be irregular relative to the present imperfect stem may be regular relative to these others. In Chapters 11-30, if the present/imperfect stem is different from that of the past definite or participle/optative, forms based on the latter will be individually glossed in addition to the citation form.

2.3 Complex forms. All forms written as more than one word are considered complex forms here, with the exception of the forms with the passive-reflexive **u** that were presented in 2.1.

2.3.1 The subjunctive. The subjunctive is marked by the clitic **të** which immediately precedes a form of the present, imperfect, or perfect (see below 2.3.4 - 2.3.8) in either active or non-active form. The 2nd and 3rd pers. sg. forms add **-(ë)s** and **-(j)ë** respectively in the present: otherwise, the endings for most verbs are the same as in the indicative.

present	**të shkoj**	**të shkojmë**	**të hap**	**të hapim**
	të shkosh	**të shkoni**	**të hapësh**	**tëhapni**
	të shkojë	**të shkojnë**	**të hapë**	**të hapin**

2.3.2 The future. The future is marked by the invariable form **do** 'want, will' immediately preceding the subjunctive present: **do të shkoj, do të shkosh,** etc.

2.3.3 The conditional. The conditional is identical to the future, except that the imperfect, rather than the present, subjunctive follows **do: do të shkoja, do të shkoje,** etc.

2.3.4 The present perfect. This is formed, like English, with a present form of **kam** 'I have' preceding the participle: **kam shkuar, ke shkuar,** etc.

2.3.5 The present perfect non-active. This is formed like the English passive, with a present form of **jam** 'I am' preceding the participle: **jam hapur, je hapur,** etc.

2.3.6 The past perfect. The past perfect is an imperfect form of **kam** preceding the participle: **kisha shkuar, kishe shkuar,** etc.

2.3.7 The past perfect non-active. This is formed with an imperfect form of **jam** preceding the participle: **isha hapur, ishe hapur,** etc.

2.3.8 Other perfects. There are a number of other perfect constructions in the indicative and other moods. They will be individually glossed.

2.3.9 The **duke** progressive. This is identified by the particle **duke** following a form of **jam** and preceding a participle: **jam duke shkuar, isha duke shkuar.**

2.3.10 The **po** progressive. This construction is simply the particle **po** before a present or imperfect form of a verb: **po shkoj; po hap.**

2.3.11 Modals. **Mund** 'can, be able to' and **duhet** 'ought, must' like **do** in the future and conditional do not change their form to agree with the subject. Only the subjunctive form following them does: **mund të shkoja, duhet të shkoni,** etc.

3. Most common meanings of verb forms

3.1 The present. The present describes a current situation or something habitually done: **Banoj në Tiranë** 'I live in Tiranë.' **Agimi ha fasule çdo ditë** 'Agim eats beans everyday'.

3.2 The imperfect. The imperfect describes acts or states at an indefinite time in the past, e.g., habitual or repeated acts in the past, similar to the English "used to" construction: **Banoja në Tiranë** 'I lived/used to live in Tiranë. **Agimi hante fasule çdo dite.** 'Agim used to eat beans every day'.

3.3 The past definite. The past definite generally represents a state or action at a definite time in the past. It usually translates as the English simple past: **Banova në Tiranë një muaj.** 'I lived in Tiranë for one month.' **Hëngra fasule dje.** 'I ate beans yesterday.'

3.4 Non-active forms. The non-active forms usually represent passives or reflexives: **unë lahem** 'I wash myself', 'I am being washed.' Sometimes the underlying agent of the passive action appears in the sentence as the object of the preposition **prej** or **nga** 'by': **unë lahem prej Agimit** 'I am washed by Agim.' In certain contexts, a plural non-active form may have a reciprocal meaning as well: **u pamë** 'we saw each other'.

Some verbs occur only in a non-active form; such a verb will be cited and glossed in a 1st pers. sg. pres. citation form, e.g. **dukem** 'I seem, appear.'

As a reading strategy, it is probably best to assume first that any non-active form is marking the passive of the corresponding active stem, since this will handle the majority of cases. It is always passive if a **prej** or **nga** phrase appears. If such an interpretation does not fit the context, next try the meanings of reflexive (acting on oneself), middle (acting with no object other than oneself), and reciprocal (acting on each other; only if verb is plural), in that order.

3.5 The optative. The optative expresses strong desire on the part of the speaker, an "if only" or "may it be so" sense: **mirë u pafshim** 'may we see each other well'.

3.6 The admirative. The admirative expresses the speaker's surprise at an exciting or unexpected situation: **Agimi qenka këtu!** 'Agim is really here!'.

3.7 The imperative. The imperative expresses a command or curt request: **Hap derën!** 'Open the door'.

3.8 The subjunctive. The subjunctive most often occurs after another verb, in which case its meaning is usually identical to the English infinitive: **Drita shpreson të shkojë.** 'Drita hopes to go'. It can also occur alone, in which case it either expresses possibility--**Kush të jetë kaq vonë?** 'Who could it be so late?'--or desirability--**Të flasim drejt** 'Let's talk straight'.

3.9 The future. This compound tense translates as 'will' or 'is going to': **Do të shkosh në Tiranë neser?** 'Are you going to go to Tiranë tomorrow? **Do t'ju ndihmoj** 'I will help you'.

3.10 The conditional. This construction generally translates as 'would have' or 'would': **Po të kisha nge, do të të shihja** 'If I had time I would see you.'

3.11 The perfect. The perfect represents an action completed in the past that is relevant to the present (present perfect) or to a particular time past (past perfect): **E kam parë mikun tim.** 'I have seen my friend.' **Kishte fluturuar dy herë në Amerikë.** 'He had flown to America twice.'

3.12 Progressive. Both the **po** and **duke** progressives indicate a past or present action in progress: **jam duke vrapuar** 'I am running', **isha duke vrapuar** 'I was running', **po vrapoj** 'I am running', **po vrapoja** 'I was running'.

4. Non-finite constructions

4.1 The privative. This construction is formed with the particle **pa** plus the participle, and it means 'without (doing something)': **Pa ngrënë, ai do të vdesë.** 'Without eating, he will die.'

4.2 The gerundive. This is **duke** plus the participle, and it means 'while (doing something)': **Duke vrapuar, ai ra.** 'While running, he fell.'

4.3 The infinitive. This infinitive, which is much more restricted in use than the English one, is composed of **për** plus **të** plus the participle and means 'to' or 'in order to (do something)': **Ai më dha lejë për të shkuar.** 'He gave me permission to go.' **Kamerieri e duroi burrin për të marrë bakshish.** 'The waiter put up with the man in order to get a tip.'

5. Some common irregular verbs

5.1

'have'	**kam**	**kemi**	'be'	**jam**	**jemi**
present	**ke**	**keni**	je	**jeni**	
	ka	**kanë**	është	**janë**	
	kisha	**kishim**	isha	**ishim**	
imperf.	**kishe**	**kishit**	ishe	**ishit**	
	kish(te)	**kishin**	ish(te)	**ishin**	
	pata	**patëm**	qesh	**qemë**	
past def.	**pate**	**patët**	qe	**qetë**	
	pati	**patën**	qe	**qenë**	

5.2 Present only

'come'	**vij**	**vijmë**	'want'	**dua**	**duam**
	vjen	**vini**		**do**	**doni**
	vjen	**vijnë**		**do**	**duan**
'take'	**marr**	**marrim**	'go'	**vete**	**vemi**
	merr	**merrni**		**vete**	**veni**
	merr	**marrin**		**vete**	**venë**
'say'	**them**	**themi**	'go'	**iki**	**ikim**
	thua	**thoni**		**ikën**	**ikni**
	thotë	**thonë**		**ikën**	**ikin**
'know'	**njoh**	**njohim**	'await,	**pres**	**presim**

njeh	**njihni**	expect'	**pret**	**pritni**
njeh	**njohin**		**pret**	**presin**
		(also **shoh** 'see')		

0.2 NOUNS

0. Nouns are morphologically distinguished as to their gender, case, number, and definiteness, all of which are marked by inflectional endings. Case, number, and definiteness are important categories for recognizing the full meaning of a noun and its relationship to the rest of the sentence. Except in animate nouns where sex is determining, the gender of a noun is arbitrary and plays little role in understanding the meaning of the noun in the sentence. These inflectional categories are intertwined so that a single morpheme may signal more than one category, as will become apparent in Section 2.

1. Typology of Inflectional Categories

1.1 Gender. Standard Albanian primarily distinguishes masculine and feminine, although there are still remnants of a third, neuter gender here and there in the language. In general, nouns whose citation forms end in a consonant are masculine, while those that end in a vowel are feminine. The stem endings **-ër, -ull, -ë,** and a few others may be found in both masculine and feminine nouns (e.g. **kodër** (f), **pjepër** (m)). This should present no problem to the reader, however, since the inflectional endings and the gloss of the citation form generally provide the information needed for determining the function and meaning of the word in a given context.

Neuter forms will be identified when they arise in the text.

1.2 Case. For the purposes of this reader, Albanian will be considered here to have five cases, although it has been claimed at times to have as few as three or as many as seven. The cases are the nominative, accusative, genitive, dative, and ablative, the last three distinguishable, as will become apparent below, only in one or two respects.

1.3 Number. Like English, Albanian marks only two numbers, singular and plural.

1.4 Definiteness. Unlike English, which marks definiteness and indefiniteness with preposed articles (*a, an, the*). Albanian incorporates this information into the inflectional endings. In the genitive, dative, and ablative plural, definiteness is no longer marked; however, some indefinite determiner, such as **disa** 'some, several' is usually present when such an ambiguous form is intended as indefinite.

2. Forms of Inflectional Endings

2.1 The Noun Stem. Compared to the verb, the noun stem itself undergoes few changes. In the singular, except for dropping a final unstressed vowel on predictable occasions, it is essentially invariable. The plural stem, however, is often different from the singular (see Section 2.3.1). Generally, the singular noun stem is identical to the citation form, and is easily identifiable in any given inflected form.

2.2 Singular Forms

Indef.:	N.	m) **-Ø**;	f) **-Ø**	Def.	m) **-i/u**;	f) **-(j)a**
	Ac.	**Ø**;	**-Ø**		**-in/-un**;	**-n(ë)**

G,D,Ab.	**-i/-u;**	**-(j)e**	**-it/-ut;**	**-s(ë)**

The choice between the inflectional variants above is determined by the phonetic qualities of the stem as follows:

a) An **-ë** at the end of a citation form is always deleted before an ending that begins with a vowel: **burrë--burri; nënë--nëna.** Therefore, given an inflected noun form to identify, the reader may find its citation form ending in **-ë**, especially if it is feminine.

b) The feminine inflectional variants with **-j** occur after any vowel except **-i**, so the citation form of a noun found with a **-j** variant is simply the rest of the word before that **-j**. Exception: stem final **-e** drops before the suffix **-ja**, so a nominative singular definite form ending in Cja (where C is a consonant) represents a stem with final **-e**, as appears in all other forms of the noun: **lule, luleje, lulja.**

c) The inflectional variants **-në** and **-së** occur after stressed vowels only (these also occur with a handful of masculine nouns) **shtëpi, shtëpinë.**

d) Inflectional suffix forms containing **-i** or **-u** are found only in masculine nouns. The **-u** forms occur only after the consonants **k, g,** and **h** and after vowels: **det--deti, plak--plaku, ka--kau.**

2.3 Plural forms

2.3.1 Formation of the plural stem. The user of this book should recognize the regular plurals of nouns, since they are not glossed separately in the readings.

a) If the singular stem ends in **-ar, -at, -an, -or,** add **-ë** to form the plural: **punëtor--punëtorë, shqiptar--shqiptarë.**
b) If the singular stem ends in any other consonant, add **-e: mal--male, provim--provime.**
c) If the singular ends in **-ë, -ë** becomes **-a, nënë--nëna, vlërë--vlëra**
d) If the singular ends in a vowel other than **-ë**, plural stem is the same as the singular: **shtëpi--shtëpi.**
e) Mass nouns, as in English, may be pluralized only when they mean "kinds of" (Compare: 'The meat is good' vs. 'The meats are good'), in which case the plural has **-ra: mish--mishra.**

The endings **-uj, -(i)nj,** always mark plural stems. Irregular plural stems are glossed separately.

2.3.2 Plural endings. The only plural endings are **-t(ë), -ve, -sh.** The nominative and accusative indefinite ending is **Ø**, and the definite is **-t(ë)**. The ending for all other cases, indefinite and definite, is **-ve,** with one exception: **-sh** is sometimes used as the indefinite ablative plural. Also, **-t** is sometimes added to **-ve** forms to mark definiteness, but this is becoming uncommon in contemporary Albanian.

2.4 Formation of feminine nouns from masculine. Animate nouns often derive feminine forms from masculine ones by adding **-e** to the masculine stem. This is a productive rule for stems ending in **-tar, -tor, -an** and **-s.** It is reversible, in the sense that a masculine word can be formed (or the citation form found) from any feminine word ending in **-tare, -tore, -ane,** or **-(ë)se: shqiptar--shqiptare; mësues--mësuese.**

3.0 Meanings of inflectional endings (cases)

As has been noted, gender is lexically arbitrary in Albanian nouns except in animate nouns, where it often corresponds to sex distinctions (in which case masculine = male and feminine = female). For number, the categories of singular and plural are essentially the same as in English. Definiteness, too, works about the same in Albanian as in English, with the following crucial exceptions: 1) Proper names usually appear in definite form, except in vocatives, where the indefinite form is generally used. Compare **Agimi është këtu** 'Agim is here,' literally 'The Agim is here' vs. **Eja Agim** 'Come, Agim.' 2) Mass and abstract nouns usually appear in definite forms when they are subjects of a verb: **Liria është e ëmbël** 'Freedom is sweet'.

Major differences between Albanian and English arise from the use of case marking, rather than obligatory word order, to specify the relational role a noun plays in a given sentence.

3.1 Nominative. A noun will have a nominative case form if it is either the subject of the sentence or a predicate nominative (following a form of **jam** 'I am'): **Agimi këdon** 'Agim sings'.

3.2 Accusative. A noun will have an accusative case form if it is the direct object of the sentence: **Pashë një qen** 'I saw a dog.'

3.3 Dative. A noun will have a dative case form if it is the indirect object or the referent of the verb, expressing the relation that is indicated by "to" or "for" or "in respect to" in English: **I dhashë urdhërin Agimit** 'I gave the order *to Agim*.' (For an explanation of the clitic **i** here, see the section on pronouns.)

3.4 Genitive. The genitive expresses the relation "character of" or "belonging to", like the English "'s" and "of" constructions: **Burrat e Tiranës** 'The men *of Tirane*', **Shtëpia e Jonit** 'The house *of John, John's* house.' The particle **e** appearing between the nouns is traditionally considered a part of the genitive form, and varies according to the gender, case, number, and definiteness of the preceding noun in exactly the same way as the adjective particle does (see the section on adjectives).

3.5 Ablative. The ablative case commonly marks a noun which characterizes another noun, identifying its source, substance, purpose, inherent association, etc.: **mish viçi** 'veal; meat *of calf*' **treni mallrash** 'the freight train; the train *for goods*', **bojë hiri** 'gray, color *of ash*'.

3.6 Cases After Prepositions. Prepositions govern a specific case in their object. In reading, identifying the case of nominal expressions after a preposition is usually important only when the reader must choose between alternate potential objects, since it is the preposition alone which determines the relational value of the prepositional phrase. Special points to remember in interpreting a reading passage: a) the prepositions **te** and **nga** govern the nominative case, so that an ambiguous masculine noun form like **leshi** is interpreted after **nga** as nominative definite ('from the wool'), while after prepositions governing the dative or ablative this same form would be indefinite (**prej leshi** 'of wool'); b) after certain prepositions that govern accusative objects, such as **në** 'to' or **me** 'with', the object is semantically definite, unless its grammatically indefinite object is preceded by an indefinite determiner of some kind:

> **Ra në lum.** 'He fell into the river.' (where the English speaker would expect the definite form **lumin**)
> **Fluturova në Tiranë** 'I flew to Tiranë' instead of **Fluturova në Tiranën** 'I flew to (the) Tiranë'.

4.0 Noun declensional paradigms

4.1 Singular masculine

	mur	indef.	def.	**shok**	indef.	def.
Nom.	'wall'	**mur**	**muri**	'friend'	**shok**	**shoku**
Acc.		**mur**	**murin**		**shok**	**shokun**
Dat.		**muri**	**murit**		**shoku**	**shokut**
Gen.		**i muri**	**i murit**		**i shoku**	**i shokut**
Abl.		**muri**	**murit**		**shoku**	**shokut**

Note: an indefinite countable noun is often accompanied by the article **një** 'a, an, one.' The indefinite form also appears after preposed determiners like **ky** 'this', even though the meaning is definite **ky djalë** 'this boy', **djali** 'the boy'.

4.2 Singular feminine

	nënë	indef.	def.	**lule**	indef.	def.
Nom.	'mother'	**nënë**	**nëna**	'flower'	**lule**	**lulja**
Acc.		**nënë**	**nënën**		**lule**	**lulen**
Dat.		**nëne**	**nënës**		**luleje**	**lules**
Gen.		**i nëne**	**i nënës**		**i luleje**	**i lules**
Abl.		**nëne**	**nënës**		**luleje**	**lules**

4.3 Plural (same for masculine and feminine)

	nëna	indef.	def.	**mure**	indef.	def.
Nom.	'mothers'	**nëna**	**nënat**	'walls'	**mure**	**muret**
Acc.		**nëna**	**nënat**		**mure**	**muret**
Dat.		**nënave**	**nënave**		**mureve**	**mureve**
Gen.		**i nënave**	**i nënave**		**i mureve**	**i mureve**
Abl.		**nënash**	**nënave**		**muresh**	**mureve**

0.3 ADJECTIVES

0.0 Adjectives in Albanian are structurally of two types: articulated and unarticulated. Both generally follow the noun they modify, and the preposed article of the former varies with the case, definiteness, gender, and number of its noun.

In addition to the variation in the preposed article, adjectives may exhibit gender and number distinction by addition of a suffix. A very few adjectives reflect these distinctions by internal stem changes.

Although in general adjectives follow the noun in Albanian, for purposes of emphasis or style they may precede it instead. In the latter case the adjective takes its substantivized form (see point 5) while the noun appears in its bare stem (singular or plural) form.

1.0 Articulated adjectives. Articulated adjectives consist of the article, followed by the base, or adjective proper. In **i mirë** 'good' the base is **mirë** and the article, **i.**

1.1 Changes in the base. The base changes for particular adjectives and classes of adjectives relative to the nouns they modify for gender and/or number. A number of common adjectives have irregular forms, glossed separately in the readings in this book.

1.1.1 The feminine -e. The ending **-e** appears on certain feminine adjectives, including all those whose masculine form ends in **-(ë)m,**. The **-ë** of the such stems is deleted before the ending, as before any other suffix that begins in a vowel: **i afërm** (m) **-e afërme** (f); **i sotëm** (m) **-e sotme** (f) **i vlefshëm** (m)--**e vlefshme** (f).

1.1.2 The feminine plural **-a**. The ending **-a** appears on all adjectives modifying feminine plural nouns except those that take the feminine suffix **-e**. Again, if the stem has a final **-ë**, it is dropped before **-a: të mirë** (m. pl.)--**të mira** (f. pl.); **të ëmbël--të ëmbla; të bukur--të bukura.** The feminine singular for these adjectives is identical to the masculine.

1.2 The adjectival article. The form of the adjectival article depends on the gender, number, case, definiteness and position (relative to the verb) of the adjective. This sounds complicated, but for reading Albanian, the article is usually redundant, since it is often clear from the context what the case, number, and definiteness of the noun is, and which adjective goes with which noun.

An articulated adjective immediately following the noun it modifies will be preceded by one of the following forms.

	Singular				Plural			
	def.		indef.		def.		indef.	
	(m)	(f)	(m)	(f)	(m)	(f)	(m)	(f)
Nom.	i	e	i	e	e	e	të	të
Acc.	e	e	të	të	e	e	të	të
Dat.	të	së	të	të	të	të	të	të
Gen.	të	së	të	të	të	të	të	të
Abl.	të	së	të	të	të	të	të	të

As is obvious, much of the time the form of the particle is **të.** When the adjective does not immediately follow the noun, the form is always **të** except for the nominative masculine (**i**) and the nominative feminine (**e**) in the singular.

2.0 Unarticulated Adjectives. The semantic redundancy of the adjectival article is underscored by the fact that many Albanian adjectives are used without them. Like articulated adjectives, unarticulated ones will show different endings for feminine forms, some in both the singular and plural, and some only in the plural. Certain masculine adjectives also add an ending in the plural.

2.1 Feminine **e**. The **e** appears on adjectives whose masculine form ends in **-ak, -an, -ez, -ist, ësh, -tar, -as, -ës,** or **-ues: shqiptar--shqiptare, tiranas--tiranase.**

2.2 The feminine plural **-a.** An **-a** ending appears on forms in the feminine plural, except for stems with the feminine suffix **-e.**

2.3 The masculine **-ë** plural. An **ë** ending appears in the plural for masculines ending in **-ta(o)r, -ak, -an, -eg, -ist: shqiptar--shqiptarë.**

3.0 Feminine plurals of masculine singulars. A great many inanimate nouns which are masculine in the singular have plurals which agree with feminine forms of adjectives: for example, all nouns ending in **-ime** in the singular have corresponding plurals with **-ime**, and have feminine adjective agreement, as in **mësime** (m) **të mëdha** (f) 'great teachings'. This again will present no problem to the efficient reader, but might disturb the cryptoanalytic reader trying to arrange in an orderly way each detail of the text he is studying.

4.0 Relation of Adjectives to other Parts of Speech. Adjectives are regularly formed from participles, adverbs, and certain classes of nouns, and vice versa. Knowing a few simple correspondences will greatly increase the reader's vocabulary.

4.1 Formation from participles. A participle preceded by an article serves as an adjective: **shkruar** 'written'-- **fjala e shkruar** 'the written word'. Knowing the verb **shkruaj** 'I write' will put the meaning of the adjective **i shkruar** at the reader's disposal.

4.2 Relation to adverbs. Many adverbs are formed simply by dropping the article of the adjective: **i mirë** 'good'--**mirë** 'well', **i keq** 'bad'--**keq** 'badly'. Similarly, an adverb preceded by an article is interpreted as an adjective with an adjectival meaning corresponding to that of the adverb.

4.3 Relation to certain nouns. A number of forms, especially those ending in -s, **-an, -tar, -tor** may be used either as nouns or as unarticulated adjectives: **amerikan** 'American (person)--**qen amerikan** 'American dog'.

5.0 Substantivization. An adjective in Albanian is substantivized when it either precedes the noun it modifies, or is used in place of the noun altogether (as in English "The big must protect the small.") In either case, the adjective takes the endings for case, gender, number and definiteness that a noun would take in the same place, and the adjectival article takes one of the following forms:

	Singular				Plural	
	Def.		Indef.			
Nom.	i	e	i	e	all	të
Acc.	të	të	të	të		
Gen.	të	së	të	të		
Dat.	të	së	të	të		
Abl.	të	së	të	të		

Preceding the noun: **i bukuri djalë** 'the beautiful boy (Nom.)'; **(i) të bukurave vajza** '(of) the beautiful girls (Gen.)'.

Substantivized: **i bukuri** 'the beautiful one (m Nom.)', **ca të bukurave** 'to some beautiful ones (f Dat.)', **një të bukur** 'a good one (m or f Acc.)'.

Note: Possessive adjectives are of two types: nominal and pronominal. The nominal form is the genitive case of the noun (see Nouns); the pronominal forms are covered in the section on pronouns.

0.4 PRONOUNS

0.0 Pronouns in this grammar have been divided into six classes: personal, demonstrative, reflexive, possessive, interrogative, and relative. The most common forms of each will be covered in this section. All other forms will be glossed separately in the readings.

1.0 Personal Pronouns. Personal pronouns are of two types: free and bound (or clitic).

1.1 Free forms. Free forms may occur anywhere in the sentence that a full noun does.

	1st pers.		2nd pers		3rd pers.			
	sg.	pl.	sg.	pl.	sg.		pl.	
					(m)	(f)	(m)	(f)
Nom.	**unë**	**ne**	**ti**	**ju**	**ai**	**ajo**	**ata**	**ato**
Acc.	**mua**	**ne**	**ty**	**ju**	**(a)të**	**(a)të**	**(a)ta**	**(a)to**
Dat.	**mua**	**neve**	**ty**	**juve**	**atij**	**asaj**	**atyre**	**atyre**
Gen.	-	-	-	-	**i atij**	**i asaj**	**i atyre**	**i atyre**
Abl.	**meje**	**nesh**	**teje**	**jush**	**atij**	**asaj**	**atyre**	**atyre**

1.2 Bound forms (clitics). Bound forms or clitics precede the verb, indicating the person and number of direct and indirect objects. Direct object clitics are used to signal that their referent is already known from context, while indirect objects are always marked by a clitic, whether or not the referent is already known.

	1st pers.		2nd pers		3rd pers.	
	sg.	pl.	sg.	pl.	sg.	pl.
Acc.	**më**	**na**	**të**	**ju**	**e**	**i**
Dat.	**më**	**na**	**të**	**ju**	**i**	**u**

Clitics are positioned before verbs:

MË dha një libër. 'He gave ME a book.'
I dha Agimit një libër. 'He gave a book to (HIM) Agim.'
NA E dha. 'He gave IT TO US.'

In commands they sometimes occur after the stem:

SillMËni ca ujë. 'Bring ME some water.'

Generally, when there is more than one clitic (both a direct and indirect object), the two forms are contracted. The contractions should be interpreted as follows (in these forms the indirect precedes the direct object clitic):

ma = më + e
m'i = më + i
ta = të + e
t'i = të + i
ia = i + e, i + i
jua = ju + e, ju + i
ua = u + e, u + i

The position of the subjunctive marker **të** is before object clitics, while that of the non-active particle **u** is after. The contractions **ta** and **t'i**, and **t'ia, t'ua** may indicate the subjunctive marker **të** as well as 2nd person singular clitic **të.**

The clitics may also contract with the passive-relexive particle **u:**

m'u = më + u t'u = të + u iu = i + u, u + u

2.0 Reflexive pronouns. Reflexive pronouns are built on the stem **vete** 'self.' They most often occur in a case other than the nominative and refer back to the subject of the sentence. They can, however, occur in the nominative case in certain constructions with the indirect object as antecedent. They may also have a noun other than the subject as antecedent, but if so this is usually clear from context.

Nom.	**vetja**	**vetvetja**
Acc.	**veten (vete)**	**vetveten (vetvete)**
Dat-Abl.	**vetes**	**vetvetes**
Gen.	**i vetes**	**i vetvetes**

(The **vetvet-** forms are optional variants. The form **vete** occurs in the accusative, after appropriate prepositions.)

Agimi e pa VETEN. 'Agim saw HIMSELF.'
Unë i fola VETES. 'I spoke *to myself.*'

The person, number, and gender of the "self" reading may be disambiguated by a possessive pronoun:

Agimi ia tregoi veten e tij Dritës. 'Agim revealed himself to Drita.'
Agimi ia tregoi veten e saj Dritës. 'Agim revealed Drita to herself (lit: herself to Drita)'.

3.0 Demonstrative pronouns. Demonstrative pronouns **ai** 'that' and **ky** 'this' in their various forms can occur either alone, meaning 'that one; he' and 'this one' respectively, or they may determine a noun in an indefinite form: **ai djalë** 'that boy', **ky djalë** 'this boy'.

The forms for **ai** are identical to the third person forms of personal pronouns. Those for **ky** are:

	Sg.		Pl.	
	(m.)	(f.)	(m.)	(f.)
Nom.	**ky**	**kjo**	**këta**	**këto**
Acc.	**këtë**	**këtë**	**këta**	**këto**
Dat.	**këtij**	**kësaj**	**këtyre**	**këtyre**
Gen.	**i këtij**	**i kësaj**	**i këtyre**	**këtyre**
Abl.	**këtij**	**kësaj**	**këtyre**	**këtyre**

4.0 Possessive pronouns. Some possessive pronouns forms resemble articulated adjectives while others resemble unarticulated adjectives. In most occurrences they follow a noun. The article of the articulated possessive pronoun forms patterns exactly like the article with other

adjectives. It agrees in gender, case, and number with the noun.

	'my' (sg.)		'our' (sg.)	
	m.	f.	m.	f.
Nom.	**im**	**ime**	**ynë**	**jonë**
Acc.	**tim**	**time**	**tonë**	**tonë**
Gen-Dat-Abl.	**tim**	**sime**	**tonë**	**sonë**
	'my' (pl.)		'our' (pl.)	
Nom.	**e mi**	**e mia**	**tanë**	**tona**
Acc.	**e mi**	**e mia**	**tanë**	**tona**
Gen-Dat-Abl.	**të mi**	**të mia**	**tanë**	**tona**
	'your' (sg.)		'your' (sg.)	
	m.	f.	m.	f.
Nom.	**yt**	**jote**	**juaj**	**juaj**
Acc.	**tënd**	**tënde**	**tuaj**	**tuaj**
Gen-Dat-Abl.	**tënd**	**sate**	**tuaj**	**suaj**
	'your' (pl.)		'your' (pl.)	
	m.	f.	m.	f.
Nom.	**e tu**	**e tua**	**tuaj**	**tuaja**
Acc.	**e tu**	**e tua**	**tuaj**	**tuaja**
Gen-Dat-Abl.	**të tu**	**të tua**	**tuaj**	**tuaja**

The corresponding third person singular forms are ordinary adjectives: **i tij** 'his' and **i saj** 'her'. Like other adjectives both add an **-a (e tija, e saja)** when their antecedent is a feminine plural noun. Similarly, **i tyre** 'their' is the corresponding third person plural adjective.

Shoku yt është këtu. 'Your (sg.) friend is here.'

5.0 The interrogative **cili** 'who'. This is the most common of the inflected interrogative pronouns. All the others will be glossed separately.

	Singular		Plural	
	(m.)	(f.)	(m.)	(f.)
Nom.	**cili**	**cila**	**cilët**	**cilat**
Acc.	**cilin**	**cilën**	**cilët**	**cilat**
Dat-Abl.	**cilit**	**cilës**	**cilëve**	**cilave**
Gen.	**i cilit**	**i cilës**	**i cilëve**	**i cilave**

Cilën ke parë atje? 'Who (f.sg.) have you seen there?'

6.0 The relative pronoun **i cili.** The relative pronoun **i cili** 'who, that, which' introduces a relative clause. In most cases it immediately follows the noun or noun phrase it modifies. Its case marking, however, is a reflection of its function in the relative clause:

Burri (Nom.) **të cilin** (Acc.) **e pashë dje është këtu.** 'The man who I saw yesterday is here.'

	Singular		Plural	
	(m.)	(f.)	(m.)	(f.)

Nom.	**i cili**	**e cila**	**të cilët**	**të cilat**
Acc.	**të cilin**	**të cilën**	**të cilët**	**të cilat**
Gen.	**i të cilit**	**i së cilës**	**i të cilëvet**	**i të cilavet**
Dat-Abl.	**të cilit**	**së cilës**	**të cilëvet**	**të cilavet**

0.5 MISCELLANEOUS

0.0 In this section, a few miscellaneous matters of syntax and morphology are listed which do not fit readily into the previous sections. For the most part they will not be pointed out in the glosses in the readings that follow.

1.0 Numbers. Albanian has cardinal numbers and ordinal numbers built on the base of the cardinals by adding a preposed article and suffix **-të**: **dy** 'two'--**i dytë** 'second'. The patterns by which larger numbers are formed from smaller ones is made clear in the chart below.

	Cardinal	Ordinal
1	**një**	(i, e, të, së) **parë**
2	**dy**	(i, e, të, së) **dytë**
3	**tre (m) tri (f)**	(i, e, të, së) **tretë**
4	**katër**	(i, e, të, së) **katërt**
5	**pesë**	(i, e, të, së) **pestë**
6	**gjashtë**	(i, e, të, së) **gjashtë**
7	**shtatë**	(i, e, të, së) **shtatë**
8	**tetë**	(i, e, të, së) **tetë**
9	**nëntë**	(i, e, të, së) **nëntë**
10	**dhjetë**	(i, e, të, së) **dhjetë**
11	**njëmbëdhjetë**	(i, e, të, së) **njëmbëdhjetë**
12	**dymbëdhjetë**	(i, e, të, së) **dymbëdhjetë**
13	**trembëdhjetë**	(i, e, të, së) **trembëdhjetë**
14	**katërmbëdhjete**	(i, e, të, së) **katërmbëdhjetë**
15	**pesëmbëdhjetë**	(i, e, të, së) **pesëmbëdhjetë**
16	**gjashtëmbëdhjetë**	(i, e, të, së) **gjashtëmbëdhjetë**
17	**shtatëmbëdhjetë**	(i, e, të, së) **shtatëmbëdhjetë**
18	**tetëmbëdhjetë**	(i, e, të, së) **tetëmbëdhjetë**
19	**nëntëmbedhjetë**	(i, e, të, së) **nëntëmbëdhjetë**
20	**njëzet**	(i, e, të, së) **njëzetë**
21	**njëzet e një**	(i, e, të, së) **njëzetenjëtë**
22	**njëzet e dy**	(i, e, të, së) **njëzetedytë**
30	**tridhjetë**	(i, e, të, së) **tridhjetë**
40	**dyzet**	(i, e, të, së) **dyzetë**
50	**pesëdhjetë**	(i, e, të, së) **pesëdhjetë**
60	**gjashtëdhjetë**	(i, e, të, së) **gjashtëdhjetë**
70	**shtatëdhjetë**	(i, e, të, së) **shtatëdhjetë**
80	**tetëdhjetë**	(i, e, të, së) **tetëdhjetë**
90	**nëntëdhjetë**	(i, e, të, së) **nëntëdhjetë**
100	**njëqind**	(i, e, të, së) **njëqindtë**
101	**njëqind e një**	(i, e, të, së) **njëqindenjëtë**
110	**njëqind e dhjetë**	(i, e, të, së) **njëqindedhjetë**
200	**dyqind**	(i, e, të, së) **dyqindtë**
300	**treqind**	(i, e, të, së) **treqindtë**
1000	**një mijë**	(i, e, të, së) **njëmijtë**

1000000 **një milion** **(i, e, të, së) njëmiliontë**

2.0 Negatives. The negative particles in Albanian are **nuk, s'**, and **mos.** **Nuk** and **s'** 'not' are used only before indicative verbs; s' is attached either directly to the verb or to a preceding clitic: **s'shkova** 'I didn't go', **s'e pashë** 'I didn't see him'. **Mos** is used with the meaning 'don't' in imperatives: **mos shko** 'don't go'. In expressions of doubt, fear, hope, etc., to indicate that the speaker is uncertain about the facts in the case, **mos** is used before subjunctive or indicative verb forms; in English the equivalent sentence may have the word *not* or *that* (in the sense of 'lest') where Albanian has **mos**, or may have a tag question at the end to indicate the uncertainty: **Kam frikë mos është mbaruar.** 'I'm afraid that it is finished.' **Shpresoj të mos jetë mbyllur.** 'I hope that it isn't closed.' **Mos e ke parë** 'You haven't seen him, (have you?)'

3.0 Interrogatives. The particles **a** and **vallë** have special interrogative uses. **A** often appears to introduce a direct or indirect yes-no question: **A e pëlqen?** 'Do you like it?' **Vallë** indicates an indirect, non-interrogative question and often translates as '**I** wonder'. The two can occur in the same question: **Vallë a do të gjejmë vend.** 'I wonder if we'll find seats.'

4.0 Comparison. The particle **më** 'more' is the central element of comparisons in Albanian corresponding to the comparative and superlative degrees in English. For the comparative, it generally appears before an adjective or adverb followed by either the conjunction se or **nga: më i bukur se Drita** 'more beautiful than Drita' **më shpejt nga unë** 'more quickly than I'. For the superlative, **më** is followed by a definite form of a substantivized adjective and optionally an indicator of the universe of the comparison: **Ajo është më e bukura (prej çupave)** 'She is the most beautiful (of the girls)'.

5.0 **Sa** and **ç** constructions. The interrogatives **sa** 'how much' and **ç'** 'what' are used in expressive constructions corresponding to English ones like 'How beautiful is the sun!' and 'What a full moon!' respectively: **Sa i bukur është dielli! Ç' hënë e plotë!**

6.0 Existential **ka.** The impersonal third person singular of **kam** 'I have' is used in Albanian like 'there is/there are' is in English: **ka bukë këtu** 'There is bread here.' **Ka shumë male në Shqipëri.** 'There are many mountains in Albania.'

7.0 **Që** and **se.** **Që** and se are commonly translated as 'that' when they appear between two clauses, but they have other meanings. **Që** is used with the meaning of 'since', **ka ditë që s'ju kam parë** 'I haven't seen you for days (lit. 'it has days since I haven't seen you')', as a relativizer, **njeriu që shkoi atje** 'the person that went there', and before the subjunctive particle **të** to mean 'in order to' or 'so that', **nëmini që t'i mas** 'give me them so that I (can) measure them'. **Se** on the other hand has the meaning 'because' (abbreviated form of **sepse**) **S'mund të shkoj se s'kam nge** 'I can't go because I don't have time' or 'than' (see point 4 above).

8.0 Adverbs from adjectives. Adverbs are commonly derived by dropping the preposed article from the citation form from adjectives: **i mirë** 'good'--**mirë** 'well'; **i butë** 'soft'--**butë** 'softly'.

9.0 Nominal suffixes **-im, -je.** These suffixes produce nouns designating actions from verbs. **-im** is used to derive nouns from verbs whose participles end in **-uar: shkruar** 'written', **shkrim** 'writing'. **-je** is used to derive nouns from verbs whose participles end in **-ur: hapur** 'opened'--**hapje** 'opening'.

10.0 Inalienable possession. Nouns designating something whose possession is inherent to the possessor--e.g., parts of the body, relatives of the person who is the speaker or the object of discourse, etc.--often appear in the definite form without an accompanying possessive pronoun:

nëna është këtu '(my, his) etc. mother is here', **theva dorën** 'I broke my hand'.

0.6 BASIC SENTENCE STRUCTURE

In reading Albanian, the basic structure of the sentence can usually be derived by using the glosses of the individual words, the grammatical clues provided by the clitics and the endings of words, and the context of the sentence. The preferred word order is subject + verb + object, but it is not uncommon for that order to be shifted stylistically for different emphases, so this order cannot be depended on, as it can for English, to provide a first guess at the structural relations of the parts of the sentence. To understand these relationships for Albanian sentences, the reader should 1) recognize the form of the verb, 2) recognize the clitics and the case of the nominals around the verb, and 3) determine what the referent of each modifier is.

The form of the verb reveals the identity of its subject. If the form is non-active, it indicates that its surface subject would be the logical object of a corresponding active verb. Depending on context, the logical subject of a non-active verb form is either identical to its surface subject (when the meaning will be reflexive or reciprocal) or not identical (when its meaning will be intransitive or passive). It is therefore crucial to remember that non-active forms generally either have -e- preceding the verb ending or have the passive-reflexive particle **u** preceding the verb stem. At the end of this grammar a reverse dictionary is provided, which contains all the inflectional endings in alphabetical order, reading from right to left, and which may be used to expedite the identification of the particular verb form under scrutiny by the reader. The pronominal clitics preceding the verb often reveal the person and number identity of the direct and indirect objects. Since the verb endings provide person and number information about the subject, the full nominal or pronominal forms of objects and subjects (particulary in the first and second persons) often do not appear with the verb, especially in dependent clauses after they have been identified in the main clause.

As noted above, word order is free enough in Albanian to require the reader to pay attention to the case of nominals or pronominals when they do occur, if he is to interpret a sentence with accuracy. In general, in Albanian as in other languages, the nominative case is the case of the subject, the accusative case the case of the direct object, and the dative case the case of the indirect object, recipient, or referent of the action indicated by the verb. However, note that some verbs have objects in the dative case that are accusative in English (e.g., **i hipa kalit** 'I mounted [to] the horse') and that in many sentences a dative case nominal may serve as the logical subject of a non-active verb, with a nominal in the nominative case serving as the logical object:

> **Nuk i besohet ngjarja.** 'He doesn't believe the story' (literally, 'the story is not believed to him').

As for determining the referent of a particular modifier, a rule of thumb for Albanian is that a quantifying or determining modifier precedes the word or phrase it modifies, while a qualifying modifier follows. Where this is not the case, either the morphology (of adjectival articles or of adjectival stems) or the context will usually suffice for the identification of the intended referent of the modifier. In some instances, where this identification may be particularly difficult for the reader, we have glossed the whole phrase.

REVERSE DICTIONARY OF ALBANIAN ENDINGS

The following list includes the inflectional endings for nouns and verbs in Albanian and a few common stem-forming suffixes, together with a description of the syntactic information they carry. It has been compiled as a convenience to save the novice reader the task of constantly turning back to the grammar in the early stages of reading, after the basic structures of the language have become familiar, but before the all the particular endings are known thoroughly. Since it is the endings that we are concerned with here, the entries appear alphabetized in reverse order from right to left to make looking them up easier.

The following abbreviations are used in the second half of the entry to express the information the ending carries:

Ab-ablative	m-masculine
Ac-accusative	N-nominative
AD-adjectival	NM-nominal
Adm-admirative	n.a-non-active
D-dative	part-participle
def-definite	pl-plural
f-feminine	pres-present
G-genitive definite	pst.def-past
ind-indefinite indefinite	pst.ind-past

The syntactic information appears in a fixed order, beginning with the categorial label VB, NM, or AD: verbals; VB-(voice)-(mood)-tense-person-number nominals; NM-case-gender-number-definiteness nominal and adjectival stems; NM/AD-s.f-gender-number For verbs, if no voice is given, it is active; if no mood is given, it is indicative.

Note that the non-active clitic 'u' and the preposed articles for adjectives and genitives are not accounted for in this dictionary.

+a	AD-s.f-f-pl
+a	NM-N-f-sg-def
+a	NM-s.f-pl
+a	VB-pst.def-1-sg
+sha	VB-Op-pres-1-sg
+esha	VB-n.a-pst.ind-1-sg
+hesha	VB-n.a-pst.ind-1-sg
+kësha	VB-Adm-pst.ind-1-sg
+fsha	VB-Op-pres-1-sg
+ja	NM-N-f-sg-def
+ja	VB-pst.ind-1-sg
+ka	VB-Adm-pres-3-sg
+ra	NM-s.f-pl (kinds of)
+va	VB-pst.def-1-sg
+e	AD-s.f-f
+e	NM-G/D/Ab-f-sg-ind
+e	NM-s.f-pl

+kësh**e**	VB-Adm-pst.ind-2-sg
+**je**	NM-G/D/Ab-f-sg-ind
+**je**	NM-s.f(forms NM from VB)
+**je**	VB-pst.ind-2-sg
+**ke**	VB-Adm-pres-2-sg
+**te**	VB-pst.ind-3-sg
+**nte**	VB-pst.ind-3-sg
+**ve**	NM-G/D/Ab-pl
+**ve**	VB-pst.def-2-sg
+**ë**	AD-s.f-m-pl
+**ë**	NM-s.f-pl
+**ë**	VB-Sbj-pres-3-sg
+**shë**	VB-pst.def-1-sg
+**jë**	VB-Sbj-pres-3-sg
+**më**	VB-pres-1-pl
+**më**	VB-pst.def-1-pl
+**jmë**	VB-pres-1-pl
+**në**	NM-Ac-f-sg-def
+**në**	VB-part
+**në**	VB-pres-3-pl
+**në**	VB-pst.def-3-pl
+**jnë**	VB-pres-3-pl
+**rë**	VB-part
+**së**	NM-G/D/Ab-f-sg-def
+**të**	NM-N/Ac-pl-def
+**të**	VB-pst.def-2-pl
+**sh**	NM-Ab-pl-indef
+**sh**	VB-Op-pres-2-sg
+**sh**	VB-Sbj-pres-2-sg
+**esh**	VB-n.a-pres-2-sg
+**esh**	VB-n.a-pst.ind-3-sg
+**hesh**	VB-n.a-pres-2-sg
+**hesh**	VB-n.a-pst.ind-3-sg
+**fsh**	VB-Op-pres-2-sg
+**i**	NM-G/D/Ab-m-sg-ind
+**i**	NM-N-m-sg-def
+**i**	VB-pst.def-3-sg
+**emi**	VB-n.a-pres-1-pl
+**hemi**	VB-n.a-pres-1-pl
+**kemi**	VB-Adm-pres-1-pl
+**ni**	VB-pres-2-pl
+**eni**	VB-n.a-pres-2-pl
+**heni**	VB-n.a-pres-2-pl
+**keni**	VB-Adm-pres-2-pl
+**j**	VB-pres-1-sg
+**ej**	VB-n.a-pst.ind-3-sg
+**hej**	VB-n.a-pst.ind-3-sg
+**kej**	VB-Adm-pst.ind-3-sg
+**m**	VB-pst.def-1-pl
+**kam**	VB-Adm-pres-1-sg
+**em**	VB-n.a-pres-1-sg
+**hem**	VB-n.a-pres-1-sg
+**ëm**	VB-pst.def-1-pl

+im	NM-s.f(forms NM from VB)
+im	VB-pres-1-pl
+shim	VB-Op-pres-1-pl
+eshim	VB-n.a-pst.ind-1-pl
+heshim	VB-n.a-pst.ind-1-pl
+këshim	VB-Adm-pst.ind-1-pl
+fshim	VB-Op-pres-1-pl
+nim	VB-pst.ind-1-pl
+n	NM-Ac-f-sg-def
+n	VB-pres-2/3-sg
+n	VB-pst,def-3-pl
+kan	VB-Adm-pres-3-pl
+en	VB-n.a-pres-3-pl
+hen	VB-n.a-pres-3-pl
+ën	VB-pst.def-3-pl
+in	NM-Ac-m-sg-def
+in	VB-pres-3-pl
+shin	VB-Op-pres-3-pl
+eshin	VB-n.a-pst.ind-3-pl
+heshin	VB-n.a-pst.ind-3-pl
+këshin	VB-Adm-pst.ind-3-pl
+fshin	VB-Op-pres-3-pl
+nin	VB-pst.ind-3-pl
+un	NM-Ac-m-sg-def
+r	VB-part
+ur	VB-part
+s	NM-G/D/Ab-f-sg-def
+t	NM-N/Ac-pl-def
+t	VB-Op-pres-3-sg
+t	VB-pst.def-2-pl
+et	VB-n.a-pres-3-sg
+het	VB-n.a-pres-3-sg
+ët	VB-pst.def-2-pl
+ft	VB-Op-pres-3-sg
+it	NM-G/D/Ab-m-sg-def
+shit	VB-Op-pres-2-pl
+eshit	VB-n.a-pst.ind-2-pl
+heshit	VB-n.a-pst.ind-2-pl
+këshit	VB-Adm-pst.ind-2-pl
+fshit	VB-Op-pres-2-pl
+nit	VB-pst.ind-2-pl
+ut	NM-G/D/Ab-m-sg-def
+u	NM-G/D/Ab-m-sg-ind
+u	NM-N-m-sg-def
+u	VB-pst.def-3-sg

LEXIMI I PARE
(the reading first)

fjálë	words
të úrta	wise

FJALE TE URTA	PROVERBS ("wise sayings")
1. Një.	1. One.
i lágur	wet
i lagúri	the wet one
trëmbet	(he) fears
s'trëmbet	(he) doesn't fear
nga	from
shíu	the rain
I laguri s'trëmbet nga shiu.	He who is wet does not fear the rain.
2. Dy.	2. Two.
miqësía	friendship
është	is
një	a; one
shpirt	soul; spirit
në	in
dy	two
trúpa	bodies
Miqësia është një shpirt në dy trupa.	Friendship is one soul in two bodies.
3. Tre.	3. Three.
gója	the mouth
le	let (imperative)
të jétë	that (it) be
rója	the guardian
e gjúhës	(of) the tongue
Goja le të jetë roja e gjuhës,	Let the mouth be the guardian of the tongue,
e	and
gjúha	the tongue
mos	not
të réndë	that (it) race
pára	before
méndjes	the mind
e gjuha le të mos rendë para mendjes.	and let the tongue not race ahead of the mind.

LEXIMI I DYTE
(second)

gjë	thing
e	and
gjëza	riddles

GJE E GJEZA

1. Një.

jam	(I) am
një	a; one
e gjállë	alive
Jam një gjë e gjallë	I am a living thing
me	with
brírë	horns
në	on; in
bállë	forehead
Me dy brirë në ballë,	With two horns on my forehead,
dhe	and
kudó	wherever
që	that
véte	(I) go
Dhe kudo që vete,	And wherever I go,
marr	(I) take
shtëpínë	the house
vete	oneself
Marr shtëpinë me vete.	I take my house with me.

Ç'është?	What is it?
Kërmílli.	A snail. ("the snail.")

2. Dy.

kur	when
lídhin	(they) tie
më lídhin	(they) tie me
íki	(I) go
Kur më lidhin iki,	When they tie me, I go,
zgjídhin	(they) untie
rri	(I) stay; remain
Kur më zgjidhin, rri,	When they untie me, I stay,
émrin	the name
tim	my
kush	who
di	knows
ma di	knows it in respect to me
Emrin tim kush ma di?	Who knows my name?

Këpúcët.	Shoes. ("the shoes.")

3. Tre.

póçe	earthenware pot; urn
Ç'është një poçe	What is a pot

shtátë	seven
vríma	holes
Me shtatë vrima?	With seven holes?
Kóka.	The head.

LEXIMI I TRETE
(third)

fshatári	the villager
aríu	the bear

Fshatari Dhe Ariu	The Villager and the Bear
na	to us (particle in folktale expressing intimacy)
u bénë	(they) became, got
miq	friends
Një fshatar dhe një ari na u bënë miq.	Once upon a time, a villager and a bear became friends.
atá	they
vendósën	(they) decided
t'i punónin	that (they) work them
tókat	the lands
së báshku	all together
Ata vendosën t'i punonin tokat së bashku.	The decided to work the land together.
mbóllën	(they) planted
patáte	potatoes
i tha	(he) said to him
aríut	to the bear
Kur mbollën patate, fshatari i tha ariut:	When they planted potatoes, the villager said to the bear:
únë	I
do të marr	(I) will take
rrénjët	the roots
ti	you
do të márrësh	(you) will take
dégët	the branches; stalks; stems
--Unë do të marr rrënjët dhe ti do të marrësh degët.	"I will take the roots and you will take the stalks."
i pëlqéu	(it) pleased him; he liked it
shúmë	a lot; very
ky	this
mendím	thought
e pranói	(he)accepted it
Ariut i pëlqeu shumë ky mendim dhe e pranoi.	The bear liked this idea very much and agreed.
patátet	the potatoes
u rrítën	(they) grew
e	and
të mëdhá	big
Patatet u rritën e u bënë të mëdha.	The potatoes grew and got big.
i ndánë	(they) divided them
móri	(he) took
kókrrat	the heads; the kernels
Kur i ndanë, fshatari mori kokrrat dhe ariu degët.	When they divided them, the villager took the potatoes, and the bear the stalks.
u zemërúa	(he) got angry

por
kish
s'kish
të bénte
ç'të bénte
Ariu u zemërua, por s'kish ç'të bënte.

vítin
tjétër
vítin tjétër
Vitin tjetër, fshatari i tha ariut:
a
mbjéllim
përsërí
báshkë
--A mbjellim përsëri bashkë?

mírë
po
këtë
hérë
--Mirë-- tha ariu --po këtë herë ti do të marrësh degët dhe unë do të marr rrënjët.
--Shumë mirë-- tha fshatari.
atë
vit
árat
grúrë
Atë vit arat i mbollën grurë.

grúri
u bë
det
Gruri u rrit e u bë det.
kallínjtë
Fshatari mori kallinjtë, dhe ariu rrënjët.
që
ahére
u prish
në mes
Që ahere u prish miqësia në mes t'ariut e të fshatarit.

but
(he) had
(he) didn't have
that (he) was doing
what to do
The bear got angry, but there was nothing he could do. ("The bear got angry, but he didn't have what to do.")
the year
other
the next year
The next year, the villager said to the bear:
interrogative particle
(we) plant
again
together
"Shall we do out planting together again?"
fine; good; well
but
this
time
"Fine," said the bear, "but this time you will get the stalks and I will take the roots."
"Very well," said the villager.
that
year
the fields
wheat
That year they planted the fields with wheat.
the wheat
(it) became
sea
The wheat grew and became a sea.
the grains
The farmer took the grain and the bear the roots.
since
then; at that time
(it) was broken
between; in the middle
From that time on the friendship between the bear and the villager was over. ("Since then was broken the friendship between the bear and the villager").

LEXIMI I KATERT
(fourth)

DUA

Mbi bar dua të prehem,
Të këndoj të dëfrehem.
Të shoh rreth bagëtinë,
Kur hanë edhe pinë.
Të shoh fushat e blera,
Bimrat kur i fryn era,
Njerëzit kur punojnë
Dhe çupat kur këndojnë.

Ah, dua dhe lulet
Kur i shfaqin pekulet!
Dhe fluturat që venë,
Mbi 'to dua të jenë.
Bilbili t'ia thotë,
Dielli t'jet' i ngrohtë,
Pylli të gjelbërojë,
Qyqja të mos pushojë.

Dua dhe Shqipërinë,
Se atje kam shtëpinë,
Ku rrija nëpër ferrat
Dhe luaja me shqerrat.
Për këto kam dëshirë
Edh' as dua më mirë,
Veç atje dua të shkoj,
Sa të jem e sa të rroj.

DUA	I Love ("I Want")
mbi	on
bar	grass
të préhem	that I relax
Mbi bar dua të prehem,	I love to lie on the grass,
të këndój	that (I) sing
të dëfréhem	that (I) amuse myself
Të këndoj, të dëfrehem.	To sing, to enjoy myself.
të shóh	that (I) see
rreth	around
bagëtínë	the livestock
Të shoh rreth bagëtinë,	To see the animals around,
hánë	(they) eat
edhé	and
pínë	(they) drink
Kur hanë edhe pinë.	Eating and drinking.
fúshat	the fields
e bléra	green
Të shoh fushat e blera,	To see the green fields,

bímrat
i fryn
erá
Bimrat kur i fryn era,
njérëzit
punójnë
Njerëzit kur punojnë
çúpat
këndójnë
Dhe çupat kur këndojnë.
lúlet
dhe
Ah, dua dhe lulet
i shfáqin
pekúlet
Kur i shfaqin pekulet!
flutúrat
vénë
Dhe flutúrat që venë,
'to (ato)
të jénë
Mbi 'to dua të jenë.
bilbíli
thótë
t'ia thótë
Bilbili t'ia thotë,
diélli
t'jet' (të jétë)
i ngróhtë
Dielli t'jet' i ngrohtë
pýlli
të gjelbërójë
Pylli të gjelbërojë,
qýqja
të pushójë
Qyqja të mos pushojë.
Shqipërínë
Dua dhe Shqipërinë,
se
atjé
kam
shtëpínë
Se atje kam shtëpinë,
ku
rríja
nëpër
férrat
Ku rrija nëpër ferrat
lúaja
shqérrat
Dhe luaja me shqerrat.
për

the plants
(it) blows them
the wind
The plants when the wind blows them
the people
(they) work
The people when they work
the girls
(they) sing
And the girls when they sing.
the flowers
too; also; and
Oh, I love the flowers, too
(they) reveal them
the properties
When they show what they hide!
the butterflies
(they) go
And the butterflies that fly,
those
that (they) are
I love them there ("on them").
the nightingale
(he) says
sings away, ("says it to him")
For the nightingale to sing away
the sun
that (it) be
warm
The sun to be warm,
the forest
that (it) be green
The forest to be green,
the cuckoo
that (it) stop
The cuckoo not to stop singing.
Albania
I love Albania, too,
because
there
(I) have
the house
Because there I have my home
where
(I) used to stay
among
brambles; bushes
Where I would stay among the brambles
(I) used to play
the lambs
And play with the lambs.
for

kktó	these
dëshírë	desire
Për këto kam dëshirë	These I want
edh' (edhé)	and
as	not
më mírë	better
Edh' as dua më mirë	And nothing more, ("and none I want better").
veç	only
të shkoj	that (I) go
Veç atje dua të shkoj,	Only there I want to go,
sa	so long as; as much as
të jem	that (I) be
të rroj	that (I) live
Sa të jem e sa të rroj.	So long as I am and so long as I live.

Aleksander Starvre Drenova, "Dua," in Dhimitër Fullani (Ed.), Asdreni--vepra të zgjedhura, Tiranë, 1958, p. 96.

LEXIMI I PESTE
(fifth)

Konferencë Mbi Kushtetutën e Re të Shqipërisë

konferéncë	conference
mbi	on; over
kushtetútën	the constitution
e re	new; young
të Shqipërísë	of Albania
Konferencë mbi kushtetutën e re të Shqipërisë.	Conference on the New Constitution of Albania.
dáta	the date
déri në	until; up to
shkurt	February
punímet	actions; proceedings; works
zhvillói punímet	(it) conducted proceedings
kryeqytét	capital city
shkencóre	scientific; scholarly
për	for; concerning
problémet	the problems
e kushtetútës	of the constitution
Nga data 5 deri në 7 shkurt zhvilloi punimet në kryeqytet Konferenca shkencore për problemet e Kushtetutës.	From the fifth to the seventh of February the Scientific Conference concerning the problems of the constitution conducted its proceedings in the capital.
e kësaj	of this
do t'i shërbéjnë	(they) will serve
zbërthímit	the solution; analysis
të idéve	of ideas
të parímeve	of principles
themelóre	basic
projékt	draft; project; plan
projéktkushtetutës	draft constitution
Punimet e kësaj Konference do t'i shërbejnë zbërthimit të ideve dhe të parimeve themelore të Projektkushtetutës së re.	The works of this Conference will serve the analysis of basic ideas and principles of the new Draft Constitution.
në këtë	in this
u mbájtën	(they) were given, held
referát	detailed report delivered at a meeting
rreth	around; about
kumtésa	informative reports
Në këtë konferencë u mbajtën 5 referate dhe rreth 60 kumtesa.	There were five detailed reports and around sixty commentaries given at this conference.
mérrnin pjésë	(they) took part

punëtóre	workers
kooperativístë	members of cooperatives
kuádro	leader(s)
të partísë	of the (political) party
të pushtétit	of the state power; power
të gjíthë	all
rréthet	the districts
Merrnin pjesë punëtorë e kooperativistë, kuadro të Partisë e të pushtetit nga të gjithë rrethet,	Taking part were workers and cooperativists; leaders of the Party and state power from all districts;
drejtúese	administrative; directing
të dikastéreve	ministries; highest state administrative offices
qendróre	central
të institucióneve	of institutions
arsimóre	educational
kulturóre	cultural
artistíke	artistic
kuadro drejtuese të dikastereve qendrore, të institucioneve shkencore, arsimore, kulturore dhe artistike	administrative leaders of central ministries, scientific, educational, cultural, and artistic institutions
të kryqytetit,	of the capital,
ushtarákë	military men
jurístë	jurists; lawyers
veteránë	veterans
të lúftës	of the struggle, war, fight
çlirimtáre	liberational
ushtarakë, juristë, veteranë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare,	military men, jurists, veterans of the Anti-fascist National Liberation Struggle,
si dhe	as well as, ("as also")
përfaqësúes	representatives
organizátave	of organizations
të másave	of masses
si dhe përfaqësues të organizatave të masave.	as well as representatives of organizations of the masses.
hápi	opened
anëtárja	the member (feminine)
e komitétit	of the committee
drejtorésha	the director (feminine)
e institútit	of the institute
të studímeve	of studies
pránë	alongside; near
Konferencën e hapi anëtarja e Komitetit Qendror të Partisë dhe drejtoresha e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë Komitetit Qendror të Partisë Nexhmije Hoxha.	Nexhmije Hoxha, member of the Central Committee of the Party and director of the Institute of Marxist-Leninist Studies of the Central Committee, opened the conference.

pastáj
Pastaj u mbajtën referatet

afterward; then
Afterward, the detailed reports were given:

e ndërtímit
të plótë
të shoqërísë
nga
<<Kushtetutë e re--kushtetutë e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste>> nga Aranit Çela;

of the construction
complete; full
of the society
by; from
"The new Constitution--a constitution of the complete construction of the socialist society," by Aranit Çela;

organizími
projékti
<<Organizimi politik i shoqërisë socialiste në Shqipëri dhe projekti i Kushtetutës së re>> nga prof. Foto Çami;

the organization; organizing
the draft
"The political organization of the socialist society in Albania and the draft of the new Constitution," by Prof. Foto Çami;

stádi
i arrítur
shoqërór
të vëndit
<<Stadi i arritur në zhvillimin shoqëror të vëndit dhe Projektkushtetuta,>> nga prof. Hasan Banja;

the stage, phase
achieved; attained
social
of the country, place
"The stage achieved in the social development of the country and the Draft Constitution," by Prof. Hasan Banja;-

përmbájtja
rëndësía
drejt
e të dréjtave
e detýrave
kushtetúese
të shtétasve
tánë
<<Përmbajtja dhe rëndësia e të drejtave dhe e detyrave kushtetuese të shtetasve tanë,>> nga Gramoz Hysi;

the content
the importance
right
of rights
of duties
constitutional
of citizens
our
"The content and importance of the constitutional rights and duties of our citizens," by Gramoz Hysi;

disá
kryesóre
shtetërór
anëtári
dhe <<Mbi disa probleme kryesore të organizimit shtetëror,>> nga prof. Ismet Elezi.

several
main, principal
state
the member
and "On several main problems of the state organization," by Prof. Ismet Elezi.

i byrósë
politíke
sekretár
mbájti fjálën

of the bureau, office
political
secretary
(he) gave the speech, ("held the word")

e mbýlljes

of the closing

Pastaj anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë Ramiz Alia mbajti fjalën e mbylljes.

Then Ramiz Alia, member of the Political Bureau and secretary of the Central Committee, gave the closing speech.

"Konferencë mbi kushtetutën e re të Shqipërisë," Shqipëria e re, No. 2 (February), 1976, p. 3. Selection originally titled, "Konferenca shkencore për problemet e kushtetutës."

LEXIMI I GJASHTE
(sixth)

Buzë Detit të Kaltër

Stina e verës është e bukur, por më e bukur bëhet ajo për punëtorët që pushojnë. Ata vijnë grupe-grupe për të kaluar gëzueshëm pushimet në shtëpitë e çlodhjes të punëtorëve në Durrës, Vlorë, Pogradec, Dhërmi e të tjerë, në Dajt, Razëm, Korçë, Voskopojë e Llogara. E kudo shohin nga afër kushtet që u janë krijuar punëtorëve për të pushuar. Ata vijnë nga fronte të punës e prodhimit, nga të katër anët e Atdheut në dimër e në verë.

Në breg t[illegible]etit, mes bukurive të r[illegible]a [illegible]ë Vlorës, shquhen godina [illegible]shtëpisë së pushimit të punëtorëve «Asim Zeneli». Kanë ardhur e vijnë këtu qindra punonjës, rreth tre mijë në vit, nga pesëdhjetë që erdhën në vitin 1949, viti i parë i krijimit të saj.

Janë mbledhur dhjetëra punonjës nga Berati, Tepelena, Shkodra, Korça, etj. Midis tyre takohemi me minatorët Haxhi Haxhiraj, Bekim Sala, Skënder Arapi, Maze Çaushi, Bajram Sadikaj. Ata kanë ardhur këtu pasi i kanë dhënë popullit dhjetëra tonë qymyrguri më shumë nga plani.

Edhe pse vijnë nga rrethe të ndryshme ata njihen e miqësohen shpejt me njeritjetrin.

Midis tyre, përherë duke biseduar përzemërsisht, është edhe veterani Elmaz Kondi, që nuk mungon t'u

búzë lip búzë détit seacoast të káltër blue

stína the season e vérës of the summer
e búkur beautiful më more bëhet becomes
ajó it; that punëtórët the workers
pushójnë (they) take vacations; stop vínë (they) come grúpe-grúpe in groups për të kalúar in order to pass gëzueshëm happily
pushímet the vacations shtëpítë the houses
e çlódhjes of (the) relaxation; rest
të punëtórëve of, for workers e të tjérë etc.; and the others
kudó everywhere shóhin they see
nga áfër from near, at close hand kúshtet the conditions u jánë (they) are being
kríjuar created për të pushúar for vacationing frónte sectors të ndrýshme different e prodhímit of (the) production
kátër ánët the four sides; four corners
e atdhéut of the fatherland dímër winter
breg hill; coast mes amid bukuríve beauties
të rrálla rare shquhen stand out
godínat the buildings e shtëpísë së pushímit of the resort house kánë they have
árdhur come këtú here qíndra hundreds
punónjës workers míjë thousand vit year
pésëdhjetë fifty érdhën (they) came
krijímit of the creation
të saj her
mblédhur gathered dhjétëra tens

etj. etc. midís among
týre them takóhemi we are met me by; with minatórët the miners

pási because; after dhënë given
pópullit to the people tónë tons (1,000 kg. per ton) qymyrgúri coal më shúmë more nga than pláni the plan edhe pse even though rréthe districts atá they; those njíhen (they) become acquainted
miqësóhen (they) become friends shpejt soon; quickly njeritjétrin one another
përhérë constantly dúke bisedúar conversing përzemërísht cordially edhe also
që who mungón fails

tregojë më të rinjve episode nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe nga betejat për ndërtimin e socializmit. Për t'u njohur me traditat patriotike të popullit të rrethit të Vlorës në kuadrin e aktiviteteve të shumta për edukimin patriotik u organizuan dhe vizita në muzeumet e Vlorës. Të kaluarën e gjejmë në gojën e të moshuarve e në stendat e muzeumeve.

tregójë tell të rínjve to the young
më të rínjve to the younger ones
betéjat the battles ndërtímin the construction e socialízmit of (the) socialism
për t'u njóhur in order to become acquainted
tradítat the traditions të rréthit of the district kuádrin the context
e aktivitéteve of activities të shúmta numerous édukímin the education
u organizúan (they) are organized dhe also vizíta visits muzeúmet the museums
të kalúarën the past e gjéjmë we find
gójën the mouth të moshúarve of aged ones
sténdat display stands muzeúmeve of museums

"Buzë detit të kaltërt," Shqipëria e re, No. 3 (August), 1976, p. 2.

LEXIMI I SHTATE
(seventh)

Gjon Buzuku

Gjon Buzuku është autori i librit të parë, nga sa dihet, në gjuhën shqipe. Libri i tij, i titulluar «Meshari,» u botua në vitin 1555. Buzuku ishte prift katolik, famulltar i një kishe. Ishte nga Shqipëria veriore, se vepra është shkruar në dialektin geg.

Nga ky libër i parë i letërsisë shqipe njihet vetëm një kopje. Ruhet në Bibliotekën e Vatikanit. Libri është shkruar në alfabetin latin.

Libri përmban lëndë të ndryshme fetare: meshët e të kremteve kryesore të vitit, copë të Ungjillit; shkurt, pjesët që i nevojiten priftit në praktikën e përditshme të shërbimeve fetare. Inisiativa e Buzukut që merr e përkthen pjesë liturgjike, është orvatje e qartë për të futur gjuhën shqipe në shërbimet fetare katolike.

Ndjenjat patriotike të Buzukut shihen jo vetëm me përpjekjen për të futur gjuhën shqipe në shërbimet fetare katolike dhe në vetë idenë e të shkruarit të një libri shqip në kushtet e rënda të shekullit të parë të pushtimit turk, po shprehen edhe në mënyra të tjera, herë çiltazi, herë tërthorazi. Ai është i frymëzuar me dashuri për shqipen dhe popullin shqiptar.

Vepra e Buzukut na shfaqet me një gjuhë mjaft të përpunuar, me fjalor relativisht të pasur, me ortografi të stabilizuar e konsekuente, rezultat i

autóri the author
i líbrit of the book të párë first nga sa díhet as far as is known gjúhën shqípe the Albanian language i tij his
i titullúar titled Meshári the Missal
u botúa was published íshte was prift priest famulltár vicar kíshë church
verióre northern vépra the work
shkrúar written dialéktin geg the Gheg dialect
líbër book
i letërsísë of literature njíhet is known
vétëm only kópje copy rúhet is kept
bibliotékën the library e Vatikánit of the Vatican
alfabétin the alphabet
përmbán contains lëndë material
të ndrýshme various fetáre religious
méshët the masses e të krémteve of the holidays kryesóre chief; main të vítit of the year cópë portions të Ungjíllit of the Bible shkurt in short pjésët the parts që i nevojíten that (they) are needed príftit by the priest praktíkën performance e përdítshme daily të shërbímeve of the services inisiatíva the initiative që merr who takes përkthén translates liturgjíke liturgical orvátje attempt e qártë clear për të fútur to introduce ndjénjat feelings shíhen are seen jo not përpjékjen the effort

vétë idénë the idea itself
e të shkrúarit of the writing të një líbri of a book kúshtet the circumstances
e rénda difficult pushtímit the occupation
turk Turkish shpréhen are expressed edhe also mënýra ways të tjéra other hérë at times çíltazi openly; directly
tërthórazi indirectly i frymëzúar inspired

na to us shfáqet presents itself
mjaft të përpúnuar considerably developed; refined fjalór vocabulary
relativísht relatively të pásur rich
ortografí spelling të stabilizúar stabilized konsekuénte consistent
rezultát the result

traditës letrare të mëparshme
të shkrimit shqip dhe i punës
së vetë autorit. Vepra ka
rëndësi të veçante për
shqipen: ajo jep material të
begatshëm për historinë e
gjuhës sonë, për gramatikën
dhe historinë e gjuhës
letrare. Ky material formon
pikënisjen e sigurtë për të
ndjekur në mënyrë të
dokumentuar zhvillimin e
shqipes.

Rëndësia e «Mesharit»
të Buzukut qëndron jo vetëm në
vlerën e tij gjuhësore e
historike-letrare, si libër i
parë i botuar shqip, monumenti
i madh i periudhës së parë të
shkrimit të ghuhës sonë dhe si
vepër e parë e letërsisë sonë,
po edhe me udhën që hapi, me
traditën e re që duhet të ketë
krijuar.

Më poshtë jepet një copë
e pasthënies që shkroi Buzuku
për veprën e tij.

...Tani unë dua të
përfundoj veprën time...E nisa
më 20 mars 1554 dhe e mbarova
më 5 janar 1555. Dhe, në
ndodhtë të kem gabuar në
ndonjë vend, unë dua dhe lutem
që aty ku të jetë gabim, atë
gabim ai që të jetë më i ditur
se unë, ta ndreqë. Sepse nuk
çuditem në paça gabuar, duke
qënë kjo më e para vepër dhe
shumë e vështirë për t'u
punuar në gjuhën tonë (dhe)
sepse ata që e shtypnin,
kishin mundim të madh dhe nuk
mund t'ia qëllonin pa bërë
gabime; me që unë, nuk mund të
gjendesha përherë pranë tyre...
Dhe tani unë ju falem të
gjithëve...

i tradítës of the tradition letráre
literary të mëpárshme previous të
shkrímit of the writing i púnës of the
work së vétë autórit of the author him-
self rëndësí importance të veçántë
special jep gives të begátshëm abundant
sónë our e gjúhës sónë of our language
gramátikën the grammar
formón marks
pikënísjen the point of departure
e sigúrtë definite; sure të ndjékur pur-
sued në mënýrë të dokumentúar in a docu-
mented manner zhvillímin the development
e Meshárit të Buzúkut of Buzuku's Missal
qëndrón rests
vlérën the value gjuhësóre linguistic
si as
i botúar published
i madh great i periúdhës së párë of the
first period
vépër work
údhën the road që hápi that (it) opened
e re new dúhet must të kétë have ("that
it has")
më póshtë below jépet is given
e pasthénies of the epilogue shkrói (he)
wrote e tij his
taní now
të përfundój to conclude tíme my e nísa
(I) began it mars March e mbaróva (I)
finished it janár January në if
në ndódhtë if it happens të kem that (I)
have gabúar erred ndónjë some lútem
(I) pray . atý ku where të jétë is
gabím error átë that ai he që të jétë
who is më more i dítur learned ta
ndréqë corrects it sépse because çudítem
(I) am surprised në páça gabúar if I have
erred dúke qénë kjo this being më e pára
the very first vështírë difficult për
t'u punúar to work with it tónë our ató
që those who shtýpnin (they) printed
kíshin had mundím trouble nuk mund could
not qëllónin accomplish it; hit it bérë
making me që since të gjéndesha be
përhérë always pránë alongside; near ju
fálem I greet you të gjíthëve to everyone

"Gjon Buzuku," Dhimitër S. Shuteriqi et al. (Eds.), Historia e letërsisë shqipe, I, Tiranë, 1959, p. 187 ff.; A. Xhomo and Dh. Qirjazi, Antologjia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1972, p. 5.

LEXIMI I TETE
(eighth)

Vendi i Shkrimtarëve të Rilindjes në Shqipërinë Socialiste.	véndi the place i shkrimtárëve of the writers të Rilíndjes of the Rebirth, basically from 1878 to 1912, the reawakening of Albanian nationalism.
Epoka e Rilindjes është një epokë revolucionare demokratike me shumë rëndësi në historinë dhe letërsinë e popullit tonë, është një epokë e ndritur e udhëhequr nga idetë iluministe, nga njerëzit tanë të shquar të asaj periudhe, që me të drejtë është quajtur Rilindja e kombit, dalja nga errësira mesjetare-feudale-imperialiste në dritë, në kryengritje, në luftë për liri, pavarësi, demokraci, për dritë dhe arësim.	epóka the era e ndrítur shining udhëhéqur guided idétë ideas iluminíste illuminative njérëzit the people të shqúar distinguished të asáj of that periúdhe period e dréjtë right; correct me të dréjtë rightfully qúajtur called e kómbit of the nation dálja the emergence nga from errësíra the darkness mesjetáre medieval feudále feudal në into drítë light kryengrítje revolution lirí freedom pavarësí independence arësím education Rilíndasit the people of the Rebirth të víhen be placed kur when; in which jetúar lived
...Rilindasit tanë duhet të vihen drejt në epokën kur kanë jetuar, punuar dhe luftuar, duhet të vihen në dukje idetë e tyre, të cilat ishin prodhimi i zhvillimit të shoqërisë së asaj epoke, duhet të vihen në dukje qëllimet e tyre ku synonin imediatisht dhe në perspektivë. Po të shtrohen gjërat kështu drejt, do të dalë se rilindasit ishin njerëz të shquar me ide përparimtare, ishin iluministë revolucionarë, të guximshëm dhe me një atdhedashuri të zjarrtë. Ata luftuan me pushkë e me pendë për lirinë dhe pavarësinë e popullit, për zgjimin e tij. Të gjitha këto janë anët pozitive të tyre, të cilat janë të mëdha. Të gjitha këto veti dhe karakteristika të epokës së Rilindjes dhe të rilindasve ne duhet t'ia japim popullit.	luftúar struggled në dúkje into the open idétë ideas të cílat which íshin (they) were prodhími the product i zhvillímit of the development qëllímet the goals synónin they aimed imediatísht immediately po të if shtróhen are set forth gjérat the things kështú thus; in this way do të dálë it will come out idé ideas përparimtáre progressive iluminístë illuminists të guxímshëm valiant; brave atdhedashurí love of the country të zjárrtë fiery luftúan they fought púshkë gun péndë pen lirínë the freedom pavarësínë the independence zgjímin e tij (their) awakening të gjíthë këtó all of these jánë (they) are ánët sides pozitíve positive të týre their të mëdhá considerable; big vetí traits karakterístika characteristics të epókës of the era të rilíndasve of the people of the Rebirth jápim (we) present; give t'ia jápim that (we) present them to them
Por nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se po këta rilindas kanë anët e tyre negative, që duhet	nuk dúhet must not të harrójmë that (we) forget asnjé not one çast moment këtá these po këtá these very

t'i nënshtrohen kritikës sonë marksiste-leniniste. Këto dobësi qëndrojnë në botëkuptimet e tyre filozofike, të cilat janë idealiste. Ky është një bagazh i rëndë, është filozofia e epokës së tyre, që është në kontradiktë dhe në luftë me ideologjinë tonë.

Të heshtim për këtë antagonizëm, për këtë luftë të pamëshirshme për jetë a për vdekje që zhvillojmë ne marksistët kundër filozofisë idealiste, kundër fesë dhe besimeve fetare? T'i konsiderojmë ata të paprekshëm, tabu, vetëm për faktin se janë rilindas? A mund të bashkekzistojmë në një kohë që nga një anë luftojmë me rreptësi teologjinë, fenë kishat dhe xhamitë, priftërit, hoxhallarët, dhe, nga ana tjetër, të ekzaltojmë atë pjesë të veprës së Naimit ku ai shpreh filozofinë e tij bektashiane, ose të Mjedës, ku flet për teologjinë kristiane; ose të Çajupit, ku thotë, për shembull, se Baba Tomori ishte froni i perëndisë, etj. dhe të gjitha këto t'ia japim ushqim ideologjik popullit vetëm pse këta janë rilindas, janë njerëz të mëdhenj, kanë hedhur bazat dhe ndihmuar në lëvrimin e gjuhës, pse vargjet e tyre poetike janë të bukura e kanë krijuar figura të këndshme?

Jo, si marksistë dhe për interes të popullit e të socializmit, ne duhet t'i luftojmë këto anë negative. Në ideologji nuk mund t'i bëjmë koncesion vargut ose gjuhës.

t'i nënshtróhen submit themselves
kritíkës to the criticism
dobësí weaknesses qëndrójnë appear; are; center botëkuptímet world outlooks
filozofíke philosophical

një bagázh i rëndë a heavy load

kontradíktë contradiction

të héshtim should (we) keep silent

të pamëshírshme merciless jétë life
vdékje death zhvillójmë (we) develop
kúndër against
fésë the religion
besímeve the beliefs
konsiderójmë (we) consider atá them; those
të paprékshëm untouchable tabú taboo
fáktin se the fact that
mund can bashkekzistójmë (we) coexist
kóhë time nga një ánë on the one hand
rreptësí severity fénë the religion
kíshat the churches xhamítë the mosques
príftërit the priests hoxhallárët moslem priests të ekzaltójmë that (we) exalt
të véprës of the (literary) work Naímit of Naim (the national poet of Albania, Naim Frashëri) bektashiáne Bectashian
bektashízëm a Moslem sect osé or të Mjédës of Mjeda (Ndre Mjeda, Albanian poet) flet speaks shémbull example
Babá Tomóri Father Tomori (mountain in Albania) fróni the throne i perëndísë of God ushqím food vétëm pse only because
njérëz men
të mëdhénj great hédhur established
bázat the bases, foundations ndihmúar helped lëvrímin the nurturing várgjet the verses të búkura beautiful
i këndshëm pleasing
si as; like; how

t'i luftójmë that (we) fight them

t'i bëjmë that (we) make to it várgut to the verse gjúhës to the language

---

Excerpt from Enver Hoxha's address, "Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë," given on March 7, 1968, Antologjia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1972, pp. 19-20.

LEXIMI I NENTE
(ninth)

Kronikë Kulturore	kronikë chronicle
Zhvilloi në Tiranë punimet simpoziumi për problemet e romanit shqiptar të realizmit socialist, organizuar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të RPSH dhe Fakulteti i Histori-Filologji i Universitetit të Tiranës.	zhvillói conducted; developed simpoziúmi the symposium e románit of the novel shqiptár Albanian të realízmit of realism zhvillói në Tiránë...të realízmit socialíst the symposium on problems of the Albanian novel of socialist realism held its proceedings in Tiranë Lídhja the league i Gjuhësísë of linguistics së Shkéncave of sciences RPSH (Republíka Popullóre e Shqipërísë), People's Republic of Albania të RPSH of the RPSH fakultéti the department i Historí-Filologjí of history and philology
Merrnin pjesë studiues e punonjës të shkencës, kritikë, shkrimtarë dhe punonjës të tjerë të kulturës.	studiúes students të shkéncës of science punónjës të shkéncës scholars të kultúrës cultural; of culture
Ndodheshin gjithashtu anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë Ramiz Alia, ministri i Arsimit e i Kulturës Thoma Deliana, anëtarja e Komitetit Qendror të Partisë Fiqret Shehu, kryetari i Akademisë së Shkencave të RPSH Aleks Buda dhe shokë të tjerë.	ndódheshin there were gjithashtú also anëtári the member mínistri the minister i Arsímit of education kryetári the chief, head shókë comrades të tjérë other
Ndodheshin gjithashtu kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës Azem Shkreli, kritiku letrar Ali Aliu dhe shkrimtari Nazmi Rahmani.	i Shoqátës of the Society Krahínës of the province Autonóme autonomous të Kosóvës of Kossovo, the Albanian populated region of Yugoslavia kritíku the critic
Në referatin e mbajtur nga zëvendësdrejtori i Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë Koço Bihiku dhe në 20 kumtesat që u lexuan në këtë simpozium, u ndriçuan një varg problemesh të zhvillimit të romanit tonë të sotëm, si çështja e zgjerimit të temës aktuale, çështja e heroit pozitiv, e pasurimit të brendisë ideore e të formës	referátin the main report; lecture e mbájtur given zëvendësdrejtóri acting director kumtésat informative reports; papers u lexúan were read u ndriçúan were brought to light varg series problémesh of problems të sótëm of today si like; as çështja the question; issue e zgjerímit of the expansion të témës of the theme aktuále current e heróit of the hero pozitív positive e pasurímet of the enrichment të brendísë of the content ideóre ideational të fórmës of the form

së romanit etj., dhe u	së románit of the novel
përcaktuan disa nga detyrat	u përcaktúan were defined detýrat the
që dalin në të ardhshmen.	tasks; duties dálin come up; emerge
Në fund foli edhe	të árdhshmen the future fund end fóli
kryetari i Lidhjes së	spoke i Lídhjes of the League
Shkrimtarëve e të Artistëve	
të Shqipërisë Dritëro Agolli.	

* * * *

Në një nga sallat e	sállat the halls
e Pallatit të Kulturës në	e Pallátit of the Palace
Tiranë, u zhvilluan punimet	u zhvillúan were conducted, developed
e seminarit kombëtar me temë:	e seminárit of the seminar
«Për një thellim të	témë theme thellím deepening
mëtejshëm të fizionomisë dhe	të mëtéjshëm further të fizionomísë of the
të karakterit kombëtar të	physiognomy; external aspect; features
baletit e koregrafisë sonë»,	të karaktérit of the character të balétit
organizuar nga Ministria e	of the ballet të koreografísë of the cho-
Arsimit dhe e Kulturës e	reography
Lidhja e Shkrimtarëve dhe e	
Artistëve të Shqipërisë.	
Merrnin pjesë koreografë	koreográfë choreographers
dhe baletmaestra, kompozitorë,	baletmaéstra ballet masters kompozitórë
piktorë, studiues e kritikë	composers piktórë painters kritíkë
punonjës të shtëpive të	critics të shtëpíve of the houses
kulturës e të krijimtarisë	të krijmtarísë of the creativity
popullore të rretheve etj.	të rrétheve of the districts
Ndodheshin gjithashtu	
anëtarja e Komitet Qendror të	
Partisë Nexhmije Hoxha,	
kryetari i Lidhjes së	
Shkrimtarëve dhe Artistëve të	
Shqipërisë Dritëro Agolli etj.	
Mbi punën e kryer dhe mbi	pínën the work e krýer completed; done
detyrat për të ardhshmen dha	dha gave
një raport kompozitori Simon	rapórt report
Gjoni.	
Pastaj pjesëmarrësit	pjesëmárrësit the participants
zhvilluan diskutime mbi	zhvillúan carried out; conducted diskutíme
probleme të ndryshme që u	discussions
ngritën rreth koreografisë	ngrítën were raised
sonë të realizmit socialist.	

* * * *

Presidiumi i Akademisë së	Presidiúmi the Presidium
Shkencave të RPSH, pas një	pas after
diskutimi të gjerë me	diskutími discussion të gjérë broad
institucionet dhe punonjësit	punónjësit workers

shkencorë të interesuar, vendosi që në muajin maj të vitit 1976 të zhvillohet në Tiranë konferenca kombëtare e studimeve etnografike.

Në referatet dhe në shumë kumtesa që do të mbahen në konferencë, do të vihen në dukje lashtësia dhe pasuria e traditave tona, uniteti dhe larmia e tyre, huazimet reciproke me kulturat e popujve të tjerë, si dhe problemi i zhvillimit të mëtejshëm të kulturës sonë popullore në kushtet e ndërtimit të socializmit.

shkencórë scientific
punónjësit shkencórë scholars
të interesúar interested vendósi decided
múajin the month maj May të zhvillóhet that it be convened studímeve studies
etnografíke ethnographic referátet the main reports; lectures do të mbáhen will be held
lashtësía the antiquity pasuría the wealth
e tradítave of the traditions unitéti the unity larmía the variety huazímet the borrowings recipróke reciprocal
kultúrat the cultures e pópujve of peoples
si dhe as well as

kúshtet the conditions

Excerpt from "Kronikë kulturore," Shqipëria e re, monthly newspaper, Tiranë, March, 1976, p. 3.

LEXIMI I DHJETE
(tenth)

Pavarësia e Shqipërisë

Shqipëria u shpall shtet më vete ditën e 28 Nëntorit 1912 pas qindra vjet vuajtjesh e mjerimesh nën robërinë turke.

Përpjekjet e vazhdueshme për liri u kurorëzuan me ngritjen e flamurit në Vlorë nga plaku Ismail Qemali me 28 Nëntor.

Kjo ka qënë një ngjarje e madhe historike për vendin e për popullin tonë, që s'pushoi së luftuari për liri.

Shqipëria vërtet që u çlirua nga zgjedha turke, por populli nuk e gëzoi dot si duhej këtë liri, sepse prapë nuk shpëtoi nga shtypja e shfrytëzimi prej bejlerëve dhe agallarëve të vendit. Këta e shtypnin fshatarin sikurse në kohë të pushtonjësit turk, me të cilin ishin mësuar të bashkëpunonin kundër popullit.

Sidoqoftë, 28 Nëntori për për ne ka rëndësi të madhe, sepse që nga ajo ditë vendi ynë u njoh nga shtetet e tjera si shtet më vete dhe i lirë.

Më 28 Nëntor 1912 populli ynë shpëtoi vetëm nga robëria e turqëve; prandaj atij iu desh që të bënte edhe shumë përpjekje të tjera për të shpëtuar nga shfrytëzimi prej bejlerëve dhe agallarëve. Kësaj dite ai mundi t'ia arrijë vetëm 32 vjet më vonë, d.m.th. më 29 Nëntor 1944.

pavarësía the independence

u shpall was declared shtet state
më véte independent dítën (on) the day
e 28 Nëntórit of November 28th qíndra vjet
hundreds of years vúajtjesh of sufferings
mjerímesh of deprivations nën under
robërínë captivity; domination përpjékjet
efforts e vazhdúeshme continual
u kurorëzúan were crowned ngrítjen the
raising e flamúrit of the flag Vlórë
Vlorë, city on the southwest pláku the old
man kjo this ka has qënë been
ngjárje event e mádhe great véndin the
country s'pushói didn't stop
së luftúari the fighting
vërtét it's true
u çlirúa was liberated zgjédha the yoke
e gëzói enjoyed it dot at all
si dúhej as it should have práپë once
shtýpja the oppression
shfrytëzími the exploitation prej of, by
bejlérëve big landlords agallárëve small
landlords të véndit of the country
e shtýpnin oppressed him fshatárin the
peasant sikursé the same as të
pushtónjësit of the occupier me të cílin
by whom mësúar taught të bashkëpunónin
(they) collaborated sidoqóftë at any rate
ne us që since ajó that dítë day
ýnë our u njoh was recognized shtétet
the states i lírë free

robëría the domination
e túrqëve of the Turks prandáj that is
why atíj iú desh it was necessary for it
të bënte to make édhe still shúmë many;
very; more të shpëtúar to escape

múndi was able to t'ia arríjë to attain
it më vónë later d.m.th. (domethénë)
that is to say

Ditë Pranvere	pranvére spring
Dita gdhihet, çel agimi, Derhet drita porsi ar, Zhduket nata, shkon qetimi, Dielli rrezet si burimi I çon poshtë porsi zjarr.	díta the day gdhíhet breaks çel appears agími the dawn dérdhet pours dríta the light pórsi like ar gold zhdúket disappears náta the night shkon goes away qetími tranquility, stillness rrézet the rays si burími like a source, spring i çon sends them póshtë down zjarr fire
Ndriten kodrat, fshati zgjohet, Lumi qiellin pasqyron, Fusha, bregu ngjyra ndrrohet, Fletët dridhen, era ngrohet; Shkëmbi majën zbardhëllon.	ndríten brighten up kódrat the hills zgjóhet awakens lúmi the river qiéllin the sky pasqyrón mirrors fúsha the plain brégu the foothill ngjýra the color ndrróhet changes flétët the leaves drídhen tremble ngróhet warms up shkëmbi the rock májën the tip zbardhëllón whitens
Fushës zbresin tatëpjetë Punëtorët në mëngjes, Nëpër arat porsi bletë, Kush me vegël kush me qetë, Me peqinjtë përmbi brez.	fúshës to the plain zbrésin they descend tatëpjétë downward mëngjés morning nëpér among árat the fields blétë bee; bee colony kush one; who végël tool qétë oxen peqínjtë hems; shirttails përmbí over brez belt
Vjen mesdita, grat' u shpien Buk' e gjellë me ç'u ndodh, Nënë hije, rrethe shtrihen, Hanë drekë, çlodhen, bien, Pastaj nisin punën mbrodh.	mesdíta the midday grat'=grátë the women u shpíen take to them buk'=búkë bread gjéllë food ç'u ndodh whatever there is nënë under híje the shade rréthe around shtríhen (they) lie hánë (they) eat drékë lunch çlódhen (they) rest bíen (they) fall nísin (they) begin púnën the work mbrodh productive; fruitful
Hijes gjethit miza grera, Zëri i zoqve rreth tingllon, Del gjahtari nëpër ferra, Vjen bariu plot me shqerra, Bujku çmallet e këndon.	híjes in the shade gjéthit of the foliage míza gréra the wasp zéri the voice i zóqve of the birds tingllón=tingëllón rings del comes out gjahtári the hunter férra the brambles vjen comes baríu the shepherd plot full shqérra lambs bújku the farmer çmállet quenches (his) longing këndón sings

Dita ngryset, vjen pushimi;	ngrýset sets into dusk pushími the rest;
Dielli unjet shkon në vend,	čalmness únjet descends në vend to (its)
Zhduket drita, erdh qetimi,	place erdh=érdhi came
Hëna rrezet si burimi	hëna the moon
I derth poshtë si ergjënd.	i derth pours them ergjënd silver

"Pavarësia e Shqipërisë," Abetare, Tiranë, 1958, pp. 203-204.

"Ditë pranvere," Dh. Fullani, Asdreni--vepra të zgjedhura, Tiranë, 1958, pp. 93-94. Selection partially abbreviated. Orthography revised to conform to standard literary Albanian.

LEXIMI I NJEMBEDHJETE
(eleventh)

Jetë e Re Për Familjen e Selmanit	famílje family e Selmánit of Selman
Ishte një ditë janari e vitit 1936. Të ftohtët e hidhur ta thante fytyrën. Në kasollen e ftohtë të Selmanit dëgjohej një zë foshnje, që sapo kish lindur. Ish fëmija e parë e Selmanit, një djalë i shëndetshëm.	të ftóhtët the cold i hídhur bitter thaj freeze; dry fytýrë face kasóllë hut i ftóhtë cold dëgjój hear zë voice fóshnje of a baby sápo just línd be born fëmíjë child djálë boy i shëndétshëm healthy
--Qoftë me jetë të gjatë e me këmbë të mbarë!-- e uroi një shok, që mori vesh lindjen e djalit prej vetë Selmanit, të cilin e takoi duke shkuar në punë. Kështu e uruan dhe e përgëzuan edhe farefisi e miqtë, që i erdhën Selmanit ato ditë për urim.	qóftë i gjátë long këmbë foot i mbárë lucky Qóftë...të mbarë May it live long and prosper urój congratulate shok buddy marr vesh hear of; ("take ear") líndje birth vétë himself takój meet dúke while shkúar going në to kështú in this way përgëzój congratulate farefís relatives míqtë the friends urím congratulation
Vetëm Menduh beu, që banonte në një shtëpi të madhe pak më poshtë, nuk e uroi Selmanin, që e kish shërbëtor prej kaq vjetësh, dhe as që e përfilli ta pyesë një herë në se i kish lindur gjë ose jo.	béj bey, title of the landlord banój live shtëpí house pak a little póshtë down shërbëtór servant që e kish shërbëtór who was his servant kaq so many vjétësh years as neither; nor; not përfíll take notice pýes ask në se...ose jó whether...or not
Në kasollen e varfër vërtet që hyri gëzimi, por bashkë me gëzimin tani u shtuan edhe brengat.	i várfër poor hýri entered gëzím joy shtoj increase bréngë trouble
Selmani tërë ditën e ditës punonte dhe copëtohej në shtëpinë e beut. Mbarte dhe çante dru, mbushte ujë, i mbante beut kalin, kur ky dilte për gjah dhe kryente një mijë e një punë të tjera. Edhe e shoqja, Zylfia, shërbente tash një vit si shërbëtore në shtëpi të beut.	tërë entire; whole dítën e dítës the livelong day copëtóhej knocked himself out mbárte (he) carried loads çaj split dru wood mbúsh fill újë water kálin the horse dílte went out gjah hunt krýej do; complete púnë chore; job shóqe wife; female companion e shóqja his wife shërbéj serve tash now
Ata, duke punuar të dy te beu, mezi siguronin kafshatën e gojës. Burr' e grua ishin në mëshirë të beut. Por tani që u bënë vet' i tretë, si do të bëhej halli? A do ta rritnin dot Tajarin duke	te at të dy both mezí barely sigurój secure kafshátë bite kafshátën e gójës livelihood búrrë husband grúa wife; woman mëshírë mercy vet' (vétë) person vet' i trétë a threesome bëj do, make hall trouble si do të bëhej hálli how would they handle their

qëndruar si shërbëtorë të beut?

Zylfia edhe s'kish mbushur mirë tri ditë që kish lindur, kur zonja e beut ia filloi të sharave me Selmanin; ajo iu kërcënua atij duke i thënë: «Thirr gruan të na lajë rrobat, ndryshe ju nxora nga kasollja!» ...Desh s'desh, Zylfia shkoi ashtu me shpirt ndër dhëmbë dhe lau rrobat e zonjës dhe të beut.

Në mbrëmje, kur vinte në shtëpi, Selmani, duke përkëdhelur fëmijën e tij të dashur, futej thellë e më thellë në mendime. Nuk kishte me se ta ushqente si duhej, nuk kish as me se ta vishte, se s'kish të vishte as gruan as veten e vet. Familja e tij ndodhej në mëshirë të beut e të zonjës së tij dhe jetonte si mos më keq me atë që i jepte beu.

Selmani doli partizan dhe luftoi për liri.

situation rrit raise do ta rríttnin dot would they be able to raise it qëndrúar staying Zylfía...líndur three days had barely passed since Zylfia had given birth zónjë wife; mistress of the house fillój begin të shárave the scoldings; insults; quarreling kërcënój threaten dúke i thënë telling him thirr call laj wash rróba clothes ndrýshe otherwise; different ju nxóra I will kick you out, ("(I) kicked you out") desh wanted desh s'desh whether she liked it or not ashtú so to speak ndër at dhëmbë teeth me shpirt ndër dhëmbë reluctantly e zónjës of the mistress mbrëmë evening vínte (he) went dúke përkëdhélur caressing i dáshur dear fut plunge théllë deep mendím thought, ushqéj feed dúhej was necessary nuk kíshte...dúhej he didn't have enough to feed her vesh clothe, dress someone as...as neither...nor véten self i vet his own ndódhej existed; was jetój live keq bad, evil si mos më keq miserably jap give dóli went out and became partizán partisan

* * * *

Kaluan 10 vjet.

Erdhi janari i vitit 1946. Era e ftohtë dhe shiu të thanin fytyrën po ashtu si në janar të vitit 1936. Dimri është dimër dhe bën punën e vet, por punët e tjera ndryshuan. Më 12 janar në «Çiflikun e Ri» erdhi lajmi se Shqipëria u shpall Republikë Popullore. Lajmin e ri e dëgjoi i madh e i vogël, e dëgjoi edhe Selmani me të shoqen, por edhe Tajari, që tani mbushte 10 vjet.

Kishin ardhur kohë të tjera. Selmani dhe familja e tij kishin shpëtuar tanimë nga thonjtë e Menduh beut. Megjithëse banonin edhe në kasolle, ata, si gjithë

kalój pass vjet years
érdhi came
shí rain

púnët matters
ndryshói changed
çiflík estate i ri new lájm news

árdhur come

shpëtój escape tanimë by this time, now
thonj nails, claws, paws
megjíthëse though

populli e ndjenin veten si të rilindur, ata ishin çliruar për gjithmonë nga çifligarët bejlerë e agallarë. Selmani po fillonte një jetë të re, të lirë me tokën që merrte sipas reformës agrare. Dhe gjithë këto ndryshime në familjen e varfër të Selmanit, sikurse në gjithë vendin tonë, u bënë të mundshme, sepse tani ishte pushteti popullor në fuqi, i udhehëqur nga Partia.

Këto ndodhnin në janarin e vitit 1946.

ndjej feel
i rilíndur reborn
çlirúar freed; liberated
gjíthmonë always
çifligár estate owner; landlord

tókë land
mérrte (marr) was receiving; taking on
sipás according to
refórmë reform
agrár agrarian

i múndshëm possible
pushtét (state) power
fuqí authority
i udhehéqur guided; led
ndódh happen; occur

"Jetë e re për familjen e Selmanit," Abetare, pp. 204-205. Reprinted in abbreviated form. Selection originally entitled "Brigadieri 20-vjeçar."

LËXIMI I DYMBEDHJETE
(twelfth)

Shqipëria dhe Bota e Jashtme	bótë world jáshtëm outside
Në degën e arteve në Universitetin e Vensenës u organizua për disa ditë shfaqja e filmave shqiptare «Operacioni zjarri», «Mëngjese lufte», «Ata quheshin arbër» e filma të tjerë dokumentarë, të cilët u ndoqën me interesim të madh nga studentët dhe pedagogët.	dégë branch; department; field art art e Vensénës of Vincennes (France) shfáqje showing film film operacióni operation lúftë struggle qúaj call árbër Albanians (an older name) dokumentár documentary u ndóqën (ndjek) were followed interesím interest studént student pedagóg educator

* * * *

Me rastin e botimit të Projektkushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, kryesia e Shoqatës së Miqësisë Itali-Shqipëri organizoi këto ditë në selinë e saj në Romë një mbledhje, në të cilën morën pjesë shumë miq e aktivistë të Shoqatës, profesorë, juristë, gazetarë, punëtorë dhe studentë.	rast occasion botím publication kryesi leadership shoqátë society; association miqësí friendship Italí Italy selí grounds; premises mblédhje meeting mórën (marr) took aktivíst activist profesór professor jurist jurist gazetár newspaperman
Mbledhjen e çeli zëvendës-presidenti i Shoqatës Artur Foski dhe pastaj miqtë e vendit tonë avokat Kavalieri, juristët Mirela e Xhiovana Lombardi, që vizituan vendin tonë vitin e kaluar, si dhe miku Ubaldo Butafava, komentuan nenet e ndryshme të Projektkushtetutës, duke u ndalur kryesisht në parimet themelore të saj.	çel open zëvéndës acting; deputy avokát lawyer vizitój visit i kalúar past; passed komentój comment on nen article ndal stop kryesísht chiefly; mainly parím principle
Pjesëmarrësit e ndoqën me vëmendje të madhe këtë diskutim dhe përshëndetën me entuziazëm popullin shqiptar për këtë fitore të shkëlqyer në konsolidimin e zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist dhe në mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së vendit.	pjesëmárrës participant ndóqën followed vëméndje attention përshëndés greet entuziázëm enthusiasm pópull people fitóre victory i shkëlqýer shining; brilliant konsolidím consolidation i mëtéjshëm further revolución revolution mbrójtje defense pavarësí independence

* * * *

Ditët e fundit, Shoqata e Miqësisë Suedi-Shqipëri dhe Shtëpia botuese «Oktobër» organizuan në qytetin Malmoe një mbledhje, në të cilën morën pjesë anëtarë të Shoqatës, miq e simpatizantë të vendit tonë, punëtorë, studentë etj. Miku i vendit tonë, Per Ake Lindblom, duke u mbështetur në materialet e vëllimit të 19të të Veprave të shokut Enver Hoxha, foli në mbledhje mbi luftën e Partisë sonë kundër revizionizmit hrushovian. Pastaj foli për Projektkushtetutën, për idetë e saj kryesore dhe për diskutimet masive që po bëhen në vendin tonë për këtë.

Pas tij fjalën e mori miku i vendit tonë Karl Magnus Edenbrand, i cili foli për sukseset e arritura në fushën e mjekësisë dhe për kujdesin e madh që tregohet në vendin tonë për shëndetin e popullit.

Pjesëmarrësit treguan interes dhe pati mjaft pyetje e diskutime mbi problemet për të cilët folën dy miqtë e vendit tonë.

Në fund për të pranishmit u shfaq një film dokumentar, si dhe u projektuan një seri diapozitivash me pamje të ndryshme nga jeta në vendin tonë.

fund end dítët e fúndit recently; lately
Suedí Sweden
botúes publishing Októbër October
qytét city

simpatizánt sympathizer

dúke u mbështétur relying materiál material
vëllím volume të 19të nineteenth
të shokut Enver Hoxha of comrade Enver Hoxha, leader of the Albanian communist party since 1941 revizionízëm revisionism
hrushovián Krushchevist

diskutím discussion masív massive
që po bëhen which are being made për
këtë about this pas after tij him
fjálën e móri took the floor

sukséset success i arrítur attained
fúshë field; plain mjekësí medicine
kujdés care tregój show
shëndét health

interés interest páti had mjaft enough
pýetje question páti mjaft pýetje there were quite a few questions fólën (flas) spoke
i pranishëm present për të pranishmit for those present shfaq show
projektój show; project serí series
diapozitív slide pámje scene
jétë life

* * * *

Ditët e fundit, Shoqata e Miqësisë Finlandë-Shqipëri organizoi dy mbledhje, në Helsinki dhe në qytetin Lahti. Në mbledhje morën pjesë anëtarë të Shoqatës, miq e simpatizantë të vendit tonë, studentë, etj.

Finlándë Finland

Në Helsinki, Raimo Monikën, mik i vendit tonë, duke u bazuar në materialet e

dúke u bazúar basing himself on

vëllimit të 19të të Veprave	
të shokut Enver Hoxha, foli	
mbi luftën e vendosur që ka	i vendósur resolute
bërë PPSH kundër revizionizmit	PPSH (Partía e Púnës së Shqipërísë) The
modern me atë sovjetik në krye.	Labor Party of Albania sovjetík Soviet
Rreth kësaj teme pati mjaft	krýe head témë theme
pyetje e diskutime, në të	
cilat u shprehën interesimi	
dhe admirimi për Partinë dhe	admirím admiration partí party
vendin tonë. Pas mbledhjes	
për të pranishmit u shfaq	
filmi dokumentar shqiptar	
«Gjithmonë në rritje».	gjithmónë always rrítje growth
Në mbledhjen që u	
zhvillua në qytetin Lahti foli	
mikja e vendit tonë Mervi	
Siven. Ajo tregoi sukseset e	
mëdha që ka arritur vendi ynë	
nën udhëheqjen e PPSH dhe i	udhëhéqje leadership
ilustroi këto me diapozitiva	ilustrój illustrate
me pamje të ndryshme të jetës	
në Shqipëri. Pastaj për të	
pranishmit u shfaq filmi	
dokumentar shqiptar «Trofetë	trofé trophies (of war)
e fitoreve».	fitóre victor

"Shqipëria dhe bota e jashtme," in Shqipëria e re, No. 3, March, 1976 p. 6. (Excerpt).

LEXIMI I TREMBEDHJETE
(thirteenth)

Motra e Zgjuar Shpëton Jetën e Vëllezërve

Ishin tre vëllezër dhe një motër.

Një ditë mbreti i thërret të tre vëllezërit dhe u thotë:

--Ç'është më i trashi send, më i holli send, e më i ëmbli send? Po s'ditët të më përgjigjeni, u shkoi koka!

I tha më i madhi:

--Na ler të mendojmë nja tri ditë e pastaj flasim.

--Po mirë-- ua kthen mbreti --shkoni e mendoni.

Shkojnë në shtëpi të tre vëllezërit e bien në mendim. Por nuk mundin t'i bien më të e bëhen të hidhur si vreri.

--Ç'keni-- i pyet motra --që jeni kaq të mërzitur?

--Se po na pret mbreti, moj motër!-- i përgjigjen vëllezërit. --Na ka pyetur se ç'është më i trashi send, më i holli send, e më i ëmbli send; e kemi tri ditë që mendojmë e s'mundim t'i biem më të.

--Kollaj!-- u thotë motra. --U mësoj vetë. Më i trashi send, në mos qoftë toka, s'di ç'mund të jetë; më i holli send, në mos qoftë fryma, s'di ç'mund të jetë; më i ëmbli send, në mos qoftë martesa e mirë, s'di ç'mund të jetë.

--S'po thua keq-- i thanë vëllezërit --e ty të lumtë goja!

Shkojnë në të tretën ditë te mbreti e i thonë:

--Në mos qoftë më i trashi send toka, e më i holli send fryma, e më i ëmbli send një martesë e mirë, ne s'dimë gjë.

---

mótër sister i zgjúar bright; alert
shpëtój save vëllézër (vëllá) brothers

íshin there were

mbret king thërrés call
vëllézërit brothers
ç'është what is më i tráshi the thickest
send thing; object i hóllë thin i ëmbël sweet s'díni you don't know
përgjígje answer u shkói kóka your head will be cut off
na ler let us mendój think nja about; approximately flas talk
po mírë well; fine kthej answer; turn

mendím thought
por but t'i bíen më të get it right; hit on it i hídhur bitter; sorrowed vrer bile ç'kéni what's the matter pýes ask
i mërzítur sad

moj oh
pýetur asked

kolláj easy
mësój teach
në mos qóftë if it be not tókë the earth
ç'mund të jétë what it can be
frýmë breath në mos if not

martésë marriage

ty të lúmtë gója good for you!
të trétën the third

--I keni rënë më të--ua pret mbreti --por ja më dëfteni kush ju ka mësuar, ja u shkoi koka.

U zunë ngushtë vëllezërit e i thonë:

--Kemi në shtëpi një motër, e ajo na ka mësuar.

--Mirë-- thotë mbreti. --Merrni këtë tufë pambuk e ia shpini motrës. Në qoftë se brenda tri ditëve s'më punon me të një palë tesha të bukura u shkoi koka të treve!

Kthehen vëllezërit të mërzitur në shtëpi, duke menduar se s'ish e mundur të bëhej një palë tesha me aq pak pambuk. I sheh e motra e i pyet:

--Ç'keni që po rrini të mërzitur?

--Tani mbaruam-- i përgjigjen vëllezërit. --Na ka thënë mbreti të të japim këtë tufë pambuk, e të punosh me të brenda tri ditëve një palë tesha të bukura.

--Kollaj!-- ua kthen motra.

Në krye të tri ditëve u jep motra një copë dru të vogël e u thotë:

--Ia shpini mbretit e i thoni:

--Penjtë i kam gati, por më bëj me këtë copë dru tllarët, shulat, berdilat, shpatën e liqtë, e pastaj teshat do t'i punoj sa më mirë.

Shkojnë vëllezërit te mbreti e i thonë:

--Motra ju çon të fala, e këtë copë dru. Penjtë-- thotë-- i kam gati, por më bëj me këtë copë dru tllarët, shulat, berdilat, shpatën e liqtë...

rënë (bie) fallen; hit
pret snap back
ja...ja either...or dëfténi you reveal; tell mësúar taught
u zúnë were caught ngúshtë narrow; tight
u zúnë ngúshtë were in a tight squeeze

túfë bunch; batch pambúk cotton
shpíe take; carry
brénda within s'më punón doesn't make for
me të with it pálë suit; pair
tésha clothes të tréve of the three of you
kthéhem return

i múndur possible
aq so
shoh see

mbarój finish

të punósh for you to make

në krye in the end

pénjtë the threads gáti ready
bëj make

tllárët...líqtë parts of the loom

sa më mírë as well as can be

çoj send të fála regards

Atëherë mbreti s'kish ç'të bënte, se e kuptoi që kjo vajzë e mundi.	atëhérë then do anything vájzë girl	s'kish ç'të bénte couldn't kuptój understand e múndi had defeated him

---

"Motra e zgjuar shpëton jetën e vëllezërve," in Këngë dhe tregime popullore për gruan, Tiranë, 1968, pp. 105-107. Selection originally titled, "Ma i trashi send, ma i holli send e ma i ambli send." Text revised to conform to standard literary Albanian.

LEXIMI I KATERMBEDHJETE
(fourteenth)

Aleksandër Moisiu

Artisti shqiptar që fitoi aq famë e respekt në botë -- Aleksandër Moisiu -- lindi në familjen e Moisive, që ka banuar në qytetin e vogël të Kavajës, në rrethin e Durrësit.	fitój gain; earn; triumph aq so much; such; so fámë fame lind be born e Moisíve of the Moisis banúar resided i vógël little rreth district
Si shumë bashkatdhetarë të tjerë, për arsye të pushtimit turk dhe gjendjes së keqe ekonomike, i ati i Aleksandrit emigroi në Trieste. Ai u martua me një vajzë arbëreshe. Nga kjo martesë lindi Aleksandër Moisiu, më 2 prill 1880. Në vitin 1884 babai i artistit të ardhshëm, së bashku me familjen e tij, u kthye përsëri në atdheun e tij, Shqipëri. Aleksandri i vogël ndoqi në Durrës shkollën fillore. Më 1890 familja e tij përsëri vendoset në Trieste dhe prej andej në Grac të Austrisë, ku Aleksandër Moisiu kreu shkollën e mesme dhe për një kohë të shkurtër ndoqi studimet në konservatorin e Vjenës.	bashkatdhetár fellow countryman arsýe reason pushtím occupation gjéndje condition; situation i áti the father emigrój emigrate martóhem marry arbërésh a descendant of Albanians who migrated to Italy in the 14th and 15th centuries martésë marriage më on prill April babá father i árdhshëm future së báshku together u kthýe (kthehem) returned atdhé fatherland ndóqi (ndjek) pursued fillór beginning shkóllë fillóre grade school vendós establish andéj there krýej complete i mésëm middle i shkúrtër short studím study konservatór conservatory
Aleksandër Moisiu gjithë jetën e tij, gjithë gjeninë e tij krijuese e vuri në shërbim të artit botëror dhe njerëzimit.	gjíthë entire; all gjení genius krijúes creative vúri (vë) placed shërbím service botërór worldwide njerëzím humanity krijimtarí creativity
Krijimtaria e Moisiut, si një nga korifejtë e skenës botërore, mund të krahasohet me një shkollë teatrale. Zëri i artë i aktorit mbetet unik dhe i dashur. Edhe sot nuk mund të qëndrosh pa u mahnitur kur dëgjon në inçizime zërin e tij të mrekullueshëm. Fytyra, mimika, lëvizjet, arti i pantomimës mbeten një shkollë e përsosur.	korifé leader skénë stage krahosój compare teatrál theatrical zë voice i ártë golden mbétem remain uník unique i dáshur dear sot today qëndrój remain; stay mahnít astonish nuk mund...u mahnítur you can't help being astonished inçizím record mrekullúeshëm marvelous mimíkë mime lëvízje movement pantomímë pantomime i përsósur perfect
Ai u admirua jashtëzakonisht nga udhëheqësit e shkollave	admirój admire jashtëzakoníshtextraordinarily udhëhéqës leader

teatrale përparimtare të shekullit tonë.

Hija e harresës nuk do të bjerë kurrë mbi figurën gjeniale të Moisiut. Ai ka lënë pas një diskotekë me vlerë të madhe, fototekë ndër më të pasurat në botë, shkrime dhe dokumenta origjinale, mbi dhjetë filma artistikë dhe një literaturë shumë të gjerë rreth tij.

Moisiu, si artist, ruan vlera universale dhe qëndron gjithmonë aktual për artistët tanë dhe të huaj.

Rëndësia ndërkombëtare e krijimtarisë skenike të Moisiut qëndron në faktin se ai krijoi me një madhëri të jashtëzakonshme në skenë personazhet më të rëndësishme të letërsisë dramatike botërore. Për këtë flet qartë repertori teatral i Moisuit. Ai interpretoi plot pasion dhe vërtetësi disa nga personazhet më të mëdha të Shekspirit. Moisiu mishëroi gjithashtu në skenë personazhet realiste të Gëtes. Edhe heronjtë e veprave të Shilerit si Franc Moor, Markiz Pozës, Fieskos, Moisiu i gjallëroi në skenë me një mjeshtëri të rrallë, duke nxjerrë në pah gjithçka që ishte e mirë dhe revolucionare te vetë Shileri.

Me të njëjtin virtuozitet që interpretonte heronjtë tragjikë, Aleksandri arrinte të krijonte një atmosferë gazmore, kur luante personazhet e Molierit ose bufonët e Shekspirit. Po ashtu ai paraqiti në skenë edhe disa nga figurat më kryesore të tragjedive të Eskilit e Sofokliut. Në Mbretin Edip ai zbuloi karakterin tragjik dhe enigmën e veprës, ndërsa në Prometeun e lidhur

përparimtár progressive
shékull century
híjë shadow harrésë ovlivion
të bjérë (bie) fall kúrrë never
gjeniál of genius
lénë (lë) left lénë pas left behind
diskotékë record collection vlérë value
fototékë photo collection ndër among
pásur rich shkrím writing

i gjérë extensive

rúaj guard; preserve

gjithmónë always aktuál current; relevant
i húaj foreign
ndërkombëtár international
skeník dramatic; of the stage; scenic

krijój create madhërí grandeur i jashtëzakónshëm extraordinary skénë stage personázh character i rëndësíshëm important

qártë clearly teatrál theatrical
interpretój interpret
pasión passion vërtetësí truth

të Shekspírit of Shakespeare mishërój embody
realíst realistic; realist të Gétes of Goethe herónj (heró) heroes të Shilérit of Schiller Franc Moor Franz Moor Markíz Pózës Marquis von Posa Fiéskos of Fiesko
gjallërój bring to life; enliven mjeshtërí skill i rrállë rare dúke nxjérrë (nxjerr) bringing out në pah in the open gjithçká everything
i njéjtë same virtuozitét virtuosity

tragjík tragic arríj succeed in; achieve
atmosférë atmosphere
gazmór joyful lúaj play
e Moliérit of Moliere bufón buffoon
po ashtú likewise
paraqíti (paraqés) presented

të Eskílit of Aeschylus
të Sofoklíut of Sophocles Edíp Oedipus
zbulój reveal
enígmë enigma ndërsá whereas
Prometéu Prometheus i lídhur bound

shprehu heroizmin dhe luftën e njeriut për të mirën e njerëzimit.	shpreh express njerí man njerëzím mankind zotësí ability
Moisiu kishte zotësinë që të mishëronte jo vetëm personazhet e autorëve klasikë, por edhe ato të dramatürgëve kontemporanë.	dramatúrg dramatist kontemporán comtemporary
Që në fillimin e karrierës së tij skenike, ai ndjeu pulsin e njerëzve të thjeshtë që vuanin nga shfrytëzimi dhe urrenin rendin borgjez. Ja pse repertori i tij përfshinte gjithashtu pjesë teatrale të autorëve më të dëgjuar bashkëkohorë si Ibseni, Çehovi, Shou, Pirandelo etj.	fillím beginning karriérë career puls the pulse njérëz (njerí) people i thjéshtë simple vúaj suffer shfrytëzím exploitation urréj hate rend order borgjéz bourgeois ja pse that's why repertór repertoire përfshíj include gjithashtú also i dëgjúar renowned; heard of bashkëkohór=kontemporan Çehóv Chekhov Sho Shaw
Nën ndikimin e mjeshtërisë artistike të Leon Tolstoit, Aleksandri ynë u kalit edhe më tepër si aktor. Përveç Hamletit, që përbën një monument lavdie për Moisiun, një ndër kulmet e mjeshtërisë së tij artistike ishte krijimi i figurës së Fedja Protasovit nga «Kufoma e gjallë».	ndikím influence mjeshtërí skill; craftsmanship ynë our kalít temper më tépër more përvéç besides përbëj constitute lavdí glory kulm high point kufómë corpse i gjállë living; alive; lively
Gjatë 15 vjetëve, Moisiu u bë aktori më i famshëm në skenën e teatrit më të madh të Berlinit, të udhëhequr nga Maks Reinhardi, nën regjinë e të cilit gjenia e tij shkëlqeu plot madhështi.	gjátë in the course of; during i fámshëm famous regjí direction e të cílit of whom shkëlqéj shine plot full of; full madhështí grandeur ngroh warm up
Në fillim Moisiu ngrohu dhe entuziazmoi me artin e tij të rrallë skenat e Austrisë, Çekosllovakisë dhe Gjermanisë, dhe më vonë ato të Moskës, Leningradit, Budapestit, Londrës, Parisit, Stokholmit, Kopenhagenit, Bukureshtit, Milanos, Romës, Firencës, Nju-Jorkut, Çikagos, Stambollit, Meksikos dhe shumë qyteteve të tjera të botës.	entuziazmój excite; enthuse Bukurésht Bucharest Firéncë Florence Stamböll Istanbul
Në shfaqjet e tija, ai iu drejtua spektatorit gjerman në gjuhën e Gëtes, spektatorit anglez në gjuhën e Shekspirit,	shfáqje performance; play drejtój direct; address gjermán German angléz English

parisianit në gjuhën e Molierit.	parisiánit the Parisian
Megjithëse nuk pati mundësi ta tregonte talentin e tij në atdheun e vet,	megjíthëse although mundësí chance; possibility
Aleksandër Moisiu nuk e harroi kurrë Shqipërinë dhe shqiptarët.	harrój forget
Kudo që ishte ai përmendte me krenari atdheun e tij. «Unë nuk dua të vdes si aktor gjerman»--thoshte Moisiu, dhe ai bëri çmos gjersa mori më në fund nënshtetësinë shqiptare, në prill 1934, një vit para vdekjes.	kudó wherever përméndte (përménd) mentioned krenarí pride vdes die thóshte (them) used to say bëri (bëj) did çmos whatever possible gjersá until më në fund at last; finally nënshtetësí=shtetësí citizenship vdékje death takój meet
Ai takohej me përzemërsi e mall me shqiptarët e mërguar në Vjenë dhe Bukuresht.	përzemërsí cordiality mall longing; nostalgia i mërgúar emigrated; living abroad
Në disa nga këta takime ai shkonte i veshur me rroba kuq e zi, ngjyrat e flamurit shqiptar.	dísa several; some takím meeting i véshur dressed rróba clothes i kuq red i zi black ngjýrë color
Sot, populli ynë, i cili i përmabahet artit të ri socialist, duke u mbështetur në traditat e tij më të mira artistike dhe në traditat e artit përparimtar botëror,	përmbáhem hold to dúke u mbështétur (mbështétem) relying përparimtár progressive
përkujton me dashuri dhe respekt artistin e madh, Aleksandër Moisiun. Për përjetësimin e kujtimit të Aleksandër Moisiut, më 1961, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RP të Shqipërisë i dha atij titullin «Artist i popullit».	përkujtój remember; commemorate; recall përjetësím immortality kujtím memory kuvénd assembly RP=Republíkë Popullóre títull title
Shkolla e lartë për aktorë në Tiranë, Pallati i kulturës dhe Teatri i Durrësit mbajnë emrin e Aleksandër Moisiut.	i lártë high shkóllë e lártë professional school pallát palace mbaj carry; hold

---

"Aleksandër Moisiu," in Shqipëria e re, No. 2, (March-April), 1970, p. 18.

LEXIMI I PESEMBEDHJETE
(fifteenth)

Kthimi i Gjergj Kastriotit
Në Krujë

Qindra vjet më parë, kur Shqipëria nxirte vetëm trima dhe luanë, në qytetin e dëgjuar të Krujës, te kështjella e Kastriotëve, rrinte pranë zjarrit mbi një poltronë veneciane një zonjë bujare me flokë të bardhë e me rroba të zeza, me një fytyrë të hequr, të tharë e të vijosur prej hidhërimeve, si ndonjë e shenjtë madhështore që vuan e mundohet po s'e thotë. Qe Princesha Voisavë, e veja e Gjon Kastriotit, e ëma e Skënderbeut.

Jashtë, veriu i egër i maleve të Shqipërisë po frynte si i tërbuar, vërshëllente si i marrë nëpër vrimat dhe mazgallat, përzjente valat e Adriatikut, të fryra perçe-shkumbë, që përpiqeshin si kuçedra, fshikullonte si me kamxhik shkëmbinjtë e thatë që oshëtinin dhe gjëmonin. Qyteti i Krujës qe si i shkretuar. Në fortesën valonte flamuri i Turqisë.

Brenda në kështjellë mbretëronte një qetësi, një heshtje prej varri. Asgjë s'pipëtin. Njerëzit atje s'flasin dhe baresin ngadalë në majë të gishtrinjve, sikur ka ndonjë të vdekur në shtëpi. Zonja me flokë të bardhë e me rroba të zeza i afrohet më tepër e më tepër zjarrit që të ngrohet. E kishte zemrën të ngrirë. Shtëpia e saj ka mbetur pa burrë, pa zot. Katër djemtë që kish ia mori Sulltani si peng tridhjetë vjet më parë. Tre prej tyresh vdiqnë të helmuar; i katërti s'dihet a është i

kthim return
Krújë Croya, town in northcentral Albania

më párë ago
nxírte (nxjerr) produced trim brave man
luán lion
kështjéllë castle
e Kastriótëve of the Castriotis
rrí stand; stay poltrónë armchair
venecián Venetian zónjë lady bujár noble
flókë hair i bárdhë white
të zéza (i zi) black fytýrë face i héqur drawn i thárë dried out i vijósur lined
hidhërím sorrow ndónjë someone; some
i shénjtë sainted; holy madhështór magnificent vúaj suffer mundój torture
qe (jam) it was princéshë princess e ve widow e ëma the mother
Skënderbéu Scanderbeg, George Castrioti's Turkish name jáshtë outside verí north (wind); north i égër fierce mal mountain
fryj blow i tërbúar mad vërshëllléj whistle i márrë insane; crazy vrímë hole
mazgállë crag përziéj stir válë wave
i frýrë swollen
pérçe-shkúmbë foam-crested përpíqem lash; try; make an effort kuçédër dragon
fshikullój beat; whip kamxhík whip (noun)
shkëmbínj (shkëmb) rocks i thátë dry
oshëtíj rumble gjëmój thunder
i shkretúar deserted fortésë fortress
valój wave
brénda në within
mbretërój reign qetësí tranquility
héshtje silence prej of; by; towards varr grave asgjë nothing pipëtíj stir
barés walk; stroll ngadálë slowly
májë tip; peak gishtrínj (gisht) toes; fingers sikúr as if i vdékur dead

afróhem approach
më tépër more
ngróhem get warm kot vain; vainly më kot in vain zémër heart i ngrírë frozen
mbétem stay; remain
zot lord djémtë (djálë) sons
peng hostage

prej týresh of them vdíqnë (vdes) died
i helmúar of poisoning; poisoned

gjallë. Po dhe në rron, a do
të kthehet vallë ndonjëherë?
Vallë a mban mend t'ëmën,
t'anë, Krujën, Shqipërinë, se
qe çilimi dur ia rrëmbyen nga
krahët. Dhe Princesha Voisava
qan e i lutet Perëndisë
duarlidhur, zemërthyer: «Tre
m'i more për mëkatet e mi, të
katërtin ma fal, mos ma merr,
o Zot; mos na e mbyll
shtëpinë!»

Në mur, përsipër vatrës,
varej një shpatë e kohëve të
vjetra që s'e ngre dot njeriu
i sotëm as me dy duar. Qe
palla e Kastriotëve, e mbajtur
brez pas brezi prej trimave që
nxori ajo derë e shkëlqyer.
Turqit e shkelën dhe e
plaçkitën kështjellën, po
pallën s'e nganë, se asnjë
s'qe i zoti ta përdorte.
Voisava e varfër ngre kryet
shpesh dhe sheh atë shpatë dhe
sytë i mbushen me lot. Qan
nëna për një bir, qan dhe
shpata për një burrë!...

Ç'u bë ai djalë, ku është
ai trim? Gjer kur do të
valojë mbi fortesën e Krujës
ai flamur i urryer i tiranit
të huaj? Gjer kur do t'a
presë nëna të birin, Kruja të
zotin, Shqipëria t'anë, bota
trimin që s'ka shok!

Po përnjëherësh hapet
dera dhe hyn brenda një luftëtar
i hieshëm, fisnik dhe
madhështor, hundëshkabë,
sypetrit, me mjekër të gjatë
e të dredhur, i veshur me
çelik, i armatosur gjer në
dhëmbë, statuja e gjallë e
Marsit. Voisava kthehet, e
shikon, përpiqet të ngrihet,
po qëndron si e ngrirë nga kjo
pamje e papritur. Fërkon
sytë, se mos sheh ëndërr.
Luftëtari që hyri është gjallë
si i shoqi, Gjon Kastrioti,
po më i ri, më i bukur, më
i lartë...

po dhe but even në if rroj live
vállë perhaps; I wonder ndonjëhérë
sometime mbaj mend remember
t'ánë=të i átin his father
çilimí child rrëmbýen (rrëmbéj) grabbed
krah arm
qaj weep; cry lútem pray; plead
duarlídhur hands clasped zemërthýer
brokenhearted m'i móre you took from me
mëkát sin ma fal grant me
mbyll close mos na...shtëpínë don't end
our line; don't wipe out our family
mur the wall përsípër above vátër hearth
var hang shpátë sword
i vjétër olden; old ngre lift
i sótëm of today; contemporary as (not)
even dúar (dórë) hands pállë sword
brez pas brézi generation after generation
nxóri (nxjerr) brought forth; produced; took
out dérë house (in the sense of bloodline);
door i shkëlqýer distinguished; shining
shkel invade; step on plaçkít pillage
ngánë (ngas) disturbed i zot able;
capable përdór use
shpesh often
sy eye lot tear
nënë mother bir son
búrrë man

gjer until gjer kur how long

i urrýer (urréj) hated tirán tyrant
gjer until gjer kur how long
të her; his; its

shok equal; peer; comrade
përnjëhérësh all at once hap open
luftëtár warrior
i hieshëm gracious fisník noble
hundëshkábë hook-nosed
sypetrít hawk-eyed mjékër beard i gjátë
long i drédhur curly i véshur dressed
çelík steel i armatósur armed gjer në
dhëmbë to the teeth statújë statue
kthéhem turn around; return
shikój look ngríhem get up

pámje appearance i paprítur unexpected
fërkój rub ëndërr dream se mos sheh
ëndërr to see that she is not dreaming
hýri (hyj) entered shoq husband

i lártë tall; high

«Në mos je hie a fantazmë, që vjen të gënjesh një plakë të varfër, qyqe të neveritur, ti je im bir, ti je Gjergji i im. Folë, folë, mos më mundo!»

Po luftëtari nuk flet dot. Ai që s'i ishin mvrojtur sytë as nga shigjetat, kur i binin si breshër mbi supe, dhe as nga qindra të vrarë e të plagosur përqark, qan tani si çilimi, bie më gjunjë, i puth dorën Princeshës së nderuar, po lotët e mbytin dhe s'thotë dot «Unë jam!» Po nëna e mori vesh. E njohu nga syri, e njohu nga fytyra, e njohu nga sjellja. Pastaj e njohu më mirë ajo dhe Shqipëria dhe bota nga ato që bëri. Ai qe i tërë dhe i gjallë Gjergj Kastrioti, Princi i Krujës, Konti i Matit dhe Zoti i Dibrës, që u quajt Skënderbej prej Sulltanit, Mbret i Shqipërisë dhe i Maqedhonisë prej Papës.

Si mori bekimin e nënës dhe u bë dy herë më i fortë se më parë, rrëmbeu shpatën, që varej në mur, sikur t'ishte e lehtë si pendë, e ngjeshi pas brezit dhe shkoi kaluar në fortesë.

Kruja, që dukej si e shkretuar, lëviz dhe ngjallet. Burra, gra, fëmijë janë mbledhur në shesh të qytetit: ca të gëzuar këndojnë si në dasmë, të tjerë qajnë, të gjithë shikojnë nga maja e fortesës dhe bërtasin e brohoritin. Flamuri i huaj u hoq dhe tani valon n'erë Flamuri i Shqipërisë. Për atë gëzohet populli, për atë tingëllojnë këmbanat, për atë gjëmojnë topat. Ato që ngjajtën nën atë Flamur, nën atë kryeushtar, i shkruan

<u>në</u> <u>mos</u> if not <u>híe</u> shade; specter <u>a</u> or <u>fantázmë</u> phantom <u>gënjéj</u> deceive; lie <u>plákë</u> old woman <u>qýqe</u> cuckoo; woman in despair <u>i</u> <u>neverítur</u> despairing
<u>fólë</u> speak
<u>mundój</u> torture
<u>dot</u> at all
<u>mvrójtur</u> clouded up <u>s'i</u> <u>ishin</u> <u>mvrójtur</u> <u>sýtë</u> didn't bat an eye <u>shigjétë</u> arrow <u>i</u> <u>bínin</u> <u>(bíe)</u> fell <u>bréshër</u> hail <u>sup</u> shoulder <u>qíndra</u> hundreds <u>i</u> <u>vrárë</u> killed <u>i</u> <u>plagósur</u> wounded <u>përqárk</u> around
<u>bíe</u> fall <u>gjúnjë</u> <u>(gju)</u> knees <u>puth</u> kiss
<u>dórë</u> hand <u>i</u> <u>nderúar</u> honorable
<u>mbyt</u> drown <u>s'thótë</u> <u>(them)</u> does not say

<u>marr</u> <u>vesh</u> recognize; find out; understand

<u>sjéllje</u> conduct

<u>nga</u> <u>ató</u> <u>që</u> <u>bëri</u> from the things he did
<u>i</u> <u>tërë</u> the whole; entire

<u>kont</u> count <u>Mat</u> region where Croya is located <u>Díbër</u> district adjacent to Mat
<u>qúaj</u> call
<u>Maqedhoní</u> Macedonia
<u>Pápë</u> Pope
<u>bekím</u> blessing

<u>dy</u> <u>hérë</u>...<u>párë</u> twice as strong as before
<u>rrëmbéj</u> seize
<u>i</u> <u>léhtë</u> light <u>péndë</u> feather <u>ngjesh</u> put on; press; compress <u>brez</u> belt; generation

<u>lëvíz</u> stir: move around <u>ngjall</u> resurrect
<u>gra</u> <u>(grúa)</u> women
<u>shesh</u> plaza; square
<u>ca</u> a few <u>i</u> <u>gëzúar</u> happy
<u>dásmë</u> wedding

<u>bërtás</u> yell
<u>brohorít</u> applaud
<u>u</u> <u>hoq</u> <u>(heq)</u> was removed <u>n'érë</u> in the wind

<u>gëzóhem</u> rejoice
<u>tingëllój</u> ring <u>këmbánë</u> bell
<u>gjëmój</u> thunder <u>top</u> gun; cannon
<u>ngjaj</u> happen; resemble <u>nën</u> under
<u>kryeushtár</u> "chief soldier," great military leader

historia me shkronja t'arta,	shkrúaj write shkrónjë letter; script
i buçasin malet, brigjet dhe	i ártë golden buçás roar brígje (breg)
gurët e Shqipërisë, i tregojnë	hills gur stone
përrallat dhe legjendat e	përrállë folk tale
pleqve dimërit rreth vatrës.	pleq (plak) old men
Kështu u ngrit më 1443,	
në vjeshtën e tretë, në	vjéshtë autumn vjéshtë e trétë November
kryeqytetin e vjetër të	
Shqipërisë, Flamuri i kuq me	i kuq red
shkabën e zezë me dy krerë.	shkábë eagle e zézë (i zí) black
	krérë (krýe) heads

"Kthimi i Gjergj Kastriotit në Krujë," Fan S. Noli, Abetare, Tiranë, 1958, pp. 136-137; Edward A. Licho (Ed.), Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Walden Press, Inc., N.Y., 1968, pp. 35-37.

LEXIMI I GJASHTEMBEDHJETE
(sixteenth)

Plaku i Vitit të Ri

Ai kishte ardhur me hapa të lehta; atë e kishte zbardhur dëbora që binte pa pushim. Në krahë mbante një thes.

Plaku kish qëndruar në prak të derës dhe vështronte se mos shihte njeri. Pastaj trokiti tak-tak-tak në derë dhe pyeti me zë të lehtë:

--Kush banon këtu?--

Por...asnjë përgjigje.

Të gjithë ishin në gjumë të parë. S'kishte se kush t'i hapte derën, ta priste n'oborr dhe t'i thoshte plot gaz «mirë se na erdhe!»

Por në heshtjen e mesnatës ai i hapi vetë dyert.

Bubi i vogël s'bëri zë se e dinte që plaku i vitit të ri është njeri i mirë.

Miku i dashur hyri brenda qetë-qetë pa u ndierë fare Së pari shkoi pranë vëllait të madh, Agimit, dhe i la te jastëku një libër, një fletore dhe një pendë të bukur. Pastaj iu afrua Petritit dhe në shtratin e tij la një çantë, një vizore e dy lapsa. Më në fund u ndal pranë shtratit të Mirkës dhe, duke fërkuar mjekrën, tha me veten e tij:

«Mirka është ende e vogël që t'i fal ndonjë libër. Për këtë duhet diçka tjetër.» Kështu foli me ngadalë plaku i dashur dhe nxori nga thesi një kukëll dhe një qeskë me sheqerka. Këto i vuri mbi shtratin e saj. Pastaj, duke vënë buzën në gaz, kapërxeu prakun dhe me thesin në krahë u zhduk nëpër borë n'errësirën e natës.

plak old man

hap step; footstep
i léhtë light; easy zbardh whiten
dëbórë snow pushím stopping
kráhë back; arms thes sack

prak step; threshold vështrój look
se mos whether or not shíhte (shoh) was seeing; saw njerí someone; person; man
se mos shíhte njerí to see if someone was there trokíti (trokás) knocked
por but përgjígje answer
gjúmë sleep
në gjúmë të párë fast asleep kush anyone; somebody s'kíshte se kush there was no one
gaz joy; mirth
mírë se na érdhe welcome; ("well that you came to us")
mesnátë midnight dýer (dérë) doors
Búbi dog's name i vógël little zë sound

hýri (hyj) entered
qétë-qétë very quietly pa u ndiérë without being perceived fáre at all së pári at first vëllá brother la (lë) left te at; on jasték pillow fletóre notebook
péndë pen
u afrúa (afróhem) approached
shtrat bed
çántë briefcase vizóre ruler laps pencil
më në fund finally; at last ndal stop

fërkój stroke mjékër beard véte self
me véten e tij to himself
énde still
fal give; grant
diçká something

nxóri (nxjerr) brought
kúkëll doll qéskë bag
sheqérkë candy vúri (vë) placed

dúke...gaz smiling kapërxéj cross

zhdúkem disappear bórë=dëbórë
errësírë darkness

Lindja e Diellit	líndje birth líndja e diéllit sunrise
Lindi dielli	
ndriti qielli	ndrít brighten; shine; illuminate
dhe natyra po ndryshohet,	ndryshój change
agoi dita,	agón it dawns
çeli drita,	çel emerge; unlock; open
gjithësia po gëzohet.	gjithësí universe gëzój gladden; make
Lulëzojnë,	joyful lulëzój flower; bloom
kundërmojnë	kundërmój release fragrance
lule, gjethe e burbuqe,	lúle flower gjéthë leaf burbúqe bud
gjelbërojnë,	gjelbëró̧j turn green
kuqëlojnë	kuqëlój turn red
bimë, bar dhe lulekuqe.	bímë plants lulekúq poppy
Sa ka hie,	híe grace; shadow sa ka híe how graceful
sa ka shije	shíjë delight; taste sa ka shíjë how
kjo natyr' e lulëzuar;	delightful i lulëzúar in flower; flowering
kur lind dielli,	
kur ndrit qielli,	
sa njeriu ësht' i gëzuar!	i gëzúar glad

Gjeli, Qeni dhe Dhelpra	gjel rooster qen dog dhélpër fox
Na ishin një herë një plak dhe një plakë. Ata kishin një gjel dhe një qen.	na íshin një hérë once upon a time there were
Një ditë qeni i tha gjelit:	
--A shkojmë të shëtisim	a shkójmë shall we go shëtít take a stroll
në pyll?	pyll the forest
--Shkojmë!-- tha gjeli.	shkójmë let's go
Të dy miqtë shkuar në	shkúan (shkoj) went
pyll. Ecën gjithë ditën.	éci walk
Filloi të ngryset. Miqtë	ngrýset gets dark
zgjodhën një lis të madh, që	zgjódhën (zgjedh) picked; chose lis oak
kishte një zgavër. Gjeli hipi	zgávër hollow place híp climb
mbi një degë, qeni u fut në	dégë branch fútem enter
zgavër.	
I zuri gjumi.	zúri (zë) grabbed; caught i zúri gjúmi
Në mëngjes herët gjeli	they fell asleep hérët early
këndoi me zë të lartë Ki--ki--ri--kiiiiii!	
Gjelin e dëgjoi dhelpra.	
Ajo iu afrua lisit dhe zuri	zúri (zë) began; started
t'i flasë gjelit:	
--Eja, or mik, tek unë!	éja come or oh tek to

--Mirë,-- tha gjeli --por unë kam edhe një shok. Ai po fle në zgavër.

Dhelpra u lëshua vrap te zgavra, por qeni hop! e kapi për noçke dhe e kafshoi.

po fle is sleeping
lëshój let loose; release vrap speedily; quickly Dhélpra...zgávra the fox quickly rushed into the hole hop! poof! kap grab; sieze nóçkë snout kafshój bite

---

Fjalët e Të Urtit

(Nga Naim Frashëri)

fjálë word i úrtë wise

Njeriu, që vetëm për vete punon,
Eshtë si një dru, që pemë s'lëshon.

dru tree pémë fruit; fruit tree lëshój bear; release

* * * *

Miku njihet q'është mik,
Në të keq e në rrezik.

njíhet (njoh) is recognized; known të keq bad times rrezík danger

* * * *

Trupi shëndoshet me të punuar,
Mendja ndriçohet me të mësuar.

trup body shëndósh make healthy; heal méndje mind ndriçój enlighten i mësúar learned me të mësúar with learning

* * * *

Kalliu, që ka bukë, nuk ngre lart kokë.
Ai, që është fyell, del mbi gjithë shokë.

kallí grain lart high kókë head Kallíu...kokë He who has brains is not proud fýell shepherd's pipe Ai...shókë He who is a fool sets himself above his friends

---

"Plaku i vitit të ri," Abetare, Tiranë, 1958, p. 104.
"Lindja e diellit," Ibid., p. 108.
"Gjeli, qeni dhe dhelpra," Ibid., p. 92.
"Fjalët e të urtit," from N. Frashëri, in Qemal Xhomo and Dhori Qirjazi (Eds.), Antologjia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1972, p. 55.

LEXIMI I SHTATEMBEDHJETE
(seventeenth)

Skënderbeu u Flet Shqiptarëvet

(The following is a famous address, delivered by Scanderbeg, Albania's National Hero, to the Albanian people who greeted him upon his return to Albania, after his break with the Turks).

Skënderbeu u kthye në Shqipëri më 1443. Si çliroi një pjesë të mirë të Shqipërisë nga Turqit, ai u kthye në Krujë.	u kthýe (kthéhem) returned si after; like; how çlirój liberate
Aty gjeti shumë të ardhur, që donin të përgëzoheshin me të. Si priti përgëzimet e zakonshme, Skënderbeu u mbajti këtë fjalim krerëve dhe popullit të mbledhur:	gjéti (gjej) (he) found shúmë many i árdhur arrived dónin (dúa) wanted përgëzój greet príti (pres) received përgëzím greeting i zakónshëm customary krérë (krýe) chiefs; heads
«Kapedanë dhe ushtarë trima! S'është as e re as e papritur pamja që kam sot përpara syve. Ashtu si ju kujtoja, ashtu ju gjeta, stërnipër të thjeshtë të një race të vjetër e bujare, trima dhe besnikë të patronditur të vendit tuaj dhe të mbretit tuaj. Edhe unë jam i lumtur tani që mund t'ju hap zemrën time. Ju them pa u mburrur që, sa kam rrojtur, kam patur gjithnjë këtë mall për atdhenë dhe këtë dashuri për lirinë.	kapedán captain; leader ushtár soldier trim brave; brave man i paprítur unexpected pámje scene përpára before ashtú si just as kujtój picture; recall ashtú just so; thus stërníp descendant ráce race bujár noble besník loyal i patrondítur unshakable tríma...patrondítur unshakably brave and loyal men i lúmtur happy hap open them say mbúrrem brag rrój live pátur (kam) had mall longing
Kur më ftuat për këtë vepër nga shërbimi i Sulltanit, kisha në zemër atë dëshirë që kishit edhe ju.	ftoj invite
Juve ndofta ju shkoi ndër mend se e kisha harruar vendin, dhe nderin, dhe lirinë, kur ju ktheva prapë të helmuar pa ju dhënë asnjë shpresë e pa ju treguar asnjë ndjenjë bujare dhe shpirtmadhe. Po unë sillesha me atë menyrë, se ashtu e deshte shpëtimi i juaj edhe imi, se puna ishte e tillë që duhej bërë e jo thënë, se	ndófta perhaps shkon ndër mend get it into one's head; think harró j forget nder honor kthéva (kthej) turned i helmúar sorrowful; embittered; poisoned shprésë hope tregój show; tell ndjénjë feeling shpirtmádh compassionate síllem act; behave mënýrë manner; fashion déshte (dúa) called for; wanted; loved shpëtím salvation i tíllë such dúhej...thënë it had to be done and not talked about

shikoja që kishit më tepër nevojë për fre se sa për shtyrje. Jua fsheha planet e mi dhe s'jua shfaqa dëshirën që kisha në zemër kaq vjet, jo se s'ju kisha besim, jo se s'ju dija shpirtin, posa ju ishit të parët që e hodhët zërin dhe u futët në këtë valle, po se puna duhej majtuar thellë, se duheshin gjetur mjetet, se duhej zgjedhur koha mirë. Ndryshe do të derdhej gjak më kot dhe përfundimi do t'ish një robëri më e keqe se e para; dhe ahere çdo shpresë për të nesërmen fluturonte, se një punë si kjo niset njëherë e mirë, dhe në mos vaftë mbarë, rasti edhe mjetet për ta nisur ikin e s'kthehen kurrë prapë. Prandaj s'ia tregoja planin tim as vetes sime dhe ruhesha mos më shkiste gjuha e mos më dëgjonin muret. Kam për dëshmor Hamzën, tim nip, që e kam pasur përkrahës, këshilltar dhe shok armësh me ca të tjerë të pakë, me besnikërinë e të cilëve e vumë këtë plan në veprim. Tani ndonëse rronim e hanim bashkë dhe kishim një zemër e një shpirt, me gjithë këtë asnjë nga këta s'më kish dëgjuar kurrë të zë në gojë atdhenë dhe lirinë, gjer sa erdhi rasti në betejë të Nishit.

«Lirinë mund ta kishit fituar me trimërinë tuaj edhe me një tjetër çlirimtar, se Shqipërisë nuk i mungojnë burrat, po ju pëlqeu ta prisni nga dora ime, ndonëse vonë, se kështu ndofta desh vetë i madhi Zot. Se është me të vërtetë çudi që trima kryelartë si ju, të rritur në liri, duruat kaq kohë robërinë e barbarëve duke pritur të më shikoni një ditë në kryet

shikój see; look kíshit më tépër you had more nevójë need fre rein se sa rather than shtýrje push fsheh conceal; hide shfaq reveal

jo se not because besím trust; faith
shpirt spirit jo...shpírtin not because I didn't know your spirit pósa since; as soon as hódhët raised; threw zë voice
válle dance (in a circle)
mejtój think out
mjéte means; ways
zgjedh select; choose ndrýshe otherwise
gjak blood do të dérdhej gjak blood would have been shed përfundím end robërí en-slavement; captivity se than; because; that
çdo every; any e nésërme tomorrow
fluturój fly
nis begin njëhérë e mírë once and for all
váftë (véte) may go në...mbárë if it doesn't go well rast opportunity; chance
íki go away

as even vétes síme myself rúhem I am careful shkíste (shkas) slipped; glided

dëshmór a witness nip nephew
pëkráhës supporter
këshilltár adviser ármësh in arms
i pákë few; not many
besnikërí loyalty vúmë (vë) (we) put
veprím action
ndónëse although ha eat

gójë mouth asnjë...gójë not one of them had ever heard me mention gjer until
betéjë battle Nish town in southern Yugoslavia
fitój win trimërí bravery
çlirimtár liberator
mungój lack
ju pëlqéu it pleased you
vónë late
desh (dúa) wanted

me të vërtétë truly çudí amazing
kryelártë proud i rrítur grown
duró̧j endure
barbár barbarian prítur (pres) waited

tuaj. Po vallë a e meritoj
këtë titull të bukur të
çlironjësit që keni mirësinë
të më jepni? Lirinë s'jua
solla unë, po e gjeta këtu në
mes tuaj. Posa shkela këmbën
këtu, posa më dëgjuat emrin,
rendët të gjithë, më dolët
përpara kush e kush më shpejt,
sikur t'ishin ngritur nga
varret etërit, vëllezërit dhe
bijtë tuaj, sikur të kishte
zbritur nga qielli vetë
Perëndia. Më pritët me aq
dashuri e gëzim, më sollët aq
shërbime të çmuara e pa numër
sa më bëtë më tepër ju robin
tuaj se sa unë të lirë ju;
armët nuk jua dhashë unë, por
ju gjeta t'armatosur, lirinë
e kishit kudo--në krahëror,
në ballë, në shpatë, e në
ushtë. Si gardianë besnikë,
të emëruar prej tim eti, ju më
vutë mbi krye këtë kurorë, ju
më dhatë në dorë këtë shpatë,
ju më bëtë zot të kësaj
mbretërie, të cilën ma ruajtët
me aq besë, me aq kujdes e me
aq mundime. Shpjerméni tani
që të çlirojmë tërë Shqipërinë.

«Pjesën më të madhe,
pothuaj tërë punën e mbaruat.
Kruja dhe tërë krahina e saj
u fitua; Dibra me malësitë u
bashkua me ne; armikut s'i
mbeti as emri as shenja në
fushat tona; qëndrojnë vetëm
fortesat. Kam shpresë t'i
marrim edhe këto me hir e me
pahir, me dhelpëri e me
trimëri, ndonse garnizonet
turke janë të forta dhe
kështjellat janë vendosur në
shkëmbinj t'ashpër e të
paafrueshëm. Armiku është
rrethuar, i dëshpëruar dhe s'i
kanë mbetur veçse muret e
fortesavet. Po për këto do
të këshillohemi e do të
perfundojmë më mirë kur të
vemi në vend e kur të kemi

vállë really meritój merit
títull title
çlirónjës liberator mirësí goodness

sólla brought

émër name
rend run dólët (dal) came out më dólët...
shpejt each one of you came out as fast as
possible to receive me ngrítur (ngre)
risen; lifted étër (átë) fathers
bíjtë (bir) sons
zbrítur (zbres) descended qíell heaven;
sky perëndí god
sóllët (sjell) you brought
i çmúar valuable númër number
bëtë (bëj) made rób captive; slave
i lírë free sa më...të lírë ju that you
made me more your captive than I made you
free ármë arms dháshë (jap) gave
i armatósur armed kudó everywhere
krahërór chest
úshtë spear
i emërúar appointed ét=átë
vútë (vë) placed; put kurórë crown

mbretërí kingdom rúaj guard; keep; preserve
bésë faith kujdés care
mundím effort shpjérméni (shpíe) take me

pothúaj nearly púnë job; matter
krahínë district; province
malësí highlands
bashkój join; bring together armík enemy
shénjë sign

hir grace; will
páhir unwillingly me hir e me pahir will-
ingly or unwillingly dhelp[illegible] cunning
garnizón garrison i fórtë strong
vendósur situated
i áshpër rough
i páafrueshëm inaccessible; unapproachable
rrethój surround i dëshpërúar desperate
s'i kánë mbétur nothing remains for it
véçse except mur wall për kétá about this
këshillój counsel; advise
përfundój conclude

armët në dorë e armikun
përpara, se sa tani për së
largu dhe pa ditur ç'kemi
përballë. Do të nisim nga
Petrela më parë, jo se kjo
është më e lehtë për t'u
fituar--përkundrazi është një
fortesë prej natyre dhe ka një
garnizon të fortë--por se
ndodhet më afër kryeqytetit,
dhe jam i sigurtë që lajmi i
mirë i ngjarjeve të Krujës ka
arritur atje dhe ua ka ngrirë
gjakun armiqve. Të tmerruar
nga trimëria juaj dhe nga
shkatërrimi i garnizonit të
Krujës ndofta do të na
lëshojnë fortesën me të mirë,
në mos, po do t'i shtrëngojmë
të na e japin me të keq. Një
gjë vetëm duhet të keni ndër
mend: Në mos e marrshim
Petrelën, asnjë nga ne s'duhet
të kthehet prapë i gjallë.

«Ngrehni pra flamurin
përpara, dhe tregohuni burra
si gjithnjë. Perëndia, si
gjer tani, ashtu dhe paskëtaj
do të na ndihmojë dhe do të na
nxjerrë faqebardhë. O
burrani!»

<u>për</u> <u>së</u> <u>lárgu</u> from a distance	
<u>përballë</u> in front	<u>nga</u> with; from; to
<u>më</u> <u>párë</u> at first	
<u>përkúndrazi</u> on the contrary	
<u>prej</u> <u>natýre</u> natural	
<u>ndodh</u> occurs; happens	<u>áfër</u> near
<u>lajm</u> news	
<u>ngjárje</u> event	
<u>ngrij</u> freeze	
<u>i</u> <u>tmerrúar</u> terrified	
<u>shkatërrím</u> destruction	
<u>lëshój</u> release; give up	<u>me</u> <u>të</u> <u>mírë</u> peacefully
<u>po</u> <u>do</u> <u>t'i</u>...<u>keq</u> then we will make them give it to us the hard way	<u>shtrëngój</u> force; squeeze
<u>pra</u> therefore	
<u>tregóhuni</u> show yourselves	
<u>gjíthnjë</u> always	
<u>gjer</u> until; up to	<u>paskëtáj</u> hereafter
<u>ndihmój</u> help	
<u>do</u> <u>të</u> <u>na</u> <u>nxjérrë</u> <u>faqebárdhë</u> we will achieve success	<u>O</u> <u>búrrani!</u> onward!

"Skënderbeu u flet shqiptarëvet," from Fan S. Noli, <u>Historia e Skënderbeut</u>, Tiranë, 1962, pp. 29-31; <u>Abetare</u>, Tiranë, 1958, pp. 137-140.

LEXIMI I TETEMBEDHJETE
(eighteenth)

Kënga e Shqiponjave

E njoha më shtatë prill.[1]
E breshka këmishë-zezë me lëkurë luani dhe me pendë këndezi e njohu dhe ajo.[2]
Më vonë e njohu dhe Huni i motorizuar.
Dhe pastaj nami i tij mori dhenë. E pashë, kur braktisi shtëpi e katandi, kur luftonte si skifter mbi malet tona, kur ngjitej gërxheve përpjetë, atje ku shqiponja ka folenë.
E pashë në një natë të thellë shënëndreu, trup të përgjakur, këmbë-enjtur.
I paskish dalë zot atdheut e vegjëlisë!
E pashë ngrënë e pangrënë, kur pinte ujë në gjurmat e mushkës, kur u plagos, kur fshinte gjakun me mëngën e këmishës, kur vdiste me këngë në gojë.
E pashë në trikëmbësh të varur. Po ai nuk vdiq! E pashë kokëprerë në fushat e Myzeqesë. Po ai nuk vdiq! E pashë në Tiranë, në Korçë e Prishtinë të masakruar. Po ai nuk vdiq! E pashë, kur u vërsul mu si luani mbi tanksin e dushmanit; e pashë të r[illegible]huar, kur u dogj i gjallë me pushkë në dorë: Por ai nuk u dorëzua!
E pashë kur qëlloi mu në lule të ballit Tradhtinë.
E njoha në Pezë, kur dha

kéngë song shqipónjë eagle

bréshkë turtle këmíshë-zézë black-shirted lëkúrë skin luán lion péndë feather këndéz rooster
Húni the Hun
i motorizúar motorized
nam reputation; name
dhe earth móri dhénë spread all over the world páshë (shoh) saw braktís abandon katandí possessions skiftér hawk ngjit climb gërxh rocky slope; cliff përpjétë up; upward
folé nest
nátë night
shënëndré December (archaic) trup body i përgjákur bloodied kémbë-énjtur swollen-footed
vegjëlí little people i páskish...e vegjëlísë he saved the fatherland and the little people ngrënë fed; eaten pángrënë hungry; unfed pi drink gjúrmë footprint múshkë mule plagós wound fshij wipe off; sweep mëngë sleeve këmíshë shirt vdíste (vdes) was dying këngë song trikëmbësh gallows; tripod i várur hanged vdiq (vdes) died kokëprérë with head cut off Myzeqé Muzeka, coastal plain of southern Albania masakrúar massacred

vërsúlem hurl myself; dash mu right; just mu si just like tanks tank dushmán enemy u dogj (djeg) was burned

dorëzóhem surrender
qëllój strike; hit
mu në lúle të bállit squarely on the forehead
tradhtí treason

---

1. On April 7, 1939 the Italian army invaded Albania.
2. This description refers to Mussolini and to Italian soldiers in general. The passage can be translated: And the black-shirted turtle dressed in the skin of a lion and the feathers of a rooster also came to know him (ajo refers to breshka).

kushtrimin, në Kurvelesh me pallë sheshit, në Mallakastër, kur hante barutin me grusht, në Vlorë, kur luftonte një me njëqind, në Korçë, kur buçisnin malet e Gorës e të Oparit; e njoha në Elbasan, kur i dha grusht feodalit, në Mirditë në Dibër, në Mat, kur përmbysi kalatë e bajrakut dhe hodhi në erë kullat e mercenarit.

Një ditë e gjeta në bisedim me kamxhikun. Ishte kapur në befasi. Kamxhiku e kishte lidhur kok-e-këmbë. (Edhe kështu e kishte frikë).

--Në do të shpëtosh trego shokët!

Dhe ky, me buzëqeshje, si me tallje, i përgjigjej kamxhikut:

--Shokët e mi? Natën e thellë si deti! Ditën e bardhë si bora!

Dhe kamxhiku:

--Të tjerë!

--Të tjerë? Dritën e zbetë të Hënës, tufanin e çmendur, breshërin e tërbuar.

Kamxhiku vazhdon duke fishkëllyer:

--Të tjerë!

--Urinë, lodhjen!

Po kamxhiku nuk ngopet, kërkon edhe më, duke fishkëllyer.

Dhe ai ia pret me gjysmë zëri:

--Dale kamxhik, se më ka mbetur edhe Një. Ai është larg, shumë larg nesh, po, megjithatë, e kam pasur gjithnjë pranë shok të pandarë. Ai më mësoi si të përmbys dy skllavëritë: atë të pushtonjësit dhe atë të gjakpirësit vendës. Dit' e natë, në gaze a në helm, zgjuar ose në gjumë, në mal ose në fushë, në tym a në flakë, në çdo vend e nga çdo anë e kam pasur si shok të pandarë...

kushtrím alarm
pállë sword shéshit drawn; in the open
barút gunpowder grusht fist; handful
kur...grusht when he tasted the enemy's gunfire buçísnin (buçás) roared; resounded

feodál feudal lord
përmbýs overthrow
kalá fortress bajrák tribal region
hódhi (hedh) threw hódhi në érë blew up
kúllë fortified house
bisedím conversation kamxhík whip
kap catch befasí offguard
lidh bind; tie kok-e-këmbë head and foot
édhe kështú even so fríkë fear
shpëtój am saved; get away tregój reveal; tell about; show shókët comrades
buzëqéshje smile
tállje joke; mockery si me tállje as if mocking

i zbétë pale tufán blizzard
i çméndur mad; insane bréshër hail
i tërbúar enraged vazhdój continue
dúke fishkëllýer cracking

urí hunger lódhje fatigue
ngop satiate
kërkój seek

gjýsmë half

dále wait!
se...Një because I have one more
larg far nesh (from) us
megjíthatë nevertheless pásur=pátur

i pándarë inseparable
skllavërí slavery

gjakpírës bloodsucker; blood-thirsty person
gaz joy; mirth helm sorrow; poison
zgjúar awake
tym smoke
flákë flame
ánë side

...Po kamxhiku ja këputi fjalën në mes.	këpút cut; pluck; break
Po ai nuk vdiq! Se ai nuk vdes!	vdes die
Ai ishte si Anteu. Baba kish malin dhe nëńë fushën. Për ta zhdukur duhej të përmbysje malin dhe të çrrënjosje fushën.	Antéu Antaeus, giant wrestler in Greek mythology Babá...fúshën his father was the mountain and his mother, the field zhduk annihilate çrrënjós uproot; eradicate
Ai ishte si Akili: Plumbi e shponte vetëm në thembër.	Akíli Achilles plumb bullet shpoj pierce thémbër heel
Por ai nuk ia kthente kurrë shpinën dushmanit...	kthej turn shpínë back; spine dushmán enemy
Dhe Shqiponja, që mbante zi në folenë e saj, kur e pa, fërkoi sytë e habitur dhe pyeti:	fërkój rub i habítur surprised; amazed
--Cili të jetë vallë?...	cíli...vállë? I wonder who he is?
Këtyre gërxheve kam parë Skënder-Benë, Rrapo Hekalin, Çeçon, Bajram Currin, Selam Musanë, po jo këtë! Gjer më sot nuk më ka zëńë syri trim si ky me yll në ballë. Ky ua kapërxeka të gjithëve.	zë sýri catch sight of yll star kapërxéj excel; cross; overcome
Ky të marrka gjak në vetull.	márrka takes (-ka ending expresses amazement) në vétull from the eyebrow Ky...vetull he is a crack shot
Ky i thënka tufanit: --S'ta kam frikën!	
Ky i thënka rrufesë: --S'më tremb dot!	rrufé lightning tremb frighten
Ky i thënka zjarrit: --S'më djeg dot!	zjarr fire djeg burn
Ky i thënka mitralozit: --S'më shpon dot!	mitralóz machine gun
Ky i thënka vdekjes: --Plaç!	plaç! drop dead!
Ky qënkërka më trim edhe nga unë! Unë luftoj vetëm në mal. Ky luftoka në mal, në fushë e në qytet!	qënkërka=qénka
Dhe Shqiponja vriste mendjen për ta njohur se kush ish. Dhe e njohu.	vríste méndjen beat its brains out njoh recognize; be acquainted with; know
Dy lote të turbullt gëzimi rrodhën nga sytë e saj të shkathët dhe si dy rrëke xhevahirësh morën shkëmbin tatëpjetë.	lóte tears i túrbullt troubled rródhën (rrjedh) trickled; flowed i shkáthët keen; nimble rrëké stream xhevahír jewel tatëpjétë downward mórën shkémbin tatëpjétë rolled down the rock
Dhe flladi i mëngjesit i përthau ata dy sy të përlotur.	fllad breeze përtháj dry out i përlótur tearful
Përplasi krahët tmerrësisht dhe fluturoi krenare, e egër,	përplás flap; hurl; slam tmerrësísht frightfully i égër fierce

madhështore shkëmb më shkëmb e gërxhe më gërxhe për t'u dhënë shoqevet, që ishin strukur në strofkën e tyre, sihariqin e madh.	shkëmb...gërxhe from rock to rock; from slope to slope për të dhënë to give shóqe (female) comrades strúkem huddle strófkë lair; den siharíq joyful tidings; good news
--Paskan mbetur burra, që t'i dalin zot tokës arbërore! --dhe kënga e shqiponjave buçiti si rrufe, simfoni e pambaruar e këtyre maleve kreshnike, e këtij populli fatkeq, që vdiste me fjalën «Liri» në gojë, po s'pa kurrë liri me sy!	arbërór Albanian buçíti (buçás) roared i pámbaruar unfinished kreshník majestic
Dhe kënga e Shqiponjave buçiti si rrufe:	
«Se mjaft në robëri, E mjera Shqipëri!»	se...robërí enough in slavery i mjérë wretched; unfortunate
Dhe jehona gumëzhiti si bubullimë majë Tomorit:	jehónë echo gumëzhít rumble; reverberate bubullímë thunder
«Përmbi shkëmbinj e gurë Liri do ngjallimë!»	ngjáll bring to life
Me mijëra yj xixëllonin në qiellin shqiptar, dhe rrethonin flamurin kuq-e-zi të shpalosur, që valavitej krenar e i pamposhtur në ajrin e pastër të Lirisë.	míjëra thousands yj (yll) stars xixëllój sparkle rrethój surround; encircle i shpalósur unfurled valavítet waves i pampóshtur invincible ajr air i pástër clean

---

"Kënga e shqiponjave," N. Bulka, in Abetare, Tiranë, 1958, pp. 182-185.

LEXIMI I NENTEMBEDHJETE
(nineteenth)

Kështjella e Shkodrës

Shkódër major city of northern Albania

Një ndër monumentet më të përmendura, në Shqipëri dhe në gadishullin Ballkanik, për të dy rrethimet e saja të njohura të shekullit XV, është kështjella e Shkodrës.

monuménT monument
i përméndur noted
gadíshull peninsula Ballkaník Balkan
rrethím encirclement; siege
i njóhur renowned

Ajo ngrihet mbi një kodër të vendosur në mes të lumenjve Buna, Drini e Kiri, Kodrës së Pashës dhe Fushës së Mbishkodrës. Atë e përdorën për herë të parë ilirët, duke ndërtuar atë bërthamë, mbi të cilën u zhvillua më vonë kështjella mesjetare, ashtu siç është sot. Vetë pozicioni i saj dëshmon se ndërtuesit e kanë zgjedhur me shumë kujdes, ashtu si kanë vepruar kur kanë ngritur qytezat e tyre, në pika strategjike, dominuese, të zonave të rëndësishme kalimi, si tokësore ashtu edhe ujore. Gjurmë të ndërtimit ilir janë të dukshme në të hyrë të kështjellës, në vendin e hapur në mes portës së parë dhe të dytë, si dhe në daljen nga porta e dytë në kështjellë, të dyja këto në krahun e majtë. Duket se muri është ndërtuar në periudhën e fundit ilir, para pushtimit romak. Gjithashtu u atribuohet ilirëve një mur guri pa llaç me një faqe të dukshme, i mbuluar me dhe në faqen e jashtme të tij dhe që krijon një hendek të madh në krahun verilindor, në pjesën më pak të mbrojtur nga natyra.

kódër hill
i vendósur situated lúmë river

përdór use
ilír Illyrian
ndërtój construct; build bërthámë kernel; seed

siç as pozicion position
dëshmój testify ndërtúes builder
zgjedh choose; select

qytézë fortress; fortified city
píkë point strategjík strategic dominúes dominant zónë zone
kalím passage tokësór of land
ujór of water gjúrmë trace; footprint
i dúkshëm visible; apparent
të hýrë entrance
pórtë gate
dálje exit

krah wing; arm i májtë left
mur wall

pushtím occupation romák Roman
atribuój attribute
llaç mortar
fáqe side; face; page i dúkshëm visible; conspicuous mbulój cover dhe earth

hendék moat; ditch
verilindór northeastern më pak less
mbroj protect

Forma që ka sot kjo kështjellë, nuk është më ajo ilire. Formën e sotme ajo duhet ta ketë marrë në shekullin e XIV dhe e ka ruajtur deri më sot, me gjithë rrënimet dhe ndryshimet

nuk është më is no longer

rúaj keep; preserve déri më=déri në
rrënim ruination ndryshím change

që ka pësuar gjatë pesëqind vjetëve të sundimit turk.

Trajta e kështjellës është thuajse vezake, ndahet në tri oborre të rrethuara me mure të larta. Vetëm në faqen ku gjendet e vetmja portë hyrjeje, dhe kryesorja, kemi katër kulla mbrojtëse si dhe një hendek të gjerë dhe të thellë, sistem i cili shërben për të siguruar pjesën më të pambrojtur të kështjellës. Në veri kemi tri kulla, në jug vetëm një.

Për daljen nga kështjella dhe për komunikimin me jashtë, përveç portës kryesore, kishte edhe dalje të tjera të fshehta, të nëndheshme. Një prej tyre dilte në fund të kodrës, në krahun nga Buna, kurse një tjetër, me hyrje nga kulla që gjendet në jug të kështjellës, nxirrte nga Drini. Ende sot këto dalje shihen, por nuk janë të përshkueshme më, pasi pjesërisht janë të shembura dhe paraqesin rrezik. Po ashtu kemi, poshtë portës së dytë kryesore, një dalje të fshehtë brenda hendekut, me drejtim nga veriu, në mënyrë që të mos shihej nga armiku. Duket se kjo dalje komunikonte me sistemin mbrojtës të portës kryesore.

Jeta në kështjellë u zhvillua e gjallë, ndërtesat aty ishin të shumta. Ato krijonin një rrjetë të dendur rrugësh e rrugicash. Këtë na e vërteton humanisti i njohur shkodran Marin Barleti në veprën e vet De Obsidione Scodrensi. Në kështjellë kishte edhe lagje e një numër të madh kishash. Kur u dorëzua kështjella në vitin 1479, mbas rrethimit të dytë

pësój suffer
sundím rule
trájtë layout
thúajse almost vezák oval ndaj divide

gjéndet is situated i vétëm only
hýrje entrance
kúllë turret mbrójtës defensive

i pámbrojtur unprotected
jug south

kommunikím communication

i fshéhtë secret i nëndhéshëm underground
dílte exited

nxírrte (nxjerr) opened out; pulled out
énde even; still

i përshkúeshëm passable
pjesërísht partially i shémbur ruined
paraqés present rrezík danger

drejtím direction

komunikój communicate

ndërtésë building

rrjétë network i déndur dense
rrúgë road rrugícë alley
vërtetój verify; confirm humaníst humanist
shkodrán of Shkodër
De Obsidione Scodrensi (Latin) On the Siege of Shkodër
lágje neighborhood
kíshash of churches dorëzój give up; surrender

nga turqit (1478-1479) | udhëhéq lead; guide
të udhëhequr nga vetë sulltan Mehmeti II, pjesa më e madhe e këtyre ndërtesave ishte e shembur dhe nuk u ngritën më nga pushtuesi, i cili të gjithë kujdesin e kishte drejtuar tek veprat e fortifikimit. | shemb ruin; pushtúes occupier; fortifikím fortification

Sot vetëm një ndërtesë është ende në këmbë dhe në gjendje të mirë. Një numër magazinash, deposh e ambientesh të tjera të mbyllura, ndër të cilat edhe ai që sot quhet «burgu», vazhdojnë të na rikujtojnë historinë e kaluar të kësaj kështjelle. Të shumta janë edhe cisternat, ndërtimi i të cilave, sipas dokumenteve, i përket periudhës pas vitit 1397. Furnizimi i tyre me ujë bëhej nëpër një sistem të gjerë kanalizimesh që përshkonin muret e kështjellës në të gjitha drejtimet, dhe që shihen edhe sot e kësaj dite. | në këmbë standing; gjéndje condition; magazínash of storage areas; déposh of depots; ambiéntesh of areas; environments; burg prison; rikujtój remind; cistérnë cistern; përkét (pérkas) pertains; belongs; furnizím furnishing; kanalizímesh of canals; përshkój run through; pervade; cross; drejtím direction; shíhen (shoh) are seen

Ndoshta që në kohën ilire, qyteti filloi të shtrihej rrëzë kodrës së kështjellës. Edhe qyteti mesjetar, si kështjella qe i rrethuar me mure. Ende sot shihen gjurmët e tyre. Kjo pjesë e Shkodrës qe e banuar deri në vitin 1467. Në këtë vit, pas një sulmi të një ushtrie të madhe turke, qyteti qe djegur dhe shkodranët u tërhoqën bashkë me familjet e tyre brenda kështjellës, duke parë se kështjella ishte vend më i sigurtë. Vetëm pas pushtimit turk (1479) qyteti mesjetar rifilloi të banohej dhe të shtrihej gjithnjë e më tepër. | ndóshta perhaps; probably; shtrij spread out; rrézë at the foot of; i rrethúar surrounded; banúar inhabited; sulm offensive; ushtrí army; djeg burn; shkodrán resident of Shkodra; u tërhóqën withdrew; rifillój begin again; gjíthnjë e më tépër more and more

Në vitin 1961, për të parën herë filluan punimet në kështjellën e Shkodrës për restaurimin e saj. U synua krysisht të meremetoheshin | restaurím restoration; synój aim; meremetój renovate

ato pjesë që kishin pësuar dëme më shumë, ose që rrezikonin të shëmbeshin. Kujdesi më i madh iu kushtua, sidomos, portës kryesore të hyrjes në kështjellë, një porte anësore, që i përket grupit të oborrit të tretë, si dhe punimeve që kishin për qëllim forcimin dhe restaurimin e kishës katedrale, e cila pas pushtimit turk qe kthyer në xhami. Me këtë nuk duam të themi se nuk u punua me kujdes edhe në pjesët e tjera të kështjellës.	pësój suffer dëm damage rrezikój threaten; endanger shemb crumble kushtój devote sidomós especially; particularly hýrje entrance anësór lateral grup group katedrál cathedral kthýer converted
Herë pas here në kështjellë janë gjetur edhe objekte me vlerë historike. Në Muzeun Arkeologjik-Etnografik të Tiranës ruhet një pllakë varri me mbishkrim latin. Kjo, duke qenë fragment, nuk ka as emrin e gruas që ngriti këtë pllakë as edhe atë të të shoqit që vdiq. ....(MARI) TOSVOFECIT QVIVIXITAN NIS XXXX	gjej find objékt object pllákë plaque pllákë várri gravestone mbishkrím inscription latín Latin fragmént fragment
Një kornizë ndërtese si dhe një kapitel me figura drangojsh në reliev, që gjendet i ekspozuar në Muzeun Popullor të Shkodrës, një fragment mbishkrimi turqisht, tulla...të vulosura me gërmat C D, dhe që mendojmë të jenë të punimit venecian, dëftojnë se kështjella e Shkodrës ruan në gjirin e vet vlera ende të pazbuluara të afta për të ndriçuar ato pjesë të panjohura të historisë së vendit tonë.	kornízë cornice kapitél uppermost part of a column drangójsh of dragons reliév relief gjéndet is found ekspozój exhibit túllë brick; tile vulós stamp gërmë letter venecián Venetian dëftój tell; point out gji bosom i pazbulúar uncovered i áftë suitable; apt ndriçój enlighten i panjóhur unknown

---

"Kështjella e Shkodrës," Vili Kamsi, in Shqipëria e re, No. 1 (January-February), 1970, pp. 32-33.

LEXIMI I NJËZETE
(twentieth)

Punëtori, Tregtari dhe Gruaja e Zgjuar

Ish një punëtor në një qytet të madh, që kish fituar nja njëzet franga ari. Punëtori druhej t'i mbante me vete të hollat, se mos ia merrte dikush. Një ditë i ankohet një burri:

--Kam këto franga ari e s'dua t'i mbaj me vete se mos më humbin. Ku t'i lë nuk di, se s'kam asnjë të njohur në këtë qytet.

Shpjeri, bre, te filani, iu përgjegj burri. --Ai është pasanik i madh e ka besë.-- Pastaj i tregoi ku rrinte ai pasaniku i madh.

Punëtori shkoi te pasaniku e i thotë:

--Puna e mbarë, zotëri.

--Mbarë paç-- ia ktheu zotëria.

--Kam nja njëzet franga ari-- i thotë punëtori. --Punoj këtu në qytet e druhem se mos më humbin. A të prishet puna sikur t'i lë këtu me ty, deri sa të punoj edhe pak e pastaj vij e i marr e shkoj në shtëpi.

I tha pasaniku:

--Këtu lënë njerëzit me qindra franga ari, dhe unë ua ruaj, e kur shkojnë në shtëpi ua jap. Lëri edhe ti e mos ki gajle hiç.

U gëzua punëtori e i la të hollat me të.

Kur erdhi dimri shkoi t'i marrë të hollat. I thotë pasanikut:

--Më jep ato frangat që lashë me ty, se po shkoj në shtëpi.

--Kur ke lënë ti të holla këtu?-- i tha zotëria. --S'më ke dhënë gjë mua, hiç. As që të njoh.

tregtár merchant; businessman
i zgjúar clever; bright

fitój earn
nja about; approximately frángë franc
ar gold drúhem be reluctant; afraid
të hólla money
dikúsh somebody; anybody
ankóhem complain

humb lose lë leave
i njóhur acquaintance

shpjéri (shpíe) take bre I say (intensifier particle) filán this guy iu përgjégj (përgjígjem) replied pasaník wealthy person ka bésë is honorable

púna e mbárë may your labor be fruitful! (a greeting response) paç may you have mbárë paç the same to you!

prish ruin; spoil
të príshet púna would you mind ("is your work spoiled") déri sa until

gájle worry hiç at all
la left

Bre ≪t'i kam lënë,≫ bre ≪s'i ke lënë,≫ s'kish ç'të bënte punëtori. Nuk mundte t'i bënte gjyq se s'kish dëshmues, dëftesë, asgjë. Doli në udhë e zë të qajë.

Vjen n'atë çast një grua, me një gócë për dore. E sheh punëtorin që po qan.

--Ç'ke, bre, që po qan?-- e pyet.

--E zezë ditë për mua.-- i thotë punëtori. --Kisha njëzet franga ari. I lashë te një pasanik. Sot vajta t'i marr e ai më thotë: ≪S'ke lënë të holla.≫Më humbën të hollat që i kisha fituar me djersë.

Foli gruaja e i tha:

--Po shkojmë bashkë te pasaniku. Po kur të hyj unë te shtëpia e tij, ti rri jashtë. Kur të zë unë fjalë me të, ti hyr brënda.

Gocës së saj i thotë:

--Ti rri jashtë. Kur të hyjë ky punëtori brënda e të marrë të hollat në dórë, ti hyr e thuaj: Nënë, nënë, erdhi babaj nga kurbeti!

Ç'bëri pastaj gruaja? Mori një shami, e bëri si qeskë dhe e shtiu në brez. I vajti pasanikut e i tha:

--Puna e mbarë, zotëri!

--Mbarë paç, zonjë !

--Ti je njeri i njohur e i drejtë, prandaj kam ardhur te ti. Më ka lënë burri njëqind franga ari. T'i mbaj me vete nuk guxój, se jam një grua e vjen e m'i merr dikush natën. I kam sjellë, pra, e dua t'i lë me ty.

--Po, zonjë,-- foli zotëria. --Këtu lënë bota me mijra franga ari, e unë ua jap kur vijnë e i kërkojnë. Hiç mo ki gajle.

Atëhere hyn brënda punëtori e thotë:

Bre...punëtóri "I did give them to you!" "You didn't!" The worker was helpless.
múndte he could gjyq court bëj gjyq take to court ("make court") dëshmúes witness dëftésë evidence údhë street; road zë begin gócë girl për dóre by the hand

vájta I went

Më húmbën të hóllat I lost the money
djérsë sweat

hyj enter

zë fjálë begin talking ("catch word")

gócës to the girl

kurbét foreign land migrated to for work to support the family at home
shamí handkerchief qéskë purse; small bag
shtíe place; put

i dréjtë just; straight

guxój dare

sjell bring

bóta people

--Puna e mbarë, zotëri!

--Mbarë paç!-- ia kthen zotëria.

--A më jep ato njëzet franga ari që i lashë këtu me ty para ca kohë.

Pasaniku, i cili ka etje për të marrë të njëqind frangat e zonjës, nuk po i dhimben të njëzet frangat e punëtorit. Pra, i thotë:

--Po, ja ku i ke njëzet frangat.-- Edhe ia dha.

Si mori të hollat punëtori e i vuri në xhep, hyri brënda goca e zonjës e i thotë nënës së saj:

--Hej, nënë, erdhi babai nga kurbeti!

--He! kur më paska ardhur burri! Tani nuk shoh pse t'i lë të hollat me ty, se nuk kam frikë se mos m'i vjedhë njeri.-- E duke thënë këto fjalë, po i rreh gishtat e po këcen.

Edhe punëtori bëri gjithashtu. Nisi t'i rrahë gishtat e të këcejë që mori të njëzet frangat e tij. Për çudi, zuri edhe pasaniku të rrahë gishtat e të këcejë. Atëhere, foli zonja e tha:

--Mirë se mua më erdhi burri e u gëzova, dhe ky punëtori këcen nga gëzimi që mori të hollat e tija. po ti pse po këcen?

--Këtë që më bëre ti, s'ma ka bërë njeri tjetër; prandaj dhe unë po këcej nga habia-- iu përgjegj pasaniku.

pára ca kóhë a while ago
étje thirst
më dhímbet hurt; feel for
xhep pocket
hej! hey!
he! well!
kam fríkë I am afriad
vjedh steal
rreh (rrah) snap; beat
gisht finger
këcéj dance
gjithashtú likewise
për çudí surprisingly ("for surprise")
habí amazement

Gjë e Gjëza

Mjaltët e kadiut, Mjaltët e myftiut, Në një qyp janë, Përzier s'janë. (Veja)	mjáltë honey kadí judge of Moslem religious law myftí Moslem religious administrator qyp earthenware urn përziéj mix

* * * *

Bie n'ujë e s'njomet, Bie n'gjemb, s'gjembohet. (Rrezja e diellit)	njom moisten; make wet gjemb thorn gjembój prick

* * * *

Një lis me dymbëdhjet' dega, Gjasht' të buta e gjashtë t'egra. (Viti)	dégë branch i bútë mild; soft i égër wild

* * * *

Sqoka e zezë i mbështjell, Sqoka e bardhë i shpërndan. (Dita, nata dhe yjet)	sqókë hen mbështjéll wrap up; gather up shpërndáj disperse ýje (yll) stars

* * * *

Një kamare, Me një zagare. (Goja dhe gjuha)	kamáre chamber zagár loud-mouth; gossip

---

"Punëtori, tregtari dhe gruaja e zgjuar," Këngë dhe tregime popullore për gruan, Tiranë, 1968, pp. 97-99. Selection originally titled "Krogtari, tregtari dhe grueja e squet." Text revised to conform to standard literary Albanian.

"Gjë e gjëza," in Dh. S. Shuteriqi et al. (Eds.), Historia e letërsisë shqipe, I, Tiranë, 1959, p. 53.

LEXIMI I NJEZETENJETE
(twenty-first)

Konstandini i Vogël

Konstandini i vogël, bir i vetëm i derës, kish tri ditë që ish martuar. Si shkuan këto tri ditë me nusen e re, i erdhi kartë nga mbreti të shkonte në ushtri në dhe të largët.

Me të marrë kartën, Konstandini shkoi te dhoma e t'et dhe e s'ëmës, iu fal, u puthi dorën dhe u lypi uratën. Pastaj i vajti së bukurës, hoqi e i dha unazën e gishtit dhe i tha:

--Nëm timen, o zonja ime, se mua më thërret mbreti në ushtri në vend të largët që të luftoj nëntë vjet. Po të shkojnë nëntë vjet e nëntë ditë dhe unë të mos kthehem, ti, vashë, mos më prit më shumë. Martohu.

Vasha e shikoi e pikëlluar e nuk i foli fare. Fshiu lotin e syrit, nxori e i dha unazën e gishtit. Konstandini shkoi në luftë të luftojë me qenin e pabesë. Vasha mbeti në shtëpi. Kaloi një mot, kaluan tre, kaluan plot nëntë vjet. Vinin e kërkonin trima e bujarë, se ishte shumë e bukur, po ajo s'donte të martohej. Pastaj kaluan nëntë vjet e nëntë ditë. Konstandini nuk u kthye.

Plaku, i vjehrri, i tha me lot në sy:

--Bija ime! Shkuan nëntë vjet e nëntë ditë. Konstandini im mbeti në dhe të huaj. Pra, ti martohu, vashë, se im bir ka vdekur.

Vasha e bardhë uli kryet, psherëtiu e s'foli fare, po fshiu lotët e syve.

E zunë për të martuar te një bujar, që e donte dhe e kish pritur nëntë vjet. Filluan dasmën.

bir...dérës the only son in the bloodline kish...martúar had been married three days núse bride kártë letter; paper mbret king ushtrí army dhe land; country te to dhómë room et=átit ëmë=nénë u fal greeted; took leave of lyp beg urátë blessing së bukúrës to his lovely (wife) hóqi (heq) took off unázë ring gisht finger nëm tímen give me mine

váshë girl
martóhu get married
i pikëllúar sadly
fáre (not) at all fshiu wipe off

i pabésë faithless qen i pabésë pagan dog; infidel mot=vit kërkój seek; demand bujár nobleman

u kthýe (kthej) returned
vjéhërr father-in-law

bíjë daughter

vdékur (vdiq) died: dead
i bárdhë white ul bow; lower
psherëtíj sigh
e zúnë (zë) they engaged her zë për të martúar engage to wed
fillój begin; start dásmë wedding celebration; wedding

* * * *

...Ndaj të gdhirë, larg, në dhe të huaj, në ushtri të mbretit, Konstandini pa një ëndërr shumë të frikshme, që i trembi gjumin. Ndaj u zgjua, lëshoj një psherëtimë të hidhur sa kumboi tërë fusha. Këtë psherëtimë e dëgjoi edhe vetë mbreti që rrinte brenda në shatore, se nata ishe e lagët. E dëgjoi, u ngrit

ndaj towards të gdhírë dawning

pa had; saw i fríkshëm fearful
tremb scare ndaj=prandáj
psherëtímë sigh kumbój echo

shatóre tent
i lágët wet ngríhem get up

menatë e dha urdhër të bien buritë e të mblidhen gjithë bujarët e rojet e ushtrisë. I vuri të gjithë në rreth e i pyeti:

--Më thoni të vërtetën, o ushtarë të mi, kush psherëtiu aq fort sot menatë?

Të gjithë dëgjuan e nuk u përgjegjën. U përgjegj vetëm Konstandini.

--Unë i mjeri psherëtiva, o mbret.

--Konstandin, besniku im, pse psherëtive ti kaq fort?

--Psherëtiva, o mbret, se atje larg sot martohet vasha ime. Ma merr një tjetër dhe vë kurorë. Kur ika nga vendi im e bëra me fjalë që ajo të më presë nëntë vjet e nëntë ditë, pastaj të martohet. Tani kaluan të nëntë vjetët e të nëntë ditët dhe ajo vë kurorë me një bujar.

--Konstandin, o biri im,-- thotë mbreti. --shko në grazhdet e mi e zgjidh vetë një kalë, cilin të duash: merr atë të zinë si ulliri, merr atë të bardhin si dëbora apo atë të pikëluarin si gjarpri. Hipi shpejt e kthehu në vendin tënd, gëzohu me vashën tënde.

Konstandini iu fal mbretit, u tha lamtumirë shokëve e shkoi shpejt në grazhdet, zgjodhi kalin e bardhë që ikte si skifteri, i hipi e i ra me shporet. Pak u preh ditën, pak u preh natën e shkoi, shkoi, gjersa sosi në vendin e tij. Gdhihej ditë e diel.

Udhës për në fshat takoi tatën plak. Konstandini e njohu, tata nuk e njohu. Konstandini e pyeti.

--Ku po shkon, o tatë?

--O bir, shkoj atje ku më shpie fati im i zi, që të gremisem nga shkëmbi i madh...

--Përse të gremisesh, o tatë?

--O bir, unë kisha një djalë të hijshëm, të vetmin. I thoshin Konstandin i vogël. E martova shumë të ri me vashën që deshi vetë. Ndenji vetëm tri ditë dhëndër. I erdhi kartë nga mbreti që e thirri në luftë, në vend të largët. Im bir i ktheu plot

menátë just before daybreak
úrdhër order bíe blow; hit
burí trumpet mblídhen (mbledh) assemble rójë guard; sentry

i mjérë unfortunate; wretched

vë put kurórë wedding crown; crown e bëra me fjálë I had an understanding

grazhd stable
zgjidh (zgjedh) choose! kálë horse
ullí olive
apó or i pikëlúar spotted
gjárpër snake hípi mount it
shpejt quickly gëzóhu rejoice!

lamtumírë good-bye

skiftér falcon ra (bíe) hit; fell
shpor spur préhem rest gjersá until
gdhíhet dawns e diél Sunday
údhës on the way tátë=átë

fat fate gremís throw off
shkëmb cliff; rock

i hijshëm handsome të vétmin the only one martóva (martój) I married off déshi (dúa) loved; wanted
ndénji (rri) stayed dhëndër groom

helm unazën vashës e i tha: «O e bukur! Unë do të nisem në ushtri të luftoj për nëntë vjet. Po të shkojnë nëntë vjet e nëntë ditë e unë të mos kthehem, merr unazën e martohu, se unë atëhere do të jem nën dhe». Sot vasha e tim biri po martohet. Këto huta që po shkrehen në dasmë thonë se im bir ka vdekur, prandaj do të vete të gremisem nga shkëmbi.

--Kthehu prapë, tatë, se Konstandini po vjen njëmend: e lashë prapa në udhë e erdha këtu.

--Më rruash, o biri im, që më dhe këtë lajm të gëzuar, se Konstandini im po vjen njëmend.

Trimi ngau kalin, i ra me shpore, që të arrijë nusen përpara se të vërë kurorën e dytë.

Sosi në katund në kohën e meshës së madhe dhe erdhi drejt te dera e kishës. Atëhere po vinte në kishë nusja me dhëndërin e ri me gjithë katundin pas. Trimi i zbriti kalit, nguli flamurin e tij te dera e u tha dasmorëve:

--Mirë se ju gjej, o krushq bujarë! A më doni mua nun që t'i ve kurorë kësaj nuse?

--Mirë se vjen, o trim i huaj e i hijshëm! Ne të duam nun që t'i vesh kurorë nuses.

U hap kisha e hynë të gjithë brenda. Kur erdhi koha t'i ndërronin unazën nuses me atë të dhëndërit të ri, Konstandini i vuri në gisht unazën e vet.

Nuses i vanë sytë tek unaza, e njohu menjëherë dhe i shpëtuan lotët syve, iu rrukullisën sumbulla-sumbulla faqeve të kuqa, i ranë pika-pika gjirit të bardhë.

Konstandini e pa, u kthye e u tha krushqve:

--O ju krushq e ju bujarë, mbani më ngadalë ato kurorë. Konstandini është lidhur për jetë me këtë vashë. Unë vetë jam Konstandini!

Pastaj Konstandini e mori të bukurën, e shpuri në shtëpi të vet dhe rrojtën e u trashëguan.

hútë kind of rifle
shkreh fire; release

njëmënd right away

më rrúash may you live long
dhe you gave

ngas (ngárë) drive on
arrij reach; arrive

katúnd village
méshë e mádhe high mass

pas behind; after
ngul stick into a surface
dasmór wedding guest
krushq in-laws
nun best man; godfather

hyj enter
ndërrój exchange

vánë (véte) went
shpëtój release; save; rescue
rrukullís roll sumbúlla-sumbúlla round and round píka-píka drop by drop gji bosom
pa saw

shpúri (shpíe) took away
trashëgóhem live happily ever after ("have children")

"Kostandini i vogël," M. Kuteli, in Tregime të moçme shqiptare, Tiranë (no publication date given), pp. 46-50.

LEXIMI I NJEZETEDYTE
(twenty-second)

Apollonia (Pojani)

Si rrjedhim i zhvillimit të marrëdhënieve tregtare ndërmjet helenëve dhe ilirëve në vitin 588 para e.r. në tokat e fisit ilir të taulantëve pranë një qendre të banuar më parë nga ilirët u themelua kolonia e dytë helene, Apollonia, kushtuar hyut Apollon. Ky qytet nuk lidhej drejt për drejt me detin, por dilte këtu me anën e lumit Vjosa, që ishte i lundrueshëm në pjesën e tij të poshtme.

Ka të ngjarë që Apollonia të mos jetë ngritur drejt për drejt nga qytetarë helenë preje Korkyra por të ardhur nga Dyrrahioni (Durrësi).

Në sajë të marrëdhënieve të mira me vendësit Apollonia u rrit shpejt dhe u bë një qendër skllavopronare e përparuar. Në Apolloni jetonin së bashku me popullsinë helene në shumicë edhe qytetarë ilirë. Ky qytet shpejt u bë një qendër tregtare dhe kulturore e përmendur në bregdetin Adriatik, një qytet i pasur dhe i lulëzuar, i rrethuar me mure madhështore që zgjateshin rreth katër km., duke përfshirë një hapësirë prej 134 hektarësh. Rrugë të ndryshme tregtare lidhnin qytetin me tokat e brendshme ilire.

Ai përshkohej nga një sistem i tërë kanalesh që shërbenin për të mbledhur e përcjellë ujrat jashtë mureve të qytetit.

Po ashtu si Durrësi edhe Apollonia ka qënë detyruar t'i nënshtrohet shtetit të taulantëve aty nga shek. IV para e.r. Në këtë kohë në jetën dhe kulturën e Apollonisë futej gjithnjë e më tepër elementi ilir. Vartësia nga shteti i Taulantëve nuk e pengoi zhvillimin e mëtejshëm të qytetit, ku lulëzoi përherë e më tepër tregtia. Qyteti u zbukurua me godina të tjera madhështore, sikurse është portiku i madh, që është monumenti kryesor i deritanishëm i qytetit antik dhe që shtrihet sot në kodrën e manastirit të Pojanit. Shtyllat e portikut paraqiten në formën e një luleje

rrjedhím consequence
marrëdhénie relations tregtáre commercial ndërmjét between; among e.r. (érë e re) A.D. new era pára e.r. B.C. fis tribe; clan taulántë an Illyrian tribe qéndër center i banúar inhabited më párë formerly themelój found; establish koloní colony kushtój dedicate hy deity lidh connect; tie drejt për drejt directly dílte këtú came out (to the sea) me ánën by means (of) i lundrúeshëm navigable i póshtëm lower ka të ngjárë it is possible ngrítur erected; built qytetár citizen prej from; of të árdhur arrivals në sájë të by means of véndës local inhabitant rrit grow skllavopronár slave-owning i përparúar advanced popullsí population shumícë majority i përmendur noted bregdét sea-coast i pásur rich i lulëzúar flourishing zgjat extend km=kilométër kilometer përfshíj enclose hapësírë area; space hektár hectare rrúgë road i bréndshëm internal përshkój pervade; criss-cross kanál canal mbledh collect; gather përcjéll convey jáshtë outside of
po ashtú si just like detyrój oblige; force nënshtrój subdue atý nga around; approximately shek.=shékull century fut insert gjíthnjë e më tépër more and more element element vartësí dependence pengój obstruct; hinder lulëzój flourish; flower përhérë e më tépër constantly greater tregtí commerce zbukurój beautify godínë building sikursé është like portík portal i deritaníshëm up to now antík ancient shtrij extend; spread out manastír monastery shtýllë column paraqít present; portray

të përdredhur, kurse kapitelet si gonxhë, interpretim ky që nuk haset gjëkundi në botën tjetër helene.	<u>përdrédhur</u> entwined <u>kapitél</u> capital <u>gónxhë</u> bud <u>interpretím</u> interpretation <u>has</u> encounter; meet <u>gjëkúndi</u> anywhere
Në shek. III para e.r. në Apolloni mjeshtrat skulptorë kishin krijuar një shkollë të posaçme për punimin e skulpturave, që janë vepra origjinale, të cilat nuk kanë shoqe në skulpturën helenistike. Në Apolloni ka pasur një shkollë te lartë filozofije dhe retorike, ku mësonin edhe djem nga shtresa të larta të shoqërisë skllavopronare të Romës, ndër të cilët edhe vetë Oktaviani, perandori i mëvonshëm i Romës.	<u>mjéshtër</u> master; craftsman <u>skulptór</u> sculptor <u>i posáçëm</u> special <u>skulptúrë</u> sculpture <u>origjinál</u> original <u>shóqe</u> equals (female) <u>helenistíke</u> Hellenic <u>ka pásur</u> there was <u>filozofí</u> philosophy <u>retoríkë</u> rhetoric <u>djem (djálë)</u> boys <u>shtrésë</u> stratum <u>perandór</u> emperor <u>i mëvónshëm</u> subsequent
Apollonia ruajti edhe nën pushtimin romak pamjen e një qyteti helen; ajo mbeti një qendër kulturore greke, me institucionet e gjuhën greke. Nën pushtimin romak në Apolloni u bënë ndërtime të reja, disa prej të cilave kanë dalë në dritë nga gërmimet që janë bërë deri tani. Kësaj kohe i përket monumenti i quajtur i agonotetëve, Odeoni, një godinë si bibliotekë etj.	<u>helén</u> Hellenic <u>gréke</u> Greek <u>të réja (i ri)</u> new <u>gërmím</u> excavation <u>kësáj</u> to this <u>përkás</u> belong <u>agonotét</u> official who presided over Olympic-type games <u>Odeón</u> concert hall <u>bibliotékë</u> library
Në shek. e III të e.r. e sidomos në të IV-tin filloi e tatëpjeta e qytetit. Në këtë kohë nga lëkundjet e tokës lumi Vjosa, që lidhte Apolloninë me detin, ndryshoi drejtimin për në jug. Rruga për në det u pre, tregtia ra dhe populli braktisi qytetin. Në shek. V Apollonia përmendet në disa dokumente vetëm si qendër peshkopale. Qytetin e mbuloi heshtja dhe kështu mbaroi jeta e qytetit të Apollonisë, që zgjati rreth 1000 vjet.	<u>sidomós</u> especially <u>tatëpjétë</u> decline <u>lëkúndje</u> shifting <u>ndryshój</u> change <u>drejtím</u> direction <u>për në jug</u> to the south <u>u pre (pres)</u> was cut off <u>ra (bíe)</u> fell; fell off <u>braktís</u> abandon <u>peshkopál</u> episcopal <u>mbulój</u> cover <u>mbaró</u> end; finish <u>zgjat</u> endure; lengthen
Apollonia është një nga qendrat arkeollogjike antike më të rëndësishme të vendit tonë. Ky «qytet i madh e hijerëndë», siç e kanë quajtur me të drejtë shkrimtarët e lashtë, ka qënë një qendër kulture dhe arti me rëndësi të dorës së parë, një nga qytetet antike të përmendura të bregut lindor të Adriatikut.	<u>arkeollogjík</u> archaeological <u>i rëndësíshëm</u> important <u>hijerëndë</u> imposing ("heavy shadowed") <u>siç</u> as <u>i láshtë</u> ancient <u>të dórës së párë</u> of the highest order ("of the first hand") <u>lindór</u> eastern
Si qendër e madhe e kulturës greke ajo ka luajtur një rol të madh në përhapjen e kulturës greke në brendi të viseve ilire. Këtë kanë treguar qytezat dhe qytetet e brendshme ilire ku janë zbuluar objekte të kulturës materiale që dëshmojnë për marrëdhënie reciproke. Nga Apollonia u përhapën në krahinat e jugut të Ilirisë edhe	<u>përhápje</u> diffusion; spread <u>brendí</u> interior <u>vise</u> places; lands <u>zbulój</u> uncover <u>dëshmój</u> testify; attest <u>përháp</u> spread out; disseminate

qytetarë grekë, tregtarë e zejtarë, të cilët zunë vend në qytetet ilire.

Materialet e ndryshme arkeologjike që janë zbuluar tregojnë ekzistencën në Apolloni të shumë punishteve zejtare ku prodhoheshin enë prej balte, vegla pune e armë, atelie ku punoheshin skulptura e relieve, që nuk qëndrojnë larg veprave të mjeshtërve të mëdhenj të botës antike dhe që dëshmojnë për shkallën e përparuar, nivelin e lartë të artit në këtë qytet antik. Edhe godinat private dhe ato publike kanë qënë punuar me mjeshtëri të madhe nga ndërtuesit apolloniatë.

Edhe gërmimet e kohëve të fundit në nekropolin e qytetit, ku u hapën 6 tuma, dhanë material mjaft interesant, ndër të cilat vendin e parë e zë qeramika e pikturuar helene. Varret e zbuluara në këto tuma i përkasin një periudhe që shkon nga shek. VI deri në shek. III para e.r. Mënyra e ndërtimit të disa varreve dhe përmbajtja e tyre vërteton edhe një herë praninë e elementit ilir në këtë qytet koloni të bregdetit të Adriatikut.

Tendenca drejt një rruge të re artistike me karakter lokal duket edhe më qartë në monumentet e varreve të shek. III para e.r. të cilat përsa i përket ndërtimit, zgjedhjes dhe rrjeshtimit të elementeve figurale dhe zbukuruese janë krejt unike në botën helene.

Materiali i gurtë që përdorej për skulpturat monumentale nxirrej rregullisht në vend dhe kjo lë të kuptohet se pjesa kryesore e veprave skulpturale kanë qënë punuar në vend dhe prej mjeshtrish të kolonive. Disa vepra skulpture kanë cilësi shumë të larta; mund të përmenden, midis të tjerave, edhe punimet skulpturale: Perëndia Eros, kryet e Silenit, një shtat gruaje, Psyhe, personifikimi i lumit Vjosa, Artemisi, Genius, bust i Luc Verit, guri i varrit të ilires Falakra etj.

zejtár craftsman

ekzisténcë existence
punishte workshop punishte zejtáre artisan's shop prodhój manufacture; produce énë utensil báltë mud énë prej bálte earthenware utensils végël tool atelié art studio reliév relief
nivél level
privát private
publík public
ndërtúes builder
apolloníat Apollonian

nekropól necropolis; cemetary
túmë sepulchral mound
qeramíkë ceramics
i pikturúar painted; pictured
ndër...helëne among which the painted Hellenic ceramics are the most important ("take first place")
varr tomb i zbulúar uncovered
përmbájte contents vertëtój verify
praní presence

tendéncë tendency; impulse drejt straight to; towards lokál local
dúket is apparent; seems qártë clearly përsá as far as përsá i përkét as far as...is concerned
zgjédhje selection; choice
rrjeshtím ordering; arrangement
elemént element figurál representational zbukurúes beautifying
krejt completely; altogether uník unique i gúrtë of stone
monumentál relative to monuments
nxírrej (nxjerr) was extracted
rregullísht regularly cilësí quality

shtat body
Psýhe Psyche personifikím personification bust bust

Pranvera

Pranvera po bëhej gati që të gëzonte njerëzit, të gëzonte kafshët, shpezët, bimët, me një fjalë, gjithë natyrën.

Dhe një ditë ajo zbriti mbi tokë bashkë me rrezet e ngrohta të diellit. Shkriu së pari dëborën dhe akullin, pastaj e ndali erën e dimrit, pastroi qiellin dhe lëshoi erën e lehtë e të ngrohtë.

Pas këtyre punëve ajo u nis dhe shkoi me hapa të lehta në fusha e ara, kopsht e lulishte, livadhe e pyje, nëpër kodra e male dhe kudo përhapi blerimin. Pemët çelën lulet e tyre të bukura plot ngjyra dhe zunë të veshin rrobën e blertë.

Njerëzit shikonin tani blerimin e fushave e lulëzimin e pemëve dhe kënaqeshin e thoshnin:

--Oh, sa bukuri! Erdhi pranvera!

Shumë kafshë e kishin kaluar dimrin në grazhd. Shumë nga kafshët e egra qenë strukur nga të ftohtit nëpër gëmusha e pyje, nëpër shpella e brenda në dhe. Edhe këto dolën jashtë. Bar të njomë e të freskët kishte tani kudo në fusha e kodra. Edhe ato thoshnin:

--Oh, sa mirë! Na u kthye pranvera!

Zogjtë shikuan plepin e lisin, që ishin mbushur me gjethe dhe filluan të ndërtojnë foletë duke kënduar. Dallëndyshet e lejlekët filluan të kthehen nga vendet e ngrohta.

Mizat e dheut dolën nga foleja, bleta doli nga kosherja dhe bretkosa, e gëzuar, nxori kokën nga ujët dhe thirri:

--Guakguak! Erdhi pranvera e bukur!

---

pranvérë spring

po bëhej gáti was getting ready
gëzój gladden káfshë animal
shpézë fowl bímë plant

i ngróhtë warm
shkrij melt ákull ice
ndal halt; stop pastrój clean
lëshój release

nísem start out
hap step árë farmland
livádh meadow pýje (pyll) forests
përhép spread
blerím verdure çel open up

i blértë green

lulëzím blooming
kënáq satisfy thóshnin (they) said sa bukurí how beautiful!; how nice!
grazhd stable; barn
strúkem huddle nëpér among
gëmúshë underbrush shpéllë cavern

bar i njómë tender grass
i fréskët fresh

zogj (zog) birds plep poplar
lis oak gjéthe foliage
ndërtój build folé nest
dallëndýshe swallow lejlék stork
mízë e dhéut ant dólën (dal) emerged blétë bee colony
koshére hive bretkósë frog
nxóri (nxjerr) stuck out; took out
thírri (thërrás) called

"Apollonia (Pojani)," S. Adhami, Monumente të kulturës në Shqipëri, Tiranë, 1958, p. 105.

"Pranvera," Abetare, Tiranë, 1958, p. 105.

LEXIMI I NJEZETETRETE
(twenty-third)

Sikur Të Isha Djalë

(Autori ngre problemin e femrës shqiptare, e cila në regjimet e kaluara antipopullore, s'gëzonte asnjë të drejtë. Dijen, protagonisten e romanit, e fejojnë kundër dëshirës së saj me një tregtar të pasur e të moshuar. Ajo, në marrëveshje me Shpendin, me të cilin dashurohet, bëhet gati të ikë fshehurazi nga shtëpia).

Dita e sotme ish më e gjata se çdo tjetër, dhe muzgu i mbrëmjes dukej sikur nuk donte të plakoste mbi këtë anë të dheut. Darka u hëngër midis gazit që shpërthente shpesh ndër ato që kanë ardhur tek ne qysh prej kohësh, për të më bërë nuse e për të më çuar ne ai tregtari. Unë, megjithëqë përpiqesha për ta fshehur shqetësimin e brendshëm herë-herë turbullohesha dhe humbja ndër mejtime, duke e sodisur arratisjen dhe jetën e ardhshme. Natyrisht edhe buka nuk më shkonte. Kafshatat më ngecnin në fyt dhe nuk gëlltiteshin. Ishte darka e fundit që po bëja në shtëpinë time. Ky mendim i hidhur më përvlonte trurin dhe s'më linte të haja. Mosngrënia e ime atyre nuk ua tërhiqte vërejtjen, sepse prej kaq kohësh janë mësuar të më shohin të sëmurë.

Pas darke u tërhoqa në dhomën time për t'u prehur e qetësuar. E mbylla derën dhe nisa të shkruaj në librin e jetës sime. Këtë libër do ta marr me vete, pse është shok i sekreteve, i ndiesive dhe i shfryrjeve të mia. Po, do ta marr me vete për t'i vazhduar shënimet, të cilat pas së sotmes, kanë për të qënë të kënaqshme.

Deri në orën nëntë, kohë e caktuar prej Shpendit për t'u takuar me të në skaj të rrugës, duhet të pres edhe një orë e disa minuta. Im atë, njerka, fëmijët, emta, kushërirat dhe mbesat janë mbledhur në dhomën e bukës poshtë, dhe po qeshin e bëjnë muhabet, të shkujdesur nga çdo e papritur.

sikúr if; as if
fémër female
regjím regime
antipopullór antipeople gëzój enjoy; gladden asnjë not one; none e drejtë right (privilege)
protagoníst protagonist
fejój engage someone to be married
i moshúar aged marrëvéshje agreement fshéhurazi secretly

muzg twilight
plakós strike; hit suddenly
dárkë dinner u hëngër was eaten
shpërthéj break out; burst shpesh often qysh since qysh prej kóhësh a long time ago; for years and years ne to; at çoj take to; send off megjíthëqë although
përpíqem try fsheh hide
shqetësím unease; disquiet
hérë-hérë from time to time
turbullój trouble humb lose
mejtím thought húmbja ndër mejtíme was lost in thought
sodís contemplate arratísje disappearance i árdhshëm future
natyrísht naturally edhe...
shkónte I couldn't eat; even the bread wouldn't go down ngec stick
fyt throat gëlltít swallow
i fúndit last përvlój burn tru brain línte (lë) left mosngrënie not eating tërhéq attract; draw
vërejtje attention prej kaq...
të sëmúrë they had been used to seeing me sick for a long time
u tërhóqa (tërhíqem) withdrew
préhem relax; rest qetësój calm down sekrét secret ndiesí feeling; emotion shfrýrje unwinding; emotional release shëním note; entry kánë për të qënë will be
i kënáqshëm pleasant órë hour
i caktúar appointed skaj corner
rrúgë street; road njérkë stepmother émtë aunt kushërí cousin
mbésë niece dhómë e búkës dining room muhabét conversation i shkujdésur indifferent; carefree

Tingujt e qeshjeve të tyre arrijnë deri këtu...Ja, më duket sikur i shoh të gjithë duke kuvenduar me ëmbëlsi. Im atë thith duhan pa rreshtur, dhe herë-herë i aprovon, me një fjalë të vetme e me një nënqeshje, mendimet e shfaqur prej hallë Hatixhes, prej njerkës, ase prej mamë Sybes. Gratë flasin pa u lodhur dhe me aq shpejtësi, sa dëgjuesit shqyrtues do t'i dukej se ato nxitohen për tu shprehur sa më parë, për të nisur pasandaj një punë me rëndësi të madhe! Të rejat, çupat, rrinë mënjanë, kokë më kokë, dhe bisedojnë me njera-tjetrën me zë të ulët e me buzëqeshje. Vetëm kur këputet fjala e ngrejnë kokën për të shikuar të tjerët, dhe për tu vënë vesh fjalëve të tyre. Shkurt, në atë dhomë përdheske fryn një erë kënaqësie dhe zotëron gazi e hareja. Oh! sa dëshiroja që edhe unë të isha në mes të tyre me zemër të kënaqur dhe të gëzuar. Oh! sa e lumtur do të isha sikur të isha fejuar me Shpendin e jo me atë tregtarin, dhe tash netët e përgatitjes së dasmës, të dëgjoja zërin kumbues e të qartë të urimeve që do të më bënin ato për një fatbardhësi të paperëndueshme.

Në mes të gjithë atyre njerëzve që janë grumbulluar në dhomën e bukës, ndodhet një njeri që unë kam lidhje të ngushtë me të, dhe më është më i afërt se të tjerët. Ky është im atë. Po, im atë, në mes të gjithë atyre, fizikisht është më i afërt tek unë, por shpirtërisht është tepër larg, pse ai më dënoi me vdekje zemrën, dhe tash më dëbon dhe nga shtëpia.

Eh fati i zi! Zemra më është çuar peshë dhe do të shfrejë duke qarë, pse ajo s'do të largohet nga shtëpia ku leu, ku u rrit dhe ku ndjeu. Të paktën ky largim duhej bërë edhe me hirin e tim eti, dhe të isha përcjellur prej urimeve e bekimeve të tij. Por, mjerisht, po

tíngujt (tíngull) sounds; tones
qéshje laughter arríj arrive ja here; behold kuvendój converse
ëmbëlsí sweetness thith inhale
duhán tobacco pa rréshtur ceaselessly nënqéshje smile
i shfáqur expressed hállë aunt; father's sister áse=ose or
mámë mama lodh tire shpejtësí rapidity dëgjúes listener
dëgjúesi shqyrtúes the discerning listener nxitój hurry sa më párë as quickly as possible pasandáj later të réja young ones rri stay
bisedój chat njéra-tjétra one another kur këpútet fjála when the conversation lags ngre raise; lift up për tu vënë vesh in order to listen përdhéske on the ground kënaqësí satisfaction
zotërój possess; own haré happiness
i kënáqur satisfied; content
i lúmtur happy

nétë (nátë) nights përgatítje preparation kumbúes booming
uríme good wishes; congratulations
fatbardhësí good fortune
i paperëndúeshëm everlasting; without end grumbullój gather
ndódhem am present lídhje tie
i ngúshtë tight; narrow i áfërt close; kin
fizikísht physically

shpirtërísht spiritually tépër very; too much dënój condemn; sentence dënój me vdékje condemn to death dëbój drive away; expel
péshë weight zémra...péshë my heart is distressed shfrej relieve qárë (qaj) weeping
léu (lej) was born ndjéu (ndiéj) experienced emotion; felt; sensed
të páktën at least largím departure dúhej bërë should have been made me hírin with the willing approval përcjéll send off; accompany mjerísht sadly; unfortunately

ngjan e kundërta. Do të përcillem e do të përmendem me mallkime, me fyerje e poshtërime. Ç'të bëj? Kështu qënka thënë...

Grepi i orës, dalngadalë po i afrohet nëntës. Tiktaket e zemrës sime po bëhen më të forta e më të shpejta se ato të orës. Jam e trazuar dhe e turbulluar fort. ...I kafshoj buzët që ta mbaj furinë e këtyre tallazeve që duan të shpërthejnë nga brenda jashtë. Hidhërohem kur i kujtoj, me një farë mallëngjimi të pashpjegueshëm, vjetet e jetës sime të kaluar në këtë dhomë e në këtë shtëpi, në këtë qytet.... Fytyra të ndryshme njerëzish të afërm e të dashur, skena të ndryshme ngjarjesh e ndodhirash dhe pamje të ndryshme banesash e vendesh po më sinematizohen para syvet të mendjes, dhe bukuritë ose shëmtimet e tyre të veçanta...më hapin plagë në zemër. Oh sa ngushtë qënka lidhur njeriu me njerëzit e me sendet që e rrethojnë dhe me viset ku ka jetuar! Një dashuri e ruajtur në thellësitë e zemrës për të gjitha këto krijesa njerëzore, tani vjen të zgjohet nga djepi i ndiesive e të ngrehë krye që të dalë jashtë, që t'i kundërshtojë të gjitha ato forca që duan të më largojnë së këtejmi...

Dashuria e Shpendit mbi të gjitha! thirra më në fund, dhe i frenova të gjitha ndiesitë e tjera që më sulmonin. Po, dashuria e Shpendit mbi të gjitha, se im atë, për fat të keq, vetë e shkuli nga zemra ime atë lule dashurie që kishte mbjellë dora hyjnore. Tash, nga ajo lule e bukur dhe aromatike pak degë dhe disa gjethë kanë mbetur; burbuqet kanë nisur të fishken më parë se të çelin, pse nuk janë ujitur, nuk janë diellur dhe i ka brejtur krrimbi...

Dëshiroja të ndahem nga kjo shtëpi mbasi ta përqafoja tim atë, mbasi t'i puthja vëllezërit e motrat, mbasi t'u shtrëngoja dorën mbesave e kushërirave, dhe mbasi të çmallesha me të gjithë... Po, për fat të keq, po largohem si një kusare, si një e dëbuar, si një e neveritur, pa e kënaqur zemrën në asnjë

ngjan happens e kúndërta the opposite përcíllem (përcjéll) be sent off mallkím curse fýerje insult poshtërím debasement
ç'të bëj? what am I to do?
kështú qënka thënë it was fated to be thus grep hand órë clock; hour dalngadálë gradually
tikták ticktock i trazúar mixed up furí fury talláz storm wave
shpërthéj erupt; burst
hidhërój make bitter
mallëngjím nostalgia; longing
i pashpjegúeshëm inexplicable

i áfërm relative
ngjárje event
ndodhí happening
banésë dwelling sinematizój play on a screen; cinematize
shëmtím ugliness i veçántë particular; special plágë wound

víse places
i rúajtur held
thellësí depth
krijésë creation; creature
njerëzór human djep cradle
kundërshtój oppose
fórcë force largój separate; keep distant dúan...këtéjmi want to take me away from here
frenój hold in; rein in
sulmój attack

shkul pluck; extirpate

mbjell sow; plant hyjnór heavenly
aromatík aromatic dégë branch

fishk wither; make dry më párë before ujít water
diellúar sunned brej gnaw
krrimb worm ndáhem am separated
mbasí after përqafój embrace
puth kiss
shtrëngój squeeze mbésë niece
çmállem fulfill one's longing

i neverítur abandoned

mënyrë, pa marrë me vete...as edhe tesha e sende, që të ma mbajnë gjallë dashurinë dhe kujtimin e këtij vendi, nëpër shtigjet e skutat e mërgimit.

Ora po avitet. Duhet të iki e t'i them lamtumirë kësaj jete për të nisur një tjetër në dhe të huaj. Lamtumirë, pra, ti moj dhoma ime që gjatë 17-18 vjeteve të vajzërisë më përkëdhele. Lamtumirë ti moj shtëpia e zemrës sime... Lamtumirë, o ju tesha e orendi, që më keni shërbyer gjatë jetës sime; lamtumirë, o ju lulet e fishkura të kopshtit tim të dashur, që ju shërbeva me kujdesin e nënës për fëmijën e saj; lamtumirë, o ju dritare, mure, tjegulla e gurë të kësaj banese që kujtimin e saj të dashur kurrgjë s'do të mundë ta shlyej nga mendja e nga zemra ime. Po falem para teje, o tempull i jetës sime; po gjunjëzohem para teje, o altar i ndiesive të zemrës sime dhe, si shenjë mirënjohje e nderimi, po të dhuroj disa pika lote të përcjellur me psherëtime të ngrohta.

Lamtumirë.....

téshë clothing; garment

shtígje (shteg) trails skútë hiding place mërgím life abroad avít draw near lamtumírë farewell

moj (term of intimate address) hey you! vajzërí girlhood përkëdhél fondle; caress tésha possessions; belongings orendí furnishings shërbýer (shërbéj) served i físhkur withered kopsht garden i dáshur dear; beloved dritáre window tjégull tile; brick kurrgjë nothing shlýej erase; cancel témpull temple gjunjëzóhem kneel altár altar

mirënjóhje gratitude nderím honor dhurój present i përcjéllur accompanied

---

"Sikur të isha djalë," Haki Stërmilli, in Antologjia e letërsisë shqipe, Q. Xhomo and Dh. Qirjazi (Eds.), Tiranë, 1972, pp. 174-177. (Excerpt from a novel. Text revised to conform to standard literary Albanian).

LEXIMI I NJEZETEKATERT
(twenty-fourth)

David Selenicasi--Piktor i Madh Shqiptar

Në verë të vitit 1953, një ekspeditë e ish-Institutit të Shkencave për herë të parë deshifroi mbishkrimin e madh në murin perëndimor brënda Kishës së Shën Kollit në Voskopojë. Ky deshifrim na bëri të njohur emrin e David Selenicasit, piktorit freskograf shqiptar më të madh të shekullit XVIIItë. Përveç mbishkrimit të mësipërm, deri më sot asnjë burim tjetër nuk njihet që të flasë mbi këtë piktor.

Arti piktural i Davidit ndryshon shumë nga arti i piktorëve tonë para dhe pas tij. Kështu që shfaqja e Davidit me një art të ndryshëm tepër të avancuar, në kohën kur arti i vendit tonë ishte duke rënë, mbetet si një fenomen i cili posa u duk, menjëherë u zhduk. Për këto arsye mund të supozohet që piktor Davidi të ketë ardhur nga jashtë, nga ndonjë vend i përparuar, si p.sh. nga Ungaria, ku ai duhet të ketë perfeksionuar mjeshtërinë e pikturimit.

Veprimtarinë e tij artistike Davidi e ka derdhur vetëm brenda Kishës së Shën Kollit në Voskopojë.

Tematika e freskave të David Selenicasit është po ajo që u përdor edhe nga piktorët e tjerë shqiptarë, si edhe të huaj, nëpër kishat tona. Eshtë tematika që u zhvillua dhe u përdor gjatë shekujve në Kishën Lindore. Kjo tematikë përbëhet prej temash nga Dhiata e vjetër dhe e re, historia dhe gojëdhëna e Kishës, nga Liturgjia dhe disiplina të tjera teologjike.

Përveç temave të zakonshme nga Dhiata e re, festat e mëdha të Krishtit që lidhen drejt për drejt me dogmatikën, si Lindja e Krishtit, Pagëzimi i Krishtit, Zbritja në Ferr, Ngjallja, etj., dhe freskat e Shën Mërisë, si Lindja e Shën Mërisë, Ungjillëzimi, dhe Fjetja e Shën Mërisë, Davidi ka pikturuar skena të rralla që janë frymëzuar ose nga dogmatika ose nga tradita e Kishës dhe jeta e shenjtorëve.

piktór painter

vérë summer ekspedítë expedition ish ex- deshifrój decipher mbishkrím inscription perëndimór western shën=shenjt saint; holy Koll Nicholas Voskopójë town in southern Albania deshifrím deciphering freskográf painter of frescoes i mësípërm above-mentioned burím source

pikturál pictorial ndryshój differ; change kështú që so that shfáqje appearance tépër quite i avancúar advanced rënë (bíe) falling; declining fenomén phenomenon u duk (dúket) appeared supozój suppose

i përparúar advanced p.sh.=për shëmbull for example perfeksionój perfect; master pikturím painting veprimtarí activity derdh pour

tematíkë subject matter

shékujve (shékull) the centuries lindór eastern përbëj compose; constitute dhiátë testament gojëdhënë oral tradition disiplínë discipline

féstë holiday Krisht Christ dogmatíkë dogma pagëzím baptism zbrítje descent ferr hell ngjállje resurrection Mërí Mary ungjillëzím annunciation fjétje sleep pikturój paint i rrállë rare frymëzój inspire shenjtór saint

Përveç këtyre temave dhe shumë të tjerave të zakonshme, Davidi ka pik[illegible]ar disa skena nga jeta e Shën Kollit, [illegible] të të cilit i kushtohet kisha. [illegible] janë: «Shën Kolli ndihmon një [illegible] vobektë për të martuar vajzat,» [illegible] Kolli duke shpëtuar një njeri që [illegible] rënë nga varka në det,» «Shën Ko[illegible] duke shpëtuar nga ekzekutimi tre të dënuar me prerjen e kokës,» etj.

Gjatë shek. XVIIItë në popujt e Perandorisë Otomane arti piktural gjendet në dekadencë. Kjo ngjau gjithashtu dhe në popullin tonë. Shfaqja e David Selenicasit me një art të një niveli të lartë, shumë të avancuar në krahasim me rrethanat e vendit e të kohës, duhet të konsiderohet një fenomen. Punët e piktorëve të tjerë shqiptarë të shek. XVIIItë, nuk krahasohen aspak me punën e Davidit, dhe para Davidit tek ne nuk gjenden piktura nga të cilat ai mund të ketë mësuar e të jetë zhvilluar. Për këto arsye, është me vend të supozohet që Davidi, mbasi të ketë marrë mësimet e para të pikturimit në Shqipëri prej ndonjë piktori vendas, duhet të ketë dalë jashtë, në ndonjë qendër shumë të përparuar, ku të ketë zhvilluar dhe perfeksionuar mjeshtërinë e tij në nivelin e lartë artistik që qëndron. Eshtë vështirë të shpjegohet ndryshe shfaqja e artit të lartë të David Selenicasit tek ne në shek. XVIIItë.

Ajo që është kryesore në punët e Davidit, është dora e sigurt e tij. Davidi pikturon ato viza që dëshiron, dhe jo ato që mund të dalin pa dashje. Kjo dorë e sigurt shihet në pjesën më të madhe të figurave në punimet e tij. Se Davidi është njohës i mirë i anatomisë së njeriut, bie në sy në kokat tullace të etërve të mëdhenj me sa përsosuri janë punuar pjesët e kafkës, mollëzat e faqeve dhe pjesët e tjera të fytyrës. Bie në sy gjithashtu punimi i këmbëve të zbathura dhe i duarve të shenjtorëve.

Fytyrat e shenjtorëve të Davidit ndryshojnë individualisht njera prej tjetrës. Ato janë plot shprehje butësie

kushtój dedicate

i vobéktë poor martój marry off
shpëtój rescue; save
várkë boat
ekzekutím execution
prérje cutting off
pópujt peoples
perandorí empire
ngjan happens

nivél level
krahasím comparison rrethánë circumstance

aspák at all
gjénden exist

është me vend it is appropriate; mbási after mësím lesson

véndas local

vështírë difficult shpjegój explain ndrýshe differently; otherwise

vízë line
pa dáshje unwillingly

në pjésën më të mádhe in the greater portion njóhës knowledgeable bíe në sý one notices ("it strikes the eye") tullác bald étër (et) fathers étër të mëdhenj Church fathers ("great fathers") përsosurí perfection káfkë skull móllëz cheek bone i zbáthur barefoot

shpréhje expression butësí mildness; softness

dhe mençurie. Të rinjtë paraqiten me një pastërti shpirtërore dhe plot sinqeritet, me një plastikë të përsosur, dhe vështrim të gjallë, si portrete.

Davidi kombinon bukur shumë persona në një skenë, në lëvizje, gjeste dhe veprime të ndryshme, dhe e jep të plotë idenë e çdo skene. Davidi ka dhënë shumë skena tragjike si atë të therjes së fëmijëve në Vithleem, dhe ato të cilat e bëjnë artin e tij dramatik.

Davidi mund të konsiderohet artist i kalibrit të madh në vendin tonë, si edhe jashtë. N.V. Lazarev, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave të Bashkimit Sovjetik, kur pa punët e Davidit u shpresh kështu: «Rusia nuk ka patur një piktor kaq të madh gjatë shek. XVIIItë.» Davidi e ka brumosur artin e tij me tipare krejt realiste. Punët e tij duken si të punuar prej natyrës së gjallë. Shenjtorët duken si portrete.

Veprat monumentale të Davidit me përsosuri në art, dëshmojnë se ky mjeshtër i madh shqiptar është një nga figurat më të shquar dhe më të talentuar të kohës së tij, jo vetëm për vendin tonë, por ndoshta dhe në gjithë popujt e Kishës Lindore.

mençurí wisdom të rínjtë the young ones pastërtí cleanliness; purity sinqeritét sincerity plastíkë plasticity vështrím look portrét portrait kombinój combine lëvízje movement gjest gesture veprím action; activity
thérje slaying
Vithleém Bethlehem

kalíbër calibre
anëtár member
korrespondént correspondent
bashkím union

kaq so
brumós endow
tipár feature; trait krejt entirely; wholly

i shqúar distinguished i talentúar talented

Proverba

Kush mbjell korr.

kush he who; who mbjell plant; sow korr reap

* * * *

Unë pula s'kam, pse të zihem me dhelprën?

púlë chicken zíhem quarrel

* * * *

Ujku bari s'bëhet.

ujk wolf barí shepherd

David Selenicasi--piktor i madh shqiptar. Adapted from Th. Popa, Piktorët mesjetarë shqiptarë, Tiranë, 1961, pp. 63-68. Selection originally titled, «Piktori David Selenicasi».

LEXIMI I NJEZETEPESTE
(twenty-fifth)

Dyrrahioni-Epidamnis (Durrës)

Ky qytet i lashtë i bregdetit tonë, i njohur me emrat Epidamn e Dyrrahion, që të dy emra me prejardhje ilire, filloi të zhvillohet si qytet qysh nga viti 627 para e.r., atëhere kur pranë vendbanimit të vogël të fisit ilir të taulantëve u vendosën kolonista helenë të ardhur nga Korkyra (Korfuzi).

Për praninë e një vendbanimi ilir me emrin autokton Epidamn flasin edhe dy autorë të lashtë. Ka të ngjarë që Epidamn të quhej kodra e fortifikuar, kurse Dyrrahion pjesa e poshtme që shtrihej gjatë bregdetit; me kohë u përdor më tepër emri i fundit, prej të cilit rrjedh emri i sotëm.

Sikurse qytetet e tjera të botës së lashtë, Durrësi formonte një polis, një qytet-shtet në një rreth të ngushtë tokash, ku pushteti ishte në duar të pronarëvë të mëdhenj të skllevërve, aristokratëve, por pas luftërave civile ai u demokratizua; nënkuptohet se përsëri vazhdoi të qe në duar të pronarëve të skllevërve. Në gjysmën e shek. IV para e.r. konflikti në mes taulantëve e kolonistëve helenë gjeti zgjidhje, duke u pushtuar qyteti nga mbreti taulant Monumi.

Megjithse tërmetet dhe luftërat kanë shkatërruar monumentet e vjetra dhe po ashtu gërmimet e rregullta arkeologjike janë penguar nga vendosja e qytetit të sotshëm mbi qytetin antik, në Durrës janë zbuluar objekte të rëndësishme arkeologjike. Nëpërmjet pjesëve arkitektonike, shtyllave, kapiteleve e skulpturave mund të përfytyrohen godinat monumentale, tempujt dhe ndërtesat private që zbukuronin «qytetin e admirueshëm», për të cilin kanë shkruar shumë autorë grekë e latinë. Nëpërmjet objekteve arkeologjike që janë zbuluar dhe po zbulohen dita-ditës në Durrës, nuk mund të mos admirohen edhe aftësitë e mjeshtërve të ndërtimit dhe artistëve të qytetit, të cilët kanë ditur të krijojnë vepra të tilla arti, që nuk

i láshtë old; ancient

që të dy both prejárdhje origin
qysh since

vendbanîm habitation place fis tribe
Korkýra Corfu island
praní presence
autoktón native; indigenous
ka të ngjárë it is possible
i fortifikúar fortified
i póshtëm lower

rrjedh derive
sikursé like
formój form polís (Greek word for city) rreth ring; circle

pronár proprietor skllévër (skllav) slaves
nënkuptój infer; understand
vazhdói të qe continued to be

gjej find
zgjídhje solution pushtój occupy

tërmét earthquake lúftëra (lúftë) battles; wars shkatërrój destroy
po ashtú for those reasons; accordingly i rrégullt normal pengój prevent; hinder; obstruct
vendósje situating; placing zbulój uncover; excavate nëpërmjét through arkitektoník relating to architecture shtýllë column; pillar kapitéle (kapitál) heads of columns përfytyrój visualize
témpuj (témpull) temples zbukuró j beautify i admirúeshëm admirable

díta-dítës day by day nuk... admiróhen we cannot but admire
aftësí skill; aptitude mjéshtër mason; craftsman

qëndrojnë poshtë veprave të artistëve të tjerë të kësaj kohe.

Për të kuptuar zhvillimin dhe madhështinë që ky qytet arriti në kohët antike, mjafton të njihemi me objektet e shumta dhe koleksionet arkeologjike të Muzeut të qytetit të Durrësit dhe ato të Muzeut Arkeologjik të Tiranës.

madhështí grandeur
mjaftón it is sufficient; it suffices

Por kolonistët helenë gjetën në brigjet ilire një kulturë autoktone, e cila nuk mund të mos përfillej e të mënjanohej prej tyre dhe të mos ndikonte kështu, në njerën ose në tjetrën mënyrë në zhvillimin e mëtejshëm të kulturës së re.

nuk...mënjanóhesh could not pass unnoticed or be ignored
ndikój influence

Kultura e kolonive helene, pra edhe e Durrësit, megjithëse ruan në përgjithësi tiparet e kulturës helene, pëson ndikimet e ambientit të ri ilir, i cili reciprokisht pati një ndikim të shumëanshëm nga kultura, arti dhe sistemi shoqëror i kolonive helene. Rëndësi të veçantë, pra, për ne kanë zbulimet që janë të lidhura me kulturën autoktone të banorëve vendas. Materiale interesante në këtë drejtim kanë dhënë gërmimet në një pjesë të nekropolit, që ndodhet në perëndim të qytetit dhe që është përdorur që nga fundi i shek. IV para e.r. deri në shek. e II para e.r.

megjíthëse although
në përgjithësí generally tipár feature pësój undergo ndikím influence ambiénit environment
reciprokísht reciprocally
shumëánshëm many-sided

zbulím excavation
banór inhabitant

perëndím west
përdór utilize; use

Në varret e këtij nekropoli janë zbuluar mjaft materiale arkeologjike të çmueshme: enë balte, figurina të vogla balte, sende zbukurimi prej bronxi, hekuri, fildishi, qelqi, disa pare bronxi të prera në Durrës, gurë varresh, pranga të gjetura në këmbët e një skllavi të dënuar etj.

i çmúeshëm valuable
bálte made of mud or clay; terra cotta zbukurími decorative
bronx bronze hékur iron fildísh ivory qelq glass páre coins
i prérë minted pránga shackles
i gjétur found

Pjesa më e madhe e qeramikës, disa prej të cilave paraqiten shumë të bukura, si në formë ashtu edhe në punim të hollë, janë prodhuar në qytet, ashtu sikurse edhe figurinat prej balte, janë të punishteve të qytetit.

i hóllë thin; fine; detailed
prodhój produce ashtú sikursé édhe so also
punishte workshop

Ndër materialet e kulturës ilire paraqesin interes të veçantë një helmet, një tok zbukurime bronxi, disa enë balte dhe mjaft emra ilire. Këto materiale, jo vetëm që dokumentojnë praninë e elementit ilir në qytet, por edhe

tok group; collection zbukurím decorative item

gjallërimin e tij, futjen në Durrës të shumë elementeve të kulturës ilire.

Me shndërrimin e Durrësit në koloni romake, ku vendosen banorë të ardhur nga Italia, ndërtime të reja kryhen në qytet, për të cilat flasin të dhënat arkeologjike; kështu njihet ujësjellësi dhe monumente të tjera të ngritura gjatë periudhës së pushtimit romak.

Krahas skulpturës me temë historike gjatë pushtimit romak zhvillohet skulptura e portretit; në këtë kategori hyn portreti sepulkral i ilires Lepidia Salvia, që rrjedh nga shtresa e skllevërve të liruar të qytetit, origjinën ilire të së cilës e vë në dukje veshja e saj karakteristike ilire.

Të gjitha këto materiale provojnë zhvillimin e madh ekonomik e kulturor të Durrësit, të kësaj skele të madhe të bregdetit Adriatik, e cila ka qënë vazhdimisht pjesë e pandarë e Ilirisë, prej së cilës merrte jetë dhe gjallëri.

E një lashtësije me Durrësin është edhe vetë kalaja, e ndërtuar për të mbrojtur koloninë e re, por muret e sotshëm të kalasë nuk janë identike me muret më të lashtë, sepse qyteti është prishur e rindërtuar disa herë, bile edhe ka ndërruar vendin; kjo tregon edhe shkakun që nuk janë ruajtur ata mure të lashtë.

Që në shekujt e parë të ekzistencës qyteti i fortifikuar luajti rol me rëndësi. Ai u bë qendër e luftimeve që shkaktuan shpërthimin e luftës së Peloponezit, u rrethua e u pushtua disa herë edhe prej fiseve ilire të vendit. Me kalimin në duart e romakëve u bë qendër e rëndësishme e luftës civile midis Qezarit edhe Pompeut, kurse me ndarjen e perandorisë bizantine, qyteti u bë bazë ushtarake detare me rëndësi e Bizantit në Perëndim.

Perandori i Bizantit, Anastasi (491-518), i cili ishte vetë prej Durrësi, more iniciativën për ta pajisur qytetin me tri radhë muresh, për ta siguruar kështu kundër sulmeve të barbarëve; por ne njohim vetëm pjesërisht rrugën që ndiqnin këto mure. Pjesë e këtyre fortifikatave është pa dyshim

gjallërím vigor fútje penetration; entrance
shndërrím conversion; transformation
krýej complete; finish
të dhéna data; "givens"
ujësjéllës aqueduct

kráhas alongside

rrjedh originate; derive shtrésë stratum

véshje dress
provój testify to; prove

skélë seaport

vazhdimísht continually i pandárë inseparable gjallërí vigor; vivacity e një lashtësíje me of the same ("one") age as kalá fortress
mbroj defend
identíke identical

rindërtój rebuild bilé indeed

shkak reason

lúajti (lúaj) played

shkaktój cause shpërthím eruption

Qezár Caesar Pompé Pompey
ndárje split; division
detár naval
Bizánt Byzantium
perandór emperor Anastás Anastasius I
pajís equip; provide
rádhë row

ndíqnin (ndjek) followed
dyshím doubt

muri me kullën, që qëndron edhe sot. Një pjesë e rrethit të jashtëm të këtij sistemi fortifikimesh është muri që shihet akoma sot 7 km. larg Durrësit tek vendi i quajtur «porta romana», i cili kishte për detyrë të mbronte hyrjen nga toka në gadishullin e Durrësit.

Kalaja e Durrësit ka qënë shumë e fortë. Sipas përshkrimit të një historianeje bizantine në shek. XI, qyteti i Durrësit mbrohej nga një mur i lartë i fuqishëm, që përforcohej edhe më tepër nga kulla të larta mbi të. Muri ishte aq i gjerë, saqë mbi të mund të kalonin lehtë katër kalorës njëri pranë tjetrit hipur mbi kuaj.

Në shek. XIII u rindërtua një pjesë e mureve të kalasë, që u dëmtuan nga një tërmet i fortë. Një sërë masash për të ngushtuar e forcuar rrethin e mureve të mbrojtjes u morën dhe nga sunduesit venecianë gjatë shek. XIV-XV, dhe kështjella qëndroi më këmbë deri në pragun e pushtimit turk; megjithatë qyteti ra në duart e turqve, me të cilët filloi rënia e qytetit dhe e kalasë duke u katandisur vetëm në një katërkëndësh të ngushtë muresh.

kúllë tower
rreth ring

shíhet (shoh) is seen; appears
akóma still larg distant from

përshkrím description

i fuqíshëm powerful përforcój reinforce; strengthen
i gjérë broad; wide saqë so that
kalórës knight; horseman
hípur mounted kúaj (kálë) horses

dëmtój damage
másash of measures
ngushtój narrow forcój reinforce
sundúes ruler

prag advent; threshold

rënie decline
katandís end up; wind up
katërkëndësh quadrangle

"Dyrrahioni-Epidamnis (Durrësi)," S. Adhami, Monumente të kulturës në Shqipëri, Tiranë, 1958, pp. 33-42.

LEXIMI I NJEZETEGJASHTE
(twenty-sixth)

Dorështrënguari dhe Ziliqari

Këtu e qindra vjet më parë na ishin dy shokë, njëri më i lig se tjetri.

I pari ishte dorështrënguar dhe i pangopur, aq sa edhe botën t'i jepje, nuk thoshte «mjaft!». I dyti ishte aq ziliqar, sa pëlciste, po ta shihte tjetrin më mirë se veten e vet.

Një ditë kishin dalë që të dy për të shëtitur dhe gjatë rrugës takuan një plak, i cili u kërkoi t'i tregojnë rrugën e një katundi aty afër. Këta s'ia vunë fort veshin, por i thanë si me përbuzje: «Eja pas nesh dhe do të ta tregojmë». Pas pak arritën në vendin ku do të ndalej plaku... «Po ju lë me shëndet», u tha plaku, «edhe të mirën që më bëtë do t'jua shpërblej. Unë jam fati dhe do t'ju bëj të lumtur për gjithë jetën, prandaj zgjidhni e kërkoni ç'të doni dhe unë do t'jua jap, por duhet të dini këtë: Atë gjë që do të më kërkojë i pari, po atë gjë do t'i jap edhe të dytit, por dy herë më shumë.»

Dorështrënguari, me gjithë dëshirën që kishte për të kërkuar, e mbajti veten duke menduar se, duke heshtur, do të merrte dy herë më shumë. Prandaj u drejtua nga shoku dhe i tha: «Hajde, miku im, zgjidh e kërko sa të mundësh, se t'erdhi rasti të bëhesh i pasur për tërë jetën!» Ziliqari, që do të vdiste nga zilia, po të merrte shoku më tepër, i thotë me inat: «Kërko ti i pari». E kështu, thuaj njëri «kërko ti», thuaj tjetri «kërko ti», koha po shkonte dhe të dy miqtë na u nxehnë aq tepër, sa puna po vinte te kopaçja. Atëhere kthehet dorështrënguari dhe, si i tërbuar, i thotë ziliqarit: «Do të kërkosh, apo të ta rrëfej qejfin!», «Mirë, do të kërkoj, dhe ke për të parë se ç'farë!» dhe si i xhindosur i u drejtua fatit duke i thënë: «Më nxirr një sy!» Dëshira e ziliqarit u plotësua në çast, dhe kështu gjithë fitimi që patën ishte: njëri mbeti me një sy dhe tjetri i humbi që të dy.

dorështrëngúar miser; tightwad
ziliqár envious one

i lig bad; evil

i pangópur insatiable; greedy
aq sa so much so that
pëlcíste (pëlcás) burst

shëtís stroll
kërkój ask for; demand; seek
katúnd village
s'ia...véshin didn't pay much attention to him përbúzje scorn
éja come!

shpërbléj reward fat fate

zgjedh choose

dy hérë më shúmë twice as much

do të mérrte (marr) he would get
hájde come on!

rast chance i pásur rich

zilí envy po if
inát anger

nxeh heat up
kopáçe stick for beating
sa púna...kopáçja that they were coming to blows i tërbúar enraged
të ta rrëféj qejfín must I beat you up ke...çfárë you'll see what it is i xhindósur possessed; raving
nxirr (nxjerr) pluck

plotësój fulfull çast moment
fitím gain gjíthë...íshte all they gained was

Viti i Ri

Porsi plak me shkop në dorë
Vit' i vjetër po kalon,
Kapërxen male me borë,
Dalngadalë ai po shkon.

Vit' i ri pas tij po vjen
Plot me shpres' e lumtëri
Sende t'bukura po na bjen,
Gëzohuni, pra, o fëmijë.

pórsi like; exactly shkop stick
kalój pass; go by
kapërxéj cross; traverse

shprésë hope lumturí happiness
bje=bíe bring
gëzóhuni rejoice! pra therefore; thus

Ardhja e Dimrit

árdhje arrival

Zunë ret' edhe po shoshen,
Dbora bie me qetim,
Dheu mbulohet në të bardhë
Me një rrobë plot shkëlqim.

rétë (re) clouds shosh sift
dbórë=dëbórë=bórë qetím=qetësí serenity
rróbë robe; cloth shkëlqím brilliance

Bien flokët si pambuku
Sërë sër' e një nga një;
Bëjnë vetulla mi muret,
Ndrron fytyrë posht' çdo gjë,

flok flake pambúk cotton
sërë sër' in sequence
vétull eyebrow mi=mbi
ndrroj=ndërrój change

Zë fryn era pa pushuar,
Del veriu me tërbim,
E ngreh dborën por si pendë
E bën togje me nxitim.

pa pushúar without letup
tërbím madness
ngreh erect; raise por si=porsí
péndë feather tógje (tog) drifts
nxitím speed

Pyll' i zhveshur rri trishtuar
Sikur qan, sikur mban zi
Drurët tunden krahë ndehur,
Bëjnë lutje si njeri!

i zhvéshur bare; unclothed
i trishtúar sad mbaj zi mourn ("wear black")
drúrë (dru) trees
tund shake lútje prayer ndeh spread out

Zhduket fusha anembanë
Në syt duket porsi det,
Përtej lumi ndrit si ergjënd
Porsi gjarpër rrethon, shket!

anembánë from one side to the other; all over
syt=sýtë eyes
përtéj on the other side; over there
ergjënd=argjénd silver rrethój wind around
shket (shkas) glide; slip

Drídhen zogjtë nga të ftohtit
Porsi fleta nënë shi
Kur foleja majës shelgut
Që t'i mbrojë s'ka fuqi!

drídhem tremble
flétë leaf nënë=nën shi rain
folé nest shelg willow
Që...fuqí that hasn't the strength to protect them

Në fshat ditën duket heshtje, Sipër tymi veç rrethon; Për m'at'anë dushk' i vogël Po tund kryet e vajton!	sípër above tym smoke veç apart; only m'at'anë=më atë ánë dushk oak vajtój lament
Her' pushimit zë dëgjohet, Rrëza, kodra shpesh gjëmon, Hyn' e dalin njerëzia, Zë sëpata depërton!	her'...dëgjóhet in the quiet a voice is heard rrëzë foot of the mountain shpesh often gjëmój thunder sëpátë axe depërtój cut through zë sëpata depërton the axe begins to cut
Natën fshati fle në prehje Kudo paqe mbretëron, Nër kasollet enden ëndra, Shpresë jetë, që s'shterron.	préhje rest páqe peace nër=ndër end weave; spin éndra=ëndrra dreams shterrój dry up
Zunë retë prap' të shoshen Dbora bie me qetim, Dheu mbulohet në të bardhë Me një rrobë plot shkëlqim!	

Ndero Prindët	nderój honor prind parent
Kush më lindi, më dha dritë? Sisë kush më dha të pi? Kush më mkoi, më hapi sytë? Kush më mbajti në pëqi? Nëna ime ish ajo, Që më lindi e më do.	lind give birth sísë breast pi drink mkoj=mëkój feed pëqí lap
Kur i mitur isha djalë, Kush më rriti, më madhoi? Kush m'ushqeu e dalngadalë Më përkëmbi, më mësoi? Babai im ish, babai im, Që më rriti, më dha mësim.	i mítur innocent; simple rrit grow madhój make big; enlarge ushqéj nourish përkémb put on one's feet; stand up mësím learning
Për këta do kujdesohem, Do t'i dua që të dy, Për këta do përgjërohem, Që t'i shoh porsi dy sy.	kujdesóhem care (for) që të dy both përgjëróhem sacrifice myself shoh see; consider Që...sy that I treat them like my own two eyes

---

"Doreshtrënguari dhe ziliqari," in Abetare, Tiranë, 1958, pp. 123-124.
"Viti i ri," Ibid, p. 103.
"Ardhja e dimrit," Asdren, (slightly abbreviated), Ibid, pp. 102-103.
"Ndero prindët," Ibid, p. 99.

LEXIMI I NJEZETESHTATË
(twenty-seventh)

Rozafati

Krenare ngrihet mbi Bunën e gjerë e mbi qytetin e Shkodrës kështjella e lashtë e Rozafatit.

Kur është hedhur guri i parë në themelet e kësaj kështjelle? S'dihet. Historia e saj humbet në mjegullën e lashtësisë ilire, banorëve të moçëm të kësaj mënge.

Një gjë dihet mirë e qartë: atë e kanë pasur dikur labeatët dhe pastaj ardianët, që ishin fise të forta ilire. Në atë kohë tërë bregu i këtejshëm i Adriatikut, gjer në Tergestën e bujshme apo Trieshtën e ditëve tona, ish breg ilir. Më vonë u derdhë këtej romakët, pastaj sllavët, normanët, venetikët, turqit e shumë popuj të tjerë të huaj. Gjatë shekujve ata krepat e thatë nën muret e Rozafatit, si edhe vetë muret e kështjellës, janë lagur me përrenj gjaku të atyre që e kanë sulmuar dhe të atyre që e kanë mbrojtur. Të huajt erdhën e shkuan, kurse populli ynë mbeti ngulur në këtë tokë ilire.

Ndërtimi i kështjellës së Rozafatit ka një gojëdhënë të bukur dhe të hidhur që na ka ardhur nga lashtësia jonë.

Ja se ç'thotë kjo gojëdhënë...I ra mjegulla Bunës dhe e mbuloi të tërë. Kjo mjegull mbeti aty tri ditë e tri netë. Pas tri ditësh e tri netësh fryu një erë e hollë dhe e lartoi mjegullën. E lartoi dhe e shpuri gjer në kodrën e Valdanuzit. Aty majë kodrës punonin tre vëllezër. Ndërtonin një kështjellë. Muri, që e bënin ditën, u prishej natën dhe kështu nuk e lartonin dot.

Na shkon aty një plak i mirë.

--Puna mbarë, o tre vëllezër!

--Të mbarë paç, o plak i mirë! Po ku e sheh ti të mbarën tonë? Ditën punojmë, natën shembet. A di të na thuash ndonjë fjalë të mirë: ç'të bëjmë që të mbajmë muret më këmbë?

--Unë di,-- u thotë plaku, --po e kam për mëkatë t'jua them.

--Atë mëkatë hidhe mbi kryet tona, se ne duam që ta qëndrojmë më këmbë këtë

krenár proud Búnë river in northern Albania

hedh lay
themél foundation
mjégull fog (feminine) lashtësí antiquity i móçëm ancient

dikúr at one time
labeátë e ardiánë Illyrian tribes
i këtéjshëm in this area; on this side i bújshëm celebrated; sensational
derdh pour in; spill
sllav Slav normán Norman
venetíkë (venecían) Venetians
krep rocky slope

lag drench; water përrénj (përrúa) brooks; streams të atýre of those

ngul fix in place

gojëdhënë legend; oral tradition

ja behold; here se ç' what

i hóllë light; thin lartój raise; erect shpúri (shpíe) sent; took; conveyed májë at the top of

prish destroy; demolish

i mbárë lucky

shemb ruin; demolish

më kémbë upright; standing

po...them but it's a sin to tell you

kështjellë.

Plaku i mirë mendohet e pyet:

--A jeni të martuar, o trima? A i keni ju të tri vashat tuaja?

--Të martuar jemi,-- i thonë ata. --Edhe të tre i kemi vashat tona. Na thuaj pra ç'të bëjmë që ta qëndrojmë këtë kështjellë.

--Në doni ta qëndroni, lidhuni me besa-besë: vashave mos u rrëfeni, në shtëpi mos kuvendoni për fjalët që do t'ju them unë. Atë nga të tri kunatat, që do të vijë nesër t'ju sjellë bukën, ta merrni e ta muroni të gjallë në mur të kështjellës. Atëhere keni për të parë se muri do të zërë vend e do të qëndrojë për jetë e mot.

Tha kështu plaku e shkoi: tani u pa, pastaj s'u pa.

Vaj! Vëllai i madh e shkeli besën e fjalën. Kuvendoi në shtëpi, i tregoi vashës së vet kështu e kështu, i tha të mos vinte atje të nesërmen. Edhe i mesmi e shkeli besën e fjalën: ia tregoi të gjitha vashës së vet. Vetëm i vogli e mbajti besën e fjalën: nuk kuvendoi në shtëpi, nuk i tregoi vashës së vet.

Në mëngjes, ata të tre ngrihen shpejt e shkojnë në punë. Çekanët godasin, gurët copëtohen, zemrat rrahin, muret lartohen...

Në shtëpi, nëna e djemve s'di gjë. I thotë së madhes:

--Moj nuse e madhe, mjeshtrit duan bukë e ujë, duan kungullin me verë.

Nusja e madhe ia kthen:

--Besa, nënë, sot s'mund të shkoj, se jam sëmurë.

Kthehet i thotë së mesmes:

--Moj nuse e mesme, mjeshtrit duan bukë e ujë, duan kungullin me verë.

--Besa, nënë, sot s'vete dot, se do shkoj te fisi për të bujtur.

Nëna e djemve i kthehet nuses së vogël.

--Moj nuse e vogël...

Nusja e vogël brof më këmbë:

--Urdhëro, zonja nënë!

--Mjeshtrit duan bukë e ujë, duan kungullin me verë.

--Besa, nënë, unë vete, po e kam djalin të vogël. Druhem se do gji të pijë e qan.

mendóhem think to myself

pra then; therefore

në if
lídhuni me bésa-bésë pledge your honor to each other rrëféj tell
kuvendój discuss; converse kunátë sister-in-law
murój wall up i gjállë alive
kéni për të párë you will see
do të zérë vend will hold its place
për jétë e mot for ages
u pa (shoh) was seen

vaj! for shame, shkel violate; abuse bésë pledge
kështú e kështú thus and so

çekán hammer
godás strike; hit copëtój break into pieces rrah beat
djem (djálë) boys

mjéshtër craftsman; mason
kúngull gourd vérë wine

bésa in truth
i sëmúrë ill; sick

i mésmë middle

fis relatives bújtje lodging
për të bújtur to spend the night

brof leap
urdhëró at your service (command!)

drúhem I fear gji breast
pi drink qaj cry

--Nisu, shko, se djalin ta shikojmë ne, s'ta lemë të qajë, --i thonë të kunatat.

Ngrihet e vogla, e mira, merr bukë e ujë, merr kungullin me verë, e puth djalin në të dy faqet, niset e bie në Kazenë; që aty ngjit kodrën e Valdanuzit, i afrohet vendit tek punojnë të tre mjeshtrit: dy të kunetrit dhe i shoqi.

--Puna mbarë, o mjeshtër!

Po ç'është kështu?

Çekanët ndalen e s'godasin, po zemrat rrahin fort e fort. Fytyrat zbehen. Kur e sheh i vogli të shoqen, hedh çekanin nga dora, mallkon gurin e murin. E shoqja i thotë:

--Ç'ke ti, o im zot? Pse mallkon gurin e murin?

Hidhet kunati i madh:

--Ti paske lindur në ditë të zezë, moj kunata jonë. Ne e kemi bërë me fjalë të të murojmë të gjallë në mur të kështjellës.

--Shëndoshë ju, o tim kunetër. Po unë do t'ju le një porosi: kur të më muroni në mur, syrin e djathtë të ma lini jashtë, dorën e djathtë të ma lini jashtë, këmbën e djathtë të ma lini jashtë, gjirin e djathtë të ma lini jashtë, se djalin e kam të vogël. Kur të nisë të qajë, me njërin sy do ta shikoj, me njërën dorë do ta ledhatoj, me njërën këmbë do t'i tund djepin e njërin gji do t'ia jap ta pijë. Gjiri im u nguroftë, kështjella qëndroftë, djali im trimëroftë.

Ata e marrin nusen e vogël dhe e murojnë në themel të kështjellës. Dhe muret ngrihen, lartohen, nuk shemben më si më parë. Po rrëzë tyre gurët janë edhe sot të lagur e të myshkët, sepse vazhdojnë të pikojnë lotët e nënës për birin e saj...

Dhe i biri u rrit, luftoi e trimëroi.

nísu set off!; start off!
lémë (lë) (we) let; allow

tek where; at; to
kunétër (kunát) brothers-in-law

zbej make pale
mallkój curse

zot lord

bëj me fjálë decide; agree

shëndóshë ju may you be healthy
porosí order, instruction
i djáthtë right líni (lë) leave; let

njëri one; one of them ledhatój fondle tund rock; shake djep cradle
nguró j turn to stone
trimëró j triumph

rrëzë base; foot
i mýshkët mossy
pikój fall; drop; leak

Breshka me Shkabën

Breshka shkabës i thosh:	bréshkë turtle shkábë eagle
--Të lutem, të më mësosh	
Kështu si ti të fluturoj	
E në erë të qëndroj,	
Fusha, male e shkëmbenj,	shkëmbénj=shkëmbínj
Det e këneta e lumenj,	kënétë swamp lumén̂j (lúmë) rivers
Që të gjitha t'i shikoj,	Që...shikój That I see it all
Shpirt e zemër të gëzoj.	
I tha shkaba: --Je me mënd?	je me mënd=mend are you crazy
Mos e thuaj këtë kuvënd!	mos...kuvénd=kuvénd don't talk
Ti je bërë për në dhe,	like this
Jo për n'erë e për në re.	re cloud
Pa krahë qysh fluturon?	qysh how
Të qesh dhe kush të dëgjon.	qesh laugh at; mock të qesh...
--Jak,-- i tha breshka --më mëso,	të dëgjón whoever hears you will
Pa s'të duhenë ty ato!	laugh at you jak come on
Edhe shkaba e rrëmbeu,	pa...ató that's not for you to
E ngriti shumë nga dheu,	worry about
Gjer në qiej fluturoi	gjer në up into; up to qíej
Dhe s'andejmi e lëshoi	(qíell) skies s'andéjmi (së andéjmi)
Nukë ra më ndonjë shur,	from there núkë=nuk did not; does
Po më një të shkretë gur!	not shur sand i shkrétë wretched
Fort të larta kush kërkon,	fort...kërkón he who aims too high
Më së fundi e pëson.	më së fúndi=më në fund pësój suffer

"Rozafati," M. Kuteli, in Tregime të moçme shqiptare, Tiranë (no publication date given), pp. 13-17.

"Breshka me shkabën," N. Frashëri, in Abetare, Tiranë, 1958, p. 128.

LEXIMI I NJËZËTETETË
(twenty-eighth)

Piktorët Onufri Dhe Nikolla

Në verë të vitit 1951 një ekspeditë shkencore e ish-Institutit të Shkencave zbuloi për herë të parë në kishën e Shën Kollit të katundit Shelcan, në rrethin e Elbasanit, një mbishkrim i cili na dha emrin e piktorit tonë të madh, Onufrit.

Në verë të vitit 1956 ekspedita zbuloi në kishën e Shën Mërisë Vllaherna, në qytetin e Beratit, një mbishkrim që na bëri të njohur piktor Nikollën, i biri i Onufrit.

Mbishkrimi i parë mban datën 1554, ndërsa i dyti mban datën 1578. Mbi vjetin e lindjes dhe të vdekjes së Onufrit dhe të birit të tij Nikollës nuk mund të flitet me saktësi. Por nga datat e sipërmendur del se piktorët, atë e bir, Onufri me Nikollën, kanë jetuar edhe punuar në shekullin XVI-të.

Si Onufri dhe Nikolla përdorën tematikën e fesë në veprimtarinë e tyre, sipas traditës së Kishës Orthodhokse. Kësisoj, ata pikturuan profetët, skena të mëdha nga jeta e Krishtit, martirët e fesë kristiane, apostujtë, etërit e Kishës, asketët, etj. Zhanrën që përdorën të dy piktorët në punimet e tyre ish freska.

Arti i Onufrit është art kishëtar i Kishës Lindore, por nuk është i kufizuar prej kanuneve që impononte dikur Kisha në kohën e Bizantit. Ky është një art i krijuar nën ndikimin e kushteve të reja dhe të Rilindjes, me tipare reale, që anon më tepër nga realizmi. Këto tipare bien në sy në të gjitha punët e Onufrit. Kështu, pra profetët e Onufrit janë dhënë me plot realizëm dhe me hollësi natyrore. Pjesët e fytyrës kanë përpjesëtime të përsosura, muskulaturë të zhvilluar në mollzat e faqeve, dhe një shprehje që i bën fytyrat të gjalla. P.sh., fytyra e Profetit David ka një gjallëri dhe plasticitet që të sjell ndër mend veprën e Mikelangjelos.

Freskat e Onufrit japin tipa individuale, krejt të ndryshëm njeri prej tjetrit, me forma natyrore dhe me pozita trupore gjithashtu të natyrshme. Me fjalë të tjera, janë tipa që përfaqësojnë figura krejt të gjalla, të marrë nga jeta e përditshme. Ka mundësi që modelet për shumë figura Onufri t'i ketë marrë nga

piktór painter

vérë summer

zbulój discover; uncover

mbishkrím inscription

dátë date

nuk mund të flítet it cannot be said saktësí certainty; precision; accuracy i sipërméndur above-mentioned del se it is evident that si...dhe as...also fe faith; religion kësisój thusly

apostúj (apostúll) apostles étër (átë) fathers askét ascetic zhánrë genre fréskë fresco kishëtár religious kufizój limit; confine kanún canon imponój impose dikúr at one time

tipáre traits; features anój lean

hollësí detail; fineness
përpjesëtím proportion

gjallërí vividness; liveliness; vigor

trupór bodily i natýrshëm natural
përfaqësój represent

njerëzit e kohës së tij në Berat dhe lokalitete të tjerë, duke i veshur ata pastaj me rrobën kishëtare. Arti i Onufrit dëshmon për një kthesë në artin tonë drejt realizmit.

dëshmój testify kthésë turn

Po ashtu, edhe shenjtorët e mëdhej Onufri i punon në mënyrë realiste të theksuar. Trajtimi i tyre tregon përvojturi dhe devocion të thellë, pozita trupore të natyrshme, qoftë të krrusur ose të drejtë. Ata tregohen duke mbajtur në dorë nga një tekst liturgjik, me rrobë meshe të thjeshtë, fundet e të cilave janë në lëvizje, sikur i merr era. Të gjitha këto cilësira të punës së Onufrit na flasin për një art të lirë e të gjallë.

i theksúar pronounced; emphatic trajtím treatment i përvójtur experienced i krrúsur bent over méshë mass lëvízje movement cilësí quality; characteristic

Një nga freskat më të përsosura të Onufrit mund të quhet ajo e Shën Grigor Theologut. Në këtë freskë, mjeshtri i shquar ka ditur t'i japë figurës një pozitë të mrekullueshme, me lëvizje të matura prej plaku, me rrobë plot lëvizje, me një kombinim ngjyrash në fytyrë të përsosur, dhe me një shprehje mendimtare të lartë. Në këtë vepër, Onufri ka arritur një harmoni natyrore të çuditshme, që dëshmon për talentin e një artisti të shquar. Ai ka ditur të kombinojë si anën natyrore dhe atë shpirtërore në mënyrë artistike të dalluar. Ëmbëlsia e gamës së ngjyrave dëshmon për mjeshtërinë e lartë dhe për guston e hollë artistike të mjeshtrit të talentuar.

i përsósur perfect

dítur (di) known i mrekullúeshëm marvelous i mátur measured kombiním combination mendimtár thinker

i çudítshëm astonishing; uncanny

shpirtërór spiritual i dallúar distinguished gámë range; variety; arrangement mjeshtërí craftsmanship gústo taste

Dhe natyrën Onufri e pikturon shumë të gjallë, megjithëse ai pikturon fare pak objekte nga natyra. Për shembull, po të vështrojmë Shën Gjergjin në kalë, të bie në sy gjallëria e kalit i cili, i trembur nga kuçedra, ka ngritur këmbët e para dhe hingëllon me fuqi. Skena është tepër e gjallë. Kali zgurdullon sytë dhe nga vrimat e hundëve i del fryma si tym.

fáre pak very few

vështrój view; examine tremb frighten kuçédër dragon hingëllój neigh me fuqí powerfully zgurdullój sýtë roll up the eyes from an emotional or physical disturbance húndë nose vrímat e húndëve nostrils frýmë breath cilësój characterize vizatím drawing i përpíktë precise

Freskat e Onufrit dhe të Nikollës i cilëson vizatimi i përpiktë, përpjesëtimet e rregullta, plastika e lirë, pozitat dhe lëvizjet natyrore, gama harmonike e ngjyrave, dhe mbi të gjitha shprehja e thellë plot jetë e fytyrave.

i rrégullt ordered; regular vléftë value

Vlefta e madhe e këtyre piktorëve nuk qëndron vetëm në cilësitë artistike që theksuam. Ata njëkohësisht kanë qënë dhe zotrues të mirë të teknikës së vështirë të

theksój stress; emphasize njëkohësísht at the same time

punimit të freskut dhe të harmonizimit të
të gjithë skenave në një lidhje kronologjike
dhe ideologjike, në një ansambël me qëllim
të qartë, për të bërë efektin didaktik dhe
artistik.

Piktorët tanë Onufri dhe Nikolla mund të
quhen artistë të Kishës Lindore, të frymëzuar
prej ideve të Rilindjes; piktorë me imagjinatë
të fuqishme dhe vullnet të lirë, që e kanë
brumosur artin e tyre me tipare të reja duke
i përpunuar ato sipas kushteve të kohës dhe
të vendit të tyre.

lídhje liaison

i fuqíshëm powerful vullnét
will brumós temper; mold
përpunój refine; utilize

Gëzuar, Vëllezër

U veshën bimët
Me lule, gjeth,
Pa nisi flutura
Mbi 'to po breth.

pa then (intensifier)
flútur butterfly breth=
bredh roam

Filloi moti,
U ngroh kudo,
Dallëndyshe e bukur
Këtej urdhro.

dallëndýshe swallow (bird)
urdhró=urdhëró welcome

E zogjtë kthehen
Varg nga mërgimi,
Në vendin tonë
Lindi gëzimi.

varg in formation

Kthehet dallëndyshja,
Lejleku vjen,
Pranvera jonë
Sa zogj po bjen.

lejlék stork

Pranver' e bukur
Bilbilin zgjoi,
Pemë më pemë
Kënga filloi.

bílbil nightingale zgjoj
awaken pémë më pémë from tree
to tree

Me to dhe puna
Nisi ndër ara.
Gëzuar pranverën!
Vllezër, përpara!

vllézër=vëllézër
përpára onward

"Piktorët Ónufri dhe Nikolla," adapted from Th. Popa, Piktorët mesjetarë shqiptarë, Tiranë, 1961, pp. 37-59. Originally titled "Onufri dhe biri i tij Nikolla."

"Gëzuar vëllezër," in Abetare, Tiranë, 1958, p. 107.

LEXIMI I NJEZETENENTE
(twenty-ninth)

Zbritja

Lart, mbi majat e maleve, u duk një aeroplan reaktiv. Pasi bëri disa rrathë në atë qiell të kaltër vere, ai çau përpara si shigjetë argjendi. Kapiten Bujar Mersini po kthehej në aerodrom. Nga ato lartësi prej mijra metrash ai kundronte tokën me kënaqësi: çatitë e shtëpive dukeshin fare të ulta, mbi to disa fjolla resh të bardha fluturonin me përtaci drejt perëndimit.

Detyrën e kishte kryer dhe duhej të kthehej në aerodrom. Ai vështroi instinktivisht tri llampat me të cilat do të kontrollonte hapjen e rrotave. Porsa të ulej dorëza, ato duhej të jepnin dritë të kuqe, por...ç'po ngjiste kështu?! Dorëza mezi lëvizi nga vendi dhe u ndal. Nga llampat vetëm njëra u ndez me dritë të kuqe, kurse dy të tjerat, të krahëve, ishin bllokuar me siguri. Në fillim ai dyshoi se mos qenë djegur llampat dhe për t'i kontrolluar shkeli sustën e tyre. U ndezën menjëherë. Pas kësaj u mundua të mbyllte rrotën e hundës por më kot. Dorëza nuk lëvizte nga vendi. Ajo, si më parë, qëndronte pak më poshtë pozicionit «neutral.»

Pra, gjithçka ishte e qartë: Ai nuk mund të hapte dy rrotat e krahëve e ndërkaq as që mund të mbyllte rrotën e hundës. Në këtë gjendje ulja ishte e pamundur. Sikur të mos hapej asnjë rrotë, ai do ta kishte më të thjeshtë. Në raste të tilla aviatori e drejton aeroplanin gati paralel me sipërfaqen e tokës dhe e ndalon diku në mes të aerodromit. Kjo ka ndodhur, por të ulesh duke patur të hapur vetem rrotën e hundës, është e vështirë: Aeroplani reaktiv në raste të tilla përmbyset dhe piloti rrezikohet.

--Këtu treqind e treshi,-- njoftoi ai tokën me radio. --Rrotat e krahëve nuk më hapen. Llampat e kuqe nuk u ndezën të gjitha. Presioni në rregull. Dorëza e rrotave ka lëvizur pak më poshtë pozicionit «neutral» dhe është bllokuar.

--Mbaj gjakftohtësinë!-- u përgjegj zëri i njohur i udhëheqësit të fluturimit. --Përpiqu edhe një herë!

U mbështet në fron me forca të këputura dhe vështroi atë dorëzë të pabindur. E dinte se ajo ishte e palëvizëshme, sado që të mundohej ai, e megjithatë, sikur të hapej...

zbrítja the descent; the landing

reaktív jet pasí after disá several;a few rrathë (rreth) circles i kaltër blue çaj shoot; break open shigjétë arrow argjénd silver lartësí altitude; height kundrój survey; observe carefully çatí roof i úlët low fjólla (fíje) wisps; strands resh (re) of clouds përtací laziness drejt toward krýej finish; complete vështrój observe; look instinktivísht instinctively llámpë lamp; light kontrollój control; check hápje opening rrótë wheel porsá as soon as ul lower dórëz handle po ngjíste (ngjaj) was happening lëvíz move ndez light; ignite i fíkur extinguished; out bllokój block dyshój doubt; suspect, shkel step on; punch sústë button;spring mundóhem try mbyll shut; lock gjithçká everything ndërkáq meanwhile gjéndje situation úlje descent e pamúndur impossible sipërfáqe surface diku somewhere

përmbýs crash rrezikój endanger; threaten treqínd 300 njoftój inform

presión pressure rrégull order

mbaj gjakftohtësínë! keep cool! i njóhur familiar udhëhéqës traffic controller; guide fron seat i këpútur exhausted; depleted i pabíndur unruly i palëvízshëm immobile

--Ja,-- mendoi me vete, --tani do ta ul dorëzën dhe dritat e kuqe do të çelen!...

Zgjati dorën, e kapi fort atë dhe e shtyri, një herë poshtë e përsëri lart, por ajo, si gjithmonë, qëndronte në vend, kryeneç.

--E në je ti një herë kokëfortë, unë jam njëqind herë--tha me inat. Pastaj e tundi disa herë në të dy drejtimet.

Kësaj here e kuptoi në gjithë qënien e tij rrezikun që i kërcënohej.

«Po sikur të mos hapen rrotat» mendoi ai i shqetësuar dhe e ngriti avionin lart, shumë lart.

Vështrimi i tij rrëshqiti nga perëndimi. Diku në breg të detit në plazh ishin e shoqja dhe e bija. Ato mbase qeshnin në atë çast kaq të vështirë për të. Para syve, si në ekran, i kaloi gjithë jeta e tij; fëmijëria, dëshira për t'u bërë aviator, martesa me Lilin...Pastaj iu kujtua vajza e përsëri Lili. Ndërkaq aeroplani ishte ngritur shumë lart. Aty poshtë shtrihej atdheu...

Ndërsa aeroplani fluturonte atje në qiell pa mundur të ulej në aerodrom, kapiten Bujar Mersini mendonte me vete zgjidhjen e këtij problemi të koklavitur. Si do t'i vinte halli! Me sa duket do të qe e nevojshme të hidhej me katapultë nga aeroplani.

«Mirë, po a bëra unë gjithçka për shpëtimin e tij?» mendoi i shqetësuar. I dukej se po të përpiqej mund të gjente një rrugëdalje për të shpëtuar të dy. Mirëpo koha s'priste që të merrej me arsyetime. Pilotit gjithnjë i duhet të vendosë në çast.

--Këtu treqind e treshi-- njoftoi tokën me radio. --Përpjekjet nuk dhanë asnjë përfundim. Rrotat vazhdojnë të mos hapen.

--Sa karburant ju ka mbetur?-- pyeti udhëheqësi i fluturimit.

--Edhe dy-tri xhiro.

--Treqind e treshi-- urdhëroi ai, -- hidhu me katapultë! Aeroplanin drejtoje në një vend që të mos ketë rrezik për popullsinë.

--Më lejoni të bëj dhe një përpjekje.

--Mirë. Kalo mbi aerodrom që t'i shohim rrotat edhe ne.

Ai buzeqëshi. « Kujtojnë se jam hutuar» mendoi dhe drejtoi aeroplanin mbi

zgjat extend kap grasp
shtyj shove; push
kryenéç stubborn
e në well if kokëfórtë hard-headed inát anger
tund shake drejtím direction
qënie being
rrezík danger kërcënój threaten i shqetësúar worried

vështrím look rrëshqíti (rrëshqás) slipped; glided
plazh beach mbáse perhaps

ekrán screen fëmijërí childhood

zgjídhje solution
i koklavítur complex si do t'i vínte hálli! how would it all end! me sa dúket it seems
i nevójshëm important
katapúltë catapult (ejection seat) gjej find
mírëpo however
mérrem occupy myself
arsyetím reasoning vendós decide në çast right away
përpjékje effort

karburánt fuel
fluturím flight; flying
édhe about; even; and xhíro circle; rotation
drejtój direct; guide

lejój allow

buzëqésh smile
hutój daze; stun

aerodrom. Shokët nuk i shihte, por e merrte me mend se si e ndiqnin ata nga toka fluturimin e atij aeroplani sakat, që nuk mund të hapte rrotat e krahëve dhe as të mblidhte rrotën e hundës si një këmbë të paralizuar.

--Gjithqka e qartë, treqind e tresh!--foli udhëheqësi i fluturimit me radio, me një zë atëror. --Pra s'ju mbetet gjë tjetër veçse të hidheni me katapultë.

--Katapulta!

Kjo nuk është kurdoherë zgjidhja më e mirë. Aeroplani i ndarë nga piloti, si një send pa shpirt, këputet e bie në ndonjë vend të shkretë, duke u bërë copë-copë ndërsa ai vetë zbret ku të mundë, i mbajtur nga litarët e parashutës. Kapiten Bujari kishte patur raste të shihte aeroplane reaktivë të rrëzuar, të ndryshkur dhe të shkallmuar, të shëmtuar, si mos më keq, që fshihnin kokën nën tokë, si të turpëruar nga një fluturim pa sukses, ndërsa shokët e tyre ngriheshin në qiellin pa kufi. Jo, katapulta nuk ishte rrugëdalja më e pëlqyer. Mirëpo rasti ishte i tillë: ose të shpëtonte ai duke u hedhur me katapultë, ose të rrezikohej së bashku me avionin.

≪Po sikur të shpëtojmë.të dy≫ mendoi fluturimthi dhe nisi një bisedë me veten e tij.

≪Në ç'mënyrë?≫

≪Duke u ulur me një rrotë≫.

≪Po është e mundur kjo?≫--pyeti me vete sërishmi.

≪E pse jo?≫

≪Ti e di, s'bëhet shaka me këto punë≫.

≪Sigurisht!≫

≪Koha s'pret. Karburanti po mbarohet!≫

Ishte me të vërtetë në një gjendje të vështirë. Në ballë, në buzë dhe kudo në trup, i rrodhën bula djerse. Para syve i doli Lili; jo në plazh, po diku në aerodrom a në shtëpi. Ajo e shikonte e vrenjtur dhe gjithë ankth.

≪Ç'thua ti, Lili?≫ pyeti ai me veten e tij.

Ajo heshti. Nuk tha as po as jo. Vetëm ≪Ti e di!≫...dhe u zhduk nga përfytyrimi.

Sa e sa heroizma njeh historia e avioacionit! Shumë prej tyre kapiten Bujari i kish dëgjuar që në vogëli. Atëhere i dridhej zemra nga gëzimi kur e përfytyronte veten në vendin e pilotit. Merrni me mend njëdjalë fshatar, që edhe makina ka parë

e marr me mend imagine; guess
ndíqnin (ndjek) followed
sakát crippled

i paralizúar paralyzed

atërór fatherly s'ju mbétet gjë tjétër you have no other choice veçsé except

i ndárë separated
këpútet breaks away
i shkrétë deserted cópë-cópë smithereens litár rope

i rrëzúar crashed; downed
i ndrýshkur rusted i shkallmúar smashed i shëmtúar ugly si mos më keq an awful mess

kufí limit
mírëpo anyhow

së báshku together avión plane
po sikúr...dy but what if we can save both fluturímthi fleetingly

dúke u úlur by landing

sërísmi again

shaká joke

bállë forehead
rródhën (rrjedh) poured búlë bead
i vrénjtur frowning ankth anxiety

përfytyrím vision
sa e sa how many

përfytyrój envision dredh wring; twist
makínë machine

rrallë herë, tek vështron fluturimin e një aeroplani të zakonshëm. Në ato çaste ai nuk është më në tokë. Gishti i këmbës i vritet tek një gur, po ai e sheh dhe e ndien dhëmbjen vetëm atëhere kur aeroplani ka kaluar prapa maleve. Vetëm ahere, ai, sikur të ishte njeriu më i qetë në botë, ulet e vështron gishtin e plagosur. Kur kish lexuar «Historinë e njeriut të vërtetë» kish thënë se ai ishte libri më i mirë.

gisht toe; finger vrítet (vras) hurt; is wounded

Atje në fluturim, iu kujtua ky mendim naiv i fëmijërisë dhe, me gjithë tensionin e lartë nervor që e kishte pushtuar, u mundua të buzëqeshte.

«Duhet ta shpëtoj patjetër aeroplanin, -- tha me vete dhe vendosi. Do të ulem me një rrotë!...»

patjétër without a doubt

«Zjarri!» «Zjarri!» --thirri ai udhëheqësin e fluturimit. --Urdhërin tuaj për hedhje me katapultë e mora por...më lejoni të bëj «ulje të detyruar»...

E ngriti avionin tepër lart, shtrëngoi rripat fort pas trupit për të përballuar inercinë, përpiu me sy atë qiell të kaltër dhe pastaj u lëshua teposhtë. Aeroplani reaktiv nuk është makinë, por një qënie me shpirt, një shok besnik për aviatorin që fluturon me të. Mjafton një lëvizje e dorëzës dhe ai shkon nga të duash, majtas, djathtas, lart, poshtë me shpejtësinë e zërit, si një predhë e drejtuar nga një dorë e sigurt. Kësaj here s'donte të bindej. E megjithatë kapiten Bujari nuk ishte zemëruar aspak me të për punën e rrotave. Kushedi se si e kishte hallin. Ai nuk e kishte lënë kurrë në baltë. Edhe kësaj here nuk duhej ta turpëronte. O sot, o kurrë!

úrdhër order hédhje jumping úlje landing úlje të détyruar forced landing rrípa (rrip) harnesses; belts përballój resist; confront inercí inertia përpí absorb; suck in tepóshtë downward

mjaftón it is sufficient; enough májtas to the left djáthtas to the right shpejtësí e zérit speed of sound prédhë shell bind persuade i zemërúar angry aspák (not) at all kushedí who knows se...hállin what bothered it o sot, o kúrrë it's now or never

Ja toka. Reaktivi po zbriste me shpejtësi drejt saj.

Ai ndjente si nga lart uturimën e shurdhër të motorave. Me trupin e anuar pak nga e majta vështronte poshtë me vëmendje të përqëndruar. Aerodromi, si një qilim i gjelbër, po afrohej. Konturet e tija po bëheshin gjithmonë e më të qarta. Piloti përcaktoi vendin ku do të ulej dhe parashikoi afërsisht se ku do të ndalej aeroplani. Ai e ngadalësoi shpejtësinë në minimum, e megjithatë toka po afrohej me një shpejtësi të llahtarshme. Një çast dhe ai u ndodh mbi të. E kuptoj menjëherë se ndjeu një tronditje të fortë që s'e kish provuar kurrë. Aeroplani, si kalë i azdisur, çau përpara me shpejtësi duke e tërhequr trupin

uturím roar i shúrdhër deafening anúar bent vëmendje attention i përqëndrúar concentrated qilím carpet i gjélbër green kontúr contour parashikój predict; foresee afërsísht approximately ngadalësój slow down i llahtárshëm terrifying

trondítje shaking provój experience i azdísur rabid; uncontrollable

osh pas tokës, por nuk u përmbys. Hunda e tij ishte kthyer nga qielli me një farë këndi, sepse mungonin rrotat e krahëve. Përshkoi kështu i plagosur disa dhjetra metra, që dukej se s'do mbaronin kurrë, dhe u ndal.	osh draggingly fárë sort; kind kënd angle përshkój cross; penetrate
Piloti u mbështet i lodhur pas kabinës.	kabínë cabin
Sikur ta linin, ai nuk do të dilte që andej për një copë herë. U përmend vetëm kur ndjeu zërat e shokëve, që bëheshin gjithmonë e më të fortë. Aviatorët e duan shurë njëri-tjetrin. E nxorën jashtë, e puthën. Ai hapi sytë, pa atë qiell të kaltër dhe e gëzua. Do të fluturonte përsëri...	përméndem come to; wake up

---

"Zbritja," Aleks Luarasi, in Tregime të zgjedhura, (Biblioteka e rinisë), Tiranë, 1967, pp. 90-96.

LEXIMI I TRIDHJETE
(thirtieth)

Unë dhe Delikatja

Letra e parë

Mirëmbrëma Bimi!

Po të them mirëmbrëma, se dielli si një lëmsh i zjarrtë sapo u kredh në anën e përtejme të Adriatikut. Tashti është kohë pushimi. Jam ulur në një shkëmb në buzë të detit dhe po të shkruaj këtë letër. Lart nga tendat vijnë të qeshurat e shokëve, ata po bëjnë shaka, ngasin poetin. Çdo mbrëmbje ne mblidhemi përpara tendave dhe fillojmë nga shakatë. Organizator është Likja, një djalë i pakët nga trupi po i shkathët dhe punëtor. Ai të gjithëve na ka ngjitur nga një epitet, po më tepër i bie në qafë poetit.

Dëgjohet edhe melodia e këngës së studentit. Këndojnë vajzat, ato kanë ikur larg dhe shëtisin buzë detit. I kemi romantike vajzat, siç thotë Likja.

Tendat tona janë ngritur në këmbët e një kodre, mu në buzë të detit. Të gjithë këtë kodër ne do ta pastrojmë nga ferrat dhe shkurret. Pastaj do të fillojmë të hapim taracat.

Këtu do të mbillen ullinj, portókalle dhe limona. Parafytyroje sa e bukur do të duket kjo kodër e mbushur me ferra dhe shkurre, pas disa vjetësh, ku do të rriten ullinjtë, portokallet dhe limonat. Unë e parafytyroj që tani.

Çdo udhëtar që do të kalojë këndej, do të ndalet një çast dhe do të soditë i manitur kodrën e bukur, të mbjellë nga kreu deri në fund: Një radhë ullinj, një radhë portokalle dhe një radhë limona.

Kemi një javë që kemi ardhur këtu. Këto ditë kemi bërë pastrimin e kodrës nga ferrat dhe shkurret, kurse vajzát i largojnë. Ditën e parë, të them të drejtën, u tremba. Pse, ne do ta pastrojmë gjithë këtë kodër nga ferrat dhe shkurret?! thashë me vete.

M'u duk e pamundur një gjë e tillë, sepse ferrat dhe shkurret ishin pleksur me njëra tjetrën si në xhungël . Që atë ditë ka kaluar një javë dhe unë e kam ndryshuar mendimin. Deri tani kemi pastruar pjesën më të madhe të kodrës. Ka mbetur edhe një pjesë e vogël. Pas ca ditësh i japim fund edhe

delikáte delicate one
létër letter
mirëmbrëma good evening

lëmsh ball sápo just kredh plunge; dive i përtéjmë other; yonder pushím rest búzë të . détit=búzë détit seashore téndë tent i qéshur laughing

ngas tease; incite; drive djem (djálë) boys i pákët small i shkáthët lively; spirited punëtór industrious ngjit stick epitét epithet me tépër more i bíe në qáfë ("fall on the neck of"); hound shëtít walk along; stroll

mu në right at; on pastrój clear; clean férrë bramble shkúrrë brush tarácë terrace ullínj (ullí) olives (trees) do të mbíllen will be planted portokáll orange (tree) parafytyrój=përfytyrój imagine

udhëtár passerby; traveler sodís contemplate i manítur astonished kréu=krýe nga kréu déri në fund from one end to the other rádhë row jávë week Kémi një...këtú We've been here a week pastrím clearing largój carry off; remove të them të dréjtën to tell you the truth

e pamúndur impossible pleks intertwine; mingel

ca a few jap fund finish

edhe kësaj pjese.

Mirë thonë: Çfarë nuk bën dora e njeriut .

Duart më janë mbushur me flluska të bardha. Ta dish sa më djegin, sidomos kur futem në det!

Ne e fillojmë punën në katër të mëngjesit dhe e lëmë në orën dymbëdhjetë. Eh, ky gjumi i mëngjesit! Ky më ha kokën.

Mezi më çojnë shokët në mëngjes.

Nuk e di pse jam kaq gjumash...

Prandaj Likja ma ka ngjitur epitetin Morfeu .

Sapo më sheh, Likja u thotë shokëve:

--Erdhi Morfeu!-- pastaj hap gojën, sikur i vjen gjumë dhe ja bën:

--Aha!-- Aha!

Nuk e di në do të mësohem edhe unë të çohem si të tjerët në mëngjes. Tani po i jap fund letrës, se po më thërrasin shokët. Natën e mirë. Pres përgjigje.

çfárë what Mírë thónë: Çfárë nuk bën dóra e njeríut Truly, is there anything that the hand of man can't do. fflúskë blister ta dish if you only knew sidomós especially

ky më ha kókën it's killing me
çoj get up; raise
gjumásh sleepyhead

thërrás call
pres cut

Shoku yt
Faiku

* * * * *

Letra e dytë

Tungjatjeta Bimi!

Më thoshe në letër që të përshkruaj bukuritë e këtij vendi. Mbrëmjet dhe mëngjeset këtu në bregdet janë të bukura, po sidomos mëngjeset, të mahnít. Në letrën e parë të shkruaja se isha gjumash dhe nuk ngrihesha dót në mëngjes. Kurse tani çohem më parë nga të gjithë. Hip në një shkëmb që e quajnë tani ≪Shkëmbi i Morfeut≫, sepse këtu më është bërë zakon të rri gjithmonë në kohën e pushimit dhe sodis detin deri sa çohen të gjithë shokët. Deti është i qetë. Ai fle, ashtu siç fle çdo gjë në natyrë gjatë natës. Në këtë kohë ai është i pastër dhe ujët e tij është i kthjellët dhe i tejdukshëm si qelibar. Në fundin e tij shkëlqejnë miliarda kokrriza rëre, si miliarda copëza të vogla diamanti. Nga gjiri i detit del një fllad i freskët. Kjo është firoma e detit e trazuar me erën e kripës, që nëpërmjet frymëmarrjes të futet në mushkëri dhe të jep hovet dhe shqetësimet e detit. Po të kthesh kokën nga lindja, do të shikosh malet e larta, që zhveshin errësirën

tungjatjéta greetings
përshkrúaj describe

mahnít astound

hip get on; mount

është bërë has become zakón habit
i qétë calm

i kthjéllët clear i tejdúkshëm translucent qelibár amber në fúndin e tij on its bottom shkëlqéj sparkle; gleam kokrrízë grain miliárd billion rërë sand; silt cópëza (cópë) pieces diamánt diamond fllad breeze firómë breath i trazúar blended; mixed up kripë salt nëpërmjét between;

dhe në hundë do të të kilikosë një fllad i freskët i trazuar me aromën e luleve të egra, që të bën të ëndërrosh për gjërat më të bukura. Kjo është firoma e malit.

U mundova të të përshkruaj bukuritë e këtij vendi, por nuk munda. Të thashë gjëra të përgjithshme dhe të thata. Edhe pena më e hollë nuk i përshkruan dot bukuritë e këtij vendi, sepse përpara tyre mahnitesh.

Kodrën e pastruam nga ferrat dhe nga shkurret. Tani kemi filluar nga hapja e taracave. Ne, djemtë, gërmojmë me kazma, kurse vajzat heqin dheun me lopata. E kemi me normë. Mua më kanë caktuar të punoj me Delikaten. Kjo është një vajzë e bukur, me flokë të arta të lëshuara mbi supe. E quajnë Elsa, por Likja ia ka ngjitur Delikatja, dhe të gjithë i thërresin Delikatja. Elsa nuk është e pakët nga trupi. Ajo ka një trup të bukur dhe të mbushur, por ia kanë ngjitur kështu, sepse kur largonte shkurret, i zinte me majat e gishtrinjve dhe po të gërvishtej pak, shkonte menjëherë për t'u mjekuar. Të gjitha vajzat janë nxirë dhe kanë marrë ngjyrën e çokollatës. Kurse Delikatja e ka trupin të bardhë, sepse ruhet mos e zërë dielli. Kur gërmoj unë, ajo më thotë:

--E mjaft gërmove, ulu e çlodhu pak. Nuk e sheh si të janë bërë duart, do të të ënjten!

Heq nja dy-tri maja lopate me dhe, pastaj ulet dhe ia fillon muhabetit. Tregon për filmat, për artistët, për muzikën, për këngëtarët. Flet për letërsinë dhe pikturën.

Elsa tregon bukur. Ah, sikur të ishte edhe punëtore e mirë! Të gjithë në kampin tonë e plotësojnë normën, kurse unë e Delikatja nuk e kemi arritur asnjëherë. Sa turp! Po ç't'i bëj unë asaj? Ta ndjek? Kjo është gjëja më e lehtë. Vete i them komandantit të kompanisë që nuk e dua për ortak Delikaten, se nuk punon, dhe marr një tjetër. Por kjo zgjidhje nuk më duket e drejtë, prandaj nuk e kam bërë deri tani dhe as kam për ta bërë. Në urdhërin e ditës kanë dalë emrat e të gjithë atyre që nuk e kanë

frymëmárrje breath mushkërí lung hov surge; impulse; drive shqetësím disturbance; restlessness të fútet...e détit it enters your lungs and gives you a sense of the surge and restlessness of the sea zhvesh unclothe; disrobe húndë nose kilikós tickle mundóhem try i përgjíthshëm general i thátë dry pénë pen i hóllë fine

gërmój dig kázmë pickaxe lopátë shovel nórmë norm; quota e kémi me nórmë we have a quote to meet caktój assign flókë hair i lëshúar dropping; flowing

zë grab; catch gishtrínj (gisht) fingers gërvísht scratch mjekój treat medically nxij darken; blacken

rúhem watch myself mos e zërë diélli lest she get sunburned úlu e çlódhu pak sit and rest a bit! nuk e sheh si të jánë bërë dúart don't you see how your hands have become énjtem become swollen muhabét conversation
këngëtár singer

tregón búkur is a good storyteller sikúr if only plotësój fulfill

asnjëhérë never; not once sa turp how shameful po ç't'i bëj unë asáj but what can I do with her ta ndjek? fire her? i léhtë easy; light orták partner zgjídhje solution véte go

plotësuar normën nga kompanitë e tjera. Kurse emrin tim dhe të Delikates nuk e kanë përmendur deri tani. Siç duket ata kanë besim tek ne. Shokët nuk më ngasin. Kushedi, ndoshta atyre u vjen keq për mua. Më mëshirojnë. Ashtu siç mëshiroj unë Delikaten. Kjo më mundon shumë. Nuk e di si do të dal nga ky hall. Mendohu dhe ti, Bimi, dhe më shkruaj ndonjë këshillë, si të veproj në këtë rast.

Më shkruaj.

Përqafime
Faiku

* * * * *

Letra e tretë

I dashur Bimi!

Tani që po të shkruaj këtë letër, jam shumë i gëzuar dhe ja sepse:

Para disa ditësh mua dhe Delikaten na nxorën në urdhërin e ditës si dembelat më të mëdhenj të kompanisë. Shokët nuk më thanë asnjë fjalë. Por unë u mërzita shumë. Kur rashë për të fjetur, gjumi nuk më zinte, si t'ia bëja?! Me mijra mendime më vinin dhe koka më ziente, si koshere bletësh. U ngrita dhe dolla jashtë. Ishte një natë e bukur, me hënë të plotë. Freskia e asaj nate, e trazuar me erën e athët të kripës dhe aromën e luleve të egra të malit, m'i kthjelluan mendimet. Mora kazmën e lopatën dhe shkova tek vendi i punës. Më të gdhirë, kur erdhën shokët, unë i kisha shkulur rrënjët e shkurreve dhe e kisha plotësuar normën. Shokët më përgëzuan. Kurse Delikatja nuk më tha asnjë fjalë. Ajo më vështroi për një çast, pastaj mori kazmën dhe filloi të gërmojë. U ngrita t'i marr kazmën, por ajo nuk ma dha:

--Rri, se je lodhur!--më tha.

Më vonë ajo e la kazmën dhe filloi të hiqte dheun. E mora unë kazmën. Atë ditë nuk u çlodhëm fare. Unë gërmoja, kurse Delikatja e hiqte dheun me lopatë. Kur e lamë punën ishim lodhur, por nga gëzimi nuk e ndjenim lodhjen, sepse e kishim plotësuar normën qindpërqind.

Kur mbetëm vetëm, ajo m'u afrua dhe më tha:

--Të lumtë Faik!-- dhe më dha dorën.

Dora e Elsës ishte mbushur me flluska të bardha.

siç so; as
besím faith
atýre u vjen keq për múa they feel sorry for me mëshirój pity
mundój bother; trouble
hall plight; worry mendóhu think! këshíllë advice si të veprój how I should act

përqafím embrace

ja sépse here is why
pára dísa dítësh a few days ago
nxórën (nxjerr) published; brought out dembél lazy person
mërzít exasperate
ráshë (bíe) fell të fjétur (fle) to sleep si t'ia béja what was I to do ziéj bùzz; boil; cook
koshére hive blétësh of bees
freskí freshness
i áthët tart

kthjellój clarify; clear up

shkul uproot; pull out
përgëzój congratulate

ndiéj feel
përqínd percent

--Si të qënkan bërë duart, moj Elsa!--
i thashë unë.

--S'ka gjë, do të më shërohen, ashtu siç t'u shëruan edhe ty! Apo i harrove të tuat?!-- më tha dhe buzëqeshi.

Duart më janë regjur dhe më janë bërë si shollë. Tani ta shtrëngosh dorën me mua, që më shisje mend atëhere!

Të nesërmen Elsa i lidhi duart me lecka dhe e hoqi të gjithë dheun.

Ne me kohë filluam ta tejkalojmë normën.

Sot në mëngjes na lavdëruan në urdhërin e ditës mua dhe Elsën. Ja sepse jam i gëzuar. Tani nuk na ngacmojnë më shokët, nuk na thonë më: «Morfeu dhe Delikatja.»

Tani po i jap fund letrës se do të shkoj në informacionin politik.

Të përqafoj
shoku yt
Faiku

s'ka gjë it doesn't matter
shërój make well të tuat yours
regj tan, as with leather
shóllë sole of foot or shoe
shtrëngój dórën shake hands
shísje (shes) sold që më
shísje mend atëhére! you who were putting on airs before!
lidh bandage; tie léckë rag; bit of cloth me kóhë very early tejkalój fulfill
lavdërój praise ja sepse that's why ngacmój tease
informaciónin polítik political discussion class përqafój embrace

---

Kam Një Mace

Kam një mace në shtëpi,
as më ha, as më pi,
po do mish e kabuni.

máce cat
as më ha, as më pi he neither eats nor drinks for me mish meat kabuní fancy dessert of rice, raisins, almonds, and meat

---

"Unë dhe delikatja," Bedri Myftari, in Tregime të zgjedhura, (Biblioteka e rinisë), Tiranë, 1967, pp. 146-152.

"Kam një mace," in Abetare, Tiranë, 1958, p. 66.

READINGS IN ALBANIAN

PART II

Leonard Newmark

Peter Prifti

Philip Hubbard

LEXIMI I TRIDHJETENJETE

Endërr e Vërtetë

Shumë herë mejtohesha: Vjete shumë shkuan që kur e kam lënë Shqipërinë. Isha djal' i vogël kur ika. Po ashtu si isha, sikur kuptoja, sikur ndjenja gjëkafshë të fshehtë, që herë më gëzonte, herë më trishtonte pa masë. Djalë mali e fushe. Natyra ish m'e para punë që më dëfrente zemrën, që më kënaqte sytë, që më hirëshonte shpirtin, prandaj një të madh trishtim ndjeva kur e lashë.

Në dhe të huaj i vajtur, domosdo u mësova me zakonet e vendit, të cilët pik' së pari më dukeshin shumë të çuditshëm. Jeta e qytetit, e shkollës pa dyshim të ndryshon, të hollon, të këmben; atje njeriu siç sheh ashtu bën; zë tjetër udhë, udhë që një të huaji mund t'i sjellë shumë të mira, po edhe shumë të liga.

Vjetet rridhnin pa rreshtur, koha shkonte, ajo kohë që i këmben të gjitha, që i harron të gjitha, që i ndryshon të gjitha. Po me tërë këto një dëshir' e brendshme e zemrës më shtynte, më shponte që t'i shoh edhe një herë ato vise, të shoh vendin e prindërve të mi q'e kisha lënë me aq mallëngjim, me aq lote; baltën e Shqipërisë, si thotë vjershëtori, nga e cila jam krijuar.

Mendja s'më rrinte më një vend; më dukej sikur nuk mund ta bëj këtë hap të rëndë, që të largohem nga ky vend ku ndodhem, ku u bëra burrë, ku u rrita, ku u madhova edhe pashë të parën shkëndijë dashurije. Më dukej sikur gjëkafshë më pengon, më ndalon që të mos largohem. Po kujtimet e vogëlisë, ata kujtime të ëmbël, që më gëzonin kurdoherë, ata kujtime të jetës së pametë, të kthjelltë, të kulluar porsi qielli i Shqipërisë në qershor, më bënin, më shtynin që t'i shoh, t'i përmend, t'i kujtoj edhe një herë.

Një mshehje e pakuptueshme më shfaqej në zemër. Trupi më çelej, më gëzohej, më kënaqej kur kujtoja se do të mund të mbush këtë dëshirë të zjarrtë të zemrës sime.

Thashë me vete: Të kapërxej male, fush' e det, të vete atje, t'i shoh të gjitha: gurët, drurët, barërat, brigjet, kodrat, t'i ngjit e t'i zbres malet, të pi ujët e kulluar të burimeve, të kqyr fshatrat për rreth, punëtorët, bagëtitë, lulet, pemët; t'i zë me dorën time, t'i ndiej, t'i përgëzoj, t'i përqafoj, të nginjem, të ngopem, të nxjerr mallin e zemrës.

Po herë-herë mendja më kthehej, zemra më trishtohej, më rënkonte. Jo, këto janë ëndërra të miturisë, të vogëlisë, të foshnjërisë; janë ëndërra të shkuara. Tashti jam i madh, ato shkuan e vanë, fluturuan, u shuan. Tashti duhet të përpiqesh, të mundohesh, të mbledhësh për rrojtje, për ushqim, për bukën e përditshme. Jam burrë, tjetër kohë, tjetër zakon, tjetër jetë. Ato ishin ëndërra foshnje, që s'di ç'është bota, ç'është mundimi për rrojtje.

Ja një burg pa mure që më pengonte lirinë, ja një gjë që më mbante në vend, ja hekura të rënda që nuk më linin të lëvizja, të mos mund të shijoj edhe një herë ëmbëlsirat e atyre kujtimeve që më dëshpëronin zemrën, që më helmonin shpirtin, që më dobësonin trupin, kur kujtoja se s'i arrija dot.

Isha në një dilemë: A më mirë midis dy gjërash, të cilat një të heq e një të shtyn? Ç'thashë: jam njeri e rroj. Sa të jem në jetë, dua që t'i jap kësaj jete ëmbëlsirën që i duhet; të jem i kënaqur. Të tjerat janë të rrena. Pra duhet të mbush dëshirën që ma do shpirti edhe zemra.

Thashë edhe bëra. Mendimet e mia u vërtetuan, se sakaq u ndodha në kufi të Shqipërisë, në kufi të dëshirave të mia, që më rrihnin zemrën dit' për ditë, orë për orë, minutë për minutë.

Ju malet e lartë me majat e mprehta,
Pyllet e dendura me vise të fshehta,
Ju burimet edhe lumenjt' e kulluar,
Që ujitni posht' e lart vendin e uruar.
Ju balt' e bekuar, vend' i trimërisë,
Atdheu i shtrenjtë, dheu i Shqipërisë,
Ju dhe Tomori mal' i shenjtëruar.
E gjithë si ç'e lashë e gjej të pa ndryshuar.
Me mall ika, me mall vij përsëri,
Ndjehem i lumtur, edhe mund të vdes tashti.

Vura dorën në ballë, qëndrova në vend. Pashë rrotull, u tunda, u shkunda, mos ndodhesha në ndonjë ëndërr, mos ishte ndonjë çudi, mos ishte ndonjë mrekulli që më gënjen sytë!? Tërë këto i gjykova, i mejtova, i kullova. Po me të vërtetë shoh se këtu ku ndodhem është dheu im, është Shqipëria. Marr udhën e gjerë, zbres malet, marr fushën. Era më dukej e ëmbël, e shijshme, e pëlqyer. Lulet rrotull lëshonin një erë të ballsamtë, që të shëron, të çel, të çmall. Vesa, që kish rënë mbi barin, shkëlqente si ca gurë të kushtueshëm; rrezet e diellit, posa kishin dalë, porsi ca shigjeta ari të derdhura begatie, më përgëzonin, më përkëdhelnin; burimet, duke rrjedhur më oshëtinin në veshët, më gudulisnin, më dëfrenin; rrëkeja që përhapej fushës porsi gjarpër e shkëlqente si argjend ashtu e derdhur midis gjelbësiravet, më kënaqte e më merrte sytë gjer së largu; natyra më ngrinte, më lartësonte, më dukej se fluturoja përpjetë, më dukej se ndodhesha me të vërtetë në ëndërrat që dëshiroja, e ndiehem i lumtur, i kënaqur, i gëzuar; edhe një shfrim i dalë nga fund' i zemrës më lehtëson nga rëndësia që më rëndonte trupin aq kohë; sikur bëhem m'i ri, sikur freskohem.

Ja Shqipëria, thashë, ja vendi ku shkova vogëlinë, që më dha jetë, që më dha dritë; ja viset që dëshiroja, q'isha djegur për to! Ja zogjtë që këndojnë dhe shqiponjat si ven' e vijnë me sulm, ja liqenet me viset e bukura, e me ujët e kulluar! Ja bagëtitë si kullosin, dhe punëtorët e gëzuar si ulen e ngrihen duke punuar me djersë, ja pleqtë me leshrat e gjata e të thinjura, ja trimat me pushkën më krahë si ecin udhës me kryelartësi, me rrobat e bardha porsi dëborë, me atë shtat të plotë, që i ngjasin Herkulit, të fuqishëm, të fortë, të bukur. Ja gratë punëtore edhe zemërmira, si rendin posht' e lart, si përkujdesen për shtëpinë, çupat të turpshme e të bukura me shtat të mermertë si t'Afroditës, të bardha si shkumb' i detit, symbëdha, cipëholla, vetullzeza, faqekuqe, si ecin me hap pëllumbi! Ja bariu i mbështetur mbi krahët me fyellin në gojë, si i bie edhe çmallet duke kënduar; dashi me këmborën që buçet gjer së largu, dhëntë të urta me shqerrat nënë hije t'atij lisi të gjerë, edhe dhitë si ngjiten nëpër shkëmbinj e drurë, që duken porsi Pan-i, shpirti i natyrës.

Ja qyteti tashti me shtëpit' e dëndura e të larta, me kishët, me minaret, që duken në eterin! Ja fshati im me shtëpitë e bardha, me kopshte të thurura, me luadhet, me vreshtat, me pemët, ja lumi, përrenjtë, brigjet, malet pertej, ja bukuria e pasosur!

Janë të gjitha në vend, si ç'i lashë prapë ashtu i shoh. Ja vendi ku lozja, ku këceja, ku zhgrryhesha! Të gjitha sikur më flisnin edhe unë i përkëdhelnja me sy, sikur këndonin edhe i dëgjoja me etje, sikur qeshnin edhe unë i përgjoja me dashuri.

Sa kujtime të pa mbaruara më përshkonin nëpër mendje. Më dukej se jam prapë foshnjë me ëndërrat e pëlqyera, e ndieja veten time të lumtur se arriva atë q'e mejtoja, q'e dëshiroja, q'e ëndërroja!

Pashë diellin si një dhisk i skuqur si perëndonte, si fshihej prapa malevet, majat e të cilëvet të ngjyruara edhe ato me një ngjyrë të kuqe të gjallë, porsi një vullkan që është në zjarr e flakë; pashë hënën porsi vashë bardhëlloshe me atë ëmbëlsirë të fshehtë q'e ka, si ndrit përmbi rrethet; yjet, kandila të pashuar si xixëllonin në qiell, era e butë si frynte e këndshme, nata si e mbuloi me fshehtësinë e thellë, gjumi si i pushtonte që të gjitha!!

.....

.....

Po kur kështu, duke u mejtuar u zgjova, edhe duke kqyrur për rreth i habitur shoh se ndodhem gjith' atje ku isha!!

1905

"Ëndërr e vërtetë," Dhimitër Fullani (Ed.), Asdreni--vepra të zgjedhura, Tiranë, 1950, pp. 152-155. The orthography has been revised to a large extent to conform to standard literary Albanian.

mejtój think
gjëkáfshë something
trishtój sadden
másë measure
dëfréj entertain; delight
hirështój grace
trishtím sadness
láshë (lë) left
domosdó wanting or not; of course
píkë point
pik' së pári at first
i çudítshëm strange; marvelous
hollój make thin; emaciate
këmbéj transform
i lig evil
rrídhnin (rrjedh) poured out; rolled on
shtyj push
shpoj pierce
prind parent
vjershëtór poet; versemaker
i rëndë heavy
shkëndí spark
kurdohérë always
i pamétë faultless; perfect
i kthjélltë clear
i kullúar pure; clear
qershor June
mshéhje feeling
i pakuptúeshëm incomprehensible
çel come alive; enliven
kujtój imagine; realize
kapërxéj cross
bárëra (bar) grasses
brígje (breg) foothills
kqyr scrutinize; examine
pémë tree; fruit
zë touch
ngij fill; satiate
rënkój groan; breathe heavily
miturí innocent youth
fóshnjërí infancy
shkúan e vánë they came and went
shúaj eradicate
mundóhem labor
rrójtje livelihood
fóshnjë infant; child
ja behold!
shijój enjoy
dëshpërój sadden
dobësój weaken

dilémë dilemma
heq pull; attract
i rrénë false

kufí frontier; border
i mpréhtë sharp; steep
lumënj (lúmë) rivers
ujít water
i bekúar blessed
i shenjtërúar holy
láshë (lë) left
rrótull around
tund shake
shkund shake out; shake up
çudí marvel; miracle
mrekullí miracle
gjykój judge
kullój sift; strain
i shíjshëm congenial
i pëlqýer pleasing
ballsám balsam
shërój cure
çmállem satisfy my longing
vësë dew
i kushtúeshëm precious
i dérdhur poured
begatí propserity; well-being
oshëtíj echo
vesh ear
gudulís tickle
rrëké stream
përhap spread out
gjelbësírë greenery
shfrim sigh
lehtësoj lighten
rëndój weigh
freskój refresh
vogëlí childhood
dëshirój desire
sulm attack
liqén lake
kullós graze
úlem sit down
pleq (plak) old men
léshra (lesh) hair; hairs
i thínjur grey
krye lartësí pride
ngjas resemble
i fuqíshëm powerful
zemërmírë good-hearted
përkujdésem care
i túrpshëm bashful
i mermértë of marble
shkúmbë foam
symbëdhá (symádh) big-eyed
cipëhóllë thin-skinned
vetullzí black-browed
faqekúq red-cheeked
hap step
pëllúmb pigeon
dash ram
këmbórë bell
buçás roar; thunder
dhën (dele) sheep
i úrtë quiet; wise
etér ether
i thúrur fenced
luádh meadow
vréshtë vineyard
përrénj (përrúa) brooks
përtéj over there
i pasósur endless

zhgrrýej roll on the ground
qesh laugh
përgjój eavesdrop
ndiéj feel
ëndërró j dream
dhisk disc
i skúqur reddened
perëndój set
fshíhej (fsheh) hid itself
i ngjyrúar colored
vullkán volcano
bardhëllósh white
rréthe surroundings
kandíl candle
i pashúar inextinguishable
xixëllój twinkle
fshehtësí concealment
pushtój capture

LEXIMI I TRIDHJETEDYTE

Fuqia e Mujit

Na ish qëmoti, andej lart, në Kladushën e Krahinës kreshnike, afër Jutbinës, një malësor që kish dy djem: Mujin dhe Halilin. Kish edhe një vajzë: Kunjën. Malësori ish i fortë, trim. Siç ish vetë, ashtu i kish edhe djemtë. Muji s'e kish moshën sa e kish shtatin. Dhe ishte i mençur, i matur, i duruar. Ashtu ish edhe Halili, i vogli. Mirëpo i ati, malësori, ishte njeri shumë nevojtar, mezi e nxirrte bukën e kripën. Kështu, sapo hodhi shtat i madhi, Muji, e u bë për punë, shkoi e u bë rrogëtar për bukën e gojës tek një zotëri. Ky zotëri ish i pasur edhe e bëri Mujin bari lopësh; i dha tufën, e dërgoi në bjeshkë të kullosë.

Këtë punë bënte tani Muji: ngrihej menatë, sapo zinin të faleshin yjet e të vogëlonte dita, vinte një krodhe bukë e ca thërrime kripe në trastë, merrte shkopin në dorë, vinte përpara lopët e zotërisë e ngjitej bjeshkëve të larta. I kulloste gjithë ditën, hante bukën e kripën, pinte ujë të ftohtë krojeve dhe prehej; s'linte rrugë e shteg pa shkelur, hidhej sot këtu, nesër përtej, e shpinte tufën nëpër kullota të mira; mbrëmave e kthente në shtëpi, tek i zoti. Ky dilte i milte e çuditej: qumështi lumë. S'kish enë ku ta vinte. Ama Mujin e mbante gjithnjë me bukë e kripë...

Sot mirë, nesër mirë, një ditë, s'di se si, Muji i humbi lopët nëpër bjeshkë. I kërkoi pas tragës, s'la lug e shteg pa shkelur, gjer në të mugëtit. Nuk i gjeti dot. Atë natë nuk u kthye në shtëpi. Qysh të kthehej vetë, pa lopët? I zoti do të bënte potere të madhe, barinjtë e tjerë, shokët, do ta qeshnin.

Si u lodh së bredhuri shteg më shteg e lug më lug, kur perëndoi dielli prapa maleve, Muji u ul i lodhur e i pikëlluar pranë një shkembi. Aty e zuri nata. Një natë e zezë pa yje, pa hënë. Me që s'kish ç'të bënte, tha të marrë një sy gjumë, të presë gjer sa të agojë dita e pastaj të dalë rishtas bjeshkëve për të kërkuar lopët.

Mirëpo te shkëmbi, ku kish ndenjur të prehej, na qenkeshin dy djepe me dy foshnja të njoma. Këto foshnja britnin e qanin me të madhe. Muji u afrua t'i shikojë. I pa se ishin shumë të mitura dhe ju dhimbsën. U përkundi lehtë djepin, i vuri në gjumë.

Pas mesnate, papritur, u dukën majë shkëmbit dy drita të bardha që të verbonin sytë. Jo, s'ishin drita, po ishin dy zana të veshura me dritë. Ato e panë Mujin tek po përkundte lehtë djepet e foshnjave, e dëgjuan tek u fliste butë, ëmbël. U çuditën dhe e pyetën:

--Cili je ti? Ç'kërkon në këtë vend? A mos ke humbur gjësend e ke dalë ta kërkosh?

--Unë jam bari lopësh, rrogëtar për bukë e kripë,--u tha Muji. --Gjithë ditën bredh bjeshkëve pas kullotave. Sot më ndodhi një e keqe e madhe: humba lopët e tim zoti e dola t'i kërkoj. Nata më zuri në këtë vend e u ula të prehem, të fle. S'munda të mbyll sy, se qanin këto dy foshnja. M'u dhimbsën e u përkunda djepet. Mezi i vura në gjumë...Po ju ç'jeni? Ç'e keni tërë këtë dritë të bardhë që ju ka veshur fytyrën e shtatin?

Ato e njohën sakaq Mujin se e kishin parë shumë herë, nga larg, bjeshkëve tek kulloste e mrizonte lopët. I thanë:

--Ne jemi zana, Muj. Dolëm, si çdo natë, lart e poshtë nëpër botë që të ndihmojmë njerëzit e mirë e të drejtë. I lamë foshnjat vetë. Ti, Muj, i paske vënë në gjumë. Rrofsh e qofsh! Na thuaj tani, O Muj, ç'kërkon të të japim ne për të mirën që na bëre? A do forcë, Muj? A do luftë të luftosh? A do mall e gjë? A do dije? A do gjuhë? Kërko ç'të duash e ne do të ta japim.

Ja ç'u thotë Muji zanave:

--Mua, moj zana të bardha, barinjtë e tjerë më ngacmojnë, më bien më qafë. A e keni në dorë të më bëni të fortë, që t'i mund të gjithë?

--Vetëm kaq do, Muj?

--Kaq.

I thotë zana zanës:

--Motër, a i japim Mujit qumësht gjiri, që ta bëjmë të fortë?

--I japim, motër.

Zanat i japin Mujit qumësht gjiri dhe e ngijnë me tri pika. Muji e ndien veten menjëherë shumë të fortë sa mund të shkulë nga rrënja një lis bjeshke. Zanat i thonë:

--Pa të të shohim, Muj, sa i fortë je tani. Kape atë shkëmb që ke pranë dhe ngreje lart.

Zanat i tregojnë Mujit një shkëmb që peshon tri pendë qe bashkë. Muji ulet, e kap shkëmbin, e shkul nga vendi, e peshon në duar, e ngre gjer te nyja e këmbës. Më lart nuk e ngre dot. E lëshon poshtë.

Prapë i thotë zana zanës:

--Duhet t'i japim edhe pak qumësht Mujit tonë që të bëhet më i fortë.

Muji pi rishtas qumësht zane, e kap shkëmbin, e peshon në duar, e ngre gjer në gju. Më lart nuk e ngre dot. E lëshon poshtë e ulet të prehet.

--T'i japim edhe pak gji Mujit tonë--thonë zanat.

I japin edhe një herë gji. Mujit i shtohet fuqia. Merr shkëmbin, e peshon mirë e mirë në duar, e ngre gjer në brez. Më lart nuk e ngre dot. Zanat e shohin e i thonë shqoja shoqes:

--Prapë duhet t'i japim gji Mujit.

Muji pi edhe një herë qumësht zane e bëhet më i fortë se një dragua. E ngre shkëmbin dhe e vë në cep të supit, e mban lart dhe qëndron shtyllë, s'tundet fare. I pyet zanat:

--Më thoni, moj zana të bardha, ku ta flak këtë shkëmb? Ta hedh në Lugjet e Verdha apo ta flak në Fushë të Jutbinës?

Zanat e shikojnë me buzë në gaz e i thonë shoqja shoqes:

--Të mos i japim më gji Mujit, se po t'i japim e shemb botën anembanë.

Pastaj zanat nisin e pyesin Mujin hollë e hollë për nënë e babë, për vëlla e motër, për gjithë Jutbinën e Krahinën. Ndërkaq hëna e bardhë, rri lart mbi krye të tyre e i kqyr si kuvendojnë. Hija e shkëmbit të madh nis e zgjatet prapa, mbi gremina. Në bjeshkë del e fryn flladi i freskët i natës. Shushurijnë gjethet e aheve, këndojnë krojet e ftohtë e ua mbajnë zërin lumenjve.

Si e pyesin mirë e mirë, ja se ç'i thonë zanat Mujit:

--O Muj, ne duam të të bëjmë vëllam. Ti ç'thua?

--Vëllam më doni, vëllam më paçi, o zana të bardha,--u thotë Muji. --Kur të jem ngushtë, do t'ju thërres të vini të më jepni dorën; kur t'ju fyejë ndokush, të më thërrisni e unë do të hidhem t'ju marr krahun.

--Të lumtë goja, vëllam: kur të jesh ngushtë, vikat e do të vimë, kur

të na fyejë ndokush, do të të ankohemi.

Kur nis të përskuqë qiellin agu i ditës, zanat marrin djepet, i varin me naplungë në shpinë e zhduken, duke lënë prapa një vilar drite. Muji fërkon sytë e mundohet të shohë se ç'u bënë zanat, po nuk shen veçse tragën e atij vilarit që tretet nëpër bjeshkë. Dhe thotë me vete: "A mos pashë ëndërr?" Shkon lan sytë në krua. Ujët e ftohtë e këndell. Aty pranë sheh një gur të madh që nuk e mbanin dot as njëzet burra bashkë. Ulet, e mbërthen me të dy duart dhe e vë në sup. Qesh e thotë: "Jo, s'pashë ëndërr" dhe e hedh gurin, që kërcen gërxh më gërxh gjersa zhduket në luginë. Oshëtijnë gjithë bjeshkët...

Del pastaj e kërkon lopët. I gjen të nginjura e sisë-plota; i merr përpara e niset për në shtëpi. Kur bie në fushë të Jutbinës, dielli ka marrë gjithë dhenë. Aty, në fushë, janë mbledhur gjithë shokët e tij, barinjtë, e lodrojnë shoq me shoq. Kur e shohin Mujin, zënë e i hedhin romuze:

--Zbrite, o ngordhaq?

Muji u vrenjt. S'u përgjegj.

--Nuk të hëngrën ujqit me gjithë lopë?

Prapë u vrenjt e prapë s'u përgjegj.

--A do të luftojmë bashkë?

Kësaj here Muji heshi e u përgjegj.

--Dua.

--S'ke frikë se të mbërthejmë me krahët për tokë?

--Jo, s'kam.

Muji përvesh llërët. Kur i afrohet bariu më i fortë e mundohet ta zërë rrokas, ta hedhë poshtë, Muji e përfshin në krahë, e hedh dhe e pret dy-tri herë në pëllëmbë, pastaj e vërvit përpjetë...

Barinjtë e shikojnë të trembur: "Ç'qenka bërë kështu Muji ynë?" dhe prapsen, kthejnë shpinën e ikin vrap.

--A ka ndonjë tjetër që do luftë?--pyet Muji.

Po s'ka kush t'i përgjigjet, se të gjithë ua kanë mbathur me të katra.

Muji merr lopët e ia shpie të zot.

--Merri, or ti, lopët e gjej bari tjetër.

Pastaj kthehet në Klladushë të shohë nënën e babën, vëllanë e motrën.

Që atë ditë Muji nis e punon për vete: gjuan bjeshkëve. Tmerrohet ujqëria kur i ndien hapin. Më tej nis e lufton për vendin e vet. Tmerrohet gjithë Kralia kur i ndien emrin.

---

1) Ky tregim është punuar simbas ciklit të këngëve kreshnike që kanë si heronj kryesorë Mujin e Halilin dhe tridhjetë trimat e Jutbinës.

2) Krahina me qendër Jutbinën dhe Klladushën është atdheu, vendi i kreshnikëve. Klladusha mbahet si vendlindja e Mujit, prandaj atij shpesh i thonë Klladushane Muji, Muji nga Klladusha.

3) Zanë-a = figurë e besimeve popullore shqiptare, e cila përfytyrohet si një vashë e bukur dhe luftarake, që u vjen në ndihmë trimave, drangojve, po që nganjëherë të shkal, të shiton. Prania e zanave e orëve dhe ndonjë figure tjetër të besimit popullor, ndihet kudo në rapsoditë e këtij cikli.

"Fuqia e Mujit," M. Kuteli, Tregime të mocme shqiptare, Tiranë (no publication date given), pp. 60-66.

qëmóti long ago
malësór mountaineer
móshë age
i ménçur wise
i mátur mature; judicious
i durúar patient
nevojtár needy
krípë salt
nxírrte...krípën earned his bread and butter
hódhi shtat grew up
rrogëtár hired hand
barí herder; shepherd
lópë cow
bjéshkë = mal mountain
kullós graze
sápo...ýjet just as the stars began to disappear
vagëllój dawn
kródhe crust
thërríme grains; bits
trástë shoulder bag
kroj [illegible]g; fountain
shteg [illegible]
shkel [illegible] on
kullótë pasture
mílte (mjel) milked
qúmështi lúmë the milk was like a river
amá yet (intensifier)
trágë footstep
lug ravine; hollow
múgët dusk
potére fuss; noise
barínj (barí) shepherds
një sy gjúmë a nap
ríshtas again
djep cradle
ju dhímbsën he felt compassion for them
përkúnd rock
paprítur unexpectedly
verbój blind
gjësénd something
bredh wander; roam
sakáq at once
mrizój put animals in the shade during the heat of the day

rrofsh e qofsh may you live long
díje knowledge
gjúhë power of speech; tongue
ngacmój tease
që...gjíthë that I may best them all
kap grab; grasp; seize
peshój weigh
péndë qe team of two oxen
nýjë ankle
gju knee
dragúa dragon
cep tip
flak fling
shemb smash
anembánë from one end to the other
hóllë e hóllë in detail
bábë = babá father
kqyr study; examine
gremínë ravine
shushuríj rustle
gjéthë leaves
ah beech
ua mbájnë...luménjve they harmonize with the rivers
vëllám blood-brother
ndokúsh someone
thërrísni (thërrás) call
të lúmtë gója well said
vikás yell

përskúq make red
ag dawn
naplúngë cheesecloth
vilár current; stream
fërkój rub
trágë imprint
tret melt
këndéll invigorate
mbërthéj grasp tightly
kërcéj bounce; dance
gërxh crag
gërxh më gërxh from crag to crag
lugínë valley
oshëtíj echo; reverberate
i ngínjur fully fed
sísë-plóta udders filled
diélli...dhénë the sun is shining all over
lodrój play
romúz barb; offensive remark
ngordháq weakling
vrénjtem frown
ujq (ujk) wolves
mbërthéj nail; pin down
përvésh roll up
llérë forearm
përvésh llérë roll up one's sleeves

rrókas by the waist
hedh...hérë throws and catches him two or three times
pëllémbë palm of the hand
vërvít fling
prápsem draw back
mbath flee; put on shoes
mbáthur me të kátra taken off like mad
ujqërí wolf world
tmerrój terrify
më tej furthermore; later on
Kralí kingdom of Slavs
simbás according to
cíkël cycle
kéngë kreshníke oral epic tradition of songs
përfytyrój envision
luftarák fighting
drangój (drangúa) dragon slayers
nganjëhérë sometimes
shkal stun
shitój wound
órë fairy

LEXIMI I TRIDHJETETRETE

Partizani i Vogël Hero

...Ecim, gjithnjë ecim. Natë. Shi.

Qentë filluan të lehin që një orë larg. Po tashti i kemi zënë pozitat. Skuadrat e sulmit janë vargosur përpara drejt kazermave. Ne jemi aty lart, në disa brigje të lëruar afër armikut. Përgatisim pozicionet për t'u mbajtur krahët shokëve që sulmojnë. Për llogoret nuk humbëm kohë, se arat janë rrethuar me çakëlle. Rregulluam sidokudo gurët dhe plloçkat dhe u shtrimë në tokën e lagur. Afër kam xha Limin. Ai ka zgjatur kokën dhe shikon përpara skuadrat e sulmit, që lëvizin si hije.

--Gjer tashti jemi mirë. Shokët janë afruar mjaft.

S'kishte mbaruar mirë fjalën xha Limi, kur një krismë pushke çau ajrin; mbas saj edhe një tjetër, edhe një e tretë. Shokët shtinë mbi rojet. Një fishek zjarri me dritë të kuqe u hodh përpjetë dhe u shtri si një gjarpër i gjatë, u ngrit ngadalë shumë lart në qiell, qëndroi aty për një çast pa lëvizur, sikur ta mbërthente njeri me dorë, pastaj filloi të rrëshqasë me shpejtësi si ylli i këputur: shenja e sulmit u dha.

Mijëra pushkë krisnë nga të katër anët. Leskoviku shkëlqeu. Qielli dukej sikur po merrte flakë e po lëshonte gjithnjë shkëndija që silleshin vërdallë në drejtime të ndryshme. Plumbat me zjarr si sprija suleshin e mbërtheheshin në muret e kazermavet të ushtarëve italianë, qindra të tjerë xixëllonin përsëri. Tri predha mortaje vërshëllyen njera mbas tjetrës dhe u përplasën mbi çatitë e kazermave. Flaka e tymi u ngritën përpjetë dhe u përhapën në qiell. Edhe tri predha të tjera goditën përsëri kazermat. Grykat e maleve oshëtitën varg njera mbas tjetrës. Lufta u ndez mirë.

Dielli porsa kishte nxjerrë synë nga maja e malit, kur në qiell lart, shumë lart, u duk një "kaçiator" italian. U vërtit e u vërtit mbi ne, lart, gjithnjë lart,--kujtonte se mos kemi edhe kundërajrorë--pastaj, si u sigurua, u ul mbi çatitë e Leskovikut, dhe filloi të hedhë si breshër plumbat e bombat. Zjarri i pushkëve u pre nga të dy anët. U shtrimë përdhe dhe ngjeshëm kokën në rrëzën e çakëllit.

Rrahu e rrahu aeroplani me bomba e me mitraloz, sa e bëri duman! U dogjën ca shtëpi aty mbi anë Leskovikut dhe tymi iu ngjit shokëve andej matanë. Po të gjithë gjallë. Asnjë i vrarë, asnjë i plagosur. Çudi, gjithë ai plumb e barut të mos vrasë njeri! Ja edhe aeroplani s'qenka gjë! Në fillim na u mblodh. Pastaj një herë,dy tri, dhe sikur u mësuam, sikur s'na bënte tërr veshi.

Mbas gjysmë ore aeroplani u zhduk prapa maleve.

--E mo, gjallë?

--Gjallë të gjithë!

Dhe lufta u ndez përsëri e ashpër, ashtu si kishte filluar.

Skuadrat e sulmit ishin shumë afër kazermave. Komandanti me atë këmbën e majtë pak të shkurtër hidhej nga një ledh në tjetrin dhe shtinte mu në frëngjitë e italianëve. Po derrat s'duan të dorëzohen! Pranë tij Zefi, me ato duar të holla dhe me atë lëkurë të ndritur e të verdhë si limon, shënon e shtie mbi italianët. Shtie rrallë, me vend, s'e prish plumbin kot, si një

luftëtar i vjetër, mejithëse ka vetëm katër muaj në çetë. Po Zefi është me të vërtetë luftëtar i vjetër; ai është rritur me pushkë krahut n'ata male të Mirditës dhe ai i di të gjitha yçkëlat e pushkës e të luftës. Prandaj edhe komandanti e mban afër. Komandantët mbajnë gjithnjë dy ose tre partizanë nga më trimat. Këta i përdorin si ndërlidhës për të shpënë e për të marrë lajme, e në shumë raste edhe për të sulmuar ndonjë llogore të fortë të armikut. Zefi është një nga këta.

Në krahun e majtë të komandantit është komisari dhe më tej Mefaili. Ata shënojnë dhe shtijnë vetëm në frëngjitë. Është dhënë urdhër sot: plumbi të zërë mish; ndryshe italianët nuk zhduken nga kazermat. Po që të mos shkojë plumbi kot, duhet të jesh shënonjës i mbaruar! Duhet ta futësh plumbin në një vrimë të vogël, sa mezi duket! Po është lehtë thua? Mirë Zefi, Mefaili, komandanti e nja njëzet partizanë, të cilëve u kanë dalë thinjët së luftuari këtyre maleve, po të tjerët që kanë dalë këto ditë në çetë?! Pa pyete Dhorin? Pa pyete Kadrinë, që s'ka as dhjetë ditë në çetë! Dhori bën ç'bën e thotë:

--More, po plumbi a bën përkulje? A të vret, kur je prapa shkëmbit?

Dhe pastaj është dhënë urdhëri që të mos shkojë plumbi kot! Po kështu do të mësohemi. Një herë, dy, tri kot, pastaj fap, e mu në frëngjitë e italianëve!

Më vonë erdhën aeroplanë të tjerë, nga një e nga një, nga dy e nga dy, jo më "kaçiatorë," po bombardonjës të mëdhenj, që nxinin në qiell si gala të tërbuara. Na hodhë e na hodhë plumba e bomba, ja kështu si shi. Po përsëri ne gjallë, as vrarë e as plagosur.

--Ikni, mo mbushuni!--u thirri xha Limi, siç rrinte më këmbë aty në mes të arës dhe u shtiu me pushkë. Pa filluam të gjithë t'u shtiem aeroplanëve. Pas pak dikush na thirri me inat:

--Po u çmendët, moreee! S'rrëzohet me pushkë, jooo! Kurseni fishekët!

Nuk shtimë më.

--He! kur s'kemi një top!--tha xha Limi duke plasur kapelën përdhe. --Pa t'ua lëshoja një gjyle e t'i bëja fërtele që në hava. Ç'e do kur s'kemi një top!

Jo top, po s'kemi as kundërajrorë, as kundërtanksa as mitraloza të rëndë, bile edhe të lehtë nja katër a pesë janë a s'janë. Vetëm një mortajë, edhe kjo harxhoi nja tridhjetë gjyle e tashti ngrohet në diell. Ne e bëjmë luftën vetëm me pushkë e me ndonjë bombë dore, që ua kemi marrë italianëve në Snosm e në Voskopojë. Po, po, italianët me aeroplanë e me çelik gjer në dhëmbë, ne me pushkë!

Një lagje e tërë e Leskovikut po vjell tym e flakë. Bombat djegëse të aeroplanëve janë hedhur brenda në qytet. Shtëpitë digjen njëra mbas tjetrës. Nëpër rrugë lëvizin njerëz. Hyjnë e dalin portë më portë si të marrë. Burra, gra, fëmijë rendin zhveshur e zbathur ndën strehët e shtëpive dhe humbasin në tymin e zi, që ngrihet lart shtëllunga-shtëllunga. Aeroplani me barku i murrmë lëshon bomba djegëse. Muret kërcasin, shkallmohen dhe shtëpitë hidhen në erë. Klithmat e fëmijëve dëgjohen gjer këtu tek ne. Dhe bombat djegëse përlajnë lagje të tëra të Leskovikut. Po barku i aeroplanit vjell, gjithnjë vjell zjarr.

Breshkat! Të vjen ndoht t'u zësh emrin në gojë!

...Djegin popullin!

Në pozicionet tona erdhi një nënë plakë me një kusi të vogël në dorë. Gulçonte. Mezi kishte shpëtuar nga zjarri:

--Ju solla qumësht, mor biro, pini!--dhe na dha kusinë. U ul pranë nesh, psherëtiu njëherë thellë dhe duke parë në qiell aeroplanin, që ulej dhe ngrihej me vërshëllima të mprehta, na tha me zë të këputur:

--Keni mendjen nga aeroplanët, se na përvëluan qafirët, na bënë hi. Ja, shikoni Leskovikun, mor biro. E bënë gërmadhë.

Psherëtiu dhe një herë dhe duke shtrënguar sytë për të mos parë atë zjarr të madh që i kish përzhitur shaminë e kokës, vazhdoi:

--Bukë s'kam, se ua dhashë të tjerëve. Po ju bjeruni qafirëve. Ashtu de! Të ngordhin në istikame!

Një bombë plasi në lagjen e përtejme të Leskovikut. Plaka u hodh përpjetë e llahtarisur.

--M'i dogjën fëmijët. Atje ra bomba, në shtëpinë e sime bije--dhe zbriti përsëri duke thirrur:

--Bjeruni qafirëve!

Më vonë erdhi edhe një fëmijë, që s'i kalonte të tetë vjetët. Zbathur me një stap në dorë e me një torbë në krah. Mezi merrte frymë. Na u afrua e na ngjiti sytë e vegjël të ndritur si qelq.

--Merrni, shokë, merrni!

Kishte qitur nga torba një krëhërkë fishekë.

--Ua kam marrë italianëve në dyqan. Po tashti dyqani u dogj. Ja atje, e shikoni? Po nxjerr akoma flakë e tym! Ndoshta edhe babai po digjet atje. Merrni dhe i vrisni italianët, se po na vrasin!

Fëmija fjaloste dhe sytë të mbushur me lot i mbante gjithnjë atje drejt dyqanit e shtëpisë, që digjej në flakë.

Italianët janë mjeshtra për të përvëluar zemrat e vogla të fëmijëve!

--Na dogjën, mo shokë, na dogjën! Po ju pse s'i vrisni? Hë? E di unë! S'keni aeroplana e fishekë! Ah! sikur të kishim një aeroplan!--dhe fshiu lotët e syve me grushtet e palarë. U ngrit menjëherë më këmbë dhe, duke përplasur pëllëmbët e duarve, na tha:

--Do të shkoj. Kam edhe dhjetë fishekë në shtëpi.

--Qëndro me ne, se do të të vrasin!-- i tha Rakoja.

--Jo! do të shkoj! I kam fshehur në hatullat...

--Qëndro!

--Po janë dhjetë fishekë, mo shokë, dhjetë fishekë! Sa italianë vriten me ta? Hë!

Na shpëtoi nga duart e ua mbathi këmbëve me të katra anës së një hendeku të vogël. Mbas një ore u kthye përsëri, po me fytyrë të nxirë e të djegur vende-vende nga tymi e nga flakët. Prej dorës së djathtë i pilonte gjak. Ish plagosur lehtë nga një predhë aeroplani.

--I solla fishekët, shokë, merrini dhe vrisni italianët...

Nuk foli më. Trupi i tij i vogël u rrëzua përdhe si pemë e këputur nga rrënjët. Ata sytë e ndritur iu venitën e iu mbyllën. E ngritëm shpejt e shpejt, i lidhëm plagën me një copë këmishë dhe ia lagëm buzët me qumështin që solli nëna plakë. Pastaj ua dhamë disa leskoviqarëve të mbetur pa shtëpi, që shkonin në një fshat aty afër.

Edhe fëmijët luftuan sot!

Na mbeti merak të gjithëve që s'ia mësuam dot emrin. Rakoja e quajti "Partizani i vogël hero". Kështu po e shkruaj edhe unë në kujtimet e mi. "Heroin e vogël!" do ta kujtojmë tërë jetën e jetës.

F. Gjata, "Partizani i vogël hero," Abetare, Tiranë, 1958, pp. 187-192.

leh bark
pozítë position
skuádër squadron
vargój arrangeñ put in line
kazérmë barrack
i lërúar tilled
përgatís prepare
sulmój attack
llogóre trench
çákëll cobblestone wall
për llogóret...çákëlle we didn't waste time digging the trenches because the fields were surrounded with cobblestone walls
sidokudó any way
pllóçkë canteen
xha uncle
krísmë gunshot
shtíe fire; shoot
rójë guard
fishék bullet
fishék zjárri flare
rrëshqás glide
kris crack; ring out (sound of a rifle shot)
shkëndí spark
vërdállë aimlessly
plumb bullet
plumb me zjarr incendiary bullet
spríjë mythological dragonlike monster
mortájë mortar
vërshëllýen (vërshëllej) whistled
përplás dash
çatí roof
grýkë valley
oshëtíj echo
u ndez mírë began in earnest
kaçiatór hunter (Italian)
vërtítem circle around
kundërajrór anti-aircraft gun
bréshër hail
përdhé on the ground
ngjesh press; compress
mitralóz machine gun
dumán bonfire
matánë on the other side
plumb lead
barút gunpowder
vras kill
na u mblodh we were frightened
s'na bënte tërr véshi we didn't pay any attention to it; it didn't bother us

e mo hey!
i áshpër rough
ledh strip of pasture between tilled fields
frëngjí loophole; small window
derr pig; swine
lëkúrë skin; hide
i vérdhë yellow
limón lemon

çétë guerrilla unit
ýçkël trick; device
ndërlídhës messenger; dispatcher
shënónjës marksman
fut put
thínjë grey hair
bën ç'bën constantly
moré look; hey
përkúlje curve; bend
fap zap
jo më no longer
bombardónjës bomber
gálë crow
íkni, mo, mbúshuni make yourselves scarce
árë tilled field
sikúr if only
rrëzój bring down
moré hey!
kurséj save
top artillery piece; cannon
kapélë cap; hat
gjýle shell
fërtéle shreds; mincemeat
havá sky; climate
kundërtánks anti-tank gun
bilé indeed
jánë a s'jánë more or less
harxhój expend; spend
po, po good grief
vjell vomit
i márrë crazy, mad
stréhë eave
shtëllúngë puff
shtëllúnga-shtëllúnga in puffs
bark belly
i múrrmë grey
kërcás crack; crackle
shkallmój destroy; smash
klíthmë scream
përláj wipe out; eradicate
të vjen...gójë it's nauseating to even mention their name
kusí pot; pail
gulçój pant; breathe hard

mor bíro dear boys
psherëtíj sigh
vërshëllím whistling
i mpréhtë keen; sharp
përvëlój burn up
gafír renegade
hi ash
gërmádhë ruin
shtrëngoj press; hold tightly; wince
përzhít singe
ashtú de that's the way; attaboy
istikám battle post
i llahtarisúr terrified
stap stick; staff
tórbë shoulderbag
e végjël (i vógël) little; small
krëhérkë round (of ammunition); little comb
krëhër comb
dyqán store
përvëlój break; scorch
hë huh
i paláre dirty; unwashed
hátulla rafters
vénde-vénde in places
i këputúr torn up
venít fade; flicker
shpejt e shpejt quickly
Leskoviqár resident of Leskovik
na mbéti merák we felt remorseful
Ráko man's name
tërë jétën e jétës forever and ever

LEXIMI I TRIDHJETEKATERT

Këngët mbi Skënderbeun

Gjatë një çerek shekulli të udhëhequr, nga Skënderbeu, shqiptarët luftuan kundër turqve dhe dërrmuan ushtritë e tyre, që ishin më të fortat e me të mëdhatë e kohës. Rreth këtyre ngjarjeve të pashoqe në historinë e kaluar të popullit tonë, ngjarje që zgjuan një admirim të madh në gjithë Evropën, u krijua një letërsi e tërë historike. Historiani italian bashkëkohësi i Skënderbeut, Antonio Sabeliko (1436-1506), na dëshmon se te Skënderbeu "populli i tij, i ushqyer me dashuri dhe admirim, shihte diçka që është mbinjerëzore dhe kujtimin e udhëheqësit të tij e përkujtonte me këngë". Epika popullore rreth Skënderbeut jetoi e gjallë edhe në shekujt që erdhën. Frano Bardhi, në apologjinë e tij të Skënderbeut, më 1636, na dëshmon për ekzistencën e këngëve mbi heroin. Edhe më 1836, dijetari francez Ami Bue thotë se në Shqipëri ekzistojnë këngë mbi Skënderbeun dhe Aranitin. Po dijetari gjerman Hahn më kot i kërkoi këto këngë në Mat, në fillimin e pjesës së dytë të shekullit XIX. Që atëhere në Shqipëri janë gjetur vetëm disa gjëra të vogla që ruajnë kujtimin e heroit. Përpjekjet e bëra nga Sektori i Folklorit të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë s'kanë pasur sukses. Këngët mbi Skënderbeun janë zhdukur. Kalimi i shekujve dhe veçanërisht sundimi i egër turk, bëri që ato të harrohen.

Për sa u takon vargjeve të pakta që janë mbledhur në Shqipëri, le të shënojmë se kemi të bëjmë me grimëza këngësh, të cilat është edhe e vështirë t'i atribuohen në mënyrë të sigurtë heroit. Njëra prej tyre duket se flet për luftën e parë të rëndësishme të Skënderbeut, atë kundër Ali pashës (1444), kurse tjetra për një rrethim të Krujës. Një këngë e mbledhur më 1949, flet edhe ajo për rrethimin e parë të Krujës (1450). Kjo këngë, megjithëse në frymën popullore, duhet të ketë qenë krijuar e botuar edhe herë të tjera.

Tetë këngë mbi Skënderbeun i botoi më 1866 De Rada, në përmbledhjen e tij "Rapsodi të një poemi arbëresh". Në këngët popullore të arbëreshëve të Italisë ruhet përgjithësisht kujtimi i luftërave kundër vërshimit turk dhe këngët që botoi De Rada, edhe pse duket të jenë krijime të tij e të ndonjë poeti tjetër arbëresh, si Anton Santori, kanë krijuar në frymën popullore dhe në bazë fragmentesh ose këngësh të plota popullore arbëreshe me karakter legjendar. Ca më shumë, ato edhe kanë qenë kënduar prej popullit. Provë se këngët arbëreshe mbi Skënderbeun janë rikrijime, është fakti se në to gjejmë elementë (si bie fjala emra personash), që janë marrë nga historianët e vonë të Skënderbeut dhe veçanërisht nga italiani Biemi (1752),--i cili edhe ka krijuar nga mendja gjëra që s'kanë të bëjnë me historinë e heroit,-- dhe fakti se ndonjë prej këngëve është një përshtatje nga historiografi shqiptar Barleti.

Këngët e botuara nga De Rada kanë një karakter lirikoepik. Në to del figura e Skënderbeut si udhëheqës popullor, luftëtar hero dhe njeri me shumë kujdes për fatet e atdheut. Kënga mbi fejesën e Skënderbeut, ku heroi kështillohet me bujarët e tij se ku ta marrë gruan dhe vendos ai vetë që të marrë arbëreshe, simbolizon jo vetëm dashurinë për vendin, po edhe idenë e bashkimit të popullit. Kënga e luftës së Skënderbeut kundër Ballaban pashës,

shqiptar renegat, është e mbushur me urrejtjen dhe përbuzjen kundër tradhtisë; Ballabanin as nuk denjon ta vrasë Skënderbeu: ai i pret veshin dhe e lë të lirë, të vejë e t'i tregojë sulltanit se si e pësoi dhe se si përfunduan lëvdatat e pashës për të pushtuar Shqipërinë. Një prej këngëve më të bukura është ajo e Skënderbeut dhe e vdekjes së personifikuar. Heroi i qëndron kësaj sypatrembur, po ai do të rrojë akoma, që të mund të ruajë atdheun aq të rrezikuar...Kënga fort e bukur mbi vdekjen e Skënderbeut, ku Lek Dukagjini del dhe lajmëron njerëzinë, duke shkulur flokët e duke çjerrë fytyrën, se Skënderbeu dha shpirt, duket të jetë një përshtatje nga Barleti...Po mënyra me të cilën "gjamon" Leka, të kujton plotësisht një zakon shqiptar, që ka vazhduar gjer në ditët tona.

Vdekja e Skënderbeut

1. Nga na vjen o tinë
   Trim o kapedan
   Vij nga ushtëria
   Nga mali Ballkan.

2. A e njef o tinë
   Trim o kapedan
   Mbret'n e Shqipërisë
   Skënderben me nam.

3. Un' e njoh fort mirë
   Bashk' jemi përpjekur
   Dhe për Shqipërinë
   Trim' i mir' ka vdekur.

4. Armiknë ç'e hëngri
   Më këmbë s'e la
   Gjer ne buz' të varrit
   Skënderbeu s'ju nda.

Këngë Lufte

1. O trima luftëtarë
   O bijt' e Skënderbeut
   Kërkoni ju shqiptarë
   Lirin' e Mëmëdheut

   Se mjaft në robëri
   O e mjera Shqipëri
   O djem rrëmbeni pushkatë
   Ja vdekje ja liri.

2. Sot lipset me flamurë
   Malit të dalimë
   Për mbi shkëmbinj dhe gurë
   Lirin' ta ngjallimë

   Se mjaft në robëri (etj.)

3. S'ju rren o shok' kjo jetë
   S'ju rren kjo robëri
   Çysh e duroni vetë
   Shqip'rinë pa liri?

   Se mjaft në robëri (etj.)

4. Ju mbetë nënë zgjedhë
   Kur bota lulëzon
   Po Shqipërin' e mjerë
   Zemra s'jua kujton?

   Se mjaft në robëri (etj.)

Zëri i Atdheut

Zër' i Atdheut po na thërret
Dhe për në luftë vrapojmë
Se ardhi koha të luftojmë
Shqipërinë ta çlirojmë.

Edhe flamuri kuq' e zi
Do t'valojë përsëri
Në të buk'rën Shqipëri
Plot me gas, me gas e me liri.

Mos u helmo se un' do shkoj
Ja ku të lë zemrën time;
Se s'duroj dot fqinjtë barbarë
Viset tona të na mbajnë.

Edhe flamuri kuq' e zi (etj.)

E bukur je kurorë
Me ar gjithë je lidhur
Po sot tinë për mua
Më dukesh fort e hidhur.

Edhe flamuri kuq' e zi (etj.)

Të Gjithë Ne O Djema

1. Të gjithë ne o djema
Të japim dorënë
Se neve jemi shokë
Me bes' e dashuri.

Eja mblidhuni këtu këtu
Eja mblidhuni këtu këtu
Eja mblidhuni këtu
Bashkë me ne.

2. Të gjithë ne o shokë
Të japim fjalënë
Për t'mjerën nënën tonë
Të bëjmë mirësi.

Eja mblidhuni këtu këtu (etj.)

3. Se fjala tonë është
"LIRI PËR SHQIPËRI"
At'herë flamuri ynë
Shkëlqen për bukuri.

Eja mblidhurni këtu këtu (etj.)

"Këngët mbi Skënderbeun," Dh. Shuteriqi et al (Eds.), Historia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1959, pp. 89-92; "Vdekja e Skënderbeut," "Këngë lufte," "Zëri i Atdheut," "Të gjithë ne o djema," Gaqo Avrazi, Këngë Patriotike, Tiranë, 1959, pp. 29, 32, 38, 39.

çerék quarter
dërrmój annihilate
i pashóq unequalled
zgjoj awaken
bashkëkóhës contemporary
i ushqýer nourished, fed
mbinjerëzór superhuman; supernatural
apologjí apology
dijetár scholar
Araníti Albanian prince of the Middle Ages
Mat region in northern Albania
sektór division; department; sector
veçanërisht particularly
bëj cause; make; do
i pákët meager
shënój note; mark
grímëz bit; piece
páshë pasha, Turkish military title
frýmë spirit, breath
përmblédhje collection
përgjithësisht generally
vërshím innundation
ca më shúmë furthermore
próvë proof
rikrijím recreation, re-make
bíe fjála for example
përshtátje adaptation
historiográf historical writer
luftëtár warrior
fejésë engagement

tradhtí treason
denjój deign, bother
pret (pres) cut
të véjë (véte) go
përfundój terminate; turn out
lëvdátë boast, praise
sypatrémbur undaunted
i rrezikúar endangered
Lek Dukagjín contemporary of Skenderbeu and law-giver for northern Albania
lajmërój announce
çjerr scratch
dha shpirt gave up the ghost
përshtát adapt; take over
gjamój lament
zakón custom

* * *

tínë = ti you
Nga na vjen o tínë where do you come from
njef = njeh know, recognize
nam renown; fame
armíknë ç'e hëngri how he ate up the enemy

* * *

bij (bir) sons
mëmëdhe motherland
ja ydékje ja lirí death or liberty
lípset it is necessary
etj. = e të tjéra etc.
rrej upset; rankle
duró j endure.

vrapój rush; dash; run
të búk'rën = të búkurën the beautiful
gas = gaz joy; enjoyment
helmój poison; cause grief; sadden
durój endure
fqinj (fqi) neighbors

LEXIMI I TRIDHJETEPESTE

Lena e Tokollarëve
(Letra nga kooperativa)

Jemi mësuar ne këtej nga kooperativat bujqësore pas një çudije, të shohim një çudi tjetër. Kohët e fundit, për shembull, pas elekrifikimit të të plotë e pas krijimit të pompave të vaditjes, që e ngrejnë ujin gjer në majë të Kamenicës, na u hap lavanderia. Vërtet kjo e fundit s'ka si krahasohet me çudinë e elektrifikimit e të pompave të vaditjes, po ja që edhe lavanderia është një çudi për huqet tona, për zakonet tona edhe që i shqetësoi tërë fshatarët, sidomos plakat e pleqtë.

--Bubu, të venë meshkuj e femra e të lahen bashkë si të dala nga nëna! Bubu, bubu, si t'u kishte plasur njerëzve fare cipa e ballit! Ku ma ke nderin, moj? Ku ma ke sedrën, moj!-- u alarmuan jo vetëm pleq e plaka, po edhe të rij e të reja.

Një kotkë iu mblodh në grykë edhe teto Lenës, së Tokollarëvet. Kur s'u bë një turp i tillë në kohë të partizanllëkut, kur qëllonte që të flinin natën partizan e partizane pranë njëri tjetrit, si do të lejohet të bëhet një gjë e tillë tani?--arsyetonte në fillim teto Lena dhe përpiqej me ato të sajat të zbuste dyshimin e shëmtuar që brente shumë fshatarë. Mirëpo vetë nuk guxonte të shkonte të lahej e as nuk i lejonte nuset e saj.

Një mbrëmje, i biri më i vogël u kthye nga puna jo si gjithnjë tërë baltë e pluhur, por i larë e i krehur pun' e madhe.

--Po ti, nga dasma po vjen?-- e pyeti Lena me një vështrim therës.

--Bëmë nga një dush në lavanderi me ca shokë. Sa mirë, e ndiej veten të lehtë pendë,-- u përgjegj ai.

Ajo tundi kokën dhe nga vështrimi i saj u shua shpotia.

--Nesër do të vij edhe unë me ty!-- e ngacmoi e shoqja.

Teto Lena sakaq i hodhi një vështrim qërtonjës: "Si do të vesh ti atje, pa vajtur më parë unë? Ç'do të thoshte bota, që nusja e Lenës harbon lakuriq me të birin në lavanderi! Sikur s'ka vend ku t'i nxjerrin sytë! Jo, jo" --këto i mendonte Lena e Tokollarëvet. Këto mendime ia kuptoi edhe i biri, edhe e reja. Mirëpo si të shkonte vetë më parë që ta provonte? "Cipëplasura!" --do ta shanin të tjerat.

Thua se u mbyll me kaq kjo punë e lavanderisë në familjen e Tokollarëvet. Mirëpo një pasdreke familja u ngrit e tëra në këmbë e alarmuar: i nipi pesëvjeçar kishte ikur fshehurazi nga kopshti më drekë dhe i kishte humbur gjurmat fare. I ranë anembanë fshatit, anembanë stallave e hangarevet; kaluan nga brigadat e punës e hipën nëpër kodrat e u futën nëpër pyjet e vajtën gjer në stanet e kooperativës, por gjurmë djalit nuk iu gjet. Sikur ta kishte përpirë dheu. U shqetësua edhe fshati.

Teto Lena nuk la vrimë pa kontrolluar në fshat, e raskapitur dhe e lodhur, me një llahtari që ia kishte mbërthyer tërë trupin: E donte atë djall nip jo vetëm pse ishte nipi i saj, --ajo shtëpinë e kishte të mbushur me nipër e me mbesa,-- por seç e donte këtë më tepër se të tjerët, se ishte më sheretli, më i zgjuar e s'linte dy gurë bashkë. Këto i pëlqenin asaj. Mirëpo ja...

--Moj, po shko gjer në lavanderi, se xheku luajnë atje kalamanjtë!--

se nga i erdhën në vesh asaj këto fjalë, ajo as që e mori vesh, po...hëhë e rendi nga lavanderia tërë djersë e pluhur e këmbëzbathur, me shaminë e kokës rënë mbi supe, me gërshetat e rrema prapa shpine, që i tundeshin andej-këndej. Sa u afrua te lavanderia, u ndal me dyshim: përpara saj ngrihej një ndërtesë si ato depot e reja të kooperativës, por me dritare të mëdha e jo aq të gjata. Sakaq i shkrepi në kokë: ja vendi ku duhet të harbonin burra e gra si të dala nga nëna! Të hynte apo të mos hynte brenda? Ç'do të thoshte bota, po ta shihte? "E shikoni që është lavire ajo edhe tani në pleqëri?" Mirëpo nga brenda dëgjoi një shushurimë të vazhdueshme dhe një oho-oho të mbytur. Mos ishte ai i paudhi, që e kishte lodhur e stërlodhur duke e kërkuar në qiell e në tokë? Mori guxim dhe kapërceu prakun e lavanderisë sikur po shkelte në një vend të mallkuar. Shushurima dhe të gajasurit po i afroheshin. Hodhi vështrimin me kërshëri anembanë: ku të jetë vallë?-- pyeti veten. Duke shkuar me ankth drejt shushurimës e gajasjes, sytë i ndeshën dhomëza të veçanta me dyer të hapura, tuba të ngatërruar që zinin fill nga një kazan i madh vënë shumë lart dhe ca si hinka me një sitë me vrima të vogla sipër, kurse dyshemetë e vogla të dhomëzave bërë tepsi me çimento. Kur iu afrua dhomëzës, që shushurinte, shtyu derën me tërsëllimë dhe ç'të shihte? Ai i paudhi, lakuriq si e kishte bërë e ëma, shllap-shllap nënë dushin e vakët luante, kërcente, hapte duart e gajasej...i vetëm në mes të stërkalave.

Asaj i erdhi hem ta ngordhte në dru, hem të qeshte. Por s'arriti të bënte as njërën e as tjetrën, se shiu i imtë e i vakët i dushit preku flokët e shaminë e rënë mbi supe, fustanin e këmishën e, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, që nga koka gjer te këmbët e bë qull.

--Mbylle, moj t'u mbylltë! Mbylle, moj të hëngërsha grurin ja mu këtu!-- klithi ajo tërë zemëratë. I nipi u pataks për një copë herë, se s'dinte as ta mbyllte dushin e as nga t'ia mbante. Por teto Lena vazhdonte të lagej e shiu i imtë që i binte mbi kokë e mbi supe filloi t'i rrëshqiste nëpër trup e ta guduliste e t'i shkaktonte mornica të forta.

--Ehe, ehe, gjyshe, si dukesh si pulë e lagur! Ehe-ehe-ehe!-- filloi ta përqeshe tani i nipi duke ardhur rrotull nëpër dhomëzën e vogël.

Teto Lena nga kjo e përqeshur e të nipit, sikur erdhi në vete. "Korba unë, si do të dal jashtë në këtë katandi që u bëra? Ja u çmend Lena e Tokollarëve! Del rrugëve me rrobat e me trupin qull! Turp, turp! U çmend e shkreta!" --ja çfarë do të thoshte bota. Ky mendim i shëmtuar e zbuti teto Lenën e filloi të nxjerrë mjaltë nga goja:

--Xhan i gjyshes, shpirt i gjyshes, mos u tremb! Pa dëgjo gjyshen: shko shpejt në shtëpi edhe më sill nga sepetja e madhe një këmishë, një shami e një fustan. Hajt t'u bëfsha kurban! Unë nuk e lë as babanë e as mamanë të të rrahin, se janë mprefur të të ngordhin në dru! Hajt, shpirt, shko sa më parë.

I nipi aq desh: lakuriq doli nga dushi e u bë erë.

Teto Lena mbeti vetëm. "Po sikur të më gjejë ndonjë në këtë hall që jam?"-- dyshoi dhe shtyu derën me forcë. Pa rrezen dhe e mbylli derën nga brenda. Tani sikur u lehtësua. Po dushi vazhdonte të binte si shi i imtë mbi kokë e mbi supe dhe merrte tatëpjetë trupit si litar. Kurrë s'e kishte parë veten aq qesharake! Guxoi dhe hoqi shaminë, hoqi fustanin, hoqi këmishën me mendimin për t'i shtrydhur.

"Korba unë, po çmendem! Jam çmendur!" --klithi dhe u mblodh kruspull e

vuri duart në gji si për të mbuluar turpin.

Por dushi vazhdonte mbi trupin e saj: ato mornica të llahtarshme, që ia përshkonin trupin në fillim, tani iu kthyen në një duguli të ëmbël dhe fërkimi i vakët sikur po e përkundte në djep: sikur po shkrihej e tëra në atë avull të hollë. Pastaj filloi të fërkojë trupin, supet, krahët, këmbët: pluhuri u tret, e rrëmbente uji tatapjetë. Tak-tak-- filloi t'i rrihte zemra me gëzim e ajo zemëratë e tërbuar, që e kishte pushtuar më parë, e ai mendim prapanik, që e kishte trullosur për lavanderinë filluan t'i treten e t'i shkrihen si pluhuri në dushin e imtë e të vakët. "Të zestë ne! Fatkeqtë ne! Ne paskemi qenë të varfër për mend e jo për ujë!" --rënkoi thellë. Trupi i saj s'kishte parë ujë dushi kurrë. Ajo vërtet kur ishte nuse e tani në pleqëri lahej, por rrallë e me sapllake e me gjym. Kurse pa shih, pa shih...sa mirë, sa të lehtë e ndiej veten, sa bukur! --belbëzonte tani me kënaqësi.

Dhe teto Lena për herë të parë e kuptoi se këtu s'kish asnjë turp. Iu mbush kraharori me një gëzim e i vinte të thërriste: "Moj korba, mos llomotitni më, po hajdeni dhe e provoni dushin e ngrohtë, e të shihni se si do të shkriheni si në ëndërr...

Kur notonte nëpër këto mendime e nëpër këto stërkala të vakëta të dushit, i nipi ia solli rrobat.

Si u vesh, doli jashtë lavanderisë serbes-serbes me të nipin për dore e mori rrugën përpjetë drejt e për në shtëpi.

--Oj, oj ti Lena e Tokollarëve në këtë vend turpi!!-- e theri mu në mes plaku i Shemove. Aty pranë ia krisën gazit disa gra.

Teto Lena mbeti në vend. Për një copë herë sikur e humbi. Pastaj, ngriti kokën lart dhe iu drejtua gravet, që gajaseshin:

--S'keni turp të turpëroheni! Shkoni në lavanderi të nxirrni edhe pisllëkun e shpirtit e mos e dëgjoni këtë plak këtu, se këtij i kanë rrjedhur ...qëkuri!

Dhe bëri tutje me hap krenar.

Mirëdita Republikë

Mirëdita, Republikë!
Këto tela tensioni të lartë që zgjaten pa kufi,
Që si nuse me tela të stolisin,
Janë nervat e tua të nderura,
Nervat e tua me çelik të salduara,
Nervat e tua të hekurta,
Shqipëri.

Mirëmbrëma, Republikë!
Shoh moshatarët
Ngjitur në shtylla,
Mbërthejnë llampa,
Mijëra dhe mijëra,
Sikur montojnë
Një qiell me yje.

Sterjo Spasse, "Lena e Tokollarëve," Nëndori (Tiranë), XVII, 10 (October), 1970, pp. 129-131; Ismail Kadare, "Mirëdita Republikë," Nëndori (Tiranë), XVI, 1 (January), 1969, p. 70. This is an excerpt from the poem, "Shënime për brezin tim" (Notes for my Generation).

e Tokollárëve of the Tokollar family
bujqësór agricultural
elektrifikím electrifivation
pómpë pump
vadítje irrigation
lavanderí public bathhouse
huq habit; mannerism
shqetësój disturb; upset
bubú good grief!
méshkuj (máshkull) males
cípë skin
si...e bállit how people have lost all sense of shame
sédër self-respect
kótkë lump
grýkë throat
této = téze aunt
partizanllék partisan era
qëllój happen
flínin (fle) slept
arsyetój reasón
zbus soften
brej gnaw
guxój dare
plúhur dust
i lárë washed
i kréhur combed
pun' e mádhe spic and span
thérës cutting; slaying
shúaj extinguish
shpotí jest; joke
qërtónjës admonishing
harbój roam; wander about
lakuríq naked
t'i nxjérrin sýtë to do such an odd thing; have their unsavory fun
cipëplásur shameless one
shaj insult; offend
pasdréke afternoon
i alarmúar alarmed
pesëvjeçár five-year-old
fshéhurazi secretly
stállë stable
stan holding pen
përpírë (përpíj) swallowed up
shqetësój worry (someone)
i raskapítur exhausted
llahtarí terror
mbërthýer (mberthej) nailed
djall devil
seç somehow
sheretlí mischievous
xhéku sometimes
kalamánj (kalamá) kids

hëhë just the same; even so
këmbëzbáthur barefoot
shamí kerchief
gërshétë braid; pig-tail
i rrémë false; fake
andéj-këndéj this way and that; to and fro
sa as soon as; so long as
shkrep erupt; burst; fire
lavíre bad woman; filthy rag
shushurímë murmur; gurgling sound
i mbýtur muffled
i paúdhë devilish
stërlódh tire out
shkel step over; step into
i mallkúar accursed
i gajásur laughing uncontrollably
kërshërí curiosity
gajásje uncontrollable laughter
dhómëzë cubicle
túbë pipe
túba plumbing
i ngatërrúar complicated
kazán vat; big pot
hínkë funnel
sítë sieve
dyshéme floor
tepsí tray
çiménto cement
tërsëllím violence; force
dush shower
i vákët tepid; lukewarm
stërkálë spray
hem...hem either...or
ngordh beat to death; kill (an animal)
i ímtë fine; thin
fustán dress
qull drenched
moj të hëngërsha grúrin ja mu këtú may you drop dead right now
klith scream; yell
zemërátë anger
patáks surprise
se...mbánte because he didn't know whether to turn off the shower or run off
lágem get wet
rrëshqíste (rrëshqás) glided
gudulís tickle
shkaktój cause
morníçë shiver

gjýshe grandmother
rrótull around
korb raven
kórba únë poor me; unhappy me

çméndem go insane
zbúti (zbus) softened
xhan precious
sepétë clothes hamper
hajt come on; get going
t'u béfsha kurbán may I sacrifice myself for you
mpref sharpen
dyshój worry; doubt
shtyj push
rréze hinge
lehtësój lighten
qesharáke comical
shtrydh wring; squeeze
krúspull rolled up; huddled up
gudulí tickling
fërkím rubbing
përkúnd rock; sway
ávull steam; mist
rrëmbéj grab; seize
prapaník backward
trullós benumb the brain; stun
tret thaw; melt
të zéstë ne how pitiful we are
fatkéqtë ne how unfortunate we are
rënkój moan; groan
saplláke tub
gjym pitcher
belbëzój stammer; stutter
kraharór chest
llomotís gossip; chatter
notój swim
serbés-serbés with no hesitation at all
kris creak; break out
turpëró j shame
pisllëk blackness
i kánë rrjédhur he is crazy
qëkúri long ago
tútje away; forward

tel wire
téla strands covering like a veil; wires
stolís decorate
nérvë nerve
i ndérur tensed up
saldúar soldered
moshatár age-peer
shtýllë pole; column
mbërthéj install; hammer; nail
montój mount; assemble (machinery, equipment)

LEXIMI I TRIDHJETEGJASHTE

Mbi Disa Probleme të të Folurit Skenik

1.

Një nga problemet më të rëndësishme të teatrit tonë në ditët e sotme është pa dyshim edhe ai i të folurit artistik, ose më mirë të themi i tingëllimit ekspresiv të gjuhës shqipe në skenë nëpërmjet veprës së shkruar të autorit. Prapambetja në këtë fushë bëhet pengesë serioze në rrugën e krijimit të teatrit kombëtar në kuptimin e plotë të fjalës dhe ka pasoja të tjera, të panumërta, negative.

Dihet se titulli Teatër nacional i jepet atij teatri, i cili ka luajtur dhe luan rol të rëndësishëm, në ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave shpirtërore të kombit. Në ballë krahas transmetimit artistik të ideve udhëheqëse të kohës, vihen meritat e teatrit dhe në fushën e gjuhës kombëtare.

Në vende të ndryshme të botës teatri ka luajtur rol udhëheqës në unifikimin e dialekteve për krijimin e gjuhës kombëtare, ose, duke zbuluar në skenë vitalitetin dhe pasurinë e një dialekti--e ka ngritur atë në vargun e gjuhës së një kombi.

Kudo, në çdo vend dhe në të gjitha kohët, qysh kur ekziston teatri, njerëzit që e kanë folur më pastër, më qartë, më bukur gjuhën e kombit të vet kanë qenë aktorët. Gjuha e teatrit, përsa i përket drejtshqiptimit, kudo bëhet normë e model.

Është për të ardhur keq që kjo e vërtetë historike nuk po gjen edhe tek autorët tanë vërtetimin e saj të plotë...

2.

Gjatë më se një çerek shekulli përmbysjesh e shndërrimesh thellësore në jetën e popullit tonë, gjuha shqipe, nën ndikimin e fenomeneve shoqërore e historike, evoluoi më tej, u lëvrua nga shkrimtarët e gjuhëtarët tanë, vazhdoi më intensivisht proçesin e filluar nga rilindasit e mëdhenj, e sot, themi se gjuha letrare kombëtare gjendet në fazën e kristalizimit të saj përfundimtar. Pra, në ditët tona, megjithë jetën e dialekteve e të folmeve nëpër krahina të ndryshme, ekzistenca e një gjuhe të vetme letrare kombëtare që përdoret në shkollë, në shtyp, në radio, në fjalimet publike etj. është një realitet objektiv. Sot, shumë e shumë rrallë mund të gjendet ndonjë shkrimtar që nuk shkruan në gjuhën letrare, por në dialekt, bile edhe ky ruan vetëm disa forma të lehta dialektore.

3.

Teatri shqiptar, qysh nga krijimi i tij e këtej ka bërë një punë të lavdëruar për edukimin e spektatorëve me frymën e mësimeve të partisë, për ngritjen e shijeve estetike të tyre dhe ka merita të mëdha për plot aktivitete të tjera të dobishme. Mjerisht, meritat nuk janë gjithaq të mëdha në drejtim të kontributit që duhej të ish dhënë, me përpjekjet e të gjithëve, për krijimin e gjuhës letrare kombëtare. Teatri ynë nuk luajti sa duhet rolin që i takonte në periudhën e këtyre përpjekjeve. Ai qëndroi në bisht kur duhej të ish në ballë dhe nuk e kreu detyrën, të thuash historike, në fushën e gjuhës dhe artit të të folurit. Në se kjo ish paaftësi për të

përballuar problemin, apo thjesht një moskuptim i rëndësisë së tij, nuk i kemi vënë vetes për detyrë ta shqyrtojmë këtu, veç një gjë duhet thënë: moszgjidhja e tij në atë periudhë i bën autorët e regjizorët të gjenden sot, në fazën e re, me një deficit të madh dhe, dihet se pa larë borxhet e vjetra, nuk mund t'u hysh punëve të reja.

Sidoqoftë, edhe pa kontributin e teatrit, gjuha letrare e kombit shqiptar u krijua. Pyetja tashti shtrohet kështu: ç'bën teatri për fazën e dytë, për atë të konsolidimit dhe forcimit të mëtejshëm të gjuhës letrare kombëtare? Do të merrja përsipër një gjynah të madh sikur të thoshja se nuk bën asgjë. Diçka bën. Por asgjë të organizuar e të ndërgjegjshme. Dhe, ajo që bëhet spontanisht nga disa aktorë të veçantë është shumë pak në krahasim me atë që teatri duhet të bëjë.

4.

Po ta shohim qëndrimin e teatrove ndaj gjuhës kombëtare në kuadrin e përgjithshëm, duke e krahasuar me institucione të tjere që kanë si mjet kryesor të shprehjes së tyre gjuhën, me shtypin, p.sh. do të vërejmë se teatrot nuk kanë të qartë njërin nga funksionet e tyre për të qenë modele të shqiptimit letrar.

Ndërsa edhe shtypi lokal bën përpjekje serioze për të shkruar në gjuhën letrare dhe me rezultate shumë të mira, duke iu shmangur dialektit të folur në rrethin ku del gazeta, disa teatro, edhe kur kanë përpara tekstet e autoreve të shkruara në gjuhën letrare, i kthejnë ato pjesërisht ose tërësisht në të folmen e tyre. Po sjell një shembull ekstrem për të qartësuar se sa larg jemi ne nga të kuptuarit e drejtë të këtij problemi. Në rrethin e Shkodrës gazeta "Jeta e re" del në gjuhën letrare, kurse teatri "Migjeni" i këtij qyteti flet në dialekt. Ai teatër e pa të udhës ta kthejë fund e krye në shkodrançe dramën "Lagja e varfër" të F. Paçramit, në kundërshtim me fjalën e autorit. Po të shohim Teatrin Popullor të kryeqytetit, ai është një magazinë brenda së cilës gjen gjithshka, një mozaik multidialektor.

Edhe teatrot e estradat e rretheve të tjerë, qofshin në veri apo në jugë, në Shqipëri të mesme apo në breg të detit, janë teatro me prirje të folmesh. Autorët dhe regjizorët duhet të mësojnë dhe të kuptojnë shumë gjëra në lidhje me dialektet, sidomos ato që përbëjnë bazën e qëndrimit marksist-leninist ndaj tyre. Duhet të kemi të qartë se dialektet janë mbeturina nga formacionet e mëparshme shoqërore. Shoqëria jonë socialiste--marrëdhëniet e saj ekonomike, kulturore etj., nuk favorizojnë forcimin, por zhdukjen graduale të tyre. Sot Shqipëria nuk përbëhet më nga bashkësi thuajse të izoluara nga njëra tjetra, por është një unitet moralo-politik e kulturor të çelnikosur nga partia. Urrejtjet e vjetra, të nxitura nga të huajt dhe klasat sunduese midis gegëve e toskëve, u bënë pluhur e hi dhe i përkasin së kaluarës. Parulla "Një për të gjithë e të gjithë për një" nuk është frazë boshe, por parullë veprimi në punën e përditëshme të shqiptarëve: Jugu e Veriu janë shtëpi e përbashkët e tyre. Kjo mënyrë jetese, kolektivizmi socialist, nuk mund të favorizojë kurrsesi dialektet, përkundrazi ajo ka favorizuar dhe favorizon krijimin dhe forcimin e gjuhës letrare kombëtare. Sigurisht shuarja e dialekteve, të folmeve të ndryshme, nuk mund të bëhet për një kohë të shkurtër; ajo do të dojë një periudhë relativisht të gjatë. Ç'do të bëjë teatri gjatë këtij proçesi historik? Do të veprojë si patericë për të mbajtur në këmbë dialektet, apo si pishtar

i gjuhës letrare-kombëtare? Këtyre pyetjeve aktorët dhe regjizorët duhet duhet t'u përgjigjen jo me aderimin e tyre formal në favor të gjuhës letrare, por me punë dhe veprime të ndërgjegjshme e të organizuara për të çrrënjosur të metat e shumta, ndonjë nga të cilat do të jetë objekti i këtij diskutimi më poshtë. Për të luftuar të metat në të folur duhet t'i njohësh ato e që t'i njohësh, duhet t'i studiosh. Gjuha shqipe, si shumë gjuhë të tjera, megjithëse karakterizohet nga një unitet, ajo prapseprapë ka variantet e saj të ndryshëm në territore të ndryshëm. Me studimin e këtyre variantëve merret dialektologjia. Në rrethanat historike të krijuara për teatrin shqiptar, kur gjuha unike letrare kombëtare zotëron në letërsi, në shtyp, në radio, në shkollë etj. nuk është vendosur tërësisht në skenë, por aty jetojnë akoma dy dialekte, kur në këto dialekte përzihen në mënyrë konfuze edhe nëndialektet apo të folmet përkatëse, të paktën për regjizorët, studimi i dialektologjisë është një nevojë e domosdoshme në mënyrë që të jenë të zotët të luftojnë për pastërtinë e gjuhës skenike, duke i mësuar aktorët jo me fjalë të përgjithëshme, por me analiza konkrete të materialeve letrare drejt asaj që kërkohet prej tyre në të folmet e shqipes.

Në shumë aktorë, veçanërisht tek ata të teatrit "Migjeni", "A. Moisiu", "Skampa" etj. vihet re si fenomen i përhapur dialektal, kthimi i r-së intervokalike në n-në. Ata shqiptojnë Vena në vend të Vera, ullini në vend të ulliri, gjarpëni në vend të gjarpëri, dimni në vend të dimri etj. Po tek këta aktorë dhe tek të tjerë në Teatrin Popullor është i përgjithshëm të ngrënit e bashkëtingëlloreve d dhe h në një mori fjalësh. P.sh., ata shqiptojnë: përmenun në vend të përmendur, prapametuna në vend të prapambetura, funit në vend të fundit, metur në vend të mbetur, nodhet në vend të ndodhet. Në shfaqjen "Studentja e vitit të fundit" të Teatrit Popullor, një aktore fjalinë: "Mirëmbrëma. Pse paske rënë në mendime?" e shqipton kësisoj: "Mirëmrama, pse paske ra n'menime?" Është bërë proverbiale e thëna e një aktori të ri, jo pa perspektivë të Teatrit Popullor në gojën e të cilit shifra 999 tingëllon kështu: "nonqinondhetnon". Ai ha gjashtë copë bashkëtingëllore dhe ndryshon tri zanore. Këto shembulla dhe të tjera, që s'na lejon koha t'i radhisim këtu, tregojnë se negligjenca e palejueshme e disa aktorëve e ka burimin tek paqartësia teorike e tyre. Ata s'janë të ndërgjegjshëm për dëmin që i sjellin çështjes së gjuhës kombëtare në qëndrimin që mbajnë. Çdo mbrëmje me mijëra spektatorë ulen në sallat e teatrove dhe estradave: nga këta shumica të rinj, nxënës, studentë, të cilët nga fjalimet e udhëheqësve tanë, nga radioja, tekstet, librat shkollore dhe letërsia artistike marrin dije në gjuhën letrare, ndërsa nga goja e qindra aktorëve dëgjonë një shqipe të çalë. Vetëkuptohet se aktori gjuhën kombëtare, që nuk e studion, që nuk djersit për ta njohur, nuk ka sesi ta flasë mirë. Kjo gjendje jo normale bëhet edhe më e mprehtë po të kujtojmë, se në këtë mes aktorit do t'i mjaftonte t'i qëndrojë besnik tekstit të shkruar nga dramaturgu, ta mësonte atë me korrektësi; se, ç'ndodh në të vërtetë? Në tekstin e shkruar ne lexojmë: "Agimi shkoi këtej". Aktori i teatrit dramatik të Vlorës shqipton: "Agimi shkoi këteja", --i shton një a nga xhepi i tij dhe bashkë me të edhe vulën e dialektalizmit. Autori ka shkruar: "Nuk mund të vij në Durrës". Aktori korçar shqipton: "Nuku mund të vij në Durrës", i shton kësisoj një u nga fondi lokal i krahinës së tij.

Çdo dialekt, siç dihet, ka veçoritë e veta dalluese dhe, kur puqen në

skenë këto veçori krahinash të ndryshme, shpesh shkaktojnë efekte komike. Po të vërejmë komeditë e kohëve të fundit, ndonjë shkrimtar i përdor enkas këto variante për hir të efektit komik. Te komedia "Dy me zero" e Spiro Çomorës, futen dy tipa miqsh të largët që s'kanë të bëjnë fare me veprimin: (si me ta dhe pa ta, ngjarjet rrjedhin njësoj) një çift burrë e grua, i pari shkodran e dyta korçare, të cilët shkaktojnë ca të qeshura në nuancat e të folurit të tyre dialektal. Pas kësaj, shohim që në komedinë "Dasmë pa nuse" të Naum Priftit dhënë nga Teatri i Vlorës, nga dy--shtohen në katër e pesë dialektet dhe të folmet. Në këtë spekullim, nuk dimë sa dorë ka aktori dhe sa teatri. Sidoqoftë, një lloj justifikimi formal mund të gjendet për të përlighur dialektalizmat në komedinë e sipërme, por një gjë të tillë e vumë re me keqardhje edhe në premierën e parë që dha teatri i ri i Institutit të Lartë të Arteve "Një shok i klasës sonë" --dramë dhe regji e K. Spahivoglit, i cili i kish lejuar vetes të paraqesë në skenë disa figura "punëtorësh" që flasin me një zhargon të tirançes, me të cilin, ndofta, mund të karakterizohet në ndonjë komedi, figura e pazarit të vjetër të dikurshëm, por kurrsesi përfaqësuesit e klasës punëtore të kryeqytetit që hyjnë në veprimin skenik, sipas aktorit, për të vënë në udhë të mbarë punët që nuk ecin mirë në një kolektiv studentësh të arteve. Aksioni i tyre është i arsyeshëm, por gjuha që përdorin e bën atë qesharak. S'kam dyshim që nuk ma merr për të keq kolegu im K. Spahivogli sikur t'i kujtoj se këtë tendencë, ia vumë re, jo pa shqetësim, edhe në shfaqjen e Teatrit Popullor të dramës "Pas dy vjetësh". Atje aktori që luante personazhin kryesor--Ademin, dhe ai që luante ndihmës traktoristin (Përkatësisht Xh. Tagani e F. Radi) e ndonjë tjetër, të revoltuar jo vetëm me leksikun e tyre (ndryshe nga teksti i autorit), por edhe me aksentin nëndialektal të tirançes së rëndë ku sapuni shqiptohet capu, akulli--okoll, domatja--domote, gomari--gomor, rregulli--rregëll, hekuri--hekër, Osmani--Asmon dhe qegëll për tjegull, qetër për tjetër, gjath për djath, gjal për djalë etj.

Gjuha letrare kombëtare shqipe do të vendoset në skenat tona si diçka e domosdoshme, pavarësisht nga shijet subjektive të ndonjë autori apo regjizori.

Në këtë kohë, kur po bëhen të gjitha përpjekjet për kristalizimin dhe forcimin e gjuhës letrare që u krijua, të mos kontribuosh aktivisht për të është një lëmë retrograde.

Mihal Luarasi, "Mbi disa probleme të të folurit skenik dhe rolit të tij në konsolidimin e gjuhës letrare kombëtare," Nëndori (Tiranë), special issue, 1971, pp. 109-115.

i fólur spoken
tingëllím tone; intonation
nëpërmjét through; by means of
prapambétje backwardness
pengésë obstacle
i panúmërtë countless
vlérë value
në/bállë up front; on the forehead
transmetím transmission
víhen (vë) are placed
pasurí richness; wealth
komb nation
i pástër pure; clean
i vet its own
përsá i përkét as far as...is concerned
drejtshqiptím correct pronounciation
vërtetím verification; affirmation
përmbýsje upheaval
shndërrím transformation; conversion
lëvrój nurture
gjuhëtár linguist
gjéndet (gjej) finds itself
përfundimtár final; definitive
e fólme expression; idiom
bilé indeed
dialektór dialectal
i lavdërúar praiseqorthy; glorious
mësím teaching
shíjë taste
i dobíshëm useful
mjerísht unfortunately
gjithág so
takój pertain to
bisht tail
në bisht on the sidelines
krej carry out; do
paaftësí incompetence; ineptitude

moskuptím lack of understanding
shqyrtój analyze; examine
veç nevertheless; even so
moszgjídhje failure to resolve
regjizór director
laj liquidate; clean; wash
borxh debt
gjynáh sin
i ndërgjégjshëm conscientious
krahasím comparison
krahasój compare
vëréj notice
shqiptím pronunciation
i shmángur avoided; averted
gazétë newspaper
tërësísht entirely
qartësój clarify
e pa të údhës saw fit
fund e krýe from beginning to end
shkodránçe in the manner of Shkodër; Shkodërese
magazínë store
estrádë variety show
prírje tendency; inclination
mbeturínë holdover; relic
i mëpárshëm former; previous
marrëdhënie relation; relationship
bashkësí community
thúajse almost, nearly
i izolúar isolated
banór inhabitant
monolít monolithic
i çelnikósur steeled
urréjtje hatred
i nxítur incited
sundúes ruling
geg Gheg; northern dialect
tosk Tosk; southern dialect
parúllë slogan; password
bosh empty
kurrsesí never
shúarje extinction
të dójë (dúhet) be necessary; need
paterícë crutch
pishtár torch-bearer

çrrënjós uproot
i métë defect
prapseprápë = prapëseprápë none the less
rrethánë circumstance
uní: singular
nëndialékt sub-dialect
përkátës respective
të páktën at least
i domosdóshëm essential; indispensable
pastërtí purity
i përhápur widespread
i ngrënë swallowed up; eaten up
bashkëtingëllór consonant
morí myriad
i prapambétur backward
shífër figure
zanóre vowel
radhís enumerate; arrange
i palejúeshëm impermissible
pagartësí ambiguity
dëm damage
çéshtje cause
nxënës pupil, student
shkollór school; scholastic
i çálë limping; crippled
vetëkuptóhet (it is) self-understood
sesí how
nuk ka sesí there is no way
mes matter
shtoj add
xhep pocket
vúlë seal; stamp
korçár from Korçë; of Korçë
kësisój thusly
fond fund; treasury
veçorí trait
dallúes distinguishing
puq bring together

shkaktój cause
énkas deliberately
hir purpose
ngjárje event
njësój just the same
çift couple
nuáncë nuance
spekullír aggregation
lloj type
përlígj legitimize
keqárdhje sorrow
regjí direction
zhargón jargon
tiránçe of Tiranë; Tiranese
pazár market-place
i dikúrshëm days gone by
përfaqësúes representative
údhë të mbárë right road
i arsýeshëm reasonable
qesharák laughable
shqetësím uneasiness
shfáqje performance; play
ndíhmës helper
traktoríst tractor driver
përkatësísht respectively
leksík lexicon
aksént accent
sapún soap
ákull ice
domáte tomato
gomár donkey
tjégull tile; brick
djáthë cheese
lëmë field; area

LEXIMI I TRIDHJETESHTATE

Mblesëria e Fundit

Sa zanate ka në botë, aq të mira qofshin e aq të mira na u bëfshin. Dikush është murator, dikush tjetër këpucar, rrobaqepës, mekanik, barkaxhi, leshpunonjës (ose punonjës leshi) etj. etj. që unë s'po i përmend se lista është tepër e gjatë e s'ka të mbaruar. Sigurisht në botë ka shumë zanate, kinezët numërojnë nja treqind. Nejse, kjo është tjetër punë, po gjer më sot ata të artizanatit nuk kanë mundur të sqarojnë a hyn në kallëpin e zanateve puna e mblesit apo jo?

Kësaj çështje s'i jep dot përgjigje të prerë. Se ç'zanat ziu është ai, kur një herë të del mbarë e tre herë prapë. Disa janë të mendimit se mblesëria duhet futur në kallëpin e diplomacisë, po kjo s'na e mbush mendjen, se më sa bën turtulli për bilbil, aq bën edhe diplomati për mbleses.

E megjithatë as jashtë listës nuk e lë dot, se ka njerëz që e ushtrojnë këtë profesion gjithë jetën e tyre, dhe rrojnë me atë.

Në krahinën tonë ka pasur e s'ka pasur mblesës po si Nako Kumiti s'pjell më nëna. Ah sa i shkathët e sa dorë mbarë që qe! Po të vinte dorë ai, kish marrë fund puna: do bëhej fejesa sikur edhe armiqësi të kishin pasur përpara ato familje.

Ai s'linte gjë pa përdorur: lutjen e qortimin, premtimin e kërcënimin, miqësinë e zemërimin, hatërin e ryshfetin, me një fjalë ishte një xhambaz njerëzish, se kjo fjalë më duket se i përmbledh të gjitha. Gjithçka dinte të përdorte me masë me sërë e në kohë, e ndofta kjo ia siguronte suksesin.

Nga kjo punë ai vetë s'kish parë hair, se gjithë mundimi i tij, shpërblehej vetëm me një palë këpucë. S'di sepse ka mbetur ky zakon nga pleqtë tanë të nderuar, por më vete mendja, se është shpërblimi më i mirë që mund t'i jepet mblesit, mbasi me vajtje ardhjet që bën ndër dyert e krushqërvet të ardhshëm, gris më tepër se një palë këpucë. Sa për fjalët e për diplomacitë që përdor, këto janë pasuri e patundshme e tij e nuk i konsumohen kështu që mund t'i përdornjë sa herë t'ia dojë nevoja e rasti.

Nako Kumiti, si gjithë mblesërit e tjerë të kësaj bote, s'e kishte për gjynah të thoshte me marifet, kur e sillte puna, se mblesërinë meazallah në e bënte për para e për gjësendi tjetër, por...nga që e kishte në gjak.

E kishte filluar këtë zanat, qysh djalë i ri e nuk e la as kur u bë me grua, e as kur u gëzua me nipër. Ndonjëherë nisej e shkonte me shërbim edhe nëpër fshatra të tjere nga pesë gjashtë ore larg, për të mbaruar ndonjë mblesëri të sëkëlldisur.

--Gjer më një ditë udhë, vete thoshte me mburrje, më tutje nuk shkoj.

Krenohej për çiftet që kishte bashkuar. "Ja edhe Kiçon unë e martova edhe Kostën edhe Maqon, edhe Poliken, Marien, tjetrën e tjetrën. Ehu! Sa të mira kam bërë unë në këtë botë".

Numëronte ata që kish bashkuar e s'i vinte mendja se ndofta kish ndarë, nga ai e nga ajo që donin me zemër. I dukej se e uronin, por në të vërtetë, të shumtët e mallkonin e sidomos ata çifte që nuk kishin shkuarje të mirë.

"Iu krimbtë shpirti Nako Kumitit" mallkonin me duf.

Në fshatin e tij s'kish lënë njeri beqar, Nakua. Kështu mendonte ai, e gjithë bota, kur tak! na i doli një pa pritur: Nja dy vjet të shkuar,

na i bie në kokë e na kthehet nga Amerika, Ligor Peshqeshi. E na qënkëshe akoma beqar. U pikëlluan të gjithë në fshat e më shumë se të gjithë kuptohet kush: Nakua. Tani i dukej sikur puna e pesëdhjetë vjetëve t'i kish shkuar kot. I doli një beqar në pleqëri!

--Si more derëbardhë, dyzet vjet ndënje pa dërguar haber nga Amerika e unë të dija me një karvan fëmijë. Beqar qënke akoma?

Ai xhanani, e kish harruar edhe shqipen e bekuar, e përgjigjej anglisht:

--Jes, jes!

Veç kusureve të tjera nuk shikonte mirë as nga sytë, dhe përdorte një palë syze me xham kaq të trashë, sa ia tregonin syrin të madh sa të kaut.

--Martoje o Nako --i thanë bashkëfshatarët --se për këtë ka ardhur i shkreti. Po s'e martove dhe këtë s'ke bërë gjë, kot puna.

--Pcë!-- u përtyp Nakua dhe e shikoi ç'yrnek qe kurbetlliu nga koka gjer te këmbët. --Do martohesh hë? Ta ka qejfi!

--Jes,-- qeshi Ligori, --nuse, nuse, dua vogël...kallaman-- tregonte me gjeste e tundëte kokën me shumë edukatë.

S'ke ç'bën. I kishte shkrepur të birit të botës, të hapte oxhak në pleqëri.

--Mirë, mirë, do mbarohet edhe kjo punë,-- foli Nako Kumiti.

Ligorit iu bë qejfi dhe duke qeshur i foli.

--Jep unë para...Frika mos ki...

--Apapapa! Mos më zër ngojë punën e paravet se do më vejë ters. Lëre se i rregullojmë pastaj ato punë, --i shkeli syrin Nakua.

****

Këtë merak, kishte Nakua e një tjetër veç këtij. Po plakej dhe e ndjente se fuqitë po e linin. Në mos një ditë një tjetër, s'do qe më i zoti për punë mblesërish, dhe e brente meraku se kush do t'ia zinte këmbën.

Vërtet tani martesat me mblesëri nuk para hiqen, po kushedi, do ketë edhe më vonë njerëz që s'janë të zotë të martohen vetë, ose bën vaki e vjen edhe ndonjë beqar tjetër nga Amerika.

Çobenjtë merakllinj, kur plaken e s'e ndjekin dot kopenë, kanë një zakon të mirë. Ia dorëzojnë simblin, pasardhësit që u duket më i zoti me një ceremoni mallëngjenjëse. Simboli në këtë rast është një kërrabë dhensh dhe ndofta kjo u duket juve gjë pa vlerë, por mendoni se çobanit më tepër i hyn në punë kërraba, se sa një skeptër mbretëror.

E pra edhe Nakua ashtu donte të bënte. Donte t'ia linte simbolin ndonjërit, veç vuante i shkreti, se mblesët akoma s'kanë ndonjë simbol e kështu s'kish ç'far t'i dorëzonte. Bile ai s'kish gjetur as njeriun.

I shkonte ndërmend të gjithë në fshat, po ç'e do, asnjë s'ia mbushte syrin. Në fund fare i ra ndërmend ai shereti i vogël, nipçja i tij, Pirua.

--E ç'kërkoj nëpër botë, kur e kam brenda në shtëpi?-- mendoi. Apo s'e kam të shkathët! Unë ja do ta bëj mblesës të mbaruar këtë, ja do të bëj paf në vend.

S'ke ç'i thua. E ndjente edhe ai nevojën e ngritjes së kuadrove. Vendosi ta stërviste vetë e t'i jepte gjithë përvojën e tij të gjatë e të çmuar.

Pirua vërtet qe më i shkathëti e më qeratai nga të gjithë nipërit e tjerë që kish Nakua. Atij i bëhej zemra mal kur shikonte se si Pirua ua

hidhte të tjerëvet.

--Ky do të ma kalojë edhe mua në zë e në nam, për besë. Ja, keni për të parë,-- e mburrte me veten e tij.

E thërriti një ditë Piron mënjanë dhe as në këtë rast nuk e harroi diplomacinë e tij. Ia filloi njëherë larg e larg.

--A të pëlqejnë dasmat?

--Si s'më pëlqejnë...

--A ta ka qejfi të rrish në krye të vendit gjithnjë?

--Me priftin e me zotin nun? Po si jo...ku ka më mirë?

--Atëhere--përfundoi Nakua--duhet të bëhesh mblesës. Pastaj i foli nja dy orë mbi rëndësinë e mblesërisë e mbi peripecirat e saj, e më në fund i tha:

--Tani do të vish pas meje, që ta shikosh edhe në praktikë.

--Kë do të fejojmë?-- e pyeti Pirua.

--Ligorin...

--Atë kurbetlliun?-- pyeti Pirua.

Nakua pohoi me kokë.

--Po ai eshte plak!-- tha Pirua i çuditur.

--Le të jetë, pse pleqtë s'martohen? Tani dëgjo këtu e vëru veshin këtyre që do të të them. Kur të vemi atje te shtëpia e krushkut mbaj vesh ç'do të them unë e ti shtoje dyfish. Edhe unë kështu e kam nisur. Qysh për shembull? Unë do të them është burrë i mirë, e është kështu e është ashtu e pastaj do t'ia filloj: ai ka njëzet dhen. Ti thuaj: --Mor ç'njëzet, ka dyzet. Unë do të them: ka tri lopë. --Gjashtë-- thuaj ti, e kështu me radhë.

--S'qënka ndonjë zor-- tha Pirua me gëzim.

--S'është zor se je me mua, po kur të jesh vetëm do ta kesh edhe zor, pse ç'pandehe ti, kollaj është?

Të nesërmen vajtën në një fshat të afërm, se në fshatin e tyre, i kishte larë duart Nakua, s'kishin mbetur më as çupa as gra të veja.

Hynë në shtëpinë e krushkut, u përshëndoshën, u përqafuan, pyetën si ishin e si kishin qënë gjer më tre breza të shkuar e pastaj ia nisi Nakua nga ato të tijat. Foli e foli sa iu tha pështyma në gojë.

--Shiko, fati i mirë njëherë të shkel në derë. Po e ktheve kësmetin prapa s'të vjen më! Kush zgjedh, mbledh. I kemi parë pasqyrat neve. E di si është kjo punë? Vajti çupa tetëmbëdhjetë, shiko më lartë se ç'je vetë, vajti çupa njëzet e dy, gjej derë e shty.

Atij tjetrit sikur s'po i mbushej mendja.

--Ç'merak ke ti? Dhëndëri është i mbaruar nga të tëra...

--Sa vjet është?-- pyeti krushka.

--Në moshë është, ia ktheu Nakua-- pesëdhjetat i ka lënë, gjashtëdhjetat s'i ka mbushur. Nuk është i vogël, mos ki merak...

--Qënka ca i madh...--tha me pikëllim krushku.

--A derëbardhë, sikur do ta hedhim në kusi e do ta ziejmë. I madh nuk është xhanëm, po i pjekur thuaj. Kurbetlli, i mësuar, i zgjuar. Ja do të ketë shkuarje çupa jote, ja unë s'ditkam gjë.

Pastaj filloi t'i lavdëronte kamjen e dhëndërit. Pirua, që ish mërzitur nga muhabeti i gjatë, i ngriti veshët se e kuptoi që i erdhi radha.

--Edhe nga gjendja janë mirë. Ai ka njëzet kokë dhen...

--More ç'njëzet? Dyzet,-- tha Pirua, e di mirë unë...

--Ja ku e ditka dhe djali. O kolopuç i gjyshit!-- e përkëdheli Nakua e pastaj u kthye nga krushku. --Ka pastaj dy hajvanë të samarit.

--More ç'dy? Ka katër,-- ndërhyri Pirua --se pardje i polli mushka...

--Mushka!?-- tha krushku dhe kërceu përpjetë.

--Jo mushka, pela-- e ndreqi gabimin Nakua --po duket i ka pjellë ndonjë mëz mushke. Pastaj ka nja dhjetë koshere bletë...

--Njëzet! ia preu Pirua-- se unë pardje ia numërova.

Krushku dëgjonte si i topitur dhe buzëqeshte i kënaqur.

--Ka edhe tre lopë...--vazhdonte Nakua.

--Gjashtë!-- u hodh Pirua.

--Veç e drejt' e Zotit,-- tha Nakua --nuk shikon mirë nga një sy...

Pirua në kulmin e suksesit të tij e të nxitimit, s'u përmbajt dot e duke qëndruar besnik porosisë që ç'do gjë ta shtonte dyfish, foli:

--More ç'nga një, ai nuk shikon mirë nga të dy! E di mirë unë...

Krushku kërceu përpjetë. Nakua u bë pik e vrer dhe po i hante dora t'ia përvishte me pëllëmbë të nipit.

--Yt, jezit,--i bërtiti me inat --gënjeshtar kopil e maskara. Siç gënjeve për të parat, ashtu gënjeve edhe për këtë... --deshi ta shpëtonte gjendjen Nakua. Pirua, si e pa që e kish shkelur, ua mbathi këmbëvet përjashta dhe qe i gëzuar sa më s'bëhet që shpëtoi pa ngrënë ndonjë pëllëmbë.

--Gënjen jeziti-- i tha Nakua krushkut, --nuk e pe se si i shtonte?

--Jo, jo s'kemi gjë o Nako...Gjer tani thoshte të vërtetën djali, tani që tha këtë, gënjen...S'ma hedh dot mua... Hiqe atë mendje o Nako, qënka edhe qorr nga të dy sytë...

Nakua u bë helm e pikë që iu përmbys plani pa pritur, pikërisht atëhere kur "krushku" pothuajse qe kandisur. S'pati ç'të bënte dhe i vrarë e i dërrmuar u kthye në shtëpi. Qysh atëhere ra në shtrat e s'është ngritur më.

Thonë se Ligori, vete ditë për ditë te Nakua, me me[illegible] në zemër dhe i lutet me zë të mekur:

--Lutem shëroju...Mbeti unë pa martuar...

"Mblesëria e fundit," Naum Prifti, Lëkura e ujkut (Tiranë), 1958, pp. 21-28.

mblesërí match-making
zanát trade; craft
Sa zanáte ka në bótë, aq të míra gófshin e aq të míra na u befshin. May there be as many good things, and may as many good things happen to us, as there are trades in the world.
muratór mason
këpucár cobbler; shoemaker
rrobaqépës tailor
barkaxhí boat maker
leshpunónjës wool worker
kinéz Chinese man
numërój count
néjse regardless
sqarój clear up
a whether; or
kallép category; mold
mbles match-maker
i prérë precise; definite
ç'zánat zíu what a sad trade
túrtull dove
se më sa bën túrtulli për bílbil aq bën edhé diplómati për mblésës because you can't make a diplomat into a matchmaker any more than you can make a dove into a nightingale.
ushtrój practice
rrójnë me 'të make a living at it
ka pásur e s'ka pásur there have been a variety
pjell give birth to
më anymore; any longer
i shkáthët alert; go-getter
dórë mbárë lucky
merr fund púna the job is sure to succeed
sikur edhé even if
armiqësí hostility
qortím scolding
premtím promise
kërcëním threat
zemërím anger; grudge
hátër favor
ryshfét bribe
xhambáz horse-trader
haír prosperity
shpërblléj reward
krúshqër (krushk) in-laws
i árdhshëm future; prospective
i patúndshëm immobile; fixed
sa hérë t'ia dójë nevója e fasti as long as the need and occasion call for it
marifét slyness; cleverness
meazalláh never; for the love of God
qysh from the time of
sëkëlldísur troubled
údhë travel; road
mbúrrje pride
tútje far
sa të míra how many good turns
urój wish well; bless
të shúmtët the majority
shkúarje relationship
iu krímbë shpírti may his soul rot
duf indignation
beqár bachelor

i bíe në kókë takes it into his head
si moré derëbárdhë honestly now!
ndënje (rri) you stayed; remained
habér news
karván caravan
xhanán poor devil
i bekúar blessed
kusúr shortcoming; defect
pálë pair
sýze glasses
xham glass
ka ox
bashkëfshatár fellow villager
pcë! bah
përtýp chew
yrnék type; sort
kurbetllí one who goes abroad; emigrant
kallamán = kalamá young boy
s'ke ç'bën what can you do
shkrep light up
oxhák chimney
I kíshte shkrépur të bírit të bótës,
   të hápte oxhák në pleqërí He got it
   into his head to start a family
   in his old age
apapapá interjection
pará money
ters badly
shkel sy wink
merák trouble; worry
bën vakí can happen
çobénj (çobán) shepherds
merakllí conscientious; caring
kopé herd; flock
dorëzój hand over
pasárdhës successor
mallëngjénjës moving; emotional
kërrábë shepherd's crook
sképtër scepter
ç'e do what's the use
sherét mischievous fellow; imp
nípçe endearing form of nip grandson
paf puff
do të bëj paf I'll drop dead
s'ke ç'i thúa what could you say
ngrítje training; raising
stërvís train
përvójë experience
qerratá sly; cunning
bëhet zémra mal burst with pride

ua hídhte të tjérëvet put one over on the others
nam reputation
për bésë by my faith; upon my soul
mënjánë aside
larg e larg from far away
si s'më pëlqéjnë how can I not like them
nun godfather
ku ka më mírë what is better
peripecítë comings and goings; peripatetics
kë = cílin whom
pohój admit; agree; confess
krushk in-law
shtoj add
dyfísh twofold; twice
zor difficult
pandéh suppose; imagine
u përshëndóshën (përshëndés) exchanged greetings
thaj dry out
pështýmë saliva
pasqýrë mirror
mbush méndjen become convinced
në móshë of age
pikëllím anguish
derëbárdhë my good man
ziéj cook
xhánëm my friend
i pjékur mature
shkúarje living; life
kámje wealth
mërzítur bored
muhabét talk; conversation
rádhë turn

kolopúç plump
gjysh grandfather
përkëdhél flatter; caress
hajván animal
samár saddle
ndërhýj intervene
pardjé day before yesterday
múshkë mule
pélë mare
mëz foal
i topítur dazed
nxitím rushing
porosí instruction; mandate
pik (=píkë) e vrer despondent
po i hánte dóra t'ia përvíshte me pëllémbë të nípit his hand was itching to slap his nephew.
yt cram; be off
jezít rascal; swine
bërtíti (bërtás) shouted
gënjeshtár liar
kopíl bastard
gënjéj lie
e ka shkélur has fouled up
qorr blind
Nákua u bë helm e píkë Nakua was crushed
i vrárë hurt; wounded
i dërrmúar annihilated; pulverized
shtrat bed
shërój make well

LEXIMI I TRIDHJETETETE

Plaka dhe Kushëriri Im

Fisi ynë është shumë i madh. Sa vjen e më tepër lindin fëmijë. Postieri i lagjes ka gjetur belanë. S'rri një minutë rehat, se nga të katër anët vijnë telegrame e letra.

Nëna ime, tani në pleqëri, është bërë si turiste. Po i bie anembanë Shqipërisë; sot në një dasmë, nesër një lindje, pasnesër në një fejesë apo në ndonjë vdekje. Babai ka filluar të mbetet vetëm. Thonë se kur ngelesh vetëm në pleqëri është gjë e trishtueshme, por babai im as që e çan kokën fare, vazhdon të pijë duhan e ndonjë gotë raki. Si gjithmonë mallkon moshën që e nxori në pension, që i thau gjymtyrët nga reumatizma, nga që s'është i ri që të bënte edhe njëherë ato që pat bërë para pesëdhjetë vjetësh.

Por ja që në lagje filluan të flasin gojët e liga, që thonë sikur nëna ime, tani në pleqëri (pika që s'i bie) ka filluar të hazdiest. Sepse më parë rrinte mbyllur, nuk dilte, s'i dëgjohej zëri, kurse tani, sa gjen rastin e ngrihet të diskutojë në mbledhjet e lagjes duke mbrojtur nuset e reja. Ç'i duhen asaj nuset e reja e pse duhet që ajo t'i mbrojë ato? S'i ka as lezet as hije.

--S'ka nuse ajo, prandaj flet ashtu. Të ishte vetë vjehërr pa të shihnim.

--Korbë, thonë se do ta zgjedhin aktiviste...I rrodhën trutë...Kështu e ka pleqëri...

--Bah! Ajo do që t'i dalë nami, se do të jetë vjehërr e mirë, kështu që nuset të mos tuten për djemtë e saj.

--Ajo do të na bëjë mbledhje, do të na flasë për emancipimin? Prit e dëgjo tani!

Edhe unë çuditem me nënën time. Se si është bërë... S'e marr vesh fare. Tjetër njeri. Edhe fjalët ka filluar t'i ndryshojë.

--Në lidhje me gjellën, ju s'mund të thoni asnjë fjalë. Kurse përsa i përket kripës...kjo është një çështje serioze,-- thotë nëna.

--Moj grua!-- i thotë babai. --Ku je këtu, në mbledhjen e grave?

--Kështu! Duhet t'i ndajmë punët... Hë, burrë, dëgjon?

--Hapi udhë,-- më thotë babai mua --hapi udhë... I erdhi drita të verbërit dhe tani nuk shikon ç'bën... Përplaset edhe pas rrobave të veta...

--M'u bëfsh kurban! Të të këpus një fletë rrufe, pa të vish vërdallë...

--Po ti s'di të shkruash, moj e shkretë. Ke parë ti kështu? I duket sikur kapi qiellin me dorë.

Të nesërmen vinte një telegram e plaka nisej prapë për udhëtim. Vetëm kështu pushonin polemikat gjithë thumba që bënin të dy pleqtë me njëri tjetrin.

Një ditë, ajo u kthye shumë e pikëlluar. Erdhi e piu menjëherë një kafe. Dukej qartë se nuk i kishte shkuar mbarë.

--Lëre! Lëre!-- përsëriste me vete sikur unë ta kisha pyetur se ç'kishte. --Gojët e liga s'të lënë rehat... Ka akoma nga ata dreq mikra... borgjezë. E thashë mirë? Këta zënë e flasin sikur unë të kisha bërë ndonjë turp..."E la plakun vetë..."--thonë.-- Ajo pinte kafen ngadalë dhe shikonte jashtë dritares, prej nga dukej parku. --Kushedi? Ndofta thonë që kam rënë edhe në sevda. Edhe kjo na duhet tani...

Ajo dukej me të vërtetë e trishtuar.

--Duhej të shkoja në dasmën e Reshatit. Tani s'mund të shkoj dot vetë... Si t'ia bëj? Kaq e pata...

Ajo bëri edhe një kafe tjetër, ndezi një cigare, e, kur e shikoja ashtu me flokë të thinjura, me rroba të zeza, të menduar, me grusht në mollëzën e faqes, më dukej si filozofe.

--Si t'ia bëj?-- thoshte vazhdimisht, --si t'ia bëj?

--Shko!-- i thashë unë. --Mos pyet fare!

--Si? Edhe ti e the këtë? Falemnderit!

U fye. Ajo mendoi se unë doja të tallesha. Por pas pak u hodh përpjetë nga një gëzim i papritur. Unë u tremba.

--Do të vish ti!...

--Ku?

--Në dasmë. Ju të rinjtë s'i njihni mirë dasmat dhe zakonet e vjetra, kështu që...meqë shtrohet me të madhe njohja e zakoneve të popullit (për këtë kish dëgjuar një emision të radios), duhet të vish. Çohu tani e bëhu gati!

Unë fillova të kundërshtoj e të nxjerr nëntëdhjetë e nëntë justifikime, por nëna ime, që është e fortë në logjikë, më kapi pikërisht në të njëqindin justifikim.

--Ti mua më ke nënë, e, në qoftë se do të më nderosh në syt' e botës, eja. Në mos daç, mos eja.

Doli jashtë nga dhoma thellësisht e prekur.

U mallëngjeva dhe unë, kështu që vendosa dhe u bëra gati, e pas gjysmë ore, unë dhe nëna, të zënë "allabraca", dolëm në rrugë me peshqeshe në duar e me buzë në gaz, si më të lumturit dhe më të sigurtit njerëz të botës.

Unë i shikoja me bisht të syrit gratë e lagjes që zgjatnin kokën pas dyerve të shtëpive dhe shihja edhe nënën time, që mbante kokën lart dhe dukej sikur s'pyeste fare.

--Korbë, mori edhe djalin me vete...

--Shiko se ç'tundet!...

--S'i ka hije, tani në pleqëri.

Nëna, duke shtrënguar akoma më fort krahun tim, më thoshte:

--Unë e di se ç'flasin ato, megjithëse buzëqeshin me dashuri të madhe... Por le të flasin.

Dasma kishte filluar kur hymë ne shtëpinë e dhëndërit. Nëna filloi të uronte sa këtej, sa andej; puthej, përshëndetej, tokte duart. E vunë në krye të vendit.

U tërhoqa mënjanë, zura një tavolinë dhe fillova të shikoj gjithë ata dasmorë që hynin e dilnin, që hanin e pinin, që uronin e këndonin këngë të bukura. Më sollën edhe mua të ha e pi, por fillova të ndiej veten të tepërt dhe në të vërtetë u bëra pishman që dëgjova nënën dhe erdha këtu, ku s'njihja asnjë njeri.

--Mirëmbrëma!-- tha një zë.

Pashë një djalë të moshës sime, që qëndronte më këmbë, pranë tavolinës-sime, duke më parë në sy.

--Ju jeni djali i Selamiut dhe quheni Xhevdet, apo jo?-- më tha ai, pas një heshtjeje.

--Po-- thashë unë.

--Mund të ulem?

--Po.

--Nuk më njihni mua?

E pashë mirë në fytyrë. Ishte krejt i panjohur. Mendova se mos ishte i dehur e pas pak, si gjithë të dehurit që e kanë inat heshtjen dhe mërzinë, do të kërkonte që edhe unë të futesha në valle, të filloja ta puthja e të mallëngjehesha, si ai e si të tjerët...

--Jo nuk të njoh...

--Pak më parë, as unë s'të njihja.

E pashë edhe njëherë nga koka deri te këmbët.

--Sigurisht. Nuk kishe si të më njihje... As unë s'të njihja më parë...

Ky njeri filloi të më dukej misterioz. I dehur s'dukej.

--Nëna më paralajmëroi që të mos flas me ju. Kur hytë, më tregoi se kush ishit dhe unë e vendosa dhe erdha t'ju flas.

--E kush jemi ne, sipas nënës sate?

--Ti je kushëriri im, kurse nëna jote është tezja ime.

--Çudi... Qënkemi vërtet fis i madh... Jemi kaq të afërt dhe nuk njihemi... Unë i dhashe dorën. E pyeta për emrin. Brenda disa sekondave ne u bëmë menjëherë kushërinj dhe filluam të flasim me përzemërsi si dy njerëz me të vërtetë të afërt. Kujtonim se si pleqtë e mi ishin grindur me pleqtë e tij për një shtëpi e ca plaçka që i ndanë kur vdiqën gjyshërit tanë para njëzet e ca vjetësh. Që atëhere familjet nuk flisnin. Sigurisht, edhe ne, bijtë, u përfshimë nga ky lëmsh. Dasma sa vinte e merrte më tepër zjarr, kurse ne ia kishim shtruar një muhabeti mjaft interesant.

Kushëririt tim, pasi rrëkëlleu disa gota, iu zgjidh gjuha dhe filloi të anonte nga filozofia.

--Prona private ka një forcë të çuditshme... Edhe kur e shkul ajo lë një vend bosh, ashtu si toka kur traktori nxjerr rrënjët e ndonjë lisi... Duhet të kalojë ca kohë që ky vend bosh të mbushet përsëri...

Pikërisht në këtë kohë kërciti tavolina. Unë, të them të drejtën, u hodha përpjetë. Shikoj plakën time me sy të hequr anash nga inati që e kishte kapur. Ajo kishte kohë që ma bënte me shenja që nga tavolinat e tjera. Unë nuk e kisha vënë re. Asaj nuk i ishte duruar dhe kishte ardhur në tavolinën time. Rrotull nesh u mblodhën disa dasmorë të na ndanin dhe të na qetësonin, sepse doemos, dasma s'duhej prishur për hiçgjë.

--Eja me mua!... E di ti kush është ky? E di që ne?...Çohu!

--E di...-- i thashë unë me qetësi --është kushëriri im. Njihu dhe ti, se, besoj, nuk e njeh nipin tënd... Është tamam sa unë...-- Ajo u habit dhe ngeli një hop me gojë të hapur, si një tunel në miniaturë.

Unë mora një gotë dhe, pa të keq, duke buzëqeshur bile, e përplasa me gotën e kushëririt tim, që porsa kishte lindur. Nëna vuri re këtë gjë dhe i zgjati dorën nipit, sigurisht, për të thyer sytë e njerëzve që donin muhabete.

--Si je, more bir?-- e pyeti. Që nga tavolina vura re tezen time, (edhe kjo e porsalindur për mua, sepse nuk e njihja më parë) që çakërriste sytë e s'dinte ç'të bënte nga inati. E gjithë kjo skenë mua më ngjallte gaz, por edhe pikëllim.

Kiço S. Blushi, "Plaka dhe kushëriri im," Nëndori, (Tiranë), XIX, 2 (February), 1972, pp. 159-163.

postiér postman
belá trouble
rehát peace
pleqërí old age
pasnésër day after tomorrow
vdékje death; funeral
ngel get stuck
i trishtúeshëm sad
çaj kókën care; give a hoot
gótë glass; drink
gjymtýrë limb
píka që s'i bíe how shameful
hazdís prance about
lezét in good taste
vjéhërr mother-in-law
tru brain
i rródhën trútë she's crazy
nam name; reputation
tútem fear
çéshtje question
i vérbër blind
përplásem collide
këpús expose; (lit. break off)
flétë-rrufé wall newspaper
vërdállë off balance
kap touch; seize
udhëtím travel
lére (lë) don't mention it; leave
përsërís repeat
dreq devil; demon
míkra borgjézë petit bourgeois
sevdá infatuation; love

kaq e páta this is the end
cigáre cigarette
filozóf philosopher
vazhdimísht continually
mëqë since
njóhje knowledge; recognition
emisión broadcast
kundërshtój object; oppose
në qóftë se if
dac (dúa) want
i prékur touched; moved
allabráca arm in arm
peshqésh present; gift
bisht corner; tail
shikó se ç'túndet look how she is swaying to and fro
tok dúart shake hands
tavolínë table
i tépërt extra; superfluous
bëhem pishmán regret; repent

i déhur drunk
mërzí boredom
mallëngjéhem become emotional; long for
paralajmërój forewarn
sáte your
përzemërsí cordiality
gjýshër grandparents
përfshí take in; sweep up
lëmsh ball of yarn; tangle
rrëkëllëj guzzle
anój lean towards
prónë property
shkul uproot
bosh empty
kërcíti (kërcás) clattered
ánash aside
shénjë gesture; sign
qetësój calm down
doemós naturally
çóhu get going
tamám exactly
ngel be stuck; stand; remain
përplás clink
çakërrís sýtë open the eyes wide

LEXIMI I TRIDHJETENENTE

Përralla Në Letërsinë Tonë Për Fëmijë

Gjinitë e ndryshme në letërsinë për fëmijë, nuk janë zhvilluar të gjitha njësoj. Poezia, tregimi i shkurtër e sidomos përralla janë lëruar më shumë se librat fantastiko-shkencorë, romanet apo novelat. Për shembull, deri para disa vitesh, ishin botuar më shumë se 50 libra me përralla të njëzet autorëve tanë, pa përmendur edhe 70 libra të tjerë me përralla të popujve e autorëve të ndryshëm të botës. Nga shkrimtarë që lëruan gjerësisht përrallat në ato vite vlen të përmendim Kolë Jakovën, Tofik Gjylin, Bedri Deden, Dhimitër Paskon, Gjergj Zhejin, Moisi Zaloshnjën, Spiro Çomorën e mjaft të tjerë. Në pjesën dërrmuese motivet e përrallave të tyre ishin të marra nga fabulistika jonë dhe pak përpjekje u bënë për të trajtuar motive të reja, për të tentuar krijimin e përrallës së re. Me një fjalë, u muar vera e vjetër--madje nganjëherë pa e distiluar--dhe u fut në voza të reja. Ndërsa këta tre katër vitet e fundit, librat me përralla janë bërë mysafirë të rrallë nëpër ~~vitrinat~~ e librarive tona, pasi botimi i tyre është zvogëluar së tepërmi. Mendoj se të dyja këto ekstreme (lërimi i tepërt edhe, tani së fundi, lënia pas dore) nuk janë të drejta dhe janë dëshmi e keqkuptimeve që ka patur dhe ka akoma sot për zhvillimin e përrallës në letërsinë tonë për fëmijë. Para disa vitesh, mendohej që përralla të ishte gjinia dominuese, ndërsa tani ka mendime që ajo të mos lërohet, të lihet pas dore derisa të shuhet si gjini.

Është e drejtë që përralla nuk duhet të jetë gjinia dominuese në letërsinë tonë për fëmijë. Sot kemi shumë nevojë të zhvillojmë gjerësisht edhe gjinitë e tjera, sidomos gjinitë e gjata dhe dramën. Fëmijët tanë lexojnë me ëndje tregimet, novelat dhe romanet, ata gjithashtu shikojnë me dëshirë ndonjë shfaqje të rrallë teatrale që përgatitet nergut për ta, pasi aty shohin jetën dhe problemet e tyre. Gama e temave që mund të ngërthejë letërsia për fëmijë është e gjerë dhe përfshin temat e jetës së përditshme të fëmijëve tanë, në shkollë, shoqëri e familje, heroizmat e njerëzve tanë, dje në luftë dhe sot në frontet e ndërtimit socialist, pa harruar edhe trajtimin e temave patriotike për historinë e popullit tonë. Besoj se jemi të gjithë në një mendje se rreth këtyre temave duhet të polarizohen tërë krijimet e shkrimtarëve tanë të të gjitha gjinive.

Përralla ka vendin e vet në letërsinë për fëmijë dhe ajo do zhvilluar e lëruar në raport të drejtë me gjinitë e tjera. Çështja që shtrohet sot është se çfarë përrallash do t'u japim ndër duar lexuesve tanë të vegjël. Për këtë ia vlen të mendohet e të diskutohet me tërë mend. Nuk do të bënim punë të mirë sikur fëmijëve tanë sot t'u jepnim përralla si "qëmoti" me kulshedra, zana e shtojzavalle, me katallana, bija mbretërish e të tjerë të këtij lloji aq të përhapura në fabulistikën tonë dhe të popujve të tjerë. Përpunimi i atyre motiveve të njohura me ato personazhe, nuk i shërben sot edukimit të fëmijëve tanë. Disa tentativa të shkrimtarëve për t'u dhënë jetë këtyre motiveve duke iu shkundur plururin heronjve të vjetër, përgjithësisht kanë dalë pa sukses siç është rasti i librit me përrallat kushtuar "Lalë Gjonit", që iu pat nënshtruar një kritike të rreptë para disa vitesh. Motivet e përrallave të vjetra bashkë me personazhet e tyre lindën

në kohë të tjera dhe shpreh.in problemet e asaj kohe, ideologjinë e saj, botëkuptimet dhe aspiratat, dëshirat, ëndërrat e të parëve tanë. Në këtë mënyrë nuk është fare e pranueshme që ata personazhe të transplantohen në një truall të ri. Edhe në se ata do t'i lëmë për të ilustruar të kaluarën, kjo gjë mund të bëhet vetëm herëpashere pasi nuk është mirë që përrallën ta kufizojmë në kohën e kaluar dhe prapë e gjithmonë të përdorim fillimin e saj shumëshekullor: "na ishte një herë...".

Pjesa më e madhe e përrallave që u botuan këtu e disa vite më parë ishin të shkruara në mënyrë të vjetër dhe përgjithësisht niveli i tyre ishte mesatar e mjetet shprehëse ato më tradicionalet. Këtyre shtohu edhe dozat ku më të mëdha e ku më të vogla të ndikimeve të ideologjisë së dëmshme të së kaluarës. Ndoshta pikërisht kjo shpjegon reaksionin kundër përrallës në përgjithësi, mohimin total të vlerave të saj edukative e didaktike dhe vënien në pikëpyetje të ekzistencës së saj në letërsinë tonë për fëmijë.

Duke kritikuar disa anë negative të përrallave të shkrimtarëve tanë të botuara në vitet e shkuara, nuk bën të arrijmë në mendime ekstremiste për eliminimin e përrallës në përgjithësi. Duke folur në konferencën XVII të partisë të rrethit të Tiranës, shoku Enver është ndalur edhe në çështjen e përrallës. "Kam lexuar, thotë shoku Enver, që diskutohet të ruhet apo të mos ruhet përralla. Mendoj se për të vegjëlit, për zhvillimin e fantazisë dhe edukimin e tyre, duhet ruajtur përralla, qoftë edhe nga jeta e kafshëve, por jo me ëndërrime e simbolizma jashtë realitetit tonë dhe moralit tonë komunist. Të përgatiten për këtë qëllim tregime dhe pjesë të tjera me përmbajtje realiste, mbi luftën kundër forcave të këqia të së kaluarës dhe të nxitet fantazia e fëmijëve për të ardhmen e ndritur e vendit të tyre, të mbështeten këto tregime mbi ndodhi të vërteta e me moral të lartë edukues, të trajtuara në gjinitë dhe format më të ndryshme, duke mos përjashtuar edhe përrallën. Kjo le të diskutohet, por të mos kërkohet t'u bëjnë kalamanëve leksione".

Në këto fjalë është përcaktuar drejt e qartë qëndrimi që duhet të mbajmë ndaj përrallës dhe në të të ravizohen edhe tiparet e përrallës sonë të re.

Sot, para njerëzve që merren me letërsinë për fëmijë nuk bën të shtrohet më pyetja: a duhet a nuk duhet të ketë përrallë, por çfarë të bëjmë për ripërtëritjer e kësaj gjinie, për krijimin e përrallës së re, e cila të mos jetë e mbushur "me ëndërrime e simbolizma jashtë realitetit tonë e moralit tonë komunist". Këtu të përqëndrohet vëmendja jonë, këtu të drejtohen tërë përpjekjet tona. Të mos vëmë në themel të përrallave humanizmin abstrakt e mbiklasor, të mos i mbështesim në luftën e së mirës kundër së keqes në përgjithësi, po t'i përcaktojmë më qartë, të jemi më konkretë, duke u mbështetur me të dyja këmbët në realitetin tonë. Në pamje të parë, duket sikur ka një kontradiktë në kërkesën e fuzionit në mes të realitetit e të përrallës, pasi ndonjë mund të mendojë se përralla në shprehjen e gjendjen e saj më gjenuine është një trillim i shthurur i fantazisë jashtë çdo realiteti e objektiviteti. Në të vërtetë puna qëndron ndryshe: përralla në asnjë kohë nuk ka qenë një trillim i fantazisë fund e krye pa asnjë bazë reale dhe pa një gjendje shpirtërore të përcaktuar. Ajo gjithmonë ka shprehur aspiratat konkrete të një populli në një moment të caktuar historik, etjen e tij për liri, drejtësi, begati e përparim, po për arsye të kushteve këto i ka veshur me elementë fantastikë e simbolikë, apo i ka shprehur me gjuhën e Ezopit. Për shembull, përralla e njohur

"Sofër shtroju" shprehte gjendjen e mjeruar të varfërisë në ato kohë dhe dëshirën për të ngopur barkun me bukë pasi ky ishte realiteti i atëhershëm. Ky motiv, ashtu si shumica e motiveve të fabulistikës së kaluar, neve nuk ka intereson më. Sot shtrohet çështja për të krijuar motive të reja, me personazhe të reja që shprehin aspekte të realitetit tonë. Këto gjë fabulistët tanë duhet ta bëjnë duke kërkuar në të njëjtën kohë edhe forma të reja, gjuhë të re, mjete shprehëse origjinale. Në përrallat e reja të [illegible] ërojë optimizmi, dinamika karakterstike e kohës sonë dhe perspektiva e n[illegible]ur e së ardhmes. Në se shkrimtari ynë shkruan një përrallë, ta zëmë [illegible] si mushkonjat mbetën pa shtëpi pasi në vendin tonë u thanë të gjitha kënetat, kjo nga ana e formës do të jetë një përrallë, por ajo në të njëjtën kohë do të shprehë një aspekt të realitetit tonë.

Ne përmendëm një rast, por ndërtimi socialist i vendit tonë, zhvillimi i gjithanshëm i industrisë, i shkencave mund të [illegible]en burim për një varg motivesh të reja në fushën e fabulistikës sonë të [illegible]. Natyrisht këtu nuk është fjala që të marrim vetëm anën e jashtme të k[illegible]yre gjërave duke ruajtur moralin e vjetër, se atëhere do të binim në një gabim [illegible] rëndë. Përralla jonë duhet të ripërtërihet nga përmbajtja, në radhë t[illegible]parë, dhe kjo përmbajtje e re do të sjellë pa tjetër edhe një formë [illegible]re dhe jo anasjellë-tas. Ripërtëritja të bëhet në themel, e plotë dhe jo [illegible]shme as e sipërfaqshme. Nëse në përrallën që përmendëm më sipër "Sofër shtroju" do ta bënim "Tavolinë shtroju", duke pretenduar se e modernizuam dhe e përtërimë, do të bënim gabim të rëndë.

Një problem, që preokupon fabulistikën tonë të re, është ai i raportit të saj me literaturën fantastiko-shkencore. Mendoj se ato mund të marrin shumë gjëra nga njëra tjetra, por nuk më duket i drejtë mendimi se përralla duhet të shkrihet krejtësisht tek letërsia fantastiko-shkencore. Ato janë dy gjini të ndryshme, megjithëse kanë gjëra të përbashkëta, sidomos përralla e re që duam të krijojmë në letërsinë tonë. Shkrirja e tyre e plotë që mund të sjellë zhdukjen e përrallës, nuk është as e dobishme dhe as e drejtë.

Megjithatë praktika dhe e ardhmja do të tregojë se në ç'mënyrë e në ç'baza do të zhvillohen raportet në mes të përrallës sonë të re dhe letërsisë fantastiko-shkencore.

Një problem që vlen të mbahet parasysh në përrallën tonë është ai i moralizimeve. Shpesh autorët tanë në fund të përrallave derdhin një varg moralizimesh të gjata që nuk i [illegible]jnë asgjë tekstit, por e bëjnë të thatë e të mërzitshëm. Nëse në një [illegible]rrallë, ta zëmë kritikohet mendjemadhësia dhe me fakte provohet sa e dëmshme është ajo dhe çfarë të këqijash i sjell atij që e ka, ç'është nevoja që në fund të thuhet: e shikuat ç'bën mendjemadhësia? Këto gjëra e dobësojnë veprën artistike dhe e mërzisin fëmijën, ashtu siç e mërzisin edhe arsyetimet e gjata e të thata, poza prej [illegible]uditi që mban nganjëherë shkrimtari. Edhe në këtë rast të mos harrojmë porosinë e shokut Enver: "Të mos kërkojmë t'u bëjmë kalamanëve leksione!"

Përralla jonë e re është në hapat e para. Ajo ende nuk e ka përcaktuar siç duhet profilin e saj definitiv dhe vihen re luhatje në trajtimin e saj. Disa prova të Bedri Dedes, Bekim Gaçes, Naum Priftit e ndonjë tjetri, tregojnë se ajo është vënë në rrugë të mbarë dhe perspektivat e saj janë të mira. Përpjekjet e përbashkëta të shkrimtarëve të vjetër e të rinj, kërkimi me guxim i rrugëve të reja, eksperimentimi i formave dhe i mjeteve

të reja shprehëse në përputhje me realitetin tonë komunist, do të bëjnë pa tjetër që kjo gjini e lashtë të ripërtëritet e të fitojë shkëlqim të ri duke edukuar e dëfryer mijëra e mijëra lexues të vegjël në e katër anët e atdheut tonë.

Gjergj Vlashi, "Përralla në letërsinë tonë për fëmijë," Nëndori (Tiranë), XVII, 11 (1970), pp. 54-58.

përrállë fable
gjiní genre
njësój the same qay
lërój cultivate
novélë novelette
vlen it is worth
dërrmúes crushing; grinding
fabulistíkë field of fables
trajtój treat; handle
tentój attempt
u múar (marr) was taken
madjé moreover
vórë cask; keg
mysafír guest
vitrínë display window
librarí bookstore
zvogëlój make small; decrease
së tépërmi considerably
lërím cultivation
i tépërt excessive
lënia pas dóre neglect
dëshmí testimony
dominúes dominant
líhet pas dóre is neglected
shúaj extinguish
ëndje pleasure; eagerness
nergút especially; on purpose
gámë gamut; scope
ngërthéj encompass
dje yesterday
trajtím treatment
rapórt relationship
lexúes reader
të végjël (i vógël) little; young
gëmóti olden times
kulshédër = kuçédër dragon
shtojzavállë fairy
katallán monster
mbrétërish kingly
lloj type
i përhápur widespread
përpuním cultivation; working out
shkund shake off
plúhur dust
kushtój dedicate
i rréptë severe

aspirátë aspiration
i pranúeshëm acceptable
trúall hearth
herëpashére now and then
kufizój limit
shumëshekullór centuries old
mesatár average
dózë dose
i dëmshëm harmful
mohím denial
vënie placing; putting
pikëpýetje question; question mark
arríj arrive
kalamán little one
përcaktój define
ravizój sketch; draw
ripërtërítje focus; center
vëméndje attention
mbiklasór outside the class
mbështés support; base; rest
kërkésë demand
trillím fabrication
i shthúrur unbridled; unchained
étje thirst
begatí well-being
Ezóp Aesop

sófër dining table
shtroj set up
i mjerúar wretched
bark belly
i atëhérshëm of that time
fabulíst fable writer
i njëjtë same
zotërój rule
mushkónjë mosquito
kënétë swamp
i gjithánshëm all-around
anasjélltas vice-versa
ripërtërítje revival
i pjésshëm partial
i sipërfáqshëm superficial
nësé if
përtëríj restore; revive
krejtësísht completely
i përbáshkët common
shkrírje fusion; melting
zhdúkje disappearance
mendjemadhësí conceit; boastfulness
e këqíjë evil thing
arsyetím reasoning
pózë pose
luhátje vacillation; wavering
próvë attempt; tryout
guxím daring

shpréhëse expressive
përpúthje harmony
dëfrýer (dëfréj) entertaining

LEXIMI I DYZETE

(Nga Kuzhina Shqiptare)

Supat

Supat kanë rëndësi të madhe për njeriun, se me anën e tyre ai merr jo vetëm substancat e nevojshme për organizmin e tij, si yndyrna, karbohidrate, kripëra e vitamina të ndryshme, por ato i hapin dhe oreksin. Veç kësaj, me anën e supave, organizmi plotëson 10-15% të nevojave të ujit. Sa më e shijshme të jetë supa, aq më tepër i shtohet njeriut oreksi, sepse lëndët ekstraktive të buljonit ndikojnë në prodhimin e lëngjeve të stomakut dhe ato hapin oreksin. Prandaj duhet të përpiqemi që supat t'i përgatisim me buljon.

Ç'kuptojmë me fjalën buljon?

Buljon quhet lëngu, që marrim gjatë zierjes në ujë të kockave, të mishit, të shpendëve ose të peshqve. Kur kemi përgatitur buljon të mirë, atëhere do të bëhet edhe supa e mirë.

Është e vërtetë se buljoni nuk ka shumë kalori. Sipas mishit mund të përmbajë 8-10 kalori në një litër, por roli i tij kryesor është që t'u japë shijë supave, mbasi përmban lëndë ekstraktive dhe ngjitëse, që nxisin sekrecionin e stomakut dhe kështu ndihmojnë tretjen.

Buljon Mishi Ose Kockash

Në një tenxhere të përshtatshme hedhim ujët. Kapim me pirunin e kuzhinës mishin dhe e vënë në tenxhere, duke patur kujdes që ta vënë në zjarr të fortë. Kur afron koha e vlimit, i heqim, me lugën e posaçme të kuzhinës, shkumën që ka nxjerrë, mbasi ajo i prish shijën buljonit, gjithashtu dhe ngjyrën. Si t'i kemi hequr shkumën mirë, e vënë në zjarr të ngadalshëm dhe i hedhim zarzavatë-të prera në formë thelash. Hedhja e zarzavateve varet sipas mishit: po të jetë mishi i vogël, i hedhim menjëherë mbas heqjes së shkumës, po të jetë i madh, e lëmë të ziejë afërsisht një orë, pastaj i hedhim ato. Buljoni i zier në zjarr të javashëm, fillon dhe nxjerr yndyrën, të cilën e heqim me një lugë, për ta përdorur në gjellët e tjera. Heqja e yndyrës është e nevojshme, ajo keqëson shijën e buljonit. Për të kuptuar nëse mishi është i zier, provojmë me gjilpërën e kuzhinës ose me pirunin. Kur shpuarja bëhet lirisht, mishi është gati, prandaj e heqim dhe e vendosim në pjetancë.

Po të duam, mishin e presim në racione, simbas personave dhe e servirim me buljonin, së bashku me zarzavatet. Ndryshe, e mbajmë buljonin për supë, e kullojmë atë dhe e heqim mënjanë, ndërsa mishin mund ta servirim me zarzavatet, simbas racioneve.

Në qoftë se buljonin e duam të koncentruar (të trashë), atëhere nga 1 kg. produkte (mishi ose kocke), nxjerrim një litër buljon dhe nga 1 litër buljon të koncentruar marrim 4-5 litra buljon të zakonshëm, duke shtuar ujë, pastaj e vlojmë këtë.

Buljon Peshku

Sasia për një racion:
Peshk: një copë të zakonshme
Mbeturina peshku, kocka, sa të kemi
Qepë: një qepë mesatare
Magdanoz: 2 rrënjë
Kripë: (gjysmë luge të vogël), 3 gram

Përgatitja

Duhet patur parasysh se nuk bën çdo peshk për supë. Marrim peshkun e përshtatshëm, p. sh. qefull, lavrak, që nuk ka erën e baltës dhe mbasi e pastrojmë nga luspat, i heqim të brëndshmet, duke i hapur barkun, e lajmë prap me ujë të bollshëm dhe e vendosim në tenxhere me ujë të ftohtë, duke shtuar mbeturinat, që mund të kemi nga sasia e peshqve të tjerë, që duam t'i gatuajmë ndryshe (si kokë, bishtra, fletë, etj.). Hedhim qepën, magdanozin, kripën, mbulojmë tenxheren me kapak dhe, kur të fillojë të marrë valë, i heqim shkumën e nxjerrë dhe yndyrën: ia heqim kapakun fare dhe vazhdojmë zierjen në zjarr të ngadalshëm për 50-60 minuta. Në qoftë se ka mbetur ose ka nxjerrë shkumë, e heqim.

E kullojmë dhe e kemi gati për të bërë supe peshku.

Buljon Shpendësh

Sasia për 4-5 veta:
Një pulë
2-3 karota
Një rrënjë selino
Dy kokrra qepë
Një rrënjë magdanoz
Disa kokrra piper të zi
Kripë: gjysmë luge gjelle

Përgatitja

Pulën, mbasi e therim, e përvëlojmë 30-40 sekonda në ujë të valuar dhe pendët fillojmë t'ia heqim, duke patur kujdes që të mos i rripet lëkura. Mbasi t'i kemi hequr të gjitha pendët e puplat, e thajmë dhe e përcëllojmë në flakë, që të pastrohen qimet që kanë mbetur.

I bëjmë një prerje në bark dhe me kujdes heqim të brendshmet. Pastaj i presim krahët në nyjet e dyta, ndërsa këmbët i presim në nyjën e parë dhe i kalojmë nga e çara e barkut, në fund të zorrës së trashë. Kështu kemi bërë një nga lidhjet e pulës dhe e kemi gati për zierje.

E vendosim pulën në tenxhere me ujë; hedhim karotat, qepët, selinon, magdanozin të prera në copa dhe piper të zi. E lëmë të ziejë, duke patur kujdes të heqim shkumën dhe yndyrën. Zierja vazhdon derisa pula të shpohet lehtë me pirunin e kuzhinës, pastaj e heqim dhe e kullojmë. Kështu buljonin e kemi gati për të përgatitur supë.

Po te duam, pulen mundet ta veme ne furre, me pak uje e kripe, pasi ta kemi

lyer me gjalpë. E lëmë derisa të skuqet.

Shënim: Për të përgatitur buljon të mirë, duhet të kemi pulë të vjetër. Shtojmë se edhe nga shpendët e tjera, përgatitja e buljonit bëhet me të njëjtën mënyrë.

Supë Orizi

Sasia për një racion:
Oriz: një lugë gjellë rrafsh
Gjalpë i freskët: gjysmë luge gjelle
Djathë kaçkavall të grirë: një lugë gjelle
Buljon (lëng mishi): një filxhan çaji
Kripë: çerek luge të vogël kafeje

Përgatitja

Mbasi qërojmë dhe lajmë orizin, e hedhim në buljonin ose në ujin e valuar. Mbas 10 minutash, hedhim kripë dhe e lëmë prapë në valë, sa të kalojnë 25-30 minuta, kohë e zierjes së orizit. Pastaj e heqim nga zjarri dhe i hedhim gjalpë të freskët.

E servirim në pjatë, duke hedhur djathë kaçkavall, të cilin e kemi kaluar në rende të hollë.

Supë Orizi me Ve e Limon

Sasia për një racion:
Oriz: një lugë gjelle rrafsh
Vezë: kokrra 1/4, ose një kokërr për katër veta
Gjalpë të freskët: gjysmë luge gjelle
Kripë: çerek lugë të vogël kafeje
Piper të zi: simbas dëshirës
Magdanoz: gjysmë luge të vogël, të grirë
Limontoz: simbas dëshirës

Përgatitja

Marrim orizin, e lajmë me ujë të vakët dhe e hedhim në kullesën e kuzhinës. Duke marrë për bazë recepturën për një racion, në një tenxhere hedhim buljonin dhe e vendosim në zjarr. Kur do të jetë gati në valë, hedhim orizin, duke e trazuar pak, i vënë kapakun dhe mbasi të fillojë vala e trazojmë edhe një herë. E lëmë në zjarr deri 20 minuta, pastaj e heqim në anë të sobës.

Nuk duhet të harrojmë që, mbas 10-15 minutash, si ka vluar orizi, të hedhim kripën.

Vëmendje të veçantë duhet të kemi në rrahjen e vezës. Në një enë porcelani rrahim vezën me telin e kuzhinës ose me pirun gjelle. Në të njëjtën kohë hedhim edhe lëng limoni ose limontozi dhe vazhdojmë t'i rrahim ato ritmikisht.

Mbasi të jetë rrahur mirë veza, fillojmë dhe i hedhim gradualisht nga pak buljon, pa ndërprerë rrahjen. Kjo vazhdon derisa temperatura e supës në

tenxhere dhe e vezës në enën prej porcelani, të jetë pothuajse e njëjtë. Pastaj duke e përzier vazhdimisht supën, fillojmë të hedhim vezën pak nga pak. Së fundi marrim sasinë e gjalpit dhe e vënë në tigan. Sapo të skuqet i hedhim magdanozin, piperin dhe ndërsa i hedhim në tenxhere trazojmë supën. Në këtë mënyrë supa është gati për t'u servirur.

Supës mund t'i hedhim edhe gjatë zierjes pak gjalpë.

Kësaj supe mund t'i hedhim edhe pak qumësht.

Ylli i Vogël

Yll' i vogël lart në qiell
Duket porsi zjarr në pyll,
Sipër dheut lart qëndron,
Xixa-xixa xixëllon.

Drit' e yllit, kur shkëlqen,
Udhëtarit ç'i pëlqen,
Natën errët kudo shkon,
Udhën natën s'e harron.

"Supat," Donika Omari, Kuzina shtëpiake (Tiranë), 1966, pp. 20-26; "Ylli i vogël," Abetare (Tiranë), 1958, p. 82.

súpë soup
yndýrë lard; fat; grease
krípë salt
oréks appetite
lëngje (lëng) juices
ziérje cooking
shpend fowl
peshq (peshk) fish
ngjítëse adhesive
trétje digestion
kóckë bone
tenxhére pot
i përshtátshëm suitable
pirún fork
kuzhínë kitchen
vlim boiling
heq remove
lúgë spoon
i posáçëm appropriate
shkúmë foam; froth
prish spoil; ruin
i ngadálshëm slow
zarzaváte vegetables
i prérë cut
thélë piece; slice; chunk
várem depend
héqje removal
ziéj cook; boil
i javáshëm gradual; slow
keqësój spoil; ruin
i ziér cooked
gjilpërë needle; spike
shpúarje piercing
pjetáncë baking dish
mënjánë aside
vloj boil

sasí amount; quantity
mbeturínë remnant; leftover
qépë onion
mesatár middle-sized
magdanóz parsley
qéfull mullet
lavrák sea-wolf
lúspë scale
i bóllshëm plentiful
gatúaj cook
bisht tail
flétë fin
kapák cover
marr válë boil up
selíno celery
kókërr head; grain; piece
ther slay
përvëlój scald; burn up
rrjep rip; tear; skin (an animal)
lëkúrë skin; hide
púpël down
thaj dry
përcëllój singe
qïme pinfeather
prérje cut
nýjë joint
i çárë cut; cut open
zórrë intestine
derisá until
shpoj pierce

lýej brush; paint
gjálpë butter
skuq make red; redden
shëním note
oríz rice
rrafsh even
djáthë cheese
kaçkaváll a hard cheese
i grírë ground
filxhán cup
çaj tea
gërój clean
i valúar boiling
pjátë plate; dish
rendé grate
limontóz tartaric acid
kullésë strainer
receptúrë recipe
trazój stir
sóbë stove; range
rráhje beating
tel wire whip
ritmikísht rhythmically
ndërpréj interrupt

pothúajse almost
përzíej mix
tigán skillet
qúmësht milk

---

xíxa-xíxa like sparks; full of sparks
udhëtár traveler; wayfarer
érrët dark

LEXIMI I DYZETENJETE

Kujtime

Jemi në Kopinovë të Beratit. Suferina dhe bora e 20 shkurtit të merr frymën dhe rrugët mezi çahen nga bora e shumtë. Një letër urgjente na vjen nga shtabi i përgjithshëm, i cili na ngarkon me një mision me shumë rëndësi. Për të kryer këtë mision duhet që forca të brigadës së I-rë të kalojnë Shkumbinin dhe të arrijnë në Shën-Gjergj të Tiranës. Arritja e objektivit është jashtëzakonisht e vështirë. Të gjithë malet janë të pakapërcyeshëm nga bora; lumi i Shkumbinit nuk mund të kalohet më këmbë; operacioni i dimrit është në zhvillim e sipër e të gjitha zonat përpara nesh janë reaksionare.

Më 21 shkurt komandanti i brigadës niset nga Dardha e Sulovës me batalionin e I-rë e të III-të për të kryer këtë mision. Kalojmë Tomoricën, Oparin, Gorën e më 25 shkurt jemi te Çezmja e Mokrës.

Udhëheqës nuk kemi. E gjithë bota është e mbuluar me borë dhe kjo vazhdon të bjerë gjithnjë pa pushim. Shkumbini mund të kalohet vetëm atje ku buron, mu afër Prrenjësit. Partizanëvet u është njoftuar vetëm rëndësia e misionit, por jo misioni vetë; ky mbahej shumë i fshehtë dhe e dinte vetëm shtabi i brigadës. Më 26 shkurt mblidhen të tre batalionet:

--Shokë! Shtabi i përgjithshëm na ka ngarkuar me një mision shumë të rëndësishëm. Kjo barrë i ngarkohet brigadës së parë. Misioni ynë është me aq rëndësi, sa që mjafton të kryhet edhe sikur të dy batalionet të asgjësohen për të arritur objektivin. Përpara nesh ndodhen pengesa gati të pakapërcyeshme, porse ne të brigadës së parë mund t'i kapërcejmë, po të duam dhe besoj se që të gjithë duam t'i kapërcejmë, dhe do t'i kapërcejmë. Do të udhëtojmë shumë larg, do të kapërcejmë lumenj, male me dëborë. Do të udhëtojmë ditë dhe net të tëra pa bukë, pa gjumë, mbathur e veshur kështu siç jemi, do të ndodhemi në zona reaksionare të rrethuar nga ballistë dhe gjermanë. Kjo është gjendja përpara nesh. Tani secili nga ju të mejtohet mirë, përpara se të flasë dhe të gjithë ata që nuk e shohin veten në gjendje që të marrin pjesë në këtë udhëtim heroik, të dalin mënjanë dhe të mbeten në Mokër.

Pa mbaruar mirë këto fjalë, buçet zëri i partizanëve në mënyrë demonstronjëse: "Të gjithë, të gjithë do të shkojmë; do t'ia tregojmë armikut se cilët jemi!...Rorftë shtabi i përgjithshëm! Rroftë Partia Komuniste!"

Në pasdreken e 26 shkurtit 1944 të tërë batalionet fillojnë rrugën nëpër dëborë të përzier me shi. Një gëzim dhe kureshtje shikohet në sytë e partizanëvet. Të gjithë janë gati të bëjnë çdo sakrificë. Të gjithë janë të ndërgjegjshëm për detyrën që u është ngarkuar dhe të gjithë kanë besim të plotë në udhëheqjen. Errësira e natës na gjen në veri të Lakteshit, në xhadenë, që të çon për Qukës. Bora ndalon, porse pasohet nga një shi i rrëmbyeshëm, i cili vazhdon gjithë natën. Me vete kemi vetëm tri mushka të forta me një mortajë të rëndë dhe të gjithë materialin tjetër të rëndë e kemi lënë në Mokër. Aty nga mezi i natës futemi në një katund dhe kërkojmë një udhëheqës. Është një katund ballist. Pas pak dëgjohen tri të shtëna pushke nga ana e katundarëvet. Kjo është shenja e alarmit të ballistëve. Marrim me zor një udhëheqës dhe vazhdojmë rrugën drejt Skroskës. Bora ka

filluar të shkrijë nga shiu dhe mezi çahet. Nata është shumë e errët dhe shpesh kolona shkëputet dhe detyrohet të qëndrojë, sa të vendoset lidhja. Aty nga ora tre pas mesnate kalojmë rrugën Elbasan-Korçë pa gjetur ndonjë pengesë. Në mëngjes arrijmë në Skroskë, një katund reaksionar afër Qukësit dhe xhadesë. Të gjithë katundarët para nesh janë reaksionarë.

Partizanët me entuziazëm dhe të vendosur, por të lodhur dhe të këputur nga udhëtimi i gjatë, ecin përmbi dëborën e trashë. Katundarët e shikojnë me habi këtë kolonë të gjatë partizane; për ta kjo është një gjë e papritur.

Kur kolona është akoma në një përrua të thellë të Skroskës, një mitraloz i rëndë na qëllon behas pas krahëvet nga Skroska. Janë tradhtarët ballistë që qëllojnë pas shpine mbi ne. Në goditjen e parë mbetet i vrarë partizani i batalionit të dytë, Behat Xhindolli. Kolona gjendet në një pozitë të keqe në vend të hapët, pa asnjë mbrojtje. Pararoja posa ka arritur në një qafë, ndërsa të gjithë ne ndodhemi në përruan e thellë dhe shumë të rrezikshëm. Batalionet me gjakftohtësinë më të madhe shpejtojnë hapat dhe pas një gjysmë ore ndodhen jashtë përroit, ata kanë kapur majat, që zotërojnë vendin rreth e rrotull. Mitralozat tanë fillojnë të rrahin ballistët e Skroskës. Po nuk shkon shumë kohë, veç kur mitralozat gjermanë fillojnë të shtijnë nga dy drejtime mbi pozicionet tona. Qindra gjermanë dhe mercenarë vërsulen kundra nesh duke kujtuar se jemi ndonjë kolonë e shpartalluar nga operacioni i jugut e tash kërkojmë strehë në veri. Mejtojnë se partizanët do t'u dorëzohen. Gabohen rëndë gjermanët dhe tradhtarët.

Partizanët, pa gjumë, të lodhur, të këputur, pa ngrënë, në mes të borës, rezistojnë dhe me anë kundërsulmesh përbmi dëborë nuk e lënë armikun që të afrohet. Qëllimi i komandës është që të rezistojmë gjer në darkë dhe pastaj, duke përfituar nga nata, ta çajmë këtë rrethim. Gjendja është me të vërtetë shumë kritike, të gjitha rrugët janë të zëna prej armikut, mali i Shebenikut, që ndodhet pas shpinës sonë, është i ngarkuar aq rëndë me dëborë, sa është gati i pashkelshëm. Dy rrugë na mbeten: ose të kthehemi prapë në Mokër ose të vazhdojmë rrugën për në objektivin e caktuar. Të rezistosh akoma në këto pozicione, do të thotë t'i lejosh armikut ta ngushtojë rrethimin. Për këtë gjë komandanti i brigadës mbledh batalionet që të gjithë dhe u thotë: "Shokë, jemi të rrethuar! Tash do të shihet në se meritojmë të quhemi partizanë të brigadës së I-rë, në se do ta mbajmë betimin tonë. Të mos harrojmë misionin që na është ngarkuar. E përsëris për të fundit herë se misioni është me shumë rëndësi. Jemi të rrethuar, porse çdo problem ka një zgjidhje. Rrethimin do ta çajmë, vetëm kërkohet nga çdo përgjegjës ushtarak e politik, nga çdo partizan e partizane vendosmëria më e madhe, shpejtësia në lëvizje, durimi në vuajtje, duhet mbi të gjitha vetemohim. Ju pyes për të fundit herë në se doni të kthehemi mbrapsht, apo të vazhdojmë rrugën për të arritur objektivin!" Zëri i partizanëvet buçet në formë demonstrate për të vazhduar rrugën drejt objektivit. Kjo mbledhje është me të vërtetë e thjeshtë, po madhështore, malrëngjyese, rrënqethëse, kur sheh vendosmërinë e partizanëve, kur dëgjon këngët revolucionare, që përzihen me jehonën e krismave të mitralozave nga të gjitha anët.

* * * *

Darka po afrohet. Kolona lë një praparojë dhe niset drejt malit përpjetë duke çarë borën, që është më tepër se një metër e trashë.

Si udhëheqës kemi dy fshatarë, që i kemi marrë në Skroskë.

Armiku përpiqet ta ngushtojë rrethin nga tri anët, porse praparoja qëndron e patundur. Çajmë malin përpjetë dhe nga ana që po shko, në tani nuk ka forca armike, meqë është borë e madhe dhe armiku kurrë nuk e mejtonte lëvizjen tonë në atë drejtim. Fillon një suferinë e fortë dhe mjegulla mbulon gjithçka. Ia fillon bora dhe sa më lart ngjitemi, aq më keq. Një kompani përpara çan borën dhe çdo 15 minuta ndërrohet me një kompani tjetër. Në një pllajë të vogël afër pllajës së Shebenikut 1400 m lart gjejmë një kasollë të një stani të vjetër. Të tri mushkat e mortajës bashkë me mortajë e municion na kanë mbetur dy orë larg kasollës e nuk ka mundësi që t'i marrim. Mbas pak ia arrin edhe praparoja. Stani është një gërmadhë e vjetër dhe gjysma e çatisë së tij është krejt e shkatërruar dhe bora e ka mbushur gjysmën e konakut përbrenda. Bora fillon të bjerë më e shpeshtë. Të gjithë jemi të lodhur e të këputur nga rruga e gjatë dhe e vështirë, nga pagjumësia, nga të pangrënët, nga lufta.

Kemi 32 orë që po udhëtojmë pa pushim në shi e në dëborë, në luftë e mundime. Me fletët e çadravet e nxjerrim borën jashtë shtëpisë dhe strukemi brenda aq shtrënguar, sa nuk mund të lëvizet dot. Dy batalione mbeten jashtë. Ç'të bëjmë? Të qëndrojmë aty, armiku do të na i mbyllë të gjitha rrugët gjatë natës; mundësi ushqimi nuk kemi; dikujt i bije të fikët nga lodhja dhe nga uria. Nisim batalionin e dytë dhe të tretë drejt disa shtëpive në krye të Hotolishtit. Këto shtëpi janë gjashtë orë larg. S'ka mundësi tjetër. Vonesa për neve është vdekje. Këto dy batalione nise në errësirën e natës pyjevet dhe gërxhevet duke pasur përpara dy udhëheqës. Arrrijmë gjer afër fshatit dhe atje ngecim në një përrua të thellë, që nuk mund të kapërcehet natën. Ashtu jashtë në dëborë, pa zjarr e pa bukë gdhihen këta dy batalione. Batalioni i parë mbetet sipër në mal në stanin e vjetër. Dikush propozon që të dërgojmë e të marrim tri mushkat e ngecura në borë për t'i therur e për t'i ngrënë, porse mushkat janë larg e zjarr nuk mund të ndizet nga dëbora.

Akoma pa gdhirë mirë dita e 28 shkurtit, kolona vihet në lëvizje. Batalioni i dytë dhe i tretë arrijnë në lagjen e sipërme të Hotolishtit dhe atje për fat të mirë gjejnë Hoxhë Çotën, një simpatizues të Frontit Nacional-Çlirimtar. E marrin këtë si udhëheqës dhe nisen në drejtim të malit për në kasollet e Dragoshtunit. Batalioni i parë pa udhëheqës çan dëborën nëpër përrenj e shkëmbinj, nëpër pyjet e mbushura me dëborë dhe afër darkës arrin dhe ky në kasollet e Dragoshtunit, 1300 m lartësi. Të ulemi poshtë katundeve nga e majta do të thotë të futim veten në gojë të ujkut. Mijëra ballistë të të gjithë katundeve bashkë me qindra gjermanë po lëvizin nga krahu ynë i majtë për të na dalë përpara dhe një pjesë e tyre nuk na ndahet nga gjurma që lë vazhda jonë. Dëbora është e madhe. Koha është e errët; herë bie shi, herë bie dëborë. Kur arrijmë në këto kasolle të banuara, një farë kënaqësie ndihet në partizanët pse do të mundim të çlodhemi pak dhe të hamë diçka. Porse vonimi është vdekje. Nga gjithë anët armiqtë sulen si të tërbuar kundër nesh, që mundëm t'u shpëtojmë nda duart si në Qukës ashtu edhe në Skroskë. Në kasollet e Dragoshtunit (dymbëdhjetë kasolle të vjetra të ndara nga bota e jashtme prej borës) familjet janë të frikësuara. Pandehin se ne do t'i vrasim dhe do t'i therim. Burrat e luftës, kanë shkuar në katund për të udhëhequr gjermanët dhe forcat balliste kundër nesh. Detyrohemi të therim 70 kokë bagëti duke i paguar që të gjitha. Shumë partizanë na

kanë mbetur zbathur, pasi kanë udhëtuar për një kohë të gjatë mbi dëborë: këmbët u janë enjtur dhe u kullojnë gjak.

Pasi çlodhemi pak, aty nga mezi i natës kolona vihet në udhëtim. Drejtimi ynë është Qarishtja, një katund nga më reaksionarët në Shqipëri. Nata është e errët: një pjesë e shokëvet janë të sëmurë. Përmes një bore të trashë 2 m ngjitemi në lartësinë 1900 m në mal të Dragoshtunit. Duam të mos kalojmë nëpër katundet, që gjenden nga e mëngjëra e jonë. Ndërsa kolona po ecën përmes pyjesh ahishte dhe pishe të dendur, prapa nga e mëngjëra dhe përpara nesh dëgjohet zëri i daulles. Të gjithë katundet reasksionare të Librazhdit dhe të Çermenikës së Zezë, nën kushtrimin e tradhtarit Azis Biçaku, u bien daulleve të tyre për t'u ngritur kundër nesh. Partizanët nuk tronditen aspak, po ecin edhe ecin e nuk kundërshtojnë; ata janë të vendosur, kanë besim në udhëheqjen. Kolona ecën shumë ngadalë nga lodhja, nga bora e madhe e nga shokët e sëmurë. Prapa kolonës në bardhësirën e pafundme nuk mbetet gjë veç vazhdës së ngushtë dhe të thellë të qëndisur me pika gjaku, që u rrjedh partizanëvet nga këmbët e zbathura e të skuqura nga të ftohtit.

Armiku ka qenë në lëvizje për gjithë natën: nja 600 gjermanë bashkë me shumë ballistë janë nisur nga Hotolishti pas vazhdës sonë; një forcë tjetër balliste dhe gjermane është nisur nga katundi Librazhd për të dalë në qafën strategjike të Shapkës së Librazhdit, që të na presë rrugën. Plani i armikut është i studiuar mirë, porse manovrimi ynë i shpejtë bën që çdo plan i tij të dështojë. Shpejtësia është karakteristika kryesore e brigadës së I-rë. Kështu në mëngjes, kur gjermanët dhe ballistët arritën në kasollet e Dragoshtunit, kolona jonë ndodhet katër orë larg në Shapkën e Librazhdit. Dhe kur armiku del në Shapkën e Librazhdit, ne jemi tri orë larg kësaj pike, jemi në Qarrishtë.

Mehmet Shehu, "Kujtime," Abetare (Tiranë), 1958, pp. 175-181.

kujtím recollection
suferínë storm; tempest
çaj break through
shtab staff
i përgjíthshëm general
ngarkój entrust; charge
i pakapërcýeshëm impassable
udhëhéqës guide; leader
burój spring; well-up
njoftój notify
asgjësój annihilate
pengésë obstacle; hurdle
kapërcéj overcome; cross
udhëtój travel
net (nátë) nights
i rrethúar surrounded
ballíst a member of the Bálli Kombëtár (Nationalist Front) group that opposed the partisans
secíli each one
mejtóhem consider
udhëtím journey
pa mbarúar mírë këtó fjálë hardly had these words been spoken
rróftë...! long live...!
i përziér mingled
kuréshtje curiosity
i ndërgjégjshëm conscientious
xhadé highway
pasój follow
i rrëmbýeshëm driving; impetuous
múshkë mule
e shtënë púshke rifle shot
zor difficult

kolónë column
shkëpút separate; break off
habí surprise
përrúa creek bed; brook
befás suddenly
tradhtár traitor
i hápët open
pararójë advance guard
gáfë mountain pass; high ground
i rrezíkshëm dangerous
gjakftohtësí composure
zotërój command; dominate
vërsúlem hurl myself; rush on
i shpartallúar decimated
stréhë shelter
gabóhem err
kundërsúlm counterattack
rresht in succession; straight
dárkë evening
përfitój take advantage of
i zënë held
i pashkélshëm inaccessible
i caktúar set; determined
ngushtój narrow; tighten
betím oath
përgjégjës responsible
vendosmërí determination
durím patience
vetëmohím self-denial
mbrapsht back
rrëngéthës quivering; thrilling
jehónë echo; repercussion
krísmë cracking
prapарójë rear-guard

i patúndur immobile
mjégull fog
pllájë slope
stan cabin; stable
gërmádhë ruin
çatí roof
i shkatërrúar destroyed
konák habitation; lodging
përbrénda within
i shpéshtë frequent
pagjumësí sleeplessness
pangrënë without food
mundím suffering; trouble
çádër tent
urí hunger
vonésë delay
pýje (pyll) forests
ngec get stuck
gdhíhem wake up
përrénj (përrúa) brooks
i májtë left
gjúrmë trail; footstep
vázhdë wake; trail
kóhë weather
voním delay
súlem take the offensive; attack
i ndárë separated
i frikësúar frightened

i sëmúrë sick
i mëngjër left
pýje ahíshte beech forests
píshë pine
daúlle drum
bardhësírë whiteness
i pafúndmë endless
i qëndísur embroidered
studiój study
manovrím maneuver
dështój fail; abort

LEXIMI I DYZETEDYTE

Arbëreshët e Italisë

Katastrofa e madhe që vërshoi mbi popullin tonë me agresionet dhe pushtimin turk, ndër të tjera, si e pamë, solli edhe emigrimin e një pjese të madhe të popullsisë. Përpara masave shfaruese të pushtuesit ndaj një populli që i kishte bërë një qëndresë aq të madhe, me mijëra shqiptarë braktisën qytetet e fushat, morën udhën e mërgimit dhe kaluan në Itali, për të shpëtuar nderin e jetën e tyre nga "qeni turk", si shphreheshin ata plot urrejtje për pushtuesin e huaj.

Ky emigrim u bë në valë të ndryshme, duke filluar nga mezi i shekullit XV. Emigrimet më të para, të viteve 1448 e 1461, përfshinë grupe të kufizuara. Ato u bënë të dendura dhe masive pas vdekjes së Skënderbeut, në vitet 1468-1478. Masat e të emigruarve u shpërndanë nga mbreti i Napolit nëpër krahinat e varfëra të jugut të Italisë, u vendosën nëpër tokat e lëna djerr të Bazilikatës, Molizes, Kapitanatës, Puljes e më shumë të Kalabrisë, ku themeluan edhe fshatra të reja. Grupe të tjera më të pakta u vendosën në Siqeli.

Më 1532-1533, ndodh një emigrim tjetër i madh shqiptarësh në Itali, po kësaj here nga arbëreshët e Greqisë të krahinës së Koronës së Moresë. Ata zunë vend sidomos në tokat e Siqelisë dhe në disa vise të Italisë së jugut. Këndej e ka burimin edhe kënga e njohur popullore:

Mori e bukura More,
çë të le më s'të pe!
Atje kam u zonjën mëmë,
atje kam u tim vëlla,
atje kam u zotin tat
të mbuluar nënë dhe!

Të arratisurit e shqiptarëve nga atdheu e vendosja e tyre në Itali ka vazhduar edhe më pas, duke u krijuar fshatra të tjera në krahinat e Kampobasos dhe Foxhias. Kolonia më e re është Vila Badesa në Abrucet, themeluar në 1744 nga banorë të fshatit Piqeras të Himarës.

Pa ndihmë dhe në kushte të vështirë, arbëreshët filluan të merren me bujqësi, të luftojnë me natyrën e varfër, të kultivojnë rrushin dhe agrumet, duke i kthyer mjaft vende të shkretë në fshatra të lulezuar.

Edhe pasi u vendosën në Itali, këta shqiptarë për shumë kohë s'e humbën shpresën që të vijnë prap në atdhe. Ata ruajtën me dashurinë më të madhe gjuhën, zakonet e traditat, mbajtën gjallë mallin për vendin e origjinës dhe kujtimin e së kaluarës së lavdishme të prindërve të tyre. Çdo vit, me rastin e pashkëve, grupe këngëtorësh, të veshur me kostume kombëtare, shëtisnin fshatrave arbëreshe duke kënduar rapsoditë e vjetra shqiptare.

Tokat ku u grumbulluan pjesa më e madhe e arbëreshëve, ishin prona feudale dhe krahinat e tyre qenë nga vendet më të pazhvilluara të Italisë në pikëpamje ekonomike, shoqërore e kulturore. Për shkak të këtyre rrethanave, arbëreshët, gjer në shekullin XIX, jetuan pa u përzier aq shumë me vendësit italiane, masat qëndruan larg ndikimit të kulturës italiane dhe kolonitë e

tyre u ruajtën të paprekura, me karakteristikat kombëtare të tyre. Më pas, me zhvillimin e marrëdhënieve të reja shoqërore e politike, me shtimin e lidhjeve me vendësit italianë e të kontakteve me qendrat e mëdha, zakonet, kultura e gjuha italiane depërtuan më gjerë e më thellë, dhe mjaft prej fshatrave e humbën fizionominë arbëreshe dhe gjuhën shqipe.

Në shekullin XIX, në Itali kishte rreth 200,000 arbëreshë. Statistikat italiane të vitit 1921, të plotësuara në 1927, jepnin 20,113 familje me 80,282 frymë. Statistikat e mëvonshme shënojnë vetëm 48 fshatra arbëreshe. Kolonitë e tyre më të mëdha gjinden në Kalabri, në krahinat e Kozencës dhe të Katancaros, dhe në Siqeli, në rrethet e Palermos.

Këta shqiptarë që zunë vend në Itali e ruajtën gjuhën shqipe jo vetëm duke vazhduar ta flasin, po edhe e shkruan dhe e lëvruan si gjuhë letrare. Ata krijuan në të edhe një letërsi, që u lejoi të mbajnë ndezur gjithnjë dashurinë për traditat kombëtare. Kjo letërsi është gati aq e vjetër sa letërsia e Shqipërisë dhe zhvillohet paralelisht me të. Si letërsia tjetër shqipe e shekujve XVI-XVII, edhe letërsia arbëreshe nis me vepra fetare. Populli s'e kuptonte mirë apo s'e njihte fare italishten, prandaj ndjehej nevoja që t'i flitej në gjuhën amtare e të zhvillohej shqip propaganda fetare. Për këtë arsye u përkthyen shqip vepra e vjersha fetare.

Lekë Matrënga 1560-1619

Për autorin e monumentit më të lashtë të letërsisë arbëreshe, që për nga vjetërsia është vepra e dytë e gjithë letërsisë shqipe, kemi disa të dhëna. Ka lindur në katundin Hora e Arbëreshëve (Piana dei Greci), pranë Palermos në Siqeli. Rridhte prej një familje të njohur, të ardhur nga Himara, që është shquar në luftën për të mbrojtur zakonet e ritit ortodoks ndër shqiptarët e Italisë kundër ndërhyrjeve të peshkopëve italianë. Matrënga është një nga priftërinjtë e parë që u përgatitën në kolegjin fetar të Shën Athanasit në Romë. Këtu ai studioi, përveç lëndëve fetare, edhe letërsi latine e greke.

Nga viti 1592, kthehet në fshatin e lindjes, ku shërben si prift. Bashkëfshatarët, si e shënon edhe ai vetë në librin e tij, nuk e kuptonin italishten. Ky fakt dhe mungesa e librave fetare në gjuhën shqipe, e shtynë Matrëngën që t'i hyjë përkthimit të një katekizmi. Ai s'pati parasysh vetëm nevojat e mësimit fetar të fëmijëve të Horës e të fshatrave të tjera arbëreshë të Siqelisë, po mendoi edhe për bashkatdhetarët e tij të Kalabrisë e të Puljes, krahina ku, sipas tij, "numëroheshin me qindra lagjet e fshatrat shqiptare".

Katekizmi që përktheu Matrënga qe ai i priftit spanjoll Ledesma. Vepra është ruajtur si dorëshkrim ne tri kopje të ndryshme që ndodhen në Bibliotekën e Vatikanit. Botimi është bërë në Romë sipas kopjes së tretë.

Libri hapet me një letër kushtesë, në të cilën autori shtjellon qëllimin, rrethanat dhe efektin e përkthimit të kësaj vepre tek besimtarët e tij.

Pas kushtesës vjen një këngë e përshpirtshme, 8 vargje njëmbëdhjetërrokëshe me rime të alternuar. Është përkthimi i lirë i katër distikëve latine, që janë botuar përbri. Kjo vjershë ka rëndësi historike, sepse kemi vargjet e para të poezisë shqipe. Ato janë shkruar me një siguri e shkathësi të plotë. Matrënga është kështu lëvruesi i parë që njohim i vjershërimit shqip.

Katekizmi është zakonisht në formë dialogu. Nëpërmjet dialogeve, që zhvillohen midis mësuesit dhe nxënësit, shtjellohen dogmat e fesë katolike, shënohen uratat, urdhërimet etj. Pranë përkthimit shqip është vënë edhe teksti italisht.

Libri i Matrëngës është i vogël (28 faqe) dhe i karakterit fetar. Ai nuk jep as material të pasur gjuhësor: leksiku i përdorur aty s'i kapërcen 450 fjalët. Me gjithë këtë, libri ka rëndësi të veçantë për historinë e letërsisë, të gjuhës dhe të kulturës shqiptare, si vepra e parë e letërsisë arbëreshe dhe monumenti i dytë letrar-gjuhësor shqip i shekullit XVI.

Duke qenë vepra më e vjetër e shkruar toskërisht dhe e një shekulli me veprën e Buzukut, ajo na lejon të shohim afërsinë e dy dialekteve të shqipes në mesjetë. Në të gjejmë edhe fakte ghuhësore që i përkasin sot gegërishtes, po që kanë qenë të mbarë gjuhës e më vonë janë zhdukur nga dialekti ynë jugor. Katekizmi i Matrëngës vlen mjaft edhe për të ndjekur zhvillimin historik të të folmeve arbëreshe në Itali dhe të toskërishtes në përgjithësi.

Matrënga mori si bazë alfabetin latin; shkronjat i përdori me vlerën fonetike që kanë italisht. Futi në përdorim kombinime shkronjash për tingujt e shqipes që s'kishte gjuha latine. Ai është i pari që dalloi në të shkruar ë-në nga e-ja.

Vepra e tij nis traditën arbëreshe të shkrimit shqip. Grafia e Matrëngës la gjurma në grafinë e mëpastajme të shkrimeve arbëreshe.

Arbëreshët e Greqisë

Një lëvizje e kufizuar kulturore dhe letrare nisi tek arbëreshët e Greqisë aty nga mezi i shekullit XIX, e lidhur me lëvizjen kombëtare të popullit tonë gjatë atij shekulli. Atëhere arbëreshët e Greqisë bëheshin disa qindra mijë: thuhet se një e pesta e popullsisë së vendit, në mos më shumë, --statistika të sakta nuk njohim.

Shqiptarët filluan të vendosen në Greqi, e pakta që nga mezi i shekullit XIV. Ata janë përndarë nëpër krahinat e Etolisë, Akarnanisë, Beotisë, Atikës, në gadishullin e Moresë, në ishullin e madh Eubea, në ishujt Hidra, Specia, Psara, Andros, dhe në shumë vise të tjera, duke formuar fshatra kompakte të tyret, të cilat në shekullin e kaluar ruanin mirë gjuhën dhe zakonet e të parëve. Shteti grek, i krijuar atë shekull, nisi punën për asimilimin e tyre në masë, po qëllimit ia arriti vetëm pjesërisht. Edhe sot, shumë koloni arbëreshe të Greqisë ruajnë gjuhën dhe zakonet e tyre të lashta.

Arbëreshët kanë luajtur role me rëndësi në historinë mesjetare dhe sidomos në historinë e re të Greqisë. Për shumë kohë, feudalët shqiptarë të familjeve Shpata, Losha, Sguri etj. sunduan gjatë mesjetës në vise të ndryshme të Greqisë. Më 1533 banorët e brigjeve të Mesenisë së Moresë, sidomos ata të qyteteve Korene dhe Modone, luftuan trimërisht kundër turqve, po, të thyer nga epërsia numerike e armikut, u detyruan të shpërngulen dhe të vendosen në Italinë jugore në Siqeli. Kujtimet e tyre të Moresë ruhen te kënga e njohur, që cituam më lart si dhe në emrin e katundit Shëmitër Korone,

në emrat e shumë familjeve arbëreshe përtej Adriatikut.

Rol veçanërisht të madh luajtën arbëreshët gjatë lëvizjes kombëtare greke, për çlirimin e vendit nga zgjedha turke. U shquan atëhere në radhë të parë kolonitë arbëreshe të ishujve Hidra dhe Specia. Këto ishin bërë dy nga qendrat më të pasura dhe më të lulëzuara të Mesdheut lindor, me një flotë prej më se 250 anijesh, me disa tregtarë të mëdhenj milionerë, që kishin marrëdhënie në të katër anët e Mesdheut dhe më tej. Jeta kulturore e tyre ishte e zhvilluar. Arbëreshët ishin në kontakt me kulturën e Evropës perëndimore dhe me idetë e revolucionit borgjez të Francës. Ja se si e përshkruan një udhëtar frëng Hidrën në fillim të shekullit XIX:

"Ishulli Hidra ndryshon nga shumica e ishujve të Greqisë, ku njeriu nuk sheh veçse një popull...të varfër në mes një vendi të begatshëm... Hidriotët janë gazmorë, të shëndoshë, aktivë, qyteti i tyre po rritet përditë...: Në atë qytet shohim magazina plot me prodhime industriale dhe tregëtare, një kishë me arkitekturë elegante... Hidriotët furnizojnë Stambollin dhe skelat e Lindjes".

Specia ngriti e para krye kundër turqve më 1821. Arbëreshët, dhe veçanërisht ata të ishujve, luajtën një rol shumë të madh në revolucionin e atij viti dhe në krijimin e shtetit të pavarur grek. Disa nga udhëheqësit më të famshëm të lëvizjes kombëtare dhe të revolucionit grek, qenë Llazar Kundurioti dhe Andrea Miauli, nga Hidra,--ky i fundit, marinar heroik që dërrmoi flotën turke më 1822,--Konstantin Kanari nga Psara etj. Heroi i revolucionit, Marko Boçari, ishte shqiptar nga Suli.

Interesimi për çështjen shqiptare tek arbëreshët e Greqisë, megjithëse ka shenja të ketë lindur që në fillim të shekullit XIX,--kur Llazar Kundurioti mendonte për krijimin e një shteti të lirë greko-shqiptar, që t'i zinte vendin atij të Ali pashë Tepelenës,--ai interesim nuk mundi të zhvillohet sa duhet. Pas shpalljes së pavarësisë (1821-1826), përpjekja për t'i helenizuar arbëreshët qe ngaditë më e madhe në Greqi. Shovinizmi dhe kisha greke u bënë edhe armiq të egër të lëvizjes sonë kombëtare. Domosdo ata u orvatën ta shtypin çdo lëvizje të arbëreshëve të Greqisë dhe s'i lanë të kenë sukses të mjaftueshëm patriotët arbëreshë që ia hynë kësaj pune.

Lëvizja kulturore-letrare shqipe e arbëreshëve të Greqisë është e lidhur me përpjekjen e tyre për t'i ardhur ndihmë atdheut të stërgjyshërve, --Shqipërisë. Nuk dimë kur nisi të shkruhet për herë të parë gjuha amtare midis tyre. Po dimë se Ungjilli shqip i botuar më 1827, qe pritur mirë dhe qe përhapur në fshatrat arbëreshe, fjala vjen në Eube. Interesi që kishin treguar për shqipen njerëz të kulturës apo shkrimtarë grekë, si Gjermanosi i Kretës dhe Jan Vellarai, a duhet lidhur me interesin e arbëreshëve të Greqisë për të shkruar gjuhën amtare? Këtë nuk mund ta themi. Ne dimë se, që në fillimet e lëvizjes sonë kombëtare, arbëreshët e Greqisë ishin në kontakt me rilindësit. Kështu, rreth vitit 1838, i biri i Andrea Miaulit e kish ftuar De Radën për një udhëtim në Greqi, udhëtim që nuk u bë. Jemi dy vjet pas botimit të "Milosaos". Më pas, kontaktet u shpeshuan. Dihet përkrahja që gjeti tek arbëreshët e Italisë, si fjala vjen Kamarda, dhe te rilindës të ndryshëm të Shqipërisë, si Mitkoja, ideja e krijimit të një shteti shqiptaro-grek. Mitkoja e kuptoi më pas kotësinë dhe rrezikun e kësaj ideje. Më 1870, Kamarda botoi një përmbledhje vjershash nga autorë të ndryshëm shqiptarë, për nder të Dora D'Istrias, midis tyre edhe një vjershë nga arbëreshi i Hidras, Gjergj Driva. Ky mburret me emrin shqiptar, duke thënë

se "Arbëria gjithmonë njerëz të mëdhenj ka nxjerrë". Pastaj, falënderon Doran se vuri në dukje "tragjikat e trimëritë" (fatet tragjike dhe bëmat) e arbëreshëve.

Figurat më të shquara të lëvizjes patriotike dhe kulturore-letrare ndër arbëreshët e Greqisë, janë Anastas Kullurioti dhe Panajot Kupitori.

"Arbëreshët e Italisë," Dh. Shuteriqi et al. (Eds.), Historia e letërsisë shqipe I (Tiranë), 1959, pp. 196-201. Selection originally titled, "Letërsia shqipe e arbëreshëve të Italisë në shekullin XVI"; "Arbëreshët e Greqisë," Ibid., Vol. II (Tiranë), 1959, pp. 203-205, 207-208. Selection originally titled, "Lëvizja kulturale-letrare e arbëreshëve të Greqisë ne shekullin XIX".

vërshój inundate
përpára in the face of; in front of
shfarúes exterminating
qëndrésë resistance
braktís abandon
mërgím migration
urréjtje hatred
pushtúes occupier
përfshí include
i kufizúar limited
shpërndáj spread out; disseminate
djerr fallow
i pákët small
zë vend settle
Siqelí Sicily
këndéj owing to this; from this
burím source
mori = moj interjection
çë = që that
le = láshë left
pe = páshë saw
u = únë I
mémë = nënë mother
tat = átë; babá father
nénë = nën under
i arratísur emigrant
të arratísurit exile; exodus
kusht condition
bujqësí agriculture
rrush grape
agrúme citrus fruits
príndër parents; ancestors
páshkë Easter
këngëtór singer
grumbulló j bring together; assemble
prónë property
i pazhvillúar undeveloped
pikëpámje viewpoint
shkak account
rrethánë circumstance

i paprékur untouched; intact
depërtój penetrate
i plotësúar refined; revised; updated
gjíthnjë always
amtár native
u përkthýen (përkthéj) were translated
vjérshë (popular) poem
autór author
vjetërsí oldness; age
të dhëna data; givens
rit rite; ritual
ndërhýrje intervention
peshkóp bishop
lëndë subject
mungésë absence
përkthím translation
dorëshkrím manuscript
shtjellój unfold; set forth
besimtár faithful one; believer
i përshpírtshëm spiritual; pious; memorial
njëmbëdhjetërrókëshe eleven-syllabled
distíkë distich; two-line verse
përbrí on the opposite side
shkathësí skill
lëvrúes cultivator
vjershërím verse-making

nxënës pupil
leksík lexicon
kapërcéj exceed
toskërísht Tosk; of the Tosk dialect
afërsí affinity; nearness
gegërísht Gheg; of the Gheg dialect
jugór southern
dallój distinguish
grafí letter; alphabet
i mëpastájmë subsequent

---

i kufizúar limited
thúhet (them) it is said
i sáktë exact; accurate
përndáj spread out
íshull island
sundój rule
epërsí superiority
shpërngúl uproot
citój cite
si dhe as well as

veçanërísht especially
shqúaj distinguish
Mesdhé Mediterranean
flótë fleet
aníje ship
më tej beyond
perëndimór western
përshkrúaj describe
frëng French
i begátshëm fertile; productive
i shëndóshë helathy; strong
përdítë daily
magazínë store
i pávarur independent
i fámshëm famous
marinár seaman; mariner
çéshtje cause
shpállje proclamation
helenizój Hellenize
qe ngadítë më e mádhe grew bigger daily
orvátem attempt
stërgjýshër (stërgjýsh) forefathers; ancestors
gjúha amtáre mother tongue
fjála vjen for example
udhëtím journey
përkráhje support
te among
kotësí futility

falënderój thank
bëmë deed; work
i shquar distinguished

LEXIMI I DYZETETRETE

Këngë Dashurie

Lirika erotike është një nga gjinitë më të pasura të folklorit tonë dhe që ka qenë mbledhur më shumë. Këngët e dashurisë, si dhe këngët e trimave, janë ato që dëgjohen më rëndom, në festa e kurdo që populli këndon. Ato përhapen shumë e shpejt dhe kështu teksti i tyre është mjaft i paqëndrueshëm. Për një këngë mund të gjejmë një tok variante, disaherë me ndryshime themelore.

Në veri këngëve erotike u thonë "këngë të buta". Ato përcillen me çifteli dhe këndohen solo. Kur janë valle, janë edhe këngë korale. Nëpër qytete ato përcillen me saze. Këngët e jugut janë zakonisht korale dhe hidhen valle. Autorët e këngëve janë njerëz që njihen si këngëtarë të zot. Që nga shekulli XVIII e këndej, bejtexhinjtë kanë luajtur një rol të madh në pasurimin e repertorit të këngëve erotike të qyteteve. Më vonë, që nga Rilindja, një rol kanë luajtur edhe poetë si Loni Logori etj.

Pasuria e madhe e mjeteve artistike, koloriti dhe ngrohtësia e këngëve të dashurisë, tregon ndjenjat e thella e shijën shumë të hollë të popullit. Populli i këndon bukurisë së vajzës, virtuteve të saj, mallit që ka për të, vuajtjes së tij shpirtërore kur has pengesa dashuria nga prindërit, opinioni publik etj. Një vend të rëndësishëm zë në këngët përpjekja për një dashuri të lirë, protesta ndaj pengesave që u dalin fejesave dhe martesave kundër dëshirës së të rinjve. Elementet sensuale nuk mungojnë në këngët.

E pasur veçanërisht është lirika erotike e fshatit. Mjetet e saj artistike ajo i merr nga natyra e hapët dhe bukuritë e saj, nga jeta e blegtorëve dhe e bujqve. Lulja, thana, shega, ulliri, qershia, çetina, dielli, hëna, ylli, sorkadhja, thëllëza, dallëndyshja etj,--ja fjalori që shtihet në punë për të krahasuar vajzën.

Midis këngëve më të bukura janë ato të jetës baritore. Dashuria në stanet, nëpër kullotat verore, ka frymëzuar me qindra këngë.

Çobani që ka lënë miken në fshat, është gati të lërë dhitë ose dhentë e të vejë të shohë të dashurën, se ka marrë vesh se është e sëmurë.

Të bukura janë këngët që paraqitin vashën kur kalon nëpër fshat dhe u merr mendjen të rinjve.

Këngët na e paraqitin miken "në penxheret", "duke qëndisur", tek mbush ujë "te pusi", kur "del në lamë", duke korrë "nd'arë" apo duke shkuar "në mal për dru", "n'at rudinë" etj.

Këngët qytetare njihen jo vetëm se janë shpesh strofike, vepra bejtexhinjsh, po edhe me krahasimet e tyre dhe elemente të tjera, si bie fjala kostumet e xhybet e mëndafshta e të ngarkuara me ar, "mantotë" e "llustrinat", që kanë hyrë së voni jo vetëm në jetë, po edhe në këngët, pa harruar edhe një notë, disa herë të tepruar, sentimentaliste, të cilën e hasim më pak në këngët e fshatarësisë.

Këngët e qyteteve flasin gjithashtu për pengesat që hasin dashnorët, ato u qajnë veçanërisht hallin të dashurve se nuk mund të shohin njëritjetrin, duke qenë vajzat të mbyllura.

Këngët erotike shquhen shpesh herë për forcën e madhe të ndjenjave, që

shprehet në vargje të pakrahasueshme.

Elegji nga më të prekëshmet janë krijuar kur njëri nga të dashurit ka vdekur. Shumë e njohur është në jug kënga e dashnorit që kërkon "jongarin" dhe i bie e qan miken, së cilës do të vejë e "t'i zbulojë varrin", të shohë "se ç'nur i ka rënë, nur i kuq a nur i bardhë". E dashura e dëgjon vajin e tij, po "është thellë" e nuk ka si del. E rrallë për bukuri është edhe kjo këngë, ku vajza kërkon të dashurin, i cili është zhdukur ose ka vdekur:

Do të dal, moj nënë,
do të dal nga malet,
t'i thërres bandillit,
vallë mos më ngjallet.
Do të dal, moj nënë,
do të dal nga brigjet,
t'i thërras bandillit,
vallë mos përgjigjet.
Do të dal, moj nënë,
do të dal nga vreshtat,
t'i kërkoj bandillit,
mos i gjinden eshtrat.

Në kundërshtim me pesimizmin e këngëve të kafeneve dhe të ahengjeve, në të cilat "miku" lidh duart përpara fatkeqësisë ku e lë "mikja", kënga popullore për dashurinë është zakonisht gjithë vrull e pasion që kërkon të triumfojë. Në kundërshtim me konceptin moral të dashurisë feudale e borgjeze, që të çon në konkubinazh, kënga popullore mbi dashurinë është e pastër. Në kundërshtim me dashurinë e blerë me para, që i çel udhën korruptimit, erotika popullore është e dlirë dhe e sinqertë. I riu dhe e reja duhen pa djallëzi, me gjithë zemër.

Vasha dhe Hëna

1. Hën' e plot' e bukur hënë,
Fort të lutem ti vrapo,
Për një lule q'i kam dhënë
Thojmi trimit në më do.

Refren: O moj vashë lozonjare
Gjumi ty s'të paska zënë,
Mos u bëj ti merak fare
Ke një trim që nuk ka shok.

2. Mbylli synë hëna plakë,
Shko ti moj dhe bjerë fli,
Edhe vasha qeshi pakë,
Kam një trim që s'ka njeri.

Refren...

3. Gjum' i ëmbël i uruar,
Oh! Sa ëndrra na dërgon,
Vash' e trim janë martuar,
Trashëguar përgjithmon'.

Refren...

Vashës Sime

1. Ti dallëndyshe që shkon fluturim
Kur të kalojsh, atje mbi fshatin tim,
Mbi fshatin tim ku bilbilat ligjërojnë
Dhe njerzit s'bashku të gëzuar punojnë...

Refren: Atje kërko një vashë,
Kërko at' vashën që zemrën ia dhashë.
Vashës m'i thuaj ti
Se trim' i saj po bën roje n'kufi.

2. Ti dallëndyshe që shkon fluturim
Kur të kalojsh atje mbi fshatin tim,
Thuaja një kënge me afsh pranveror
Këngës më t'bukur për njerzit puntor.

Refren...

3. Thuaja me këngën që di ti më mirë
Le të punojnë të qet e të lirë,
Le të punojnë dhe le të gëzojnë
Roje besnike n'kufi ne qëndrojmë.

Refren: Atje kërko një vashë,
Kërko at' vashën që zemrën ia dhashë.
Thuaj le t' punojnë
Roje besnike n' kufi ne qëndrojmë.

Vetëm Unë Për Ty

1. Sa her' që m'kalove
Nga shtëpia ime,
Sa her' qe m'takove
More zemrën time.

Refren: M'i fal syt' e ballit,
Ata syt' e zi.
Moj fellanz' e malit
Vetëm un' për ty.

2. Në takim'n e fundit
Dy tri fjal' m'i the:
Do shkoj t'i ngrej trenit
Shinat mbi trase.

Refren...

3. Udh' e mbarë për mua
Udh' mbarë për ty.
Ti me kazëm n'duar,
Unë mbroj kufinë.

Refren...

4. Emrin tënd e pashë
Mbi gazetë shkruar,
Kishe dal' sulmuese,
Moj të lumshin duart.

Refren...

5. Sa fort që të dua
Që prej asaj dite,
Vetëm ti për mua
Pritëm sa më prite.

Refren...

Mrika e Vogël

1. Se ç'na erdh pranvera,
Çil moj lule mollë.
Kjo Mrika e vogël-o
Qenka fort e hollë.

2. Se ç'na erdh pranvera,
Çil moj lule dardhë.
Kjo Mrika e vogël-o
Qenka fort e bardhë.

3. Se ç'na erdh pranvera,
Çil moj lule pjeshkë,
Kjo Mrika e vogël-o
Sy e vetulla kaleshë.

Kur Del o Moj Marina

Kur del, o moj Marina,
Marina nga kisha, moj
Mendjen ç'e prisha.
M'e bardhë e moj gusha,
Gusha se këmisha, moj
Mendjen ç'e prisha.

Ç'të ra moj fustani
Dy gisht përmbi dhe,
Mblidhe mendjen ku m'a ke.
Në daç, o moj martohu,
Në daç rri e ve, o moj,
Sa e vogla je.

N' daç çap në kishë
Bëju kallogre, e moj,
Sa e vogla je.

"Këngë dashurie," Dh. Shuteriqi et al. (Eds.), Historia e letërsisë shqipe I (Tiranë), 1959, pp. 128-132; "Vasha dhe hëna," "Vashës sime," "Vetëm unë për ty," "Mrika e vogël," "Kur del o moj Marina," Këngë dhe valle (Tiranë), 1957, pp. 79, 87, 98, 104, and 118.

gjiní genre
rëndóm often
kurdó whenever
féstë festival
i paqëndrúeshëm unstable
tok together
një tok variánte a number of variants
përcjéll accompany; send off
çiftelí two-stringed instrument
sáze folk music orchestra
këngëtár singer
bejtexhí folk poet
kolorít color
ngrohtësí warmth
i hóllë refined; thin
mall desire; longing
blegtór herder
bújqër farmers
thánë dogwood
shégë pomegranate
qershí cherry tree
çetínë pine; fir
sorkádhe deer; antelope
thëllëzë pheasant
baritór pastoral
stan shepherd's camp; habitation
míke girl friend; beloved female
dhi goat
penxhére window
qëndis embroider
pus well
lámë = lëmë yard
dúke kórrë (=kórrur) reaping
nd'árë = në árë in the field
rudínë plateau; upland pasture
strofíke in stanxa form
krahasím comparison
xhybé jacket
i mëndáfshtë silken
i ngarkúar overlaid; loaded
mantó coat
llustrínë patent leather garment
së vóni lately
i teprúar excessive
has encounter
fshatarësí countryside
dashnór lover
qaj lament; cry
i mbýllur shut in; closed up

i pakrahasúeshëm incomparable
elegjí elegy
i prékshëm moving; touching
jongár three-stringed lyre
nur look
vaj lament
bandíll lover; gallant man
éshtër bone
kundërshtím contrast
kafené coffee house
ahéng casual nightclub with live music
míku lidh dúart përpára fatkeqësísë
ku e lë míkja the male lover resigns himself to the misfortune of being abandoned by his loved one
vrull drive; momentum
i blérë purchased
i dlírë chaste
i sinqértë sincere
djallëzí devilishness; wickedness

---

thójmi = thúaji tell
lozonjár playful one
bjérë (=bjer) fli go to sleep
pákë = pak little

i urúar blessed
dërgój send
trashëgúar blessed with offspring
përgjithmónë forever after

---

fluturím flying
ligjërój warble
kufí frontier
thúaj say
afsh warmth, glow of passion

---

fellánzë = thëllézë pheasant

tren train
shínë railroad tie
trasé railroad bed
sulmúes distinguished worker
të lúmshin dúart good work; bravo
prítëm (=prítmë) sa më príte wait for me

çil (çel) open up; bring forth
móllë apple tree
dárdhë pear tree
pjéshkë peach tree
kalésh dark

gúshë throat
fustán dress
daç = në do if you want
çap go
kallogré nun

LEXIMI I DYZETEKATERT

Marin Barleti

Jetën e këtij historiani të parë të popullit tonë e njohim pak. Kemi vetëm disa të dhëna që i nxjerrim nga ç'na thotë ai vetë në librat e tij. Jetoi në gjysmën e dytë të shekullit XV dhe në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XVI. Ka lindur aty nga viti 1450 në Shkodër. Shkodra asohere ishte zotërim i venedikasve, të cilët e kishin shtënë në dorë që më 1396. Gjatë rrethimit të dytë të këtij qyteti nga ushtritë turke (1478), Barleti mori pjesë aktive në mbrojtjen heroike të tij. Dhe kur ua dorëzuan venedikasit Shkodrën turqve, ai u mërgua bashkë me të tjerët. Jetoi në Venedik e në Romë. Këtu, Marini pat rast të vijë në kontakt nga afër me lëvizjen e madhe të Rilindjes evropiane, që u zhvillua më parë se kudo në Itali, dhe iu dha mundësia të plotësojë e të përkryejë njohuritë, duke u pajisur me një kulturë humaniste të gjerë.

Kujtimi e dashuria e atdheut mbetën të gjallë tek ai. Krenar për të kaluarën e afërt të popullit të vet, plot pikëllim për gjendjen e mjeruar të Shqipërisë, Barleti i vu si detyrë vetes të përshkruajë e të tregojë atë të kaluar të lavdishme, për t'ia bërë të njohur gjithë botës e për të përjetësuar trimëritë e bashkëqytetarëve dhe të bashkatdhetarëve të tij, luftën e tyre për të mbrojtur lirinë nga sulmet e sulltanëve turq, dhe udhëheqësin zëmadh të kësaj lufte, Skënderbeun. Më 1504, ai boton në Venedik veprën mbi rrethimin e Shkodrës, dhe midis viteve 1508-1510 "Historinë e Skënderbeut".

Historia e Skënderbeut

Vepra kryesore e Barletit, që e bëri të njohur emrin e tij në gjithë Evropën shekuj me radhë, qe "Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum Principis" (Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut, Princit të Epirotëve). Librin e shkroi nga patriotizmi e malli për të kaluarën plot lavdi të popullit shqiptar, i magjepsur nga personaliteti i pushtetshëm i udhëheqësit të luftës për liri të bashkëkombasve të tij, nga personaliteti i Gjergj Kastriotit.

Në parathënie, autori thotë me modesti, se e përmbajti për shumë vjet dëshirën e zjarrtë që kishte për të shkruar biografinë e heroit të dashur të tij, me shpresë se do të dilte ta shkruante ndonjë më kompetent. Për Barletin, Skënderbeu është si një perëndi e lirisë, se simbolizon ditët e pavarësisë e të lavdisë së athdeut, ditë këto që fillojnë me kthimin e tij në Shqipëri dhe perëndojnë me vdekjen e tij. Bëmat që kishte kryer ky hero, e nxitnin Barletin të orvatet t'i ngrejë një "monument letrar", një epope në prozë, që t'ia përjetësonte emrin, bashkë me atë të shokëve të tij të luftës. Barleti ndjente kënaqësi të madhe kur shikonte se edhe koha e brezi i tij ishin të zot për vepra trimërie aq të mëdha sa ato të kohës së lashtë klasike, për të cilën kishte admirim të madh. Ai s'mund të gjente një subjekt më të përshtatshëm se ky që zgjodhi, për të treguar entuziazmin e tij prej humanisti për madhërinë e njeriut.

"Historia e Skënderbeut" është një vepër me vëllim të madh, prej 13

kapitujsh e librash. Fillon me kohën kur Skënderbeu ndodhej si peng në oborrin e Sulltanit dhe mbaron me vdekjen e tij në Lezh. Vepra u shkrua në bazë të pak kujtimeve personale, po sidomos të burimeve gojore (tregime pjesëmarrësish në këto luftëra, gojëdhëna popullore), si edhe të një togje burimesh të shkruara, kronikanësh të ndryshëm mesjetarë.

Si bashkëkohësit e tij humanistë, Barleti veprës historike i jep edhe karakter letrar. Ai nuk ndjek kronikanët mesjetarë, që mjaftohen zakonisht me tregimin e thjeshtë e të thatë të ngjarjeve, po ecën në gjurmat e historianëve grekë e latinë dhe përpiqet të krijojë një vepër artistike, që të kënaqë e të emocionojë lexuesin, me anë të një kallzimi të gjallë e interesant, të veshur me një stil të bukur. Humanistët e Rilindjes i jepnin rëndësi të madhe formës, shprehjes. Mendohej se vetëm gojëtaria e stili mund t'i sigurojnë sukses dhe jetë të gjatë një vepre historike e mund ta përjetësojnë heroin ose ngjarjet e trajtuara në të.

"Historia e Skënderbeut" është një vepër që mundi të përhapet e të njihet shumë, në sajë të cilësive letrare me të cilat ishte e pajisur. Ajo u ribotua latinisht tri herë, u përkthye gjermanisht (7 botime), italisht (4 botime), polonisht, portugalisht, u përshtat në shumicën e gjuhëve të Evropës dhe u bë burim i një letërsie të tërë.

Çështja që mbron Skënderbeu dhe populli shqiptar, për Barletin është e drejtë. Skënderbeu, po në Kuvendin e Lezhës, u thotë princërve: "Princa, sa të mundni, ruani e mbroni, për nderin tuaj të madh, atdheun, gratë, fëmijët e gjërat tuaja...Nuk flasim me ata që mohojnë luftërat e drejta". Për Barletin, mbretëria turke, me gjithë fitoret e saj, nuk ka jetë të gjatë, sepse mbështetet në dhunën, krimin, poshtërsinë. Skënderbeu e shqiptarët fitojnë kundër ushtrive të panumurta të sulltanëve, se dinë përse luftojnë, se mbrojnë një çështje të drejtë. Nga kjo, humanisti ka një dashuri edhe më të madhe për heorin e tij, e vështron me entuziazëm e adhurim, e ngre aq lart figurën e tij. Në çdo frazë, diktohet tendenca për të madhëruar heroin që kishte luftuar gjithë jetën për çlirimin e atdheut dhe mbrojtjen e lirisë së fituar.

Tradhtitë e Moisiut e të Hamzës i dënon rëndë, me fjalët më të ashpra.

Barleti hap paranteza të shpeshta në tregim dhe shtjellon mendime filozofike e morale. Po këto, të shumtën e herës, janë të frumëzuara nga leximet e autorëve klasikë e bashkëkohës, ndonjëherë janë retorikë e thjeshtë dhe s'mund të merren gjithnjë si shprehje e bindjeve personale të autorit e të na ndriçojnë për botëkuptimin e tij real. Shpesh është vështirë të dallosh nëse ke të bësh me një ide, karakterizim a gjykim që shpreh mendimin e plotë e të vërtetë të Barletit, apo me ndonjë imitim stilistiko-letrar.

Vlera Historike e Letrare e Veprave te Barletit

E pamë se Barleti kërkon të krijojë një vepër që të lexohet me përfitim e ëndje. Ai i jep rëndësi të madhe formës, po jo se nuk e përfill edhe brendinë. Barleti është i vetëdijshëm i detyrës që ka historiani për të kërkuar e zbuluar të vërtetën, për të qenë objektiv. Në parathënien e "Historisë së Skënderbeut", autori u del përpara vërejtjeve të mundëshme të skeptikëve që nuk do të duan të besojnë trimëritë e Skënderbeut, dhe orvatet të arsyetojë. Bën dallimin ndërmjet burimeve, duke u dhënë më shumë besim

informatave të dëshmitarëve që i kanë parë vetë ngjarjet dhe kanë marrë pjesë në to, se sa të dhënave të gojës së popullit. Kur ka informata të ndryshme në kundërshtim njëra me tjetrën, orvatet t'i shoshitë, të ndajë ç'është e vërtetë nga ç'nuk është e këtillë. Nuk mjaftohet me tregimin e thjeshtë të fakteve dhe ngjarjeve, po shpesh shfaq edhe mendimet e gjykimet e tij mbi to. Disaherë bën rezerva mbi vërtetësinë e të dhënave që ka e që referon. Ndonjëherë e quan veten të detyruar të japë shpjegime rreth fakteve që tregon dhe kërkon të gjejë arsyet e ngjarjeve (p.sh. me rastin e tradhtisë së Hamzës).

Barleti provon se nuk i mungoi gjykimi kritik. Po admirimi që ka për Skënderbeun, burimi gojëdhënor që i shërben si mbështetje, sidomos retorizmi, e bëjnë që t'i zmadhojë ngjarjet, të gabojë, herë-herë t'i shmanget vërtetësisë historike, të mos jetë kosekuent në saktësinë e paraqitjes. Kjo shkaktoi që, në shekullin e kaluar, nisën ta nënçmojnë dhe t'ia mohojnë vlerën historike veprës së humanistit tonë. Po shumë prej të dhënave të tij u vërtetuan nga burimet arkivale.

Po në qoftë se Barleti s'u përgjigjet plotësisht kërkesave të kohëve të reja ndaj shkencës historike, veprat e tij kanë merita të mëdha letrare. Thamë se "Historinë e Skënderbeut" mund ta quash si një epope në prozë për entuziazmin, frymën epike që e përshkon, madhështinë me të cilën paraqitet aty figura e Skënderbeut, përpjesëtimet që u jepen ngjarjeve. Autori s'është tregues i qetë; në kallëzim e sipër, ai s'i fsheh ndjenjat e veta; ai kërkon, me anë të mjeteve të ndryshme letrare, të vërë në dukje heroizmin e bashkatdhetarëve, të ngrejë lart heroin e tij, që të shërbejnë ata si shembull për të tjerët.

Figura e Skënderbeut na paraqitet në gjithë madhështinë e një heroi legjendar, si çlirimtar e mbrojtës i lirisë, simbol i luftës për liri të popullit shqiptar. Ai vihet në krye të shqiptarëve për të fituar lirinë e grabitur nga turqit, arrin t'i bashkojë e t'i mbajë të bashkuar për njëzet e pesë vjet, udhëheq me lavdi qëndresën e tyre heroike kundër mizerive turke. Fitimtar kundër dy sulltanëve nga më të mëdhenjtë e Turqisë, që i kishin kallur tmerrin Evropës, përpara politikës së pabesë të Venedikut, ai s'trembet të hyjë në luftë edhe me këtë.

Me një shtat prej atleti, Skënderbeu fiton admirimin e të tjerëve që kur është si peng në oborrin e Sulltanit. "Kishte trup të gjatë e të drejtë, krahë që s'u panë më të bukur në ndonjë mashkull, qafën të shëndoshë e të fortë, ashtu si çmohet ndër ata që munden me krahë. Shpatullat të një gjerësie të mrekullueshme, fytyrën të bardhë si të mbuluar me një cipë purpuri, pamjen e syve jo të egër, jo boshe, po shumë të këndëshme". Është për të vënë re që Barleti, si njeri i Rilindjes, nuk është i pandieshëm ndaj bukurisë fizike. Ai ka kujdes ta vërë në dukje jo vetëm në portretin që i bën Skënderbeut, po edhe në ata të Gjon Kastriotit, Muzakë Topisë etj.

Skënderbeun Barleti e paraqit me një trimëri e guxim të jashtëzakonshëm, me forcë trupore e shpirtërore të pakalueshme, të papërkulur, plot urrejtje për armikun, të tmerrshëm në luftë: "Si një përrua që, për shkak të shirave të mëdha, zbret nga mali, rrëmben çdo gjë që gjen përpara, e rrëzon, e përmbys, ashtu edhe Skënderbeu, duke shpërthyer në kampin e armiqve, herë nga një anë, herë nga një tjetër, s'i linte të qetë dhe bënte në ta kërdinë e u sillte dëme të mëdha". Po heroi është shpirtmadh, zemërgjerë e i butë pas betejës, i urtë e i mençur, popullor, modest e hokatar.

Skënderbeu paraqitet si udhëheqës i dashur e popullor, që ka kujdes të madh për jetën e ushtarëve, i këshillon që të kursejnë veten e të mos ekspozohen pa nevojë, të mendojnë se jeta e liria e fëmijëve dhe grave është në dorën e tyre. Ai i njeh të gjithë, ia di emrin secilit. Skënderbeu lufton gjithë jetën për bashkimin e shqiptarëve, për mbrojtjen e tyre e të atdheut nga agresionet e robëria turke. Në shtratin e vdekjes, si porosi të fundit u lë shokëve, të kenë mendjen e t'i shmangen përçarjes: "Besomëni se s'ka asnjë shtet, sado i fuqishëm e i fortë, që të mos bjerë poshtë, kur ka në gji mërira e përçarje dhe kur vihen përmbi të mirën e përgjithshme dobia dhe interesi vetiak. Po, në se do të jeni vërtet të bashkuar e të një mendje, s'ka si t'ju dëmtojë armiku dhe sulmi i tij. Shteti e mbretëria juaj do të rrojnë e do të qëndrojnë përgjithnjë...Plaçkat që i zinim armikut, prenë që bënim tek Barbarët, ua ndaja juve dhe s'mbaja kurrgjë për vete. Mbretërinë, pushtetin, mallin, të gjitha të mirat i kisha të përbashkëta me ju, s'kisha asgjë të ndarë." Karakteri popullor i tij, ndjenjat njerëzore që e frymëzojnë, shihen, edhe në fjalët e fundit që i drejton të birit të vogël: "Kur të mbretërosh, duaje e nderoje drejtësinë, që është sheshit virtuti më i madh ndër gjithë virtutet; s'do të bësh dallim në mes njerëzve, midis të varfërit, të pasurit e të fuqishmit; gjyko njëlloj si të voglin si të madhin... Do të forcosh mbretërinë tënde me miqësitë... Miqtë besnikë fitohen me mirësi... Ashtu si kjo toka jonë dëshiron diellin që shohim, ashtu edhe jeta njerëzore ka nevojë të madhe për miqësinë... Mos i trajto ushtarët si shërbëtorë, po si miq e shokë... Rri larg ashpërsisë së tepruar e mizorisë, që janë vërtet të bishave."

Skënderbeu është luftëtar i një kauze të drejtë, armik i skllavërisë e i padrejtësisë, plot dashuri për popullin. Kur sulltan Mehmeti i propozon paqe, me kusht që t'i paguajë haraç, ai i përgjigjet, se ishte kthyer në Shqipëri për ta çliruar vendin nga barra e rëndë e pagesave dhe nga skllavërimi. Në rrethimin e Beratit u thotë ndër të tjera ushtarëve: "Ne s'lakmojmë gjënë e tjetrit, ne s'kërkojmë për vete ndonjë famë tjeter, ne se fitojmë, po vetëm të na kthehen zotërimet tona të vjetra, të lahet turpi i fundit jo vetëm yni po i gjithë fisit epirot. (Banorët e Beratit - Red.) do të vrapojnë menjëherë, posa të dëgjojnë emrin e lirisë". Sa e sa herë ai thotë se kauza e tij është e drejtë, se ai bën një luftë të drejtë, se ai lufton për t'i siguruar lirinë e lumturinë bashkatëhetarëve të vet.

Si shkrimtar e si historian, Barleti ka tiparet e Rilindjes evropiane. Ai është figura më e shquar, me të cilën populli ynë merr pjesë në rrymën e madhe të humanizmit të shekujve XV-XVI. Ka një kulturë të shëndoshë klasike, njeh mirë historinë e letërsisë latine. Mendimet e tij karakterizohen nga mbizotërimi i ideve përparimtare: ndjenja e zjarrtë patriotike, dashuria e madhe e lirisë, optimizmi e besimi në fuqitë e njeriut. Letrar me talent e kallëzimtar i mirë, ai na la vepra që përshkruan me ngjyrat më të gjalla dhe e përjetësuan një periudhë të lavdishme të historisë sonë. Emri i tij është i lidhur në mënyrë të pashkëputur me emrin e Skënderbeut. Barleti e bëri të njohur për shekuj në publikun e mësuar të Evropës heroin tonë kombëtar. Portreti që dha për të, bëri përshtypje të thellë në mendjet e njerëzve. Ky u gjykua si tepër teatral e u kritikua, po në pikat themelore u vërtetua më vonë edhe nga burimet e tjera. Pa pendën e talentuar të humanistit tonë, emri i Skënderbeut, jashtë kufijve të Shqipërisë, s'do të kishte gëzuar famën që gëzoi. Parafytyrimi koherent e i gjallë që dha

Barleti, e bëri figurën e Skënderbeut popullorë në gjithë vendet e Evropës. Në bazë të veprës së tij, lindi një letërsi e tërë historiografike dhe artistike.

"Marin Barleti," Dh. Shuteriqi et al. (Eds.), Historia e letërsisë shqipe (Tiranë), 1959, pp. 165, 167-169, 171-174, 177.

dhjetëvjétësh decade
asohére at that time
zotërím dominion
shtënë (shtíe) put
mërgóhem migrate
përkrýej finish
njohurí discipline; field of knowledge
pajís equip; furnish; endow
zëmádh great spokesman
i magjépsur enchanted
i pushtétshëm powerful
bashkëkómbas fellow countryman
parathënie foreword
orvátem attempt
epopé epic
përjetësój immortalize
i përshtátshëm suitable; relevant
madhërí greatness

vëllím volume
peng hostage
gojór oral
gojëdhënë lore
tog collection
kronikán chronicler
stil style
gojëtarí eloquence
ribotój reprint
kuvénd convention
mohój deny
dhúnë violence
poshtërsí baseness
adhurím adoration
diktój detect
madhëró j exalt
i áshpër rough; tough
parantézë parenthesis; digression
bíndje conviction
dallój differentiate
gjykím judgement
përfitím profit
ëndje pleasure
brendí content
i vetëdíjshëm self-conscious
u del përpára confronts
vërejtje remark
arsyetój reason

dëshmitár witness
shoshít sift
i këtíllë of this sort
rezérvë reservation
tradhtí betrayal
gojëdhënór folklorish
zmadhój exaggerate; enlarge
konsekuént consistent
nënçmój belittle; undervalue
arkivál archival
tregúes storyteller
kallëzím tale; story
i grabítur grabbed
mizerí horde; countless number
fitimtár victor
kall instill; insert
atlét athlete
máshkull male
çmoj admire
mund defeat; overcome; be able
gjerësí breadth
púrpur scarlet
bosh empty
i këndshëm pleasant; congenial
i papërkúlur unbending
shíra (shi) rains
rrëmbéj seize
dúke shpërthýer (shpërthéj) exploding; erupting
i qétë calm; tranquil; peaceful
kërdí carnage
dëm harm; injury
shpirtmádh magnanimous
zemërgjérë big-hearted
i ménçur wise
hokatár jovial

kësheillój advise; counsel
kurséj save; take care of
secíli each one
i shmángem avoid; evade
përçárje splitting; disunity
mërí grudge
dobí profit, advantage
vetiák personal
dëmtój damage
pláçka booty
pre prey
kurrgjë anything; nothing
i përbáshkët in common
shéshit plainly
virtút virtue
gjykój judge
njëlló j the same way
ashpërsí severity
mizorí misery
bíshë beast
padrejtësí injustice
haráç tribute
bárrë load
pagésë tax; payment
lakmój covet
epirót of Epirus
Red. = redaksía editorial staff
sa e sa hérë time and again
rrýmë current
i shëndóshë solid
mbizotërím mastery
letrár literary man
kallëzimtár story-teller
i pashkëpútur inseparable
përshtýpje impression
parafytyrím vision

LEXIMI I DYZETEPESTE

Gjergj Elez Alia

Trim mbi trima kish qenë gjithmonë Gjergj Elez Alia...

Vjete e vjete ai i kish dalë zot truallit të të parëve; ia kish mbrojtur nderin. Kish luftuar me topuz e shpatë kundër armiqve të derdhur këtej nga deti e nga toka për të shkelur vendin, për ta dhunuar e zhveshur. Dhe të gjithë këta armiq Gjergj Elez Alia i kish shtrirë përtokë, pa frymë.

Por në luftërat e shumta me dhunonjës të shumtë trimi ynë kish marrë nëntë plagë në shtat dhe tani kish nëntë vjet që dergjej në kullë. E motra i rrinte ditë e natë mbi krye, i lante plagët me ujët e gurrës nëntë vjeçe, ia shpëlante me lotët e syve të saj, i terte gjakun me flokët e ballit; shtatin ia lidhte me shamitë e nënës, ia hijeshonte me petkat e moçme të tatës; armët e brezit ia rendiste mbi krye, sepse, kur i shihte armët pranë, bacë Gjergji e ndiente zemrën ende të ngrohtë, i ngjallej një fill shprese.

Ai i duronte si burrë dhembjet e plagëve kur i ndërronte e motra shtatin. Vetëm një dhembje nuk e duronte dot Gjergji: dhembjen për motrën e dashur të varrosur së gjalli pranë tij, në kullën e lartë që t'ia mjekonte plagët, të përkujdesej për të. Kjo dhembje e shtrinte Gjergjin si të vdekur, pa frymë. E motra e Gjergjit s'kish pasur kurrë çaste gëzimi. Ndërsa shoqet e saj gëzonin të ritë e tyre, kishin dashuruar, ishin martuar, kishin lindur fëmijë, ajo rrinte gjithnjë mbyllur në kullë pranë Gjergjit të sëmurë.

Kështu kaluan të nëntë vjetet.

Vitin e nëntë u hap e mori dhenë fjala gjëmëmadhe se kish dalë nga deti një baloz i zi, trim i fortë e i prapë, më i lig nga gjithë balozët e tjerë që kishin shkelur gjer atëhere truallin tonë. Ky baloz i prapë i kish hedhur vendit një rreng të rëndë; çdo derë t'i jepte një dash të pjekur, çdo vatër t'i dërgonte një vashë të njomë. Balozi vriste ditë për ditë, digjte javë për javë një krahinë. Kish vrarë kaq kreshnikë, sa tani askush s'kish zemër t'i dilte përpara e t'i priste hovin, sepse topuzi i tij ishte shumë i rëndë, shpata e tij ishte shumë e mprehtë dhe heshta e tij e përshkonte tejpërtej shtatin e kreshnikut. Kështu, tërë vendi lëngonte nën thundrën e tij.

Gjergj Elez Alia s'dinte gjë: ai dergjej në shtrat si i vdekur i pakallur në varr.

Kur i ardhi radha shtëpisë së Gjergjit që t'i jepte balozit haraçin: dashin e pjekur dhe motrën, kjo, motra, qau me lot, u ankua dhe nëmi:

--O vëlla, po qysh na harroi neve mortja e s'na mori? Nëna e tata kalben të vdekur nën blir. Shtati i vëllait kalbet së gjalli brenda në shtëpi. Shtati i motrës do të bjerë në duart e balozit të zi... Pse vallë s'shembet kjo kullë të na zërë brenda të vdekur? Pse s'bëhet gërmadhë kjo shtëpia jonë? Vdekja është më e ëmbël, moj e zeza nënë, se sa jeta pa nder!

Atëhere Gjergji u zgjua, shikoi përreth e s'dinte ç'kishte ndodhur. Kish ndier se i qe lagur fytyra dhe kish pandehur se kulla qe rrënuar kaq shumë, sa i shtinte shiun brenda. Zemra ju bë dy copë, shikoi motrën: dy vija lotësh ia përshkuan faqet e tretura. Dhe nga pikëllimi mallkoi

kullën:

--Hej, u nxifsh, moj kulla ime! Të mbuloftë fund e krye lëmashku! Paç banorë brevën e gjarpërin! Si më lëshove ti kaq shpejt pikat e shiut brenda në shtrat?

Motra ia fshiu me dorë të dredhur lotët e i tha:

--Jo, more vëlla, nuk bie shi jashtë e nuk pikon çatia e kullës. Ty të kanë lodhur fort plagët e shtatit dhe shkretia, prandaj s'di se ç'flet: sytë e mi pikojnë lot, vëlla!

Atëhere Gjergji i shtrëngoi dorën me atë pëllëmbën e thatë, i lëmoi ëmbël fytyrën, e shikoi me ata sytë e mallit dhe i foli me zjarr, si nuk kish folur kurrë:

--Pse qan, moj motër? Pse ma thyen kaq fort zemrën? Shtati im ka nëntë vjet që po kalbet së gjalli. Në këta nëntë vjet Gjergji yt s'ka pasur kurrë pushim e ka fërfëlluar gjithnjë si ai gjethi i ahut në faqe të shullërit. Vallë a s'ke pasur të hash e të pish në këta nëntë vjet? A s'të ka mbajtur ty vëllai me të veshur e të mbathur? A të ka rënduar ndonjëherë me fjalë? Apo t'u mërzit vëllai e të ka lindur dëshira të martohesh e ta braktisësh?

Atëhere motra i mori dorën, ia shpuri në ballin e saj e ju përgjegj bukur:

--Oh, vëlla! Kaq fort të paska mërzitur ty vuajtja që më flet kështu? Hyfsha gjallë në dhe, në më shkon mendja të martohem! Të ngrënë e të pirë kam pasur mjaft, vëlla. Edhe të veshur e të mbathur kam pasur mjaft. Kurrë s'më ke rënduar në fjalë si sot. Unë ty të kam tatë, ty të kam vëlla. Po sot, bacë Gjergj, dua të të qaj një brengë të madhe. Si nuk t'u përkëmb vallë shtati në këta nëntë vjet që të dalësh gjer te praku i derës? Si nuk u tha motra jote--e thaftë vera! Po qysh të duroj unë e zeza turpin që t'i shkoj balozit në derë?

Kur dëgjoi këto fjalë, bacë Gjergji i harroi të nëntë plagët e shtatit, i harroi të nëntë dhembjet dhe brofi drejt më këmbë sikur të mos paskej lënguar kurrë në shtrat: i hollë, i gjatë, asntu siç kish qenë dikur: trim mbi trim. I tha së motrës:

--O motër, merr që tani gjogun e luftës e zbrit shpejt në qytet drejt tek nallban vëllami. I thuaj: "Të dërgon falmeshëndet Gjergji, t'ia mbathësh mirë gjogun me potkonj hekuri të farkuar e thumba trunxhi, se do t'i dalë balozit në shesh të burrave". Po s'desh të ma mbathë gjogun vëllathi, hipi sërish e shko në derë të nallban dashamirit.

Vajza i hipi gjogut, e ngau shpejt, zbriti në qytet, shkoi drejt te nallban vëllami.

--Puna mbarë, o nallban vëllami!

--Mbarë paç, moj vashë e largët!

--O vëllam, të dërgon falmeshëndet bacë Gjergji, t'ia mbathësh mirë gjogun me potkonj hekuri të farkuar e thumba trunxhi, se do t'i dalë balozit në shesh të burrave.

Mirëpo në këta nëntë vjet, që kur Gjergji ish varrosur së gjalli brenda në kullë, nallban vëllami e kish harruar fare vëllazërinë e vjetër. Ai nisi t'i flasë së prapthi motrës së bacë Gjergjit.

--Po të m'i falësh,--tha --moj vashë, ata sytë e ballit, unë do të ta shpëtoj Gjergjin tënd: do t'ia mbath mirë gjogun e do t'ia bëj të fluturojë si era.

Motra e Gjergjit ia ktheu me zemërim:

--Ç'po thua ashtu, o nallban, t'u thaftë goja? Unë pandeha se pata ardhur në derë të vëllamit, po e shoh se paskam rënë në derë të magjypit. Këta dy sy unë ia kam falur njëherë e përgjithmonë nënës e tatës që kalben nën dhe, ia kam falur Gjergjit tim që kalbet me nëntë plagë mbi dhe!

Kaq i tha motra e Gjergjit nallban vëllamit që e kish harruar vëllazërinë dhe i ra kalit e shkoi te nallban dashamiri.

--O nallban dashamiri,-- i tha, --të dërgon falmeshëndet bacë Gjergji, t'ia mbathësh mirë gjogun me potkonj të farkuar e me thumba trunxhi, se do të dalë të luftojë me balozin e detit.

Nallban dashamiri s'ia bëri fjalën dy, po ia mbathi kalin mirë e bukur, si për vete.

--I thuaj,-- tha, falmeshëndet bacë Gjergjit e daltë faqebardhë në luftë.

--Rrofsh e qofsh, o nallban dashamiri!... --ia ktheu vasha.

Mbrëmanet vajza u kthye në shtëpi dhe e gjeti Gjergjin tek po priste në hije të blirit: i veshur e i mbathur, me armët pranë.

Ai kish mposhtur dhembjen e shtatit për të ruajtur nderin e shtëpisë së vet e të gjithë vendit, për hakmarrje.

Ç'bëri Gjergj Elez Alia? I dërgoi falmeshëndet balozit të detit e i tha:

--Unë s'kam vashë për ty, o baloz! Deshtë e vathës nuk i kam majmur për ty. Kam vetëm një motër në shtëpi, po nuk ta jap dot se s'ka kush m'i lidh plagët e shtatit. Pra, të pres të dalësh në dyluftim në shesh të burrave!

Kur zuri drita të zbardhë majat, ata të dy--Gjergji dhe balozi i detit--dolën kaluar në fushë të luftës dhe zunë ta thumbojnë shoqi-shoqin me fjalë. Balozi ish veshur me parzmore të rënda hekuri, kish vënë në kokë përkrenare çeliku, ish armatosur me topuz të rëndë e me shpatë të gjatë. Edhe kalin e kish ngarkuar me pllaka hekuri. Tundej dheu ku shkelte.

Sapo e pa Gjergjin fort të tretur, kaluar mbi gjog, balozi qeshi me të madhe e i thirri:

--Nga varri qenke ngritur, o Gjergj? Pse më ke nxjerrë kot, bre burrë, në fushë të luftës? A nuk di ti se mua më thonë baloz deti? Unë kam shembur nga kali shumë kreshnikë e i kam dërguar në botën tjetër. Ty do të të shemb me gishtin e vogël.

Gjergji ia ktheu bukur:

--Mirë po thua, o baloz, të lumtë goja! Vërtet unë kam nëntë vjet që kam marrë udhën e varrit, se kam nëntë plagë në shtat. Po pa arritur ende në varr, ti më ktheve prapë. Sepse ti më ke kërkuar motrën përpara se të kërkosh dyluftimin, ke kërkuar berrat përpara se të kërkosh barinë. Unë kam ardhur këtu të të tregoj se ç'na thotë kanuni i të parëve tanë: të mos lëshojmë gjënë përpara se të lëshojmë armët, të mos ia japim kurrë motrat balozit përpara se të pritemi me shpatë në shesh të luftës. Bëhu gati, baloz, se te ka ardhur dita e fundit! Ketu i thone Gjergj Elez Alia!

I lëshuan kuajt vrap në fushën e luftës tym me tym. Balozi i prapë mori në shenjë i pari dhe hodhi topuzin. Gjogu i Gjergjit përkuli të dy gjunjët dhe u ul. Topuzi i rëndë i balozit i fluturoi Gjergjit mbi krye dhe u ngul tutje dymbëdhjetë pashë thellë në lëndinë. Pluhuri u ngrit dymbëdhjetë pashë lart.

Kur i ardhi radha Gjergjit e hodhi bukur topuzin e vet dhe e qëlloi

balozin në shteg të ballit. Balozi u përkul e u gremis i vdekur. Kur u gremis, u tund tërë fusha. Kali mori arratinë. Gjergji nxori menjëherë shpatën e mprehtë dhe ia ndau kryet nga trungu. Kryet ia vari në mollë të shalës, trungun ia hoqi zvarrë për këmbë, nëpër fushë, përmes ferrash e drizash dhe ia hodhi në një krua. Gjaku i balozit të zi rrodhi nëpër përrua, nxiu gjithë lumin. Tre vjet rresht vendi rreth e qark kundërmoi erë kërme.

Si e vrau balozin e zi, trimi u kthye fitimtar në shtëpi, mblodhi gjithë shokët e u tha:

--Pa dëgjoni, o shokët e mi! Falë ju qofshin kullat e mia, falë ju qofshin gjithë paret e mia, falë ju qoftë gjithë malli e gjëja ime! Amanet motrën e Gjergj Elez Alisë!

Dhe trimi u hodh të përqafojë motërzezën, që e priste me gëzim. Të dyve zemrat u pushuan përnjëheresh. Vëlla e motër ranë përdhe të vdekur.

Vdekje më e lehtë dhe më e ëmbël s'ish parë kurrë!

Shokët i vajtuan me gjëmë të madhe. Hapën pastaj një varr të gjerë sa t'i nxerë të dy, vëlla e motër, të përqafuar. Varrin e rrethuan me një muranë të bukur që të mos harrohej kurrë sa shumë e kish dashur motra vëllanë dhe sa shumë e kish dashur vëllai motrën, që të mos harrohet trimi i madh Gjergj Elez Alia që mbrojti nderin e vet e të shtëpisë dhe që shpëtoi vendin nga dhunat e balozit të zi!

Mbi krye shokët u mbollën atyre të dyve një bli të bukur: atje pushon nëahera zogu i verës.

...Kur nisi të dushkohet mali, qyqja qëndroi mbi muranën e varrit të ri se e gjeti blirin të tharë; fluturoi mbi sarajet e zeza dhe e gjeti tërë kulmin të shembur përdhe; atëhere zuri vend në një dritare e i tha shtegtarit që shkonte udhës:

--Dëgjo, o shtegtar i malit! Në qofsh duke kënduar, kur të afrohesh kësaj ane, pushoje këngën tënde; në qofsh duke qarë, kur të afrohesh kësaj ane, shtoje edhe më shumë vajin e gjëmën. Unë kërkova bjeshkë me bjeshkë, verova verri me verri, mjerova shtepi pas shtepie, po kurrkund nuk pashë një trim si Gjergj Elez Alia!

Të gjitha shkuan e vanë: Gjergj Elez Alia vdiq, motra e dhimbshme vdiq, kulla e lartë u shemb. Edhe murana e varrit s'njihet më, as kulla e dikurshme. Po doli kënga që shkon si një yll drite nëpër shekuj për të kënduar trimërinë e vëllait dhe dashurinë e motrës, fisnikërinë e shpirtit të madh shqiptar.

Dhe kënga nuk vdes kurrë!

"Gjergj Elez Alia," M. Kuteli, Tregime të moçme shqiptare (Tiranë) (presumed date of publication 1960), pp. 37-45.

topúz mace
dhunój violate
zhvesh strip bare
shtrij lay out
përtókë on the ground
dhunónjës violator; invader
plágë wound
kúllë house; fortified home
gúrrë fountain
shpëláj rinse
tert dry
hijeshój grace
pétkë clothing
bácë elder brother
fill thread
dhémbje pain
shtat = trup body; stature
mjekój doctor; care for
i sëmúrë sick; ill
gjëmëmádhe sorrowful; forlorn
balóz knight
i prápë perverse; wicked
rreng burden; demand
dash ram
dígjte (djeg) burned
askúsh nobody
hov drive; onrush; momentum
héshtë spear
tějpërtej through and through
lëngój suffer
thúndër heel
i pakállur uninserted
rádhë turn; row
ankóhem complain
nëm curse
mórtje death
kálbem rot; decay
blir lime tree
përréth around
pandéh imagine
rrënúar rundown; deteriorated
i trétur drawn; dried out; melted

nxij blacken
lëmáshk slime; scum
brévë boa constrictor
lëmój caress
përfëllój cast off
shull sunny spot
rëndój offend; make heavy
braktís abandon
búkur openly; straightly
brëngë misery
përkëmb recover; get well
vérë summer
më tháftë véra may summer find me dead
brof jump up
gjog white horse
nallbán blacksmith
vëllám best man
falmeshëndét best regards
mbath put on shoes
potkónj (potkúa) horseshoes
i farkúar wrought; worked
thúmbë spur
trunxh bronze; copper
shesh arena; plain
vëllath = vëllám best man
sërísh again
dashamír benevolent
i lárgët from afar
varrós bury
vëllazërí brotherhood

zemërím anger
magjýp gypsy
mbrëmanet in the evening
mposht overcome
hakmárrje revenge
váthë corral
majm fatten
dyluftím duel
thumbój taunt
shóqi-shóqin one another
parzmóre chain mail
përkrenáre helmet
túndem tremble
bre oh
shemb nga káli unhorse
kanún canon; law
kúaj (kálë) horses
tym më tym blazing smoke
shénjë aim
përkúl bend
gjunj (gju) knees
pash length from fingers to fingers, arms spread
lëndínë meadow

shteg pathway; pass
në shteg të bállit in the middle of the forehead
gremís knock down
arratí exile
móllë të shálës saddle horn
krúa well
kundërmój reek; smell
kërmë carcass
fálë ju qófshin I bequeath you
amanét in custody
motërzézë wretched sister
përqafúar embraced
muránë wall or stones encircling a grave
dhúnë violence; destruction
ngahéra from time to time
dushkóhet becomes green
i thárë dried up
sarái palace
kulm high point; pinnacle
vaj weeping
bjéshkë më bjéshkë from mountain to mountain
veró j summer; spend the summer
vërrí më vërrí from sheep pasture to sheep pasture
kurrkúnd in no place; nowhere
i dhímbshëm compassionate
fisnikërí nobility

LEXIMI I DYZETEGJASHTE

Provim Në Korridoret e Bardha

Atë e nxorën nga salla e kinemasë, ashtu thjesht: filmi u ndërpre, dritat u ndezën dhe atë çast nga galeria u dëgjua një zë:

--Mjekja Vadet...të dalë se e presin në spital!

Valdeti u ngrit dhe buzëqeshi si e zënë në faj tek dëgjonte shoqet e saj që turfullonin dhe spektatorët që pë shpërisnin. Doli me kokulur sikur donte t'u kërkonte ndjesë atyre qindra njerëzve që u ndërpreu në gjysmë atë film të bukur.

Përjashta binte shi, por shoferi e kish afruar makinën aq pranë portës sa që mjaftonte një hap të futeshe brenda e të rrije në kolltukun e butë.

--E, Zef, ç'kemi?-- e pyeti vajza kur makina u nis.

--S'e di, por më duket se apendicit, diçka si ky më zuri veshi në poliklinike! Kishte dhembje të mëdha. Përpëlitej në makinë me të ardhë keq!

--Burrë apo grua?

--Burrë plak. Mësues pensionist!

--Mjekun e lajmëruat?-- vazhdoi vajza.

Shoferi nuk u përgjegj përnjëherësh. Fshiu xhamin e lagur të makinës, pastaj shtoi ngadalë:

--I shkova dy herë, por nuk e gjeta në shtëpi.

Vajza hapi sytë e çuditur:

--E si do t'ia bëjmë?

--U pa puna! Do t'ju çoj në spital, pastaj po kthehem edhe një herë. Ndërkaq ora do të shkojë vonë, kështu që asnjë pijetore s'do të jetë e çelur! Mjeku s'para shkon në pijetore, por, helbete, mund të ketë shkuar me shokë...tha Zefi e qeshi.

--Mos fol ashtu!-- e qortoi vajza, por me të butë, sepse edhe ajo buzëqeshi padashje. Edhe ajo kish dëgjuar se mjeku çeku kish filluar të pinte ndonjë gotë tani që po i afrohej pleqërisë.

--E pse të mos flas!-- vazhdoi shoferi, shyqyr që kam me kë të ndërroj dy llafe. S'i thonë shaka të rrish tërë ditën në timon... Pastaj ai e kreu me nder detyrën. Fëmijët i rriti, u dha shkollë, asistentja i erdhi tani...kot që nuk del në pension.

--Ehe, ka kohë për pension; është ende i fortë. Mjekët si ai i kemi të rrallë. Ti e di më mirë se ke shërbyer kaq vjet me të! Apo jo?

--S'them se jo! Gruan time ai e shpëtoi nga ulçera. Por tani s'është më vetëm, erdhe edhe ti!

--Unë vetëm gjashtë muaj kam! Ende s'kam bërë operacionin e parë.

--Por do ta bësh! Gjithnjë asistente s'ke për të ndenjur...

Heshti një çast. Pastaj se ç'iu kujtua dhe shtoi:

--A e di çka! Mos ma vër veshin që të flas me "ti". S'u mësova që s'u mësova me u folë të tjerëve me "ju". Mjeku më flet tash pesëmbëdhjetë vjet për këtë...

Valdeti qeshi. Vërtet që s'e kish dëgjuar Zefin t'i drejtohej ndonjëherë në shumës.

--Jo, bre Zef! Unë jam vajza jote! As më ka shkuar ndërmend një gjë e tillë. Ti veç mos më ler të kthehem natën vonë në këmbë nga operacioni, pa

më thirr me "ti" sa herë të duash.

--S'e paske harruar natën e vitit të ri! E po ne zbatojmë urdhërat, moj doktoreshë.

Valdeti qeshi përsëri. Iu kujtua nata e vitit të ri kur e thërritën në operacionin para mesnate, kur qe shuar drita gjatë operactionit, dhe ajo me mjekun e pritën vitin e ri me errësirë para një barku të çarë, ku do të hiqnin tre të katërtat e një stomaku... Atë natë, pas operacionit, ish kthyer në shtëpi në këmbë, vetëm sepse shoferin e kishin urdhëruar të nisej urgjent për një fshat...

Ndërkaq arritën në spital. Valdeti doli nga makina.

--Zef, vrapo edhe një herë tek mjeku,-- i tha shoferit dhe u fut në spital.

Në paradhomën e sallës së operacionit ish shtrirë një burrë thatim i veshur me një palë pizhame të blerta. Kishte dhembje dhe të prera. Valdetit i doli përpara kryeinfermieri:

--Hë Gjon! Ç'kemi?

--Apendicit perforacion!

--I pe analizat?

--I pashë!

--Si janë?

Kryeinfermieri i dha fletën e laboratorit.

--13,000 leukocitë! Qenka keq!

--Sikur ta shohësh edhe ti, doktoreshë!

--Po e shoh, megjithëse diagnoza e klinikës paska dalë.

Valdeti veshi bluzën e bardhë dhe iu afrua të sëmurit. Por, kur e vështroi në fytyrë, duart iu drodhën dhe u skuq si flaka. Përpara saj qëndronte mësuesi i fillores, mësuesi i fshatit, ai që e kish mësuar për katër vjet me radhë, që ish kujdesur t'i delte bursa jetimes së vogël, ai që i shkruante vazhdimisht edhe atëhere kur ajo ndodhej në një qytet të madh të një vendi të huaj, ku studionte për mjeke.

--M...Mësuesi im! Ju jeni?-- belbëzoi vajza me ngashërim...

I sëmuri, një burrë rreth gjashtëdhjetë vjeç, me një ballë të gjerë, me flokë krejt të thinjur, çeli me mundim sytë dhe e vështroi gjatë vajzën... Kur e njohu, buzëqeshi me zor.

--Valdet, bija ime!... dhe e zunë përsëri dhembjet, përsëri deshi të villte por, siç duket, tanimë stomaku s'kish brenda asgjë. Gogësiti dy-tri herë. Gogësima ia shtoi dhembjen.

Valdetit iu mbushën sytë me lot. Ato fjalë "Valdet, bija ime!" iu dukën si qortim. Kish plot disa vjet pa e parë! Ish kthyer nga universiteti mjeke dhe s'kish shkuar në fshat të takonte mësuesin e saj, që e kish dashur aq shumë. Sa e padrejtë, sa e pakujdesshme kish qenë!...

I kapi dorën mësuesit dhe ia shtrëngoi fort. Mësuesi u përmend. E falënderoi me sy.

--Mos u bëni merak! Dhembjet për pak do t'ju kalojnë. Po si ju erdhën? Ose, mos më tregoni fare, mos flisni. Ja, t'ju shoh barkun një minutë.

I preku barkun. E kish të fortë. Çdo prekje i shkaktonte mësuesit dhembje të mëdha. Shenja të një apendiciti akut. Edhe analiza e urinës fliste qartë.

--Merr në telefon familjen e mjekut dhe pyet nëse është nisur ai për të

ardhur në spital,-- urdhëroi infermieren e narkozës. Mësuesi i mëgjoi ato fjalë dhe pyeti me zë të mekur:

--Pse, nuk do të më bësh operacion ti Valdet?

Vajza përsëri u skuq!. U përgjegj me turp:

--Unë s'kam filluar të bëj vetë operacione. Jam stazhante ende. Duhet të kalojë sëpaku një vit.

--E unë kisha aq dëshire të më bëje ti. Kur të pashë që hyre, m'u kujtove kur ishe e vogël...

--Mos flisni, i dashur mësues!-- Mjekes përsëri iu mbushën sytë me lot. Iu kujtua dita kur i vdiq e ëma. Mësuesi e kish marrë atë natë në shtëpi vogëlushen tetë vjeçare, nxënësen e klasës së dytë. Ajo tashmë kish mbetur vetëm. Jetoi një javë në shkollë, tek mësuesi, deri sa e mori gjyshja. Por fshati i gjyshes nuk kish shkollë dhe vajza bënte një orë rrugë për të vazhduar mësimet. Mësuesi i thoshte vazhdimisht:

--Ç'don të bëhesh ti Valdet?

--E vajza përgjigjej:

--Doktoreshë!...

Dhe mjeke u bë!

Infermierja hyri e alarmuar:

--Në telefon më thonë se mjeku ka një orë që është nisur në lokalitetin B. Atje ka ndodhur një aksident automobilistik. Ndoshta sonte nuk vjen!

--Siii?!?-- bërtiti Valdeti dhe u zbe në fytyrë! --Po tani?

Kryeinfermieri dhe tre infermierët e vështronin si të ngrirë. Edhe mësuesi nuk rënkoi ato çaste. Valdetit iu duk sikur qielli i ra në kokë. Po të mos operohej tani, mësuesi mund të vdiste. E ajo vetë s'kish bërë kurrë operacion. Kish marrë pjesë në shumë operacione, por është ndryshe të operosh vetë. Është si në farkë: njëri mban darën, por hekurin e rreh dhe i jep formë një tjetër dhe merita i takon atij...

Si t'ia bënte? Vështroi mësuesin. Edhe ai po e vështronte. Ata zhvilluan një bisedë me sy, folën sytë e tyre, zemrat e tyre:

--Ke frikë?-- pyeti mësuesi.

--Disi! S'kam bërë ndonjëherë.

--S'ka gjë! Provo me mua!

--S'po guxoj!

--Ndërsa unë po! Kam besim tek ti! Ke qenë nxënëse e mirë.

--Megjithatë! Po sikur...

--Po sikur mjeku të mos vijë... Jepi, Valdet! Mos më korit!

Vajzën e mbuluan djersët. Ngriti kokën lart dhe urdhëroi pa vështruar asnjërin në sy:

--Dërgojeni në sallë!

Infermierët shikuan njëri tjetrin. Kryeinfermieri Gjon iu afrua dhe e pyeti:

--Do ta bëni ju operacion?

--Pregatisni sallën! Ti do të asistosh!-- i tha mjekja.

Dhe çdo gjë pastaj u zhvillua në heshtje.

Valdeti lau duart, infermierja i veshi dorëzat e llastikut, i vuri maskën. Dhe ajo, me duart që i dridheshin, ndjeu për të parën herë në jetën e saj emocione të jashtëzakonshëm. Vërtet kish përpara një operacion të lehtë, por ai ish i lehtë për kirurgët me përvojë e jo për një stazhante që s'kish gjashtë muaj që qe ndarë me auditorin e universitetit. Pastaj apendiciti ish

akut, dhembjet sipas kartelës kishin filluar që ditën e shkuar, pra kishin kaluar 24 orë... Po sikur?... Oh, jo, jo...

Mësuesit posa i kishin vënë maskën e narkozës, por kjo efektin akoma s'e kish bërë... Valdeti e shikoi edhe një herë, sytë e mësuesit përsëri thoshin:

--Mos ki frikë, Valdet! Me guxim!

Vajza puliti sytë dhe tundi kokën. Vështroi dorën e lidhur për shtrat dhe gati deshi ta zërë atë dorë plot rrudha; por u kujtua se ish me dorëza. Infermierët e shikonin në sy. Edhe kryeinfermieri e vështronte në sy. Ai tani qëndronte në vendin ku ajo kish qëndruar për gjashtë muaj. Edhe për Gjonin ky ishte një rast i vështirë. Zakonisht, para se të vinte Valdeti, mjeku thërriste për të asistuar mjekun patolog.

--Fillojmë?-- tha Valdeti.

Gjoni tundi kokën.

Filluan! Valdetit i dukej si në provim. Plagën e çeli shumë të vogël, aq sa e çelte edhe mjeku. Dhe filloi të punojë me gishta në atë skutë të vogël të errët, ku fshihej apendiciti i mësuesit të saj...

...Kur mbaroi, iu prenë fuqitë. Shkoi duke u lëkundur deri në dhomën e zhveshjes. Gjoni e ndihmoi të hiqte dorëzat dhe garzën. Ishte qullur në djersë. Shkoi në lavaman, por nuk piu ujë. I vinte për të vjellë. Futi kokën në rubinetë dhe la që uji t'i përshkojë qafën e ti derdhej në faqe, në qafë, kish kryer operacionin e parë, provimin e parë në jetën e mjekut... Ishte e lumtur, por kishte ende frikë. Si do të bëhej i sëmuri? Po mjeku ç'do t'i thoshte? Vështroi nga dritarja. Shiu kish pushuar. Ora e qytetit po i afrohej dymbëdhjetës, ish mesi i natës. Operacioni kish zgjatur dyzet e pesë minuta.

--A ta thërrasim shoferin?-- pyeti Gjoni.

--Përse?

--T'ju çojë në shtëpi! Është mesnatë.

--Thërriteni dhe shkoni ju. Natën e mirë!-- tha vajza dhe Gjoni e kuptoi se nuk i duhej folur më. Për të sonte nuk kish gjumë, kish bërë operacionin e parë.

--Natën e mirë, doktoreshë!-- tha Gjoni, e këtë herë në zërin e tij kish më respekt se kurrë.

Narkoza i doli pas një ore, por mësuesin e kish zënë gjumi. Vonë, aty nga mëngjezi, i erdhën të vjellat.

Valdeti i qëndronte mbi krye dhe dorën e mësuesit e mbante në të sajën.

Zbardhi. Të sëmurët e pavionit u zjguan një nga një.. Kur panë mjeken bri të operuarit ngriheshin në heshtje nga shtrati dhe delnin në korridor. Ata që s'mund të lëviznin, vështronin me frikë... Ku ta dinin ata se mjekja kish bërë operacionin e parë! Ata kujtonin se i sëmuri ish shumë rëndë.

Mësuesi çeli sytë. Kur pa Valdetin, qeshi dhe i shtrëngoi dorën.

--E, të thashë se do kalojmë mirë! Tani s'kam dhembje, veç ca të vjella. E ti kishe frikë...budallaqe.

Valdeti sa s'po çmendej nga gëzimi.

--Pra, jeni mirë? Nuk ndieni më dhembje?

--Jo, pra, jam krejt mirë!

Vajza i mori dorën e filloi t'ia puthë me forcë, një, dy herë... Kushedi kur do të mbaronte sikur të mos e kapte dikush për supi. Ktheu kokën dhe menjëherë u ngrit në këmbë, si një nxënëse e zënë në faj.

--Ç'e puth ashtu?

--E...e kam mësuesin tim të fillores...mundi të thotë vajza.

--E pastaj? Përse të mallëngjehesh? Dale ta shoh plagën. Ma trego!

Valdeti hoqi pambukun nga plaga. Mjeku plak e mati plagën e vogël sa gishti.

--Shumë mirë e paske çelë! Ç'doli?

--Perforacion.

--Sa zgjati?

--45 minuta!-- tha vajza dhe uli kokën.

--Sa moj?! 45 minuta?! Shumë keq! Pse, operacion i thua këtij? Ikë tutje, shko bëju pediatre!-- tha mjeku, por Valdeti e kuptoi se mjeku ish i kënaqur. Ai nuk lavdëronte kurrë, po këtë radhë toni i zërit ish atëror, shumë më i butë se zakonisht.

Mjeku e mbylli vetë plagën dhe u suall nga mësuesi.

--Po ti, vëlla, ç'ke? Po qan?

Mësuesi qeshi e u përgjegj ngadalë:

--Ndoshta! Tani jam në pension e më falen.

--Ke të drejtë-- tha mjeku. --Ja, dhe unë s'kam ç'të bëj më. --Dhe bëri me gisht nga Valdeti.

--Ish provim për të?-- pyeti mësuesi.

--Provim!

--Ç'notë?

--Pesë! Sa kujtove ti?

--Ndërsa unë dhjetë!

--Ohu! I paske të lira notat!

--E meriton!

--Mos e përkëdhel! S'është fëmijë. E Valdet, pse rri ashtu, shko poshtë në mencë, se të presin infermierët e pavionit.

Vajza u çudit:

--Mua më presin?

--E moj, ty po këtë tjetër? Ke bërë operacionin e parë. Duhet të na qerasësh! S'e di ligjin e kirurgjisë?

Fadil Kraja, "Provim në korridoret e bardha," Tregime të zgjedhura (Tiranë), Biblioteka e rinisë, 1967, pp. 137-145.

sállë hall
kinemá cinema
ndërprés interrupt
ndez light
buzëqésh smile
zë catch
tek while
dëgjój hear
turfullój snort
pëshpërís whisper
kokulúr bowed head
shofér chauffeur
hap step
kollttúk armchair
polikliníkë polyclinic
përpëlítem toss and turn from pain
përnjëhérësh at once
me të árdhë keq = për të árdhur
keq in a pitiful manner
fshij wipe
xham glass
i lágur wet
u pa púna it's obvious
ndërkáq meanwhile
pijetóre bar room
helbeté however
qortój scold
padáshje unwilling
çéku somewhat
pleqërí old age
shyqýr thank goodness
ndërró j exchange; change
llaf = fjálë word
timón wheel
krýej complete
énde still
shërbéj serve
shpëtój save
ndénjur remain (participle of rri)
hesht be silent
kujtój recall
se ç'iu kujtúa (he) recalled something
ve vesh pay attention
me u fólë = t'u flas speak to
bre emphatic particle

thërrás call
zbatój carry out
moj emphatic particle
mesnátë midnight
errësírë darkness
bark belly
çaj cut open
vrapój hurry
paradhómë antercom
shtrij stretch out
thatím skinny
pizháme pajamas
i blértë green
të préra stabbing pains
kryeinfermiér head nurse
flétën e laboratórit laboratory report
drídhem shake
skúqem blush
flákë flame
búrsë scholarship
jetíme orphan (female)
belbëzój stutter
ngashërím compassion
i thínjur grey-haired
çel open
me mundím with difficulty
vështrój look at
vjell vomit
gogësít yawn
i padréjtë unjust
i pakujdésshëm thoughtless
shtrëngój squeeze
përménd revive
prek touch
shkaktój cause
qártë clearly

narkózë anesthesia
i mékur faint; weak
stazhánt candidate; intern
kaló,j pass; spend
sëpáku at least
i vdiq e ëma her mother died
vjeçár years old
ç'don = ç'dëshirón what do you want
lokalitét location
bërtás holler
zbej make pale
zbéhem become pale
ngrij freeze
rënkój breathe with difficulty
vdes die
fárkë blacksmith's shop
zhvillój develop
dísi somewhat
guxój dare
megjíthatë nevertheless
korít hurt deeply
mbuló,j cover
djérsë sweat
dórëz glove
llastík rubber
ndiéj feel
i jashtëzakónshëm extraordinary
kirúrg surgeon
përvójë experience
ndárë (ndaj) separated

sipás according to
kartélë chart
pulís blink
tund shake
gáti almost
rrúdhë wrinkle
patológ pathologist
plágë wound; incision
skútë hole
lëkúnd wobble
zhvéshje undressing
dhómë e zhvéshjes dressing room
heq remove
gárzë surgeon's mask
qull drench
lavamán washroom
rubinétë faucet
përshkój run through
mes middle
zgjat last
zbardh dawn
pavión ward
zgjoj awaken
sa s'po çméndej could barely keep
from going crazy
sup shoulder

mallëngjéj move emotionally
pambúk cotton
mat measure
çélë = çélur opened up
atërór fatherly
i bútë mild
sjell bring; turn
qaj cry
provím examination
nótë grade
ohú oho
lírë cheap
përkëdhél fondle
méncë dining hall
çudít surprise
qerás treat
kirurgjí surgery

LEXIMI I DYZETESHTATE

Shoku Im

"Kam lindur dhe jam rritur në Tiranë". Kështu e filloi bisedën ushtar Petrit Vrapi. "Në Tiranë mbarova politeknikumin dhe hyra si elektricist në një ndërmarrje të kryeqytetit". Ushtar Petriti, si ndenji më mirë, vuri duart mbi gjunjë e, duke më vështruar në sy, vijoi: "Në ushtri kam katër muaj që po shërbej. Isha emëruar në nënrepartin e vendosur në lartësinë njëmijë e tetë qind metra. Dhe ja dita që u nisëm për rrugë. Zbritëm nga makina dhe zumë të ecim. Do të bënim tetë orë më këmbë. Ishte vjeshtë. Fletët e dushkut qenë përflakur, kurse ato të ahut binin palë-palë... Në një burim hëngrëm drekën e, në të perënduar të diellit, mbritëm ne kazerma.

"Na pritën. I pari na dha dorën komandanti, pastaj punëtori politik, e me radhë të gjithë ushtarët. Përnjëherë u krijua një ngrohtësi e sinqertë. Si u qetësuam dhe hëngrëm darkë, na caktuan shtratin ku do të flinim, pastaj na ftuan të dëgjonim radion, e, pas radios, një shfaqje nga grupi diletant. Të them të drejtën, u habita me rregullin. Jo se nuk e dija që në ushtri kish rregull, po nuk ma merrte mendja që në një vend të vetmuar, larg botës, si i thonë, të ishin të gjitha mjetet për një jetë të kulturuar. Po i them të gjitha këto, se pikërisht këtu edhe fillon historia që dua të tregoj. Dhe ja, duke parë shfaqjen e grupit diletant, u hap dera dhe në dhomë hyri një ushtar trupmadh, fytyrëkuq, me tipare të qeta, të rregullta. Sa e pashë, u rrënqetha dhe zemra më rrahu me tik-take të ngatërruara.

"Skënder Kalaja...dhe ai shërbeka këtu"-- thashë me vete.

"U trondita shumë saqë, jo vetëm nuk e shijova shfaqjen, po edhe kur rashë të flija, mezi më zuri gjumi, megjithëse isha i lodhur.

"Ku ishte shkaku i gjithë këtij turbullimi? Im vëlla ish fejuar me motrën e Skënderit, po fejesa nuk pat zgjatur asnjë javë. Deshën prindërit po nuk deshi vajza. Dëgjuam se atë e kish përkrahur shumë edhe Skënderi... Vëllai nuk e meritonte këtë turp. Kushedi sa herë mallkova vajzën dhe Skënderin për këtë njollë që na vunë.

"Ja pra, ky ishte shkaku i shqetësimit... Si do të jetoja në të ardhmen bashkë me atë njeri që e urrente i madh dhe i vogël në familjen time? U mata t'i thosha komandantit që të largonte nga nënreparti njërin prej të dyve, po e lashë për më vonë.

"Të nesërmen në mëngjes na lajmëruan se shenjuesit më të mirë do të zhvillonin qitje me pushkë dhe mitraloz... Midis tyre dallova Skënderin. Pashë përfundimet e tij. S'kishe ç'të thoshe: Plumbat kishin shpuar tabelat, sikur t'i kishe vënë me dorë.

"Kur shihja tabelat, Skënderi më buzëqeshi, po unë e vështrova me inat dhe i ktheva krahët. Prapë mendja më mbeti tek ai. Ç'të bëja? E vendosa. S'duhej as t'i flisja, as të kisha ndonjë marrëdhënie. Po në të vërtetë po ndodhte ndryshe. Skënderi binte në sy si njeri i pajisur me një edukatë të përsosur. Ishte i përpiktë, i palodhur, i dashur me të gjithë. Dhe, ajo që më pëlqente mbi çdo gjë te ky njeri, ishte thjeshtësia dhe zemërgjerësia. Çdo punë ai e kryente në një mënyrë të zakonshme, pa u dukur dhe pa u mburrur."

Petriti heshti një çast, buzëqeshi dhe, me një zë si më të kthjelltë,

vazhdoi:

"Para se të rrëfej thelbin e ngjarjes, dëshiroj të ndalem te disa ndodhira që më bënë ta nderoj atë njeri. Ta nderoj, po të mos heq dorë nga vendimi që kisha marrë. Është pak kontradiktore kjo që thashë. Ta duash njeriun e të mos i flasësh me gojë, do të thotë të bëhesh pak i çuditshëm. Pra unë po tregohesha pak i çuditshëm. Nejse, të ftohtit dhe acari tek ne filloi shpejt. Dheu kish ngrirë, ujët po e po. Nënreparti, duke iu përgjëgjur thirrjes së partisë për të hapur tokë të re, vendosi të qërojë nga kaçubat dhe ferrat katër dynym tokë dhe këto t'i kthejë qilizmë për t'i mbjellë patate. Dhe puna nisi. Temperatura kish zbritur shtatë gradë nën zero. Të gjithë rrëmbyen kosoret. Bashkë me fishkëllimën e erës nisi të dëgjohej dhe fishkëllima e kosores. Padashur ndiqja me një vështrim tinëzar punën e Skënderit, po jo me qëllim të keq. As unë s'e di pse ndiqja me kujdes çdo lëvizje të tij. Kjo po më bëhej si sëmundje. Ai punonte me gjithë shpirt e përdorte kosoren sikur ta kishte zanat, megjithëse ai s'ish marrë kurrë me kësi punësh.

"Bora filloi të bjerë edhe tek ne. Ajo filloi dhe s'kish në mend-të pushonte. Një mëngjes në orën e gjimnastikës, si bëmë vrapimin, komandanti tha:

--Kush dëshiron, mund të lahet me borë!

"Që atë çast nga rreshti dolën ushtarët e vjetër. Midis tyre dhe Skënderi. Se si më erdhi...

--Shoku komandant do të lahem dhe unë,-- thashë.

--Jeni larë ndonjëherë?-- pyeti.

--Jo, shoku komandant.

--Akoma është shpejt për ju, ushtar Vrapi. Në fillim duhet mësuar trupi, pastaj mund të laheni e të bëheni si Skënderi. Ja, shikoni, ushtar Kalaja është bërë vërtet kala-- dhe i ra gjoksit te Skënderit.

"Merrni me mend, në një temperaturë pesë, gjashtë gradë nën zero të qëndrosh lakuriq dhe të fërkohesh me borë e, kush kështu? Një kavajas, që e kish parë apo s'e kish parë me sy borën shtatë t[illegible] herë në jetën e tij.

"Më vonë ndodhi kjo ngjarje:

"Komandanti na urdhëroi që unë bashkë me Skënderin të shkonim deri në Babzuh, fshat që mbante pesë orë më këmbë, për të pritur punëtorin politik, i cili kthehej nga komanda e njësisë. Për një çast ngurova, po pastaj u binda. U nisëm. Skënderi përpara çante borën, unë prapa shkelja në gjurmët e tija. Ishim veshur trashë. Në sup kishim hedhur automatikët. Në çantat e shpinës, kishim nga një racion ushqim. Sa dolëm nga lëndina ku ishin ndërtuar kazermat, zumë të ecim në një rrugicë që çante shpatin tejpërtej. Bora kish rënduar pemët. Toka e stërbardhur dukej si e lyer me alabastër. Asgjë s'pipëtinte, vetëm zboraku, ky zog bishtlarmë me gjoks të kuq cicëronte e fluturonte nga një degë në tjetrën. Përshkuam Shpatin në një orë. Tani do të ktheheshim në të djathtë. Udhëza gjarpëronte buzë një gremine. Vendin s'e kish parë kurrë dielli. Në verë kish borë, ndërsa në dimër akull. Skënderi ndaloi, u kthye nga unë e, duke më vështruar me ata sy të kaltër e duke vënë buzët në gaz, tha:

--Na duhet të ecim krah për krah që të mos rrëshqasim.

"U drithërova. Shfryva me vete dhe se si më shpëtuan këto fjalë:

--Kur e dije se do të na ndodhte kështu, pse nuk i the komandantit që nuk mund të shkonim bashkë në shërbim? Ti e di mirë se unë nuk të kap prej

krahu.

"Skënderi më pa një hop si me habi, pastaj m'u afrua dhe më tha:

--Ec përpara!

"Shkova përpara. Skënderi më arriti, më vuri në të majtë, në anën që s'kishte rrezik, se edhe sikur të rrëshqisja, mund të më kapte. Vetë zgjodhi skajin më të vështirë. E vështrova në fytyrë, pastaj ula kokën i hutuar.

--Ki mendjen, se mund të biesh,-- më tha, sikur të kuptonte gjendjen time.

"Nisa të eci me kujdes. Një afsh i ftohtë më kish pështjellë nga të gjitha anët. Më dukej vetja sikur isha futur në një frigorifer të madh. Këmbët s'i ndjeja të miat. Si bëmë gjysmën e udhës, në vendin më të rrezikshëm, ku rruga ishte shumë e ngushtë e gremina binte thikë përposh, sikur m'u ngatërruan këmbët e desh rashë. Përnjëherë më kapën duart e forta të Skënderit, pastaj ai më shkoi krahun e më tha:

--Duhet të ecim e jo të biem. Nuk është mirë që të arrijë para nesh punëtori politik dhe të na presë, më kuptove?

"E kaluam dhe rrugicën. Tani udha shkonte në një pllajë të ngrirë, të zhveshur. Shkëlqimi për një çast na verboi sytë. Vijonim të ecnim krah për krah. Si bëmë hja dhjetë hapa në pllajë, Skënderi krejt papritur tha:

--Ti, Petrit, ke lindur dhe je rritur në Shqipërinë e re, po hiqesh në disa raste sikur të jesh ndonjë plak prapanik.

--Unë kam një vëlla shumë të mirë, që nuk e meritonte atë turp,-- ia ktheva gjakftohtë.

--Nuk e shau kush vëllanë tënd. Ai është një njeri i ndershëm. Po në qoftë se ime motër nuk deshi të bashkonte fatin me të, se donte një tjetër, kjo nuk do të thotë se turpëroi ose përbuzi vëllanë tënd.

"Ma mbylli gojën. Çfarë t'i thosha? Bëmë dhe disa hapa. Skënderi shtoi:

--Ti duhet të gëzohesh, more shok, që një vajzë nga Kavaja më në fund u bë e zonja të zgjedhë vetë shokun e jetës.

"Sa mbaroi fjalën Skënderi, një fishkëllimë e mprehtë, si e çjerrë, përshkoi anembanë vendin. Një erë e papandehur sa nuk na rrëmbeu.

--S'i kemi punët mirë. Po na zë furtuna e po na zë në një vend të keq. O burra hidh këmbët, të kapërcejmë pllajën,-- tha Skënderi.

"Furtuna nisi. Ne shpesh përmendim fjalën furtunë, po nuk e kemi provuar ç'është ajo kur të mbërthen në male. Furtuna të bën të verbër, se asgjë nuk vështron, bile as shokun që të ka zënë për krahu. Furtuna të bën shurdh, se asgjë nuk dëgjon. Furtuna të merr e të përplas ku të dojë, ashtu si t'i teket asaj. Ajo të fut në trup akull, sado i veshur qofsh. Furtuna të zë fytin, nuk të lë të marrësh frymë. Ajo përlan shtëpi, gjerdhe, pemë. Vetëm shkëmbinjve s'ka se ç'u bën. Po ja shkëmb ishte dhe Skënderi. Një shkëmb i gatuar me një përbërje të veçantë që edhe ajo furtunë, mbase më e madhja që kish ndodhur atyre anëve, s'e trembi, s'e tundi. Kisha ecur më se njëmijë metra, kur m'u pre fuqia dhe rashë. Isha mbledhur kuspull, këmbë e duar s'i ndjeja të miat. Merrja frymë me vështirësi. Era, me një fuqi të çuditshme, më ngrinte e më përplaste përtokë. Kur më shtynte nga ana e Skënderit, gjeja mbështetje tek trupi i tij e më dukej sikur më mbronte një shkëmb i vërtetë; kur më shtynte në të kundërtën, më mbante krahu i Skënderit që më kish mbërthyer si ndonjë çengel. Më në fund duart e Skënderit më kapën e më ngritën përpjetë. Ai më shtrëngonte fort dhe nisi të çante

stuhinë. Kuptoja se ecte me mundim e shumë ngadalë, po prapë lëvizte përpara. Veshët më ishin shurdhuar nga ajo gumëzhimë e vazhdueshme, e madhe. Sytë më ishin agulluar. Herë pas here hapja qepallat dhe vështroja fytyrën e përqëndruar të Skënderit.

--Mbahu, o burrë!-- më tha.

"Kur fillova të marr veten disi mirë, dëgjuam një zhurmë që tronditi anembanë dheun.

--Ka rënë ndonjë ortek!-- tha Skënderi. Si heshti një hop shtoi: --Duhet të lëvizim prej këndej se mund të shkëputet ndonjë gur, ose ndonjë rreshmë e do të na palosë. Përtej, ndonjë mijë metra larg, është një tunel, duhet që të mbërrijmë patjetër atje, ndryshe humbëm.

"Një mijë metra. E ç'janë një mijë metra? U gëzova kur mora vesh këtë lajm, se nuk e dija që Skënderi nga vendi që më kish marrë në krah e deri sa mbërriti te shkëmbi, kish bërë tri orë e kish udhëtuar vetëm katërqind metra.

--Nisemi, Skënder,-- ia ktheva. Ndihej një zhurmë e tillë që nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë. Na rrethonte një tym i përhimtë, sa që nuk vështroje dot asnjë qënie, sikur të ish dhe një hap larg...

"Sa hymë në tunel, Skënderi më mbështeti pas lehdit. Vuri automatikët aty pranë dhe u ul. Jashtë furtuna vijonte me tërbim.

--Po errësohet, apo më bëjnë sytë?--mërmërita nëpër dhëmbë.

--Po errësohet, po mos fol, mos e harxho frymën kot,-- më këshilloi.

"E vështrova në fytyrë, i buzëqesha. Atë çast Skënderi më përqafoi e më puthi. Si hoqi kapotën dhe xhaketën prej pambuku e i shtroi, më tha:

--Mos luaj. Tani na duhet zjarr e asgjë tjetër.

"E pashë që u ngrit. I merreshin këmbët. Hyri në thellësi të tunelit e pas pak erdhi me një krah dërrasa të vjetra.

--Dru kemi boll; sa të rrimë dhe dhjetë ditë. Dhe ushqim kemi, tani le të tërbohet era. Vetëm kam frikë se mos kjo e mallkuar ka zënë në rrugë punëtorin politik,-- tha dhe mblodhi grushtin.

"Skënderi ndezi zjarr, një zjarr të madh, që na pruri mirë në vete. Pastaj vuri në zjarr popla guri, i nxehu, i mbështolli me pece dhe m'i vuri në putrat e këmbëve. Këtë punë e bëri disa herë, pastaj gurët e nxehur m'i vuri në shpatulla e në të gjitha pjesët e tjera të trupit. Vështroja Skënderin, që donte të më ndihmonte me mish e me shpirt, po vija re se ishte shumë i shqetësuar dhe shumë i lodhur.

--Skënder, sikur të pushoje pak, nuk do të ishte keq,-- i mërmërita.

--Mos fol, se të bën dëm,-- ma preu shkurt.

--Po sikur të hanim pak bukë?

--Mirë u kujtove, bukë duhet të hamë,-- ma ktheu.

"Shoku nxori bukën që ishte bërë qull dhe e vuri sipër prushit. Mori një kuti konserve mishi, e hapi dhe e vuri të ngrohet. Kur u mata të ngrihesha për të ngrënë bukë, e pashë se nuk mundja. Jo vetëm kaq, po mua nuk më lëviznin as këmbët e as krahët. Kuptova shkakun e shqetësimit të Skënderit.

--Ti mos u bëj merak për mua, se me siguri do të shërohem,-- i thashë.

--Për ty nuk bëhem merak, na, ha pak bukë,-- ma ktheu.

"Si mbaruam së ngrëni, Skënderi shtoi:

--Për ty s'kam merak, Petrit, se si ti dhe unë shpëtuam, po ku do të jetë punëtori politik? Ja, për të shqetësohem. Ne duhej të mbërrinim në

Babzuh për ta pritur, kurse ne mezi erdhëm deri këtu.

"Pas dymbëdhjetë orëve furtuna pushoi. Skënderi më tha:

--Në qoftë se punëtori politik është gjallë, pas një ore e kemi këtu.

"Dhe vërtet, fjalët e Skënderit dolën. Nuk shkuan dhjetë minuta e, papandehur, në tunel hyri punëtori politik i shoqëruar nga dhjetë fshatarë. Ai, bashkë me fshatarët, kishin dalë për të na gjetur, pikërisht kur furtuna tundte dheun.

"Ne qëndronim pranë zjarrit dhe bisedonim. Biseda vinte e shtruar, e ngrohtë. Ne të gjithë ishim të gëzuar që kishim gjetur njëri tjetrin. Flaka lodronte dhe hidhte në tunel hie e dritë të bukura.

Reshat T. Nepravishta, "Shoku im," Tregime të zgjedhura (Tiranë), Biblioteka e rinisë, 1967, pp. 97-105.

bisédë discussion; conversation
politeknikúm polytechnic
ndërmárrje enterprise
vijój continue
nënrepárt sub-unit
vjéshtë autumn
përflákur crimson; in flame
pálë-pálë one atop another
drékë lunch
kazérmë barrack
me rádhë in turn
i vetmúar isolated
trupmádh big-bodied
sa as soon as
rrëngéthem shudder; shiver
i ngatërrúar confused
mezí më zúri gjúmi it was hard for me to sleep
shkak cause; reason
déshën (dúa) wanted
njóllë stain
ja pra there; then
mátem attempt; try
shenjúes marksman
qítje shooting; target practice
dallój take note of; differentiate
tabélë target; poster; sign
i pajísur endowed; equipped
thjeshtësí simplicity
zemërgjerësí big-heartedness; generosity
pa u dúkur without showing off
hesht stay silent

thelb core; kernel
heq dórë renounce
néjse no matter
acarí bitter, dry cold
po e po for sure; without a doubt
qërój clear
kaçúbë shrub; bush
dynym 1,000 square meters
çilízmë deep plowing
patáte potato
grádë degree
rrëmbýen (rrëmbéj) grabbed
kosóre scythe
tinëzár stealthy
sëmúndje disease
kësí this kind of
kalá fortress
gjoks chest
fërkój rub
kavájas person of Kavaja city
njësí unit
ngurój hesitate
çántë bag; briefcase
rrugícë path
i stërbárdhur whtiened
i lýer painted
pipëtíj stir; make a sound
zborák finch
bishtlármë dappled tail
cicërój chirp
údhëzë way; small trail
gjarpërój slither; wind like a snake
rrëshqás slip
se si somehow
kap grasp

skaj rim; edge
i hutúar dumbfounded
afsh draft
pështjéll wrap up; envelop
frigorifér refrigerator
thíkë knife; extremely sharp
bínte thíkë përpósh was a sheer drop
ngatërrój mix up
e kalúam dhe rrugícën we made our way to the end of the path
pllájë slope
i zhvéshur barren; naked
prapaník backward
gjakftóhtë cold-blooded; composed
shaj offend
fishkëllím whistling; hissing
i çjérrë hoarse; torn
sa nuk na rrëmbéu almost blew us away
furtúnë blizzard; storm
hidh kémbët push onward
i vérbër blind
shurdh deaf
si t'i téket asáj according to its mood
përláj obliterate
i gatúar molded
përbérje composition
pres cut off
çengél hook

stuhí storm
shurdhój deafen
gumëzhímë roar; clatter; rumble
agullój cloud
qepállë eyelash
i përqëndrúar steady; concentrated
disí somewhat
zhúrmë noise
orték avalanche; landslide
shkëpút tear off; pluck
rréshmë avalanche
palós engulf; flatten
mbërrí,j arrive
i përhímtë ashen
mërmërís mumble
kapótë overcoat
i mérreshin këmbët his feet wobbled
dërrásë plank; board; slate
boll plenty
pópla gúri cobblestones
mbështólli (mbështjéll) wrapped up
pecé piece of cloth
pútër sole (of foot)
me mish e me shpirt body and soul
dëm damage; harm
qull drenched
prush live coal; ember
kutí can
konsérvë canned foodstuff
shëróhem get well

LEXIMI I DYZETETETE

Burri i Vogël

'Do të mbledhim kamomil" thotë mësuesja kujdestare. Aksion është ky? Shpërndahesh fushës apo brigjeve dhe, duke kënduar tra-la-la, si fëmijët e kopshteve, këput lule kamomili dhe mbush qesen. Hera-herës rend me vrap te mësuesja për t'i treguar se sa shumë ke mbledhur. Ajo, vëren qesen, gjoja e habitur, vë buzën në gaz dhe përtyp nëpër dhëmbë një lëvdatë të zakonshme... Jo, mor shok, ky s'është aksion, ky është çilimillëk! Për kë duhet kamomili? Për fëmijët? Bukur fare! Atëhere le të venë vetë fëmijët e ta mbledhin! Kështu po, kështu merret vesh, po mos ejani të më thoni se të mbledhësh kamomil, hithër apo sherbelë është një aksion njësoj si të shkosh me brigadën e të hapësh taraca në kodër! Asaj, po, asaj i them punë unë, jo shaka! Shkon njeriu, përvesh llërët, rrok kazmën apo shatën, shkul më parë shqopën dhe ferrat që kanë mbuluar tërë faqen e kodrës, pastaj, vap e vup, jepi për të hapur taracat. Agronomin apo gjeometrin e ke aty, te koka, dhe të mat punën, të thotë se sa e ke plotësuar normën ti, duke fshirë djersën, po djersë tamam ama! Dëgjon e kënaqesh. Kurse këtu na mbledhin si çiliminj e na ngarkojnë me nga një punë të vogël, që të mos sorollatemi rrugëve e të na shkelë ndonjë automobil apo të rrëzohemi nga ndonjë pemë a mur.

Kështu mendon Fatmiri, ndërsa klasa mblidhet në oborrin e shkollës, nga do të niset për të mbledhur kamomil.

Është i shkurtër në shtat, i mbushur në trup dhe në kokën e madhe flokët, megjithëse mundohet t'i mbajë të krehura dhe herë pas here i lag me ujë, vazhdimisht i ngrihen përpjetë si gjëmba iriqi. Në mësime është i mirë, nuk shquan, bile as kërkon të shquajë se, me sa duket, e quan si çilimillëk edhe përpjekjen për të dalë i pari i klasës. Vetëm se në përgjigje apo biseda të ndryshme, është, padyshim, më i pjekur nga të gjithë të tjerët. Gjer në klasën e gjashtë ka qenë një nxënës që nuk linte dy gurë bashkë. Kishin gjetur belanë mësuesit, sidomos mësueset e reja, të cilat shpesh fjalët e tij të lëshuara pa kujdes, i merrnin me nënkuptime. Por unë e dija që në zemër ai, megjithëse e hiqte veten si burrë i pjekur, ishte fëmijë.

Me Fatmirin, me sa dukej, kish ndodhur një pjekje para kohe: ajo që të tjerëve u ndodh zakonisht në klasën e tetë, atij po i ndodhte në të gjashtën e të shtatën. Kjo dukej qartë. Shokët e tij më të mirë ishin ata të klasave më të larta, mundësisht maturantët. Futej midis tyre dhe bisedonte, si të ish vërsnik me ta. Merrte pjesë në mbledhjet, në mbrëmjet e tyre të vallëzimit dhe, si kavaljer, ishte i palodhur. Edhe librat i zgjidhte për moshë më të madhe. Ishte mjeshtër në mbajtjen e shënimeve-- i mjaftonte një fletore e vogël për gjithë vitin. Një ditë po diktoja një rregull morfologjik. Sapo e kisha shpjeguar. Ndërsa klasa vazhdonte të shkruante, ai diç shënoi me dy fjalë dhe pastaj ngriti kokën e po më shikonte. "Përse nuk shkruan?" i thashë me zë të ulët. "E kam shkruar të gjithë", m'u përgjegj. Hodha sytë në fletore: kishte të drejtë. Ndërsa nxënësit e tjerë vazhdonin të shkruanin, ai i kishte rënë shkurt me një "dhe anasjelltas".

Ditën e dytë, Fatmiri nuk vajti në shkollë. Mësuesja pyeti për të.

Dikush i tha se do të ishte sëmurë. Ajo i vuri mungesë dhe, me nxënësit e tjerë, u nis. Atë ditë i çoi fëmijët në lindje të shkëmbit të kalasë për të mbledhur hithra. Por mbas dite, në dhomën e saj, ku banonte së bashku me një shoqe, e zgjoi nga gjumi i drekës një e trokitur në derë. Tha se mos ishte ndonjë telegram nga Shkodra, ku kishte familjen, ndaj brofi në këmbë. Në derë qe një grua e skuqur dhe e djersitur nga dielli dhe të bariturit: nëna e Fatmiri .

--Nuk është në shtëpi?-- pyeti e habitur mësuesja.

--Jo,-- u përgjegj nëna. --Iku në mëngjes herët e nuk është kthyer akoma! Si tha këto, vuri dorën në faq dhe tundi kokën me dëshpërim.

* * * *

Një copë të rrugës e bëri në këmbë, se kamioni i Bardhit, që kryen shërbimin urban midis Krujës dhe Fushë-Krujës, nisej më vonë. Të priste, nuk donte.

U dha këmbëve. Për t'i rënë shkurt, u var poshtë, zbriti nga pas shtëpisë së pionierit, duke kaluar nëpër monopatin midis ullinjve, anës përroit, deri sa arriti afër shkollës tetëvjeçare "Xak Pengili". Në oborr kishin nisur të mblidhen nxënës.

Edhe pak, e do të dilte në rrugë. Po të rastiste ndonjë kamion, do t'i nxirrte krahun përpara e do ta ndalonte. Shoferët e njihnin, si bir shoferi që ishte, dhe kishin për ta marrë. Po sikur në ndonjë nga këta kamionë, për dreq, të ishte i ati? Këtë nuk e kishte menduar më parë, ndaj tani iu prenë gjunjët.

Vendosi të fshihej pas dyqanit ku, zakonisht, kamioni i Bardhit bënte ndalesën e parë dhe aty të priste. Nëse në kamion nuk do të ishte i ati, do të hipte. Vërtet që do të vonohej ca, po s'kishte ç'të bënte.

Tani qe ulur në karrocerinë e kamionit, duke u shtypur midis një plaku dhe një nuseje të re.

--Ku po shkon kështu, mor shejtan?-- e pyeti plaka përballë, që kishte në këmbë një thes të mbushur me ca gjëra të forta. Fatmirit, thesi i vriste gjunjët mbi të cilët ai kish mbështetur kapelën prej kashte.

--Në aksion po shkoj,-- u përgjegj djali dhe ktheu kokën nga ana tjetër, si për të thënë se me kaq biseda mori fund.

Plaka heshti, por pranë saj qe një ushtar me një fizarmonikë në krah, që i ra në sup, sikur ta kish mik të vjetër.

--Të lumtë, bre burrë!...-- i tha. --E shiko të dalësh sulmues!

--Sa për atë,-- foli prapë plaka, --s'duket të ketë vullnet për sulmues ky! Janë të tjerë ata...

Fatmiri u nxeh.

--Pse, si janë ata?-- u hodh e pyeti.

Plaka rregulloi thesin e ia pruri më pranë djalit, që e shtyu me inat.

--Ata,-- tha plaka, --kanë ditë që po punojnë atje...

Kamioni la pas kthesën e gërcores.

Në kodrën përballë, në të majtë të rrugës, u dukë vullnetarët. Të shpërndarë shpatit, po punonin në hapjen e taracave. Të gjithë kthyen kryet dhe i panë. Fatmiri e ndjeu me të vërtetë veten të vogël në sy të pasagjerëve, iu duk vetja si një përtac, që ua ka hedhur shokëve dhe tani po del i fundit në punë.

Kamioni u var poshtë duke gjarpëruar nëpër kthesa, deri sa qëndroi te Kroi i Fokës.

Bardhi nxori kokën nga kabina.

--Do të zbresë njeri këtu?-- pyeti.

* * * *

Vullnetarët e njohën që poshtë, në rrugë, kur ai u hodh nga kamioni. Të gjithë lanë punën e u kthyen nga ai, duke tundur kapelat, shamitë dhe e përshëndetën me zë të lartë mikun e tyre.

Fatmiri u ngashërye. Nga gëzimi, iu qep shpatit si një dhi e egër.

Kur arriti në taracën e parë, u përqafua me Gencin, një maturant, të cilit i qenë bërë duart me kallo nga kazma. Pastaj gati me të gjithë ç'qenë atje. Edhe me katër mësuesit. Edhe me gjeometrin, të cilin s'e njihte fare.

--Sa mirë bëre që erdhe!-- i thoshin.

--Ç'kemi andej?

Midis shokësh Farmiri e ndjente veten të qetë, në vendin që i përkiste. Jepte përgjigje majtas e djathtas, i sigurt, me fjalë të pakta, edhe kur thoshte gënjeshtër për të shpëtuar. Vera, komandantja e brigadës, pasi kaloi tërë entuziazmi i parë dhe të tjerët u shpërndanë përsëri në punë, e pyeti:

--Përse erdhe, Fatmir?

--Erdha të punoj me ju, të thashë njëherë.

--Vërtet thua?

--Vërtet. Përse?

--Po a e di njeri që ti ke ardhur këtu?

Nga kjo pyetje e vështirë, e shpëtoi Genci, i cili foli me të madhe:

--Vera,-- tha, --fute në punë që tani. Të na bjerë unë!

--Jo, u hodh Caja, një nxënëse e klasës së dhjetë, që punonte një taracë më lart. --Fatmiri të mbledhë sherbelën e asaj faqe'e atje, para se ta shkulim ne. Është gjynah të vejë dëm!

--Mirë thotë Caja, Vera!

Vera iu kthye Fatmirit.

--Mirë,-- i tha, --po sot do të punosh poshtë.

Fatmiri u hodh:

--Sherbelë nuk mbledh!

--Nuk do të mbledhësh sherbelë? Atëhere do të shkosh në Halilaj. E di rrugën?

--E gjej.

--Atje do të shkosh te Maja. Është dezhurne bashkë me nja tre të tjerë. Do të zëvendësosh Shpëtimin që është sëmurë. Kuptove?

--Kuptova. Po ç'punë do të bëj?

--Ta cakton Maja.

Në fshatin Halilaj, njëzet minuta larg vendit të punës, vullnetarët kishin mensën dhe fjetoren. Fatmiri arriti kollaj. Në oborrin e shkollës kishin ndërtuar një tendë me fier dhe atje hanin vullnetarët. As në shkollë, as në tendë s'kish njeri, por pas ca gëmushave dëgjoheshin tringëllima enësh. Djali bëri me tutje dhe atëhere, pranë një çezme me dy fyta, nën hien e një plepi me trup të përcëlluar nga rrufeja, pa Majën, që po lante enët.

--Maja!-- i foli.

Maja ngriti kokën dhe i buzëqeshi. Kur ndenji pranë saj, ajo i shpjegoi se ku hanin shokët, ku flinin (në një kasolle të gjatë, që andej nuk dukej) dhe se dezhurnët e tjerë kishin vajtur, bashkë me guzhinierin, të merrnin ushqimin e ditës.

Fatmiri dëgjonte. Në të vërtetë nuk ua kishte vënë shumë veshin fjalëve të saja. Shikonte ato pjata e tasa prej alumini--plot njëqind e pesëdhjetë copë, siç i tha Maja, dhe habitej se si ajo, që kish qenë maturante e shkëlqyer, e kishte ulur veten sa të lante enët.

--E kështu, Fatmir,-- i tha Maja, --erdhe të punosh me ne!

--Po,-- u gjegj djali. --Dhe për sot, Vera më dërgoi tek ti.

--Ashtu? Shumë mirë ka bërë. Do të punojmë bashkë.

Fatmiri u hodh:

--Ç'punë do të bëj?

--Ç'punë do të bësh?-- Maja i tregoi enët. --Ja, do të më ndihmosh mua, që të mbarojmë shpejt!

Fatmiri brofi në këmbë.

--Të laj enët?-- ia bëri dhe vrenjti ballin.

--E përse jo?

--Sepse unë po habitem edhe me ty!... Kam ardhur këtu të bëj punë e jo të merrem me... me... çikërrima!

Maja vuri buzën në gaz.

--Puna është punë kurdoherë,-- i tha. --S'ka punë të madhe e punë të vogël, ka vetëm punë. Këtu kështu punojnë të gjithë.

Fatmiri heshti. Këtyre fjalëve nuk dinte si t'u kundërshtonte. Mendoi një çast t'i thoshte se ai kishte ardhur të bënte punë burrash e jo punë grash, por e bëri gjuhën zap, sepse të tilla fjalë i kish dëgjuar shpesh nga Dulle Dembeli, që sorollatej pazarit. Sidoqoftë, një gjë ishte e sigurt: atje lart, në taraca, do ta caktonin të barte ujë ose të mblidhte sherbelë, kurse këtu poshtë, Maja po e vinte të lante enët!

--Ulu aty, Fatmir,-- i tha Maja me një zë të qetë, sikur të ishte plotësisht e sigurt që djali do të bindej. --Ulu aty dhe spastroi enët nga mbeturinat e ushqimeve. Mbeturinat, ki kujdes, mblidhi në një tas, që të mos përhapen djathtas e majtas, se gjejmë belanë nga mizat.

Fatmiri dëgjonte dhe s'dinte ç'të bënte.

--Në fillim,-- vazhdoi Maja, --dy ditët e para, kishim shumë miza, por erdhën dhe e spërkatën vendin me ilaç, tendën, muret e shkollës, fjetoren tonë,-- po ulu, Fatmir, --tani mizat janë zhdukur. Mjafton të mbështetet miza në murin e spërkatur, e bie në çast e ngordhur përtokë! Kaq ilaç i fortë është!

Kur erdhën dezhurnët që kishin ndihmuar kuzhinierin për të marrë ushqimet, Fatmirin e gjetën duke shpërlarë pjatat e fundit.

Pas buke, ranë të flenë.

Fatmiri u shtri në vendin që i kishin caktuar, pranë Gencit. Nuk flinte. Mendime të ndryshme i vërshonin në kokë. Tani që po e shikonte me sy të ftohtë atë që kish bërë, vinte re se punët nuk qëndronin aspak ashtu siç i kish menduar këtu e ca orë më parë, kur ish larguar nga Kruja. Aty ku kish ardhur, në brigadën "Skënderbeg", ishte mirë; ai e dinte që duke punuar e duke jetuar së bashku me shokët e tij më të ngushtë, do të kënaqej. Por kur kërkonte të gjente shkakun e vërtetë të ikjes së tij nga shokët, që

kishin mbetur në Krujë për të mbledhur kamomil, hithër dhe sherbelë, atëhere ndjente në zemër një darë të ftohtë që nuk e linte të qetë. Si nuk i kish rënë në mend më parë që puna është punë kudo, se, ashtu siç thoshte Maja, nuk ka punë të mëdha e punë të vogla, por ka vetëm punë? Po gënjeshtrat që kish thënë? Kushedi sa do të jenë shqetësuar në shtëpi! Ja, nga këto gjëra ai duket se është akoma çilimi, megjithëse e heq veten burrë! Ikën nga Kruja fshehurazi, nuk i thotë asnjeriu në shtëpi apo në shkollë se ç'ka ndër mend të bëjë, gënjen shokët në aksion dhe tani është shtrirë aty si guak, si t'i kishte të gjitha në rregull! Pse kështu bëjnë burrat?

I nxehur me veten, u ngrit ndenjur.

--Ç'ke?-- e pyeti Genci që hapi sytë pranë tij.

--Asgjë!-- ia ktheu Fatmiri dhe u shtri prapë.

Por, pas pak, si pa që të gjithë po flinin qark tij dhe se Genci po gërhiste, u ngrit ngadalë, mori kapelën prej kashte dhe doli jashtë.

Në sheshin e madh përpara fjetores, në majë të shtyllës valavitej flamuri. Fatmiri hodhi vështrimin rrotull, si për të mbërthyer në kujtesë atë pamje. U drejtua më të djathtë, nga flinin vajzat. Donte të bisedonte me Verën. Në qoftë se nga Kruja kish ikur pa i thënë njeriu, këtu nuk donte ta përsëriste këtë gjë.

--Kam bërë një marrëzi,-- i tha asaj me zë të ulët dhe zbrazi tërë brengën e zemrës.

--Do të ikësh që tani?-- e pyeti Vera.

--Që tani. Më vjen turp të rri akoma këtu. Me shokët rregulloje vetë: u thuaj se nuk kisha ardhur për të ndenjur, por vetëm për t'i parë, ose si të duash ndryshe. Ose u thuaj të vërtetën. --Heshti një hop e pastaj vazhdoi: --Më mirë thuaju të vërtetën.

Vera u ngrit dhe zbriti me të kodrën. Kaluan mensën, kaluan nëpër shtegun e mbushur me manaferra, që nxinin nga të dy anët, kaluan midis shtëpive të fshatit dhe, kur dolën në breg, panë së largu kamionin e Bardhit që vinte nga Fushë-Kruja.

--Ika,-- tha Fatmiri dhe ia dha vrapit ta zinte kamionin te Kroi i Fokës.

Komandantja e brigadës e pa që hipi në kamion.

Kur makina u nis, ai hoqi kapelën dhe u ngrit në këmbë. Vera ishte atje akoma. Ai tundi kapelën për ta përshëndetur dhe ashtu vazhdoi deri sa kamioni mori kthesën...

Gjergj Zheji, "Burri i vogël," Tregime të zgjedhura (Tiranë), Biblioteka e rinisë, 1967, pp. 153-161.

kamomíl chamomile
kujdestár manager; person-in-charge
aksión work project
fëmíjët e kópshteve kindergarten kids
gjója supposedly
çilimillëk child's play; childishness
kë whom
híthër thistle
sherbélë sage
llërë forearm
përvésh llërët roll up the sleeves
shqópë heather
vap e vup this and that; quickly; with resolve
te kóka on hand
mat measure; estimate
tamám real
amá (intensifier)
çilimínj kids
i vógël small
sorollátem loiter
iríq hedgehog; porcupine
mësím lesson
shqúaj stand out
belá bother; trouble
nënkuptím implication; inference
pjékje maturity
mundësísht if possible; more likely
maturánt senior; graduating student
vërsník of the same age
vallëzím dancing
shëním note
sápo just
anasjélltas vice versa

mungésë absence
i djersítur sweaty; sweated up
dëshpërím distress
u dha kémbëve he started off
Për t'i...póshtë he took a shortcut
and headed downward
pioniér pioneer (member of a youth group)
monopát short-cut trail
shofér chauffeur
për dreq as ill luck would have it
ndalésë stop
vonój delay
karrocerí carriage; truck bed
shejtán devil
përballë across from
i fórtë hard; strong
kapélë hat
káshtë straw
fizarmoníkë accordion
sulmúes outstanding worker
prúra brought (past only)
kthésë turn; bend
gurór rocky
vullnetár volunteer
pasagjér passenger
përtác lazy person
ua ka hédhur has put one over

ngashëróhem become moved, emotional
gáti nearly; practically
përkás belong
gënjéshtër lie
me të mádhe with authority; self-assurance
të véjë dëm go to waste
dezhurné kitchen helper
ménsë mess hall
fjetóre dormitory
téndë tent
fiér fern
tringëllím tinkling
çézmë fountain
rrufé thunderbolt

guzhiniér cook
pjátë plate
tas cup; bowl
u gjegj = u përgjégj answered
çikërríma odds and ends
e bëri gjúhën zap he held his tongue
Dúllë Dembéli Lazy Dulle
sorollátem loiter; loaf
spastrój wash up; clean
spërkát spray
iláç medicine; solution
shpërláj rinse; sprinkle
largóhem depart
íkje departure

dárë pliers
e heq véten he pretends to be
fshéhurazi secretly
guák dope
gërhás snore
valavítet waves
në góftë se although; if
marrëzí crazy thing; madness
zbras empty; pour out
brëngë remorse
që taní right away
manaférrë berry bush

LEXIMI I DYZETENENTE

Çupa Më e Vogël

Hasan Kurtit i kishte mbetur peronë në zemër që nuk kishte mundur të bënte dot djalë. E shoqja i kishte lindur dy herë, dhe për fat të keq, të dy herët çupa. Kush i kish fajet? Domosdo e shoqja, që s'bënte dot djalë, nga që, siç thosh Hasani, e kishte mesin shumë të ngushtë.

Mbrëmavet, shtruar këmbëkryq pranë oxhakut, bënte ç'bënte dhe e hidhte fjalën për fëmijët.

--Si do të pleqërohemi, moj grua?-- e pyeste i menduar. --Kush do të na mbajë? Hë! si thua ti?

--Si të të them dhe unë e mjera,-- i jepte zemër Sanija --se mos ata që kanë djem kanë ndenjur nën hije?-- Një copë herë ajo nuk fliste, pastaj shtonte si duke folur me vete të saj: --Fëmijët po s'u bënë të hairit, më mirë të mos bëhen fare.

Dhe ky avaz përsëritej, të paktën tri herë në javë.

Po Hasani mendonte ndryshe: "Më tjetër është shtëpia kur ka djalë brenda. Djali është ai që mbush shtëpinë. Çupa, nderin e ka në derë të burrit."

U hidhte një sy fëmijëve dhe përsëri binte në të thella e pinte duhan.

Dy çupat e tij, Tefta dhe Lirika, punonin mënjanë pa bërë zë. E dëgjonin të jatin dhe diç pëshpërisnin vesh më vesh. Pastaj Lirika i thoshte:

--Do të të mbaj unë ty, baba, kur të plakesh!

--Ah! jo, moj bij e babait, jo. Ti do të martohesh dhe unë do të mbetem vetëm me mamanë.

--Jo, unë nuk martohem-- ia kthente Lirika e vogël dhe e padjallëzuar. --Unë do të rri me ty!

Hasani qeshte nën mustaqe dhe i përkëdhelte flokët Lirikës. Ajo atëhere ishte e vogël, mësonte në shkollën 7-vjeçare dhe qe nga nxënëset më të dalluara. Sa e urtë dhe e përmbajtur ishte Tefta, aq terse ishte Lirika. Me të hyrë në shtëpi ajo, fillonte të këndonte, të qeshte e të fliste, sa që gjithë shtëpia gjallërohej. Hasanit i bëhej qejfi tek e shihte ashtu të hedhur si djalë dhe i pikëlluar thoshte me veten e tij:

--Ti u nise për djalë, moj thëllëzë e babait, po jot' ëmë të ktheu e të bëri çupë!

Atëhere kur Lirika mbaroi shkollën 7-vjeçare Hasani mendoi:

"Mjaft vajti në shkollë; tani le të fillojë të mësojë nga punët e shtëpisë".

Po Lirikës ia kishte ënda shkollën, sepse me mësime kishte dalë fare mirë dhe të gjithë i kishin thënë se duhej të vinte edhe në shkollat më të larta. Filloi t'ia thoshte mendimet e saj të jatit. Ndonjëherë në mbrëmje, të lodhur nga puna e rëndë e beharit, kur rrinin në oborr, ajo, si duke folur me vete të saj, thoshte:

--Babai s'më do mua...-- dhe ngrinte kokën dhe i vështronte drejt në sy.

Të jatit i vinte rëndë nga këto fjalë. Veç kësaj, ai, thellë në zemër, e donte shumë atë vajzë dhe mendonte: "Nga që e dua shumë, s'më vjen mirë ta kem larg."

--Unë të dua shumë, moj bij' e babait, se të kam evlat!-- ia kthente

Hasani dhe psherëtinte duke shkuar kurrizin e dorës pas mustaqeve kaleshe; pastaj, duke hedhur vështrimin nëpër pemët e oborrit, i thoshte: --Po si të të lëshojmë nga duart? Ne ty të kemi gëzimin e shtëpisë!

Lirika mendohej dhe e menduar shkonte të flinte.

Kur erdhi shtatori shoqet e Lirikës shkuan në shkollë, të gëzuara, të qeshura, duke marrë me mend jetën plot zhurmë të qyteteve, kurse ajo mbeti në fshat. I kishte dalë bursa për në shkollën e mesme, po Hasani kishte ngulur këmbë dhe e kishte mbajtur në shtëpi.

Pas punës së madhe të korrjevet e të shirjevet, fshatarët do të çlodheshin për pak kohë, deri sa të fillonte përsëri puna jashtë, për mbledhjen e groshëve, të kungujvet dhe për vjeljen e misravet.

Lirika rrinte brenda. I ndihmonte së ëmës në punë të ndryshme pa e shkuar ndër mend shkollën, për të cilën pandehte se i ishte prerë rruga përgjithmonë...Motra e madhe ishte fejuar në fshat dhe përgatitej për dasmë. Atë verë Tefta nuk punoi përjashta, që të mos e nxinte dielli, se në vjeshtë të tretë do të nisej nuse.

Jeta rridhte e qetë në familjen e vogël të Hasan Kurtit dhe sigurisht do të vazhdonte kështu kushedi dhe për sa kohë, sikur të mos kishte ardhur nga ushtria një nip i Hasanit, një djalë trupmadh, i lidhur mirë, me fytyrë të nxirë prej diellit dhe me sy të qeshur. Si bisedoi me Hasanin për punët e bujqësisë dhe të gjësë së gjallë e pyeti:

--Po Lirikën pse s'e ke dërguar në shkollë?

Si t'i përgjigjej Hasani? Si t'ia mbushte mendjen? T'i thoshte që nuk mund ta lëshonte çupën nga duart aq kollaj? Ai do t'i përgjigjej: -- "Eh! bre xha Hasan, në vend që të shkosh përpara po ecën prapa. Po a nuk ishe ti, që bashkë me tim atë dhe me komunistët e tjerë të fshatit, mblidheshit dhe bisedonit, si do të ndryshohej jeta kur të çliroheshim nga pushtuesit, si do të jetonim me të drejta të barabarta, dhe tani, pse i hodhe prapa krahëve ato? Babanë tim e vranë ballistët, kurse ti, shyqyr, je shëndoshë e mirë me mall e me gjë, me tokën që ta dha reforma, pa më thuaj pse ua pret rrugën femijeve te tu?"

T'i thoshte që çupës së tij nuk i duhej shkolla, kish kush të vinte në shkollë? Ai përsëri do t'ia mbyllte gojën e do t'i përgjigjej: --"Qëmoti këtë nder të madh, për të vajtur nëpër shkolla, e kihsin vetëm fëmijët e bejlerëve dhe të pasanikëve, tani na erdhi radha neve; kurse ne, ja se ç'bëjmë: atëhere s'na linin ata, tani nuk duam vetë". E pra, as këtë nuk mund t'ia thoshte.

U mendua duke thëthitur thellë tymin e duhanit, pastaj i tha si nëpër dhëmbë:

--Po ja, more nipçe, duam ta kemi në shtëpi sa për një urdhëratë. Njëherë ujë të na mbushë aq mjafton...

--S'mendon mirë, xhaxha, mos i pre rrugën çupës, mos e merr më qafë duke e mbajtur në shtëpi. Ajo duhet të vejë në shkollë, të hapë sytë për vete të saj dhe për të tjerët. Ja, zëre se kishe vetëm një fëmijë, vetëm çupën e madhe, atëhere si do të bëje? Dhe tani ta kesh për nder që çupa jote do të vejë nëpër shkolla të mëdha. Pas ca vjetëve, kur të kthehet Lirika jote profesoreshë ose doktoreshë, tërë njerëzit do ta nderojnë e do të thonë: Nga ka dalë kjo çupë? Si lum i ati dhe e ëma që kanë të tillë fëmijë!

Hasanit ju bë qejfi. As nuk mund ta merrte me mend se si do të ishte ajo kohë, por një gjë dinte, se ato kohë do të ishin më të mira e më të

bukura, si për të, ashtu edhe për fëmijët e tij.

Po xhaxhai seç mendoi thellë në zemër dhe fytyra iu errësua e balli iu vrenjt. Po sikur çupa e tij të merrte rrugë të ligë larg prindërve dhe larg familjes?

--Ah, po e kam çupë dhe ja kam merakun, more nipçe! Zoti mos e dhëntë, merr rrugë të ligë, ku të mbytem unë pastaj? Se vërtet i varfër kam qenë, po nderin e kam pasur.

I nipi iu përgjegj aty për aty:

--Mos e ki atë frikë, xhaxha. Atje kujdesohen për to si prindër, dhe ca më mirë. E pse të marrë rrugë të shtrembër Lirika?

--E s'di si të të them!-- ia mbylli bisedën Hasani dhe u ngrit e iku në kopsht, sa për t'u gjendur në punë dhe sa për të humbur mendjen.

Atë natë mezi e zuri gjumi, gjer ndaj të gdhirë. U kthye e u rrotullua në shtrat, me merak në zemër e me mendje të prishur... S'ishte e lehtë për të të ndahej nga të dyja çupat përnjëherësh.

Të nesërmen në mëngjes, e shoqja, kur e pa me sy të ënjtur, e pyeti:

--Po ti, pse je bërë kështu, sikur ke ndenjur pa gjumë?

--S'kam gjë, jo! Për të fjetur fjeta mirë, po sikur më dhemb kjo djallo dhëmballë-- gënjeu Hasani dhe doli përjashta për të gjetur të nipin.

E gjeti dhe i tha:

--More mirë, sikur të vejë në shkollë, ta zëmë, po a do të mësojë dot kjo Lirika ime? Se vërtet këtu doli mirë dhe e mbanin në gojë për zgjuarsi, po andej a do t'ia dalë mbanë, se edhe mësimet s'do mend që janë më të rënda.

--Dëgjo këtu, xhaxha! Ajo që ka dalë mirë këtu, edhe andej do të dalë mirë; ta dish nga unë këtë gjë... Domethënë, t'u mbush mendja ta dërgosh Lirikën në shkollë, -së? Ashtu më rrofsh... po të di unë!...

Hasanit iu ngroh zemra, po deshi ta mbante veten.

--Jo, bre nipçe, s'thashë ashtu...

--Lëri ato. Thuaj më mirë kur do ta nisësh për në Tiranë.

--Me kë ta dërgoj në Tiranë? Unë s'kam nge të vete...

--Më ke mua ti-- i tha i nipi i gëzuar. --Vete unë e shpie Lirikën si mollë.

Hasan Kurtit i qeshi nuri.

--Ta ndezim njëherë!-- i tha të nipit dhe i zgjati kutinë e duhanit, duke vënë njërën dorë në zemër sipas zakonit.

Ato ditë që do të ikte Lirika, Hasani gjithmonë i fliste si të sillej me më të mëdhjenjtë dhe si të mësonte që të delte faqebardhë.

Dhe atë ditë kur e përcolli s'i mbajti dot lotët. Ata i riguan nëpër faqet e zeshkëta duke lënë vijëza të ndritshme.

--Dëgjo, Lirikë, ty të kam çupë, ty të kam djalë; ki mendjen të dalësh mirë me mësimet, të mos na turpërosh dhe të na shkruash letra për javë. Unë këtu do të jem, po mendjen andej nga ti do ta kem.

Atë ditë frynte erë. Hasani me Sanijen ndenjën buzë një are me misër duke shikuar të bijën që po u largohej për në ato vendet e largëta. Ndenjën atje deri sa e humbën nga sytë.

--Daltë faqebardhë!-- uroi Sanija, pa ne do të bëjmë si të bëjmë edhe pa të.

Hasani nuk foli.

Pas pesë vjetëve.

Lirika kishte mbaruar gjimnazin due kishte hyrë në klasë të parë të Institutit të lartë bujqësor. Fshati i Hasan Kurtit ishte bërë kooperativë. Atë pranverë Hasanin e kishte marrë malli për të bijën dhe po përgatitej të vinte në Tiranë.

Si mbaruan të mbjellat dhe si u ngroh mirë moti, Hasani u nis për në Tiranë, hipur mbi një kamion të zbuluar.

Ishte muaji i prillit, muaji më i bukur në Tiranë. Pas ndonjë shiu që binte, gjithë natyra dukej e larë dhe e pastër. Gjelbërimi i pemëve në shëtitoret dhe nëpër kopshtet të kënaqte sytë. Dhe në mbrëmje perëndimi i bukur dielli të çlodhte shpirtin.

Hasani arriti në mes të ditës në Tiranë. Shkonte nëpër rrugët e pastra e të gjera, i habitur nga lëvizjet e makinave dhe nga gjithë ata njerëz. Në fillim mendoi: "E ku ta gjej Lirikën në gjithë këtë popull?"

Rrobat prej shajaku të zi dhe kapela e leshtë i sillnin vapë Hasanit dhe veç këtyre mbante në kurriz dhe një palë hejbe të rënda.

Si u suall rrotull një copë herë duke shikuar shtëpitë shumëkatëshe dhe vitrinat e mbushura plot me mall, nxori nga xhepi një zarg, dhe policit të parë që gjeti në rrugë i tha si me ndrojtje e duke shpënë buzën në gaz:

--O shok-o, të lutem, në ka mundësi, të më tregosh nga bie kjo shkolla që shkruan ky zarfi. Kam time bijë dhe dua ta takoj, se kam ardhur që nga fshati.

Polici i tregoi me dorë. --Merr këtë rrugë dhe të shpie vetë...

Hasani me të pyetur e gjeti Institutin bujqësor.

Sa shkarkoi hejben, ia filloi bisedës me portierin.

--E njeh ti, një Lirikë, Lirikë?

--Për cilën thua? Për Lirikë Kurtin-a? e pyeti portieri duke hequr nga goja një çibuk të vjetëruar.

--Hë! Për atë!-- i tha Hasani si i shkarkuar nga një barrë e padukshme.

--Poo, këtu e kemi-- i tha portieri. --Është një vajzë ajo, që nuk e ka shoqen.

Hasanit ju bë qejfi që një i huaj fliste për të bijën ato fjalë aq të mira.

Ai i hodhi një sy shkollës, pastaj u fut në sallon dhe filloi të shikonte me vërejtje gazetat e murit, tablot e ndryshme dhe në një vend i zuri syri edhe fotografinë e së bijës. Përse ta kishin vënë atje, vallë? Ç'kishte bërë e bija e tij? U kthye te portieri dhe e pyeti:

--Po ato fotografite atje pse i kane vene?

--Atje vënë ata që mësojnë më shumë-- i shpjegoi portieri.

--Aha, kështu! Dhe unë thashë pse t'i kenë vënë atje!

Hasani u kollit njëherë i kënaqur. Çupa e tij jo vetëm që s'ie kishte nxirë faqen, por ishte edhe nga më të dalluarat.

--Kur dalin nga mësimi këta?-- e pyeti portierin. --Në ka mundësi thuaji asaj Lirikës të dalë.

--Ja, tani për një çerek ore dalin.

Në atë çerek ore Hasani shkoi ndër mend tërë jetën e tij plot vuajtje. Të pakta kishin qenë çastet e gëzimit, dhe kjo dita e sotme ndofta ishte një nga më të mirat.

"Se, kush e bëri atë çupë që mbajnë bota nëpër gojë?-- mendonte Hasani. --Kush e rriti? Unë! Unë jam babai i saj".

Kur i thanë Lirikës se i kishte ardhur i jati, fluturoi nga gëzimi dhe u vërsul përjashta; ju hodh të jatit në qafë dhe i puthi me dashuri ato faqet e ashpëra prej punës, si atëhere kur ishte e vogël.

Hasani pëshpëriste i lumtur:

--Të lumtë, bijë e babait, të lumtë! Na nderove, na zbardhe faqen-- dhe ishte kaq i ngashëryer sa dukej sikur do t'i shpëtonin lotët.

Edhe shoqet e Lirikës e rrethuan xha Hasanin me dashuri dhe filluan t'i tregonin se sa shumë e donin Lirikën. Ato e pyetën edhe për fshatin.

--Tani kemi kooperativë, kemi filluar dhe ne të shikojmë si është jeta dhe si duhet rrojtur,-- u thoshte me mburrje xha Hasani.

--Edhe ne, nëpër fshatra do të punojmë, nëpër kooperativa, nëpër ferma, sepse për ato, po mësojmë në shkollë.

--E di, moj bijë, e di; më rrofshi ju...

Një ditë, kur shkonin rrugës, Hasani i tha së bijës:

--Si nuk humbisni ju në tërë këto rrugë! Ja, në vend të marrësh këtë këtu (Hasani tregonte me gisht) merr atë tjetrën dhe hajde pastaj ta gjesh shtëpinë.

--Në fillim edhe unë nuk i dija dhe kisha frikë të largohesha nga konvikti, por tani u mësova. Edhe ti, po të rrish këtu, do t'i mësosh-- i tha Lirika.

--Jo, jo, unë s'bëj dot këtu-- ia ktheu Hasani duke qeshur. Mirë jam atje në fshat unë. Do të më vish dhe ti agronome dhe atëhere ku do të ketë më të lumtur se Hasan Kurti?

Shikonte dhe mendonte: "Çudi, ç'ditë arritëm! Tani u bënë njësoj si çupat edhe djemtë. Me të tilla çupa s'ke merak për pleqërinë."

* * *

Pas pesë ditësh Hasani u kthye në fshat. Dielli po perëndonte duke lëshuar rreze të kuqerremta; era e mbrëmjes përkulte bimëzat e holla të grunjërave dhe së largu dëgjoheshin të lehurat e qenve... Përpara oborrit të shtëpisë disa shqerra po luanin duke kërcyer përpjetë. Hasani i futi në vathë, pastaj u drejtua për në shtëpi.

Sa shkeli pragun i thërriti Sanijes:

--Tani njësoj janë si çupat si djemtë!-- Dhe i tregoi ç'kishte parë e ç'kishte dëgjuar në Tiranë.

"Çupa më e vogël," Naum Prifti, Tregime të zgjedhura (Tiranë), 1972, pp. 12-19.

perónë nail
faj blame; fault
oxhák fireplace
plegëróhem spend old age
rri nën híje be sitting pretty
haír well-being; success
avváz habit; custom
pi duhán smoke
mënjánë aside
pëshpërís whisper
i padjallëzúar innocent
ters spirited
thëllëzë pheasant
ka ënda like; be pleased by
behár summer
i vínte rëndë was hurt, upset
evlát child
të kam evlát you are my child

psherëtíj sigh
kurríz back
kalésh bushy and black
shtatór September
búrsë scholarship
kórrje reaping
shírje threshing
gróshë bean
kúngull pumpkin
vjélje harvesting
mísër corn
vjéshtë e trétë = nëntór November
i lídhur mírë well built
gjë e gjállë livestock
i barabártë equal
shyqýr thank heavens
me mall e me gjë prosperous
ia pres rrúgën hold (her) back; block (her) path
kish kush...shkóllë school was for others
qëmóti in the old days
pasaník wealthy person
thëthít suck; draw
urdhërátë housemaid; helping hand
xha = xhaxhá uncle
mos e merr me qáfë don't ruin her life
zére imagine; suppose
lum blessed

seç somehow
atý për atý right away
i shtrémbër crooked
me méndje të príshur troubled
përnjëhérësh at the same time; at once
dhëmbállë molar
ta zémë let's say
zgjuarsí intelligence; cleverness
s'do mend it's understood
lëri ató come on!
nge time
nur appearance; look
ta ndézim njëhérë let's light one up
kutí box; package
më të mëdhénjtë those older
dáltë faqebárdhë may she do well
përcólli (përcjéll) saw off
rigón drips
i zéshkët swarthy; dark
víjëzë streamlet
për jávë every week
po méndjen...kem but my mind will be with you
árë field
urój wish well

gjimnáz junior college
te mbjéllat the planting season
mot year
múaj month
shëtitóre strolling path
perëndím setting
shaják thick flannel
vápë heat; summer heat
hejbé saddlebag
u súall rrótull he wandered around
shumëkátësh multi-storied
vitrínë display window
zarf envelope
políc policeman
ndrójtje hesitation
nga bíe where; in which direction
shkarkój unload
portiér gatekeeper
çibúk pipe
i vjetërúar old
bárrë burden
i padúkshëm invisible
sallón waiting room; parlor
tabló picture

i áshpër tough; rough
i ngashërýer moved; touched
të shikójmë...rrójtur to see what life is like and how it should be lived
férmë farm
hájde...shtëpínë how will you find your home, then
konvíkt boarding school
agronóm agronomist
i kuqerrémtë reddish
përkúl bend
bímëzë small plant
grúnjëra cereals; crops
të léhurat the barkings
njësój the same

LEXIMI I PESEDHJETE

Kostandin Kristoforidhi (1830-1895)

Detyrat e mëdha që i shtroi vetes Rilindja në punën me gjuhën, gjetën te Kristoforidhi një punonjës fort të zotin. Bashkëkohësit atë e quajnë "baba të shqipes". Kristoforidhi lindi në Elbasan, në familjen e një argjendari. Mësimet e para i bëri në shkollën greqishte të qytetit të lindjes dhe ato të mesme në gjimnazin Zosimea të Janinës (1847-1850). Këtu mori një kulturë të mirë klasike, mësoi latinishten e greqishten e vjetër, pak frëngjisht e italisht. Në Janinë Kristoforidhi u njoh me shkencëtarin gjerman Hahn, i cili u ishte vënë studimeve të tij të rëndësishëm mbi historinë, jetën, zakonet dhe gjuhën e popullit tonë. Hahnit, Kristoforidhi i shërbeu si mësues i shqipes; me të shëtiti vise të ndryshme të Shqipërisë e i dha lëndë gjuhësore elbasanase. Bashkëpunimin me Hahnin, ai e vështronte më vonë si fillimin e veprimtarisë së tij për shqipen.

Kristoforidhi plotësoi mësimet e mesme në një seminar të Maltës, qe pak kohë mësues në Tiranë dhe ndoqi studimet e larta ne Angli. Pas këtyre studimeve, më 1859 e shohim mësues në një shkollë gjysmë të mesme greqishte të Tunisit, ku ndenji pesë vjet dhe ku u martua me një greke. Atëhere, iu vu përkthimit të Dhiatës së re në shqip.

Më 1864 Kristoforidhi hyri në shërbim të Shoqërisë Biblike angleze dhe bëri gati për të një pjesë të Dhiatës së re, të cilën e botoi pastaj në Stamboll, nën titullin "Katër ungjillat edhe punët e apostuivet" (1866) në dialektin verior. Libri pat një jehonë të mirë në Shqipëri e ndër kolonitë shqiptare e arbëreshe. Kristoforidhi nisi të bëjë emër si lërues i shqipes. Ai përktheu dhe botoi Dhiatën e re (gegërisht më 1872, toskërisht më 1879), disa pjesë të Dhiatës së vjetër (vetëm toskërisht 1880-1884), si dhe nja dy libra për mësimin e fesë. Kristoforidhi e bëri këtë punë, duke u vënë në kontakt jo vetëm me botimet e mëparshme shqipe, po duke shëtitur edhe Shqipërinë, për të mësuar dialektet e të folmet e gjuhës nga vetë goja e popullit. Ai u familjarizua kështu me të dy dialektet e shqipes dhe diçka me të folmen arbëreshe, botoi "Gramatikën" (1882) dhe hartoi "Fjalorin" shqip-greqisht, që u botua pas vdekjes së autorit (1904).

Puna e Kristoforidhit për gjuhën, idetë patriotike që e frymëzonin, e bënë që të marrë pjesë herët në lëvizjen tonë kombëtare. Me të arritur në Stamboll, më 1864, ai u njoh me Vaso Pashën, Ismail Qemalin e patriotë të tjerë, me të cilët rrahu çështjen e një alfabeti të përbashkët të shqipes dhe të themelimit të një shoqërie kulturore. Këto përpjekje i vazhdoi disaherë më vonë, në Stamboll dhe në Shqipëri, po pa sukses.

Ai vdiq më 1895 nga një sëmundje e rëndë, në varfëri të plotë, shumë i nderuar e i dashur nga populli.

Kristoforidhi e nisi veprimtarinë letrare me përkthimin e librave kishëtare. Kjo punë ishte një hap drejt krijimit të kishës shqipe që rilindësit e patën në programin e tyre. Përkthimet e librave fetare shqip bënin një punë të mirë për shkëputjen e të krishterëve shqiptarë nga ndikimi antikombëtar i klerit të huaj. Kisha katolike e veçanërisht ajo ortodokse greke, librat e Kristoforidhit i luftoi tërë kohën. Megjithatë, librat e tij u përhapën mirë, sidomos në Shqipëri të mesme dhe të jugut. Ato ndihmuan

në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjuhës së re letrare shqipe.

Me përkthimet e tij, Kristoforidhit iu desh të bëjë një përpjekje jo të vogël gjuhësore, në një kohë kur shqipja s'kishte fituar akoma shumë shkathtësi si gjuhë shkrimi. Ai nuk punoi vetëm për një shqipe të pastër e të pasur, po iu desh të përballojë edhe kërkesa të veçanta stili e paraqitnin ungjijtë. Një krahasim i thjeshtë midis përkthimeve të tij dhe të Meksit me shokë, tregon përparimin e madh që ka bërë shqipja letrare në më pak se një gjysmë shekulli. Kristoforidhi, duke i ndenjur besnik origjinalit, pa u skllavëruar prej tij, ka mundur zakonisht të shkruajë një shqipe më të zhdërvjellët e më të vetëvetishme, duke ruajtur mirë edhe frymën e stilit biblik. Sigurisht këtë s'e arrin gjithkund njësoj, po kemi një përparim të vazhdueshëm në punën e tij që nga përkthimet e para. Një përpjekje artistike për të vënë re, ai e bëri te Psallmet e Davidit. Përkthimet e Kristoforidhit janë fillimi i prozës shqipe të Rilindjes, i një proze të shëndoshë, të shkruar në bazë të kritereve të reja mbi gjuhën.

Kristoforidhi është një nga botuesit e abetareve të para shqipe, pas Veqilharxhit. Abetarja e tij (1872) qe një mjet i përhapjes së shkrimit të shqipes. Aty gjejmë edhe disa proza të shkurtëra për të vegjlit. Kristoforidhi hartoi edhe një kozmografi e një "Jetëshkronjë të Gutenbergut", shenjat e punës që kishte nisur për hartimin e teksteve shkollore. Ai shkroi veçanërisht një si tregim të vogël, "Gjahun e malësorëve" (1884), në të dy dialektet, vepër që shquhet për gjuhën e saj të bukur e të pasur e që frymëzohet nga ndjenjat kombëtare: aty autori ngre lart të kaluarën e popullit tonë e i fton shqiptarët të bashkohen kundër pushtuesit turk. Me shkrimet e tij shkollore, Kristoforidhi është një ndër iniciatorët e një letërsie shqipe për fëmijë në shekullin XIX.

Veprat kryesore origjinale të Kristoforidhit janë "Gramatika" dhe "Fjalori".

Kristoforidhi shkroi gramatikën e dialektit jugor. Vepra e tij, e hartuar e eqisht, ka më shumë karakterin e një studimi. Ajo është e pasur në materiale dhe vërejtje gjuhësore dhe është në vazhdën e punimeve më të mira të llojit në shekullin e kaluar.

Fjalori i Kristoforidhit qe një nga veprat më të rëndësishme të Rilindjes e të gjuhësisë shqiptare. Më 1882 autori e kishte gati për botim, po duke mos e vënë dot në shtyp, ai e përpunoi dhe e pasuroi vazhdimisht gjersa vdiq. Kristoforidhi e hartoi shqip-greqisht, që të mundë t'ua caktojë më me siguri kuptimin fjalëve.

* * * *

Një Komb--Një Gjuhë Letrare

Rruga e vështirë që ka kaluar kombi shqiptar, është e njohur kaherë, duke filluar prej kohës kur ishte popull, emth. komb në mundësi, e përfundimisht me kohën kur kombi ynë formohet dhe zhvillohet gjithnjë e më tepër. Gjuha shqipe, si një ndër veçoritë thelbore të qenies kombëtare shqiptare, ka historinë e vet të ndërlikuar, e cila më në fund, pas shumë e shumë

shekujsh, është kurorëzuar si gjuhë letrare kombëtare shqipe.

Tanimë, gjuha letrare kombëtare shqipe, të cilën e përdor kombi ëmë, është bërë imperativ kohe për të gjithë shqiptarët, kudo që ata jetojnë.

Ne shqiptarët nënvizojmë se jemi një komb; ne theksojmë se kemi një kulturë kombëtare; ne luftojmë për afirmimin e kulturës sonë kombëtare si të tërësishme edhe jashtë suazës së qenies sonë kombëtare. Ne në atmosferën demokratike postbrione kemi ngritur zërin dhe pamëdyshje kemi vënë në pah faktin se nuk ka kulturë kombësie dhe kulturë kombëtare, si dëshironin të na imponojnë forcat regresive dhe shoviniste, por ekziston për çdo popull, pra edhe për popullin shqiptar, një kulturë kombëtare, e cila nuk është e futur në lëvozhgën e vet e pa relacione me kulturat e tjera kombëtare, por me specificitete të veta dhe si pjesë përbërëse e kulturës ballkanike dhe evropiane.

Nëse këto të dhëna, që po vëmë në dukje, janë të vërteta dhe nuk kërkojnë koment të hollësishëm, atëhere vetë shqiptarët, pa marrë parasysh se ku jetojnë, kanë për detyrë që në mënyrë të paevitueshme dhe pa humbur kohë, të përdorin atë gjuhë letrare, atë drejtshkrim, që përdoret nga kombi ëmë. Në këtë gjë dilemë nuk duhet pasur, sepse çdo mendim i kundërt, me hir a me pahir, objektivisht është në dëm të progresit të qenies kombëtare shqiptare, të kulturës sonë kombëtare.

Ne jemi koshientë se në rrugën e përvetësimit të gjuhës letrare kombëtare ka pasur, ka dhe do të ketë vështirësi, por ato mund të kalohen. Ne, në këtë tubim, që në të vërtetë është çast historik, nuk e kemi për detyrë të profetizojmë lidhur me çështjen se kur do të përvetësohet edhe nga masat e gjera popullore letrarishtja, sepse këtu është në pyetje një problem, i cili duhet realizuar me kohë, madje këtë gjë nuk e kanë arritur plotësisht as popujt më të civilizuar të Evropës. Ne në këtë çast jemi mbledhur të deklarojmë botërisht se tani e tutje, duke respektuar në këtë rast edhe realitetin, do të përdorim po atë gjuhë letrare, po atë drejtshkrim që përdorin bashkëkombësit tanë në Shqipërinë socialiste. Sa më shpejt që t'i përvishemi kësaj pune, aq më mirë do të jetë për kulturën tonë kombëtare. Mendojmë se nuk ka arsye që ta shtyjmë punën zvarrë me këtë ose atë pretekst. Së shpejti mund t'i nxjerrim gazetat dhe revistat me atë letrarishte që përdoret në kombin ëmë. Madje "Përparimi" duke filluar nga Nr. 3 do të dalë në letrarishten e përbashkët. Pastaj, duhet t'i hyjmë punës që edhe librat t'i botojmë ashtu si duhet--në letrarishten e përbashkët, e me kohë, pas përgatijeve të duhura, të zhvillohet mësimi në shkollat dhe fakultetet tona me atë gjuhë letrare si zhvillohet në shkollat dhe universitetin e kombit ëmë.

Ne jemi plotësisht të bindur se të gjithë kemi një dëshirë dhe jemi për zgjidhjen më të drejtë: një komb--një gjuhë letrare, një drejtshkrim. Jo vetëm që jemi për këtë zgjidhje, por duhet të luftojmë deri në fund, që ky imperativ kohe të bëhet realitet, me të cilin do të krenohemi ne dhe të gjitha gjeneratat, pas nesh. Ne jemi plotësisht të bindur se në këtë punë do të kemi përkrahjen e plotë si të bashkësisë socialiste, gjithashtu dhe përqafimin e përzemërt të kombit ëmë.

* * * *

Konkluzat e Konsultës Gjuhësore të 22-23 Prillit 1968 Mbajtur në Prishtinë

Më 22 e 23 prill të vitit 1968 Instituti albanologjik dhe Katedra e gjuhës dhe e letërsisë shqipe e Fakultetit filozofik të Prishtinës, organizuan një konsultë mbi ortografinë dhe gjuhën letrare shqipe. Në Konsultë merrnin pjesë lërues dhe arsimtarë të gjuhës shqipe nga Kosova, Maqedonia e Mali i Zi, nga Beogradi dhe viset e tjera të Jugosllavisë. Bazë diskutimi e këtij tubimi të gjerë qe Projekti i ortografisë së re të shqipes letrare, hartuar nga Komisioni i përbërë nga Androkli Kostallari, Eqrem Çabej dhe Mahir Domi. Pas një këmbimi të lirë dhe të frytshëm mendimesh rreth problemeve kyçe të objektit për të cilin u diskutua, ky tubim aprovoi këto konkluza:

1. Tubimi shpreh bindjen se njësimi i shqipes letrare është rezultat i natyrshëm i proçeseve progresive të shoqërisë shqiptare, veçanërisht nga Rilindja e këndej.
2. Mbledhjet e viteve 1952, 1957 dhe 1963, që u mbajtën në Prishtinë e që trajtuan çështjet e gjuhës të ortografisë shqipe, me gjithë lëkundjet në disa pika, luajtën një rol pozitiv në stabilizimin e shqipes letrare.
3. Tubimi i 22 e 23 prillit të vitit 1968 bëri një hap drejt mënjanimit të disa divergjencave që në të shkuar kanë ekzistuar në praktikën e deritashme dhe si gjuhë letrare të shqiptarëve në Jugosllavi njeh, njëzëri, gjuhën letrare të vendit ëmë.
4. Projekti i ortografisë që u zu ngoje, e që shërbeu si bazë diskutimi në këtë Konsultë, porsa të aprovohet dhe të marrë formën zyrtare në Republikën Popullore të Shqipërisë, do të zbatohet.
5. Në ndërkohë, dmth, deri sa të aprovohet, projekti ekzistues është bazë e shëndoshë dhe mund të zbatohet dhe të konsiderohet ortografi shqipe.
6. Vetë Projekti, në disa pika, ka nevojë të shqyrtohet më me kujdes dhe vërejtjet e argumentuara dhe shkencërisht të arsyetuara, mund të jenë vetëm të dobishme. Në këtë kuptim Konsulta e sheh të udhës një diskutim, në rend të parë me anë të shtypit ku do të trajtoheshin çështjet e ortografisë, për të cilat pjesëmarrësit në diskutim mendojnë se janë të diskutueshme dhe mund të zgjidhen shkencërisht më drejt. Diskutimi rreth pikave kontestuese nuk pengon zbatimin e drejtshkrimit në fuqi.
7. Tubimi konstaton se ky hap i rëndësishëm drejt unifikimit të gjuhës letrare, kur është fjala për shqiptarët në Jugosllavi, rezulton nga zhvillimi i tyre i deritashëm arsimor e kulturor, mundësohet e favorizohet nga demokratizimi i marrëdhënieve shoqërore dhe trajtimi i i drejtë socialist i pozitës e i funkcionit të kombësisë, të relacionit kombësi-kombi ëmë e të çështjeve të trashëgimisë e të unitetit të kulturës kombëtare.
8. Tubimi autorizon Institutin albanologjik dhe Katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, si organizuese të kësaj Konsulte, që ta njoftojnë Universitetin shtetëror të Tiranës me konkluzat e tubimit dhe me vërejtjet e bëra rreth projektit të ortografisë.

9. Instituti e Katedra autorizohen t'u rekomandojnë institucioneve e enteve arsimore e pedagogjike, gazetare e botuese, shkencore e kulturore që të krijojnë mundësitë e zbatimit sa më të shpejtë të konkluzave të Konsultës.

Konsulta Gjuhësore
e 22-23 prillit 1968

* * * *

Çupa Dhe Hëna

Kjo përrallë ka lindur para katërgjyshit tim. Mund të bëhet edhe më herët. Por, kjo s'është e rëndësishme. E rëndësishme është se na ishte një përrallë e bukur, një çupë dhe hëna.

Para shumë e shumë vjetësh, thonë hëna nuk ka lundruar nëpër qiellin e kaltër e të qëndisur me yje.

Pra ku banonte hëna asokohe?

Thonë, se ishte shndërruar në medalion ari dhe rrinte varur në qafën e bardhë të një çupe.

Thuhet se çupa kishte gishtërinj të butë si fijet e lëmuara të barit, krahët si krahë dallëndysheje, flokët si fije mëndafshi e sytë e shkruar... te shkruar!

Kur çupa e bënte hënën si medalion e fillonte të qeshte, dhëmbët e saj shndërroheshin në rreshta margaritarësh të bardhë.

Atëhere, nëna i thoshte se bëhej më e bukur se zana. Sepse, ato nuk kanë medalione. Atëhere çupa i buzëqeshte ëmbël nënës së vet, ndërsa hëna rrezatonte në shumë ngjyra dhe krijonte ylber të bukur në mes çupës dhe nënës.

Nëna kishte vetëm këtë çupëz dhe jetonin në një shtëpizë të rrethuar me lule mu në vetullën e malit të blertë.

Kur qeshte çupa, qeshnin lulet dhe zemra e pyllit mbushej me aromë.

Atëhere nëna merrte flokët e mëndafshta të çupës dhe bënte dy gërsheta mbi supet e saj të njomë. Dhe kështu çupa bëhej princeshë e të gjitha vocrrakeve të botës.

Kur i thoshte nëna: prej buzëqeshjeve të tua lindin ylberet, ajo shikonte më parë nënën e pastaj e puthte medalionin. Mandej, e përkëdhelte me gishtërinjtë e butë si fijet e barit dhe ata merrnin ngjyrën e florinjtë.

Kur sëmurej nëna, çupa hynte në zemrën e pyllit të blertë ku i gjente barnat shëruese. Kështu çupa kalonte ditët plot lumturi, deri sa një ditë u gjend para pasqyrës dhe nisi ta shikojë veten. Dhe, mbas pak tha:

--Unë qenkam si e Bukura e Dheut! Kush mund të ketë tjetër në botë këso bukurie e kësi medalioni. Ky është vetëm i imi dhe s'do ta shohin më vogëlushet e tjera të lagjes.

Pasi i tha këto fjalë, u largua nga pasqyra dhe u shtri mbi krevat.

Hëna që varej si medalion, në qafën e saj të butë, posa dëgjoi këtë, e hidhëruar tha me vete:

--Posa ajo të bjerë të flejë, do të iki! Do t'i thërras erërat e buta nga pylli, ato do të hyjnë nëpër dritare dhe do të më marrin e do të

më çojnë lart në qiell.

Dhe, kështu ngjau: posa çupa mbylli sytë, hëna i thirri erërat e pyllit. Ato e morën dhe e çuan lart...lart në livadhin e kaltër të qiellit të mbushur me yje dhe s'u kthye më mbi tokë.

"Kostandin Kristoforidhi (1830-1895)," Dh. Shuteriqi et al. (Eds.), Historia e letërsisë shqipe II (Tiranë), 1959, pp. 244-249; Ali Hadri, "Një komb--një gjuhë letrare," Përparimi (Prishtinë), XIV, 3-4 (March-April), 1968, pp. 323-324; "Konkluzat e konsultës gjuhësore të 22-23 prillit, 1968, mbajtur në Prishtinë," Ibid., pp. 325-326; "Çupa dhe hëna," Rr. Dedaj, Zogu dhe kulla (Prishtinë), 1972, pp. 15-18.

argjendár silversmith
shkencëtár scholar; scientist
seminár seminary
shkóllë gjýsmë të mésme junior high school
Dhiátë e re New Testament
ungjíll gospel; bible
apostúj (apostúll) apostles
lërúes cultivator
i mëpárshëm above-mentioned; preceding
hartój compile
fjalór dictionary
hérët early
shkëpútje separation
i krishtér Christian
kler clergy

shkathësí flexibility; agility
përballój face
i zhdërvjéllët dexterous; agile
i vetëvetíshëm spontaneous
kritére criteria
mjet instrument
jetëshkrónjë biography
gjah hunt
ftoj invite
studím study
vëréjtje observation; notation
vázhdë continuation; line
lloj kind; sort
përpunój refine; elaborate; revise

---

komb nation.
kahérë some time ago
dmth. = do me thënë i.e., that is to say
gjíthnjë e më tépër more and more
veçorí characteristic
thelbór core
qénie existence; being
i ndërlikúar complex; complicated

kurorëzój crown
tanimë at this time; now
nënvizój underline; emphasize
theksój stress
i tërësíshëm entire
suázë framework
postbrión period after the plenum on the island of Brion, which liberalized Yugoslav policy toward the Albanian minority
pa mëdýshje without reservations
kombësí nationality
imponój impose
lëvózhgë peel; rind
specificitét trait
përbërës integral; component
i hollësíshëm detailed
i paevitúeshëm unaboidable
drejtshkrím correct writing
me hir e me pahír willingly or unwillingly
koshiént conscious
përvetësím assimilation
tubím conference; discussion
profetizój prophecy
përvetësój assimilate
në letraríshten in the written language
madjé furthermore
botërísht publicly
përvíshem engage in
zvárrë dragging
revístë magazine
Përparími Albanian-language journal in Kosovo, Yugoslavia
i dúhur proper
përkráhje support
bashkësí community

konklúzë = konkluzión conclusion
konsúltë conference; consultation
katédër Chair (academic)
arsimtár educator
i përbërë comprising
këmbím exchange
i frýtshëm fruitful
kyç key
njësím unification; sameness
lëkúndje oscillation
mënjaním elimination
i deritáshëm until now
njëzëri unanimous
u zu ngóje it was mentioned
zyrtár official
zbatój implement; carry out
i argumentúar reasoned out
i arsyetúar reasoned
e shoh të údhës see fit
i diskutúeshëm debatable
kontestúes contested; disputed
konstatój ascertain
kur është fjála with respect to
pozítë position
trashëgím heritage
njoftój notify

ent agency; office
mundësí means; possibility

---

hënë moon
përrállë fable
katërgjýsh great-great-great-grandfather
më hérët earlier
lundrój sail
i qëndísur embroidered
asokóhe in those times
medalión medallion
gishtërínj (gisht) fingers
fíje blade; strand
i lëmúar smooth
mëndáfshi silken
i shkrúar dappled; variegated
margaritár pearl
buzëqésh smile
rrezatój beam; radiate
ylbér rainbow
çúpëz little girl
shtëpízë little house
mu right; just
gërshétë braid
i njómë soft; young
vocrráke little girl
mandéj afterward
florí gold
sëmúrem become sick
bárna (bar) medicine
shërúes curative
pasqýrë mirror
kësó this kind of (feminine)
kësí this kind of (masculine)
vogëlúshe little girl
krevát bed

KLARA KODRA

LEXIMI I PESËDHJETENJËTË

GRUAJA NË ROMANIN E NJË GRUAJE

afirmím affirmation
i papárë unseen
ngulm insistence
pasqyrím mirroring; reflection
i papërlígjur unjustified; illegitimate
i zbrázët empty
zbrazësí emptiness
prozatór prose writer
kuptimplótë meaningful
tashmë by now

Afirmimi gjithnjë më i madh i personalitetit te gruas në jetën tonë vitet e fundit, ngritja e këtij personaliteti në një lartësi të paparë kurrë gjer tani, krijonte me ngulm pasqyrimin në letërsi.

Në qoftë se ky pasqyrim deri diku ishte arritur në llojet e vogla të prozës dhe në dramaturgji, në lloje të gjëra si romani vihej re ende një farë ngurrimi për të vënë plotësisht në qendër figurën e gruas sonë, ngurrim, që bëhej gjithnjë e më tepër i papërligjur dhe nuk mund të mos krijonte një hapësirë të zbrazët në letërsinë tonë.

Një hap perpara për të mbushur këtë zbrazësi, krahas veprave të prozatorëve tanë të tjerë, përbën romani «Një lindje e vështirë». Dhe kuptimplotë është fakti se këtë hap e ka bërë pikërisht një grua në romanin e saj të parë i shkruajtur nga një grua në letërsinë tonë. Duke e vënë problemin e gruas në qendër të veprës së vet, autorja e ka parë të lidhur ngushtë me problemin e luftës kundër patriarkalizmit, luftë që nuk shihet këtu në aspektin tashmë të njohur e të trajtuar — gjerësisht të mbrojtjes së të drejtës së vajzës për të zgjedhur lirisht shokun e jetës, po në aspektin më të gjerë të mbrojtjes së të drejtave të gruas në familje.

Heroina e romanit, vajza fshatare Bardha, e ka krijuar tashmë lumtërinë e vet familjare dhe duhet ta mbrojë. Familja e burrit të saj nuk pranon t'i japë për nuse motrën e Fadilit njerit prej djemve të xhaxhait

të Bardhës. Këtu lind dhe konflikti midis këtyre dy familjeve. Bardha ndeshet jo vetëm me patriarkalizmin e t'et dhe të xhaxhait, të cilët pa marrë fare parasysh ndjenjat e vajzës, janë gati ta shkatërrojnë këtë familje të re të porsakrijuar për hir të konceptit të shtrembër patriarkal të ndërit, po edhe në ngurrimet e lëkundjet e burrit të saj që, ndonëse e dashuron me sinqeritet nuk gjen forca të luftojë për të mbrojtur dashurinë, duke qenë nga një anë nën ndikimin e konservatorizmit të njerëzve të tij e duke mos qenë, nga ana tjetër, në gjendje për të mundur sedrën e fyer.

Konflikti që ndizet midis dy familjeve pas refuzimit të njerëzve të burrit të Bardhës për t'ua dhënë vajzën e vet djalit të xhaxhait të nuses, ka një bazë reale dhe është plotësisht i besueshëm, veçse shtjellimi që i jepet këtij konflikti nuk ka gjithnjë vërtetësi.

Autorja ka depërtuar në psikologjinë e personazheve të vet, veçanërisht të heromës, Bardhës, bota shpirtërore e së cilës është zbuluar me tërë larminë e nuancave të holla që karakterizojnë psikologjinë e gruas dhe që autorja, duke qenë vetë grua, i njeh në thellësi dhe kjo është një meritë e padiskutueshme e romanit. Për figurën e Bardhës mund të thuhet se është më e realizuara. Te ajo shikohet ai kompleksitet karakteristik për natyrën njerëzore që takohet në jetë.

Bardha nuk është, pa dyshim, nga luftëtaret e së resë që dalin në pararojë, ajo tipizon tërë ato vajza që kalojnë nëpër një rrugë të vështirë e të ndërlikuar për të formuar personalitetin e tyre. Ambienti patriarkal ku është rritur ka lënë gjurma të thella tek ajo duke e bërë shumë të ndrojtur e të përulur, megjithëse nuk i mungon forca e karakterit. Para martesës nuk guxon të takohet me burrin e saj të ardhshëm, megjithëse i pëlqen shumë një gjë e tillë; më vonë në shtëpinë e burrit, ndonëse është e ndërgjegjëshme për trajtimin e padrejtë që i bëhet nga vjehrra konservatore, hesht dhe kënaqet me pak; dhe në ndjenjën e dashurisë së saj për të shoqin ka një ndjenjë nënshtrimi; vetëm kur vihet në rrezik lumturia e saj familjare, revoltohet, po revolta e saj është prapseprapë mjaft pasive. Ndikimi i shoqërisë sonë e bën dhe atë një grua të vetëdijshme për të drejtat e veta.

Kthesa e saj, e cila zë fill që nga çasti kur ajo merr vendimin për t'u kthyer te burri dhe shkon më tej gjatë qëndrimit të saj në maternitet, është analizuar imtësisht nga autorja dhe relativisht është motivuar.

t'et=të jatit
shkatërrój destroy
i porsakrijúar just created
lëkúndje vacillation
sédër self-respect; dignity
i fýer offended
i besúeshëm believable
shtjellím evolution; unfoldment
i padiskutúeshëm indisputable
së résë the new wave
pararójë vanguard
i ndrójtur withdrawn; shy
i përúlur submissive
i ndërgjégjëshëm = i ndërgjégjshëm conscious
i padréjtë unfair; unjust
vjéhërr mother-in-law
prapseprápë nonetheless
i vetëdíjshëm conscious; aware
imtësísht in detail

Për çeshtjen se sa i plotë është ky motivim do të kemi rast të flasim më poshtë.

Nëpërmjet figurës së Fadilit, burrit të Bardhës, autorja ka dashur të shprehë idenë interesante se bartës të patriarkalizmit mund të jenë jo vetëm njerëzit e vjetër në moshë, po edhe të rinjtë.

Figura e Fadilit, ashtu siç jepet, është një figurë komplekse. Në qëndrimin e vet ndaj punës ai jepet si i përparuar (le të kujtojmë grindjen e tij me agronomin që tregon qartë se ai e quan interesin e përgjithëshëm si të vetin), kurse në familje ky i ri i kohës sonë, ky brigadier i dalluar mban një qëndrim krejt të ndryshëm, duke ju nënshtruar mendimeve konservatore të s'ëmës për vendin që duhet të zëjë gruaja në shtëpi.

Këto mendime të vjetra, shpjegojnë qëndrimin e lëkundur të tij kur njerëzit e së shoqes i çojnë fjalë për prishjen e martesës, por nuk kuptohet si nuk ndihet fare depërtimi i së resë në ndërgjegjen e tij në këtë pikë, aq më tepër se ai është rritur në një ambient më të përparuar se sa Bardha dhe autorja e nënvizon herë pas here epërsinë e ambientit të fermës mbi ambientin e fshatit të Bardhës. Veç kësaj, tek Fadili nuk e shohim kthesën që ndodh tek Bardha; ai deri në fund lëkundet dhe karakteristike është fraza e fundit, në të cilën autorja na përshkruan gjendjen e tij shpirtërore: «Përse kjo jetë po i rrokullisej kështu, po e mirrte përpara dhe ai s'kishte forcë ta ndalte? (Theini fraza e fundit, se ndryshimi i tij i mëtejshëm nuk pasqyrohet artistikisht).

Ky pasivitet i gjatë bën që figura e Fadilit të mos jetë bindëse deri në fund.

Si thamë, konflikti mbi të cilin është ndërtuar romani është plotësisht real dhe i mundshëm, por autorja vende-vende e ka zgjatur në mënyrë artificiale duke futur në të elementë të rastësisë, siç është të mosmarrurit e letrës së Bardhës nga ana e Fadilit (dhe që kjo ngjarje e rastit luan një rol të rëndësishëm ndikues në luftën e tij shpirtërore theksohet nga vetë autorja, e cila pohon se sikur ai të kishte marrë letrën që i dërgonte ajo, puna do të kish shkuar ndryshe. Ai s'do të kish qëndruar në këtë mëdyshje për asnjë çast. Do të ngrihej e do të shkonte menjëherë, ose biseda e dy punëtorëve të fermës që Fadili dëgjon rastësisht dhe ja lëkund vendimin e marrë pas takimit me sekretarin e partisë.

Një figurë kuptimplote është ajo e nënës së Bardhës

nëpërmjét through
bártës carrier
gríndje quarrel
príshje breakup
depërtím penetration
aq më tépër all the more
nënvizój underline
epërsí superiority
rrokullís tumble; roll down
merr përpára drive willy-nilly
pasqyrój present
vénde-vénde here and there
të mosmárrurit the failure to receive
ndikúes influential
theksój stress
pohój admit
mëdyshje dilemma
lëkúnd cause to vacillate; weaken

personalitetin e së cilës pothuajse e ka asgjësuar atmosfera mbytëse patriarkale ku është formuar e ku jeton. Kjo figurë të kujton figurën e nënës së Verës te «Shuaje dritën, Verë!» e po kësaj autoreje, po ndryshon prej saj se me gjithë nënshtrimin skllavëror ndaj burrit, në karakterin e saj vihen re shenja të revoltës, revoltë që shpërthen kur është çeshtja për të mbrojtur lëmturinë e së bijës.

Nga përfaqësuesit e së vjetrës spikasin si më të realizuar Kadriu dhe Bajrami. Mësi gjallë ka dalë i pari tek i cili duken shenjat e dyshimit dhe të brerjes së ndërgjegjes.

Duke lexuar romanin ke përshtypjen se autorja është ndalur më tepër mbi aspektin psikologjik se sa mbi aspektin shoqëror të konfliktit. Ndikimi i kolektivit ndihet pak (me përjashtim të fundit të romanit ku jepet ndërhyrja e organizatës së partisë të maternitetit). Madje në fillim të romanit pohohet se njerëzit në fshatin e Bardhës nuk dinin gjë për gjëndjen e saj dhe për shtrimin e saj në maternitet.

Një indiferentizëm i tillë zor se mund të besohet. Gjithashtu, në rast se roli i organizatës së partisë dhe të rinisë si në fshat ashtu dhe në fermë pothuajse nuk ndihet fare (këtë autorja është përpjekur ta motivojë me formalizmin dhe burokratizmin e disa elementëve) nuk ndihet me forcën e duhur as ndikimi i elementëve më të përparuar, i përfaqësonjësve të së resë siç janë shoqja e Bardhës, Sadija dhe sidomos e kunata, Vjollca, që mishëron vajzën e ditëve tona.

Vlerësimi i drejtë i situatës nga ana e tyre na bën që të presim prej tyre jo vetëm fjalë, po më tepër veprim.

Duhet thënë se në roman ekziston një shpërpjestim midis forcës së të vjetrës dhe forcës së të resë duke u paraqitur e para më qartë dhe më me fuqi dhe kjo përbën një të metë të ndieshme të veprës. Kjo ka bërë që edhe kthesa e Bardhës të ngjajë si e nxituar, megjithëse autorja na ka pregatitur deridiku për këtë.

Mund të bëhen vërejtje dhe për qëndrimin e Bardhës ndaj Marianës. Nuk mund të bindemi lehtë që kjo grua e re fshatare, e cila ka qenë për kaq kohë e shtypur nga ambienti patriarkal, të shohë me sy kaq të zhveshur nga paragjykimet vajzën që ka lindur një fëmijë të paligjshëm, edhe duke marrë parasysh natyrën e dhëmshur të Bardhës dhe afrimin që mund të

asgjësój annihilate
mbýtës suffocating
shúaj shut; shut off
spikás stand out; distinguish
brérje pricking; gnawing
përshtýpje impression
zor difficult
riní youth
vlerësím evaluation
situátë situation
shpërpjestím disproportion
e métë defect; fault
deridikú up to a point; to a degree
paragjykím prejudice
i palígjshëm illegitimate

krijohej midis këtyre dy grave nga ngjashmëria relative e fatit të tyre.

Episodi i Marianës — në vetvete interesant — i është dashur autores për të na paraqitur një aspekt tjetër të problemit të gruas e për të plotësuar deridiku linjën kryesore; figura e Marianës, megjithëse episodike, është e gjallë, po ndikimi që ajo fillon të ketë te Bardha nuk është i motivuar. Më e motivuar mendojmë se duhej të ishte edhe dashuria e Fadilit me Bardhën. Që kjo dashuri të ishte kaq e thellë dhe e fuqishme, siç jepet në roman, duhej të kishte baza më të forta se sa simpatia që mund të lindte në vështrim të parë.

Një përshkrim i tillë i dashurisë lidhet me konceptin e vjetruar të kësaj ndjenje duke e lidhur me pamjen e jashtme dhe kjo shprehet edhe në nënvizimin e tepruar të bukurisë fizike të heroinës. Sadoqë një njohje e tillë e sipërfaqëshme e dy të rinjve para martesës mund të përligjet me ambientin patriarkal ku është rritur Bardha dhe në përgjithësi me kushtet e fshatit, për deri sa autorja kërkon të na bindë për thellësinë e ndjenjës që i lidh dy të rinjtë, për deri sa kjo ndjenjë në fund të fundit triumfon, ajo duhej të ishte më e argumentuar, aq më tepër se duke bërë një krahasim me fatin e Marianës, drama e së cilës qëndron në faktin se nuk e njohu mirë njeriun që dashuroi, të lind spontane pyetja: «Përse të jetë më e fuqishme dashuria e Bardhës me Fadilin, të cilët para martesës ishin parë vetëm një herë?

Në përgjithësi romani është shkruar me ngrohtësi dhe e përshkon vende-vende një lirizëm i kulluar që shfaqet sidomos në disa pjesë që janë copëza të vërteta poezie në prozë. Le të citojmë disa prej tyre.

«Vjen një çast në jetën e gruas dhe ajo fillon ta kuptojë jetën më qartë. Ajo beson se e mira do të triumfojë në jetën e njeriut dhe fyerja, poshtërimi dhe përbuzja do t'i përkasin një bote që s'është më e saj. Ato do të shuhen, ose do të harrohen dhe ajo s'ka për t'i takuar më kurrë. Ashtu duhej të ishte. Këtë e tregonte qartë ajo diçka e vogël, që po rritej aty në bark të saj, që lëvizte... dhe provonte se do të triumfonte mbi vdekjen dhe mbi çdo gjë të ulët dhe të vrazhdët».

«Qumështi! Më në fund kishte ardhur. Ai e kishte spërkatur për herë të parë si një shi i mrekullueshëm duke i dhënë emrin e nënës. Ajo ndjente se si nëpër tërë trupin e saj, nëpër pejzat dhe gjëndrat e panumërta po përpunohej me një dhimbje të këndëshme ky

ngjashmërí resemblance
vetvéte itself
línjë line
vështrím glance; look
i vjetrúar old-fashioned
sadóqë regardless; even though
përlígj justify; legitimize
citój cite
fýerje insult
poshtërím debasement
përbúzje scorn
shúhem disappear
i vrázhdët brutal; coarse
péjzë tissue
gjëndër gland
dhímbje pain

ERIC
Full Text Provided by ERIC

kënd**é**z rooster
trumbët**á**r trumpeter

Këndezi

Në mëngjez,
O këndez,
këngëtar,
trumbëtar
ti më zgjon,
kur këndon
ki-ki-ki
e më thua:
«Çohu, mos fli!»

LEXIMI I PESEDHJETEDYTE

LËVIZJA KULTURALE NË VOSKOPOJË NË SHEKULLIN XVII

Voskopoja, sot fshat i rrethit të Korçës, në shekullin XVII e sidomos XVIII, ishte një qytet i madh, qendër e lulëzuar ekonomike e kulturale, me një artizanat shumë të zhvilluar me një tregëti të pasur, me lagje të shumta. Një shkrim i kohës e quan Voskopojën qytet nga më të mëdhenjtë e gjithë perandorisë turke. Tregëtonte me krahinat fqinje të Shqipërisë së jugut, të Shqipërisë së mesme, e me pjesë të tjera të perandorisë, dhe mbante marrëdhënie tregëtie transite të vazhdueshme me vendet e ndryshme të Evropës Qendrore, Lindore e Jugore. Voskopojarët rrihnin sidomos Trieshtën, Venedikun, Leipcigun, Vienën, Budapestin, Poloninë. Atje kishte grupe të shumta voskopojarësh të organizuar në vëllazërira. Këto ndihmonin shumë institucionet mirëbërëse dhe arësimore.

Kulmin e lulëzimit Voskopoja e arriti në vitet 1720-1769. Qyteti gëzonte një farë autonomie, duke lojtur rol të dorës së parë në administrim esnafet. Nga mezi i shekullit, numuroheshin 17 esnafe, në kuadrin e të cilave ishin organizuar mjeshtëritë e shumta që ishin zhvilluar aty.

Zhvillimi ekonomik solli natyrisht edhe zhvillimin e kulturës. Lulëzimi i zanateve e mirëqënia ekonomike, pasurimi i voskopojarëve në metropolet e ndryshme evropiane, rënia në kontakt në këto vende me arritjet më të përparuara të kulturës, qenë shtysa për marrje inisiativash të ndryshme në fushën kulturale.

artizanát handicraft industry; trade
tregëtí commerce
tregëtój trade
fqínjë neighbor
rrah ply; frequent; beat
vëllazërí brotherhood
mirëbërës charitable; benevolent
esnáf guild
mirëqënie prosperity
rënie në kontákt coming into contact
shtýsë incitement; stimulus

Në fillim të shekullit XVIII e ndofta edhe më parë, Voskopoja ka shkollën e saj në gjuhën greke. Më 1744, kjo u lartësua në nivelin e një shkolle të mesme dhe më 1750 mori emrin «Akademia e re». Shkolla e Voskopojës u bë nga më të mirat e Ballkanit. Në të dhanë mësim njerëz të ditur, shumë prej të cilëve vinin nga kolonitë voskopojare të qendrave evropiane, si p.sh. **Sevast Leontiadhi**, që kishte studiuar në Padovë, **Gjon Bakërxhiu**, më parë mësues në Venedik. Këta sollnin e perhapnin idetë e përparuara të kohës, zbatonin sistemet e reja pedagogjike. Akademia e Voskopojës kishte edhe internat. Atjo mësonin edhe nxënës nga vise të ndryshme të Shqipërisë, të Maqedonisë e të vendeve të tjera fqinje. Shumë voskopojarë studionin ndër universitetet e Italisë, Gjermanisë dhe Evropës Qendrore.

Në vitin 1720 u ngrit edhe një shtypshkronjë, ahere duket e vetmja e gjithë perandorisë turke. S'na kanë arritur tërë botimet e kësaj shtypëshkronje. Njihen gjer më sot 19 libra mësimore e kishëtare greqishte, të botuara në vitet 1731-1761. Voskopoja kishte një bibliotekë të pasur, që përfshinte edhe vepra letrare të shekujve XVII e XVIII në gjuhë të ndryshme. Ndonjë libër i saj gjindet në bibliotekën e sotme të Mitropolisë së Korçës, ku shihen, ndërmjet të tjerave, edhe vepra të klasikëve grekë e latinë e të klasikëve frëngj Rasin, Kornej etj, në botime të shekullit XVIII, gjë që dëshmon nivelin e ngritur dhe horizontin e gjerë mendor të jetës kulturale të vendit tonë nga mezi i atij shekulli

Në Voskopojë lulëzoi edhe arti fetar. Qyteti kishte afer njëzet kisha. Shumica prej këtyre u ndërtuan ose u rindërtuan e u zbukuruan në shekullin XVIII. Ato janë realizime të shquara të artit shqiptar të stilit bizantin, sidomos me veprat e punuara nga piktorë shqiptarë, e me punimet prej druri.

Kështu Voskopoja, në shekullin XVIII, ishte një vatër e madhe qytetërimi e kulture për gjithë vendet përreth, një metropol i vërtetë i gadishullit ballkanik. Nga ajo dolën burra të mësuar, që u shquan në fushën e kulturës. Ndër ta përmendim: **Dhimitër Prokop Pamperin**, mjek filozof, sekretar e mësues në oborrin e princërve të Vllahisë; **Ambroz Pamperin**, prift i kishës ortodokse të Leipcigut, që shkroi

i dítur learned
zbatój implement
internát boarding school
shtypshkrónjë printing press
e vétmja the only one
mitropolí region under the jurisdiction of a bishop or archbishop in the Eastern Orthodox Church
qytetërím civilization
mjek physician

libra të ndryshme e vjersha greqisht; **Kostandin Ukutën**, protopapë në Poznan të Polonisë, që hartoi një manual për mësimin e gjuhës arumune, botuar në Vienë më 1797; **Dhimitër Bojaxhinë**, profesor i greqishtes më 1817 në Universitetin e Vienës, auktor i një gramatike të rumanishtes e të arumunishtes, Kostë Xhehanin, Theodhor Kavaliotin, Dhaniel Haxhinë

Figurë veçanërisht interesante është ajo e **Kostë Xhehanit**. Mësimet e shkollës së Voskopojës ky i vazhdon në një gjimnaz të Hungarisë, më 1766, fshehurazi të jatit, që merrej me tregëti në Vienë dhe kërkonte ta mbajë prané vehtes; ikën dhe shkon me këmbë në Halle të Gjermanisë, për të vazhduar studimet në universitetin e famshëm të atjeshëm (1). Aty i ndihmoi profesorit Thunman, me informatat e pasura që i dha, për të hartuar studimin «Mbi historinë e gjuhës së shqiptarëve e të vllehëve» (1774). Xhehanin e shohim të bëjë udhëtime studimi të gjata, të vizitojë njerën pas tjetrës qendrat më të famëshme e universitare të kohës (Gëtingen të Gjermanisë, Paris, Londër, Leiden të Hollandës, ku mori famë me polemikën e tij me një nga profesorët e atjeshëm, i cili guxoi të flasë me qesëndi për popujt e Ballkanit), të jetë gjithënjë në lëvizje, të shkojë në Venedik e Romë, në Amsterdam e Angli, në Vienë e Poloni, në Vllahi e Stamboll.

Te Xhehani kemi një njeri që është në lartësinë e kulturës së kohës. Profesori Thunman flet kështu për të më 1774: «*Është burrë me shumë njohuri, veçanërisht në filosofi dhe matematikë, me një mendje të ndritur dhe që do të meritonte një fat më të mirë. Pasi qëndroi dy herë, gjithësej tre vjet, në këtë universitet dhe pasi vizitoi Leiden dhe Kembriç, pasi pa Francë e Itali, tani po kthehet në atdheun e tij për t'u shërbyer bashkatdhetarëve me njohuritë që ka fituar*». (2)

1) I. M. Qafëzezi, Kostë Haxhi Jorgji Çekani nga Voskopoja, të Buletini Shk. Shoq. 1954, nr 3.

2) J. Thunmann, Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker, Erster, Theil, Leipzig 1774, fq 179-180 (shënime).

protopápë clergy rank between priest and bishop
arumúne Arumunian
të játit = të etit
véhte = vete
i atjéshëm over there; of that place
vlléhë Vlachs, people of Walachia, now southern Rumania
qesëndí ridicule; mockery

Kënë Xhehani shkroi greqisht shumë vepra letrare, shkencore etj., që deshmojnë për kulturën e gjerë enciklopedike të tij: katër epika heroelegjiake (nga të cilat një kushtuar perandoreshës Katerinës II të Rusisë, botuar në Leiden më 1776, dhe një tjetër perandorit të Prusisë, Frederikut II), dy epigrame, një tekst aritmetike, një studim matematike (Teori e re e kuadraturës së rrethit), përkthime greqisht nga gjermanishtja etj.

Kultura që u zhvillua në Voskopë, qe kryesisht në gjuhën greke. Po aty, si edhe në qendrat e tjera të Shqipërisë së jugut e të mesme, arësyet didaskalike e nevoja për t'i vënë një gardh islamizmit bënë të domosdoshme përdorimin edhe të gjuhëve amtare, duke i dhënë shkas kështu zhvillimit të kulturave kombëtare. Në shkollat e Voskopojës, u përdoren edhe arumunishtja e shqipja për mësimin e greqishtes. Në shkrime greqisht të fundit të shekullit XVIII, flitet për përkthime të Ungjillit shqip në Voskopojë. Gjon Zavira (1719-1804) thotë: *«Grigori i Durrsit*(3) *nxënës i Gj. Bakërxhiut, përktheu Dhjatën e vjetër e të re edhe e shkroi atë me germa shqipe, të cilat ai vetë i shpiku»*.(4)

Në një studim mbi arumunët, të botuar në Budapest më 1808 nga Gjergj Roza (5), thuhet se, në shtypëshkronjën e Voskopojës, u shtypën shumë libra arumunisht. Arësyeja përse ne nuk kemi sot veçse një pjesë të vogël të librave qe u botuan këtu, është e qartë. Shkrimet e librat shqip e arumunisht u ndoqën nga Fanari, i cili, me anë të klerit ortodoks që ishte nën mvartësinë e tij, luftoi për helenizimin e ortodoksëve të Ballkanit dhe për mbytjen e çdo çfaqje të kultu-

3) Për këtë Grigor të Durrsit, që quhet dhe Grigor Voskopojari, s'kemi të dhëna të mjafta e të sakta. Qe nga njerëzit më të mësuar të kohës së tij. Dha mësim në shkollën e Voskopojës dhe drejtoi shtypëshkronjën e këtij qyteti mjaft vjet. Shkroi një akoluthi greqisht të Kirilit, Metodit e të tjerëve, që u botua në Voskopojë, shënime mbi kohën, muajt e ditët, fjalime të ndryshme etj. Më 1740 u zgjodh mitropolit i Durrsit. Më 1767 merr pjesë në një Sinodh të Patrikanës në Stamboll. Vdiq më 1772. Vitet e fundit duket se i kaloi në manastirin e Shën Jonit, pranë Elbasanit.

4) Zavira, fq 236.

5) Per. Papahari, Scriitori aromâni in secolul al XVIII, Bucuresti 1969, fq 43.

heroelegjiák heroic elegiac
didaskalík didactic
gardh fence
shkas cause
gérmë letter
shpik invent
Fanár locale in Istanbul of the patriarchy of the Eastern Orthodox Church
mvartësí dependence
mbýtje suppression; drowning
çfáqje = shfaqje

rës kombëtare të tyre. Kjo veprimtari intensifikohet në shekullin XIX, kur mund të jenë zhdukur edhe monumentet e shkruara shqip, që ndodheshin nder manastire e kisha në duart e peshkopëve grekë e grekomanë.

Më 1769, Voskopoja pësoi prishjen e parë të saj nga fuqitë bashibozuke të ushtrisë turke. Ajo u bë objekt grabitjesh e kusërish të feudalëve të krahinave fqinjë. Djegur e plaçkitur disaherësh, qyteti filloi të shkretohet; popullsia të ikë. Voskopoja u kthye në një fshat. Kështu, nga anarkia e shtypja feudale turke, u shua kjo vatër kulture e ndritëshme.

THEODHOR KAVALIOTI (vd. 1789)

Lindi në Voskopojë nga viti 1718. Mësimet e para që mori aty, i vazhdoi në Janinë, duket më 1732-1734. Janina në këtë kohë po bëhej një qendër e madhe tregëtare e kulturale dhe kish dy shkolla greqishte të nivelit të shkollës së mesme. Ato patën si mësues një sërë burrash të mësuar e të ditur. Kështu përmendet janinoti Method Antrakiti, që në periudhën 1720-1735 dha mësim disa vjet. Ai mësonte, përveç algjebrës, gjeometrisë, trigonometrisë, edhe filosofinë e Dekartit e të Malëbranshit, parimet e të cilëve i kishte bërë të vetat. Prandaj edhe u ndoq nga Patrikana e Stambollit, e cila e dënoi dhe i dogji dorëshkrimin pedagogjik si edhe një libër që kishte botuar në Venedik. Në shkollat e Janinës njiheshin dhe idetë e filosofëve të tjerë të Evropës, si të Leibnicit e Lokut (6). Kavalioti pati mundësi të marrë pra një kulturë enciklopedike të mirë për kohën, të përvehtësojë metodat e idetë e reja që ishin shpënë në Janinë nga universitetet e ndryshme të Evropës Perëndimore.

Si kreu studimet, ai u kthye në Voskopojë, ku u emërua më 1743 mësues në shkollën e qytetit, u bë prift dhe pastaj protopapë. Më 1746, u emërua drejtor i shkollës, që me punën e tij u ngrit në rangun e një shkolle të mesme dhe mori më 1750 emrin Akademia e re. Zhvilloi një aktivitet të madh në fushën mësimore, kulturale dhe në atë kishëtare si protepapë e predikues i Patrikanës së Ohrit.

6) I. M. Qafëzezi, Th. Kavalioti, monografi e pabotuar. Së këndejmi i nxorrëm citatet nga Kavalioti.

manastír monastery
grekomán pro-Greek
grabítje plunder
kusërí = kusarí robbery
plaçkítur pillaged
shkretój desert; abandon
vd. = vdiq
patrikánë patriarchy
përvehtësój = përvetësój assimilate; appropriate
drejtór dean; director
rang rank
predikúes preacher

Kavalioti, për nevojat e shkollës, hartoi tekste të ndryshme shkencore-mësimore, po shumica e madhe e tyre mbetën dorëshkrim dhe pjesërisht humbën. Se ç'emër kishte marrë Akademia e re dhe dituria e Kavaliotit, e tregon fakti se kopje të tri teksteve të kësaj shkolle, të punuara prej protopapës, «Fizika», «Logjika», «Metafizika», janë gjetur në Jashi e Bukuresht të Rumanisë, ndër librat e bibliotekave të shkollave greqishte që funksiononin në shekullin XVIII në këto qytete dhe që numuroheshin ahere ndër më të mirat e Ballkanit. Mundet që mësuesit e nxënsit e këtyre shkollave i kanë përdorur si libra mësimi veprat e voskopojarit tonë.

Na mungojnë të dhëna të mjaftueshme për veprimtarinë e Kavaliotit. E kaloi, duket, gjithë jetën në qytetin e lindjes, bëri dhe ndonjë udhëtim në Evropë. Vdiq në vitin 1789.

Profesori gjerman Thunman, që i ka informatat nga nxënësi i Kavaliotit, K. Xhehani, thotë, për të se ka shkruar pothuajse mbi gjithë degët e shkencës filosofike, po prej tyre s'ka botuar asgjë. Prej Kavaliotit njohim gjer më sot një libër mësimi, «Protopiria», botuar më 1770 në Venedik, një gramatikë elementare të greqishtes, botuar në Voskopojë më 1760, dhe tri traktate mësimore në dorëshkrim: «Logjika», 218 faqesh (1749), Fizika, 116 faqesh (1752) dhe «Metafizika», 150 faqe.


ΠΡΩΤΟΠΕΙΡΙΑ
ΠΑΡΑ
ΤΟΥ ΣΟΦΟΛΟΓΙΩΤΑΤΟΥ,
ΘΕΟΔΩΡΟΥ Α'ΝΑΣΓΑΣΙΟΥ
ΚΑΒΑΛΛΙΩΤΟΥ
ΤΟΥ ΜΟΣΧΟΠΟΛΙΤΟΥ
ΗΤΝΤΕΘΕΙΣΑ.

29. — Th. Kavalioti, Protopiria, 1770.

shumíca e mádhe the great majority

traktát treatise

Vetëm «Protopiria» intereson drejt për drejt gjuhësinë e letërsinë shqipe, veprat e tjera janë krejt greqisht. Po traktatet shkencore filosofike të Kavaliotit kanë rëndësi të veçantë për historinë e mendimit dhe të kulturës në vendin tonë dhe kështu marrin rëndësi edhe për historinë e letërsisë; ato pasqyrojnë nivelin relativisht të lartë të mësimeve të shkollës së Voskopojës, jetën mendore që zjente në këtë qytet e në qendrat e tjera, jehonën e ideve filozofike të Evropës Perëndimore.

Kavalioti ishte burrë me dituri të thellë, me njohuri të gjerë enciklopedike. Në pajtim me frymën e kohës, të shekullit të iluminizmit, ai është për kërkimin e zhvillimin e diturisë, për zgjerimin e horizontit mendor, tregohet entusiast i mendimit, të cilit i drejton një himn të vërtetë në parathënjet e «Fizikës» e të «Logjikës», ka dashuri e nderim të madh për filosofinë, është kundërshtar i obskurantistëve dhe i metodave skolastike. Rinisë voskopojare i mëson, se, nga të gjitha dijet njerëzore, *«vetëm filosofia është më hyjnore»*; me anë të saj *«ne integrohemi në Perëndinë»*; dhe se *«vetëm me anë të filosofisë mundet dualizmi unik i qenies njerëzore të arrijë gradën më të lartë të përsosurisë së tij, duke u vënë në gjendje të njohë realitetin e vërtetë dhe në praktikën e përditëshme të mos punojë pa rregull»*. Në anën tjetër, si njeriu i kishës, ai kërkon që dija të harmonizohet me ndjenjën dhe mendimin fetar, të mos vijë në kundërshtim me të. Qëndron pra në vijën e një filosofie idealiste me elemente racionaliste. Kavalioti kërkon të pajtojë fenë me filosofinë. Ngrihet kundër atyre që hiqen si njerëz të mësuar dhe tremben nga filosofia, se mos i bjerë pengesa fesë, po duke pasur frikë nga ateismi, kërkon gjithashtu të luftojë rrymat materialiste dhe të tregojë udhën o një ideali moral të lartë në harmoni me fenë. Mendimi i Kavaliotit del i dominuar nga spiritualizmi i krishterë. Ja si flet në parathënie të «Fizikës»:

«Papo ata që na zvarrisin në gënjeshtra me anë të një mendimi të pasigurtë, si dhe ata që besojnë se përkundër kishës, si rregull e përpiktë, ka pengesa prej anës së filosofisë, këta le t'i luftojmë me tërë fuqinë tonë si ca dëmtonjës. Papo, në qoftë se disa kanë huqin e keq të thonë për-

mendóre intellectual
pajtím harmony; conciliation; accord
kërkím seeking
kundërshtár opponent; opposing
hyjnóre heavenly
pajtój reconcile
rrýmë current

herë se kjo është sipas filosofisë dhe kjo sipas fesë, ne ta hedhim tutje këtë dallim si diçka të palogjikëshme dhe qesharake, sepse filosofia është ajo që vështron tek e vërteta e vetme.

«Ngrihuni, po thom, në besën e krishterë, duke vënë në themel të punës krijonjësin e të gjithave. Përndryshe, s'do të jetë e mundur të arrijmë, ndër punët që gjurmojmë, në cakun e një pune nga ato që janë të denja për t'u lëvduar, po shumë shpejt në cakun e atij njeriu që kërkon t'ua dalë në krye të gjithave sa mundet më tepër me para apo me fuqi. Po që të bëhesh rob i dëfrimeve të neveritura, edhe kjo përbën një zinxhir të rëndë për shpirtin e lindur në natyrë të lirë».

Kavalioti merr pozicion kundër shkollës aristotelike dhe i flon të rinjtë të luftojnë kundër filosofëve të rrymës kundërshtare. *«Dërmojini mendimet e tyre, bile edhe ato të Aristotelit, kryetari i të gjithëve, dhe me sa të jetë e mundur t'i shtyni ndaj së vërtetës».*

Këto shfryrje kundër mendimeve e rrymave të filosofisë materialiste, nuk duhen marrë si retorikë e thjeshtë, pa lidhje me realitetin shqiptar të kohës. Ato na tregojnë se mendime materialiste qarkullonin në Shqipëri në atë kohë, sa që të shtrengohet Kavalioti t'i luftojë e të largojë nga to nxënsit e lexuesit e tij. Si edhe idetë e filosofëve të tjerë, në vendin tonë kanë depërtuar pa tjetër edhe mendimet e filosofëve materialistë, po këto kanë lënë më pak gjurma në shkrimet, pse ndeshnin në luftën e ashpër të kishës. Shumë shqiptarë, si e pamë, kishin studiuar nëpër universitetet e Padovës, Leipcigut, Vienës etj., dhe aty ishin njohur me idetë e rrymat e ndryshme filosofike. Se në Shqipëri s'kanë qenë të panjohura idetë e materialistëve frëngj të shekullit XVIII, na e dëshmon konsulli frëng pranë Ali pashës, Pukëvili (4). Vepra e Laplasit mbi sistemin e botës dhe vepra të

4) *Pouqueville*, Voyage dans la Grèce, vëll. I, fq 285-286. Ky, nga viti 1806, pas një udhëtimi nëpër malet e Kolonjës, arrin në Përmet. Ja s'thotë. «E ndjeja vehten të lumtur që ndodhesha perseri ne mes njerzish, kur m'u afrua një plak i nderuar, më përshëndeti frëngjishi e me një mënyrë aq fisnike e të sjellë, sa që mbeta për një çast pa

qarkullój circulate

tjera shkencore ndodheshin në bibliotekat e mjaft njerëzve të Janinës.

Kavalioti parathënien e «Fizikës» e mbyll me porosinë që i jep rinisë për jetë jetë të ngritur mbi parime të larta, në shoqëri shpirtërore me ata burra të ditur të botës, fama e të cilëve qëndron në mënçuri: *«Me kujtimin e burrave të mëdhenj në mendjen tuaj dhe me ndihmën e filosofisë, do të jeni mjaft të fuqishëm ndaj poshtërsirave të jetës»* Si shihet, për Kavaliotin filosofia s'ishte një spekullim i thjeshtë, po një udhëheqës veprimi e jete.

Mendimin filosofik të Kavaliotit e karakterizon elektizmi. Ndjehet i fuqishëm në të ndikimi i Platonit e po aq ai i filosofisë moderne, veçanërisht i Dekartit, Gassendit, Malëbranshit, Leibnicit. Në gjurmat e Gassendit (1592-1655), që kërkon të pajtojë teorinë e atomeve me teologjinë e krishterë, duke thënë se është *«Perëndia shkaqi i parë që ka krijuar e vënë në lëvizje atomet»*, Kavalioti, në kapitullin «Mbi materien» (Fizika) pranon, sipas filosofisë «pagane», se materia mund të ndahet, po shton menjëherë se, *«gjer ku mund të ndahet, këtë e njeh vetëm Perëndia që i di të gjitha»*.

Leibnici e konsideronte përsosurinë si qëllim të fundit dhe inteligjencën si bazë themelore të përsosurisë. Edhe për Kavaliotin, gjykimi është kusht i domosdoshëm si në spekullimet teorike, si në jetën e çdo dite. Përsosuria, — thotë ai në parathënien e «Logjikës», — nga e cila duhet të synojmë ne, arrihet vetëm me ndihmën e një mendje të organizuar, që të dallojë realitetin nga dukja, të vërtetën nga e rrema, të mirën nga e keqja. Natyra njerëzore është e prirur nga gabimet e rrëmuja, mendon Kavalioti, dhe vetëm me ndihmën e studimit arrin mendja e njeriut saktësinë, si në lëmin e spekullimeve teorike, ashtu edhe në praktikën e çdo dite.

Me mësimin e tij dhe me traktatet që hartoi, Kavalioti,

---

lu-përgëlgjur. Ai më tregoi udhëtimet e tij në Francë e qëndrimin e tij në Paris. Kishte frekuentuar kafenë Prokop, ku kishte njohur Didëronë, Dalamberin, Frerenë dhe letrarët e shekullit të fundit. Ai thoshte me gojë vjershat e Rasinit, Kornejit, Volterit dhe, pa dashur të duket nëpërmjet një ekspozimi të pavend diturie, më provoi se e njihte mjaft mirë letërsinë tonë».

parím principle
mençurí wisdom
elektízmi = eklektízëm (mp.) electricism
kusht condition
e rrëmë error; distortion
i prírur inclined
rrëmújë chaos; disorder
lëmë field

përhapi njohuritë shkencore dhe idetë e atyre filosofëve që, duke qëndruar në planin idealist, përmbanin në idetë e tyre edhe shumë elemente të reja përparimtare. Këto ide, në botën e mendimit shqiptar, të kohës, të ndrydhur nën peshën e botëkuptimit teologjik-skolastik, ishin një hap i madh përpara. Aio frymëzonin interes e dashuri për shkencat. Vetë futja e shkencave pozitive në planin mësimor i epte një grusht të rëndë obskurantizmit teologjik.

Tani të vimë te vepra «Protopiria» (Mësimet e para). Përveç lëndës së zakonëshme të një abetari të asaj kohe (lutje e këngë kishëtare, tregime nga historia biblike e kishëtare, sentenca të shkurtëra dogmatike e morale, të gjitha greqisht), ajo përmban (faqe 3-59) edhe një Fjalor greqisht-arumanisht-shqip. Ky fjalor u hyri mjaft në punë shkencëtarëve si burim për studimin e leksikut të shqipes dhe të rumanishtes.

Aty ka nja 1.200 fjalë shqipe. Shihet se auktori ka dashur të shkruajë një fjalor për popullin, me fjalët e popullit, duke përdorur vetëm ato fjalë të huaja, greqisht e turqisht, që kishin zënë vend në gjuhën e folur. Me gjithëse, lënda s'është aq e madhe, vepra ka rëndësi për gjuhësinë shqiptare, sepse është nga të parët fjalorë shumëgjuhësh dhe sidomos sepse ep një pasqyrë të së folmes së krahinës së Korçës në shekullin XVIII, duke qenë teksti më i vjetër i saj. Pranë fjalëve e formave toskërishte, fjalori ka edhe një sasi fjalësh e formash gegërishte.

Ideja e hartimit të këtij Fjalori tri gjuhësh ka të ngjarë që ti ketë ardhur Kavaliotit nga mendimet filologjike të Leibnicit.

From Dhimitër S. Shuteriqi et al. (Editors), in Historia e letërsisë shqipe, I, Tiranë, 1959, pp. 302-11.

péshë load
i épte = i jépte
lútje prayer
shumëgjúhësh multi-lingual
sasí number; quantity
hartím compilation

LEXIMI I PESEDHJETETRETE

From M. Kuteli, Tregime të moçme shqiptare (second edition), Tiranë (no publication date given), pp. 219-28.

SKËNDERBEU E BALLABANI

Ra një shkulm i madh turqërie mbi Arbërinë; u thye. Ra edhe një tjetër, më i madh e më i fortë: prapë u thye. Edhe i treti, i katërti, i pesti... U thyen shumë shkulme, shumë vjet me radhë. Gjithë këto shkulme i thyen arbërit krenarë e gjithmonë të pashtruar, që kishin kryezot Gjergj Kastriot Skënderbenë, sepse arbërit luftonin me trimëri, me që mbronin truallin e tyre, nderin e tyre, jetën e fëmijëve të tyre. Shumë vjet e në shumë luftra Arbëria e vogël u bë varr i madh për turqërinë. Ushtritë vinin e s'kthehesin prapë. I përpinte dheu.

Pastaj u ngrit e erdhi vetë mbreti i madh i turkut, Murati, me një ushtri si rëra e detit. Edhe ky u thye. Shkoi e mblodhi një ushtri të re, më të madhe se sa të parën, vuri në krye jeniçerët dhe u hodh në luftë, po prapë u thye. Dhe mbreti i madh i turkut, Murati, vdiq tërë helm. «Ah! — tha në çastin e sprasmë, — sa keq më vjen që, më shkoi jeta kot! Shtrova gjithë botën: pushtova Bullgarinë e Sërbinë, zbrita poshtë në Greqi, hodha Tunën e gjërë, shkela tejmatanë fushat e gjëra të Vilahisë e të Maxharisë e s'munda të mposht Arbërinë e vogël... E shtira një herë në dorë, copa-copa, po ma shkuli Skënderbeu...»

Këmbën e Muratit e zuri i biri, mbreti i madh, Mehmeti, që ishte edhe më i vrazhdë se sa i ati. Ky u hodh e pushtoi Kostandinopojën e fortë të rrethuar

shkulm wave; surge
kryezót chief lord
me që inasmuch as
rérë sand
jeniçérët Janissaries, elite of the Turkish Army
i spráspëm last
tejmatánë all the way across
cópa-cópa bit by bit
shkul wrench; wrest
i vrázhdë cruel

me tri palë mure e me shumë pirgje të larta. Si e pushtoi këtë qytet, me të bukurin e më të begatin e botës, Mehmeti ngriti e vuri aty fronin e tij të artë dhe e quajti veten «Ngadhnjimtar». Pas kësaj bëme të madhe, që tronditi tërë Evropën, vendosi të shkelë e të pushtojë Arbërinë, siç e kish porositur i ati në çastin e sprasmë.

Pra, mbreti i madh Mehmeti mblodhi një ushtri të re shumë të madhe, dhe kalorëse dhe këmbësore, nga të gjitha skotat, u vu në krye të saj dhe u nis për në Arbëri.

Mbreti i madh i turkut kish marrë me vete edhe Ballaban Badherin, atë arbërin atdhemohonjës dhe e kish vënë të printe përpara. Ballabani ishte trim, sepse ishte arbër, bir arbëri, po e kish mohuar gjakun dhe fisin e vet dhe luftonte për turkun, që të fitonte ofiqe, lavd, pasuri; ai kish bërë shumë luftra, ish ngjitur i pari në muret e lartë të Kostandinopojës dhe kish ngulur atje flamurin me gjysmë hënëzë. Mbret Mehmeti e kish bërë pasha Ballabanin dhe e mbante në pekule të mëdha, nder për nder. Po nderi i turqërisë ishte helm për Arbërinë, sepse Ballabanit nuk i dhimbsej asgjë që ish arbërore: as toka që shkelte, as plëngu që digje, as gjaku që derdhte.

Me këtë ushtri të fortë mbreti i madh, Mehmeti, e kish mendjen të fjetur: do ta shtronte Arbërinë.

Po Arbëria kish Gjergj Kastriotin.

Kur dëgjoi se turku ish hedhur të shkelte përsëri dheun e Arbërit, Skënderbeu kish mbledhur njerëzit e tij — oh, sa të paktë ishin këta njerëz përpara rrëmetit të turqve e të skotave të tjera! — dhe ish nisur që t'i dalë përpara; ay kish ngritur tendat në një hije shumë të madhe, Arbërit ishin ulur e rrinin buzë një lumi të kulluar; aty hanin, pinin, qeshnin, sikur nuk shkonin në luftë, ku mund të linin kryet, po në dasmë e ngazëllime. Dhe ja, tek hanin e pinin bashkë buzë

pálë line; series
pirg tower
ngadhnjimtár conqueror; victorious one
porosít charge; entrust
kalórëse cavalry
skótë race; racial stock
atdhemohónjës denier of one's country
mohój deny
ofíq office; position
lavd glory
hënëzë moon
pekúl attention; care
plëng property; wealth
rrëmét horde
ngazëllím amusement

lumit të kulluar, panë një turk që vinte kaluar me flamur të bardhë në dorë. Bënë përpara e i prenë udhën.

— Ç'je ti e ç'kërkon këtej?

— Jam lajmëtar i mbretit të madh të turkut e dua të flas me kryezotin e Arbërit, Skënderbeun.

— Zbriti kalit dhe eja me ne.

E morën e ja shpunë Skënderbeut.

Lajmëtari ju fal e i tha:

— O kryezot i Arbërit, mua më dërgon mbreti i madh i turqërisë, që është më i forti në botë, të të pyes: ku do ti të luftosh me mbretin tonë?

Skënderbeu ju përgjegj shkurt:

— Ecë i thuaj le të vijë.

Si u kthye lajmëtari, mbreti i madh Mehmeti e pyeti:

— Më thuaj, o lajmëtar besnik, a e pe ti Skënderbeun?

— E pashë, o mbret i madh.

— Po ushtrinë e tij e pe?

— E pashë.

— Kish shumë ushtri Skënderbeu?

— Ushtri s'kish shumë, po të gjithë ata që ishin, e kishin synë pishë: këndonin e hidhnin vallen e shpatave, prisnin pa durim të merrnin urdhër që të turreshin në luftë.

— Ç'është kjo valle e shpatave, o lajmëtar besnik?

— Një valle arbërore, o mbret i tokës dhe i detit. Të dridhen mishrat kur i sheh ata burra si lisa që hidhen e vijnë rrotull shpatëzveshur, i përpjekin shpatat njëri me tjetrin si në luftë të vërtetë. Më vunë në mes e zunë të hedhin vallen e shpatave, t'i kryqëzonin mbi kryet time, po nuk më prekën fare.

— Pastaj?

lajmëtár messenger
shpúnë (shpíe) brought
píshë sharp; keen
túrrem rush
shpatëzvéshur with naked sword
kryqëzój cross
prek touch

— Arbërit s'e kanë për gjë vdekjen, o mbret i madh; aq më fort vdekjen në luftë. Thonë se vdekja në luftë, me shpatë, është më e ëmbël se mjalti...

Mbreti i madh Mehmeti psherëtiu e tha me vete: «Eh, t'i kisha këta njerëz nën urdhërat e mia, që të luftonin për fronin tim».

Ju kthye përsëri lajmëtarit:

— Ashtu?

— Po, o mbret i madh.

— Përse thonë se vdekja në luftë qenka më e ëmbël se mjalti?

— Sepse, thonë, ne luftojmë për truallin tonë, për lirinë tonë. Ata, o mbret i madh, betohen për shpatën.

— Vetëm për shpatën?

— Jo, edhe për tokën, për ujët, për gurët. Edhe për bukën e krypën. S'dinë parajsë e skëterrë, po vetëm nder e turp. Nderi, thonë, është parajsë; turpi është skëterrë.

— Po Skënderbeu si t'u duk? A ishte i trembur?

— Jo, o mbret i madh: nuk ishte i trembur. Kur vajta unë, e gjeta tek hante e pinte me ushtarët e tij. U ngrit e më priti më këmbë, me të dy duart të mbështetura në dorezën e shpatës, si një perëndi lufte. Më tha shkurt: «Ecë i thuaj le të vijë!»

Mbreti i madh Mehmeti u nxeh e thirri:

— Unë do t'u tregoj arbërve se ç'është vdekja; do të lëshoj ushtrinë time që t'i kositin si bar. Të shohim pastaj në do të jenë të zotë të ngrihen e të hedhin vallen e shpatave.

— Si të urdhërosh, o mbret i madh.

Mbret Mehmeti kërceu më këmbë edhe urdhëroi t'u bien daulleve. Ashtu si tha u bë. U ranë daulleve. Bubulloi tërë fusha, gjëmuan grykat sikur të paskej ardhur dita e pastajme.

Të mblidhen këtu gjithë shqytëtarët e mi!

s'e kánë për gjë don't give a hoot about
betóhem swear
parájsë heaven
skëtérrë hell
i mbështétur supported
kosít cut down
daúlle drum
bubullín roars; thunders
gjëmón thunders
dita e pastájme judgment day
shqytëtár shield-bearer

U mblodhën shqytëtarët e mbretit të madh të turkut e i thanë me një zë:

— T'u shtofshin vjetët, o mbret i madh! Ditët tona në të tuat! Presim urdhër.

— O ju shqytëtarët e mi, — u tha mbreti i madh i turqve Mehmeti, i biri i mbretit të madh Muratit, — më thoni kujt nga ju i bën zemra të ma sjellë këtu Skënderbeun o të gjallë o të vdekur.

Të gjithë e dëgjuan, asnjë s'u përgjegj, sepse u drodhën kur dëgjuan emrin e kryetrimit arbër. Atëhere, në mes të heshtjes, bëri përpara Ballaban Badheri, ai tradhëtari që kish mohuar gjakun e vet dhe luftonte për flamurin e turkut.

— Ç'dhuratë do të më falësh ti mua, o mbret i madh, po të ta sjell Skënderbeun të gjallë a të vdekur?

— Do të të fal nëntëqindmijë dukatë të artë dhe do të të blatoj të gjitha vendet e Arbërit, që t'i sundosh nën hijen time, si pashallëk, sa të jesh gjallë. Do të kesh dorë të lirë të vrasësh e të presësh kë të duash e sa të duash.

— Sonte e ke të lidhur a të vrarë.

Mbreti i madh i turqve u gëzua shumë; ai e dinte se vetëm hekuri mund ta thyejë hekurin, pra vetëm arbëri mund ta thyente arbërin.

Ngriti dorën e bëri shenjë të fillojë lufta.

Ranë të nëntë buritë e ortasë së madhe të jeniçerëve; pastaj ranë të nëntëdhjetë e nëntë buritë e tjera të ushtrisë. Bubulluan daullet prej lëkure bualli të egër e prej lëkure kau të egër. Turqit nxuar shpatat, lëshuan një vikamë të madhe si suvalë deti dhe u hodhën me mburje të madhe në luftë, nën sytë e mbretit të madh Mehmetit, ngadhmonjësit e Kostandinopojës. Ky rrinte përpara tendës së mëndafshtë majë një bregoreje dhe shikonte; shikonte e priste që

dítët tóna në të túat may you live longer at our expense
dhurátë gift
dukát ducat
blatój bequeath
burí bugle
ortë order
búall buffalo
vikámë scream
suválë wave
mbúrje = mbúrrje pride
bregóre = breg

Ballaban Badheri t'i shpinte Skënderbeun të lidhur a të vrarë.

Harkëtarët tatarë shkrehën harqet trishigjetëshe që errësuan qiellin. Ushtria e turqve dukej si një det valë-valë që sulej ta përpinte ushtrinë e vogël të Skënderbeut.

Krisi lufta.

Lumi i kulluar tek kishin qëndruar arbërit u skuq me gjak. Turqit bënin ta kalonin e nuk e kalonin dot. Binin kalorësit megjithë kuaj.

Skënderbeu priste t'i vinin ushtarë të ijerë nga malet, po këta, s'di përse, vononin...

Lufta gjëmonte.

Ndërkaq Ballabani gjeti një vend dhe e kaloi lumin në krye të ushtarëve të tij. Atëhere Skënderbeu i preu udhën atij qenit tradhëtar dhe i thirri arbërisht:

— Hajde, hajde, o Ballaban Badheri! Për një lugë çorbe turku tradhëtove fisin tënd. Të lumtë, o burrë i dheut!

Ballabani u verdh, u drodh, po nuk u praps

Atëhere Skënderbeu i thirri së dyti:

— Ti dashke nëntëqind dukatë të artë dhe vendin e Arberit pashallëk Turqie. Ja tek i ke nën tehun e shpatës sime. Merri!

Ballabani ngurroi.

Skënderbeu i thirri së treti:

— O qen tradhëtar: ja qëllo, ja të të qëlloj!

Qeni tradhëtar bëri përpara me të tijtë dhe qëlloi i pari: hodhi një heshtë.

Skënderbeu bëri t'ja kthejë, po i ra freri nga dora; Ballabani i kish plagosur krahun edhe kalin. Skënderbeu ra poshtë, më gjunjë, pastaj aty për aty brofi më këmbë. Qentë turq lëshuan një thirrmë ngazë-

harkëtár archer
tatár Tatar
hark bow
hark trishigjétësh bow that fires three arrows at once
válë-válë wave upon wave
súlem rush
kúaj (kálë) horses
vonój delay
lúgë spoon
çórbë gruel; porridge
vérdhem become pale; become yellow
prápsem retreat
teh cutting edge; blade
ngurrój hesitate; falter
qëllój strike
me të tíjtë with his men
fre bridle

llimi, u turrën ta qarkojnë. Ballabanit i xixëlluan afër e afër të nëntëqindmijë dukatët e turkut dhe pashallëku i Arbërisë, po ndërkaq Skënderbeu kish mbështetur shpatullat tek një lis i madh dhe kish nisur të loste shpatën. Ata që guxuan t'i afrohen ranë përdhe kapule. Të tjerët u prapsën një çast, pastaj u turrën përsëri, me Ballabanin në krye.

Po ja, ndërsa Skënderbeu po luftonte fill i vetëm në mes të armiqve, zbritën rrembyer nga malet e Arbërisë dymijë malësorë që kishin në krye Dukagjinin e Livetën. Të dymijët vinin shpatëzhveshur, si valishte mali që përlan çdo gjë që gjen përpara. Valishte, sepse arbërit ishin veshur tërë me të bardha. Kur i pa trimat malësorë, Skënderbeu bëri buzën me gas e thirri:

— Mirë se ardhe, o Dukagjin! Pa bëj këtej e më ruaj krahët sa të luftoj me këtë qen tradhëtar, të më shohë se si e luaj me njërën dorë shpatën e se si e bëj flamurin të valojë për nderin e Arbërisë.

Tha kështu e u lëshua mbi armikun si ai zjarri flakëmadh që u bie kallamëve të thatë. Hendeqet u mbushën me krerë pa trungje e trungje pa krerë. Të gjithë ranë a u prapsën, vetëm njëri qëndroi gjer në fund: Ballaban Badheri.

Tani luftonin një me një, arbër me arbër: njëri për nderin e vendit të tij, tjetri për nëntëqind mijë dukatë të artë e për pashallëkun e Arbërisë. Skënderbeu nuk donte ta vriste tradhëtarin, po ta zinte të gjallë. Përnjëmend shpata arbëre e theu shpatën turke dhe Ballabani mbeti duarvarur, kryeulur.

Skënderbeu zgjati shpatën e çiku lehtë veshin e djathtë, ja preu e i tha:

— Shko tani tek yt zot, si qeni te qeni!

Ndërkaq ushtritë e turkut kishin marrë arratinë. Arbërit ja u prisnin udhën valtheve e përrenjve, i gri-

áfër e áfër nearer and nearer
lóste (luaj) brought into play; played
kapúl cornhusk
valíshtë avalanche; landslide
gas = gaz
sa while; how much
flakëmádh great-flamed
kallám reed
trung turnk; body
përnjëménd truly
duarvárur hands hanging
kryeúlur head bowed
arratí flight; migration
grij cut up

nin. Daullet ishin shqyèr e rrukullisur tejetutje, flamurët me gjysmëhënë kishin mbetur drizave.

Ballabani u kthye i gjakosur e kryevarur te tenda e të zot, mbretit të madh të turkut. Ky e pyeti:

— Ballaban kryeplagosur, ç'u bë lëvdata jote? A nuk më the ti se do të ma sillje sot Skënderbeun ja të vrarë, ja të lidhur?

Ballabani ra mbë gjunjë, ju fal mbretit të madh dhe pastaj ju përgjegj:

— O mbret i mbretërve, që sundon mbi gjithë dherat e mbi gjithë detet! Dëgjo pak, mos dëgjo shumë. Skënderbeun nuk e solla dot as të lidhur, as të vrarë, sepse atij nuk i ndihmon vetëm krahu, po i ndihmon gjithë vendi, lisi ku mbështeti krahët, shkëmbi, rrahu, mali, gjithë Arbëria. Unë kam luftuar shumë luftra nën hijen tate, kam ndeshur e mundur shumë burra, po burrë të këtillë, si Skënderbeun, s'kam parë kurrë. [1])

Mbreti i madh i turkut ja ktheu ashpër:

— Ballaban, qasmë kryet e tu që fsheh brenda pabesinë tënde, se dua ta pres, që të shuaj zjarrin e zemrës për tërë këtë ushtri që m'u vra në Arbëri. Ti më pate dhënë fjalën se kësaj here do t'i shtroje arbërit e tu nën këmbët e mia, dhe e shkele këtë fjalë.

Atëhere u bëri shenjë jeniçerëve të tij, dhe ata e rrëmbyen qenin atdhemohonjës, Ballaban Badherin, e shtrinë në një trung e i prenë kryet. [2])

Ndërkaq po afrohej valishta e bardhë e arbërve shpatëzhveshur. Mbreti i madh Mehmeti e pa këtë valishte, i hypi kalit e iku vrap, duke lënë majë kodrës shatoren e tij të mëndafshtë dhe, rreth e rrotull, në fushën e luftës, lulen e ushtrisë së tij të vrarë.

Arbërit e ndoqën gjer tej, po mbreti ikte me vrapin e frikës, ndërsa kumbonin brirët që lajmëronin fitoren e Skënderbeut. [3])

shqýej rip open
rrukulís roll down
tejetútje here and there; all over
kryeplagósur with wounded head
mbë = mbi
rrah forest clearing
i këtíllë = i tillë
qásmë bring me
shatóre tent
kumbój ring out
bri horn
lajmërój announce

Skënderbeu me shokë kish thyer edhe një herë valomën e madhe të turqërisë, që ish derdhur në Arbëri.

---

1) Populli shqiptar me Skënderbeun në krye arriti të korrë fitore pas fitoresh, sepse qe i bashkuar si një trup i vetëm rreth tij. Dhe Skënderbeu u bë i famshëm jo vetëm se qe i aftë, por pse u mbështet tek masa e gjerë e popullit.

2) Kënga e moçme arbëreshe thotë se sulltan Mehmeti nga zemërimi, dha urdhër t'i prisnin kryet Ballabanit. E vërteta historike është se ai e fali dhe, më vonë, e nisi përsëri në krye të një ushtrie të madhe kundër Skënderbeut, për të rrethuar Krujën. Ballaban tradhëtarin e vrau me plumb (atëhere sapo kish dalë arma e zjarrit) trimi arbër Gjergj Aleksi.

Turqit e varrosën Ballabanin në kështjellën e Petrelës.

3) Për të patur një pasqyrë të luftrave dhe të qëndresës së shqiptarëve kundër turkut si dhe të mynxyrave që bënte ky në Arbëri, do të japim më poshtë edhe disa pjesë të nxjerra nga libri i Kritobulit të Imbrosit:

. . «Në pranverë, mbreti (Murati II) filloi luftë kundër ilirëve, që banojnë në breg të detit Jon, në të djathtë, sapo të hysh aty . . . Në kohërat e lashta këta quheshin taulantë dhe mahaonë (haonë) dhe rrojnë *të pavarur dhe askush nuk sundon mbi ta* prej shumë kohësh».

. . . «*Ata mbrojnë vendin e tyre me juqi e sauan as të lidhin paqe me mbretin, as t'i paguajnë këtij haraç dhe nuk pranojnë në asnjë mënyrë t'i shtrohen mbretit*».

. . . «Mbret Murati u hodh në luftë me shumë ushtri dhe fuqi të madhe, shkeli një pjesë të vendit të tyre dhe e shkretoi dhe pushtoi disa kështjella . . dhe bëri plaçkitje shumë të mëdha, po nuk i mundi dot dhe nuk i nënështroi krejt. . . dhe u tërhoq me pre lufte shumë të madhe që ja ndau ushtrisë . . . Por ata (ilirët) . . . u ngritën përsëri».

. . . «Mbreti Mehmeti II nisi luftë përsëri dhe u dynd me tërë ushtrinë në vendin e tyre (të ilirëve) ndërsa gruri kish nisur të piqej; shkeli një pjesë të madhe të atij vendi, prishi drithërat dhe mori plaçkë të madhe lufte, njerëz dhe kafshë të të gjitha llojeve, pushtoi disa kështjella dhe i shkatërroi nga themeli, shkurt, kudo që shkeli, nëpër fushë, zhveshi, grabiti, shkatërroi . . . dhe u kthye në Edrene në fund të verës (1459) dhe një pjesë të presë e mbajti për vete, kurse pjesën tjetër ja ndau ushtrisë».

...«Pasi u çlodh mirë gjithë vitin bashkë me ushtrinë, mbreti (Mehmeti II) filloi të bëjë pregatitje që, në pranverë, të hidhet në vendin e ilirëve (shqiptarëve). *Sepse ilirët (shqiptarët), siç thashë më parë... donin të qëndronin të paraqitur dhe krejt të lirë dhe s'donin të jepnin as haraç vit për vit, si fqinjët e tyre të tjerë, dhe as ushtarë s'donin të jepnin për luftra. Dhe ata nuk kishin dashur t'i shtroheshin as babajt, të mbretit (Muratit II) dhe as vetë atij (Mehmetit II) dhe nuk donin t'i bindeshin aspak,* dhe shpesh, me kryezotin e tyre (Skënderbenë) në ballë dilnin nga kufitë e tyre dhe shkelnin me guxim vendin e mbretit».

...«Kundër këtyre kish luftuar edhe më parë mbreti (Mehmeti II) dhe babai i këtij (Murati II) dhe kishin hyrë në vendin e tyre, kishin grabitur dhe shkretuar dhe kishin pushtuar kështjella dhe kishin marrë shumë bagëti dhe robër dhe kishin bërë pré shumë të madhe».

«Siç thashë, si u pregatit mirë gjatë dimrit, mbreti (Mehmeti II) u nis në pranverë kundër tyre me fuqi të madhe dhe me shumë ushtri, kalorë dhe këmbësorë, duke marrë me vete topa dhe armë të tjera dhe të gjitha të nevojshmet për të ndërtuar një kështjellë, dhe muratorë, zdrukthëtarë dhe shumë hekur dhe bronx».

...«Pra, duke u ngritur nga Edreneja me tërë ushtrinë kalore dhe këmbësore, u nis me nxitim dhe përshkoi shpejt vendin e tij dhe, kur arriti në kufitë e ilirëve (shqiptarëve), ditën e parë vendosi kampin aty, kurse të nesërmen mori ushtarët e armatosur lehtë, harkëtarë dhe hobetarë dhe heshtëtarë dhe shqytëtarë dhe sulmoi qafmalet, të cilat i ruanin me ngulm ilirët (shqiptarët). *Dhe u bë luftë e madhe trup më trup dhe rrëmujë dhe ai lëshoi shumë ushtarë sepse ilirët (shqiptarët) luftonin dhe kundërshtonin me hov të madh».*

Më tej, kronikasi bizantin tregon se sulltan Mehmeti shkretoi tërë pjesën e poshtme të vendit, domethënë fushat, dhe u vuri zjarr drithërave dhe i bëri shkrumb. Shqiptarët ishin tërhequr në malet bashkë me kryezotin e tyre (Skënderbeun) dhe që aty sulmonin paréshtur ushtrinë e turkut. Sulltani e pa Krujën dhe e rrethoi, po nuk e pushtoi dot. Atëhere ndërtoi një qytet (Elbasanin) mbi themelet e një qyteti të vjetër, «në mes të vendit». Që aty ushtarët turq dilnin dhe shkatëronin vendin, grabisnin. Aty mbreti la shumë ushtri dhe sidomos jeniçerë. Pastaj la Krujën të rrethuar dhe u kthye përsëri në Edrene.

LEXIMI I PESEDHJETEKATERT

Nëntori, No. 1 (January), 1974, pp. 10-17.

SHKRIMTARË, ARTISTË E LEXUES PËRSHËNDESIN REVISTËN «NËNTORI» ME RASTIN E 20-VJETORIT TË SAJ

Urimet më të mira bëhen për ditëlindjen e shokut të dashur. Ne kemi një shok të përbashkët që mbushi njëzet vjet dhe vijmë për ta uruar nga zemra për punën dhe luftën e tij të madhe në dobi të letërsisë, artit dhe kulturës sonë socialiste. Ky shok është «Nëntori», i cili, në njëzet vjetët e jetës së tij, kushedi sa herë na ka mbledhur tok për të kuvenduar për letërsinë dhe artin, dhe për ta vënë penën, brushën, daltën dhe pentagramin në shërbim të popullit, Atdheut, socializmit. Ai, ashtu siç e ka mësuar partia dhe shoku Enver, ka punuar pa u lodhur për të propaganduar parimet e metodës sonë të realizmit socialist; partishmërinë proletare, karakterin kombëtar, frymën popullore... Është gëzuar kur ne, shokët e tij, i kemi dhënë vepra të mira dhe me to në krahët e veta ka fluturuar dhe i ka shpënë nëpër gjithë Atdheun, duke jua shpërndarë punëtorëve, fshatarëve, intelektua-

përshëndés	greet
revístë	magazine
Nëntóri	Albanian literary journal
ditëlíndje	birthday
urój	wish
dobí	benefit
brúshë	brush
dáltë	chisel
partishmërí	partizanship

lëve, ushtarëve. Njëzet vjet më parë, kur ka fluturuar me romanet, tregimet, vjershat e këngët nëpër shtëpitë fshatare ndofta nuk ka gjetur dritë elektrike në të gjitha, por ka gjetur llampa vajguri e kandilë. Megjithatë u ka thënë djemve e vajzave: «Lexoméni edhe nën kandil, se këtu flitet edhe për jul» Por tani ai hyn në shtëpitë fshatare e kudo gjen dritë elektrike e u thotë: «Lexoméni, se këtu flitet edhe për dritën elektrike».

Ky shoku ynë, «Nëntori» njëzetvjeçar, e ka ndjekur gjurmë më gjurmë e gjen tonë. Atëhere më 1954, kur nisi udhën për herë të parë, na kërkonte t'i jepnim më shumë romane. Edhe ne kishim dëshirë t'i jepnim më shumë, por mezi i jepnim një roman në vit. Tani ai gëzohet se i japim njëzet romane në vit, për të cilët edhe flet me dashuri, edhe gjen vend në faqet e tij.

Megjithëse në ditëlindjen e shokut nuk bëhen vërejtje e kritika, por «Nëntorit», mund t'ia themi se nuk zemërohet. Vitet e fundit edhe ai u prek nga liberalizmat. Botoi edhe vjersha formaliste e hermetike, botoi edhe ndonjë teorizim të dëmshëm. Por, kur ngriti zërin me të madhe partia kundër liberalizmit, kur ajo tha që të ruajmë si sytë e ballit pastërtinë ideologjike të letërsisë dhe artit nga çdo ndikim i huaj dhe vuri detyra të rëndësishme në Plenumin e saj të katërt për shkrimtarët dhe artistët, shoku ynë «Nëntori» bëri autokritikë për gabimet dhe u zotua të mbajë lart flamurin e realizmit socialist. Dhe ne, në njëzetvjetorin e tij, e urojmë që të mbajë lart flamurin e realizmit socialist dhe të bëhet luftëtar i flakët i vijës së partisë në letërsi, art dhe kulturë!

DRITËRO AGOLLI

vajgúr kerosene
kandíl candle
écje march; walk
Plenúm meeting of the Central Committee between party congresses
i dëmshëm damaging
autokritikë self-criticism
mirëfílltë proper; right
përfshíj include

Njëzet vjet në jetën e një reviste janë mjaft; po kur të mbahen parasysh detyrat që i ka shtruar vetes dhe që e presin atë në të ardhmen, njëzet vjet nuk janë shumë. Duke shikuar me një vështrim përmbledhës punën e kryer gjer tani, kjo punë paraqitet pozitive nga shumë anë, e gjithsesi e pasur dhe e larmishme. Kjo gjë vlen për veprimtarinë e revistës në përgjithësi, vlen në veçanti për krijimin e mirëfilltë letrar, në poezi e në prozë, për fushën e përkthimit, si edhe për kritikën letrare; dishka më shumë mund të përfshihej në të ardhmen krijimtaria

popullore. Viti më vit është zgjeruar rrethi i bashkëpunëtorëve, duke afruar aty në mënyrë shumë të kënaqshme edhe forcat e reja. Në këtë rrugë, me këtë punë të pandërprerë, «Nëntori» ka marrë fizionominë e vet dhe është tashmë revista letrare përfaqësuese e vendit.

Puna që kanë kryer në këto njëzet vjet shokët e redaksisë dhe rrethi i bashkëpunëtorëve është një garanci që revista do të shkojë përpara edhe në të ardhmen dhe që do të arrijë maja edhe më të larta, e udhëhequr si kurdoherë nga mësimet e Partisë e të shokut Enver e, sidomos, nga materialet e fundit të Plenumit IV të KQ të PPSH. Në këtë drejtim shkojnë dhe urimet tona. Furojmë revistës sonë jetë të gjatë, veprimtari pjellore si kurdoherë, dhe që të ndihmojë për të mbajtur të gjallë e të çojë përpara letërsinë shqiptare të realizmit socialist.

PROF. EQREM ÇABEJ

Këto radhë po ua dërgoj nga kantieret e ndërtimit të Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit. Ne, montatorët, të quajtur nga letërsia «zogj shtegtarë të pesëvjeçarëve», edhe këtu, brenda një vepre, shtegëtojmë, sepse numri i kantiereve është i madh, objektet janë me qindra, vepra — sikundër dihet, është më e madhja e ngritur ndonjëherë në vendin tonë. Pas punës, biscdojmë shpesh me librin, me shtypin, dhe domosdo me revistën e dashur «Nëntori», që tani mbush me gëzim 20-vjetorin e saj. Edhe revista vjen këtu, bisedon me ne, na ndihmon në jetën tonë me fjalën e saj të vlefshme, dhe kjo është një lidhje e përjetshme midis fjalës së partishme luftarake të letërsisë, artit dhe shtypit, dhe lexuesve të tyre.

Në këto pak radhë, me të cilat dua të përshëndes revistën me rastin e jubileut të saj, urimi im dhe i shokëve të mi, lexues të rregullt të «Nëntorit», është të na gëzojë përherë e më shumë në të ardhmen me materiale që të pasqyrojnë sa më mirë e më bukur jetën tonë socialiste, vrullin krijues të të gjithëve, edhe të ndërtuesve të veprave të mëdha të socializmit.

Ndërtimi i Kombinatit Metalurgjik tani, në vitin e madh jubilar të 30-vjetorit të çlirimit të Atdheut, ka hyrë në një fazë të re. Tani ne jemi hedhur me një vrull të ri në punë në frymën e Plenumit të 4-të të K.Q. të Par-

zgjerój expand
i pandërprérë uninterrupted
redaksí editorial staff
garancí guarantee
KQ Kometéti Qendrór
pjellór fruitful
dërgój send
kantiér workshop; construction site
montatór assembly worker
pesëvjeçár five-year plan
objékt project; object
i vléfshëm valued
jubilé jubilee
urím wish; greeting
jubilár jubilee (adjective)

tisë dhe të fjalimeve të fundit të shokut Enver Hoxha. Urimet tona për jubileun tuaj janë që, duke u udhëhequr nga këto mësime, revista të bëhet sa më e afërt për ne, lexuesit e saj të shumtë e të apasionuar në të katër anët e vendit, për të kryer kurdoherë me nder misionin që i ka vënë Partia.

MAKSIM MANUSHI
montator, Kombinati Metalurgjik, Elbasan.

Përshëndetjet dhe urimet e mia më të ndiera revistës sonë të dashur, «Nëntori», në 20-vjetorin e tij të parë.

Në të vërtetën, «Nëntori» është më i madh se njëzet vjeç, jo aq nga puna e rëndë që ka bërë, nga lufta e vështirë që ka zhvilluar dhe nga fitoret që ka realizuar, të cilat mund të krahasohen me ato të një organi me stazh të gjatë dhe me pjekuri e përvojë shumë më të madhe, por edhe nga fakti që ai kish filluar jetën e tij, ndën tjetër emër, bashkë me jetën e re të popullit, pothua menjëherë pas fitores së 29 Nëntorit 1944. «Bota e Re» e vitit 1945 dhe pas saj, «Literatura jonë» e viteve 1947--1953 s'ishin veçse po ajo revistë që do të pagëzohej, përfundimisht, 20 vjet të shkuar, me emrin «Nëntori», që gëzon edhe sot, emër që uroj ta gëzojë në shekuj dhe gjithmonë me fitore si ato që ka shënuar në historinë e popullit tonë muaji Nëntor.

Rreth revistës «Nëntori», që filloi botimin e vetë në një kohë kur populli ynë, nën udhëheqjen e partisë dhe të shokut Enver Hoxha, kish hyrë me të dy këmbët në rrugën e madhe të ndërtimit socialist të vendit, u grumbulluan si rreth një vatre të dashur zjarri, që ndizej e ndriçohej nga idetë e Partisë dhe ku kalitnin pendat për luftrat e ardhëshme që e prisnin vendin, shkrimtarët shqiptarë të të gjithë brezave, ata që e kishin njohur një vatër të tillë qysh në vitet e zjarrta të luftës, në ilegalitet, dhe ata që nuk patën rastin ta njihnin, ata që i kishin provuar pendat e tyre në shërbim të popullit qysh përpara ose gjatë luftës dhe ata që sapo hidhnin hapat e para në këtë fushë.

Le të kujtojmë, nga tre brezat që bashkëjetuan,

stazh training; apprenticeship
pothua almost
pagëzój baptize; christen
ndízej (ndez) was lit up
ilegalitét outlawhood; illegality

ata që s'janë sot midis nesh: Aleksandër Xhuvanin e Haki Stërmillin, Milto Gurrën, Ali Asllanin e Dhimitër Paskon, Nonda Bulkën e Mark Gurakuqin dhe, më të riun ndër të gjithë, poetin dhe estetin me shumë perspektivë, Drago Siliqin.

Në faqet e «Nëntorit», në dritën që merrte ai nga Partia, të gjithë ne gjetëm dritën për të krijuar në shërbim të popullit e të revolucionit të tij, gjetëm forcën dhe diturinë për të luftuar çdo ndikim të huaj e frymë të sëmurë, dekadente, që kish lënë, ku më shumë e ku më pak, e kaluara në ndërgjegjen dhe botëkuptimin tonë. Aty, në ato faqe, provuan për herë të parë pendat e tyre brezat e tjerë pasardhës duke nisur nga ata që janë sot përfaqësues të merituar të artit e të letërsisë sonë kombëtare të realizmit socialist gjer te ajo armatë filizash të rinj të ditëve të sotme (pra, e arthmja e nesërme e kësaj fushe) që manifestuan aq bukur, në konferencën e tyre kombëtare të nëntorit të kaluar, talentin krijues dhe qartësinë e tyre ideo-estetike, vendosmërinë e ndërgjegjshme për të vazhduar më tej, në dritën marksisteleniniste të Partisë, rrugën e pararendësve.

E çmuar ka qenë puna e «Nëntorit» në popullarizimin dhe njohjen e traditave më të mira letrare të së kaluarës (Naimit, De Radës, Çajupit, Nolit, Mjedës e Migjenit me shokë), në zbulimin dhe popullarizimin e thesarit tonë artistik të krijimtarisë popullore, në ngritjen ideo-profesionale të shkrimtarëve dhe në ndihmën që u ka kushtuar talenteve të reja.

Ndonse akoma djalosh nga mosha, në jetën tonë të re prej vetëm 30 vjetsh, «Nëntori» është quajtur dhe quhet, me të drejtë, si më i moshuari dhe më i pjekuri në revistat e gazetat letrare të kohës. Sigurisht, në krizën e tij të rritjes ka pasur edhe ai dhëmbjet e tij, lajthitjet e tij, por ato peshojnë pak në bilancin e pasur të punës pozitive që ka kryer 20 vjet resht në shërbim të çeshtjes.

Mësimet e plenumit IV të Komitetit Qendror të Partisë dhe të fjalimeve të shokut Enver gjatë vitit të kaluar, të cilat hodhën dritë edhe më të madhe mbi çështjet e ndërlikuara të estetikës, mbi metodat dhe qëllimet e kamufluara të armiqve imperialistë e revizionistë modernë për të depërtuar me ideologjinë e tyre të degjeneruar në artin dhe kulturën tonë socialiste, janë, ashtu si për çdo qytetar të Republikës, edhe për «Nëntorin» tonë, arma më efikase e luftës për të ruajtur të pastra si kristali parimet jetëdhënëse të marksizmë-leninizmit, si në të

estét student of aesthetics
ku më shúmë e ku më pak more or less, here and there
pasárdhës successive
armátë armada
filíz shoot; stalk
vendosmërí resolve
pararéndës predecessor
thesár treasure
ndíhmë help; assistance; aid
djalósh youthful
móshë age
lajthítje error
i kamuflúar camouflaged
i degjenerúar degenerate
efikús efficient
jetëdhënës life-giving

gjitha fushat e jetës, edhe në atë të letërsisë e të arteve.

Fitore të plotë e të shkëlqyer në këtë luftë i uroj, mbi të gjitha, «Nëntorit» tonë të dashur në jubileun e 20 vietve të tij.

SHEVQET MUSARAJ

Linde dhe u rrite në përpjekje për ndërtimin e socializmit. U bëre një tribunë luftarake për përçimin e idealeve të Partisë në masat e popullit duke dhënë një kontribut të çmuar në edukimin ideo-estetik të tyre. Me materialet e botuara u ke dhënë një ndihmë të veçantë edhe institucioneve tona artistike. Ne punonjësit e teatrit jemi të bindur se në të ardhmen, duke u frymëzuar nga materialet e Partisë dhe sidomos nga vendimet e Plenumit IV, duke patur parasysh gjithmonë mësimet e shokut Enver, revista «Nëntori» do të forcohet dhe do të lozë një rol akoma më të madh edukonjës, sidomos në fushën e letërsisë dhe arteve.

Uroj nga zemra që botimet tuaja të ndihmojnë më shumë në zhvillimin e teatrit tonë.

NAIM FRASHËRI

Edhe për ne muzikantët, revista «Nëntori», në rrugën e saj njëzetvjeçare, është bërë tribunë ndriçuese e vijës së partisë për problemet e artit, me orientimet dhe artikujt me përmbajtje ideoestetike, po ashtu në rrahjen e problemeve nga më të ndryshmet, me kritikat, reçensionet e veprave, vështrimet analizuese etj.

Revista «Nëntori», në periudha të ndryshme, bile do të thoshnja, me hope, na ka dhënë edhe ndihma të shumëanshme për ngritjen tonë ideoprofesionale duke botuar studime të ndryshme, shkëmbim përvoje nga kompozitorët më të mëdhenj botërorë. Të tilla shkrime nuk duhet të mungojnë kurrë në këtë revistë. Megjithëse akoma jo në masën dhe përpjestimin e duhur revista «Nëntori» ka botuar herëpashere artikuj kritikë për ve-

<u>përçím</u> carrying
<u>të lózë (lúaj)</u> play
<u>reçensión</u> review
<u>vështrím</u> inquiry
<u>me hópe</u> not continuously; sometimes
<u>i shumëánshëm</u> manifold
<u>përpjestím</u> ratio; proportion

prat tona muzikore me vlera të mira ideore dhe profesionale. Mendoj se në të ardhmen revista do ta shtojë interesin edhe për këtë sektor të artit siç është muzika. Kohët e fundit është reduktuar shumë kronika kulturale (muzikore). Mendoj se ajo duhet të zejë një vend të mirë dhe të organizuar në lëndën e kësaj reviste, mbasi aktivitetet artistike na mbesin pa jehonën e duhur dhe pa vlerësimin përkatës.

I uroj revistës suksese të mëtejshme në pasqyrimin e vijës së partisë në lëmin e letërsisë dhe arteve, në paraqitjen sa më denjësisht të mendimit artistik dhe të jehonës së gjithë jetës sonë artistike.

TONIN HARAPI

Në vitet e para, kur dilte revista «Nëntori», isha nxënës në klasat e ulta dhe dëshira ime për të vizatuar sa vinte e rritej më shumë. Dhe kujtimet e mia të para me revistën «Nëntori» lidhen pikërisht me ato pak vizatime që botoheshin atëhere, por që mua më bënin aq përshtypje. Revista «Nëntori» u bë një nga revistat më të dashura aq më shumë kur unë, më vonë, fillova të lexoj me ëndje poezitë, tregimet e shkrime të tjera letraro-artistike.

Kanë kaluar 20 vjet. Revista «Nëntori» pritet e lexohet me shumë interes jo vetëm nga shkrimtarë e artistë, por edhe nga masat e gjëra të popullit. Poezitë apo tregimet, novelat dhe shkrimet kritike, vizatimet dhe riprodhimet e ndryshme të shkrimtarëve dhe artistëve, shumë herë edhe krijimet e para të tyre, kanë zënë vend në faqet e kësaj reviste dhe, nëpërmjet saj, janë bërë të njohura nga qindra lexues.

Duke botuar veprat më të mira që kanë pasqyruar jetën, punën e luftën e popullit tonë, vepra këto me frymë të lartë partishmërie, revista «Nëntori» ka milituar, krahas organeve të tjera të shtypit tonë, në formimin ideoestetik të artistëve tanë. Studimet, kritikat, mendimet për probleme të ndryshme të letërsisë e artit të bazuara në shkencën materialiste marksiste-leniniste e materialet e partisë sonë kanë ndikuar në trajtimin e drejtë të problemeve, e kanë ndihmuar masën e shkrimtarëve e artistëve në krijimin e një botëkuptimi të shëndoshë teorik.

idéor ideational
siç është as is
reduktúar reducing; reduced
kroníkë chronicle
lëndë material
vlerësím evaluation
përkátës pertinent
denjësísht worthily
vizatój draw
vizatím drawing; sketch
riprodhím reprint; reproduction
militój have weight or effect
bazój base

Ajo ka qëndruar shumë pranë krijimtarisë së çdo fushë me problemet e shqetësimet që kanë dalë.

Por me gjithë sukseset e meritat, në revistën «Nëntori», ashtu siç u theksua në materialet e partisë e fjalimin e shokut Enver në Plenumin IV të KQ, zunë vend kohët e fundit, si rezultat i presionit të ideologjisë së huaj borgjeze-revizioniste dhe uljes së vigjilencës, disa teorizime të gabuara, që përligjnin modat e huaja dekadente, përbuznin traditën nën maskën e luftës kundër konservatorizmit, teorizime këto që ndikuan negativisht në krijimtarinë letraro-artistike. U botuan gjithashtu vepra me prirje të theksuara liberale e të meta ideore e me huazime të huaja që s'përputhen me parimet e artit të realizmit socialist. Këto të meta, që u vërejtën dhe në revistën «Nëntori», me siguri nën udhëheqjen e partisë do të luftohen vazhdimisht prej saj duke mprehur vigjilencën e duke pasur një ndihmë më të afërt nga të gjithë krijuesit, në mënyrë që çdo faqe dhe rrjesht të jetë i pastër, që revista të militojë sa më me shumë forcë në arritjen e qëllimeve të larta të socializmit.

Natyrisht, si piktor, në këtë rast, unë dëshiroj që revista «Nëntori» kolektivi i saj, shokët e mi krijues në fushën e arteve figurative, të nxiten më shumë e të shkruhet më tepër për probleme teorike të arteve figurative, se gjer tani janë botuar pak artikuj studimorë e kritikë.

Duke përfunduar, si lexues i rregullt i saj, i uroj revistës «Nëntori» me rastin e 20 vjetorit jetë të gjatë e suksese të vazhdueshme për kontributin e madh që jep në edukimin ideoestetik të masave tona punonjëse.

ÇLIRIM CEKA

Uroj revistën «Nëntori» të ketë jetë të gjatë e të shëndetshme! Uroj që në faqet e saj të gjejnë akoma dhe më shumë vend problemet që kanë të bëjnë me kinematografinë tonë të re, por të fuqishme e të larmishme! Uroj që mësimet e lavdishme të Partisë sonë të pasqyrohen më me forcë e mprehtësi në shkrimet e saj, në rrugën e saj, në punën e luftën e saj për suksese të mëtejshme të artit të realizmit socialist.

DHIMITËR ANAGNOSTI

shqetësím preoccupation; unrest
vigjiléncë vigilance
përlígj legitimize
i theksúar accentuated
huazím borrowing
e mëtë defect
studimór studied; scholarly
mprehtësí keenness

LEXIMI I PESEDHJETEPESTE

GABIMI I NJË SHOFERI

I

Ai kish filluar të shkëputej nga unë dhe, kur e takoja, më mbyste me erën e alkoolit. Prandaj atë natë vendosa të pres deri vonë. Një ditë më parë, më kishin rënë në duar kujtimet e shoferit Gil dhe po më kalonin orët pa i ndier. Në rrugën kryesore u rralluan lëvizjet, qyteti po binte në heshtjen e natës. Nga një ndërtesë e lartë karshi hotelit vinte deri në dhomën time melodia e violinës cigane. Pas pak edhe ajo pushoi e radio Tirana njoftoi mbylljen e emisioneve. Prita akoma, deri sa akrepat mbuluan njeri tjetrin mbi orën dymbëdhjetë, por ai nuk erdhi.

Në mëngjez zbrita shkallët e hotelit dhe u futa në lokalin e kafes. Shyqyriu po rrinte më këmbë pranë banakut, me gotën e fërnetit përpara. Përshëndeta banakierin dhe porosita një kafe.

— Si u gdhive, more shok, pse s'më flet? — më tha Shyqyriu, duke më shikuar me bisht të syrit.

— Si në krevat, po ti si u gdhive? — iu përgjigja i vrejtur.

— Si në makinë.

— E pse u gdhive në makinë, ç'hall të zuri?

— U ktheva vonë dhe... hoteli ishte mbyllur.

— Ashtu ë?... Hajde të ulemi.

— S'ka gjë, mirë jemi dhe më këmbë.

— Atëhere, paske fjetur rehat mbrëmë!

Mora kafen dhe u ula në një tavolinë. Pas pak erdhi dhe ai e më vuri përpara një gotë konjak.

— Po këtë ç'e deshe?

— Ta pish ti.

— Unë? Nuk e kam pirë ndonjë herë në mëngjes.

— Epo s'ka gjë, e ke pirë ndonjëherë në darkë, njësoj është.

— Jo. Janë dy soje: në darkë shkoj në shtrat, kurse tashti do të shkoj në makinë. Kam tetëdhjetë kilometra për të bërë sot.

—Me fal, shoku shofer i rregullt, — më tha ai duke më shikuar nën vetulia dhe e afroi gotën për vete, por unë e ndalova.

shkëpút separate
alkoól alchohol
ndiér (ndiej) sensing
rallój = rrallój diminish; thin out
karshí opposite
cigán gypsy
emisión broadcast; transmission
akrép clock hand
lokál locale
banák bar; counter
fërnét type of alcholic beverage
banakiér bartende
Si u gdhíve How did you sleep
fjétur (fle) slept; sleeping
Po këtë ç'e déshe? What's this for?
soj kind; sort

335

— Atë nuk do ta pish. Do t'ja kthesh prapë banakierit, ndryshe, do ta derdh në pështymore.

— Ç'ke kështu xhanëm, që je ngritur me xhinde sot?

— Ç'kam ë? Hëm... si duket u dashkan mbledhje të veçanta, që të kuptohemi bashkë, pasi bisedat shoqerore nuk të bëjnë efekt ty?

— Po pse, more vëlla, ç'ka ngjarë? — më pyeti ai si krejt i pafajshëm.

— Ku e ke makinën? — e pyeta i nxehur.

— Në axhensi, ngarkuar.

— Për ku?

— Për në Durrës.

— Si duket, para se të fillosh një udhëtim të gjatë, duhet të kthesh tri gota fërnet!

— Jo, ore, për nder, kjo është e dyta. — m'u përgjigj ai me buzën në gaz, prandaj dhe unë ja ktheva me të keq:

— Nuk ke turp... pa shkelur akoma të njëzet e pesat, po merr rrugën e një pijaneci. Mos kujton se të punosh larg ndërmarrjes sate, larg rregullit dhe disiplinës kolektive, (ne kishim gjashtë muaj që punonim tranzit në një qytet të jugut) mund të bësh si të të dojë qejfi? Nuk ke faj ti, jo... — i thashë tërë nerva dhe u ngrita nga tavolina. Kur i u afruam makinave, ai më hodhi duart në qafë dhe ja filloi me të tijat.

— Nuk të shoh dot me xhinde, më fal ore, për nder, në më pafsh më me gotë në dorë, të më pështysh. Më fal, shoku «kapiten» (kështu më quante ai, qysh ditën që bëmë udhëtimin e parë me makinë, nga që unë, i tërhoqa vërejtjen për shpejtësi). E keqja isht.e, se dhe unë nuk e mbaja dot gjatë inatin ndaj tij...

Shyqua u nis para meje. Në të dalë të qytetit, u ndal dhe mori një vajzë që mbante në dorë një çantë të zezë.

Ndërsa pranë kabinës sime u gjëndën dy burra me një nuse të re dhe një ushtar.

— Shoku shofer, më merr deri në Lushnjë, të lutem? — më tha njeri nga burrat.

— Shofer, deri në Vlorë, po deshe, — më foli ushtari me zë të lartë.

— Nuk shkoj, jam për Elbasan.

— Po mirë, deri te kthesa e Lushnjës, se më mbaron leja sot.

— Hajde ushtar!

pështymóre spitoon
xhánëm by golly
xhind evil spirit
u dáshkan it is necessary
ç'ka ngjárë what happened
i pafájshëm blameless
pijanéc drunkard
sáte your
tërë nérva nervously; all nerves
me të tíjat with his ways, mannerisms
pështýj spit
Shýqua nickname for Shyqyriu
léjë leave; permission
úrë bridge
vajgurór petroleum
zik-záke zig-zags

II

Zakonisht Shyqyriu ecte shpejt, kurse atë ditë nuk po i kalonte të tridhjet e pesat.

Pasi kaluam kthesat e urës vajgurore dhe dolëm në rrugë të drejtë, makina e Shyqyriut filloi të bënte zik-zake nga një anë e rrugës në tjetrën. Në trup më shkuan mornica, ç'të ketë ky? mendova me vete. Shkela pedalinën e gazit dhe iu afrova për ta tejkaluar, por ai nuk ma hapi rrugën, nxori pak kokën nga kabina dhe i dha makinës shpejtësinë maksimale.

Atëhere e kuptova, se nuk kishte ndonjë difekt, por si dukej diçka ngatërronte me atë vajzën e re...

Nuk pata kohë të mendoja më tepër për këtë, pasi ushtari më ndërpreu:

Ç'pati ai që desh shkoi në kanal?

— Nuk e di për nder, ndoshta ndonjë bllokim timoni...

Tek varrezat e Lushnjës, ku rruga kthehet për në Fier, makina e parë frenoi dhe vajza me çantë të zezë u hodh menjëherë në tokë duke përplasur derën e kabinës.

— Këtu do të zbres unë, shofer, — më tha ushtari dhe më preku lehtë në sup, pasi e pa që unë nuk e kisha mendjen.

E ndalova makinën përpara vajzës dhe zbrita gjoja të kontrolloj një herë livelin e vajit.

Ushtari doli përpara makinës dhe më zgjati dorën, duke më falenderuar, por mënd më rrëmbeu me vete, nga që një autobuz, ndaloi në drejtim të Fierit.

Në kohën që po shtrëngoja fijet e distributorit, nga mbrapa dëgjova zërin e vajzës, që, pa e vënë re, ishte afruar pas meje:

— Më falni një minutë, shofer!

— Urdhëroni, — iu përgjigja unë, duke nxjerrë kokën nga kofanua e motorit, që e kisha ngritur në tako.

— E njihni këtë shoferin, që kaloi para jush? — pyeti ajo, duke shikuar targën e madhe të karrocerisë sime.

— Po, e njoh, në një ndërmarrje punojmë.

— Ashtu? Kini tjetër maskara të tillë në ndërmarrjen tuaj? — pyeti ajo duke lëshuar shkëndija nga sytë.

Nuk besoj se do të më kishte rënduar më shumë kofanua, po të më zinte kokën në buzët e radiatorit. E humba një çast, sikur të isha unë ai maskarai i zënë në çark. Pastaj e pyeta në tym:

— Përse e keni fjalën, ju lutem?

mornica shivers
pedalinë pedal
tejkalój pass
ngatërrój mess up
bllokím blockage
timón wheel
varrézë cemetery
frenój brake
gjója supposedly
kontrollój check; control
falenderój thank
mënd almost
kofanúa e motórit hood
tako supporting rod
targë license plate
karrocërí carriage
maskará scoundrel
shkëndí spark
lëmsh lump
grýkë throat
zinxhír zipper

— Per ate aventurierin, qe kaloi para jush dhe me te cilin jeni në një ndërmarrje, — m'u përgjigj ajo prerë dhe duke u dhënë fjalëve të fundit një ton të fortë ironik.

Nuk dija ç'të bëja, m'u bë një lëmsh në grykë, sikur do të më zinte frymën. M'u duk sikur një mjergull më mbuloi sytë dhe unë nëpër të shikoja një herë aventurierin, që ish dhe shoku im, një herë motrën time, pastaj përsëri vajzën me çantën e zezë që qëndronte në këmbë pranë meje.

— Më falni, moj motër, por...

— Si e quajnë atë, ju lutem? — më ndërpreu ajo duke hapur zinxhirin e çantës.

— Shyqyri Haxhia, parku automobilistik... iu përgjigja unë, kurse ajo e mbajti shënim me një stilolaps të kuq dhe shtoi:

— Besoj se ka ardhur koha t'u tregoni vendin tipave të tillë, që duan ta mbulojnë me turp profesionin tuaj.

Këto fjalë ajo m'i tha shumë e qetë, sikur të m'i thosh motra ime, prandaj m'u duk se më rënduan më shumë...

— Na falni për këtë, poooo... ku punoni ju?

— Nuk ka rëndësi kjo, — tha vajza me të mirë, — besoj se do ta mësoni një ditë. Rrugë e mbarë — përfundoi ajo dhe u nis drejt një rrugice fshati.

Pasi kalova qytetin, e lëshova makinën përpara, me shpejtësi. Akrepi i kilometrazhit kaloi 60,65 dhe shënoi 70 km në orë, sytë i kisha fiksuar në shiritin e zi të xhadesë, që përpiqej poshtë turirit të makinës. Duart i kisha të sigurta, kurse në shpirt ndjeja një boshllëk të thellë. Për herë të parë m'u neverit aq shumë shoku im, sa i bëra vetes këtë pyetje: — përse më duhet një shok i tillë? Sa dëshirë kisha ta zija në rrugë. Nuk e dija ç'do të bëja, por për një gjë isha i bindur, se ai do të ishte çasti që do të më ndante përherë me të. Por kjo nuk ndodhi, pasi Shyqyrinë nuk e takova deri në Rrogozhinë, që mora kthesën e Elbasanit. Pas tri ditësh u ktheva në park për t'i bërë shërbimet përkatëse makinës. Në kapanonin e brigadës ishte dhe makina e Shyqyriut. Të nesërmen, aty nga ora dhjetë, qendra e zërit njoftoi punonjësit për një mbledhje të jashtëzakonëshme, në orën katër pasdite.

Mbledhja filloi pa ndonjë ceremoni. Në presidium zunë vend katër punëtorë, sekretari i partisë dhe kryetari i komitetit profesional. «Provokuam këtë mbledhje të organizatës, për të diskutuar gjestin e ulët të një punëtori tonë», — tha kryetari i komitetit profesional dhe nga xhepi i xhaketës nxori një letër, e hapi dhe lexoi:

stiloláps ballpoint pen
akrép needle
kilometrázh speedometer
fiksój fix
shirít strip
xhadé highway
turí snout; muzzle
boshllék emptiness
neverítem be disgusted with
kapánon shed; hangar
qéndra e zérit public address system
provokój call; provoke
bëj fjálë speak
sjéllje behavior
pjestár member
sadó pak no matter how little
kënd corner; angle
rastësísht by chance
bajáte tasteless

«Drejtorisë së ndërmarrjes... për kolektivin:. «Më vjen keq, që kjo letër bën fjalë për sjelljen e ulët të një pjestari të kolektivit tuaj. Unë kam parë në shtyp e kam dëgjuar për sukseset tuaja dhe jam e bindur se gjesti, për të cilin bën fjalë kjo letër nuk e errëson dot punën tuaj revolucionare, por sado pak ju turpëron juve. Prandaj unë po ju shkruaj, që t'a dënoni vetë këtë qëndrim të huaj për shoqërinë tonë...»

Në sallën e madhe të këndit të kuq ra një heshtje e rëndë. Të gjithë po prisnin si në ankth...

«...Rastësisht, udhëtova me një shoferin tuaj nga Berati në Lushnjë. Unë u solla me të ashtu siç mund të sillet një vajzë e edukuar në shoqërinë tonë. Kurse ai iu përgjigj këtij qëndrimi me ca fjalë bajate.... Megjithëse unë, përsëri me gjakftohtësi, i tërhoqa vëmendjen, ai vazhdoi të tijat derisa unë bëra të hidhem nga makina së cilës ai ia shtoi shpejtësinë. Vetëm ky qëndrimi im e detyroi për të mos ngacmuar më. Këtë gjest shikojeni vetë shokë dhe zgjidheni ashtu siç i ka hije një kolektivi revolucionar të ditëve tona. Unë jam arësimtare në shkollën 8 vjeçare katundi M. Kam ardhur këtu vullnetarisht, nga një rreth i largët, për të edukuar brezin e ri, që të mos ketë në të ardhmen në gjirin e tij tipa aventurieri si Shyqyri Haxhia..»

Salla u elektrizua, fytyrat lëviznin sa në një anë në tjetrën për të gjetur Shyqyrinë, që rrinte si i habitur andej nga qoshja e sallës.

— Kjo është, more shokë, tashti si mendoni ju?

— Me leje, — e rgriti zërin një shofer i gjatë, nga fundi i sallës.

— Urdhëro folë!

— Jooo... unë them, të na flasë, një herë ky shoku, që akuzohet. Ku di unë, more vëlla, ne e njohim për shofer të mirë Shyqon...

—Po, po, po, të flasë vetë! — u dëgjuan zëra.

Nga qoshja e sallës u ngrit Shyqyriu, duke u munduar të tregohej i qetë, por në fytyrë qe bërë spec.

— Ajo letra nuk është e vërtetë, shokë, unë kam dy vjet këtu dhe nuk më është ndjerë zëri për keq. Me plan jam mirë... makinën e kam mbajtur si jo më mirë...

— Mirë, mirë, këto i dimë dhe ne të kemi vlerësuar. Tashti është fjala për një gabim tëndin të rëndë, për këtë folna, — ndërhyri sekretari i partisë.

siç i ka híje as it befits
vullnetarísht voluntarily
qóshe corner
spec pepper
nuk më...keq no one has heard evil spoken of me
bën vakí it happens
kurájë courage
i pafájshëm innocent
i ngatërrúar complicated
ne márrim në qáfë we do harm
tornitór lathe operator

— Po, po, ja për atë do... flas, shoku sekretar. Unë nuk kam bërë asnjë gjë nga ato që thotë letra. Unë zgjata një herë dorën përpara saj, për të mbyllur derën që e kish lënë hapur dhe ajo si duket e ka marrë për keq...

— E pooo, kjo bën vaki, more vëlla, — tha një shofer aty pranë tij, duke shikuar si me habi shokët. Ky i dha kurajë Shyqos për të vazhduar si i pafajshëm.

— ...Kështu ka qënë, për nder, more shokë...

— Me leje, more shokë të presidiumit, po pushoni, more shokë një herë të flasim.

— Urdhëro, Dyl, folë, mbani qetësi, shokë! — e ngriti zërin kryetari.

— Unë them, more shokë, se kjo punë duket si shumë e ngatërruar. Në qoftë se e ka bërë këtë gjest Shyqua, duhet kritikuar rëndë, po... si të them unë?... sikur të mos jetë ashtu, ne marrim në qafë kot shokun.

— Jo, shok, nuk është qëndrim ky, «Dashko ta marrësh në qafë ti! Dashko ta «kritikosh rëndë». Mos harro se ti je kritikuar për vete, për këto gjëra, para se të flasësh përpara kolektivit, vuri gishtin kokës! — ndërhyri i nxehur një tornitor.

— Shoku Remzi, prit, të lutem, lere të mbarojë njëherë fjalën, — ia priti dikush nga mezi i sallës.

— Nuk është diskutim ai, more shokë. Këtu bëhet fjalë për një gjest që na turpëron të gjithëve. Kurse Dyl Sabriu na i lustron gjërat, — tha tornitori dhe u ul tërë mllef.

— Edhe unë jam dakord me këtë shokun parafolës, — e mori fjalën shoferi pararojë Sherif Gjoni, — këtu nuk ka vënd për diskutim me hamendje. Letra që i ka ardhur kolektivit ka adresën e plotë të dërguesit. S'ka asnjë arësye për të dyshuar. Ne kemi një detyrë të lartë karshi popullit. Dhe në skajin më të largët të atdheut makina shpie bukën, dritën dhe kulturën. Por ka tipa të veçantë, që me gjeste kaq të ulta, i veshin profesionit tonë një nam të keq. Unë mendoj që Shyqyriut t'i hiqet e drejta e profesionit për një vit dhe të kalojë në brigadën e investimeve.

Salla filloi të ziejë si koshere bletësh. Disa aprovonin me kokë duke bërë shenjë nga presidiumi, disa të tjerë bisedonin me njeri tjetrin. Aty nga rreshti i parë një pompiste e ngriti zërin:

lustrój beautify; embellish
dakórd accord
parafólës previous speaker
pararójë van; vanguard
haméndje guessing
dërgúes sender
skaj border; reach
investím investment
pompíst pump-operator
avásh take it easy
repárt section
kovaçánë blacksmith shop
keqkuptój misunderstand

— Ashtu të bëhet, shoku Sherif, diskutoni drejt.

— Avash ti, moj shoqe, mos e merrni nxituar të shkretën, — ndërhyri një i repartit të kovaçanës.

— Unë them që të flasë edhe një herë Shyqyriu. Të tregojë të vërtetën dhe.... ta shikojmë më mirë..

— Unë ju thashë një herë, shokë... për fder ajo është keqkuptuar. Unë... gjykoni vetë, ju të gjithë më njihni... — u përgjegj Shyqyriu.

Ai ishte i sigurtë se nuk kishte dëshmi tjetër për fajin e tij veç asaj letre, prandaj po mashtronte me hipokrizi shokët... Ndodh që në natyrën e njeriut grumbullohen, qoftë edhe instinktivisht, shumë të keqia. Secila nga këto e shëmton njerinë, por më tepër nga të tjerat e shëmton atë gënjeshtra e ndërgjegjëshme. Pikërisht ajo me të cilën Shyqyriu mundohej t'i shpëtonte përgjegjësisë.

Kjo më shtoi neverinë për atë njeri, që ishte shoku im, më i afërt. Ne ishim rritur bashkë dhe bashkë po punonim në profesionin, për të cilin patëm ëndërruar qysh në bangot e shkollës.

Vitet kishin thurur në mes nesh një shoqëri të sinqërtë dhe ja, kjo shoqëri doli para një prove të rëndë. Unë e doja shumë Shyqon, prandaj dhe s'kisha ditur t'i luftoja gabimet e tij, që nxorën veshët atje në jugë, larg kolektivit dhe familjeve tona.

Ai është nga ata tipa me një natyrë të theksuar aktive dhe që veprojnë në emër të ndjenjave momentane e jo të arësyes. Këta tipa gabojnë lehtë, edhe Shyqua gabonte dhe unë i flisja shpesh. Por jo me këmbëngulje dhe me ashpërsi, ashtu siç duhen goditur qysh në fillim gabimet e shokut, po me butësi, se mos i thyeja zemrën, në emër të asaj dashurie shoqërore që nga ndonjëherë të vret...

Dhe tashti që ai kish shkelur në dërrasë të kalbur unë e ndjeja veten ngushtë...

— Si të veproj — mendoja me vete. — Të ngrihem t'jua tregoj shokëve të vërtetën? — Atëhere... ai nuk do të vijë nesër me mua. Unë do të nisem me një tjetër në jugë. — Ktheva kokën dhe i hodha shokut të fëminisë një shikim vjedhurazi. Ai rrinte me kokën mënjanë dhe duart po i shtrëngonte me njera tjetrën sikur diçka kishte vënë midis tyre për ta dërmuar... Përsëri më erdhi keq, por në çast arësyeja më pëshpëriti fjalët e autores së letrës: «Besoj se ka ardhur koha t'u tregoni vendin tipave të tillë, që duan të mbulojnë me turp profesionin tuaj». — Ngrita dorën për të marrë fjalën.

faj guilt
mashtrój lie
secíla each one; every one
shëmtój stain; uglify
bángo desk
thur weave; knit; fence
shoqërí cameraderie
që nxórën...júgë which set them on their ears down in the south
momentán momentary
këmbëngúlje insistence

— Urdhëro, shok, folë: Pa dëgjoni, ju lutem, se ky duhet ta dijë më mirë, pasi ka punuar bashkë me Shyqyriun, — tha kryetari i komitetit.

— Unë mendoj se... në raste të tilla ne duhet të mbajmë qëndrim të drejtë. Letra që u lexua është e vërtetë. Shyqyriu është plotësisht fajtor.

Në sallë ra një qetësi e thellë. Ndonjë shofer, shikonte shokun tjetër, pranë si me habi, nga që unë, shoku më i ngushtë i Shyqos, po flisja keq për të.

— Po, shokë, kështu është. Unë nuk mund ta harroj pyetjen që më bëri vajza që ka shkruar atë letër. «Kini tjetër maskara të tillë atje në ndërmarrjen tuaj?» — më tha ajo.

Këto fjalë ranë si bombë në sallë, prandaj një shok nga presidiumi u ngrit dhe vendosi qetësinë. Kurse unë vazhdova:

— Këtu kam gabim dhe unë shokë, megjithëse i kam folur shpesh herë, për çdo sjellje të pahijëshme gjatë gjashtë muajve atje në jugë, ai nuk u vuri rëndësi fjalëve të mia Shkurt, unë nuk munda ta ndreq. Por këtë që nuk bëra dot unë, s'ka dyshim që do ta bëni ju. Shyqyriu, duhet ta ndjejë thellë gabimin e tij dhe të ngrihet e të dënojë veten përpara kolektivit — përfundova unë, duke kthyer kokën nga fundi i sallës, ku Shyqyriu kish marrë kokën në duar, sikur ta kishin zënë një palë ethe të forta...

Siri Sulejmani, «Gabimi i një shoferi,» Nëndori, No. 1 (January), 1970, pp. 50-56.

dërrásë board; plank
i kálbur rotten
veprój act
fëmíní childhood
vjédhurazi stealthy
fajtór guilty
sjéllje behavior
i pahíjëshem tasteless
një pálë éthe të fórtë a strong fever

LEXIMI I PESEDHJETEGJASHTE

From Enver Hoxha's «Report to the Sixth Party Congress,» Nëndori, No. 12 (December), 1971, pp. 4, 22-27.

Lufta ideologjike dhe edukimi i njeriut të ri

Zhvillimi i revolucionit në fushën e ideologjisë e të kulturës vitet e fundit është karakterizuar nga një luftë frontale klasore kundër të gjitha formave të ideologjisë së huaj, duke filluar që nga mbeturinat e vjetra, që vijnë nga thellësitë e shekujve, e deri tek ndikimet e sotme të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Qëllimi themelor i kësaj lufte është revolucionarizimi i mendjes dhe i ndërgjegjes së njerëzve, i gjithë botës shpirtërore të tyre për të afirmuar ideologjinë marksiste-leniniste, moralin proletar, kulturën socialiste. Kjo është një luftë e gjerë masive, që zhvillohet me pjesëmarrjen aktive të të gjitha shtresave të popullsisë, që realizohet në praktikë nëpërmjet lëvizjeve dhe aksioneve revolucionare, diskutimeve të gjera popullore, debatit dhe kritikës së hapur publike, ku ballafaqohen mendimet dhe zakonet e vjetra reaksionare me idetë dhe moralin e ri revolucionar.

Lufta për thellimin e revolucionit ideologjik e kultural, si pjesë përbërëse e procesit të revolucionarizimit të gjithanshëm të jetës së vendit, u pregatit nga tërë puna 30-vjeçare e Partisë. Duke u mbështetur në rezultatet e arritura, Partia jonë lufton për ta çuar përpara pa ndërprerje punën për formimin e njeriut të ri të shoqërisë së re socialiste, të pajisur me bindje të thella marksiste-leniniste, me veti morale të larta revolucionare komuniste, me horizont të gjerë kultural e botë të pasur shpirtërore.

315

shtrésë stratum
ballafaqój confront
i gjithánshëm all-around
ndërprérje interruption
i pajísur imbued
vetí trait
horizónt horizon

T'I VEMË GJITHNJË MË MIRË ARËSIMIN, KULTURËN DHE ARTIN NË SHËRBIM TË SOCIALIZMIT E TË POPULLIT

Gjatë periudhës së fundit është zhvilluar një punë kolosale për të revolucionarizuar më tej arësimin e kulturën, letërsinë e artet, për t'i vënë ato gjithnjë e më mirë në shërbim të çështjes së socializmit e të popullit

Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës është një ndër aksionet më të mëdha që ka ndërmarrë Partia. Diskutimi i gjerë popullor që u zhvillua për këtë çështje kontribuoi shumë në luftimin e koncepteve e të ndikimeve borgjeze e revizioniste dhe në përpunimin e koncepteve marksiste-leniniste për shkollën. Tani po luftohet frontalisht për t'i zbatuar orientimet e Partisë në këtë fushë dhe jeta po vërteton çdo ditë drejtësinë e tyre. Programet e reja mësimore po zbatohen me sukses. Një punë e madhe, në të cilën janë aktivizuar mijra arësimtarë e pedagogë, po bëhet për hartimin e teksteve të reja shkollore. Po punohet gjithashtu për revolucionarizimin e strukturave, të metodave e formave mësimore dhe edukative. Këto masa synojnë realizmin e boshtit ideologjik marksist-leninist në të gjithë punën mësimore-edukative të shkollës, zbatimin në unitet të komponentëve themelorë të saj, mësimit, punës prodhuese dhe edukimit fizik e ushtarak, lidhjen e saj të ngushtë e të gjithanshme me praktikën revolucionare.

Masat për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës prekin në themel të gjithë jetën e saj. Krahas zhvillimit të mëtejshëm në gjerësi të arësimit, vemendjen e Partisë e tërhoqi në mënyrë të veçantë zhvillimi në thellësi i tij, forcimi i gjithanshëm i përmbajtjes socialiste të shkollës. Sigurisht, edhe në të ardhmen do të kemi zgjerim dhe masivizim të mëtejshëm të shkollës në rrugë të shumëllojta, sidomos në arësimin e mesëm e të lartë. Por çështjet e përmbajtjes mbeten gjithnjë më themeloret. Prandaj zbatimi i plotë e me

gjithnjë e më mírë evermore; more fully
synój aim
prodhúes productive
prek touch
themél foundation; core
gjerësí breadth
zgjerím broadening
masivizím making massive; enlarging
i shumëllójtë manifold

ritme sa më të shpejta i detyrave që kemi shtruar, përpunimi i mëtejshëm teorik, mbi bazën e përvojës praktike, i çështjeve ideologjike, shkencore e pedagogjike, të brendisë së punës mësimore-edukative, sidomos të programeve dhe teksteve shkollore, përbën preokupacionin tonë kryesor.

Tani që përfundoi shtrirja dhe zgjerimi i shkollës tetëvjeçare në të gjithë vendin del akoma më e mprehtë nevoja e konsolidimit dhe e forcimit të gjithanshëm cilësor të saj. Kjo është një premisë themelore për një nivel e cilësi më të lartë pune në të gjitha kategoritë e shkollave. Para shkollës sonë qëndron sot detyra e rëndësishme e modernizimit shkencor-pedagogjik të të gjithë procesit të mësimit, të brendisë dhe të metodës së tij. Ajo nuk mund të realizohet pa pasqyruar në mësim në mënyrë të përshtatshme proceset aktuale dhe prirjet e zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor, pa u thelluar në studimin e shkencës dhe të teknikës moderne, pa përdorur metoda pedagogjike moderne. Për këtë kërkohet të bëhen ndryshime të rëndësishme dhe më të shpejta jo vetëm në programe e tekste, por sidomos në bazën mësimore-didaktike, në futjen graduale të teknikës moderne në mësim, në kualifikimin e mësuesve, në sigurimin e literaturës për nxënës e pedagogë, në rritjen e kërkesave ndaj tyre. Një problem i dorës së parë është përdorimi i metodave aktive që stimulojnë punën e pavarur të nxënësve e të studentëve, si edhe zhvillimin e aftësive, të prirjeve e të talenteve të tyre.

Në shkollën tonë socialiste ngritja e nivelit shkencor dhe metodik të dhënies së mësimit po realizohet edhe si lidhje e ngushtë e teorisë me praktikën e me punën prodhuese. Megjithë problemet e ndërlikuara organizative e pedagogjike, pjesëmarrja e rinisë shkollore dhe e studentëve në punë prodhuese në fabrika e kooperativa, në aksione lokale e kombëtare po realizohet me sukses. Por akoma ka mjaft vështirësi që rrjedhin nga moskuptimet dhe pengesat që dalin në organizimin e zbatimin praktik të saj, si nga drejtuesit e shkollave, ashtu dhe nga ata të ndërmarrjeve ekonomike.

rítëm pace; rhythm; tempo
përvójë experience
shtrírje establishment; setting up
zgjerím expansion
pasqyrúar mirroring
sigurím securing; providing
dhénie giving
riní youth
vështirësí difficulty
moskuptím misunderstanding

Një kujdes i veçantë duhet treguar edhe për zbatimin e programeve të përgatitjes ushtarake të rinisë si një komponent tjetër tepër i rëndësishëm i shkollës sonë të re. Kjo përgatitje duhet bërë me tërë seriozitetin e saj, në përshtatje me moshën, duke luftuar çdo shfaqje të nënvleftësimit të kësaj detyre që ka të bëjë me forcimin e mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së Atdheut.

Është e kuptueshme se lufta për revolucionarizimin e shkollës kërkon ngritjen e gjithë punës në një nivel më shkencor. Pa ju futur seriozisht studimeve, pa zhvilluar shkencat pedagogjike nuk mund të plotësohen me sukses gjithë detyrat që qëndrojnë përpara shkollës sonë.

Programet e reja të edukimit fizik e ushtarak në shkolla, të cilat po vihen në jetë me sukses, dhanë shkas për një gjallërim të mëtejshëm të kulturës fizike e të sportit. Megjithkëtë ky është një sektor akoma i prapambetur i punës sonë. Parimet e përcaktuara, sipas të cilave themelore është lëvizja masive fizkulturale, kultura e përgjithshme fizike dhe sportet bazë që e sigurojnë atë, nuk po zbatohen në mënyrë konsekuente, dhe në praktikë ka shumë njëanëshmëri. Lëvizja fizkulturale e rinisë dhe e masave është e kufizuar dhe nuk është në qendër të vemendjes të organeve të Partisë e të pushtetit, të arësimit e të fizkulturës, të rinisë e të bashkimeve profesionale. Kryesore këtu nuk janë pengesat e mungesat materiale, megjithëse edhe të tilla ka dhe ato mund të zgjidhen. Themelore është të luftohen konceptet e shtrembëra që shprehen në nënvlerësimin e lëvizjes masive fizkulturale dhe të sporteve bazë. Për ne që duam një rini e popull të fortë, të shëndetshëm e të kalitur, është e domosdoshme të bëjmë kthesë edhe në këtë fushë dhe ta shtrojmë këtë si një detyrë të rëndësishme partie.

Më shumë duhet të kujdesemi edhe për jetën e rinisë e të punonjësve, për kulturën e tyre të gjithanshme, për çlodhjen e dëfrimin e tyre, për lodrat, për bazat sportive, për botimin e librave, lëvizjen artistike etj. Harmonizimi më i mirë i punës së shkollës me gjithë sistemin e edukatës jashtëshkollore dhe të kulturës masive, si edhe formimi i një koncepti të drejtë për gjerësinë e brendisë dhe të mjeteve të punës kulturale, janë një problem shumë i rëndësishëm e aktual. Botimi

seriozitét seriousness
përshtátje adaptation
nënvleftësím underestimating
shkas cause
gjallërím revitalization; revival
i prapambétur backward
i përcaktúar defined; delimited
fizkulturál physical-cultural
njëanëshmërí one-sidedness
mungésë lack
i shtrembër distorted
çlódhje rest
dëfrím amusement
jashtëshkollór extra-curricular

dhe përhapja më e gjerë e librit, zgjerimi dhe shtrirja e qendrave kulturale e artistike në të gjithë vendin, rritja e madhe e lëvizjes artistike amatore, tani së fundi ngritja e televizionit, si edhe revolucionarizimi i brendisë së gjithë kësaj pune janë tregues të rëndësishëm të hopit sasijor e cilësor të saj. Në këtë lëmë ne jemi angazhuar në një luftë intensive për theksimin e tipareve socialiste të kulturës sonë dhe për shkallmimin e ndikimeve të huaja e të vjetëruara. Por kërkesat gjithnjë në rritje të masave për kulturë janë shumë të mëdha dhe plotësimi i tyre nuk ecën me ritmin e duhur. Mjetet e shumëllojshme të kulturës masive nuk kanë depërtuar akoma siç duhet brenda në familje dhe nuk janë vënë akoma në shkallë të gjerë në përdorim të përditshëm të individit në punë dhe në kohën e lirë. Prandaj, në shumë raste, njohuritë e fituara në shkollë nuk plotësohen, nuk zhvillohen e përforcohen. Detyra jonë është të marrim masa për të mos lejuar thellimin e mëtejshëm të kësaj kontradikte.

Jeta jonë socialiste është e duhet të jetë kulturë. Kjo do të thotë se, krahas shkollës, librit, veprimtarisë artistike etj., e tërë jeta, dhe prodhimi, edhe mënyra e jetesës dhe e sjelljes, edhe krijimi i ambienteve në uzinë, në shkollë ose në fshat, edhe mënyra se si ne i ndërtojmë e i rregullojmë qytetet e fshatrat tona, arqitektura dhe urbanistika jonë, mirëmbajtja e rrugëve, edhe mënyra se si i shërbehet popullit, të gjitha, çdo gjë tek ne duhet t'i shërbejnë formimit kultural të njeriut të ri. Qëllon që ka kuptime të ngushta ose nënvlerësime për njerën dhe tjetrën fushë të kulturës. Sidomos më pak tregohet vemendje për kulturën e jetës. Tërë kujdesi përqëndrohet në çështjet e prodhimit dhe kjo është e kuptueshme, por duhet më shumë vemendje edhe për kushtet e punës, për çlodhjen dhe kohën e lirë të punonjësve, për shfrytëzimin racional të të gjitha mjeteve të informacionit e të komunikimit social nga ana e tyre, për zhvillimin e gjithanshëm kultural të tyre.

gjerësí broadening
aktuál current
amatór amateur
tregúes index
hop leap; hop; gap
sasijór quantitative
cilësór qualitative
angazhój engage
theksím accentuation
shkallmím destruction
i shumëllójshëm varied
shkállë scale
individ individual

Në luftë për kapërcimin e këtyre dobësive është e domosdoshme të rritet interesimi i gjithanshëm shtetëror e shoqëror për punën edukuese kulturale, për përsosjen e metodës së kësaj pune, për shfrytëzimin e plotë racional të mjeteve ekzistuese, si edhe për krijimin e mundësive e sigurimin e mjeteve të nevojshme materiale.

Të ndjeshme dhe me një vlerë të çmuar edukuese janë rezultatet e viteve të fundit edhe në zhvillimin e letërsisë e të arteve. Lufta heroike e Partisë dhe e popullit kundër bllokadës imperialiste e revizioniste, revolucionarizimi i gjithanshëm i jetës së vendit, kërkesat e Partisë për një kulturë militante me frymë revolucionare aktuale dhe kombëtare, si edhe kuptimi e qëndrimi më i drejtë ndaj botimeve e repertoreve nga letërsia dhe arti i huaj, i dhanë nxitje të fuqishme zhvillimit të letërsisë dhe artit tonë. Ata fituan pjekuri më të madhe ideopolitike dhe nivel më të lartë artistik. Si kurrë ndonjëherë është rritur krijimtaria artistike dhe janë zhvilluar me sukses të gjitha gjinitë e artit e të letërsisë, si proza ashtu edhe poezia, si muzika ashtu edhe artet figurative, teatri, kinematografia etj. Talenteve të njohura ju shtuan e po u shtohen çdo ditë talente të reja. Krahas ngritjes cilësore të krijimtarisë profesioniste, shpërtheu një hov i paparë i krijimtarisë popullore dhe i lëvizjes artistike amatore. Arti ynë socialist po ecën kështu i fuqishëm me të dyja këmbët. Duke ndjekur në mënyrë konsekuente parimet e realizmit socialist, në të ardhmen, letërsia dhe arti ynë revolucionar do të njohin me siguri zhvillime të reja, edhe më të mëdha.

Partia, në krye të masave, lufton me këmbëngulje për afirmimin e asaj që është socialiste dhe për heqjen e çdo pengese që frenon ecjen tonë përpara, ajo zbulon me guxim kontradiktat dhe lufton për kapërcimin e tyre, kritikon të metat dhe nuk e humbet kurrë perspektivën, kryen për ditë atë proces të njohur të ndërtimit të së resë dhe të shkatërrimit të së vjetrës, transformon jetën e njerëzve, formon njeriun e ri. Këto qëllime duhet të kenë kurdoherë parasysh edhe letërsia e arti-

jetésë living
uzínë workshop
mirëmbájtje care
nënvlerësím belittling
kapërcím overcoming
përsósje perfecting
repertór repertoire
hov drive
i papárë unprecedented; unseen
këmbëngúlje insistence; stubbornness
héqje removal; drawing
écje march
vúlë stamp; seal

ynë, këtë vulë të mbajnë edhe ato. Pasqyrimi i realitetit të ri socialist në zhvillimin e tij revolucionar dhe me kontradiktat e kohës, që i japin letërsisë dhe artit dramaticitetin dhe konfliktet e nevojshme, — këtu qëndron përmbajtja e re që i jep forcën letërsisë e artit tonë të realizmit socialist. Dhe një përmbajtje e tillë patjetër çon edhe në kërkime e në gjetje formash të reja. Të gjitha këto, si edhe mbështetja fort në truallin kombëtar, në krijimtarinë e trashëgiminë kulturale përparimtare të popullit tonë, i japin letërsisë dhe artit socialist atë origjinalitet dhe atë novatorizëm që e dallojnë nga të tjerët, jo vetëm si krijimtari e një populli dhe e një kombi të caktuar, por edhe për tiparet që fiton kjo krijimtari përmes kushteve të luftës kundër imperializmit e revizionizmit modern dhe për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit.

Pikërisht karakterin militant revolucionar të letërsisë dhe të artit mohojnë revizionistët. Pasi i shpallën «të ngushtë» ose i hodhën poshtë realizmin socialist si metodë krijuese dhe parimin e partishmërisë proletare, ata u hapën portën rrymave më të ndryshme reaksionare dhe dekadente, të cilat çuan në degjenerimin e letërsisë dhe të artit, duke i kthyer ato në mjete avanguardiste për restaurimin kapitalist. Kur arti mbart idetë dhe synimet e kundërrevolucionit, kur ai bëhet zëdhënës i elementëve ose i shtresave të burokratizuara e të borgjezuara, kur u kundërvihet aspiratave dhe luftës së masave, ai nuk mund të jetë kurrë art i vërtetë.

Lulëzimi i mëtejshëm i artit të realizmit socialist do të arrihet, duke përforcuar pozitat e fituara, në luftë me çdo ndikim të huaj, që nuk pajtohet me ideologjinë tonë socialiste, në luftë si me modernizmin, ashtu edhe me konservatorizmin, duke e pasqyruar akoma më thellë nga ana ideoartistike jetën dhe luftën e gjithanshme të popullit për ndërtimin e socializmit, duke vënë në qendër të krijimtarisë heronjtë e kohës sonë, duke forcuar partishmërinë proletare dhe karakterin popullor të artit tonë, në luftë me çdo ndikim të objektivizmit borgjez dhe të humanizmit abstrakt, duke e rritur pa ndërprerje rolin edukues të letërsisë dhe të arteve.

dramaticitét dramatic element
gjétje finding
truáll soil; land
novatorízëm novelty
pórtë door
restaurím restoration
mbart carry
kundërvíhem counterpose; place in opposition
pajtój reconcile

LEXIMI I PESEDHJETESHTATE

Me rastin e vdekjes së Fan. S. Nolit.

FAN S. NOLI

Fjalë e mbajtur në mbledhjen solemne kushtuar kujtimit të F.S. Nolit, mbledhje e organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, më 25. III. 1965.

S'ka disa muaj, shokë, ishim mbledhur në këtë sallë të Universitetit tonë, si sot, për të festuar 150 vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës, njërit nga rilindësit tanë më të parë e më të çkëlqyer. Dhe ja sot mblidhemi përsëri në këtë sallë, jo më për festë, po në një çast të rëndë zie për kulturën shqiptare, me zemrën të lënduar rëndë, që të nderojmë njërin nga rilindësit tanë më të prasmë, të fundmin e rilindësve e ndër më të çkëlqyerit, Fan S. Nolin.

E quajta rilindës Nolin e e lidha fytyrën e tij me fytyrën e De Radës. Ai, në fakt, i përket një faze më të re të letërsisë dhe kulturës sonë, të jetës sonë kombëtare në përgjithësi: fazës së përpjekjeve për të mëkëmbur një shtet të lirë shqiptar dhe për ta mbajtur të gjallë e të lulëzuar, në një kohë kur, kope me ujq u vërtiteshin, - siç u vërtiten edhe sot e kësaj dite, - herë njërit popull të vogël dhe herë tjetrit. Po pishën e tij, Noli e ndezi tamam në ato

festój celebrate
çkëlqýer = shkëlqyer
fëstë celebration
i prásmë late
mëkëmb put on its feet
kopé me ujq wolfpacks
vërtít hurl; revolve
píshë torch; pine
mërgím migration
gjysh-stërgjýsh ancestor
i patrondítur unshakable

të ketë ndjerë thellë atje në Gregi se ç'është të jesh pa atdhe, dy herë pa atdhe, siç qe Theofani, - i shpërngulur në të huaj dhe me tokën e stërgjyshëve të robëruar. E jo vetëm të robëruar, po të përbuzur. Të përbuzur e me qëllim të injoruar.

Ç'dinte ai për Shqipërinë, për lavdinë e herëshme të saj, për organizimin e lëvizjes së çlirimit, që kishte rrëmbyer edhe kolonitë shqiptare në mërgim? Përmendëm se në fshat ai kishte marrë mësimet e para të atdhedashurisë. Vetë na mëson se, kur qe ende i vogël, lexonte greqisht historinë e Skënderbeut dhe shqip ungjijtë e Kristoforidhit. Është mjaft për të kuptuar se ai, që në vogeli, u lidh me Rilindjen, dhe për të zbuluar atë që po e quaj «ungjillëtarin» e ardhëm Noli, për të zbuluar edhe historianin e ardhëm të Skënderbeut. Ja kështu lidhen breznitë, bashkohen zoqtë e shpërndarë nga tramundanat, njihen e më të vjetrit mëkojnë të rinjtë. Është histori e Shqipërisë ndër tallaze kjo. Është edhe histori e Nolit veçanërisht, si bir i Shqipërisë dhe si bir i mërgimit tragjik shqiptar.

Noli, që në fshat, ishte përpjekur të hyjë në marrëdhënie me Nikolla Naçon. Tani, në Misir, ai njihet me dy patriotë po aq të rrebtë, me Thanas Tashkon dhe Jani Vruhon. Aty erdhi si mësues i greqishtes. Po tregojnë se punën e suflërit e kishte humbur, sepse shkroi dhe vuri në skenë një dramë greqisht me titullin «Zgjimi» (To ksipnima), e cila u lojt, prej trupës ku bënte pjesë, në qytetin Pirgos të Peloponezit, dhe u ndalua nga autoritetet e vendit, sepse aludonte në lëvizjen kombëtare shqiptare. Ishte e para ndeshje e Nolit me megaliidenë.

Në Misir, Noli, si ç'e pamë, diti të zgjedhë shokë. Dhe këta e çmuan menjëherë si njeri të mundësive e të misioneve të rralla. Jemi në vitin 1905. Emri i Theofan Mavromatit nis të duket në shtypin shqiptar, ndonse Theofani shkruan greqisht. Ai në këtë gjuhë përkthen e boton atë që është quajtur «manifest i Rilindjes», veprën e Samiut, «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhetë». Noli ka ditur të zgjedhë edhe udhërrëfyesin e tij. Dhe është ndeshja e tij e dytë me megaliidenë. Le të mësojnë megaliidenjtë dhe opinioni grek në përgjithësi, se lëvizja patriotike shqiptare nuk është më ndër pelena, se ka një Shqipëri të rilindur, e cila, shpejt a vonë, do t'i thyejë vargonjtë. Këtë s'ka për ta penguar më asgjë, as edhe armiqësia

i rrébtë staunch; severe
aludój alude
megáliidé Greek expansionism; idea of greater Greece
ndónse even though
udhërrëfyes pathfinder; guide
elénë swaddling cloth; diaper
argór heavy chain
ndéshje clash
përmatánë across
letërkëmbím correspondence
epistoliér letter-writer
sqaró j clarify
vapór boat
menjëcopëhérësh at once
ca some
i përlótur tearful
shëkón = shíkón
shaj insult

vjet kur vdiq Naimi dhe po jepte shpirt De Rada, në mërgim si ata, i mërguar gjysh-stërgjyshi. E gjithë për të njëjtat ideale: të ndriçojë udhën e popullit të vet «drejt çlirimit dhe qytetërimit». Këto ideale, Nolin e frymëzuan tërë jetën e tij të gjatë. Ato ishin qëllimi i tij i madh e i patronditur. Ato shpjegojnë veprimtarinë e tij prej shkrimtari dhe artisti, prej politikani dhe kleriku. Ai mbeti, tërë jetën, një rilindës nga më të përparuarit.

De Rada kishte ardhur që nga larg te Shqipëria. Kishin kaluar shekuj që kur të parët e tij u arratisën në brigje të huaja. E megjithatë, në Itali, ku shqiptarët formuan një koloni të madhe prej më se 200 qind mijë frymësh, u zhvillua një kulturë shqipe e pasur, dhe kuptohet lehtë se si flaka e atdhedashurisë jo vetëm që s'u shua, po u rrit. Noli vinte ndofta po nga aq larg.

Ka mbetur mister koha në të cilën u formuan fshatrat shqiptare të rretheve të Adrianopojës. Poeti vetë është për gojëdhënën, që i bën më të lashta se marrja e Stambollit nga turqit (1453). Ato fshatra ndonse ruanin, me këmbënguljen shpëtimtare të çuditëshme, gjuhën, zakonet, vetijat stërgjyshore, prapë nuk është dëgjuar të kenë bërë prova për ta zhvilluar kulturën e tyre amtare. Dhe kjo qe e natyrëshme, sepse ato ishin të paka dhe gjindeshin nën Turqinë e nën ndikimin e kulturës greke. Sidoqoftë, Noli, në Ibrik Tepe, në fshatin e lindjes, i mori mësimet e para të atdhedashurisë dhe të shqipes. Rilindja mundi të prekë çdo kënd shqiptar, kudo të ish, dhe, që nga aq larg, me shekuj larg, të bashkojë kolonitë e shpërndara në të katër anët e Mesdheut, me vendin e të parëve të tyre, në përpjekjen e madhe për çlirimin e këtij vendi të robëruar e të prapambetur. Noli vinte kështu nga shumë larg në gjirin e Rilindjes e të atdheut.

Një ditë prej ditësh, atë e shohim të zbresë në Misir dhe të futet në lëvizjen patriotike të shqiptarëve të anëve të Nilit. Është një djalosh ezmer, shumë ezmer, me dy sy prush, i shkurtër e i shkathët, me fjalën që merr flakë e që të tierët i ndez. I thonë Theofan Mavromati ose Fan Noli, si ç'ka për t'i mbetur. Vjen aty prej Greqie, ku, më shumë se student universiteti, ka qenë një suflër theatri endacak. Kjo jetë e yështirë, po në shoqëri të Shekspirit e të dramaturgëve të tjerë, i ka mësuar më shumë gjëra se ç'do t'i kish mësuar universiteti ndofta. Ai, ndër të tjera, duhet

mistér mystery
gojëdhénë folklore
këmbëngúlje insistence
shpëtimtar salvaging; saving
stërgjyshór ancestral
kënd corner
e të párëve të týre of their forefathers
Misír Egypt
djalósh djalë
ezmér swarthy
prush fiery; live coal
súflër prompter
endacák wanderer; drifter
i shpërngúlur uprooted; transplanted
i përbúzur scorned
i injorúar ignored
ungjillëtár evangelist
brezní (brez) generations
tramundánë adversity; turmoil

e shtetit dhe e kishës greke, midis të tjerash. E treta ndeshje e Nolit me megaliidenë, - e treta dhe e vërteta, - do të ngjiste pas dy vjetësh, përmatanë oqeanit, në Amerikë.

Të riun e nisi për Amerikë Th. Tashkoja. Kjo del nga letërkëmbimi i tyre, që përbën një dokument të çmueshëm për jetën dhe idetë e Nolit të fillimeve, dhe për Rilindjen gjithashtu. Është edhe një dokument letrar i vërtetë: Noli epistolier i do shtuar Nolit që kemi njohur zakonisht në fushat e tjera të letërsisë dhe të kulturës. Le të ndalemi një çast te idetë e tij në kohën për të cilën bëjmë fjalë.

Ka në to, ahere, një si paradoks që duhet sqaruar. Noli, nga njëra anë, enthusiaset për Niçen e «Zarathustrën», të cilit i përkthen e boton dhe ndonjë fragment, kurse, nga ana tjetër, veten e quan revolucionar (Letër Tashkos, 1. VI.1906). Ia vlen të citojmë disa rrjeshta nga më tipiket për mendimet e tij të asaj kohe. Në vaporin që e çonte në Amerikë, ai tregon se zuri miqësi me një italian: «Zura miqësi vetëm me një italian dhe i thashë se jam shqipëtar revolucionar. Menjëcopëherësh më rrethuan të tërë dhe më shikonin me çudi. Unë u përgjigjeshe në çdo gjuhë që më pyesnin, dhe ata mbeteshin me gojë hapët. Ca më thoshin ku gjindet kjo Shqipëri, ca s'dinin fare dhe më shikonin në syt. Sa më kushtuan këto pyetje, ti e merr vesh, po ç'të bësh. Dhe posi u larguam, u ngritçë nga poltrona (vizon F. N.), vajta anësë vaporit dhe kështu i fola qjellitë me sy të përlotur përpjetë: «Shëkon si na shajnë neve më të shëndoshët e dynjasë (1), moj Perëndi? Dhe në u shurdhove, do hipim gjer në fron tënt të të lëkundim të zgjuhesh dhe të na dëgjosh. Hardhi koha.» (Po në atë letër). Është pra i riu thellësisht i revoltuar; i cili nuk mund të durojë më padrejtësinë, i cili ka vendosur të ngrejë krye dhe të rëmojë tokë e det që çështja e Shqipërisë të marrë udhë të shpejtë e të zgjidhet, që populli shqiptar të çlirohet. Këtu qëndron revolucionari Nol i asaj kohe. Më 1907, ai do të botojë dramën «Israelitë dhe filistinë», e para vepër e tij shqip, që ai vetë e pat çkonsideruar dhe që ne s'e kemi çmuar ende sa duhet për fillimet e tij dhe të dramaturgjisë sonë. Aty, Noli i ri shtroi çështjen e madhe dhe të ditës të lëvizjes sonë kombëtare: të kufizohemi te propaganda, apo të rrokim pushkën? Noli u tregua në atë vepër të parë, partizan i dhunës. Mbetet për të shpjeguar si ndikoi për këtë çeshtje Niçeja, të cilit i riu shqiptar duket se nuk ia zbuloi thelbin e mendimit reakci-

dynja = botë
shurdhóhem become deaf
fron throne
tënt = tënd
zgjúhesh = zgjóhesh
hárdhi = árdhi
padrejtësí injustice
rëmój dig
çkonsideró̧j disregard
rrok take up; seize
thelb core
kryengrítës revolutionary
mbínjeri supperman
epistolár collection of letters
mbiçmím overestimation
i árdhtë keq may he have pity

onar; Noli njohu kryesisht atë vrull të jashtëm kryengritës, ose më mirë të ndërkryer, që filosofia e Niçes ka. Sidoqoftë, ai, nga filosofi gjerman, ruante ahere idenë e «Mbinjeriut», ide që do ta hasim edhe më pas në jetën e tij, veçanërisht në epistolarin, po edhe në artikujt e vjershat, dhe që ka si çfaqje të saj një farë nënçmimi të rolit të masave në histori, një farë mbiçmimi të rolit të individit. Atë ide Noli e kapërxeu me shumë sukses te rrëfimi i «Historisë së Skënderbeut» që botoi në vitet '40. Prapë, një përpjekje të tillë ai e ka bërë gjatë jetës, sa herë që u është drejtuar masave, qoftë në Amerikë, qoftë në Shqipëri, dhe kjo ka qëlluar shpesh.

Këto të tëra, sigurisht, duhen parë e shpjeguar me gjendjen e përgjithëshme të zhvillimit politik të popullit tonë dhe me dobësinë e klasës borgjeze veçanërisht, e cila pat për mision të udhëheqë lëvizjen kombëtare dhe pastaj lëvizjen demokratike të vendit në kohën e Nolit. Këto i shënojmë sepse janë me interes për të vërejtur edhe kufizimin e natyrshëm që mund të kenë pasur idetë e Nolit, për kohën kur jetoi dhe për njohjen që ai kishte të Shqipërisë së largët. Po, nga ana tjetër, për të kuptuar edhe se si ai i kapërxeu ndikimet e huaja, që mund të kishin qenë të dëmëshme për veprimtarinë e tij politike dhe kulturale, duke u bërë një nga përfaqësuesit më të njohur të aspiratave patriotike dhe demokratike të masave tona popullore. Dhe themelore është kjo, për jetën dhe veprën e tij.

Duke veshur më 1908 rroben e priftërisë, - ndonse ai nuk besonte, - «Perëndisë, që nuk i besoj, i ardhtë keq», shkruan për mundimet e tij në Amerikë më 1906 (Leter Tashkos, 9.VIII), - Noli është plotësisht i ndërgjegjëshëm se po bën një gjest e një sakrificë të madhe për çështjen kombëtare. Dhe kështu qe. Dasisë fetare të Shqipërisë, ai i druhet shumë dhe nuk e mbiçmon një shpiritë tolerence që ka ekzistuar vërtet në popullin tonë ç'prej kohësh. Noli e interpretonte në mënyrë pak literale parullën e drejtë të Vaso Pashës me shokë, «feja e shqyptarit asht shqyptaria». Po ai tregohej realist, kur nuk i gjente me vend mendimet që patën qarkulluar ahere, për ta kryer bashkimin e shqiptarëve me anë të një sekte apo të një feje të tretë e të katërt, si

1) Shprehje që e dëgjoi nga një udhëtar dibran në Aleksandri.

dasí split
drúhem fear
ç'prej kóhësh from long ago
parúllë slogan
shqyptár = shqiptár
asht = është
Shqyptaría Albanianism
gjej me vend find appropriate
qarkullój circulate
unitízëm unitarianism
lípset = dúhet
ironizój speak with irony
kryefetár religious leader
kápem hang on; cling; depend; rely
faj fault
krérë (krye) heads
njër-játrin = njëri-tjátrin one another

bektashizmi, unitizmi dhe protestantizmi. «Përse njeriu lipset të ndrojë kaq gjëra që të bëhet «shqipëtar»?» ironizon Noli dhe përgjigjet: «Të mos ndryshojmë gjë prej gjëje: vetëm të krejmë kryefetarë me ndërgjegje dhe vetëdijë.» Vështrimi i tij qëndron këtu: të mos kapemi pas feve; fajin na e kanë kryetarët e tyre. Ai shkruan: «Krerët e feve kanë qenë jo vetëm armiq të popullit shqiptar, po dhe armiq me njëri-jatrin nënë pikë-vështrim politik... Asnjë s'munt ta mohojë që sot fetë në Shqipëri janë vegla politike» (rev. Albania 1907, fq. 35). Pra: të formojmë kryetarë feje pat iotë. Kjo duhet bërë, mendon ai, duke futur edhe shqipen në shërbesat fetare. Kështu kisha do të kthehet në një qëndër të propagandës dhe veprimit kombëtar. Noli mundi të enthusiasë shpejt, për këtë qëllim, të emigruarit shqiptarë të Amerikës, me gjithë luftën që iu desh të mbajë jo vetëm kundër veprimtarisë armiqësore greke dhe grekomane, po edhe kundër moskuptimit të ndonjë patrioti, siç na e tregon vetë në letrat e kohës. Krijimi i kishës shqipe qe ndeshja e tij e tretë dhe e madhe me megaliidenë. Ky qe kontributi i tij i parë me peshë për çështjen kombëtare. Luftën kundër klerit grek, më 1908 Noli e quajti «kryqësatë të parë të Historisë shqipe» (Letër Tashkos, 14. VIII).

Kjo «kryqësatë» qe me përfitim të dukshëm edhe për letërsinë. Gjer tani kemi treguar se Noli u nis në rrugën letrare përmes dramaturgjisë, me ndonjë vepër greqisht dhe një shqip. Po zumë me gojë se ai ishte, që në fillim, edhe përkthyes, nga ndonjë gjuhë e huaj në shqipet dhe nga shqipja në greqishtet. Përpjekja që ai tani filloi për të kthyer shqip librat e meshës, qe hapi i tij i parë i rëndësishëm për t'u rrahur si duhet me shqipen, ndonse, që në letrat e tij më të herëshme, gjejmë një shkrimtar plot gojën dhe që e përdor gjuhën e mëmës me një shije të pazakontë, duke u përpjekur me sukses që të mos përdorë të folmen arkaike të fshatit nga i cili vjen. Librat e meshës, Nolin e bënë nxënës të Kristoforidhit, kurse puna për gazetën «Kombi» të S. Pecit dhe puna e propagandistit nëpër kolonitë shqiptare të Amerikës, e kishte afruar edhe më shpejt me shqipen e Shqipërisë.

munt = mund
rev. = revístë
fq. = fáqe
enthusiás make enthusiastic
kryqësátë = kryqëzátë crusade
i hérëshëm = i hérshëm early
plot gójën articulate
arkaík archaic

Le të vemë re se këtu qëndron një ndryshim i tij kryesor me De Radën dhe arbëreshë të tjerë. Këta, duke pasur një publik injaft të gjerë shqiptar në Itali, i drejtoh shin në radhë të parë këtij publiku dhe nuk e ndjenin sa duhet shtytjen për t'iu drejtuar publikut të Shqipërisë. Me gjuhën e atdheut, ata ishin në kontakt thuase vetëm me anë të librave dhe të shtypit. Nga ana tjetër, ata nuk arritën të int grohen si Noli në lëvizjen letrare, patriotike dhe shoqërore të vetë Shqipërisë.

Që të vimë sërish te përkthyesi, duhet të themi se hapin e parë të rëndësishëm Noli nuk e bëri vetëm duke vënë shqip librat fetare, po edhe vepra të ndryshme, sidomos nga frëngjishtja: novelën e Stendalit «Vanina Vanini» (1909), apo komedinë e Molierit «Martesa me pahir» (1910). I pari përkthim i madh që shënon një datë në jetën e tij letrare, qe drama «Otello», e cila ishte në rrugë të shqipërohej, në mos ka qenë shqipëruar, që më 1910 (v. gaz. Dielli, 10. III). dhe që u botua më 1916. Vjen menjëherë pasta vazhda e ndritur e «Skënderbeut» të Longfellovit dhe e «Korbit» të Edgar Posë, për t'u kthyer në vitet '20 Noli te Shekspiri, me 3 vepra të tjera, dhe për të vijuar me Khajamin, Ibrenin, e gjer te Cervantesi (1933). Aq vepra sa dhe kryevepra, aq kryevepra, sa dhe mendime të mëdha që e çqetësonin përkthyesin artist. Këto mendime e kishin burimin te ndeshjet në Shqipëri midis demokracisë dhe reakcionit, ndeshje në të cilat Noli, përditë e më shumë, po loste rol udhëheqës.

Vitet 1910-1920, Noli i kaloi në Amerikë e në Evropë, me tallazet e çështjes shqiptare, si përkrahës i qeverive të Ismail Qemalit e të Vidit, në çqetësime të rënda, gjatë luftës së parë botërore, për fatin e ardhëm të Shqipërisë, shumë aktiv gjatë Konferencës së Paqes, edhe më aktiv për çështjen e regjimit që do të vendosej tek ne, kur kaloi rreziku i një copëtimi të plotë të atdheut nga fqinjët e përkëtej dhe përmatanë Adriatikut. Ai tanimë ishte prifti i dëgjuar, që çeli të parën kishë në gjuhë shqipe dhe që po realizonte «autoqefalinë» e kësaj kishe, d.m.th. shkëputjen e saj të vërtetë nga thonjtë e Fanarit. Noli tani ishte udhëheqësi kryesor i kolonisë shqiptare të Amerikës, koloni të cilën kishte ditur ta bashkojë e ta hedhë në frontin e çështjes kombëtare. Ai kishte dhënë prova si politikan nga më të zotët, me ideale

drejtóhem address myself
në rádhë above all
shtýtje urge; push
thúase = thúajse almost
shqipèroj translate into Albanian
v. = viz
gaz. = gazétë
vázhdë stream; continuation
korb raven
çqetësój agitate
qeverí government
tanimë by now
autoqefalí independence from the Patriarchy of the Eastern Church in Istanbul
përfaqësúes representative
tetór October
theksój stress; accentuate; define

të përparuara demokratike. Kishte dhënë edhe prova si njeri me kulturë universale. Përfaqësuesi i punëtorëve shqiptarë të Amerikës, qe e natyrëshme që të mbronte ideale te përparuara, në një kohë kur Revolucioni i tetorit kishte tronditur botën dhe kur në Shqipëri, pas Kongresit të Lushnjës, lëvizja popullore vinte duke u theksuar. Tek ne, ahere, nje Mihal Grameno e të tjerë po shihnin te bolshevizmi shpëtimin e vërtetë të vendit. Idetë e Nolit morën në këtë kohë një zhvillim shumë të mbarë dhe e vunë atë në ballë të lëvizjes për një regjim demokratik në Shqipëri.

Kanë mbetur të famëshme si ndërhyrjet e tij në parlamentin shqiptar dhe fjalimet publike, si deklaratat e tij në Lidhjen e Kombeve. Ndërsa të parat e tregojnë në ndeshje të ashpër me feudalët e anadollakëzuar dhe me rolin e tyre prej varrmihësish në krye të shtetit të ri shqiptar, të dytat e paraqitin në përpjekje me reakcionin ndërkombëtar, me imperializmin dhe përfaqësuesit e tij më të zot e më dinakë, të cilëve Noli ua zbuloi hiletë dhe pabesinë ndaj popujve të vegjël. Po ndërsa ai, ndaj feudalëve shqiptarë dhe pasuesve të tyre, nuk ushqen gati asnjë iluzion, ndaj imperializmit nuk është pa iluzione. Kështu përkrahjen e presidentit Uillson për çështjen shqiptare, Noli nuk e shel nën prizmin e kontradiktave imperialiste, po përmes një iluzioni të përgjithëshëm ndaj «demokracisë anglo-amerikane», të cilën ia kundërve «demokracisë evropiane», - p.sh. kur flet për «sistemin parlamentar anglo-sakson», i cili «i transportuar në Europën kontinentale, u bë lodrë».

Të mos harrojmë se Noli, me gjithë që ishte një demokrat revolucionar, me gjithë që e diktoi hipokrizinë e demokracisë borgjeze, kur kërkonte krijimin në Shqipëri të «një shteti modern», nuk shkonte më tej se idealet e shtetit borgjez, ku të mos mbretëronin më «të pesë anarkitë», - si shprehej ai,-dhe ku të respektohej ligji. Parulla e tij e njohur e një fjalimi elektoral të vitit 1923 (19. VIII), kur në fuqi ishin klikat feudale të Zogut me shokë, - «duam një qeveri të popullit, prej popullit, për popullin, të përbërë prej njerëzve më të ditur, më patriotë, më të zotërit e më të nderçim», — ishte parulla e një idealisti të vërtetë, po që në thelb nuk synonte më shumë se një demokraci borgjeze të përparuar.

feudálët e anadollakëzúar feudal chiefs under the Ottoman influence
varrmíhës grave digger
dinák sly; cunning
hilé lie
pasúes follower
lódrë game
ligj law
klíkë clique
i ndefçim = i ndérshëm honorable
rushfét bribe
i theksúar pronounced
pamvarësí = pavarësí
or' e çcast every moment
gjakësí blood letting

Në shtetin e ri, që Noli kërkonte, do të mos kishte më «tirani», si ç'thotë patrioti demokrat, vendi «do të mos shtrohej me dru, po me kanun e me drejtësi», do të rregullohesnin financat e do të përdoreshin ndershmërisht e me kursim, do të zhdukeshin rushfetet dhe do t'u jepej «rëndësi kryesore degëve të bujqësisë, të shëndetësisë dhe t'arësimit». Dihet se një nga pikat më të avancuara të programit të tij, qe reforma agrare. Dihet nga ana tjetër, se ky program kishte një karakter të theksuar anti-imperialist dhe synonte pamvarësinë e vërtetë të vendit, në një kohë kur ajo rrezikohej or'e çast. Program i gjerë, konkret, shumë përparimtar për kohën, program revolucionar, që bejlerët, me gjakësi e tradhëti, i bëri të marrin masat për të mos u realizuar kurrë, që borgjezinë e pasur të fshatit dhe të qytetit e çqetësoi gjithashtu, dhe jo pak, dhe që e bëri edhe atë shumë të druajtur ndaj lëvizjes demokratike, e cila po rritej në Shqipëri. Ai program e vuri Nolin në krye të lëvizjes sonë demokratike në prak të Revolucionit të Qershorit, dhe në krye të qeverisë që doli prej këtij revolucioni.

Dh. S. Shuteriqi, «Fan S. Noli,» Nëndori, No. 5 (May), 1965, Part I, pp. 136-43.

qershór June

LEXIMI I PESEDHJETETETE

FAN S. NOLI

Njihet çmimi që ekziston në Shqipërinë socialiste për Revolucionin e Qershorit, këtë ngjarje të madhe në historinë e Shqipërisë dhe në historinë e demokracisë shqiptare veçanërisht, ngjarje që ne përkujtuam me solemnitet vitin e kaluar, me rastin e 40 vjetorit të atij revolucioni. Njihet edhe çmimi që ekziston tek ne për rolin udhëheqës të Nolit në atë ngjarje.

Do të vinte gjatë të merremi gjithashtu këtu me shkoqitjen e ideve të Nolit të atij gjysmë viti të qeverisë revolucionare dhe me veprimtarinë e kësaj qeverie. Noli shkrimtar, auktori i vjershave të motiveve biblike, na ka folur, ndonse përmes metaforës e simbolit, për idetë dhe veprimin e tij të kohës. Më 1907, e pamë se, te «Israelitë dhe filistinë», ai shtroi çështjen e dhunës dhe përfundoi që pa dhunën nuk u bëka. Më 1924, ai na thotë se mendoi të mos e përdorë «kamçikun». Nuk është më fjala, sigurisht, për çastin krucial të revolucionit, - përmbysjen e feudalëve, - çast në të cilin Noli qe për dhunën. Është fjala për faktin se revolucioni nuk mbaron me marrjen e pushtetit, po vazhdon, pra se dhuna duhet të vazhdojë. Në vjershat e tij, Noli na thotë se «kamçikun» nuk e mbajti në dorë. Ai mendonte që:

çmim evaluation; estimation
shkoqítje analysis
nuk u bëka it can't be done
kamçík = kamxhík
nuk është më fjala we're not speaking any longer
është fjála we're speaking
kurríz back
aludím allusion
dyfíshtë two fold
Legalitét reign of King Zog after Noli's fall from power in 1924
kap seize; grab
saráf money changer
shëmp = shemb smash
po atý Ibid. (from the same work)
stërnip heir
shtryét squeeze
derbeder vagabond; vagrant

...«S'e ka fajin kurrizi, po truri,
se lirin' e sjell drita e mëndjes, jo druri».

(Krishti me kamçikun)

Nuk del e qartë mirë në se ai aludon vetëm te klasa feudale që ra, apo dhe te masat popullore, që mund të gënjehen sërish prej asaj klase. Aludimi, mendojmë ne, duhet të jetë i dyfishtë. Noli në emigrim, pas «Legalitetit», mendon se një diktaturë e rrebtë do të kishte qenë e domosdoshme, po tanimë është vonë. Tani:

...e kapnë kamçikun sarafët për fenë,
dhe e shëmpnë çlironjësin, fen' e atdhenë.

(Po aty)

Tani në Shqipëri mori pushtetin një «stërnip i Kainit», që «na shtyp e na shtrydh» edhe «gjakun na pi», një «derbeder ujk e derr», i cili na dha «varfëri, poshtërsi, robëri», dhe të cilit i «krusen mbi gju dallkaukët, kopukët e turmat pa tru» (Marshi i Barabbajt). Idealisti, — Noli vetë, i personifikuar në fytyrën e Krishtit, — ai që «s'ka dashur as jet' as martes' as para (aluzion te dorëzimi i tij prift te braktisja e mundësive që kishte për të vënë pasuri dhe për ta gëzuar jetën), Noli bie pre e urrejtjes dhe përndjekjes së tiranit, «se e do vegjëlin' e tiran' e urren»:

Vrajeni, se përunj dhe përmbys pasurinë,
pasuron, dhe çliron, dhe forcon varfërinë,
se lëngatën shëron, se ndriçon verbërinë:
kryeqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha...

Vrajeni kryengritësin e Shënjtëruar,...
se kujtoi që pa armë na ka për të zgjuar...

(Marshi i kryqësimit)

Kjo qe eksperienca shumë e hidhur që njohu revolucionari, sepse mendoi të hedhë «kamcikun». Ai tregon se si mbaruan patriotët e mëdhenj nga dora e pabesë e katilit Zog. (Elegji për Luigj Gurakuqin, Shpell' e Dragobi-ës).

ujk wolf
derr swine
krúsem bow down; bend low
dallkaúk boot licker
kopúk knave; rogue
turm = túrmë crowd; mob
dorëzím ordination
pre prey
vegjëlí little people; childhood
përúl deprecate
lëngátë disease
verbërí blindness
kryqësój = kryqëzój crucify
kryengrítës rebel
i shënjtërúar = i shenjtërúar saintly; sainted
kryqësím = kryqëzím crucification
katíl thug; assasin
shpéllë cavern
Dragobí region in far northern Albania

Pastaj ironizon, herë hidhur e herë më hidhur me frikanashët bashkudhëtarë të revolucionit (Shën Pjetri mbi mangall), apo me bashkudhëtarët e rastit (Kirenari), për të përbuzur kthesat e njerëzve që «dje shanin e sot lëvdojnë», që «edhe Katranin zbardhëllojnë», si Feridi, —Faik Konica i «Këngës së Salep Sulltanit». Kështu Noli, zemërvrarë e i deziluzionuar, do të fillojë të rrahë mendjen në mërgim e të pyesë veten për rrugën që tani duhet të ndjekë.

Lufta kundër Zogut nisi të bëhet nga pozita të ndryshme dhe në «aleancë» me fuqi të ndryshme. Italia fashiste e futi njërën këmbë në Shqipëri dhe kishte interes të mbajë me bukë e të ketë rekrutë ata prej emigracionit që do të viheshin «në hullinë» e politikës së saj grabitqare: Mustafa Merlikat ishin prej kohësh të gatshëm. Jugosllavia «militariste» (si ç'e quan Noli) nuk hiqte dorë nga synimet kundrejt Shqipërisë dhe kishte edhe ajo nevojë për rekrutë shqiptarë: Ali be Këlcyrat nuk munguan në emigracion. Fuqitë e mëdha të Evropës nisën, kush më herët e kush më vonë, t'i lënë «carta bianca» Musolinit në Shqipëri. Edhe Amerika e ish-presidentit Uillson po kështu. Noli, në këtë situatë, humbi edhe disa iluzione.

Rënia në kontakt me lëvizjen antifashiste dhe komuniste evropiane e ndihmoi të çelë sytë. Patriotët e vërtetë shqiptarë gjetën mbështetje te kjo lëvizje dhe te B.S. Dy rrugë mbeteshin: ose që Noli të bashkohej me lëvizjen komuniste, e cila ndër ne, në fund të viteve '20 dhe në fillim të viteve '30, ishte fare e re dhe e vogël, ose që ai të priste dit më të mira, duke mos u shkëputur nga lëvizja patriotike shqiptare. Nuk dimë në se Noli ia shtroi apo jo kaq qartë vetes çështjen. Sidoqoftë, peshkopi patriot e demokrat preferoi të hidhet edhe një herë në Amerikë, ku pat krijuar një teren të mirë veprimi para '24-ës dhe ku shpresonte se do të gjejë një teren të favorshëm përsëri. Atje ai ruante shumë simpati midis të emigruarve shqiptarë, me gjithë rrënimin jo të vogël, që ishte përpjekur të bëjë F. Konica me shokë për hesap të Zogut.

Le të kujtojmë se, më 1927, Noli avancoi kaq shumë, sa mori pjesë në Kongresin e Miqve të BS, që u mbajt në Moskë, midis personalitetesh të njohura përparimtare e revolucionare të kohës, si Ajnshtajni e Barbysi. Ai ahere

frikanásh = frikac timid; weak-hearted
bashkudhëtár fellow traveler; associate
mangáll brazier
katrán pitch; tar
zemërvrárë heart broken
aleáncë alliance
mbájë...rekrútë to feed and have as recruits
hullí mold; furrow
grabitqár aggressive
Mustafá Merlíkat collective name for characters in opposition to Noli
i gátshëm ready
be = bej
Ali be këlcýrat collective name for members of the landed aristocracy

ka bërë deklarata kaq të maita, sa duket se kish arritur në mendimin që e ardhëmja e Shqipërisë do të sigurohet vetëm përmes lëvizjes komuniste dhe triumfit të kësaj. Çlirimin e vendit ai nuk e ndante dot nga çlirimi i gjithë Ballkanit prej forcave popullore. Ai ishte për «një federatë ballkanike të republikave të punëtorëve dhe fshatarëve, si ato të BRSS». Kështu i ka deklaruar korespondentit të gazetës «Pravda» (4. XI. 1927). Noli deklaron ahere: «Jam i mahnitur që pashë me sytë e mi të parin shtet të punëtorëve e fshatarëve, të cilin e pret një e ardhëme e madhe, e që është një shembull i të tilla republikave të punëtorëve dhe fshatarëve të së ardhëmes». Ai ka besimin se pjesëmarrësit e Kongresit të Miqve të BS, «do të mund t'u japin fund çpifjeve të fëlliqura dhe trillimeve që përhapin armiqtë e vendit sovjetik». Ata pjesëmarrës, «kur të kthehen në vendet e tyre, do të tregojnë me tërë forcat, para popujve të tyre, vijën e vërtetë të politikës së BS, dhe do të demaskojnë makinacionet kriminale të imperialistëve, të cilët merren me përgatitjen e një lufte të re». Përsa i takon popullit shqiptar, deklaron ish-kryeministri i Shqipërisë, ai «ushqen një simpati të madhe për BS». Po «nuk mund të flitet», shton Noli, «për perspektiva të afërta revolucionare në Shqipëri», sepse kryengritja në vendin tonë do të shtypet nga ndërhyrja e Italisë fashiste dhe e militarizmit jugosllav, po nuk pat një lëvizje të gjerë ndërballkanike, me të cilën të koordinohet.

Jemi më 1927. Më 1930, kur tek vjersha e Marathonomakut Noli përfundon:

se i vogli shtrin viganin
dhe i shtypuri tiranin,
veç e tok....—

vetëm qoftë apo me shokë, — Noli paraqitet më optimist për lëvizjen revolucionare në Shqipëri. Tani ai e sheh valën e kësaj lëvizje që po rritet «që nga Shkodra gjer në Vlorë», sikundër shkruan, në maj 1930, te vjersha «Anës lumenjve», ku «brohorit me bes' e shpresë» dhe i bën kështu thirrje vegjëlisë shqiptare për bashkim e për luftë:

B.S. = Bashkími Sovietík Soviet Union
peshkóp bishop

Ngrehuni dhe bjeruni,
korini dhe shtypini,
katundar' e punëtorë!...

Jemi në vigjiljen e nisjes së tij për Amerikë. Më 15 maj, e shohim të thotë meshën e parë në Boston dhe të predikojë luftën kundër bejlerëve të Shqipërisë. «Kjo është e treta e vërteta», ka deklaruar ai (gaz. Dielli, 16.V.1930). Dhe nis tërbohet kundër tij, kundër «peshkopit të kuq», lufta e F. Konicës me shokë, një luftë e paskrupul dhe e paprerë, që nga shantazhi e gjer te frikësimet Noli nuk gjeti në emigracionin e përtej Atlantikut dhe në Amerikë në përgjithësi, një situatë të tillë të favorëshme, ku të mund të vinte në veprim idetë e tij të përparuara demokratike të asaj kohe. Me një mbështetje të pamiaftueshme, i shkëputur nga tereni i Shqipërisë dhe jo sa duhet në lidhje me anën më të përparuar të lëvizjes sonë patriotike dhe demokratike të emigracionit në Evropë, Noli u thye dhe, pak e nga pak, nisi të largohet nga jeta politike, të mbajë pozitën e një prifti të thjeshtë, duke pushuar luftën e hapët kundër Zogut, duke u pajtuar me Konicën, po dhe duke u përpjekur, me prestigjin e vet dhe me shpresën se dit më të mira do të vinë, që ndër shqiptarët e Amerikës të mos shuhet ndjenja patriotike. Pra: i tryer, po jo i mundur. Është koha kur ai i hyn një pune të re për historinë e Skënderbeut, kur jepet pas muzikës dhe historisë së saj. Kjo punë do t'i falte frutet e çmueshme pas luftës së dytë botërore.

Pushtimin fashist të Shqipërisë, Noli e priti si një gjëmë e qe ndër ata emigrantë që e luftuan haptazi. Luftën Nacional-Çlirimtare që plasi dhe u organizua në Shqipëri, e shikoi me shpresë e simpati të madhe, duke e përshëndetur më se një herë. Ai e kuptoi qartë se tani populli shqiptar, tek udhëheqja e tij komuniste, kishte gjetur prijësen që i duhej dhe me të cilën do të shpëtonte përgjithëmonë nga shtypësit e jashtëm dhe të brendëshëm. Ky besim ngazëllonjës u formulua kështu më 25.XI.1944 prej Nolit: «Nga erresira e qorsokakeve po hyjmë në dritën edhe në fushën e hapur të veprimit me udhëheqës që e kanë sprovuar zotësin' e tyre në vijën e zjarrit. Këta udhëheqës duhen për-

terén terrain
rrënim destructive work
hesáp account
e árdhëme = e árdhme future
BRSS = Bashkími i Republíkave Socialíste Sovietíke U.S.S.R.
çpífje = shpífje lie
i fëllíqur dirty
trillím fabrication
demaskój unmask
Marathonomák Marathon runner
vigán giant

krahur pa kondita, pa rezerva dhe pa kursim, se e meritojnë besimin e popullit plotësisht. Me këta udhëheqës fati i atdheut është i shiguruar. Rroftë Shqipëria!» Kështu e përshëndeti Noli çlirimin e atdheut nga forcat partizane. Kur udhëheqësve të rinj, — «Kryetrimave që shpetuan Shqipërinë nga Nazistët, nga Fashistët, nga Bejleret», — Noli u kushtoi më 1947 «Albumin» e vjershave të tij, libër në të cilin ai përmblidhte ajkën e punës së vet krijuese dhe të mendimeve të tij përparimtare, Noli sikur firmonte, me gjakun e zemrës së vet, testamentin e jetës së tij prej patrioti dhe demokrati revolucionar.

Mosha, rrethanat, bënë që Noli, duke dashur të qëndrojë në krye të kishës shqiptare të Amerikës, t'i druhet një vizite në Shqipëri, ndonse i përvëlohej zemra për atdheun. Ai, sigurisht, i druhej edhe vdekjes në dhe të huaj, pa e parë Shqipërinë, si ç'e pat shkruar më se një herë, e veçanërisht te «Anës lumenjve», ku, në mërgim, e quan veten «as të gjall' as të varrosur». Po Noli kishte tani ngushëllimin se Shqipëria u bë si ç'e pat ëndërruar ai. Më 1964, më 25 maj, të nesërmen e festës së madhe të 20 vjetorit të Kongresit të Përmetit, Noli kështu i shkruante një miku të tij të vjetër në Shqipëri, M.S. Gurrës: «Ne, që të dy, kemi pasur fatin se kemi rrojtur mjaft gjatë për të parë këtë (që u bë në Shqipëri, — Dh. Sh.). Sa shumë të tjerë nuk e gëzuan këtë privilegj! Kështu, sidoqoftë, ne i përkasim grupit të fatlumurve. Vetëm kjo ndjenjë është e mjaftë për të kundërbalancuar gjithë vështirësitë që kemi pasur në të kaluarën dhe që mund të kemi përsëri në të ardhëmen» (1). Noli, ky «luftëtar i zjarrtë dhe i paepur për pamvarësinë dhe lulëzimin e Shqipërisë», siç e cilësoi në telegramin e vet të ngushëllimit kryeministri, shoku M. Shehu, Noli vdiq midis «fatlumurve» që «gëzuan privilegjin» dhe arritën ditën e pamvarësisë dhe të lulëzimit të vërtetë të atdheut. E megjithatë, ai vdiq e u varros në dhé të huaj. Qeveria amerikane, në armiqësinë e saj konsekuente ndaj popullit shqiptar, nuk e lejoi përfaqësuesin e qeverisë sonë që të bëjë nderimet mbi trupin pa jetë të Nolit në varr. Tani, eshtrat e Nolit, edhe më të rëndë do ta kenë tokën e mërgimit. Vetëm kur ato të prehen në Shqipëri, vetëm ahere do të prehet plotësisht kujtimi i tij në memorien e atdheut të përgjëruar e mirënjohës.

kor = korr cut with a reaper; reap
vigjíle eve
predikój preach
paskrúpul unscrupulous
i paprérë unceasing; uncut
shantázh blackmail
frikësím intimidation
i pamjaftúeshëm insufficient
pak e nga pak little by little
frut fruit
i çmúeshëm valuable
háptazi openly
plas view
príjës leader
ngazëllónjës joyful
qorsokák = qorrsokák dead end street; blind alley
sprovój test
kondítë condition
kursím thirft
pa kursím unstintingly
i shgurúar = i sigurúar assured
ájkë cream
firmój autograph; sign

Na vdiq, shokë, një prej njerëzve tanë më të ndritur të patriotizmit e të kulturës. Unë fola shkurt për jetën dhe veprën e tij. Duhet të kisha folur edhe më gjatë për poetin, kritikun, publicistin, oratorin, shkencëtarin, muzikantin. Po ne të gjithëve, veçanërisht këto dit, na ka kumbuar fjala e tij në vesh, kjo fjalë që u bë një pjesë e pandarë e kulturës që morëm, një pjesë e qumështit me të cilin na ushqeu dhe po na ushqen Shqipëria. Çfarë të përmendja më parë në këtë mbledhje? Cilin Nol të përkujtojmë më parë? Ju të gjithë e dini sa i ëmbël mund të ishte ai, edhe pse fjala e tij shërbeu më shpesh si ajo e një Tirteu. Ai që pat shkruar:

Ngrehuni dhe bjeruni,
korini dhe shtypini,
katundar' e punëtorë,
që nga Shkodra gjer në Vlorë! —

ai që pat shkruar:

Pastaj sulet si shigjeta
me një qint pothua veta
nëpër lum' e pyll e garth
përmi malet Argjendar,
dhe me zemrën plot gëzim
kapërceu lumin Drin...—

gjith' ai shkroi:

Thuaj yjtë s'janë zjarr,
thuaj dielli u shua,
thuaj jeta është varr,
po mos thuaj që s'të dua; —

e gjith' ai shkroi:

Të bardhë si dëbor' e kish savanin,
me lule të stolisur,
i vogël e i madh me lot e qanin,
me zemër të zalisur.

---

1) Origjinali anglisht. Noli, i dobësuar, thotë se shkruan me dorën e një sekretari që nuk e di shqipen.

ngushëllím consolation
fatlúmur lucky one
i paépur unyielding; unbending
ushqéj feed

Dhe çfarë nuk vuri ai në vjershat e tij origjinale apo në ato që përktheu! Kujtoni «Rubajatë» e Khajamit dhe mjafton. Një ndër denigruesit e ulët, që përpiqej ta përflasë e ta njollosë emrin e tij më 1931, jo kot i kujtonte Nolit pseudonimet e shumta, si Ali baba Qyteza, Rushid Bilbil Gramshi etj, me të cilat peshkopi u detyrua të firmojë idetë e tij të guximëshme, që vinin ç'prej skepticizmit e gjer te materializmi, ç'prej hedhjes poshtë të dogmave e gjer te liria e mendimit e e gëzimit të jetës tokësore, duke qesëndisur xhenet e xhehenem, pa harruar mërinë shekullore ndaj padrejtësisë në shoqëri:

Të kisha, eh! fuqi prej Perëndie,
i jipnja shkelmin kësaj gjithësie
dhe krenja Botë tjatër ku të ishte
çdo plotësim dëshire dhe lirie.

Dhe që të mos rri pa folur për harmoninë e rrallë të vargut nolian, po kujtoj dy rrjeshta vetëm nga përkthimet e tij, të cilat shpesh, më shumë se përkthime, janë rikrijime, e më shumë se rikrijime, — kulmime të fjalës poetike shqipe:

Era frynte që përjashta,
rrihte përdet e mëndafshta...

Të kujtoj historianin? Tre qenë ata që i mësuan historinë e Skënderbeut Shqipërisë: Barleti, Naimi, Noli. Noli i fundit, po jo më i dobëti. «The last but not the least». Shkenca tek ai gjeti artistin dhe artisti shkencën. Dhe kështu historia fitoi, nëpër pendën e tij, jo vetëm vërtetësinë kritike, po edhe forcën më të madhe emocionuese. Tërë një jetë i kushtoi Noli asaj pune, për kryetrimin legjendar të shekullit XV, — që nga një panegjirik i parë, i mbajtur më 1907, e gjer te libri i vitit 1949. Historia e Skënderbeut qe bërë për Nolin libër i jastëkut dhe «Historia e Skënderbeut» e Nolit u bë për shqiptarët libër i jastëkut. Thonë se ai vdiq duke e ripunuar për së treti herë veprën e tij. S'është për t'u çuditur që ky kalorës i fjalës dhe i historisë, të ketë mbyllur sytë me një mendim skënderbejan, sikundër e mbylli gojën me një buzëqeshje drejtuar Shqipërisë.

garth fence
saván shroud
i stolísur decorated
i zalísur fainted
denigrúes denigrators
përflás villify
njollós stain
i guxímëshëm = i guxímshëm daring
tokësór worldly
qesëndís ridicule
xhenét heaven
xheheném hell
mërí grudge
gjithësí universe
tjátër = tjétër

Të kujtoj auktorin e veprës «Betoveni dhe Revolucioni frëng»? Më pëlqen ta mbaroj këtë fjalë me këtë kujtim. Së pari sepse një artist i madh shqiptar gjykoi, dhe gjykoi drejt, një artist të madh të botës. Dihet ushëtima ndërkombëtare e studimit të Nolit, mendimet që shprehu për të Tomas Mani e ato të Bernard Shouit me të tierë. Ky çmim ndërkombëtar nuk është e para herë që i blatohet Nolit. Jokli pat deklaruar për punën e poetit, se tietër përkthim të Khajamit në gjuhët evropiane më të mirë s'njeh, përveç atij të Ficxheraldit. Ne mund të pyesim: në cilën gjuhë Shekspiri foli më bukur se shqip, pas anglishtes? Do ta kishin zor bota të na përgjigjeshin. Dhe mund të përfundonim se Noli, me vjershat e tij e me poezinë që përktheu ose përshtati, i kapërxeu kufinjtë e letërsisë sonë dhe është ndër ata artistë të fjalës shqipe që na përfaqëson në letërsinë botërore. E po kështu dhe historiani i Skënderbeut apo kritiku i Betovenit, në shkencën botërore.

Fan S. Noli ishte klasiku ynë i gjallë. Letërsia e re shqipe, shkenca e re shqiptare, që janë në vazhdën e punës së letërsisë dhe shkencës përparimtare të së kaluarës së vëndit tonë, janë edhe në vazhdën e punës së Nolit, të këtij personaliteti nga më të fuqishmit të kulturës sonë, përpara të cilit, në këto çaste zie, ne përulemi me veneratë e mirënjohje. Vepra dhe kujtimi i tij mbeten të pavdekshëm.

DH. S. SHUTERIQI

kulmím culmination
rríhte (rrah) beat; flutter
pérdë = pérde drape; curtain
emocionúes emotional
jasték pillow
líbër i ja[illegible]ékut a book that is a constant companion
blatój devo[illegible]
zor difficu[illegible]
përúlem bow [illegible]
veneratë veneration

LEXIMI I PESËDHJETËNËNTË

ISMAIL QEMAL VLORA

(24 Janar 1844-1919)

Emri i Ismail Qemalit u bë që në fillim të këtij shekulli një nga më të dëgjuarit emra shqiptarë, si brënda vendit tonë, ashtu dhe në botën e jashtme. Ky burrë i madh shteti fitoi famë jo vetëm nga reputacioni që gëzonin stërgjyshër e tij në historinë e perandorisë otomane, por edhe për shkak të virtuteve të tij të çquara dhe të shërbimeve të paçmuar q'i solli Shqipërisë.

Kur Hurshid Pasha vrau Ismail benë më 1827, Tafil Buzi, syrgjynosur n'Ysqydar, u dërgoi fjalë lebërvet: «Turp për ju! Erdhi halldup i Konjës në vatër tuaj, ju vrau vëllanë në Janinë, dhe s'u bë për burrë asnjë nga ju t'i merrte gjakun!» Dhe Gjoleka iu përgjegj:

«Tafil Buzit të m'i thoi,
Gjoleka s'e turpëroi
Kaftanasin e martoi,
Me të dyja ç'e qëlloi,
Nëpër dyzet mijë shkoi».

Pas disfatës së kryengritjes së madhe fshatare 1847, turqit e syrgjynosën Mahmud benë, të birin e Ismail beut tanë e Ismail Qemalit. Kështu Ismail Qemali u bë bartësi i detyrimeve të tre brezave brënda familjes së tij dhe dolli i nderuar në luftën e jetës.

Ismail Qemali lindi më 24 janar 1844 në Vlorë, n'atë qytet të Shqipërisë, ku shumë vjet më vonë do të çpallte indipendencën e mëmëdheut të tij prej sundimit turk; dhe i mbylli sytë përjetë po këtë ditë të janarit 1919, në Peruxhia t'Italisë tek po kthehej nga Parisi për n'atdhe, që t'i ndente edhe një herë dorën nënës Shqipëri në një kohë kur fati i saj luhatej në balancë.

virtút virtue
syrgjynósur exiled
lébër inhabitant of Labëria in southern Albania
halldúp contemptuous name for Turkish occupiers
thói = thóni
kaftanás wearer of caftan
disfátë debacle; fiasco
kryengrítje uprising
bártës carrier
luhás swing; hang

Ky bir i çquar i Shqipërisë zbriste prej derës së vjetër të Sinan Pashës, vezirit dhe admiralit të madh në kohën e Sulejmanit të Shkëlqyer. Dyke ndjekur shëmbullin e gjyshit dhe të t'et, Ismaili u largua nga traditat e klasës së tij aristokratike dhe, në jetën e veprat e tija, u bë një me popullin. Të kushërinjtë Ferid Pasha dhe Syrja bej Vlora, dhe gjithë bejlerët e turqëzuar të vëndit tonë, nuk ia falën kurrë këtë mohim q'i bëri oxhakut të tyre, duke u solidarizuar me «harbutërinë», dhe në këtë devijim të Ismail Qemalit e kanë burimin edhe goditjet q'i bënin Midat beu dhe Faik Konica herë pas here, kur plaku i Vlorës mbronte interesat e vegjëlisë.

Gjyshi i Ismail Qemalit qe Ismail bej Vlora, që pati anuar nga Ali Pashë Tepelena dhe kish kundërshtuar të merrte pjesë në luftë kundër grekërvet, që përpiqeshin të fitonin lirinë. Më 1827 Rushid Pasha e ftoi Ismail benë në kryeqytetin e Toskërisë, me qëllim gjoja që ta vishte me autoritetin e të parit të vëndit; por i ngriti kurth atij dhe shnurës prej pesëqind vetash, dhe e vranë kur po zbriste nga kali.

Më vonë, kur plasi kryengritja e madhe fshatare me 1847, biri i Ismail bej Vlorës, Mahmud beu, mori anën e kryengritësvet, prandaj, pas disfatës së tyre, Turqia e syrgjynosi atë në Monastor, dhe familjen e tij në Selanik, ku Ismail Qemali, fëmijë, nisi të nxërë turqisht.

Gjatë luftës së Krimesë, Ismail Qemali po vazhdonte studimet në Zosimean e Janinës, duke marrë edhe mësime private frëngjisht prej profesor Tsimas dhe arabisht prej Ymer Efendiut. Pasi mori diplomën, i pregatitur shumë mirë në greqisht e latinisht e në gjithë lëndët humaniste, por edhe në shkencë e mathematikë në të cilat ish dalluar ndër të gjithë, shkol në Stamboll tek i ungji Ismal Pashë Plasa.

Që nga ky moment kur u bë madhor dhe gjer sa vdiq, Ismail Qemali e pasuron jetën e tij me një varg të gjatë ngjarjesh, prej të cilavet edhe më e parëndësishmja ka lidhje me historinë e popullit të tij, të popujve që lëngonin nënë hyqmin e sundimit turk, me historinë e vetë shtetit turk.

Figura e këtij shqiptari të madh që kur nisi karierën si sekretar i Midat Pashës dhe e vazhdoi si guvernator i Varnës dhe i Dobruxhës, si President i Komisionit ndërkombë-

vezír vizier
dýke = duke
oxhák lineage; fireplace
harbutërí low class
devijím deviation
kundèrshtój come out against
gjója allegedly
kurth trap
shpúrë entourage
lëndë subject
ungj uncle
madhór adult
i parëndësíshëm insignificant
lëngój languish
hyqm authority

tar të Danubit, si sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, edhe sepse herë-herë pushohej ose syrgjynosej në vise t'izoluara, për ta rifilluar karierën përsëri si guvernator i Bolusit dhe i Golipolisë, i Bejrutit dhe i Kretës, por edhe si qytetar i thjeshtë, duke botuar ndonjë gazetë e revistë, ose si mik i përsonaliteteve të dëgjuara n'arenën politike, ose prapë si guvernator i përgjithshëm i Tripolisë. sa gjen rastin t'arratiset nga Turqia për të bërë udhëtime të gjata në Greqi, n'Itali, n'Angli dhe Francë e Svicër, ose nëpër kolonitë arbëreshe të Siqilisë dhe Kalabrisë, gjithmonë i ndjekur prej sikarëve të Sulltan Hamidit, por edhe i lutur prej ambasadorëvet të madhërisë së tij që veç të kthehej në Stamboll pa do t'i bënin çdo nder që t'i dëshëronte e bardha zëmër në Pushtetin otoman, — figura e këtij shqiptari të çquar, pikërisht për mospranimin e gjithë bllatimevet të Sulltanit të kuq rritet e bëhet gjithmonë më e madhe, gjersa arrin apogjenë e saj atë ditën e lumtur për gjithë popullin shqiptar: 28 Nëndor 1912.

Ismail Qemali, të cilin qeveria tiranike e Stambollit e kish dënuar me vdekje, u kthye në Vlorë vetëm pasi u çpall kushtetuta më 10 korrik 1908. Vlora e zgjodhi deputet në parlamentin e Stambollit, Partia Liberale lider dhe opozita kryetar të saj. Grupi patriotik i deputetëvet shqiptarë shihnin në Ismail Qemalin udhëheqësin e tyre të nderuar, dhe xhonturqit kundërshtarin e tyre më të rrezikshëm.

Në verën e 1911 Ismail Qemali shkoi në Cetinjë, ku u poq me kryengritësit e malsorët, që me familjet e tyre kishin gjetur strehim në Mal të Zi. Atje Ismail Qemali protestoi kundër barbarizmave të Shevqet Turgut Pashës dhe nënshkroi, bashkë me delegatët e kryengritjes të mbledhur në Gerçë, memorandumin e famëshëm me të 12 pikat për autonomi kombëtare.

Ismail Qemali parashikon në Ballkan luftën, që do ta pushtonte Shqipërinë nga gjithë anët; ay u dërgoi nga Nica qarkore gjithë qëndravet shqiptare, duke u kujtuar nevojën imperative që t'ishin gati për t'i bërë ballë çdo eventualiteti.

Kur, si pasonjë e hyrjes triumfale të kryengritësvet shqiptarë në Shkup, qeveria xhonturke ra nga fuqia, Ismail Qemali u kthye në kryeqytetin e Turqisë, dhe përpiqej të forconte koloninë shqiptare t'atjeshme.

pushój dismiss; discharge
rifillój begin again
sikár murderer
i lútur invited
mospraním refusal
bllatím offering
apogjé apogee
korrík fully
lidér leader
xhontúrk young Turk
píqem meet
strehím shelter; refuge
kryengrítje rebellion
parashikój forsee
qarkóre circular
i bëj bállë confront successfully
pasónjë = pasójë consequence

Në Robert Kolezh atë mot shkollor kishin ardhur njëzet studentë shqiptarë. Ne të vegjëlit, në kursin pregatitor, ishim në konflikt me drejtorinë, e cila na impononte turqishten për gjuhë amtare. Një pasdreke hyri në sallën e studimit një profesor dhe lajmoi sa qenë shqiptarë të dilnin jashtë.

«Do të na përzënë», thamë, duke dalë prej dere.

Po jo. Profesori na porositi të vinim në dhomën e gjumit, të laheshin e të ndërroheshim dhe të shkonim në sallën e pritjes. Këtu qenë mbledhur gjithë studentët e kolezhit, njeri prej të cilëvet na tha të qëndronim me radhë dhe të rrinim urtë, se do të na vizitonte Ismail Qemali.

Emri i tij na ndezi kujtimet e së kaluarës. E kush nga ne s'e kish dëgjuar këtë emër? Kush nga ata që s'e kishin parë nuk u gëzua për rastin se do ta sillte ballë për ballë me plakun e nderuar të Shqipërisë? Edhe sepse minutat na u dukën orë të tëra, kur po prisnim pa durim dera u hap dhe te praku qëndroi një burre.

Të gjithë rilindasit shqiptarë, Naum Bredhasi, vëllezërit Frashëri, Pashko Vasa, Koto Hoxhi, Themistokliu, Çerçizi, Spiroja, — gjithë rilindasit shqiptarë, — kanë qënë jo vetëm të mënçur e të mirë, po dhe shumë të bukur. Atë moment kur Ismail Qemali qëndroi te dera e dhomës ku po prisnim, m'u duk sikur pashë më të bukurin e gjithë rilindasvet.

«Të gjithë shqiptarë?» — pyeti Ismail Qemali, duke kthyer kryet nga ata që e përcillnin. Dhe, duke hyrë na dha dorën. E putha atë dorë me gjithë dashurinë që ndjen një fëmi ri për moshën dhe punën e një plaku të nderuar. Më në fund qëndroi me mes tonë dhe na tha:

«Gëzohem, të shoh kaqë shumë studentë shqiptarë në një shkollë. Po te kete nga kaqë dhe në të tjerat, Shqipëria shpejt do të kete plot njerëz të mësuar. Djemt e mi, kini dëgjuar se punët nuk venë mirë për vëndin tonë. Ushtëritë armike kanë hyrë në Shkup e po marshojnë drejt Manastirit... Po mos u deshproni, ka perëndi dhe për Shqipërinë. Edhe Shqipëria do të bëhet shtet më vehte. Po një shtet më vehteka nevojë për njerëz të ditur që ta qeverisin. Prandaj vështroni të mësoni... A kini ndonjë dëshirë?»

«Po! — i thamë ne më të rinjtë», — duam të vinjë një mësonjës shqiptar për gjuhën shqipe...»

drejtorí administration
përzë dismiss
bállë për bállë face to face

Pas disa ditësh, qe fillim i vjeshtës së prasme, erdhi mësues i shqipes Sali Nivica. Përditë mësonjësi ynë hynte në klasë, kokë-ulur, i heshtur, i brengosur dhe fillonte mësimin mengadalë e me kujdes. Vetëm njëherë erdhi me nxitim, me fytyrën të qeshur. Sytë e zes të bukur i shkëlqenin nga gëzimi:

«Vëllezër, gëzohuni! — thirri, duke na shikuar të gjithë në fytyrë, — Ismail Qemali, delegatët, arrinë në Vlorë! Çpallën indipendencën e Shqipërisë!... Rroftë Shqipëria e lirë!»

Janar, 1961

i brengósur miserable
mengadálë slowly

Skënder Luarasi, «Ismail Gemal Vlora,» Fjala shqipe, Tiranë, 1961, pp. 85-9; «Nga jeta e tim eti,» ibid., pp. 105-9.

NGA JETA E TIM ETI

Më 10 maj 1903, një yzbash me shumë asqerë,[1] që nëmëngjes, na kishte rrethuar shtëpinë, të cilën e bastisi; ngarkoi dy barrë me libra shqipe, dhe urdhëroi tim atë të nisej për n'Erseké. Më parë se t'ia lidhnin duart me hekura, babai më ngriti lart e më puthi. Sa kisha mbushur tre vjet e s'e mbanj mënd këtë ngjarje, por nëna më tregon se i paskësha thënë të më sillte sheqer të kuq kur të kthehej prej Erseke.

Prapë nëna më tregon se të mërkurave dilnja tek Udha e madhe e pyesnja pazarakët mos ma kishin parë babanë. Po dalëngadalë e harrova; dhe më në fund zura të besonj, sidomos kur burrat e tjerë, ditët e shënuara, ktheheshin nga kurbeti dhe u sillnin kalamanjve këpucë e roba të bukura, se unë s'do të kisha pasur kurrë baba. Kështu. për pesë vjet me radhë.

Ndërkaq babai u arratis e vajti n'Amerikë.

Më 1908, Pradellën, tokë buke ndonjë orë larg fshatit, e patëm mbjellë grurë. Arat qenë korrur. dhe duajt prisnin t'i shpinin në lëmë. Atë ditë që me natë u bë dyfek në pyllin e Shënkollit të Vodicës midis ushtarëve turq e (siç u mësuarrvesh më vonë) çetës së Çerçiz Topullit. Bujqit e tjerë i fshehën kafshët e samarit, po mua bujku Bido m'i ngarkoi të mijat dhe më tha t'u vinja pas. Te kroi i Janit po çlodheshin disa burra me mjekër, t'armatosur. I dirsur, mora zëmër dhe zbrita të pi ujë. Njëri nga ata më pyeti: «I kujt je, mor djalë?» — «I Petr. . . Illi Dikos», iu përgjegja. (Asikohe trimat e Maliq Beut, si Dake Mali, mirrnin dhe skllevër, prandaj nëna na kish porositur, ne vllezërit, të thoshim se qëmë djemt e mjeshtrit më të varfër të mëhallës).

Burri me mjekër qeshi, më puthi në ballë dhe më dha një grosh. «Na — më tha — ta blesh sheqer të kuq». Nxitova pas kafshëve të ngarkuara (që shyqyr nuk m'i muarrnë!) dhe pa kaptuar Shën-Thanasin ktheva kryet dhe thashë: «Mor, paska dhe hajdutë, të mirë!»

Nëna e dinte se babai qe kthyer fshehurazi në Shqipëri që në maj. Kur ja tregova ngjarjen, ajo më porositi: «Se mos ja thuash njeriu këtë gjë!»

Më 10 korrik u çpall Hyrjeti.

1) ushtarë turq

yzbásh captain in the Turkish army
bastís raid
bárrë cartload
sheqer të kuq kind of candy
e mërkúrë Wednesday
pazarák shopper
dúaj bundles of grain stalks
lëmë threshing area
që me nátë at daybreak
u bë dyfék shots were exchanged
çétë guerilla unit
i dírsur all sweated up
asikóhe at that time
mëhállë neighborhood
grosh money
na here
kaptój pass
hajdút bandit
Hyrjét reforms instituted by the Turks in 1908

Për Shenepremte kishim vajtur në Blush, te teze Janja, për panagjir. Sa kishte mbaruar mesha, mysafirët ishin shtruar n'ode dhe ne kalamanjtë shikonim si piqeshin mishrat në hell, kur Xheli, duke u kthyer nga Korça, trokiti në portë dhe thirri me zë të fortë: «Sihariq, o teze Jane, se t'erdhi Petroja!»

Nga gëzimi e gjora plakë u hodhi mysafirëve hapset, u tha t'i shtronin vetë sufrat, na rrëmbeu ne përdore: mua, tim vlla Dhimitrin, dhe motrën e vogël Shegën, dhe të katër u sulëm drejt Luarasit. Prej mëhallëvet të ndryshme dëgjoheshin pushkë. Të kroi i madh hasëm burra të mëhallës Matorusë që ngjiteshin për në Kostallarë: «Shyqyr që t'erdhi Petroja shëndoshë, o teze Jane!» dhe zbrazën dyfegjet edhe ata.

Plakës nuk i pritej nga gëzimi; na la ne të vegjëlit prapa dhe nxitoi drejt shtëpisë. Kur arriva vetë, pashë dyshemenë e qoshkut të mbushur plot me njëqind palë këpucë. Motra e madhe më përqafoi, duke thirrur: «Erdhi babai! Shih ç'të ka sjellë! Vishi! Mbathi! Shko, thuaji mirë se erdhe!» dhe m'i veshi robat e ra prej kadifeje bojë hiri, më mbathi këpucët me xhufka, dhe më vuri në kokë takijen e qindisur me ar.

«Po kujt t'i them Mirë se erdhe?» e pyeta.

«Atij burrit që s'e ke parë tjetër herë», — më porositi kushërira Gule.

Kur hyra n'odën e madhe, i hutuar, vura re se teze Janja i kish hequr dorën e djathtë në qafë burrit të huaj. Ky u ngrit, më puthi në ballë e në faqe, dhe më mori pranë. Ndenja shesh, e vështronja me bisht të syrit e thosha me vete: «Ky qënka gjallë ay hajduti që më dha groshin të ble sheqer të kuq!» Ku ta dinja se ay hajdut paskish qenë im atë!

Atë çast erdhi dhe plaku Miti Kosta nga Penkollarët, që pati mbajtur anën e dhespotit Fillaret dhe i kishte thënë babait se me atë shqipen e tij do të ngordhte në ndonjë qoshe t'Anadollit. Hyri Xha-Miti me rrobat e shajakta të rreckosura, dhe që rga dera thirri në mes të kallaballëkut: «Shyqyr q'u ktheve gjallë, o Petro-Nini! A e pe ç'te bëri mallkimi i Dhespotit? Gjer prapa diellit të shpuri».

E babai, duke i dalë përpara, iu përgjigj: «Mirë se mua më zuri mallkimi i dhespotit, o xha Miti, sa vajta gjer prapa diellit, e ndërrova katër-pesë palë rroba, po ti ç'gjynahe

panagjír = panaír religious festival
ódë living room; room
hell spit
siharíq good news
i gjórë wretched
vlla = vëllá
has meet; run across
zbraz fire
dyfégje (dyfek) muskets; rifles
dyshemé floor
qoshk pavilion
kadifé velvet
bójë híri ash colored; grey
xhúfkë tassel
takíje skullcap
i hutúar dazed
shesh on the ground
qënka gjállë is exactly like
dhespót peshkop
i shajáktë coarse flannel garment
i rreckósur ragged
kallaballëk crowd

aske bërë, mor i gjorë, që me këtë gunë të lashë e me këtë unë të gjeta?!» Dhe u përqafuan.

Një ditë erdhi te miqt e tij në fshat Asllan Lubonja. «Na a ftuar Petroja për darkë. Eja dhe ti.» i thanë të titë,

«Po kam qenë armik me të»! u përgjigj Asllani.

«Ehu dhe ti! Ay u pajtua me Dake Malin e jo me me ty, ë as vrarë, as prerë jini!» dhe e muarnë pas. Babai dolli te hkallët, përshëndeti Asllanin të parin dhe n'odë e vuri në rye. Pastaj, përpara se të shtrohej darka, na thirri ne, vlleër, motra, kushërinj e kushërira dhe nisëm të këndonim:

«O moj fushë e Qerbelasë...
Abaz Aliu zu Tomorë,
Erdhi afër nesh;
Shqipëria s'mbet e gjorë,
Se Zoti e desh».

Kur mbaruam së kënduari, dhe babai u ngrit e shkoi në vatër për të parë ndë ishte gati darka, Asllani u tha të tjerëvet: «Ky qënka më turk se ne!»

Një ndajnatëherë, kur qielli qe mbushur me re të zeza, ly kallaxhij shkuan përmes mëhallës, drejt Hanit të Qesarakës, me vrap.

«Ç'kini që nxitoni? — i pyeti babai.
« Mos na zërë shiu» — u përgjegjën ata.

«Nuk do t'arrini dot!» u tha babai, dhe i mbajti për darkë e i gostiti si miq të vjetër.

Atë vjeshtë shkoi në Manastir të celte shkollë edhe atje, po negovanasit e lutën të vinte në fshat të tyre. Që prej tragjedisë së 12 shkurtit 1905 — andartët kishin vrarë atje 15 patriotë shqiptarë.

«Po s'ke frikë se mos të të vrasin?» — e pyeti Telemak Gërmenji.

«S'ka gjë. Sa më shumë të na vrasin, aqë më shumë do të shtohemi» — tha babai dhe pranoi të vejë. Në dhjetor e hapi shkollën me 10, e në qershor e mbylli me 100 nxënës dhe me dy mësonjës ndihmës.

Andartët i zinin pusi përherë e kudo. Po tani jo vetëm

gúnë cloak; cape
Ehú dhe ti! Listen to him!
me me = me (mp.)
ndë whether
ndajnatëhére dusk
kallaxhí = kallajxhí solderer; tinsmith
han inn
gostít treat
negovánas inhabitant of Negovan, village in northern Greece
andárt Greek irregular
s'ka gjë no matter
dhjetór December
ndíhmës assisting

vjéhërr father-in-law
myftár village elder
únjeshin (ulem) descended
pállto coat
pëllëmbë palm; span of outstretched hand
thur fence
deklamój declaim; proclaim
i kërthínjtë tender
muftár = myftár
tútjetëhu to and fro

fliste me vete, i zëmëruar, i gëzuar. Dhe në prill botoi «Epitimion» (Mallkimi). Atë natë kur fliste me vete ndoshta kuvendonte me hijen e dhespotit Fillaret dhe i thoshte:

«Ne shqiptarët i duam jo vetëm vllezërit tanë grekër, po gjithë vëllezërit e botës, veçse dëshërojmë dhe lutemi që të na duan edhe ata neve».

Kur u kthye nga Manastiri në Korçë, një ditë para se të ngjiste lufta n'Orman Çiflik, më 17 korrik e futnë në burg; dhe kur i kishin sjellë dëshmorët tek ura e Hyqymetit ay po gjykohej në zyrë të Mystendikut. Përveç Bajazidit, të pesë djemtë e vrarë kishin qënë nxënësit e tij në shkollën e Korçës. Kur erdhi në fshat e na tregoi tragjedinë, i rrodhën lotët ë faqe.

Nuk u çlodh asnjë javë atë verë, kur prapë e thirrën në Manastir me ngutësi... Më 10 gusht u nda nga shokët shënd[illegible] mirë e me përgëzimet e tyre që doli faqebardhë.

[illegible]asi e mbajtën edhe kësaj radhe nja dy-tri ditë t'arrestuar në Korçë, arriu në fshat të djelën në mëngjes. Vajti drejt në [illegible]shë e shëtiti me burrat për urime.

[illegible]ni dy gjëra qenë bërë qëllim i jetës së tij: shkolla e Luar[illegible]it dhe ajo që dëshironte të hapej n'Ersekë. Ah, sikur t'i bi[illegible]dte dot tyxharët e Ersekës ta çelnin shkollën shqip n'atë qënder, ku vetë e kish hapur në vitin 1887!

Të hënën 15 gusht, d[illegible]n e Shënmërisë, e kremtoi me mysafirët. Nga fshatrat rretn[illegible] rrotull kishte thirrur nga një përfaqësonjës dhe bisedoi me ta për arësimin në Kolonjë. Bënte plane për një shkollë bujqësore praktike në Pradellë, e për një tjetër, për vajzat, me internat, në Kostallarë, nënë drejtimin e bijës së madhe, Thomaidhës.

Të martën, sa përcolli miqt e fundit, tek hidhte vrah, e lajmëruan të vinte n'Ersekë. Të mërkurën u nis për atje më këmbë me pazarakët. Qe i fortë nga këmbët dhe i pëlqente shumë t'udhëtonte duke biseduar me të tjerët.

Kur dukej sikur tregëtarët grekomanë e pranuan të celej shkolla shqip dhe vllezërit Prodani kësaj radhe po e dehnin me fjalët e tyre t'ëmbla «vllezërore» e «patriotike», Mësonjësin e Shqipes e «gostitën» me konjakun e helmuar, q'e pati përgatitur spiceri dhe doktori grek Thanas Janulli me porosinë e Hyqymetit dhe me shtytjen e Mitropolisë greke.

Hyqymét Turkish government
zýrë office
ngutësí urgency
e djélë Sunday
tyxhár trader
e hënë Monday
kremtój celebrate
internát boarding school
e mártë Tuesday
vrah sheaf of threshed grain
udhëtój travel
deh intoxicate
spicér druggist

LEXIMI I GJASHTEDHJETE

Po ju flasim nga zemra e pyllit
Ku është derdhur tërë natën drita e një yllit.
Për fillim një buzëqeshje të ëmbël nga Puci
Dhe përqafimet më të ngrohta nga Rruci!
Sot gëzojnë të gjithë. Në pyllin e bleritë shiu dhe erërat janë ndalur. Dasma e lepur bishtshkurtërit filloi.

Krushk i parë u bë hutini, lepur bishtshkurtëri kërcente nga gëzimi. Lepuroshja nuse e re, u printe krushqve plot hare. Ishte stolisur krejt me të kuqe, fort përngjante në një burbuqe. E tërë ndritte porsi hënë, i përngjante më të bukurës zanë. Luante e fliste fjalë sheqer, me një gjerdan në qafë si ylber.

Veglave u binin të gjithë me rend, një majmun ishte dirigjent. Kitrrës së vogël i shkonte për dore të jetë më e mira defatore. Ndërsa dhelpëra si violiniste, të gjithëve zemrat na i rriste. E ariu se në mëni, gati e pëlciti një bori. As kanguri nuk mbet prapa, shtriu menjëherë duart e gjata. Këtu mjeshtëria e tij u duk, bëri strajcën tarabuk. Elefanti si gjithmonë, ishte i këndshëm me trombonë. Simpatike ishte zebra e hollë, që na kënaqte me viollë. Në orkestër tingulli i parë, ishte një lepur me kitarë. Në mes të turmës se ç'kumbon — tigri i madh me saksafon. As kaprolli prapa s'do të ngelë, dhe s'ka shoq në violonçelë. Por mbi të gjithë është qesharak, mbi një cung luani plak. Ky mun-

e shtúnë Saturday
përqafím embrace
lépur rabbit
bishtshkúrtër short-tailed
húti screech owl
lepuróshe female rabbit
haré happiness; joy
përngjáj resemble
ndrit light up
gjerdán necklace
végël musical instrument
majmún monkey
dirigjént conductor; director
kítërr = kétër squirrel
i shkónte për dóre it came naturally
defatór drummer

dohej me një fllaut, që të nxirrte tinguj të butë.

E zonja vjedull donte vetë, të shoqërojë vallen me kllarinetë.

E për ujkun të gjithë thanë
Se ka shoqin për tupan!

Vallja e këngët shumë vazhduan, në dasmë të lepurit të gjithë u gëzuan.

Në fund bishtshkurtëri plot hare, mori për dore nusen e re. Lepuroshen fytyrë si hënë, që i përngjante më të bukurës zënë. Lamtumirë — na tha më zë — unë s'mund të pres më.

U nisën ngadalë me hapa të lehtë
Shkuan të flejnë në kasollë të qetë.

Rrahman Dedaj, «Tre diejt,» Zogu dhe kulla, Prishtinë, 1972, pp. 32-4; «Dasma e lepurit,» ibid., pp. 98-9.

rríste (rrah) beat
mëní = mërí
pëlcíti (pëlcas) burst
kangúr kangaroo
strájcë pouch; bag
tarabuk
simpatík sympathetic
kapróll roe deer
cung stump
i bútë soft
vjédull badger
válle circular dance
tupán kettle drum
i qétë tranquil; peaceful

diéj (diéll) suns
ekspozítë exposition
vizatím drawing
shkrij dissolve; melt
gjuetár hunter
e prémte Friday
shkop cane

TRE DIEJT

NDODHET një çupë me emrin Diana... Ndodhet një ballkon i bardhë... Në ballkon ndodhet një ekspozitë... E në ekspozitë një-qind vizatime të çuditshme që bën Diana për çdo ditë.

Një të hënë vizatoi lepurin me tri këmbë!

Kur e pyeta ku është këmba e katërt, ajo duke e shkrir buzën në gaz, m'u përgjegj:

— Ja ka vrarë gjuetari që ban kapelën e kaltër!

Të martën, Diana vizatoi gjirafën me tre sy...

E pyes:

Si mund të ketë gjirafa tre sy?

Ajo, pasi kujtohet pak, më thotë:

— Gjirafa duhet t'i ketë tre sy, sepse e ka qafën shumë të gjatë. Syri i tretë, që e mban mbi kokë, i shërben t'i shikojë yjet dhe qiellin.

Të mërkurën, Diana vizatoi tri gjyshe...

Të enjten, pranë gjysheve vizatoi nga një gjysh...

Të premten për çdo gjysh vizatoi nga një shkop. Por, unë do t'ju tregoj për vizatimin që bëri ditën e shtunë.

Mori tri fletë të bardha e të bukura dhe një shishe të vogël me ngjyrë. Kësaj here donte të punojë vetëm me një ngjyrë. Me ngjyrën që i përngjante arit. Doli në ballkonin e bardhë ku kishte ekspozuar edhe vizatimet e tjera dhe filloi:

Në fletën e parë bëri një rreth të madh...

Në fletën tjetër bëri rrethin e dytë.

Dhe në të fundit, rrethin e tretë...

Pasi vizatoi tre rrathë të njëjtë në tri fletët, mori brushën dhe i ngjyrosi me bojë ari. Pastaj u largua pak dhe i shikonte duke ju buzëqeshur. Atëherë e pa Mrika, motra e saj më e madhe:

— Ç'ke vizatuar kështu! — i tha buzagaz.

— Tre diej të bukur — u përgjegj Diana.

— Diej! — sikur u çudit Mrika.

— Secili prej tyre do të lëshoj rreze ërgjënti — shtoi Diana.

— Kujt i duhen këta diej, gjersa kemi diellin e madh — foli motra.

— Si kam bërë për ty — ndërhyri Diana.

— Pra, më thuaj për kend — pyet Mrika.

— Ja — fillon Diana — dielli në fletën e parë është për gjyshin. Ai është i sëmurë dhe s'mund të dalë e të rrezitet jashtë.

Dielli në fletën e dytë është i dajës sim që ka shkuar larg në botë. Ky do t'i bëjë dritë në vendet e largëta.

Ndërsa dielli i tretë do të rrezatojë në dhomën tonë, kur dielli i madh të ikë pas bjeshkës së lartë e të fillojë muzgu.

e shtúnë Saturday
shíshe bottle
ngjyrós color
secíli each one
ërgjënt = argjénd
për kend = për kë for whom
rrezítem sun myself
dájë uncle on mother's side
rrezatój shine
bjéshkë mal
muzg dusk; twilight

LONI PAPA: „CUCA E MALEVE"

Mu pse shtron një kompleks të gjërë çështjesh — duke filluar që nga përpjekjet e para për përhapjen e dijës dhe ngritjen arësimore të masave të gjëra e luftën për çrranjosjën e paragjykimevet e botëkuptimevet mesjetare të trashëguara nga e kaluara në viset malore, e deri te lufta në planin ideologjik në mes të klasave, në mes të mbeturinave të asaj që po i numëronte ditët e fundit dhe asaj më progresive, çështje këto që lidhën në mes vedi për të krijuar një tërësi organike — drama e Loni Papës *„Cuca e maleve"*, po sa u publikua në Shqipëri, u çmua si realizim me vlerë, si vepër që, sipas mendimit të një kritiku „mund ta thuash pa droje, do të ketë jetën e saj në atë dritare në botë që mbyllet e hapet me një sipar të thjeshtë". Dhe kjo dramë, ky realizim artistik i një autori të rinj, që në fillim kishte shkruar disa poezi për t'u paraqitur mandej më rrallë para publikut të gjërë lexues, e shtjen Loni Papën në mesin e krijuesvet bashkëkohorë që dijnë dhe mundë t'i hetojnë problemet më bashkëkohore, më aktuale që i kanë qitur në shesh marrëdhaniet e reja shoqërore e ekonomike, për t'iu dhënë atyre mandej një mishërim me të vërtetë artistik, duke përvehtësuar format më të përshtatshme të të hartuarit letrar e dramatik, që bëjnë të mundëshme përfshirjen e një serë problemesh e çështjesh në një vepër jo aq voluminoze përkah vëllimi por që thotë shumë.

cúcë lassie; maid
Cucë girl's name
mu precisely
mu pse precisely because
çrranjósje = çrrënjósje
paragjykím prejudice
védi by itself
tërësí wholeness; unity
çmoj rate; evaluate
dróje hesitation
sipár theater curtain
mandéj afterwards; then
shtíe put; place
hetój handle
aktuále timely
qis bring out; shoot
shesh open
mishërím embodiment
përvetësój appropriate
i hartúar mapped out; designed
përkáh in terms of; compared with

Lëndën dhe frymëzimin për dramën „*Cuca e maleve*" autori e
nori nga ngjarjet e vërteta, nga disa sosh që u zhvilluan në ditët o
para të pasluftës në Malësi. Loni Papa nuk është regjistrues i këtyre
ngjarjeve e as që mbështet në njerën prej tyre kryekreje. Përkundra-
i. Në dramën e tij, në shtjellimin e fabulës së saj vërejmë dhe kemi
ë bëjmë me një krijues, që ka një fantazi të frytshme krijuese, një
ftësi të lakmueshme për të zgjedhur e potencuar gjithë ate që është
esenciale për një problem a çështje, për veçimin e gjithë asaj që
utorit i shërben për t'i zbuluar lexuesit, gjegjësisht shikuesit idenë
dhe tendencën e vet. Me të drejtë është thënë se në këtë vepër është
e hapët tendenca e autorit, ashtu siç janë të hetueshme simpatitë o
ij ndaj veprave të protagonistëve kryesore dhe gjithë atyre që e
përkrahin ate. Por të gjitha këto janë motivizuar e dhënë me një
njesitri të vërtetë artistike që jo vetëm se nuk e dëmtojnë dramën,
por i shtojnë edhe më shumë efektin letrar dhe ate shoqëror në
masë, për mos të thënë së Cuca me vetëmohimin, me guximin e saj
për të luftuar pa kompromis kundërshtarët me të gjitha mjetet dhe
me të gjitha mënyret i jep veprës një ton mobilizues në drejtim të
luftës për emancipimin e femrës në shoqëri dhe jo vetëm të saj.

Dramën e Cucës së maleve, që personifikon dramat e disa cucave
të tjera, luftën e saj për triumfin e ideve më progresive, duke vijuar
kështu punën e filluar nga mësuesi i saj Ndrec Ndue Gjoka — autori
e zhvillon në retrospekcion, në njëzetë e tetë episode që rradhiten
njera pas tjetrës, formë kjo e të shtjelluarit që dëshmon se Loni
Papa o njeh teknikën dhe kërkesat e artit skenik, gjë që vërtetohet
edhe me shumë elemente të tjera. Dhe drama e Loni Papës nuk
mbaron me vrasjen e Cucës, siç do të pritshim apo siç do të mendoj-
shim kur dikush të na tregonte fabulën e saj. Ajo me këtë pothuaj
se edhe fillon, apo më konkretisht drama fillon me hetimet kundër
vrasësvet të mësuesës dhe aktivistës së Hirgenit, vend në të cilën
zhvillohet edhe ngjarja e dramës. Tërë kohën në hetusi. skenë kjo
që e përcjellë dhe ndërprenë zhvillimin e fabulës, sintrohet problemi
e kërkesa e zbulimit të motivit të vrasjes, zbulimit të motivit të
vërtetë politik. Këtu, në këtë skenë me ndërprerje, zhvillohet edhe
një pjesë e konfliktit kryesor të dramës, atij konfliktit që shërben
dhe ndihmon për të zbuluar fytyrat e vërteta të atyre që e vrasin
Cucën gjëja për të mbrojtur zakonet e malëve, por që në të vërtetë
nuk kanë të bëjnë me mbrojtës të zakoneve të maleve, sepse disa
prej normave të këtyre i shkelin me këta kriminel, por me luftë
klasash, ideologjish. Në episodet tjera Loni Papa vetëm i pasqyron

sosh such
malësí highlands
regjistrúes recorder; witness
kryekréje principle; main
shtjellím development; unfolding
fabúlë story
i frýtshëm fruitful
i lakmúeshëm enviable
potencój make powerful
gjegjësísht specifically
shikúes observer
i hetúeshëm detectable
vetëmohím self-denial
kundërshtár adversary
rradhít arrange
shtjellúar developing
vrásje killing; murder
hetím inquiry
vrásës murderer
hetusí = hetuesí (mp.) coroner's office
gjëja = gjója

veprimet e tyre duke radhitur njerin pas tjetrit veprimet e tyre që nuk kanë asgjë të përbashkët me veprimet njerëzore, për të zbuluar këtu, në hetuesi, motivet dhe prapavijën e tyre, ideologjinë e tyre. Shikuar nga ky aspekt drama në shikim të parë duket si vepër që ka për subjekt një veprim policor. Drama që zhvillohet në hetuesi, ku shohim jo vetëm fundin e krimineleve, por edhe thyrjen e tyre shpirtërore, sepse lidhën me konop të vedin, duke u përpjekur të mëshehin të vërtetën, motivin e vërtetë, është dramë në vedi me rëndësi pothuajse të njëjtë me ate të Cucës. Sepse me këtë edhe e potencon autori triumfin e së resë me sakrifica, pa marrë parasysh se kryeprotagonistja e veprës, ajo që mban mbi vedi gjithë barrën e luftës, humb jetën, por jo edhe betejën.

Por vemendjen e lexuesit dhe shikuesit e tërheq diçka tjetër, pra jeta, vepra dhe fati i Cucës. Për këtë edhe autori kujdes të posaçëm u kushton episodeve që zhvillohen në retrospekcion, nga të cilat mësojmë mjaft për kryeprotagonisten dhe zhvillimin e ngjarjevet që nga kohërat më të hershme. Loni Papa e përcjell me qëllim të caktuar fatin e Cucës dhe familjes së saj prej ditës kur prifti i fshatit, që është një ndër udhëheqsit e krimineleve, nuk e pagëzon ate si ferishte, por e fyen të jatin e saj, Gjinin, që „koc i fortë thonë se ka qenë", sepse nuk mund të durojë t'i mveshen veprat që nuk i ka bërë. Konfliktet në mes të kundërshtarëve të progresit dhe forcave progresive janë më të hershme. Kundërshtarët e Cucës, që ishin edhe kundërshtarë të të jatit të saj, janë njerëz të pasur të fshatit. Për të shkatrruar të varfërit ata kanë përdorë çdo mjetë e metodë, madje edhe predikuesin e fesë. Por në ditët e pasçlirimit ata shihnin shkatrrimin e tyre, prandej edhe me çdo kusht duan të mbrojnë ate që nuk mund të mbrohet më. Në Cucën ata nuk shihnin vetëm kundërshtarin e tyre që u doli përpara sypatrembur, siç thotë Hetuesi, por njerium që po u çilte sytë edhe të tjerëve për të shtuar kështu numërin e kundërshtarëve që nesër do t'ua qesin të vërtetën lakuriq. Këtë ata e kuptojnë, prandej edhe duan ta pengojnë, gjaja për të mbrojtur zakonet e maleve të trashëguara brez pas brezi. Situata e krijuar nuk i lejon të veprojnë ashtu si kanë vepruar dikur, haptazi, me shpifje, duke shtier të tjerët të dëshmojnë krejshëm apo shpifur. Prandej veprojnë mëshehtë të organizuar rreth Komitetit të tyre të maleve me shpresa që do të kenë ndihmën nga jashtë, të përkrahur edhe nga predikuesi i fesë, që në njëfarë dore është edhe ideologu i tyre që gjuan gurin por mësheh dorën. Prifti i fshatit, don Marku, është dinak. Veprimtaria e tij është ndër më të fshehtat. Sepse e

njerëzóre human
policór police
konóp rope; cord
të védin = vet
i posáçëm special
ferishte infant
koc = kóskë bone
mvesh = vesh
predikúes preacher
me çdo kusht at all costs
sypatrémbur unlinking
qes present
gjája = gjója
háptazi openly
shpífje lie
shpif lie
prandéj = prandáj
mëshéhtë = tshéhtas secretary
mëshéh = tsheh hide

gjejmë kurdoherë me fshatarët dhe paraqitet se gjëja gëzohet për ndërrimet e reja, për reformën agrare, që do të sjellë ndryshimin më të madh në marrëdhaniet shoqërore e ekonomike në fshat. Keqpërdorë mësimet fetare dhe rrobet që mban për të mbuluar veprat e tij të ndyeta e armiqësore edhe si një ndër propagatorët kryesorë kundër veprimtarisë së Cucës e të tjerëve. Të gjitha këto e ngrejnë edhe më lartë personazhin kryesor të dramës, Cucën e maleve, e qesin me pah si luftare të pakompromis kundër gjithë asaj që pengon përparimin, gjithë asaj që është në dëm të masës së gjerë. Ajo është e palodhshme në punën e saj, nuk e frigojnë as kërcenimet me të rrepta të kundërshtarëve që, duke humbur luftën me armë, kanë hapur frontin tjetër — kundër arësimit të fshatarëve. Proceset në zhvillim dhe gjërat i studjon dhe përpiqet të zbulojë në rrënjë, sepse vetëm kështu mund të luftohen me sukses. Ata nuk e nevrikosin aq shpifjet që bëhen në adresë të saj për gjëja shkeljen e moralit, sepse din nga vijnë këto, sa moskuptimi nga bashkëluftarët dhe i vëllai që dikur ka luftuar me armë, që „Vetëm për nji gja më vjen keq, Pal, se të dy të njajtën gja duem, por s'po merremi vesh. Edhe ti, edhe unë zemrën ja kemi falë Partisë, por ja që ti kujton se anmiku na lufton vetëm me pushkë... Anmiqtë përpiqen të mbajnë të pushtueme mendjet e njerëzvet!". Për këtë veprimtari të armiqëvet ajo është e vetëdijshme dhe mu këtu don t'i thejë, duke përvehtësuar zemrat e të mashtruarvet me butësinë, bindjen dhe zemërgjerësinë. Së këndejmi lufta e saj është e drejtuar kundër fjalëve të përhapura të armikut, sepse — „Po duhet me ditë se fjala asht ma e randë se plumbi" — i thotë të vëllait ajo për të shprehur kështu të vërtetën e pamohuar. Kjo është ideja dhe bindja e saj dhe në këtë drejtim e orienton luftën duke mos i zmadhuar aq shumë kërcenimet që i bëhen nga kriminelët, nga mbeturinat e klasës në shkatrrim. E bindur për efektin e madh të fjalës, që thyen mendjet e njerëzvet, ajo përpiqet të depërtojë në të gjitha poret e jetës dhe mendjet e njerëzvet dhe të përvehtësojë masën e pangritur jo me forcë, por me urtësi, me argumente siç ngjet në disa raste, ndër të cilët më karakteristike është ai kur e gjen priftin në shtëpinë e fshatarit që do të pengojë vajzën gjëja për të ruajtur moralin.

Në një mënyrë të këtillë nuk janë vijëzuar edhe bashkëluftarët e tjerë të Cucës, që disi mbesin nën hijën e saj. Ata janë më pak aktiv, kështu që drama humbë ngapak efektin e saj artistik, sepse e gjithë vemendja e lexuesit dhe shikuesit është e drejtuar në Cucën herë herë të vetmuar. Palin, të vëllain e Cucës, për të kaluar në akcion

keq· përdór misuse
i ndýer dirty
pah open
në dëm harmful
frigój = frikój frighten
kërcním = kërcënním threat
nevrikós become nervous
gja = gje
njájtën = njéjtën
dúem = dúam
anmik = armik
don = do
thejë = thyejë
i mashtrúar deceived
zemërgjerësí magnanimity
asht = është
zmadhój enlarge; exaggerate
shkatrrím = shkatërrím ruin
por pore
i pangritur dormant
ngapák a little; somewhat
rándë = rëndë

të hapër kundër armiqëve e pengojnë pehatjet në mes të kanuneve, rrethit dhe veprimeve të së motrës që ka lën të fejuarin. Duket se ai akoma nuk i ka sqaruar çështjet me disa norma prapanike të kanuneve të pashkruara. Nga se nuk është në gjendje t'i kuptojë gjërat në esencë herë herë në një anë dhe i nxitur nga fjalët e armiqëvet, nga ata që kalimthi i lëshojnë ndonjë fjalë të rëndë për të motrën ai herë herë bëhet kundërshtar i flukët e veprës së saj, jo pse është i tillë, por pse mendon se duhet të kujdeset për të motrën si vëllai më i madh. Konfliktet e brendëshme të tij, lufta psikologjike në mes të vëllaut që ndien fjalë të këqija për motrën dhe njeriut që ka luftuar pengate që është progresive janë të natyrshme. Si i këtillë ai mbetet personazh interesant, personazh drama e të cilit ka një domëthenie në vedi, madje edhe atëherë kur kjo e len fare të vetmuar Cucën në luftën e saj për ngritjen e masës dhe kundër armiqëve të fshehët që vepronin aktivisht.

„Cuca e maleve" e Loni Papës mbetet vepër me vlerë, vepër që deshmon se edhe temat më aktuale të kohës, të ashtuquajtura të angazhuara, mund të gjejnë mishërimin artistik të vërtetë atëherë kur krijuesi e ndien, përjeton dhe studjon me kujdes temën dhe kohën për të cilën shkruan. *„Cuca e maleve"* është vepër realiste, në mënyrë realiste janë vijëzuar edhe personazhet e saj. Nëse protagonistja kryesore len përshtypjen e një fytyre të idealizuar, që në të vërtetën ruan në vedi karakteristikat e luftares revolucionare të vetëdishme, kjo nuk mund të thuhet edhe për protagonistët tjerë. Fshatarët që kushtet jetësore dhe ekonomike i kanë lënë të paarësimuar, të cilët një mësues i mirë do t'i shtjen në rrugën e progresit të cilën e përkrahun intimisht, janë vijëzuar mjaft mirë.

From A. D Jasiqi, «Dhjetë drama shqipe,» Jeta e re, No. 6 (Nov. - Dec.), 1968, pp. 1242-6.

tè hápër = të hápur
pehátje inhibiting syndrome
kalímthi in passing
domëthënie = domethënie
i ashtuqúajtur so-called
i angazhúar relevant
i paarësimúar uneducated

LEXIMI I GJASHTËDHJETËNJETË

Ai priste tek stacioni i autobuzit. Kishin kaluar pesë minuta. Shiu porsa kish pushuar dhe njerëzit që përkohësisht kishin gjetur strehë nëpër hyrjet e dyqaneve, tani shpejtonin që të mos i zinte furija e re e shiut, që, me sa dukej, nuk do të vononte. Gjëja e parë që atij i kish bërë përshtypje në Tiranë, kur kishte ardhur para dy javësh nga qyteti i vogël malor B., ishte lëvizja. Këtu njerëzit ecnin më shpejt se në qytetin e tij. Ata nxitonin kur shkonin në punë, ose kur delnin prej saj, nxitonin për në shtëpi, për në kinema, për kudo. Veçanërisht kur binte muzgu. Ahere qyteti dukej si në ethe. Në trotuaret e qendrës njerëzit të shtynin me sup, përplaseshin me ty dhe, pa thënë as «më fal», iknin më tutje. Në fillim atë e shqetësonte kjo lëvizje, por pastaj filloi t'i pëlqente. Atij i pëlqente Tirana dhe jeta e saj. I pëlqente çdo gjë, duke filluar që nga emri Tiranë, që i dukej si diçka që çpaloset papritur dhe ecën drejt, gjer tek rrugicat e vogla pranë qendrës, që janë të qeta e të ngushta, në krahasim me rrugët kryesore. Kur erdhi natën e parë në konviktin e studentëve, në kokën e tij ishin grumbulluar kaq shumë përshtypje, sa që nuk e zinte dot gjumi. Ai do të ishte pesë vjet qytetar i këtij qyteti. Kjo gjë e turbullonte. Ditët e tjera dalngadalë ai filloi të njihej më mirë me rrugët, me jetën e studentëve dhe me zakonet e kryeqytetit. Pastaj i bëri përshtypje një gjë tjetër. Këtu njerëzit që ti njeh, kur të shohin rastësisht në rrugë (gjë që ndodh rrallë), nuk ndalojnë të këmbejnë dy fjalë, por të japin një përshëndetje të ftohtë dhe vazhdojnë rrugën me nxitim. Kështu i ndodhi atij ditën e tretë, kur pa në bulevard të madh ca shokë të kursit të tij. Atij iu duk kjo gjë një ngjarje e madhe (po takonte të njohurit e tij mu në mes të kryeqytetit).

takím date; rendezvous; appointment
strehë shelter
furí fury
me sa dúkej it seemed
éthe fever
trotuár sidewalk
çpalós = shpalós unfold; unwrap
nxitim hurriedness
kurs course; curriculum
i njóhur acquaintance
kalímthi in passing
mërzít irk; annoy; bother
vetmí isolation; aloneness
mësóhem get used to; I am taught
rádjua = radioja

dhe u bë gati të ndalonte, por ata i dhanë një përshëndetje kalimthi dhe vazhduan rrugën. Kjo gjë e mërziti pak në fillim, ashtu siç e mërziste vetmija, por filloi të mësohej. Përveç shokëve të kursit në Tiranë s'kishte asnjë të njohur tjetër. Duke ecur nëpër rrugë mbrëmjeve, ai mendonte se do të vinte vallë dita që të mos e ndjente veten i huaj në këtë qytet të çuditshëm. Natën në konvikt dhe në klubin e studentëve kishte gjallëri. Studentët mblidheshin tek radjua dhe dëgjonin lajmet e fundit për ngjarjet në Çekosllovaki. Ata diskutonin pastaj për një kohë të gjatë për to dhe ai e ndjente veten shumë mirë midis tyre. Por kur delte nëpër qytet vetmija e mërziste. Ai qe mësuar që në çdo rrugë dhe në çdo klub në qytetin e tij të vogël të takonte miq dhe të njohur, kurse këtu s'kishte asnjeri. Rrugët e Tiranës ishin mbushur me vajza të gjalla dhe simpatike. Ato i mbanin flokët ndryshe, ecnin ndryshe dhe buzëqeshnin ndryshe nga vajzat e qytetit të tij të vogël. Në fillim atij i qe dukur pothuaj i pamundur shoqërimi i tij me një vajzë të tillë. I dukej sikur i përkisnin një bote tjetër, të panjohur dhe të paarritshme për të. Tani, duke qëndruar tek stacioni i autobuzit, atij i vinte çudi nga vetja, se si vetëm dy javë pas ardhjes së tij në Tiranë ai po priste në takim një vajzë tiranase. Atij i qe dukur gjithmonë se gjëra të tilla fillojnë zakonisht me vuajtje dhe me fletë të shumta ditari, plot supozime dhe dyshime. Kurse kjo ndodhi në mënyrë fare të thjeshtë. Atë e quanin Djana. Ishte në kursin e tij. Nga përshëndetjet e të gjitha vajzave të kursit, përshëndetja e saj i qe dukur më e ngrohtë. Ata kishin qëndruar disa herë bashkë gjatë leksioneve. Ai ishte shumë i fortë në fizikë dhe ajo e pyeste vazhdimisht. Atë ditë në mëngjes kur, në pushim, ra fjala për një film që loste këto ditë dhe ai tha se akoma nuk e kishte parë, ajo tha se gjithashtu nuk e kishte parë filmin dhe po të donte ai mund t'i merrte biletë për në orën pesë e gjysëm, meqenëse rruga për në shtëpi i kalonte para kinemasë. Këtë gjë ajo e tha pa drojtje përpara të tjerëve. Ai gati sa s'u skuq.

Kjo ishte vërtet një ditë e jashtëzakonëshme. Në të gjitha emisionet radjua jepte vazhdimisht lajmin e daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës. Studentët nëpër koridoret flisnin se do të krijohej brigada e studentëve. Ata diskutonin për automatikët e rinj që do të merrnin. Në pushime u bënë dy mbledhje të shkurtëra, ku u tha se ç'duhet të bëjnë studentët e konvikteve në rast prove të alarmit ajror.

simpatík friendly; sympathetic
shoqërím companionship
i paarrítshëm inaccessible
ditár diary
pushím break; intermission; recess
bilétë ticket
meqënëse since; because; on accout of
dálje exit; withdrawal
Traktáti i Varshávës Warsaw Pact
alárm ajrór air raid
i kuptúeshëm understanding
mund të mos might not
ngrys get dark
zbraz empty

Jeta papritur mori një ngjyrë të fortë dhe të jashtëzakonëshme. Atij iu duk se filloi të shkrihej ajo distancë që ai kishte patur me studentët e tjerë, sidomos tiranas. I dukej sikur ata iu bënë papritur më të afërt dhe më të kuptueshëm. Sikur të mos mjaftonin gjithë këto përshtypje të forta, Djana e ftoi të shkonin në kinema. Jeta fitoi papritur një densitet të tillë, sa që atij i dukej sikur nuk do ta përballonte dot.

Djana po vononte. Mendimi se ajo mund të mos vinte i u var si një hije mbi mendimet e tjera. Ai donte që ajo të vinte. Donte shumë që ajo të vinte. Në këtë orë, kur dita po ngrysej me shpejtësi, ajo duhej të vinte pa tjetër. Autobuzët zbrazeshin në stacion njeri pas tjetrit. Ai nuk i hiqte sytë nga dera e përparme, ku njerëzit hidheshin sikur i shtynte dikush. Porsa autobuzi ikte, duke zbrazur për një çast stacionin, stacioni fillonte të mbushej përsëri. Ai pothuajse e kishte humbur shpresën kur Djana erdhi.

— Më fal se u vonova, — tha ajo gjithë gëzim sikur të kishte bërë punën më të mirë në botë. Ai e ndjeu turbull se në qoftë se do që të provosh gëzimin e dashurisë, duhet më parë të provosh shqetësimin e vonesës, që rri gjithmonë si roje përpara pragut të dashurisë. Ai e ndjeu se këto fjalë do të përsëriteshin shumë herë dhe shumë herë ai do të thoshte «s'ka gjë», megjithëse kjo nuk ishte e vërtetë.

— Jemi vonë, — tha ajo, — duhet të ecim shpejt.

Megjithëse shpejtuan, ata nuk u futën dot në film. Porta e kinemasë ishte mbyllur. Dy tri të inatosur po i binin portës me grusht, por asnjeri nuk e hapte. Biletat që ajo i kish nxjerrë nga xhepi gjatë ecjes i mblodhi shuk dhe i hodhi. Ato ranë mbi trotuarin e lagur dhe duke parë se si ajo qeshi, ai e kuptoi se ajo ishte po aq indiferente për filmin sa dhe ai.

— Po tani ç'do të bëjmë? — pyeti ajo.

Ai ngriti supet. Në këto raste nuk e dinte ç'duhej bërë, sepse asnjëherë nuk i kishte qëlluar të vinte në kinema me një vajzë dhe porta e kinemasë t'ishte e mbyllur dhe vajza t'ishte kaq simpatike.

— Shkojmë në ndonjë kinema tjetër, — pyeti ajo.

— Shkojmë.

Ata u nisën prapë drejt qendrës megjithëse të dy e dinin se nuk do të shkonin në asnjë kinema tjetër, sepse në këtë orë ishte e vështirë të gjeje bileta dhe veç kësaj as ai, as

rójë guard
i inatósur angry
shuk lump; wad
qéndër downtown; center
méspërmes right through the middle
pastiçerí pastry shop
akullóre ice cream
i tépërt excessive
reklámë sign
blej buy
thjeshtësí simplicity
kam qejf like; enjoy

ajo nuk ishin të sigurtë se dëshironin të shikonin vërtet ndonjë film.

Duke ecur nëpër rrugët e qendrës ai çuditej se si mund të ecte kështu lirisht me një vajzë mespërmes qytetit, pa tërhequr vëmendjen e askujt. Ai po vriste mëndjen se a duhej që t'i propozonte asaj të hynin në ndonjë pastiçeri që të blenin akullore, apo ndoshta kjo gjë do t'ishte një guxim i tepërt nga ana e tij. Ai kishte vënë re se vajzat e Tiranës i hanin shumë akulloret, megjithëse vera kishte kaluar dhe kishin filluar shirat. Diku përpara, u çfaq reklama e një akulloreje të madhe. Ajo i a paralizoi krejt mendimet. Kur u gjendën pothuaj nën dritën e reklamës dhe ai po bëhej gati të hapte gojën, ajo tha e para.

— Blejmë akullore?

Ajo e tha këtë gjë me thjeshtësi, duke kthyer kokën nga xhami i veshur me avull, prapa të cilit me dhjetra njerëz hanin akullore ne këmbë.

— Une porsa mendoja...

— Apo s'i ke qejf akulloret? — e ndërpreu ajo.

— Pse s'i kam?

— Të them të drejtën mua s'më pëlqen kur djemtë hanë akullore, — tha ajo, duke qeshur.

Ai s'dinte ç't'i thoshte.

— Megjithatë ti mund të blesh për hatrin tim, apo jo?

Dreq o punë. Përsëri ai nuk dinte ç'të thoshte. Ajo hyri e para në pastiçeri.

— Në anët tuaja duhet të ketë shumë dëborë, — tha ajo duke e mbajtur akulloren me dy gishta.

— Po, bie shumë. Disa herë arrin trashësinë dy metra.

— Ah, sa bukur!

Ai donte që të vazhdonte biseda për dëborën sepse e ndjente që këtu kishte përse të fliste. Dëbora ishte një taban i sigurtë që nuk do ta linte bisedën të fundosej.

— Kurse në Tiranë, mezi bie një herë në vit, — tha vajza pothuaj me trishtim.

— Vetëm një herë?!

— Po. Bile ka vite që s'bie fare.

— Çudi!

— Ama, kur bie bëhet nami, — tha ajo me një ton të gëzueshëm. — Nuk shkon dot në rrugë, sidomos po të jesh vajzë. Djemtë gjuajnë nga të gjitha anët. Po tek ju gjuajnë me dëborë të rriturit?

dreq o púnë great scott
arríj reach; arrive
trashësí thickness
tabán plank; base
fundós sink
nam curse; name
gjúaj strike
frigorifér refrigerator
pelerínë cloak, cape
çun boy
çfrytëzój = shfrytëzój utilize; use up
këndë corner; nook
brýmë frost
kat store; section; floor
i sípërm upper

— Jo. Lozin vetëm të vegjëlit.

— Sigurisht. Atje ka gjithmonë dëborë, kurse këtu është një gjë e rrallë. Prandaj çmënden i madh e i vogël. E di, ç'bëri vitin që shkoi vëllai im i vogël? Prishi frigoriferin.

Ai qeshi.

— Më kujtohet, vitin që shkoi ra dëborë të nesërmen e ditës kur u inaugurua monumenti i Skënderbeut. Në mëngjez ai u gdhi i mbuluar me dëborë. Sa bukur që ishte! Mbi pelerinë, mbi qafën e kalit. Ah, sa bukur!

— Po frigoriferi pse u prish? — pyeti ai.

— A, po, harrova ta them. — Ajo qeshi përsëri. — Në mbarim të ditës, dëbora pothuaj u shkri. Çunat e paikatit tonë mezi gjenin grushtet e fundit të saj nëpër tarracat. Kur u çfrytëzua çdo kënd, vëllait tim dhe një djali tjetër, që banonte në apartamentin përballë nesh, ju ra ndërmënd të hapnin frigoriferin dhe të bënin topa dëbore me brymën e katit të sipërm. Kur erdhëm në shtëpi e gjetëm guzhinën të lagur. Frigoriferi i hapur punonte pa pushim. Ata zgjatnin duart brënda me radhë dhe nxirrnin grimcat e fundit të brymës.

Duke treguar, ajo qeshte dhe hante akullore. Ai gjithashtu qeshte. Pastiçeria ishte plot me njerëz dhe asnjeri nuk e dëgjonte bisedën e tyre, sepse kishte shumë zhurmë. Ata nuk kishin mbaruar së ngrëni akulloret, kur nga radjua, që ishte vendosur tek banaku, u dëgjua zëri i spikerit që po jepte lajmet. Përsëritej lajmi i daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës. Në pastiçeri u bë një farë qetësie. Pas deklaratës zyrtare, jepej një reportazh nga jehona që kish bërë lajmi në një uzinë të Tiranës.

— Në lagjen tonë u bë një mbledhje e Frontit ku u dhanë udhëzime se ç'duhet të bëjë secili në rast alarmi ajror, —tha ajo duke dalë.

— Edhe tek ne në konvikt u bë një mbledhje e tillë, — tha ai.

Rrugët ishin plot me njerëz. Ata ecnin pa ndonjë qëllim dhe asnjeri nuk u kujtua të shkonin në ndonjë kinema tjetër.

— Si mendon ti, — pyeti ajo, — ka mundësi që shtetet revizioniste të bëjnë ndonjë sulm kundër nesh ashtu siç e bënë në Çekosllovaki?

Ai nuk u përgjigj menjëherë.

— Ka mundësi, — tha pastaj. — Në kohën tonë çdo gjë mund të pritet prej tyre.

grímcë speck; bit
zhúrmë noise
spikér speaker
zyrtár official
jehónë repercussion; echo
udhëzím guideline
pa kujtúar unconsciously
i vérdhë yellow
shterrím sterility; exhaustion

— Prandaj do të bëhen tek ne alarme ajrore?
— Sigurisht.
— Asnjëherë nuk kam parë alarm ajror, — tha ajo.

Ata pa kujtuar e lanë qendrën dhe, pasi kaluan hotel «Dajtin», u kthyen në bulevardin e qetë «Marsel Kashen». Trotuaret ishin mbushur me fletë të verdha. Duke shkelur mbi to ata e ndjenë se bisedat e tyre ishin në shterrim e sipër. Tani që ecnin midis pemëve të larta, të dyve i u dukej se ishte një gjë e panatyrëshme dhe artificiale të flisnin për akulloret ose ndonjë qyfyr tjetër. Meqënëse nuk gjenin dot një bisedë që t'i përshtatej atmosferës vjeshtore të bulevardit, ata, përsëri pa e kuptuar, e lanë bulevardin «Marsel Kashen» dhe shkuan drejt qendrës. Tani ai priste çdo sekondë që ajo të thoshte se u bë vonë. Por ajo nuk e tha këtë gjë as kur arritën në sheshin Skënderbej dhe as kur kaluan në Rrugën e Dibrës. Ai mendoi se ajo do ta thotë këtë gjë me siguri kur të dalin nga Rruga e Barikadave tek Mapua Nr. 2. Nëqoftëse ajo nuk do ta thoshte as atje, ahere do ta thoshte tek magazina e Librit Ndërkombëtar. Dhe nëqoftëse nuk do ta thotë as atje ahere ai, me siguri do të flinte shumë pak kur të kthehej sonte natën në konvikt. Ata kaluan Rrugën e Barikadave dhe ajo s'tha gjë. Tani po kalonin Librin Ndërkombëtar. Ecën përpara bar «Krimesë», xhamet e të cilit ishin veshur si gjithmonë me avull të dëndur, pastaj, me hapa gjithmonë e më të ngadalta, vazhduan rrugën përbri Pallatit të madh të kulturës. Tani ajo do të thotë me siguri, mendoi ai. Do të shikojë orën e qytetit dhe do të thotë. Ajo ktheu kokën vërtet nga ora dhe ai priste të thoshte se u bë vonë, kur në atë çast, diku nga e djathta, sipër qytetit, në fillim e ngadaltë sikur zgjohej nga gjumi dhe pastaj gjithëmonë më e fortë dhe e mprehtë, u dëgjua një sirenë. Zëri i saj rritej e rritej vazhdimisht dhe, kur arriti pikën më të lartë dhe filloi të ulej, u dëgjua një tjetër sirenë. Pastaj një tjetër. Një tjetër. Dritat e rrugëve u shuan. Disa zëra thirrën «alarm». Rruga e zhytur papritur në errësirë, në fillim u duk sikur shtangu, pastaj u përmend papritur, u dëgjuan zëra, hapa që vraponin, një zhurmë e mbytur që vinte nga errësira. Dritat e Pallatit u shuan gjithashtu. Dritat e lokaleve dhe të MAPO-ve po shuheshin njera pas tjetrës. Ata qëndruan në vend. Rruga oshëtinte nga një zhurmë e mbytur. U shuan dritat e kafeve. Ora u zhduk nga qielli. Qëndra u zhyt në errësirë të plotë. Diku u ndez dritë në një dritare. Një

qyfýr amusement; joke
vjeshtór autumnal
Mápo = Magazína Popullóre state department store
sónte nátën tonight
bar bar; nightclub
ávull steam
përbrí opposite
i zhýtur plunged
shtang freeze; petrify

zë i rreptë thirri: «shuani dritën!» Drita u shua. Dikush në rrugë fliste me zë të ashpër në formë urdhëri: «Qytetarë, futuni nëpër strehët më të afërt. Zbrazni rrugët». Zhurma e verbër e hapave sa vinte bëhej më e mbytur. Sirenat vazhduan të binin njera pas tjetrës.

Pa ditur as vetë se si, ajo e kish kapur atë për dore. Përbri tyre ndjenin njerëzit që ecnin dhe futeshin diku. «Qytetarë, largohuni nga rrugët!» dëgjohej zëri i ashpër.

— Këtu është një lulishte e vogël, — tha ai. — Futemi në lulishte.

Ata u futën në lulishten e vogël përpara Pallatit të madh të kulturës. Ajo nuk ia kish lëshuar dorën. Në lulishte ishin futur edhe njerëz të tjerë. Ai pa një cingare, pastaj një tjetër. Nga zhurma e sirenave zërat e ultë të të panjohurve nuk dëgjoheshin. Ata rrinin fare pranë njeri tjetri. Ishte hera e parë në jetën e tij që një vajzë kishte vënë dorën mbi dorën e tij. Ai ndjente aromën e flokëve të saj të krehura bukur. Një aromë e këndëshme, e pànjohur.

Sirenat filluan të pushonin njera pas tjetrës. Dukej sikur po ju merrej fryma. Kur heshti sirena e fundit, u bë befas një heshtje tronditëse. Dëgjoheshin vetëm ca hapa të largëta që iknin diku. Pastaj, nga qielli erdhi një zhurmë tjetër më e shtrirë dhe më e largët. Ata ngritën kokat. Lart, shumë lart fluturuan dy reaktivë, njeri me sinjale të kuqe, tjetri me të kaltërta.

Me një furi të papërmbajtur atij i dyndeshin në gjithë qenien e tij copra ndjenjash e mendimesh të shkëputura. Ato shkëlqenin një çast, pastaj shuheshin, pastaj ndizeshin të tjera, ashtu si shkëndijat që lëshon një zjarr i madh kur dikush trazon urët Kishte diçka madhështore dhe tronditëse në këtë minutë alarmi. Dhe befas, i u duk se për herë të parë në jetën e tij, ai mundi të perceptonte në mënyrë jashtëzakonisht të përmbledhur e të qartë, atë që kishte mësuar, dëgjuar dhe lexuar, mijëra herë, në mijëra këngë e faqe librash, e abetaresh, që nga moshë e vogël e gjer më sot për historinë e popullit. Atij iu duk se për herë të parë preku me duar historinë. Ai preku trupin e historisë. Historia ishte aty, rreth e rrotull, e thjeshtë dhe e kuptueshme si asnjëherë.

Në rrugë kaloi një gaz i policisë me dritë të kuqe. Drita e tij, duke rrëshqitur e zbetë midis drurëve, ra për një çast me një përflakje të përgjakur mbi ballin e tij dhe pastaj humbi. Ajo e mbante dorën e tij shtrënguar edhe më fort. Përse, që nga mëngjezi, kur studentët u lajmëruan për formimin e

i mbýtur muffled; clouded
zhyt plunge
stréhë shelter
i vérbër blind
lulíshte flower garden; park
cingáre = cigáre cigarette
ju = iu
i shtrírë lengthened; flat
i papërmbájtur unrestrained
dynd jolt; shake
gaz i policísë police car
i zbétë pale
përflákje flaming hue
i përgjákur blood-red

brigadës dhe u bë ndarja në bataljone, asaj, i lehtë si një mjergull, i kaloi dy tri herë në kokë mendimi se në rast lufte, ai mund të... përpara saj? Ndoshta sepse ai ishte nga zonat e largëta malore, atje ku në meloditë e këngëve ka gjithmonë diçka dramatike? Apo ndoshta se në fytyrën e tij kishte diçka prej atyre që hidhen të parët në sulm? Apo që kjo gjë i kish kaluar asaj nëpërmënd ashtu thjesht, vetëm sepse ai ishte djalë? Ajo vetë nuk e dinte përse dhe asqë përpiqej ta dinte.

Njerëzit që ishin futur në lulishte bisedonin me njeri tjetrin, sikur të ishin të njohur prej kohësh. Ishin po ata kryeqytetas që para një çerek ore mbushnin me nxitim rrugët dhe që atij i qenë dukur gjithmonë të ftohtë e të paafrueshëm. Tani ata bisedonin për avionët, për sulmin e mesnatës kundër Çekoslovakisë, për manevrat e ushtrisë sonë. Dikush tregonte hollësira se si u pushtua atë natë aeroporti i Pragës. Një tjetër i thoshte dikujt diçka për mënyrën si asgjësohen desantët.

Atij i u duk sikur ishte në shtëpinë e tij në qytetin e vogël malor. B., midis njerëzve të tij, pranë zjarrit dimëror.

Një sirenë e vetme ngriti frymëmarrjen e saj të fuqishme mbi kryeqytet.

— Mbarol alarmi, — tha një zë.

Neonet e rrugëve u ndezën të parat, duke u përpëlitur si të përgjumura. Pastaj u ndez ora e madhe, dritat e Pallatit të kulturës, lokalet, MAPO-t. S'kaluan shumë sekonda dhe rrugët u mbushën përsëri me njerëz dhe zhurmë. Maqinat që kishin ndaluar ndanë trotuareve, atje ku i kish zënë alarmi, filluan të lëvizin, Ca fëmijë vraponin duke imituar zërin e sirenës.

Ata ecën midis turmës së kalimtarëve drejt sheshit Skënderbe. Sheshi ishte plot gjallëri. Autobuzët urbanë, të mbushur më tepër se zakonisht, mezi çanin midis njerëzve. Ajo pa orën.

— Koha për shtëpi? — pyeti ai.

Ajo bëri «po» me kokë. Në «po»-në e saj kishte një keqardhje të gëzueshme. Kur kaluan përbri monumentit të Skënderbeut ata të dy buzëqeshën me vete. Me siguri ju kujtua biseda për dëborën.

Tek stacioni i autobuzit kishte shumë njerëz që prisnin. Ata bisedonin me njeri tjetrin, duke treguar gjithë gëzim ku i zuri alarmi. Disa pyesnin se a ishin ndërprerë seancat e ki-

asqë = as që
kryeqytétas citizen of the capital
manévër = manóvër maneuver
hollësí detail
desánt member of a landing party
dimërór winter; wintry
përpëlít writhe
i përgjúmur asleep
ndánë alongside
túrmë crowd
kalimtár passer-by
keqárdhje sadness
seáncë show
ushtarák military
kuréshtje curiosity

nemave apo çfaqjeve por asnjeri nuk e di te me saktësi këtë gjë. Tre autobuzë u mbushën njeri pas tjetrit, por turma që priste rritej vazhdimisht. Asnjëherë ai nuk kishte ndjerë kaq ngrohtësi në shpirt.

Nga të gjitha anët dukeshin njerëz të armatosur të veshur gjysëm civilë, gjysëm ushtarakë. Ajo i vështronte me kureshtje.

— Janë çetat popullore, — i shpjegoi ai.

— Për mbrojtje kundër desantëve?

— Po.

Asaj iu bë qejfi që ju kujtua kjo gjë nga zbori dhe që e përdori në kohën e duhur.

Midis të armatosurve kishte vajza.

— Kurrë neve nuk do të na gjejë askush në gjumë si çekët, — tha ai.

Ndërsa prisnin autobuzin njerëzit qeshnin, bisedonin, bënin shaka. Më tepër se me qytetarë që presin autobuzin ata ngjanin me një grumbull njerëzish të afërm që po shkonin diku për të uruar ndonjë ditëlindje apo thjesht për vizitë.

çétë defense unit
zbor rally; assembly
çek Czech

A story by I. Kadare, Nëndori, No. 4 (April), 1969, pp. 43-50. Story originally titled «Historia».

LEXIMI I GJASHTEDHJETEDYTE

Sterjo Spasse, «Të fala nga fshati,» Nëndori, No. 10 (October), 1957, pp. 11-16 (excerpt).

1

LETËR NGA KRYEQYTETI

I dashur Sokol,

Sot pata me të vërtetë një gëzim të madh: mësuesi i gjuhës shqipe më dorëzoi një letër duke më kështilluar: «— E mira është t'i përgjigjesh këtij shoku të panjohur».

E mora letrën dhe me padurim lexova drejtimin:

«E dërgon: **Sokol Skënderaj,**
Nxënës i klasës së VII të shkollës
Shtatëvjeçare «KRISTOFORIDHI» — Tiranë.»

— **Sokol Skënderaj! — Tiranë.** — Qënkemi më një klasë, veçse jo më një shkollë, jo më një vend. Unë jam në fshat, kurse ai në kryeqytet. Ehu, në kryeqytet! Lum ai! — Mendova sakaqë e në krahëror filloi të më rrahë krahët një si zog: sikur fluturonja me krahët e këtij zogu. Më një qoshe të shkollës lexova letrën. Sa mirë, sa mirë! Një shok i panjohur nga kryeqyteti më shkruante mua fshatarit të Kallmasit. Sa mirë, sa mirë!

Renda te shokët dhe me krenari ua tregova letrën. Edhe ata u gëzuan dhe m'u lutën t'ua lexonja. Ashtu bëra.

— Nga kryeqyteti, thua! Lum ti! — thanë me një ze.

Vërtet lum unë! Do të më shkruash kaqë gjëra të bukura per kryeqytetin. Kurse unë do të shkruaj jo gjëra të bukura, por gjëra të fshatit. Kam etje t'ja them këto të fshatit një shokut, që jeton në kryeqytet. Dhe për ne nxënësit fshatarë është gjë e madhe të kemi miqësi me qytetarë, sidomos me kryeqytetas. Besoj se edhe dëshira juaj është e tillë, gjersa më dërgove letër e kërkon shokërinë time.

Sa vajta në shtëpi, ja tregova nënës. «Sa kohë që s'na ka ardhur letër në shtëpi!» psherëtiti thellë. E pashë që mbushi sytë me lot. Edhe gjyshi — ah Sokol, ta dish se ç'gjysh që kam — edhe ai ma shtrëngoi kokën në kraharorin e tij të plakur edhe më gudulisi me mustaqet e thinjura:

— Kështu, xhan i Babagjyshit, të zesh miqësi: me të gjithë edhe me ata të kryeqytetit. — më kështilloi dhe të dy me nënën më shtynë që t'ua lexonja letrën.

Shënim: Po botojmë disa pjesë nga vëllimi me tregime për pionerët e për të rinjtë.

padurím impatience
lum ai lucky him
sakáqë = sakáq like this
kraharór chest
babagjýsh grampa

E vërteta është se s'e di sa vetëve ua kam lexuar letrën tënde. I gjithë fshati është interesuar për këtë letër. Edhe Xha Koroveshi, një plak I thinjur e që s'para i pëlqen të flasë me çdo njeri, më ndalol rrugës e më tha:

— O i nipi i Stefanit, paske marrë letër nga kryeqyteti a? Të lumtë! Po shiko se mos na turpërosh. T'i shkruash për gjërat më të mira të fshatit. T'i matësh fjalët mirë!

E vërteta është se unë i mata fjalët dy ditë me radhë e mezi po të përgjigjem.

Të shkrova kaqë gjatë, por asgjë nga fshati.

Mos e humb durimin gjersa të marrësh letrën e dytë.

Të përshëndes me gjithë zemër duke të dërguar sëpari të fala, shumë të fala nga fshati!

I yti: **Ylli Tokallari**
Nxënës i kl. së VII-të Shkollës Shtatëvjeçare «Partizani» të katundit Kallamas, Lokalitetl i Drithasit — Korçë,

2

FAMILJA IME

I dashur SOKOL,

më pyet për gjendjen time familjare E ç'të të shkruaj më parë?

Unë jam i biri i Jani Tokallarit. Nëna ime quhet Eleni a Lenkë si e thërret gjyshja. Ajo mirret me punët e shtëpisë edhe me punët e bujqësisë. Në shtëpi kam gjyshin, Stefanin. Ai është shtylla e shtëpisë. E di sa plak që është? Besa, të rallë, i ka shokët këtu. Veç gjyshi Koroveshi, hë-hë se ja kalon tjetër me thinjat, por edhe në punët. Ta shikosh pa qeleshe: të duket sikur ke kokën e një shqereje me lesh rude. Kaqë i bukur më duket. S'ja përton për asgjë. E harron vehten në punë. E në ç'punë do të thuash? Punët e fshatit janë të rënda. Ai lëron e mbjell, e korr. Ai kujdeset për pëndën e qevet, e për ato njëzet dhi, që kemi. Ai kujdeset edhe për gomarkën. S'është shaka të mirresh me bujqësi. Nuk them se punon vetëm gjyshi. Edhe nëna s'është e pakët: edhe ajo është krahu i djathtë i gjyshit në punët e bujqësisë. Kujdeset veçanërisht për lopën e për pulat. Por edhe kafshët e tjera nuk i harron. Mos harro, se nëna na gatuan edhe na lan. Motër s'kam; as vëlla s'kam. Do të desha t'i kisha e t'u gëzohesha si shumë bashkënxënës të mij, por...

.E lëmë këtë fjalë.

Edhe unë kur jam i lirë, përpiqem t'u ndihmoj, mirëpo shpeshherë gjyshi më qërton.

«Shko bëj mësimet më parë! Dua të bëhesh njeri, pa ne shkuam si shkuam!» — më thotë.

Pra: gjyshi, nëna dhe unë: Ja familja ime, Sokol!

Harrova të të them se kam edhe një gjyshe, që më do shumë. Kjo është gjyshja Maro, nëna e nënës sime. Po ajo jeton në shtëpi të saj.

Me siguri që do të më njohësh edhe ti me familjen tënde.

I yti: YLLI

mat measure
së pári first of all
shtýllë pillar
Bésa, të rrállë...këtú In truth he has few equals here
shqerr lamb
rúde soft, short, and wooly
përtój be lazy
lërój till; plow
qe(ka) oxen
dhi goat
gomárkë female donkey
s'éshtë e pákët it is not unconsequential
gatúaj cook
qërtój scold

3

BABAJ IM

Sokoli im,

të paska lënë vragë, pse s'të paskam shkruar gjë për babanë. Ke të drejtë, ke shumë të drejtë. E vërteta ishte se nuk më pëlqente të kujtonja midis të gjallëvet një emër të dhimbëshëm e aqë të dashur për mua: babanë tim.

E hidhur është, Sokol, por unë babanë nuk e njoh, s'e kam njohur kurrë.

Sa herë, që ulet nëna të çlodhet, më thërret edhe mua pranë saj, ma ve kokën në pëqi e më përkëdhel faqet, e më puth, e shpesh fytyrën ma lan me lot duke më folur për babanë. Dhe a e di si është puna?

Babaj im ishte një nga të parët në fshat që doli partizan që më 1942. Kishte luftuar anembanë. Shpesh herë zbriste fshehura në fshat, i mblidhte fshatarët natën e u fliste për luftën nacional-çlirimtare, u fliste kundra fashistëvet e kundra tradhëtarëvet të vendit. «Jani Partizani», e quanin atëherë. Edhe sot mua më thonë «Ylli, i biri i Jani Partizanit». Më vonë nga fshati ynë duallnë edhe shumë partizanë të tjerë, por nëna më thotë se flamurin e Partisë kurdoherë e mbante babaj. Për herë të fundit paska ardhur në shtëpi babaj nga muaji Maj i vitit 1944. Se si i kishte rënë rruga andej, e ishte këthyer një natë në shtëpi. Që atëhere s'u këthye më. Unë u linda në Korrik t'atij viti. Babaj e kishte marrë vesh edhe i kishte dërguar nënës një copë letër. Këtë letër edhe sot e ruajmë në sendyq si hajmali. Unë e di përmëndësh. Ja se ç'shkruan:

> **«Lenkua e dashur**
>
> **nuk e merr dot me mënd se sa jam i lumtur, që jemi gëzuar me djalë. Më duket sikur linda përsëri. Tërë të mirat që do oa sjellë liria, që është në prak të derës, do t'i gëzojë djali ynë. Pres me padurim ditën e çlirimit, që të vij t'ju përqafoj të dyve me djalin të cilin të lutem, ta pagëzosh YLL. A të kujtohet Ylli i qëndisur prej dorës sate? Babajt i puth dorën. — JANI. — Diku në malet e Shqipërisë: 20 korrik 1944.» —**

Ja kjo është letra. Por për fat të keq babaj s'më përqafoj kurrë, se s'u këthye kurrë. Ai vdiq si trimat në luftën për çlirimin e Tiranës. Një shok i tij, Xha Goli që erdhi më vonë, na tregoi se babaj ishte vrarë duke sulmuar fortinën e armikut mu pranë xhamisë së vjetër. Unë, as nëna, as gjyshi s'kemi qenë ndonjë herë në Tiranë. Nëna shpesh herë më thotë: «Hë, bir, rritu, të vesh të mësosh në Tiranë. Të vij të shoh edhe Tiranën.» Por unë e kuptoj: ajo e ka plagë në zëmër. Do të vijë në Tiranë që të shohë vendin, se ku është vrarë babaj! Ka të drejtë, nënocka ime, ka të drejtë!

Unë e kuptoj nënën pse i mbush sytë me lotë, kur i them se kam marrë letër nga Tirana prej Sokolit; unë e kuptoj pse pyet edhe babagjyshi kaqë shpesh për letrat e tua.

Ja cili është babaj im, i dashur Sokol; ja çfarë na lidh me Tiranën!

Gjithëmonë i yti: YLLI.

të páska lënë vrágë	you are sad
pëqí	lap
e di si është púna?	you know what the story is?
dúallnë = dólën	
sëndýq	chest
hajmalí	amulet
pagëzój	christen; baptize
sáte = tënde	
fortínë	fortification
nënóçka	dear mother

4

SHOKËT E MIJ

I dashur Sokol,

sa i lumtur duhet të jesh në familje, që paske edhe baba, edhe nënë, edhe dy motra. Kush' e di sa duheni njeri me tjetrin. Kush e di se si të përkëdhelin, edhe në gjumë·të dy motrëzat e tua, se thonë që motrat i duan vëllezërit më shumë se shumë.

Makari të kisha edhe unë një motër!

Më fal, Sokol, bëra gabim që u shpreha kështu! Më të shumtën e kohës e ndjej vehten me vëllezër e me motra. Sidomos kur ndodhem në shkollë. Aty jemi një grup shokësh, që s'ndahemi kurrë: S'i njeh ti: është Pirroja i Llamkës një djalë i shkathët dhe i hollë; është Gergji i Shemos, që s'i sheh gjë tjetër veç ata dy sy si filxhanë e ato dy buzë të trasha; është Vasoja i Gjergjevicës,— një çapkën që s'le dy gurë bashkë; eshtë Todri i Tinkës, — një nursëz, si e quan gjyshja e tija: gjithëmonë i mvrejtur, gjithëmonë i menduar. Pastaj kemi Liljanën, një këngëtare që të magjeps si thotë mësuesi i gjuhës; është Nala që s'ja prish kurrë njeriut; eshtë Vita, pak përtace ,por e shëndoshë e faqekuqe. Eshtë... e është... ehu, sa jemi ne këtu!

Fjalën e kisha gjetkë: unë kam shumë shokë e shumë shoqe, që i dua e që më duan si vëlla e motër. Bashkë mësojmë, bashkë pastrojmë, bashkë luajmë. Pa fjalë që ne edhe zihemi e zemërohemi nga ndonjë herë. Për shëmbëll, dje, Vasos i kishte hipur të qeshte e të cyste të tjerët. Ishte caktuar të vizatonte Gazetën e Murit, se — e vërteta është që atij i vjen shumë përdorësh për vizatim, — po a e di se ç'bëri burri i botës: Kishte marrë me vehte Todrin e i kislun shpënë të gjyshit bukë n'arë. Mirë ka bërë për këtë. Por pastaj në vënd që të vinin në shkollë n'orën e caktuar, ata të dy i kishin rënë korijes përpjetë, kishin ndjekur zoq e ljepuj si gjahtarë, — veçse me shkopinj, se s'kishin as çifte e as llastikë, e të këthehen si burra të mirë vonë fare e na u krekosën sikur kush e di se ç'kishin bërë. «Po gazeta e Murit»? — e pyetëm Vasion. Ai fërkoi zverkun si e ka zakon, fërshëlleu një herë mirë me gishtërinjtë në gojë e pastaj... hopa bëri një pelivanllëk duke kërcyer mbi bankat, Mua m'ardhi rëndë e s'm'u durua:

— Na turpërove organizatën, more derëzi! — i thashë. —. Gazeta duhej të dilte dy ditë më parë, kurse ne s'e nxjerim as nesër.!

Ai shrembëroi pak buzët, fërshëlleu edhe një herë dhe hopa... përsëri pelivanllëk; Ç't'i bënim?

Pirros i hipi gjaku:

— Ore, ty të flet! Përgjigju këtu! — i tha tërë inat. Ai pa na e varur fare, hapi derën e sallës së leximit dhe u çduk! Ne mbetëm të ngurosur. Vendosëm që ta thërisnim e të përgjigjej për këtë mefshtësi përpara shtabit të çetës. Por .. sot gabimin e tij çeta jonë e paguai shtrenjtë: Pa pandehur na erdhi inspektori i arsimit nga Korça. Gjëja e parë që i ra në sy ishte mungesa e Gazetës së Murit të shkollës. U turpëruam! Turpi na takon më tepër neve, që presim zbukurimin vetëm nga Vasoja. Sot pasdreke iu përveshëm me Pirron e me Liljanën dhe vonë fare e rregulluam. Sigurisht jo ashtu si e bënte Vasoja. Veçse jemi të

me shúmë se shúmë more than one can say
makári = makár if only
flxhán cup
çapkën young rascal
nursëz grouch
i mvréjtur frowning
i mendúar pensive; thoughtful
magjéps mesmerize
s'ja prish kúrrë njeríut never contradicts anyone
përtác lazy
fjálën e kísha gjétkë I had in mind something else
i kíshte hípur të qéshte had a case of the giggles
cys tease
llastíkë slingshot
krekós strut
zverk back of the neck
fërshëlléj whistle
hópa just like that
pelivanllëk stunt
derëzí wretch; unworthy one
shrembërój distort; twist
pa na e várur ignoring us
çduk = zhduk
i ngurósur stony; like stone
mefshtësí underhanded behavior

gëzuar se nesër në mëngjes inspektori me mësonjësit tanë, edhe shokët e shkollës do ta gjejnë Gazetën e Murit në rregull. Në gazetë i hoqëm një fashë Vasos. Të shohim si do ta presë.

Sokol, se si më duket kjo letër: shumë e ngatëruar, por s'ka gjë.

Po e le me kaqë. Mos harro, veç prindërvet, m'i përqafo për mua edhe të dy motrëzat e tua.

YLLI

5

TURP, TURP QË JE PIONIER

Sokol,

që kur i hoqëm vërejtje në Shtabin e Çetës e në gazetë, Vasoja është bërë më i egër. Po tërheq me vehte edhe Todrin. Nuk shtrohet në punë dhe shkollën sikur s'e ka në qef. I pëlqen të shkojë nëpër korijet. Fola me Todrin e ai më tha se Vasos i pëlqeka gjuetia. Se ku paska gjetur një llastikë e tërë ditën e ditës me këtë gjuan zoq, njerës, kafshë, ç't'i dalin përpara. Pa le: edhe mësimit ja ka varur fare. Sot bëri një gabim të rëndë: Mësuesi i matematikës na bëri provim të ditës me shkrim në mësimin e kimisë, — se edhe këtë lëndë na e bën ai. Vasoja siç duket nuk i kishte hedhur sy fare: pa një, pa dy hap librin dhe e fsheh midis gjunjëvet dhe filloi të kopjojë. Unë e pashë. Si t'ja bënja? Ta linja të kopjonte, apo të lajmëronja profesorin? U mendova gjatë. S'dinja nga t'ja mbanja. Që bënte keq Vasoja, këtë e kuptonja, por që të bëhesha unë shkakëtar për t'i prishur sjelljen Vasos, — as këtë s'e duronja. Duke u marrë me këto mendime, s'më ipej që të shkruanja vetë. Ora kalonte. Më ziente përbrenda. Isha në rrezik të merrnja dyshin edhe unë. Mësuesi e kuptoi se unë e kisha humbur. M'afrohet ngadalë e më pyeti se ç'kisha. Shikoi letrën të bardhë. «He-he, s'qënke përgatitur fare! — më tha. — Unë kurrë nuk e shpresonja këtë prej teje» M'u duk sikur ra çatija e më zuri u skuqa dhe sytë m'u mbushën me lot. Mësuesi më tërhoqi më një anë dhe më pyeti pse nuk e kisha mësuar mësimin. «— E kam mësuar!» — i përgjigjem. Më detyroi t'ulesha edhe të shkruanja pa tjetër. Fillova, por përsëri syri më vajti te Vasoja: ai kopjoi faqen e parë, dhe e këtheu me shumë kujdes faqen tjetër.

— Yll, ki mendjen! Të nxorra jashtë! — dëgjova zërin e hakerritur të mësuesit.

«Turp, turp, o Yll!» — sikur më thanë vështrimet e habitura të shokëvet. Vasoja buzëqeshi me të keq dhe vazhdoi të kopjonte.

«Turp, turp, që je pionier!» — më dukesh sikur më thoshnin të gjithë, me shokë, me organizatë, me mësues! — Turp që lejon të kopjojnë shokët! Pa le, je edhe kryetar shtabi! Turp që do të marrish dyshin edhe ti!» — ja, sikur më buçitnin veshët nga këto fjalë.

Vasoja sapo kopjonte edhe radhën e fundit; shokët të gjithë më shihnin me përçmim. Unë i drobitur, i hutuar, i tronditur u ngrita dhe kërkova lejë për të folur: E pashë se të gjithë përsëri këthyen vështrinin nga unë, por jo me habi.

— Vasoja, shoku mësues, po kopjon! Ja kjo është e tëra! — thashë duke gulçuar dhe s'durova më: u shkriva në vaj!

Se ç'u bë s'e mora vesh.

— Turp, turp! — i dëgjonja këto fjalë shpesh por nuk e kuptonja:

i hóqëm një fáshë Vásos we twisted Vaso's ear
shtab staff
koríje woodland
gjuetí hunting
llastíkë slingshot; rubber
gjúaj shoot
pa le not to mention
kimí chemistry
pa një, pa dy just like that; all at once
kopjój copy
nga t'ja mbánja which direction to take
sjéllje conduct; behavior
ípej = jépej
dýshin grade of two, a low mark
çatí roof
pa tjétër without fail
i hakarrítur menacing
përçmím scorn
i drobítur exhausted
gulçój pant
vaj weeping; oil

më drejtoheshin mua që kallëzova Vason, apo i drejtoheshin Vasos, që kopjonte.

Kur ngrita kokën, Vasoja s'ishte më atje: mësuesi e kishte nxjerrë përjashta. Pas pak hyri edhe Drejtori i shkollës. E mblodha vehten dhe dëgjova fjalën e tij: «Në klasën tuaj ka ngjarë një gjë e shëmtuar: Vasoja u zu me kopje. Vepra e Vasos është turp, turp i pafalur! Por në klasën tuaj ngjau edhe një gjë shumë e lartër: Ylli nuk duroi mashtrimin e Vasos nuk duroi një turo të tillë për klasën e vet dhe e paditi Vason shëshazi. Vepra e Yllit është vepër e një pionieri të vërtetë. I lumtë!».

Unë u skuqa më keq dhe ula kokën. Në klasë nuk ndihej as miza. Sikur s'mernin frymë.

«Ju ftoj të gjithëve të jeni të ndershëm në punën tuaj. Vasoja duhet të bëjë ç'mos për të shlyer këtë turp. Punën e tij ne do ta shohim edhe në Këshillin Pedagogjik». — shtoi Drejtori.

Kur duallmë jashtë, pjesa më e madhe e shokëvet nuk m'u afruan fare. Dikush bile murmuriti: «Pse e more Vason në qafë? S'të vjen keq?» Vetëm Pirroja me Liljanën më muarnë më një anë: «Mirë ja bëre! Nuk durohet! Duhet të bëhet pionier i mirë!» — më thanë.

Unë jam i turbulluar fare. Edhe tani që po ta shkruaj këtë letër, s'e kam mendjen në vend. Ka çaste që mendoj se bëra mirë. Edhe qëndrimi i ftohtë i shokëvet më mundon shumë.

Nuk e di se ç'do të mendoje ti për këtë gjë?

I yti, YLLI.

6

PSHERËTIMA TË DHIMBËSHME

SOKOL,

letra jote e fundit na la vragë të madhe, jo vetëm mua, por edhe nënës, edhe babagjyshit. Sa më është shtuar dëshira të vij me nënën në Tiranë e të përfalemi përpara përmendores së partizanit të panjohur, që qenka ngritur aty, ku është vrarë babaj me shokët e tij për çlirimin e Tiranës. Nëna, duke më përkëdhelur pas flokëvet, më jepte zemër: «— Ke pasur një baba trim, ja, po me këta sy të kaltërtë që më ke dhe ti, ja po me këtë ballë të gjërë, po me këto flokë ngjyrëarr po me këtë gojë të vogël. Je gjallë babaj. «— më thoshte dhe fjalët sikur i gulçonin në grykët.

Unë e di që nëna vuan shumë, por nuk e thotë. Për babanë më ka folur e më flet kaqë shumë, sa mua më duket sikur e shoh kudo, sikur e kam të gjallë. sikur do të hyjë në shtëpi prej një çasti në tjetrin.

Nga ndonjë herë heq fotografinë e tij nga muri dhe e shoh në dritën e diellit. Është një fotografi që e ka zmadhuar gjyshi në Korçë: Përpara kam një partizan të gjatë, të shëndoshë, me yllin e kuq në kapën e kokës, ngjeshur me dy breza fishekësh e me bomba. Në dorë mban një automatik. Rri drejt mbi një shkëmb dhe shikon përpara kush e di sa lark. Me siguri ky alamet trup, ky alamet partizan do të ketë tmeruar armiqtë. Më mbushet kraharori me krenari e i them vehtes: «Lum ti, o Yll, që paske pasur një baba të tillë!» e puth fotografinë fshehura, që të mos më shohë nëna. edhe pastaj e vendos përsëri në

kallëzój accuse
drejtór principal; director
i páfalur unforgivable
mashtrím deception
padít denounce
shéshazi openly
mízë fly
shlýej erase; wipe out
s'të vjen keq aren't you sorry

LEXIMI 1 GJASHTEDHJETETRETE

From Dhimitër S. Shuteriqi et al. (Eds.), Historia e letërsisë shqipe, II, Tiranë, 1959, pp. 292, 299-305, 357.

NAIM FRASHËRI
(1846-1900)

Fytyrë qendrore e letërsisë shqipe të Rilindjes është Naim Frashëri. Patriot i shkëlqyer, njeri nga përfaqësuesit më të shquar të lëvizjes sonë kombëtare, Naimi bëri një punë të madhe për themelimin e letërsisë së re shqipe dhe për gjuhën e re letrare shqipe.

JETA

Naimi lindi në 1846, në kohën kur lëvizja jonë kombëtare po njihte manifestimet e saj të para me veprat e Veqilharxhit, De Radës e ndonjë tjetri. Është koha kur marrëdhëniet e popullit tonë me Turqinë po ashpërsohen shumë: një mot pas lindjes së Naimit plasi kryengritja e fshatarësisë së Mallakastrës e të Kurveleshit, ushtima e së cilës qe e madhe në tërë Shqipërinë.

Frashëri, vendlindja e poetit, ishte një qendër feudale, dikur e fortë, po që tani e kish humbur shumë rëndësinë e mëparëshme. Frashëri ishte dhe një qendër bektashiane dhe vjershëtorësh bektashianë, si Dalipi dhe Shahini.

Naimi lindi në një shtëpi bejlerësh timariotë, që jetonin më shum me mercenarizëm se me prona. I jati, Halid beu, e sidomos i vëllai më i madh, Abdyli (1839-1892), pas zhdukjes së mercenarizmit në Turqi, ishin bërë tregëtarë e nëpunës.

Në jetën e poetit mund të dallojmë dy faza: faza e parë shkon gjer më 1882; e dyta nis këtu e mbaron me vdekjen e tij. Në këtë fazë ai u bë fytyra më e ndritëshme e Rilindjes.

ashpërsój aggravate
ushëtím = oshëtímë echo; repercussion
vjershëtór poet
timariót proprietor of a timar, or military fief
nëpúnës civil servant

Vdekja e poetit la vërtet një zbrazësirë të madhe në radhët e patriotëve dhe të letrarëve, po vetë Çajupi që ndër ata që e morën dhe e mbajtën me nder flamurin e tij.

MENDIMTARI

Që më 1884 Naimi nis të botojë te revista «Drita» disa shkrime të shkurtëra me elementet e para të shkencave të natyrës dhe të shoqërisë: anatomi, antropologji, zoologji, botanikë, gjeografi, astronomi etj. Këto shkrime ai i përmblodhi pastaj në librat «Histori e përgjithëshme» (1886) dhe «Dituritë» (1888), me nonjë ndryshim të vogël (4). Librat shërbyen jo vetëm si manuale shkollore, po edhe në përhapjen e diturisë ndër lexuesit e shumtë të Naimit. Ato kanë një interes më vehte për të njohur pikëpamjet filosofike të poetit, demokratin, pedagogun dhe mendimtarin Naim në përgjithësi.

Pikëpamjet filosofike. Me rëndësi është fakti se Naimi, si edhe Samiu, nuk i epte vend fesë në shpjegimin e fenomeneve shoqërore dhe të natyrës. Poeti mbështetet te feja vetëm për të shpjeguar krijimin ose qenien e botës dhe për të kërkuar te hyjnia një si arbitër e gjykues që shpërblen ose dënon njerëzit pas vdekjes, sipas veprave të mira ose të liga që ata kanë bërë në jetë. Ai beson se feja mund të ndihmojë shumë për edukimin moral të njerëzve. Nga ana tjetër, duke ditur se populli i tij është fetar, ai përpiqet ta shfrytëzojë për mirë këtë rrethanë. Me gjithë këto, Naimi arrin të bëhet një deist, që beson në ekzistencën e një fuqie hyjnore, e cila, edhe sikur ta ketë krijuar botën, edhe sikur të ekzistojë përjetësisht në të, — pikpamje e panteizmit, botëkuptimit filosofiko-fetar të poetit, — nuk ndërhyn më në punët e kësaj bote, ligjet e së cilës janë vënë një herë e përgjithëmonë. Nga ana tjetër, poeti mendon se njeriu *«lind i lirë»* dhe ka mundësi të veprojë lirisht, ashtu si ç'i thotë mendja e zemra. Naimi na çfaqet si një admirues entusiast i Volterit dhe Rusoit, të cilët i vështronte si

4) Një ribot. nga libri i parë ishte «Histori e Shqipërisë», Sofje (1899), kurse libri i dytë u ribotua nën titullin «Gjithësia», Bukuresht 1895, të dy me ndryshime te paka. Elemente të shkencave gjejmë edhe në këndimet e Naimit.

zbrazësírë emptiness
diturí knowledge; scientific discipline
nónjë = ndónjë
hyjní deity
gjykúes judge
përjetësísht permanently

shpëtimtarë të Evropës nga errësira mesjetare (5). Këto kështu bëjnë që poeti të jetë shumë i gjerë në botëkuptimin e tij, të pranojë pa asnjë ngurim dhe me besim të plotë teoritë e zbulimet shkencore që e tronditën nga themelet idealizmin dhe fenë, që i dhanë materializmit dhe ateizmit argumente dërrmuese, — si teoria planetare e Kantit dhe Laplasit, dhe darvinizmi.

Poeti shkruan: *«Ish një ndalje, që e ndalonte mbrodhësin' e njeriut: lathim' i fillosofëvet të vjetërë, që aojne të merreshinë shumë herë me gjërara të patrupta. Seneku. q'është një nga t'urtët e vjetërë thotë: fillosofia duhetë të mirretë me punërat e shpirtit e të mos fëlliqetë me punërat e lëndëta të botësë! Kjo mëndje s'ish e drejtë, se u hapte udhënë përrallavet e i mbyllte rrugënë mbrodhësisë. Eshtë m'e vjejturë fjal' e Dekartit, q'është nga fillosofët e rinj, që thotë: pse të merremi me punëra, që s'na sjellënë nonjë mirësi?. . . Të marrimë vesh ç'janë gjërat që na sheh syri..., të mësojmë se ç'janë, e me këtë mënyrë njeriu të bënetë zot'i naturësë»* (6).

Kështu Naimi nuk pranon që filosofia të vihet në shërbim të fesë, po kërkon që ajo t'i shërbejë njeriut për njohjen e botës, për t'u bërë «zot' i naturësë». Me rëndësi themelore është fakti që poeti ynë pranon se bota materiale mund të njihet dhe duhet të njihet, pikëpamje që atë e vinte në rrugën e materializmit.

Një pikëpamje të tillë, Dekarti e mbronte në shekullin XVII, duke u ngritur kundër filosofisë mesjetare, që ish tamam një «shërbëtare e fesë» («ancilla teologiae»), kundër botëkuptimit të klerit e të feudalëve. Kur Naimi mbron në Shqipërinë e shekullit XIX mendime të njëjta, ai gjiashtu ngrihet kundër botëkuptimit të klerit e të feudalëve, që janë klasa në fuqi. Racionalisti Dekart besonte

5) Istori e Skenderbeut, Bukuresht 1899, fq 45:

Evrop.' e shkret' atëherë
ishte për djall e për lumë,
pritte Ruson' e Volterë
ta zgjuanin ng'ay gjumë...

6) Istori e përgjithëshme, Bukuresht 1886, fq 112.

shpëtimtár savior
ngurím hesitation
dërrmúes crushing
ndálje hindrance; obstacle
lathím = lajthím error; mistake
gjḗrara = gjḗra
i patrúptë immaterial; bodiless
fëllíq make dirty
i lḗndët material; of matter
i vjéjtur = i výer valuable
të bëńetë = të bḗhet
shërbëtáre = shërbëtóre handmaiden; serving girl

dhe ai në ekzistencën e Zotit: ky, për të, ish arësyeja e të qenit të botës e të çdo gjëje. Po kur Dekarti shpallte se bota materiale ka një ekzisencë më vehte dhe mund të njihet, ai i çilte ashtu udhën materializmit francez të shekullit XVIII. Gjithë në atë mënyrë, edhe Naimi është idealist, gjersa beson në ekzistencën e një fuqie hyjnore; po ai merr udhën e materializmit, kur pranon se bota materiale mund të njihet. Racionalizmi kartezian lindi në Francë, në një kohë kur borgjezia po zhvillohej shumë, po kur feudalizmi ish akoma në fuqi, ajo filosofi i bënte akoma konçensione të rëndësishme idealizmit, botëkuptimit të klasës sunduese. Kur në Francë klasa borgjeze u bë aq e fortë, sa shtroi çështjen e revolucionit të saj, të përmbysjes së feudalizmit, botëkuptimi i saj u bë gjithashtu më i përparuar, më revolucionar: materializmi u bë filosofia e borgjezisë revolucionare. Naimi jetonte dhe ai në një kohë, kur në Shqipëri e në Turqi sundonte feudalizmi, edhe pse borgjezia kishte lindur si klasë dhe po zhvillohej lëvizja kombëtare. Si idealist, Naimi i bën akoma konçensione ideologjisë së klasës feudale; duke marrë udhën e materializmit, ai përfaqëson borgjezinë e re. e cila ka nisur të bëjë të sajat idetë e përparuara të borgjezisë evropiane, po duke qëndruar me një këmbë në idealizëm.

Pa dyshim, pikëpamjet filosofike të Naimit janë nga më të përparuarat e Rilindjes sonë dhe e tregojnë poetin si një nga mendimtaret më të shquar në historinë e popullit shqiptar. Ato pikëpamje i ndihmonin shumë formimit të një botëkuptimi materialist tek lexuesit e librave të Naimit. Libri «Dituritë», ku Naimi tregon se si materia organike lindi në një fazë të vonë të zhvillimit të materies inorganike, duke thënë se njeriu lindi nga një lloj majmuni dhe se *«njeriu është një punë e naturësë»* (7), nuk mund veçse të mbillte farën e materializmit. Këto pikëpamje Naimi i kishte mbrojtur që më 1884, duke treguar kështu një guxim të madh për kohën në Shqipëri dhe në Turqi.

Demokrati. Botëkuptimi filosofik i Naimit është ai i borgjezisë që ngrihet. Aspiratat e poetit janë ato të bor-

7) Dituritë, Bukuresht 1888, fq 57.

konçensión = koncesión concession
majmún monkey

gjezisë kombëtare, që kërkon të krijojë shtetin e saj të pamvarur, shkëputjen e Shqipërisë nga Turqia. Po këto janë aspiratat e gjithë popullit shqiptar të shtypur nga feudalët e huaj.

Në pikëpamjet e Naimit gjejmë të pasqyruara dobësitë e klasës së re borgjeze të vendit, e cila nuk është e zonja ta marrë mirë në duar lëvizjen kombëtare dhe ta bëjë si duhet aleate të saj fshatarësinë. Kompromisi filosofik që vëmë re në botëkuptimin e Naimit, ish edhe një pasqyrim i kompromisit që i bënte borgjezia klasës feudale në lëvizjen kombëtare. Naimi nuk na flet fare se si do të marrë vendi «udhën e qytetërimit», d.m.th. do të vendoset në Shqipërinë e ardhëme regjimi borgjez. Po përmes shkrimeve të tij, kuptohet se ai, për këtë çështje, ishte i një mendimi me të vëllanë, Samiun. Poeti u bën kështu vazhdimisht thirrje «gjithë shqipëtarëve», të çdo klase shoqërore qofshin, të çdo krahine dhe besimi, që të bashkohen kundër pushtuesit, të mendojnë dhe të veprojnë «të gjithë» për çlirimin e Shqipërisë dhe për ndërtimin e një shteti «të qytetëruar» shqiptar. Gjersa kjo thirrje u drejtohej klasave të ndryshme të vendit për t'u çliruar nga Turqia, ajo ishte realiste dhe e zbatueshme në disa rrethana; po kur i drejtohej edhe klasës feudale për të sjellë në fuqi regjimin e borgjezisë, ajo thirrje i afrohej më shumë një utopie. E tillë ishte edhe dëshira që shpreh ndonjëherë humanisti Naim për një harmoni shoqërore në konditat e ndarjes së shoqërisë në klasa antagoniste.

Këto kufizime të natyrëshme për kohën në Shqipëri, nuk e pengojnë Naimin të ketë ide me të vërtetë të përparuara, kur është fjala për të ardhëmen e vendit. Këto ide poeti i ka shprehur paralelisht me Samiun. Me rëndësi të parë është fakti se Naimi kërkon për shtetin e ardhëm shqiptar një regjim demokratik, sipas shëmbëllës së demokracive borgjeze më të përparuara të kohës së tij. Naimi ishte dhe për regjimin republikan, kundër monarkisë. Këtë përfundim nxjerr lexuesi kur i bien në sy shprehjet plot admirim të poetit mbi triumfin e revolucionit borgjez të Francës dhe kur pastaj gjen te Naimi fjalën si këto:

aleát ally
qytetërím civilization
i qytetërúar civilized
gjérsa to the extent that
i zbatúeshëm implementable
shëmbëll shëmbull
së gjíthash above all
pleqësí council of elders; senate
pëlqím liking; fondness; approval
hiq = ikë

«*Dhimokratia dhe liria e madhoi së gjithash Francën*», po «*më 1804, Bonaparti u bë mbret i Francës e dhimokratia, q'u ble me shumë gjakëra, humbi përnjëherë*» (8). Poeti çmon më shumë rivendosjen e republikës se humbjen e luftës e të disa tokave nga Franca më 1871: «*Franca humbi luftënë dhe Alsasn' e Lorenë, po fitoi dhimokratinë*» (9). Për Naimin, fjalët «demokraci» dhe «republikë» janë pra sinonime. Si dhe Samiu, ai ka dëshirën që t'u epet një përmbajtje e re institucioneve të demokracisë patriarkale të fiseve shqiptare, «*pleqësisë*» (10).Nga ana tjetër, poeti çfaq pëlqimin e vet për demokracitë borgjeze më të përparuara të kohës. Ai do një shtet të lirë dhe demokratik shqiptar nga më të përparuarit.

Përsa i takon lulëzimit të Shqipërisë së ardhëme, poeti e bazon këtë në radhë të parë në dëshirën demokratike të përhapjes së diturisë në gjithë masat e popullit, si dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Ai shkruan: «*Koha s'vjen pas teje, ti hiq pas kohësë. . . Të hyjmë në qytetërimt e në shpëtimt*» (11). Me fjalë të tjera, Shqipëria është e humbur në se vazhdon të jetojë në prapambetjen e saj të madhe feudale, të cilën Naimi e sheh si burim të gjithë fatkeqësive të populit tonë, e në radhë të parë, të robërisë.

Pedagogu dhe edukatori. Lëvizja kombëtare, duke shtruar si një kërkesë të saj kryesore atë të lirisë së gjuhës, shtronte me forcë çështjen e shkollës shqipe. të arësimit kombëtar. Këtë arësim rilindësit e deshën të qe në baza të shëndosha shkencore dhe pedagogjike. Një nga ata që bënë më shumë gjatë Rilindjes për krijimin e arësimit shqip, qe Naimi, — me librat që botoi, me përpjekjet e ndryshme dhe me idetë që çfaqi mbi shkollën dhe edukatën. Këto ide janë nga më të përparuarat e Rilindjes dhe dëshmojnë

8) Istori e përgjithëshme, fq 86-87.
9) Po aty, fq 95.
10) Pamë se këtë fjalë Samiu e përdor për dhomën e larte apo enatin. Naimi e përdor fjalën «pleqësi» edhe për «demokraci». Ai hkruan: «Pleqesi a dhimokrati thuhetë kur nuk ka mbret, po të gjedhurit venë vetë për një kohë një të parë, si është Franca sot v. E këndimit çunavet këndonjëtoroja, Bukuresht 1886, vëll. I, fq 91).
11) Istori e Shqipërisë, Sofjë 1899, fq 42.

jetík vital
zor difficulty
këndím reader
predikój preach
lugát demon
gogól goblin; boogey man
i paqénë inexistent
veti trait; quality

edhe një herë për ndikimin e filosofëve dhe të pedagogëve përparimtarë borgjezë, veçanërisht të Rusoit.

Si demokrat, Naimi kërkon së pari arësimin për të gjithë, edhe për gruan. Ai e shtron këtë kërkesë si një çështje me rëndësi jetike, ashtu si ç'pat bërë që në fillim Veqilharxhi: duhet të kulturohet një popull, që të fitojë ndërgjegjen e qenies së vet si komb, ndërgjegjen e të drejtave të tij për të jetuar i lirë; një popull pa kulturë s'or të çlirohet dhe të mund të jetojë i lirë në ditët tona.

Librat shkollore të Naimit, ato mbi shkencat e natyrës dhe të shoqërisë, që ndihmonin për të formuar botëkuptimin materialist tek nxënësit, ja puna e tij kryesore për arësimin. Poeti vërtet fut në këndimet e tij, — kështu ka bërë edhe Samiu, — pjesë të ndryshme që predikojnë një moral fetar. Po nga ky moral ai përpiqet të ruajë parimet humanitare të përgjithëshme, pa pranuar dogmën dhe përrallat biblike. Te «Mësimet» ai shkruan se fëmijët sikundër nuk duhet t'i rrahim, ashtu edhe nuk duhet t'i trembim me *«lugatë e gogolë dhe të tilla gjërëra të paqëna* (12). Fëmija duhet edukuar me anë të shëmbëllës së mirë: *«Një mijë fjalë të mira të mëmës e t'atësë, nuk vlejnë për fëmijënë sa vlen një punë e mirë, q'e shohënë me syt e vet»* (13). Prandaj dhe roli i prindërve dhe veçanërisht i gruas (14), roli i edukatës familjare, është fort i rëndësishëm, mendon Naimi. Në librat e tij, ai përpiqet që t'i edukojë fëmijët q[illegible] kenë vetijat më të shquara mendore

12) Mësimet, Bukuresht 1894, fq 18.

13) Po aty, fq 19.

14) Rolin e gruas, poeti e sheh përbrenda shtëpisë dhe si edukuese të fëmijës: «Brënda derësë është pun'e gravet, pun' e burravet është jashtë derësë më shumë». (E këndimit çunavet kënd., vëll. II, fq 12). Po për gruan ai ka respektin më të madh e kërkon zhvillimin e saj: «Gruaja duhetë të jet'e mësuarë më shumë nga burri, se fëmia së pari nga mëma e marrënë arësimnë dhe mësimetë. Gruaja është mëm'e fëmijësë, zonj'e shtëpisë dhe krei i njerëzisë» (Mësimet, fq 17). «Si burri dhe gruaja një janë e s'kanë të ndarë» (Fletore e bektashinjet, Bukuresht 1896, fq 5). «Gruaja s'pshihet e s'mbuloket, veçse me mbulesët të trupit e të nderit» (Po aty, fq 6). Poeti ishte pra për emancipimin e gruas, kur kërkonte zbulimin e saj, edukimin e saj, dhe kur shpallte barazinë midis burrit dhe gruas.

i pakursýer boundless; unstinting
cilitdó = cilidó anyone; whichever; whatever
shpenzím expense
kúję wail
të qárë me kúję heart-rending weeping; ceremonial mourning

dhe shpirtërore: të jenë të dërur dhe miq të diturisë, të jenë punëtorë, të kenë dashuri të pakursyer, vetmohuese për atdheun, të duan gjithë njerzit, të çlitdo kombi apo race qofshin, të jenë të sjellur, të pastër, të ruajnë shëndetin etj. Parimi udhëheqës i edukatës për Naimin. është më përparimtari: *«Mësojini, kanë thënë t'urtëtë, fëmijët tuaj të dinë më shumë se ju, se ata janë për një kohë me tej nga koha juaj»* ([15]).

Duke dashur të bëhet edukator i kombit, poeti u ep këshilla të shumta e të vlefshëme bashkatdhetarëve: se si t'i bëjnë me kohë martesat, të mos marrin dy gra, të mos bëjnë shpenzime martese që «prishin shtëpinë», zi të mos mbajnë tepër, të mos qajnë me kuje etj.

Si mendimtar, si demokrat e edukator, Naimi lojti një rol të shquar gjatë Rilindjes dhe ushqeu idetë e idealet më të përparuara të kohës në Shqipëri.

PËRFUNDIM

Naimi është një nga fytyrat qendrore të letërsisë shqipe të Rilindjes, fytyrë e shkëlqyer e patriotizmit shqiptar gjatë lëvizjes sonë kombëtare të shekullit XIX. Me veprimtarinë e tij patriotike, poeti dha një kontribut të çmuar në lëvizjen kombëtare jo vetëm të Stambollit, po edhe të shqiptarëve të kolonive të tjera të mërgimit dhe përbrenda në Shqipëri. Ai bëri hapin e parë vendimtar në letërsinë e re të Shqipërisë për kapjen e temave të reja, temave që sugjeronte ose epte lëvizja kombëtare, qofshin ato aktuale, qofshin me karakter historik. Romantik, ai ekzaltoi të kaluarën dhe këndoi me entusiazëm për të ardhëmen e lirë e të lulëzuar demokratike të Shqipërisë, me dashurinë e madhe për popullin e me besim të plotë në forcat e tij për t'u çliruar e për të shkuar përpara shpejt në ekonomi dhe kulturë. Naimi u nis nga bejtexhinjtë, nën ndikimin e letërsisë orientale. Po, me ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit, ai bëri një

kápje grappling; dealing
sugjerój suggest
bejtexhí improvising poet; writer of extemporaneous poetry
didaskalík didactic
i vjershërúar in verse
strófë stanza
njëzím = njësím unification

kthesë të madhe në krijimtarinë e tij. I ndikuar nga romantizmi evropian, duke u bazuar në gjuhën e gjallë të popullit, të cilën e shkroi të pastër dhe e pasuroi vazhdimisht. Naimi hodhi bazat e letërsisë së re në Shqipëri. Ai që kryesisht poet lirik, po shkroi edhe vjersha didaskalike, përshtati fabulën e provoi historinë e vjershëruar, gjë që ishte një hap drejt poemës epike-heroike. Ai provoi edhe tregimin e shkurtër. Naimi është një nga themeluesit kryesorë të letërsisë sonë për fëmijë. Poeti bëri një punë të mirë për pasurimin e metrikës shqipe me vargje e strofa të reja. Puna e tij qe e çmueshme për njëzimin e toskërishtes letrare, për ngritjen e mundësive shprehëse të shqipes si gjuhë arti dhe kulture. Veprat e tij gëzuan popullaritetin më të madh gjatë dhe pas Rilindjes. Ato ushtruan një ndikim të madh në zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë shqipe.

LEXIMI I GJASHTEDHJETEKATERT

Pas tri javësh ata u kthyen. Ishte mbrëmje. Vetura e tyre bojë bari u ndal përpara hyrjes së hotel «Dajtit», nën pishat e larta. Gjenerali zbriti i pari. Kish një pamje të lodhur e të topitur. Bile ishte hequr pak në fytyrë, ose kështu së paku dukej nga drita e kuqe e reklamës së hotelit. Vështrimi i tij i mpirë u ndal një hop te vetura. Së paku t'i kishin fshirë baltën, mendoi me nervozitet. Por ata porsa kishin mbërrijtur, kështu që shoferi nuk kishte faj. Këtë ai e dinte, por nuk donte të arësyetonte.

Ngjiti shpejt shkallët, mori letrat, që i kishin ardhur porositi një bisedim telefonik me shtëpinë dhe shkoi ngadalë në dhomën e tij.

Edhe prifti shkoi në dhomën e tij.

Pas një ore ata rrinin në një tavolinë, në sallonin e katit të parë. Të dy kishin bërë banjë dhe qenë ndërruar.

Gjenerali porositi raki. Prifti kërkoi kakao. Ishte e shtunë. Nga taverna poshtë dëgjohej muzikë. Herë pas here dukeshin çifte të rinjsh në fund të sallonit. Ata kalonin përmes sallonit në tavernë dhe anasjelltas. Edhe në holl kalonin vazhdimisht njerëz. Salloni ishte hijerëndë me perdet e errëta dhe kolltukët e mëdhenj.

— Mbaroi më në fund edhe turneu i parë — tha gjenerali.

— Po, mbaroi.

vetúrë car
i topítur bewildered
së páku at least
i mpírë numb; glazed
mbërríj arrive; come
kat floor; story
bánjë bath
rakí Albanian brandy, generally made from plums
çift couple
anasjélltas vice versa
holl hall
hijerëndë gloomy; forbidding demeanor
pérde curtain
kolltúk armchair
turné phase; shift of work

— Si mendoni ju, a do ta mbarojmë këtë punë brenda një viti, siç e kemi parashikuar?

— Si të them? — u përgjegj prifti. — Kjo varet nga vështirësitë që do të na dalin dhe nga moti. Sidoqoftë mendoj se vitin që vjen, në këtë kohë do të kemi mbaruar.

— Edhe unë ashtu besoj — tha gjenerali. — Mendoj se ideja për të filluar kërkimet nga zonat pranë qyteteve, është e drejtë. Natyrisht vështirësitë më të mëdha do të na dalin fshatrave, dhe sidomos në krahinat e largëta malore.

— Ju e dini më mirë — tha prifti.

— Në male do ta kemi keq.

— E besoj.

— Edhe ata keq e kanë patur në male.

— Është e vërtetë.

— Nesër do të studjoj përsëri hartat dhe do të bëj planin konkret për turneun e dytë.

— Veç mos bëjë mot i keq!

— Ç'ti bësh? Është vjeshtë.

Prifti pinte kakao i qetë, duke e mbajtur filxhanin me dy gishtat e gjatë.

Është i bukur, mendoi gjenerali tek vështronte vjedhurazi profilin e ngartë dhe të palëvizshëm të priftit. Pastaj, papritur tha me vete: Ç'të ketë bërë vallë me gruan e ve të kolonelit? Midis tyre duhet të kishte ndodhur diçka. Ajo ishte e bukur; sidomos në plazh dukej e mrekullueshme. Kur ai i kish përmendur aherë emrin e priftit, ajo qe skuqur dhe kish ulur sytë. Ç'të ketë pasur vallë midis tyre? pyeti përsëri veten gjenerali, duke mos i hequr sytë nga fytyra e priftit.

— Kolonelin Z. s'e gjetëm që s'e gjetëm dot — tha me zë të shkujdesur.

— Ndoshta do ta gjejmë — tha prifti dhe uli sytë. — Besoj se do ta gjejmë.

— Është vështirë, sepse rrethanat e zhdukjes së tij janë të panjohura.

— Vështirë është, — pohoi prifti me një ton të thatë — por akoma jemi në fillim. Kemi kaq kohë përpara.

parashikój forecast
mot weather; year
hártë map
tek as; while
vjédhurazi stealthily
se gjétëm që s'e gjétëm dot we couldn't find a trace of him
i shkujdésur careless; nonchalant
pohój admit

— Ç'ka bërë me të venë e tij? mendoi gjenerali. Ai ishte kureshtar të dinte sa larg mund të shkonte ky atë i shenjtë me një grua.

— Duhet t'i gjejmë eshtrat e kolonelit patjetër — tha gjenerali. — Ai është i vetmi oficer madhor i padeportuar gjer më sot. Të tjerët janë hequr me kohë. Familja e tij u interesua kaq shumë, sidomos e shoqja.

— Po — tha prifti. — Ajo u interesua shumë.

— A e patë varrin e bukur prej mermeri që ka pregatitur për kolonelin familja e tij?

— Po, — tha prifti — ma treguan para se të niseshim për në Shqipëri.

— Një varr me të vërtetë madhështor, me përmendore dhe rrënjë trandafilash të kuq e të bardhë — tha gjenerali. — Vetëm se është bosh.

Ata qëndruan një kohë të gjatë në heshtje. Gjenerali pinte raki dhe vështronte e ndjente përreth jetën e huaj. Papritur e ndjeu veten fare të vetëm. Të vetëm me varret e ushtarëve. Nuk desh të kujtonte «varret e vëllezërve». Në asnjë mënyrë s'desh. Mjaft ishte vërtitur tri javë rrjesht midis tyre. Tri javë rrjesht, ditë e natë, çdo orë, çdo minutë, vetëm me ta. Tani donte të ishte i lirë prej tyre. Mezi e kishte pritur këtë ditë pushimi. Ishte e shtunë. Ai donte të çlodhej. Ishte i gjallë. Ishte e drejta e tij e natyrshme.

Që poshtë vinin të mbytur tingujt e muzikës. Atje poshtë pihej, vallëzohej.

— Duhet të çlodhemi — tha ngadalë duke menduar prapa fjalës çlodhje fjalën dëfrim.

Prifti ngriti sytë. Jo.

Kjo ishte e vërtetë. Ai ishte një gjeneral i huaj. Për më tepër i ngarkuar me një mision qeveritar. Veç kësaj ky mision ishte tepër i përzishëm. Dhe më në fund rreth e rrotull ishte po ai popull me të cilin ushtarët e tij ishin përfytur për vdekje.

Gjenerali uli sytë mbi tavllën e mbushur me mbeturina cigaresh. Ai e kuptoi se në javët dhe në muajt e ardhshëm të këtij shtegëtimi të gjatë, që porsa kishte filluar, ai nuk do t'i përsëriste më këto fjalë. Revolta e

kureshtár curious
patjétër without question
oficér madhór high ranking officer
i padeportúar undeported
me kóhë long ago
mermér marble
rrënjë cluster; root
trandafíl = trëndafíl rose
përréth all around
vërtítem go here and there; spin; cast
i mbýtur muffled; drowned
qeveritár governmental
veç kësáj besides
i përzíshëm funereal; mournful
përfýt grapple by the throat
távllë ashtray
mbeturínë remains; remnant
shtegëtím = shtektím pilgrimage; journey

shkurtër, ishte shtypur menjëherë. Këndej e tutje ai do-
të ishte me ta. Vazhdimisht.

Po, ishte ledhur shumë: Gjithë ato rrugë të vështira, ato varre të lagura, aty-këtu grumbuj-grumbuj, aty-këtu të vetmuara, gjithë ajo baltë e mërzitshme, ato fortino gjysmë të shkatërruara (edhe fortinove, si ushtarëve, u kishin mbetur vetëm skeletet). Pastaj ngatërresat me varret e ushtarëve të kombeve të tjera, procesverbalet, kuitancat me përfaqësuesit e komunales, vërtetimet për derdhjen e valutës në bankë. Si ishte përzier gjithçka. Sidomos ishte vështirë të ndanin të vrarët e ushtrive të ndryshme. Në mes të dëshmitarëve kishte shpesh kundërthënje: pleqtë ngatërronin ngjarjet dhe luftërat. Asgjë nuk ishte e saktë. Vetëm balta e dinte të vërtetën.

Gjenerali ktheu përsëri gotën.

— Ajo barrakë, atje në fushë — murmuriti me vete. — Ai magazinier...

Përpara se të hynin në Tiranë (e kishin të ndaluar të hynin me eshtra nëpër qytete), kishin bërë dorëzimin e tyre, diku në periferi, te barraka e grumbullimit, e ngritur për këtë gjë, në bazë të marrëveshjes.

— Barrakë, magazinier... Dhe një qen te dera...

Prifti nuk foli.

Në sallon, si zakonisht, ishte qetësi. Vetëm atje tej, në qoshe, ca djem të rinj se çtregonin dhe qeshnin herë pas here. Atyre u dukeshin vetëm shpinat. Më tutje rrinin një djalë e një vajzë, siç duket të fejuar. Ata më tepër vështronin njëri-tjetrin se sa bisedonin. Djali kish kokë të rregullt, ballë të pjerrët e të madh dhe nofullën e poshtme mjaft të gjerë. Tip alpin, mendoi gjenerali.

Pas banakut rrinte kamerieri. Koka e tij e rrumbullakët dukej fare e qetë midis dy pjatave me portokaj dhe mollë.

Hyri një burrë i imët, me një çantë në dorë dhe u ul në tavolinën pranë radios.

— Të zakonshmen — i tha kamerierit.

Ndërsa kamerieri i pregatiste kafen, burri i imët nxori nga çanta një fletore të trashë dhe nisi të shkruan-

grúmbuj = grúmbuj clustered together
i mërzítshëm nauseating
fortíno emplacement; fortification
ngatërrésë complication
procesverbál court proceeding
kuitáncë negotiation
komunál municipal; of a community
dérdhje deposit
valútë foreign currency
dëshmitár witness
kundërthënje contradiction
kthej gótën take a drink
magaziniér warehouse man
dorëzím surrender
i pjérrët sloping; slanting
nófull jaw
alpín Alpine
kameriér waiter
i rrumbullákët round
pjátë plate
portokáll orange
i ímët = i ímtë thin; slight

te. Ai kishte nofulla të ngushta dhe mollëzat pothuaj nuk i dukeshin fare. Kur thithte cigaren, në faqe i krijoheshin dy gropa, që tregonin qartë konstruktin e nofullave.

— Ja, pra, këta qenkan shqiptarët! — tha gjenerali sikur të vazhdonte një biseedë të lënë përgjysmë. — Njerëz fare të zakonshëm. As që e merr dot me mend se në luftë bëhen si tigrat.

— O, si bëhen ata në luftë!

— Dhe të mendosh që janë aq pak!

— S'janë dhe aq pak — tha prifti.

Hyri prapë një njeri me ballë të pjerrët.

— Ç'është kjo dreq pune që na kanë ngarkuar të bëjmë? — tha gjenerali. — Kudo, kur shikoj fytyra njerëzish, në rrugë apo në kafene, aty për aty, padashur përfytyroj si do ta kenë kafkën.

— Më falni, ju po pini pak si tepër — tha prifti me një ton të njerëzishëm dhe e vështroi me sytë e tij bojë hiri. Në atë çast gjeneralit ju duk se ngjyra e syve të priftit ishte tamam si ekrani i televizorit në fund të sallonit. Si një televizor që nuk punon kurrë, mendoi. Ose më mirë, si një ekran që vazhdimisht merr të njëjtin program, krejt të pakuptueshëm.

Vështroi një copë herë gotën e bardhë, që e vërtiste nëpër gishtërinj.

— Po ç'të bëj sipas jush? — tha me një ton nervoz. — Ç'më keshilloni të bëj? Mos vallë duhet të marr aparatin fotografik dhe të bëj poza për t'ja treguar gruas kur të kthehem? Apo të mbaj ditar dhe të shkruaj kurioziteto? E? Si thoni ju?

— Unë nuk thashë asgjë të tillë. Thashë vetëm se ju po pini pak si tepër.

— Kurse unë çuditem si nuk pini ju. Çuditem shumë. bile.

— Unë s'kam pirë kurrë alkool. — tha prifti.

— Megjithatë çuditem se si nuk filloni të pini tani. Të pini çdo natë, kështu si unë, që të harroni ato që shikoni ditën.

— Përse duhet të harroj ato që shikoj ditën? — tha prifti.

thith suck; draw on
grópë hole
përgjýsmë in the middle.
káfkë skull
ekrán screen
i pakuptúeshëm unintelligible
pózë pose

— Sepse ne kemi një atdhe me këta të mjerë — gjenerali i ra me gisht çantës. — Nuk ju vjen keq për ta?

— Mos më fyeni — tha prifti. — Edhe unë jam patriot.

Gjenerali buzëqeshi.

— A e dini? — tha — Këto tri ditë kam vënë re se bisedat tona i ngjajnë dialogëve të mërzitshëm të ca dramave moderne.

Edhe prifti buzëqeshi.

— S'ke ç'i bën. Në një mënyrë ose në një tjetër bisedat njerëzore u ngjajnë dramave ose komedive.

— Ju pëlqen teatri i sotëm?

— Njëfarësoji.

Gjenerali e vështiri në sy një copë herë. Pastaj i hoqi syte.

— Ushtarë të mjerë — tha papritur, sikur zgjohej nga gjumi. — Më dhemb shpirti për ta. Më duket vetja si ai prindi që rrit fëmijët e braktisur nga të tjerët. Ngarjëherë këta fëmijë duhen në shumë. Ç'mund të bëj unë për ta?

— Edhe mua më dhemb shpirti — tha prifti. — Më pikon helm.

— Jemi të pafuqishëm me këto listat dhe proçes-verbalet tona. Bredhim dhe bredhim prapa vdekjes së tyre. I qëmtojmë një e nga një. Si u katandisëm kështu?

— Fati.

Gjenerali tundi kokën.

Prapë si në dramë, tha me vete.

Ky prift është prej metali, mendoi. Megjithatë do te isha kurioz të dija se sa metalik ka qenë me gruan e bukur të kolonelit Z., tha me vete, pa i hequr sytë nga fytyra e tij. U mundua të merrte me mend si mund të siilej prifti me një grua si ajo dhe si do ta hiqte ate rrobën e zezë kur të ulej pranë gjunjëve të saj. Vërtet, t'i ketë pëlqyer prifti asaj, apo ta ketë bërë për interes? Në qoftë se vërtet midis tyre ka pasur ndonjë gjë... E g'më duhet, në fund të fundit?

I vuri veshin radios së madhe të sallonit. Gjuha shqipe

njëfarësóji certain ones
i pafuqíshëm impotent
bredh wander
qëmtój scrutinize; consider
katandís end up

i dukej e rëndë. E kish dëgjuar kaq herë ta flisnin fshatarët shqiptarë pranë varrezave, ku mblidheshin për t'u ndihmuar. Edhe gjithë ata të vrarë me siguri e kanë dëgjuar këtë gjuhë fatale, mendoi. Tani me sa duket po jepnin lajmet, sepse spikerja përsëriste fjalë të njohura. Tel Aviv, Bon, Laos.

Qytete të ndryshme ka bota, mendoi dhe prapë ju kujtuan ushtarët e kombeve të ndryshme, që kishin qenë në Shqipëri. Tabelat e llamarinta të ndryshkura, kryqet, shenjat, emrat e shkruara shtrembër. Shumica i kishin varret pa asnjë tabelë. Bile shumica nuk kishin fare varre. Ndodheshin nëpër gropa të përbashkëta, hedhur drejt e në baltë. Kish nga ata që s'ndodheshin as në baltë, por ishin vetëm në lista.

Eshtrat e një ushtari i kishin gjetur në muzeumin e një qyteti fare të vogël në Jugë. Muzeumin e kishin ngritur ca qytetarë entuziaztë. Në kalanë e vjetër të qytetit, në një qeli të thellë, ata kishin gjetur, midis të tjerash, edhe eshtrat e një njeriu. Për disa javë rrjesht në kalenenë e qytetit arkeologë, amatorë bënin çdo ditë hipoteza të ndryshme për këto eshtra. Bile dy prej tyre ishin duke shkruar një artikull mjaft të guximshëm dhe të ngatërruar për ta botuar ~~në~~ ndonjë revistë, kur në qytetin e vogël mbërrijti grupi i kërkuesve të eshtrave të ushtarëve. Specialisti kish kaluar rastësisht nga muzeu dhe menjëherë e kish njohur skeletin nga medaljoni. (Në artikullin e amatorëve për medaljonin kishte dy hipoteza: medaljoni ishte ose mjet zbukurimi, ose monedhë e kohës romake.) Por kalimi i specialistit nga muzeumi u dha fund të gjithave. Një gjë ishte e çuditshme: si kish mundur të futej ushtari në labirintet e pashkelura të kështjellës dhe pse?

E qyeti priftin, por atij nuk i kujtohej.

— Ah, po. E gjetëm emrin e tij — tha më në fund prifti.

— E gjetëm, — tha gjenerali — por desha të di, a është vallë nga ata për të cilët na janë lutur familjet personalisht.

varrézë graveyard
tabélë marker; table; chart
i llamaríntë galvanized sheet metal
i ndrýshkur rusted
shtrémbër crookedly
m nédhë coin

— Ne na janë lutur personalisht për shumë ushtarë — tha prifti. — Po ku mbahen mend të gjithë?

— Është e vërtetë. Pastaj ka dhe shumë emra të njëllojtë midis tyre. Listat janë tepër të gjata dhe unë s'mbaj mend kurrgjë.

— Ushtar si çdo ushtar ka qenë — tha prifti.

— Ç'është nevoja më për këta emra e gjeneralitete të hollësishme? — tha gjenerali. — Dhe në fund të fundit ç'emër mund të kenë në një grumbull eshtrash?

Prifti tundi kokën sikur të thoshte: «S'ke ç'i bën, ja që kështu është».

— Emrat e tyre duhet të ishin të gjithë të njëllojtë ashtu si medaljoni që mbanin në qafë — vazhdoi gjenerali.

Prifti nuk u përgjegj. Nga taverna dëgjohej muzika dhe gjenerali tymoste vazhdimisht.

— Na kanë vrarë kiamet — tha si nëpër gjumë.

— Është e vërtetë.

— Edhe ne kemi vrarë.

Prifti heshti.

— Edhe ne kemi vrarë — përsëriti gjenerali. — Varret e tyre janë kudo. Do të ishte shumë e turpshme dhe e trishtueshme, sikur varrezat e ushtarëve tanë të ishin fare të vetmuara.

Prifti tundi kokën në një mënyrë të atillë, që nuk u kuptua nëse bëri «po» apo «jo».

— Ngushullim i vogël — tha gjenerali.

Prifti prapë tundi kokën sikur të thoshte: «s'ke ç'i bën».

— Nuk ju kuptova, — tha gjenerali — është apo s'është kjo gjë një ngushullim për ne!

Prifti hapi pëllëmbët.

— Unë jam fetar, — tha — unë nuk e përkrah vrasjen.

— O — ja bëri gjenerali.

Dy të fejuarit u ngritën e dolën nga salloni.

— Jemi therur me njëri-tjetrin egërsisht — vazhdoi gjenerali. — Këta paskëshin qenë të fortë për luftë.

— Kjo shpjegohet — tha prifti. — Nuk është punë

i njëllójtë identical
tymós smoke
kiamét an awful lot
i atíllë = i tillë

trimëria të ndërgjegjeshme. Është çështje e psiqikës së tyre.

— Nuk e kuptova — tha gjenerali.

— Kjo është e thjeshtë — vazhdoi prifti. — Në luftë disa i udhëheq arësyeja e dobët ose e fortë, kurse disa të tjerë instinkti.

— Po.

— Shqiptarët janë një popull i ashpër e i prapambetur. Atyre, që kur janë foshnje, u venë në djep pushkën, kështu që pushka bëhet pjesë e pandarë e jetës së tyre.

— Duket, — tha gjenerali — edhe ombrellat i mbajnë sikur të ishin pushkë.

— Duke u bërë që në vogëli një pjesë e qenies së tyre, — vazhdoi prifti — si një element bazë i jetës së tyre, pushka influencon direkt në krijimin e psiqikës së shqiptarit.

— Interesant.

— Por një gjë që njeriu e do dhe e adhuron me gjithë shpirt, natyrisht që ka qejf edhe ta përdorë. Po përse mund të përdoret më mirë se çdo gjë pushka?

— Për të vrarë njerëz — tha gjenerali.

— Ashtu është. Shqiptarët gjithmonë kanë patur qejf të vrasin ose të vriten. Ata janë vrarë me njëri-tjetrin kur nuk kanë patur me kë të luftojnë. Keni dëgjuar për gjakmarrjen e tyre?

— Po.

— Ata në luftë i shtyn instinkti i vjetër. Kjo është një nevojë e diktuar nga natyra e tyre. Në paqe ata trullosen e përgjumen ashtu si gjarpëri në stinën e dimrit. Vetëm në luftë e tregojnë plotësisht vitalitetin e tyre.

Gjenerali tundi kokën.

— Lufta është gjendja normale e këtij vendi. Prandaj ata në luftë janë të egër, të rrezikshëm dhe bëjnë dëm me tepër se ç'duhet.

— Domethënë ky popull, me këtë etje që ka për asgjësim ose vetëasgjësim, është i destinuar të zhduket — tha gjenerali.

psiqíkë psyche
dúket it's obvious; it seems, appears
gjakmárrje blood feud
përgjúmem get sleepy
étje thirst

— Natyrisht.

Gjenerali pitu. Tani ai i shqiptonte fjalët me ngathësi.

— Ju i urreni shqiptarët? — pyeti ai papritur.

Prifti buzëqeshi hidhur.

— Jo. Pse?

Gjenerali i afroi fytyrën te veshi. Prifti bëri një shenjë të lehtë neverie kur ndjeu erën e alkoolit.

— Si pse? — ja bëri me zë të ulët gjenerali sikur të thoshte një të fshehtë. — Ne të dy i urrejmë ata, por tani për tani nuk e themi, se kështu është puna...

Ismail Kadare, Gjenerali i ushtrisë së vdekur (Third Edition), Tiranë, 1971, Chapter 3, pp. 20-29.

ngathtësí sluggishness
neverí nausea; disgust
taní për taní for now

LEXIMI I GJASHTEDHJETEPESTE

From M. Kuteli, Tregime të moçme shqiptare, Tiranë (no publication date given), pp. 146-156.

DASMA E HYSEN KRAPOSHNIKUT

Pas shumë luftrash, në Jutbinë e në tërë Krahinën zotëron qetësi e ëmbël. Asnjë baloz deti e asnjë kapedan Kralie s'guxon t'ua shkelë caqet e fushat, lugjet, bjeshkët, sepse gjithë ata, që patën guxuar, kishin mbetur pa krye e ishin bërë varr e bar, apo ishin kalbur brrakave. Kështu balozi i zi, kështu balozi i bardhë e shumë balozë të tjerë; kështu Behur kapedani me të tridhjetë pendurët e tij, kështu Kreshto kapedani me të treqindët, e shumë skota kapedanësh.

Barinjtë e bareshat kullosin gjënë e gjallë lugjeve e ograjave, druvarët presin dru, bujqit mbjellin e korrin, kositin barin e rreshkur, venë haje për bagëtinë. Kumbojnë bukur e ëmbël këmborët e lingat e mandrave, buçasin lumenjtë që bidhen prak më prak, krisin kopanët e vashave që lajnë lesh gurrave.

Malet e kaltër kukëzohen të veshur me kith të kaltër. Që sandejmi lugajat e valthet sjellin kur e kur ndonjë ta-ta-ta e ty-ty-ty brirësh gjahtarësh që kanë rënë pas sutës e drerit, pas lepurit e kaposhit të dushkut. Gjuan edhe vetë Gjeto Basho Muji me të tridhjetë zotërit e vendit. Gjuajnë sa gjuajnë, pastaj zbresin në Jutbinë, sjellin gjahun, e pjekin e ja shtrojnë me të ngrënë e të pirë. Pinë ngadalë, këndshëm, zotërisht, jo që të dehen, po për ta zgjidhur gjuhën e për të kuvenduar.

balóz knight
cak border marker
lug water trough; viaduct
kálbem rot; decay
brrákë brook
pendúrë armed retinue
skótë race; kind
baréshë shepherdess
ográjë pasture grove
druvár woodman
i rréshkur parched
háje = háe food
língë small bell
mándër herd
prak brink; threshold
krísin (kërcás) crack; bang
kopán clothes beater
gúrrë spring
kukëzój arch; bend over
kith haze
sandéjmi = s'andéjmi from there
lugájë stretch of a valley
valth
brírësh gjahtárësh of hunting hor
sútë doe
kapósh i dúshkut wild rooster
dushk woodland; oak
këndshëm enjoyably
zotërísht lordly
déhem get drunk

Si flasin për shumë e shumë ndodhje të moçme e të reja, hidhet Gjeto Basho Muji e thotë:

— Dëgjoni, o tridhjetë zotërit e vendit! Dua t'ju pyes për një fjalë. A do të më përgjegji?

— Folë, Muj, se po të dëgjojmë. Sa për përgjegjen, po të jemi të zotët - do të ta japim, po të mos jemi — nuk do çelim gojë.

— Më thoni, vëllezër, kush heq e vuan më shumë nga të gjitha ato gjërat me shpirt që rrojnë në botë.

Hidhet njëri e thotë:

— Më shumë nga të gjitha heq e vuan gjarpëri nën gur; rri i ngrirë akull tërë dimrin; thua se s'është fare i gjallë. Çudi e madhe se qysh nuk i shuhet fara e skota . . . Po, kur fillon të çelë gjethi në pranverë e të ngrohë dielli, gjarpërit i vjen prapë shpirti e ngjallet. Zoti s'i ka dhënë askujt tjetër short më të hidhur se sa gjarpërit! Vdes e ngjallet.

Ja pret një tjetër:

— Unë them se më keq e kanë zogjtë e malit: rrinë pa ngrënë e pa pirë majë bjeshkës tërë dimrin, në shi e në dëborë, në mes të shkulmeve [1]). Çudi e madhe se qysh nuk u shuhet fara e skota . . . Po kur fillon të çelë gjethi në pranverë e të ngrohë dielli, ja nisin bukur këngës. Hej, sa shumë heqin e vuajnë zogjtë e malit!

Gjeto Basho Muji dëgjon urtë, pastaj thotë shtruar:

— Jo, o zotër të Jutbinës! Nuk heq e vuan gjarpëri nën gur në dimër, nuk heqin e vuajnë zogjtë e bjeshkës në shi e në dëborë, në mes të shkulmeve, sa heq e vuan ai trimi i ndjerë Hysen Kraposhniku. Djali ka shtatë plagë pushke në shtat e ka plot shtatë vjet që dergjet mbyllur në shtëpi si i vdekur e i pakallur në varr. Në këta shtatë vjet s'ka shkelur prakun jashtë, s'ka dalë në dritën e diellit e të hënës, s'ka kundruar fushat e bjeshkët që përtërihen verë për verë. Ka thi-

fárë seed
skótë kind; race
askújt no one
short fate
përtërihem = përtríhem recover; rene
vérë për vérë from summer to summer

rrur gjithë mjekët e botës e nuk e kanë mjekuar dot, s'ja kanë mbyllur plagët. E ç'trim i fortë e i fismë ka qënë Hysen Kraposhniku, o vëllezër. I dilte për zot çdo të mjeri, i merrte krahun, luftonte. Po e keqja e së keqes është se Hysua ka qenë i fejuar me një vashë të bukur, nga derë e mirë. Vasha është jetime . . . Hysua e donte shumë, ajo e donte edhe më shumë. Po, kur e pa se kish marrë udhën e varrit, Hysua i dërgoi fjalë vashës: «O vashë e bardhë! Unë të kam dashur fort e tani të dua edhe më fort. Po unë s'jam për ty, as për këtë jetë, se kam shtatë plagë pushke në shtat e më pret varri i zi. S'ka shërimtar që të më shërojë. Nuk dua që ty, vashë, të të kalojë të ritë duke pritur; pra, martohu me një tjetër e gëzo jetën tënde; martohu, vashë, me vëllamin tim Ymer Deliun, që është trim e zotëri. Unë, vashë, do të vdes i gëzuar kur ta di se ti do të kesh gjetur fatin tënd». Vasha u hodh e tha: «Më lini mua të shkoj në shtëpi të Hysos e ta shëroj në tri ditë!» Po qysh mund të shkelë një vashë në shtëpinë e të fejuarit para se të martohet? Nuk e lanë të shkojë dhe e fejuan me Ymer Deliun; e fejuan edhe e prenë ditën e dasmës.

«Hysua vdes e s'vdes dot. Siç duket, s'do të vdesë para se t'i martohet vasha.

«Më thoni tani, o tridhjetë zotër, a nuk vuan Hysen Kraposhniku më shumë se gjarpëri nën gur e akull e më shumë se zogjtë e bjeshkës në shi e në dëborë?»

Ke të drejtë, Muj. Fjalë burri ke thënë — i thonë të tridhjetë zotërit me një gojë. — Hyso Kraposhniku vuan më shumë.

Pastaj kuvendi pritet. Të tridhjetë zotërit ngrihen e shkojnë pikë e vrer.

* * *

Dëgjoni ç'ndodhi më tej.

Si fejohet me vashën e vëllamit të tij, Ymer Deliu ngre e bën dasmë të madhe, nis treqind dasmorë e i

jetím orphan
shërimtár healter
të rítë youth
pres dítën set the date
vdes e s'vdes dot refuses to die
píkë e vrer very distressed
si after

dërgon të marrin nusen. Dasmorët shkojnë te miku, që i pret mirë, u shtron të ngrënë e të pirë. Tërë nata kalon me këngë e valle, me kuvend të këndshëm. Flasin për luftra e për trimëri, flasin për urtësi e bukuri, për të gjitha.

Vetëm Hysen Kraposhnikun nuk e ze askush në gojë. E kush ka kohë t'i përmendë të vdekurit në dasmë? Dasmorët mblidhen për gaz, jo për helm. Po nusja qan tek e nisin dhe e stolisin. Ajo e do më shumë Hyson. Mirëpo nusen nuk e pyet askush [2]). Ka vetëm një shpresë... Po për këtë shpresë do të flasim më vonë, kur t'i vijë radha.

Kur zbardh drita, -- e bardhë qeftë! -- miku e bën gati nusen, ua nxjerr dasmorëve e i përcjell gjer tej. Zbrazen bataré në erë.

Dasmorët nisen e shkojnë me këngë në gojë. Udhës i lodrojnë bukur kuajt. Kur kalojnë pranë kullës së Hysen Kraposhnikut dëgjojnë gjëmë e vaj: ata të shtëpisë vajtojnë Hysen Kraposhnikun.

Gjëmën e vajin e dëgjon edhe nusja që rri majë kalit; e dëgjon, mban kalin, fshin lotët e hidhet u thotë dasmorëve:

-- O krushq dasmorë! Këtu do të ndalemi të prehemi pak, se jam fort e lodhur.

Atëhere gjëma e vaji kumbojnë edhe më fort: Hyso Kraposhniku hëq shpirt.

Nusja hidhet e thotë përsëri:

-- O krushq dasmorë, më prisni këtu nja dhjetë dekika sa të hyj pak brenda që ta shoh e të falem me atë Hyso Kraposhnikun, sepse unë e tij kam qenë.

Krushqve u vjen pak rëndë, po nuk ja prishin dot nuses. Edhe për Hyson u vjen keq, se e dinë që trimi vuan. Nusja as që pret përgjegjen, hidhet nga kali poshtë e hyn me nxit brenda në shtëpi, e veshur me rroba nusërie, e kërkon odë më odë Hyson. Më në fund e gjen. Hysua rri dergjur në shtrat i tretur, i zbetë,

bataré volley
lodrój make perform; cause to play
gjémë catastrophe; misfortune
dekík minute
nusërí bridehood
ódë më ódë room by room
dérgjur seriously ill
i trétur emaciated
i zbétë pale

me sytë të thelluar nën vetullat e dendura, të mbyllur. Asaj i dhimbset. E pyet:

— Shumë sëmurë më je, o trim?

Hysua hap sytë dhe e sheh odën plot dritë, dhe në mes të odës sheh të bukurën e tij të veshur me petk nusërie: me xhubletë bardhëzezë, me kaçurrelat derdhur ballit, me vështrimin të ëmbël... Përnjëmend i dukat si zanë mali. Jo, s'është zanë mali, po është ajo! Ajo që e kish dashur kaq fort e që ja kish falur vëllamit të tij, që ta dinte se do të rronte e lumtur. Zemra e vdarur nis sakaq t'i rrahë, faqet i marrin ngjyrë.

Ja kthen me zë të butë:

— Sëmurë jam, moj vashë e bardhë. Po ti ç'kërkon këtu? Unë s'pres askënd tjetër veç vdekjes së ëmbël që të më marrë e të më shpëtojë nga vojtja. Ti, vashë e bardhë, nisu e shko tek fati yt i ri, gëzo nusërinë ende me vëllamin trim.

Nusja bën sikur s'dëgjon. E pyet përsëri:

— Çfarë vigjëlese të kanë bërë ty, o trim? Dua të them vigjëlese dite e vigjëlese nate. M'i thuaj të gjitha, se dua t'i di.

Hyso Kraposhniku psherëtin e thotë:

— A dëgjon, moj vashë e bardhë? Vigjëlesë dite mua më kanë bërë mjaft. Vigjëlesë nate, besa s'më kanë bërë fare.

Nusja hidhet e thotë:

— A dëgjon, o Hyso Kraposhniku? Unë e kam pasur babanë shërimtar që kish mjekuar gjithë botën. Para se të vdiste më ka mësuar disa sende nga të tijat. Më fal, o trim, po unë dua të rri sonte me ty, këtu në odë, të të vigjëloj, të të mjekoj.

— Ti s'mund të rrish këtu, moj vashë e bardhë, se ti je nisur nuse e ke me vete treqind krushq e dasmorë që të presin të të shpien te burri.

petk dress; garmet
xhublétë bell-shaped skirt
kaçurrél curly
përnjëmend indeed; truly
i vdárur = i vdjerrur waning; expiring
askënd nobody
vigjëlésë = vigjíle vigil
vigjëlój keep vigil

-- Të treqind krushqit e dasmorët do të rrinë këtu. Ti do t'u japësh të hanë e të pinë. Sonte dua të fle në këtë odë e do të vigjëloj, do të të mjekoj.

Dëgjoni se ç'bën nusetrimja!

Zbret poshtë, te praku, e u thotë krushqve:

-- O krushq dasmorë! Sonte do të rrimë këtu që të ruajmë Hysen Kraposhnikun para se të japë shpirt. Ai po ju shtron të ngrënë e të pirë sa t'i doni. Unë do të vigjëlloj gjer të zbardhë e bardha dritë, pastaj do të nisemi.

Krushqve u vjen shumë rëndë, po nuk ja prishin dot nuses. Kjo thotë fjalën, nuk pret përgjegjen, ngjit shkallët e hyn prapë në odë të Hyso Kraposhnikut.

Ai e shikon hidhur në ninëzat e ndritura të syve e prapë i duket si një zanë, e qarkuar me një suazë drite.

Vjen nata e bardhë qoftë! — Nusja i rri mbi krye Hysos: ja fshin lehtë-lehtë djersën e ballit, ja njom me ujë kroi buzët e thara, e shikon ëmbël me ata sytë e ballit. Pastaj Hysoi e ze gjumi. Kur kalon mesnata, hyn në odë një gjarpër i madh, i zi si korbi, përshëllen, i afrohet Hysos e matet t'i lëpijë plagët, t'i derdhë helmin. Nusja i rri gati e ja pret kryet me gërshërë, e ja hedh në një qoshe të odës; ulet përsëri në krye të Hysos; ja fshin ballin e dirsur, ja njom buzët e thara e shikon me ata sytë e ballit. Pas pak hyn një gjarpër tjetër, më i madh, i kuq si gjaku, përshëllen edhe më fort se sa i pari, i afrohet Hysos, matet t'i lëpijë plagët, t'ja helmojë. Nusja i rri edhe këtij gati: i pret kryet me gërshërë, dhe ja hedh në qoshe të odës pranë të parit.

Hop, hyn një gjarpër tjetër, edhe më i madh, i bardhë si dëbora, përshëllen fort e më fort, i afrohet Hysos, matet t'i lëpijë plagët. Nusja ja pret edhe këtij kryet.

Bëhen tre gjarpërinj kryeprerë. Ajo i mbulon të tre me një thes dhe kthehet e vigjilon mbi krye të Hysos . . . Gjë tjetër nuk sheh. Hysua fle i qetë.

nínëz pupil (of the eye)
suázë halo
e bárdhë qóftë! may it be lucky
njom wet
i thárë = i thátë dry
përshëllëj hiss; whistle
mátem attempt; try
lëpíj lick
gërshérë scissors

Në mes të heshtjes dëgjon një bulkth që ja thotë bukur, ëmbël, në qoshe të vatrës.

Gdhihet ditë; bie dielli.

Kur zgjohet nga gjumi, Hysen Kraposhniku e ndjen veten të prehur, të lehtë. E shikon vashën, i buzëqesh.

— Kësaj nate, — thotë, — bëra një gjumë të mirë sikur fjeta në një luadh bjeshke. M'u pre shtati e tani jam mirë. Flladi më flladiti ballin, kroi më njomi buzët. Tani e ndjej veten kaq të lehtë sa më vjen të fluturoj.

Thotë kështu e ve prapë buzën në gaz. Ngrihet shesh në shtrat. Nusja i gatuan vetë sillën e ja sjell në shtrat.

— A dëgjon, o Hyso Kraposhniku? — i thotë ajo. — Unë ndenja e vigjilova tërë natën, t'i mjekova plagët e shtatit që s'të kanë lënë të çohen më këmbë.

Pastaj ngrihet e i tregon të tre gjarpërinjtë kryeprerë: atë të zinë si korbin, atë të kuqin si gjakun, atë të bardhin si dëborën.

Hej, sa shumë gëzohet Hyseni!

Nusja i thotë:

— Unë dua të rri me ty edhe dy net gjersa të shërohesh krejt e të ngrihesh më këmbë.

— Jo, ti s'rri dot, moj vashë e bardhë. Krushqit presin të të marrin. Vëllami pret në shtëpi. Kushëri ç'mund të thotë.

— Mos kij brengë për këtë punë, o Hyso. Veç jepu të ngrënë e të pirë dasmorëve, se unë dua të fle edhe dy net të tjera këtu.

Nusja s'pret përgjegje, del jashtë e u thotë krushqve:

— O krushq dasmorë! kërkoni ç'të doni për të ngrënë e për të pirë, se unë duhet të rri këtu edhe dy net që të mëkëmb Hysenin. Ndofta do ta ngre më këmbë, pastaj do të shkojmë te burri.

bulkth = burkth cricket
fjéta (fle) slept
flladít breeze; blow
çóhen = çohesh (m.p.)
brénge anxiety
mëkëmb cure

Krushqit hidhërohen shumë, po s'kanë ç'i bëjnë nuses. Rrinë aty ku janë, presin se ç'do të bëhet e ç'fill do të marrë kjo punë.

Nusja fle aty, dy net të tjera, e mjekon Hyson. Kur mbushen plot tri net, Hyso Kraposhniku i thotë nuses:

— Të gëzoftë ai që do të të gëzojë, moj nuse! Ti paske qenë shërimtare e madhe. Tani e ndjej veten kaq mirë sa më vjen t'i hyp kalit e t'i shëtis të gjitha bjeshkët majë më majë, se më ka marrë fort malli për shtegtim, të nuhat lule e bar, të pi ujë gurrave, të gjuaj.

— Dëgjo, o Hyso Kraposhniku! Ngreu që tani, djalë; vishu e ngjishu mirë, hipi kalit e dil shëtitje në fushë që të të shohin krushqit e dasmorët. Unë s'ndahem nga ti, edhe sikur ta di se do të më vrasësh. Jotja isha, jotja dua të jem!

Hysenit i rreh zemra. E shikon e s'i nginjet syri si shikuari. Po në cep të qerpikut i ndrit një pikëz loti. Ajo skuqet, ul kryet.

— A më do me të vërtetë, moj vashë? Unë kam qenë gjer dje buzë varrit . . . Ti më ktheve në jetë, me jetë qofsh! Po . . .

— Të thashë, Hyso: jotja isha, jotja jam! Nga kjo shtëpi nuk dal veçse e vdekur.

Atëhere Hysenit i bëhet zemra mal: vasha e bardhë, dashatarja syndritur, e këndell. Vishet e mbathet mirë, i hyp kalit, i ngul shporret, e lëshon me vrap të madh, fushës, e mbyt në djersë dhe kthehet te krushqit. Ata mahniten kur e shohin: e dinin buzë varrit, e ai u vjen majë kalit! Hysua u falet bukur, zotërisht. Ata ja kthejnë edhe më bukur, më zotërisht.

— Mirë se ju gjej, o krushq dasmorë!

— Mirë se vjen, o trim Hyso Kraposhniku.

— Si t'ja bëjmë kësaj pune, o krushq dasmorë? Nusja s'do të vijë me ju te vëllami. Unë, thotë, dua fatin tim të parë.

fill outcome
hyp = hip
nuhás smell
víshu e ngjíshu mírë get all dressed
jótja yours
ngínjem satiate
qerpík eyelash
dashatár lover
syndrítur bright-eyed
këndéll revive
vrap pace
mahnit = manit astound

Krushqit varin vetullat, zymtohen, venë dorë në silahe. Ç'do të ndodhë tani? Do të derdhet gjak?

— Ne nuk shkojmë dot pa nuse — thonë ata, prerë.

Hyseni vret mendjen.

— Pa dëgjoni, o krushq dasmorë. Ymer Deliun vëllam e kisha, vëllamë e kam. Kam një motër, të mirë mbi të mira. Këtë motër do t'ja jap Ymer Deliut. I veshim petkat e nusërisë, e merrni e ja shpini. I thoni: «Të dërgon shumë falmeshëndet vëllami yt Hysen Kraposhniku, që u shërua e u ngrit nga shtrati. Në vend të nuses po të dërgon të motrën e vet. Në daç ta mbash motrën e tij për grua, mbaje për jetë e mot. Në mos daç ta mbash për grua, mbaje për motër».

E veshin motrën nuse, ua japin krushqve. Këta e marrin e shpien në derë të Ymer Deliut. Ky u del përpara e i pyet:

— Ç'është kjo punë, u krushq dasmorë? Pse u vonuat kaq fort? A nos miku s'desh t'ja japë nusen? A nos jua preu udhën ndokush e ratë në luftë?

- Jo, Ymer Agë, — i thonë ata. Miku na priti mirë e më mirë, na e dha shpejt nusen. Udhën nuk na e preu askush, në luftë nuk ramë. Po kur po vinim këtej, kaluam pranë shtëpisë së vëllamit tënd, Hysen Kraposhnikut, e dëgjuam vaj e gjëmë. Hysen Kraposhniku po jepte shpirt. Nusja mbajti kalin e na tha të ndalemi pak që ta shihte për herë të fundit Hysen Kraposhnikun. Ne nuk ja prishëm dot fjalën. Hyri brenda. Në shtëpi pushoi vaji e gjëma. Nusja doli prapë te praku e na tha të rrinim edhe pak që të mjekonte Hyson. Ndenjëm tri ditë e tri net. Ajo e mjekoi: e ngriti më këmbë. Tani vëllami yt është shëndoshë e mirë. Ju mbyllën menjëherë të shtatë plagët. I hyp kalit e i bie fushës tejpërtej. Ne u gjendëm shumë ngushtë. Nusja s'desh të vijë këtej. Unë, tha, po marr fatin e parë, Hyso Kraposhnikun... Hysna na tha:

zymtóhem become gloomy
siláh wide leather belt

falmeshëndétje greeting
ndokúsh someone

«Ymer Deliun vëllam e kisha, vëllam e kam. Po i jap time motër, që e kam të mirë mbi të mirat. Në s'dashtë ta mbajë për grua, le ta mbajë për motër».

Ymer Deliu nuk e thyen fare zemrën. Pyet:

— A është shëndoshë e mirë vëllami Hysen Kraposhniku?

— Shëndoshë është e mirë është.

Atëhere, nga gazi i madh, Ymer Deliu nxjerr dy koburet e brezit e i zbraz të dyja menjëherë, në erë:

— Për shëndet të Hysen Kraposhnikut e të nuses!

Pastaj Ymer Deliu shtron darkë të madhe për gazin e vëllamit që shpëtoi nga vdekja, merr të treqind dasmorët, merr edhe motrën e Hysen Kraposhnikut e shkon i bie në derë.

Hyso Kraposhniku del e i pret bukur: i hedh krahun mbi sup, e i fut brenda në shtëpi.

— Mirë se ardhe, vëllam Ymer Deliu.

— Mirë se të gjeta, vëllam Hyso Kraposhniku. U trashëgofsh një herë e me jetë. Të kam ardhur me treqind dasmorë që të gëzohen për gazin tënd. Motrën ta kam sjellë prapë, se unë motër e kisha motër e kam. Nuse për vete do të gjej, se bota është e madhe. Edhe motrës do t'i gjejmë një burrë të mirë.

Të dy vëllamët u përqafuan si vëllezër.

Dasma e re zgjati shtatë ditë e shtatë net. Gëzohet tërë Jutbina e krahina, se Hyso Kraposhniku shpëtoi nga vuajtjet që e kishin gozhduar shtatë vjet në shtrat; gëzohet dhe e lëvdon nusen trime që e mjekoi Hyson, e ngriti më këmbë, e ktheu në jetë.

Pastaj rruan e trashëguan.

Rrofshi edhe ju që e dëgjuat.

---

1) Shkulm-i = dallgë, valë e turrshme, suvalë.

2) Në ditët e soçme këtij zakoni prapanik ju dha grushti vendimtar. Sot vajza shqiptare vendos vetë për fatin e vet.

kobúre pistol
rrúan = rrójtën

LEXIMI I GJASHTEDHJETEGJASHTE

Fatos Kongoli, «Mëngjes vere,» Nëndori, No. 5 (May), 1972, pp. 130-137.

Abetare, Tiranë, 1958, p. 151.

provím test; experiment
provímet e matúrës final exams before graduation
paprítmas unexpectedly
gríndem quarrel; argue
kot së kóti for no reason

Mëngjez vere

Prej disa ditësh ai kishte vënë re një ndryshim të pakuptueshëm në sjelljet e djalit. I biri, që sapo kishte mbaruar provimet e maturës, me një natyrë të veçantë, vazhdimisht e kishte shqetësuar me karakterin e tij të mbyllur, që e largonte nga njerëzit. Diçka nervoze, të cilën mundohej ta përmbante me vështirësi, u çfaq papritmas në syt e tij. U mbyll akoma më tepër në vetvete, grindej kot së koti dhe s'i pëlqenin as ato gjëra që më parë e tërhiqnin.

Këto po mendonte Sotiri, profesor në biologji, ndërsa

priste i ulur mbi një karrike në ballkonin e apartamentit të shoqen, që akoma po rregullohej në dhomë. Ajo e kishte zakon të rregullohej në çastin e fundit-e, sidoqë at qe betuar disa herë se s'do të vishej përpara se të bëhej gati, e shoqja, prej më se gjysëm ore po e priste duke ndjerë erën e lehtë të parfumit që vinte nga dhoma.

— Mos ka rënë në dashuri, — mendoi profesori për të birin. Ky iu duk shkaku më i mundëshëm pas gjithë arësyetimeve që i erdhën në kokë, duke vështruar qytetin në muzgun e mbrëmjes.

— Marta, — thirri i mërzitur — edhe sa do të pres akoma.

Ai fshiu sumbullat e djersës me një shami të bardhë. Nga dhoma dolli e shoqja, laborante në një institut kërkimesh, që ruante nga rinia veç tipareve të rregullta dhe shijën e hollë të tualetit.

— Më duket u vonuam, — tha ajo.

«Ta merr mendja», mendoi me ironi profesori, por këtë nuk ia zuri me gojë.

— Viktori s'do të vijë?

— Jo.

— S'është e mundur, — u habit ai.

— Edhe unë s'e kuptoj — tha gruaja. — Ka qysh në mëngjez që është mbyllur.

Profesori shtrembëroi buzët. Por ai ishte njeri i prerë. Përderisa djali kërkonte vetminë, me siguri duhet të kishte diçka dhe zgjidhja më e mirë do të qe ta linte në këtë vetmi, gjersa të kërkonte vetë të dilte prej saj.

Ata zbritën shkallët me zhurmë, i hipën autobuzit urban që kalonte aty pranë dhe, pas disa minutash, u gjendën në qendër të qytetit.

— Larg e ka shtëpinë dhe ky Bezhani, — tha gruaja.

Në të vërtetë këtë ajo e tha kot, sa për të folur diçka, për të thyer heshtjen e akullt të të shoqit. Ajo qe e mërzitur nga këto vajtje e ardhje nëpër natë nga njëri skaj i qytetit në tjetrin, vetëm sepse akoma s'po mundnin të merrnin një televizor. Ndërsa miku i tyre prej disa muajsh e kishte instaluar në dhomën e pritjes. Sa herë që i afroheshin shtëpisë së tij, një vilë dykatëshe me çati të lartë të stilit gotik, antena mbi tjegullat e kuqe, me atë krekosje fodulle zgjonte tek ajo lakminë së bashku me inatin për të shoqin, i cili asnjëherë s'kish mundur ta nxjerrë qimen nga qulli.

Sotiri nuk iu përgjegj. Ai e dinte se ku donte të dilte

sidóqë even though
betóhem swear
parfúm perfume
laboránt lab worker
kërkím research
tualét toilette
i prérë precise; determined
përderisá as long as
skaj corner; locality
vílë villa
dykátësh two-storied
gotík Gothic
tjégull tile
krekósje pride
fodúll boastful
lakmí envy
i cíli asnjëhérë...qúlli who had never been able to succeed at anything

e shoqja dhe kjo e mërziste. Edhe vapa e rëndë e mbrëmjes e mërziste, edhe përplasjet nervoze të njerëzve të shkujdesur në supin e tij, edhe kjo vajtje në shtëpinë e mikut. Të gjitha këto i shkaktonin një ndjenjë pakënaqësie të përgjithëshme ndaj diçkaje të papërcaktuar. Ai ishte njeri studioz, i matur në veprimet e tij, të cilat kurrë nuk ishin të tepërta, pa një qëllim në vetvete. Prandaj bisedat e kota të gruas, sorollatjet pa fund të kalimtarëve nëpër vitrinat e mëdha dhe rrugët e zhurmëshme, llomotitjet që dëgjonte pothuajse çdo mbrëmje në dhomën e pritjes së Bezhanit tek shihnin programet televizive, i krijonin një zbrazësirë të padurueshme. Ca herë që largohej nga Bezhani, duke marrë me vete një ndjenjë kotësie, grindej me të shoqen, betohej se s'do të harxhonte më kohën me dërdëllitjet pa vlerë mbi lavapjatat dhe modelet e fundit të kuzhinave moderne e mbyllej në dhomën e tij, ku së fundi qetësohej. Megjithatë, të nesërmen pasdite i harronte këto, ose më mirë të thuash mposhtej nga vendosmëria e së shoqes për të parë vazhdimin e puntatës së filmit të fundit televiziv. Për këtë mbrëmje të qetë vere nuk ishte këmbëngulja tekanjoze e Martës që po e dërgonte në skajin tjetër të qytetit...

Pas kthesës së fundit, përmes muzgut ata dalluan vilën ku banonte Bezhani dhe antenën e lartë mbi çati. Ngjitën shkallët e jashtme. Sotiri shtypi sustën e ziles. Nga brenda u dëgjua kërcëllima e një dere që u hap...

— Sonte qëndkemi të parët, — tha Marta e zhytur në një kolltuk të madh.

Sotiri tundi kokën me ngathtësi. Nga biblioteka e murit pranë tij, i tërhoqi vëmendjen një libër i trashë me kopertinë të lustruar. E mori në dorë. Titulli i ngjalli instinktivisht një ndjenjë zilie për mikun e tij: «Larus 1971».

— Thuaj ç'të duash, por Bezhani është njeri me gusto, — tha Marta. Ajo filloi të përshkruajë sendet me të vërtetë me gusto të hollë të dhomës së pritjes.

Sotiri shfletonte larusin pa e patur mendjen në fjalët e gruas.

— Aha, — tha Bezhani që hyri në dhomë me një tabaka në dorë, — po sheh larusin?

Ai ishte një burrë i mbajtur mirë rreth të gjashtëdhjetave.

— Po, — iu përgjegj i hutuar Sotiri, ku e gjete?

— Ma solli Ruzhdiu nga Franca. Ti e di se ai ndenji atje gjashtë muaj.

— Jo, — tha Sotiri i habitur — nuk e di.

vápë hot weather; sultriness
përplásje bumping
i shkujdésur careless
pakënaqësí dissatisfaction
i papërcaktúar undefined
i mátur cautious; measured
i tépërt excessive
sorollátje idling; loitering
i zhúrmëshëm = i zhúrmshëm noisy
llomotítje babbling
sa hérë whenever
kotësí purposelessness; futility
dërdëllítje chatter
lavapjátë dishwashing machine
vendosmërí determination
puntátë episode
këmbëngúlje stubborness
tekanjóz cranky; ill-tempered
sústë spring; switch; button
zíle bell
kërcëllímë banging
sónte tonight
zhyt plunge; sink
kolltúk armchair
kopertínë cover
Larús Larousse, French dictionary
gústo good taste
shfletój leaf through
tabáka tray
i mbájtur mirë in good shape

Bezhani ia mori librin nga dora dhe e lëmoi i kënaqur.

— Si kështu, — foli edhe ai i habitur — ai vajti dhe erdhi, ndërsa ti s'paske marrë vesh gjë.

— Ç'të bësh — mërmëriti Sotiri. — na mbytën punët... leksionet.

Pastaj, si të kujtohej për diçka e pyeti.

— Për çfarë u specializua?

— Më duket mbi disa ligje të përgjithëshme të matematikës statistikore.

Sotiri lëshoi një psherëtimë të gjatë dhe u zhyt më thellë në kolltukun e madh. Miku i tij afroi një kolltuk tjetër aty pranë, por atë çast zilja elektrike tringëlliu me forcë. Ai u ngrit. Pas pak, në dhomë u futën dy çifte, të cilët Sotiri i njihte. I kish parë shpesh aty. U përshëndetën dhe secili zuri vendin e tij. Më vonë erdhën edhe pesë veta të tjerë. Brenda disa minutash dhoma u mbush me tym duhani. Gratë bisedonin kokë më kokë me zë të lartë mbi po atë gjëra që ai i kishte dëgjuar qindra herë. Burrat heshtnin. Më të rrallë ata këmbenin ndonjë fjalë. Vetëm njëri, një mësues historie në një shkollë të mesme, po e bezdiste me ankesat për nxënësit e sotëm, që kërkonin ta merrnin shkollën duke bërë pallë.

Sotirin e mbuluan përsëri sumbulla të mëdha djerse, të cilat i fshinte me shaminë e bardhë. Marta nga kolltuku ku qe ulur i bëri me shenjë të ngrinte këmbët e pantallonave. Ai i ngriti. Në krye të dhomës mbi një tryezë të lustruar qëndronte televizori. Së largu Sotiri lexoi instinktivisht, ashtu siç kishte lexuar kushedi se sa herë, titullin e markës. Më në fund Bezhani shtypi sustën, mbylli dritën dhe në dhomë ra qetësia. Bezhani u ul në kolltukun pranë tij.

— Super ambasadorët kanë dalë mjaft të mirë, — tha dikush në errësirë.

Asnjë nuk i ktheu përgjigje. Drita jeshile e zbetë i mbuloi të tërë.

— E, — i tha Bezhani mikut të tij në vesh — ç'të reja keni?

— Asgjë — tha Sotiri me ndjenjën e një pakënaqësie që po i rritej.

— Si asgjë!?

— Dëgjo Bezhan. Unë bëra çmos, por yt bir më duket i ngathët.

Spikeri nga ekrani i vogël thërriste me entuziazëm për prodhimin e fundit të aspirinave që të largonin dhimbjen e kokës.

leksión lecture
bezdís bother
ankésë complaint
bëj pállë loaf
tryézë table
márkë make; brand
jeshíl green

— Si kështu? — pyeti Bezhani. — Ai përkundrazi, ka dashur ta takojë vetë dy herë. Çupa s'ka pranuar...

Sotiri heshti. Edhe Bezhani heshti. Sotiri mendoi se djali i Bezhanit ishte padyshim një kungull pa fara, përderisa shpresonte që nusen t'ia gjenin të tjerët. Bezhani krenohej kudo me djalin e tij, që ishte një inxhinier i talentuar.

— E di ç'më ndodhi? — tha pas pak Sotiri.

— Çfarë?

— Ajo vajza erdhi e më takoi në fakultet.

Bezhani lëshoi një psherëtimë habie.

— Të them të drejtën s'di ç'të bëj tani...

Por ata e ndërprenë bisedën. Në ekranin e televizorit u shfaqën kuadro nga udhëtimi i kozmonautëve në hënë. Të dy profesorët ranë në heshtje. Ata ishin mjaft të interesuar për të dhënat biologjike që spikeri me një zë solenin transmetonte nëpërmjet aparatit. Ai fliste, fliste, fliste... Para syve të tyre parakalonte hëna... Pastaj spikeri filloi të flasë për gjëra të zakonëshme dhe ata nuk e dëgjuan më.

— Erdhi tek ti, the? — pyeti Bezhani.

Sotiri fërkoi zverkun.

— I jati i saj është burrë i mirë, — tha, — ai më premtoi. Ti e di që unë i folà për ty, për tët bir... bile ai të njihte. Me një fjalë puna mbaroi, sepse ai kishte shumë dëshirë ta bënte këtë krushqi.

— Pastaj?

— Nuk e di, mbase gjithçka e ka prishur yt bir.

— Pse?

— Mbase s'duhej të dilte përpara vajzës. — Sotiri e ndjeu se po fliste kuturu. Ai s'dinte ç'të fliste.

Miqtë heshtën përsëri.

— Ç'të tha vajza? — pyeti Bezhani.

— Më tha se s'duhej të fusja hundët në punët e saj.

Bezhani lëvizi nga kolltuku. Spikeri edhe një herë po fliste për aspirinat.

— Sigurisht — tha Bezhani, — ajo është e re, gjimnaziste hesapi. Mbase nuk ka idenë se cili është djali im, ç'familje jemi ne.

— Nuk e di...

Sotiri vështroi përreth. Kjo bisedë po e mërziste. Vizioni i vajzës iu shfaq para syve dhe ai nuk mundi ta shqiste. Zëri i saj ishte i egër. Edhe pamja. Emrin e kishte të bukur, Roza. Edhe vetë qe e bukur, mjaft e bukur. Ky kungulli i Bezhanit sigurisht nuk ishte pa gusto. Por vi-

bisédë = bisedim
kuádro scene
parakalój pass
zverk back of the neck
bëj krushqí make a match (wedding)
kuturú haphazardly
gjimnazíste hesápi we're dealing with a gymnast
shqit shake off

ioni i vajzës nuk po i shqitej. Ai e mundonte me atë kryeneçësi të egër.

— Ç'të bëjmë tani? — tha Bezhani.

— Nuk e di.

Bezhani ndezi një cigare. Sotiri nuk e pinte duhanin.

— Si janë nga gjendja ata?

— Ç'ka...

— Sa fëmijë ka Hitua?

— Pesë.

— E madhja është çupa?

— Jo, e dyta. Ka një djalë në universitet. Çupa ka ayrë në punë qysh këtë verë.

— Gjynah, — tha Bezhani.

Sotiri nuk foli.

— Dëgjo, futju edhe një herë kësaj pune, — u lut ai.

Sotiri heshti.

— Provoje edhe një herë. Mbase vajza është nxituar.

Sotiri u zhyt më thellë në kulltukun e tij.

— Thuaj Hitos se ne do ta dërgojmë në shkollë. Do t'i nxjerrim bursë.

— Çfarë?

— Do t'i nxjerrim bursë thashë.

Sotiri tundi dorën i pakënaqur. Atij filloi t'i dhembë koka dhe donte të dilte jashtë, në ajër të pastër. Atij i dukej sikur spikeri thërriste vazhdimisht me zë të lartë: «Aspirina, aspirina...».

Afër mezit të natës u kthyen në shtëpi. Marta i shtërngohej pas krahut nga të ftohtit e mbrëmjes dhe këndonte ehtë melodinë e një kënge. Djalin e gjetën zgjuar. Sotiri e vështroi me vëmendje dhe i shkoi ndër mend se mbase ai kishte rënë në dashuri. Fytyra e tij iu duk mjaft e nequr, sytë të futur thellë e të menduar.

— Përse nuk erdhe me ne? — e pyeti.

— Eh, mor Viktor, ç'film të bukur që pamë sonte, — tha Marta. — pamë edhe kozmonautët në hënë.

Djaloshi u ngrit. Kaloi pranë tyre me indiferencë dhe u tha «natën e mirë». Sotirit i bëri përshtypje indiferenca e tij. Kishte diçka të egër, kryeneçe.

— Viktor, — i thirri, — eja këtu!

Djali u bind. Ai qëndroi drejt para të jatit, si një ushtar që rri gatitu.

— Ç'është kjo punë me ty?! — thirri Sotiri, që e kuptoi se po nxehej, — që kur je mësuar të mos u përgjigjesh të tjerëve.

Djali e vështroi drejt në sy.

— Jam shumë i lodhur, dua të fle — tha ai.

kryeneçësí stubbornness
nga gjéndja economically; financially
gjynáh a shame
Mbáse...nxitúar Perhaps the girl was hasty
búrsë scholarship
djalósh = djálë
bíndem obey
që rri gatítu who is standing at attention

Sotiri e la të qetë. Marta u fut në dhomën e gjumit e filloi të zhvishej. Ajo vazhdonte të këndonte, ndërsa i shoqi mendoi se s'kish lumturi më të madhe se sa ta mirrje jetën si ajo, me një këngë.

Ai nuk kishte uri. Nuk i hahej. Filloi të mendojë për të birin dhe, padashur, kujtoi vajzën. Sotiri mendoi se të rinjtë e sotëm nuk ishin aq të respektueshëm sa ç'kishte qenë ai me shokë në një kohë. U zhvesh me ngathtësi, u fut në shtrat dhe shtypi sustën e abazhurit.

— Sidoqoftë, nesër do të bisedoj edhe një herë me Hiton, — tha me vete.

Pastaj e zuri gjumi nën krahun e butë të Martës...

Të nesërmen u zgjua më heret se zakonisht. Kishte dhëmbje koke. Qysh në mëngjez dielli ishte i nxehtë, mjaft i nxehtë. Marta vuri xhezven e kafesë në një plitkë. Edhe i biri ishte zgjuar heret. Ai qëndronte në ballkon. Sotiri vështroi profilin e tij përmes derës së ballkonit, duke pirë kafenë. Marta këndonte këngën e mbrëmëshme me zë të ulët. Poshtë, në asfaltin e rrugës, lëviznin njerëzit e makinat. Dielli digjte, digjte... I biri ishte tretur shumë, kishte ndryshuar shumë dhe atij i erdhi keq.

— Viktor! — i thirri pa dashur.

Djali nuk lëvizi. Ai i thirri përsëri. Djali erdhi dhe u ul para tij me një pamje të çuditëshme, të huaj.

— Viktor, çfarë ke?

Djali vështroi nga e ëma. Marta këndonte.

— Asgjë.

Sotirin nuk e kënaqi përgjigjja e tij.

— Viktor, ti ke diçka, thuaja babit.

Djali mori frymë thellë.

— Më vjen turp baba, — tha ai papritur.

Viktori ishte serioz dhe Sotiri e dinte këtë. Gjithmonë kishte menduar se i biri kishte një seriozitet të çuditshëm. Ai gjithmonë kishte dashur gjithashtu të gjente ndonjë mjet për t'ia larguar ndjenjën e turpit, që e veçonte nga njerëzit. Sepse profesori ishte i bindur, që djali i tij bënte një jetë të vetmuar. Sigurisht, duhej të kishte bërë edhe një fëmijë tjetër...

— Dëgjo, Viktor, — i tha me dhembshuri — edhe nga unë ke turp?

Djali u mundua të zotrojë veten.

— Jo.

Marta në kuzhinë këndonte.

— Ahere ç'ke? — i tha Sotiri.

— Asgjë...

abazhúr lamp with a shade
i búrë tender; soft
xhezvé small pot
plítkë burner
dhembshurí compassion
zotrój = zotërój

Sotiri e vështroi i habitur. Ai mendoi se në fakt dashuria i bën ca budallenj njerëzit dhe i erdhi për të qeshur.

— Hajt, lëri këto tani.

Pas një ndrydhjeje të fuqishme që mezi mundi ta mposhtë, djali mërmëriti:

— Unë kam patur një shoqe shkolle, baba, atë e quajnë Roza.

Sotirit iu drodhën buzët. Roza, Roza... Fytyra e vajzës iu shfaq si një vizion i turbullt dhe i ngjalli një ndjenjë pasigurie.

— Dhe çfarë? — tha ai.

Djali psherëtiu.

— Një ditë u takuam në bulevard...

Profesori e humbi durimin.

— Ti me Rozën e Hitos... pyeti ai pa e çuar mendimin gjer në fund.

— Eh... — tha djali i pakënaqur.

Sotiri u përpoq të mbledhë veten.

— Viktor, ç'janë këto marrëzira që flet.

— S'janë marrëzira për fat të keq, — tha djali i qetë.

Sotirin e mbërtheu dhëmbja e kokës. Kjo i ndodhte pasi kishte dhënë ndonjë leksion të gjatë në auditorin e zhurmëshëm. Vetëm pasi mbante leksionin.

— Roza më tregoi disa shënja të zeza në trup. Atë e kishin rrahur.

Profesorin e mbulnan sumbulla të mëdha djerse. Marta këndonte...

— Mua më erdhi turp për ty, baba, — përsëriti djali, — s'desha ta besoja se shkaktari ishte im atë.

Marta në derën e kuzhinës mbeti si e ngrirë me një kusi në dorë.

— I di të gjitha, — tha pastaj Viktori me zë të mbytur.

— Viktor, — thirri Marta. — ti s'je në vete.

Profesori u trondit. Ai i bëri me shenjë së shoqes të largohej. Mbase për herë të parë ndjeu t'i përmbysej diçka. I hipi një deshirë e papërmbajtur për të qëndruar vetëm me djalin. Dielli i atij mëngjezi vere digjte si saç.

budallá fool
hajt come on
ndrýdhje strain
mposht subdue; keep down
i túrbullt murky; blurred
pasigurí insecurity
i pakënáqur displeased
marrëzí nonsense
shkaktár causative agent
me zë të mbýtur in a stifled voice
ti s'je në véte you're not yourself; you're crazy
i papërmbájtur uncontrollable
saç Dutch oven

FOLË, MOJ MIKE, NJË FJALË *)

Folë, moj mike, një fjalë,
Se jam gati për të dalë.
Ku vete, mos vafsh i gjallë,
Se mua s'ma nxore mallë !
Kur dolla nga dera jashtë,
M'u muarrë mënt e rashë.
Kur dolla në mes t'avllisë,
M'u këput gjysm' e fuqisë.
Kur dolla nga porta jashtë,
E besova që u ndashë.
Pampor, o dhoga e thatë,
Na ndave neve nga gratë
Pampor, o një dhog' e zezë,
Ku na shpie, i pabesë ?
Na ndave nga kishim shpresë.

(POPULLORE)

ku véte, mos vafsh i gjállë May you never get to where you're going alive.
nxjerr mállë get full satisfaction
múarrë = mórën
mënt = méndja
avllí wall around a house.
m'u këpút gjysm'e fuqísë I lost half my strength
pampór ship
dhógë plank

gjétkë elsewhere
luksóz fancy
kulláro tie

SHQIPETARET NE AMERIKE

IMIGRANTET E PARE

Më parë se të fitonte independencën e saj më 1912, Shqipëria ish një vënd i mbytur në varfëri, nga shkaku i sundimit 500-vjeçar të Turqisë. Populli Shqipëtar bënte një jetë mizerabile, dhe burrat ishin të shtrënguar të linin gratë dhe fëmijët, dhe të mernin udhën e kurbetit për të gjetur punë. Kështu, pra, shkuan në Greqi, Bullgari, Serbi, Rumani, Egjyptë, Turqi, Rusi dhe gjetkë.

I pari Shqipëtar që erdhi "gjetkë"—në Amerikë—ish nga fshati i Katundit. Ky ish Kole Kristofor, i cili arriu këtu rrotull vjetit 1884. Kolea ardhi me një vapor Grek në Boston, Mass., dhe me qënë se nuk dinte se ku të vinte, natën e parë n'Amerikë fjeti përjashta stacionit të trenave (South Station), i shoqëruar prej disa Grekëve që ardhë bashkë me të. Pas gjashtë vjet në Amerikë, Kolea u kthye në Katund, në fshatin e dashur të vënd-lindjes së tij, veshur me rroba "alla Franga", me një kapellë lluksoze, kullaro të he-

kurosur dhe xhepet plot para. Kur ardhi në Katund, u ngrit më këmbë i gjithë fshati, si edhe populli rredh e përqark. Kolea u rrëfeu fshatarëve çuditë që kish parë në Botën e Re, edhe ata e besuan. Vizitori nga Amerika u rrëfeu se në Amerikë një punëtor mund të fitonte dhjetë dollare në ditë duke shitur lule dhe fruta nëpër udhë, një sumë të hollash që një punëtor në Shqipëri mezi e bënte në një vjet. Fjalët e Koles i frymëzuan fshatarët me dëshirë që të shikonin Amerikën, dhe sikundër dihet, një popull i frymëzuar shpesh herë ia arrin qëllimit të tij.

Më 1892, Kole Kristofori, i cili më vonë u bë prift, u kthye në Amerikë, këtë herë me disa shokë nga Katundi. Pas pakë vjeteve, u mblodhë rredh Koles të tjerë shokë që kishin qënë në kurbetet e Rumanisë dhe Greqisë. Me këta, numuri i Shqipëtarëve në Amerikë arriu shtatëmbëdhjetë veta, dhe të gjithë ishin nga Katundi.

Të 17 pionerët Shqipëtarë në Amerikë ishin këta:

At Kole Kristofor
Hari Take Rrapo Laska
Dhoske Sotir Adham
Thoma Sotir Adham
Josif Sotir Adham
Sotir Lezi
Geli Goni Stevenson
At Dhosi Katundi
Dhime Pano (Peterson)
Fani Kosta
Thoma Kosta
Hari Kaçka
Argjir Peto
Fani Cico Angjel
Dhime Andrea Pano
Rapi Fanes
Toli Dhami

dúke shítur (shes) selling
të hólla money

Nuk dua të lë përshtypjen se burrat e Katundit e kishin monopolizuar Shqipëtarizmën. Po fati e solli që ata u frymëzuan me ndjenja kombëtare njëzet vjet më parë nga bashkëatdhetarët e tyre, dhe kësisoj përfituan nga rasti. Duhet përmëndur se Petro Nini Luarasi ish mësuës në Katund për dy vjet, 1886-1888, dhe u mësoi fshatarëve abetaren Shqipe, këngën e Krishtlindjes, "Vete Sot në Vithania, Zoti Krisht e Perëndia", si edhe ngjarjen nga Ungjilli, "Jakovi dhe të dymbëdhjetë bijtë e tij, nga të cilët më i vogëli ish Josifi." Malo Selenica, trim i fshatit, një burrë që kish marë emër në fshatrat e Vakëfeve, ish një nga nxënësit e Petro Ninit.

* * *

Pothua se të gjithë pionerët e lart-përmëndur kishin qënë në kurbet në shtetet e Ballkanit që të fitonin bukën e gojës. Kjo u dha rast atyre të shikonin shtete independentë, që qeveriseshin vetë dhe kishin shkolla në gjuhët e tyre. Kur ardhë në Amerikë, Shqipëtarët gjetën një vënd akoma më të lirë, si edhe raste më të mira të bënin më shumë të holla. Duke parë këto gjëra, pionerët Shqipëtarë e mbushnë mëndjen një herë e mirë që të punonin për independencën e Shqipërisë. Historia na rrëfen se dëshira e tyre u plotësua. Shqipëria fitoi independencën e saj. Pionerët në fjalë filluan që n'atë kohë të ndihmojnë vëndin e lindjes, dhe vazhdojnë t'a ndihmojnë edhe sot e kësaj dite.

Më 1900, Shqipëtarët filluan të vinin n'Ame-

kësisój thus
ngjárje story; event
në fjálë in question
qark district
kartpostále postcard
mbássi = mbási
gjithashstu = gjithashtú (m.p.)
pas-árdhës = pasárdhës successor

rikë tufa-tufa nga të gjitha anët e Shqipërisë. Pakë më vonë, më 1903, u duknë këtu shënjat e para të independencës të Shqipërisë, me botimin e gazetës "Drita" në Sofje të Bullgarisë, prej Shahin Kolonjës; revistës "Albania", prej Faik Konitzës; "Kalendari Kombiar", prej Kristo Luarasit; "Istori e Skënderbeut", prej Naim Frashërit, ashtu edhe me përhapjen në Boston dhe qarket të kartpostaleve që kish nxjerë Princi Aladro Kastrioti, me flamurin e Shqipërisë si edhe me pikturën e tij.

Lëvizja Shqipëtare n'Amerikë filloi seriozisht në Maj, 1904, me ardhjen e Petro Nini Luarasit. Petrua ish "The Paul Revere" i Shqipëtarëvet, mbassi vinte në çdo vënd ku kish Shqipëtarë, dhe gjithëmonë predikonte partiotizmë. Ay ish një librari më dy këmbë, me xhepet mbushur plot pamfleta, revista dhe gazeta. Petron mundet gjithashstu t'a krahasojmë me Shën Janin, sepse pregatiti udhën e lëvizjes kombëtare për ata që ardhë pas tij. Dhe pas-ardhësit nuk vonuan. Në grupin e tyre bënin pjesë Sotir Peci, Fan Noli, Kristo Dako, Faik Konitza, Mihal Grameno, Kostë Çekrezi, Kristo Floqi, Bari Omari, Loni Kristo, dhe më së fundi, po jo i fundit në zotësi, djaloshi kavalier, Anton Frashëri.

Kollonia Shqipëtare e Natick-ut n'atë kohë ish një nga kollonitë më të mëdha dhe më aktive në Amerikë. Kjo kolloni pati ndihmë nga Kisha Protestane në Natick, e cila interesohej në Shqipëtarët dhe Shqipërinë, mbassi kish lidhje me shkollën Amerikane në Korçë që hapi Zoti dhe Zonja

lëshój release; make available
një farë-sój = njëfarësój
tjátrin = tjétrin

Kennedy, të cilët i ndihmonte me të holla. Kontrollorët e kishës në fjalë na lëshuan një dhomë ku mblidheshim çdo të Dielë mbrëma të dëgjonim Petro Ninin, Kristo Dakon dhe Fan Nolin, si edhe të tjerë folës. Kjo dhomë ish një farë-soj klubi për ne ku mund të takonim njeri tjatrin. Programi i çdo mbledhje ish ndarë më tri pjesë: një pjesë fetare, një tjatër politike dhe një pjesë shoqërore. Pas mbledhjes pinim nga një kafe dhe hanim nonjë "donut".

Prifti i kishës, Dr. Morris H. Turk, i donte Shqipëtarët. Së bashku me të shoqen, ay vizitoi Shqipërinë, dhe udhëtoi vëndin hipur mbi kalë. Gjatë vizitës, mori edhe shumë piktura. Kur u kthye në Amerikë, mbajti fjalime në shumë komunitete mbi Shqipërinë, dhe njëkohësisht rrëfeu edhe pikturat që kish marë atje; piktura të popullit si edhe të pamjeve natyrale. Dr. Turk e pëlqeu Shqipërinë fund e krye, me përjashtim të haneve, të cilët nuk i duronte dot. Preferonte më mirë të flinte përjashta se sa në han.

* * *

Kur dolli "Kombi" gazeta e parë Shqipëtare n'Amerikë më 1906, ne u hodhëm përpjetë nga gëzimi. "Kombin" e këndonin dhe e shijonin shumë veta, po pajtimtarët ishin të pakët. Brënda një vjeti gazeta u zu ngushtë nga financat, dhe hyri në borxh 485 dollare. Kjo i shtrëngoi Pecin dhe Nolin të vinin në Natick të kërkonin ndihmë. Më së fundi, Kristo Kirka, Andrea Pani, Kol Tromara, Ilo Tromara, Sotir Noke, Ilo Zdrulie dhe disa të tjerë nga grupi ynë mblodhë pa-

han inn
se sa than
këndój read; sing
zíhem ngúshtë I am in a tight spot
borxh debt
gjigánd gigantic
rrógë wage

ratë që nevojiteshin, dhe paguan borxhin. Kjo sumë duket fare e vogël sot, po n'atë kohë ish një sumë gjigande, kur marim parasysh rrogat shumë të vogla që mernin punëtorët.

Më 1909, "Kombi" pushoi së botuari, dhe vëndin e "Kombit" e zuri gazeta "Dielli", e cila botohej po në atë shtypëshkronjë, dhe me të njëjta shkronja që botohej "Kombi".

Tre veta përkujdesesheshin për botimin e "Kombit": Peci, Noli dhe një tjatër person i domosdoshmë, Efthim Natsi. Natsi bënte tre punë bashkë: radhite gazetën, bënte korrektimet dhe punonte shtypëshkronjën. Si kjo shtypëshkronjë s'kish gjëkundi, mbassi punohej me këmbë. Pikturo në mëndjen t'ënde këtë sqenë: Më të djathtë, Noli, i cili vinte kartën në shtypëshkronjën; në mes Thimaqi (Efthimi) i cili punonte shtypëshkronjën; dhe më të mëngjërt Peci, i cili kujdesej për gazetat që dilnin të shtypura. Ah, sa të lumtur ishim n'atë kohë. S'ka dyshim se kujtimi i asaj kohe gëzon zëmrën e njerit prej bashkëpunëtorëve të asaj "ortakërie" të famshme, që rron akoma.

Të 17 imigrantët e parë ishin tepër aktivë në lëvizjen kombëtare, dhe u bënë miq, pasonjës dhe bashkëpunëtorë të Sotir Pecit dhe Peshkop Nolit. Nga të gjithë imigrantët e parë, më i dëgjuari dhe më punëtor ish Hari Kaçka. N'ato vjetet e para, çdo mbledhje që bënin Shqipëtarët, si me karakter politik ose shoqëror, s'mund të quhej zyrtare ose authentike pa prezencën e Hari Kaçkës. Kur fliste Hari Kaçka të jepte ku-

shtypëshkrónjë = shtypshkrónjë printing press
përkujdésem am responsible for
i domosdóshëm indispensable
radhít set type
pikturój picture
t'ënde = tënde
kujdésem look after; care for
i shtýpur printed; compressed; oppressed
ortakërí partnership
pasónjës follower
më punëtór hardest worker

rajo dhe të bënte të qeshnje. Për çdo rast, ay kish gati nonjë ngjarje ose anekdotë të përshtatshme. Dhe s'kish shok në të rrëfyerit e ngjarjeve. Më 1940, në moshën 77 vjet, Hari Kaçka u largua nga rrëdhi ynë.

* * *

Kristo Dako, arësimtar, theollog, mësues, historian, botonjës, dhe editor i revistës, "Yll i Mëngjezit", ndonëse çalonte kur ecte, nga që ish sakat në këmbën e djathtë, ish njeri shumë energjetik, që s'dinte të lodhur. Dakoja mbante diplomë nga Oberlin Theological Seminary. Për hirin e Shqipërisë vinte nëpër kolexhe dhe kisha Protestane në shumë vënde të Amerikës, dhe mbante fjalime mbi çështjen kombëtare. Gjithashtu, vizitonte dhe në shumë raste banonte në shtëpi Amerikane. Kësisoj, Dakoja pati rast të fjalosej me Amerikanët nëpër shtëpi, kisha dhe kollexhe, dhe t'i informonte ata mbi Shqipërinë dhe hallet e saj.

Propagandën mbi Shqipërinë e vazhdoj dhe me artikuj që shkruante për revistat e misinarëve Amerikanë. Kontributa e tij për përparimin e Shqipëtarëve ish më e madhe nga ç'pandehet. Por Dakon, si çdo veprë arti e vërtetë, duhet t'a studiosh që t'a çmosh, dhe, si arti i Englezëve, ka bukuri më tepër kur shikohet për së largu.

Zonja e tij, Sevastia Dako, dhe motra e saj, Parashqevi—që dihen më mirë me emrin Kirias—ishin të parat gra Shqipëtare me famë n'Amerikë. Të dyja studiuan dhe banuan në shtëpi

çalój limp
për hírin for the sake of
zgjerój expand
díje knowledge

Amerikane për shumë vjete, dhe mundën me këtë mënyrë të zgjeronin dijenin e tyre, dhe të informoheshin mbi shumë gjëra. Më vonë, të dy motrat u kthyen në Shqipëri, dhe me bashkëpunimin e Dakos, si edhe me përkrahjen financiale të fillanthropistit Charles R. Crane, prej Chicago, hapnë një shkollë Shqipëtaro-Amerikane në Tiranë.

Gjatë vjeteve 1886-1912, një periudhë prej 26 vjet, ne pamë me sytë t'onë një fenomenë ie cilën mund t'a karakterizojmë si çudi. Pamë transformimin e një populli të shtypur dhe një vëndi të këputur nga varfëria. Pamë Shqipëtarët të fitojnë lirinë e tyre! Pamë Shqipëtarët të bëjnë komb, dhe të themelojnë kishën e tyre autoqefale! I pamë të rrojnë të lirë për të parën herë në afro 500 vjet!

Prandaj, jemi mirënjohës ndaj imigrantëve të parë që hapnë udhën dhe na rrëfyen një jetë të re në një vënd të ri. Jemi mirënjohës ndaj udhëheqësve t'onë të cilët duall me një program të qartë, dhe na bindnë ne—djema të mallëngjyer dhe burra të përmalluar—se kishim një qëllim në jetë, e kësisoj na bënë të punonim me zëmër të gëzuar, katër mijë mila larg mëmëdheut. Me bashkëpunimin e mirë midis udhëheqësve dhe pasonjësve, mundëm të organizonim shoqëritë, "Mall i Mëmëdheut" dhe "Besa-Besën", të botonim "Kombin", dhe të themelonim Kishën Autoqefale Shqipëtare, gazetën "Dielli", dhe Federatën "Vatra." N'ato vjete njohëm gëzime të mëdha në një kohë të shkurtër; ishin vjetet më të lumtur që kemi rrojtur në jetën t'onë.

i këpútur broken; languishing
autoqefál self-governing
mirënjóhës appreciative; grateful
i përmallúar nostalgic
bésa-bésën pledge of honor

KAFENE "VATRA"

Një nga vëndet e këndëshme të Bostonit që s'dua t'a harroj, dhe që e kujtojnë me gëzim të gjithë ata fatmirë që e dinin këtë vënd, ish Kafene "Vatra". Drejtimi i kafenesë ish 65 Eliot Street, i cili sot dihet si Stuart Street. Pronari dhe manaxheri i kafenesë për një kohë të gjatë ish Goni Katundi.

Sikundër dihet, kafenea është një institutë e njohur në vëndet e Meslindjes. Në shtetet e Ballkanit dhe në Meslindje, burrat kalonin orë të gjata dhe të mërzitura në këto kafene të shëmtuara, duke biseduar dhe analizuar politikën, duke gatuar kompllota kundër qeverisë, ose duke lozur karta ose lodra të tjera, për të shkuar kohën.

Popujt që ardhë në Amerikë nga vëndet e lart-përmëndura, për ca kohë u përulën dhe u shtruan, po passi u orientuan në vëndin e ri, nisnë të themelonin edhe këtu institutat e tyre të shumë-çmuara, dhe veçanërisht kafenetë.

Sikundër meret me mënd nga emri, Kafene "Vatra", u emërua pas shoqërisë të famshme Shqipëtare, The Pan-Albanian Federation of America, "Vatra." Themeluar në Boston më 1912, "Vatra" ish destinuar të lironte Shqipërinë nga Turqia, dhe me ndihmën morale e të guximshme të Presidentit Woodrow Wilson, e shpëtoi atë shtet të vogël nga copëtimi prej fqinjëve, pas Luftës së Parë Botërore.

drejtím address; direction
pronár proprietor
kompllótë = komplót plot
lózur = lúajtur
përúl lower; humble
passí = pasí

Kjo kafene e famshme ish nga çdo pikëpamje si një vënd i shënjtë për Shqipëtarët patriotë, të cilët vinin në Boston nga të gjitha anët e New England-it, dhe shpesh herë, kur vëndi i lindjes ish në rrezik nga fqinjët, bashkonin fuqit' e tyre me Shqipëtarët e Bostonit për mbrojtjen e Shqipërisë.

Në periudhën e saj të florinjtë, "Vatra," ish një organizatë me më tepër se 80 degë, dhe shtrihej në shumë qytete dhe shtete. Prandaj, kur bëhej kuvëndi i përvitmë i Federatës—i cili shumë herë mbante dy javë — delegatët e shumtë që vinin nga degët e ndryshme i jepnin kuvëndit më tepër pamjen e një parliamenti kombëtar se sa të një kuvëndi të thjeshtë. Disa nga delegatët ngriheshin që nga Seattle, Washington, dhe Bisbee, Arizona, dhe vinin në Boston, që të mernin pjesë në kuvënd.

Dhe, natyrisht, qendra e delegatëve në Boston ish Kafene "Vatra". Pas bisedimevet që bënin në sesionet e kuvëndit gjatë ditës, delegatët vinin në kafene dhe vazhdonin atje argumentat e nxehta dhe bisedimet që nisnin në kuvënd. Populli i kafenesë kënaqej tepër me këto bisedime, të cilat vazhdonin vonë në orët e natës.

Në këto kuvënde delegatët mësuan regullat, ligjet dhe mënyrat parliamentare. Nga kjo praktikë përfituan shumë disa prej delegatëve të cilët u kthyen në Shqipëri dhe shërbyen si deputetë në Parliamentin e Tiranës.

Të vimë tani ne Goni, pronari i kafenesë në fjalë. Ky Shqipëtar patriot ish një nga imigrant-

copëtím dismemberment
dégë branch
i përvítëm = i përvítshëm annual
përfitój profit; gain
móshë age
vójti = vúajti

ët e parë që ardhë nga fshati i Katundit—ay fshat që njihet si origjina e pionerëve të parë Shqipëtarë në Amerikë. Në moshën e djalërisë, Goni vojti nga Turqit shpirt-keq dhe Grekët barbarë.

Goni, i cili ardhi në Amerikë më 1901, mbahet mënd gjithashtu si një nga pionerët e "West End-it"—ajo mëhallë historike e Bostonit, ku u grumbulluan dhe u strehuan me mijëra Shqipëtarë, si edhe të tjerë të huaj. Në West End, Goni u shoqërua me shumë burra Shqipëtarë, të cilët rronin tok nëpër konakë.

Goni ish burrë i qeshur, i dashur dhe popullor. Ish i drejtë, i besuar dhe, natyrisht, patriot. Kudo që vinte përhapte ndjenjat kombëtarë me enthusiazmën e një misionari fetar. Pas Luftës së Parë Botërore, kur Shpipëria mbeti shkretuar, dhe "Vatra" hapi fushatën e Huas Kombëtare, për $265,000, që të ndihmonte bashke-atdhetarët e mjeruar, Goni ish arkëtari i Federatës, dhe dha një kontributë të madhe për suksesin e fushatës.

Sot Goni ndodhet në Shqipëri, në fshatin e tij të dashur, Katundi. Atje, patrioti i vjetër rron një jetë private. Po në qoftë se e sjell rasti që t'i bjerë në dorë kjo librëzë, do të d'je se bashkëfshatarët, si edhe bashkë-atdhetarët e tij n'Amerikë, e përshëndoshin nga zëmra dhe e urojnë të rrojë i lumtur.

Një nga personat më të dëgjuar që na vjen ndër mënd kur kujtojmë Kafene "Vatra," është Kryepeshkop Fan S. Noli. Noli vinte shpesh herë në kafene, dhe posa hynte brënda miqtë dhe ad-

mëhállë neighborhood
konák small cooperative living group
i qéshur jovial
i besúar trustworthy
i shkretúar desolate
fushátë campaign; [illegible]e
húa loan
i mjerúar needy; wretched
arkëtár treasurer
në...rásti if it chances
líbrëzë booklet

mironjësit e tij grumbulloheshin rredh tij, aqë zell të madh kishin ta dëgjonin kur bisedonte mbi politikën, punët e kishës, ose letërsinë—mbi të cilën ligjëronte që nga koha e Omar Khayyamit dhe gjer ne Shakespeare. Shumë herë Noli recitonte pjesë të përkthimeve të tij poetike me famë, sidomos vjershën *Korbi*, prej Edgar Allan Poe.

Në lidhje me Kryepeshkop Nolin, vlen të përmëndet një ngjarje komike dhe sentimentale. Një ditë në kafene, disa burra po pinin kafe me qef, kur një prej tyre e pyet Fan Nolin, "Nga të kemi ty?" Menjëherë, Noli iu përgjegj, "Nga Katundi".

Tani, pothua se të gjithë sa ndodheshin atje e dinin nga vinte Fan Noli—e dinin që ish lindur në Thraqë—po megjithatë, e pranuan përgjigjen që ju dha, ndonëse pakë me hezitim dhe zili. Nuk e kundërshtuan se e dinin, jo vetëm që shumë prej pionerëve Shqipëtarë në Amerikë ishin prej Katundi, po edhe nga shkaku se këta kishin qënë "fqinjët", miqtë dhe mbrojtësit e Nolit, që në vjetet e para të imigracionit, si edhe passi u kthye nga Evropa më 1915. Noli, pra, ndofta me të qeshur, ndofta seriozisht, deshi me këtë mënyrë të çfaqte mirënjohjen e tij ndaj Katundllinjve për të gjitha të mirat që i kishin bërë.

Sikundër thotë një fjalë Shqip: "Gjuha vete ku dhëmb dhëmballa."

Kjo ngjarje më kujton gjithashtu dhe poetin e madh, Homer, për të cilin dikush ka shkruar:

"Homeri, gjallë, shtatë qytete bukë s'i dhanë:

zell zeal
hezitím hesitation
zilí envy
dhëmbállë molar

Homeri, vdekur, shtalë qytete hero e kanë."

Po kjo është e para herë, nga sa di unë, që një njeri i famshmë zgjodhi një fshat modest si të tinë, dhe me qënë se ky fshat është Katundi ynë, natyrisht, Katundi mburret me "birin" e saj të adoptuar, që ka marë famë an' e mbanë.

Në faqet e librit të historisë t'onë mësojmë se më 1906 ardhi në Boston, pa-pritur e pa ceremoni, një Shqipëtar që s'e dinte njeri—Sotir Peci nga Dardha. Personi në fjalë ardhi nga Greqia, dhe mbante diplomë nga shkolla Panepistimion të Athinës. Me fjalë të tjera, ish burri më i mësuar në mes t'onë.

Brënda disa javëve, Sotir Pecin e mbanin në gojë të gjithë, mbassi ay e bëri të mundur për anën t'onë të marë ofensivën në çështjen kombëtare. Me ardhjen e tij, pushuan menjëherë argumentat, grindjet dhe shamatat që bëheshin gjithënjë midis Shqipëtarëve dhe Grekomanëve. Mjaftonte të bisedonje me Pecin vetëm një herë që të shkatërronje argumentat e kundërshtarëve t'onë. Duke parë kështu, ata që na luftonin më parë se të vinte Peci, tani u hodhë nga ana jonë, sikur kishin frikë se mos mbeteshin prapa botës. Të tillë influencë kish ky burrë i urtë—Sotir Peci.

* * *

Po të vazhdojmë të këndojmë në librin e historisë t'onë, do të gjejmë edhe këtë shënim me rëndësi. Kur u vra Spiro Kosturi në Selenik të Greqisë të sotme, Shqipëtarët bënë një mbledhje

grîndje bickering
shamátë quarrel
plakós show up

të madhe në Boston, për të nderuar memorjen e martirit Shqipëtar, dhe për të protestuar vrasjen e tij. Shqipëtarët plakosnë nga të gjitha anët në këtë mbledhje, e cila ish një nga më të mëdhatë që u bënë n'atë kohë.

Nga Natick-u ardhi një delegacion prej 82 vetash, me një travaj të agazhuar posaçërisht për atë qëllim. Kur arrinë në Park Square, nisi të binte dëborë. Delegatët nisnë të marshonin dy nga dy në sallën e mbledhjes. Sotir Nokea, me flamurin e Amerikës në dorë, shkonte përpara. Pas flamurit të Amerikës dukej dhe një flamur vogëlush i Shqipërisë, që kish qëndisur Zonjusha Anna Howe, sipas flamurit në postalen e Princ Aladro Kastriotit. Zonjusha Howe jepte mësime në shkollën dielore të Kishës Protestane në Natick, ku shumë Shqipëtarë mësuan të shkruajnë dhe të këndojnë gjuhën Inglishte.

Sikundër dihet, lisat nga lëndet bëhen; ashtu edhe flamuri ynë, si një foshnjë që bën hapat e para, dukej sikur kërkonte këshilla dhe mbrojtje nga flamuri i Amerikës, nënë të cilin marshonte përmes udhëve të Boston-it, në paradën që u bë atë ditë. Kur pamë flamurin t'onë në paradë për të parën herë, na u rritnë shspresat shumë për një të ardhme më të mirë për Shqipërinë. Në sallën e mbledhjes në Washington Street, s'kish vënd ku të hidhnjë mollën, aga populli i madh. Të gjitha kollonitë u përfaqësuan në mbledhjen. Kryefolësi i ditës ish një Shqipëtar i ri nga Misiri, Fan Noli.

travaj = tramváj (mp.) trolley car
i agazhuar = i angazhuar (mp) engaged
posaçërísht especially
marshój march
vogëlúsh small
postále = kartëpostále postcard
shkóllë dielóre Sunday school
Inglishte = anglíshte
lënde acorn

Kur mbaroi Noli ligjëratën e tij mbi Spiro Kosturin, gjëndja e enthusiazmuar e brohoriti me një zë kaqë të fortë sa u tund binaja gjer në themeli. Kurrë në jetën t'ime s'kam parë një gjë t'atillë. Që prej asaj dite, Shqipëtarët e pasuan Nolin pa patur asnjë rezervim, shpresë-plotë se udhëheqësi i tyre nuk do të gabohej kurrë në asgjë; po edhe sikur të gabohej nonjë herë, përsëri ay ish udhëheqësi i tyre, dhe ata do t'a pasonin gjer në fund.

Gjithë atë ditë ngjau një tjatër gjë me rëndësi: u dërguan telegrame dhe kabllograme kombësive të mëdha, për të protestuar barbarizmat që po bëheshin në Shqipëri nga të huajt. Që atë ditë e tutje, Shqipëtarët e Amerikës ecën së bashku, nënë udhëheqjen e burrave të zotë.

Constantine A. Demo, The Albanians in America - the First Arrivals (In English and Albanian, Boston, Massachusetts, 1960, pp. 56-67, 69-74, 85-88.

gjëndje = gjéndje audience; situation
biná building
shprésë-plótë hopeful

NDRE MJEDA
(1866-1937)

Nuk është e lehtë vendosja e Mjedës në historinë e letërsisë shqipe. Ai krijimtarinë poetike e filon gati në një kohë me Naimin, të pakën me botimin e vet të parë (1887), dhe tematika e veprave të tij është ajo e rilindësve. Po me gjithë se veprat e tij më të rëndësishme, si pjesa më e madhe e vjershave të përmbledhjes «Juvenilia» dhe poemthi «Liria», u shkruan gjatë Rilindjes, ato u botuan pas vitit 1912, — e para më 1917 dhe poemthi shumë më vonë, më 1937. Sidoqoftë, ne po e vendosim Mjedën në ndarjen e madhe të letërsisë shqipe të Rilindjes, sepse me tematikën dhe frymën e saj, vepra e tij i përket asaj kohe. Mjeda është një ndër ata auktorë që bën kapërximin midis letërsisë së Rilindjes dhe asaj të kohës së pamvarësisë.

JETA

Ai lindi në Shkodër më 1866 të njëjtin vit kur lindi Çajupi dhe vdiq Zarishi, vit në të cilin gjuha dhe letërsia shqipe shënuan suksese të rëndësishme me botimet e De Radës, Kamardës, Kristoforidhit etj. Mjeda ishte bir i një lopçari të varfër të zbritur nga fshati. E ëma lante rroba nëpër botë me pagë. I vogli ishte izgjuar dhe jezuitët e futën në seminarin e tyre italisht të Shkodrës, ku përgatitnin kuadrot e tyre të ardhëme. Mjeda tregoi zotësi në shkollë dhe jezuitët e dërguan të ndjekë studimet e larta fetare në Spanjë, Poloni, Kroaci dhe Itali. Ky ndërrim vendesh gjatë periudhës së studimeve, e bëri të njohë një sërë gjuhësh

përmblédhje collected work; collection
lopçár cowheard
nëpër bótë for others
përgatít prepare

dhe të marrë një kulturë mjaft të gjerë klasike dhe moderne. Pasi fitoi doktoratën në filosofi e teologji, Mjeda dha mësim në një shkollë të lartë fetare në Itali. Po në këtë detyrë ai mik qëndroi më shumë se dy vjet, për arësye të mospajtimit të tij me vijën dhe metodat e urdhërit jezuit (1).. Njeri me karakter të fortë dhe me pikëpamje të gjera, Mjeda u padit nga kundërshtarët e tij si *«i keq»* dhe *«kokëfortë»* (2). Ahere poetin e shohim të lidhur me idetë dhe idealet e Rilindjes, që luftoheshin prej klerikëve katolikë të huaj në Shqipëri, si ç'ishin jezuitët. Më 1887, kur nuk është më shumë se 21 vjeç, Mjeda boton një nga krijimet e tij më të njohura, poemthin romantik «Vaji i bylbylit» (3). Vjersha frymëzohet nga dashuria dhe malli për atdhe, nga dëshira për ta parë atdheun të lirë. Janë temat më të zakonëshme të kohës që hasim te De Martino, — tek i cili Mjeda ka gjetur një ndër modelet e tij të para, — te Naimi, Shiroka, Gurakuqi etj.

I përjashtuar nga urdhëri jezuit, i rrethuar me shpifje dhe përbuzje, Mjeda u kthye në Atdhe, ku e emëruan famulltar nëpër fshatra të ndryshme të Shkodrës. Ai zhvilloi ahere një veprimtari të dukëshme patriotike dhe kulturale, dhe njohu nga afër jetën e shumëvuajtur të fshatarësisë. Më 1901, bashkë me të vëllanë, Lazër Mjedën, — edhe ky klerik, — poeti i ri themeloi shoqërinë kulturale «Agimi», e cila u bë rivale e shoqërisë tjetër kulturale të klerit katolik, «Bashkimi», që drejtonte Preng Doçi. «Agimi» krijoi një alfabet të vetin, edhe ky krejt latin, po që ndryshonte nga ai i «Bashkimit», sepse çdo tingulli i përgjigjej një shkronjë e vetme, si dhe në alfabetin e Stambollit. Shoqëria botoi edhe libra shkollore me këtë alfabet. Më 1902 Mjeda mori pjesë në Kongresin e orientalistëve, në Hamburg, ku paraqiti një disertacion mbi çështjen e qiellzore-

1) Li Shiqi, Poeti, patrioti dhe linguisti, Ndre Mjeda, rev. Letërsia jonë, gusht 1952, fq 61.

2) Nga artikulli i një prifti, kundërshtar i Mjedës, te rev. Albania 1902, fq 201.

3) Te përmbledhja me folklor dhe vjersha origjnale «Shahiri elierz», Shkodër, ku botonte disa poezi të vetat edhe Ndue Bytyçi.

mospajtím non-reconciliation
padít denounce
bylbýl = bilbíl
has encounter
i përjashtúar expelled
i dukëshëm = i dukshëm considerable; apparent.
i shumëvúajtur miserable; long-suffering
qiellzóre palate

ve të shqipes (4). Kur u kthye në Atdhe, ai u arrestua nga qeveritarët turq të Shkodrës dhe për pak desh e mërguan në Anadoll. Opinioni publik bëri që në krye të dhjetë ditëve të lirohet, kur ishte në frugën e mërgimit, në Tiranë. Poeti u padit se kishte shkruar për parinë e Mirditës një memorandum, që iu dorëzua konsujve të fuqive të mëdha në Shkodër. Për arrestimin e tij ndikoi edhe pjesëmarrja në kongresin e Hamburgut. Preng Doçi i gjeti rastin dhe e pushoi nga shërbimi si famulltar (5).

Mjeda nuk e rreshti veprimtarinë e tij letrare dhe patriotike. Bashkë me Anton Xanonin, tjetër lërues i zoti i gjuhës dhe letrar me aftësi, Mjeda hartoi libra këndimi për shkollat. Aty gjejmë edhe shkrime të tij, prozë e poezi, që e radhitin auktorin, bashkë me Xanonin, ndër themeluesit e një letërsie për fëmijë me vetitja artistike.

Si përfaqësues i shoqërisë «Agimi» dhe studiues i shqipes, Mjeda mori pjesë në Kongresin e Manastirit (1908), i cili u mblodh për të vendosur mbi një alfabet të përbashkët të gjuhës sonë. Poeti u zgjodh anëtar i komisionit që do të përpilonte alfabetin dhe mbrojti tezën e tij të njohur, — për çdo tingull një shkronjë. Në kongres fitoi teza e shoqërisë «Bashkimi», e përfaqësuar nga Fishta. Të dy poetët u hëngrën ahere midis tyre në Kongres. Kjo mosmarrëveshje pa dyshim ishte më e vjetër: ajo pasqyronte jo vetëm mosmarrëveshjet midis shoqërisë «Agimi» dhe «Bashkimi», për çështje të alfabetit dhe çështje të ndryshme kulturale, po grindje më të thella në gjirin e klerit katolik. Polemika midis poetëve dhe partizanëve të veprave të tyre do të ndizej sërish më vonë dhe do të vijonte edhe pasi ata të dy të kishin vdekur.

Më 1916-1917, kur u mblodh në Shkodër Komisia letrare, e cila u orvat të caktojë normat e shkrimit të shqipes në bazë të elbasanishtes, Mjeda mori pjesë në të bashkë me Gurakuqin, Fishtën etj. Më 1917 poeti botoi veprën e tij më të rëndësishme, përmbledhjen lirike «Juvenilia», e

4) «De pronunciatione palatalium in diversis albanicae linguae dialectis», në Aktet e Kongresit të orientalistëve, Hamburg 1904.
5) La nazione albanese, 21 ottobre 1902.

<u>për pak desh</u> almost
<u>në krye</u> by the ned of
<u>parí</u> elite
<u>rreshtój</u> arrest; halt
<u>lërúes</u> cultivator
<u>letrár</u> man of letters
<u>përpilój</u> draft
<u>u hëngrën (hahem)</u> quarreled
<u>mosmarrëvéshje</u> disagreement
<u>orvátem</u> attempt; try
<u>elbasaníshtë</u> dialect of Elbasan

cila bëri përshtypje, me idetë e përparuara patriotike-shoqërore dhe me vlerën e lartë artistike. Mjeda u afirmua kështu si një poet i shquar i kohës, po dhe u luftua nga rivalët e tij dhe përfaqësuesit e klerit reakcionar. Fishta, duke theksuar përtej masës anën melankolike të lirikave të para romantike të Mjedës dhe duke lënë në heshtje anën realiste shoqërore të poezisë së këtij, vuri në dyshim thellësinë dhe vlerën e talentit të Mjedës. Ai shkroi ahere se *«kjo melankoli nuk rrjedh gjithëmonë prej zemret aq sa prej mendet»* (6).

Në periudhën e ndërë të ndeshjes së forcave të brendëshme, në vitet 1920-1924, Mjeda mori pjesë në jetën politike të vendit. Ai u zgjodh në Shkodër deputet i Opozitës, d.m.th. i atij bloku rrymash politike ku mori pjesë edhe kleri katolik, kundër klikës feudale të Zogut dhe për një regjim demokratik. Mjeda mbrojti ahere interesat e popullit me fjalimet e tij në Kuvendin kombëtar (parlamenti).

Pasi dështoi revolucioni i qershorit dhe erdh në fuqi regjimi feudalo-borgjez i Zogut, Mjeda u tërhoq nga skena politike dhe shërbeu si famullitar i thjeshtë në Kukël, fshat i vogël pranë rrugës Shkodër-Lezhë, ku edhe sot kujtohet me nderim emri i tij. Këtu poeti qëndroi gjatë, duke u marrë me studime gjuhësore, veçanërisht me veprat e Budit e Bogdanit, si dhe me krijime letrare, me përpunimin e tyre, dhe me studime të historisë sonë të lashtë. Në vitet e fundit të jetës, jezuitët e morën si mësues në gjimnazin e tyre të Shkodrës. Me pasionin dhe aftësinë që e karakterizonte, Mjeda u mësoi nxënësve gjuhën dhe letërsinë amtare. Ai vazhdonte studimet gjuhësore dhe kishte letërkëmbim me albanologët më të njohur, si Norbert Jokl dhe Pedersen, — përpara tyre, edhe me G. Majerin, të cilit i pat kushtuar edhe një nga lirikat e tij më të bukura, vjershën «Gjuha shqype». Më 1934, Mjeda botoi në Shkodër broshurën «Vrejtje mbi artikujt e premna pronës të gjuhës shqype», studim që mbështetej veçanërisht në punimet e Pedersenit. Pak muaj para vdekjes u botua një nga veprat

6) Te gaz. Posta e Shqypënlës Shkodër 18 shkurt 1918.

përtéj	beyond	
rrjedh	derive; result	
i ndérë	tense	
dështój	fail; miscarry	
prémna =	përémra	pronouns
prónës =	pronárë	possessive

më të forta të tij, poemthi «Liria», që kishte qenë shkruar në prak të çlirimit nga turqit.

Mjeda vdiq në Shkodër më 1937, i përcjellur me nderime të veçanta prej rinisë përparimtare të qytetit, kundër orvatjeve të argjipeshkvit dhe të klerit reaksionar për të bërë një varrim të shpejtë dhe pa nderimet që i përkitnin patriotit, gjuhëtarit dhe poetit aq të shquar. Edhe pas vdekjes, nuk pushoi përçmimi që i bënte kleri reakcionar veprës dhe kujtimit të tij. Revista «Hylli i dritës» shkruante: *»Mjerisht, duhet me thanë se Mjeda ka shkrue pak, sa me mujtë me xane at vend aq të naltë nderimit, ku e kanë naltue dishepujt.»* (7)

Mjeda mbeti një fytyrë e madhe e letërsisë shqipe. Pas çlirimit vepra e tij u çmua në mënyrë të merituar dhe emri i tij u përmend si emër i një kleriku popullor. Në një takim të mbajtur në Shkodër më 14 shtator 1949, shoku Enver Hoxha ka thënë: *«Klerikët katolikë popullorë, që e kanë dashur popullin dhe i kanë shërbyer këtij, si ç'kanë qenë Dom Ndre Mjeda dhe të tjerë, kanë qenë neveritur, dënuar dhe persekutuar nga Vatikani dhe agjentët e tij».* Pas çlirimit, vepra e Mjedës u studiua, zuri një vend nderi në historinë e letërsisë shqipe, u ribotua dhe nisi të njihet nga masat e gjera.

PËRFUNDIM

Ndre Mjeda mbetet një nga figurat më të mëdha të letërsisë shqipe. Poezia e tij, me një përmbajtje të lartë ideore dhe artistike, me një realizim nga më të shquarit, ka një forcë edukative dhe estetike jo të zakonëshme. Mjeda eci në traditat e mëdha përparimtare të letërsisë shqipe dhe ndih-

7) Hylli i dritës 1939, fq 500. Revista, me rastin e vdekjes së poetit, kishte botuar dy vjet më parë një nekrolog të shkurtër e të thatë, të shkruar nga një klerik i çfardoshëm, me pseudonimin «Pof».

argjipéshk = arqipéshk archbishop
përçmím belittling
hyll = yll
Mjerísht...dishépujt Unfortunately, it must be said that Mjeda has written too little to occupy that position of high honor where his disciples have elevated him.
neverítur neglected; forsaken
ribotój reprint

moi shumë që këto tradita të shkojnë përpara. Ai thuase nuk u bëri ushëtimë në veprën e tij, ose u bëri shumë pak, ideve reakcionare që do të viheshin më se një herë në qendër të krijimtarisë së shumë shkrimtarëve të rrymës së klerit katolik të veriut, duke nisur nga vetë Fishta. Ai qe jo vetëm një shkrimtar patriot, po dhe me ideale të shëndosha demokratike, ideale të cilat nuk e shtynë të hymnizojë patriarkalizmin dhe feudalizmin, po përkundrazi, të kërkojë shembjen e tyre. Idetë dhe idealet e tij i kufizonte vetë fakti, që Mjeda ishte besimtar dhe klerik. Po gjithashtu, fakti se ai u ndenji besnik ideve demokratike, u tërhoq nga politika kur Zogu mori fuqinë më 1924, botoi para se të vdesi poemthin «Liria», ku shprehu në mënyrë më të qartë idealet patriotike dhe antifeudale të tij; fakti që ai e kaloi jetën në një farë mospajtimi, jo të njohur mirë prej nesh, me klerin katolik që e përbuzi ose dhe e ndoqi, duke u orvatur vazhdimisht, me gjallje të tij dhe pas vdekjes së poetit, që t'ia nënvleftësojë veprën; — gjithë këto tregojnë se Mjeda nuk u pajtua me veprimtarinë reakcionare dhe antipatriotike të një pjese të klerit katolik dhe të eprorëve të tij, të cilët mbështetën në Shqipëri politikën e imperialistëve austriakë dhe më pas të atyre italianë, dhe veçanërisht të fashizmit. Ndonse i pajisur me një kulturë të gjerë dhe me aftësi të mëdha, Mjeda nuk pati poste në hierarkinë kishëtare, po qe një famullitar ose një mësues i thjeshtë.

Talenti i Mjedës u çfaq sidomos në poezi. Ai shkroi shumë pak, për një jetë letrare prej plot një gjysëm shekulli. Mjeda me sa duket shkruante rrallë dhe nuk i leshonte lehtë nga dora krijimet e tij, po i punonte gjatë dhe me durim, me limë në dorë. Poet i shkëlqyer romantik në rininë e tij, ai, në prag të pleqërisë, e vaku frymëzimin, po artin e pati gjithë aq të sigurtë dhe kurdoherë në shërbim të çështjes së madhe patriotike. Kohë shumë i hëngërën përshtatjet ose përkthimet fetare në prozë, të cilat përbëjnë një vëllim të madh në krahasim me poezinë e tij. Shumë kohë ai e shpenzoi edhe për studimin e gjuhës dhe të auktorëve të vjetër të shqipes. Mjeda qe një poet i kur-

realizím achievement; realization

479

syer dhe koha që i morën punët e tjera nuk i vajti kot. Ai shkroi një prozë të ngjeshur e të pasur, dhe kontribuoi për njohjen e mësimin e shqipes.

Ndikimi i Mjedës, me gjithë luftën që u bë kundër veprës së tij, u duk në një pjesë të poetëve të veriut, po nuk mund të thuhet se vepra e tij pati një ndikim të madh. Ajo u popullarizua pak dhe zuri një vend të pamjaftueshëm në programet shkollore. Bie në sy fakti se, te «Shkrimtarët shqiptarë», Mjedës i epet një numur shumë i kufizuar faqesh dhe poeti përfaqësohet jo me gjërat më të bukura dhe më të forta të tij, po me 6 tingëllima nga «Lissus» e «Scodra» dhe me 7 strofa nga «Andrra e jetës». Ky ishte një nënçim flagrant.

Vendin e merituar në historinë e letërsisë shqipe dhe në studimet e saj, Mjeda e fitoi pas çlirimit. Vepra e tij u rrit në sy të lexuesve dhe fitoi ngaditë një çmim më të madh, me idetë dhe idealet e mëdha që atë e frymëzojnë, me formën e lartë artistike që është pajisur.

LEXIMI I GJASHTEDHJETETETE

Dhimitër S. Shuteriqi et al. (Eds.), Historia e letërsisë shqipe, II, Tiranë, 1959, pp. 393-4, 397-9, 428-30.

ushëtím = oshëtímë
hymnizój glorify; sing hymns to
shémbje overthrowing; demolition
eprór superior
i pajísur equipped; endowed
me sa dúket apparently
límë file
prag = prak
vak make tepid
shpenzój spend
i kursýer thrifty; meticulous

LUIGJ GURAKUQI (1879-1925)

Një ndër fytyrat më të shquara të lëvizjes sonë kombëtare, në fushën politike-shoqërore, ka qenë Luigj Gurakuqi. Ai u muar edhe me letërsinë, — si poet, publicist, kodifikues i parë i metrikës shqipe etj. U shqua dhe si orator.

Gurakuqi lindi në Shkodër. Mësimet e para dhe ato gjysëm të mesmo i bëri në shkollat italiane të qytetit e pastaj shkoi në Itali, ku mbaroi gjimnazin dhe vijoi studimet e larta të shkencave biologjike, të cilat nuk i kreu. Në Shëmitër Korone qe nxënës i De Radës. Për poetin e madh arbëresh, që i la një mbrecë të thellë e pa dyshim ndikoi mbi te, Gurakuqi ka shkruar: *«Kam pasë fatin me qenë afritë prej Plakut të nderuem Jeronim De Rada. Tue u gjetë përpara t'amblit këngëtar të «Milosaut», të «Skanderbeut të pafan», tue ndie qortimet e këshillat e tija, tue ndigjue zanin e tij të fikët, që bahej ma i plotë, e tue pa syt'e tij të mekun kah ndezeshin e shkëlzeshin, tue përmendë Shqipninë, unë, gjithë përmallue, nuk mujta me u ndalë pa lëshue, bashkë me dy pika loti, nji të puthun*

i pamjaftúeshëm inadequate
tingëllím sonnet; sound; noise
strófë stanza
nënçim = nënçmím (mp)
ngadítë day by day
çmim esteem
frymëzój inspire

të nxehtë mbi at dorë që punoi sa e sa për atdhe!»(3) Portret i gjallë i De Radës, parë nga një patriot i njomë, çast i mallëngjyeshëm, ku njohim Gurakuqin me tërë dufin që e karakterizonte për çështjen e çlirimit kombëtar.

36.— Luigj Gurakuqi, 1879-1925.

Shumë i ri, që kur ishte student, Gurakuqi bëri emër në shtypin shqiptar, si poet dhe publicist, nën pseudonimet Jakin Shkodra e Lek Gruda. Për veprimtarinë patriotike, gjykatorja turke e dënoi me burgim të përjetshëm në mungesë. Që më 1899, njëzet vjeç, ai ishte anëtar i shoqërisë «Bashkimi» të Shkodrës, themeluar atë vit. Në Itali e shohim të lidhë miqësi me arbëreshë të ndryshëm, veçanërisht me Sqiroin, për të cilin shkroi një parathënie të botimit të tretë të poemës më të çmuar të tij, «Mili e Haidhia» (1907).

Më 1908 Gurakuqi u kthye në Shqipëri, pas shpalljes së Hyrrjetit. Tani filloi për të veprimtaria e gjerë politike. Gurakuqi u bë shpejt një nga udhëheqësit kryesorë të lëvizjes kombëtare. Ai mori pjesë në Kongresin e Manastirit, ku përfaqësoi Shkodrën dhe arbëreshët e Italisë, qe drejtori i parë i Shkollës Normale të Elbasanit, lojti role të rëndësishme në kryengritjen e Malësisë së Madhe e të Ko-

3) L. Gurakuqi, Vjersha, Bari 1941, fq 8 (parathënie nga Gjikam).

metríkë poetry; metric
Shëmítër = Shën Dimitër
pásë = pásur
me qénë = të ísha
afrítë = áfër
të nderúem = të nderúar
túe u gjétë = dúke u gjétur
t'ámblit = t'ëmblit
i pafán unfortunate
túe ndíe = dúke ndjérë
qortím rebuke
túe ndigjúe = dúke dëgjúar
zánín = zërin
i fíkët faint
báhej = bëhej
ma = më
tue pa = dúke párë

sovës, qe dora e djathtë e Ismail Qemalit në tërë punën e tij më 1912 për shpalljen e pamvarësisë. Veprimtaria e Gurakuqit u rrit edhe më shumë pas krijimit të shtetit shqiptar. Minister në qeverinë e Vlorës, drejtor i arësimit në zonën e pushtimit austriak gjatë luftës botërore, iniziator i Komisisë letrare, Gurakuqi bëri një punë të çmueshme për çeljen e shkollave shqipe dhe për çështjen e gjuhës letrare. Më 1918, duke mos i gjykuar mirë rrethanat politike, ai mori pjesë në qeverinë e Durrsit dhe në delegacionin e saj pranë Konferencës së Paqës në Paris. Si deputet i Shkodrës, Gurakuqi ishte vazhdimisht në opozitë në vitet 1921-1923, kundër qeverive të Zogut e të feudalëve të tjerë. Ai luftoi ahere me forcë për krijimin dhe përforcimin e institucioneve shtetërore sipas shembëllës së demokracisë borgjeze; luftoi veçanërisht kundër orvatjeve të imperialistëve të huaj për të hedhur dorë mbi ekonominë shqiptare dhe për të ndikuar politikën e shtetit të ri shqiptar. I lidhur ngushtë me masat e gjera të popullit, Gurakuqi ishte ndër përfaqësuesit më përparimtarë të borgjezisë së vendit. Pas kundërrevolucionit të dhjetorit 1924 shkoi në Itali. Këtu, me komplicitetin e fashistëve italianë, Zogu shtiu njeri dhe e vrau në Bari, më 1925.

Gurakuqi nisi të duket në shtyp më 1898, nëntëmbëdhjetë vjeç djalë. Vjersha e tij e parë është përgjigja vjershës së Shirokës, «Dallëndyshe shko». Gjer më 1907, ai botoi një numur të kufizuar vjershash në fletoret e kohës. Pas atij viti, veprimtaria shumë e madhe politike nuk e lejoi më që të merret me poezinë. Vjershat e tij u mblodhën për herë të parë në një vëllim më 1941.

të mékun = të mékur moist
kah when; from; by
ndézeshin = ndízeshin
shkëlzéshin = shkëlqénin
túe përméndë = dúke përméndur
gjíthë përmallúe = krejt i përmallúar
mújta = múnda
me u ndálë = të ndalem
lëshúe = lëshúar
të púthun = të púthur

Rrahman Dedaj, Zogu dhe kulla, Prishtinë, 1972, pp. 73-76.

VASHA E LULEVE

Një ditë Vjosa e vogël e pyeti gjyshin:

— Ku i marrin lulet ngjyrat e tyre të bukura?

— Pyetje e vështirë — tha gjyshi.

— Ndoshta këtë e bën ndonjë piktor me brushën e tij magjike — filloi Vjosa.

— Jo! — foli gjyshi duke buzëqeshur.

— Ndoshta kur bie shi, bien edhe pika të ngjyrosura dhe i lënë ngjyrat e veta mbi lule — u mundua t'ja qëllojë Vjosa dhe e shikoi gjyshin.

Në atë çast, gjyshit ju kujtua përralla për Vashën e luleve dhe filloi:

— Ka jetuar njëherë një vashë dhe njerëzit e quanin Vasha e luleve. Vetulla e saj ishte ylberi më i bukur i ngjyrave. I kishte dhëmbët si gurëzit e bardhë të lumit. Goja e saj ishte si kuti magjike dhe pëshpëriste emrat dhe ngjyrat e luleve të bukura që i donin fë-

Kur vasha lëkund vetullat e saj të ylberta, erërat fryjnë nëpër botë dhe i ngjyrosin lulet në vend të vashës.

at = atë
i njómë youthful
duf fervor; passion
gjykatór court
në mungésë in absentia
shpállje promulgation
Hyrrjet reforms of the Young Turks
malèsí highland
çélje opening
shémbëllë = shémbull
shtíe hire; shoot
fletóre publication

Ndoshta një ditë, kur të gjithë fëmijët do t'i duan lulet si më parë, vasha e bukur përsëri do të dalë, tha gjyshi në fund të përrallës.

mijët. Vasha kishte gishtërinj të butë dhe secili prej tyre kishte nga një ngjyrë të këndshme. Ajo jetonte në një kasollë të ndërtuar prej fijeve të barit dhe fletëve të luleve.

Kësaj vashe të bukur njerëzit ja patën dhënë emrin Lule. Por, hyri në përrallë me emrin Vasha e luleve. Asokohe, lulet kishin vetëm një ngjyrë. Por fëmijët dëshironin që lulet t'i kenë të gjitha ngjyrat e gishtërinjve të vashës. Ajo e pranoi këtë dëshirë të fëmijëvëve tërë gëzim.

Prej atëherë, vasha e bukur filloi të vizitojë tëra kopshtijet e botës dhe t'u veshë luleve ngjyrën e gishtërinjve të saj. Kështu lulet muarën bukurinë e vashës. Fëmijët i donin më shumë lulet dhe në to i ngjyrosnin gishtërinjtë.

Por një ditë, ndodhi kjo para shumë e shumë vitesh, disa fëmijë filluan t'i këpusin lulet.

Vasha filloi të qajë. Lotët e saj patën rënë mbi fletët e luleve, dhe prej asaj kohe mbi to bie vesa.

Pas kësaj, vasha e hidhëruar iku.

Thuhet se ka tretur në një pyll të largët përtej shtatë bjeshkëve dhe deteve. Atje jeton në një shpellë dhe nuk del prej saj. Në atë vend jetuakan erërat e buta.

t'ja (=t'ia) qëllójë answer; hit the mark
ylbér rainbow
fíje blade
asokóhe in those days
këpús pick; break off
vésë dew
trétem wither away; shrivel up
shpéllë cave

LEXIMI I GJASHTEDHJETENENTE

M O L L E T

Ajo vinte më parë se i shoqi në barakë, vinte 15 minuta më parë, sepse objekti ku punonte ishte më pranë, kurse i shoqi punonte diçka më larg, në bazën e pregatitjes. Në atë kantier të largët vetëm ata të dy ishin familjarë. Aty u njohën, aty u martuan dhe ata të drejtorisë, nga që s'kishin dhomë të veçantë, u dhanë barakën e rojes që ish një katror i vogël dërrase katër me katër në të hyrë të kantierit. Pesëdhjetë metra më larg ishin tre kapanonë të mëdhenj, ku flinin punëtorët, menca dhe një barakë e gjërë, e ndarë trish. Njera pjesë ishte klubi, tjetra këndi i kuq, kurse kusuri ishin zyrat. Kantieri në përgjithësi ish i vogël. Punonin aty rreth dyqind e pesëdhjetë punëtorë. Dhe vendi ish i ashpër, i thatë e gjithë gurë. Në zyrat e drejtorisë kish shkresa e protokolle, plane e skica që vërtetonin të kundërtën e asaj që dukej me sy. Gjithë ajo ashpërsi, gjithë ata gurë shpejt do të ndryshoheshin. Planet e skicat e drejtorisë, po t'i shikoje, të habisnin. Dhe kjo habi kish nisur të bëhej realitet. Vepra po hidhte shtat. Objektet e veçanta, të lidhura me tubacione, kishin zënë gjithë buzën e malit dhe oxhaqet kishin nisur të rriteshin nga dita në ditë. Dhe punëtorët shkonin e vinin, me këmbë ose me kamionat e kantierit. Shkonin në mëngjes dhe ktheheshin në mbrëmje. Dhe ajo kthehej dhe përpiqej që për pesëmbëdhjetë minuta të bënte gati gjithçka, të rregullonte darkën, të shtronte tavolinën, sa më shumë që punonte, aq më shumë ndjente të rrahurat e zemrës, ndjente se po afrohej i shoqi. Ajo kish nisur të dallonte midis të ecu-

kantiér construction project
familjárë of a family; familiar
katrór square
kapánon shed; hanger
kusúr balance; remainder
skícë sketch
ashpërsí roughness
shtat body
tubaciónn pipe; conduit
oxhák chimney
të écurit walk

rit të njerëzve buzë barakës të ecurit e burrit të saj. Hapat e tij ishin të ngutur, të nxituar. Në ato çaste ajo kthente kokën nga dera, e cila u shty me forcë nga jashtë dhe u hap me vrull. Hyri ai, i lodhur, i djersitur. Hyri dhe u ul në karriken e tij dhe të dy, në heshtje, nisën të hanin darkën që ajo e kish bërë gati. Ajo herë pas here ngrinte kryet dhe vështronte të shoqin. Vështronte se si hante, pa ngritur kokën nga pjata, pa folur.

— Ç'ke? — e pyeti Bardha.

— Asgjë, — u përgjegj dhe ngriti kokën e vështroi Bardhën në sy. Ai u habit nga pyetja e së shoqes. Dhe aty për aty i erdhi inat. Kurse Bardhës i erdhi turp. Ajo, sa herë që binte çanga për mbarimin e punës ngutej më shumë se kushdo dhe ecte pothuaj më shpejt se të gjithë që të vinte sa më parë në shtëpi, të bënte sa më shpejt gjithçka gati, që, kur të vinte i shoqi, të kënaqej. Dhe ai vinte, hante dhe heshtëte. Ose fliste, tregonte ndonjë gjë që kish ndodhur në objektin ku punonte ai. Po të gjitha këto dhe heshtja e tij, dhe fjala e tij, bile dhe vështrimi i tij kishin diçka të ftohtë, të huaj, që Bardhën e prekte. Kohët e fundit edhe e shqetësonte. Ajo s'duroi dot më dhe e pyeti përsëri. Ai ngriti kokën e tha:

— Jam lodhur.

— Edhe unë jam e lodhur, — kundërshtoi Bardha.

— Atëhere flemë, — tha ai, pa e kuptuar të shoqen, dhe filloi të xhvishej. Dhe ajo u xhvesh. Ai iu afrua, i puthi supin dhe i përkëdheli flokët. Bardha u drodh.

Gjatë gjithë ditës së nesërme Bardha mendoi për të. Ajo sikur e kish mbi sup të puthurën e tij dhe dorën e tij të madhe e të ashpër sikur e kish mbi flokë, megjithatë ajo kish një brengë, e cila i shtohej sa herë që kapte me duar soletat për t'i vendosur mbi mur. Ajo e dinte që ato pregatiteshin më tej, në bazën e pregatitjes, dhe atje punonte ai vetë. Një natë më parë ai i kish folur asaj për soletat e reja. Ai i bënte, kjo i montonte. Të dy jetonin midis zhurmave të këtij transformimi, të dy po transformonin atë vend të thatë e të gërtë, kurse midis tyre diçka kish që nuk shkonte mirë. Ajo e dashuronte dhe për këtë gjë i vinte keq. Dhe ai, me sa dukej e donte. Dashuria e tyre kish nisur qysh kur u hapën themelet e objekteve. Atëhere ai fliste më shumë, kurse tashti heshtte. Kjo heshtje u bë e padurueshme për Bardhën.

Ra çanga dhe Bardha la veglat e punës, u la dhe rregulloi flokët.

— Prit, Bardha, se po vimë dhe ne, — i folën sho-

i ngútur urgent
çángë gong
mbarím end; finishing
ngútem feel pressed; hurry
xhvíshej = zhvíshej
e púthur kiss
solétë
montój mount

qet megjithëse ajo s'po ngutej për t'u nisur. Kur mbërritën në kantier, rreth e qark kish rënë nata. Dritat e kantierit ishin ndezur dhe vezullonin. Bardha hyri në barakën e saj dhe, me përtesë, bëri gati gjithçka. Ajo u habit kur vuri re se çdo gjë ishte mbaruar kurse ai s'po dukej: E lodhur, u ul në karriken ku rri zakonisht i shoqi dhe u ngrit e trembur sepse në çast diçka u rrukullis në dyshemenë prej dërrase të barakës. Bardha u qetësua dhe sytë i shkëlqyen. Tamam mu tek këmbët e saj kish qëndruar një kokërr mollë e madhe, e kuqe. Ajo pa me kujdes rreth e qark e dalloi një vend të hapur midis dërrasave të dyshemesë e faqes së barakës. Atë vrimë ajo e kish parë dhe herë të tjera, po këtë radhë i u duk e madhe. U ul pak, mori kokrrën e mollës dhe ndjeu t'i rrahë zemra. Në çast ajo dëgjoi dhe hapat e njohura. Një ngjyrë e purpurt ja mbushi fytyrën. U ngrit me rrënbim dhe u nis t'i hapë derën të shoqit dhe arriti më parë se ai tek porta dhe e hapi. Ai shtangu te pragu i derës.

— Ç'ke? — i tha Bardhës kur e pa aq të qeshur, aq të gëzuar dhe me një mollë të madhe në dorë. Për një çast ai s'qe më në gjendje të dallojë se kush ish më e kuqe, molla apo Bardha.

«Ç'ke?», kjo fjalë kaq e prerë dhe e papritur në atë çast e hutoi. Në fillim u trondit sikur t'i kishin hedhur një kovë me ujë të ftohtë, pastaj dalngadalë e mori veten, po atëhere nga fytyra e saj ishin tretur të gjitha, buzëqeshja, gëzimi dhe ngjyra e purpurt.

— Ç'ke? — përsëriti i shoqi, po këtë radhë me një ton më të butë e më të shtruar.

— Asgjë, — u përgjigj Bardha, — dola të të hap derën, i ndjeva hapat e tua dhe thashë të të hap derën.

Kur ajo mbaroi së folurl, burri ndjeu një rrënqethje t'i shkojë për trup dhe një peshë e rëndë sikur i ra mu në gjoks. Ai diçka kuptoi nga sjellja e tij, diçka që nuk shkon, dhe aty për aty u mundua të qeshë. Dhe këtë gjë u mundua ta bëjë për ta qetësuar atë.

— Paske blerë mollë? Sa mirë! Ku i bleve, Më ka marrë malli për një frutë. Këtej pemët piqen më vonë, — tha i shoqi.

— Pse, nuk e hodhe ti, nga vrima? — pyeti ajo më shumë me sytë e saj se sa me fjalë.

— Unë? Jo, tha prerë dhe ndjeu gjithë atë që kish ndjerë pak sekonda më parë, te pragu i derës kur e pa të shoqen aq të emocionuar, aq të skuqur.

— Si, kështu? — belbëzoi ajo dhe uli sytë. Kur ngri-

vezullój gleam
rrukullís roll
vrímë hole
i púrpurt crimson; purple
hutój stun
rrënqéthje shiver
gjoks chest
píqem ripen
belbëzój stammer

ti kokën ai s'ish më. Kish dalë si furtunë përjashta, kish parë në errësirë rreth e qark e, pasi s'kish diktuar asgjë, u kthye në dhomë i heshtur e i ngrysur.

— Kush e hodhi?

— Nuk e di, unë thashë se e hodhe ti, se në çast ndjeva dhe hapat e tua.

— Kush e hodhi? — pyeti ai përsëri.

Bardha nuk u përgjegj. Pas pak, duke vështruar të shoqin drejt e në sy, tha:

— Nuk e di. Për kokën tënde nuk e di.

Ai ja mori mollën nga dora dhe e flaku jashtë, në errësirë, pastaj mbylli derën dhe të dy, në heshtje, hëngrën darkë. Duke ngrënë bukë ai e vështroi disa herë të shoqen. Vetëm radhën e fundit ~~ai e~~ pa mirë, vuri re tiparet e saj, vetullat, ballin, flokët. Ai ndjeu dëshirë t'ia shikonte sytë, po ajo vazhdonte të hante pa e ngritur fare kokën.

furtúnë tempest
flak fling
tipár feature
pendúar sorry
sherr discord

* * *

Të nesërmen, Bardha i priti shoqet pa i thënë gjë ato. Dhe rrugën deri në kantier e bënë ngadalë, duke biseduar.

— Ti, Bardha, se ç'ke! — i tha një shoqe.

— Mos je penduar që u martove?

Bardha ngriti përnjëherë kokën dhe aty për aty iu përgjegj:

— Ç'flet budallallëqe! Unë e desha pa e mora, po të mos e doja, s'kisha pse ta merrja.

— Të mori ai ty, apo ti e more atë, e pyeti me të qeshur një tjetër.

— Të dy, u deshëm dhe u morëm, — tha prerë Bardha, — kush mund të të marrë sot po s'deshe?

Shoqet qeshën me seriozitetin që foli Bardha. Dhe ajo qeshi dhe u tregoi historinë e mollës. Atëhere ata u gajasën së qeshuri.

— Po ti pse s'e hëngre pa ardhur ai?

— Doja ta hanim bashkë.

— Pse hahet bashkë me burrin molla e sherrit?

Ata përsëri qeshën dhe filluan ta ngasin më shumë shoqen e tyre, po Bardha u mërzit nga shakatë.

— Natën e mirë, — u tha ajo kur arriti pranë barakës së saj.

— Natën e mirë, — i thanë ato dhe vazhduan rrugën duke biseduar.

— Mbase s'e do më ai, — tha njera.

— Pse, ç'dashka ai? Ku ka më të mirë se Bardha!

— E, s'i njeh burrat ti.

— Pse s'i njohkam? S'punojmë bashkë?

— Tjetër është të punosh me ta e tjetër është të jetosh. Bardha tashti po jeton me të. Kur punonin bashkë, pa u martuar, e tillë ishte Bardha? Kaq serioze?

— Jo, — kundërshtoi ajo që pretendonte se i njihte burrat.

— E, pra, ç'del nga kjo?

Vajza tjetër s'iu përgjegj, shtërngoi shallin e leshtë pas qafe dhe futi duart në xhepat e kominosheve.

— Nga kjo del e qartë një gjë, — vazhdoi po ajo, — që ne, shoqet e saja, duhet t'i qëndrojmë më afër Bardhës. Ajo ka nisur një jetë të re, dhe ne duhet ta ndihmojmë.

Duke biseduar, ato hynë në kantierin plot drita ku buçiste altoparlanti, pastaj u futën në kapanonin e tyre. Kurse Bardha, e cila kish kohë që kish hyrë në barakën e saj, kish filluar të pregatiste darkën. Duke ardhur vërdallë nëpër dhomë ajo vuri re se si u rrukullis përsëri një kokërr mollë, po aq e madhe dhe e kuqe sa e para. E pa dhe u zbeh. U zverdh dhe shtangu. Molla qëndroi pranë këmbëve të saj dhe ajo s'guxoi të lëviste. Në qetësinë e plotë të mbrëmjes së thellë ajo priste me ankth të dëgjonte hapat e njohura të të shoqit. Oh, kurrë s'i kish pritur ajo me aq ankth ato hapa të rënda e të nxituara që i afroheshin kasolles së saj, po përjashta asgjë s'lëviste. Vetëm era që kish nisur të fryjë me rrëmbim nga faqja e malit dhe që përplasej pas barakës. Dikush po afrohej drejt derës. Pas pak, dera u hap dhe ajo pa të shoqin.

— Ç'ke që je zverdhur? — pyeti ai dhe vuri re pranë këmbës së saj kokrrën e mollës, pastaj ngriti sytë dhe pa përsëri Bardhën që qe zverdhur fare. Fytyra e saj gjithnjë e qetë dhe e qeshur sikur kish ngrirë. Një zbehtësi e hollë i ish ndehur si pah në ballë e në faqe. Sytë e zez, gati të përlotur dukeshin edhe më të mëdhenj e më të bukur. Buzët e plota që dridheshin shprehnin një dëshpërim rrënqethës. Ata donin të flisnin, të thoshnin diçka, po një forcë e brendëshme, e fuqishme, që ish ndrydhur në gjoksin e njomë, e ndalonte. Pa marrë përgjigje ai doli përjashta, pa përsëri rreth e qark, po s'dalloi asgjë. U kthye, mbylli derën dhe u ul në karrike, pranë tavolinës, mori që përdhe mollën, e vendosi mbi tavolinë dhe i tha asaj të ulet.

shall shawl
kominóshe overalls
altoparlánt loudspeaker
vërdállë helter-skelter
zbéhem become pale
zvérdhem become white; become pale
rrëmbím force; fury
zbehtësí paleness; pallor
ndeh spread
pah dust
rrënqéthës tremulous

Bardha u ul, ndau gjellën, preu bukën dhe vështroi të shoqin. Sytë e saj tashti flisnin qartë: «Besomë, s'di asgjë, s'di kush e hedh këtë mollë, s'di dhe pse e hedh» dhe ai e vështroi gjatë e drejt' e në sy. «Ti s'di gjë? Po pse hidhet një kokërr mollë duhet ta dish. Kjo s'do shumë mend për t'u kuptuar, apo jo»? Dhe kështu, duke folur gjithsecili me veten e tij, hëngrën darkën, ranë e fjetën dhe u nisën të nesërmen për në punë.

«Do të ruaj sonte, — mendonte me vete Rustemi gjatë rrugës, — do të dal para saj, do të shpik një arësye për t'u larguar nga puna e do të fshihem. Do ta gjej se kush është ky maskara që na paska rënë në dashuri me time shoqe dhe e mban me mollë!»

Dhe ashtu bëri kur erdhi mbrëmja. Ruajti i fshehur deri sa erdhi koha që duhej të kthehej në shtëpi. Hyri brenda dhe gjeti gjithçka në rregull, tavolinën shtruar dhe gruan të qetë. Kështu vazhdoi dhe ruajti barakën disa net, deri sa u mërzit. Atëhere tha se s'bëri mirë që ruajti dhe vendosi të mos çante kokën më. Ka qenë ndonjë shaka, spjegoi me vete dhe hyri në shtëpi i sigurt. Dhe pas kaq ditësh hëngri darkë i qetë.

«Po kjo ç'ka»? pyeti veten Rustemi kur vuri re Bardhën pak të mërzitur. «Mos vallë ka kuptuar që e kam ruajtur? Po unë s'i kam rënë në sy fare?» Dhe aty për aty e pyeti:

— Më thuaj, ç'ke?

— U mërzita duke dëgjuar gjithnjë këtë pyetje.

— Ashtu?

— Po. Neve s'na mungon asgjë që të jemi të lumtur.

— I lumtur jam, — tha Rustemi duke ia prerë shkurt dhe i qetë filloi të hajë bukë.

Të nesërmen ai erdhi në shtëpi si zakonisht, 15-20 minuta pas kthimit të gruas dhe u çudit sa s'thuhet kur gjeti mbi tavolinën e bukës një kokërr mollë. Dhe u nevrikos sa s'bëhet me të shoqen, e cila këtë radhë ishte shumë e qetë. Ishte tamam gruaja e tij, Bardha e urtë dhe e gëzuar. Bardha e qeshur, me sytë e saj të zes e të gjallë, me trupin e saj të shkathët e të bukur. Tamam ajo Bardha që dikur ai luante mendsh për të. Rustemi u habit se qysh nga koha e martesës qëkur kishin marrë dhomën, s'e kish vënë re të shoqen si atë ditë. Ai shikonte me vëmendje herë atë, herë mollën e pjekur mbi tavolinë dhe, pa e kuptur, filloi të ndjejë një farë qetësie. Po, inati po i shkonte dalngadalë. Ata hëngrën bukë po

gjithsecíli each one
shpik invent
nevrikósem get nervous
qëkúr since
i pjékur ripe
e kuptur = e kuptúar (mp)

mollën nuk e ngarë. Ai u ngrit i qetë, mori mollën dhe e hodhi përjashta.

Po të nesërmen ai gjeti në shtëpi, mbi tavolinë, një kokërr mollë tjetër dhe pa dashur vuri buzën në gaz. Dhe Bardha qeshi. Të dy qeshën dhe u shikuan sy në sy e u puthën gjatë e me mall.

— O, — rënkoi Bardha, — sa më paska marrë malli!

Ai e mbuloi me të puthura e me përkëdhelje. Pastaj e largoi pak dhe e vështroi e iu duk gruaja më e bukur që kish parë në jetën e tij.

U ulën dhe hëngrën gjithçka dhe mollën e hëngrën dhe përsëri u puthën e u përqafuan si natën e parë të dashurisë.

* * *

Në mëngjes u nisën për në punë. Ai e përcolli deri pranë objektit dhe që të mos vonohej vetë i ra për shkurt përmes arave tërë baltë.

— Ç'e gjeti sot që të përcolli? — e pyetën shoqet Bardhën.

— Grua më ka, pse të mos më përcjellë?

— M'u duk sikur të kish dashnore, — u hodh dhe thumboi njera.

— Siç duket do të kesh kohë që s'të kanë futur mollë në kasolle, — e ngau një tjetër.

— Mbrëmë kishim mollë dhe e hëngrëm, — u përgjegj Bardha duke qeshur.

— Ju bëftë mirë, — tha një grua.

— Unë do të pëlcas gjer sa ta gjej se kush është ky dashnor kaq romantik që s'iu dhimskan moliët!

Në darkë, kur u ktnyen, shoqet i thanë natën e mirë Bardhës dhe i u lutën që ta sillte në punë të nesërmen kokrrën e mollës.

— E duam për ekspertizë, për të gjetur gjurmat e gishtrinjve, — u tall teknikja.

— Natën e mirë, — u tha Bardha dhe hyri në barakën e saj.

Bëri gati gjithçka dhe u ul. Përjashta era frynte e ftohtë. Vjeshta kish dalë atë javë. Në majën e malit kish rënë dëbora e parë. Bardha u ngrit dhe futi dru të tjera në sobë.

«Ftohtë», — tha ajo me vete dhe hodhi mbi shpinë një shall të leshtë. Si u mbështoll mirë, ndjeu se dikush kaloi. Ajo u ngrit të shohë në dritare, po s'pa gjë. Kur u

dashnóre mistress
thumbój goad
ju bëftë mírë "bon appetit"
që s'iu dhímskan móllët that it doesn't bother him to sacrifice apples
sóbë stove
mbështjéll wrap up

kthye nga dritarja, pa në dysheme kokrrën e mollës. Dhe i erdhi keq. Gjithë gëzimi i saj sikur u ftoh, sikur u rrudh e u mblodh një dorë, një shuk, sa ajo kokrra e mollës, që mund të ish mbase e fundit. Bardha u ul e ngriti nga dyshemeja dhe filloi ta shikojë me kujdes. Kokrra e mollës kish nisur të vyshkej. Ajo e fërkoi me gishtrinjtë e saj dhe i erdhi keq. Pastaj e fshiu me përparse, e fërkoi, e lau dhe u kënaq kur e pa të shkëlqejë. Atëhere e vuri mbi tavolinë.

Pas pak erdhi i shoqi. Bardha u ngrit, ja hoqi xhupin, i shtiu ujë për të larë duart dhe, të zënë dorë për dore, u ulën për të ngrënë.

— Paskemi mollë, sonte, — tha ai duke buzëqeshur dhe zgjati dorën, e mori dhe e pa.

Bardha u drodh dhe ndjeu t'i njomen sytë. U ngrit nga vendi nga që s'iu durua dhe e puthi të shoqin.

— Bardha ç'ke kështu, ç'është me ty?

— Unë pata frikë, pata shumë frikë se mos ti u ftohe prej meje pas martesës, ti ndryshove shumë. Tashti po, tashti je ai që unë dashurova. Tashti ti ke besim tek unë. Pandeha se mos dashurisë sonë i erdhi fundi.

— Çudi! E si filloi të të mbushej mendja ty për këtë gjë?

— Ja, nga qëndrimi yt karshi meje dhe për shkak të mollëve.

— Mollëve? — tha Rustemi dhe e vështroi me kujdes mollën që kish në dorë. — Po. — vazhdoi ai, — mollët më tronditën, — tha, dhe heshti.

— Hamë, se po ftohet gjella, — tha Bardha.

— Hamë, — tha Rustemi.

Dhe në fund morën kokrrën e mollës.

— Paska filluar të vyshket, siç duket do të jetë molla e fundit.

— Mbase, tashti s'kanë më rëndësi mollët.

— S'kanë, — tha Rustemi, dhe mori thikën.

— Mos e pre, — i u lut Bardha. — Mbrëmë ma kërkuan shoqet,

— Ato mbase kanë qeshur.

— Jo, ma kërkuan seriozisht,

— Mirë, tha ai dhe la thikën mënjanë.

* * *

— Qënka shumë e shijshme! — tha teknikja duke përtypur kafshatën e mollës.

rrudh shrink; reduce
vyshkem shrivel up; fade
përpárse apron
xhup heavy sweater
njom make wet
kárshi toward
thíkë knife
përtýp chew
kafshátë bite

— S'kam ngrënë ndonjëherë mollë kaq të butë! — tha tjetra po duke përtypur.

— Dale, moj, e kam radhën unë, jam më e madhe se ty, — foli ajo që pretendonte se i njihte burrat dhe ja nguli dhëmbët mollës, dhe filloi të përtypej e të përplaste buzët. — Vërtet qenka mollë e mirë e ëmbël dhe e thartë, e butë, e shijshme dhe e bukur, tamam si dashuria.

Bardha shikonte shoqet e saj që përtypeshin, që qeshnin, që bënin shaka dhe i vinte të hidhej e t'i përqafonte të gjitha.

— Tashti e kam radhën unë, — tha ekspertja dhe e kqyri mirë e mirë. — Ka shumë njolla gishtash, u përzien shumë duar në këtë punë, — dhe e kafshoi, e përtypi, mori frymë dhe vazhdoi: — nga të ngrënët duket si mollë Korçe. Dashnori yt i dytë, dashnori romantik i përvëluar nga afshi i dashurisë duhet të jetë pe Korçe.

— Bravo, — thirrën të tjerat dhe përplasën duart.

— Mos e tepëro, — tha Bardha serioze.

— Pse, moj, të ardhka keq?

— Keq, jo, po se si më vjen. Ju e dini, unë vuajta shumë për shkak të këtyre mollëve, vuajta, po më në fund e rifitova atë që s'doja ta humbisja, besimin. Kjo mollë e bëri punën e saj.

Dhimitër Xhuvani, «Mollët,» Nëndori, No. 10 (October), 1970, pp. 178-186.

përplás	smack; clash
i thártë	tart
kqyr	examine
njóllë	stain
i përvëlúar	scorched
tepërój	exaggerate
rifitój	regain

LEXIMI I SHTATEDHJETE

Temo Mandili, Nga Butrinti në majën e Korabit, Tiranë, 1968, pp. 23-30.

NË RIVIERËN E VENDIT TONE

Në mëngjezin e freskët, të 1 qershorit të vitit 1965, Tiranën e mbulonte një shtresë e dendur mjegulle, e cila deri në një farë shkalle e ngadalësonte zgjimin e qytetit. Zakonisht, në agim, njeriu e fillon ditën e re me optimizëm, pa luftë ndjenjash e mendimesh, por ne ishim akoma më optimistë e më të gëzueshëm sepse do të shkonim në jugun tonë, në bregdetin e tij të këndshëm, në ambientin e të cilit gjithnjë ke dëshirë të qëndrosh sa më gjatë.

Makina u nis në orën e caktuar dhe motori i i saj filloi zhurmën monotone që do të shoqëronte gjithë ditën udhëtarët e këtij udhëtimi relativisht të gjatë, që fillonte në gjërësinë gjeografike veriore 41 gradë e do të mbaronte në paralelin 39 gradë të vendit tonë.

Së bashku me studentin që merrte pjesë në vrojtimet e kësaj radhe, arritëm në Sarandë aty nga ora tetë e mbrëmjes atëherë kur në sipërfaqen e detit nuk dallohej asnjë kolorit, pasi drita e diellit që krijon ngjyrën e tij blu, tashmë prekte vetëm shtresat e larta atmosferike. Kur u ndodhëm në rrugët e këtij qyteti piktoresk e të pastër e ndjemë veten të rrethuar nga një ajër i freskët e përkëdhelës që të lehtëson e të lodh ashtu sikurse

ngadalësój slow down
sa më gjátë as long as possible
gjërësí gjeografíke latitude
vrojtím observation
dallóhem distinguish
tashmë now
ájër air

të lehtëson një melodi e ëmbël muzikore pas një pune të gjatë e të lodhshme.

Të nesërmen, më 2 qershor, filluam nga puna herët në mëngjez, pasi në këtë periudhë, në gjerësitë gjeografike të vendit tonë, drita e lehtë e agimit fillon të zbardhojë anën lindore të kupës qiellore aty nga ora tre e gjysmë dhe dielli lind rreth orës katër e gjysmë.

Në planin e vrojtimeve tona përfshihen matje mbi rrezet diellore, mbi lagështinë e temperaturën e ajrit, mbi temperaturën e ujit të bregdetit në këto zona, që kanë klimën më të butë e më me pandryshime ditore dhe stinore të gjithë territorit të Shqipërisë.

Bregdeti i Sarandës shtrihet në gjerësinë më jugore të vendit tonë ku ndikimi i detit të ngrohtë Jonian dhe i erërave të nxehta të Afrikës Veriore i japin klimës së tij një shkallë butësie të atillë që nuk e gjen në rajone të tjera detare të vendosura në të njëjtën paralel me të.

Temperatura mesatare shumë vjeçare e janarit, muajit më të ftohtë në vendin tonë, këtu arrin rreth plus 11°C, ndërsa në Durrës kjo temperaturë është + 8°C, në Tiranë + 7°C dhe në Korçë rreth + 1°C. Në këtë zonë bregdetare temperatura më e ulët gjatë këtyre 30 vjetëve të fundit nuk ka zbritur nën vleftën minus 1,5° C, kurse njëkohësisht kjo temperaturë në Vlorë ka arritur vleftën — 7°C, në Durrës — 7,4°C dhe në Fier 13°C.

Bregdeti i Sarandës me klimën e tij tipike mesdhetare-subtropikale, bën pjesë në ato zona të vendit tonë me shira vjetore relativisht të pasura, sasia e të cilave lëkundet rreth vlerës mesatare prej 1450 mm, ndërsa në Vlorë shuma e reshjeve vjetore është rreth 1000 mm. dhe në Durrës rreth 997 mm. Por këto shira kanë një shpërndarje shumë heterogjene, akoma më të çrregullt se sa në çdo rajon tjetër të territorit të Shqipërisë.

Në Sarandë muaji më i pasur me shi është janari me një vleftë mesatare rreth 210 mm., kurse në korrik këtu mesatarisht bie vetëm 5 mm. Gjatë dimrit në këto krahina kemi mesatarisht 592 mm.

kúpë dome
mátje measurement
lagështí humidity
stinóre seasonal
fajón region
detár littoral; oceanic
shúmë sum
rréshje rainfall

shi, në pranverë 239 mm. në verë 54 mm. dhe në vjeshtë 568 mm. Thatësia e theksuar, sidomos në muajin korrik, lidhet me anticiklonin e Azoreve, që mbisundon në këto gjërësi gjeografike gjatë tërë stinës së ngrohtë. Megjithatë, në sajë të ndikimit freskues të detit, temperatura mesatare maksimale prej 27°C, e muajit korrik, në Sarandë rezulton më e vogël se ajo e Shkodrës kur arrin vleftën rreth 31°C.

Gjatë muajve të verës, klima e nxehtë e këtyre anëve zbutet nga erërat flladitëse që vijnë prej detit e që fryjnë pothuajse me ritëm të rregullt e të vazhdueshëm. Duke filluar aty nga ora 10 e paraditës deri në ora 16 pasdite atmosfera e Sarandës freskohet nga puhia detare, e quajtur prej vendasve maestral, e që fryn sidomos nga kuadranti jugperëndim i detit Jonian me një shpejtësi prej 4-5 metra në sekondë. Natën atmosfera e bregdetit përtëritet prej erërave që fryjnë nga lartësitë e maleve rrethonjëse. Këto male e ngushtojnë shumë horizontin e këtij qyteti bregdetar, që i shëmbëllen një maketi arkitekturial të mbyllur brenda një kutie të qendisur me ngjyra e konture artistike.

Lagështira ajrore e klimës së Sarandes paraqitet më e favorshme për organizmin e njeriut se sa ajo e bregdetit të Durrësit. Gjatë muajit korrik lagështira relative e ajrit në atmosferën e Sarandës lëkundet rreth vleftave mesatare 62%, në Durrës lagështira relative gjatë po këtij muaji arrin 69%, madhësi kjo që del jashtë intervalit 50-60%; që konsiderohet si intervali më i përshtatshëm për shëndetin e njerëzve. Një interes të veçantë për ne paraqiti matja e energjisë së rrezeve diellore në gjërësinë gjeografike më të ulët të vendit tonë. Për ta patur mundësinë e krahasimit, organizuam vrojtime të njëkohshme si në Sarandë ashtu dhe në Tiranë e Durrës. Nga kjo matje rezultoi se, në bregdetin e Sarandës, rrezet diellore në mesditë janë pak më të forta se sa në bregdetin e Durrësit dhe, kjo spjegohet me faktin se Saranda ndodhet më në jugë nga Durrësi dhe, si

thatësí drought
anticiklón high pressure area
mbisundój prevail
stínë season
freskúes cooling; refreshing
flladítës breezy
rítëm rhythm
paradíte morning; before noon
pasdíte afternoon
puhí breeze
jugperëndím southwest
përtërít revive
makét scale model

pasojë dielli atje ngrihet më lart në horizont e rrezet e tij bien më perpendikularisht mbi sipërfaqen e tokës.

Në përgjithësi në butësinë e klimës së rivierës sonë jugore një ndikim të theksuar ushtron deti Jon, i cili është më i ngrohtë se sa Adriatiku për arësye se ky i fundit rrihet më tepër nga erërat e ftohta që vijnë nga thellësia e Gadishullit Ballkanik ndërsa deti Jonian është i hapur për erërat e ngrohta që vijnë nga zonat e nxehta të Saharës.

Bregdeti i Jugut tonë, me ujrat e tij të pastërta e diellin e nxehtë, ajrin e këndshëm e tokën pjellore, i përket atij brezi të privilegjuar të klimës mesdhetare që me të drejtë është quajtur brezi i klimës së artë, zona e citruseve, e limonit, e palmës, e ullirit, zona e plazheve blu dhe e qyteteve të bardha. Në këtë klimë të artë, Saranda jonë është një margaritare e rrallë në rivierën e Jonit të kaltërt.

Mbaş vrojtimeve në bregdetin e Sarandës u nisëm për në Fermën bujqësore të Vrinës. Me instrumentat shkuam në qendrën e peshkimit të Manastirit prej nga do të lundronim për në Butrint, nëpër liqenin e Vivarit.

Në motoskaf ishin pasagjerë që kalonin për herë të parë në këto anë, ndërmjet nesh ndodheshin edhe miq të huaj që, para se të niseshin për në atdheun e tyre, kishin shfaqur dëshirë të vizitonin jugun tonë dhe, në mënyrë të posaçme, antikitetet e Butrintit.

Në orën 11 e 40', pikërisht në mesditën e vërtetë lokale të këtij meridiani, kur dielli arrezatonte sipërfaqen e liqenit nga pozicioni i tij më i lartë, prej 73 gradë mbi horizontin, motoskafi filloi të rrëshqasë mbi sipërfaqen e lëmuar të ujit. Ne soditnim në heshtje një tablo me ngjyra e veçori të jashtëzakonshme, admironim pamjet e mrekullueshme të këtij liqeni të ngrohtë e të qetë, nga brendësia e të cilit, herë pas here, kërcenin në ajër peshq të shëndritshëm, të shtyrë e të gjallëruar nga një forcë e madhe jetësore. Venedikasit e kanë quajtur këtë liqen «Vivar» që do të thotë «rezervuar jete» e

spegój = shpjegój explain
ushtrój exercise
pjellór productive; fertil
plazh beach

në të vërtetë këtu jeta shpërthen e buçet me tërë dinamizmin e saj të jashtëzakonshëm.

Malet e kodrinat, gjysmë të veshur, që rrethojnë nga të dy anët Vivarin, të krijojnë përshtypjen sikur ndodhesh mbi ujrat e një liqeni verior, në rilievin e alpeve, ndësa lejlekët që fluturojnë buzë këtij baseni natyral, të kthejnë përsëri në ambjentin e vendeve më të ngrota mesdhetare-subtropikale.

Udhëtimet e bukura gjithmonë i duken te shkurtëra njeriut dhe, në të tilla raste, të ngjan sikur koha e nxiton ecjen e saj të zakonshme. Pa e ndier bile edhe këtë ritëm të shpejtuar, të rrëmbyer nga poezia e rallë e këtij pejsazhi, pa pritur u ndodhëm para panoramës mahnitëse të kodrës së Butrintit në majën e të cilit ngrihet akropoli i këtij qyteti të lavdishëm, që shkëlqen si yll i ndritshëm në horizontet e botës antike.

Motoskafi u ndal në portin e vogël, buzë kanalit, që lidh liqenin me Jonin dhe ne zbritëm të prekur nga kjo natyrë me të vërtetë përrallore dhe nga aspekti imponues i kësaj qendre të qytetërimit antik që do të fillonte të na fiiste mbi historinë e jetës së tij, me anën e kryeveprave artistike që shekujt nuk mundën t'i hidhnin në humnerën e së kaluarës.

Arkeologu, që priti dhe shoqëroi vizitonjësit e huaj, na ndali para bustit të Perëndeshës së Butrintit. Pamja e ëmbël e kësaj fytyre ëndërronjëse, në të cilën skulptori i të kaluarës skaliti tiparet më të hijshme të bukurisë së gruas mesdhetare, zgjoi tek ne djenjën e adhurimit e respektimin e thellë për veprat e bukura të dorës së natyrës e të njeriut, si dhe krenarinë për atë kontribut të shquar që i kanë dhënë thesarit të kulturës botnore banorët e kësaj toke të begatshme.

Duke kaluar nëpër rrugën e monumenteve kryesore të qytetit dhe, duke admiruar arkitekturën e mrekullueshme të amfiteatrit, babtisterit, nekropolit dhe skulptorëve të pavdekshëm të muzeut dolëm në majën e Akropolit, prej nga njeriu mund të sodisë bukurinë magjepse të natyrës së Butrintit megjithë harmoninë e larmitë e saj të shumta.

margaritár pearl
peshkím fishing
lundrój sail
liqén lake
motoskáf motor boat
antikitét antiquity
rrëshqás glide
i lëmúar smooth
veçorí characteristic
i shëndrítshëm glistening
riliév terrain; relief
ndësá = ndërsá whereas
lejlék stork

Një zbulonjës i huaj, në kujtimet e tij mbi Butrintin shkruan:

«Këtu e butë është klima dhe, borë nuk bie kurrë; gjatë dimrave mantoja e bardhë duket vetëm mbi majat e maleve të largët. Pranvera mbulohet me të vërtetë nga ngjyra magjepëse e frymëzonjëse; pemët e lulëzuara; barërat me aromë, pyjet e dendura si në xhunglat e vërteta banohen nga zogj këngëtarë, ndërmjet të cilëve bilbilat zënë vendin e parë; agimet dhe muzgjet me ato kolorite që nuk i gjen në asnjë pikturë, netët e qarta me hënën gjysmë ëndërronjëse, sipërfaqja e ujrave të Jonit që së largu duket si pasqyrë me reflekse valore, më bëjnë që të harroj mallin për atdheun tim...»

E tillë ka qenë natyra e Butrintit për syrin e vizitonjësit të huaj, por në ditët e sotme këtij ambienti me aspekte përrallore i është shtuar dhe bukuria e punës heroike e njerëzve të lirë që, brenda një periudhe të shkurtër 20-vjeçare, thanë kënetat e moçalet, zhdukën kasollet prej balte dhe kashte të këtyre krahinave të mbuluara nga prapambetja shekullore.

pejsázh landscape
përrallór fabled
kryevépër masterwork
humnérë abyss
ëndërrónjës dreamlike
skalís sculpt
djénjën = ndjénjën (mp.)
adhurím adoration
thesár treasure
botnóre = botëróre world-wide
i begátshëm prosperous
babtisterí baptistery
i pavdékshëm immortal
magjépse magical
megjíthë withall
larmí diversity; variety

NAIM FRASHËRI
(1846-1900)



BAGËTI E BUJQËSIA

(Pjesë të zgjedhura)

I frymëzuar nga dashuria e zjarrtë për atdheun, Naimi i këndon plot mall dhe krenari kombëtare natyrës së mrekullueshme shqiptare, njerëzve të thjeshtë, barinjve dhe fshatarëve, që janë protagonistët e veprës dhe që ai i ngre lart si njerëz të punës.

Poema ngjall ndjenjën e patriotizmit dhe të respektit ndaj masave popullore. Por ajo heshtë për kontradiktat e ashpra klasore, për varfërinë e madhe dhe shtypjen që rëndonte mbi fshatarësinë: aty shprehet edhe botëkuptimi fetar i Naimit

O malet e Shqipërisë e ju o lisat e gjatë,
Fushat e gjera me lule, q'ju kam ndër ment dit' e natë,
Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt'e kulluar,
Çuka,[1] kodra, brinja,[2] gërxhe[3] dhe pyje të gjelbëruar,
Do të kendoj bagëtinë, që mbani ju e ushqeni:
O vëndëthit e bekuar, ju mendojen ma dëfreni.
Ti, Shqipëri, më ep nderë më ep emrin shqipëtar,
Zemërën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.[4]

1) Maja e një mall a e një bregu.
2) E përpjetë e vogël.
3) Vend shkëmb shkëmb me thepa.
4) Vini re me ç'forcë shprehet ndjenja e krenarisë kombëtare.

bagëtí livestock; sheep
fshatarësí peasantry
çúkë hill or mountain peak
brínjë small incline
ushqéj nourish; feed
vëndëthit = vénde
i bekúar blessed

a ime, ndonëse jam i mërguar,
kurrë zëmëra s'e ka harruar
n e s'ëmës qysh e le qengji kopenë,
i herë edhe ikën e merr dhenë;
in udhën njëzet a tridhjetë vetë
s'kthehet, po shkon në mes si shigjetë,
ime më le këtu, tek jam, mua,
me dëshirë aty ndër viset e tua.
ftohtë lhe fryn veriu në verë,
me gaz shumë dhe me bukuri e me erë
xhurasë,[6]) tek kullosin bagëtia
pi me zile, atje i kam mënt e mia.
qeshur edhe hëna e gëzuar,
nirësia në atë vend janë mbluar...
shat e malet, jashtë, jashtë nga qyteti,[7])
thash-e-themet, nga rrëmuja nga rrëmeti.[8])
lëza me gaz edhe zogu me dëshirë
eshur, bilbili me ëmbëlsirë.
fill, atje ma ka ënda të jem,
st edhe unë t'ja thërres këngës e t'ja them;
[9]) e shqerrat, deshtë, cjeptë, dhentë dhitë
uar, dhenë me lul'e me dritë.
sh' e bariut,[10]) që vjen me llërë përveshur,
fryer e me buzëzë të qeshur,
ndër duar të bukura si dhe vetë,
e shoh gazë,[12]) që s'e kam gjetur ndë jetë,
me këmborë, q'e ke manar,[14]) po të vjen pas

i bariut.
duke nde-
t për ba-

e në Sla-
e aparatit
perando-
antitezën.
ëzish.

10) Naimi u këndon njerëzve të thjeshtë të punës.
11) Sy.
12) Gëzim.
13) Thuhet për bagëtinë që ka një rreth të zi rreth syrit dhe njolla të zeza në turi.
14) Qengji i mësuar pas të zotit.

zëthin = zërin
blegëríj bleat
marr dhénë run off; race away
tremb frighten
tek where
mbij sprout; take root
xhurá shepherd's flute
mërzéj take a siesta; pass the heat of the day in the shade
cjap billy goat
mblúaj mill; generate
thash e théme = thashethéme gossip
rrëmújë chaos; tumult; confusion
rrëmét crowd
thëllëzë pheasant
qýqe cuckoo
ëndë desire
shpésë fowl
kédhër (kec) kid goats
desh (dash) rams
cjep (cjap) billy goats
i dëfrýer cheerful; amused
sýthit = syrit
sysk spotted livestock
manár pet lamb

Dhe qeni me bes' i larmë [15]) të ndjek me dëshir' e me gas;
Dashç Perëndinë, pa më thua, a mos na pe bagëtinë?
— Pash' atje pas më të gdhirë... ja atje përtej tek vijnë!
O sa bukuri ka tufa! sa gaz bie bagëtia!
Vijnë posi blet' e plotë, i bekoftë Perëndia!
Nëpër shesh e ndër bregore janë përhapurë shqerrat
E kecërit nëpër rripat dhe në gjethet e në ferrat!
Sa me vrap e me gaz bredhin edhe lozin shoku me shok.
Aty përhapenë me nxit, aty mblidhenë prapë tok;
Edhe prapë tufë-tufë përhapenë duke bredhur.
Duke ikur me vrap shumë, duke lojtur duke bredhur,
Nxitojn' e s'lodhenë kurrë dhe kur i merr uria.
Secili futet në tufë, suletë te mëmë e tija.
Posa gjen mëmën e dashur dhe me vrap i hyn në gji,
Rri më gjunjë dhe zë sisën dhe qumështin e ëmbël pi;
Pa e ëma me mall shumë, ndo dhi qoftë e ndo dele,
Birë e vetëm merr në gji me gaz e me përkëdhele...
Sa më pëlqen blegërima. zër' i ëmbël'i bagëtisë,
Qëngji edhe kec' i bukur që rri në gjunj' e pi sisë!
Përhapurë bagëtia nëpër shesh, nëper brinja
Ndër lajthi, e nëpër dushnja [16]) ndër murriza, [17]) në dë-
llinja; [18])
Bien zilet e këmborët dhe fyelli e xhuraja,
Dheu bleron e gjelbërojnë fusha, male, brigje, maja
Edhe gjithë gjë e gjallë ndjen në zëmër një dëshirë,
Një gaz t'ëmbël e të shumë, o sa bukur e sa mirë!
Pelën e ndjek mëz'i [19]) bukur, lopës i vete viçi pas,
Dallëndyshja punëtore bën folenë me të madh gaz;
Ogiçi [20]) ikën përpara, i bie tufës në ballë
Me zëmër të çelur shumë vete si trimi me pallë...
Qielli sa ësht'i i kthjellët e sa është zbukuruar!
E dielli sa ndrin bukur mbi lulet të lulëzuar!...
Çdo lulezë ka më vete një emër' e një fytyrë,
Një bukuri, një mirësi. një shtat. nj'erë e një ngjyrë;
Si dhe çdo dru e çdo pemë edhe çdo bar e çdo fletë
Sa ësht' e bukur faq'e dheut! s'të zë syri gjë të metë!

zbulónjës discoverer
mantó coat; mantle
frymëzónjës inspiring
valóre wavy
kënétë swamp
moçál marsh
káshtë straw

15) Lara-lara.
16) Dushqe të vegjël.
17) Lloj shkurresh me gjemba.
18) Dru i vogël me kokrra të zeza si në ngjyrë të vjollcës.
19) I vogli i pelës.
20) Dashi me këmborë që i prin kopesë.

...O malet e Shqipërisë, që mbani kryet përpjetë,
Tmerr e frikë përhapni, përpini qiejt e retë!
Të patundurë për jetë jini, pa kur oshëtini,
Udhëtarët në zemër frikë të madhe i vini;
Kini shkëmbenj, gërxhe, lisa, lumenj dhe dëborë ndë gji,
Përsipër lulez e gjethe dhe brenda ergjënd e flori.
E ju fusha bukuroshe edhe të majm' e pëllore...
Ju sheshet e lulëzuar, ju bregore gjelbërore...
Zemrën e varfërë time aty ndë ju e kam mbuluar,
Tek buron nga gjithi juaj uj'i i ftoht' e i kulluar;
Jam larg jush i dëshiruar edhe s'e duroj dot mallë,
Po s'e di, si dua unë, do t'ju shoh një herë vallë?!
Të paskësha vrapn'e veriut, të kisha krahë pëllumbi,
Nxitimn' e lumit me valë, që ikën me vërtik [21]) si plumbi,
E të vinja në gjit tuaj një ujë të ftohtë të pinja,
Edhe nëpër ato hije një copëherë të rrinja.
Syt' e ballit t'i zbavitnje, zemërënë të dëfrenje,
Gazë, që paçë një herë, prapë aty, ndër ju ta gjenje.
Opopol kshu [22]) pse më vini përpara syve pa pushim
O ditët e djalërisë, o moj kohëz e të rit tim! [23])
O flutura krahëshkruar, që fluturon nëpër erë,
As merr dhe zemrënë time me vet'hezë dhe ma shpjerë
Ndër malet e Shqipërisë, tek kullosin bagëtia,
Tek i fryn bariu xhurasë tek më rrinë ment' e mia

i lármë spotted
gaz = gas
dashç = të dúash
rrip slope
lózin = luajnë
tok together
bredh roam; frolic
sísë udder; breast
ndo whether
bírë = bir
blegërîm bleating
lajthí hazelnut
dúshnja (dushq) little oaks
murríz hawthorn
dëllínjë juniper
pélë mare
mez colt
lópë cow
viç calf
ogíç ram that leads the flock
i bíe túfës në bállë goes to the head of the flock
ndrin = ndrit
i métë defective

Naim Frashëri, «Bagëti e bujqësia,»
Antologjia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1972,
pp. 29-32.

njësím unification
i njësúar unified
etápë phase
përbëj represent; comprise

ANASTAS DODI

«DREJTSHKRIMI I GJUHËS SHQIPE» SI TREGUES I NJËSIMIT TË NORMËS SË GJUHËS LETRARE KOMBËTARE

Botimi i «Drejtshkrimit të gjuhës shqipe» u prit me gëzim dhe interesim të veçantë nga opinioni ynë shoqëror. Ai shënon një ngjarje me rëndësi për historinë e gjuhës dhe të kulturës sonë kombëtare. Për herë të parë në historinë e saj shqipja ka një drejtshkrim të njësuar, gjë që tregon se dhe gjuha letrare kombëtare është njësuar, normat e saj themelore janë kristalizuar. Prandaj «Drejtshkrimi i gjuhës shqipe» ka rëndësi jo vetëm si kodifikimi më i plotë i rregullave të shqipes letrare të shkruar, por, në radhë të parë, si tregues i një etape të re në formimin e gjuhës sonë letrare.

Gjuha jonë letrare kombëtare e njësuar u formua në kushtet e favorshme të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Ajo përbën një fitore të madhe të popullit tonë, që u arrit në vitet e pushtetit popullor, me kujdesin e vazhdueshëm të Partisë.

Botimi i «Drejtshkrimit të gjuhës shqipe» shënon përfundimin e një periudhe të tërë historike të popullit tonë për një gjuhë letrare e për një drejtshkrim të një-

suar për gjithë kombin. Përpjekja për një drejtshkrim të përbashkët është pjesë përbërëse e luftës për njësimin e gjuhës së shkruar, dhe për njësimin e gjuhës sonë letrare në përgjithësi.

Breza të tërë shkrimtarësh, gjuhëtarësh, publicistësh e arsimtarësh kanë punuar për ta ruajtur të pastër, për ta pasuruar dhe për ta lëvruar gjuhën amtare si një nga tiparet themelore të kombit dhe si një thesar të çmuar të tij. Forcat përparimtare e patriotët e flaktë janë përpjekur që ta bëjnë gjuhën shqipe një armë që t'i shërbejë ngritjes së ndërgjegjes dhe krenarisë kombëtare. Në periudhën e Rilindjes, kur u hodhën themelet e gjuhës sonë letrare kombëtare, lufta për gjuhën shqipe bëhet pjesë e luftës politike të popullit shqiptar për t'u çliruar nga zgjedha turke. Me sa dashuri e vetmohim punuan patriotët e Rilindjes për ta ngritur gjuhën shqipe në shkallën e një gjuhe letrare të përpunuar, për të zbuluar thesaret e saj të pashtershme! Me veprat e tyre këta shkrimtarë treguan se gjuha shqipe është po aq e pasur sa dhe gjuhët e tjera të përpunuara dhe ajo i kishte të gjitha mundësitë për t'u bërë gjuha e një letërsie me vlera të larta artistike, gjuha e kulturës dhe e shkencës. Këta patriotë tek gjuha e popullit shikonin gurrën e pashtershme, që do ta usnqente gjuhën letrare. Ata u përpoqën që gjuha letrare të qëndronte sa më afër gjuhës së popullit, që të kuptohej e të përvetësohej prej tij. Kjo gjuhë lindi si një kërkesë e kohës dhe është pjesë përbërëse e programit të madh për bashkimin e popullit dhe ngritjen e tij në luftën për çlirim. Kjo rrethanë përcaktoi dhe një tipar tjetër të gjuhës letrare të kësaj periudhe; përpjekjen për t'u shkëputur nga format e ngushta lokale, për të kërkuar trajta sa më të përbashkëta e të përhapura. Natyrisht ky synim në kushtet e atëhershme nuk mund të realizohej plotësisht, sepse për këtë mungonin kushtet objektive. Në rrethanat e pushtimit të huaj, në një ekonomi krejt të prapambetur e të copëtuar, në kushtet e një analfabetizmi masiv, me disa të pakta shkolla shqipe, masat e gjera të popullit ishin të zhytura në errësirën e padijës. Këto kushte nuk krijonin mundësi për njësimin e normës letrare, për formimin e një gjuhe letrare të përbashkët për gjithë kombin. Megjithatë, duhet thënë se përpjekjet e patriotëve të shquar të Rilindjes për një gjuhë sa më të përbashkët luajtën një rol të madh pozitiv në punën që u bë më vonë për njësimin e gjuhës letrare.

Përpjekjet e forcave përparimtare u bënë dhe më të organizuara pas formimit të shtetit shqiptar.

i përbáshkët common
pjésë përbërëse constituent part
i pashtérshëm inexhaustible
u përpóqën (përpiqem) endeavored; tried
trájtë trait
analfabetízëm illiteracy
padíjë ignorance

Por në kushtet e regjimit anadollak të Zogut, ekonomia, arsimi dhe kultura u karakterizuan gjithashtu nga një prapambetje e theksuar. Politika antipopullore e regjimit feudo-borgjez të A. Zogut nuk solli ndryshime në zhvillimin e forcave prodhuese të vendit, në zhvillimin e arsimit dhe të kulturës. Ekonomia e copëtuar, rrjeti i dobët i mjeteve të komunikacionit, zhvillimi i paktë i qyteteve, analfabetizmi masiv nuk mund të ndihmonin për formimin dhe përhapjen e normës së përbashkët gjuhësore. Numri fare i vogël i shkollave, mungesa e institucioneve kulturale ishte pjesë përbërëse e tablosë së përgjithshme, që ushtronte ndikim negativ në përhapjen e normës gjuhësore dhe në njësimin e saj. Por dhe në këto vite të errëta kur zotëronte padija, varfëria dhe sëmundjet, forcat përparimtare e shtruan problemin e njësimit të gjuhës letrare. Hallkën kryesore për këtë njësim këta patriotë e shihnin në gjuhën e shkruar. Forma e shkruar udhëhiqte procesin e njësimit të gjuhës letrare. U bënë hapa përpara për mënjanimin e varianteve të ngushta dialektore, gjë që çonte në formimin e normës mbidialektore, e cila shpesh nuk arrinte të fitonte karakter gjithëkombëtar.

Njësimi i drejtshkrimit, u bë një nga problemet kryesore të gjuhës letrare duke filluar që nga vendimet e Komisisë letrare të Shkodrës (1916) e duke shkuar tek Kongresi arësimor i Lushnjës (1920). Në këtë drejtim një punë shumë pozitive kanë bërë atdhetarë të tillë të shquar si Luigj Gurakuqi e Aleksandër Xhuvani. Të gjitha këto rezultate janë arritur me një luftë këmbëngulëse e të vendosur kundër forcave reaksionare. Qarqet reaksionare të veriut mbajtën në këtë rast një qëndrim diversionist. Ato u përpoqën të thellojnë në gjuhën letrare dallimet midis dialekteve, të ngrejnë në normë letrare variante të ngushta krahinore, që i kuptonte vetëm një pjesë e vogël e popullsisë. Në këtë mënyrë ata treguan dhe këtu ideologjinë reaksionare e përçarëse, që synonte ta mbante popullin në skllavëri dhe në errësirën e padijes.

Ata u përpoqën të propagandojnë idenë se gjuha letrare e njësuar nuk është e domosdoshme. Duke mbyllur sytë me qëllim përpara letërsisë përparimtare, që krijoi dhe në atë kohë vepra me vlera ideoartistike, këta apologjetë të obskurantizmit përpiqeshin të mbillnin pesimizmin lidhur me perspektivat e formimit të gjuhës letrare të njësuar. Si idealistë reaksionarë, ata e lidhnin krijimin e një gjuhe letrare me daljen e «shkrimtarit gjenial», veprat e të cilit mbas disa qindra vjetësh do të formonin gjuhën letrare. Në thelb në këto pikëpamje shprehej qën-

anadollák pertaining to the backwardness of the Ottoman Empire
rrjet network
sëmúndje sickness
hállkë link
mënjaním avoidance
mbidialektór super-dialectal; beyond dialects
këmbëngúlës stubborn
qárqe (qark) circles
përçárës divisive; splitting
mbíllnin (mbjell) sow; plant
thelb core; pit; kernel

5'8

drimi antikombëtar i tyre, mosbesimi në forcat krijuese të popullit dhe përulja kozmopolite ndaj gjuhës dhe letërsisë së vendeve të tjera. Këto pikëpamje të urryera vazhduan të propagandoheshin nga qarqet klerikale gjer në çlirimin e vendit më 1944. Ato u përqafuan dhe nga okupatorët italianë, sepse pikëpamje të tilla kozmopolite i shërbenin politikës shkombëtarizuese që ndiqte okupatori, ndërsa qarqet klerikale nuk ishin gjë tjetër veçse agjentë të kësaj politike. Ky qëndrim reaksionar gjente mbështetje në rrethin e hierarkëve të regjimit antipopullor dhe shprehej në politikën gjuhësore, që ndiqte ky regjim. Kjo politikë gjuhësore karakterizohej nga pengesa artificiale dhe mosinkurajim për veprimtarinë e atyre forcave, që përpiqeshin ta nxirnin çështjen e gjuhës së përbashkët nga rruga pa krye. Megjithatë, duhet thënë se puna vetmohuese e shumë brezave të patriotëve e lehtësoi mjaft zgjidhjen e problemit të drejtshkrimit të njësuar dhe të gjuhës letrare, që do të mbështetej mbi të.

Çlirimi i vendit më 1944, si rezultat i revolucionit popullor, i udhëhequr nga Partia e gjeti gjuhën tonë pa një normë letrare të vetme e pa një drejtshkrim të njësuar. Realizimi i ëndrrës shekullore të shumë brezave për krijimin e një gjuhe të vetme letrare për gjithë kombin u takon ndërtuesve të socializmit. Vetëm në kushtet e socializmit u krijuan mundësitë objektive dhe subjektive për kristalizimin dhe përhapjen e normës letrare të njësuar. Problemi i gjuhës letrare u vu në kushte të favorshme që ndihmuan shumë për zgjidhjen e shpejtë të tij. Zhvillimi i vrullshëm i ekonomisë, revolucioni në fushën e arsimit dhe të kulturës, ngritja e një rrjeti të gjerë shkollash dhe institucionesh mësimore e kulturale, lulëzimi i letërsisë artistike dhe politike qenë faktorë vendimtarë për njësimin e normës letrare dhe përhapjen e saj gjer në skajet e atdheut. Në këtë proces ka ndihmuar karakteri shoqëror i prodhimit, zhvillimi i madh i komunikacionit, qëndrat industriale me popullsi të përzjerë etj. Revolucioni popullor i udhëhequr nga Partia dhe shoku Enver e pastroi rrugën për krijimin e një gjuhe të përbashkët letrare. Duke e vlerësuar gjuhën letrare si një mjet të fuqishëm që ndihmon për përhapjen e kulturës, për edukimin e masave të gjera të popullit, për njohjen me sukseset në fushat e arsimit, të shkencës dhe të teknikës shoqëria jonë socialiste krijoi të gjitha mundësitë reale që norma gjuhësore të njësohej dhe të përvetësohej nga masat e gjera të popullit. U krijuan mjete të fuqishme për rrezatimin e kësaj norme, që nga

<u>përúlje</u>	submission; humbling
<u>i urrýer</u>	hateful; hated
<u>shkombëtarizúes</u>	de-nationalizing
<u>hierárk</u>	member of the heirarchy; superior
<u>mosinkurajím</u>	discouragement
<u>rrúgë pa krýe</u>	dead end street
<u>u takón</u>	belongs to them
<u>rrezatím</u>	radiation; dissemination

librat, shkollat, gjer tek radioja e televizioni. Me gjuhën letrare ndërtuesi i socializmit haset kudo. Ajo bëhet pjesë e veprimtarisë së tij. Transformimet rrënjësore në fushën e ekonomisë e të kulturës sollën ritme të papara dhe për njësimin e normës letrare. Ky proçes njësimi është ndihmuar dhe nga politika e drejtë gjuhësore e shoqërisë sonë socialiste. Partia dhe Shteti e kanë vlerësuar krijimin e një gjuhe letrare të përbashkët si një çështje me rëndësi kombëtare. Prandaj ato e kanë ndihmuar me të gjitha forcat procesin e konvergimit të dialekteve, që çonte në krijimin e një norme të përbashkët për gjithë kombin. Në këto rrethana u bë e mundur që forma e shkruar e gjuhës letrare të njësohet mbi bazën e një drejtshkrimi të përbashkët.

Në «Drejtshkrimin e gjuhës shqipe» janë pasqyruar vendimet kryesore të miratuara nga Kongresi i Drejtshkrimit, që u mbajt në nëntor të vitit 1972.

«Drejtshkrimi...» mbështetet mbi një koncept të drejtë gjuhësor: u jepen parësi trajtave sa më të përbashkëta për gjithë kombin. Kjo sjell si pasojë që të thyhen kornizat e ngushta dialektore, sepse vetë gjuha letrare i ka thyer këto korniza. Gjuha jonë letrare është formuar në kushtet e një bashkëveprimi të fuqishëm ndërdialektor. Duke u mbështetur e duke qëndruar afër gjuhës së popullit, gjuha letrare ka thithur e ka shkrirë në një tërësi organike elemente të dialekteve e të të folmeve të ndryshme. Kjo natyrisht nuk do të thotë se në gjuhën letrare bëhen përzjerje pa kriter, amalgama elementësh. Në strukturën e gjuhës janë integruar tipare të tilla që pajtohen me sistemin dhe që lejohen prej tij.

Drejtshkrimi mbështetet në një analizë shkencore për gjëndjen e sotme dhe për prirjet e gjuhës letrare. Kjo është bërë e mundur në sajë të studimeve të kryera nga gjuhësia shqiptare në fushat e leksikologjisë, dialektologjisë, fonetikës, gramatikës dhe etimologjisë. Prandaj zbatimi i këtij drejtshkrimi do të ndihmojë për ta bërë gjuhën shqipe një mjet sa më të gjerë komunikimi, mjet për forcimin e unitetit të shoqërisë socialiste, për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës së popullit.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave lidhur me «Masat për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe» formimi i një gjuhe letrare kombëtare të njësuar vlerësohet si një fitore e madhe, me rëndësi historike, që arriti populli shqiptar në vitet e pushtetit popullor, i udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë. Ky vendim, që kërkon zbatimin e detyrueshëm të Drejtshkrimit në

rrënjësór radical
rítëm rate of progress
i papárë unprecedented
miratój approved
thýej break up; shatter
kornízë frame; border
bashkëveprím collaboration
përzjérje fusion; mingling
kritér criterion
në sájë as a result
i detyrúeshëm obligatory

gjithë veprimtarinë botuese e arsimore, në veprimtarinë shtetërore dhe shoqërore, është një dëshmi tjetër e kujdesit të Partisë dhe të pushtetit popullor për zhvillimin e gjuhës sonë amtare.

Mori fund një periudhë e gjatë e kaosit në normat e gjuhës së shkruar. Zbatimi i Drejtshkrimit të njësuar për gjithë kombin është jo vetëm detyrë, por, në radhë të parë, një fitore e madhe që arriti populli ynë në kushtet e ndërtimit të socializmit. Natyrisht gjuha letrare është shumë më e gjerë se rregullat e Drejtshkrimit. Të zotërosh rregullat e Drejtshkrimit nuk do të thotë aspak se ke zotëruar gjuhën letrare. Zotërimi i gjuhës letrare kërkon zotërimin e normave leksikore, fonetike dhe gramatikore. Shkrimtarëve, si artistë të fjalës, u takon një rol i dorës së parë në lëvrimin e gjuhës letrare. Zbulimi dhe përdorimi i thesarit të fjalëve që jetojnë në popull, përpjekja për të pastruar gjuhën tonë nga fjalët e huaja të panevojshme duhet të konsiderohen si detyrë nderi dhe patriotizmi për çdo shkrimtar. Gjatë viteve të pushtetit popullor letërsia jonë e realizmit socialist ka bërë shumë për gjuhën letrare, për pasurimin dhe lëvrimin e saj. Por gjuha e popullit është burrë e pashtershme për gjuhën. Në popull jeton fjala e pastër shqipe, thjeshtësia në shprehje dhe mendimi i gjerë. Prandaj shkrimtarët gjithnjë i janë drejtuar gjuhës së popullit, fjalës së tij, të cilën e kanë përpunuar duke na dhënë vepra me vlerë jo vetëm nga pikëpamja ideoartistike, por dhe nga pikëpamja gjuhësore. Shkrimtarët tanë i takojnë popullit dhe shkruajnë për popullin. Në fjalën e tyre masat e gjera të popullit kërkojnë modelin që duhet të ndjekin në shprehje dhe në gjuhë. Kjo përcakton atë përgjegjësi të madhe dhe kujdes të vazhdueshëm që duhet të tregohet për gjuhën letrare të njësuar, si një nga sukseset më të mëdha të kombit në lëmin e kulturës socialiste.

Parimi themelor i drejtshkrimit tonë është parimi fonetik, sipas të cilit shumica dërrmuese e fjalëve shkruhen ashtu siç shqiptohen. Zbatimi i këtij parimi është bërë i mundshëm për shkak se ndryshimet midis dialekteve dhe të folmeve në gjuhën tonë nuk janë të mëdha. Zbatimi i këtij parimi lehtëson përvetësimin e drejtshkrimit nga masat e gjera të popullit. Dhe në këtë çështje është ndjekur një politikë e drejtë gjuhësore. Le të kujtojmë p.sh. se ç'probleme nxjerr përvetësimi i drejtshkrimit të gjuhëve të tilla si anglishtja dhe frëngjishtja, që mbështeten sidomos në parimin historik-tradicional. Klasat sunduese në këto vende nuk janë të interesuara për reforma në drejt-

pastrój cleanse; clean
i panevójshëm unnecessary
parím principle
lehtësój make easy, light

511

shkrim, që do ta thjeshtonin atë dhe do t'u jepnin mundësi masave të gjera për ta përvetësuar. Në këto shoqëri arsimi dhe shkenca janë pronë e një pakice, e cila pengon me të gjitha mënyrat arsimin e popullit.

Një parim tjetër që zë një vend relativisht të gjerë në drejtshkrimin është parimi morfologjik, sipas të cilit morfemat dhe njësitë me kuptim shkruhen njëlloj, pavarësisht nga dallimet që mund të kenë në shqiptim. Përdorimi i parimit morfologjik lidhet me ndryshimin në shqiptim të disa fjalëve dhe të formave të fjalëve. Në rrethana të tilla gjuha e shkruar, për të siguruar njësimin, largohet nga shqiptimi dhe kalon në parimin e ruajtjes së njësisë së morfemave.

Parimi historik, sipas të cilit fjalët shkruhen ashtu siç janë shkruar dikur, në etapat e kaluara të gjuhës, zë një vend fare të vogël në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe.

Anastas Dodi, "Dreftshkrini i gjuhës shqipe" Nëntori, (Tiranë), XXI, 5 (May), 1974, pp. 59-65. (Title abbreviated)

pakícë minority
morfémë morpheme
morfémat...njélloj morphemes of a unitary meaning are written in a single way

Brenda një periudhe që nuk mbulon as gjysmën e një jete njerëzore, populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, bëri të vërtetë një kalim që me një figurë mund ta shprehim si kalim nga kandili në viganet e hidroenergjetikës, nga parmenda e drunjtë primitive në një agroteknikë me rendimente të larta shembullore, nga obskurantizmi mesjetar e analfabetizmi masiv në revolucionin po aq masiv tekniko-shkencor.

Triumfi i revolucionit popullor, fryt i udhëheqjes së PKSH (sot PPSH), u bë në këtë kuptim edhe çlirimi i shkencës shqiptare, që po bënte hapat e saj të para, çlirimi nga prangat ku e patën mbajtur të ndrydhur regjimet e errësirës, të shtypjes e të shfrytëzimit.

Kujdesi i Partisë nuk iu nda kurrë asaj inteligencie të pakët të rritur në kushtet e vështira të regjimeve antipopullore. E nëodhur përpara detyrave të mëdha që shtronte ndërtimi i socializmit në atdheun e çliruar, ajo duhej ti vendoste dijet dhe aftësitë e saj shkencore-teknike mbi një bazë metodologjike shkencore që të delte nga caqet e kufizimet e një pune të ngushtë artizanale, me tipare spontane e subjektive, të cilat kishin karakterizuar deri atëherë punën e saj në fushën e studimeve.

Radhët e inteligencies sonë shkencore erdhën duke u rritur sistematikisht e çdo vit me forca të reja, të dala nga gjiri i masave punonjëse, bij punëtorësh e fshatarësh. Krijimi i kësaj inteligencie të re, besnike e çështjes së revolucionit e të socializmit, përvetësimi nga ajo, në mënyrë frontale, i metodologjisë marksiste-leniniste si e vetmja bazë shkencore, shënonin një fitore nga më të rëndësishme të politikës së Partisë në lëmin e shkencës.

Në këto kushte historike, në valën e një lufte intensive ideologjike, në terrenin e praktikës së ndërtimit socialist, u formua e u kristalizua shkenca e re shqiptare si shkencë e bazuar në marksizëm-leninizmin.

kalím transition; passage
vigán giant
hidroenergjetíkë hydro-electric power

Në një vend të prapambetur, për më tepër të shkatërruar nga lufta, të kërcënuar nga uria e nga armiq të hapur e të fshehur, fillol me ritme intensive qysh në vitet e para pas Çlirimit ngritja e institucioneve tona shkencore.

Kuadri i gjerë perspektiv në të cilin Partia vendoste gjithë politikën e vet në fushën e kulturës e të arsimit, e, brenda tyre, edhe të shkencës, shihej qartë në fjalën e shokut Enver Hoxha, në Kongresin e 2-të të Frontit Demokratik: «... Këtu nuk është një çështje e thjeshtë arsimore ose administrative, po këtu kemi përpara një problem të madh politik, që ka lidhje me të ardhmen tonë si komb dhe si shtet».

Në këtë kuadër ka rëndësinë e vet formimi i të parit institut studimor në historinë e Shqipërisë më 28 janar 1947 (i quajtur më vonë Instituti i Shkencave), me të cilin viheshin themelet e veprimtarisë së organizuar shkencore në vendin tonë. Ideja e përgjegjësisë politiko-shoqërore të shkencës pasqyrohej qartë në vendimin qeveritar, ku theksohej se instituti i ri duhej që, me veprimtarinë e tij të frymëzuar nga reformat e mëdha ekonomike e shoqërore të pushtetit tonë, të kontribuonte në studimin e zgjidhjen e problemeve aktuale që lidhen ngushtë me zhvillimin ekonomik-shoqëror e kulturor të popullit tonë.

Vitet kalonin dhe, në bazë të planifikimit, dëndësohej rrjeti i institucioneve të larta arsimore-shkencore, shtohej numri i punonjësve dhe rritej kualifikimi i tyre, rritej edhe rrethi i problemeve madhore që ata atakonin, rëndësia shoqërore ekonomike dhe ideologjike e problemeve që ata zgjidhnin. Më 1948 krijohej Muzeu Arkeologjik-Etnografik, më 1955 i pari institut kërkimor, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, dhe më 1957 forcat mësimore-shkencore kryesore përqëndroheshin në Universitetin e ri të Tiranës për t'u bërë ballë nevojave të rritu-

drójtje hesitation
guxím daring
rapórt report
udhërrëfýes signpost
parimór principled
mënýrë të mendúari mentality; way of thinking

ra të vendit për pregatitjen masive të kuadrove të larta. Duke filluar nga vitet 60-të e deri në ditët tona, krijohen një varg institucionesh, katedrash, stacionesh, bërthamash, byrosh teknologjike, që e bënë masiv eksperimentimin shkencor, e çuan deri në bazë, duke u dhënë gjithnjë e më tepër përparësi kërkimeve në fushën e shkencave teknike e natyrore. Si një ngjarje e shënuar historike qëndron në historinë e shkencës sonë vendimi i plenumit të 2-të të KQ të Partisë më 1972, që vuri gurin e themelit të Akademisë së Shkencave të RPSSH si institucioni më i lartë shkencor i vendit tonë.

Pak dhjetëra vjet na ndajnë nga fillimi i kësaj rruge, por ato vite do të mbeten përgjithmonë të freskëta në kujtim me romantikën e çdo fillimi revolucionar. Ato fillime mund të duken modeste në krahasim me arritjet e së sotmes. Pjesëmarrësit në ato ngjarje mund tu kujtojnë me sa drojtje u nisën, por ata janë edhe dëshmitarë se me sa siguri e guxim i drejtoi kurdoherë dora e Partisë, duke i udhëhequr nëpërmes vështirësive të natyrshme të fillimit e të rritjes, por edhe nëpërmes veshtirësive që krijoi bllokada e viteve 60. Dokumentet themelore të Partisë, fjala e shokut Enver e mbajtur në takimin me përfaqësuesit e inteligencies së kryeqytetit në vitin 1962, fjalimet e shokut Enver Hoxha mbi kooperimin e revolucionin tekniko-shkencor, mbi problemet e mëdha ideologjike të thellimit të revolucionit kulturor, raporti në Kongresin e 6-të dhe ai në Kongresin e 7-të etj. qëndrojnë si udhërrëfyes të mëdhenj në rrugën e ngjitjes së vazhdueshme të shkencës sonë, të mbështetur fort në marksizëm-leninizmin.

Përparimi edhe këtu nuk mund të realizohej pa një luftë të ashpër parimore klasore kundër çdo shfaqjeje të huaj në konceptet tona për pu-

parméndë plow
fryt fruit
prángë shackle; fetter
i ndrýdhur suppressed
cáqe (cak) borders
për më tépër moreover
kuádër framework; context
qeveritár governmental
planifikím planning
dëndësój multiply; make dense
rreth scope; circle
kërkimór research
përqëndrój concentrate
katèdër study chair; department
bërthámë germinal; core
përparësí priority

nën shkencore, pa mposhtur një mënyrë të menduari intelektualist e teknokratik, që e shihte shkencën si një monopol të disave, pa luftuar kundër qëndrimeve liberale e burokratike, kundër vetëkënaqësisë e prakticizmit, që janë armiq të betuar të çdo pune të vërtetë shkencore. Në sajë të udhëheqjes së vazhdueshme të Partisë, në gjirin e institucioneve tona shkencore zhvillohet sot një jetë e dëndur me diskutime të gjalla parimore për të thelluar gjithnjë e më tepër tendenciozitetin klasor të shkencës sonë, për të luftuar konceptet antishkencore, antimarksiste e antishqiptare të shkencës së vëndeve borgjeze e revizioniste — një luftë e madhe që e çliroi shkencën tonë nga tutela e shkencës së vëndeve kapitaliste e revizioniste.

Ne mund të flasim me krenari për një shkencë shqiptare me të vërtetë marksiste-leniniste, me metodat, tiparet, pikëpamjet e veta shkencore e themelore të përcaktuara. Këtu nuk është fjala vetëm për aspektin e shifrave, të numrit të punonjësve, të veprave të shkruara ose të mishëruara në praktikën e ndërtimit, por në radhë të parë për aspektin e saj cilësor, për një shkencë, që u rrit, si të thuash, nga asgjëja, në një terren në të cilin zotëronte analfabetizmi masiv, për një shkencë të [illegible] bë burim force për përparimin teknik, [illegible] zhvillimin ekonomik-shoqëror të Atdheut tonë socialist. Me forcat tona u arrit të formohet një mendim shkencor yni mbi problemet kryesore të jetës së vendit e të popullit tonë, mbi probleme që kanë të bëjnë me njohjen e zotërimin e burimeve e të pasurive të natyrës dhe të kulturës sonë socialiste kombëtare e begatë, e lashtë dhe gjithmonë e re.

E nisur nga mësimet e Partisë e të shokut Enver, shkenca jonë nuk u mbyll në muret e «kuliave të fildishta», qofshin këto edhe të instituteve shkencore. Ajo po zbret gjithnjë e më sistematikisht në bazën, për t'u pasuruar me

vetëkënaqësí complacency
prakticízëm empiricism; overemphasis of practice
tutélë tutelage; dependency
shífër figure; cipher
i mishërúar embodied
si të thúash so to speak

përvojën shkencore, të grumbulluar nga masat, për t'ia kthyer praktikës së ndërtimit përvojën e saj teorike. Masivizimi i shkencës është bërë kështu një nga tiparet dalluese të shkencës sonë, duke mishëruar mësimin e shokut Enver se «revolucioni tekniko-shkencor në shoqërinë tonë socialiste nuk mund të çohet përpara vetëm nga disa institucione kërkimore të specializuara», se «vendimtare në eksperimentimin shkencor është që të tërhiqen aktivisht masat e gjera të punëtorëve e të fshatarëve, kuadrot e specialistët e prodhimit».

Detyrat e mëdha e të rëndësishme që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë edhe në fushën e shkencës, janë një program i qartë pune dhe një burim frymëzimi i lartë për të gjithë punonjësit e shkencës, për t'ia kushtuar gjithë punën e tyre çështjes së madhe për të cilën luftojë Partia jonë revolucionare, për të arritur fitore të reja në shërbim të ndërtimit të socializmit e komunizmit në vendin tonë.

zotërím mastery
i fildíshtë ivory
masivizím making something a part of the experience of the masses.

Aleks Buda, "Zhvillimi i vrullshëm i shkencës shqiptare", Shqipëria e re (Tiranë), No.I (January-February) 1977, pp.6-7

Kulla e kështjellës së Krujës, skicë nga Dh. Trebicka

The Albanian National Anthem was written by Asdren (Aleksander Stavre Drenova) in 1912, under the title "Betimi mbi flamurin"

tradhëtór = tradhtór
dëshmór martyr

HIMNI KOMBETAR I SHQIPERISE

(The Albanian National Anthem)

Rredh Flamurit të përbashkuar
Me një dëshir' me një qëllim
Të gjith' atje duk' u betuar
Të lidhim besë për shpëtim.
Nga lufta veç ai largohet
Që është lindur tradhëtor
Kush është burrë nuk frikohet
Po vdes po vdes si një dëshmor.

* * *

Në dorë armët do t'i mbajmë
Të mbrojm' Atdheun nga ç'do kend
Të drejtat tona ne s'i ndajmë
Këtu armiqtë s'kanë vend.
Se Zoti vet' e tha me gojë
Që shuhen kombe për mbi dhe
Po Shqipëria do të rrojë
Për të për të luftojmë ne.

LEXIMI I SHTATEDHJETEDYTE

Skifter Këlliçi "Fundi i një legjende"
Këndori (Tiranë) XVI, I (January), 1969,
pp. 125-133

FUNDI I NJË «LEGJENDE»

(tregim)

Ajo i ngjante një goje të stërmadhe, pa buzë, pa dhëmbë dhe, ashtu e hapur, e thellë në trupin e zhveshur të kodrës ndillte llahtarë e frikë.

Dukej se prej shekujsh një fuqi e padukshme dhe e tmerrshme e natyrës kish goditur mbi kurrizin e gunguar të kodrës së ashpër shkëmbore me kaq forcë, sa ajo, si ta ndjente ende këtë goditje, ish tkurrur e kish hapur gojën nga dhëmbja. Kështu kishte mbetur e gurosur dhe e vetmuar me vështrimin e ftohtë mbi fshatin malor, që ngrihej në këmbë të saj, duke përcjellë legjendën dhe të fshehtat, që e mbështillnin dhe e bënin të frikshme si kuçedrat e hataashme të përrallave.

Thonin se në kohë të lashta goja kishte vjellë zjarr, kishte përvëluar fshatin e kishte sjellë fatkeqësi. Se kur kishin ngjarë këto dhe pse, asnjë nuk e dinte. Por gjyshërit ua thoshin baballarëve e baballarët fëmijëve, sapo lindnin. Dhe legjenda, si një hije gjëmëmadhe zbriste nga kodra e zhveshur dhe mbulonte fshatin me errësirën e të fshehtave të saj të mistershme.

Çfarë fshihej në atë gojë? Këtë asnjë nuk e dinte, se asnjë s'kish mundur të ngjitej deri atje. Po edhe s'kish guxuar, se urata thonte se ai që do të guxonte ta bënte këtë, do të ngrinte në vënd. Flitej se një djalë i ri kish dashur të ngjitej, por ish rrokullisur dhe qe bërë copë e grimë. Ca, që e kishin parë, thonin se ai kishte rrëshqitur, sepse faqja e kodrës ishte shumë e thepisur, po urata kishte thënë se e kishte vrarë shpirti i keq. Dhe fshatarët uratën kishin besuar.

i stërmádh very big
ndiéll evoke; arouse
llahtár horror; terror
kurríz back
i gungúar hunched; humped
godítje blow
tkurr shrink; contract
i gurósur petrified; stony
i hatáshëm frightful; dreadful
vjell vomit
baballárë fathers
gjëmëmádhe ill-fated; wretched
urátë Reverend; pastor
cópë e grímë bits and pieces
rrëshqás slip
i thepísur steep
i zýmtë bleak
stuhí storm
flakërój enflame
ulurím = ulërímë ululation; wail
i mpírë numb
gllabërój swallow up
i përbíndshëm monstrous

Tani goja nuk villte zjarr. Por netëve të zymta, të mbushura me gjëmime, vetëtima dhe stuhi, thonin se flakëronte, lëshonte një ulurimë të mbytur që shuhej tutje, tej shpateve të maleve. Dukej sikur kodra do të shkundte shpatullat e mpira, do të ngrihej, atëhere do të hapte gojën e stërmadhe, për të gllabëruar fshatin në këmbë të saj.

Të gjithë jetonin me këtë ankth, ndaj i urrenin netët e zeza, gjëmimet e stuhitë. Atëhere disa shkonin te urata në kishë e luteshin e luteshin që shpirti i përbindshëm, që fshihej në zemër të malit, të mos zgjohej, që gjoja të mos villte zjarr si qëmoti e fshatit të mos i ndodhte asgjë. Dhe urata i dëgjonte lutjet e tyre, u fliste që të ishin gjithnjë bij besnikë të Krishtit të amëshuar, të besonin perëndi, të bindeshin e të mos bënin mëkate, se atëhere goja do të bënte gjëmën. Urata lutej e ata bindeshin dhe e besonin. Dërgonin dhe dhurata në kishë për shpirtin e shënjtë, që një ditë do të sillte mbarësi e lumturi.

Po vjeshta e atij viti erdhi e egër dhe e rrëmbyeshme. Qielli derdhte gjëmime e rrëkera shirash dhe kodra e gurosur filloi të ulurijë si të ndillte shpirtin e përbindshëm të fjetur. Viti s'do të ngrysej i mbarë. Të korrat kishin qënë të këqija, për të mbjellat as që bëhej fjalë. Flitej se në krahinat përreth qenë dukur diversantë. Gjurmët e tyre ishin parë edhe në fshat. Fshatarët lëshuan kushtrimin dhe rrokën pushkët. Po diversantët humbisnin gjurmët. Pleqtë dhe plakat filluan të vinin dhe më shpesh në kishë. Tani as që i dëgjonin fjalët e te rinjve dhe të sekretarit të partisë, që mundoheshin t'i bindnin se këto prapësira nuk kishin të bënin me shpirtin e fshehur thellë gojës së stërmadhe. Por ata i kishin varur tërë shpresat tek urata, i cili lutej përpara alltarit me zërin e trashë, që humbiste në skutat e errëta të kishës, nga ku e vështronin sytë e trishtë të fshatarëve.

Ngjanë dhe të papritura të tjera. Një natë u zhduk kryqi i artë që mbahej në krye të alltarit. U zhdukën dhe dy shandanë. S'ish parë e dëgjuar kurrë që të vidhej kisha. Këtë mund ta bënte vetëm shpirti i keq.

E panë atëhere uratën të vinte shpesh mbrëmjve e të drejtohej prapa kodrës. Kur e pyesnin, u thonte se shkonte të falej për të qetësuar shpirtin e keq. Ata kërkonin ta shoqëronin, se mos t'i ngjiste gjë, por urata nuk pranonte. Po megjithë lutjet e tij qielli derdhte gjëmime e rrëkera shirash e goja e stërmadhe mbetej gjithnjë e llahtarshme me ftohtësinë e saj.

i amëshúar anointed
gjëmë catastrophe
mbarësí prosperity
rrëké torrent
ulurí j = ulërí j howl; wail
të kórrat harvest
as që bëhej fjálë nothing could be
diversánt diversionist; opponent o the regime
alltár altar
skútë corner; nook
i tríshtë frightened
shandán candelabra
vjedh steal
shqýej scatter; open up
i shënjtërúar = i shenjtërúar holy
alpiníst mountain climber
i hájthëm skinny
fjétën (fle) slept

Mirëpo një ditë, kur retë po shqyheshin, duke lënë të dukeshin copa të kaltra qielli, që shëmbëllenin me dritare të mbushura tërë dritë (pleqtë e plakat e fshatit pandehnin se kjo po ndodhte nga lutjet e uratës së shënjtëruar), në fshat erdhi një grup alpinistësh, që po përgatitej të bënte një ngjitje alpinistike në majën e malit të fshehur në horizontin e mjergulluar. Alpinistët i udhëhiqte një burrë i hajthëm, me fytyrë të rreshkët, të nxirë e me flokë të thinjur. Me këtë pamje ai s'ta mbushte syrin dhe, po të mos e njihje, s'do të të binte kurrë në mënd se ai ishte alpinist. Të tjerët qenë djem të rinj. Atë natë, ata fjetën në shtëpitë e fshatarëve.

Të nesërmen në mëngjes, kur po bëheshin gati për t'u nisur, atyre u doli përpara sekretari i partisë, që atë natë nuk kishte qënë në fshat.

— Do të doja t'ju pyesja për diçka. Është me shumë rëndësi, — tha ai duke iu drejtuar alpinistit me flokë të thinjur.

— Flisni! — u përgjegj ai i habitur. — Për çfarë është fjala?

— Si mendoni, a mund të ngjiteshit në atë zgavrën atje? — Dhe i tregoi me gisht kodrën me gojën e stërmadhe.

— Qënka një kodër e çuditëshme! Çfarë nuk krijon natyra! — tha alpinisti. — Jam ngjitur në maja e shpate malesh, po gjëkundi nuk kam parë një kodër të tillë. Kaq e rrafshtë, kaq e thepisur dhe me atë zgavër si goja e një fytyre pa asnjë tipar tjetër!

—E pra, a mund të ngjiteni?

Alpinistin e habiti dhe më tepër këmbëngulja me të cilën po i drejtohej sekretari i partisë që dukej i ngrysur.

— Për t'u ngjitur, mbase do të ishte vështirë dhe s'do kishte shumë leverdi, sepse rruga është e gjatë, — tha ai, pasi u mendua pak — Po ne mund të zbresim nga maja e kodrës drejt e në zgavër, sepse që andej është më afër.

— A mund ta bëni këtë sot?

— S'e kuptoj, përse duhet ta bëjmë këtë pikërisht sot!

Atëhere sekretari i partisë u tregoi alpinistëve se si qëndronte puna. Pas çdo fjale të tij, ata habiteshin gjithnjë e më shumë.

— Kur qënka kështu, atëhere ne do ta shtyjmë ngjitjen tonë alpinistike dhe do të zbresim qysh sot atje, për t'u treguar të gjithëve të vërtetën e kësaj legjende, — tha alpinisti me flokë të thinjur.

i rráfshtë	flat
aplinistík	pertaining to mountain climbing
jánë në véte atá	are they all there

— Ju falemnderit! — u përgjegj sekretari i partisë dhe i shtrëngoi duart tërë gaz.

Lajmi, se grupi i alpinistëve do të zbriste në gojën e stërmadhe, u përhap sakaq në tërë fshatin.

— More, po ku është parë e dëgjuar kjo!

— Të shkosh me këmbët e tua drejt vdekjes!

— Janë në vete ata, apo kanë shkalluar. Po si do të arrijnë deri atje.

— Perëndia na ruajtë. Në vënd kanë për të ngrirë. Nuk ju kujtohet si e pësoi ai djali qëmoti?...

Kështu flisnin fshatarët, të pushtuar nga një ndjenjë pasigurie e frike.

— S'kini përse shqetësoheni, — u thonte atyre që takonte sekretari i partisë. — Ejani, dilni në fushë dhe do të shihni me sytë tuaja si do të zbresin!...

Lajmëruan atëhere uratën që ishte në kishë. Ai erdhi në kohën kur alpinistët po bëheshin gati të kalonin nga prapa kodrës për t'u ngjitur në majë. Nga që kish rendur, fytyra, që mezi i dukej përmes mjekrës së dëndur, i qe skuqur e ai merrte frymë me zor.

— Mos, mos shkoni atje! Perëndia na ruajtë! — u thirri ai alpinistëve. — Atje s'ka shkelur kurrë këmbë njeriu!...

— Do të shkelim të parët, — iu përgjegj alpinisti me flokë të thinjur.

— Do të ngrini në vënd ose, pa arritur, do të shëmbeni teposhtë.

— Të jeni të sigurtë, se asgjë nuk do të ngjasë!

— I dëgjoni ju, o besnikë të Krishtit? Thonë se asgjë nuk do të ngjasë. Po kjo është vetvrasje!

Qe mbledhur një turmë e madhe pleqsh e plakash e po dëgjonin të llahtarisur fjalët e uratës.

— Mosni, more bijt e nënës, përse mirrni veten në qafë? — tha një plakë gati duke qarë.

Alpinisti me flokë të thinjur ktheu kokën nga sekretari i partisë.

— Ata janë të robëruar nga hija e kësaj legjende. Po-para, pa humbur kohë!

Pas këtyre fjalëve alpinisti me flokë të thinjur u bë i shënjë shokëve të ecnin drejt.

Por, pa bërë disa hapa, si fantazmë, u doli urata.

— Mosni më dëgjoni mua, dëgjoni dhe zërin e besnikëve të Krishtit!

Turma murmuriti, po alpinistët vazhduan udhën.

• • •

shëmb = shemb cast; hurl; collapse
tëpóshtë downward
vetvrásje = vetëvrásje suicide
litár rope
shtóhem increase; enlarge
rastís chance
lugínë valley; canyon
i pjérrët sloping

Po zbriste teposhtë.

Nga sipër, majë kodrës, shikonte alpinistët e tjerë, që mbanin litarë, ndërsa ai, duke u mbështetur në faqen e lëmuar të shkëmbit të thepisur, zbriste e zbriste. Kur kthente kokën, shihte atje në fushë turmat e fshatarëve që vinin e shtoheshin. Midis tyre dallonte sekretarin e partisë, uratën dhe ata pleqtë me fytyra të tronditura që aq shumë kishin folur. Ai e dinte që edhe tani ata po flisnin. Urata bënte shënja me duar dhe dridhej i tëri.

«Dridhu, dridhu, djall i zi! Mjaft i ke ndrydhur zemrat e këtyre njerëzve!»

Me siguri sytë e atyre qenë mbërthyer tek ai. Kishte kryer gjatë këtyre viteve me dhjetra e dhjetra ngjitje e zbritje majash, po rrallë i kishte rastitur të bënte një zbritje kaq të thiktë. Atëhere kishte patur dëshmitarë të heshtur majat e maleve, luginat e mbushura me dëborë, erërat e mjegullat dhe, të vetmit spektatorë, shokët që ngjiteshin e zbrisnin pas tij. I tillë është alpinizmi. Kurse kjo ishte një tjetër zbritje e rrezikshme dhe e vështirë, jo vetëm se ishte shumë e pjerrët, por edhe pse s'kishte dëshmitarë të heshtur. Ata, atje poshtë, të mbërthyer nga ankthi, prisnin ç'do të ngjiste me të, ndiqnin çdo lëvizje të tij.

«Po sikur të rrëzohesha?»

Ai kujtoi djaloshin, që s'dihet se kur, kish dashur të ngjitej e ishte shembur tëposhtë. Gjithnjë vazhdonte të zbriste. Po zbritja bëhej ngadalë. Njëri nga litarët kishte ngecur midis dy të dalave të mprehta shkëmbore. U orvat ta shkëputse që andej, po nuk qe e mundur. Mbeti ca kohë ashtu.

«Çfarë mendojnë tani për mua?...»

Sillte ndërmënd fytyrën e sekretarit të partisë, pakëz të ngrysur, bisedën që kishte patur me të në mëngjes, këmbënguljen e tij për të zbritur në gojën e stërmadhe të kodrës.

«Vërtet, pse ka qëndruar! — mendoi sekretari i partisë. Fshatarët filluan të pëshpërisnin.

— Sikur ka ngrirë!

— Jo, jo, po lëviz.

— Po pse mbeti?

— Mbase ka frikë! I shkreti ai. Në vënd ka për të ngrirë! — foli urata. — Thojini që të ngjitet. Hë, pra, ç'prisni?

— Po lëviz, po lëviz! — u hodh një nga të rinjtë.

Sekretari i partisë mori frymë thellë. Alpinisti me flokë të thinjur po zbriste poshtë. Urata heshti dhe u mbështuall me rason e tij të zezë, duke vështruar gjithnjë me ligësi sekretarin e partisë.

ngec stick
e dálë protuberance; projection
pákëz a little; a bit
u mbështúall (mbështjéll) wrapped himself up

Sa më tepër zbriste, aq më qartë i shihte fytyrat e fshatarëve. Tani ndodhej vetëm disa metra larg zgavrës.

«Edhe pak, edhe pak! dhe atëhere...»

Po befas ndjeu një tronditje. Ju duk se masa shkëmbore iu shemb nën këmbë e ai po rrëkëllehej në pafundësi. Për disa çaste mbeti pezull në ajër, mezi e përmbajti një klithmë, që i shpërtheu nga buzët dhe u përplas në shkëmb.

«Ç'po ndodh kështu?»

Njeri nga litarët mes të dalave të shkëmbenjve ish këputur e tani varej teposhtë si trupi i një gjarpëri që i presin kokën. Ai shtrëngoi duart pas litarit tjetër dhe e mblodhi veten. Atëhere ndjeu një dhëmbje therëse në këmbë.

Turma u lëkund. U dëgjuan britma. Shokët nga sipër e panë me shqetësim dhe e shtrënguan litarin. Mbeti ca ashtu për të mposhtur dhëmbjen.

— A nuk ju thashë: shikojeni vetë! Po zgjohet shpirti i djallit. Nëqoftëse zbret më poshtë, do ta ngrijë në vënd, ose do ta hedhë nën shkëmb! — thirri këtë radhë urata. — Kjo është mëkatë. Do të merremi më qafë edhe ne. Po akoma ka kohë. Po të mos zbresë, atëhere do të shpëtojmë. Po prishet dhe koha. Së shpejti do të shpërthejë stuhi me rrufe e vetëtima.

Tani re të dëndura vërshonin në qiell si dallgët e një deti të tërbuar.

Sekretari i partisë kishte mbërthyer vështrimin tek alpinisti me flokë të thinjur.

— Ç'pati kështu, mbase është plagosur... A do të mund të zbresë...

Gjithçka varej tani nga alpinisti me flokë të thinjur.

«Po sikur të jetë plagosur?»

Atëhere solli ndërmënd se ç'do të mund të bënte urata, fytyra e të cilit vente e vinte dhe fshatarët që kishin mbetur të shtangur.

Filloi të binte shi. Qielli gjëmonte. Disa fshatarë nisën te shpërndahen, po atëhere alpinisti me flokë të thinjur filloi të lëvizë.

— Qëndroni! — thirri sekretari i partisë. — Ai po zbret.

— E ç'të qëndrojmë. Ai po na merr në qafë. Gjëma do të bëhet! — thanë pleqtë.

— Qëndroni! — thirri përsëri sekretari i partisë duke u dalë përpara.

ráso priests robe
ligësí malice
trondítje tremor
rrëkëllëhem tumble
pafundësí abyss
pézull dangling; suspended

Alpinisti me flokë të thinjur i dëgjoi qartë këto fjalë. Më tepër se kurrë ai e kuptoi se gjithçka varej prej tij. Shtrëngoi nofullat për të mposhtur dhëmbjen në këmbë, fshiu fytyrën e lagur nga djersa e shiu që e bënte shkëmbin të rrëshqitshëm, vështroi shokët sipër dhe turmën poshtë dhe vazhdoi të zbresë.

Kishin mbetur dhe pesë a gjashtë metra nga pjesa e sipërme e zgavrës. Ai bëri edhe disa përpjekje e rrëshqiti përposh. Nga turma shpërthyen britma.

— Dhe dy tri metra...

— Mos, mos bëj më tutje... O perëndi e madhe! — klithi urata, që tani ish zverdhur fare.

— Durim edhe pak, se arrite, — thirri sekretari i partisë pa e përmbajtur veten.

Alpinisti me flokë të thinjur dëgjoi zërin e tij dhe më pas britmat e të rinjve që i jepnin zemër dhe ndjeu t'i përtërihen forcat. Tashti shiu po pushonte dhe qielli po çirohej nga retë, që humbisnin si shkumba e detit në rërën e zhuritur.

U var nën shkëmbin e mprehtë dhe, kur turma kish mbetur si një bllok i gurosur, u lëshua brenda gojës së stërmadhe që shtillej në gjysmëerrësirë. Mori frymë thellë i lehtësuar dhe u mat të dalë buzë asaj zgavre për t'i folur turmës së ngurrosur, kur befas vuri re, se në shtjellën e dëndur të errësirës depërtonte një rreze e hollë drite që dukej se vinte nga larg. Kjo e habiti.

«Këtu qënka një shpellë e thellë! Nga vjen kjo dritë?»

Duke menduar kështu, ai bëri disa hapa të tjera përpara, megjithëse ndjente një dhëmbje therëse në këmbë, duke haruar se poshtë në fushë ata po shastiseshin.

Zgavra po bëhej gjithnjë e më e ngushtë, ajri po freskohej, po drita po kthjellohej. Dëgjoi gurgullimën e ujit që rridhte nën këmbët e tij.

«Këtu qënka burim!» — tha dhe ndezi fenerin elektrik që mbante me vete.

«Si qënka krijuar kjo e çarë tamam si tunel këtu thellë kodrës! Siç duket, nga ujrat e nëndheshëm...»

U kujtua se duhej të kthehej, po në këto e sipër syri i zuni diçka që shndriste rrëzë një shkëmbi.

«Po kjo ç'është?...»

U afrua dhe më afër dhe mbeti i shtangur.

* * *

dhe = ne (mp)
nófull jaw
i rrëshqítshëm slippery
përtërij revive
rërë sand
shtëllís unfold; reveal
gjysmë errësírë half-darkness
i lehtësúar relieved
shtjéllë unfolding
shpéllë cavern
fenér lantern
e çárë opening; split
i nëndhéshëm underground

— Ç'u bë? Ç'ngjau me të?
— Si u zhduk ashtu?
— Mos e përpiu goja! Mjerë ai!...
— Mjerë dhe ne... Po tani, uratë, ç'do të ngjasë?

Kështu flisnin disa fshatarë. Po urata diç belbëzonte, vështronte me frikë përreth e zbardhej në fytyrë.

— Ç'pati? Mos i ka rrëshqitur këmba në ndonjë hon të fshehur në errësirë? Si t'i ndodhte tashti që çdo gjë po shkonte kaq mirë! — tha me vete sekretari i partisë dhe vështroi të rinjtë që s'po merrnin vesh se ç'po ngjiste.

Por, papritur, në gojën e stërmadhe u duk alpinisti me flokët e thinjur. Sekretari i partisë nuk mundi ta përmbajë një britmë gëzimi që i shpëtoi thellë gjoksit. Turma lëshoi një pasthirmë habije.

— Shiheni, qënka gjallë!
— Vërtet gjallë qënka!
— More, po s'paska ngrirë!
— Heshtl Mbase tani do bëhet gjëma!
— Uratë, për hir të perëndisë, thuajna ç'do të ngjasë tani!

Po urata kishte mbetur i tromaksur, me sytë e kapsallitur dhe dridhej i tëri.

— Bobo, e paska humbur edhe urata!...

Sekretari i partisë u mat të flasë. Ky ishte rasti që kishte pritur prej kohësh. E vërteta po çfaqej tani me tërë lakuriqësinë e saj. Mirëpo në çast u dëgjua zëri i alpinistit me flokë të thinjur:

— Hej, kaloni prapa kodrës, ngjituni te rrapi buzë shkëmbit që është pranë kodrës, hiqni shkurret, lëvizni gurët dhe, nga një grykë, do të vini deri këtu ku jam unë!

Këto fjalë u përplasën si bombë midis turmës që u lëkund.

— More, po ç'thotë ai! Dashka të vemi dhe ne! Si është e mundur që të ketë grykë nga prapa kodrës?

— Mos e dhëntë perëndia! Ka apo s'ka grykë andej, aq më bën mua.

— Të vemi, të vemi!
— E ç'të shohim? Djallin me brirë? Lipsur qoftë!
— Do të na ndëshkojë perëndia!

U bë rrëmujë. Njerëzit flisnin si mundnin.

— Mos kini frikë. Ju e shikoni se mua asgjë nuk më ka ngjarë. Lerini mënjanë përrallat dhe ejani prapa kodrës. Atëhere do të shihni të vërtetën! — thirri alpinisti me flokë të thinjur dhe zëri i tij kumboi si kushtrim.

shdris = shëndrís shine; gleam
diç something
belbëzój stammer; stutter
hon gulch; chasm
pasthírmë interjection
i tromáksur traumatized
i kapsallítur blinking
e páska húmbur has lost his bearings
rrapí grove
grýkë passage; throat
lípsur qóftë far be it from me
rrëmújë confusion

— Ejani, ejani! — përsëriti sekretari i partisë.

Turma u zmbraps e mbeti në mëdyshje, por, kur pa-që të rinjtë e shumë fshatarë të tjerë shkuan pas sekretarit të partisë, si të shtyrë nga një forcë e brendëshme, u dha përpara dhe la pas uratën, që, duke i ndjekur, çirrej:

— Mos shkoni! O perëndi, mjerë ne ç'do të na ngjasë!...

• • •

Sekretari i partisë, fshatarët dhe alpinistët e tjerë tani ishin ngjitur mbi burimin pranë shkëmbit, ku ndodhej trupi.

— Këtu, këtu! — u dëgjua një zë sikur vinte nga poshtë dheut.

— Hiqini këto shkurre, se shkëmbenjtë lëvizin lehtë.

Ishte zëri i alpinistit me flokë të thinjur.

Sekretari i partisë dhe nja dy të rinj deshën të heqin shkurret, kur përsëri vunë re se ato u shkulën vetë që nga rrënja. Dukej se një dorë e huaj i kish shkulur më parë, dhe, për të humbur gjurmët, i kish vënë përsëri atje. Filluan të heqin gurët që mbyllnin një grykë të lartë jo më shumë se një metër. Aty u duk koka e alpinistit me flokë të thinjur.

Tek po bëhej gati të hynte, sekretari i partisë pa uratën që duke gulçuar belbëzonte:

— Në kini perëndi mos u futni atje... E kuptoni... atje ju... gjëma do të bëhet... Mos, mos hyni!... — uluriu ai dhe ra më gjunjë.

Turma lëvizi e tmerruar.

— Po çmëndet! — tha dikush.

— Vërtet që po çmëndet!

Sekretari i mori një të riu aty pranë një pishtar të ndezur e, duke u mbështetur në krahun e alpinistit me flokë të thinjur, u fut brenda grykës. Pas tij dhe fshatarët e tjerë. Urata mundohej t'i pengonte, po në çast një nga të rinjtë, duke e shtyrë, e futi brenda dhe i tha:

— Eja dhe ti e të shohim sa do të ngrish brenda!

Urata bëri një përpjekje për të dalë, po turma, që kish marrë zemër nga fjalët e sekretarit, e mori përpara.

Gryka po zgjerohej dhe drita e pishtarëve ndriçonte shkëmbinjtë të çarë me të dala. që dukeshin si gjymtyrë të coptuara.

Befas turma u ndal. Disa nuk i përmbajtën britmat e habisë.

— Shikoni këtu! — tha alpinisti me flokë të thinjur, duke treguar me gisht.

zmbrápsem withdraw
çírrem scream
gulçój pant; gasp
pishtar torch bearer
zgjeróhem expand
gjymtýrë limb
bataníje blanket
shíshe bottle

Sytë e të gjithëve pushtuan kryqin e artë, dy shandanët që ishin zhdukur nga kisha, disa batanije të leshta, dy a tri shishe me verë dhe bukë meshe:

— Po kryqi e shandanët ç'duan këtu?

— Ai që i ka vjedhur, i paska fshehur!

— Ama kjo na paskish qënë guvë kusarësh, kurse neve na kish hyrë djalli në bark qysh prej vjetësh!...

— Çudi, po shishet e mia me verë, që i solla dje uratës, ç'dashkan këtu?

— More, po dhe bukët e meshës që bëri pardje ime shoqe qënkan këtu!

— Përsëri e paskan vjedhur kishën. Po urata s'na tha gjë!

— Hë, uratë! Po, ku është ai?...

Të gjithë ktheyen sytë prapa dhe panë të strukur rrëzë një shkëmbi uratën, që vështronte i llahtarisur. Ai desh të kthehej, të ikte, kur pa që po e vështronin me urrejtje, po një nga të rinjtë i doli përpara.

— E njihni këtë shkrim? — tha sekretari, duke i afruar disave që ndodheshin aty pranë një copë letër.

— Ky është shkrimi i uratës.

— Po, po. Ai vetë e ka shkruar.

— Çfarë ka shkruar?

— Dëgjoni këtu! — tha sekretari i partisë me një zë që dridhej nga urrejtja dhe nisi të lexojë:

«Mos u afroni në kishë. Fshatarët kanë filluar t'iu gjurmojnë dhe mund t'ju kapin. Merrini këto ushqime dhe shkoni drejt shtigjeve, që ju kam treguar.»

— Ah, djall i mallkuar! Pra, ti i paske bërë të tëra këto!

— Na ke llahtarisur tërë jetën me këtë legjendë.

— Ndaj thërrisnje ashtu, kur po zbriste alpinisti!

— Të kemi besuar si perëndi, po ti qënke dhe armik, o i mallkuar.

— Paske sjellë këtu dhe kryqin dhe shandanët për të humbur gjurmët, për të na tmerruar.

— Bjerini, mbyteni si qeni!

Urata zgurdulloi sytë lëshoi disa fjalë pa kuptim dhe u shemb përtokë duke humbur ndjenjat.

— Lereni! — tha sekretari i partisë, teksa shihte që atë dhe alpinistin me flokë të thinjur po i shikonin me ngrohtësi. — Ai do të marrë dënimin e merituar. Ja, ky ishte fundi i legjendës. Tani, përpara të kapim bandën e diversantëve.

Dhe u sul nga gryka e ngushtë, i ndjekur nga turma e fshatarëve, ndërsa dy a tre veta po ngrinin trupin e uratës që dukej më tepër i vdekur se i gjallë.

kusár thief
i strúkur huddled
gjurmój trail; follow
kap capture
zgurdullój pop out; bulge

dashamírë friend; well-wisher
rindërtój rebuild

THIMI MITKO
(1820-1890)

I lindur në Korçë, ai mësoi në shkollën fillore greke të qytetit. Që në të ri e shohim dashamir të diturisë: me 1843 rindërton shkollën e shembur të Korçës. Më 1850, i ungji, Peti Mitkoja, udhëhoq të krishterët e qytetit që nuk dëgjonin të bëjnë shërbimin ushtarak. Qëndresa e tyre fitoi, po Petit iu desh të marrë kurbetin. Pas tij shkoi edhe i nipi, i cili u vendos së fundi në Misir. Në kurbet, aty nga mezi i viteve '60, Mitkoja iu vu punës për mbledhjen e folklorit shqiptar, nën nxitjen e De Radës e të Kamardës, me të cilët kishte lidhur miqësi të ngushtë. Pionier i lëvizjes patriotike të shqiptarëve të Misirit, Mitkoja bëri përpjekje të vazhdueshme për organizimin e tyre dhe të lëvizjes kombëtare në përgjithësi.

Më 1878, në pragun e krijimit të Lidhjes së Prizrenit, të cilën e mbrojti me zjarr, ai botoi në Aleksandri përmbledhjen e tij folkloristike, «Bleta shqiptare», që u prit shumë mirë nga rrethet e patriotëve dhe nga shkencëtarët e huaj që interesoheshin për shqipen e për traditat tona popullore. Mitkoja u miqësua ahere me albanologët Jarnik, Majer etj, të cilëve u dërgonte lëndë folkloristike shqiptare. Midis dorëshkrimeve të Jarnikut, u gjet këto vitet e fundit në Pragë një vëllim i panjohur i Mitkos, me lëndë folkloristike që mbledhësi e kishte gati për shtyp më 1889, po që mbet pa u botuar (10). Mitkua provoi edhe vjershërinë, sidomos në kohën e Lidhjes së Prizrenit.

Ai vdiq në Beni-Suef të Misirit më 1890.

Vjershat origjinale të Mitkos, veç ndonjë fragmenti, janë pa vlerë artistike. Po ato janë ndër krijimet e para të poezisë shqiptare të frymëzuar nga lëvizja jonë kombëtare. Vjershëtari është ndër të parët që e ka shprehur

10) Gjithësejt 157 faqe me këngë lirike dhe epike, përralla, proverba të përcjellura me shënime italisht e greqisht, shpesh te përkthyera frëngjisht. I zbuloi Dh. Pilika. Familja e Mitkos ruan në Misir një tjetër dsh të tij me folklor, që është quajtur «Bleta e vogël».

19.— Thimi Mitko, 1820-1890.

haptazi e me forcë në letërsinë tonë të re unrejtjen ndaj pushtuesit dhe dëshirën e shkëputjes prej tij. Në një kohë kur lëvizja jonë kombëtare shtronte zakonisht vetëm kërkesa kulturale, duke menduar se për së shpejti do të ndizet edhe në Shqipëri lufta çlirimtare, ashtu si dhe Serembeja dhe ndonjë tjetër, Mitkoja shkroi disa nga vargjet më të guximëshme të poezisë sonë përpara Lidhjes së Prizrenit. Kështu, që përpara vitit 1870, ai i bënte thirrje popullit të rrëmbejë armët kundër Turqisë.

O vëllezër shqiptarë,
pse duroni halldupnë?
Mblidhij turq e të krishterë,
kërkoni lefterinë,
përpiqi si tjatër herë
e përzëni tiraninë.
Leni besatë mënjanë
e luftoni gjithë bashkë,
pra, si të zboni Osmanë,
bëni bajram, bëni pashkë.

halldúp barbarian
mblídij = mblídhuni
lefterí liberty
përpíqi = përpíquni
përzëni = përzíni
léni = líni
zboj chase away
bajrám chief Moslem holiday
páshkë Easter

O vëllezër, mos haroni,
mos merrni fjalën prapë,
po të tërë të bashkoni
e të merrni armëtë vrapë. (11)

Gjithë këtë ton kanë edhe vjershat e tij të viteve 1878-1880, ku ai fton popullin të mos lëshojë asnjë pëllëmbë tokë të atdheut, po më mirë të vdesë me armë në dorë. Ahere u përshtat shqip edhe hymni i revolucionit francez, «Marsejeza», me sa duket prej Mitkos, që e botoi si fletë të shkëputur gjatë konfliktit shqiptaro-malazez, si një këngë kushtrimi. Thirrja për të mbrojtur kufinitë e Shqipërisë, aty shoqërohet me urrejtjen e papërmbajtur kundër pushtuesit turk dhe me grishjen për të rrëmbyer armët kundër tij. Shqipërimi i këtij hymni të revolucionit borgjez frëng të vitit 1789, dëshmon për idetë demokratike që frymëzonin rilindësit.

Duke parë se lëvizja jonë kombëtare ishte akoma në fillimet e saj dhe e dobët, i ndikuar prej kulturës greke dhe prej mendimit të Kamardës, se popujt shqiptar e grek dhe gjuhët e tyre janë gjëri që së lashti, Mitkoja është çfaqur në vjershat e tij për një mbështetje te Greqia. Një mendim të tillë kishin edhe patriotë dhe shkrimtarë të tjerë të kohës si, fjala vjen, Gavrill Dara i Ri. Mitkoja mendonte që të krijohej një shtet i madh shqiptaro-grek, ku secili popull të ruante veçoritë e të drejtat e tij. Kështu do të shpëtonin nga çkombëtarizimi edhe arbëreshët e Greqisë, të cilët bëheshin disa qindra mijë dhe kishin filluar të asimilohen. Në kohën e Lidhjes së Prizrenit, Greqia jo vetëm që nuk e ndihu lëvizjen tonë kombëtare, po e luftoi.

11) Vjersha «E ndër shqiptarëtë gjithë sa janë», te A Dora d'Istria-gli alb., fq 122. Botuar pa emër auktori dhe me shënimin se ka qenë botuar dhe tjetër here.

bashkóni = bashkóhuni
përshtát adapt
malazéz Montenegrin
grísbje appeal; call
gjëri related to one another
që së láshti since old times
fjála vjen for example
çkombëtarizím denationalization
e ndíhu = e ndihmói

Ahere Mitkoja nisi të humbë iluzionet që kish, sidomos kur i dogjën edhe librin në mes të sheshit publik, në Athinë.

«Bleta» e Mitkos është botimi më i rëndësishëm i folklorit të Shqipërisë gjatë Rilindjes. Në lëndën e saj të bollëshme e të zgjedhur, përfaqësohen thuase tërë gjinitë e folklorit tonë, si këngët e riteve të motmotit dhe të familjes, erotika, këngët e kurbetit e të nizamit, epika historike dhe trimërore, dëgka edhe gjëzat, proverbat, përrallat. Epika legjendare aty përfaqësohet shumë pak, për arësye se Mitkoja mblodhi e botoi kryesisht folklorin e jugut të Shqipërisë, ku këngët legjendare ishin bërë të rralla. Folkloristi tregohet mbledhës i saktë e me shije, ai boton zakonisht gjëra me të vërtetë të bukura. Aty-këtu, Mitkoja e ka prekur lëndën, po me shumë maturi, për të zëvendësuar ndonjë turqizmë me fjalë shqipe.

Botimi i «Bletës» më 1878 qe një manifestim i bukur i gjenisë poetike shqiptare, në një kohë kur në Berlin popullit tonë i mohohej gjer ekzistenca dhe kur studiozë të huaj nuk linin gjë pa shkruar kundër Shqipërisë. «Bleta» e Mitkos provonte në mënyrë të shkëlqyer, se në Shqipëri jetonte shumë e gjallë dhe zhvillohej pa pushim një letërsi popullore me cilësi të mëdha artistike; se gjatë pushtimit turk ishin krijuar disa nga gjërat më të bukura të folklorit tonë, si fjala vjen një numur i pambaruar këngësh historike dhe të trimërisë, në të cilat i thuren himne qëndresës së madhe e luftës së paprerë të popullit shqiptar kundër pushtuesit anadollak. Në këngët historike të botuara prej Mitkos, flitej veçanërisht për përpjekjet e Bushatasve dhe të Ali pashë Tepelenës për t'u shkëputur nga Turqia, e sidomos për kryengritjet e shumta popullore që plasën në Shqipëri në kohën e Tanzimatit. Ajo epikë bëri një përshtypje të madhe tek lexuesit shqiptarë e të huaj. E botuar më 1878, ajo ishte një grishje e vërtetë për të mbrojtur vendin prej grabitjeve të shteteve fqinje dhe për të rrëmbyer armët kundër Turqisë. Më 1885, Majeri shkruante, se me «Bletën» e Mitkos *«u provua si e vërtetë ajo që më parë dyshohej, se dhe tek shqiptarët jeton ndër këngë kujtimi*

i bóllëshëm = i bóllshëm plentiful
i zgjédhur well-chosen
motmót year
nizám soldier in the Turkish army
prek alter; touch
maturí discretion
zëvendësój replace
studióz scholar
thur weave
qëndrésë resistance
grabítje grabbing

i ngjarjeve të ndryshme të historisë kombëtare» ([12]). Në fakt, «Bleta» e Mitkos provoi më shumë se kaq: ajo provoi se gjatë qëndresës së madhe të popullit shqiptar kundër Turqisë, letërsia popullore shqipe kishte ecur përpara, ishte zhvilluar. Kënget e dasmës, erotika, lirika në përgjithësi, që botoi Mitkoja, shpalosin bukuritë e mëdha të folklorit shqiptar, bukuri të cilat njeriu mund t'i diktonte që te kënget e para të poezisë popullore shqiptare të jugut të botuara nga Hahni (1854).

Më 1878 letërsia e Rilindjes ishte akoma në provat e saj të para në Shqipëri. Botimi i «Bletës» qe një ngjarje me rëndësi të madhe. Në atë vepër, poetët e rinj mund të mirrnin shëmbëll e të mbështeteshin me përfitim të madh për krijimtarinë e tyre. Këtë bëri veçanërisht Çajupi.

SPIRO DINE (1844-1922)

Mitkoja pat një nxënës e bashkëpunëtor të zellshëm, i cili, edhe ai, e çoi më të shumtën e jetës në Misir, Spiro Dinen, nga Vithkuqi i Korçës. Ky kishte marrë pjesë aktivisht në lëvizjen e Rilindjes, veçanërisht në organizimin e shqiptarëve të Misirit, ku vajti shumë i ri dhe ku vdiq. Që nga viti 1868, e shohim të shkruajë vjersha në frymë popullore, kundër pushtuesit turk dhe për lirinë e Shqipërisë. Dineja prek gati gjithë temat e zakonëshme të rilindësve. Ai nuk arriti t'i botojë me kohë vjershat e tij, po i mblodhi në librin «Valët e detit» (1908). Aty futi edhe një numur të mirë vjershash patriotike, fabulash, satirash etj, nga Koto Hoxhi, Thimi Krej, Loni Logori, Kristo Floqi, Jani Vruho etj. Shkrimet e tij dhe ato të miqve të tij zënë gati gjysmën e librit. Gjysmën tjetër e zë folklori, — një numur i madh kënges popullore të gjinive të ndryshme, një shumicë provenbash e fjalësh të urta, përralla etj. Folkloristi na thotë vetë, se ai iu vu mbledhjes së letërsisë gojore nën nxitjen e Mitkos, që nga viti 1866, kur vajti në Misir. Ai na mëson gjithashtu, se një pjesë të lëndës që kishte mbledhur vetë, ia kishte dhënë

12) G. Meyer, Della lingua e della letteratura albanese, në Nuova antologia, prill 1885, sp Petrotta, Pop., lingua e lett. alb., fq 210-219.

diktój detect
i zéllshëm zealous
gojór oral

20.— Spiro Dine, 1844-1922.

Mitkos. «Valët e detit» është një nga botimet më të rëndësishme e më të gjera të folklorit shqiptar gjatë Rilindjes. Pasuria e grumbulluar në të është e madhe. Herë-herë, aty gjejmë variante me interes të këngëve që na kishin dhënë më parë Mitkoja e ndonjë tjetër. Dines i ka munguar ai kujdes që e shquan Mitkon në regjistrimin dhe në zgjedhjen e këngëve që boton. Shënimet me të cilat i shoqëron këngët, janë të rralla e të pamjaftueshme. Ngatërron aty këtu gjinitë ose bashkon këngë të ndryshme në një të vetme. bën edhe përdhunime vargjesh. Sidoqoftë, në pjesën më të madhe lënda paraqitet mirë.

"Mbledhës të folklorit Th. Mitko dhe S. Dine" in Dh. Shuterigi et al (Eds.) Historia e letërsisë shqipe II, Tiranë, 1959, pp. 237-242

i gjérë extensive; broad
përdhunîm descecration; violence

SPORT

LEXIMI I SHTATEDHJETETRETE

BASKETBOLL

V. SHUNDI

PER ARRITJE TE METEJSHME

Mjaft ndeshje të një nivelli të kënaqshëm tekniko-taktik, pjesëmarrja në ndeshje e mjaft elementeve shtatlartë e me të ardhme premtuese, përpjekjet për lojë me sistem e sidomos në sulm — këto ishin disa nga karakteristikat e aktiviteteve në lojërat e basketbollit për meshkuj e femra për vitin 1976-1977. Skuadrat në përgjithësi në këtë kampionat treguan pregatitje më serioze.

Në këto aktivitete ka pasur rivalitet dhe në mjaft takime skuadrat fituese janë përcaktuar vetëm në sekondat e fundit dhe me rezultate të ngushta. Si ndeshje të tilla mund të përmendim për meshkuj takimet «Labinoti» — «17 Nëntori» 73-74; «Vllaznia» — «Lokomotiva» 102-101; «Dinamo» - «Vllaznia» 90-88; «Vllaznia» - «17 Nëntori» 90-87; «Studenti» - «Flamurtari» 73-74 etj. Ndërsa për femra mund të përmendim takimet «Labinoti» - «Flamurtari» 77-73; «17 Nëntori» — «Skënderbeu» 61-60; «Apollonia» - «Lokomotiva» 61-58; «Labinoti» - «Partizani» 62-63.

mjaft ndéshje a considerable number of matches
elemént player; element
shtatlártë tall
lójë game
skuádër squad; team
kampionát championship
fitúes winner; victor
i shënúar scored
shënúes scorer
gjúaj shoot
pësój lose; experience
denjësísht worthily
konkurój complete; contest
i barabártë equal
shpénë (shpíe) push; carry; take
ekíp personnel; team; roster
titullár title-holder

Në përgjithësi ka një shpërndarje proporcionale të pikëve ë shënuara tek të gjitha skuadrat pjesëmarrëse ndërmjet lojtarëve që aktivizohen. Shënuesit më të mirë për meshkuj psh. në fund të fazës së parë ishin G. Angjeli i «Flamurtarit» me 223 pikë, N. Froku i «Kastriotit» me 213 pikë dhe V. Agaraj i «Lokomotivës» me 202 pikë; ndërsa për vajza më shumë shënoi Xh. Shestani e «Vllaznisë» 284 pikë dhe pas asaj u rreshtuan F. Xhyra e «Labinotit» me 223 pikë dhe S. Sinoimeri e «Luftëtarit» me 206 pikë.

Për meshkuj, «Partizani» është një skuadër me përvojë ndeshjesh edhe ndërkombëtare, luan shpejt dhe lojtarët e saj gjuajnë mirë e shënojnë shumë pikë; ka një mbrojtje të organizuar mirë, që ka pësuar më pak pikë se gjithë skuadrat e tjera. Denjësisht konkurojnë edhe «Vllaznia», «17 Nëntori» e «Dinamo».

Për femra rivaliteti është akoma më i madh. Këtë e dëshmon dhe rreshtimi i skuadrave në klasifikim njëra pas tjetrës vetëm me një pikë diferencë. Në krye të tabelës «17 Nëntori» e «Flamurtari» e mbyllën fazën e parë me pikë të barabarta. Këto dy skuadra u treguan më të pregatiturat. Por nuk qëndrojnë larg tyre dhe «Apollonia», «Skënderbeu» e «Vllaznia».

Pavarësisht nga sukseset e arritura, skuadrave tona të kategorisë së parë si për meshkuj ashtu dhe për femra u mbetet ende shumë për të bërë, për ta shpënë akoma dhe më përpara basketbollin tonë. Del nevoja e kompletimit të disa ekipeve (meshkuj e femra) me rezerva, me elementë të zgjedhur ashtu si duhet dhe të punohet me ta që të arrijnë nivelin e titullarëve. E themi këtë sepse në mjaft ekipe pak i kushtohet vëmendje kësaj çështjeje. Dhe nuk janë të pakta rastet që një mungesë e tillë t'i ketë kushtuar skuadrave dhe humbjen. Për këtë duhet punuar akoma më mirë me ekipet e të rinjve, tek të cilët zgjedhja të bëhet duke parë perspektivën dhe jo sa për t'u përfaqësuar në një kampionat. Këtu nuk duhet harruar për asnjë çast problemi i elementëve shtatlartë shumë të nevojshëm për basketbollin tonë.

Për të plotësuar mungesën e shtatlartësisë së nevojshme që vërehet akoma në ekipet tona dhe duke u mbështetur dhe në përvojën e takimeve ndërkombëtare, i duhet kushtuar më shumë kujdes disa elementëve të lojës, siç janë kërcyeshmëria (elasticiteti) për luftën në tabelë ndaj një kundërshtari me shtatlartësi më të madhe; rritja e shpejtësisë së lojës si edhe shtimi i saktësisë në gjuajtje, sidomos nga distanca, gjysmë-distanca dhe ato të lira. Çdo skuadër duhet të punojë që të ketë jo një e dy, por të gjithë lojtarët të aftë që të gjuajnë me saktësi nga distanca të ndryshme, sepse numri i tyre është ende i vogël.

Të gjitha këto arrihen duke rritur kërkesat në stërvitje, duke punuar për përmirësimin e cilësive tekniko-individuale të lojtarëve, duke i gërshetuar ato me punën kolektive të të gjithë skuadrës.

kërcyeshmërí jumping
tabélë balckboard; board
shtim growth; increase
stërvítje practice
më = për (mp)
përmirësím improvement
gërshetój braid; twist together

FUTBOLL

ILIR RITMIKU

«17 NENTORI» - FITUES I KUPES SE REPUBLIKES

futbollíst soccer player
kúpë cup
cilësór qualitative
repárt team; department
táshmë = tashtí
ambícje ambition
sédër pride
futbollistík pertaining to soccer
luhátje wavering

Ky vit shënoi një ngjarje të rëndësishme për kolektivin e futbollistëve të «17 Nëntorit»; ata fituan kupën e Republikës.

Finalet e kupës treguan edhe njëherë përparimet që ka bërë futbolli ynë, hopin cilësor në rritje dhe punën e mirë që po bëjnë të gjitha klubet tona për pregatitjen e futbollistëve të rinj. Veçanërisht ndeshjet finale midis «Dinamos» dhe «17 Nëntorit» paraqitën karakteristikat e vërteta të futbollit tonë; korektësinë, shpirtin luftarak e pasuruar kjo edhe me cilësi të lartë tekniko-taktike.

Të dyja finalistet qenë të denja për njëra-tjetrën. «Dinamo» kampione, një skuadër e plotë dhe me lojë të pjekur në të gjitha drejtimet, që ka një mbrojtje të fortë e të kujdesshme, me një repart në mesin e fushës, ku spikat loja plot fantazi dhe pjekuri e Çeços, dhe me një vijë sulmi tashmë të njohur si një nga më të mirat e skuadrave tona, u takua në finale me «17 Nëntorin».

Është, pra, meritë e të dyja skuadrave tona të njohura, që i dhuruan publikut dy ndeshje të bukura, nga më të mirat që kemi parë në stadiumet tona. Natyrisht, meritat më të mëdha i përkasin «17 Nëntorit», sepse në këto ndeshje arriti një fitore të merituar pikërisht sepse ajo demostroi në fushat e lojës cilësitë më të mira të saj, lojën me ritëm të lartë, shpirtin e sakrificës, ambicjen e sedrën e mirë sportive të krejt kolektivit, pregatitjen fizike dhe nivelin e saj tekniko-taktik që po ngrihet gjithnjë e më shumë.

Vazhdimi me konsekuencë i lojërave me nivel të mirë është detyrë e të gjithë kolektivave tona futbollistike dhe rrit personalitetin e çdo skuadre. Si skuadër me tradita, «17 Nëntori» ka pa-

suruar gjithmonë e më shumë cilësinë e lojës së saj. Duke krahasuar jo vetëm rezultatet, por edhe mënyrën se si ka luajtur ajo në fazën e parë të Kampionatit kombëtar të futbollit 1976-1977, në finale arriti të korigjojë mjaft nga të metat e saj, që paraqiti në fazën e parë.

Domosdo që fitorja e kupës është një meritë e dyfishtë, pasi «17 Nëntori» e fitoi atë dy herë radhazi dhe kjo i shton edhe më shumë detyrat e kësaj skuadre për rritjen e cilësisë sportive, për të zhvilluar në të ardhmen ndeshje pa luhatje tekniko-taktike dhe me një harmonizim më të madh të lojës si midis reparteve ashtu edhe ndërmjet lojtarëve me të rinj.

Tani që po zhvillohen ndeshjet e fazës së dytë të Kampionatit kombëtar të futbollit, rivaliteti midis ekipeve është rritur mjaft dhe për të gjithë futbollistët dalin detyra të mëdha për ta çuar edhe më përpara futbollin tonë.

FAQE NGA TRADITAT TONA SPORTIVE

«FLAMURTARI» I VLORES

V. RUSHITI

Në vitin 1915 futbolli ndezi shkëndijat e tij. të para në Vlorë. Në vitin 1918 skuadra e qytetit zhvilloi ndeshjen e saj të parë. Në vitin 1921 në vendin tonë lëvizja e përgjithshme demokratiko-borgjeze po zgjerohej gjithnjë e më shumë. Patriotët demokratë, që ishin në krye të kësaj lëvizjeje, kërkonin që të afronin dhe të bashkonin rininë e popullin rreth vetes. Prandaj, me inisiativën e patriotit të shquar Avni Rustemi, në qytetin e Vlorës u mblodh kongresi i bashkimit kombëtar, i cili miratoi njëzëri bashkimin e të gjitha shoqërive të Federatës së madhe «Atdheu», në statutin e së cilës, përveç të tjerave, përfshihej edhe aktiviteti sportiv. Më 23 mars 1923 u formua shoqëria sportive me emrin «Jeronim De Rada» dhe më vonë kësaj shoqërie iu dha emri «Ismail Qemali», të cilin e kr mbajtur edhe në vitet e para pas fitores mbi nazistët gjermanë e tradhtarët e vendit. Tani ai quhet klubi sportiv «Flamurtari».

Në kujtimet e tij, një veteran shkruan: «Jemi në muajin qershor 1930. Shkojmë në Korçë për të zhvilluar ndeshjen e parë të parit kampionat kombëtar të futbollit. Mbas tre ditë udhëtimi të lodhshëm zhvilluam ndeshjen në mënyrë më vëllazërore, të cilën e fituam me rezultatin 1:0. Kjo fitore bëri bujë. Sportdashësit vlonjatë na priten me shumë entuziazëm».

Në kampionatin e parë kombëtar të notit më 1930, midis 50 notarëve Vlora u përfaqsua me 12 djem. Pa dyshim, një figurë të mirë në atë kohë kanë bërë edhe atletët vlonjatë.

Pas pushtimit të Shqipërisë, fashizmi italian zbatoi në mënyrë sistematike politikën e fashistizimit të vendit. Ata që në fillim morën masa organizative për të formuar shoqëritë e tyre sportive. Ata përdorën forma dhe metoda të ndryshme për të afruar të rinjtë rreth tyre, por qëllimi i tyre djallëzor nuk u realizua. Që në vitin 1940 të rinjtë vlonjatë nuk u panë më në takime zyrtare sportive që organizonin fashistët. Por futbolli nuk u shua. Me formimin e Partisë Komuniste, komunistët e të rinjtë komunistë, duke parë synimet e fashistëve. i kushtuan kujdes grumbullimit e aktivizimit të rinisë në sport e sidomos në futboll, shfrytëzonin ndeshjet sportive për afrimin e rinisë në

flamurtár standard bearer
shkëndíjë spark
riní youth
vëllazërór fraternal
bëj bújë cause a great sensation
sportdáshës sport lover
vlonját resident of Vlorë
not swimming
notár swimmer
djallëzór devilish
syním aim
lágje neighborhood
qarkór regional
studenté scholastic
përkujtój commemorate
gárë competitive match
paléstër gymnasium
poligón qítjeje shooting range
radioamatorízëm pertaining to amateur radio

lëvizjen nacional-çlirimtare. Ndeshjet sportive në këtë kohë zhvilloheshin më tepër midis lagjeve e me qytetet e afërta si me Fier'n, Lushnjën e Beratin.

Më 25 maj 1943 në Babicë u zhvillua nën drejtimin e komitetit qarkor të Partisë e në fshehtësinë më të madhe një piknik i madh sportiv i rinisë punëtore e studenteske. Edhe sot kjo ngjarje përkujtohet çdo vit po në atë vend me gara e ndeshje të ndryshme të rinisë. Nga gjiri i futbollistëve vlonjatë dhanë jetën për çlirimin e vendit dëshmorët Mitaq e Lef Sallata, Teli Ndini dhe Fadil Dauti.

Dëshmori Lef Sallata.

Sporti i vërtetë, si në të gjitha fushat e tjera të jetës, u zhvillua me të gjithë madhështinë vetëm pas Çlirimit të vendit, në sajë të kujdesit të madh të Partisë e të pushtetit popullor. Kushtet e krijuara për sportistët dhe bazat materiale që janë vënë në dispozicion të tyre janë një dëshmi e qartë e këtij kujdesi. Sot Vlora është pjesëmarrëse në të gjitha disiplinat sportive me 70 ekipe. Klubi sportiv «Flamurtari» ka rreth 1000 sportistë e sportiste, midis tyre 20 mjeshtra sporti. Në dispozicion të tyre sot janë 2 stadiume, 3 fusha futbolli, 4 palestra, 5 terrene sportive të hapura për lojrat me dorë, 1 poligon qitjeje, 1 sallë radioamatorizmi, pishina e notit që është në ndërtim e sipër.

Skuadra e futbollit «Flamurtari» ka debutuar gjithmonë me dinjitet në kategorinë e parë. Nga gjiri i sportistëve vlonjatë kanë dalë shumë mjeshtra dhe rekordmenë që kanë mbrojtur me dinjitet ngjyrat e «Flamurtarit» dhe ato të ekipit kombëtar.

From Ylli (Tiranë) No.2 (February), 1977, pp.32-33

pishínë pool
debutój come out; debut
dinjitét dignity
rekordmén record holder

LEXIMI I SHTATEDHJETEKATERT

kritér criterion
i rëndómtë common; ordinary
mbarështrój order; set forth
përtëdhánie derivation
tejkalój surpass
suázë framework
méqë inasmuch as; since

Vetitë kryesore të filosofisë të pragmatizmit

Doktrina e parë filosofike me rëndësi, e krijuar në Shtetet e Bashkuara t'Amerikës ka qenë pragmatizmi, sistem i ideve që i është prezentuar opinionit amerikan dhe botëror nga mbarimi i shekullit të kaluar dhe në fillim të këtij shekulli. Momenti i çfaqjes së pragmatizmit në atë kohë, i përgjigjet plotësisht rrethanave shoqërore-ekonomike në ato vënde, ku lindi dhe u zhvillua si filozofi, e cila sjell me vete qëndrim metodologjik për zgjidhjen e çështjeve shoqërore, është përhapë me shpejtësi të madhe dhe ka fituar popullaritet, jo vetëm në qarqet profesionale filosofike, por edhe në ato shkencore dhe të njerëzve të arësimuar. Fjala p r a g m a t i z ë m rrjedh prej greqishtes p r a g m a, që dmth., vepër, punë, akt, sukses etj. Ky është një drejtim filozofik që konsiderón se veprimtaria dhe vlefta praktike janë kritere vendimtarë për caktimin e kuptimit ose të vërtetësisë së teorive. Në jetën e rendomtë: vlefta praktike duhet të jetë rregulluesi suprem i mendimit dhe i veprimit njerëzor.

Për përhapjen e vrullëshme të pragmatizmit ka kontribuar Vilijem Xhemsi, i cili idetë e tij i ka mbarështruar në një mënyrë të shkathtë, me një stil konkret dhe në një formë adekuate. Prandaj, mund të thuhet, se popullariteti i pragmatizmit ka përtëdhanie jo aq thellsisë dhe origjinalitetit të teorisë së tij filosofike, por mënyrës në të cilën është mbarshtruar kjo doktrinë. Për këtë arsye Xhemsi ka qenë, dhe mbetet deri më sot si filosof i shquar amerikan. Përveç kësaj, pragmatizmi është përpjekë të bëjë kthesë në koncepcionet filosofike të deriatëhershme. Shpesh herë deklarativisht, por ngu një herë edhe faktikisht, ai e ka tejkaluar suazën e mendimeve filosofike tradicionale. Ky drejtim filosofik është një ngjarje me rëndësi meqë çfaqet si

orvatje për zgjidhjen e krizës së njerlut modern, prandaj edhe përhapet me vrull të madh.

Sikurse e tërë kultura, shkencat ashtu edhe filosofia pragmatiste lindi dhe u zhvillua nën ndikimin e kulturës dhe filosofisë europiane. Zhvillimi i filosofisë empiriste n'Europë ka qenë njeri ndër impulset e parë që ka vepruar dhe ndikuar në çfaqjen e një filosofie të re, origjinale, burimore amerikane, sikurse është pragmatizmi. Mendimtarët amerikanë në atë kohë qenë të angazhuar me probleme gati të njëjta, sikurse mendimtarët dhe mësuesit e tyre në kontinentin tonë. Lindja e pragmatizmit dhe e rrymave të tjera filosofike në Shtetet e Bashkuara t'Amerikës, nuk është spontane, por është rezultat i zhvillimit specifik të shoqërisë atje dhe e mendimit të ri tipik amerikan.

Karakteristikë kryesore e këtij drejtimi filosofik, që është duke luajtur një rol të madh në këtë kohë, është se ai lind në atmosferën e dominimit të hegelianizmit të djathtë në disa shtete të perëndimit, veçanërisht në SHBA. Filosofia e Hegelit ishte asokohe platforma teorike, me të cilën u bë kritika konstruktive e jetës kulturore dhe shoqërore t'atjeshme. Pragmatizmi si termin dhe si qëndrim filosofik, nuk qe i panjohur edhe më parë. Shumë drejtime filosofike bashkëkohore që rrahin çështjet, e që i hasim edhe te përfaqsuesit e mëparshëm (Volfagang Shtegmiler: Rrymat kryesore të filosofisë bashkëkohore, „Nolit" 1962, faqe 52), mund të shihen gjithashtu edhe te pragmatistët. Pikëpamje pragmatiste kanë pasë më parë në antikë edhe Protagora, Sokrati e Aristoteli, të tilla pikëpamje hasim edhe te mendimtarët anglezë, si te Fransis Bekoni, Tomas Hobsi, Xhon Loku, Xhorxh Berkli dhe David Hjumi. Si elemente më pak të rëndësishëm, idetë pragmatiste gjënden edhe te mendimtarë të tjerë si psh. te P. Paskali, Zh. Zh. Rusoi, I. Kanti, O. Konti, J. Gëte, Fr. Niçe e të tjerë. Xhemsi, si pararendës të pragmatizmit, numron edhe kimistin dhe natyralistin filosof Vilhelm Osfaldin dhe disa të tjerë, meqë edhe ata konsiderojnë se mendimet dhe teoria kanë kuptimin e tyre në pasojat praktike. (Vilijem Xhemsi, Pragmatizmi, „Kosmos" 1940, fq. 35—36). Ai e pranon edhe vetë se mendimet pragmatiste gjënden edhe shumë më përpara te mendimtarë të ndryshëm.

Kështu Xhemsi konstaton se pikëpamje pragmatiste kanë pasë edhe mendimtarët e botës antike. Arsyetimin për pikëpamjet e tij ai e lyp në zhvillimin e filosofisë së mëparshme, edhepse teorisienët nuk kanë një qëndrim të përbashkët — kur është fjala për burimet e pragmatizmit. Ndër burimet e pragmatizmit konsiderohen, perveç atyre që cekëm edhe, empirizmi e nominalizmi, të cilët janë zhvilluar me shekuj në Angli dhe në disa vende të tjera. Burimi i dytë i pragmatizmit është pozitivizmi, si-

burimór pertaining to the source
pararéndës forerunner
pasójë result
konstatój affirm
lyp solicit; beg
edhepsé even though
teorisién theorist
cek touch upon; cite
empirízëm empiricism

domos një variantë e posaçme e pozitivizmit — empiriokriticizmi. Kjo variantë e pozitivizmit është e lidhur me emrin e fizicienit dhe filosofit të shquar gjerman, Ernest Mahut, i cili mendon „se objektet e botës fizike nuk janë substancë, por grumbull i elementeve shqisore". Përfaqësuesit e pragmatizmit kanë përvehtësuar tezat e empiriokriticizmit dhe, natyrisht, i kanë plotësuar me disa veti karakteristike. Burimi tjetër i ideve të pragmatizmit, janë rryma të ndryshme të filosofisë borgjeze në fund të shekullit të kaluar dhe në fillim të këtij, sidomos ndikimi i V. Diltait, A. Bergsonit dhe përfaqësuesve të tjerë. Natyrisht, përveç këtyre burimeve teorike dhe drejtimeve filosofike, që u cekën më sipër, në zanafillën e pragmatizmit kanë ndikuar edhe gjendja shoqërore e shkencore në atë kohë në SHBA, në kohën e formimit të pragmatizmit. (Mlodrag Cekiq, Pragmatizmi dhe instrumentalizmi amerikan, „Rad" 1959, fq. 5—8 etj.). Pra, zanafillën e pragmatizmit si drejtim filosofik e kanë kërkuar vetë rrethanat shoqërore e filosofike.

Pragmatizmi, është pikë së pari një metodë dhe një teori mbi të vërtetën, por në të njëjtën kohë është edhe filosofi që ka teorinë e saj mbi të njohurit, e që sipas nyansave të tij thirret pragmatizëm (V. Xhemsi), humanizëm (F. Shileri), instrumentalizëm (Gj. Djui) e tjerë. (Dragan Jeremiq, filosofia bashkëkohore e perëndimit, „Biblioteka filosofike" 1952, fq. 36). Pragmatizmi, si Weltanschaung i ri filosofik, apo si mënyrë e re e të menduarit në filosofi, zuri fill mu ahere kur Xhemsi dhe të tjerët i interpretuan kështu qëndrimet e Carls Pirsit: e vërteta mbi botën nuk është dhënë në relacionin e vetëdijes, por është „Veti e vetëideve"; e vërteta është dhënë vetëm „në pasojet e akcioneve njerëzore". Kështu e në dukje edhe filosofi bashkëkohanik amerikan Barton Peri, kur thotë se pragmatizmi e ka zanafillën prej interpretimeve të gabueshme të Pirsit mbi konceptet tona. Mirëpo, duhet shtuar se vetë Pirsi e kundërshton interpretimin e këtillë të kuptimeve të veta.

Vepra e Xhemsit „Pragmatizmi", që u botua më 1907, i tronditi me njëherë pas daljes në dritë të gjitha kokat intelektuale, jo vetëm në Shtetet e Bashkuara t'Amerikës, por edhe në vende të tjera. Sistemi i ideve, që përfshihen në konceptin e pragmatizmit dhe janë mbarështruar në këtë vepër, sipas mendimit të autorit, duhet të bëjë kthesë radikale në koncepcionet filosofike. Pragmatizmi, si dihet nuk ka mundur të bëjë revolucion në mendimin njerëzor, mirëpo ai paraqet një novitet interesant dhe specifik në këtë fushë. Preokupimet dhe ndikimi filosofik i tij zënë një vend të posaçëm dhe luajnë një rol të madh në rrymat e shekullit tonë. Pragmatizmi, duke u përhapur në kontinentet e tjera, has aderonjës entusiastë, por edhe kritikë të pakompromis

fizicién physicist
shqisór sensory
zanafíllë beginning
kërkój demand; seek; ask for
nyánsë = nuáncë nuance
kështú e = kështú e vë (mp)
novitét innovation; novelty
aderónjës adherent

në metropolet e kulturës edhe në provincat e saj. Ndërsa disa e kanë përvetësuar si revolucion në jetën kulturore dhe fillimin e një faze të re, të tjerët e kanë shikuar si teori jo kritike prakticiste dhe mistike, e bile e kanë hedhë poshtë si alimine në mënyrë të vendosur.

Mendimtaria arsimuese amerikane dhe ndikimi saj

Filosofia arsimuese amerikane është ideologjia e revolucionit borgjez-demokratik amerikan. Përfaqsuesit më të spikatur t'arsimimit amerikan — Tomas Xhefersoni, Benxhamen Franklini, Tomas Peni etj., kanë qenë në të njëjtën kohë edhe revolucionarë aktivë. Për vendimtarët amerikanë të asaj kohe është karakteristik interesi unik teorik dhe praktik dhe gjithëanshmëria enciklopedike, si atribut i ideologëve në epokat revolucionare. Vetitë ushtarake, filosofike, diplomatike, pamfletizmi politik etj. pasqyrojnë veprimtarinë revolucionare dhe individualitetin e tyre të gjithanshëm. Kjo mendimtari paraqet anën e ndritshme të historisë së filosofisë përparimtare të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe të nëndëmbëdhjetë n'Amerikë. Në mendimet e veta këta vazhdojnë veprimtarinë që në kontinentin europian kanë pasë arsimuesit dhe materialistët françezë e anglezë. (Historia e filosofisë, në redaksinë e G. V. Aleksandrovit, libri i II, „Kultura" 1949, fq. 453—474).

Për zhvillimin e mendimeve të popujve amerikane rëndësi të posaçme kanë ndryshimet e shumta ideologjike dhe revolucionare në disa shtete të Europës. Në veprat e përfaqsuesve të parë të filosofisë amerikane kanë zotëruar gati krejtsisht interesat teologjike dhe etike. Interesante është se logjika në kolegjet amerikane është dhënë sipas Ramusit (Pjer de la Rame). Ndër veprat e para që përmenden nga ky lëmë është teksti kartezian i logjikës „Compendium logicae secundum principia d. Renati Cartezii". Burimet teorike t'arsimuesve amerikanë kanë qenë, në rradhë të parë, pikëpamjet e Xhon Lokut dhe pikëpamjet e materialistëve dhe arsimuesve françezë, të cilët kanë ndikuar mbi ideologjinë amerikane, me pikëpamjet e tyre revolucionare. Ndër figurat më autoritative të arsimimit amerikan, ka qenë pa dyshim T. Xhefersoni, pikëpamjet shoqërore-politike të të cilit janë nën influencën e Lokut. Ato kanë qenë të fiksuara në dokumentet më të rëndësishme amerikane, në Deklaratën e drejtësisë dhe të pavarsisë, autori i të cilit ka qenë ai vetë. Pastaj përfaqsues i spikatur e me famë jo vetëm në SHBA, por edhe jashtë kufijve të tyre, ka qenë B. Franklini, natyrisht edhe të tjerët.

alimín learned; sophisticated
i spikátur outstanding
gjithëanshmërí well-roundedness

Në pjesën e konsiderueshme të veprave të kësaj kohe shihen mendimet progresive, edhepse e mbajnë kojën e vet teologjike. Kjo gjë mund të shihet në veprën e përfaqsuesit të deizmit Iten Alenit, i cili shkruan veprën „Arsyeja është i vetmi profet i njeriut" (*„Reason the only oracle of man"*). E ngjashme me këtë vepër, por në një formë të zhvilluar, ka qenë edhe libri i T. Penit, teorisienit dhe revolucionarit të kësaj periudhe me titull: „Shekulli i arsyes" (*„Age of reason"*), që, bashkë me veprat e tjera ka pasë një jehonë të madhe. Mirëpo, si këta ashtu edhe të tjerët, si psh. Tomas Kuperi, Benxhamen Reshi etj. nuk kanë qenë materialistë konsekuentë në interpretimin e kuptimsisë së natyrës. Deizmi i përcjell ane e me kufi materializmit të tyre. Mirëpo merita historike e tyre qëndron me faktin se popujt amerikanë i kanë njohtur me idetë përparimtare të kohës së tyre.

Ndikimi evident në zhvillimin e mendimeve filosofike të SHBA kah gjysma e shekullit të kaluar kanë pasë edhe lëvizjet revolucionare të vendeve europiane. Deri në atë kohë në fushën filosofike amerikane ka luajtur rol e ashtuquajtura era e prosorve, në të cilën qenë përfshirë Laurens Hikok, Frederik Hexh, Xhems Uolker etj. Në këtë kohë mbarshtron pikëpamjet e tij Emersoni, i cili i hedh poshtë interpretimet e këti, qarku mendimtarësh, dhe intelektin (under standing). Perveç pikëpamjeve të tjera të filosofisë europiane, në mendimtarinë amerikane dhe në zanafillën e pragmatizmit ka influencuar mjaft pozitivizmi, themeluesi i të cilit konsiderohet teoricienti françes Ogyst Konti. Mbi pragmatizmin ka ndikuar edhe evolucionizmi i mendimtarit anglez Herbert Spenserit, veçanarisht në interpretimin e disa kategorive. (W. Windelband, H. Heimsoeth, Historia e filosofisë, libri i II, „Kultura" 1957 fq. 244). Edhe koncepcionet evolucioniste të Çarls Darvinit kanë pasë ndikim në shkenca të ndryshme dhe në mendimtarinë amerikane. Vetë Xhemsi ka qenë i interesuar për pikëpamjet e darvinizmit, dhe duke studjuar atë ai vjen në kontakt me interpretimin e pikëpamjeve të Darvinit nga ana e Spenserit. Ai i ka berë një kritikë bukur të mirë Spenserit pikëpamjeve të tij në lidhje me interpretimin e vetëdijës. Natyrisht, ndikim më të madh ka pasë Hegeli, mendimtarja enciklopedike e të cilit ka sunduar nëpër qarqet filosofike dhe n'universitetet. Por, kur është fjala për ndikimin e filosofisë europiane mbi atë amerikane, duhet të shtohet se përfaqsuesit e filosofisë amerikane nuk e kanë përvetësuar mendimin e kolegëve të tyre europianë në mënyrë të verbët. Ata i kanë interpretuar këto mendime në aspektin e tyre, duke ua adaptuar rrethanave të veçanta të jetës amerikane. Ata kanë përvetësuar dhe modifikuar mendimet e filosofëve të tjerë në mendimin amerikan, por nuk është dalluar ndonjë mendimtari ori-

kójë crust
i ngjáshëm similar
njóhtur = njohur
kah toward
i ashtuqúajtur so-called
búkur very; beautifully
dallój detect

gjinale, e cila do të kishte merita të veta në arenën filosofike ndërkombëtare, dhe të zinte vend të posaçëm në historinë e mendimtarisë botërore. Filosofia amerikane gati përherë, e sidomos nga fillimi i shekullit tonë, ka qenë në lidhje direkte me nevojat praktike. Prandaj, edhe pragmatizmi çfaqet, në rradhë të parë, si orvatje për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme të jetës shoqërore.

Përfaqsuesit e filosofisë së pragmatizmit

a) Xhemsi

Pragmatizmi si mendimtari e re është popularizuar dhe berë e njohtur atëhere kur Vilem Xhemsi (William James, 1842—1910) përpunoi në mënyrë të vet *„maksimet e logjikës"* së pragmatizmit të Persit, duke krijuar një doktrinë personalistike. Derisa pragmatizmi i Persit ka zënë fili prej logjikës së vet, ai i Xhemsit lind prej metafizikës voluntaristike, si një teori e re mbi të vërtetën, „që të jetë një rezistencë e pikëpamjeve iracionaliste ndaj botës". Xhemsi nxjerr prej maksimeve të Persit konkludime të caktuara teorike — gnoseologjike, mbi të ciliat është bazuar teoria nominalistike dhe pluralistike mbi të vërtetën.

Xhemsi lindi në Nju Jork. Ka qenë shkrimtar i frytshëm. Ka dhënë psikologjinë, fiziologjinë dhe filosofinë në universitetin Harvard dhe në disa univerzitete të tjera. Ka dashur të jetë piktor dhe ka pasur prirje për filosofi. Në rini udhëton mjaft dhe gjatë arsimit të vet ndërron disa shkolla. Studioi në SHBA, në Francë, në Zvicër. Gjatë shkollimit u njoh me shkenca të ndryshme me art, me filosofi etj. Në universitetin Harvard studioi artin figurativ, shkencat natyrore dhe medicinën, kurse në Gjermani psikologjinë. U rrit në një atmosferë familiare ku shpeshherë bëheshin diskutime filosofike. Ndikim të madh, përveç tjerash në pikëpamjet e Xhemsit lë edhe teoria e Lokut, në koncepcionet e të cilit gjen principet e praktikalizmit. (Miladin Zhivotiq, Pragmatizmi personalistik i Vilem Xhemsit dhe Ferdinand Shileri, „Savremene filozofske teme" 1963, faqe 115).

Simbas Xhemsit, bota është e shumëdueshme dhe e ndryshuarshme. Ajo nuk është sistem i mbyllur dhe i përkryer, por „kolekcion ose grumbull i një numri të madh dukunishë dhe gjësendesh". Gjithësia është diçka e hapët dhe e gjerë. Nuk mohon që botën mundemi ta kuptojmë si tërësi unike, por as nuk pranon se bota është e njësuar në çdo pikëpamje. Konsideron se shkalla e njësimit të njëmendësisë varet „prej akcioneve tona njerëzore" në ndërtimin e lidhjeve harmonike në mes të njeriut

547

mendimtarí way of thinking; philosophy
derisá while
gnoseologjíke pertaining to knowing
i frýtshëm fruitful
ka dhënë he taught
familiár of the family
tjérash = të tjérave
i shumëdúershëm = i shumëdúarshëm manifold
i ndryshúarshëm variable
dukuní = dukurí appearance
gjësénd article; object
njëmendësí oneness of thought

548 5

dhe rrethit fizik, sikurse edhe në mes të njeriut dhe shoqërisë. Empirizmi i Xhemsit është i lidhur me pragmatizmin e tij, meqë në suazat e kësaj doktrine ai ka kritikuar teoritë filosofike mbi substancën. Në koncepcionet e veta mbi empirizmin ai arrijti nën presionin e kritikës së pikëpamjeve të tij, mbi të vërtetën. Ate e kanë kritikuar, pse nuk e interpreton se ç'është e vërteta, por enventualisht si duhet të vihet gjer te ajo. Empirizmi radikal, simbas Xhemsit për ndryshim nga teoritë e vjetra filosofike mbi substancën, ka vlerësimet e veta praktike. Ajo është „Bazë teorike e një shikimi të ri ndaj botës bazë e kosmologjisë së re, filosofisë dhe religjionit". Me këto ide Xhemsi ka ndikuar në disa disiplina shkencore. Mirëpo, ndikimi i tij është shënuar edhe në rradhët e sekteve religjioze, burimi i të cilave është ërvatja të gjejë dhe t'i japë mjete moderne individit të botës së teknologjizuar, komercializuar dhe të alienuar të shoqërisë së kohës së tij.

Pragmatizmi i Xhemsit është padyshim më i popullarizuar dhe më autoritativ në filosofinë dhe në mentalitetin amerikan. Është mendim origjinal, në krahasim me shumë tendenca të filosofisë bashkëkohanike. Në këtë situatë teorike dhe praktike, pragmatizmi lind dhe zhvillohet me misionin e vet pajtimtar, të cilën gjë e ka cekë edhe vetë Xhemsi. „Pragmatizmi është koridor, që në pallatin njerëzor duhet të lidhë dhoma të ndryshme dhe ku të vetmuarit mirren me mendime të ndryshme". Këte metaforë mbi pragmatizmin si koridor „që lidh dhe pajton" ai e ka huajtur prej përfaqësuesve të tjerë, që kanë pasur këtë tendencë filosofike. Me zhvillimin e mëtejmë të pragmatizmit dhe me rezultatet që arrijti ai me logjikën, metodologjinë e përgjithëshme të shkencave, në etikë, semantikë, psikologji sociale, në sociologji etj. pragmatizmi i Xhemsit ka qenë i korigjuar prej pasardhësve të tij. Ai nuk është ngritë kurrë në nivelin e sistematizuesit, duke dhënë një sistem tërësor të përpunuar në filosofi, etikë ose në disiplina të tjera, por ka qenë i preokupuar fundemaje me zgjidhjen e problemeve të krizës së individit, kur ka vepruar dhe ka jetuar. Në lidhje me këtë çështje, si Xhemsi ashtu edhe pragmatistë të tjerë përparësi i japin rolit të individit të madh. Individët shoqërorë imitojnë dhe përvetësojnë „ato që individët e mëdhej kanë kontribuar me vullnetin edhe me jetën e tyre shoqërore".

b) Djui

Ndër mendimtarët e spikatur të gjysmës së parë të shekullit tonë është padyshim Gjon Djui (John Dewwy, 1859—1952), i cili me një diapazan të gjërë ka përfshirë probleme të ndryshme në

pse because
enventualísht eventually; finally
shikím view
alienúar alienated
pajtimtár reconcilatory
i vetmúar isolated
pasárdhës successor
sistematizúes systemizer
tërësór complete
fundemájë from beginning to end
në lídhje me in connection with
indivíd individual
diapazán scope

kërkimet e tij. Me origjinalitetin e ideve të tij ai ka ndikuar te përfaqësuesit e logjikës dhe të disiplinave të tjera filosofike, në shkencat juridike, në pedagogji, politikologji dhe në fusha të tjera teorike. Këtë influencë të madhe që ka pasur ky mendimtar e pranojnë edhe ata teoricienë që janë kundër pikëpamjeve teorike të tij. Rëndësinë dhe ndikimin e Djuit në mendimtarinë botërore e ve në pah edhe Bertrand Rasel, filosofi më i madh bashkëkohor. Ai thotë bile se pikëpamjet e tij me Djuin ndaj çështjeve sociale janë identike. *(Bertrand Rasel, Historia e filosofisë perëndimore, „Kosmos" 1962, fq. 783).* Opusi filosofik i Djuit është shumë i gjerë. Disa teorikë pajtohen se Djui zë vënd bile edhe para themeluesve të pragmatizmit, si përfaqësuesi më tipik i mendimit filosofik bashkëkohor amerikan. Historiani i filosofisë Artur Hybsher *(Arthur Hübscher, Phillosophen der Gegenwart, München 1949), faqe 5),* duke vlerësuar veprimtarinë teorike dhe influencën e tij, vë në dukje se Djui është mendimtar reprezentativ i Amerikës së sotme. Frytshmërija është veçi që e përcjell këtë mendimtar në krijimtarinë e tij të gjerë.

Në jetën e vet të gjatë Djui publikoi një numër të madh veprash dhe polemikash, me tematikë lëmishë të ndryshme: nga logjika, etika, pedagogjia, politikologjia etj. Opusi i tij është i madh. Në veprimtarinë teorike ai publikoi jo më pak se pesëqind vepra dhe punime.

Djui i ka ndërruar dhe plotësuar vazhdimisht pikëpamjet e veta gjatë karierës. Në fillim të zhvillimit ishte nën ndikimin e neohegelianizmit dhe drejtimeve të tjera filosofike, në bazë të të cilave ndërtoi pikëpamjet vetiake filosofike, të cilat karakterizohen si instrumentalizëm, eksperimentalizëm dhe operacionalizëm. Natyrisht, ai qe nën ndikimin e Xhemsit dhe të Persit. Kështu pikëpamjet e Persit, mbi natyrën simbolike të të menduarit, kanë ndikuar me të madhe në formimin e koncepcioneve logjike të Djuit.

Zhvillimit të mëtejm të pragmatizmit Djui i ka kontribue tepër, duke u orvatë t'i lidhë me rezultatet e shkencave moderne. Djui, i cili historikisht ka ardhur pas Hegelit, Marksit, Persit e të tjerëve i ka shfrytzuar mirë rezultatet e pararendësve të tij. Prandaj, në filosofinë bashkëkohore teoria e vlerësimit të Djuit luan një rol mjaft të madh dhe ka elemente pozitive (Mihailo Markoviq, Teoria dialektike e vlersimeve „Nolit" 1961, fq. 81) Filosofia e Djuit përfaqson më tepër instrumentalizmin se sa pragmatizmin, ka qenë më i matur, më e afërt me rezultatet e metodologjisë hulumtuese. Ky është nji ndër shkaqet që përfaqsuesit dhe bashkëmendimtarët e pragmatizmit në SHBA e konsiderojnë veten më tepër si pasardhës të Djuit. Dorisa filosofia

juridík judicial
teorík theoretician
vë në dúkje brings out; makes apparent
frytshmërí fruitfulness
lëmishë = lëmish of fields
politikologjí political science
puním study; lesser work
plotësój refine; make full
vetiák one's own
pararéndës predecessor
vlerësím value
më tépër even more
hulumtúes pertaining to research

pragmatiste e Xhemsit interesohet në radhë të parë për brendinë iracionale të përvojës, pragmatizmi i Djuit është logjikë e përpunuar, metodologji e përgjithëshme e shkencave të përgjithëshme dhe natyrore, sistem i përpunuar pedagogjik dhe estetik.

Djui i ka dhënë pragmatizmit një karakteristikë të re, që bëri të mundur përhapjen e saj. Ai e zhvilloi më tutje anën oportuniste dhe konzervative të pragmatizmit, duke ia adaptuar rrethanave të reja, duke u përpjekë të ireqojë pragmatizmin si mendim progresiv dhe revolucionar të shoqërisë bashkëkohanike. Reforma filosofike te ai fillon në lëmën e teorisë së të njohurit. Kritikon mendimtarinë e mëparëshme, e cila, sipas mendimit të tij ka kërkuar vazhdimisht një njëmendësi jashtë nevojës sonë të përditshme. Djui konsideron se nji filosofi e tillë nuk mund të qëndrojë më tutje. Rolin e vetëdijës njerëzore e kundron në aspektin biologjik dhe me përdorjen e të menduarit si instrument: njerzit mësohen të kontrollojnë ngjarjet dhe të sigurojnë qëllimet e veta. Përpjekja kryesore e tij ka qenë që pragmatizmi i mesëm instrumentalistik, me elasticitetin dhe me liberalizmin e vet, t'i afrohet neopozitivizmit, neorealizmit dhe drejtimeve të tjera filosofike, mirëpo kjo orvatje e Djuit nuk kurorëzohet me sukses. Por, pikëpamjet instrumentalistike të tij janë mjaft të përhapura si në SHBA, ashtu edhe jashtë dhe kanë ndikuar te teoricientë të ndryshëm në lëmën e pedagogjisë, psikologjisë dhe të shkencave të tjera shoqërore, psh. në shkencat e jurisprudencës, ekonomike sociologjike etj.

c) Pirsi

Çarls Pirsi (Charles Peirce, 1839—1914), është figurë e shquar në filosofinë amerikane, edhepse gjatë tërë jetës së tij ka mbetur nëpunës i thjeshtë dhe i panjohtur i institutëve të ndryshme, që nuk kanë pasur gjë të përbashkët me filosofinë. I panjohur gati fare sa ishte gjallë, pas vdekjes u bë një ndër filosofët me më autoritet në jetën teorike të SHBA. U rrit në një ambient akademik, prej një familje profesori të universitetit, me ambicie të madha për karierë akademike. Filloi të merret herët me filosofi. Në moshën rinore lexoi veprën e Kantit „Kritika e arsyes së pathjellët" nga e cila u entuzazmua së tepërmi dhe ra nën influencën e saj, Pirsi i takon me jetë shekullit të kaluar, kurse me mendime dhe veprimtari i takon shekullit tonë. (Simbas Milladin Zhivotiq, Pragmatizmi i Çarls Sanders Persit, „Filozofia", nr. 4/1962, faqe 11—40 dhe Dr Dushan Nedelkoviq, Pragmatizmi dhe dialektika, „Kultura" 1960, faqe 30—41).

Çfaqja e Persit, që përdori për herë të parë fjalën pragmatizëm, bëri një influencë të madhe në zhvillimin e mendimtarisë

më tútje further; anymore
kurorëzój crown
edhepsé even though
mérrem herët begin early
së tépërmi greatly
çfáqje = shfáqje appearance

programatistike në Amerikë dhe jashtë saj, prej së cilës u zhvilluan rrymat e tjera pragmatistike, për të cilën më vonë Djui do të shkruajë se „është një ndër mendimtarët më origjinalë dhe më të frytshëm në filosofinë bashkëkohanike". Kryevepra e vet „Logjika e madhe", dhe një pjesë e konsiderueshme e veprave të tij të tjera nuk kanë mundë të botohen gjatë jetës së vet. Mbas vdekjes, punimet e pabotuara dhe të botuara janë përmbledhë në një vepër të përbashkët me titull „Veprat e zgjedhura", në gjashtë vëllime: I Principet e filosofisë, II Elementet e logjikës, III Logjika ekzakte, IV Matematika më elementare, V Pragmatizmi dhe pragmatiçizmi dhe VI Metafizika shkencore. Në këtë mënyrë mendimi i tij shkencor dhe mjaft kompleks në terësinë e tij ka valuar kaleodoskopin idealistik të filosofisë së sotme dhe i ka dhënë kontribut zhvillimit të filosofisë.

Persi është mendimtar origjinal, por kontradiktor. Ndaj veprave dhe mendimeve të tij bëhet një polemikë e gjallë në mes të teorikëve të shquar. Janë shkruar për te monografi të shumta, studime dhe janë mbajtë simpoziume, ku janë interpretuar veprat e Pirsit. Procedura e interpretimit të filosofisë së Pirsit është gjithëfarësh. Kështu, disa konstatojnë se mendimi filosofik i tij është terësor, sistem koherent — nëse tejkalohen disa gjëra që nuk janë karakteristike për filosofinë e tij, megjithse ka edhe mendime të tjera, që njohësit e Persit mendojnë se filosofia e tij është e ndarë në dy tendenca të papajtueshme.

Në atmosferën post-darviniste në SHBA Pirsi filloi i pari të kritikonte kuptimësinë idealistike, formale — logjike të së vërtetës, duke vënë në pah mospajtimin në mes të logjikës aristoteliane me praktikën eksperimentale — shkencore, duke u dhenë interpretime të reja kuptimeve tona. Koncepti shkencor për Pirsin është instrument eksperimental i praktikës: ai çfaqet si ide, hipotezë për zgjidhjen e problemeve shkencore dhe praktike, „Domethënia e tij është dhënë me anë të kundrimit të rrjedhimeve që nxit si prijs i përvojës shkencore". Mendimet e Pirsit të mbarshtruara në punimet e veta si psh. „Si t'i bëjmë të qarta idetë tona" (How To Make Our Ideas Clear), merren si etapë e parë e zhvillimit të pragmatizmit. Ato fitojnë një publicitet të madh dhe ndikojnë mbi zhvillimin e mëtejmë të mendimit pragmatistik. Pra, mendimtaria e Pirsit, si u pa, është kontradiktore. Ai kritikoi me vend spekulimet metafizike, duke kërkuar precizitet dhe kthjellësi në filosofi, por qe poashtu, mendimtar me ambicje të mëdha, pa talent për spekulime teorike, sikurse themeluesit e sistemeve të mëdha të mendimtarisë njerëzore. Për zgjidhjen e këtyre kundërthënieve Pirsi, me ndihmën e disa veprave të përfaqsuesve të klasiçizmit gjerman, formon teorinë e

i zgjédhur selected
valój fuel; boil
gjithëfárësh = gjithfárësh many-faceted
tejkalój overlook
njóhës knowledgable person
kuptimësí way of understanding
domethënie meaning
kundrím observation
prijs = príjës guide
me vend rightly
spekulím speculation
precizitét precision
poashtú likewise
kundërthënie contradiction

vet mbi kategoritë, e cila është mbështetje e logjikës dhe e metafizikës së tij. Aty shihet një sistem triadik, i ngjashëm me ato të përfaqsuesve të klasiçizmit gjerman.

Për Pirsin kryesore mbi të gjitha është praktika eksperimentale si vlersim bazë. Në kushte të reja të zhvillimit të hovshëm të shkencave empirike dhe eksperimentale, ai qe ndër teorisienët e parë qe ia nënshtroi kritikës teorinë e vjetër racionale mbi të vërtetën, duke kërkuar kritere të reja të vlerësimeve që do të zhvilloheshin prej studimit logjik të eksperiencës shkencore. Rezultatet kryesore të Pirsit, dmth të analizës së kuptimeve të vlerësimit, ndikuan radikalisht mbi zhvillimin e pragmatizmit në tërësi e sidomos mbi zhvillimin e koncepcioneve të logjikës së Djuit dhe në pikëpamjet e Xhemsit. Këtë gjë e ka cekë edhe vetë. (V. Xhemsi, Ibidem, fq. 34—45).

Lëma kryesore e aktivitetit të filosofisë së Persit është logjika. Pikëpamjet e Pirsit mbi pragmatizmin janë të lidhura drejtpërdrejt me koncepcionet që ka trajtuar në logjikën, që ai e konsideron si shkencë filosofike normative. Është interesante, të shenojmë, kalimthi edhe klasifikimin e shkencave, ashtu sikurse e bën Persi:

Klasifikimi i shkencave simbas Pirsit

Matematika

Filosofia { fenomenologjia; shkencat normative { logjika, etika, estetika dhe të tjerat; metafizika (epistemologjia, antologjia) e tjerat

Shkencat ideoskopike — fizika dhe shkenca të tjera të veçanta

Në pikëpamjet e veta mbi logjikën, Persi ka kundruar dhe kritikuar koncepcionet e deriatëhershme për lëndën dhe metodën e logjikës, duke hedhë poshtë qëndrimet, në bazë të të cilave logjika identifikohet me psikologjinë, epistemologjinë, sociologjinë, fiziologjinë dhe i cakton lëndën e logjikës „si studim mbi kushtet formale të së vërtetës", ose logjika është shkencë „mbi ligjet e përgjithëshme të simboleve".

Prej pikëpamjeve të Pirsit, mbi vlerën e ideve, Xhemsi zhvilloi teorinë e vet voluntaristike dhe egocentrike mbi të vërtetën. Pirsi është rezervuar prej pikëpamjeve të Xhemsit dhe ka-fi lluar të përdorë termin e ri pragmatiçizëm, që është vetëm si „maksima e logjikës", regulla e logjikës, teoria e analizës logjike etj., e që duhet të jetë me doemos mbështetje e pikëpamjeve realiste. Maksima e pragmatizmit, sipas Pirsit, duhet të plotësohet me qëndrimet kryesore të një filosofie kritike rácio-

vlersím = vlerësím evaluation; value
i hóvshëm rapid; impetuous
kalímthi in passing
shkéncat ideoskopíke physical sciences
kundrój observe
lëndë substance; field; subject matter
me doemós = medoemós essentially

nale (Critical common sensism). Ky qëndrim bazohet në „urtinë sociale të njerëzimit", filosofia e të cilit, dmth. e këtyre qëndrimeve dunet të niset kritikisht prej interpretimit të proçeseve të njohurit dhe të së vërtetës. Mirëpo, filosofia e Pirsit nuk qe imune prej spekulimeve të përgjithëshme dhe nuk mund t'i ndërprejë të gjitha lidhjet me shekullin e vet kur ai jetoi.

Ali Dida, "Vetitë kryesore të filozofisë të pragmatizmit", Përparimi (Prishtinë), Nos.6-7 (1968), pp.722-733 (Excerpt)

urtí wisdom

etrúsk Etruscan
dijetár scholar
mirënjóhës grateful
i del zot defends
bíndës persuasive

ANDREA VARFI

Fundi i misterit etrusk dhe gjuha shqipe

Këtu dymbëdhjetë vjet të shkuara, (në «Nëntori» 1962, nr.6, fq 121-131), i bënim të njohura përfundimet e kërkimeve të dijetarit frëng Zaharia Mayanit në fushën e etruskologjisë, të cilat ai i kishte botuar në veprën «Etruskët fillojnë të flasin» («Les Etrusques commencent à parler»). Ajo vepër, e botuar në frëngjisht, u përkthye në anglisht, në gjermanisht, në rusisht dhe, me përjashtim të grupit të etruskologut italian, Pallottino, u përshëndet nga shumë dijetarë të tjerë si një punim serioz. Kështu, p.sh., albanologu Stuart Mann, ndër të tjera, i shkruan autorit: «Shpresoj se shkencëtarët e ardhshëm do t'ju jenë mirënjohës për gjithë përpjekjet e mëdha që keni bërë». Albanologu M. Lambertz, i thotë: «Metoda juaj e hollë për intepretimin e teksteve më frymëzon respekt të thellë». Profesori anglez W. Lyon-Blease shkruan: «Ai (Mayani) i del zot tezës së vet në mënyrë energjike dhe bindëse. Dijetari frëng D. Bernet shkruan: «(Mayanin) e mbështesin në mënyrë të çuditshme edhe zbulimet e bëra kohët e fundit në arkeologji dhe në histori». Dijetari amerikan P. Welch shkruan: «Etruskët fillojnë të flasin» është një vepër e rëndësishme dhe, ndofta, epokale e një shkencëtari që i

është kushtuar me mish e me shpirt punës së vet». Gjermani K.R. shkruan: «Një libër i mahnitshëm. Që specialistët të shikojnë me një farë armiqësie një të huaj që guxon të ndërhyjë në lëmin e tyre, kjo është e natyrshme... Po nuk është krejt e papërligjshme shpresa se vepra e tij mund të dalë si një nga sukseset e mëdha në interpretimin e gjuhëve të harruara» («Z.M». «Fundi i «misterit» etrusk», Tiranë 1973, fq 438-441).

Zaharie Mayani, autor i njohur i veprave «Druri i shënjtë dhe riti i besëlidhjes te semitët e lashtë (Geuthner, Paris 1935), Hyksostë dhe bota e Biblës» (Payot, Paris 1956), pas veprës «Etruskët filluan të flasin» (Arthaud, Paris 1961), dhe në vazhdim të saj botoi më 1970 veprën «Fundi i «misterit» etrusk» (La fin du «mistère» etrusque», Maloine, Paris 1970).

Në këtë vepër Mayani thellohet më tepër në zanafillet (origjinat), gjuhën dhe jetën e etruskëve, pasi ka studjuar thuajse plotësisht veprat më kryesore të albanologëve, si Jokl, Krahe, Kretçmer, Lambertz, Mann, Mayer, Miklosiç, Pedersen, Ribezzo, ka vizituar vendin tonë, është njohur me punimet e profesor Çabejt, me vepra të tjera të etruskologëve, me vepra të disiplinave të tjera që kanë lidhje me pellazgë, etruskë, trakë, ilirë, dhe, në të njëjtën kohë, pasi ka bërë edhe deshifrime të reja mbishkrimesh etruske gjatë viteve 1963-1968, (veç atyre të deshifruara më përpara dhe të përfshira në veprën «Etruskët fillojnë të flasin»).

Vepra «Fundi i «misterit» etrusk», prej 452 fq. në origjinal frëngjisht, hapet me një parathënie të autorit. Këtu Mayani hedh tezën-platformë të tij, të cilën e argumenton në vepër me të dhëna arkeologjike, gjuhësore, se etruskët, «sipas një tradite të vjetër, që e përmend Herodoti, shkuan në Itali duke u nisur nga Azia e vogël (Anadolli)». Këto vise të Azisë së vogël egjeane, (Jonia, Troja, Lidia e mëvonshme, Frigjia, Karia, Lykia), rreth shekullit 13 përpara erës sonë, ishin «pjesërisht të populluara me ilirë dhe trakas të ardhur nga Ballkanet». Kështu brigët e Maqedonisë bëhen frigë në Azi të vogël, dardanët ballkanas vendosen në Trojë. Ata flasin dialekte ilire, (një gjuhë indoevropiane më vete, as greke, as latine). Arsyeja përse gjer më sot nuk u arrit në deshifrimin e gjuhës etruske, sipas Mayanit, ka qënë dhe është, sepse etruskologët, çelsin e deshifrimit të mbishkrimeve etruske e kanë kërkuar dhe e kërkojnë vetëm në dy gjuhët klasike, në greqishten dhe latinishten. Por ai çelës nuk mund të ishte dhe nuk mund të jetë në këto dy gjuhë: Vetëm ilirishtja lejon të

i papërlígjshëm illegitimate
besëlídhje oath taking; pledging; alliance
semít Semite
hýksos Hyksos, Semitic invaders of Egypt, circa 1600-1700 B.C.
i deshifrúar deciphered
egjéan Aegean
çels = çelës key

përcaktohet mjaft mirë treva e kërkimeve për të dalluar korrespondencat përkatëse me gjuhën etruske». Dhe shqipja e sotme «është ajo gjuhë që ka ruajtur një bërthamë të ilirishtes së vjetër».

Pra, sipas Mayanit, metoda më e mirë për të deshifruar mbishkrimet etruske qëndron në të mbështeturit në tre burime: a) në gjuhën shqipe si të vetmen gjuhë të gjallë që ruan si bazë ilirishten; b) në fjalët e lashta ilire që kanë mbijetuar në emrat e njerëzve ose të viseve të lashta ilire; c) **në fjalët iliro-etruske** që kanë mbijetuar në dialektet lokale të viseve italiane, ku dikur banonin fise ilire, si, f.v., në Apuli, ku jetonin mesapët, që kanë jo vetëm bashkëkohës, po edhe farefis me etruskët, siç është pohuar tashti së fundit.

Duke ndjekur këtë metodë, duke shfrytëzuar këta tre burime, autori na thotë se **arriti të shpjegojë «një pjesë të mirë të bërthamës etruske»**, elementet e së cilës kryqëzohen në kontekstet e ndryshme dhe vërtetojnë njeri-tjetrin. Kjo i lejoi atij të shpjegojë «jo vetëm disa fjalë të shkëputura, por edhe fjali të renditura» e që përfaqësojnë periudha të plota. «Tanimë, thotë Mayani, «rruga është e hapur: detyra jonë e ardhshme është që ta bëjmë këtë metodë sa më të saktë, duke zgjeruar fushën e materialeve të shfrytëzuara». (V.: Z.M. — Fundi i «misterit» etrusk, Tiranë 1973, fq. 7-10).

Vepra ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë (fq. 13-168) Mayani, pasi flet për origjinat e etruskëve, për shtrirjen trako-iliro-etruske, jep një hartë konkordancash toponimike dhe etnike, hidhet në gjuhën etruske, në gjuhën shqipe, si gjuhë-çelës për deshifrimin e gjuhës etruske. (Këtu përmend dijetarë të ndryshëm, prekursorë, ndër të cilët ne mund të shtonim edhe gjuhëtarin e shquar italian, Askolin, i cili, (duke pranuar tezën e Hahnit, që ishte edhe e mjaft dijetarëve arbëreshë rreth prejardhjes së shqiptarëve prej pellazgëve), shkon edhe më tej, duke menduar se edhe etruskët duhet të bëjnë pjesë po në të njëjtën familje tirreno-pellazgjike, pra «edhe në qoftë se ndonjeri do të tentojë të deshifrojë me ndihmë të shqipes, mbishkrimet shumë misterioze të etruskëve, nuk mund të pohohet me siguri se ai niset nga premisa më pak të shëndosha nga premisat prej të cilave u nisën shumë ndër dijetarët që provuan forcat e tyre në këtë fushë» (V.G. Ascoli — Studi critici (Fragmenti albanesi-Gorizia 1861).

Në kapitujt «Humorizmi» dhe «Diskutime të gjalla», Mayani, me një frymë polemike të fortë, godit gjithë grupin e Pallottinos me shokë, si Blok, Pareti e të tjerë. «Zoti

trévë area
përkátës relevant
bërthámë core; kernel
mbijetój survive
f.v. = fjala vjen so to speak
pohój affirm
kryqëzój cross
fjalí sentence
i rendítur ordered
i plótë complete; full
shtrírje expansion
prejárdhje derivation; descent
tentój attempt

Pallottino është një ndër figurat qendrore të etruskologjisë moderne, thotë Mayani, dhe e ardhshmja e kësaj shkence varet mjaft prej tij. Askush nuk mund të kundërshtojë autoritetin e Pallottinos në fushën e qytetërimit etrusk. Ai merret me çështjen e deshifrimit prej një kohe të gjatë». Por «mjerisht rigoroziteti në zbatimin e metodës shoqërohet te Pallottinoja me përjashtime (exclusions) dhe ndëzhkime kishëtare (interdits) 1) që shpesh janë pa bazë. Kur kundërshton tezën e shtegtimit etrusk në Itali, ai u afrohet pikëpamjeve të z.Devoto; kur mohon shtrirjen e lashtë ilire, ai i afrohet tezës së z.Pizani; me qëndrimin e tij skeptik ndaj rolit të shqipes në këtë fushë, ai u afrohet pikëpamjeve të z.Taljavini. Një qëndrim i tillë nga ana e tij, ka si pasojë të pashtëmëngshme jo vetëm mospranimin e mejtimit të njëzëshëm të autorëve romakë (mbi zanafillet e etruskëve), por edhe mohimin e pikëpamjeve të Buonamiçit, Askolit, Ribezzos, Trombettit, Lattesit, Mustilit, Dukatit, të Kretçmerit, Joklit, Vesmërit, Shahermajerit, Krahes, Wainwrightit dhe të shumë të tjerëve. Në të vërtetë ai mohon faktet. Ne që kemi mësuar, si të thuash, gërmat e alfabetit etrusk në veprat e z.Pallottino dhe që kemi ndjekur evolucionin e opinioneve të tij qysh prej tridhjetë vjetësh, shpesh mbetemi pa frymë, (të shtangur) në kthesat e njëpasnjëshme që ai bën».

Për Pizanin thotë: «Z.Pizani, që dallohet për qëndrimin e tij shumë skeptik ndaj faktorit ilir, i ka shpallur luftë një të ashtuquajturi «panilirizmë» retrospektiv të J. Pokornit, Krahes, Gjerogjevit... Nga ana tjetër, z.Pizani pranon që shqipja rrjedh nga ilirishtja, por njëkohësisht ankohet që... kjo gjuhë ka mbetur shumë e panjohur. Ky qëndrim është me të vërtetë paradoksal, gjersa Jokli, Krahe, A. Majeri, Lohner e dijetarë të tjerë kanë arritur të nxjerrin në dritë me qindra rrënjë ilire shumë të sigurta. (Po aty, fq. 126, 132).

Akuzës së Pallottinos se krahasimet etimologjike të Mayanit janë bërë «pa u kujdesur nëse fjalët shqipe i përkasin fondit ilir te vjetër apo janë depërtime leksikale të mëvonëshme», autori i përgjigjet: «Kjo akuzë nuk është e vërtetë: në 75 raste (në «Etruskët fillojnë të flasin») kam verifikuar nëse fjalët shqipe i përkisnin fondit të vjetër», duke ndjekur dhe konsultuar autoritetet më të dëgjuar në fushën e vjetërsisë së fjalëve shqipe». (fq. 153-154).

Akuzës së R. Blokut se gjoja «mungon çfarëdo arsye-

1) Nuk kuptojmë përse fjala «interdits» në përkthimin shqip është dhënë me fjalën «përgjithësime (fq. 126).

zbatím implementation
ndëshkím punishment
z. = zóti
i pashtëmëngshëm unavoidable
i njëpasnjëshëm continuous; one after another
gjersá inasmuch as
rrënjë root
akúzë accusation
nësé whether
fond fund; stock
depërtím penetration
përkás belong (to)
gjója allegedly
çfarëdó any; every

558

timi serioz mbi historinë e gjuhës etruske» (në «Etruskët fillojnë të flasin»), Mayani i përgjigjet: «Z.Blok nuk ka vënë re se gjatë gjithë librit tim nuk kam pushuar së ballafaquari të dy gramatikat, për ta bërë më të dukshme aférinë e habitshme (të shqipes dhe etruskishtes)». Dhe pasi citon faqet e librit ku bën këto ballafaqime, thotë: «Për të mos e zgjatur nuk po i përmend z.Blok edhe përmbledhjen e gramatikës etruske, që ndodhet në faqet 433-435 të librit tim. Si nuk i vuri re ai gjithë këto gjëra? Ka të ngjarë që kjo mungesë vëmendjeje të jetë edhe diçka e paramenduar, një mënyrë veprimi e zakonshme për disa rrethe të caktuara». (fq. 155-156).

Në pjesën e dytë (fq. 171-410) Mayani flet për qytetin etrusk, për lodrat, pijet, luftrat, për besimet e tyre, për mbishkrime të ndryshme të zbërthyera prej tij me çelës gjuhën shqipe. Në mes të këtyre mbishkrimeve, të zbërthyera prej tij, le të ndalemi te mbishkrimi i pabotuar i Shkodrës. Gjatë vizitës së tij në Muzeun Arkeologjik të Shkodrës, më 1962, i treguan një mbishkrim të pabotuar, [illegible]ndur mbi një tullë gjatoshe, të thyer në pjesën e [illegible] poshtme. Balli i shkruar i kësaj tulle është i dëm[illegible] gërgjysmë. «Në pjesën e saj të poshtme bie në sy [illegible]a a dhe disa shënja .të tjera të errëta. Vetëm pjesa e sipërme e këtij mbishkrimi është e lexueshme, ndonëse edhe ajo mjaft e prishur nga koha». Ky mbishkrim, i lexuar nga e djathta në të majtën, paraqitet: iu paifuu bris naltu. Dhe do të thotë iu (hyut, hyjnisë, perëndisë) Paifuu (Phebus, Phulfu, Apolon Diell, bris (baris, bariut) naltu (të naltë): (Dielli, Apoloni, Febi dihet se ka qenë dikur perëndia, hyu i kopeve).

Pra, mbishkrimi i Shkodrës është një kushtim i shkurtër drejtuar: «Hyut Diell, bariut të naltë». Fjala e parë iu (hyu) është ilire dhe etruske. Fjala e dytë është greke dhe kjo shpjegohet me faktin se jemi në Iliri të jugës, krahinë fqinje me Eladën. Fjala e tretë, bari ose bëri është ilire, etruske, prej nga kaloi edhe në latinishte. E katërta, naltu është etruske dhe shqipe. Pllaka e jashtëzakonshme e Shkodrës, thekson Mayani, vërteton edhe njëherë tjetër autenticitetin e trekëndëshit iliro-etrusko-shqiptar. «Vlerën e këtij dokumenti të ri nuk mund të mos e marrin parasysh të gjithë ata që ia fillojnë studimit të gjuhës etruske pa paragjykime, pa komplekse dhe pa à priori. Ky është i pari, apo i dyti mbishkrim ilir i zbuluar gjer më sot. «(Po aty, fq. 326-329).

Në kapitullin «Disa vërejtje të fundit», duke folur reth lidhjeve Etruri-Shqipëri, Mayani thotë se përveç

gjátë gjíthë throughout
ballafaqój present face to face
ballafaqím face to face presentation
për të mos e zgjátur to cut it short
i paramendúar deliberate
i zbërthýer solved; resolved
i \gdhéndur chiseled
túllë brick
gjatósh longish
bállë front; face; forehead
gërmë letter
i érrët obscure
hy god
kushtím prayer
trekéndësh triangle
pragjykím prejudice

afërsisë në mes të gjuhës etruske dhe iliro-shqipes (duam të themi shqipes-bazë) dhe përkimit të emrit të toskëve të Shqipërisë me emrin toskë, Toskanë të Italisë, bien në sy edhe lidhje të tjera: a) mjaft emra të përveçëm të përbashkët; b) mjaft zakone, si maskat që u viheshin të vdekurve (të gjetura në Kiuzi të Etruries dhe në veri të liqenit të Ohrit); c) punime në bronx po të një stili, (si ai i gjetur në brigjet e liqenit të Ohrit me atë të kreshtës së Kimerës së Arecos); ç) kostumet e grave (xhubleta e Malësisë së madhe e përngjashme me kostumin e një valltareje etruske), etj.

Në shtojcat Mayani nxjerr gjithashtu pika të përbashkëta të ilirishtes me gjuhët balte; variacione të zanoreve dhe të disa bashkëtingëlloreve të përbashkëta të etruskishtes dhe shqipes së ndërrimi i a-së në e; ai atna — etna (etr) shqip: at — etën:; ndërrimi i a-së në u: Akrisius-Ukresia (etr) shqip. banues-bunë (kasolle); ndërrimi i i-së në l: piute-plute (etru),...

Përputhje rrënjësh dhe radikalesh; atra = at, anea = enë-a, kure-gur, ersha = errët, tal = dal, tial = djalë; thurs = thurrës etj.

Nga fjalori: ap = ap, aplu = ambël, aune = aynë, ai, endiam = endem, ape ruken = hape rrugën, ast = asht (koskë). at anti = mëma, karath-gardh, ecus = gjysh, kla = gaj, kure-gur, kala = gjallë, celi = gjellë, cerhun = therun, kuie = kuje, gjëmë; elfa = elb, vehr = vjehër, ve = ve (foje), vaze = vajzë, ui = ujë, zar = zjarr, zah = gjak, zi = zi, zui = zonjë, grua, ha = ha etj.

Gjer këtu u ndalëm kryesisht në përqasjet e fjalëve etruske me fjalët shqipe. Tashti le të ndalemi pak edhe në dy komponentet e tjera të metodës së ndjekur prej Mayanit: tek përqasjet e gjuhës etruske me fjalë ilire që kanë mbijetuar në emra njerëzish ose visesh të lashta iliro si edhe me disa fjalë iliro-etruske, që kanë mbetur në dialektet lokale të viseve ku dikur banonin fise ilire.

Le ta nisim nga viset e banuara dikur prej një grupi protoilir, prej pellazgëve, të afërt me etruskët, stërgjyshët e të cilëve, na thotë Mayani, duke u mbështetur te Kretçmeri, njihen që përpara njëmijëvjeçarit të dytë përpara erës sonë. Ata bëhen zotër të Larisës, qytet i Thesalisë, popullojnë Atikën dhe Argolidën. Në Lesbos, Trojë, Lidi e gjetkë, emrin Larisa pellasgët ua venë shumë qyteteve të tyre. Kretçmeri sheh një afrim në mes këtij emri pellazg dhe emrit të përveçëm etrusk Laris. Straboni shkruan se dikur Thesalia quhej Pellazgji. Në brigjet e Propontidit (Marmarasë) ngriheshin qytetet pellazge,

<u>përkím</u>	agreement
<u>émër i përvéçëm</u>	proper noun
<u>liqén</u>	lake
<u>kréshtë</u>	mane; crest
<u>xhublétë</u>	bell-shaped skirt
<u>valltár</u>	dancer
<u>shtójcë</u>	appendix; addition
<u>balt</u>	Baltic
<u>ndërrimi i a-së në u</u>	the change of <u>a</u> to <u>u</u>
<u>thúrrës</u>	fencer
<u>éndem</u>	loiter
<u>gardh</u>	fence
<u>thérun</u> = <u>therur</u>	slain
<u>elb</u>	barely
<u>ve</u> = <u>vë</u>	
<u>përqásje</u>	resemblance
<u>protoilír</u>	pre-Illyrian

Plakia, Skilakia, Kisiku. Pellazgët i gjejmë të vendosur në Lemnos dhe në Greqi. Lidhjet pellazgo-ilire vërtetohen proj gjuhës së tyre. Kështu, sipas «Iliadës», stërgjyshja e Larisës ishte thesaliotja (pra, pellazgia) Teutamos. Emri Teuta, thotë Mayani, është thjesht ilir dhe etrusk dhe do të thotë «popull», «qytet». Këtë e gjejmë edhe te osko-umbrasit. «Plakia» do të thotë «plaka», nga shqipja «plak», shumës «pleq». Në një shënim të Hesikut fjala «Pellas» përkthehet me fjalën «plak», megjithëse greqishtja ka një formë të përafërt: palai (nga vjen fjala «paleografi», etj.[1]).

Mayani, duke u mbështetur në mjaft argumente arkeologjike, historike e gjuhësore, dhe në një errudicion të pasur, zbritjen e etruskëve në siujdhezën e Apenineve (Italì), e lidh, në analizë të fundit, me lëvizjet e gjera etnike që gjatë mijëvjeçarit të tretë përpara erës së re tronditën dhe krijuan hap pas hapi botën e ardhëshme evropiane. Gjatë atij mijëvjeçari në brigjet e Danubit vërtetohen dyndjet e indoevropianëve të parë, që më vonë do të quhen edhe pellazgë «trakë», ilirë», «etruskë». Rreth viteve 2600-2300 përpara erës sonë, siç na dëshmon arkeologjia, në brigjet e Danubit, jo larg Beogradit të sotëm, dalngadalë gjahtarët neolitikë shndërrohen në bujq. Qysh atëhere gjejmë te ata poçerinë danubiane me ngjyrë të zezë, që është edhe karakteristika e parë e qytetërimit të tyre.

Përmjet Danubit këto popullata (fise), indoevropiane shtrihen në Panoni, Bohemi, Moravi. Po këto popullata (fise) rreth vitit 2000 i gjejmë në Cikladet, në Trojë, Kretë. Katër shekuj më vonë i gjejmë në Kroaci, Istria, Bosnjë, brigje të Adriatikut, Maqedoni. Tashti nuk kemi të bëjmë me një magmë etnike, po me fise trako-ilire dhe me stërgjyshër të grekëve. Një shtytje trake i hedh dorianët në Greqi dhe brigët ilirë në Azi të vogël. Një grup tjetër ilirësh depërton në Greqi pas dorianëve dhe shtrihet në Beoti, Argos, Spartë. Mali Bion në Beoti si edhe mali Mesapion (kuptimi: mes-ujrash, detesh), kundruall skajit verior të ujdhezës Fubea, janë fjalë ilire-trake. Vetë Beotia dikur quhej Mesapia. I pari mbret legjendar i Spartës, Oibalos dhe gruaja e tij, Bateja, kanë emra thjesht illre. Po kështu edhe djali i tyre, Tindari. Sipas Kretçmerit, thotë Mayani, ky emër përbëhet edhe nga dy elementë etruskë: Tin (emër i përveçëm) dhe dar = thur

1) Edhe këtu, si në shumë vënde të tjera, në përkthimin në shqip fjala «paleografi» bëhet «paleogjeografi».

shëním note
i përáfërt similar
siujdhézë = gadíshull
dýndje migration
bujq farmers
poçerí pottery
mágmë mingling
shtýtje push
tráke Thracian
skaj tip
ujdhézë = íshull

(shqip: dorë), në kuptimin fis, grup, bir (nga, dorë e Tinit, trashëgimtar i Tinit). Në Argos, sipas një legjende, «njeriu i parë» quhej Pellazgos. Një tjetër fis nga Dardania ilire u hodh edhe në Trojë. Këta i dhanë emrin grykës së Dardanelevo dhe arritën gjer në sundim të Trojës homerike. Emrat homerikë Priam, Paris, Baton, Bunimos, Asarak janë emra ilirë. Edhe një fis tjetër ilir, meonianët, hidhet nga Maqedonia në jugë të Trojës dhe atdheu i tyre do të quhet Lidi. Karakteri i këtij qytetërimi, që gabimisht cilësohet si «egjean», thotë Mayani, është përkufizuar shumë qartë nga Ed. Meyer, i cili ka vërejtur «lidhje të shumta të kulturës trojane, në teknikë, në formë të enëve, në llojet e dekorimeve, në veglat dhe armët, jo vetëm me tumbat e Trakës, por edhe me zbulimet e neolitikut në Evropën qendrore e lindore, dhe, përpara së gjithash, në trevën e Danubit». (V. Ed. Meyer - Gesch. des Altert., I, 2 & 500, 1928).

Të gjitha këto fise flisnin dialekte të ndryshme trako-ilire, të cilat degëzohen gjithnjë e më tepër dhe mund të duken si të ndryshme, ndonëse kanë rrënjë të përbashkëta dhe një numër shumë të madh fjalësh të njëllojta. Nga këta do të shfaqen edhe turshët, etruskët. (Po aty, fq. 20-23), edhe këta të afërt me këto fise ilire të Azisë së vogël. Edhe këta, ashtu si pellazgët, dardanët, brigët, mesianët, meonianët e të tjerë hidhen nga Ballkanet në Azi të vogël. Atje, të kalitur nga bota mikeneane në ndërmarrje detare të mëdha, etruskët lidhen me akeanët si edhe me fqinjët e tyre, dardanët, sardianët, teukrët, likianët, me gjithë këta «popuj të detit», plaçkisin edhe Egjiptin dhe më vonë, ashtu si pellazgët, dardanët, etruskët braktisin Azinë e vogël krejtësisht apo pjesërisht, kjo nuk dihet) dhe kërkojnë vendbanime të reja. Tok me trojanë ilirë, me elimët (edhe këta ilirë), shtegtojnë ujrave të Mesdheut: teukrë, filistinë dynden në drejtim të Kananit, e limët drejt Siqelisë, sardinët drejt Sardenjës, etruskët drejt brigjeve të Tirrenit dhe të lumit Tibër dhe trevave rreth këtij lumi u japin emrin Etruri. (Eposet «Odisea» e Homerit dhe «Eneida» e Virgjilit tërthorazi shtojmë ne, janë, në të njëjtën kohë, edhe pasqyrim fantastiko-legjendar i këtyre shtegtimeve të lashta me baza reale historike). Sigurisht që edhe në këto vende të reja gjetën banorë të tjerë, por me epërsinë e tyre si shkallë zhvillimi e qytetërimi; këta të ardhur, me kohë, bëhen zotëronjës dhe faktorë me rëndësi të madhe qytetërimi. Një pjesë e etruskëve, thotë Mayani, në mënyrë «hipotetike», «mund të jetë vendosur edhe në Shqipërinë e sot-

grýkë strait; pass
sundím domination; rule
gabimísht erroneously
cilësój designate; classify
përkufizój delimit; define
énë utensil
túmbë tomb
i njëllójtë identical
detár naval; marine
ashtú si just as
dýndem migrate
epós = epíkë epic
tërthórazí indirectly
zotërónjës ruler

me, ndofta më vonë, për t'i shpëtuar shtypjes së romakëve». (Po aty, fq. 408).

Sikurse shihet, vepra e Mayanit «Fundi i «misterit» etrusk», nuk ka rëndësi vetëm gjuhësore, po edhe historike. Pra, jemi të mendjes se meriton të trajtohet me seriozitet jo vetëm nga gjuhëtarët po edhe nga arkeologët e historianët tanë.

Është krejt e natyrshme që autori në zbërthimet e tij gjuhësore mund të ketë edhe gabime e të meta. Këtë edhe ai vetë e pranon. Por çështjet që ai shtron, metoda që ai përdor, në bërthamë të saj, ashtu siç e pohojnë edhe dijetarë të sotëm me peshë, (pohime, të cilat i përmendëm që në krye), na detyrojnë të mbajmë qëndrim. Teoria jo indoevropiane autoktoniste e Pallottinos me shokë rreth origjinës së etruskëve, siç dëshmohet nga shumë dijetarë bashkëkohës, nuk i bën ballë dot kritikës serioze dhe fakteve të shumta arkeologjike, historike e gjuhësore, të cilat i lidhin etruskët dhe gjuhën e tyre me popuj e gjuhë të Ballkanit dhe të Azisë së vogël pellazgo-trako-ilire, me popuj dhe gjuhë indoevropiane, pra, edhe ilire-shqipe.

Gjuha etruske «kjason (kullon, pikon, nxjerr) nga të gjitha poret e saj, thotë Mayani, një indoevropianizëm--arkaik dhe ballkanik. Ta mohosh këtë, ky nuk është më një bindje, por vetëm një ide fikse. Për këtë shkolla kombinatore e Pallottinove duhet t'u japë llogari dijetarëve objektivë». (Po aty, bot. origjinal, fq. 414).

Antiilirizmi i Pallottinove, me shokë, sot, dashje pa dashje, ia çon ujët në mulli edhe antishqiptarizmit, me sfond politik dhe ideologjik, që u shtua, veçanërisht, pasi populli ynë, me luftën e tij antifashiste, arriti të bëhet zot i atdheut dhe vendosi demokracinë socialiste. Ky antishqiptarizmë u shfaq dhe shfaqet, jo vetëm në shtyp, po edhe në botime historike, arkeologjike, gjuhësore. Pa u shtrirë gjatë, le të ndalemi edhe në një krahasim të vogël në mes dy fjalorëve enciklopedikë italianë, të destinuar për masat e gjera, tek fjalori «Melzi scientifico», botim i vitit 1942 dhe «Enciclopedia Garzanti», botim i vitit 1962. Le t'i lemë mënjanë dizinformimet historike, të vjetra e të reja, të të dy fjalorëve, si të ashtuquajturin «pushtim sovjetik të Shqipërisë që më 1944» (Garzanti vll. I., fq. 34), Shkodrën të cilësuar si «seli të metropolitit të kishës kombëtare ortodokse» (po aty, vll. II), e të tjera si këto, dhe le të kufizohemi në raportet ilirë-shqiptarë. Në «Melzi scientifico» të 1942-së ilirët cilësohen si paraardhësit e shqiptarëve :«Ilirë: popull indoevropian,

péshë influence
pohím admission
i bën bállë meets the challenge
por pore
nuk është më is no longer
kombinatór combinative
llogarí account
dáshje pa dáshje willingly or unwillingly
ia çon újët në mullí serves the interest of
sfond background
dizinformim misinformation
selí see; seat
raport relation

në lashtësi shumë i përhapur dhe sot i reduktuar në shqiptarët» (Po aty, fq. 631). Në «Garzanti» të 1962 ilirët janë «një popullatë e lashtë indoevropiane e vendosur në mes të Istries dhe maleve Karaune». (Po aty, vll. I, fq. 664). Pra, shqiptarët këtu nuk na dalin si pasardhës të ilirëve. Le të shikojmë emrin «shqiptarë»: Tek «Melzi scientifico» të 1942-së: Albanezi (shkiptari): popull trako-ilir, banorë të Shqipërisë». (Po aty, fq. 35). Në «Garzanti» të 1962-së emri shqiptarë (albanezi) nuk ekziston fare si kombësi më vete, kurse Shqipëria (Albania) si shprehje gjeografike që në lashtësi ishte «një provincë romake e Ilirikumit». (Po aty, fq. 34). Për etruskët «Melzi» i 1972-së qëndron plotësisht në pozitat Pallottiniane. (Po aty, fq 448), kurse «Garzanti» i 1962-së pranon, me një «ndofta», ardhjen e tyre prej Azisë së vogël dhe në artin e tyre sheh ndikime greko-ballkanike (lindore). (Po aty fq. 484). Le të shikojmë arbëreshët. Në «Melzi scientifico» të 1942-së këta përmenden në fjalën «italo-greke»: «emër që gabimisht u është dhënë shqiptarëve të vendosur në Pulje, Kalabri e Siqeli në shekujt 15 e 16». (Po aty, fq. 899). Si sasi, popullata arbëreshe, e njohur si nacionalitet më 1942, përbën 2 për mijë të gjithë popullsisë së Italisë, (Melzi, fq. 682), përmenden edhe disa shkrimtarë arbëreshë, si De Rada, Skiro. Kurse, pas njëzet vjetësh, më 1962, «Enciclopedia Garzanti» arbëreshët si nacionalitet, i fshin fare nga defteri. Bashkë me De Radë e Skiro këta janë shkrirë si kripa në njët e reaksionit shovenist italian të pasluftës së dytë botërore. Këtu nuk kemi të bëjmë as me ndonjë «svista» apo «lapsus» të rastit, por me qëndrime të përllogaritura me djallëzinë më të stërhollë jezuitike, që i kalon shumë sferat e redaksive të botimeve për masat e gjera: shpifja dhe dizinformimi për popujt që janë bërë sovranë të vendeve të tyre, pra, edhe për neve, janë ngritur në një sistem të gjerë e të përbindshëm për të krijuar mjegull, pasi në mjegull gjahu për ujqit imperialistë të çdo ngjyre mund të bëhet më me lehtësi.

Edhe nga kjo anë, dy veprat e Mayanit «Etruskët fillojnë të flasin» dhe «Fundi i «misterit» etrusk», meritojnë të përshëndeten, bashkë me vlerat e tyre në fushën e zhvillimit të dijeve historiko-gjuhësore.

Përkthimi i veprës «Fundi i «misterit» etrusk» në përgjithësi nuk na duket i keq, por mendojmë se po të ishte treguar një kujdesje më e madhe, mund të mos ishin lejuar shumë gabime, të cilat shpesh dëmtojnë edhe kuptimin. Pakujdesje është treguar madje që në faqe të parë,

i 1972-së = i 1942-së (mp.)
sasí quantity
deftér notebook
svísta oversignt
lápsus lapse
i përllogarítur calculated
djallëzí deviltry
i stërhóllë refined
sférë sphere
shpífje lie

ku as që thuhet se kjo vepër është një përkthim, ashtu si nuk thuhet asgjë për autorin, qoftë edhe në një shënim të shkurtër, e ca më mirë do të ishte në një parathënie. Po e njëjta pakujdesje vazhdon të bjerë në sy edhe në «Shkurtimet-Shqiptimi-Alfabeti», ku, jo vetëm mbiemri Buffa është bërë Buja, por edhe shqiptimi i gërmave të alfabetit etrusk nuk është shoqëruar me shqiptimin e gërmave korrespondente të alfabetit shqip c, ç, ë, j, q, sh, x, xh. Po në këtë faqe, në alfabetin etrusk të transkriptuar, dy gërmat o dhe f janë paraqitur keq. Por, pavarësisht nga këto të meta të përkthimit, vepra «Fundi i «misterit» etrusk» e vlen të studjohet me seriozitet nga të gjithë ata për të cilët janë të shtrenjta si historia dhe gjuha e popullit tonë ashtu edhe të vërtetat rreth lashtësisë dhe qytetërimit të popujve.

Andrea Varfi "Fundi i misterit etrusk dhe gjuha shqipe", Nëntori (Tirane), XXI, 7 (July), 1974, pp. 171-181

shkurtím abbreviation
shqiptím pronunciation
mbiémër surname
i shtrénjtë dear

PROBLEME TË TREGIMIT FANTASTIK SHKENCOR PER FEMIJE

rahas gjinive të tjera të letërsisë për fëmijë në rrugë
ërë po ecën edhe gjinia fantastike ose njohëse shken-
ër fëmijë, sidomos këto vitet e fundit. Nga skicat e
et e thjeshta, që botoheshin disa vite të shkuara ve-
ë revista e gazeta, janë botuar disa vëllime me tre-
novela dhe romane të këtij zhanri. Ndër të parët që
htua kryesisht kësaj letërsie është Flamur Topi. Kra-
hrit të tij sot mund të radhisim një numër autorësh
atribuojnë në këtë zhanër si: Alqi Kristo, Bedri De-
kënder Drini, Kudret Hoxha, Niko Deda, Nexhip Ne-
li Eltari, Llambro Ruci, Riza Hasimi. Përralla të bu-
hkencore kanë shkruar Naum Prifti, Bardhyl Xhama,
sa Vreto, Gaqo Bushaka etj.
as librit të parë me tregime shkencore «Zemra tri-
botuar më 1969 prej Flamur Topit, një vit më vonë
ne vëllimi tjetër i tij «Tinguj të harruar». Po më 1970
p Nexha doli me vëllimin «Toka sulmon detin». Niko
ka botuar dy vëllime radhazi me tregime të tilla:
i i Arkimedit» (1973) dhe «Letër nga Hëna» (1974),
Ali Eltari «Fotografia blu» (1974). Janë botuar dhe
ovela si: «Një jetë në anije» (1972) të Alqi Kristos,
ëtari i planeteve» (1973) të Kudret Hoxhës, «Kërcë-
thonjve kozmikë» të Bedri Dedjes, etj. Ndër të parët
ëvroi zhanrin fantastiko-shkencor me përmasa më

fantastík shkencór science fiction
fantastík fantasy; fantastic
gjinía fantastík. óse njóhëse shkencóre
the fantasy or science fiction group
skícë sketch
zhánër genre
radhís line up
rádhazi in succession
lajmëtár messenger
thonj (thúa) claws
përmásë dimension

të gjera qe Alqi Kristo me romanin «Shëtitje në kozmos». Edhe romani «Njeriu gjigand» i Skënder Drinit ka elemente fantastike shkencore.

Por arritjet e letërsisë fantastike shkencore në vendin tonë duhen parë jo vetëm në anën sasiore, por edhe në atë cilësore, sidomos në përmbajtje.

Kjo letërsi përshkohet fund e krye nga partishmëria dhe ideologjia socialiste, ajo u bën jehonë ideve të kohës sonë, duke i shikuar problemet në prizmin e mprehtë klasor revolucionar, në luftë me botkuptimin idealist e bestytnytë fetare. Kështu psh, në tregimin «Vëllezërit biotikë», Flamur Topi shpjegon edhe dukurinë e flakëve që duken natën në varret, që sipas bestytnive «i ndiznin djajtë». Në tregimin tjetër «Nervi» po ky autor fut moralin tonë: «armikut mos i beso». Në «Tregim për gurin me vija« Nexhip Nezha u çjerr maskën njerëzve të fesë, të cilët gënjenin njerëzit e paditur me rrobat e bëra me fije asbesti duke thënë: «Këto rroba kanë rënë nga qielli dhe janë të shenjta, nuk dig. Futeni këtë xhyben në zjarr dhe do të shikoni se nuk digjet.....»

Fabulën dhe subjektin e tyre ato e zhvillojnë në ambientet shqiptare. Në ato tregime shpalosen bukuritë e natyrës sonë, forca e njeriut të punës, që nën udhëheqjen e Partisë po e bën edhe më të begatshëm këtë vend, po ndërton shoqërinë socialiste. Kështu në tregimet e Nexhip Nezhës spikat bukuria e pyllit me pisha të Divjakës, Jugu i Shqipërisë me Butrintin, stalagtitet e stalagmitet e gurorës së Urës Vajgurore të Beratit, kënetat e thara nga dora e njeriut e të kthyera në toka pjellore, Pishkashi me pasuritë e tij minerale etj. Parakalojnë para syve të lexuesit të vogël bukuritë e malit, qyteti i lashtë i Beratit, fusha e begatë e Myzeqesë. Me tregimin fantastik shkencor «10 ditë në nëdhesen «Shamia e pionierit»» të Riza Hasanit, lexuesi njihet me pasuritë nëntoksore të Atdheut tonë, me vendet ku gjënden ato. Tregimet e tij mbi elektrisitetin Llambro Ruci i lidh me elektrifikimin e vendit. Në to pasqyrohet puna për të sjellë dritën elektrike në fshatrat e malësisë së Veriut, jepen tablo kur në fshat sjellin transformatorin me elikopter, bëhet fjalë për hidrocentralet e vendit tonë, për sistemin e përbashkët energjitik të Atdheut, për uzinën e llampave elektrike në Vlorë e atë të telave në Shkodër etj.

Kjo letërsi hedh dritë edhe në të ardhmen e ndritur të vendit tonë. Realizimet e ardhshme të teknikës autorët i vendosin në Shqipëri. Kështu Niko Deda stacionin lëvizës

sasiór quantitative
bestytny = bestytní (mp) superstition
biotík biological
dukurí appearance; phenomenon
víjë line
i begátshëm prosperous; plentiful
guróre quarry
kënétë marsh
i thárë drained; dried
parakalój parade
i begátë = i begatshëm
nëdhesë underground
nëntoksór underground
tabló scene; tableau
hidrocentrál hydro-electric power plant
uzínë factory; machine shop

hekurudhor të së ardhmes, ku treni në asnjë stacion s'do ta zvogëlojë shpejtësinë e udhëtarët do të mund të hipin e të zbresin nga ai me anë të platformës rrotulluese, e vendos në Shkozet etj.

Personazhet pozitive të këtyre tregimeve, zakonisht fëmijë, kanë botën e brendëshme të njerëzve tanë të brumosur nga idetë e Partisë dhe mësimet e shokut Enver. Tregimet fantastike shkencore i nxisin nxënësit të punojnë, u zgjojnë kurreshtjen, u rrisin zotësinë, u kumtojnë dituri, u zhvillojnë të menduarit shkencor. Fëmijve u duket vetja pjestarë aktivë në procesin e njohjes. Ata janë të etur për dije dhe shkencë, për të zgjeruar horizontin, janë të etur për të bërë shpikje. Pionierët që veprojnë në tregimet e Ali Eltarit synojnë për të fituar dijeni të shkencave biologjike më të gjëra nga ato që kanë tekstet shkollore, ata të Flamur Topit — njohuri mjeksore e të anatomisë, ata të Niko Dedes, Llambro Rucit e Riza Hasimit — njohuri fizike, ata të Nëxhip Nezhës — njohuri gjeografike etj. Që këndej pra rrjedh dhe vlera e madhe edukative që kanë këto tregime për brezin e ri. Ato janë mjet i edukimit politik, moral dhe ideo-estetik të këtij brezi.

Meritë e kësaj letërsie duhet konsideruar saktësia shkencore e njohurive, të cilat janë thjeshtëzuar, janë bërë më të kuptueshme për lexuesin sipas moshës që i drejtohet, si dhe niveli i ngritur artistik. Autorët që shkruajnë bëjnë përpjekje për të njohur sa më thellë botën e brendëshme të fëmijëve, ta përshkruajnë atë nga këndvështrimi fëminor. Kjo letërsi u nënshtrohet qëllimeve arsimore të shkollës sonë dhe të edukimit komunist të brezit të ri. Për t'u komunikuar lexuesve të vegjël këto apo ato njohuri shkencore është gjetur fabula e bukur dhe tërheqëse, që përmban në vetvete edhe moralin e saj. Disa nga këto tregime përshkohen nga një humor i natyrshëm që e kanë me aq dëshirë fëmijët.

Veç arritjeve, në tregimet e këtij zhanri vihen re edhe të meta e dobësi, që në të ardhmen do të kapërcehen, se janë të meta të rritjes, të ecjes përpara.

Njera nga dobësitë e kësaj letërsie është ngushtësia e problemeve që trajton, tematika e kufizuar e saj. Letërsia fantastike shkencore është ndihmëse e mësimeve që merr nxënësi në bangat e shkollës. Kjo letërsi thellon dhe zgjeron horizontin e atyre dijeve. Në këtë mënyrë ndihmon karakterin politeknik të shkollës. Tregimet e kësaj natyre u rrëfejnë nxënësve në mënyrë tërheqëse për anatominë e fiziologjinë e njeriut, për fizikën, kiminë e prodhimin

hekurudhór railway
zvogëlój decrease; reduce
rrotullúes revolving
nxis encourage; incite
kurréshtje = kureshtí curiósity
kumtój communicate
pjestár = pjesëtár participant
i étur thirsty
thjeshtëzój simplify
móshë age
kendvështrím viewpoint
fëminór = fëmijór pertaining to a child or children
nënshtróhem fit in; conform
bángë bench

moderne, për ato ligje shkencore që përbëjnë parimin e funksionimit të makinave të ndryshme. Por duhet pranuar se këto tregime kanë qenë ende të pakta për të mbuluar pjesën më të madhe të temave të programeve shkollore; pastaj në disa lëndë, si kimia, e cila po njeh zhvillim të paparë në vendin tonë, janë shumë të pakta tregimet me karakter njohës shkencore, s'kemi asnjë vëllim me tregime të këtij lloji.

Ne kemi disa tregime njohëse shkencore për teknologjinë e prodhimit të plehut kimik, të çimentos, të letrës, për teknologjinë e përpunimit të naftës e të pambukut. Por janë shumë të rralla tregimet për planet e mëdha 5-vjeçare, mbi ndryshimet që po pësojnë harta e Atdheut tonë. Në to mund të jepen me forcë artistike idetë dhe përpjekjet e Partisë sonë për lumturinë e popullit, epërsia e rendit tonë socialist mbi atë kapitalist etj. Në këtë mënyrë ne do t'i njohim fëmijët edhe me ligjet themelore ekonomike të socializmit. Kuptohet se këtë do ta bëjnë jo me leksione, por në mënyrë artistike.

Po kështu në letërsinë tonë fantastike shkencore mungojnë edhe tregimet për insektet që dëmtojnë bimët bujqësore, për përpjekjet që bëjnë punonjësit tanë të bujqësisë për studimin pedologjik të tokave, për sistemimin e parcelave, për eksperimentimet e frutshme që po rritsin rendimentet e kulturave bujqësore, shkurt, tregimet për futjen e shkencës në bujqësi.

I varfër është tek ne edhe tregimi biografik për njerëzit e mëdhenj të shkencës e të teknikës. Jeta e këtyre njerëzve është heroike, ajo është e mbrujtur me dashurinë për shkencën për Atdheun, për njerëzimin. Për të zbuluar ndonjë ligj ata kanë arritur ngadonjëherë të bëjnë sakrificën më supreme, deri në vetmohim. Shumë prej këtyre figurave të shquara janë viktima të rendeve shoqërore antipopullore, viktima të kishës. Ndaj edhe tregimet rreth biografisë së këtyre njerëzve janë shumë edukuese për brezin e ri. Ato frymëzojnë dashurinë për shkencën e për Atdheun, pasionin për punën shkencore, këmbënguljen, burrërinë e veti të tjera pozitive të karakterit.

Letërsia jonë ka bërë hapat e para në këtë fushë. Është e mirë puna e autorit Niko Deda i cili na ka dhënë «grimca nga jeta» aq e pasur dhe e apasionuar për fizikën e Galileo Galileut, si dhe nga zbulimet më me vlerë të Arkimedit (tregimi «Gjyqi i Arkimedit»). Po i tillë është tregimi tjetër i po këtij autori «Procesi numër ekstra». Në to është përshkruar kjo ngjarje e vërtetë: përplasja e çu-

pleh fertilizer
létër paper
përpuním processing
náftë oil
pësój undergo
hártë map
epërsí superiority
pedologjí pedology; study of the soil
parcélë parcel (of land)
i mbrújtur leavened
këmbëngúljе persistence
burrërí bravery
përplásje collision

ditshme e anijeve të mëdha «Olimpik» dhe «Gauk» në çastin kur po lundronin paralel me njëra tjetrën, në distancë të vogël. Tregimi të edukon me dashurinë për të zotëruar ligjet e fizikës. Te ne janë të pakta tregimet e këtij lloji. Është mirë që të shkruhen edhe më shumë tregime biografike duke zgjedhur nga shkenca e vendit tonë, apo ajo botërore ato figura shkencëtarësh që zgjojnë interes duke i shikuar me syrin aktual. A nuk do të ishte emocionues, për fëmijët një tregim përshëmbull, për djegjen mbi turrën e druve të Xhordano Brunos nga kisha katolike? Letërsisë sonë i del për detyrë, në radhë të parë, të pasqyrojë figurat e shquara të shkencës shqiptare në të kaluarën dhe sot në fushën e shkencës, të pasqyrojë figura punëtorësh, shpikësash e racionalizatorësh, teknikësh, inxhinierësh etj, shqetësimet, përpjekjet ëndrrat e tyre, kujdesin dhe ndihmën e gjithanëshme që tregon për ta Partia jonë.

Në shumë tregime shkencore jepet bukur dhe në mënyrë tërheqëse procesi teknologjik i prodhimit të këtij apo atij artikulli industrial. Megjithatë ne duhet ta konsiderojmë si dobësi, si të metë esenciale mungesën e dhënies së njeriut, punëtorit tonë duarartë, që nën udhëheqjen e Partisë nënshtron dhe transformon natyrën, vë në lëvizje ato makineri, që prodhojnë atë artikull industrial për të cilin e bëjnë tregimin. Ai detyron lumin të vërtitë turbinat, shkëmbin të prodhojë bukën, zotëron teknikën dhe aplikon shkencën. Kështu psh përralla fantastike shkencore «Mrekullitë që ndodhin në qytetin prej hekuri» e Shpresa Vretos, jep mirë rrugën e marrjes së benzinës, vajgurit, gazoileve dhe mazutit nga nafta, por aty nuk del si duhet bota e atyre njerëzve që nxjerrin naftë, bota e naftëtarëve tanë. Janë njerëzit ata që e detyrojnë naftën të marrë udhën «nëpër qytetin prej hekuri», ata që zbatojnë shkencën.

Bukur na jep Gaqo Bushaka luftën që bëjnë punëtorët për kursime. Në përrallën e tij «Ç'më ndodhi me një fije pambuku» fija e pambukut, që e ka marrë për dore Gentin, për t'i treguar procesin teknologjik të përpunimit të saj brenda kombinatit, i thotë vogëlushit:

«— Tani unë do të zvoglohem dhe do të futem në xhepin tënd. Kujdes se mos harron dhe më shtyp!

— Pse do të zvogëlohesh.

— Po më panë punëtorët, ti mbete vetëm. Ata nuk lënë asnjë fije pambuku të vejë dëm».

Duhet pranuar që në këto lloj tregime nuk ka dalë sa duhet punëtori ynë novator racionalizator, përpjekjet e këtyre njerëzve për të shpënë përpara prodhimin, bota e

aktuál current; realistic
túrrë pile
shpíkës inventor
racionalizator worker who applies the principles of science to production
shqetësím concern
duarártë golden-handed
vërtít turn
vajgúr petroleum; kerosene
gazoíl diesel fuel
mazút tar
naftëtár oilman
fíje strand
kombinát factory; plant
të véjë dëm go to waste
novatór innovator

tyre e brendëshme, motivet që i shtyjnë për të bërë këto shpikje e racionalizime. Prania e heronjve të tillë jo vetëm do të pasqyronte më mirë klasën punëtore të vendit tonë, por do të kishte vlera të mëdha edukuese për brezin e ri.

*
* *

Shumicën e tregimeve fantastike shkencore autorët tanë i kanë ngritur mbi bazën e një fabule interesante. Nëpërmjet kësaj fabule jo vetëm jepen njohuri shkencore, por del edhe një moral i saj.

Por jo gjithmonë në tregimet e botuara është gjetur një subjekt me konfliktin e duhur, që të mbajë në këmbë tregimin. Pra shumë herë tregimet e tillë kanë të njëjtën skemë ndërtimi: paraqitet një «dukuri e çuditëshme» dhe pastaj mësuesi, inxhinieri, apo ndonjë tjetër tregon sekretin shkencor të «çudisë».

Më të shumtën e herëve tregimi nis me një linjë artistike dhe përfundon me atë shkencore dhe teknike, pra në shpjegimin e një kurioziteti, në një «orë të thjeshtë biologjie, fizike apo gjeografije» duke iu drejtuar drejtëpërdrejtë mëndjes së lexuesve të vegjël. Kjo e bën tregimin të mërzitshëm e pa interes. Që vepra të jetë artistike duhet të veprojë jo vetëm mbi gjykimin, por edhe mbi ndjenjën, të nxisë përfytyrime dhe emocione të forta.

Shumë nga tregimet e Ali Eltarit në vëllimin «Fotografia blu» janë të ftohta dhe pa jetë, pa dinamizëm, s'janë gjë tjetër veçse përshkrime të thjeshta eksperimentesh. Le të marrim psh tregimin «Fotografia blu» nga i cili merr edhe emrin vëllimi: Zamira shkon në shtëpinë e Norës. Ajo çuditet nga një fotografi me ngjyrë blu, që ishte stamposur në gjethen e një bime, të vendosur midis dy xhamave. Për të mësuar se si bëhet një fotografi e tillë, vajzat shkojnë tek Gimi, antar i rrethit të natyralistëve. Në praninë e tyre, djali bën n. . tjetër fotografi të tillë. Pra këtu mungon trilli artistik, kënaqësia e zbulimit.

Kur fillon të lexosh tregimin e gjatë «10 ditë në nëdhesen «Shtëpia e pionierit»» të Riza Hasimit, entuziazmohesh nga fantazia e ndezur e autorit për ambientin e ndërtuar. Dhe duke udhëtuar me atë nëndhese, pret shumë të papritura. Po ky interes nuk vazhdon gjatë. Vëmendja e lexuesit bie. Tregimi bëhet monoton. Dhe e dini pse? Mungon konflikti i duhur, mungon fabula, aventura fëminore (kujtoni psh romanin e Zhyl Vernit «Udhëtim për në qendër

i dúhur needed
skémë scheme
përfytyrím vision; picture
stampós stamp
trill notion

të tokës», që ka të njëjtën temë, udhëtimin e nëndheshëm). Tregimi kalon në përshkrim, duket dora e teknikut, por jo fantazia e letrarit. Po kështu, nuk mund të konsiderohen tregime pjesët «Copëza të një ditari», «Në lumë», «Bisedë në plazh», «Udhëtim i fizikantit të vogël» etj. të Niko Dedës.

Edhe disa nga «tregimet gjeografike» të Nexhip Nezhës s'janë gjë tjetër veçse përshkrime gjeografike. Kështu psh në tregimin «Mali me kësulë» përshkruhet Guri i Pishkashit; inxhinier Batoja u tregon pastaj fëmijve se si është krijuar ajo «kësulë». Për të thyer monotoninë dhe shabllonizmin e skemës së vetme mbi të cilën janë ndërtuar pesë nga këto tregime, sipas së cilës tregimi fillon me një dukuri gjeografike që u bën përshtypje fëmijëve dhe vazhdon me sqarimin që bën inxhinieri, mësuesi, gjeologu etj., autori përdor edhe formën e hartimit («Një mrekulli e Myzeqesë») si dhe atë të letrës («Margaritari i Jugut»). Por përsëri ato pjesë ngelin në nivelin e skicave pa arritur në tregime.

Mbi një bazë më interesante janë ngritur perrallat shkencore «Ngjala, pulëbardha dhe historia e kënetave» dhe «Teli e harabeli». Ndërsa «Përbindëshi me gjuhë të zjarrtë» ka elementët e një tregimi njohës shkencor.

Edhe arsyetimet e gjata nuk janë në natyrën fëminore. Nga një dobësi e tillë vuan psh tregimi «Kushurinjtë» i Ali Eltarit. Është pozitiv fakti që në këtë tregim autori e vë fëmijën në rolin e shkencëtarit, por gjykimi aq i thellë, kredhja në mendime të tilla, nga të cilat Genci qe bërë si i «hutuar», biseda me vetveten për të mësuar të vërtetën, nuk janë të natyrës fëminore. Është e pabesueshme që një fëmijë të arrijë kaq shpejt e kaq thjeshtë në konkluzione të tilla, psh që njerëzit e bimët kanë ngjashmëri që shkencës i janë dashur aq mund e djersë, aq eksperimente. Pra, tregimi vuan nga mungesa e aksionit, e dinamizmit gjë që e bën atë të lodhshëm për lexuesin...

Në letërsinë tonë fantastike shkencore shohim ende një përzierje pa kriter të elementëve fantastikë me ata realë, shohim ngatërrim të këtyre dy planeve.

Flamur Topi herë-herë tregimet e tij i jep mbi bazën e një plani të vetëm, real ose fantastik, herë mbi bazën e dy planeve ose me elementë të tyre. Kështu tregimi «Beteja e ashpër» zhvillohet i gjithi në planin fantastik. Në një plan të vetëm fantastik jepet dhe tregimi «Gjyqi i vitaminave», veçse këtu kemi përzierje pa kriter të elementëve realë me ata fantastikë.

kësúlë cap
shabllonízëm triteness
sqarím explanation
ngel become stuck
ngjálë eel
pulëbárdhë seagull
harabél sparrow
arsyetím reasoning
kushurinjtë = kushërínjtë
krédhje immersion; diving
i hutúar dazed; bewildered
ngjashmërí similarity
plan plane; plan
i gjíthi = i gjíthë
gjyq trial; court

Mbi bazën e dy planeve shtjellohet tregimi «Një fund i lavdishëm». Tregimi nis në plan real. Artani mëson mësimin për rruazat e gjakut... Befas (dhe këtu fillon plani fantastik), dëgjon disa hapa. Vijnë Leukosi, Eritrosi dhe Trombosi... Në fund përsëri kemi plan real: Artani i del gjumi dhe e kupton se e gjithë ajo ngjarje e çuditshme s'kishte qenë gjë tjetër veçse një ëndërr.

Përzierje pa kriter planesh shohim edhe te «Ëndrra e Bledarit», tregimi «Gjyqi i Arkimedit» të Niko Dedes dhe te Llambro Ruci në tregimin «Punëtori i padukshëm» («Pionieri», 20 nëntor 1968 – 8 janar 1969).

Pra, siç shihet dhe nga këto që thamë, përparësia u takon tregimeve me tematikë shkencore që ngrihen mbi bazën e një plani të vetëm, real ose fantastik. Do të ndalemi dhe në mënyrën e kalimit nga njëri te tjetri. Mënyrat mund të jenë nga më të ndryshmet, nga më të larmishmet. Ngadonjëherë nuk përdoret asnjë mjet i tillë. Kështu tregimi «Gjigandi i urtë që gumëzhin» nis me një plan real: në një fshat malor sjellin me elikopter një transformator. Elektriçisti u tregon fëmijëve pjesët përbërëse të tij. Në mbrëmje fëmijët mblidhen dhe shkojnë tek transformatori. «Kur arritën atje, – vazhdon autori i tregimit Llambro Ruci, – gjëmoi një zë i rëndë që i bëri të dridhen(!)

– Mirëserdhët, të dashur fëmijë»

Dhe pastaj nis biseda midis fëmijëve dhe transformatorit. Pra autori nuk përdor asnjë mjet kalimi, veçse mugëtira e mbrëmjes krijon një sfond fantastik.

Po kështu te tregimi «Punëtori i padukshëm» i po këtij autori: «Duke folur, elektroni me Amanden, zënë dorë për dore, qenë futur thellë në qytetin e atomeve të bakrit».

Në shumicen e rasteve si mjet artistik kalimi perdoret ëndrra; fëmija shikon në ëndërr një skenë për të cilën ka lexuar diçka në libër, i ka folur ndokush apo e ka shqetësuar një pyetje. Ngadonjëherë është përdorur edhe ndonjë mjet artistik i diskutueshëm. Le të marrim psh tregimin «Iliri i vogël e rrezet rontgen» të Flamur Topit. Ne fillim kemi një plan real: Ilirin e vogël e ka marrë i ati, mjek, që ta vizitojë në radioskopi, që ta njohë me rrezet rontgen. Babai i jep Ilirit një palë syza magjike dhe e fut djalin në dhomën e rrezeve (këtu fillon plani fantastik). Në «mbretërinë e çuditshme» vogëlushit i dalin përpara tri rrezet: rrezja rontgen, ultraviolet, infraruzhe. Djali bisedon me to (rrezet tregojnë historinë e zbulimit të tyre, dobitë etj) madje hyn dhe në marrëdhënie me to (rrezja rontgen i jep

rruázë = ruízë corpuscle; bead
gumëzhít roar
pjésë përbérës component part
mugëtírë dusk
bakër copper
i diskutúeshëm debatable
rrézet róntgen X-rays
radioskopí radioscopy; fluoroscopy
sýza glasses
dobí benefit

vogëlushit një përparëse me doreza prej plumbi për t'u mbrojtur nga vetë rrezja).

Pra në këtë tregim planet janë të pavarur nga njeri tjetri dhe ky fakt është pozitiv, veçse mjeti artistik që përdor autori për kalimin nga njeri plan në tjetrin (syzet magjike) le për të dëshiruar. Ai e çorodit arsyetimin e fëmijës, ndikon keq në formimin e botkuptimit të tij materialist.

Këto mjete artistike me magji, si «syzet magjike», apo «plakushe» që të zvoglojnë me marifetet e tyre, janë elemente mistike dhe nuk i vlejnë aspak edukimit materialist të fëmijëve tanë.

Dobësi tjetër në letërsinë tonë fantastike shkencore është dhënia e njohurive shkencore në atë masë që nuk mund të përvetsohen lehtësisht nga mosha fëminore së cilës i drejtohen. Kjo vjen nga mosnjohja e cilësive psikologjike të moshave fëminore.

Por shpesh herë ndeshim në tregime që kanë njohuri shkencore për të cilat lexuesi i vogël s'ka asnjë bazë e kështu nuk mund të perceptohen prej tij. Kështu psh në tregimin «Udhëtimi i fizikantit të vogël» e Niko Dedës një udhëtar nxjerr një guaskë breshke, që kur e afronte tek veshi i dukej sikur përplasej me dallgët e stuhisë. E pastaj tregimi vijon:

«— Ah, xha Shazo! Sa mirë e zbatoni ju fizikën në jetë! — thirri Genci. — Kjo guackë qenka një rezonator i vërtetë natyral!...

Duhet shtuar këtu se ky tregim u drejtohet pionierëve kurse edhe të rinjtë e klasës VIII, në kapitullin e fizikës «Dukuritë akustike», nuk marrin njohuri mbi rezonancën e rezonatorit, mbi lëkundjet, frekuencën e lëkundjeve dhe frekuencën vetiake. Atje dhe përhapja e lëvizjes dridhëse të tingullit shpjegohet thjesht në mënyrë konkrete me tendosjen horizontale të një suste, dëndësimeve e rrallimeve të spirave të saj.

Edhe në tregimin «Ëndrra e Bledit» të po këtij autori ka aq shumë dijeni të reja shkencore, nocione e koncepte, sa që korniza e tregimit është e vogël për t'i shtjelluar në mënyrë të kuptueshme për moshën së cilës i drejtohet.

* * *

Letërsia me temë shkencore për fëmijë merr një rëndësi të veçantë jo vetëm se sot vërehet një përshpejtim psiqik në zhvillimin mendor e moral të fëmijëve, interesa e

<u>përpárëse</u> apron
<u>dorézë</u> glove
<u>le për të dëshirúar</u> leaves something to be desired
<u>çorodít</u> disorient
<u>sýze plakúshe</u> reducing glasses
<u>marifét</u> contrivance; artifice
<u>móshë fëminóre</u> childhood age bracket
<u>perceptój</u> understand; perceive
<u>guáskë</u> shell
<u>stuhí</u> storm
<u>guáckë</u> = <u>guaskë</u>
<u>dukurí</u> property; appearance
<u>lëkúndje</u> oscillation
<u>frekuéncë vetiáke</u> resonant frequency
<u>tendósje</u> tension
<u>sústë</u> spring
<u>dëndësím</u> density
<u>rrallím</u> thinning out
<u>spírë</u> coil
<u>dijení</u> knowledge
<u>përshpejtím</u> acceleration
<u>psiqík</u> psychic

prirje më të avancuara për moshën, por se në vendin tonë po zhvillohet me sukses revolucioni tekniko-shkencor. Dhe dashuria për shkencën e teknikën tek njerëzit tanë duhet edukuar që në moshë të re. Këtij qëllimi i ndihmon edhe kjo lloj letërsie. Tek lexuesi i vogël kjo letërsi shikon nëtorin a kooperativistin e nesërm, që do të vejë [illegible] në shërbim të prodhimit, shikon ndërtuesin e ardhmërisë socializmit.

Astrit Bishgemi "Probleme të tregimit fantastik shkencor per fëmije" Nëntori (Tirane) XXIII, I0 (October) I976, pp.I43-I52

Thoma Kacori, "Shahin Kolonja dhe bashkënxënësi i tij turk" Nëntori (Tiranë) XXI, 8 (August) 1974, pp.77-83

SHAHIN KOLONJA DHE BASHKËNXËNËSI I TIJ TURK

Tregim

nga THOMA KACORI

Rifat beu kishte më tepër se një javë që ndodhej në Sofje. Ai ra në hotelin «Splendit», që ishte hoteli më i mirë i kryeqytetit të ri bullgar, ku vinin më shumë të huajt dhe tregëtarët e mëdhenj të vendit. Por edhe ai nuk qe njeri i vogël, ishte një nga diplomatët më të mirë të Turqisë. E kishte filluar karierën e tij si sekretar legate në Londër, ku kishte kaluar pesë vjet stazh, pastaj e kishin hedhur në Paris, Berlin dhe tani kishte arritur gradën e këshilltarit dhe po vinte të zinte postin e tij të ri në ambasadën turke të Vjenës, pasi të kryente një mision të posaçëm në Sofje. I gjatë, elegant, me sjellje të dalluara, ai binte menjëherë në sy me fjalën e tij të zgjedhur e të shoqëruar gjithnjë me një buzëqeshje të ëmbël.

Që ditën e parë e pyeti portierin nëse e dinte ku mblidheshin shqiptarët dhe i dha pesëdhjetë qindarka bakshish, një shumë mjaft e mirë për atë kohë.

Portieri, megjithëse e ndjeu veten si të detyruar nga

bashkënxënës classmate
ra (bíe) stayed; fell
bullgár Bulgarian
legátë legation
stazh apprenticeship
këshilltár counselor; adviser
ambasádë embassy
sjéllje manners
qindárkë monetary piece ("one-one hundredth")
bakshísh tip

të hollat që mori, iu përgjigj se, e di që në Sofje ka shqiptarë, por se ku mblidhen dhe me se merren nuk di gjë.

Po Rifat beu nuk u dëshpërua nga fjalët e tij, e falenderoi me një buzëqeshje dhe i tha se e pyeti meqë ka një mik shqiptar këtu në Sofje dhe do ta takojë e do ta gjejë, megjithëse nuk ia di adresën, për derisa i di emrin, ka mënyra sesi ta gjejë; dhe doli përjashta.

Të vente të pyeste menjëherë në polici, nuk i erdhi mirë, këtë do ta bënte më në fund, po të mos arrinte ta zbulonte ndryshe mikun e tij. Duke ecur, zuri të shikonte firmat e ndryshme të dyqaneve.

Rifat beu nuk dinte të lexonte bullgarisht, por nga greqishtja, që kishte mësuar në shkollë, mund t'i zgjidhte disa prej tyre. Dhe hem ecte, hem sytë nuk i shkëpuste nga firmat e ndryshme që i dilnin përpara. Por emrat e tyre ishin të gjitha sllave dhe Rifat beu nuk mori mundimin as të hynte, as të pyeste në ndonjë dyqan.

Por siç kalonte kështu, i dolli përpara një firmë me gërma të mëdha e të shkruara bukur. Rifat beu qëndroi në vend si i gozhduar dhe lexoi: «A L B A N I A»!

— Hë, — tha me vete, — kujto qenin e rrëmbe shkopin, është e pamundur që të mos e njohin këtu mikun tim, se ai është arnaut përmbi arnautët, — dhe hyri brenda.

Një burrë i hedhur, me një palë mustaqe të gjata i doli myshteriut përpara dhe e ftoi të zërë vend në një tryezë afër një dritareje, që edhe të shlodhet duke pirë kafenë, edhe të zbavitet duke shikuar përjashta.

— Urdhëroni, zotëri, — i tha, dhe vazhdoi: — Çfarë do të dëshironi?

— Një kafe të mirë, — ia ktheu ai turqisht, duke pandehur se kafexhiu do ta kuptonte.

Por ai ngriti supet, si shënjë, që nuk e mirrte vesh këtë gjuhë.

— Ç'gjuhë dini? — i tha myshteriu pastaj.

— Po di shqip, greqisht, bullgarisht, — ia bëri kafexhiu.

Atëhere Rifat beu e përsëriti greqisht porosinë e tij. Desh t'i thoshte dhe diçka tjetër kafexhiut, por ai u kthye menjëherë prapa dhe s'pati kohë.

Kafeneja ishte pothuajse e zbrazët, sepse nuk ishte as mëngjes, as drekë. Vetëm dy veta po loznin letra mënjanë, por edhe ata nuk ndiheshin shumë, qenë mjaft larg myshteriut të ri.

Rifat beu zuri të shikojë rreth e rrotull, i bëri përshtypje pastërtia dhe rregulli brenda, pastaj sytë i ranë në një tablo të madhe, të varur në mur, pikërisht karshi

<u>për derisá</u> as long as
<u>të vénte</u> = <u>të vínte</u>
<u>fírmë</u> sign
<u>hem écte, hem sýtë nuk i shkëpúste nga</u> as he walked, he couldn't take his eyes off
<u>sllav</u> Slavic
<u>i gozhdúar</u> nailed
<u>arnaút</u> Turkish for Albanian
<u>búrrë i hédhur</u> well-built man
<u>myshterí</u> client
<u>tryézë</u> table
<u>kafexhí</u> proprietor of, or waiter in a coffee house
<u>mëngjés</u> breakfast
<u>drékë</u> lunch
<u>lóznin</u> = <u>lúanin</u>
<u>tabló</u> picture

hyrjes, që ta shikoje menjëherë. Ishte një luftëtar hipur në një kalë të bardhë, me shpatë në dorë. I bënë përshtypje sytë e tij të zjarrtë, mjekra e gjatë dhe sidomos përkrenarja, që mbante në kokë, me dy brirë dhie përpjetë.

Pas pak, erdhi kafexhiu me kafenë, që avullonte akoma, në tabaka të bakërtë e që ia lëshoi përpara myshteriut bashkë me një gotë ujë të ftohtë duke thënë:

— Urdhëroni, zotëri! — dhe bëri të kthehet.

Po Rifat beu e ndaloi:

— Më falni, — i tha, — po ky portret i bukur, mos është i ndonjë shënjtori? Se kam dëgjuar që ju të krishterët e nderoni shumë shën Gjergjin dhe e vizatoni me shpatë në dorë!

— Dhe ky Gjergj e ka emrin, iu përgjegj kafexhiu, me një buzëqeshje të ëmbël, por nuk është shënjtor, është Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, që ka lëftuar njëzet e pesë vjet kundër turqve dhe nuk e mundën dot.

— Hë, hë! Ia kam dëgjuar emrin! — tha duke u kollitur Rifat beu dhe nuk e pyeti më tepër kafexhinë.

Si piu kafenë, Rifat beu i ra tryezës me dorë dhe kafexhiu rendi për nga myshteriu i tij.

— Sa të bën? — e pyeti Rifat beu.

— Dhjetë qindarka, zotëri! — iu përgjegj kafexhiu.

Rifat beu i hodhi në tabaka pesëdhjet qindarka dhe e pyeti përsëri:

— Me që kjo kafene mban emrin e Shqiperisë, a e njihni ju një Shahin, Shahin Kolonja?

— Po si jo, nuk ka shqiptar këtu që të mos e njohë Shahinin. Ai nxjerr edhe gazetën. «Drita» e ka emrin, në qoftë se e kini dëgjuar.

— Po a vjen ai këtu? — e pyeti prapë Rifat beu.

— Vjen, por nuk dihet kur vjen, vjen kur ka ndonjë punë, apo kur takohet me ndokend. Po ju, ku e njihni zotëri Shahinin? — e pyeti nga ana e tij kafexhiu.

— E kam mik, kemi qenë bashkënxënës me të në Stamboll, — tha ai dhe vazhdoi: — Po si mund ta gjej? A e dini ju ku banon?

Kafexhiut nuk i bënë përshtypje të mirë fjalët e këtij turku, që i dha një bakshish kaq të majmë dhe zuri ta brente një farë dyshimi përbrenda.

— E njoh, por nuk e di se ku banon, zotëri! — u përgjigj kafexhiu, megjithëse e dinte fare mirë se ku rronte Shahini, se në dhomën e tij mblidheshin shpesh dhe bisedonin për çështje patriotike.

— Por do ta dish se ku ha drekë e darkë atëhere? — e pyeti përsëri Rifat beu.

ERIC

përkrenáre	helmet
brírë dhíe	goat horns
avullój	steam
tabákë	tray
i bakërtë	of copper
i krishtér	Christian
lëftúar = luftúa	
po si jo	but of course
ndokénd	someone
brej	gnaw
dárkë	dinner

— Edhe këtë nuk e di! — ia bëri kafexhiu.

— Ju e dini që nxjerr gazetën, e njihni mirë dhe nuk dini asgjë tjetër për të! Si është e mundur? — ia ktheu atëhere si i zemëruar Rifat beu.

— E di që nxjerr gazetën, se ne këtu e shpërndajmë, zotëri. Dhe po të dëshironi, mund t'ju japim një copë dhe juve! — iu përgjigj kafexhiu.

— Jo, nuk ka përse, por tërë këto jua thashë për t'ju treguar që e njoh dhe që e kam mik dhe jo për gjë tjetër. Por unë do ta gjej dhe pa ndihmën tuaj!

— Më falni! — ia bëri kafexhiu dhe e la Rifat beun, se në atë çast i thërritën ata që po loznin letra.

— Xha Dhami, dy kafe me pak!

Rifat beu u ngrit nga vendi si me zor dhe dolli nga kafeneja e shqiptarëve, hem i kënaqur, hem i dëshpëruar. I kënaqur se e kishte gjetur çerdhen e mikut të tij, i dëshpëruar se gjurmët nuk ia kishte zbuluar ende.

Disa ditë me radhë, Rifat beu bënte ç'bënte dhe kalonte nga kafene «Albania», se mos e takonte Shahinin rastësisht, por më kot.

Një ditë, portieri i hotelit i dolli përpara myshteriut të rëndë dhe i tha:

— Zotëri, shqiptarët mblidhen që te gjithe tek kafenea e tyre «Albania», kurse për të ngrënë hanë prapë në një restorant shqiptar, që e ka emrin «Avlona»[1]) dhe që ndodhet në rrugën «Maria Luiza», afër urës së luanëve.

Rifat beu buzëqeshi. Këtë radhë nxori nga xhepi një levë të tërë dhe ia dha portierit duke i thënë:

— Faleminderit shumë, se më keni bërë me të vërtet një shërbim të madh.

Portieri e mori levën dhe u përul gjer në dhe.

Disa ditë me radhë Rifat beu kalonte o nga kafenea «Albania», o nga «Avlona», por mikun e tij nuk e rastiste. Një drekëherë ai zuri vend si gjithnjë karshi restorantit shqiptar dhe po shikonte me vërejtje ata që hynin dhe dilnin atje. Punëtorë të thjeshtë, fshatarë, zanatçinj, por më tepër muratorë, të cilët njiheshin menjëherë nga rrobat e tyre të llangosura me baltë e me gëlqere. Dhe i dukej si çudi, që Shahini, i cili kishte arritur një pozitë aq të lartë, sa të bëhej prefekt i disa qyteteve dhe më në fund i qytetit të Vlorës, të mos pranonte të shkonte atje, por të ushqehej në këtë birucë, me këta njerëz të pagdhendur e të ndyrë.

Dhe duke menduar kështu, i doli përpara vetë Sha-

1) Vlora.

nuk ka përsé no reason for that
kafé me pak lightly sweetened coffee
hem...hem... both...and...
çérdhe den; nest
úrë bridge
lévë monetary unit of Bulgaria
përúlem bow
rastís happen upon; meet by chance
drekëhérë noontime
zanatçì tradesman; craftsman
muratór mason
i llangósur smeared; spattered
gëlqére lime
prefékt mayor
birúcë hole-in-the-wall
i pagdhéndur rough; unhewn

hini, pa kapellë në kokë, me flokët e qethura shkurt, duke nxituar, pa shikuar as majtas as djathtas, por me kokën ulur dhe i menduar, sikur po zgjidhte atë çast ndonjë çështje me rëndësi.

Ishte veshur me një kostum blu të fërkuar, bile anët e mëngëve kishin filluar t'i grisen. Edhe këpucët nuk i kishte të llustruara, siç i mbante njëherë e një kohë.

Rifat beut i erdhi me të vërtet keq, që po e shikonte shokun e tij në këtë gjendje, se e dinte që Shahinit i pëlqenin gjërat e mira dhe i viate ndore për t'i zgjedhur.

I doli përpara dhe i zuri rrugën.

Shahini, që ecte kokëulur, u përpoq me të. Ngriti kryet dhe në vend që ta qërtonte njeriun, që i kishte zënë rrugën thirri:

— Rifat! Ti, këtu?

— Po shkoj për në Vienë. Sot mbeta këtu dhe dola nëpër qytet dhe ja, allahu deshi e na bashkoi, — ia ktheu Rifat beu.

Të dy miqtë e vjetër hynë pastaj në «Avlona». Tryezat ishin plot me njerëz dhe nga të gjitha anët dëgjoheshin:

— Mirëdita, zoti Shahin! Si vete, zoti Shahin? Kur do të dalë «Drita», zoti Shahin?

Dhe Shahini, me një buzëqeshje të ëmbël, përgjigjej më të mëngjër e më të djathtë.

Rifat beu ecte prapa bashkënxënësit të tij, i heshtur, por i menduar, dukej që kishte diçka me rëndësi për t'i thënë shokut të vet.

Ata zunë vend në një tryezë, që ishte e zbrazët dhe menjëherë filluan nga muhabeti:

— Sa kam dashur të të takoj njëherë, — tha Rifat beu, — se ditët që kemi kaluar bashkë, si në shkollën qytetse ashtu edhe në shkollën e lartë, s'i harroj kurrë. Vallahi, bukur kemi kaluar!

— Vërtet të paharruara janë ato ditë! — u përgjigj edhe Shahini dhe vazhdoi: — Por thuaj tani, ç'do të marrësh? — Se kamarieri kishte ardhur pranë tryezës së tyre dhe po priste porosinë në këmbë.

— Muhabeti ynë është më i ëmbël se çdo gjë tjetër, por të të them të drejtën, porosit ti gjëkafshë, se unë nuk i njoh gjellët e këtueshme.

— Mirë, — u përgjigj Shahini dhe i tha kamarierit: — Do të sjellësh dy turligjyveç dhe një çikë verë nga ajo e Filibesë!

Restoranti mbante më snume erë uthull dhe djerse. Po erërat e gjellëve përzjeheshin me to dhe sikur e ndreq-

kostúm suit
i fërkúar worn thin
i grísur worn out; shabby; ragged
i vínte ndóre had a knack
i zúri rrúgën cut him off
alláh Allah; God
shkóllë qytétse middle school
i paharrúar unforgetable
kamariér waiter
i këtúeshëm local; of this place
turligjyvéç Turkish meat and vegetable casserole
çíkë bit
úthull vinegar

nin pak atë shijen e áthtë, me atë avullin e tyre të ëmbël, që dilte nga tenxheret e bakërta, të radhitura njëra pas tjetrës përmbi zjarr dhe që shkëlqenin si të florinjta që tutje.

Muhabeti ngeci për një hop. As njëri as tjetri nuk dinte sesi të fillonte. Shahini rrinte i menduar, kurse Rifat beu përpiqej të zbulonte mendimet e shokut të tij.

Më në fund, Rifati tha:

— Shahin, ç'bëre? A u martove?

Shahinin e tronditi shumë kjo pyetje e papritur dhe u përgjigj:

— Jo, akoma s'jam martuar! Po ti, ç'bëre?

— O, unë kam pesë vjet që jam martuar dhe kam dy fëmijë, një djalë e një vajzë!

— Të të rrojnë! — i tha Shahini.

— Po ti, si mbete kështu, pse nuk martohesh? — e zuri prapë fjalën Rifat beu.

Shahini psherëtiti.

— Hapja zemrën shokut tënd të vjetër. Keshtu mund të të lehtësohet pak dhëmbja, pse psherëtin? — ia bëri Rifati.

— Çfarëdo që të bëj, shpirti im nuk do të lehtësohet! — u përgjigj Shahini.

— Sidoqoftë, thuamë, si e ke hallin? — e pyeti përsëri shoku i tij.

Shahini tundi kokën dhe vazhdoi:

— Kam rënë në sevda, o Rifat, në një vajzë shqiptare të krishtere dhe jam i sigurt që nuk do të ma japin, prandaj po rri i pamartuar!

Rifat beu sikur tamam këtë po priste, i tha menjëherë:

— Prandaj bëhesh merak ti?! Do të të gjejmë menjëherë një turkeshë të bukur e do të të martojmë. Leri këta kaurët!

— S'e kanë fajin ata, — u përgjigj Shahini, — se ne jemi një. Kjo gjë vjen nga padija, se edhe unë, megjithqë jam muhamedan, nuk jam turk, por shqiptar si edhe ata vetë, se para se të kemi qenë të krishterë apo muhamedanë, ne kemi qënë shqiptarë.

Rifat beu mblodhi buzët dhe nuk u përgjigj. Atë çast mbërriti kamarieri me gjellët dhe muhabeti u ndërpre.

Shahini filloi të hajë menjëherë me shije të madhe, kurse Rifat beu po e shikonte gjellën si me nakar dhe e kishte më dysh: të fillonte a të mos fillonte.

— Po si e kalon këtej? — e pyeti pas pak Rifati.

i áthtë, tarty
tenxhére pot
i florínjtë golden; gold
të të rrójnë may they live long
sevdá love; desire
kaúr derogatory term for Christian Albanians
megjíthqë although
mbërrít arrive
si me nakár begrudgingly
si e kalón këtéj how are you doing here

— Të lëvdohem, o Rifat, s'të lëvdohem dot; nga gjendja nuk jam mirë! — u përgjigj Shahini.

— E po shokë kemi qenë e shokë jemi, — tha Rifati, — po të kesh nevojë, thuaj sa para të duhen? — dhe futi dorën në xhep.

Shahini e ndali duke i thënë:

— Falemnderit, Rifat, por nuk kam nevojë për para. Unë me të vërtet s'kam të holla, por patriotët e mi shqiptarë, ja këta muratorët, nuk më lenë të urët, këta ma paguajnë edhe restorantin edhe shtëpinë ku fle!

Atëhere Rifati mori një pamje serioze dhe tha rëndë-rëndë:

— Shiko Shahin, vëndi yt nuk është këtu, midis këtyre njerëzve dhe midis kësaj ere që të zë frymën. Unë të thashë në fillim se të takova rastësisht, por tani ja ku po të them të vërtetën. Mua më ka dërguar këtu vetë sulltan Hamiti, i cili t'i fal të gjitha dhe të emëron këtë radhë prefekt në Edrene, në qoftë se e ke ndjerë veten të fyer herën e fundit meqë të dërguan larg, në Vlorë.

Shahinit i ra një çehre e kuqe nga këto fjalë. Shtrëngoi nofullat dhe u përgjigj me inat:

— Ti gjithnjë ke qenë dinak, o Rifat dhe vazhdon të jesh i tillë! A e mban mend, se edhe për gjënë më të vogël, ti doje të kishe ndonjë shpërblim që ta bëje? Por qëllimi im nuk është as për pasuri, as për pozitë, por është për ideal. Dhe ideali im është çlirimi i Shqipërisë nga zgjedha turke. Dhe i thuaj sulltanit, që derisa Shqipëria nuk do të jetë e lirë, Shahin Kolonja nuk blihet as me para, as me ofiqe!

Dhe heshti.

Rifat beu e ndjeu veten të fyer dhe të vetëm midis këtyre njerëzve të huaj. U ngrit nga tryeza dhe i tha Shahinit:

— Unë bëra timen, të dola nga borxhi, si bashkënxënës që të kam! — dhe pa i lënë shëndet, u largua.

Shahini e ngriti kupën me verë që kishte përpara dhe e zbrazi gjer në fund. Pastaj tha:

— Qenkam në rrugë të drejtë! Derisa dhe sulltani e ka marrë vesh dhe kërkon të më kthejë nga kjo rrugë, qenkam me të vërtet në rrugë të drejtë.

Dhe vazhdoi të hajë bukë, sikur nuk kishte ngjarë asgjë me ikjen e bashkënxënësit të tij.

i úrët = i urtúar hungry
pagúaj pay
rëndë-rëndë gravely
i fýer offended
i ra një çehré e kúqe became red faced; flushed
shpërblím reward
bëra tímen I did my duty
të dóla nga bórxhi I payed my debt to you.
íkje departure

vjéshtë autumn
u çduk = u zhduk
shkojti = shkói
térret = érret darkens
hápen rétë the clouds become dense
ndrroj change
çvíshen = zhvíshen become bare

VJESHTA

U çduk vapa, shkojti vera,
Dhe bilbili më s'këndon,
Ardhi vjeshta me të tjera
Syri ynë që i shikon.

Terret koha, hapen retë,
Ngjyrë plumbi përsëri;
Duket prapë tjetër jetë
Që natyra ndrron tashti.

Era fryn dhe fletët bijen,
Pemët çvishen si nga mot,
Mali, fusha më s'kanë hijen,
Që e kishin gjer më sot.

Qiell i bukur, që dëfrente
Trupin tonë, sot u terr;
Më s'ka ngjyrën, që shkëlqente
Si pasqyrë, si mermer.

Bukuritë janë çdukur,
Shiu e bryma zuri vënd,
Bari, lulet, kopësht' i bukur
U ndryshuan më çdo kënd.

Dhe liqeni i kulluar,
Që ndriçonte me shkëlqim,
E ka faqen të trazuar,
Dridhet, tundet pa pushim.

Veç ngaherë me ëmbëlsirë
Dielli rrezet na i dërgon,
Natën hëna me një hirë
N'ergjënd malet i ngjyron.

Por e mirë është vjeshta,
Sepse bujku gjith' punon;
Për të vjelur sot ka vreshta,
Nesër arat po lëron.

brýmë frost
vënd = vend
kopësht = kopsht
kënd corner, nook
i trazúar agitated
hir grace
ergjénd = argjénd silver
ngjyrój paint
vréshtë vineyard
çdo = çdo gjë

Njerëzia nga çdo anë,
Po sa ngrihen në mëngjez,
Nëpër fushë cdo që kanë,
Rendin mbledhin me kujdes.

Pra me punë gjith' të rrojmë,
Se veç puna ne na vlen,
Sepse ndryshe s'trashëgojmë
Verën tjetër që po vjen.

ASDREN

Asdren, "Vjeshta" Abetare Tiranë
1958, pp.100-101

i murósur walled up
varg verse
mbrámë = mbrëmë twilight; evening

Afërdita Skënderi, "Të jesh edhe dumë"
Nëntori (Tiranë), XXI, 8 (August) 1974
p.II5, "Toka", Ibid, p.II5

Poet nga Kosova

TË JESH EDHE LUMË

Të jesh grua,
nuk do të thotë
të jesh e murosur
si në urë.

Të jesh grua,
do të thotë
të jesh edhe lumë.

TOKA

Është bukë,
është dashuri.
Toka. Toka. Toka.
Është dritë,
është jetë.
Toka, vargu im i parë,
vargu im i mbramë.

LEXIMI I SHTATEDHJETETETE

"Ni klimën e maleve të Pogradecit" in Temo Mandili, Nga Butrinti në majën e Korabit, Tiranë, 1968, pp.5-22

NË KLIMËN E MALEVE TË POGRADECIT

Katedra e meteorologjisë së Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë, në muajin korrik të vitit 1964, organizoi ekspeditën e parë shkencore në malet e Pogradecit. Kjo ekspeditë kishte për qëllim që të kryheshin vrojtime rreth ndryshimit të intensitetit të rrezatimit diellor në mvartësi nga lartësia si dhe për të studjuar ndikimin që mund të ushtrojnë rrezet e diellit dhe faktorët e tjerë meteorologjikë mbi sëmundjen e dermatit solar që ishte shfaqur, prej disa vjetësh, mbi tufat e dhenve që verojnë në kullotat e Malit të Thatë.

Ekspedita e përbërë nga laborantja e meteorologjisë Afrodhiti Kllapi, mjekut veterinar Ferit Puka dhe unë, u nis prej Tirane më 6 korrik.

Për kryerjen e detyrave tona morëm me vete një kompiet të tërë aparatesh fizike si radiometra, piranometra, psihrometra e termometra.

Sa herë që të udhëtohet nga Tirana për në Korçë, gjithçka ruhet si diçka e këndshme e e tërheqëse për udhëtarin. Kjo ndjenjë kënaqësie ndihet jo vetëm nga natyra e bukur e këtyre zonave piktoreske, dhe klima e tyre verore e freskët, por edhe nga vendi i veçantë që zë krahina e Korçës në pasurinë e botës shpirtërore e kulturale të popullit tonë.

Pogradéc region in southeast Albania
kryéj carry out
vrojtím observation; survey
rrezatím radiation
diellór solar
mvartësí = varësí dependence
ushtrój exert; exercise
dermát solár skin desease related to sun exposure; solar dermatitis
verój spend the summer
laboránt lab worker
prianométër pyrometer; heat measuring instrument
psihrométër psychrometer; water vapor measuring instrument

Duke kaluar nëpër bregoret jugëlindore të Tiranës, makina na nxori në lartësinë e Kërrabës, 950 m. mbi nivelin e detit, prej nga pamja shtrihet mbi sipërfaqen e valëzuar të relievit të ulët të Prezës, i cili duket sikur formon një kornizë të skalitur rreth pasqyrës së kaltërt të ujrave të Adriatikut. Përtej, në drejtimin e lëvizjes së makinës, dallohet i fshehur në një ishull gjelbërimesh, qyteti i Elbasanit, mbi atmosferën e të cilit gjarpërojnë shtëllungat e tymit të fabrikave të reja.Në çdo udhëtim nëpër vendin tonë, njeriu kur kalon në ndonjë qytet apo qendër të banuar ndien dëshirën që të ndalet për të shikuar se shfarë ndryshime kanë ndodhur në të, gjatë periudhës që s'e ka parë, por shoferit tonë, koha e kufizuar nuk i lejoi një ndalesë të tillë, prandaj pa humbur as edhe një minutë, kaloi nëpër rrugën qendrore të Elbasanit me shpejtësi pak të ulur të cilën e rriti përsëri në luginën e ngushtë të Shkumbinit. Që nga Elbasani deri në Pishkash të gjithë qëndruam në heshtje; kjo është pjesa më monotone e rrugës për në Korçë. Por në fushën e Domosdovës udhëtari sikur zgjohet, me forca të përtëritura, nga ambienti i bukur i kësaj pllaje të gjelbërt, i rrethuar nga të gjithë anët me një varg kodrinash, në brendësinë e të cilave natyra mbajti të fshehura për shumë shekuj gurët e mineralit të çmueshëm. Historia tregon se të parët tanë në këtë rrafshinë janë përleshur me hordhitë turke për të mbrojtur këtë tokë aq të shtrenjtë për ne, mbi të cilën sot ushton triumfues zëri i jetës, i punës dhe i së ardhmes. Duke u ngjitur në të përrietën e Qafës së Thanës me ritëm të ngadalësuar, patëm mundësi që mendimet tona

prej nga from which
i skalítur chiseled
shtëllúngë puff
shfárë = çfárë
i përtërítur renewed
pllájë slope; plateau
kodrínë small hill; knoll
të párët tánë our ancestors
përléshem clash
hordhí horde

t'i kthenim në të kaluarën e largët, t'i ndalnim në të sotmen e lavdishme e të shikonim të ardhmen e ndritur. Mbi këto parafytyrime mbisundonin pamja e qytetit të ri të minatorëve dhe siluetat e punëtorëve të palodhshëm që me krahët e tyre të fuqishëm krijojnë jetën në thellësi të nëntokës.

Në kuotën 1100 metra mbi nivelin e detit dualëm në ora 12⁰⁰. Nga kjo kuotë para shikimit të udhëtarit shtrihet një tablo që me bukuritë e veçoritë e saj e gjallëron dhe e përtërit.

Ngjyra e kaltërt në blu gjithmonë është çlodhëse për syrin e njeriut, por kur kjo ngjyrë hapet si sfond për koloritet e tjera të relievit tokësor, atëhere kjo e rrëmben atë më me forcë dhe e përqëndron në reflekset e këndshme të saj. Me të tilla kolorite të lehta, që shkrihen në mënyrë të padijshme njëra me tjetrën, del përpara liqeni i kulluar i Ohrit, në konturet e të cilit spikatin me ngjyra më të forta fshati i Linit dhe më përtej qyteti i bukur i Pogradecit. Gjithë kësaj bukurie i jep një timbër akoma më të ëmbël, klima e shëndetshme e këtyre anëve, e cila ndryshon në mënyrë të theksuar nga ajo e vendeve të ulta të Shqipërisë.

Si Pogradeci ashtu dhe rrafshina e Korçës ndodhet pothuajse në të njëjtën lartësi në nivelin 800 m. mbi sipërfaqen e detit. Karakteristikat klimatike të kësaj zone përcaktohen në radhë të parë nga vargmalet që e rrethojnë, nga relievi i saj i lartë dhe nga largësia e saj prej detit. Si në Korçë ashtu edhe në Pogradec temperatura mesatare shumëvjeçare e muajit korrik luhat rreth vlerës 21°C. ndërsa, në Tiranë e Durrës, tempe-

e kalúar past
e sótme present
mbisundój rule
minatór miner
siluét silhouette
i palódhshëm tireless
kuótë elevation
dúalëm = dólëm
shikím view
veçorí quality; characteristic
blu dark blue
kolorít hue; tone
reliév terrain; relief
tímbër timbre; tone
vargmál mountain range
luhás waver; sway

ratura e të njëjtit muaj, mbërrin rreth 25°C. Muaji më i ftohtë, janari, në Korçë, ka temperaturën mesatare rreth 1°C., kurse në Tiranë rreth 7°C. e në Sarandë rreth 10°C. Ndërsa në bregdetin e Jonit, në këto 20 vjetët e fundit temperatura minimale absolute nuk ka kaluar nën minus 5°C, në krahinën e Korçës, në Voskopojë, ka zbritur edhe në minus 25°C.

Një veçori tjetër karakteristike e klimës së Korçës janë dhe reshjet, të cilat gjatë dimrit, pjesërisht bien edhe në formë bore. Mesatarisht gjatë vitit në këto krahina bien rreth 680 mm. reshje, nga të cilat 213 mm. në dimër, 159 mm. në pranverë, 103 mm. në verë dhe 248 mm. në vjeshtë. Kurse në Vlorë p. sh. shuma mesatare vjetore e reshjeve i kalon të 1000 mm, por grafiku i tyre, aspak i përpjestuar, ka një maksimum prej 419 mm në dimër e pastaj zbret në 182 mm. në pranverë, në 62 mm. në verë, dhe përsëri ngjitet në një maksimum tjetër të dytë prej 365 mm. në stinën e vjeshtës. Në të tilla kushte klima e rrafshnaltës së Korçës dhe e relievit të saj kodrinor e malor paraqitet më e favorshme për kultivimin e grurit, të elbit, të thekrit dhe në terrenet me ujë edhe për misrin.

Duke shijuar ambjentin çlodhës të kësaj klime ne po i afroheshim qytetit të Korçës i cili ish mbuluar me një vel të bardhë kristaline, ku nga oxhaqet dilte lart në vijë të drejtë kolona e tymit të bardhë, gjë që tregonte se të nesërmen moti i kthjellët me karakter anticiklonik, do të vazhdonte. Mjaft rëndësi kishin për ekspeditën tonë kushtet meteorologjike të javës së ardhshme,

réshje = rréshje precipitation
mesatarísht on the average
shúmë sum; total
i përpjestúar distributed proportionately
stínë season
rrafshnáltë plateau; mesa
elb barely
thékër rye
mísër corn
vel veil

gjatë së cilës ne do të endeshim në rellevin e Malit të Thatë.

Nëpër një rrugë me kthesa e me gropa, gazi, në mëngjezin e 8 korrikut, na shpuri në fshatin Koritë që shtrihet në rrëzën e Malit të Thatë, ku pa humbur kohë filluam nga vrojtimet e riferimentit. Barometri aneroid shënonte presionin atmosferik prej 687 mm dhe kalkulimet përkatëse na treguan se ndodheshim në lartësinë 820 metro mbi nivelin e detit. Freskia e këndshme e klimës malore të rrafshinës së lartë të Korçës ndihej si në hije ashtu dhe në diell. Termometri në orën 10⁰⁰ jepte temperaturën 21°C, ndërsa po në këtë moment, në Tiranë, zhiva ngjitet në ndarjen 28°C. Era e lehtë lokale, puhia flladitëse e malit që fryn rregullisht në mëngjezet verore të këtyre anëve na dha sinjalin e parë të motit të mirë, që do të kishim gjatë kësaj dite.

Në orën 10 e 30', lart në pjerrësinë e malit, dallohen mushkat e Ndërmarrjes shtetrore blegtorale të Vurkut, të cilat do të na çonin arkat me instrumenta në kuotat e vrojtimeve. Ndërmjet nesh lindin ndjenja pasigurie të shoqëruara me një farë shqetësimi të natyrshëm. Do të mundemi vallë të transportojmë, në gjendje të rregullt, aparatet matëse shumë delikate në këto rrugica malore të thepisura? Rrëzimi i ndonjë mushke ose shkarja e ndonjë arke do të thoshte shkatërrimi komplet i veglave jashtëzakonisht të kushtueshme, do të thoshte falimentimi i ekspeditës! Frika dhe shqetësimi që na pushtoi të gjithëve, sikur u zhduk kur pamë mjeshtërinë e rrallë dhe sigurinë, me të cilën ngarkonte arkat në samarin e mushkave bariu i shkathët, i papërtuari Pilo, të cilin me

grópë depression; hollow; hole
gaz car
përkátës relevant
zhívë mercury
ndárje dividing line; separation
puhía flladítëse the soft breeze
pjerrësí slope
múshkë mule
blegtorál pertaining to livestock; pastoral
árkë case
i shoqërúar accompanied
mátës measuring
i thepísur steep
rrëzím falling
shkárje slip
do të thóshte would have meant
falimentím failure
samár saddle
i papërtúar industrious

plotë të drejtë shokët e tij e quanin sokol mali.

Kafshët e ngarkura muarën të përpjetën dhe pas tyre shkonin mushkat e kalorësisë.

Në ora 13⁰⁰ u ngjitëm në bazën e ndërmarrjes ku banorët e fshatit të vogël blegtoral na pritën me përzemërsi e ngrohtësi të madhe.Këtu takuam edhe dy të rinj të njohur, kryezooteknikun dhe mjekun veterinar, ish-studentë të Fakultetit të zooteknisë e veterinarisë, të cilët me punën e palodhur dhe thjeshtësinë e tyre kishin fituar besimin e dashurinë e të gjithë shokëve të punës. Nga këta specialistë të rinj, që dikur i kishim parë të ndrojtur para biletave të provimeve,ne mund të mësonim shumë gjëra. Tashmë ata nuk paraqitëshin më me atë fizionominë e çliruar nga çdo preokupacion, që karakterizon moshën e studentit, por në fytyrat e tyre të kaluara, dalloheshin qartë gjurmat e pjekurisë, të guximit dhe prakticitetit.

Mbas kalimit e njohjes me ambientin e ri çelëm arkat dhe verifikuam aparatet: Çdo gjë u gjet në rregull dhe kjo na kënaqi pa masë si ne, ashtu dhe udhëheqësin e karvanit.

Lexuam përsëri barometrin. Gjilpëra e tij shënonte presionin atmosferik 648 mm.; ndodheshim pra në lartësinë 1340 metra.

Dielli po ulej drejt perëndimit, në anën e vargmaleve të Lenies. Në lindje, mbi kryet tonë, ngrihej madhështore maja e lartë e Zonjës, e cila me krenarin e saj të heshtur na dukej sikur na ftonte në botën e saj të qetë, në pragun më të afërm të thellësive blu të oqeanit atmosferik.

Të nesërmen u zgjuam në ora 4. Termometri tregonte temperarturën 8 gradë Celsius. Ngarkuam përsëri aparatet dhe karvani u nis për në kullotat

sokól brave man

múarën (=mórën) të përpjétën went up the incline

muśhkë e kalorësísë mules used for riding

kryezootekník chief zoological technician

i ndrójtur = i ndrúajtur reserved; hesitant

pára bilétave të provímeve at exams times

fizionomí e çlirúar carefree look

pjekurí maturity

verifikój check; verify

karván caravan

gjilpërë needle

e «Sheshit të Qenve», ku gjatë këtij viti ishte shfaqur me forcë më të madhe dermatiti solar. Në këtë rrugë na shoqëronte përgjegjësi i ndërmarrjes, një burrë i matur me eksperiencë të gjërë në sektorin e blegtorisë, i cili na dha mjaft të dhëna të vlefshme mbi kushtet e shfaqjes së sëmundjes.

Ecëm dy orë dhe përpara nesh u shtrinë pllajat e dallgëzuara të Malit të Thatë, në të cilat kullosnin mbi 20.000 krerë dhen. Shtypja atmosferike arrijti në 614 mm. Gjendeshim në lartësinë 1670 m. Laborantja instaloi aparatet, në fillim radiometrat, pastaj hygografin e psihometrin, vendosi termometrat dhe ja, pas disa minutash, para syve tona, në gjirin e këtyre fushave malore, ndoshta për herë të parë në jetën e tyre të gjatë, u ngrit një stacion i vogël aktinometrik, i pajisur me aparate e instrumente të sakta.

Shoqëruesi, vërente me habi e kureshtje veglat e nikeluara, që përdoreshin me aq kujdes nga duart e shpejta të një vajze që, në kushtet e regjimit të Zogut e të bejlerëve, do ta shkonte jetën e saj të mbyllur në muret e shtëpisë së zymtë të ndonjë qyteti të vogël.

Ai duke u munduar të zbulonte sekretet e funksionimit të këtyre aparateve, foli me ndrojtje: «Kurrë nuk e merrja me mend se edhe këtu ndërmjet nesh do të na vinin maqina të tilla».

Filluam vrojtimet e rregullta me interval për çdo orë. Në këto lartësi rrezet e diellit përvëlonin me forcë fytyrat tona, ndërsa në hijen e kasolles së përkohshme, nuk mund të qëndroje pa pallton e dimrit. Termometri në vendet ku zinte dielli, në orën 8 të mëngjezit, tregonte 36°C, ndërsa në hije 14°C. Puna vazhdonte plot gjallëri e kureshtje. Por nga thellësitë e verilindjes filluan të duken re të bardha shtëllungore, të cilat me shpejtësi lëviznin

<u>përgjégjës</u> boss; director
<u>i mátur</u> prudent
<u>i dallgëzúar</u> rising and falling
<u>hygográph</u> = <u>hygrográph (mp.)</u> apparatus for recording humidity
<u>aktionometrík</u> pertaining to measuring the heating power of the sun's rays

drejt diskut të diellit. Këto re, të cilat këtu zhvillohen pothuajse vazhdimisht gjatë verës nga kondensimi i avujve të ujit të liqeneve të Ohrit e të Presvës që lagin nga të dy anët masivin e gjatë të Malit të Thatë, krijojnë kondita të veçanta meteorologjike, me një alternacion të shpeshtë të rrezatimit diellor e të temperaturës së ambientit që ndikojnë në mënyrë negative në zhvillimin e dermatit solar prej të cilit goditen dhentë e këtyre kullotave.

Në kuotën 1670 metra në të cilën shtrihen pothuajse gjithë rrafshinat e kullotave blegtorale, vrojtimet vazhduan 6 ditë.

Tani na mbetej për t'u ngjitur në kuotën më të lartë, në majën e Alarupit. U pa e arësyeshme që atje të shkonte vetëm një nga pjesëtarët e ekspeditës dhe kryerja e kësaj detyre më takonte mua.

I shoqëruar, prej një njohtësi të praktikuar të këtyre anëve, me dy mushka; u nisëm nga baza e ndërmarrjes në orën 3 të mëngjezit, atëherë kur mbi majën e Zonjës porsa kishte lindur ylli i mëngjezit dhe, në ora 9, arritëm në tendat e brigadës së parë. Prej këtej maja e Alarupit nuk ndodhej larg. Suksesi i gjithë kësaj rruge mvarej nga kushtet e motit, shenjat lokale të të cilit nuk ishin aspak qetësuese. Era frynte me hope nga drejtime të ndryshme dhe mjegulla lëvizte si e tërbuar drejt kreshtës së thepisur. Megjithatë muarëm të përpjetën e thikët. Mushkat ecnin ngadalë pasi u duhej që të zgjidhnin vetë shtigjet e kalimit. Më në fund, në ora 11 e 38' dolëm, pa asnjë aksident, në majën aq të lakmuar. Pa shgarkuar mirë vërej aneroidin. Presioni atmosferik 590mm. Asnjëherë në jetën time nuk më kishte takuar të thithja ajrin e ralluar, në një presion të tillë kaq të ulët. Më dukej sikur nuk ngopesha me ajër dhe ndieja një marrje mendësh të lehtë. Por kush-

shoqërúes guide
i nikelúar nickel-plated
i zýmtë bleak; dreary
me intervál për çdo órë at one hour intervals
i përkóhshëm temporary
shtëllungór puffy; lumpy
masív massif; principal mountain mass
më takónte múa fell on me
mvárej = várej depended on
qetësúes quieting
me hópe intermittently
kréshtë crest
i lakmúar desired
shgarkój = shkarkój unload
nuk më kíshte takúar never had I the occasion
thith breathe; suck
márrje méndësh dizziness
llogarí calculate

let metereologjike nuk më lejonin t'u kushtoja vëmendje këtyre sensasioneve fiziologjike. Llogaris me shpejtësi lartësinë. Ndodheshim në kuotën maksimale prej 2200 metra. Në këto lartësi, uji valon në 93° C dhe, sado që të vazhdohet të nxehet, nuk mund të kapërcejë në asnjë mënyrë këtë temperaturë; për këtë arësye me të drejtë barinjtë thonë se, në këto lartësi, mishi dhe qumështi nuk ziejnë mirë.

Retë dalë nga dalë fillojnë të zhduken dhe para nesh u hap një pamje me të vërtetë magjepse. Nga njëra anë duket liqeni i Ohrit me Pogradecin e bukur, të mbuluar nga një velë të hollë pluhuri që zakonisht në ditët e verës mbështjell objektet e largëta. Nga ana tjetër shtrihej liqeni mahnitës i Prespës dhe, tej në thellësi, pika ku priten të ve linjat kufitare të Shqipërisë, Jugosllavisë e Greqisë. Në këto momente ajri i hapësirave të Atdheut tim m'u duk më i pastër dhe më i këndshëm.

Në orën 13 e 10' qielli kthjellohet dhe unë filloj nga vrojtimet. Radiometri tregon se rrezet diellore këtu në majë janë shumë më të forta se në kuotën 820 m. Ndërsa temperatura këtu, në orën 13, ishte 15°C, në Durrës po në këtë orë termometri shënonte 27°C. Në orën 18 u dhashë fund vrojtimeve dhe zbritëm me kënaqësi të tatëpjetën e majës.

Atë natë na takoi ta kalojmë me barinjtë e Brigadës së parë blegtorale. Tendat e shtrungat ishin ndërtuar pikërisht nën majën e Alarupit, në një gropë të mbrojtur nga erërat veriore, në lartësinë 1800m. nga niveli i detit. Në këtë gropë malore nata ishte e ftohtë dhe, të gjithë u mblodhëm shpejt rreth prushit të zjarrit tërheqës, drita e kuqe e të cilit i jepte, atmosferës së asaj kasolleje të thjeshtë, një kolorit poetik, përrallor. Në këtë ambient gjysmë të ndriçuar dalloheshin fy-

dálë nga dálë = dalngadálë
obiékt = objékt
línjë kufitáre borderline
shtrúngë milking area
përrallór fabled
i brónxët bronzed
vizatój draw
yndýrë fat
létë watering facility for animals
gúnë heavy cape
ka shúmë të ngjárë it's quite possible

tyrat e bronxëta të barinjve, ku me vija të prera e të skalitura vizatohej bota shpirtërore e këtyre njerëzve me karakter burrëror e të pastër.

Atë natë, afër zjarrit biseduam gjatë, rreth shumë çështjesh, për tufat e dhenve, për shtegtimin e tyre prej Vurkut në këto lartësi për barin e mrekullueshëm të këtyre kullotave verore të përmendura për qumështin e tyre plot me yndyrë, për mungesën e burimeve dhe mbi letë që mendohej të ndërtoheshin në të ardhmen. Këto male të Pogradecit, populli i ka quajtur Male të Thata pikërisht, pse në to mungojnë uji, pyjet e hijet. Në ditët e kthjellëta të korrikut, rrezet e diellit, këtu janë më të forta se në zonat e ulta fushore. Bile në bazë të gojëdhënave, barinjtë na treguan se në këto gropa rrezet e diellit kanë djegur edhe gunat e zeza të çobenjve që i linin në ndonjë pjerrësi jugore. Ka shumë të ngjarë që edhe dhentë e këtyre kullotave të jenë goditur më shumë nga dermati solar pasi këto janë mbajtur pothuajse gjithë ditën në diell pa kaluar zhegun në tenda e hije dhe, pa u ujitur në mënyrë të mjaftueshme, për shkak se letë, e largëta e të rralla nuk plotësojnë nevojat e gjithë tufave.

Aty nga ora tre e mëngjezit ritmi i biseedimeve sikur ra dhe, të gjithë u shtrimë të flemë rreth prushit, i cili na ngrohte vetëm anët e trupit të kthyer drejt tij, kurse nga vrimat e kasolles ajri i ftohtë i majës, që zbriste nga pjerrësitë në kuotat më të ulta të kësaj grope, na jepte rrëqethe të pjesshme, të cilat na e bënin gjumin të copëtuar e jo të thellë, megjithëse ndienim shumë nevojë për të fjetur. Temperatura më e ulët gjatë asaj nate zbriti pothuajse afër zeros. Ora gjashtë e mëngjezit na gjeti të zgjuar, përsëri rreth zjarrit, ku zienin kusitë e qumështit. Ngarkuam njushkat e muarëm rrugët e ngushta të këtyre livadheve të bukura për të zbritur në kuotat më të ulta, ku na prisnin shokët.

zheg heat of the day
i pjésshëm partial
i copëtúar broken
livádh meadow
blegtór heardsman
fisnikój ennoble
virtýt virtue
i çmúeshëm worthy

Me ngjitjen, në Kreshtën e Alarupit, plani i vrojtimeve gjeofizike, në Malin e Thatë, mori fund. Pas 10 ditësh matjesh në kuota të ndryshme të këtij relievi malor, u ndamë me përzemërsi nga blegtorët e pa lodhur e të guximshëm të kullotave të gjëra të maleve të bukura të Pogradecit. U ndamë me të vërtetë të emocionuar nga këta njerëz bujarë që natyra e vështirë e punës së tyre i ka fisnikuar me virtytet e larta të thjeshtësisë, ndershmërisë e trimërisë, me këta njerëz që punojnë me vetëmohim e pasion të madh për t'i dhënë atdheut kontributin e tyre, jashtëzakonisht të çmueshëm.

Në mëngjezin e 24 korrikut, karvani i mushkave të ngarkuara me arkat e instrumenteve, u nis nga fshati malor dhe, ne, me hapa të ngadalta po largoheshim nga këto lartësi me konture të dallgëzuara, atmosfera e pastër e të çlave sikur na kishte filtruar shpirtin e mendjen nga çdo gjë të rëndë, të ngathët e pa lëvizje. Mali, të gjallëron, të jep forca për ta dashuruar akoma më me pasion jetën, të jep atë besim e atë optimizëm që nuk lejojnë të ndalesh, por të shtyjnë përpara për të punuar e vepruar më me vrull e këmbëngulje.

Klima malore ndryshon në shumë aspekte nga ajo e fushës dhe e bregdetit. Në kuotat e larta temperatura dhe presioni atmosferik bëhen më të vogla, ndërsa atmosfera është më e pastër dhe, rrezet diellore janë më të forta e më të pasura me ultraviolete se sa në bregdet. Në kuotat e Malit të Thatë ne e ndjemë fortësinë e këtyre rrezeve, të cilat kur na goditnin fytyrën e qafën, dukej sikur na përvëlonte një flakë e nxehtë dhe e padukshme. Megjithëkëtë temperatura e ambientit ajror në mal zakonisht është më e ulët se sa në fushë e në vendet e ulta detare. Kjo përcaktohet nga fakti se sipërfaqja e lartësive malore, duke qenë e rrethuar me një atmosferë më të pastër e më transparente nëpërmjet të vetë rrezatimit

filtrój cleanse; filter
megjithëkëtë in spite of this
hapësírë space
kushtëzúar determined; viewed
disnivél discrepancy

infrakuq humbet më shumë nxehtësi, e cila kalon në kapësirat e larta stratosferike e jonosferike. Vrojtimet e shumta kanë treguar se për çdo 100 metra ngjitje vertikalisht, temperatura e ajërit ulet mesatarisht 0,6°C. Kështu, në kushte kur atmosfera ndodhet në një gjendje të stabilizuar, në majën e Alarupit të lartë rreth 2200 m. duhet të kemi një temperaturë rreth 13°C, më të ulët se sa në bregdet. Ndërsa në vendet me lartësi 800 m., mbi sipërfaqen e detit, sikurse është rrafshina e Korçës, temperatura e ajrit, e kushtëzuar vetëm nga disniveli i relievit, duhet të jetë rreth 5°C më e ulët se sa në fushat e ulta të Myzeqesë. Por ka raste, veçanërisht në mot të kthjellët, kur në lartësitë e maleve temperatura është më e lartë se sa në vende të ulta. Ky fenomen i njohur me emrin inversion, lidhet me faktin se ajri i fushës, i nxehur nga sipërfaqja e tokës, bëhet më i lehtë dhe si pasojë ngrihet lart, ndërsa vendin e tij, e zë ajri i malit që është më i rëndë e më i ftohtë.

Vargmalet e larta ndikojnë gjithashtu edhe mbi sasinë e reshjeve në lartësi si dhe në zonat afër tyre. Zakonisht në zonat malore, sasia e shiut vjetor vjen duke u rritur sa më lart të shkojmë. Por kjo vazhdon deri një farë lartësie që zakonisht arrin deri në 2000 m. Nga kjo kuotë e lartë shirat fillojnë të pakësohen në krahasim me nivelet më të ulta. Sidomos janë të pasura në shi ato faqe malesh që rrihen nga rryma ajrore detare, sikurse ndodh p.sh. me pjerrësitë e malit të Dajtit që vështrojnë nga deti Adriatik. Në këto pjerrësi gjatë vitit bien rreth 1700 mm, ndërsa në bregdetin e Durrësit sasia mesatare e reshjeve vjetore nuk i kalon të 1000 mm.

Ambienti malor karakterizohet me presion të ulët atmosferik, i cili sa më lart që shkojmë vjen, duke u zvogëluar për shkak se pakësohet trashësia e shtresës ajrore që qëndron mbi ne dhe objektet e tjera. Në majën e Alarupit barometri shë-

pakësój lessen
zvogëlóhem become smaller; diminish
trashësí thickness
shtrésë layer
zvogëlím reduction
helmúes poisonous
ngarkésë charge; load

nonte presionin 590 mm, kurse në bregdet presioni zakonisht është 760 mm. Deri në afro 3 km lartësi, në çdo 13 ngjitje presioni bie mesatarisht një milimetër. Krahas zvogëlimit të presionit, në lartësitë e maleve kemi dhe uljen e sasisë së oksigjenit që përmbahet në ajër, por kjo ulje deri në lartësinë 2000 m., nuk është e konsiderueshme dhe njerëzve me shëndet normal u ndikon në mënyrë pozitive. Ajri i maleve është i pastër, përmban shumë më pak pluhur e lëndë të tjera helmuese dhe është më i pasur me ozon dhe me ngarkesa elektrike pozitive.

Faktorët kryesorë të klimës malore që ndikojnë mbi shëndetin e njeriut janë: presioni i ulët atmosferik dhe mbajtja e ulët e oksigjenit në ajër; temperatura më e ulët e ajrit dhe lëkundjet e saj ditore më të theksuara; forca më e madhe e rrezeve të diellit, të pasura sidomos me rreze ulreviolete, që kanë një aktivitet të madh biologjik dhe fiziologjik; thatësia e madhe e ajrit, e cila në kushtet e presionit të ulët krijon rrethana mjaft të favorshme për një avullim të fortë; jonizimi i fuqishëm dhe pastërtia e ajrit.

Klima malore ushtron një ndikim të madh mbi njeriun dhe në rastet më të shumta, kur nuk kemi të bëjmë me sëmundje të veçanta ky ndikim është i favorshëm dhe kalitës për organizmin.

Kur njeriu kalon prej vendeve të ulta në lartësi deri 1000 metra, ku kemi një pakësim të oksigjenit, frymëmarrja bëhet më e thellë dhe më e shpeshtë, fenomen ky që të shpie në forcimin e ajrimit të mushkërive dhe në shtimin e ajrit që shkon në to. Krahas me ndryshimet e veprimtarisë së aparatit të frymëmarrjes kryhen zhvendosje edhe në funksionimin e zemrës. Në lartësitë mesatare konstatohet një shpejtim i pulsit deri 90-100 godîtje në minutë. Por ky shpejtim vihet re vetëm 20 ditët e para të qëndrimit në male dhe pastaj fre-

avullím vaporization
jonizím = ionizím ionization
pakësím lessening
ajrím aeration
mushkërí lung
zhvendósje shift
konstatój confirm
shtim increase

kuenca e pulsit ngadalësohet e arrin në nivel pothuajse normal. Në lartësi më të madhe frekuenca e pulsit mund të arrijë deri në 180 goditje, ndërsa frekuenca e frymëmarrjes bëhet 25-30 në minutë. Kur ndodh një shpejtim, jo i tepëruar i pulsit, njëkohësisht vihet re dhe një rritje e volumit të gjakut për minutë, gjë që ka si pasojë furnizimin më të mirë me gjak të mushkërive.

Klima malore e lartësive 800-1200 m. stimulon një apetit të mirë dhe në këtë mënyrë shpie në shtimin e peshës. Në përgjithësi në mal vihet re një shtim i proceseve oksido-rigjenerative, dhe si rrjedhim një aktivizim i përgjithshëm i funksioneve biologjike të organizmit.

Nga maja e Alarupit na u desht të kalojmë në bregdetin e Durrësit. Klima detare kësaj radhe, me lagështirën e saj depërtuese na u duk jo shumë çlodhëse. Observatori ynë i vogël ambulant filloi të funksionojë në bregun e Golemit. Qysh në ditën e parë të vrojtimeve doli i qartë ndryshimi i madh që ekziston ndërmjet intensitetit të rrezeve diellore në lartësitë e maleve dhe në nivelin e detit.

Nga krahasimi i këtyre matjeve rezulton se në lartësinë 2200 metra intensiteti i rrezeve diellore është rreth 127% më i madh se sa ajo që vihet re në bregdetin e Durrësit. Temperatura minimale në bregdet gjatë muajit korrik arrin në 18°C, ndërsa në majën e Alarupit rreth 4 gradë Celcius.

Mbas plotësimit të programit modest të kësaj ekspedite gjeofizike, të organizuar për herë të parë në lartësitë e mrekullueshme të relievit tonë malor e në bregdet, u kthyem me dëshirë e projekte të reja për ta vazhduar punën e filluar në një shkallë akoma më të gjerë edhe në kuota të tjera të vendit tonë.

kësáj rádhe this time around
çlódhës restful
ambulánt mobile

ERIC

LEXIMI I SHTATEDHJETENENTE

"Shënime për brezin tim" in Ismail Kadere
Shekulli im, Tiranë, 1961, pp.64-80

korigjój = korrigjój correct
pedánt pedantic
udhëkrýq crossroad; intersection
spastrój cleanse
zinxhír chain
ndaj distinguish
zarf envelope

SHËNIME PËR BREZIN TIM

1.

Brezi im,
Jotja qoftë kjo këngë!
Dhe unë qofsha kudo me ty

Të jem me ty gjenerata ime
Jo të gjykoj e të korigjoj
Si redaktor pedant i stuhisë,
Të jem me ty dua unë
Një vijë e kuqe, e dridhëshme mes stuhisë.
Dhe ne të gjithë të jemi:
Drurë të mbjellur në udhëkryqet e historisë,
Tabella të kuqe përpara kohrave të vështira,
Me mbishkrimet:
«Kohra të shpëtuara»
Ne ta spastrojmë këtë planet,
Nga kolonializmi, zinxhirët, poshtërimi,
Që ju pas nesh kur të vini
Atò mos tu pëlcasin ndënë këmbë
Si mina.

Me këtë këngë
Dua vetëm t'i ndaj atij shkollarit
Që në sallën e madhe të postës
Një plakë i lutet ngadalë
T'i shkruajë mbi zarf
Adresën e të birit ushtar.
S'bëj gjë më tepër se ky shkollar.

2.

Ne erdhëm në jetë
Në kohra plot duman.
Ne erdhëm si ajo nusja e veshur me të bardha
Që pjek në rrugë një funeral vigan,
Ne erdhëm si manushaqe të herëshme.
Mbi varrin e ushtarit.

S'lindëm ne princa
Megjithatë
Mijra topa salutuan ardhjen tonë.
Ish kohë e hekurt kur në qiej
Më shumë bombardonjës
Se sa zogj fluturonin.

Po! o moshatarët e mij
Unë akoma zogjve s'ua di emrat mirë
Ne markat e aeroplaneve
Ahere si Abecenë dinim.
Nga zhurm' e motorreve i njihnim
Siç duhet të njihnim
Zogjtë nga cicërima.

Dhe si u rritëm kështu
Dhe ja pa pritur një mbrëmje
Nënat me lot në sy thanë
«U bënë burra»
Dhe ja na erdhi radha.

3.

Po. Radha jonë.
Koha.
Si rezervuar vigan uji

dumán = tym
vigán gigantic
manushége violet
i hékurt of iron
bombardónjës bomber
moshatár age-peer
Abecé ABC
cicërím twittering

Rezervon lavdinë
Dhe ua ndan gjeneratave
Si nikoqire e mirë
Qëllojnë ditë me vërshime ujrash
Qëllojnë dhe thatësira.
Po për lavdinë
Ne s'do kemi nevojë
Si për një karamele
Q'e shkrijnë në goië.
Le të bëhen metalet
Lugë dhe biçikleta.
Për ndërtonjësit e tyre,
Pastaj monumentet.

E shoh Republikën
Në mëngjeze industriale
Me kombinezon veshur,
Republikën time
Q'akoma mban qeleshe.

4.

Mirëmëngjez Republikë!
Ndjej frymarrjen tënde ritmike
Tek përkulesh
Me syza të zeza
Mbi fisat oksidrike.

Mirëdita Republikë!
Këto tela tensioni të lartë që zgjatem pa kufi.
Që si nuse me tela të stolisin,
Janë nervat e tua të nderura
Nervat e tua me çelnik të salduara,
Nervat e tua të hekurta,
Shqipëri.

ndaj distribute
vershím flood
thatësírë drought
lúgë spoon
kombinézon = kominóshe overalls
qeléshe white skullcap
ndjej = ndiéj
sýza të zéza dark goggles
físë oksidríke accetylene torch
i saldúar soldered

Mirëmbrëma Republikë!
Shoh moshatarët
Ngjitur mbi shtylla,
Mbërthejnë llampa
Mijëra dhe mijëra
Sikur montojnë
Një qiell me yje.

5.

Ka në jugë një lumë,
Që ka tremijë vjetë
Që buron nga malet,
Që rrjedh nëpër Eneidë,
Akeroni.
Akeroni skëterrës
Bistricë e sotme thonë.

Mbi këtë lumë vozitën
Turma të vdekurish
Me qefinë të bardhë,
Me koka të verdha,
Të qullur nga shiu,
Të ngrirë nga era.

Ky lumë që shekuj mbi valë
Shtyu varkën e Karontit,
Turbinat do të shtyjë
Dhe mbi të do lëvrijnë
Jo më mijëra shpirtëra
Po miliona elektrone.
Dhe ti xha Karont
Erdh koha –
Në pension

shtýllë pole; pillar
burój well; spring up
Akerón Acheron, river of Hades
skëtérrë hell
vozít row
të vdékurish of dead (people)
qefín shroud
i qúllur dampened; soaked
várkë = bárkë rowboat
Karónt Charon, ferryman of Hades

Braktise varkën e vjetër
Vozite tremijë vjet
Se erdh një kohë e madhe
Xha Karont,
Varkar i lashtë sa bota
xha Karont.

(Dhe ovullat që u more të vdekurve
Kur i çoje në botën e amëshimit,
Depozitoji, xha Karont,
Në Sarandë
Në arkën e kursimit!)

Po, o brezi im
Ne kemi punë sot
Me Akeronë
Dhe Karontë;
Kjo s'është kaqë e thjeshtë
Sa të shkulësh një fletë
Nga e lashta Eneidë.

6.

Eja ulu këtu,
Xha Karont,
O filozof i vdekjes,
Ulu të kthejmë një gotë;
Për gjithë brezat nuk ka pasur
Kryqëzor më të tmershëm
Se barka jote.

Ulu dhe më trego
Për miliardet e shpirtrave
Që transportove në atë botë
Për skllevërit, poetët, militarët,

varkár = bárkar boatman
óvull old coin
amëshím anointment
árkë e kúrsimit safe deposit box; savings account
kryqëzór cruiser
miliárd billion

Akilenjtë, Neronët, Cezarët,
Tregomë
Si me kujën
E erërave përzihej
Kuja e tyre
Mes rrëmujës
Së ujërave
Që rrokulliseshin
Rrokopujë.

I frikshëm tregimi yt Karont,
I frikshëm dhe i math;
Me këto shpatulla
Duke lëvizur lopatat
Ke tërhequr
Një botë të tërë të vjetër,
Drejt vdekjes.

Po tani më dëgjo mua xha Karont
Të të tregoj diçka
Nga bota jonë e të gjallëve.
Të tregoi për brezin tim
Që varkën tënde
Do ta coptojë rëzë maleve;
Të tregoj për brezin tonë.
Që mbi trvezë, ku pleqtë lozin dominonë
Në vënd të 4-3-shit
Harushën e madhe mund të zbresël
Se ka një forcë të madhe
Sot Shqipërija
Q'u shtohet maleve, stuhive, krenarive
Të saj
Forca e re:
Partija!

kújë lamentation
rrëmújë chaos
rrokopújë helter-skelter
lopátë oar; shovel
rëzë máleve = rrëzë máleve foot of the mountains
lózin = lúajnë
4-3-sh kind of game
harúshë e mádhe great bear; ursa major

7.

Popujt
Janë si anije të mëdha
Në det të historisë qëllonte që shtërgatat
U thyenin dyrekët
I zhytnin në errësirat si nata.
Partija,
Ishte periskopi
Që, që nga errësirat
Përgjonte horizontet
Dhe vendoste:
Këtu,
Do të dalim mbi ujra prapë!

Si gjeni i detit
Prej ngjyrës së stërkalave
Partija dallon e para
Erërat si fryjnë,
Forcën, drejtimin dhe njelmësinë e valëve;
Nga grumbullimi sipër saj i reve
Dallon stuhinë,
Si shkëmbinj të nënujshëm nënë vahte
Zbulon tradhëtinë.

8.

Këtë tokë të sigurtë që quhet atdhe
Na e lanë brezat që ikën,
Që ne të tjerëve t'ua lëmë
Kaq sa e gjetëm,
Më pak asnjë pëllëmbë!

shtërgátë gale; storm
dyrék = dirék mast
përgjój spy; eavesdrop
gjení genie
stërkálë spray
njelmësí saltiness
saj = asáj
i nënújshëm underwater

Atdheu im shtatlartë,
Plot muskuj, pa bark e dhjamë,
Fytyrë-hequri, burërori,
Shami-kuqi,
I pathyeshmi,
Madhështori.

Kur mbreti Gjenc i krrusur
Karrocën tërhiqte nën Harkun e Triumfit
Të Romës krenare,
U nxinë nga turpi këto male.
U nxinë, po s'u dhanë,
U mbështollën me mjergulla,
Nga urija
Rrufetë hanin,
Dhe prisnin
që turpi të lahej
Këto male të shkreta.

O Hark i triumfit të Romës,
Nën këmbët e tua të paralizuara
Nga pleqërija
Tani enden turistët e huaj.
Si mund'të kalonte atdheu im shtatlartë
Nënë kubenë tënde
Më thuaj!

Harqe triumfi –
Endërime të përkulura
Mbi koka të ulura
Harqe triumfi
Mbi zverqe të skuqura
Nga plagë të tmerrëshme,

bark belly
dhjámë fat
fytýrë héqur drawn-faced
burërór = burrërór manly
i pathýeshëm invincible
Gjenc Illyrian king enslaved by Romans
i krrúsur hunched over
karrócë chariot; carriage
hark arch
jépem give in
rrufé thunderbolt
laj cleanse; eradicate
éndem loiter; walk about
kubé vault; dome
endërím = ëndërrím dream; dreaming
i përkúlur stooped
zverk nape

Harqe triumfi
Sy të shqyer tiranësh
Mbi trupa të mundura!
U shëmbët ju,
Por mbeten në botë
Popujt
dhe malet e patundura!

Dëgjoj në qetësi të natës mbretin Gjenc fatkeq
Se si drejt errësirës dhe harrimit
Atë karrocë turpi përjetë tërheq,
I munduri i vetmuari mbreti Gjenc!
Ne
Rrugë të tjera çajmë.
Të pathyer,
Me një lëvizje brrylash
Çdo hark triumfi të huaj përlajmë,
Nderin e atdheut
Më lart se këto male e mbajmë!

Armiatë përreth
Harqe triumfi na ngrenë
Që ne nënë to të kalojmë
Ata ëndërojnë
Me shekuj ata ëndërojnë.
Për ju, o armiq,
Harqe triumfi, s'ngremë ne.
Ne ngremë
Oxhakë gjer në re,
Se Shqipërija vetë është një Triumf
M'e lartë se çdo hark triumfi.

i shqyer torn up
shëmb = shemb overthrow; smash
çaj thrust; break through
i pathyer unbroken; undefeated
bryll elbow
ëndërojnë = ëndërrojnë

9.

Mbi ish fushat e luftrave
Ne ngremë një botë të re,
Por qielli nuk pastrohet,
Siç, duke hapur kanatat,
Pastrohet mëngjezeve,
Një kafene.

Mbi shpinën e globit
Si shpirt i keq i zi
Fluturoj Pauersi
Si një shqetësim që nxjerr nga bisht i gjatë
tym të zi.

Pauersi ra
Po retë prapë mblidhen
Ngarkuar me shi radioaktiv
Duke mbështjellur në krahët e zeza
Të tjerë Pauersa.

Të tjerë Pauersa
Që parashutat u bëhen qefinë
Që savane ju bëhen
Dëborat dhe ujrat.
Nuk do të vijë
Dita e zezë
Kur nga qiejt të bien
Jo, më shi
Por formula!

Sot qiejt dhe kontinentet
Vështrojnë njëri tjetrin
Me syrin e mjergullave

kanát shutter
Pauers Francis Gary Powers, U.S. U-2 spyplane pilot
saván shroud

njérzve = njérëzve
mez waist
vézme cartridge case
kurm body
kapótë trenchcoat
çpoj = shpoj pierce
pléksur entwined

Me majat e raketave;
Ardhtë vëllazërimi,
I qjejve dhe kontinenteve
I brigjeve dhe i ujrave.
I lartësive dhe thellësive,
I largësive dhe afërsive.
I njerëzve dhe i njerzve!

10.

Ti, brezi im.
Brezi i mezit
I shekullit të XX
Vezme me plumba e
Shekullit XX.
Lufta mbi kurmin tënd
S'do të kalojë.
Rrezet radioaktive
Endrat s'do t'i përvëlojnë.
Telat e llogoreve
Kapotën s'do ta çpojnë:
Armiku këndej [illegible]or..
Një pengesë të [illegible]he do ngrejmë.
Me armë, bajonetë, [illegible]engë
Tela hekuri, nerva, ëndra,
Pleksur;
Një të madhe, të tmershme
Pengesë.

Prapa armik!
Na njeh?
Jemi ne
Ne

ryp = rrip belt
Mínat në s'mjaftófshin Should the mines not suffice.
gavétë
prédhë shell
hon gulch; ravine
pëlcítje explosion

Rypi i mezit
Ryp vezmesh
I shekullit luftëtar.

Minat në s'mjaftofshin
Shpirtrat tonë si mina do vendosim,
Fushave të pambaruara,
Që ti të mos kalosh.
O fusha të tmerëshme
Me shpirtra të minuara!

Lavdinë
S'do presim ta marrim me gavetë në dorë.

Përpara kohës
Por me tonë.

Dhe nga metali i shkrirë
Në fushat e betejave,
Nga metalet e predhave,
Të llogoreve telave,
Shqyer mbi hone;
Gjeneratat
Le të ngrejnë,
Monumentin tonë!

11.

O brezi im
Kjo mos ndodhtë!
Për pëlcitje atomi,
Mos u bashkoftë!
Po edhe në ndodhtë kjo

fáshë bandage; strip
krídhem dive; plunge
anëdét seaside
vrap trot
tantéllë = dantéllë lace
shkúmë foam
shkúmbë = shkúmë
gjýsëm = gjýsmë
marshím marching

Ne prapë fitimtarë
Nga fushat e betejave do të kthehemi
Plot flamurë të kuq.
Dhe fasha të bardha.
Dhe fashat në s'mjaftofshin
Me re do t'i lidhim,
Plagët e hidhura,
Me mjegulla të bardha,
Do mbështillemi,
Në kaltërsitë e mëngjezeve të ardhme,
Do të kridhemi,
Në gjokset njerzore drejt nga gjiri vdekjes
Do të hidhemi.

12.

E madhe si urrejtja jonë
Është dashurija jonë.
Dil në këtë anëdet dhe vështro
Zhurmën e përjetëshme të valëve.
Dëgjo këtë kaltërsi, këtë vrap të zbetë yjesh;
Duket sikur mijra gishta të freskët t'erës
Po u qëndisin tantella të bardha shkume
Valëve
Dhe mos harro,
Është shkumbë deti kjo,
Nuk është shampo!

E madhe është dashurija jonë:
Ky brez
Me një milion hapa të forta
Shkon mbrëmjes në gjysëm milion takime,
Dhe do të shkojë në mijra marshime
Për të mbrojtur këto takime.

i pasósur endless
tráse plain; outline
vendós place; set up; determine

Dashurinë tonë të mbrojmë
Ne të gjithë, të dashuruarit.
Të gjithë
Edhe ti po, të duash të vish, Brixhit Bardo,
Moj moshatarja jonë e bukur, me duar të plagosura
Mirse të vish!

Ne jemi,
Miliona Romeo që dashurojmë miliona Zhulieta
Të vëndeve,
Qeveritë e të cilëve kemi armike!
Rroftë dashurja jonë e madhe!
Megjithse për te nuk jepet Çmimi Nobel,
Ajo mund të trondisë globin!

13.

Të shoh brezi im
Sot ngjitur mbi shtylla,
Monton ti llampa
Mijëra dhe mijëra,
Nesër,
Në qiej ti do të sulesh të pasosur
Të shtrosh të ftohtat trase të universit
Dhe i pari ndër orbita të vendosish shënjat:
«Përpara»
«Zik-zak»
«Kthesë».

Po o brezi im
Sot nxjerr ti në pension
Të lashtin varkar Karont
Nesër në udhëkryqe mes yjeve
Trafikun do t'u mësosh perëndive.

semafór traffic light
gjobój fine; penalize
matufósem become senile
i demodúar obsolete
rufeprítës = rrufeprítës lightning rod
rjétë net
NISH = Ndërmarrje Industriale Shtetërore
State Industrial Enterprise
grévë labor strike
plákem grow old
s'ta vémë re we don't bother with you

Do të digjen semaforët e tu
Në kozmos natë e ditë:
I math je ti, brezi im
Nesër
Do të gjobosh perëndinë.

14.

Zeus,
Ti u matufose, Zeus!
Ti akoma me rufe gjuan qytetet.
Se s'e kupton që rufetë e tua
Janë armë të demoduara,
Se njerzit i kapin me rufepritse rufetë
Si peshqit në rjetë.

Po Zeusi s'e kupton.
Ai gjuan përherë
Dhe ballin e djersitur
I a fshin gruaja e tij, Hera.

Dhe Vullkani,
Përgjegjësi i «NISH prodhimit të rufeve»
Vështron si mundohet zoti i tij,
Vështron kupolat e qyteteve të tmerrshëm
posintë reve
Dhe siç duket
Mendon për grevë!

Bota ka ecur përpara
Dhe përpara botës
Marshojmë ne.
Ti grindesh atje majë Olimpit
Por u plake fare dhe s'ta vemë re!

shekull shpejtësish fast-paced century
Tu-104 Soviet jet
vjétët = vjétet
shkundém drop off; shake loose
aranxhátë = arançátë orangeade
bastún walking stick
érrem grow dark
i lúmë blissful
i památë = i pamásë vast; rash
afíshe poster

15.

Në këtë shekull shpejtësîsh
Më shpejt se Tu-104
Më shpejt se sputnikët në fluturim,
Fluturojnë vjetët e tu,
Brezi im.

Fluturojnë vjetët e rinisë,
Ditët shkunden një nga një
Si pendët e shqiponjave.
Ditët bijen si rëra prej ballonave,
Që më lart ballonat të ngjiten
Në gji të pafundësisë.

Kështu ikshim një nga një duke u ngjitur,
Duke shpërthyer tavanet plot tym duhani të klubeve,
Ku pijnë aranxhata,
Dhe mezi shqiptojnë «Lumumba».

Ne do ikim
Jo të krrusur mbi bastune.
Po në sfonde shtyllash tensioni të lartë,
Do të erremi si silueta
Horizonteve të lume.

Ne do t'ikim nga kjo botë si një funeral i vogël'
Që pjek në udhë një dasmë të pamatë,
Ne do t'ikim
Siç hiqen afishet e qullura
Pas një çfaqjeje gjigande, pas mesnate.

u rítë = u rrítë may it grow
përtërítem revive
rezëllím = rrezullím reflection; meditation
i papërlýer unblemished; unsullied
frymzím = frymëzím imspiration
lyp ask for; beg
biná building
vídhë screw
ti = t'i (mp.)
mbart carry
t'i = t'u (mp.)

16.

E vogël kënga
Për ty, brezi im
Por kënga u rittë
Nga agimi në agim,
Kënga u përtërittë
Nga luftimi në luftim.
Si avalansh gjigand
Plot rezullime ëndrash të qarta,
Me vehte shkëlqim e vrull nga çdo shpirt marrtë.
Se kjo këngë s'është
Këngë ndjenjash të papërlyera,
Se s'më erdhi natën si lugat frymzimi
Kjo këngë më erdhi siç vjen e diela
Pas një jave mbushur përpjekje dhe shqetësime.

Dhe po ta lypte Shqipëria
Unë këto vargje
Si metal do t'i shkrija
Binarë prej tyre do të krijoja,
Me rima,
Si me vidha ti montoja.

Dhe më i lumturi në botë
Do t'isha unë
Sikur vargjet-binarë
Të mbartnin trenat mbi shpinë,
Trena, që bukë punëtorëve t'i shpinin,
Që nga bot'e madhe.
Miq të na sillnin udhtarë
Dhe që n'alarme drejt kufijve
Të çonin në mesnatë ushtarë.

1960

LEXIMI I TETEDHJETE

JERONIM DE RADA
(1814-1903)

Jeronim De Rada është një nga figurat qendrore të letërsisë shqipe. Duke nisur veprimtarinë e vet që në agimin e lëvizjes së Rilindjes, ai dha një kontribut të madh në krijimin e një letërsie artistike kombëtare, që një nga themeluesit e saj. Krijimtaria e De Radës u bë jehonë e vrullit të ri patriotik që kishte marrë lëvizja çlirimtare e popullit tonë. Duke ngritur lart të kaluarën heroike të vendit, duke dhënë pamje të fuqishme artistike të kohës së Skënderbeut, ai edukonte tek shqiptarët ndjenjën e dashurisë për atdheun, urrejtjen për anmiqtë dhe forconte besimin në të ardhëmen e Shqipërisë, duke bërë thirrje për çlirimin e saj sa më të shpejtë.

Figura e De Radës është ajo e një atdhetari të kulluar, që shkriu tërë jetën e vet për ringjalljen e Shqipërisë, për zhvillimin e kulturës dhe të gjuhës shqipe. Veprat e tij artistike, që merituan konsideratën dhe vlerësimin e lartë të shumë shkrimtarëve të njohur evropianë të kohës, ndihmuan që populli shqiptar, kultura dhe çështja e tij kombëtare, të njihen dhe të çmohen në botën e jashtme.

JETA

Jeronim De Rada lëu në Maki, fshat i vogël arbëresh mbi një shpat përballë detit Jon, në krahinën e Korencës së Kalabrisë, nja nëntë kilometra afër Shëmitër Koronës, qendër e kolegjit arbëresh të Shën Adrianit. I ati, Mikel De Rada, prift ortodoks, ishte mësues i gjuhëve greq e latine në këtë kolegj.

ringjállje resurrection

Mësimet e para, Jeronimi i mori nga i ati. Më pas hyri në kolegj (1822), ku nisi të shquhet në mësime, sidomos në letërsi e matematikë. Kolegji, me gjithë se i ngritur për qëllime fetare, shërbente edhe për edukimin e të rinjve që s'kishin ndër mend t'i kushtohen meshtarisë. Aty, përveç lëndëve fetare, zhvilloheshin në radhë të parë edhe lëndët humanitare. Nxënësit njiheshin me një numur veprash, sidomos të letërsisë greke e latine. Po hynin fshehurazi edhe vepra të letërsive të reja e moderne, që lexoheshin me etje të madhe, edhe pse të ndaluara nga çensura e shkollës. Kishin filluar të hynin edhe idetë e reja. De Rada vetë na thotë se kolegji ishte bërë *«një çerdhe volterianësh revolucionarë»*.

Në shkollë poeti i ardhëshëm u dha shumë pas leximit. I përlqenin mbi të tjerë Sofokliu e Euripidi, Homeri e Virgjili, Petrarka, Torkuato Taso e Ariosti. Lexoi Foskolon, Zonjën Stal, Viktor Hygonë. Ky i fundit i la përshtypje të pashlyeshme me figurat e reja e sublime të tij.

Provat e para poetike De Rada i bëri që kur ishte në shkollë, duket nën ndikimin e Bajronit. Më 1830 ai hartoi një poemth italisht në katër këngë me subjekt shqiptar, «Odise».

Më 1833, De Rada mbaroi shkollën e mesme. I ati nuk e la të vazhdojë menjëherë studimet e larta, po e mbajti një vit në fshat për t'u çlodhur. Djaloshi s'e kaloi kohën kot. Avokati kozentinas Rafael Valentini, që do të ishte më 1848 në ballë të kryengritësve kalabrezë, kishte ngjallur në zemrën e tij dashurinë për folklorin. Romantizmi kishte filluar të hynte e të ndjehej në Itali dhe, me të edhe entusiazmi e interesimi për poezinë popullore. De Rada u vu të mbledhë nga goja e plakave dhe e vajzave të Makit e të fshatrave përreth, këngët e tyre të bukura, duke vazhduar kështu traditën e vjetër arbëreshe të mbledhjes së letërsisë gojore. Këngët popullore i zbuluan poetit të ri një botë të re frymëzimesh, e njohën me jetën, ndiesitë, aspiratat e shijën e popullit të tij, i ngjallën dashurinë për gjuhën amtare dhe besimin për aftësitë shprehëse të saj. I hyri kështu edhe dëshira për të shkruar al

me gjíthë se = megjíthëse although
meshtarí priesthood
étje thirst
çérdhe nest
u dha shúmë pas lexímit read a lot
i pashlýeshëm indelible
próvë attempt
kozentínas resident of Cosenza
kalabréz inhabitant of Calabria
ndiesí feeling

vetë shqip në frymën e këngëve që mblidhte. Ky vit që kaloi në fshat qe pra vendimtar për orientimin e veprimtarisë poetike të tij. Interesimi për folklorin do të vazhdojë te De Rada mund të themi gjithë jetën.

Në fshat atij i lindi dashuria për një vajzë të varfër, të bijën e bariut të vet. Kjo dashuri i frymëzoi këngët që do të përbënin veprën e tij të parë shqipe, «Milosaon».

Në fund të vitit 1834 De Rada shkon të studiojë drejtësi në Napoli. Ky qytet, qendra më e madhe politike e kulturale e Italisë së jugut, hapte përpara djaloshit arbëresh një botë të tërë. Ai ndoq studimet juridike, po shpirtin e tij të ndieshëm nuk e tërheqin ligjet e thata e komentet e tyre. I riu merret më shumë me letërsi: lexon Shekspirin, Shilerin, Gëten, Kalderonin dhe tragjedianët frëngj, frekuenton rrethet letrare, shkruan poezi. Kur kthehet në fshat më 1836, për shkak të kolerës që kishte rënë në Napoli, ai sjell me vehte të botuara «Kangjelet e Milosaos». Me këtë libër hapej periudha e re e letërsisë artistike kombëtare. Aty për të parën herë, nëpër gojën e heroit, jehonte thirrja kushtrim: *«Ardhi dit' e Arbrit!»* Vepra u prit mirë nga arbreshët dhe e bëri të njohur poetin.

Që kur ishte në Napoli, De Rada kishte rënë në kontakt me organizatat e fshehta dhe më 1837 ai mori pjesë në një komplot që kishte për qëllim të përmbyste regjimin absolutist të Burbonëve. Komplotistët u zbuluan para se të veprojnë. Disa prej tyre u burgosën, ose dhe u vranë. De Radën e shpëtoi një gjykatës admirues i «Milosaos». Pas kësaj ngjarje, poetit iu desh të qëndrojë i fshehur nëpër katundet e malet e Kalabrisë, të bëjë për gjashtë muaj jetën e komitit. Kjo kohë ilegaliteti pati efekte të fuqishme mbi artin e tij, i mprehu edhe më tepër ndjenjën e hollë të vëzhgimit të natyrës.

Si kalon dallga e parë e shtypjes, De Rada kthehet në shtëpi dhe, pas ca kohe, shkon prap në Napoli, ku hyn si praktikant pranë penalistit të famshëm Rafael Konforti. Policia e gjurmon si njeri të dyshimtë dhe e arreston, duke e mbajtur një muaj në burg. Kur u lirua, mbet pa punë. Përveç artikujve në revista e gazeta, De Rada shtypi

drejtësí jurisprudence
ndoq = ndóqi
i ndiéshëm sensitive
kolérë cholera
kangjélë tale; gate
komplotíst plotter
komít outlaw
vëzhgím observation
praktikánt apprenticeship
penalíst criminal lawyer
gjurmój track
i dyshímtë suspicious; suspect
mbet = mbéti

në zemrat e shqiptarëve të Rumanisë, si Veqilharxhi dhe shokët e tij.

Më 1846 poeti u takua me filologun arbëresh Dh. Kamarda, që interesohej edhe për këngët popullore. De Rada ia filloi kështu përsëri mbledhjes së folklorit arbëresh dhe i vuri vehtes për qëllim, që krijimtarinë poetike dhe tërë veprimtarinë t'ia kushtojë kombit të vet *«aq bujar e aq të braktisur»*.

Vjen viti 1848. Gjithë Evropa përfshihet nga dallga e revolucioneve. Edhe Italia e jugut ngrihet më këmbë kundër absolutizmit të Burbonëve. De Rada merr pjesë në lëvizje përbri liberalëve. Ai përshëndet me entusiazëm kushtetutën që u shtërngua të apë, nën presionin e masave popullore, Ferdinandi II. Po sa më shumë shkonte përpara lëvizja revolucionare, aq më shumë ftohej prej saj De Rada o më i lëkundëshëm tregohej. Ai u neverit prej kaosit të këtyre ditëve dhe prej arrivizmit të shumë politikanëve liberalë, të cilët e hiqnin vehten si miq të popullit, po që në të vërtetë kërkonin të sigurojnë ndonjë të mirë materiale a pozitë për vehte. Ahere De Rada nxorri gazetën «L'Albaneso d'Italia» (Shqiptari i Italisë), e para gazetë shqiptare, ku poeti mbrojti pikëpamjet e tij mbi ngjarjet politike të kohës.

Në ndeshjen që vijon midis forcave reakcionare dhe revolucionare, De Rada s'diti të orientohet: në pozitën o tij të pamvarur, ai u armiqësua me liberalët, duke mos pranuar njëkohësisht ofertat e partizanëve të pallatit e duke marrë herë pas here pozicion kundër tyre. Reakcioni më i tërbuar shpërtheu, revolucioni u mbyt në gjak në Napoli; De Rada, që kishte shpresuar në zhvillimin e rregullt të një regjimi kushtetues dhe në sigurimin e të drejtave, i pakënaqur nga rruga që morën ngjarjet, mbylli gazetën që kishte nxjerrë, thotë ai, *«për mbrojtjen e pavarësisë së Italisë»*, dhe plot dezilużione vendosi të heqë dorë nga jeta politike dhe të tërhiqet në fshatin e lindjes, *«për të pritur kohë më të mira»*.

Tani e tutje, De Rada do t'i kushtojë vëmendjen e punën letërsisë shqipe dhe çështjes shqiptare. Më 1849 ai arriti

<u>përbrí</u> alongside
<u>të ápë</u> = <u>të jápë</u>
<u>arrivízm</u> = <u>arrivízëm</u> opportunism
<u>i pakënáqur</u> dissatisfied

të shtjerë në kolegjin e Shën Adrianit mësimin e shqipes dhe u bë mësues i saj. Po pas tre vjetësh u pushua nga puna, i paditur për ide përparimtare e për pjesëmarrjen e tij në lëvizjen revolucionare të mëparëshme.

Më 1850 De Rada u martua me arbëreshen Madalena Maliki. Më të pati katër djem dhe çoi disa vjet një jetë të lumtur familjare.

Më 1848 gjer më 1860, De Rada nuk botoi asgjë. Po, edhe në vetminë e Makit, ai nuk ra në letargji. Ato vjet mosveprimi të dukshëm, ai i shkoi duke endur veprat e ndryshme, që do të botonte më vonë me një ritëm të shpejtë. Pas vitit 1861 dalin italisht «Parimet e estetikës», «Vjetërsia e kombit shqiptar», «Letra G. Stamiles». Rëndësi të veçantë pati botimi i përmbledhjes së tij folklorike, «Rapsodi të një poemi arbëresh» (1866), që u përhap shumë. Emri i De Radës njihet tani jo vetëm në botën arbëreshe e në botën letrare të Italisë, po edhe në botën shkencore e kulturale evropjane. Numuri i mjqve e i admiruesve të tij është rritur. Midis tyre janë: princesha rumune me origjinë shqiptare, Helena Gjika, letrare e publiciste e njohur në gjithë Evropën me emrin Dora d'Istria; filologu gjerman T. Stier, që përktheu gjermanisht pesë këngët e para të veprës së tij «Anamaria»; historianët italianë Ç. Kantu dhe N. Tomazeu, etj. Ai filloi të hyjë në korespondencë me patriotë shqiptarë e dashamirë të Shqipërisë. Lufta politike, puna propagandistike për të drejtat e popullit tonë, zë një vend gjithënjë më të madh në veprimtarinë e De Radës.

Më 1868, ai mori drejtimin e gjimnazit italisht të Koriliano-Kalabros. Në këtë detyrë, qëndroi afër dhjetë vjet. Me materjale të vjetëruara, De Rada themeloi aty një shtypëshkronjë të vogël, në të cilën botoi veprat e tij të reja, si dy librat e para të poemës epike «Skënderbeu i pafan» (1873), dhe rishtypi ndonjë vepër të tij të mëparëshme.

Viti 1878 e gjen në Maki pa punë. Ai ndjek së afërmi zhvillimin e ngjarjeve politike dhe proteston energjikisht kundër sakatimit të tërësisë tokësore të Shqipërisë, mbështet kërkesat kombëtare të Lidhjes së Prizrenit. Atë vit, fatkeqësi të rënda familjare zunë t'i bien mbi kokë,

pushój discharge
i padítur accused
end weave; wander
vjetërsí antiquity
rumún Romanian
dashamír well-wisher
i vjetërúar used; old
i pafán unhappy
sakatím crippling; dismemberment
fatkeqësí misfortune



Anno I. | Corigliano Calabro, 20 Luglio 1883. | Num. 1

FIAMURI ARBËRIT

LA BANDIERA DELL' ALBANIA

PUBBLICAZIONE PERIODICA MENSILE

PER CURA D'UN COMITATO DI SIGNORI D'ALBANIA E DELLE SUE COLONIE

ABBONAMENTO ANNUO

Per l'Italia . . . . . L. 3,00

per l'Estero . . . . . » 6,00

Non si restituiscono i manoscritti.

10.— Revista «Fjamuri Arbërit» Corigliano Calabro 1883.

duke i vdekur njeri pas tjetrit të katër djemtë, pastaj e 'shoqja dhe i vëllai. Pikëllim të veçantë i shkaktoi vdekja e djalit të madh, Zefit (1883), tek i cili kishte vënë shpresa se do t'ia zinte vendin si letrar e militant i luftës politike për çështjen shqiptare (2). Po as këto mënxyra as shtrëngesat ekonomike që i nisën këtë kohë dhe e munduan gjer në çastet e fundit, nuk e prapsën dhe s'e bënë dot të heqë dorë nga ideali i tij. Ai e shtoi edhe më shumë veprimtarinë letrare e politike.

Më 1883 nisi të botojë një revistë letrero-politike shqip dhe italisht «Fjamuri Arbërit», të cilin e bëri tribunë të çështjes sonë, vatër të forcave patriotike shqiptare. Nëpërmjet revistës, ai përforcoi e zgjeroi lidhjet me atdhetarët shqiptarë të ndodhur në vende të ndryshme, luftoi synimet e huaja ndaj Shqipërisë, demaskoi qëllimet e shovinistëve

2) Zefi kishte hartuar bashkë me t'anë një gramatikë të shqipes, të cilën e botoi në Firencë më 1871. Vepra ka një interes të veçantë, si e para gramatikë e të folmeve arbëreshe të Italisë.

mënxýrë = mynxýrë calamity
shtrëngésë squeeze
të héqë dórë renounce
demaskój unmask

ballkanas dhe të imperialistëve austriakë. De Rada s'ngurroi të dënojë dhe politikën italiane ndaj Shqipërisë. Ja ç'thotë në artikullin «Shqipëria dhe gazetat italiane»:

«Me t'u bashkuar krahinat e Italisë, në fletoret e asaj pjese që mori në dorë frenat e këtij bashkimi, pasqyrohej e pasqyrohet akoma dëshira e Italisë për të vënë këmbë në bregdetin e Shqipërisë, nga frika se mos e vërë më parë Austria e i zë diellin... Jo vetëm që këto gazeta nuk thonë asnjë fjalë të mirë për ne, po, me të parë se fillon të duket ndonjë çikë tym në lindje, të gjitha njëzëri i urojnë suksese Greqisë e Malit të Zi, që, të bashkuar, duan të copëtojnë Shqipërinë. Unë do të thosha se Italia ose është e një mendimi me to, sepse i janë zotuar për ndonjë copë të Shqipërisë fatkeqe, ose... e shikon të mbyllur udhën e Austrisë në brigjet e Adriatikut. (3)

Synimet italiane kundrejt Shqipërisë, De Rada i dënoi që me çfaqjen e tyre të parë, sikur shihet nga korespondenca e tij. Ai paralajmëron dashamirë e patriotë shqipëtarë për këtë rrezik. Qëndrimi i tij është dëshmi e patriotizmit më të pastër, e qartësisë dhe mprehtësisë politike të poetit.

«Flamuri Arbërit», pas tri vjet lufte, pushoi botimin për shkak të mungesës së mjeteve financiare të nevojshme dhe të pengesave që i sillnin qarkullimit të tij çensura greke e turke. Revista bëri një punë të madhe si në fushën politike ashtu edhe në fushën letrare.

Me ndërhyrjet e përpjekjet e tij të palodhura, u fut përsëri më 1899 mësimi i gjuhës shqipe në kolegjin e Shën Andrianit dhe De Rada u bë përsëri mësues i saj.

Vitet e fundit të jetës poeti i kaloi në vetmi dhe varfëri, veçse plot zjarr luftarak për çështjen kombëtare, me një veprimtari letrare akoma pjellore. Shtypi në këtë kohë një seri veprash me karakter historiko-gjuhësor, si «Pellazgë e shqiptarë», «Konferenca mbi gjuhën shqipe», «Karakteri dhe gramatikë e gjuhës shqipe», një antologji shqipe, shkrimin autobiografik me titullin «Autobiologjia». Përveç dy librave të fundit të «Skënderbeut të pafan», ai bo-

3) Shuteriqi, Hist. letër. Shqipe, fq 72.

fletóre newspaper
fre rein
i zë diéllin shuts out the sun
njëzëri with one voice
paralajmërój warn
luftarák militant
pjellór fruitful

ERIC
Full Text Provided by ERIC

ARTI DHE RËNDËSIA E VEPRËS SË DE RADËS

Vepra e De Radës lindi e u zhvillua në klimën e romantizmit dhe, me tiparet e saj kryesore e shumicën dërmuese të elementeve të saj, hyn në këtë rrymë letrare. Me romantizmin kuptohen e shpjegohen frymëzimi, përmbajtja e forma e saj. Ajo i përket kryesisht romantizmit përparimtar, duke u frymëzuar nga ideja personale e poetit dhe nga idealë e lëvizjes kombëtare të popullit tonë. Ngjarjet e poezive të tij, De Rada i vendosi kurdoherë në gjysmën e parë të shekullit KV, në kohën e luftërave të popullit tonë kundër turqëve, dhe u përpoq të ringjallë me artin e tij një epokë aq të lavdishme të historisë sonë, me skenat e çastet më dramatike e epike të saj, për të forcuar krenarinë e vetëdijën kombëtare ndër bashkatdhetarët e për të afirmuar para botës të huaj të drejtat e Shqipërisë. Idejenja e atdheut e përshkon gjithë botën poetike të tij. De Rada ia kushton jetën çështjes kombëtare, krijimit të një letërsie artistike kombëtare shqibe, misionit të realizimit të Rilindjes së Shqipërisë. Besimi në këtë mision që i kishte caktuar vehtes ishte aq i ngulët, pa në 70 vjet veprimtarie s'e harroi asnjëherë. Për ta kryer pa më mirë, ai u bë filolog, historian, publicist.

Figura e De Radës ngrihet lart si figura më e kulluar, më e fuqishme e letërsisë arbëreshe, e botës arbëreshe, si një nga figurat më të bukura të Rilindjes sonë. Ai luftoi pa u epur kundër çdo armiku të çështjes sonë kombëtare, kundër politikës së shovinistëve ballkanas e në mënyrë të veçantë grekë, që donin të mbytin lëvizjen kombëtare të popullit tonë, kundër imperializmit austriak, po edhe kundër imperializmit italian. Ai ka meritën të ketë diktuar që herët tendencat imperialiste të borgjezisë italiane ndaj Shqipërisë, t'i ketë demaskuar me kohë ato.

De Rada i vuri themelet letërsisë sonë të re, një letërzie artistike me frymë kombëtare. Ai e mbështeti krijimtarinë e tij letrare në poezinë popullore, në atë të arbëreshëve të Italisë, dhe hapi kështu një rrugë të re që do të ndiqej edhe nga poetë të tjerë. Është i pari që paraqiti në letërsinë shqipe figurën epike të Skënderbeut si simbol të shpirtit liridashës e heroik të popullit tonë.

shpjegój explain

Krijimet e ndryshme poetike të De Radës janë të një poeti të madh romantik, karakterizuar nga një orgjinalitet i fuqishëm i koncepteve, përfytyrimeve dhe mjeteve letrare. «Milosaoja» me lirizmin e thjeshtë bukolik që e përshkon, mbetet nga poemat më të freskëta të letërsisë sonë. Me veprat e tij të tjera, De Rada na la një galeri të pasur tipash, episode epike nga më të fuqishmet, skena të një dramaticiteti të fortë ose të një lirizmi prekës a të gëzueshëm Ai u shqua si përshkrues i hollë i natyrës dhe i psikologjisë njerëzore. Po veprën e tij poetike e dëmtuan mjaft inorganiciteti e fragmentariteti, prirja për shtjellimet diskorsive letrare, filosofike, politike, stili eliptik që përdori dhe gjuha e papunuar e dialektit të tij arbëresh.

Shprehja e De Radës bëhet shpesh e errët, e pshtjellur, të folurit shpesh alegorik, me stërhollime mendimesh e figura të guximëshme, ndonjëherë të pakuptueshme e të çuditëshme (41). De Rada shkroi në të folmen e fshatit të tij, të cilën u përpoq ta pasurojë dhe ta ngrejë në një gjuhë letrare. Po s'qe dorëmbarë në këtë punë. Poeti mblodhi me zell fjalë e fraza shqipe të rralla, u tregua i rezervuar ndaj kalabrizmave të gjuhës së folur, po e bëri të ashpër dhe të vështirë gjuhën e tij me shprehjet e vrazhda që përdori shpesh, me neologjizmat që krijoi pa shumë kriter dhe sidomos me ndërtimet e spërdredhura, me periudhat e këputura (42).

Edhe vargënimi i De Radës paraqit një fizionomi të veçantë, shpesh të parregullt. Duke ndjekur poezinë popullore, ai përdor tetërrokshin e përzier me gjashtërrokshin, pa rimë e pa strofa. Monotoninë e njëtrajtësinë e masës e thyej në ndonjëherë këngëzat, pjesët lirike që fut auktori vendevende dhe që zakonisht janë të hartuara në njëmbëdhjetërrokësh.

41) M. Marchianò, Giovani Uniade, canto inedito di G. De Rada, Trani 1902. — parathënie.
42) Petrotta, Pop., lingua e let. alb., fq. 268.

fuqizój strengthen
i ngúlët persistent
épem bend; yield
diktój detect
që hérët from the start
me kóhë very early
liridáshës freedom loving
përfytyrím image; imagery
bukolík bucolic
prékës touching

Studiues të ndryshëm kanë vënë në dukje parregullsinë dhe të metat teknike në ndërtimin e vargjeve të De Radës. Markianoi shkruan: «*Më kot do të kërkoje një ligjë rregulluese të këtyre vargjeve, pse ka nga tërë tipet dhe nga tërë llojet, që ose largohen nga vargjet italiane të së njëjtës masë ose (kjo ndodh rrallë) përputhen me to*» (43). Kjo parregullsi e vargjeve për nga ana e rrokjeve, duket se vjen, si e vë në dukje Sqiroi i Ri, nga që «*parimi themelor deradian, s'ianë njësija silabike e theksi, po ritmi, i cili duhet riprodhuar me një lexim të përshtatëshëm*». De Rada shkroi kryesisht sipas metrikës së këngëve arbëreshe. «*Kush ka pasur fatin*, vazhdon Sqiroi i Ri, *të dëgjojë këngëtarët popullorë që lulëzojnë në fshatrat arbëreshe të Kalabrisë, mundet lehtë t'i rindërtojë e t'i deklamojë vargjet e De Radës. Del nga kjo një lexim stentorian, që mbush rrokjet e meta me zgjatime të përshtatëshme zanoresh dhe sidomos me mundësinë për të shqyptuar zanoret e pazëshme, kur mungojnë, ose për të mos i shqyptuar, kur ato janë*» (44).

Ndikimi i De Radës qe i madh mbi poetët e shkrimtarët arbëreshë. Ndikimi i tij i drejtpërdrejtë mbi shkrimtarët e Shqipërisë qe i kufizuar, po jo pa rëndësi. Ai dha i pari shëmbëllën e një letërsie me frymë kombëtare, që këndon të kaluarën për të ngritur lart ndjenjën kombëtare. Pa dyshim De Rada ka ndikuar që fytyra e Skënderbeut dhe koha e tij të zërë një vend të shënuar në letërsinë tonë të Rilindjes.

Botimet folkloristike që bëri ai, u hapën rrugën botimeve folkloristike ndër ne dhe qenë një nxitje për patriotët tanë të Rilindjes, që iu përveshën mbledhjes së folklorit. Idetë e veprave të tij gjuhësore e historike gjetën përhapje të gjerë ndër rilindësit, si te Samiu, Naimi etj.

Veprat poetike e veprat e tjera, të shkruara shqip me përkthim italisht ose vetëm italisht, revista «Fjamuri Arbrit», veprimtaria e tij e palodhur, lidhjet me njerzit më të shquar të botës letrare, shkencore, politike të kohës, bënë një punë të madhe për njohjen e propagandimin e popullit tonë e të çështjes sonë kombëtare në gjithë Evropën.

13) Marchiano, L'Alb. e l'opera di De Rada, fq 186.

44) G. Schirò Junior, Storia della letteratura Albanese, Milano 1959, fq 149.

inorganicitét e fragmentaritét inorganic and fragmentary in character
i pshtjéllur = i pështjéllur entangled; muddled
stërhollím excess
dorëmbárë lucky
zell zeal
kalabrízëm word or phrase of the Calabrese dialect
i vrázhdë rough
i spërdrédhur twisted
vargëním = vargëzím versification
i parrégullt disorderly
tetërrókësh octameter
gjashtërrókësh hexameter
strófë stanza
njëtrajtësí sameness of treatment
njëmbëdhjetërrókësh eleven foot line of verse
kánë vënë në dúkje have made known
parregullsí disorderliness
deradián of de Rada
theks accent

Gjykime nga më admirueset u dhanë për të dhe veprën e tij, ndonjëherë edhe nga njerzit më të njohur. Revista folkloristike «Melusinë» e Parisit, profesori Kurt Hassert Universitetit të Tubingut në Gjermani, e quajtën *«Orfeun bellazg dhe Homer shqiptar»*; S. Mylleri, *«Makferson të Shqipërisë»*; Buholc shënon se ai ka koncepsione të denja për Eskilin e Shekspirin; Dora d'Istria shkruan se *«poezitë e tij janë agimi i ditëve të lumtura të Shqipërisë»*.

"Jeromim de Rada" in Dh.Sheterigi et al (Eds.) Historia e letërsisë shqipe II Tiranë, 1959, pp.58-68, III-114

deklamój recite
rrókje metrical foot; syllable
i métë deficient
zanóre vowel
shqyptúar = shqiptúar
iu përvéshën mblédhjes set out to collect

LEXIMI I TETEDHJETENJETE

ÇEZMA E FLORIRIT

(Dashuria e Kaçakut)

Po ta soditësh Voskopojën që nga kodrat e Shëndëllisë ose të Shënprodhromit, shpirtin ta kllapon një ndjenjë trishtimi, tek e shikon ashtu gur mbi gur, të lënë e të harruar, të mplakur dhe të fishkur para kohe nga rrebeshet dhe nga luftimet që i kanë rënë mbi krye. E sado që të mundohesh të ngjallësh me mend atë kohë kur Voskopoja ishte qytet i bukur dhe i lulëzuar, nuk do t'ja arrish dot qëllimit. Tani, në vend të tri mëhallëve me shtëpi të larta, ndërtuar me gurë të bardhë e të skalitur, do të shikosh togje gërmadhash; në vend të kopshteve të bukura plot lule, do të shikosh livadhe të lëna djerrë. Vetëm rrugët e gjera e të drejta, të shtruara me kalldrëm, e kanë ruajtur gjer në ditët tona formën dhe bukurinë që kanë pasur një kohë, po nëpër rrugë më nuk ndihen, si dikur, as të thirrurat e karvanarëvet e as tringëllimat e ergjendta të zileve të mushkave; tani rrugët janë fare të qeta e bari po i mbulon dalëngadalë, sikur përpiqet të fshehë nga sytë e njerëzve edhe kujtimin e fundit të asaj kohe.

Voskopoja, qendra e bukur e dikurshme, vendi i dyzet kishave të ndërtuara e të zografisura prej mjeshtërve më të mëdhenj të asaj kohe, tani është katandisur një fshat i vogël malor, e aq sa dikur paskësh kisha, sot mezi i ka shtëpi.

çézmë fountain
florí gold
kaçák outlaw; fugitive; freedom fighter
sodít contemplate
kllapós devour
trishtím sadness
i mplákur aged
i físhkur wilted; shriveled
rrebésh upheaval; calamity
mëhállë neighborhood
tógje (tog) heaps
gërmádhë ruin
i djérrë uncultivated
kalldrëm cobblestone
karavanár person in a caravan
i zografísur painted
aq sa...shtëpí it barely has as many houses today as it once had churches

S'mbahet mend sa herë është prishur e sa herë është djegur! E përvëluan turqit në kohët e para; e rremetisi tërmeti më vonë; e zhuriti greku dhe më së fundi e shkrumbiti edhe Italia me zjarr e me hekur.

Veç ne verë Voskopoja edhe tani gjallërohet. Atëhere, në kodrat që gjinden përreth, bari gjelbëron; pishat krenare, që ngrehin kryet përpjetë, janë të lumtura tek dëgjojnë së bashku me cicërimat e zogjve edhe cicërimat e pionierëvet, që vijnë për të veruar, dhe pyjet e krojet bëhen dëshmitarë të hargalisjeve të rinisë, të pëshpëritjeve në mugëtirën e mbrëmjes dhe të puthjeve të fshehta. Dhe gjer natën vonë, nga kampet verore të pushimit, përhapen tingujt e një muzike plot jetë e gjallëri.

Ka e s'ka fshatra me kroje, po kroje si ato të Voskopojës nuk gjen gjëkundi. Të duket vetja sikur je në mes të një shatërvani dhe ta kënda të pulitësh sytë e të ëndërrosh, të ëndërrosh...

E kush ua di numrin burimeve e krojeve të Voskopojës? Shtrugu i Vogël, Shtrugu i Madh, Zhombri, Pashuta, Burim'i Thanasit, Kroji i dembelit, Çezma e Bezhës, Çezma e floririt dhe sa e sa të tjera! Këto sikur kanë mbetur kastile nga ajo kohë e largët, dhe me gurgullimën e këngës së tyre kanë mall të tregojnë ngjarje të lashta dhe lavdinë e kaluar, që iku e u tret si tymi në qiellin e kaltër.

Çezma e floririt! Ah, pse s'i thonë më mirë çezm'e trëndafiles, çezma e vajzës që u bë kurban në të!

Çezma gjendet anës një përroi, përfund të një livadhi, e fshehur, e tulatur, si e hequr mënjanë dhe aty pranë, si dy roje, rrinë e i bëjnë hije dy shelgje pleq.

Po të shikosh me vërejtje brenda në burim, ke për të parë disa grimca të vogla si flori i ronitur, të cilat, të përkëdhelura nga drita e Diellit, shkëlqejnë e vezullojnë si kristale dëbore. Thonë se janë grimca prej gjerdanit të gushës së asaj fatzeze. Dhe ujërat e burimit rrjedhin e rrjedhin vatëpjetë, duke kënduar të njëjtën këngë, të ëmbël e perkëdhelëse. Dhe natën Hënëza shikohet në burim si në pasqyrë e burimi ndriçon, ndriçon e gjithmonë vazhdon të këndojë këngën e pambaruar e të për-

prish destroy
rremetís turn to rubble
tërmét earthquake
zhurít scorch
shkrumbój incinerate
krúa = çézmë
hargalísje laughter
shatërván decorative fountain
ta kënda you feel like
pulít blink
kastíle on purpose
gurgullím gurgling
tret dissolve
kurbán sacrifice
i tulátur huddled up
rójë guard
shelg willow
i ronítur worn away; worn out
vezullój glitter
gjerdán necklace
gjerdán të gúshës choker

jetshme dhe në këtë këngë sikur nanuriset tregimi për dashurinë e një kaçaku.

* * *

Dyqind e ca vjet përpara Voskopoja ishte qyteti më i dëgjuar në këto anë. Këtu kryqëzoheshin asokohe karvanet e tregëtarëvet, që vej'e vinin nëpër rrugët e pamatura të perandorisë otomane. Atëhere qyteti kishte shumë shkolla, shtypshkronjën e tij dhe një Akademi.

Verës, tregëtarët e pasur dhe ata që e kishin xhepin të ngrohtë, vinin të argëtoheshin e të dëfrenin në këtë vend klimaterik, të rrethuar nga të gjitha anët me male të larta, ku ajri i pastër bie erë trëndelinë dhe rrëshirë. Po a thua se vetëm era e borigave dhe tufat e trëndelinës grishnin bandillët nga ana e anës? Jo, mor, jo, se boriga dhe trëndelinë kish edhe gjetkë, po se ky vend na rriste ca sorkadhe, që aman aman, të lije mëndtë e kokës! E, se ka pasur gjithmonë vajza të bukura shtatbilonja, pa kanë dalë dhe gjithato këngë për voskopojarkat.

Mos vallë ujërat e burimevet ose era e trëndelinës i bën kaq të mira? Ku ta dish? Ndofta edhe njëra, edhe tjetra...

Vjete të shkuara, në qytetin e Voskopojës, më e bukura nga gjithë të tjerat e përmi shoqet paska qenë kjo çupa e Dhaskal Sotës. Dhe aq të bukur e kishte emrin sa ç'ishte dhe vetë. Trëndafile e quanin, dhe emër më të përshtatshëm s'mund t'i gjeje. Faqet e saj qenë të kuqe e të mbuluara me push të hollë si ato pjeshkët në qershor. Dhe kur kthehej vajza nga burimi, ngarkuar më kënaçe, atëhere përmbi pushin e faqeve i ndritnin pikëzat e imta të djersës e dukeshin si vesa e mëngjezit mbi fletët e trëndafilit. Gushën e bardhë ja stoliste një gjerdan floriri. Dy gërsheta i derdheshin prapa që nga cepi i lahurisë qëndisur me oja e me zhizha, e i arrinin gjer te beli. Pa, kur shkonte ajo sokakut, majërat e gërshetave luanin

nanurís soothe
vej'e vínin came and went
argëtój amuse
dëfréj entertain
klimaterík climatic
trëndelínë trigonella
rrëshírë resin
borígë spruce
grish invite
bandíll playboy; philanderer
kish edhé gjétkë could be found elsewhere
sorkádhe doe
amán amán boy oh boy
mëndtë = méndtë
shtatbilónjë statuesque
voskopojárkë woman of Voskopojë
përmi = përmbi above
push tint
pjéshkë peach
kënáçe jug
gërshétë braid
lahurí fringed kerchief
ójë lace
zhízhë sequin
bel waist
sokák street

valle e kërcenin. Dhe për gjoksin e saj ç'të të them? Të bardhë si dëbora e të fortë si shegë.

Babai e kishte të vetme dhe e donte e e donte si dritën e syrit. Kur sillte ndër mend se po i afronte koha vajzës e një ditë duhet ta martonte e të ndahej nga ajo, atëhere pikëllohej dhe një e therur i kalonte tej e përtej. Si do t'i dukej shtëpia pa Trëndafilen, si do të ulej në tryezë e si do t'i shkonte ajo bukë, pa e pasur dritën e syve aty pranë?

Po vjen një ditë që pjeshka, e pjekur dhe e mbushur plot me lëng, del nga fletët e pemës ku qëndron fshehur, e, duke zbuluar gjithë bukurinë e saj, duket sikur i thotë udhëtarit, që kalon aty pranë: «Këputmë e futmë në gji!» Dhe sado e rëndë që të jetë ndarja e këputja nga pema, ajo e pret atë ditë me një gëzim të përmbajtur. E në mos e këputtë njeri, ajo pikëllohet, tretet e bie vetë në tokë. Oh, po ta dini, more shokë, sa e hidhur e sa e dhimbshme është kjo rënje!

Dashurinë s'e kish njohur Trëndafilja dhe jastëkun nuk e kish lagur natën me lot të nxehtë, nga gëzimi i takimit a nga malli i ndarjes. Ajo i donte të gjitha me një dashuri naive e fëmijërore. Ajo donte edhe nënën, edhe babanë, edhe saksitë me karafile, edhe kecërit me ato leshra të buta si kadife, por dashurinë e madhe akoma s'e pat njohur e zemra për trimin s'i kishte rrahur.

Një herë, veç një herë, kur Trëndafilja ishte njëmbëdhjetë-dymbëdhjetë vjeç, qe tronditur dhe kish mbetur si e mbërthyer në vend nga vështrimi i syvet të një kaçaku, që pat ardhur në shtëpinë e tyre.

Ai ishte ndeshur ballë për ballë me të në krye të shkallëve dhe që andej i kishte thërritur Dhaskal Sotës:

— Jotja kjo çupë, o Dhaskal?

— Imja — i qe përgjegjur ai.

— Shiko ma ruaj mua këtë, se e paske shumë të bukur. Ta dish, po s'ma dhe, do të ta rrëmbej — dhe, si kishte thënë këto fjalë, përsëri kish vështruar me ata syt e tij të zjarrtë Trëndafilen, që rrinte si e zalisur mbështetur pas parmakëvet.

Ajo në fillim e pa me frikë e pastaj me inat, si gjithë

shégë pomegranate
e thérur cutting pain
tej e përtéj through and through
lëng juice
këpút pick
këpútje picking
rënje = rënie falling
jastëk pillow
saksí flowerpot
karafíl carnation
kadifé velvet
rrëmbéj kidnap; seize
i zalísur fainted
parmák bannister

vajzat e vogla, kur u zënë ngoje punë martese. Dhe nga turpi u bë në fytyrë si ato lulekuqet e arave. Ndënji atje në krye të shkallëve me kënaçen në duar dhe me ndrojtje në zemër se mos kaçaku kthehej e thoshte edhe ndonjë fjalë tjetër.

Po kaçaku s'tha asgjë më tepër. Veç, kur i kaloi përpara, u mat e zgjati dorën si të donte ta përkëdhelte në faqe, pastaj u pendua, dora e zgjatur u ngrit gjer në takije, si për ta përshëndetur, i buzëqeshi krenar dhe zbriti tatëpjetë shkallëve. Xhufka e zezë e takijes i tundej me fodullëk mbi mëngoret e anterisë dhe maja e myllit, që i arrinte gjer te kocinari i këmbës, i kërciste duke u përpjekur pas basamakëvet të shkallës. Pastaj kaçaku ju afrua doriut, i kërceu mbi shalë dhe kali, duke ndjerë se kishte përpara rrugë të gjatë, hingëlliti e turfulloi. Patkonjtë e doriut nxuarën shkëndija kur u përpoqën në kalldrëmin e oborrit e doriu me kalorësin u nisën si shigjeta në shenjë. Trëndafilja pa vetëm xhufkën e takijes që u tendos prapa si pendë shqiponje dhe pluhurin e hollë e të verdhë që ngrihej atje ku shkelte kali. U duk jo sikur iku, po sikur kish fluturuar. Dhe oborri mbeti i qetë e i shkretë dhe Trëndafilja ndjeu se diçka i mungonte dhe atë që i mungonte ju duk se ja kish marrë ai kaçaku me vete. Ah, po, ai i kish rrëmbyer zemrën.

* * *

Kish pritur ato ditë se mos e shikonte, por më kot: kaçaku s'ishte dukur. Dhaskal Sota mbante lidhje të ngushta me kaçakët që kishin ngritur krye kundër Turqisë dhe ata hynin e delnin atje si në shtëpinë e tyre. Shumë vinin, shumë iknin, veç «ai» s'dukej.

Trëndafilja i shikonte me bisht të syrit. Ajo dëshëronte të pyeste për atë, të dinte prej nga ishte e ku ndodhej tani, po ku i gjenden gjurmët kaçakut e si të pyesësh për një njeri që nuk i di as emrin?

lulekúq poppy
ndrójtje apprehension; fear
mútem attempt
takíje skull cap
xhúfkë tassel
fodullëk boastfulness
mëngóre embroidered sleeved waistcoat
anterí waist-long jacket
myll scabbard
kocinár ankle
basamák railing
dorí roan horse
shálë saddle
hingëllín neighs
turfullój snort
patkúa horseshoe
nxúarën = nxórën struck; caused to emerge
shkëndíjë spark
shénjë target; mark
tendoś straighten out

Kaluar vjete dhe tronditja e parë e Trëndafiles kish mbetur si një vegim i largët dhe nuk e dinte në i kish ndodhur vërtet apo e kish parë ëndërr. Ajo punonte gjithë ditën e duke punuar, qeshte e këndonte e tok me të qeshte gjithë shtëpia, qeshnin edhe saksitë e luleve, qeshnin edhe ujërat e burimeve, që gjendeshin aty në përrua. Veç në mes të këtij gëzimi të thjeshtë e të kësaj qetësie shpirtërore, xheku i kujtohej kaçaku dhe e merrte malli për atë vështrimin e tij fodull e çapkën.

E ku t'i shkonte asaj në mendje se një ditë do të takohej me të papritur e papandehur! Po jeta kështu e ka: herë na rrëmben lumtërinë që kemi në duar dhe herë na e sjell këtë lumturi nga an'e anës, në mënyrë të pakuptuar.

U ndodh një pasdreke në burim e, tek po mbushte ujë, dëgjoi trokun e një kali, që ngjitej shtegut të përroit. Vajza vazhdoi të mbushte ujë dhe as e ktheu kokën ta shikonte, kurse kalorësi, me t'u afruar në burim, ja shtrëngoi frerin kalit dhe ja mbajti vrapin.

Shikon kalorësi në burim, si në pasqyrë, fytyrën e vajzës dhe habitet. A është vasha me të vërtetë kaq e hijshme sa ç'e tregon burimi apo ujërat e gënjejnë? Ai kërkon t'i shohë fytyrën, ndaj i flet pa zbritur nga kali:

— E kujt je, moj gjeraqinë?

Vajza nuk i përgjegjet. Faqet i skuqen prej turpit, ngreh pakëz kokën e i hedh një vështrim vjedhurazi kalorësit. Atëherë, padashur e pa e kuptuar se përse, një drithërimë i përshkoi gjithë shtatin. Ju duk sikur atë vështrim krenar e çapkën dikur e kish ndeshur, sikur ata sy diku i kish parë... «O zot, mendoi, mos është «ai»? Dhe... kur i njohu në faqen e djathtë atë nishanin e zi, atëherë gjithë dyshimet ju daravitën e ju duk se zemra do t'i fluturonte nga krahërori.

Trëndafilja e kryqëzoi edhe një herë vështrimin me kalorësin, psherëtiti lehtë-lehtë e përsëri uli kokën. Bucelat, të mbushura me ujë, po prisnin aty në diell e Trëndafiles nuk i bënin duart t'i merrte e të ikte. Ajo, me merak në zemër, mendonte: «Vallë, a do të më njohë»?

Kalorësi qëndronte hipur në kalë. Takijen e kuqe me

trondítje stirring
vegím apparition; dream
xhéku now and then
fodúll boastful; proud
çapkën rascal
papandéhur without warning
trok trot
shteg path
shtrëngói pulled in
fre rein
gjeraqínë fast-moving woman; falcon
pákëz a little
drithërímë thrill; trembling
nishán mark; token; target
daravít clear up
bucélë cask
nuk i bënin dúart lacked the strength
merák anxiety

Kaçaku inbeti ngushtë, ngriti dorën, përkëdheli atë baluken që i kishte dalë nga takija dhe i foli:

— S'qenke vetëm e bukur, po qenke dhe e zgjuar, moj sorkadhe e malit. Ta dish që unë s'do të të ndahem ty...

Psherëtiti Trandafilja e, duke përmbledhur gjithë fuqitë e saja, guxoi të thoshte:

— Pa kujtoju mos i ke dhënë fjalën ndonjë tjetre.

Ngriu kaçaku në vend dhe më t'ju errësua ai vështrimi i syve të zez dhe një re trishtimi i kaloi përmbi ballë. Dielli perëndoi prapa malit e pylli i pishave përkundrejt u duk më i errët e hijerëndë. Ranë kambanat e kishës së Shënprodhromit e dy harabela të trembur erdhën e u tulatën në fletët e shelgjevet. Kaçaku e ndjeu që e humbi davanë dhe, duke tundur kokën, foli ngadalë:

— Ikë, moj fëllënzë, ikë; po ta dish që s'do te te ndahem. Unë do të të rrëmbej — do të të hedh në vithe të kalit e do të të shpie në kaliven time.

Trëndafilja ju përgjegj me krenari:

— As më rrëmben dot e as më prek dot, Unë jam e bija e Dhaskal Sotës.

Atëhere kalorësi ndëjti i menduar, fërkoi me gishtërinj majën e mjekrës dhe, duke kujtuar atë vajzën e mitur të Dhaskal Sotës, që e kish takuar në parmakët e shkallës, i tha:

— Dhaskal Sotą një vajzë që ka, e ka akoma të voger. — Shikoi sytë e Trëndafiles; shikoi edhe gushën e saj edhe sikur u përmend. Ishin po ato tipare të asaj njomëces, veç më të pjekura, më të gjalla e më të ndezura nga gjaku i rinisë, që i vlonte ndër deje. — Po në është e vërtetë ajo që the, dije se atëhere je e zgjedhura ime.

Vajza vuri buzën në gaz e i kërkoi bucelën.

— Merre bucelën, po unë një nishan e dua që ta quaj veten të fejuar me ty...

— S'kam çfarë të të jap.

— Nëmë unazën tënde, që ta kem peng për dashurinë tonë e të të përgjërohem se unaza do të më dalë nga gishti atëhere kur të më dalë edhe fryma e fundit.

Trëndafilja shikoi duart e saj, fërkoi unazën me gisht

hijerëndë grave
harabél sparrow
tulátem cuddle up
davá case; lawsuit
víthe rump; buttocks
kalíve hut
síkur u përmënd began to recall
njómce little one
déje (d l) veins
nishán token of engagement; mark
peng p edge; hostage
përgjër hem swear

e sikur u mat ta nxirrte. Pastaj tundi kokën e i foli kaçakut e vendosur:

— S'ta jap dot, o trim i malit. Po të më pyesin në shtëpi pse s'e kam unazën, çfarë t'i them nënës, çfarë t'i them tatës?

— Thuaji nënës që të humbi, tek po mbushje ujë.

— Jo, o trim, s'i gënjej dot, se jam vajzë shqiptare.

Kali hingëlliti sikur kjo përgjigje ta kishte gëzuar, kurse kalorësi psherëtiti.

— Nëmë byzylykun e dorës...

— Jo, o trim, nuk ta jap dot. Kot e ke që më vardisesh.

Sa më shumë krenare që tregohej vasha, aqë më shumë i pëlqente kaçakut. S'ish vetëm e bukur, e zgjedhur e tij, po qe edhe trime.

— Nëmë gjerdanin e gushës. Do ta mbaj si hajmali; ja këtu, në gjoksin tim.

— Jo, o trim, nuk ta jap dot. Në më pyestë nëna, në më pyestë tata, si t'i them unë e shkreta?

— Thuaju tek mbushje ujë, ta rrëmbeu shqiponja e malit.

— S'jam e zonja të gënjej, o trim se me të hapur gojën e di që do të më kuptojnë. Dhe po qe se ti më do vërtet, ashtu sikurse thua, atëhere nuk më mëson t'i gënjej, se sot gënjej ata e nesër ty.

Kjo përgjegje më shumë e gëzoi se sa e çuditi. Ai hapi krahët e thërriti:

— Të gjeta ashtu si te endërroja, moj drenushe. Tani, në daç më jep nishan, në daç mos më jep, ti je imja që tani e gjer sa të më regëtijë zemra në krahëror. Betohem, për tokë e për qiell, se nuse tjetër nuk e kapërcen pragun e shtëpisë sime. — E, duke thënë kështu, bëri dy hapa përpara, i mbërtheu të dy supet e Trëndafiles, që dridhej e tëra si fleta e plepit, e tërhoqi pas vetes dhe e puthi me afsh e me zjarr si natën e parë të martesës. Dhe Trëndafilja, mbështetur kokën në gjoks të tij, qante. Qante nga gëzimi, nga dashuria, nga diçka që e ndjente thellë në shpirt, po s'e dinte si ta shfaqte. I

vardísem importune; beg
hajmalí amulet
në daç if you like
regëtís expire
betóhem swear
plep poplar
afsh passion

dukej sikur duke qarë fliste e sikur lotët e saj thoshin të atilla gjëra, që as goja e as zemra s'i shfaqnin dot.

— Pse qan, moj bukuroshe? — e pyeti kaçaku, duke ndjerë një dhembje në shpirt dhe duke mos ditur në kish bërë mirë a keq që ish sjellë kështu me vashën.

— Qaj, se të kam pritur... — ju përgjegj ajo.

Trëndafiles i shkonin lotët çurg dhe donte të shtrëngohej pas tij, se i dukej sikur gjente mbrojtje e përkrahje, nga një e keqe që i kanosej. Duke futur kokën në gjirin e tij, ndjente atë erë e atë amëz të vecantë, që kishte trupi i kaçakut.

Ai ja fshinte lotët, që i shkisnin nëpër faqet, me mëngën e bardhë të tallaganit e mezi mundi ta pushonte. Pastaj të dy u ulën rrëzë shelgut e kuvenduan gjerë e gjatë.

Aty muarrën vesh se që të dy e kishin dashur njëri-tjetrin, qysh atë ditën e takimit në parmakët e shkallës, dhe këtë çast të lumtur e kishin ëndërruar në këto vjet që kishin jetuar larg e larg.

Aty dëgjoi Trëndafilja fjalët e para të dashurisë, e, duke i dëgjuar, e ndjente zemrën të dehur e të velur nga lumturia; i dukej se ngazëllimi i buronte në shpirt si ujërat e burimit e zemra i thoshte se ky çast nuk do të kishte të mbaruar. Po kur hodhi sytë e pa në shalën e kalit dy jataganë që vareshin tatëpjetë dhe grykën e pisqollës, që dukej e kuqërremtë nga rrezet e diellit, atëhere gëzimi ju turbullua dhe u përmend.

— E përse i mban gjithmonë këta jataganë me vete? Trembem kur të shikoj kështu.

E trimi ju përgjegj krenar:

— Jam kaçak i malit. Dhe kaçaku pa armë është si luani pa kthetra e ca më keq akoma. E di si jemi ne kaçakët? Siç e thotë ajo kënga:

«Jastëk kanë gurët,
Për flënj kanë gunët,
Bie bora i mbulon,
Bie shiu i zbulon,
Bie dielli dhe i ngron...»

çurg waterspout; jetstream
përkráhje support
kanós threaten
ámëz scent; flavor
tallagán cape; cloak
múarrën = mórën
i déhur intoxicated
i vélur overfilled; brimful
jatagán scimitar
grýkë muzzle
pisqóllë pistol
i kuqërrémtë reddish
kthétër claw; talon
flënj blanket

Armët na duhen si buka e si kripa. Tani jemi pak, po kemi shpresë të bëhemi shumë, të ngrihemi të gjithë më këmbë, dhe atëhere Turku do ta kete keq. Madje, ai qysh tashti na e ka frikën, prandaj ka vënë koshadhet që të na ndjekin këmba-këmbës. Dhe përse na ndjekin? Se duam të jemi zotër në shtëpitë tona.

Tej luginat u errësuan dhe që andej dukej sikur dilte e shkiste vjedhurazi mëzgu i mbrëmjes. Ranë përsëri kambanat e manastirit të Shënprodhromit. Hënëza, lart në qiell, sa vinte bëhej më e ndritshme dhe drita e saj e ergjendtë mbuloi gjithë vendin. Fletët e shelgut fëshfëritnin nga flladi i erës dhe burimi dukej si i ndezur e sikur një tufë rrezatimesh të çuditshme e të padukshme e ndriçonin që poshtë ëmbëlsisht. Doli dhe mali i mbrëmjes, duke vezulluar midis drurëve të kreshtës së malit dhe atëhere, vajza u ngrit të ikte. Kur u ndanë ai e pyeti?

— Nesër a do të vish në burim?

— Do të vij dhe, e mjera unë, s'do më pritet gjer sa të ngryset.

Gjithë atë javë ata takoheshin te burimi, sa fillonte të ngrysej, dhe, aty prapa shelgjeve, putheshin e përqafoheshin plot dashuri, si dy zogj të lumtur. Dhe Hënëza në qiell e ujërat e burimit qenë dëshmitarë për dashurinë e tyre të pastër e të sinqertë.

Veç dashuria e lumturia e tyre qe e shkurtër: më e shkurtër se lulëzimi i trëndelinës në verë, më e shkurtër se jeta e manushaqes; ajo zgjati në jetën e tyre aq sa zgjat vetëtima.

Koshadhet e turqvet ndiqnin kaçakët shqiptarë dhe ai u nda nga ajo, duke i thënë:

— Kasollja ime nuk është aq e pasur sa e tyt eti, po dashuria ime do të të mbajë ngrohtë. A do të vish?

— Ku të duash ti do të vij; edhe në një shpellë mali, veç tok me ty të jem.

Kaçaku atëhere u nepua nga kali, i përkëdheli gërshetat, e puthi në buzë dhe i la fjalë se do të kthehej ta merrte pas një javë, kur të delte hënë re dhe ajo le ta priste aty në burim.

madjé furthermore
këmba-këmbës close on the trail
shkas glide
fëshfëríT rustle
i ndézur aflame
s'do më prítet I'll be so impatient
manushége violet
koshádhe patrol
hépem bend; bend over

Pastaj u nis për rrugë e u bashkua me shokët, që po e prisnin mbanë pyllit.

Iku, po më s'u kthye. U vra kaçaku në luftë kundër koshidheve të turqve dhe s'mundi ta mbante fjalën e dhënë. E vdiq me merak në zemër. Mbështetur në trungun e një pishe, u la amanet shokëvet që të vinin e t'i jepnin mandatën së fejuarës së tij, që po e priste me një bohçe në duar, në një nga burimet e Voskopojës. E kur po jepte frymën e fundit, ngriti sytë në qiell e pa si nëpër mjergull dy shqiponja, që endeshin lart, duke bërë rrathë të mëdhenj. Dhe atyre u la amanet:

«Moj shqiponja krahëbardha,
Hamëni, moj, ç'të më hani,
Vetëm sytë mos m'i shponi,
Se jam trim e më shëmtoni.
Në pyettë nën-ja për mua.
Ju t'i thoni, u martua.
Në pyettë se ç'muse mori,
Dy-tri plumba pas krahrori,
Në ju pyettë keq e keq,
Thojini, moj, ja tek vjen...»

Shikoi pishat e larta, ktheu fytyrën nga lindja, pa për të fundit herë Diellin, që po lindte dhe pastaj, si i lodhur e i kapitur, mbylli sytë përgjithmonë...

* * *

Dhe Trandafilja priti te burimi, sipas fjalës, të shtatën ditë gjer u err, por trimi nuk i erdhi. E priti ditën tjetër, sa leu dielli e gjersa majë kreshtës së pyllit doli drapri i hollë i Hënës, po kot: dhe, duke pritur, qante nga malli e nga dhembja e nga kobi i zi që ndjente, në zemër. Dhe kështu, duke qarë, e gjetën shokët e kaçakut, por ata s'i thanë gjë, se pandehën që dikush tjetër do ta kish lajmëruar, përpara tyre për mënxyrën që e kishte gjetur,

trung trunk
amanét mandate
mandátë bad news
bóhçe bundle
éndem soar; loiter
shëmtój make ugly or unattractive
Në ju pyettë keq e keq If she persists in asking
i kapítur exhausted
drápër sickle
kop calamity; disaster
mënxyrë = mynxyrë misfortune

kurse vajzës përveç zemrës së saj, s'i kishte thënë asnjeri. Dhe po kështu prit e qaj të nesërmen e të pasnesërmen. Lotët e saj shtonin ujërat e burimit dhe vaj'i saj drithëronte shelgjet, sa që ata, me zemrën të lënduar, ulnin degët përmbi Tr ndafilen dhe me gjethet e tyre mundoheshin t'i fshihnin lotët. Pa nga të qarët më ju tret gishti e i ra unaza, ju tret dora e i ra byzylyku, ju tret qafa, e m'i ra gjerdani. Ah ç'm'i ra gjerdani, ky gjerdan i gushës. në mes të burimit! Ra dhe u ronit e u shkri, sikur të paskesh qenë prej dëbore.

Dhe vasha qau e qau, sa u tret e sa u mblodh një grusht, e pastaj, kur ju duk se në ujërat e burimit pa fytyrën e kaçakut që e grishte duke buzëqeshur me krenari, nuk u mendua hiç, po u hodh e ra në fund të burimit, siç bie guri në pus. Ra e humbi. Pranë atij burimi, ku kish njohur lumturinë më të madhe, njohu edhe dhembjen më të thellë.

Atëhere, i ati i saj, Dhaskal Sota, për kujtim të së bijës, ndërtoi aty një çezmë, që gjendet edhe sot e kësaj dite.

Dhe tani, një herë në vit, ditën që ka rënë Trëndafilja në burim, thonë se fletët e shelgjeve, që gjenden aty pranë, frushullijnë me të madhe e burimi nxjerr një zë si të psherëtiturat e një vajze.

"Çezma e flririt" in Naum Prifti Tregime te zgjedhura, Tiranë, 1972, pp.20-32

trétem waste away; melt
ronítem wear away
pus pool
frushullíj rustle
të psherëtíturit sighing

ËNDËR INDUSTRIALE

1.

Fusha nënë shi,
Era me bryle shtyn druret,
Xhips i komitetit ndanë xhadesë...
Nesër
Në këte horizont të ftohtë si një frazë latine
Furrat martin do të vjellin fjalë të reja
Fjalë tymi,
Hekuri,
Shkëndijash;
Fjalë kuq e zi,
Nesër.

Do të ngrihet një qytet i ri.
Pa mure të lashtë,
Pa kisha e muze me antika:
Pa kështjellë me bedenë si dhembë pleqsh të renë
Dhe pa perendeshë mbrojtëse, klasike

2.

Ky do të jetë një qytet i hekurt,
Përmes tij s'do të marshojnë kurrë
T'armikut ushtarë,
Nga kullat e tij, s'do të ulen kurrë

ëndër = ëndërr
bryl forearm; elbow
xhips gypsum
këté = këtë (mp.)
fúrrat martín steel blast furnaces
shkëndíjë spark
muzé museum
bedén battlement
perëndéshë goddess
mbrójtës protective

Avujt kuq e zi
Dhe flamujt kuq e zi,
Ky qytet i shqiptarëve
Per shqipëtarët.
Dhe s'do të mbajë ay emra të bujshëm:
«Qyteti i diellit»
«Qyteti i parajsës»
«Qyteti i lumterisë»
Ky do të quhet thjesht:
Qytet i ri industrial
I R. P. të Shqipërisë.

3.

Ky qytet
Do të veshi kombinezonin proletar
S'do të gogësijë mbrëmjeve duke pirë çaj
I futur në pizhame
Në këtë qytet nuset s'do t'u çojnë fanatikeve
Virgjërinë
Si një reklamë të kuqe
Mes dritarve të bardha të dasmes.

Në kafenetë e këtij qyteti
S'do të kapardiset gjakmarësi
Me kobure në brez
Mustaqe të zeza mbi gojë;
Korenti
Çdo kalbësirë dhe ndryshk do përcëllojë,
Si çelik i shkrirë i ndritshëm
I pastër
Nderi proletar do rëzëllojë.

avuj (avull) vapors; steams
per = për (mp.)
ay = ai
parájsë paradise
kombinezón = kominóshe overalls
gogësít yawn
pizháme pajamas
virgjërí virginity
reklámë advertisement; store sign
të dásmes = të dásmës (mp.)
kapardísem strut
gjakmárës = gjakmárrës blood avenger
kobúre pistol
korént current
kalbësírë rotten; rottenness
ndryshk rusty; rust
përcëllój singe
i shkrírë molten; melted
rëzëllój = rrezatój

4.

Fusha plot pellgje
Era vërshellen e rreptë.
Ndanë xhadesë
Xhips i komitetit.
Vështroj përmes xhamit me njolla
Të parat pikeq,
Si farë mi tokën e lagur po ngulen
Të bardhat piketa.
Farë e sirenave,
Korpuseve, dritave
E çelikut, zhurmave,
E dashurive t'arthme.
Erë e dhjetorit
Si than kot kurrë
Piketat.

5.

Unë e di,
Larg me qindra kilometra,
Diku në një vend
Të shkretë, të largët
Ka ndalur kështu ndanë xhadesë
Një maqinë ushtarake.

Dhe larg
Si një iks i tmershëm
I një ekuacioni të tmershëm të zi,
Në këtë drejtim do të montohet një raketë e re
E destinuar për këtë qytet të ri.

pellg pond; pool
njóllë stain; spot
pikétë stake; picket
mi = mbi
korpús corps
iks X
ekuación equation

Një parabolë vdekjeje përjetësisht do përpiqet të bashkojë
Dritat. lulet dhe dashuritë e qytetit
Me bazën e raketave.

Kohë e kalkulimeve
Të distancave të qyteteve
Nga bazat e raketave!

Po mos harro, o kapital i dhjamur,
Se edhe ne
I kemi kalkuluar largësitë e kryeqyteteve tuaj
Plot xhaz, rrëmujë e reklama.

6.

Asnjë tufan si përmbys dot piketat.
Të thjeshtat të bardhat, delikatet piketa.
Dhe perëndeshën mbrojtëse, «Athina-në»,
Ky qytet
Le të mos e ketë

Në mbrojtje të këtij qyteti foshnjë krahas nesh
Do të ngrihen të rëndë radhë, radhë
Në gjëmë dritërash,
Kupolash,
Zemërimesh,
Kolloset e moçmë
Moska, Pekini, Varshava.

7.

Do të lulëzojë
Ky qytet i pavdekur,
S'do ti ndrvshken kurrë

parabólë parable; parabola
i dhjámur fat
xhaz jazz
rrëmújë confusion
kráhas alongside
në gjëmë drítërash in an overwhelming array of lights

Qelizat e hekurta;
Poetët bejtexhinj
S'do të thurin për të vargje
Psherëtimash me kilometra
Si hekurishte të vjetra;

Dhe poetë të tjerë s'do të zvarrisen
Lokaleve të natës,
Qosheve, skutave;
Honoraret e poemave të dashurive të pastra
Ti prishin
Pijetoreve
Mes prostitutave.
Dhe në qëlloftë të vinë të tjerë
Nga fisi i demoduar i poetëve
Me soneta të demoduara nenë sqetulla;
Do të hutohen
Dhe do të pyesin:
– Shoko, ku është
«OFICINA E RIPARIMEVE TË SONETEVE?» –

8.

Por do të vimë dhe ne
Poetet e realizmit socialist
Me ndonjë defter vjershash në xhep,
Atje ku derdhet çelik do të drejtohemi
Vargjeve tu themi:
«Vini syze dielli
Që të mos verboheni!»
Vargjet klorofilianë të mos afrohen,

qelízë cell
hekurishte scrap iron
zvarrísem drag
skútë lair; hideout
pijetóre barroom
në qëllóftë if it should happen
sqétull armpit
hutój daze; stun
oficínë workshop
riparím repairing
deftér notebook
derdh cast
verbój blind
klorofilián of chlorophyll

Më të fortët me ne le të vinë
Djerset t'ju venë palë;
Metal i shkrirë
Ne sy të shohë vargjet,
Vargjet,
Metalë .

9.

Metali do të derdhet
Metali i parë.
Shqipëria do të japë metal të saj,
Çelik të gjallë.

Do të dridhen herojtë në varret e ftohtë
Që me shpata të huaja,
Hekur të huaj,
Luftuan nëpër shqota.
Nga derdhje parë
Bëni një shpatë, o puntorë,
Për kujtim të Gjergj Kastriotit!

Sikur'të vinin vargan nga thellësitë e shekujve
Nga thellësitë e varreve e katakombeve
Duke bartur plagët
Si trasta të kuqe mbi shpinë,
Të renët e këtij kombi
Të vinin
Para furave martin.
Të lexonin këtë tabelë në të hyrë
«Metal për paqen»
Shqipëria e lirë.

djérset = djérsët
t'ju = t'iu
shqótë storm
dérdhje párë = dérdhja e párë (mp.)
vargán in procession
bart carry
trástë bag; pack
të rénët the fallen
fúrave = fúrrave (mp.)
të hýrë entrance

10.

Porse armiku po të guxoje,
Metali xixa do xixëllojë,
Armë të tmershme do të derdhim,
Në gjoks të hasmit plumb të hedhim;
Dhe unë e di se ju do vini,
Armet e moçme do t'i bini
Dhe në furnaltat do ti hidhni
Shpatat e vjetra,
Që ne ti shkrijmë për atdhenë,
Ti bëjmë raketa.

11.

Qytet i ri
Pa kishë e këmbonare plakë,
Por aty pranë
Rrethuar me parmakë
Varrezë e virgjër do të fillojë e brengosur.
Jeta është jetë,
Do të vij një ditë
Të parin metalurg do të çojnë për të varrosur.
Prift s'do të ketë
S'do të bjerë këmbana,
Sirena do përcjellë në varr me ulerime metalurgun
Dhe lote të nxehtë
Metalesh të sinqertë
Furave martin do t'u venë çurgë.

Të më qanin dhe mua
Në vend të sokëllimave të grave
Kujet e sirenave,
Lotet e metaleve.

pórse if
të tmérshme = të tmérrshme
hasm = armik
furnáltë = furrënáltë blast furnace
këmbonáre bell tower
parmákë grating
i bregósur grievous; sorrowful
metalúrg metallurgist
çúrgë jet; stream
sokëllím scream
kúje lamentation

12.

Qytet metalik
Fo në mes të metalevę
Njerëzit shpirtra të freskët do të kenë.
Do të ketë gra me buzëqeshje kaproni
Që dashuritë i ruajnë në zemër
Si frigoriferet
Coprat e sallameve;
Gagarelë
Që shkëmbejnë valutë trotuareve;
Do të ketë aborte,
Njerëzucë të panevojshëm si komisjon O.K.B-je
Si krem kolodont
Të zakonshëm.

Por mbi gjithë kalbësirat do shkëlqejë
Prapë i pastër
Morali i proletarëve.

13.

Mirmbrani, mbrëmje t'arthme!
Nga mali i lartë
Do të shkëputet duke mbritur një malsor i vetmuar,
Si një kompas mbi këmbët e gjata.
Me qeleshe në kokë
Si një copë alpesh,
Drejt dritave të qytetit do t'orientohet nëprë natë.

Do të vështrojë larg horizontet nga furnaltat të
përzhitura
Një lamtumirë pa fjalë

kaprón = kaprua mountain deer
sallám sausage
gagarél shylock
valútë foreign currency
abórtë abortion
njerëzúcë little man
O.K.B. = Organizata e Kombeve të Bashkuara (United Nations)
krem kolodónt type of custard
mirmbráni = mirëmbrëmë
néprë = nëpër (np.)
i përzhítur scorched

Bjeshkëve të larta
Një lamtumirë,
Krzimave të pushkëve gjakmarëse të vetmuara
Kanuneve, konvencioneve
Që nga gropat e kohrave ulurijnë të trishtuara,.

14.

Por një natë tjetër,
Një natë ernash vjeshte
Një tjetër malsor do të zbresë,
Një plak i thinjur sinjë bredh i vjetër
Me tufan akujsh në kokë,
Me kobure të moçme në brez.

Do të zbresë
Bijën e vet për të vrarë,
Që, la të fejuarin
Q'u bë metalurge
Që «koriti
Nder, shtëpi e besë».

Larg
Plot reflekse do të përgjaken mjergullat prej
furrnaltave
Që do të vjellin tym të zi, parandjenja e zëmërim
të zjarrtë.

Plaku që larg do të shohë me urrejtje
Furnaltat
Dhe furrnaltat së largu
Flokët e tymtë e të përgjakur do ti tundin
Plakut.

krzimave = krísmave cracking sounds
ernash = érërash winds
bredh fir tree
korít disgrace
përgják make bloody
parandjénjë premonition

Dhe ai do të zbresë
Si një paragraf i thinjur kanunesh
I ngadaltë,
I thinjur,
I tmershëm.

15.

Në mëngjez
Trotuareve të qytetit të porsazgjuar
Opinga e tij do të trokasë
Si në dyert e botës së re,
Një trokitje shekujsh të shkuar.

Ai do të ngrejë kokën e thinjur si një bjeshkë,
Përpara tij do të ngrihen
Të zeza,
Të paprekura
Furrat e larta në sfond të reve dhe të qiellit.
Një perandori hekuri;
Me heshta kryqëzuar përpara tij
Me ulurimë sirenash
Me mijra sy shkëndijash e avujsh,
Në mbrojtje të së resë,
Të pathyeshëm,
Të tmershëm:
«Ndalu»

Dhe plaku koburen e vjetër
Do flakë në asfalt
Nesër
Tok me hekurishtet e vjetra
Do ta shkrijnë armen përsëri,

porsazgjúar just awakened
opíngë sandal
trokás sound; ring
trokítje sound; ringing
i paprékur untouched
héshtë lance; spear
i pathýeshëm incincible
flak cast; toss

Ndryshku i shekujve do të digjet
Dhe prej metalit të vjetër,
Do të derdhet i shkëlqyeshëm
Një grusht metal i ri.

18.

Mirmbrëma, arqitekturë e re!
Tabellat e bardha të rrugëve të porsa pagëzuara:
«Rruga Homer».
«Sheshi i elementeve».
«Pjaca e Komunës».
Mirmbrëmani konture t'arthme
Të bloqeve dhe kuartaleve të punëtorëve.
Fanarë të sinqertë rrugësh q'i zbeh verniku i mëngjezit.
Shinat që ndajnë të dashuruarit, ngulçimet e ndërprera të lokomotivave.
Telefonat automatike me barqet n'agim t'urritura,
Ajri naiv mëngjezor që plaket gjer në mbrëmje.
Katrorët e taksive që ndajnë tej e përtej natën!
Afishet e çfaqjes së fundit që lagu shiu.
Të vonuarit e rrugëve natore që u ngjajnë monumenteve.

Mirmbrëma,
Skicë e hajthme e qytetit të ri,
I ngjan trupit të një vajze fare të njomë
Kur nisin ti duken vijat e para të gruas,
Të një gruaje pjellore që do të lindi më vonë
Statuja!

arqitektúrë = arkitektúrë
të pórsa pagëzúara newly christened
kuartál city block
fanár lantern
zbeh make pale
verník polish; glaze
shínë rail; track
ngulçím pant; gasp
i ndërprérë intermittent; interrupted
bárqe (bark) bellies
i urrítur = i urítur famished; hungry
afíshe poster
të vonúarit...monuménteve the late comings on night streets that resemble monuments.

Fusha në shi.
Ndanë xhadesë
Xhipsi i blertë.
Un jakën nga era ngre.
Ndez një cigar i qetë.

Këtij qyteti s'do t'ia kërkojnë kurrë gërmadhat
Arkeologët
Kohrat s'do ti hedhin me radhë
Hi dhe pluhur mbi kokë.

I gjallë ai
Me buzëqeshje të zjarrtë
Do marrë frymë përherë
Gjaku i çeliktë
Do ti mbushë arteriet,
Tymra, shkëndija, avuj,
Mbi muzeumet, kohrat dhe Harrimin
Përjetësisht do të vjellë.

1960

"Ëndërr industriale" in Ismail Kadere
Shekulli im, Tiranë, 1961, pp.90-101

un = unë
cigár = cigáre cigarette

Si hyri fëmija në këtë tregim të pakryer të qytetit të vogël në mes të pyllit?

Kjo nuk dihet. E as poeti i vogël nuk do të tregojë gjersa të marrë fund tregimi. Por dihet se ditën e parë kur filloi të shkruajë vargje, frynë erëra nga jugu dhe ja sullën një medalion të florinjtë me gur xhevahiri në mes, në të cilin ishte i shkruar emri i tij.

Ditën e dytë frynë erëra nga lindja dhe ja sollën fjalët e gjuhës më të ëmbël me të cilat thurte vargje.

Ditën e tretë frynë erëra nga veriu dhe ja sollën një fletore të bardhë në të cilën shkruan për çdo ditë.

Duke shkruar, poeti i vogël herë është i qeshur e herë-herë shihet duke qarë. Pse i ndodh kjo? Sepse fryjnë erërat nga katër anët e botës dhe ndalen në qytetin e vogël në mes të pyllit. Ato ja përshpërisin poetit të vogël të tëra fjalët e ëmbla që flasin fëmijët gjatë ditës. Kur dëgjon fjalët e ëmbla, ai qesh

dhe shkruan vargje si dielli, Kur i pëshpërisin për gjëra të tjera të papëlqyera, ai loton.

Këngët dhe vargjet e tij, një ditë do t'i mësojnë në çdo vend fëmijët e tërë botës. Kur?

Poeti i vogël thotë, kur të marrë fund tregimi.

Atëherë kur çdo fëmijë
Veç fjalë të ëmbla do të dijë.

ja súllën = ia sóllën
gur xhevahíri precious stone
nga kátër = nga të kátër (mp.)
i papëlqýer unpleasant

LEXIMI I TETEDHJETEDYTE

A.Çajupi, "Ujku dhe gengji" Abetare Tiranë, 1958, p.110

UJKU DHE QENGJI

Një qëngj pinte ujë brënda në përrua,
një ujk e kish parë dhe i u afrua.
— Pse trubullon ujët? — thirri gjakëtori.
Sa, kur e pa, qëngji nga frika përmori.
— Ujët vete poshtë, ti pi përmi mua, —
thotë qëngj' i mjerë — qysh u trubullua?
— Janë gjashtë muaj, pse më keshe shajë?
— Unë s'keshë lerë, ku të keshe sharë?
— Për zonë — tha ujku — ati yt më shau!
Dhe u hoth, e zuri dhe me dhëmb e çau.

A. ÇAJUPI

ujk wolf
qëngj lamb
turbullój make turbid
gjakëtór = gjakatár bloodthirsty one
përmjérr urinate
shaj insult
unë s'késhë (=s'kísha) lérë I wasn't born yet
për zónë = për zotin
u hoth = u hodh

NE TREN

Mbi platformën e stacionit rëndon zhegu. Vagonat e vjetër mbi linjat e verbëra, hekurishtet, pllakat e çimentos shfryjnë dumanë me afshe të valë si gojë furrash dhe çdo gjë është e mbuluar me një pluhur bojëndryshku.

Një grua e merr të bijën për dore dhe të dyja tërhiqen në një skaj të platformës ku është një çezmë pa ujë. Dy djem, të mbështetur në telat rrethues, me kurrizët lakuriq, hanë shalqi dhe pështyjnë me përtesë fara të kuqe mbi asfalt. Gruaja e bredh vështrimin e saj si prej zogu të trembur në të gjitha anët e platformës dhe ndjenja e një frike të panjohur i fërgëllon në shpirt dhe i trazohet me ndjenjën e mërisë dhe përbuzjes për gjithë ata trupa njerëzish të zhveshur ose gjysëm të zhveshur që kullojnë djersë. Vajza lëvis si e mpirë, me gjymtyrë të drunjta. Por gruas i duket sikur vështrimi i së bijës është i dyshimtë dhe i lëvizshëm si zhivë. Vajza zhvesh me ngathtësi xhaketën prej akriliku dhe llërët e bardha e të plota i fërgëllojnë nga një dridhje e mornicë e lehtë.

zheg siesta time
vagón coach; car
hekuríshte hardware
dumán = tym
afsh vapor
i válë hot; boiling
bojëndrýshk rust-colored
kurríz back
shalqí watermelon
pështýj spit
përtésë laziness
bredh let wander
fërgëllój quiver
trazój mingle
gjymtýrë limb
i drúnjtë wooden
zhívë mercury
ngathësí sluggishness
llërë forearm
drídhje shivering
mornícë chill
stréhë eave
zhezhíj smell
zhuzhák dung beetle
zhúkë reed
i mbírë grown; planted
dérgjem suffer
dremít doze
lëpíj lick
fund skirt

Gruaja e lëshon shaminë e bardhë si strehë mbi sy. Fytyrën ia mbulon hija e shamisë, por megjithatë, i zhezhit kryet sikur ka brenda një tufë zhuzhakë. Ndofta prandaj edhe mendimet i ka shumë të vala dhe i dridhen ashtu siç dridhet edhe zhegu mbi zhukat e mbira në rërë. Vajza vështron detin që dergjet e dremit nën dritën e madhe të diellit. Platforma e stacionit është afër detit. Ajo sheh se si hypnin njerëzit në një vapor të vogël turistik. Ajo s'kishte hypur kurrë në një vapor turistik. Bile, ajo s'kishte hypur as në varkë. Varkat e plazhit duhet të jenë më të mëdha se ato të liqenit artificial që i kishte parë një të dielë kur kishte dalë shëtitje me shoqet. Ajo vëren dhe katër vajza që lëpijnë akullore. Njëra e ka gjoksin shumë të hapur dhe që të katra kanë funde të shkurtë. Ajo s'kishte mbajtur kurrë fund të tillë. Njerës i duken format e rrobave të banjës që nuk i janë tharë akoma. Gruaja kthen fytyrën nga qyteti dhe mundohet të shohë afrimin e trenit nëpër shina.

Ato kishin ardhur vizitë tek vëllai i saj që banonte në Shkozet. Vajza nuk e dinte se përse kishin ardhur ashtu papritur për vizitë dhe as që i shkoi ndër mend se kjo gjë u bë që atë ta shihte një njeri. Atë mbrëmje, si rastësisht, tek xhaxhai kishte ardhur edhe një njeri tjetër. Shumicën e kohës ata të dy kishin luajtur tavëll dhe ajo nuk e kishte vënë re mirë, sepse e kishte mendjen tek qëndizmat e shumta që kishte pregatitur për pajë Luljeta, kushërira e saj që ishte fejuar në Elbasan. Nënës, nga ana e saj, ky burrë nuk i kishte pëlqyer. Vështrimi i tij ngulmonjës e i pacipë, iu duk sikur e zhvishte vajzën e saj. Ky duhej të ishte zagar burrë. Pa le që ishte edhe i madh nga mosha. Pse, ç'e kujtonte vajzën e saj ky i vëllai? Të mbetur e dinte? Punë e madhe se ai burri na paska një pozitë të mirë! Vajza e saj është si dritë dhe nuk i ka dalë as gjysëm fjale, larg qoftë! Ajo iu mërzit të vëllait për këtë zgjedhje dhe kjo fejesë nuk do të bëhej. Po vëllai ishte finok i madh. Ai bënte sikur në këtë mes i fyeri ishte ai dhe mezi i tha «udhën e mbarë».

Sheshi i stacionit tani është mbushur dëng me njerëz dhe lëvizja e tyre të merr sytë. Koka, krahë të nxirë dhe të rjepur, lëkurë e rjepur, vajza pa cipë.

Gruaja dhe vajza ishin nga i njëjti qytet i madh me udhëtarët e tjerë. Ky qytet ishte rritur si një përbindësh

távëll backgammon
qendízma (qendímë) embroiderings
pájë dowry
ngulmónjës fixed; penetrating
i pacípë shameless
zagár dirty dog; hound
e mbétur spinster
púnë e mádhe so what
larg qóftë far be it
finók wily
shesh yard
dëng to the brim
të merr sýtë blinds you
i rjépur peeled
namúz = namús reputation; good name; honor
e kíshte márrë lúmi had gone down the drain
përdhése down to earth
të érdhurve = të árdhurve
mëmëlígë porridge
íshin márrë nëpër këmbë were trampled underfoot
rryp kaíshi blockhead
shyqýr luckily; fortunately
mbíjnë (mbjell) arise; grow
lëvríj move about
fustán dress
stófë material
hetój examine

me njerëz të ardhur nga krahina të tjera, që flisnin secili sipas të folmeve të tyre dhe gruaja mendonte se gjithë zakonet e mira dhe namuzin e qytetit e kishte marrë lumi tani. Dhe shkaku ishin ata të ardhurit e pacipë. Ajo vetë ishte nga ato familje të vjetra të qytetit që i kishin pasur rrënjët po këtu dhe që binin një jetë të veçantë e të këndëshme nëpër shtëpitë e vogla përdhese. Kjo ishte një jetë më vete, që asaj i kishte pëlqyer shumë, po të erdhurve që e shtonin qytetin, thoshin se ajo nuk u pëlqente. Lagjia e tyre tani s'njihej më. Ishte bërë mëmëligë. Zakonet ishin marrë nëpër këmbë. Thoshin se çupat e Sturmasëve, që ishte derë nga të vjetrat, tani vinin çdo të dielë në plazh dhe i ati, rryp kaishi, s'bëhej merak. Vajza e saj, shyqyr, s'kishte erdhur kurrë këtu. Kishte vëllezërit ajo, shyqyr, dhe ata s'e linin të bënte çap!

Gruaja dëgjon vërshëllimën e lokomotivës dhe turma lëviz drejt trenit si e shtyrë nga era. Ato mbeten të fundit dhe hyjnë në koridorin e vagonit, atëhere kur ai është mbushur plot me njerëz. Gruaja e tërheq të bijën për dore, del përpara dhe mundohet të çajë nëpër turmë. Që tani asaj fillon t'i mbahet fryma dhe e ndjen se si i mbijnë e i lëvrijnë në gjithë trupin djersë të vala. Fustani i ri, prej një stofi të mirë të errët, i është ngjitur pas trupit. Ajo kthen kokën dhe heton sytë e vajzës. Sytë e saj i duken të lodhur e si të përgjumur. Në shpinë të saj është ngjeshur një grua e veshur si vajzë me një fustan të bardhë e të tejdukshëm. Vajza-grua, mban me kujdes ngritur mbi krye një kasetë të vogël druri. Ajo thotë njëherë me vete: «Ç'mund të ketë ajo grua-vajzë në atë kasetë që e ruan sikur e ka prej kristali? Por pastaj qetësohet dhe bën përpara. Pastaj, nga fundi i koridorit, vjen një valë tjetër, njerëzit dynden e ngjishen njëri me tjetrin dhe ato, vetvetiu, shtyhen më tej. Gruaja është tani nën ventilatorin dhe herë pas here ndjen ajrin e ftohtë që i than djersët e fytyrës. Kjo freski i pëlqen dhe ajo vendos të mos bëjë këmbë më tej. Ajo s'ka udhëtuar kurrë në mes të një turme të tillë. Sytë e saj kërkojnë ata të vajzës dhe e pyesin «ç'bëhet kështu?» Vajza buzëqesh me ndrojtje. «S'kuptoj asgjë!» thonë sytë e saj.

Një djalosh korrozi ia lëshon vendin e vet me mirësjellje dhe bën të zerë vendin e saj në shpinë të vajzës, po ajo i rëndon mbi supat dhe e ul në vëndin e tij. Pastaj

ngjéshur pressed against
i tejdúkshëm translucent
kasétë small case
dýndem flood; unundate
vetvetíu automatically
korrozí swarthy
mirësjéllje good behavior
rëndój weigh
gumëzhíj buzz
budallallëk stupidity
tramplín diving board
mburravéc braggart
notój swim
básmë calico
gudulís tickle
flokëvérdhë blond
tëmth temple (of head)
i ímtë thin
ndénjëse seat
llafazán gossiper; garrulous
i prápë perverse

vagoni lëkundet dhe treni niset. Të panjohurit rreth saj gumëzhijnë dhe ajo kap me vesh ca fjalë pa kuptim që e mërzitin.

— Budallallëku më i madh është kur lahesh afër bregut. Uji është i pastër vetëm në thellësi, tek tramplini..

— Njëzet herë i rashë bregut nga «Iliria» tek «Teuta», po nuk e pashë më...

— Ama ç'mburravec!

— Po ta dija me siguri se ishte në rërë edhe njëzet herë të tjera t'i bija, nuk më vinte keq!

— Ti nuk noton dot deri tek tramplini. E di unë...

— E ruajnë shumë të vëllezërit...

— Mos e bëj atë provë, se do të vesh në alarm barkat e shpëtimit...

— Kur e kuptoj të dielën e shkuar që...

Ato të dyja ngjasin shumë me njëra tjetrën. Po ai ballë i ngushtë nën një kurorë të zezë flokësh, hunda pak me samar, goja e madhe, sensuale. Vajza është një kokë më e gjatë. Nën fustanin prej basme i dridhen gjinjët dhe ajri i ftohtë i ventilatorit e gudulis e i hyn midis tyre. Befas, gruaja ve re se tani ndodhen në mes të meshkujve. Para vajzës është shpina e një djali të gjatë flokëverdhë. Në krah të saj, një burrë me flokë pak të thinjur në tëmtha dhe me syze. Në anën tjetër është një djalë i imët që mbështetet në krahun e ndenjëses. Ky ishte llafazan i prapë. Sytë e gruas mbushen me dyshime të egra dhe me urrejtje... Ato shkundin kudo mijra dyshime, si fletë të zverdhura. Treni lëkundet si një i dehur tojnë pikturën e vërtetë. Kurse ju... Unë e vura re menjëherë këtë gjë. Ky është një akuarel. Po, po.

— Portreti i këtij... natyrisht... do t'ju shërbejë për ndonjë kompozim...

— Po, po... Për një kompozim...

— Po ky pejsazh...

— Hë?... A nuk të kujton pak atë të Saliut që bëri bujë në ekspozitën e fundit?...

— Në kompozimin tuaj... ishte i spikatur portreti i atij inxhinierit..

— Më ka pozuar një alamet djali... Oi, ç'alamet ishte! Është portreti i tij!

— Kishte shume ngrohtësi...

kërcënúes threatening
mjerőhem become desolate
pákëz a little
drithërőhem yearn
hep bend
ia ka énda is pleased by
bërrýl elbow
xham lens; glass
qorr blind
i shtrembërúar distorted

Fytyra e vajzës me fustan të bardhë ka disa rrudha të lehta rreth syve. Ajo është e shqetësuar shumë për to dhe ia tregon burrit me syza. Ai ia prek ato me dorë, si mjek. «Nga dielli... nga dielli...» dëgjon ajo nëpërmjet kaosit të zhurmave zërin e trashë të burrit. Pastaj, ai e heq këmishën dhe mbetet vetëm në kanatjerë. Trupin e ka të nxirë. Llëra e tij prek rastësisht llërën e vajzës së saj. Asaj i duket sikur ngjyra e kuqërremtë është shtuar edhe më në fytyrën e vajzës. Tani ajo e ka fytyrën e vajzës karshi dhe vëren se sytë e saj janë pulitur e shohin larg, nëpër gjelbërimin e fushave, me ëndërrim. I bëhet se vajzës i vjen mirë nga prekja e burrit në llërë. Ajo e shtyn në mënyrë energjike burrin me syza, që habitet fare nga kjo gjë. Tani e ka vendosur vajzën midis vetes dhe djalit të imët llafazan. Ky i duket i vogël. Është edhe llafazan, pra e ka mendjen vetëm tek fjalët. Treni nxiton. Lëkundjet shtohen edhe më. Ajo mundohet të dëgjojë me saktësi se ç'llomotit ai thatuqi. Duhet ta dëgjojë mirë se ç'thotë ai. Mos thotë edhe maskarallëqe si këta të dy të pacipët? Ai flet shumë shpejt dhe ajo dëgjon vetëm ca fjalë: «ishte një copë që...» Dhe ai me të tjerët, pasi flasin disa herë për një «copë», ia marrin një kënge

Treni nxiton si i harbuar tani. Të gjithë i ndjejnë lëkundjet e tij dhe lëkunden me përtesë. Asaj i duket sikur gjatë këtyre lëkundjeve, këmba e djalit thatuk afrohet dhe e prek puplën e vajzës së saj. I vogël, i vogël por...

Lëvrin tërë nerva. Nuk ze vend gjëkundi. Shtyn përsëri me bërryla, çan përpara dhe e tërheq vajzën për dore. Vajza e ndjek pas me trishtim, si manare.

Më në fund, ajo është larguar nga ai rreth njerëzish të pacipë dhe tani ato janë midis një grupi vajzash. Këtu dhe zhurmat e tij varen kërcënuese në ajër. Sytë e gruas mjerohen. I duket vetja fare pafuqi. Trembet. Ve re se gjinjët e vajzës janë mbështetur pakëz në shpinën e flokëverdhit. I bëhet se ai, i panjohuri flokëverdhë, e ndjen atë prekje të lehtë, drithërohet për atë prekje dhe prandaj e kërkon duke e hepuar edhe më shpinën prapa. Vajza vështron tani përpara dhe ajo nuk ia sheh më sytë. Por ajo vëren se si ngjitet e shtohet në qafën e në llërët e saj të bardha një ngjyrë e kuqërremtë. Kjo është ngjyra e diellit të gushtit që ra për herë të parë në një lëkurë aq të bardhë, po gruaja nuk e di dhe as që do ta dijë këtë

akuarél watercolor
pejsázh landscape
búję sensation
íshte i spikátur stood out
alamét implement; tool
kanatjér undershirt
karshí opposite
pulítur half closed
llomotít babble
thatúq skinny one
maskarallëqe scandalous things
i harbúar maddened
thatúk = thatúq
púpël calf
manár pet

gjë. Ajo është e sigurtë se kjo është kuqërremja e turpit. Pastaj, i bëhet se edhe vajzës ia ka ënda atë prekje të lehtë. Ajo bën një lëvizje të shpejtë e të vendosur. E shtyn me bërryl burrin me syza dhe vajzën e saj dhe del vetë prapa shpinës së flokëverdhit. Vajza tani është vendosur në vend të sigurt, midis saj dhe burrit me tëmtha të thinjura. Ai i duket njeri serioz. Ai duhet të jetë i martuar. Kurse ai flokëverdhi... atë do ai.... Kurse ky tjetri është burrë i mirë dhe serioz. Jo si disa... Megjithse ai është akoma i ri. Po të mos kishte disa thinja, do të dukej fare i ri. Ai duhet të ketë rrethin e unazës në gisht. Paçka se nuk i duket, sepse i ka duart të varura poshtë, po ai duhet ta ketë me siguri rrethin e unazës.

Ajo qetësohet një copëherë dhe vetvetiu i vjen më të mbyllur sytë. Djersa i ngjitet në fytyrë. Tani ajo e ndjen edhe më shumë djersën, sepse është qetësuar dhe s'mendon më asgjë të trishtuar, nuk ruan më asgjë. Pastaj e ndjen érën e ftohtë të ventilatorit dhe kot më kot mundohet të shohë diçka prapa xhamave të syzeve të burrit. Po xhamat e syzeve të tij janë shumë të errëta. Përse i mban këto syze kaq të zeza? Mos është qorr? Po kush e mban për dore? Jo, jo... s'është qorr, po këta mbajnë të gjithë syze tani. Ajo nuk sheh asgjë përveç fytyrës së saj të shtrembëruar që pasqyrohet në xhama si në një pasqyrë me avull. Gruaja vëren se është afruar këtu edhe ajo gruaja-vajzë me kasetë, që i ka të gjitha të tejdukshme. Burri me syza ia ka nisur një bisede shumë të përzemërt me vajzën. Ajo, e pacipa, vajza-grua, nxjerr nga kaseta disa fletë letre vizatimi dhe ia tregon atij. Gruaja ve re se në to janë vizatuar trupa njerëzish lakuriq... O, ç'turp, e pacipa! Kjo qënka një... Qënka një zagar nga ata që... Këta janë më të rrezikshmit. Këta, tridhjet e pesë, dyzet vjeçarët... Punë e madhe se janë të martuar!

— Oi! Ç'fatkeqësi! Kemi shumë pak njerëz që e kupka edhe disa djem me kanatjere, por shumica janë vajza. Në shpinë, përpara, krahëve, ato kanë tani vetëm femra.

— Unë bëja sikur nuk e vija re, po ai vinte pas meje. Ti e di, ishte ai që të kam prezantuar...

— Pastaj?

— Unë e shihja me bishtin e syrit dhe mundohesha t'i bëj një shenjë që ta kuptonte...

— Pse?

xhelóz jealous
përpíj swallow up
Vdes! He would die for me!
makth nightmare
pllakós strike; afflict
uturój rumble; roar
mjegullóhem become foggy
i shkélin sýrin wink at her; make eyes at her
trokój roll; trot

— Se isha me atë kushëririn pra...

— Edhe?

— Ai u bë xheloz, se nuk e njihte kushëririn dhe më shihte me një inat që... thashë se më përpiu!

— Të dashka shumë!

— Vdes!

Shqetësimi i gruas rritet dhe e mbërthen si një makth. I bëhet se është në një ëndërr dhe e ka pllakosur hija. Po s'është ëndërr. Ja, vajza e saj po shikon mbrapa, po shikon grumbullin e njerëzve ku kishte qenë më parë. Ajo ndofta kërkon sytë e flokëverdhit!

Fytyra e flokëverdhit i ngatërrohet me atë të burrit me syza, pastaj me atë të asaj së pacipës që kishte vizatuar njerëz lakuriq, që i kishte futur vizatimet në një kasetë dhe që e ruante kasetën sikur e kishte prej kristali...

Treni uturon dhe vështrimi i saj mjegullohet. S'i nga ta ruajë vajzën më parë. Të gjithë ia kanë qepur sytë asaj, fytyrës së saj, llërëve, gjinjëve... Dhe të gjithë, zagarët, i shkelin syrin. Dhe vuajtja e syve të saj rritet e rritet. Ku ta fshehë vajzën nga ato vështrime lakuriq, nga ato krahë lakuriq, nga ato trupa la...

Dhe, sa më shpejt trokon e ecën treni, aq më shumë vuajnë e ngrijnë sytë e gruas që kishte ardhur në Shkozet, me vajzën për dore!

Teodor Laço, "Në tren", Nëndore (Tirane) XIX, 9 (September), 1972, pp.118-123

LEXIMI I TETEDHJETETRETE

TRI VAJSHAT

Sipas përrallës popullore

Kur e filloi gjyshja këtë përrallë, qengjin e bardhë e zuri gjumi mbi barin e butë në mes të luadhit të gjelbërt. Në atë çast, mund ta zësha lehtë që të lozja me të e t'ja përkëdhelja gushën e bardhë. Por, gjyshja sikur e dinte s'e çmendoja, më tha me një zë të qetë e të ëmbël:

— Sot e ka radhën ajo përralla që e ëndërrojnë të gjithë fëmijët që i duan qengjat e bardhë.

Unë, ju afrova gjyshes dhe si zakonisht fillova:

— Një ... dy ... tre!

Gjyshja ja nisi.

— Pra, na ishte njëherë një përrallë

Në përrallë tre kuaj me jela të florinjta

Tri vasha të bukura
Dhe një Baloz i zi.

Por, kështu nuk fillon përralla, unë sikur e gabova — tha gjyshja, dhe vazhdoi:

Para se të hynin në përrallë tre kuajt me jela të florinjta, tri vashat e bukura dhe Balozi i zi, gjindej një fshat. Një fshat i lumtur në të cilin jetonin njerëzit e mirë e të urtë.

Fshati kishte shtatë shtëpi të bardha
Shtatë vreshta që bënin rrushin më te ëmbël
Dhe shtatë ara buke ku rritej misri i kuq, prej të cilit gatuhej buka si dielli.

Kështu fshatarët e urtë kalonin jetë të lumtur e të pasur në fshatin e tyre të dashur e të vogël në mes të një pylli të blertë dhe të dendur.

Por, një ditë, kur vashat vilnin rrushin nëpër vreshta, kur nënat gatuanin bukën e ëmbël prej misrit të kuq nëpër magje, kur fëmijët luanin me qengjat e bardhë në luadh ... Doli një Baloz i Zi nga deti!

Dhe thonë u dridh toka dhe u rrëxuan pullazet e shtëpive. Dhe kështu, u shkatërrua lumturia e fshatarëve në fshatin e vogel e të bukur.

Por, këtu asgjë nuk merr fund.

Këtu është vetëm fillimi i përrallës ...

Thonë se atë ditë zogjtë harruan këngët që këndonin për gjelbërimin. Fëmijët harruan të dilnin në lojë pas fluturave me krahë të shkruar që ju binin mbi gishtërinj. Të gjithë njerëzit i kaploi një pikëllim i madh dhe një frikë e papërshkruar nga Balozi i Zi që doli nga deti për ta shkretëruar tokën.

rrush grape
mísër corn
vjel harvest
mágje breadbox
rrëxój = rrëzój demolish

Kjo ishte vetëm fillimi i kobit.

Pas pak ditësh, Balozi i Zi, mori nga fshati i vogël tri vasha të bukura.

E para, thonë i përngjante diellit...

E dyta, kishte fytyrën si hëna e plotë ...

E treta, ishte si Ylli i Mëngjezit ...

Pas kësaj, pikëllimi në fshatin e vogël me shtatë shtëpi të bardha nuk pati fund.

Për tri vashat e bukura qajti vreshta, sepse duart e tyre të buta nuk do të vilnin më rrushin e ëmbël nga hardhia. Qajtën trëndafilët, sepse duart e tyre të bardha nuk do të ujitnin fletët e tyre të hedhura.

E kush nuk qajti për tri vashat e bukura që i mori Balozi i Zi dhe i mbylli në një kullë të fortë prej guri në rrëzë të një bjeshkës së lartë dhe një lumi të rrëmbyeshëm.

Balozi i zi e la një njeri ta ruajë kullën, ndërsa vetë vazhdoi të shkretërojë fshatra dhe qytete të tjera:

Nga bjeshka në det

Nga deti në bjeshkë!

Kulla prej guri në të cilën i ndryen vashat kishte tri dhoma. Në secilën dhomë jetonte njëra nga vashat. Jetonin të vetëmuara dhe në pikëllim të thellë. Kur qanin, thonë në fshat binte shi i valë që e digjte barin dhe lulet. Atëherë qanin edhe fshatarët e fshatit të vogël.

Kështu i kalonin ditët vashat në kullën e gurit.

E roja e ashpër s'lente njeri t'i afrohej as të shikojë muret e kullës.

Kur motra e madhe hapte dritaren e dhomës së vet

kaplój = kapllój overwhelm
i papërshkrúar indescribable
për ta shkretërúar (=shkretúar) to devastate
përngjáj resemble
hardhí grapevine
i hédhur comely; stately
kúllë tower
i rrëmbýeshëm raging; torrential

Lindte dielli në fshat ...
Kur hapte dritaren motra e mesme
Mbi fshatin e vogël lindte hëna e plotë ...
Kur çilte dritaren e kullës motra e vogël
Fshatarët shihnin Yllin e Mëngjezit që pikonte dritë mbi shtëpitë e tyre të bardha.

Kështu kalonin ditët ... muajt ... dhe vjetët ... Ndërsa dhembja dhe pikëllimi mbetnin gjithnjë dhe nuk kalonin. Por fshatarët e urtë e të mirë filluan përsëri të punonin si më parë. Të mbillnin e të korrnin misrin e kuq në shtatë ara dhe t'i punonin shtatë vreshtat që bënin rrush të ëmbël.

E një ditë, papritmas, në pyllin që e rrethonte fshatin e vogël me shtatë shtëpi, ja behën kuajt e egër e të çuditshëm nga një vend i largët. Jetonin në pyll dhe filluan ta shkretërojnë njërën nga shtatë arat që gjindej në zemrën e pyllit. Ishte kjo ara e shtëpisë së parë të fshatit në të cilën jetonin tre vëllazër që i patën dashur shumë tri vashat e bukura që i ndrye në kullë Balozi i Zi.

— Do ta ruajmë arën që bën misrin si dukati — u tha dy të tjerëve vëllai i madh. U përgatit dhe u nisë para se të agonte që të zërë pusi te shtegu i arës.

Posa arriti, u palua pas një trungu të madh dhe zuri të vështronte me kujdes kah ara. Mbas pak, nisi të dëgjohet një oshëtimë thuajse tani donte të dalë nga zemra e pyllit një Baloz tjetër. Dhe ja, në shteg të arës u dukën tre kuajt të hedhur e të shpejtë si vetëtima.

Kali i parë kishte jelën e bardhë,
I dyti të kuqërremtë

ndryj lock up

Dhe i treti kishte jelën ngjyrë hiri.

Filluan të lodrojnë nëpër arë dhe thyenin misrin që kishte zënë të qesë tufën e mëndafshtë. Kur vërejti këtë çudi, vëllai i madh që kishte ardhë ta mbronte arën, e rroku frika dhe zuri të kthehet në shtëpi. Kur arriti, u tha dy vëllezërve të tjerë se atë ditë në arë s'hyri asnjë kal i egër. I tha këtë me dhembje, por sikur ta thonte të vërtetën do të skuqej para vëllezërve dhe tërë fshatit.

Të nesërmen, duhej të shkonte në rojë vëllai i dytë. Edhe ky, si i pari, zuri pusi pas trungut të madh dhe priste. Por i ndodhi e njëjta gjë si vëllait të madh dhe u kthye në shtëpi duke thënë se ara edhe atë ditë ishte e qetë dhe në të nuk hyri asnjë nga ata kuajt e çuditshëm që arritën nga largësia e panjohur.

Ditën tjetër u nis për në roje vëllai më i vogël. Ai jo vetëm që ishte më i ri përkah mosha, por ishte edhe trupshkurtër dhe i thonin Shkurtabiq. Her-herë talleshin me të duke i thënë:

Të jeshë Shkurtabiq

Është sikurse hiçl

Edhe ky zuri pusi po në atë vend, si vëllazërit e tij dy ditët e mëparshme. S'kaloi shumë kohë, e në shteg të arës u duk kali me jelë të bardhë. Vëllai i vogël njëherë sikur u hutua nga ajo jelë e çuditshme dhe e bukur. Fijet e saj të gjata krijonin një tufë të madhe ërgjënti që shkëlqente. Në atë çast, vëllai i vogël sikur të fitonte flatra shqiponje, ju ngjit kalit të bardhë mu në qafë. Ai

paprítmas unexpectedly
ja béhën chanced
dukát gold
agón dawns
zë pusí set an ambush
palóhem huddle; nestle
qes reveal

lëshoi një hingëllimë të çuditshme dhe theku vrapin arës duke vrapuar si në rreth. Ky i ngjitej gjithnjë e më fort dhe e shtëngonte në qafë e jelë.

Pasi hingëlloi disa herë dhe bëri disa rrathë në vrapim kali u ndal. U ndal si ai kali i urtë i kalorësve të mëdhenj kur kthejnë nga beteja e fituar. E shikoi njëherë djaloshin në fytyrë dhe sikur i tha:

— Këpute një tufë nga jela ime e barhë dhe ruaje në një arkë. Kur të duhet kali i fuqishëm për ndonjë betejë, hape arkën. Unë do të vij atëherë me flatra si vetëtima.

Djaloshi mori një tufë jele nga qafa e kalit dhe u ndanë. Kali iku në pyllin e blertë e djaloshi u nis për në shtëpi.

Ditën tjetër edhe pse s'ishte në radhë, vëllai i vogël përsëri shkoi ta ruajë arën.

Atë ditë erdhi kali me jelë të kuqërremtë.

Djaloshi e priti dhe i ngjau tërë ajo si një ditë më parë. Në fund, kali sikur i tha:

— Merre nga jela ime një tufë të kuqërremtë dhe mbylle në arkën tënde. Trimave si ti u nevojiten kuaj të fortë për beteja të mëdha.

U nis djaloshi për në shtëpi duke i shikuar me dashuri fijet e buta si mëndafshi të jeles së kuqërremtë. Dhe, sikur mendonte në një betejë të madhe ku do të lëshohej si trim i vërtetë me njërin nga kuajt.

Për të tëra këto që i ngjanin, djaloshi nuk u tregonte vëllazërve. Ata çuditeshin kur ky pa pritur radhë zgjohej heret dhe shkonte të bëjë roje.

trupshkúrtër of short stature
tállem mock
hutój daze
fíje strand
flátër wing
ju = iu

Kështu ndodhi edhe ditën e tretë, me kalin e tretë që kishte jelën ngjyrë hiri. Edhe atij, ja mori një tufë nga jela dhe e mbylli në arkën e tij magjike.

Dhe kështu mori fund roja sepse, asnjëherë tjetër s'hynë kuajt në arën në mes të pyllit të blertë.

Pas kësaj, fshatarëve u kaloi frika nga kuajt e çuditshëm, por pikëllimi për tri vashat e robëruara rritej dita me ditë.

Pa pritur e pakujtuar një ditë, erdhi në fshat një lajmëtar nga kulla e gurit ku jetonin të ndryera tri vashat. Ai thoshte se roja e kullës ka vendosur për të shitur tri vashat e bukura. Pronar i tyre do të jetë aj, që me kal mund ta kalojë lumin e rrëmbyshëm pranë kullës dhe do të sjellë një arkë me florinj. Kështu për secilën vashë. Lajmi është shpërndarë në të katër anët e botës dhe pritet se nesër do të vijnë kalorës me kuaj të fuqishëm dhe me shumë florinj.

Kur dëgjuan këtë lajm të kobshëm, tërë fshatarët filluan të vajtonin. Vashat në kullë derdhnin lot dhe filloi.të bie shi i valë që digjte barin e njomë dhe lulet.

Të nesërmen, i madh e i vogël nga fshati, me lot nëpër faqe vrapuan te lumi i rrëmbyeshëm pranë kullës së gurit për të parë se çka do të bëhej, meqë ishin të pafuqishëm t'i shpëtonin vashat e tyre.

Në fshat mbeti vetëm djaloshi që ruante në arkën magjike me tri tufa jelash që kishte marrë nga tre kuajt.

Te lumi i rrëmyeshëm pranë kullës së gurit u tubuan shumë kalorës nga katër anët e

théku vrápin picked up the pace
shtëngónte = shtrëngónte (mp.)
bárhë = bárdhë (mp.)
árkë chest; box
lëshóhem rush off
hérët early
pakujtúar abruptly
shes sell
pronár proprietor

botës. Me radhë njëri pas tjetrit msynin kullën, por asnjë ta kalonte lumin.

Në fshat, djaloshi ju afrua arkës magjike.

— Sot ose kurrë —tha në vete. Pastaj zgjati dorën dhe e hapi arkën. Nxori njërën pas tjetrës të tri tufat. Dhe pa vonuar, në oborrin e tij arritën:

Kali i bardhë

Kali i kuqërremtë

Dhe kali me jelë ngjyrë hiri.

Djaloshi pa humbur kohë, ju hodh në shpinë kalit të bardhë dhe u lëshua si vetimë kah kulla .Dy kuajt e tjerë vraponin me të, njëri në krahun djathtë njeri në të majtin.

Vraponin si me flatra. Kur arritën te lumi i rrëmbyeshëm, turma e madhe e njerëzve dhe e kalorësve që mundoheshin të arrinin te kulla, filluan të largohen të habitur.

Tre kuajt dhe djaloshi me një kërcim kaluan lumin e gjërë dhe të rrëmbyeshëm dhe u futën në kullën e gurit. Dhe me shpejtësi vetëtime djaloshi mori tri vashat dhe i nxori nga kulla. Pastaj ,të parën e vuri mbi kalin e kuq, të dytën mbi kalin me jelë ngjyrë hiri ndërsa vashën e tretë, më të voglën, e mori mbi kalin ku ishte vetë dhe msynë si era e shpejtë kah fshati.

Askush nuk kuptoi se kush ishte ky kalorës i çuditshëm, si erdhi dhe ku shkoi. Roja e kullës alarmoi. Kalorësit u shpërndanë në të katër anët. Fshatarët filluan të qanin për vashat e tyre.

Djaloshi me të kthyer në fshat, i futi kuajt në ahër e tri vashat e lumtura i vendosi

i kóbshëm terrible
mégë since; because
i rrëmýeshëm = rrëmbýeshëm (mp.)
tubój assemble
msyj = mësýj assault; move on
alarmój give the alarm
áhër = ahúr stable
befasí suddenness
ju = iu

në mes të kopshtit me trëndafilë të kuq.

Kur kthyen fshatarët dhe i panë vashat në fshat, sikur nuk u besonin syve të tyre. Por ishte kjo, ajo befasia e lumtur që e ëndërronin. Zemra e secilit u mbush me gëzim dhe fshatit ju kthye lumturia.

Buzëqeshi vasha e parë dhe të tëra lulet e fshatit zunë të çelin.

Buzëqeshi vasha e dytë dhe lindi hëna e plotë mbi majën e pyllit të blertë.

Buzëqeshi vasha e tretë dhe filloi të rritet bari.

Atëherë, djaloshi nxori tre kuajt nga ahri dhe doli para fshatarëve e me zë kalorësi të vërtetë filloi:

— Këta janë kuajt për beteja të mëdha, kuaj me flatra! I dua dhe dy vullnetarë të vinë me mua që ta ndjekim Balozin e Zi.

Dhe, papritur ta mbarojë fjalën, dy vëllazërit e tij u hudhën mbi kuaj.

Atëherë, plaku shakaxhi i fshatit foli:

— O Shkurtabiq,

Pa ty më mirë hiç!

Kështu, tre vëllazërit shkuan ta mbysin Balozin e Zi, ndërsa tri vashat e bukura mbetën t'i presin si heronjtë e vërtetë.

Përralla këtu merr fund. Gjyshja më pat thënë se kështu ka ndodhur. Ta pyesim-përsëri, nuk mundemi. Gjyshja tash nuk është më.

"Tri vashat" in Rrahman Dedaj Zogu dhe kulla, Prishtinë, 1972, pp.41-51

shakaxhí clown

pa ty më mírë hiç without you we'd be better off dead

DINJITETI

(tregim)

Drejtori u nis të thoshte diçka të hidhur e të rëndë, por u përmbajt. E përse ta prishte gojën? A nuk mund t'i tërhiqte asaj vemendjen pa i bërtitur dhe pa qënë nevoja të shprehej rëndë?

— Nuk e kuptoj, — tha drejtori, duke i theksuar fjalët një e nga një — nuk po e marr vesh se ç'po ndodh me ju, shoqja Violetë! Ju jeni një punonjëse e vjetër dhe shumë e kujdesëshme, keni punuar mirë, kur papritur... Është e katërta herë që po bëni gabime pas gabimesh. Ku e keni mendjen? — Dhe këtu drejtori e ngriti zërin. — Shumë keni ndryshuar këto kohët e fundit! Si e keni hallin? Ju ka ndodhur gjë? Mos keni njeri të sëmurë?

Gruaja, që qëndronte në këmbë, e heshtur dhe e pa lëvizur, përpara tavolinës së drejtorit, nuk foli.

— Mund t'ju ndihmojmë? — Vazhdoi drejtori i vendosur për t'i shkuar deri në fund kësaj çështjeje, duke kthyer kokën nga sekretari i organizatës së partisë, që ishte ulur në një kolltuk pranë kasafortës dhe po e shikonte me vemendje Violetën.

Sekretari miratoi me kokë dhe pa pritur as që drejtori të mbaronte me pyetjet e tij, as përgjigjen e gruas së re, duke e shikuar atë në sy, me një zë që shprehte më tepër lutje se sa qortim, i tha:

—Ç'është kështu, moj shoqe? Çfarë ke? Si e ke hallin? Si mund të të ndihmojmë?

Violeta mori zemër nga shikimet dashamirëse të dy burrave dhe u mat të thoshte diçka, por si duket, u pendua dhe, në vend të fjalëve, nga sytë e saj të bukur dolën disa pika lot, që iu rrukullisën me shpejtësi tatëpjetë faqeve.

Drejtori dhe sekretari i partisë u vështruan sy në sy.

Gruaja e re uli kokën dhe me hap të matur u largua, napi derën me kujdes dhe humbi në koridor.

dinjitét dignity
e prish gójën speak ill
pa i bërtítur without hollering at her
kóhët e fúndit recently
si e ke hállin what's the trouble
për t'i shkúar déri në fund to get to the bottom of
kolltúk armchair
kasafórtë strongbox; safe
miratój approve
qortím chastisement
shikím look
dashamírës friendly; of goodwill
pendóhem change my mind
bashkëshórt spouse

1.

Familja e saj, prej disa vjetësh, dukej një vatër e ngrohtë, e lumtur, e ngritur me përpjekjet, me punën dhe me djersën e të dy bashkëshortëve. Dy fëmijët, dy vajza, po rriteshin të forta, të shëndetëshme e të lumtura, të rrethuara nga kujdesi dhe dashuria e të gjithëve. Punët dhe jeta po shkonin si jo më mirë, kur një ditë prej ditësh, Violeta vuri re përsëri një farë ftohtësie në qëndrimin e të shoqit. Në fillim, qëndrimi i Petritit nuk i bëri asaj ndonjë përshtypje të madhe, sepse me të kjo ndodhte shpesh dhe shpjegohej me krizat e lehta nervore periodike që e zinin. Rrinte i mërzitur dhe i heshtur. Mirëpo kur u bë kjo gjendje më e theksuar, kur filloi ai të sillej ftohtë edhe me fëmijët, natyrisht kjo rrethanë e re nuk kishte sesi të mos e shqetësonte bashkëshorten.

Violeta e pyeti disa herë të shoqin për gjendjen e tij shëndetësore dhe e nxiti sa e sa herë që të shkonte për t'u vizituar tek nevrologu, por i shoqi nuk pranonte në asnjë mënyrë. Violetës i ishte mbushur mendja top se edhe kësaj radhe Petriti ishte i sëmurë dhe se kriza e nervave kësaj here ishte jo vetëm më e gjatë, por edhe shumë më e fortë. Me këtë e shpjegonte ajo edhe faktin që vazhdimisht i shoqi grindej me të edhe për gjënë më të vogël, që ai refuzonte vazhdimisht të dilte shetitje me të, të shkonin bashkë në kinema, teatër, estradë ose për urime ose për ndonjë shkak tjetër, tek ndonjë njeri i tyre, shok ose shoqe, etj.

Asaj nuk i vinte aspak çudi edhe kur i shoqi u përgjigjej me fjalë të rënda propozimeve të saj për të shkuar këtu ose atje: «Po pse, qenka thënë që të dalim gjithmonë së bashku? U bë bajate kjo punë! U bë si gjella pa kripë! Shko ku të duash, me kë të duash dhe për mua mos pyet më!...» Atij i pëlqente shumë të dilte vetëm... Violeta e shikonte e trishtuar dhe shpesh i mbusheshin sytë me lot. «E ka fajin sëmundja! Eh ç'bën e shkreta sëmundje! Shpesh vetmija është shok i pandarë i sëmundjeve nervore. S'ka gjë, së fundi do të zbutet, — thoshte me vete Violeta, — do të bindet dhe do të shkojë tek nevrologu për t'u kuruar». Dhe ajo me siguri do të kishte vazhduar për një kohë të gjatë me këto mendime, sikur të mos kishte vënë re disa sjellje e qëndrime të bashkëshortit, që sinjalizonin

qëndrím attitude
krízë crisis
i mërzítur despondent; bored
nuk kíshte sesí could not help but
nevrológ neurologist
i íshte mbúshur méndja top was totally convinced
estrádë variety show
për uríme for social calls
me fjálë të rënda insultingly
bajáte stale
mosmarrëvéshje misunderstanding
telásh hang up; worry; problem
brávë lock
i kýçur locked up

për diçka tjetër. «E po këto nuk duhet të jenë nga sëmundja, — thoshte me vete ajo. — Prapa këtyre sjelljeve e qëndrimeve ka mundësi që të jetë nëonjë shkak tjetër, që unë nuk e di akoma». Mos vallë i shoqi kishte ndonjë mosmarrëveshje ose telashe në punë? Pak kohë i u desh Violetës që të sqaronte se në këtë drejtim asgjë s'kishte për t'u shqetësuar. Mos vallë ky qëndrim kishte lidhje me personin e Violetës vetë? Dhe Violeta kaloi nën kontroll gjithë sjelljet e saj në punë, në familje e në shoqëri dhe asgjë të keqe dhe për t'u qortuar nuk gjeti në të. Po edhe sikur të kishte gabime në sjelljet e saj, përse i shoqi nuk ia thoshte dhe nuk e kritikonte, siç bënte më parë?

Violeta u përpoq disa herë që të gjente çelsin për të hapur bravën, që mbante të kyçur gojën e Petritit, për të zbërthyer të fshehtën që ndrydhte brenda i shoqi. Prandaj vuri në përdorim të gjitha aftësitë e saj si njeri, si femër, si bashkëshorte dhe si nënë e dy fëmijëve. Futi miq e futi shokë, të afërm e far' e fis; por pa dobi, i shoqi rrinte i heshtur si varri dhe i ftohtë si akulli.

Natyrisht kjo nuk kishte si të mos ndikonte për të keq në të gjithë jetën familjare dhe t'u binte në sy edhe fëmijëve, të cilët kishin kuptuar se midis nënës dhe babait kishte diçka që e prishte tërë qetësinë familjare dhe gëzimin e shtëpisë. Nga ana tjetër, kjo atmosferë e nderë në familje nuk kishte sesi të mos ndikonte edhe në punën e Violetës, gjë që kishte sjellë si pasojë që shpesh herë ajo të mos i kryente si duhet porositë e drejtorit, punën e ngarkuar dhe detyrat e saj.

Kishte kaluar një muaj nga dita që Violeta vrejti shenjat e para, të ftohtësisë tek i shoqi, kur një ditë prej ditësh...

2.

...Një ditë prej ditësh ajo dolli nga zyra gjysëm ore para mbarimit të orarit zyrtar. Do të shkonte në një ndërmarrje për të marrë diçka për zyrën. Me të dalë në rrugë, ajo u takua ballë për ballë me një shoqen e saj të ngushtë, me Shpresën. Duke ecur rrugës, ajo e pa të udhës t'i hapte zemrën shoqes së saj të vegjëlisë dhe, për habinë e saj, vuri re se Shpresës nuk i bëri aspak përshtypje tregimi i Violetës. Po kjo si shpjegohej? Mos vallë shoqja e saj dinte diçka rreth marrëdhënieve të saj me burrin? Dhe me të vërtetë Violeta kuptoi se Shpresa diçka dinte dhe e fshihte. Violeta e inkurajoi shoqen me shikimin e saj.

përdorím operation; use
vréjti = vëréjti noticed
orár time schedule
zyrtár official
ajó e pa të údhës she found it advisable
inkurajój encourage
mikéshë female friend
shqéu sýtë opened her eyes in pain
tákë sole
mëngë sleeve
tríko sweater
gríndje strife
ves vice; habit
kafshój bite
shúmë e ka tráshur has gotten very familiar
i përkóhëshëm = i përkóhshëm temporary

Shpresa i kaloi krahun Violetës dhe, duke i peshuar fjalët një e nga një, me zë të ulët, sikur po fliste me vete, i tha:

— Shiko motra ime! Unë kam dashur të të flas kohë më parë, por të të them të drejtën, kam pasur frikë. Pastaj s'më besohej, bile as edhe tashti s'më besohet...

Violeta qëndroi në vend, sikur ta kishte tërhequr njeri nga prapa.

— Çfarë the? — pyeti ajo e habitur, duke mvrenjtur vetullat; — ke pasur frikë? Përse? Nuk të besohet, për çfarë? Dhe i tundi fort krahun mikeshës së saj.

— E di, Violeta, — vazhdoi ajo duke e tërhequr atë për të vazhduar rrugën — të mos nxitohemi, mund të mos jetë e vërtetë; ndoshta më kot flasin bota...

Violeta shqeu sytë, gjunjët iu prenë dhe këmbët iu rënduan, sikur takat e këpucëve t'i kishte prej plumbi. E kapi Shpresën nga mënga e trikos dhe i bërtiti:

— Çfarë mund të mos jetë e vërtetë? Përse flasin bota?

Shpresa u zu keq, por ishte tepër vonë për t'u tërhequr prapa. Tashti duhej t'i shkonte çështjes deri në fund, ta vinte në dijeni shoqen e saj të ngushtë. Megjithatë, Shpresën e shqetësonte diçka, po sikur të mos ishte e vërtetë? Atëhere do të fuste pa të drejtë grindje në familje; veçse sikur puna të ishte në fillim, a nuk kishte mundësi që të shpëtohej familja?

Violeta u mat diçka të thoshte, por Shpresa i preu fjalën...

— E di, e di ç'do të më thuash. Por unë e njoh mirë Petritin, i di veset e tij, por kësaj radhe, mua më duket ndoshta është vetëm përshtypja ime dhe kështu uroj që të jetë, por s'e besoj...

Violeta u drodh sikur ta kishte kafshuar gjarpëri.

— S'e beson? Çfarë?

— Ai Petriti yt sikur shumë e ka trashur me një shoqe që punon me mua. Vjen e takon shpesh. Shumë herë e merr në telefon. E kanë parë natën me të edhe duke e shoqëruar në shtëpi... E quajnë Adelina Shkëmbi... Mund të jetë edhe kjo ndonjë miqësi e rastit dhe e përkohëshme. Por unë kam frikë kësaj radhe. Dhe Shpresa bëri përshkrimin e tipareve të Adelinës.

Violetës iu duk sikur dikush ia ngjeshi turinjve me një dackë të fortë, ndërsa nga balli filluan t'i dilnin djersë të ftohta. U mbështet fort mbi krahun e Shpresës, ndryshe

turí face
dáckë slap
rrëzój bring down
rrëzóhem fall
tállem joke; jest
shpif lie; fabricate stories
pispillósem spruce up
mënjanój avoid
trullós daze; stun
pallát appartment complex
u prénë were taken aback
i výshkur wilted
ngadhnjimtár victorious
dyluftím duel

do të ishte rrëzuar. Vërtet? A ishte e mundur kjo? Petriti donte një grua tjetër? Mos tallej shoqja e saj dhe mos shpifnin bota nga inati? Jo, ajo nuk tallej, ajo fliste seriozisht. Pra kjo na qënka arësyeja e kësaj ftohtësie. Prandaj ai pispillosej dhe nisej aq shumë, kur dilte në pazar! Kjo na qënka arësyeja që ai rrinte shpesh natën vonë përjashta! Aha! Tashti po e kuptonte ajo përse Petriti përpiqej të mënjanonte shikimet e saj... Ia kishte prishur mëndjen një femër tjetër! Prandaj nuk i afrohej më asaj! Një grua tjetër pas kaq vjet martese? — Këto pyetje e dyshime e trullosën fare.

Violeta u nda nga shoqja e saj gati pa u përshëndetur. Ecte sikur hiqej zvarrë. E ndjente veten shumë të këputur, koka i digjte dhe trupi i dhimbte, sikur ta kishte rrahur njeri me dru. Shpejtoi për në shtëpi. Çupat e pritën mamanë në oborrin e pallatit, duke kënduar këngën që asaj i pëlqente aq shumë dhe që ato, për t'u bërë qejfin prindërve, e këndonin të dyja së bashku, si rregull, çdo mbrëmje, përpara se të flinin. Por kënga mbeti në mes të rrugës. Fëmijët u prenë, kur panë se në buzët ende të bukura të nënës së tyre, mezi po lulëzonte një buzëqeshje e vyshkur dhe pa jetë. Ajo u përpoq të sillej me fëmijët ashtu si gjithmonë. U mundua t'i jepte zemër vetes. Por dhembja morale është më e fortë se ajo fizike dhe kjo e fundit, shumë herë del ngadhnjimtare në dyluftimin e saj të tmerrshëm me vullnetin. Violeta nuk mundi ta përmbajë dot veten dhe nga sytë e saj të bukur shkrepën disa pika lot. Doçka e vogël e vajzës së madhe u përpoq t'i fshinte dhimbjen dhe dëshpërimin. Kështu kishte parë nënën e saj të vepronte, kur kishte qarë ajo vetë ose motra e vogël.

Violeta u përpoq të qeshte, por as buzët dhe as fytyra e saj nuk iu binden urdhërit. Vajza e vogël, në mënyrë instinktive, pa e kuptuar dhe ajo vetë, me lëvizjet e saj të thjeshta dhe të padjallëzuara, u përpoq ta bënte për të qeshur nënën. Violeta u përpoq t'u përgjigjej dëshirës së fëmijëve dhe qejfit të tyre, bëri çmos që të luante rolin e aktorit në skenë duke u shtirë sikur po argëtohej dhe po zbavitej me lodrat e së bijës. Por dukej qartë se ndërsa fytyra e saj përpiqej të qeshte, brenda, thellë në shpirtin e saj, ajo qante e qante me dënesë.

Ajo ushqeu fëmijët shpejt e shpejt, i zhveshi dhe i vuri të flenë më herët se zakonisht. Çupat iu binden në mënyrë mekanike urdhërave të saj. Violeta u shtri herët në krevat dhe vuri të gjitha forcat e saj që ta zinte gjumi, por ishte

dóçkë little hand
i padjallëzúar innocent
qejf pleasure
argëtóhem have a good time
zbavít amuse
dënésë sob
dyshék mattress
tru brain
çthur = shthur unravel
i lezéçëm = i lezétshëm attractive
përvëlónjës scorching
nallán = nallëne sandal
bezdís bother
spic well groomed
i porsaárdhur just arrived
i páshëm good-looking

e pamundur. U përpoq tërë natën në dyshek si peshku në rërë. Dhe truri filloi të çthurë fillin e kujtesës, e kaluara nisi të kthehej me shpejtësi, në dukje ose në të vërtetë, ndoshta po me atë shpejtësi me të cilën kishte kaluar.

... E shihni atë vajzën e lezeçme, që ecën anës së rrugës dhe përpiqet t'u shmanget puthjeve të rrezeve përvëlonjëse të diellit? Nuk e njihni? Shikojeni me vemendje! Do ta njihni, sepse nuk ka ndryshuar shumë, sepse nuk ka kaluar shumë kohë nga ajo ditë, vetëm njëmbëdhjetë vjet! Është Violeta, që kthehet nga puna në shtëpinë e saj...

Violeta u zhvesh, hëngri bukë me nxitim, mbathi nallanet dhe vrapoi në çezmën e madhe, për të mbushur ujë të ftohtë për gjyshen. Kapërceu me nxitim rrugën dhe, pasi u fut në një rrugicë, u ndodh përpara çezmës. Por atje kishte njerëz dhe ajo u detyrua të priste. Me gjithë se priti pak, asaj iu duk sikur priti shumë, sepse e bezdiste me shikimet e tij ngulmonjëse një burrë i ri, i lezeçëm, me mustaqe spic, veshur pak sipas modës. Ajo i njihte të gjithë banorët e lagjes dhe burri i panjohur, si duket, ose kishte ardhur mysafir tek ndonjë banor i lagjes, ose ishte i porsaardhur në atë lagje.

Violetës kjo nuk i bëri shumë përshtypje. Edhe djem e burra të tjerë e kishin shikuar dhe e shikonin pa ja ndarë sytë; bile kishte dhe nga ata që e kishin ndjekur nga prapa, gjoja si rastësisht. Punë e madhe! Për gratë dhe vajzat e bukura gjenden kurdoherë burra që u vinë rrotull dhe që përpiqen të njihen e të afrohen me to.

Violeta e pa dhe disa herë të tjera djaloshin e pashëm, por nuk ja vuri veshin. Takime të rastit! Po kur ajo vuri re se pothuaj përditë djaloshi e priste në të njëjtin vend, këto nuk mund t'i quante më takime të rastit. Domethënë se djaloshi i pashëm e priste dhe interesohej për të! Po kush ishte ky? Violeta as që e njihte dhe as që e dinte se kush ishte, nga vinte dhe çfarë bënte në atë lagje. Si duket, djaloshi ishte shumë i zgjuar sepse u bë si u bë, se si u ngatërruan punët dhe ai e gjeti rastin që të njihej me Violetën. E quanin Petrit Argjenti. Pastaj ngjau ajo që ngjau. U dashuruan! Atëhere sikur u bë tjetër njeri.

Këto ndryshime nuk kishin se si të mos binin në sy të nënës, gjyshes dhe motrës së saj. Për më tepër, e ëma u bë merak dhe u sigurua vetëm atëhere kur dikush nga gratë e lagjes i tregoi ç'kishte parë e ç'flitej në lagje për Violetën.

u bë si u bë whatever happened
zaptój capture
ndermjétës match maker
çapkën rascal
luks luxury
búrrë xhevaír (=xhevahír) jewel of a man
akóma te úra you're still naive
beqár bachelor
s'i kíshte lënë kusúr kësáj púne he lived a promiscuous life
m'u prish púna, it bothered me (said sarcastically to mean the opposite: "it didn't bother me!")

Vajza paska rënë në dashuri! Po pse nuk flet ajo? Po pse ç'jemi ne? Fanatike jemi që ta pengojmë vajzën të martohet me atë që do? Po kush na qënka ky që paska zaptuar zemrën e çupës?!

Një ditë prej ditësh në shtëpinë e Violetës hyri një burrë i moshuar: Ishte ndërmjetësi, që kishte ardhur për të bërë kërkesën sipas rregullit dhe zakonit, megjithëse të gjithë i dinin lidhjet midis saj dhe djaloshit.

Violeta nuk i fshehu asgjë nënës kur ajo e pyeti. Por ajo nuk i fshehu gjithashtu dhe ato që kishte dëgjuar për Petritin. I kishin thënë se ishte një tip çapkëni, që i pëlqeka qejfi, pijet, luksi.. .Duke ja thënë këto Violeta mendoi për një çast se e ëma do të mbante qëndrim negativ, por ndodhi e kundërta.

— Kemi pyetur edhe ne për djalin. Ka pyetur babai edhe unë. Po! Po! Mos u çudit! Babai i di të gjitha! Ai ka shkollë, ka zanat, ka një punë shumë të mirë dhe kjo ka shumë rëndësi. Burrë xhevair në radhë të parë nga puna që ka. Pastaj ai e ka babanë në gjendje shumë të mirë.

— Po pse, paraja e bën njeriun të lumtur? — ja preu fjalën Violeta.

— Mirë! Mirë! Llafosu ti. Akoma te ura. Ato ja u thuaj të tjerëve e jo mua! Po pse keq jetova e po jetoj unë me babanë tënd? Kështu është jeta. Kur më martuan mua, as që më pyeti njeri. Unë s'e kisha parë burrin. Por im atë u nis nga ajo që yt atë kishte para mënjanë të lëna nga babai, kishte një dyqan dhe zanat.

— E po, ka edhe të tjera, — deshi të vazhdonte Violeta.

— E di! E di! — Ja preu e ëma. — Po burrat kështu e kanë. Edhe unë kisha dëgjuar se kur qe beqar, yt at s'i kishte lënë kusur kësaj pune. Kështu fliste bota... Po mua ç'më pengoi kjo? Ja, u martova, u trashëgova, të më rrojë burri, djali, ti dhe Shpresa. Do të merresha unë me fjalët e botës... M'u prish puna!...

Violeta tundi kokën.

— Mos më tund kokën! Sa do që të thoni e të bëni ju, burrat do të mbeten burra dhe gratë do të mbeten gra! Burri do të pijë, do të dëfrejë, prandaj dhe i thonë burrë...

— Mua më pëlqen shumë si djalë dhe unë, më fal nënë që po ta them, ti vetë ma hape, edhe unë s'kam kujt t'ja them e t'ia shpreh ato që kam në zemër, përveç teje. Unë e dua shumë atë, por ma prishin qejfin të gjitha ato që thonë për të...

zilí envy
gardh fence
krushqí in-law
gjynáh sin
na bëke édhe náze you're fuzzy, on top of it all
surrát face
prútë brought
lavíre tramp; whore
máshë tongs
t'i përshésh turínjtë I'll smash your face
dájo uncle
téka idiosyncracy; whim
thúndër heel
manjetík magnetic
gjilpërë needle
i volítshëm convenient
vjéhërr father-in-law

— Lere se ç'flasin bota! Të kanë zili, se të ka vënë synë një alamet djali! Mos i dëgjo llafet e botës, sepse gojët e botës dhe vrimat e gardhit nuk mbyllen kurrë... Pastaj unë nuk marr vesh një gjë. Ne në kohën tonë nuk flisnim kurrë keq për krushqitë, sepse kush prish një krushqi, bën një gjynah të madh...

Kurse gjyshja ja preu me sëpatë të madhe:

— Oj, Oj, — i tha ajo të mbesës; — na bëke edhe naze! U bë surrati yt që të na mësojë... Bota flasin nga zilia. S'i pëlqeka surratit tënd! Po ti ç'e kujton veten? E bukura e dheut? Po a je parë në pasqyrë? E ke parë atë hundën, që ma ke si patate? Ju të rejat e të rinjtë na i prutë këto. Ne as na ka pyetur njeri dhe as i kemi thënë njeriut për burrë. Edhe pas martesës, dhjetra vjet me radhë, gruaja nuk lejohej të përmëndte emrin e burrit, kurse ju tashti i zgjidhni vetë e na bëni edhe llafe! Pse mos do të bësh si ato laviret që ikin nga shtëpia fshehurazi dhe shkojnë te burri! — e duke ngritur mashën e zjarrit i bërtiti: — Llafe nuk dua, se po ta përvesh me këtë e të t'i përshesh turinjtë...

Violeta e bisedoi këtë çeshtje edhe me dajon e madh, me të cilin kishte më tepër afrim. Dajua e dëgjoi me durim dhe ja mbylli bisedën.

— Ti je shumë e re akoma dhe nuk mund të mendosh thellë! — Pse ne të gjithë të duam të keqen ty? Ne përpiqemi për të mirën tënde! Ti s'mund të gjykosh si ne dhe sa ne! Burri ka veset e tija, ka tekat e tija, pse i thonë burrë!

Violetës i erdhi turp nga vetja. Iu duk sikur po luante teatër Violeta me Violetën dhe me njerëzit e saj; sepse ajo e ndjente veten qysh tashti nën thundrën e Petritit dhe ai e tërhiqte atë me forcën që tërheq një fushë e fuqishme manjetike gjilpërën...

Pati edhe raste lëkundjeje në shpirtin e saj vajza e re, por këto ishin lëkundje të vogla e të parëndësishme, të cilat në vend që të dobësonin themelet mbi të cilat ishte ngritur godina e dashurisë, duke e tundur atë, sikur e vendosën në një vend më të sigurtë, më të përshtatshëm dhe më të volitshëm.

Viti i parë i martesës kaloi gjithë qejf dhe shëtitje dhe vjenrri i Violetës nuk pranonte në asnjë mënyrë që nusja të shkonte në punë, por, i kështilluar nga miqtë e tij, më në fund e lejoi të punonte. Ata s'kishin nevojë për para.

mosdërgím not sending
mund të rëndónte pozítën might have had a bad effect on his position
qétë qétë quite calmly
shákull bag made of skin
vërdállë in a roundabout way
sherr quarrel
flakurímë slap
duró be patient
i durúari, i trashëgúari he who is patient wins out (becomes "the inheritor")

Por mosdërgimi i nuses në punë, kishte mundësi të merrej për të keq nga të tjerët dhe kjo mund të rëndonte pozitën e vjehrrit, të cilin kishin filluar të mos e shikonin me sy të mirë.

3.

Edhe pas lindjes së vajzës së parë, i shoqi vazhdoi me qejfet, dëfrimet e pijet e tij. Violeta i kishte tërhequr disa herë vemendjen për këto sjellje e qëndrime, por sa herë që hapte biseda të tilla, aq herë bëhej grindje; shamatë e madhe dhe një zhurmë e tillë, sa që tundej i tërë pallati. E pa më të arësyeshme të heshtëte nga turpi i botës. Dhe ajo heshti deri sa mbërritën në veshët e saj fjalë, se i shoqi shkonte me gra të tjera. Kjo i ra Vicletës ashtu siç mund t'i bjerë në kokë një send i rëndë një personi që ecën qetë-qetë rrugës... U përplas shakull në krevat e qau me ngashërim, me orë të tëra.

Pastaj u ngrit dhe me sytë e skuqura iu drejtua pasqyrës se madhe! Po pse, mund të tradhëtohej një grua e tillë kaq e lezeçme? Mos kishte ndërmend vallë Petriti ta ndante atë dhe të martohej me ndonjë grua tjetër? Po me sa gra do të martohej? Në mbrëmje Violeta e solli fjalën vërdallë dhe, kur pa që i shoqi filloi të dredhonte, ja përplasi në fytyrë. Po ku pranonte ai pa. Fol ajo e fol ai, bërtit ajo e bërtit ai dhe, së fundi, sherri pushoi me një flakurimë fytyrës, të cilën Violëta s'e harroi për vite me radhë. Ajo u këshillua edhe me t'ëmën. Mirëpo ajo ja mbylli çdo rrugë:

— Shiko punën, shtëpinë dhe çupat dhe të jesh grua e bindur, besnike dhe e urtë! Bëji rrugë burrit. Kështu ka qënë e kështu do të jetë... Duro se ky qe fati yt! Nuk thonë kot i duruari, i trashëguari... Burrit i falet! Do të vijë në rrugë të mbarë! Se mos bësh ndonjë gabim e i thua ndonjerit për të ndërhyrë! E prishe me burrin, e bëre hasëm dhe të mori lumi, do të mbetesh pa burrë dhe gruaja pa burrë është si njeriu pa çati... Pa shiko, ke akoma shoqe vërsnike të tua pa martuar... Burri nuk është gjë e vogël, është nderi i gruas dhe çobani i saj! — i tha e ëma.

Violeta u kthye në shtëpi pik e vrer. U përpoq edhe disa herë të tjera ta sillte të shoqin në rrugë të drejtë, duke i folur me të mirë e me të keq, me zë të ulët e duke i bër-

hásëm = hasm enemy
pik e vrer really upset
qyrék bellows
i dërmúar shattered
kurórë wedding crown

titur, por sa më tepër që ngulte ajo këmbë, aq më tepër kjo këmbëngulje shërbente si qyrek që i frynte zjarrit, duke e ndezur atë më shumë e më shumë. Violeta u tërhoq nga fusha e betejës e thyer dhe e dërmuar, duke mbajtur në dorën e saj fort, të vetmen gjë që mund të shpëtonte tashti për tashti: kurorën ....

Edhe pas lindjes së fëmijës së dytë, i shoqi vazhdoi romuzet e tij. Violeta tashti i ishte shtruar fatit. Koha e vitet do ta rregullonin atë e do ta sillnin në rruge të mbarë dhe, duke u plakur avash avash, do të ndreqej.

Kishte vendosur t'i hante kokën me të mirë të shoqit, duke u shtirë sikur nuk kishte parë e dëgjuar gjë. Bile edhe shoqet e saj i ndaloi të flisnin për sjelljet dhe qëndrimin e Petritit.

Fjalimi i 6 shkurtit, i shokut Enver, tundi gjithë Shqipërinë dhe ngriti në këmbë të madh e të vogël, burra e gra, pleq e të rinj në luftë për të drejtat dhe për emancipimin e plotë të gruas, për shkuljen nga rrënjët të zakoneve prapanike dhe të sjelljeve e qëndrimeve që nuk përputhen me normat e moralit komunist. Avulli i nxehtë i këtij fjalimi filloi të shkrijë dalë nga dalë akullin që kishte zënë vend në zemrën e Violetës. Por ai ishte akull shumë i fortë, sikur të kishte shekuj që ishte vendosur atje... Megjithatë, Violeta nuk po lëvizte nga vendi dhe nuk fliste edhe në ato raste, kur shokë e shoqe të qendrës së punës ku punonte Petriti, e pyesnin herë pas here, se si shkonte me burrin, si i kishte marrëdhëniet me të. — «Po këta pse pyesin? — thoshte Violeta me vete. — Me siguri Petriti është ngatërruar përsëri me ndonjë femër...»

Kështu Violeta jo vetëm që nuk fliste dhe nuk ankohej për të shoqin, por përkundrazi ajo e ngrinte në qiell dashurinë që i shoqi ndjente për të... «E po kur shkojnë mirë, — thoshin shokët e shoqet e kolektivit të Petritit dhe të organizatave të masave, — përse të bëhemi shkak ne që të prishet familja?»

Shpesh, në mbrëmje, Petriti kthehej i skuqur e tërë inat. Si duket ja skuqnin veshët në punë. Prapë me femra? Po ç'të bënte ajo, ai e kishte ves këtë! I kishin zënë këmbët fëmijët dhe e pengonin... Po kjo vetëm e pengonte? E he sa herë e kishte shkelur ai, por ajo ja kishte falur... E kishte babanë e dy fëmijëve. Prandaj s'kish faj njeri. Fajin e kishte vetë ajo që e kishte bërë rrugë, e kishte duruar të shoqin dhe e kishte lejuar atë të vepronte si t'i donte qejfi.

romúzë illicit affair
t'i hánte kókën to win him over
shkúlje tearing out
drójtje hesitation
i dënúar condemned

Edhe ajo vetë nuk e shpjegonte dot përse e ndjente veten aq inferiore kundrejt të shoqit, — përse i trembej atij dhe ç'ishte kjo frikë. Se mos ishte e vetmja ajo. Si ajo kishte dhe shumë të tjera. Mos vallë edhe ajo, si shumë shoqe të tjera, trashëgonte një pjesë të asaj frike dhe drojtje të madhe që gjeneratë pas gjenerate e brez pas brezi kishte kaluar nga nëna tek e bija dhe nga e bija tek e bija. Asaj shumë mirë i kujtohej kur nëna e saj, megjithse ishte e kaluar në moshë, i rrinte të shoqit në këmbë, si nuse e re dhe i shërbente atij; pa le pastaj vjehrrit e vjehrrës. Frika e ndarjes i paralizonte gratë ashtu siç tmerron pamja e litarit të dënuarin me vdekje. Frika e ndarjes i bënte ato që të heshtnin dhe t'i duronin të gjitha. Burrat mund t'i rrihnin, mund t'i shanin gratë dhe ato jo vetëm që nuk revoltoheshin e nuk ankoheshin, por e quanin këtë si krejt të natyrshme. Burrit, themelit të shtëpisë, i lejohej gjithçka.

Shumë kishte bërë kjo parti dhe shumë po bënte për to. Dora e fuqishme e saj u ishte shtrirë të gjitha grave, por akoma vargoj të padukshëm u rëndonin mbi supe dhe i pengonin ato të ecnin me ritmin e kohës. Dhe sa kohë do të vazhdonte kështu? Edhe ajo vetë e kuptonte se duhej një luftë akoma më e fortë nga ana e saj për t'i zhdukur fare këta vargoj, këto mbeturina të skllavërisë së kaluar; mirëpo ndjente përbrenda ende frikën e hijes së burrit... Por krahas kësaj frike papritur e pakujtuar, ajo ndjeu një frikë tjetër. Po sikur me gjithë mend të kishte dashuruar ai ndonjë grua tjetër? Violeta u tmerrua dhe u drodh, sikur të kishte parë ndonjë ëndër të llahtarshme. Sikur ta ndante ai e ta linte qyqare me të dy fëmijët. Ja, kjo nuk i kishte shkuar kurrë ndërmënd. Vërtet u trondit tmerrësisht. Ah sikur ta kishte pranë të shoqin! Do ta shqyente! Por ai ndodhej larg, e kishin dërguar me shërbim. Filloi ta urrejë tmerrësisht.

Violeta shkoi në zyrë e shqetësuar më tepër se kurrë...

Veli Budo, "Dinjiteti" Nëndori (Tiranë), XVI, 7 (July) 1969 pp.83-92

qyqár miserable; pitiful
shqýej tear up

4.

... Të pasnesërmen Petriti u ktnye nga shërbimi dhe, siç e kishte bërë zakon kohët e fundit, mezi e përshëndeti të shoqen, u kaloi dorën mbi kokë dy çupave, sikur i përkëdheli, u rrua shpejt e shpejt, ndërroi kostumin dhe u lëshua poshtë shkallëve. Ku po shkonte? Violeta, ashtu siç ishte me rrobat e shtëpisë, ju vërsul nga mbrapa duke e ndjekur në një distancë të afërtë. Ec ai dhe ec ajo... Petriti nxitoi në drejtim të bulevardit të madh, preu nga e djathta dhe qëndroi tek stacioni u autobuzave, ku u takua me një grua të re. Takim i rastit? Kush ishte ajo? Pastaj të dy muarrën drejtimin nga rruga e Elbasanit. Violeta u afrua me shumë marifet dhe dalloi tiparet e gruas së re. S'kishte më asnjë dyshim, ajo vetë ishte... Tamam ashtu siç ia kishte përshkruar Shpresa. Violeta shtrëngoi dhëmbët. E kishte kapur me presh në duar. Deshi t'ja ngjeshte me një pëllëmbë surratit; por u përmbajt duke iu trembur një skandali.

Violeta vrejti se gruaja që shoqërohej me burrin e saj ishte shumë e re, mjaft e lezeçme dhe e veshur mirë. Prandaj ai i thoshte shpesh Violetës si me të qeshur dhe si seriozisht: U plake, Violeta! Shkove dhe ti! Kurse unë... unë jam akoma mjaft i ri... Dukem sikur jam më i ri nga ty!...

Tashti filloi të kuptojë se nuk ishin pa kuptim fjalët që i thoshte i shoqi, se ajo nuk dinte të mbahej. Vërtet Violeta nuk i kishte qejf nisjet e tepërta, por ajo nuk ishte gjithashtu nga ato gra që në shtëpi rrinë mos më keq, pis e të pakrehura, kurse rrugës të marrin në qafë me nisjet, sa që ai që i ka parë vetëm në shtëpi, zor se mund t'i njohë përjashta... Violeta mbahej, nisej e vishej ashtu siç e kërkonte mosha dhe këtë e bënte jo aq për burrin, se sa për të qenë në rregull me veten e saj... Por s'ishte halli këtu...

... Të nesërmen Violeta e mbajti vrapin te zyra e Shpresës dhe pa frymë, e zverdhur dhe e dërmuar, u përplas në kolltukun e saj.

Shpresa ngriti kokën dhe pa sytë e lagur të Violetës U përpoq ta qetësonte, por ajo vazhdonte të qante. Shpresa u çua, mbylli derën e zyrës nga brenda, iu afrua Violetës dhe, duke vënë dorën në sup, i tha me zë të butë:

— Përse po qan?

rrúhem shave
marifét agility; cleverness
presh leek
kap me presh në dúar catch with the goods on
shkóve dhe ti you've shot your wad

Violeta i tregoi shoqes me ngashërim fill e për pe historinë e një nate më parë dhe bisedën që kishte pasur me të shoqin. I shoqi, si gjithnjë, e kishte mohuar këtë fakt, por i kishte qëndruar i ftohtë akull.

— Tani u binda, se ai s'më ka dashur kurrë! Se ai ndofta me këtë Adelinë do të donte të martohej, e pastaj ta braktiste përsëri si atë! Por unë, — bërtiti duke përplasur dorën mbi tavolinën e vogël, — nuk ja jap kurorën, të ngordhi qeni!

— Unë nuk pajtohem aspak me sjelljen e qëndrimin e tij, përkundrazi i dënoj ato. Por ka një llogjikë këtu... Pse, me zor do ta mbash ate? S'ka forcë dhe ligj në botë që ta detyrojnë njerin ose tjetrin të dashurojë apo të dojë dikë, kundër vullnetit të tij, sa për kurorën, vazhdoi të flasë ajo, për mendimin tim nuk ka shumë rëndësi nëse njeri apo tjetri bashkëshort e jep apo nuk e jep ate; rëndësi vendimtare ka fakti, në se familja qëndron në këmbë mbi baza të shëndosha, apo është prishur, pa shpresa për t'u ngritur përsëri. Shoqëria nuk ka asnjë interes që të mbajë të lidhura familje, që janë të tilla, sa për formë, sa për sy e faqe. Firma në zyrën e gjendjes civile nuk është gjithçka; kryesorja është dashuria për njeri tjetrin...

Violeta e shikonte me vemendje të madhe.

— Dhe tashti dëgjomë mua, motër! — vazhdoi Shpresa, — unë dje e kapa vetë Adelinën dhe bisedova gjër e gjatë me të. Kur e pashë se nuk po dëgjonte, e shava dhe nuk i lashë gjë pa thënë. Po, e di se ç'm'u përgjigj. Nuk e merr dot me mend? Më tha se dashuroheshin dhe se do të rronin të lumtur me njeri tjetrin. Mua s'm'u durua dhe i thashë se nuk ishte aspak e drejtë dhe e ndershme të ndash gruan nga burri dhe babanë nga fëmija, të ndërtosh lumturinë tënde mbi fatkeqësinë e të tjerëve. Budallaqe. i thirra unë. Ti nuk e njeh atë! Ti nuk i di veset e tij! Unë e njoh mirë, se e kam patur fqinj dhe sot burrin e shoqes sime të ngushtë. Ti e sheh atë kështu, vetëm në jetën e tij të jashtëme. Adelina më shikoi nga lart poshtë, sikur me këtë desh të thoshte se ajo nuk ishte punë për të. S'i bënë asaj asnjë përshtypje fjalët e mia. Përkundrazi qeshi dhe mblodhi supet. Atëhere u zemërua edhe më shumë. «E po ç'pandeh ti, i thashë me zë të lartë, — se kundër Petritit kolektivi e shoqëria do të rrinë duarkryq dhe nuk do të mbajnë qëndrim? Po kundrejt teje, nuk do të merret ndonjë masë?»

nísje preening; grooming; dressing up
pis dirty
i pakréhur unkempt
ngashërím pain
fill e për pe from beginning to end
(le) të ngórdhi qeni let the dog die
diké someone
nësé whether
për sy e fáqe for appearances
fírmë signature
dje yesterday

Ajo u largua duke buzëqeshur me ironi dhe ashtu nga larg, më bërtiti: «Do të jetoj e lumtur me të edhe në një kasolle në majë të malit». Desha t'i bërtisja dhe t'i thoshja, se kjo ishte një fjalë goje, pa ta provonte një herë; por ajo ishte larguar mjaft.

Violeta pa folur, u ngrit dhe u bë gati për të dalë nga zyra, kur Shpresa e ndali me një të lëvizur të dorës.

— Pa dale, — i thirri ajo, — prit pak! Moj ti! Po përse nuk kërkon ndihmën e kolektivit të qendrës së punës, si të asaj tëndes, ashtu dhe të Petritit? Kërko ndihmën e Frontit të lagjes dhe të organizatës së gruas. Drejtoju partisë!

Violeta tundi kokën.

— S'ke besim tek forca e tyre? — përsëriti Shpresa.

— S'e kam fjalën këtu, por mendoj se ndërhyrja e tyre do të sjellë më shumë dëm se sa dobi, sepse do të bëhet bujë dhe çështja do të marrë karakter zyrtar. Pastaj do të merret vesh nga të gjithë dhe kjo do ta zemërojë më shumë Petritin. Kam shpresë ta kthej përsëri pranë meje, me ndërhyrjen e shokëve dhe miqve të tij.

Shpresa mblodhi supet.

... Violeta u përpoq të paraqitej sa më e qetë në punë, por me gjithë përpjekjet e saj, kujtdo mund t'i binte në sy gjendja shpirtërore dhe vuajtjet e saj.

Duke punuar, vuri re se zv. sekretarja e komitetit të partisë, shoqja Donika, disa herë me radhë i kishte vajtur në zyrë dhe kishte bërë përpjekje për të hapur bisedë me të. Violeta u kishte bërë bisht pyetjeve të zv. sekretares dhe këtë e kishte bërë duke u nisur nga fakti se kjo mund të merrej si ankim nga ana e saj dhe, po ta merrte vesh Petriti, do të zemërohej akoma më shumë dhe kështu do të mbyllej çdo rrugë për t'u pajtuar. Ajo kishte shpresë akoma se i shoqi do të vinte në vete.

Violeta bëri çmos për t'iu shmangur një bisede serioze me Donikën, por më së fundi, me gjithë përpjekjet e saj, nuk qe e mundur t'i shmangej bisedës.

— E dijmë, e dijmë të gjithë historinë, — i tha asaj Donika, — dijmë gjithë rrjedhimin e çështjes dhe po të njoftoj se kemi ndërhyrë, pa na thënë ti, si parti e si pushtet, si front e si grua, si nga qendrat e punës ashtu dhe nga lagjia dhe kemi bërë të gjitha përpjekjet, por Petriti nuk pranon në asnjë mënyrë se ka bërë ndonjë të keqe. Ti ç'mendon të bësh?

budallaqe idiot
një fjalë góje hollow talk
kujtdó anyone
zv. = zëvéndës deputy; acting head
u kíshte bërë bisht had evaded

— Unë? — u përgjegj me zë të dridhur Violeta, — unë jam gati t'ja fal të gjitha, vetëm të vazhdojmë jetën...

— Si t'ja falësh? — e ndërpreu Donika.

— T'ja fal gabimin, — tha Violeta në mënyrë të vendosur.

— Po sikur të ishe ti ajo që kishe vepruar në atë mënyrë, — e pyeti zv.sekretarja, — a do të ta falte yt shoq gabimin?

— Jo!

— Atëhere, përse ti ja fal atij? — përsëriti Donika.

— E po, ndryshe është burri, ndryshe është gruaja.

— Unë, u përgjegj, Donika, — nuk gjej asnjë ndryshim midis burrit dhe gruas në këtë drejtim dhe nuk shoh asnjë arësye për të justifikuar tradhëtinë e burrit dhe për të dënuar atë të gruas dhe jo vetëm unë, por e tërë shoqëria jonë nuk e pranon atë që thua ti. Këto që thua ti, janë mendime të ndryshkura, që i takojnë kohërave të kaluara, kur gruaja ishte skllave e shërbëtore e burrit. Ti, moj shoqe, si duket, nuk i ke kuptuar drejt mësimet e partisë e të shokut Enver për emancipimin e plotë të gruas. Duhet të rilexosh dhe jo vetëm një herë, por për disa herë me radhë materialet e partisë. Duhet të jesh më tepër revolucionare jo vetëm në punë, por edhe në jetë.

— Mirë thoni ju, shoqja Donikë, por unë jam nënë me dy fëmijë. E kush më merr mua?

— Edhe vetë shtruarja e problemit në këtë mënyrë, — tha duke tundur kokën zv. sekretarja e partisë, — është e gabuar dhe e shtrembër. Ç'do të thotë kush më merr mua? Po ç'je ti, lopë që shitesh në pazar? E qysh të të marrin? Mund të thuash: kush martohet me mua grua me dy fëmijë, megjithëse edhe kjo nuk është e drejtë. Pastaj c'është kjo frikë për të jetuar pa burrë? Ti ke profesionin tënd, ke duar të arta dhe mund të jetosh fare mirë me punën tënde, pa patur nevojë t'i shtrish dorën për ndihmë ndonjë burri! Ti je grua e zgjuar dhe duhet të kuptosh se çdo njeri, qoftë burrë ose grua, ka personalitetin e vet; ka dinjitet. Përse të përulesh kaq shumë? Kujt ia ke nevojën? Duhet të jesh më luftarake dhe më parimore. Kështu na mëson partia, të jemi revolucionarë në punë, në jetë e shoqëri! Dhe Donika i foli shumë dhe bisedoi me të gjatë, shumë gjatë...

njoftój notify
rilexój reread
parimór principled

5.

Violeta u kthye në shtëpi kësaj radhe akoma më e tronditur. Gjatë gjithë rrugës i kumbonin në vesh po ato fjalë. I dukej sikur të gjithë ata që flisnin thoshin po ato fjalë, sikur nga një megafon i madh dilte një zë i fuqishëm që përsëriste vazhdimisht: «Këto që thua ti janë mendime të ndryshkura... Nuk i ke kuptuar drejt mësimet e partisë e të shokut Enver. Duhet të jesh më tepër revolucionare... Ti nuk je lopë që shitesh në pazar...» Violeta zuri veshët me duar, por ai zë i fuqishëm dëgjohej përsëri po aq i fortë... I dukej sikur mijra sy e shikonin me inat dhe shigjetat që lëshonin ata sy e shponin drejt e në zemër... «Duhet të jesh më luftarake dhe më parimore edhe në jetë» thoshin ata sy me shikimet e tyre. Violeta shpejtoi hapin, ngjiti shkallët me nxitim, hapi derën dhe hyri brenda. U ndërrua me nxitim, u ul në shtrat dhe vuri kokën midis duarve. Tëmthat i rrihnin, sikur ta kishin zënë shtatë palë ethe... Goja i ishte tharë, sikur të kishte ditë të tëra që nuk i kishte njomur buzët me ndonjë pikë ujë.

Ç'duhej të bënte? Ç'vendim duhej të merrte? «Ta ndante ajo atë, se vetëm kështu do të vinte nderin në vënd!» mendoi me vetëdije.

Dera u hap me vrull dhe brënda vrapuan dy gocat duke qeshur e bërtitur. Goca e madhe u shqetësuar, kur pa nënën që qëndronte në atë mënyrë...

— Mami! Mami! — bërtiti ajo, — ç'ke? Mos je sëmurë? — dhe vajza ju hodh në duar. Po Violeta e shtyri lehtë.

— Mami është e sëmurë, i dhemb koka. — ju drejtua ajo fëmijve, — prandaj mos bëni zhurmë, se nuk ju dëgjoj dot, — u tha me një ton lutës.

— Po babi a s'paska ardhur akoma? — pyeti vajza e vogël...

— Babi, babi... — i tha Violeta duke iu marrë goja, — nuk është kthyer akoma nga shërbimi, do të kthehet shpejt.

Dhe Violeta hyri në luftë me Violetën. Beteja filloi me furi dhe përleshja e parë qe e tmerrshme. Kush do të fitonte? Forcat e errësirës i bërtisnin me zërin e tyre të llahtarshëm: Po ku do të mbytesh, moj e shkretë? Si do do ta ndash burrin, babanë e fëmijëve, me të cilin ke kaq vjet martuar? Po nuk e di ti se vetëm do ta kesh vështi-

tëmth temple
sikúr ta kíshin...éthe as if she were in great pain
gócë girl
u shqetësúar = u shqetësúa (mp.)
dúke iu márrë gójа stuttering
përléshje clash
si do do = si do (mp.)
mburójë shield
hedh në gjyq take to court
çúrkë in jets; in a stream

rë? Po nuk e di ti sa ndikon kjo për keq tek fëmijët? Burri është themeli i shtëpisë, mburoja e gruas dhe çatia! Si do të jetosh pa burrë? Ti do ta ndash atë? E qysh do ta hedhësh në gjyq? Mos e ndaj! Dhe lotët i ridhnin çurkë nga faqet dhe mjekra. Violeta tundëte kokën.

Violeta! Violeta! I fliste një zë nga thellësia e zemrës. Ishte e reja që i bënte thirrje. Po ç'je ti? Skllave e burrit? Kafshë? A nuk ke ti dinjitetin dhe personalitetin tënd. Mos iu trëmb jetës! Ti ke tërë shoqërinë me vete, ke partinë... Pse ke frikë të jetosh vetëm? A nuk ke profesionin tënd? A nuk ke punën tënde? Ndaje! Ndaje! Asnjeri nuk të dënon ty! Ti nuk je fajtore! Ai të la! Ai të tradhëtoi! Ai të ka përbuzur kurdoherë! Ai kurdoherë turpet e ndyrësitë e tij i ka fshehur nën kurorën tënde! Përbuze tani! Hidhe si leckë tej! Ndiqe!

Violeta u përmënd, kur dëgjoi zërin e çupës së madhe që po bërtiste dhe e tërhiqte nga mjekra:

— Mami! Mami! Mos fli këtu. Bjer në krevat...

Të nesërmen Violeta hyri në zyrë pak më e zbetë nga ditët e tjera. Megjithatë, shumë veta, që e njihnin nga afër, nuk mund të mos vinin re një farë ndryshimi në qëndrimin, sjelljen dhe fytyrën e saj. Po ç'ishte ky ndryshim? Asnjeri nuk dinte si ta shpjegonte.

Violeta kishte ulur kokën mbi shkresat dhe po punonte pa i ngritur sytë. Kishte një punë që kërkohej shpejt dhe, duke punuar kështu, në mënyrë intensive, ajo nuk u linte rast mendimeve të saj që ta sulmonin vazhdimisht...

— Shoqja Violeta, — i tha kryetarja e komitetit profesional, — të solla ftesën. Bashkë me disa shoqe të tjera do të shkoni sot mbasdite në pallatin e madh të kulturës. Organizohet një konferencë, ku do të flitet për një problem me rëndësi të madhe aktuale...

Violeta bëri një lëvizje të dorës së djathtë, duke dashur të shprehte me këtë se në gjëndjen që ndodhej ajo, nuk kishte kokë për të dëgjuar leksione...

Kryetarja e thithi menjëherë mendimin, që kishte ajo në kokë dhe për t'i prerë rrugën çdo diskutimi, i tha:

— Jeni caktuar nga komiteti profesional i uzinës, — dhe mbasi i vuri ftesën mbi tavolinë, u largua.

Violeta mori ftesën dhe e lexoi me zë të lartë. Tema e leksionit ishte: «Kanuni i Lek Dukagjinit — ligj' i skllavërisë së gruas»

ndáje divorce him
përbúz scorn; abuse
ndyrësí dirty doings
léckë rag
shkrésë written material; paperwork
ftésë invitation
mbasdíte in the afternoon
thith absorb
me një lëmsh...në kókë with a bigger headache
prejárdhje origin
referój speak; give a talk
pabarazí inequality

Pas konferencës, Violeta u kthye në shtëpi me një lëmsh më të madh akoma në kokë... Kështu qënka, ë? Fjalët që kishte dëgjuar nga të vjetrit, nga gjyshja, halla e tezja, nga plakat e pleqtë e lagjes, lidhur me detyrat dhe gjëndjen e gruas në shtëpi, familje e shoqëri, qënkeshin të vjetra, shumë të vjetra. Prejardhja e tyre zinte fill në thellësinë e shekujve, që nga koha e Lek Lukagjinit, ndoshta edhe më heret akoma.

Të shtunën mbas dreke, në klubin e uzinës një lektor i kabinetit të partisë referoi mbi temën «Feja mbrojtëse e pabarazisë shoqërore të gruas». Duke dëgjuar lektorin, Violeta tundte kokën herë pas here... E çuditëshme, shumë e çuditëshme! Kanuni dhe feja, që të dy predikonin pabarazinë e gruas, ligjëronin skllavërinë e saj dhe mbronin sundimin e burrave mbi gratë. Kanuni dhe feja vëlla e motër të një nëne, bijt e shoqërisë çfrytëzuese dhe të prapambetjes shekullore.

Të enjten mbas dreke, Violeta, mbasi nxori fëmijët në oborr, filloi të përgatitej për të nesërmen, për formën e edukimit, për seminarin për ngritjen ideo-politike. Emancipimi i gruas pasqyruar në fjalimet e fundit të shokut Enver.

Duke studjuar materialet e partisë dhe duke i konspektuar ato, Violetës i dukej sikur fjalët e shokut Enver përshkonin tej për tej mendjen dhe zemrën e saj, sikur ato hynin në gjakun e saj dhe duke qarkulluar bashkë me të nëpër të gjitha qelizat e trupit, çonin në çdo qoshe të organizmit të saj dritën dhe i jepnin forcë e kurajë për të luftuar me vendosmëri kundër së vjetrës, që i ishte mpleksur nëpër këmbë dhe s'e linte të ecte përpara me ritmin e kohës.

6.

Aty nga mesi i ditës dikush e kërkoi Violetën në telefon dhe pas gjysëm ore në zyrën e saj hyri një grua, në moshë pak më e re se ajo. Violeta i dha dorën dhe gruaja e re iu prezantua:

— Landa Simoni, vij nga organizata e partisë dhe kolektivi i .... Kam ardhur të bisedoj me juve lidhur me qëndrimin e anëtarëve të kolektivit tonë kundrejt burrit tuaj, Petrit Argjentit.

Violeta e shikoi të porsaardhurën. «Kjo puna jonë paska filluar të kutërbojë kudo», mendoi

ligjërój legitimize
çfrytëzúes = shfrytëzúes exploiting
konspektój survey
mpleks entangle
lídhur me relative to
ka fillúar të kutërbójë kúdo has begun to be discussed everywhere
shqyrtím analysis; scrutiny
autokritíkë self-criticism
që të vínim...sýtë instead of helping, we made things worse

— Çështja është se këto dit do të mblidhet kolektivi punonjës i ndërmarrjes sonë, për të marrë në shqyrtim qëndrimin e burrit tuaj, se ka bërë bujë kudo për të keq. Ne e analizuam punën e tij dhe duallëm me autokritikë, sepse edhe ne si organizatë, kolektiv e drejtori, kemi fajet tona... Rrënja e keqe duhej shkulur qysh në fillim, por ne ngurruam në këtë drejtim, duke patur frikë se mos prishej familja, se mos e ndanit ju... Dhe, siç e shihni, në vend që të vinim vetulla, nxuarrëm sytë. Apo jo? Si thoni ju?

Violeta përsëri nuk u përgjegj.

— Ne, si kolektiv e drejtori, përpara se ta marrim në shqyrtim çështjen e tij në mbledhje, deshëm të dinim edhe mendimin tuaj, i cili për ne ka një rëndësi të madhe! Ç'mund të na thoni?

Violeta u mat diçka të thoshte, por si duket u pendua. Landa nuk ja ndante sytë.

— E, ç'thoni? Ç'mendim keni?

Violeta u zbeh akoma më shumë; si t'ja bënte? Çfarë qëndrimi të mbante? Të thoshte se ajo burrë e kishte dhe burrë e ka, i vinte turp nga vetja. Desh të bërtiste: «Bëni ç'të doni, ai s'është më burri im», por u përmbajt.... Mirëpo ajo priste përgjigjje! Po si t'i përgjigjej? Rrugë të mesme nuk kishte. Ose ta mbronte, të kërkonte mëshirë e falje, dhe me këtë të tregonte se ja kishte falur të gjitha dhe se e donte akoma, ose të kërkonte dënimin e tij, duke mbajtur qëndrim parimor dhe me këtë të tregonte se midis tyre çdo gjë kishte marrë fund. Si të bënhe? Papritur i erdhi një mendim në kokë...

— Gjykojeni si të doni!

Landa mblodhi supet. Si ta kuptonte këtë shprehje? Ajo desh ta pyeste përsëri Violetën, por ajo e kuptoi qëllimin dhe me zë të ulët ju përgjegj:

— Kaq mund t'ju them... Bëni punën tuaj!

Landa i dha dorën, e përshëndeti dhe doli.

Violeta u kthye në shtëpi më vonë se ditët e tjera. Pazari i kishte ngrënë shumë kohë. Atë natë ajo e ndjeu veten më mirë. Në thellësinë e shpirtit, furtuna e madhe që zjente me furi prej disa muajsh, dalëngadalë po qetësohej. Horizonti po kthellohej dhe rrezet e ndritura të diellit sikur kishin filluar t'i ngrohnin ndjenjat e saj dhe ta shkrinin më me forcë akullin që kishte në zemër...

Atë natë ajo luajti me fëmijët dhe për herë të parë pas kaq kohësh kërkoi nga çupat t'ja merrnin këngës që këndonin çdo mbrëmje pas buke, para se të flinin.

bënhe = bënte (mp.)
hall care
telásh trouble; entanglement
i érdhi mírë it was welcome
sakáq at once

Violeta lëshoi penën nga dora, fshiu ballin e djersitur dhe u ngrit. Sa të lodhur që e ndjente veten! Dhe ishte lodhur jo aq nga puna se sa nga hallet e telashet që i kishin rënë mbi kokë... Ç'rrugë do të merrte çështja e saj? Violeta kësaj here ishte plotësisht e bindur se rruga që do të merrte çështja përmbi të gjitha varej nga vetë ajo; sepse në fund të fundit, jetën dhe të ardhmen e krijon vetë njeriu me duart e tij... Këtë mendim të ri, të pjekur, iu duk sikur ja thoshte një Violetë tjetër dhe i erdhi mirë.

Kyçi derën, zbriti tatëpjetë shkallëve dhe u drejtua për në klub. Një kafe dhe një limonadë e ftohtë do t'i jepte forca të reja për të vazhduar punën, që kishte filluar qysh në mëngjes. Ju afrua klubit dhe u bë gati të kapërcente pragun, kur dëgjoi të zihej në gojë emri i të shoqit. Sakaq u ndal në vënd. Brenda valonte një bisedë e zjarrtë. Po bisedohej për diçka me zë të lartë dhe me pasion.

— Po ju vetë i patë fletë-rrufetë, — vazhdonte zëri i brigadierit të brigadës së elektriçistëve, — çfarë fletë-rrufe pa! I ishin përveshur drejtorisë, organizatës së b. p. dhe kolektivit të uzinës... dhe s'u linin gjë pa thënë, dhe me shumë të drejtë... I kritikonin për mungesë vigjilence e vendosmëri për të luftuar gjer në fund kundër elementëve të degjeneruar, që bredhin pas grave të tjera. — E kishin fjalën për Petritin, burrin e Violetës. — Mirë ja qëndisnin kolektivit, që ka bërë një sy qorr e një vesh shurdh kundrejt sjelljeve të këtij gagareli e aventurieri...

— More, po mirë, pa dyshim, shumë mirë ja bënë, — u dëgjua një zë gruaje, — po mua më vjen shumë keq për Violetën! Të them të drejtën, unë kam respekt për të, por po tregohet e dobët... Njeriu ka karakter... Unë, të isha si ajo, po të më bënte burri të tilla gjëra, do ta kisha ndarë pa një pa dy...

— Është lehtë të flasësh për të tjerët: trimëria duket kur e ke në kurrizin tënd... Nuk i thonë shaka, kaq vjet martesë dhe dy fëmijë! Urdhëro e ndahu zotrote, — u dëgjua zëri i portierit plak.

— Mirë, or mirë! Mirë thua ti, o xha Petraq, por njeriu nuk mund të bëhet leckë... Ama kur ti s'më do një herë, unë nuk të dua njëqind herë. Hajt sikter, nga sytë këmbët! — Ishte shefi i repartit Nr. 5 që fliste.

flétë rrufé wall newspaper ("thunder-sheet")
i përvíshem go after; criticize
b.p. = bashkímeve profesionále (trade unions)
ja(=ia) qëndísnin kolektívit they let the collective have it
shurdh deaf
gagarél rogue
pa një pa dy without hesitation
trimërí valor
portiér gate-keeper
hajt siktér nga sýtë këmbët leave my sight

— Po përse nuk e shtrojnë në kolektiv? — pyeste zëri i një të riu.

— S'janë gjëra që mund të shtrohen në kolektiv, — ja preu dikush me zë të lartë.

— Sidoqoftë edhe kolektivi ynë nuk duhet të rrijë duarkryq. Ne duhet ta ndihmojmë Violetën të dalë nga gjëndja në mënyrë revolucionare... — thoshte me zë të lartë shefi i planit...

— Fajin e ka dhe kolektivi i Petritit; edhe ai shpejt u kujtua — u dëgjua zëri i brigadierit të repartit të saldimit. — Priti sa u qelb peshku, pastaj e ngriti zërin.

— Unë mendoj, — thoshte zëri i një gruaje, — se shumë drejt kanë vepruar që fletë-rrufetë i vunë tashti dhe jo më parë... Me familjen nuk luhet... Duhet patur shumë kujdes; sepse, në vend që të ndreqësh punë, mund të bësh të kundërtën. Janë gjëra shumë delikate keto. Duhet të dish si të kritikosh, kë të kritikosh dhe kur. Fletë-rrufeja është një akuzë publike... një armë që mund të bëjë shumë mirë, por po s'u përdor drejt, mund të sjellë pasoja shumë të dëmshme...

Violeta hyri brënda në klub dhe bisedat u prenë...

8.

Pas tri ditësh, Violeta trokiti në derën e drejtorit, hyri brenda, doli prej andej duke nxituar, zbriti shkallët dhe u drejtua për në qendër të qytetit. Autobuzi qëndroi në krye të bulevardit të madh, pastaj Violeta, pasi bëri dhe disa hapa, u gjend përballë një godine dykatëshe, tek dera e së cilës ishte shkruar me gërma të mëdha «Zyra e ndihmes juridike». Violeta kapërceu pragun me hap të vendosur dhe pa u matur

Pas një javë Violeta, duke dalë nga zyra, takoi përpara drejtorin dhe sekretarin e komitetit të partisë. Sekretari e shikoi në sy Violetën dhe e pyeti me dashamirësi:

—Ç'ke ndërmënd të bësh, shoqja Violetë?

Violeta sikur u shkund nga diçka dhe iu përgjegj në mënyrë të vendosur:

— Kam disa dit që e padita në gjyq dhe kam kërkuar zgjidhjen e martesës. Kur nuk më do ai, as unë nuk e dua më. Kam edhe unë dinjitetin tim si grua, si nënë dhe si punonjëse. — Dhe bëri tutje duke harruar t'i përshëndesë.

repárt unit
qélbem rot
akúzë accusation

Kur u shpall vendimi i gjykatës, salla ishte mbushur plot me njerëz. Kishte nga të qendrës së punës të Violetës, kishte nga ata të qendrës së punës të Petritit, por ai vetë nuk erdhi për ta dëgjuar. Martesa u zgjidh për fajin e Petritit dhe të dy fëmijët iu lanë nënës, për rritje dhe edukim. Vendimi u prit me duartrokitje. Shumë nga të pranishmit iu afruan Violetës dhe i shtrënguan dorën. E uronin, përse? E përgëzonin përse? Ato duar që e shtrëngonin fort dhe ato shikime dashamirëse shprehnin konsideratën e tyre: «Bravo të qoftë! Dalç faqebardhë në jetën e re!

Kur doli nga salla e gjyqit, Violeta ndjeu t'i rrahë zemra fort. Kishte akoma të rrënjosura thellë diçka nga ndjenja e frikës për të ardhmen, për të jetuar vetëm, pa burrë. Megjithatë me një ndjenjë krenarie, ajo mori drejt bulevardit... E ndjente veten të lehtësuar, kishte hedhur poshtë një peshë të madhe që rëndonte në ndërgjegjen e saj...

Në shtëpi e pritën të dyja gocat duke brohoritur nga gëzimi. Vajzat iu varën mëmës në qafë dhe ajo e pati vështirë të ngjitte shkallët duke mbajtur edhe peshën e të dy fëmijëve. Iu muarr fryma, por prapëseprapë nuk e dha veten: bashkë me to ngjiti shkallët.

Nuk kishin mbaruar akoma së ngrëni drekën, kur dikush hyri brënda pa trokitur. Violeta nuk mundi ta shikonte atë që hyri, por dëgjoi vetëm britmën e fëmijëve tërë gëzim: «Babi! Babi!»

Një rrymë si e korentit e përshkoi tejetej trupin e Violetës.

Petriti kapërxeu pragun e derës mengadalë dhe si i ngrirë, kurse sytë i kishte të gozhduar në dysheme. Hyri në kuzhinë dhe shtangu në vend.

Violeta u mat t'i thoshte diçka të keqe, por u përmbajt dhe, duke e shikuar drejt e në sy, i tregoi karriken.

Duke e parë nënën kështu të ngrysur, fëmijëve u ngriu në buzë gëzimi. Ato, me logjikën e tyre shumë të thjeshtë nuk e shpjegonin dot sesi e ëma po e priste në këtë mënyrë dhe kaq ftohtë babin e tyre.

Violeta u ngrit dhe, me marifet, i nxori fëmijët në oborr. Vajzat e kryen porosinë e nënës pa kundërshtim dhe si të hutuara. Ato nuk po merrnin vesh se ç'po ndodhte në shtëpinë e tyre, midis mamit dhe babit.

dykátëshe two stored
dúke dálë nga zýra going over to the office
dashamirësí kindliness
kam dísa dítë a few days ago
padít bring suit; sue
duratrokítje applause
i pranístëm person present
dalç faqebárdhë may you be successful
iu múarr frýma she ran out of breath
prapëseprápë in spite of that
nuk e dha véten she didn't let on
brítmë call; shout

Violeta u kthye në dhomë dhe vazhdoi të pastrojë tavolinën e të heqë pjatat, duke mbajtur një qëndrim të tillë indiferent, sikur të mos kishte njeri tjetër zty. Ndërsa ajo, siç dukej nga sjelljet e saj, nuk priste gjë nga Petriti, ky i fundit, në të kundërtën, priste ndonjë fjalë nga goja e saj. Ai priste një fjalë të ngrohtë, fjalë që do të shkrinte akullin, që e kishte pllakosur, por më kot.

Në atë heshtje të trishtuar u dëgjua vetëm tik-taku i sahatit të madh të varur në mur.

Petriti e kuptoi se s'kishte rrugë tjetër për të. Për të thyer akullin, ai duhej ta hapte gojën i pari. Pa guxuar të ngrerë sytë, me zë të ngjirur dhe mengadalë, filloi t'i flasë me të mirë Violetës. Në fillim, ai i kërkoi ndjesë asaj për të gjitha vuajtjet dhe dhëmbjet që i kishte shkakëtuar... Ju lut që ta falte. E kërkoi këtë në emër të fëmijëve, të së ardhmes së tyre dhe të dashurisë që kishte ushqyer ajo për të. Bëri bera e rrufera se do të bënte kthesë, se ishte penduar thellë për ato që kishte bërë, se kishte prerë çdo marrëdhënie me femrat dhe se ishte gati të fillonte jetën si më parë, po të pranonte ajo...

Violeta e la Petritin të mbaronte fjalën dhe pastaj iu përvesh:

— Unë nuk të kuptoj se çfarë kërkon prej meje dhe përse më lutesh? Mjaft të kam duruar dhe shumë ke luajtur në kurrizin tim...! Të kam falur kush e di sa herë, por tashti u mbush kupa... Unë kam qënë budallaqe, kisha frikë se mos më ndaje... Kisha frikë të jetoja e pavarur ...Ti erdhe këtu i bindur se do të fitosh, sepse ti kujton se do të gjesh prapë atë Violetën e trembur, të drojtur dhe frikacake që ke njohur ti. Sa gabon! Nuk më njeh? Çuditesh! Edhe unë me zor e njoh veten time të tanishme... E po ja ku po ta them! Ajo Violetë që ke njohur ti nuk jeton më, jo vetëm për ty, por për asnjeri... Tashti është një Violetë tjetër, të cilën ti nuk e ke njohur dhe nuk mund ta kuptosh dot, sepse kështu je brumosur... Shumë vonë u kujtoye... Të kujtohet kur t'u luta unë me lot në sy në emër të fëmijëve e të së ardhmes së tyre? Ty nuk të përkulën lotët e mia; tani as mua nuk më përkulin lutjet e tua prej hipokriti e gënjeshtari. Ti më përbuze mua, kurse unë të urrej! Humba vërtet burrin e padenjë, por gjeta veten, dinjitetin dhe personalitetin tim dhe këtë e gjeta në sajë të ndihmës që më dhanë shoqet e shokët, shoqëria e kolektivi, në sajë të dorës që më dha partia...

korént = korrént draft of air
téjetej through and through
gozhdój nail
dyshemé floor
kundërshtím objection
pjátë dish
në të kúndërtën on the contrary
pllakós strike; afflict
sahát clock
ndjésë forgiveness
ushqéj nourish; feed
bëri béra e rrufére he swore to high heaven
shúmë ke lúajtur në kurrízin tim you've stepped on me too much
u mbush kúpa I've had it
frikacák coward

Dhe pa e zgjatur më, Violeta veshi fustanin e ri, mori të dy fëmijët për dore dhe u nis në drejtim të sheshit Skënderbej. Ishte nata e 27 Nëndorit. Duke kaluar para Komitetit Ekzekutiv, goca e madhe bërtiti: «Shiko, shiko, xhaxhi Enveri». Violeta ngriti kokën dhe pa portretin e shokut Enver. Asaj iu duk sikur sytë e tij po e shikonin ëmbël dhe sikur ai po i thoshte: «Duhet ju të parat të luftoni për të drejtat dhe dinjitetin tuaj. Mos kini frikë, sepse prapa jush qëndron dora e fuqishme e tërë shoqërisë».

Violeta ktheu kokën përsëri dhe, nga larg, pa sytë e dashur të udhëheqësit tonë që e shikonin me dashamirësi, ndërsa në majë të sahatit ndriste ylli i kuq i partisë...

Veli Budo "Dinjiteti" Nëndori (Tiranë) XVI, 7 (July) 1969, pp.92-103

i padénjë unworthy

LEXIMI I TETEDHJETEGJASHTE

FOQION P. POSTOLI

Lulja e kujtimit

Më dy tetor të këtij viti mbushen tridhjet vjetë nga dita e vdekjes së shkrimtarit dhe patriotit Foqion P. Postoli, i cili ka pasqyruar në veprat e veta idet e atdhedashurisë, të urrejtjes kundër pushtonjësve, të krenarisë për të kaluarën e lavdish ne të popullit tonë dhe është përpjekur ta afrojë atë sa më tepër me frytet e arësimit e të kulturës.

Foqion Postoli lindi në Korçë më 1889 në një familje tregëtare. Mori mësimet e para në shkollën greke të qytetit dhe në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçe shkoi në Stamboll për të vazhduar shkollën financjare, që t'i vinte në ndihmë të jatit në punët tregëtare. Në Stamboll ai qëndroi dy vjet. Me t'u kthyer në Shqipëri mori rrugën e kurbetit me që edhe tregëtija e të jatit nuk shkonte mbarë.

Në Amerikë Foqioni qëndroi katërmbëdhjetë vjetë. Kjo ka qënë periudha me e frytëshme në punën e tij krijonjese. Ai zhvilloi atje një aktivitet të gjëre si ne fushën e letërsisë ashtu edhe në lëmin politik e shoqëror.

I frymëzuar nga idetë përparimtare e patriotike, që egzistonin ndër shqiptarët e Amerikës, Postoli nisi të punojë pa u lodhur si sekretar i degës së Federatës «Vatra» në qytetin «Brokton» dhe gjat periudhës 1910-1921 bashkpunoi në revistën «Dielli».

Në Amerikë Postoli, për të siguruar bukën e gojës, punonte në një fabrikë këpucësh dhe ndiqte, në të njëjtën kohë, shkollën e natës. Po, me qithë këto kushte të vështira ai shkroi gjatë kësaj periudhe veprat e veta kryesore: romanet «Lulja e kujtimit», «Për mbrojtjen e atdheut» dhe dramën «Detyra e mëmës», të cilat në fillim u botuan si pamflete në revistën «Dielli» dhe më vonë, kur shkrimtari u kthye në atdhe, dolën vëllime më vehte.

Më 1921 Postoli u kthye në atdhe që të punonte për krijimin e kishës autoqefale shqiptare, bazat e së cilës u hodhën prej Fan Nolit qysh me 1908, kur u çel kisha e parë shqipe në Boston. Krijimi i kishës autoqefale shqiptare ishte një grusht i rëndë që i jepej Patriakanës greke, e cila mbante qëndrim armiqësor ndaj popullit tonë dhe ndaj çështjes shqiptare dhe i shërbente sulltanit e shovinistëve grekë. Postoli në këtë punë patriotike-fetare ishte bashkëpunëtor i Nolit dhe, qysh me themelimin e kishës autoqefale shqiptare, u caktua më 1922 sekretar i Dhimogjerondisë. Në këtë detyrë ai shërbeu deri në fund të jetës.

Vdiq në Korçë më 2 tetor 1927.

Veprat e tij kryesore janë: «Lulja e kujtimit», «Për mbrojtjen e atdheut», drama «Detyra e mëmës» dhe komedija e pabotuar «Martesa e një advokati» si dhe shumë shkrime të tjera të botuara në revistën «Dielli».

Me rastin e tridhjet vjetorit të vdekjes së Foqion Postolit po botojme katu disa pjesë të ckëputura nga romani i tij «Lulja e kujtimit».

financjáre = financiáre financial
shkóllë financiáre business school
Dhimogjerondí ecclesiastical unit of the eastern orthodox church
i pabotúar unpublished
çkëputur = shkëputur detached
pjésë e shkëpútur excerpt

* * *

...Dashuria me shpresa, me ëndëra kapërxen të gjitha; malet përpara saj duken fusha; lumënjt e gjërë duken vija të ngushta dhe çdo ndalim i math humbet përpara dashurisë. Këto janë ëndrat dhe shpresat e atyre që bien viktimë të shigjetave të dashurisë. Kështu dhe për Dhimitrin çdo ndalim i dukej se do ta kapërxente lehtazi. «Mëmë, tha Dhimitri e dua Olimbinë dhe ajo më do; kurrë nukë do na ndajë Perëndia, se zemrat tona janë aqë të lidhura sa as pasuria e Z. Kristo, as nonjë gjë tjatër nuk do mundë t'a çkëputë në këtë botë, po vetëm të lutem, mëmë e dashur jepmë uratën që Zot' i Gjithësisë të mbushë dëshirën time, se nonjë ditë, o mëmë, do të dal në botë dhe unë si tregëtar dhe ahere do kërkoj dorën e Olimbisë nga ati i saj si një tregëtar e jo si shërbëtor».

E ëma mbet e habitur me përgjigjen e birit të saj dhe që të mos hidhëronte zëmrën e tij, i tha:

«Uratën te Perëndisë dhe t'imen paç, o bir, dhe dhënte Zot'i math të të udhëheqë në drejtësi dhe të mbushë qëllimin dhe dëshirën tënde».

«Po, mëmë, si mbet çështja e lules?» pyeti Dhimitri dyke nënqeshur.

«Bir tani që më tregove të gjitha kurdohere që të duash lulja e tërë është jotja.»

«Sa e mira që je!...»

«Dhimitri, shkojti mjaft ora dhe duhet te fleç se nesër do veç në punë.»

«Po, me të vërtet mëmë». Me të mbaruar këto fjalë Dhimitri u ngrit dhe vajti në dhomë të flerë .po nga gëzimi i math mezi e zu gjumi..

Të nesërmen Dhimitri i tha Olimbisë se të Dielë do t'i sjellë lulen e mëmës së tij dhe ajo me padurim priste ditën e Dielë.

E Diela arriti dhe Dhimitri me një një gëzim të math po gatiteshe për vizitën që do t'i bënte Olimbisë. Pas dreke u nis për në shtëpi të Z. Kristo me një garbe në dorë të mbuluar me kartë të bardhë. Posa hyri në shtëpi të Z. Kristo, Olimbia e priti me buzëqeshje dhe plot gëzim i tha:

«Dhimitri, më duket se me tërë këtë kujdes që mbani lulen do jetë me të vërtet e bukur.»

«Duro, pa do t'a shikosh Olimbi, po ku t'a vëndos?»

«Ku të duhash vendose po shpejt se nukë më durohet, dëshëroj aqë t'a shoh!»

Dhimitri dyke vendosur garben me kujdes, e zbuloj lulen. Gëzim' i Olimbisë ish i patreguar. Dyke bashkuar duart' e saj me një çudi të bashkuar me gëzim thirri:

«O sa e bukur që është!» Nukë gjente dot fjalë që të çmonte lulen e mëmës së Dhimitrit.

«Dhimitri, pasoj Oimbia, tani pa dyshim jam e sigurtë se as nonjë në Korçë nuk do ketë lule të këtillë, po të lutem thuajmë, si iu ndoth mëmës tuaj kjo lule dhe si e quan ajo këtë lule?»

léhtazi easily
núkë = nuk
nonjë = ndonjë
tjátër = tjétër
paç may you have
dýke = dúke
fleç = flesh
veç = vesh
me një një = me një (mp.)
garbé flowerpot
dúhash = dúash
i patregúar indescribable
si iu ndoth mëmës túaj kjo lúle how did your mother come to have this flower.

«Kjo lule quhet «Lulja e Kujtimit», u-përgjegj Dhimitri.

«Lulja e Kujtimit! po thuajmë, po tregomë si ka ardhur në Korçë?» Dhimitri u- shtrëngua, ndonëse nukë desh, të çfaqte historinë e lules.

«Olimbi, kjo lule ka ardhur që nga Misiri dhe ka një histori të veçantë për mëmën time». Me zë të unjtër i tregoj fjalët që bëri me mëmën e tij për lulen. Olimbija me vërejtje të madhe dëgjonte të gjitha dhe u mallëngjye tepër.

«Dhimitri, i thotë vajza, si mëma tuaj e mbajti këtë lule, si shënjë dashurie dhe besnikërie për atën tuaj, gjith ashtu dhe unë do kujdesem për këtë mbi ato shënja për ty.»

«Olimbi! thiri djaloshi nga gëzimi, do të thuash se ti më do siç desh mëma ime atën tim?» Pyetja e Dhimitrit ish shumë e kuxuar, po flaga e dashurisë që diqte gjoksin e tij nukë e ndaloj të flasë me atë kuxim dhe dyke hedhur syt' e tij mbi syt' e Olimbisë kërkonte të rëmonte thellë në zemrën e saj që të merte përgjigjen. Ajo pa humbur kohë i zgjati dorën dhe i tha:

«Pa dyshim. Dhimitri, dashuria ime për ty është rënjosur thellë».

Dhimitri rrëmbeu dorën e Olimbisë dhe e afroi pranë buzëve të tij. Po fati! Ah fati që ndjek pa mëshirë të dashurit, ja preu sulmën, se zërra dhe fjalime u-dëgjuan afër portës. Porta u-hap dhe Z. Kristo me shkronjësin Nikon u duknë. Dhimitri pati kohë të lëshonte dorën e Olimbisë me zemër të hidhëruar. Fytyrat e tyre u-kuqnë, atë minutë si nonjë djali të vogël kur zihet në vjedhje e sipër posa që ata panë Z. Kristo dhe Nikon të hyjnë; po, lulja ua nxori frikën dhe që të dy hodhën svtë mbi të.

«Atë, thiri Olimbia, shëko këtë lule kaqë të bukur që më solli sot Dhimitri»!

«Pa dale ta shohim»! tha me të qeshur Z. Kristo. «Po, po me të vërtet oënka shumë e bukur. Ku e gjete Dhimitri këtë lule? Më duket se do të koh trapitur mjaft për këtë».

«Jo Z. Kristo as fare nukë trapita për të, se e kishte mëma ime dhe kur pashë se Olimbia nukë kish kësisoj lule i thashë mëmës dhe ajo me gëzim ia dërgoj me mua Olimbisë si një dhuratë të vogël».

«Mbetemi fort të kënaqur. Dhimitri, dhe çfaqni kënaqësit' e mija mëmës tuaj për këtë lule të bukur.

«Dhe falënderjet e mija shtoj Olimbia.

«Mëma ime do kënaqet dhe do gëzohet tepër kur t'i çfaq asaj kënaqësitë tuaja», u-përgjegj Dhimitri.

«Afrohuni dhe juve Z. Niko», ju drejtua Nikos Z. Kristo, dhe e pyeti: «Si e pëlqeni këtë lule»?

«Me të vërtet, u-përgjegj Nikua, është mjaft e bukur, ndonëse nukë di të çmoj lulet, po thom pa frikë se kjo mund të barabitet me ato më të bukurat lule të dheut». Syt' e tij u-ngritnë mi fytyrën e Olimbisë që të studionte ç'përshtypje i bëri asaj fjala e tij, Olimbia dyke mos kuptuar dinakërinë e Nikos nënëqeshi për lavdimet që përfliteshin për lulen.

Ejani të hyjmë brënda», tha Z. Kristo.

«Ju falem, ditën e mirë», tha Dhimitri, dyke u matur të shkojë.

«Po ku do veç që tani»? e pyeti Z. Kristo; rri pak brënda dhe pastaj shko».

ERIC

të únjtër = të ûlët
mallëngjéhem am moved
besnikërí loyalty
thíri = thírri
i kuxúar = i guxúar daring
flágë flame
kuxím = guxím courage
rëmój = rrëmój
rënjósur = rrënjósur rooted
mëshírë mercy
zërra = zëra
shkrónjës clerk
vjédhje stealing; thievery
shëko = shikó
pa dále të shóhim let's have a look at it
trapít search
kësisój this kind
dhurátë present
falëndérje thanks
barbít compare
mi = mbi
dinakërí cunning
përflás speak about; express

«Ju falem ndërit, Z. Kristo, po më pret mëma se do vizitojmë bashkë një mik».

«E po të jetë kështu nuk të mbajmë».

«Mos haro, Dhimitri, foli Olimbia, të fala, të fala shumë t'i thuash mëmës tuaj dhe nuk gjenj dot fjalë kënaqësie për lulen që më dërgoi».

«Me gëzim do t'i them të falat tuaja. Ditën e mirë Olimbi».

«Ditën e mirë, Dhimitri,» u-përgjegj ajo.

Dhimitri shkoj për në shtëpinë e tij me zemrën plot shpresë dhe gëzim. Ideja që Nikoja gjendet pranë saj e mvrejti. Kish frikë nga dhelpëria e tij dhe nga shqerësia e saj. Me të hikurit e Dhimitrit të tre hyjnë brënda në dhomën e miqve dhe si ndenjnë, Z. Kristo tha:

«Dhimitri është një djalë mjaft i çkathët».

«Dhe tepër i bindur dhe i dashur», shtoi Olimbia.

«Dhe një punëtor i mirë pasoj Nikua...

Ditët po fluturonin, javët po shkonin, dhe muajt po kaptonin që kur Dhimitri dhe Olimbia çfaqnë dashurinë e tyre. Plot shpresë ëndëronin një jetë të lumtur dhe ndonëse kaluan njëzet muaj, kurrë nukë ju ardhi rasti që të fjaloseshin për ëndrat e bukura që po thurnin dita me ditën. Bashkoheshin mbrëma për mbrëma po, as njeri prej tyre nukë kuxonte të hapte fjalën, po priste njeri tjatrin të merte nisiativën. Një mbrëma, kur Dhimitri pas zakonit vajti në shtëpi të Z. Kristo, Olimbia i tha:

«Dhimitri, nisa te mësonj gjuhën tonë shqipe me të shkrojtur».

«Me të vërtet»? u-përgjegj Dhimitri.

«Po, një nga vajzat e fqinjës që e mësoj gjuhën shqipe në Misir e mori përsipër që të më mësojë; më këndoj një librë me ca vjersha shqip; po sa bukur janë lidhur fjalët! Nukë pandenja se gjuha jonë do kish kaqë shijë».

«Olimbi, pa dyshim gjuha jonë është një nga më të bukurat në botë, po mjerisht nuk është e lëruar nga që kombi ynë ndodhet nënë zgjedhën Turke prej afro katër qint e pesëdhjetë vjet. Qeveria turke nukë le të hapen shkolla shqipe; po, veç kësaj kemi dhe Patrikanën, e cila vepëron për propagandën greke dhe me anën e fesë, ndalon mësimin e gjuhës sonë. Po jam i sigurtë që do vinjë dita kur Shqipëria të çlirohet nga thonjt'e Turqisë dhe të Patrikanës; ajo ditë do të jetë përlindja e kombit shqiptar dhe e gjuhës sonë; po më ndje Olimbi se fola shumë për çështje kombëtare nga që juve femërat nukë interesohi kaqë shumë për të këtilla çështje se sa neve burrat».

«Folë, Dhimitri, folë, se dua të mësonj të gjitha shkaket që ndalojnë shqipen, gjuhën tonë, folë të lutem», i thosh vajza me zë ëngjëllore. Kur do vinjë ajo ditë që do çlirohet Shqipëria? Ke nonjë lajm ti? Se unë natë për natë nuk dëgjoj gjë tjatër nga ati im ose nga ca miqt' e tij që vinë dhe fjalosen me atë, veç se Greqia do të marrë vendin tonë dhe ata thonë se e presim me padurim atë ditë që të shëkojnë flamurin e Greqisë të valonjë në Korçë».

«Sa gabohen këta zotërinj! Venë me idhenë e ndryshkur të Patrikanës, dhe paditur tradhëtojnë atdhen' e tyre ne të huajt. Se vetëm ahere do jemi të lirë, Olimbi, kur flamuri ynë i kuq me shkabën e zezë do krerore të valojë mbi Korçën! Ahere dhe vetëm ahere do jemi të lirë».

«Dhimitri, po kemi dhe neve flamur»?

«Po! jo! Kemi flamurin tonë shumë të vjetër; atë flamur te Sko-

haró = harró
mvrejt make gloomy
shqerësí innocence
të híkurit = të íkurit exit
dhómë e míqve guest room
kaptój roll along; pass
fjalós talk
hap fjálën bring up the subject
nisiatívë = iniciatívë initiative
fqínjë female neighbor
shíjë flavor; taste
Patrikánë Patriarchy of the Greek Orthodox Church
vepëroj = veprój act
fólë = fol
ëngjëllór = engjëllór angelic
lajm news

ndërbeut, atë flamur që në kohërat e vjetra e nderonin gjithë miqtë dhe armiqtë e kombit tonë.»

«Dhimitri, sa dëshëronj të shoh flamurin tonë! Ke ndonjë të më tregosh»?

«Nukë kam, as mund të ndodhet nonjë këtu, nga shkaku që po t'a kuptojë qeveria, vrasja e pret atë që e mban. Po ti jam i sigurtë që do t'a kesh parë».

«E kam parë! Nuk të kuptonj ç'do të thuash. Si unë mund t'a kem parë kurse thoni që nukë ndodhet nonjë këtu?

«Ke të drejtë Olimbi. Me të vërtet nuk' e ke parë flamurin po ke parë pikturën e flamurit, atë pikturë, e ke parë që kur u-linde, është ajo që zbukuron djepin tuaj. atë pikturë e ke parë dhe në kasellën e martesit të mëmës tuaj, se stërgjyshrit tanë ndonëse nënë zgjedhë, na lanë shënjat e shënjta të lirisë dhe historisë tonë të cilat na përmendin që kurrë mos harrojmë dhe mos mohojmë kombësinë tonë. po që kurse propaganda greke dhe turke u-rënjosnë këtu po hidhen më nj'anë ato shënja të shënjta të kombit tonë».

«Me të vërtet, me të vërtet! U përgjegj Olimbia, i kam parë ato shënja atje ku më thua. po kurrë nuk më shkonte mëndja për qëllimin e tyre. po Dhimitri kurse tërë Korça ndodhet në gjumë....

«Olimbi mos pandeh se të tërë ndodhen në gjumë: se ka dhe shumë që punojnë po nukë çfaqen nga frika e qeverisë turke, veçan këtyre tërë korçarët dhe Shqipëtarët që jetojnë lark Turqisë në vise të huaja. si në Misir, Rumani dhe në Amerikë. po punojnë pa reshtur; javën e shkuar mora një letër nga një shoku im prej Amerike. ku më shkruan për lëvizjet kombëtare që bëhen atje. Që kur mora atë letrë një gëzim i math ka mbështjellë zemrën time».

«U lumtë atyre që përpiqen për zgjimin e kombit tonë», tha Olimbia. dhe Perëndia le t'i shpëtonjë nga çdo rezik».

«Amin», shtoj Dhimitri.

«Po sikur t'i them atit për mësimet shqipe që marr, vallë cdo të thotë»?

«Kurrë mos kuxo, se do të qërtojë shumë rëndë dhe do t'i grisë librat dhe nuk do nqasë më atë shoqen tuaj që të pasosh mësimet. ndonëse shtë ati yt Olimbi, po është një Grekoman shumë i rreptë. Ka pothuaj nja dy vjet që u fjalosa për gjuhën tonë dhe ay lëvdonte greqishten dhe Nikon. dhe më tha veçan qërtimeve se nukë do në dyqan të bisedohet gjuha shqipe më. Kjo ngjau posa ardhi Nikua; po që atëherë e tani aqë më tepër, i është rënjosur idhea greke dhe është bërë një fillogrek i tillë, sa dhe vetë Grekërit nukë janë aqë të flaktë atdhetarë»

«Më duket se dhe Nikua ka gjisht në këtë gjë», tha Olimbia.

«Pa dyshim, se Zoti Kristo ka kaqe besim tek ay sa mund të them më tepër se një atë tek biri i tij; pra, ja ku të them merr masa kundra dinakërisë tij se një frikë e pa dukur më ngjeth nga nonjë herë kur mejtohem për atë, se sytë dhe fytyra e tij më duken si prej katili».

«Dhe unë Dhimitri gjithë si juve mejtohem dhe kam frikë se mos nonjë rezik rethohet për neve. Ah, sa më mirë do ish të mos e kish sjellë kokën në mes tonë!

«Thuamë Olimbi si sillet Nikua tek ju»?

«O ay do të sillet si nonjë njeri fismik tek mua; kur do herë bisedon për gjëra të larta, po në mua ato nukë shkojnë; përkundrazi, ati

dëshërónj = dëshirój
zbukurój embellish
kaséllë e martésit (=martésës) hope chest
kombësí nationality
lark = larg
pa réshtur unceasingly
amín amen
gris tear up
nqas = qas allow; let
fillogrék Greek-lover
i pa dúkur unseen; inapparent
ngjeth make shudder
katíl assasin
rethóhet = rrethóhet
kur do hérë = kurdohérë
në = ne mua ato nukë shkojnë he doesn't fool me

im e dëgjon me gojë hapur dhe nga nonjë herë bisedojnë për martes që të dy dhe në bisedim e sipër Nikua heth sytë tek mua, po kaqe më hipën një e qeshur dyke kuptuar dëshirën e tij, sa nukë më durohet, po dal jashtë dhomës dhe ja thres të qeshurit». Dhimitri nuk' e mbajti dot të qeshurën në fjalët e funtme. «Kur kthehem prapë e gjenj të mvrejtur dhe syt' e tij ndritin si të nonjë maçoku të egër; atëhere më ze një frikë se mos pësojmë gjë».

«Olimbi, po si kur ati të të zgjedhë Nikon për burrë ç'do të bësh?

«Kurrë. Dhimitri, kurrë nukë do bindem, se zemra ime është dhënë tek ty. Dhimitri, që atë ditë kur më solle lulen e kujtimit dhe s'e urdhëroj dot. As për gjë tjetër nukë mejtohem po vetëm për ty dhe si për shënjë dashurie dhe besnikërie ja ku të jap dorën time, dhe betohem që sa të rronj në këtë botë, jo Nikua, po as nonjë tjatër nukë do zënë vëndin tuaj në zemrën time»!

«Dhe unë betohem Olimbi se do përpiqem për ty të të mpronj me tërë fuqinë dhe me jetën time do të të ruanj nga çdo rezik, do t'i lutem Perëndisë që të na falë shëndetin, dhe të na udhëheqë në rugën e drejtësisë, lumtërisë dhe dëshirës tonë». Në ato fjalë Dhimitri ngjiti buzët e tij mbi dorën e Olimbisë me një mall, me një dashuri të tillë sa zemrat e të dyve këcyen nga gëzimi...

«Olimbi. Olimbi», dolli një zë nga kuzina dhe dera e së cilës u-hap, po për fat të mirë buzët e Dhimitrit ishin lark dorës së vajzës.

«Mos më thire Sandë» u përgjegj Olimbia.

«Po, foli Sanda që nga kuzina: iku Dhimitri a po jo, se më duket si kur dëgjova të qeshurit e tij».

«Jo mukë ka ikur»!

«Ejani këtu që të dy».

«Eja të vemi ne Sanda të shëkojmë përse na thëret», i Tha Olimbia Dhimitrit, dhe që të dy vanë në kuzinë; Sanda shërbëtorja e Z. Kristo po gatite darkën, posa kish nxjerë një lakror nga zjarri, era e të cilit iu solli urinë përnjëherësh që të dyve.

Sanda me një të qeshur i pa ,rëmbeu thikën dhe preu dy gastra prej lakrorit, dyke thënë:

«Dhimitri paske fatin e mirë sonte që u vonove se kur dëgjova të qeshurit tuaj atëhere po nxirnja lakrore nga zjarri, prandaj ju thirra që t'a shijoni. A e kam goditur mirë»?

«O, është fort i mirë Sanda që nga era kuptohet po mos e pri për mua».

«Prihe, prihe se dhe mua më hahet thiri Olimbia».

Sanda nuku priti përgjigjet e tyre se ajo e kish prerë që më parë dhe ja u dha dyke thënë. tani mireni dhe mos bëni naze.

Sanda ish një grua shumë e mirë, e dashur dhe zemër-bardhë; ajo qe bërë mëmë e vërtetë për Olimbinë, e cila e desh si mëmë. Veçanërisht Sanda desh Dhimitrin si djalë se ay silleshe shumë mirë dhe dëndur ay e ndihmonte në punëra shtëpiake. Dhimitri dhe Olimbia posa muar gastrat e lakrorit mukë mënuan, po përnjëherësh ngulën dhëmbët e tyre mbi atë.

«Të lumçin duart Sandë», tha Dhimitri.

«E paske goditur shumë të mirë dhe të shishmë», shtoj Olimbia dyke lëpirë buzët e saj. «Të dogji Dhimitri? se mua më përvëloj buzët!»

«Edhe mua pak», Sanda qeshte me gjith zemër, dyke parë se që të dy kishin mjaft uri po nukë kuxonin t'a kafshonin se ish i nxehtë.

<u>në bisedím e sípër</u> in the course of the conversation
<u>thres</u> = <u>thërrás</u>
<u>ja thres të qéshurit</u> I burst out laughing
<u>e fúntme</u> = <u>e fúndme</u>
<u>maçók</u> tomcat
<u>pësój</u> experience something unpleasant; suffer
<u>të mpronj</u> = <u>të mproj</u>
<u>shërbëtór</u> servant
<u>dárkë</u> dinner
<u>lakrór</u> pie
<u>thíkë</u> knife
<u>gástër</u> = <u>ngástër</u> slice; piece
<u>príhe</u> = <u>príe</u>
<u>núku</u> = <u>nuk</u>
<u>mireni</u> = <u>mérreni</u> take it
<u>zémër bárdhë</u> = <u>zemërbárdhë</u>
<u>shtëpiák</u> pertaining to the house
<u>mënój</u> delay
<u>të lúmçcin</u> = <u>të lúmshin</u> may they live long
<u>i shishëm</u> = <u>shíjshëm</u> tasty
<u>lëpij buzët</u> smack (my) lips

Dhimitri passi e hëngri lakrorin e shishmë dhe pasi iu fali naten e mirë Olimbisë dhe Sandës. shkoj dhe arriu në shtëpin' e tij me zemrën plot gëzim dhe shpresë...

* * *

Shërbëtorja hyri, duke parë Olimbinë që po qante u hidhërua tepër dhe habitesha cili është shkaku kur Z. Kristo tha:

«Mer Olimbinë dhe vere në shtrat të flerë»!

Sanda s'priti më. Mori Olimbinë në dhomën e saj dyke i thënë fjalë të ëmbla. «Pusho lotët Olimbi se kur qan ti më dridhet shpirti se ndonëse jam shërbëtorja tuaj po të dua si bijën time, tregomë shkakun e lotëve të tu»! Olimbia me zë të dredhur nga që ngulçimet nukë e linin të fliste lirë u përgjegj:

«Sandë, ati im kërkon të më martonjë»!

«Po, për këtë qan? Tërë vajzat në vërsën tuaj gëzohen kur u thonë për martesë, po, më duket se nukë është ky shkaku i lotëve të tu».

«Sandë, a e dini se cilin ka zgjedhur ay për shoqin tim»?

«Jo! Cilin»?

«Nikon».

«T'u bëftë kurban ay evgjit dhe të martë të keqen morajti. Më vjen shumë keq për Zotin Kristo që do të bënjë dhendër një të aratisur dhe këpucëgrisur. Sa të jetë Sanda në këtë shtëpi t'a dish Olimbi se kurrë ati yt nukë do mbushë dëshirën e tij për ty, pa pyetur dhe mua; se unë të kam rritur si bijën time, dhe kam dhe unë ise në ty si sot edhe për të pastajmën tënde». Fjalët e Sandës i dhanë një kurajo Olimbisë, ndonëse ato fjalë dilnin nga goja e shërbëtores; po, kur një zemër e hidhëruar dhe e dëshpëruar dëgjon fjalë të buta dhe të ëmbla, mbushet me shpresë të padukur. U-ndoth në botë një që t'a mpronte kundra vendimit të atit të saj. Olimbia desh që t'i tregonte Sandës cilin dëshëronte për shoq; tek cili ish dhënë zemra që t'a dinte dhe ajo dhe mund t'iu ndihmonte me këshilla të urta, po s'kuxonte. Nga turpi futi fytyrën e saj në jastëk që të mos shëkonte drejt për drejt dhe dyke u-skuqur gjer te veshët i tha:

«Sandë kurrë nuk do bëhem e shoq'e Nikos se unë jam shtënë në dashuri»!

«Me cilin, bijë, e pyeti Sanda me nënqeshje». Sanda i kish rojtur kaqe herë të dy të dashurit dhe nga hera thosh me vehten e saj sa të lumtur do të rojnë bashkë të dy; i lutesha Atit Math Qiellor për të mbushur dëshirën e tyre si ndonjë mëmë e vërtetë që lutet për fëmijën e saj. U-bë si e paditur që t'ia çpallte vetë Olimbia dashurinë që kish me Dhimitrin.

«Sandë unë dua Dhimitrin atë do dhe dëshëron zemra ime; as ndonjë tjatër nuk do të zërë vëndin e tij në zemrën time».

«Dhëntë Zoti i math të mbarojë dëshirën tuaj plotërisht. Ki shpresë dhe besim tek Ay, se me të vërtet Dhimitri meriton të jetë shoqi yt për jetë. Fli tani Olimbi, lutju Perëndisë për dëshirën tënde dhe mbetu e sigurtë se Ay kurdoherë vjen ndihmëtar në besnikët e Tij».

Fjalët e Sandës qetuan pak Olimbinë dhe gjumi ardhi në syt' e saj të njomur me lotë. Sanda dyke parë se gjumi e qepi Olimbinë vajti edhe ajo në shtratin e saj.

Zoti Kristo, passi iknë Olimbia dhe Sanda, si një i çmëndur po ecë-

passí = pasi
habítem wonder
ngulçím sobbing
vërsë age group
T'u bëftë...morájti may that gypsy be your sacrificial lamb and take all the evil that would befall you
i aratísur = arratísur exiled
këpucëgrísur with worn-out shoes
isé share
të pastájmën the future
nënqéshje smile
çpall = shpall declare
gjúmi e qépi fell fast asleep
qep sew

nte nëpër dhomë dyke u-mejtuar me çmënyrë të sillej paskëtaj; cigare pas cigare po tymoste, po nuk përfundonte gjë se u-frikësua nga fjalët e fundit të bijës së tij. Një zëmërim, një urejtje të madhe ndjente kundra Dhimitrit se atë gjente shkaktar dhe fajtor për mos bindjen e bijës së tij. Orët po shkonin me këto mejtime. U-kujtua që t'ia çfaqte të gjitha Nikos, të përfundonin që të dy ç'udhë të mbanin, dhe kështu si pak i çkujdesur u-shtri të flinte.

Të nesërmen u-ngrit më parë se kurdoherë; zbriti në dyqan dhe posa hasi Nikon i tregojti fjalimin që bëri me Olimbinë.

Nikua i tha me dinakëri, në është se lumtëria e bijës tij mvaret te Dhimitri përse të kundrështohet; po, Z. Kristo i verbuar dhe i tërbuar thiri:

«Dëshira ime do të mbarohet! Të lutem Niko të më ndihmosh se nukë dua të qeshin miqtë dhe armiqtë me mua. Niko shtoj Z. Kristo, të tregova të gjitha se ne ty kam mbesim të plotë, mos verë re fjalët e Olimbisë se ajo si një mituri nukë di se ç'flet, po eja le të bashkëpunojmë që të dalim faqebardhë në këtë çështje»!

«Zoti Kristo, u-përgjegj Nikua, kurdoherë jam shërbëtori tuaj me ç'do mënyrë».

«Si është më mirë t'a dbojmë nga dyqani Dhimitrin»? tha Zoti Kristo.

Nikua nuk desh vetëm të dbuarit nga dyqani të Dhimitrit se kurdoherë ay do ish gjembi në ligësitë që kish ndër mënt, po desh që të mos dukej më Dhimitri mi faqen e dheut po këtë gjë nukë kuxonte t'ia çfaqte sheshazi Z. Kristo.

«Unë nuk e gjenj të arësyehme që të zbohet nga dyqani Dhimitri se vetë më kini thënë Zoti Kristo se të tërë tregëtarët dëshërojnë t'a kene Dhimitrin në dyqanet e tyre, kësisoj nuk do vinjë nonjë ndryshim».

«Po atëherë si të sillemi dhe ç'të bëjmë»?

«E para është durimi dhe e dyta duhet të gjejmë nonjë mënyrë që të largohet Dhimitri nga Korça dhe kështu kur ay të ndodhet larg Olimbia dal nga dal do t'a harronjë».

«Të lumtë për mejtimin që çfaqe Niko, tha Z. Kristo dhe fytyra e tij u çel.

...Dita e tmeruar, dita e hidhërimeve për Dhimitrin si dhe për Olimbinë arriti. Ishte e enjte. Nikua iku nga dyqani më parë se ngahera, udrejtua në kryepolica i Korçës, të cilit i çfaqi tërë kallëzimin që kishin thurur për Dhimitrin. Kryepolica u-habit shumë, po dhe u-gëzua. Si Anandollok që ish, nukë kish mëshirë mbi trupin e tij për shqiptarizmën po vetëm për Turqinë kujdeseshe, dhe e priste këtë rast që të tregohesh, te qeveria se me sa zell mbaronte detyrat e tij, desh që në atë çast të zinte Dhimitrin, po Nikua e kështilloj që të duronte gjer në kohën kur Dhimitri do këndonte librën që t'a zinte me librë në duar, dhe të mos mundoheshe për prova të tjera. Ky mejtim i pëlqeu kryepolicës, dhe Nikua duke i lënë shëndenë atij, u nis për në shtëpi të Z. Kristo që t'i tregonte dhe ati pllanin që kish bërë për të larguar Dhimitrin. Kur arriti në shtëpi të Z. Kristos nuk ish ngrysur mirë. Pranë zjarrit të vatrës Z. Kristo rrinte i futur në mejtime, Olimbia dhe Sanda ishin në kuzinë,

Kur Nikua hyri brenda një frikë e padukur drodhi Olimbinë, dhe një fuqi e brendëshme nga zemra e saj e shtynte që të vinte të përgjonte fjalët që do të bënte Nikua me atin e saj, po nga ana tjatër mejto-

paskëtáj henceforth
tymós smoke
shkaktár causer
fajtór guilty one
i çkujdésur (=shkujdésur) upset; careless
has encounter
shtoj = shtói
miturí child; childishness
dboj = dëbój expel; get rid of
të dbúarit = të dëbúarit the expulsion
ligësí evil thing; evil
mënt = mend
që të mos dúkej më Dhimítri so that Dhimitri might disappear
kryepolíc police chief
kallëzím accusation
Anandollók = Anadollák person from Anatolia, the Asian part of Turkey
këndój = lexoj
lë shëndénë say good-by
përgjój eavesdrop

nej se e përgjuara është një mëkat i madh. Po fuqia e brendëshme e mundi atë dyshim. Dyke ecur mi thonjtë e gishtrinjve, vajti e pa djéhur nga të dy burrat afër dhomës ku ata fjaloseshin me zë të unjtë; nguli veshin e saj në kyçet e derës dhe dëgjoi pakë fjalë, tmeri e zu kur i dëgjoj. U-mat të thërriste, po për fat përnjëherësh mbajti veten. U-mat të hynte brenda dhe t'iu binte nër këmbë që të dy burrat të kishin pak mëshirë për atë. Po prap ajo fuqi e brendëshme e ndaloj, se që të tëra ishin më kot, asnonjë mëshirë mos priste nga ata. Me atë kujdes q'u-afrua në dhomë gjithashtu u-largua. Hyri në kuzinë. Sanda kur e pa të verdhë dhe të bregosur u-trem dhe e pyeti: ç'pësove Olimbi? Sande, Sandë, Dhimitri sonte zihet prej qeverisë ah, sa lajmë e hidhur! me buzë të dredhur foli Olimbia.

«Kush të tha?»

«E dëgjova me veshët e mi. Ka ardhur Nikua edhe po i dëften atit tim se ç'kallëzim ka thurur për Dhimitrin t'a humbasin nga faqe e dheut...» Pasi mori pak frymë pasoj: e kallzuan te kryepolica se merret vesh me Shqipëtarët që rrojnë jashtë Shqipërisë për të bërë kryengritje kundra qeverisë, dhe sonte kur rri bashkë me nënën e tij i çkujdesur nga që nuk di se ç'gjet, do shtihet në duart e qeverisë tirane».

«Po Zoti Kristo ç'thotë për këtë, Olimbi?»

«E pëlqeu, Sandë, dhe e përhiroj për kallëzimin që bëri. Po Perëndija më dërgoj atje që t'i dëgjonj të gjitha. Mos humbasim kohë, do shkruaj një letër të cilën t'ia shpiesh Dhimitrit me një herë». Me shpejtësi dhe me dorë të dredhur shkrojti këto pak radhë:

«Dhimitri, posa të marrësh këtë notë, shko lark Korçës, lark Atdheut, lark Turqisë, se je i kallëzuar te qeveria për kryengritës. Nuk do të gjesh asnjë mëshirë nga ajo po të jepesh në duart e saj dhe të kërkosh drejtësi, se armiqtë e fortë janë kundra teje. Këto radhë po t'i shkrua; me zemër këputur. Gishtrinjtë po me dridhen dhe mezi mbanj pendën. Shko dhe Perëndia le të mpronjë nga çdo rezik, të cilit dhe unë do t'i lutem për dita, gjersa vojtjet tona të mbarohen.

Jotja besnike dhe p[illegible] c[illegible]uri gjer në varr.

Olimbia

Fogion P. Postoli "Lulja e kujtimit"
Nëndori (Tiranë) IV, IO (October),
I957, pp.I60-I68 (Excerpt)

pa djéhur = pandiér undetected
kyç keyhole; lock
kyçet the keys
nër = ndër
të bregósur = të brengósur
u trem = u tremb
dëftéj tell; relate
përhirój congratulate
mbanj = mbaj

LEXIMI I TETEDHJETESHTATE

"Shemo Hajduti" in Arshi Pipa, Libri i burgut, Rome, 1959, pp.120-123

SHEMO HAJDUTI

Gjirokastër, ishe zonjë!
Gjirokastër, mbeç beronjë!
Kape, vrave një shqiponjë!
Le pa kengë një milonjë!

5 Në Stamboll një lajm gëzimi:
Than' u-zu Shemo Brahimi!
Qysh u-zu! ku zihet trimi!
Nendë vjet' në mal firar,
se nuk desh të vej' ushtar.
10 S vete — tha —, nuk ja kam ngenë!
Nendë vjetë brodhi dhenë.
Rumelin' edhe Morenë.
Qysh e futën pra në lak?
Mos u-lodh a mos u-mplak?

hajdút guerrilla; outlaw
Gjirokástër city in southern Albania
mbeç berónjë may you be sterile
kap capture
milónjë type of gun used by outlaws in the 18th-19th century
firár outlaw
kam nge I have (the) time
Rumelí Balkan areas of Ottoman Turkey
Moré old name for Peloponnesus peninsula of Greece
lak snare

15 U·mërzit nga çeta, vall?
Mos ju·shkrep, i ra një mall
për një vatër, një kope,
për një stan në Valare,
për fëmijt', gruan e re,
20 u·kaudis se do ta falin?...
E ku lê kurr' ujku malin!
Jo mor jo, s u·mplak hajduti
as u·lodh, as falje luti.
Po s mendoi se do ta shesë
25 kushëriu me të pabesë
Faqeziu, i shtroi gosti,
mish të pjekur dhe raki...
kallëzoi në qeveri.

Me të dalë nga shtëpija
30 ra pisqolla te pusija.
« Mos u-vra, o Shemo, kot!
Jemi shumë, s ikën dot! »
Uturin përroj e zalli:
« S dorëzohem për së gjalli!
35 Mos gëzo, këlysh dobiçi!
S ta harron Shemo Ogiçi! »
Katër plagë trimi muar,
dy në brinjë, një në duar,
tjetrën mu në kraharuar.

40 Në Janinë gjall' e shpien,
në pazar vërdall' e bien,
lidhur, hypur mbi gomar.
I nduk mjekrrën një xhandar.
« Shemo, ç' ke që s kuvëndon? »

Mos ju (=iu) shkrep did he get some idea
kopé herd
stan shepherd's community
e ku how can
lê = lë
fálje pardon; amnesty
faqezí shameless; villain ("black-cheeked")
gostí feast
pusí place of ambush
zalli quarry
uturíj rumble
këlýsh puppy
dobíç bastard
ogíç lead ram
bri rib
nduk pull; pinch
xhandár policeman

45 « Jo për gjë, s e kam zakon!
Në ju shtença dot ndër thoj
dhjam në hell do ju pikoj! »

Në budrumet e kalasë
vjen Hysni Pashaj t' i flasë.
50 « Ja lëroni ca litarët!
— Fol, hajdut, dëshmo të vrarët,
sa ke djegur e plaçkitur,
duke shkelur, neveritur,
ligjet, forcën e Sulltanit,
55 kundër dinit dhe vatanit!
Vilajetit kalle datën!
Të kam ndjekur ditën, natën,
dimër, verë, që nga prapa:
Shemo, mê në fund të kapa! »

60 « O Pasha, që flet mbi fron,
s jam ashtu si më gjykon!
Me koshadhe me xhandarë
më ke ndjekur: të kam vrarë
Për haraç të marr' armikut,
65 për grabitjen e çifllikut
të një beu, të një agaj...
mirë pra se paskam faj!
Kam plaçkitur edhe stane,
ku kish mjaft... edhe karvane.
70 Po të thotë një njeri
se rrëmbeva misër, dhi,
nga një bujk, nga një bari!
Un' i dhashë varfanjakut
(e di Zoti, m' ardhtë hakut!).

<u>në ju shtença dot ndër thoj</u> if I ever get a hold of you
<u>dhjam në hell do ju pikój</u> I'll roast you on a spit
<u>budrúm</u> dungeon
<u>lëróni</u> = <u>lióni</u> loosen up; release
<u>plaçkít</u> plunder
<u>neverít</u> forsake
<u>din</u> faith
<u>vatán</u> = <u>atdhé</u>
<u>vilajét</u> province
<u>kall</u> instill
<u>dátë</u> horror; terror
<u>haráç</u> ransom
<u>çifllík</u> = <u>çiflík</u> landed estate
<u>agá</u> small landlord
<u>varfanják</u> poor one
<u>m' árdhtë hákut</u> may he give me my just dessert

75 Edhe çupa kam martuar,
pleq, bonjakë kam ndihmuar.
Se nuk thashë peqe, lepe,
për nizam e për xhelepe,
për një mbret në vend të tij
80 që s më di dhe që s e dij...
jam hajdut: pëlqej mê mirë
të rroj malesh ujk i lirë
se sa balo me zinxhirë!»

«Shemo, nesër që me natë
85 të këtilë ligjëratë
bêja lakut edhe rrapit!»

« S pres mëshirën e kasapit!
— Amanet, pasha, një gjê!
Porosi Lules i lê:
90 të martohet!... E grabita
kur ish foshnjë, vet' e rrita...
êsht' e re, njeri nuk ka...
djemt' t' i jepen tim vëllai»

Gjirokastra mal e brigje,
95 qan një grua, qan me ligje.
« Pse të njoha, korba, kurrë!
Lulja jote s merr mê burrë!
Do rris djemtë, t' u kall zjarrin,
gjakun tend ata ta marrin!
100 Pasuri, oxhak, nuk dual
Do të bredh krua më krua,
të dëgjoj kengët e tual»

bonják orphan
péqe as you please
lépe at your service
nizám law; order
xhelépe tax on cattle
bálo sheep dog
që me nátë at dawn
ligjerátë lecture
lak noose; snare
rrap kind of tree
kasáp butcher
porosí request
oxhák family name

Alfred Uçi "Modernizmi - ndërgjegje mitologjizuese" Nëntori (Tiranë) XXI, 10 (October) 1974, pp.141-149

ALFRED UÇI

MODERNIZMI – NDËRGJEGJE MITOLOGJIZUESE *)

Në kohën tonë problemi i mitit dhe i raportit të tij me artin po zë një nga vendet më kryesore në polemikat dhe diskutimet estetike. Rritja e interesimit të estetikës për problemin e mitit është e lidhur ngushtë, së pari, me roliin fetishizues mitologjizues, që luan ndërgjegjja estetike moderniste në kohën tonë dhe, së dyti, me ato shkaqe social-klasore, që ushqejnë në shoqërinë e sotme kapitaliste ndërgjegjen e jetësuar, që lindin një varg iluzionesh ideologjike, të cilat marrin shpeshherë trajtën e miteve.

*) Pjesë nga libri «Labirintet e modernizmit», që pregatitet për botim.

KUPTIMI I MITIT

Mitologjia[1]) është një fenomen shumë i lashtë i jetës shpirtërore, kryesisht i shoqërisë së komunitetit primitiv dhe i fazës së kalimit të saj drejt shoqërisë skllavopronare, ndonëse elementë të krijimtarisë mitologjike ndeshen edhe në etapa të mëvonshme të historisë njerëzore.

Miti, sipas marksizmit, është një trillim fantastik, i përpunuar nga ndërgjegja kolektive e fiseve primitive, që ka karakter sinkretik, sepse në të shkrihen përfytyrimet dhe mendimet e tyre të ndryshme, morale, artistike, fetare, njohëse, etj. Mitologjia, është produkt i fantazisë kolektive, që bashkon përfytyrimet shqisore mbi sendet me dëshirat dhe synimet ideale të njerëzve primitivë. Në mitet elementi artistik është i pandarë nga gjithë elementët e tjerë, prandaj miti nuk është thjesht art, ashtu si dhe arti nuk është i barabartë me mitin në tërësi. Elementi artistik në mitet lot një rol të nënshtruar. Mitet formohen në trajtën e përfytyrimeve me karakter mrekullie, çudie. Te mitet elementi fantastik, imagjinar plekset me përfytyrime e mbresa konkrete shqisore dhe me pikëpamje fetare. Njeriu, që krijon dhe përdor mitet, nuk i konsideron ato pasqyrim ose figura të jetës, por i merr si një realitet.

Miti nuk reduktohet tërësisht në fenë, sepse teja pranon ekzistencën e fenomeneve mbinatyrore, të forcave shpirtërore të përtejme, mbishqisore, kurse mendimi mitologjik i konsideron figurat me krijimet mitologjike si pjesë të pandara të natyrës, të botës reale. Miti për njeriun primitiv nuk lot rolin e simboleve fetare, sepse nuk ka funksion të shënojë diçka që s'shihet, që s'kapet nga shqisat. Miti është edhe një farë shpjegimi naiv, fantastik i fenomeneve të botës, por edhe një mënyrë e të pamit të tyre. Zeusi i plotfuqishëm drejton gjithë gjërat, sidomos, bubullimat e rrufetë, ai ndërron stinët e vitit, por njëkohësisht është edhe përsonifikim i tyre, i të pamit të tyre, edhe përjetim emocional i tyre. Te miti shprehja e diçkaje është e pandarë nga ajo që shprehet.

Gjatë evolucionit të saj mitologjia ka përdorur më parë figurat e kafshëve (zoomorfizëm), pastaj edhe të njeriut (antropomorfizëm) për të objektivizuar përfyty-

1) Koncepti «Mitologji» përdoret në disa kuptime: a) si shkenca mbi mitet; b) si tërësia e miteve të një populli; c) si një veprimtari specifike shpirtërore krijuese, që përpunon mite..

mitologjizúes mythologizing
mit myth
fetishizúes fetishizing
shkáqe (shkak) causes
i jetërsúar shaped by property ownership

rimet dhe emocionet. Këto trajta të mitologjisë dëshmojnë se ai, që i ka krijuar, njeriu primitiv, ka qenë në një shkallë, kur nuk e veçonte dhe nuk e dallonte veten nga sendet, nga qëniet e tjera të natyrës. Mendimi mitologjik s'e dallon njeriun nga natyra, figurën nga sendi, subjektivën nga objektivja, fantastikën nga realja.

BURIMET TEORIKE TË ESTETIKËS MITOLOGJIKE

Estetika e modernizmit ndjeu qysh në hapat e saj të para afërsinë midis prirjeve të ndërgjegjes estetike moderniste dhe mendimit mitologjik dhe iu vu punës për të dhënë një interpretim të tillë të miteve, që të përligjte variantet e ndryshme «magjike» ose «mitologjike» të modernizmit. Prandaj, nga fundi i shekullit XIX dhe gjatë shekullit XX estetika e modernizmit filloi të formulojë një platformë teorike mbi mitet. Si pikëmbështetje i shërbyen idetë e estetikës së romantizmit, e cila, për të kundërshtuar racionalizmin e njëanshëm të klasicizmit, të iluminizmit, e çmonte mitin si prototip të krijimtarisë poetike. Në qoftë se iluministët i identifikonin mitet me paragjykimet, me mashtrimet, romantikët e estetizonin mitologjinë, çmonin lart forcën e imagjinatës krijuese mitologjike dhe i merrnin mitet si shprehje të veçorive më të kapëshme të «shpirtit» të popujve. Në rritjen e prestigjit estetik të mitologjisë tek artistët e fundit të shekullit XIX një rol të madh lojtën pikëpamjet e Vagnerit, i cili e idealizonte mitologjinë popullore dhe me të e lidhte të ardhshmen dhe ringjalljen e artit. Këto pikëpamje gjetën miratimin e flaktë të simbolistëve në fund të shekullit XIX.

Estetika e modernizmit u nis, sidomos, nga teoria e F. Niçes, i cili fillesën mitologjike e konsideronte si fillesën me vitalitet më të madh të kulturës njerëzore. F. Niçja njihet jo vetëm si themelues i teorisë mbi antinominë e Dionizit dhe të Apollonit, mbi luftën e pandërprerë të dy fillesave mitologjike të kundërta, që përcaktojnë fizionominë e kulturës së shoqërisë, por edhe si ithtar i idesë mbi universalizmin e mitologjisë. Ai i quante mitet themel të gjithë jetës shpirtërore të shoqërisë, duke përfshirë edhe filozofinë. Niçja u përpoq të fusë në filozofi dhe estetikë stilin mitologjik, kjo gjë bie në sy qartë në veprën e tij «Kështu foli Zarathustra».

sklavopronár slave owner
trillím fantasy; fabrication
shqisór sensory
syním aim
i nënshtrúar subdued
trájtë mold; frame; shape
mbres memory; recollection
mbinatyrór supernatural
i përtéjmë outside
mbishqisór extrasensory
shqis sense
i plotfuqíshëm omnipotent
përjetím perpetuation

Estetika modernisté ka treguar interesim jo vetëm për estetizimin dhe idealizimin e mitologjisë, por sidomos për interpretimin iracionalist të saj prej Niçes, i cili paralajmëronte mbarimin e «qytetërimit humanist» dhe vërshimin e një mitologjie të re. Niçja thoshte se «njerëzimi nuk mund të jetojë më me të vërtetën», sepse «vullneti drejt së vërtetës është bërë sistem degjenerimi». Meqenëse shkenca, sipas tij, nuk është e plotfuqishme dhe e vërteta nuk është një çelës universal, njeriut s'i mbetet veçse të kridhet në mitologji. Te mitet Niçja nuk shikonte asnjë dije, asnjë element njohjeje; miti ishte për të «ngadhënjim mbi njohjen», ishte kurorëzim i çdo lëvizjeje, që humbet besimin te e vërteta, te dija. «Vetëm horizonti i rindërtuar mbi bazën e mitit, — shkruante Niçja, — mund ta çojë një lëvizje të tërë kulturore drejt kurorëzimit. Figurat mitologjike duhet të bëhen rojtarë demoniakë të kudo-gjindurë, nën mbrojtjen e të cilave rriten shpirtrat e njomë dhe nën flamurin e të cilave burri duhet të masë dhe të vlerësojë jetën, luftën e tij. Dhe madje vetë shteti s'ka ligje më të fuqishme të pashkruara se sa themelet mitologjike. Niçja e quante të dobishëm vërshimin e valës së iracionalizmit. Si terapi për të kundërshtuar proceset, që po e shkatërronin nga brënda rendin borgjez, Niçja konsideronte përpunimin e një mitologjie të re, e cila ta vinte njerinin nën ndikimin e një botëkuptimi iracionalist, ta manipulonte ndërgjegjen e tij, duke e kredhur në mbretërinë e errësirës, duke e lidhur pas fillesës dioniziane.

Në veprën e tij «Origjina e tragjedisë» Niçja shkruante se qëllimi i artit të ri duhej të ishte «etja e pashuar për iluzione, etja për t'u çliruar me anë të iluzioneve». Mitologjia e re, si një mjet për mistifikimin e historisë, duhej të ishte, sipas Niçes, një nga armët e reja të imperializmit përballë zgjimit të masave, një nga mjetet për t'i trullosur dhe për t'i vënë në gjumë ato. Nuk është e rastit që nazistët u kujtuan për idetë e Niçes dhe e shpallën doktrinën e tyre reaksionare «mit të ri të shekullit XX».

Estetika e modernizmit huajti nga teoria e Niçes idenë mbi vitalitetin dhe universalitetin e mitologjisë, idenë mbi domosdoshmërinë historike të një ndërgjegjeje të re mitologjike, që t'i kundërqëndronte racionalizmit, ndërgjegjes shkencore.

Një burim tjetër i estetikës mitologjike të modernizmit ka qenë edhe teoria simbolike e E.Kasirerit. Në veprat e tij «Mendimi i mitologjisë» dhe «Filozofia e for-

veçój separate
iu vu púnës set out
pikëmbështétje keystone
mashtrím deception
estetizój aestheticize
veçorí characteristic
fillésë beginning; starting point
ithtár idolater; idol worshipper
të fúsë (fut) to introduce

mave simbolike», të botuara dhe ribotuara në vitet 20-30 të shekullit tonë, Kasireri e shpalli gjithë veprimtarinë mitologjike si veprimtari simbolike dhe mbi këtë bazë e afroi me artin; sipas tij mitologjia është, si edhe arti, një formë simbolike, autonome e kulturës, domethënë një sistem i mbyllur simbolesh, me një strukturë specifike, të pavarur nga faktorët socialë dhe nga zhvillimi historik i shoqërisë, e aftë për të objektivizuar dhe simbolizuar emocionet, përjetimet shqisore.

Estetika e modernizmit ka përdorur idetë e Kasirerit mbi identifikimin e artit dhe të strukturës së tij me mitin në bazë të universalitetit simbolik mbi artin si një «tërësi autonome formash të brendshme simbolike», që nuk pasqyrojnë realitetin dhe jetën, por që ndërtohen ashtu si dhe mitet, që nuk plotësojnë ndonjë funksion gnoseologjik, njohës. Teoria e mitologjizmit simbolik e Kasirerit merrte drejtpërdrejt nën mbrojtje variantet simbolike të modernizmit, abstraksionizmin simbolik.

Estetika mitologjike moderniste ka përvetësuar një varg idesh nga interpretimi frojdist i miteve. Frojdi dhe Jungu në vend që t'i kërkonin lidhjet e mitologjisë me kushtet konkrete të historisë së lashtësisë, përkundrazi, u nisën nga fenomenet psikike patologjike, nga neurozat e njerëzve të kohëve moderne dhe, me ndihmën e tyre, u përpoqën të shpjegojnë prejardhjen e mitit. Frojdi këtë interpretim e jep në veprën e tij «Totema dhe tabu», ku bën një paralelizëm të plotë antihistorik midis tabusë, totemizmit dhe kushteve të jetës së shekullit XX. Sipas tij, zakonet dhe kufizimet sociale, morale janë identike me tabutë e fiseve primitive dhe prandaj në «kompleksin e Edipit», në raportet e fëmijës ndaj atit, në kufizimet sociale të marrëdhënieve seksuale qëndron, sipas tij, rrënja e vetme e artit. «Bota është seks» — ja formula e frojdizmit. Frojdi i afronte dhe i reduktonte artin dhe mitologjinë në një fillesë të vetme aktive, në prirjet e shtypura, të parealizuara seksuale, në një fillesë asociale, thjesht instinktive.

Jungu i lidhi mitin dhe artin me disa figura arkaike, produkte të pavetëdijshme, kolektive me origjinë super personale, nga disa arhetipe, që kanë karakter simbolik-mitologjik dhe që nuk i nënshtrohen arsyes, ashtu si dhe ëndërrat. Jungu e absolutizoi mitin aq sa e shndërroi në një fillesë mitologjike misterioze, që shpreh thelbin e psikikës primitive arkaike dhe që ndërton një realitet mitologjik, i cili është, sipas tij, i vetmi realitet për njeriun. Në frymën e idealizmit subjektiv, Jungu nuk e merr mi-

paralajmërój foretell; predict
çélës key
díje knowledge
ngadhënjím = ngadhnjím victory
kurorëzím crowning success
kudó gjindúrë omnipresent
terapí therapy
kredh plunge; dive
me ánë by means of
húaj borrow
domosdoshmërí indispensability

tin si pasqyrim të fenomeneve të realitetit, por si thelb të psikikës, të shpirtit që e ndërton njeriu. «Bota është drama e shpirtit», — thosh Jungu në frymën e idealizmit. Prandaj si miti ashtu edhe arti janë produkte të pavetëdijshme, që manifestohen në arhetipet. E gjithë historia e artit s'është veçse një modifikim i pjesshëm i arhetipeve që përfshin gjithë pasurinë themelore të botës shpirtërore.

Interpretimi i mitologjisë nga Jungu dhe Frojdi u bë mbështetje për të përligjur në modernizmin jo vetëm pornografinë, por edhe metodat spontane, të pavetëdijshme të krijimtarisë, interpretimin e artit si një veprimtari iracionale, spontane, që nuk i nënshtrohet kontrollit të arsyes.

KRITIKA E THELBIT TË ESTETIKËS MITOLOGJIKE

Mbi bazën e këtyre ideve, në estetikën e modernizmit u formua një variant «mitologjik», që përpiqet të përligjë artin modernist duke u nisur nga interpretimet antishkencore të mitologjisë. Estetika e kritika mitologjike me përfaqësues të saj si Mod Bodkin, Riçard Çejz, Nortrop Fraj, R.Garodi, E.Fisher etj., është sot e kësaj dite një nga drejtimet më të rëndësishme në estetikën borgjeze e revizioniste të kohës sonë.

Shkolla mitologjike në estetikë dhe kritikë e shikon gati gjithë historinë e artit si histori mitesh dhe për këtë arsye e barazon krijimtarinë e modernistëve, të Xhojsit, Kafkës, Apdajkut me atë të shkrimtarëve të tillë si Miltonit, Blejkut, Shekspirit, Defosë, Kollrixhit, Tenisonit, T. Hardit, Toros, Stendalit, Zolasë, etj., që kanë përdorur figura ose motive mitologjike në veprat e tyre.

Estetika mitologjike e modernizmit shpall se i vetmi mjet për ta ripërtërirë artin bashkëkohor është mendimi mitologjik.

Krahas rritjes së ndikimit të estetikës mitologjike, gjatë shekullit XX u zgjerua shumë edhe drejtimi mitologjik në artin modernist. Krahu mitologjik i modernizmit u bë shumë i fuqishëm nëpërmjet veprave të Xhojsit, Kafkës, Eliotit, Apdajkut, Kamysë, Foiknerit, etj. Po kështu edhe në pikturën moderniste mendimi mitologjik ndikoi fort krijimet e pasimpresionistëve, primitivistëve, surrealizmit dhe të abstraksionizmit «magjik».

Estetika mitologjike përpiqet ta përligjë dhe ta mbrojë modernizmin duke fshehur shkaqet e vërteta sociale,

gnoseologjík pertaining to knowledge
frojdíst Freudian
kufizím inhibition; limitation
prírje drive; disposition
i shtýpur suppressed
i pavetëdíjshëm unconscious
arhetíp archetype
shndërrój transform
i pjésshëm partial
barazój equalize
ripërtërít revive
piktúrë painting

klasore, konkrete, që e kanë lindur, duke e lidhur burimin e tij me një faktor «mbihistorik», «pannjerëzór», me prirjen e përjetshme të njeriut për t'u marrë me magji, me mitologji, me prirjen e tij për të ëndërruar, për t'u kënaqur dhe habitur me mrekullitë. Ka mjaft estetë borgjezë, që përpiqen të tregojnë se mitologjia, krijimi i miteve është një kusht i domosdoshëm dhe i përhershëm i jetës njerëzore. Mitologu dhe esteti gjerman H. Bart në librin e tij «Masat dhe miti» (1958) përpiqet ta paraqitë mitin si një atribut të pandarë të shoqërisë dhe një kusht të përhershëm të ekzistencës normale të saj. «Forcat fillestare të njeriut në vrullin e tyre, — shkruan ai, — mund të shpërthejnë në sipërfaqe, fluturimi i shpirtit mund të shfaqet vetëm në sajë të figurës, po kurrë nëpërmjet konceptit. Doktrina mbi mitin social, s'ka dyshim, është e lidhur ngushtë me kuptimin e lëvizjes së masave. Masa dhe miti i përkasin njeri tjetrit. Masa bëhet e vetëdijshme me ndihmën e mitit. Më saktë, miti lind bashkësitë e njerëzve, sepse ai drejtohet mu në zemër të njeriut. Miti likuidon izolimin e njerëzve. Ai kryen punën e koordinimit të veprimeve njerëzore. Ai ndihmon të vendoset marrëveshja. Miti është fillesë organizuese. Prej tij vjen frymëzimi, të cilit njerëzimi i detyron ekzistencën dhe madhështinë. Miti plotëson dhe forcon atë besim, mbi bazën e të cilit kryhen punë të mëdha historike».

Në të vërtetë, mitologjia, si krijim mitesh, është një fenomen specifik, që i korespondon një shkalle shumë të ulët të zhvillimit të shoqërisë, kur njeriu, sipas shprehjes së Leninit, ende nuk ishte veçuar nga natyra, nuk e dallonte veten nga sendet dhe qëniet e tjera të natyrës, kur ishte ende tepër i pafuqishëm përballë forcave spontane shkatërruese të natyrës. «Çdo mitologji, — ka shkruar Marksi, — nënshtron dhe formon forcat e natyrës në fantazi dhe imagjinatë dhe me ndihmën e imagjinatës; ajo zhduket, si pasojë, së bashku me arritjen e sundimit real mbi këto forca të natyrës (K. Marks, F. Engels, veprat, v. 12 f. 737, rusisht).

Historia dëshmon se krahas zhvillimit të jetës shoqërore dhe zgjerimit të sferës së sundimit të njeriut mbi botën që e rrethon, u kufizua, u ngushtua krijimtaria mitologjike dhe qysh në shoqërinë skllavopronare zunë të diferëncohen dhe të fitojnë pavarësi prej saj përfytyrimet filozofike, morale, fetare, estetike etj. Historia e zhvillimit të shoqërisë njerëzore ka qenë dhe do të jetë, në përgjithësi, një proces demitologjizimi i jetës shpirtërore, ndonëse ky proces ka patur zikzaket e veta. Historikisht,

mbihistorík outside of history
pannjerëzór throughout all humanity
i përhérshëm everlasting
fillestár original
vrull impetus
në sájë through the aid
bashkësí community

krijimtaria mitologjike, roli i saj në kulturën shpirtërore të shoqërisë janë ngushtuar. Kjo është një pasojë krejt e natyrshme po të kemi parasysh rritjen progresive të forcave prodhuese të shoqërisë, zhvillimin e shkencave, që shpjegojnë dhe çmistifikojnë gjithë ato fenomene të natyrës dhe të jetës, që ishin të pakuptueshme për njerëzit primitivë dhe që pasqyroheshin në një trajtë fantastike, të shtrembëruar në mendimin e tyre mitologjik.

Natyrisht, gjatë progresit shoqëror, mitologjia e çdo populli nuk zhduket pa lënë gjurmë, por, përkundrazi, si një faktor kulturor, ndikon dhe do të ndikojë mbi anë të ndryshme të jetës shpirtërore të shoqërisë. Çdo popull ka patur mitet e tij, në të cilat janë pasqyruar veçoritë e jetës, të historisë së tij, në të cilat janë shprehur, siç është bërë zakon të thuhet, «shpirti», aspiratat, ëndërrat, synimet, përfytyrimet, idealet morale, estetike të tij. Prandaj mitologjia ka qenë një forcë kulturore e rëndësishme, madje, jo vetëm brenda caqeve të kulturës kombëtare, por edhe në shkallë botërore.

Por, së pari, përdorimi i miteve në epoka të ndryshme dhe në ditët e sotme nuk mund të konsiderohet si një krijimtari e mirëfilltë mitologjike, sepse mitet e lashta tashmë nuk funksionojnë me atë kuptim që kanë patur kur lindën, por me një kuptim tjetër. Shumë nga mitet e Greqisë së lashtë, miti i Zeusit, i Anteut, i Heraklit, i Sizifit, etj. përdoren edhe në kulturën e sotme bashkëkohore, por njerëzit sot i shikojnë thjesht si figura artistike dhe nuk i vlerësojnë, ashtu siç i vlerësonin grekërit e lashtë, të cilët nuk e vinin në dyshim ekzistencën reale të Zeusit dhe besonin se ai dënonte me të vërtetë duke gjuajtur me bubullima e vetëtima.

Së dyti, nuk është e drejtë që njëlloj veprimtaria mitologjike, ose më mirë të thuash, mitologjizuese apo mistifikuese, që ekziston edhe në kushte të caktuara të zhvillimit shoqëror, të barazohet me mitologjinë e lashtë klasike dhe të nxirret përfundimi se mitologjia është një atribut i pandarë i qënies njerëzore, siç pohojnë estetë dhe shumë mitologë borgjezë e revizionistë. Edhe në epokën tonë, në vende kapitaliste e imperialiste, ekziston një veprimtari mitologjizuese, krijohen mite. Në këtë kuptim flitet për «mitet e shekullit XX». Mirëpo s'ka asnjë bazë shkencore të barazohet dhe të identifikohet krijimi i miteve në kohën tonë me mitologjinë e lashtë klasike.

Mitologjia e lashtë ka tjetër përmbajtje, të tjera rrënjë sociale, kryen të tjera funksione dhe zë një vend tjetër në krahasim me mitet, që krijohen në shoqëritë e

çmistifikój demystify
veçorí trait; feature
çak limit; confine
mirëfílltë exact; accurate
njëllój equal

kohëve moderne. Mitologjia e lashtë klasike ishte produkt i një shkalle të ulët të zhvillimit shoqëror, ishte produkt i shkrirjes së njeriut me kolektivin dhe me natyrën dhe përmbledhte të vetmet përfytyrime të mundshme morale, fetare, estetike, etj. të njerëzve primitivë. Kurse mitet e sotme janë produkte të ndarjes së shoqërisë në klasa antagoniste, të kontrastit midis individit dhe shoqërisë, që mbështetet në pronën private, janë produkte të veprimit të forcave jetëreuese të rendit shfrytëzues, të një ndërgjegjeje të jetërsuar, të tëhuajtjes dhe braktisjes së njeriut, që e ndjen veten në armiqësi me shoqërinë, me natyrën. Mitet e sotme krijohen, përpunohen dhe përhapen në kushte të caktuara historike, kur ekzistojnë forma të diferencuara të ndërgjegjes shoqërore — filozofia, shkenca, morali, politika, e drejta, feja, arti etj., të cilat, për më tepër, kanë karakter klasor. Mitet e sotme formohen, përpunohen dhe përhapen nëpërmjet një veprimtarie përgjithësisht të ndërgjegjshme ideologjike për të manipuluar ndërgjegjen e masave, për të rrënjosur tek ato përfytyrime të shtrembra mbi jetën, për t'i mashtruar. Në kushtet kur shkenca, ideologjia marksistë-leniniste e bënë të mundur, që njerëzit e kohës sonë të kenë përfytyrime të drejta mbi fenomenet dhe proceset më të ndryshme të natyrës e shoqërisë, ideologjia borgjeze përdoret për të thurur lloj-lloj mitesh, për t'i mashtruar masat, për të fshehur plagët e rendit shfrytëzues dhe për të lindur e ushqyer iluzione, përfytyrime të rreme. Pra, krijimi i miteve në kohën e sotme është pjesë e veprimtarisë ideologjike të klasave shfrytëzuese për të mistifikuar qëllimisht disa anë të jetës shoqërore.

Kjo veprimtari ideologjike, mistifikuese quhet shpesh edhe mitologjike, krijim mitesh të reja, sepse këtyre u jepet pak a shumë trajta e produkteve të mitologjisë së lashtë. Kështu, p.sh., ato përpunohen në trajtën e iluzioneve shqisore, konkrete ose si një ndërthurje alogjike e reales me irealen, me dëshirën, me ëndrrën. Këtu qëndron edhe një nga shkaqet që këto mite nganjëherë kanë forcë të madhe emocionale, mashtruese dhe mund të përhapen gjerësisht. Pra, paralelizmi, që bëjnë mitologët borgjezë midis mitologjisë së lashtë dhe krijimit të miteve në kohën tonë, është krejt i pathemeltë, është antihistorik dhe bëhet për të fshehur qëllimin thjesht mistifikues të veprimtarisë ideologjike të forçave shoqërore reaksionare të kohës sonë.

shkrírje fusion
prónë property
jetërsues tending to perpetuate
tëhúajtje alienation
mashtrój deceive
lloj-lloj all kinds of
ndërthúrje weaving

LEXIMI I TETEDHJETETETE

MITI DHE ARTI

Estetika e modernizmit ka përkrahur edhe një ide tjetër, të huajtur nga teoritë idealiste, antishkencore mbi mitologjinë, idenë që e barazon mitin me artin, që vë shenjën e barazimit midis mitologjisë dhe krijimtarisë artistike. Kjo ide ka qenë vënë në qarkullim prej kohësh nga mitologët borgjezë, mirëpo estetët borgjezë ë kohës sonë, duke marrë shkas dhe nga praktika artistike e modernizmit, po e përhapin si idenë më frutdhënëse për shkencat moderne artistike e estetike. Shumë prej tyre mundohen të tregojnë se kuptimi i thelbit të mitit, të mitologjisë është themeli për ta kuptuar edhe artin, krijimtarinë artistike, për të zbuluar thelbin specifik të tyre, perspektivat dhe tiparet që do të ketë arti në të ardhmen. «Unë supozoj, — shkruan mitologu dhe esteti i njohur amerikan R.Çejz, — se idea e mitit të përfunduar në zhvillimin e saj na jep kyçin për të shpjeguar shumë të fshehta të artit modern, madje, të dukurive më autentike të tij si, p.sh., «Gernika» e Pikasosë me mohimin e dëshpëruar prej saj të formave tradicionale, me shprehjen e thëksuar të shëmtimit, të krimit të përbindshëm dhe të vuajtjeve».

Një pasion të veçantë për ta marrë nën mbrojtje, madje, duke i veshur dhe petkat e marksizmit, teorinë mitologjike të artit, po tregojnë shumë estetë revizionistë të kohës sonë. Gjithë përpjekjet e tyre për të revizionuar estetikën marksiste-leniniste estetët revizionistë E. Fisher dhe R. Garodi i kanë mbështetur në interpretimin mitologjik të artit. Ata u përpoqën të tregojnë se gjoja veprimtaria mitologjike dhe ajo artistike janë identike dhe prandaj artin ata e shpallin mit, magji, madje, e barazojnë me kruhun mitologjik të modernizmit dhe, përgjithësisht, me veprimtarinë ideologjike për krijimin e miteve në shoqërinë e sotme borgjeze. Në këtë drejtim ata kanë spekulluar sidomos në idenë e Marksit se mitologjia greke ka qenë jo vetëm arsenali nga i mori mjetet e shprehjes artistike arti grek, por edhe trualli mbi të cilin lulëzoi ky art.

Edhe revizionistët sovjetikë po tregojnë vëmendje të madhe për të përvetësuar idetë e mitologëve borgjezë dhe po i përdorin për të mbështetur interpretimin mitologjik të artit. Kështu, një nga mitologët kryesorë sovjetikë, Meletinski, pasi merr nën mbrojtje teoritë e mitologëve borgjezë, të Shelingut, Niçes, Frajzerit deri tek ato të Frojdit, Jungut, Kasirerit dhe të kohës sonë Bodkinit, Çejzit

frutdhënës fruitful
i përfundúar complete
shëmtím ugliness

dhe N. Frajit, pasi shtron nevojën e kryqëzimit të marksizmit me këto teori, e konsideron mitologjinë një cilësi të përjetshme të njeriut dhe e barazon me artin në përgjithësi. Meletinski shkruan se në shekullin e XX «miti e zbuloi veten jo vetëm si burim gjenetik për zhvillimin e mendimit artistik, por deri në një shkallë si një model i përjetshëm dhe element qenësor i tij».

Miti, mitologjia dhe arti, krijimtaria artistike kanë një afërsi dhe disa tipare të përbashkëta; produktet mitologjike dhe artistike gjithmonë aktualizohen në trajta konkrete shqisore; në krijimtarinë artistike dhe në mitologjinë lot rol të madh imagjinata, fantazia. Në mitet dhe në veprat artistike mbresat dhe përfytyrimet konkrete shqisore janë të pandara nga përjetimet emocionale, nga dëshirat, aspiratat, synimet ideale të njerëzve, nga përzierja e mbresave reale me imagjinatën, me ëndërrën, fantastiken. Por midis artit, krijimtarisë, artistike, dhe mitit, mitologjisë ka edhe dallime thelbësore, të cilat, po të mos i përfillësh, nuk të lejojnë të kuptosh specifikën e secilit prej këtyre fenomeneve të ndryshme të kulturës.

Dallimet midis mitologjisë dhe artit manifestohen, së pari, në faktin se mitologjia e nënkupton si të domosdoshëm besimin në realitetin figurativë të krijuara prej fantazisë mitologjike, kurse figurat e poezisë, letërsisë, artit, që të funksionojnë me të gjitha vlerat e tyre, nuk kanë nevojë të merren për gjëra reale, që të ushtrojnë gjithë ndikimin për të cilin krijohen nuk kanë nevojë që të kuptohen si të barabarta me sendet. Krejt ndryshe nga arti, në mitologji figurat mitologjike nuk mund të plotësojnë funksionet e tyre po të vihet në dyshim realiteti i tyre.

Së dyti, miti është produkt i fantazisë kolektive dhe, nga pikëpamja e mekanizmit të përpunimit të tij, ai është i afërt me mekanizmin e krijimtarisë artistike kolektive, kurse në letërsinë dhe artin e kultivuar lë gjurmë të pashlyera imagjinata individuale. Mendimi mitologjik asimilon, ruan dhe përpunon vetëm ato elemente të fantazive individuale, që janë në përputhje me idealin kolektiv.

Së treti, mitologjia e nënkupton medoemos mrekullinë, çudinë, që pranohen për të vërteta prej mendimit mitologjik, për ngjarje reale. Tek miti, realja dhe fantastikja nuk dallohen, përkojnë.

Figurat mitologjike nuk kanë ndonjë kuptim të tërthortë ose nënkuptim; për mendimin mitologjik janë të

qenësór essential
dallím difference
thelbësór fundamental
i pashlýer ineradicable; indelible
përpúthje agreement; harmony
nënkuptój imply
medoemós necessarily
përkój harmonize; coincide
i tërthórtë indirect
nënkuptím implication

huaja metaforat, alegoritë. Në artin dhe letërsinë e kultivuar, përkundrazi, edhe kur në to përfshihen ngjarje ose veprime të çuditshme, mrekullira, ato nuk kanë kuptim të drejtpërdrejtë, por të tërthortë, kanë kuptim metaforik ose alegorik. Figurave më të çuditshme, më fantastike në artin e kultivuar u jepet një karakter alegorik, një nënkuptim. Për këtë arsye figura të tilla mund të hasen edhe në artin realist. Lenini ka theksuar nevojën e dallimit të figurës artistike nga realiteti; sipas tij, ato s'janë një.

Nganjëherë, për të përligjur produktet e shëmtuara të modernizmit, mjaft estetë modernistë i drejtohen faktit që edhe në artin dhe letrësinë realiste janë krijuar figura jo vetëm fantastike, por, madje, të përçudnuara si, për shëmbull, përbindëshat në tablonë «Mëkatat e Shën Antonit» të Bos'hit, hyjhnhnmëstët e Xh. Suiftit, ëngjëjt ose pinguinët në romanet e A. Fransit, humbja e hundës së një personazhi të N. Gogolit, fantasmagoritë e Gojës etj. Mirëpo këto figura nuk janë krijuar si figurat e miteve, përkundrazi, ato janë krijuar sipas ligjeve të krijimtarisë artistike dhe jo të mitologjisë, ato janë krijuar si metafora, simbole e alegori, përmbajta ideore e të cilave është përpunuar paraprakisht nga arsyeja. Asgjë mitologjike nuk ka në këto figura, sado fantastike qofshin, sepse ato janë përdorur si konvencione artistike për të satirizuar fenomenet e ulta dhe të shëmtuara të botës. Asnjë prej piktorëve dhe letrarëve të mësipërm nuk ka besuar në realitetin e këtyre figurave, por në to secili ka futur një nënkuptim për të shprehur plot patos vlerësimin kritik të tyre ndaj fenomeneve të shëmtuara të jetës, për të konkretizuar një ide të caktuar estetike. Figurat, që përmbajnë veprat e artit realist, sado groteske qofshin, nuk kanë asgjë mitologjike, por përdoren për të shprehur një ide, e cila nuk po përkon me përmbajtjen e drejtpërdrejtë të figurës, por me nëntekstin, me nënkuptimin, me një kuptim të tërthortë, indirekt të tyre.

Dallimet midis artit dhe mitologjisë është e vështirë t'i konstatosh. kur është fjala për mitologjinë e lashtë klasike, sepse në lashtësi arti nuk ekzistonte si një veprimtari e diferencuar dhe përfshihej si pjesë e pandare e kulturës sinkretike, shpirtërore të shoqërisë, domethënë pleksej edhe me mitologjinë. Më vonë, në kushtet e shoqërisë me klasa, kur u diferencua edhe arti nga format e tjera të kulturës shpirtërore të shoqërisë, dallimet u bënë përherë e më të qarta. Edhe Marksi, kur

i drejtpërdrejtë straightforward
i përçudnúar disfigured
paraprakísht deliberately
i mësípërm above; afore-mentioned
patós pathos
nëntékst underlying meaning
konstatój determine; affirm

flet për artin grek, nuk e identifikon me mitologjinë, ndonëse thekson afërsinë dhe lidhjet midis tyre. «Mitologjia greke, — ka shkruar ai, — përbënte jo vetëm arsenalin e artit grek, por edhe truallin e tij, sepse a është e mundur ajo pikëpamje mbi natyrën dhe marrëdhëniet shoqërore, që qëndron në themel të fantazisë greke, prandaj, edhe të artit grek, a është e mundur në kushtet e selfaktorëve, hekurudhave, lokomotivave dhe telegrafit elektrik? Ku ia del Vullkani përballë Roberts dhe K°, Jupiteri kundër rrufepritëses dhe Hermesi kundër Credit Mobilier! Çdo mitologji mposht, nënshtron dhe i përpunon forcat e natyrës në imagjinatë dhe me ndihmën e imagjinatës; ajo zhduket, si pasojë, së bashku me ardhjen e sundimit të vërtetë real mbi këto forcat të natyrës. Premisë e artit grek ishte mitologjia greke, domethënë natyra dhe vetë format shoqërore, por të përpunuara nga fantazia popullore në një mënyrë të pavetëdijshme dhe artistikisht. Ky është materiali i tij. Por jo çdo mitologji, domethënë jo çdo përpunim i pavetëdijshëm artistikisht i natyrës (këtu me natyrën kuptohet gjithë realiteti objektiv, duke përfshirë edhe shoqërinë). Mitologjia e Egjyptit kurrë s'mund të ishte truall ose vendlindje e artit grek. Por, sigurisht, njëfarë mitologjie duhej. Rrjedhimisht, jo një zhvillim i tillë i shoqërisë, i cili përjashton çdo qëndrim mitologjik ndaj natyrës, çdo mitologjizim të natyrës, i cili, për pasojë, kërkon nga artisti një fantazi të pavarur nga mitologjia. Nga ana tjetër, a është i mundur Akili në epokën e barutit dhe të plumbit? Ose përgjithësisht «Iliada» krahas shtypshkrimit dhe sidomos makinës tipografike? Dhe a nuk zhduken pashmangërisht balladat, legjendat dhe muzat dhe me këtë edhe premisat e poezisë epike me shfaqjen e shtypshkrimit?» (K. Marks, F. Engels, Veprat, v. 12, fq. 736-737, rusisht).

Në këtë pasazh Marksi vë në dukje, së pari, se arti grek në shkallën e lulëzimit të tij më të lartë ishte shkëputur nga mitologjia, e cila i shërbente si arsenal nga ai nxirrte mjete të ndryshme të shprehjes artistike. Këtë rol mitologjia vazhdoi ta lozë edhe më vonë ndaj artit të epokave të tjera të mëvonshme.

Së dyti, Marksi thekson se në kushtet e qytetërimit skllavopronar lidhja e artit me mitologjinë doemos ka qenë më e madhe se sa në epokat e mëvonshme dhe prandaj ai e quante mitologjinë greke edhe «truall» të artit grek.

Së treti, Marksi vinte në të njëjtën kohë në dukje se jo çdo mitologji mund të lozte ndaj artit këtë rol;

selfaktór self-acting agent
hekurúdhë railroad
rrufeprítës lightning rod
rrjedhimísht as a result; consequently
pashmangërísht inevitably

sipas tij, mitologjia e Egjyptit të lashtë, që kishte doza të forta misticizmi, përmbajtje të gjerë fetare dhe lidhej ngushtë me ritet dhe kultin fetar, nuk mund të lozte ndaj artit atë rol që lojti mitologjia greke. Ky mendim tregon edhe njëherë jo vetëm faktin se Marksi nuk e identifikonte artin me mitologjinë, por njëkohësisht tregon se roli i mitologjisë ndaj artit nuk është gjithmonë pozitiv, i dobishëm, kurse estetika mitologjike e modernizmit përpiqet të tregojë sikur mitologjia është një burim i përhershëm jete dhe lulëzimi për artin, sikur arti vyshket po të mos lidhet me rrënjën mitologjike, po të mos e shikojë mitologjinë si një burim të përhershëm të tij.

Që mitologjia mund të lozë edhe rol pozitiv edhe rol negativ ndaj artit, kjo gjë është e kuptueshme, sepse lidhet me vetë përmbajtjen dhe veçoritë qoftë të miteve, qoftë të artit. Kështu mitologjia e Egjyptit të lashtë, në të cilën mbizotëronin motivet fetare, (perënditë nuk përfytyroheshin me pamje njeriu, por me pamje kafshësh, përbindëshash, të cilëve njeriu u përulet) nuk e stimulonte lulëzimin dhe zhvillimin e pavarur të artit, kurse mitologjia greke (në të elementi fetar ishte i kufizuar dhe perënditë ishin antropomorfizuar, përfytyroheshin me pamjen e njeriut, që merrej si zot mbi natyrën) lojti një rol pozitiv ndaj artit grek.

Mitologjia e çdo populli ka patur evolucionin e saj dhe ka shprehur ndryshimet e jetës shoqërore. Shumë nga mitet më të lashta kanë patur një përmbajtje të ngjeshur fetare, kanë shprehur frikën dhe pafuqishmërinë e njeriut ndaj forcave spontane, shkatërruese të natyrës. Të kësaj kategorie kanë qenë mitet për lloj-lloj demonësh, përbindëshash, kuçedrash, që ngjallnin tmerr e llahtarë, frikë dhe nënshtrim tek njerëzit primitivë; por me rritjen e forcës së njeriut, të kolektivit dhe me zgjerimin e sundimit të tyre mbi natyrën, njerëzit e kohëve më të lashta krijuan edhe mite, që janë mbushur me frymën e optimizmit, me besimin në forcën e pamposhtur krijuese të njeriut, që kanë shprehur ëndërrat e njerëzve për të zotëruar të fshehtat dhe forcat e natyrës. Miti mbi Dadallën dhe të birin e tij Ikarin, mbi qilimin-fluturues etj, kanë shprehur ëndërrën e njeriut për të fluturuar dhe për të mos qenë i lidhur pas tokës. Ka mite, që e kanë perceptuar botën si sundim të kaosit, por ka edhe mite, që e kanë parë si mishërim të harmonisë. Tjetër përmbajtje ka miti i Dionizit dhe tjetër ai i Apollonit, tjetër kuptim ka miti i Sizifit dhe tjetër ai i Proteit, tjetër i Orfeut dhe tjetër i Prometeut. Prandaj edhe roli i tyre

doz dose
vyshkem wilt
mbizotërój dominate
i ngjéshur solid
qilímin-fluturúes flying carpet
mishërím embodiment

ndaj artit nuk ka qenë i njëjtë. Nuk është e rastit që arti i klasave dhe shoqërive të ndryshme ka përdorur mite me përmbajtje të ndryshme ose i ka interpretuar ato në mënyra të ndryshme. S'është e rastit që edhe modernizmi zgjedh nga mitologjia e lashtë ato mite, që i përshtaten më fort përmbajtjes ideore estetike të tij (Kamy zgjodhi mitin e Sizifit për të personifikuar filozofinë e absurditetit) ose i interpretojnë në përputhje me orientimin e tij ideologjik (Kafka i dha një interpretim të ri në përputhje me platformën ideore estetike të krijimtarisë së tij mitit të Prometeut).

Historikisht, arti i kultivuar gjatë zhvillimit të tij ka përdorur dhe vazhdon të përdorë motive dhe elementë të huajtur nga mitologjia, mirëpo sipas veçorive të platformës ideoestetike rrymat e ndryshme artistike nuk i kanë përdorur në mënyrë të barabartë elementët mitologjikë. Disa nga këto rryma si, p.sh., në artin e kultivuar të antikitetit, në artin fetar të Mesjetës, në romantizmin elementi mitologjik zinte një vend më të gjerë se sa në rrymat artistike të iluminizmit, të realizmit. Edhe variantet e ndryshme të realizmit s'e kanë përdorur në mënyrë të njëjtë elementin e huajtur nga mitologjia. Piktura e Rilindjes u referohej shpesh temave mitologjike, ndonëse në to futi një interpretim realist, përparimtar, të kundërt me interpretimin, që i jepte arti fetar, kurse në pikturën e realizmit kritik të shekullit XIX elementi mitologjik u ngushtua shumë.

Po kështu elementi mitologjik haset dendur në letërsinë ekzistencialiste, në surrealizmin, kurse në variantet e pikturës apo skulpturës konstruktiviste është më i pakët ose mungon.

Në përgjithësi, historia e zhvillimit të kulturës artistike, është historia e demitologjizimit të saj, e ngushtimit në të të elementit krijues mitologjik ose të huazimeve mitologjike. Sidomos në artin realist në përgjithësi dhe, veçanërisht, në artin e realizmit socialist elementi mitologjik përdoret në mënyrë shumë më të kufizuar se sa në çdo rrymë tjetër artistike.

ARTI MODERNIST DHE MITOLOGJIA

Në ç'raport është modernizmi me mitologjinë? Gabimisht, nganjëherë mendohet se modernizmi fiton karakter mitologjik, sepse përdor figura ose motive të mitologjisë

motív motif; motive
referóhem deal with
është më i pákët is less present

së lashtë. Në fakt një punë të tillë e kanë bërë më shumë a më pak edhe rrymat e tjera artistike, duke përfshirë këtu edhe realizmin, kurse raporti i modernizmit ndaj mitologjisë është më i veçantë. Së pari, ndryshe nga realizmi, modernizmi tregon një interesim shumë të madh për elementin mitologjik, që zë një vend shumë të gjerë, sidomos në disa variante të tij. Kjo dukuri, është, përveç të tjerash, shprehje e shterpësisë krijuese të artistëve modernistë, që i kthejnë veprat e tyre në një ripunim të materialit të gatshëm, të huajtur nga mitologjia e lashtë, që përpiqen të kompensojnë mungesën e imagjinatës individuale me prestigjin, autoritetin, bukurinë e krijimeve mitologjike.

Së dyti, modernistët i tërheqin kryesisht ato mite, që kanë shprehur frikën, pafuqishmërinë e njeriut, që kanë qenë të ngarkuar me përmbajtje fetare, që përhapin emocione negative. Modernistëve u kanë pëlqyer e u pëlqejnë mitet, që janë të ngjeshur me përmbajtje sa më alogjike, magjike. Ata çmojnë më shumë elemente të simbolikës arkaike, prehistorike, elementët mistikë, ritualë, impulsivë të mitologjisë së lashtë, domethënë kapen pas çdo gjëje mitologjike, që përkon me botëkuptimin pesimist, mistik, iracional të tyre.

Së treti, modernistët motivet mitologjike, që huazojnë, i përpunojnë dhe i manipulojnë në një mënyrë të tillë sa që shpeshherë ua ndërrojnë kuptimin e vërtetë fillestar të tyre: ata i shtrembërojnë dhe i interpretojnë arbitrarisht mitet klasike, duke ua mënshtruar qëllimeve dhe përmbajtjes së botëkuptimit të tyre idealist, antishkencor, reaksionar. Krejt antihistorike është përpjekja e modernistëve për ta bërë këtë ose atë mit produkt të një ndërgjegjeje primitive, kyç për të shpjeguar jetën dhe problemet e njerëzve të kohës sonë.

Shumë prej figurave e motiveve mitologjike manipulohen nga modernistë në një mënyrë të tillë sa që e humbasin freskinë dhe bukurinë e vërtetë të tyre, si krijime të fantazisë kolektive; ato kthehen në mjete të ftohta për të objektivizuar koncepsionet filozofike, morale, estetike ose politike të borgjezisë reaksionare të epokës sonë. Le të rikujtojmë, me këtë rast, mendimin, që ka shprehur Marksi se gjithë lezeti i artit dhe i mitologjisë së lashtë është, kur ato perceptohen të lidhura ngushtë me jetën e shoqërisë, me atë shkallë të ulët të zhvillimit të saj.

Manipulimi i figurave dhe i motiveve mitologjike nga

shterpësí sterility
i gátshëm available; ready
pafuqishmërí impotence
lezét taste

artistët modernistë kryhet edhe në një rrugë tjetër. Nganjëherë, ata e ruajnë në mënyrë autentike mitin e lashtë me të cilin ndërtojnë veprat e tyre, por paralelisht me kuptimin autentik, të mirëfilltë të motiveve mitologjike, futin edhe një kuptim të dytë, që ngre krye herë në mënyrë të hapët e herë në mënyrë të fshehtë, që hyn në polemikë me kuptimin autentik të tyre, madje, që e çmonton dhe e diskrediton dhe ua nënshtron në fund të fundit veprën në tërësi qëllimeve të botëkuptimit modernist. Kjo vihet re, p.sh., qoftë në «Ulisin e Xhojsit, qoftë në dramën «Mizat» të Sartrit.

Lidhja e modernizmit me mitologjinë shfaqet jo vetëm në ato raste kur huazohen dhe përpunohen motivet e mitologjisë së lashtë, por edhe në një mënyrë më të drejtpërdrejtë. Disa variante të modernizmit huazojnë dhe imitojnë teknikën e përpunimit të mitit, vetë ligjësitë e mitologjisë dhe përpiqen që krijimtarinë e tyre artistike ta largojnë nga ligjet e përvetësimit estetik të realitetit, t'ia nënshtrojnë asaj teknike dhe atyre ligjeve, që qëndrojnë në themel të mitologjisë. Kështu, p.sh., metoda surrealiste afrohet shumë me teknikën dhe ligjësitë e krijimtarisë mitologjike; ajo është e afërt me principin e automatizmit, spontanitetit, me karakterin iracional të produkteve të fantazisë, me kombinimet alogjike të përfytyrimeve dhe mbresave shqisore dhe me një lloj iluzionizmi natyralist, që përdoret për t'i bërë të besueshme figurat e përçudnueshme të tabllove surrealiste, duke u qëndruar besnik hollësive e detajeve deri në iluziozëm.

Po kështu metoda krijuese e Kafkës ka diçka me teknikën e mitologjisë; duke paraqitur një botë absurde, fantazmagorike, Kafka e paraqit në një mënyrë të tillë, sikur ajo të ishte një pjesë e pandarë, reale e botës, e jetës më të rëndomtë, duke shmangur çdo gjë, që mund ta shtynte lexuesin të vinte në dyshim ekzistencën e saj. Botën iracionale, që i ofrojnë publikut, përfaqësuesit e modernizmit e përpunojnë në një mënyrë mitologjike me qëllim që publiku ta pranojë për reale, t'i besojë ashtu siç besonte njeriu primitiv në realitetin e mitit dhe e merrte atë si pjesë të pandarë të botës reale.

Teknikën mitologjizuese të modernizmit mjaft ithtarë të teorive estetike mitologjike janë përpjekur e përpiqen ta ngrenë në qiell, duke e paraqitur si të vetmin burim për gjallërimin e ripërtëritjen e artit modern, si të vetmin kusht për ta shpëtuar artin nga ftohtësia e ndërgjegjes dhe racionalizmit teknik-shkencor, për

çmontój pull down; dismount
ligjësí legitimacy; legality
mbrésë recollection
i besúeshëm believable
i përçudnúeshëm contorted
hollësí particular
detál detail
i rëndómtë common; ordinary
ithtár idolizer

të kultivuar në të fillesën e domosdoshme lirike, ndiesore, emocionale të artit, për t'i lënë fushë të lirë forcës krijuese, të imagjinatës artistike. «Realizmi i kohës sonë, — shkruan R. Garodi, duke patur parasysh modernizmin, — është krijues mitesh, realizëm empirik, realizëm prometian».

Estetika e modernizmit e konsideron teknikën mitologjike si një faktor pozitiv, që e kthen artin në stërburimin e tij «të natyrshëm», drejt gjëndjes së artit primitiv të shpellave, që i kthen artit «natyrën» e tij specifike, sepse e bën një krijimtari absolutisht «të lirë», duke e shkëputur nga realiteti, duke e zhytur në një botë të trilluar, misterioze. Duke përcaktuar karakterin dhe tipin e imagjinatës, për të cilën ka nevojë arti modernist, esteti anglez H. Rjd thotë se «bota e fantazisë ndjek të vërtetën e vet dhe ligjet e veta, duke u zhvilluar në mënyrë të lirë, duke qënë e pavarur nga çdo domosdoshmëri, si të brendshme edhe të jashtme, si subjektive edhe objektive». Por, mund të pyesnim, se ç'kishte për t'i sjellë artit një fantazi e tillë? Vetëm shtrembërimin e falsifikimin e realitetit!

Teknika mitologjike nuk mund t'i sjellë artit asgjë pozitive, sepse ajo sidoqoftë është në kundërshtim me natyrë specifike të artit, me ligjet estetike të krijimtarisë artistike. Teknika mitologjike e tërheq artin prapa, e kufizon dhe e ngushton forcën njohëse të tij, e largon nga zbulimi i së vërtetës së jetës dhe e shndërron artin në një veprimtari mitologjizuese, fallsifikuese.

Nuk është e rastit që modernistët japen fort pas krijimit të simboleve dhe alegorive më ireale, më iracionale, sepse me to ata fshehin, mistifikojnë dhe e shtrembërojnë përmbajtjen e jetës, të realitetit. Bota e ëndërrave më të llahtarshme, e kllapive tmerruese, e alogjizmave, e një psikike të sëmurë e të copëzuar, e krimeve është bota më e preferuar e modernizmit. Këtej vjen edhe tendenca moderniste për t'i imponuar artit funksionin e ashtuquajtur të funk-artit, domethënë të artit si mjet për të mbjellë tmerr e llahtar dhe për të çoroditur njerëzit.

Pranimi i teknikës mitologjizuese s'është ndonjë gabim i rastit ose keqkuptim teorik i modernizmit, por shkon në përputhje të plotë me qëllimet jetësuese, fetishizuese, mistifikuese të këtij arti. Modernizmi konseguent në logjikën e tij e shpall normë të krijimtarisë artistike ndërgjegjen fetishizuese, animizimin e botës,

stërburim source
i trilluar deceptive; fabricated
anglez English
domosdoshmëri necessity
fallsifikues = falsifikues falsifying
ireal unreal
kllapi delirium
i copëzuar fragmented
çoroditur disorient
pranim acceptance; approval
keqkuptim misunderstanding
konseguent consistent

shtrembërimin mitologjik të saj. Prandaj modernizmi i drejtohet aq fort parimit të deformimit të realitetit, me të cilin u kundërqëndron parimeve realiste të përgjithësimit. Deformimet më absurde janë bërë një praktikë kaq e rëndomtë për artistët modernistë sa që ata e pranojnë tashmë haptaz deformimin si një parim metodologjik, universal të krijimtarisë së tyre. «Qëllimi im i fundit, — thotë piktori modernist anglez F. Bekon, — është shtrembërimi i realitetit». E vërteta për artin, sipas tij, është një absurditet, një gjë pa kuptim, sepse gjoja çdo gjë që krijohet nuk mund të mos jetë e vërtetë. Deformimi modernist e shtyn artin në rrugën e shtrembërimit të realitetit, e falsifikimit të tij, e largon nga rruga e perceptimit normal, të natyrshëm të fenomeneve estetike, në rrugën e shkatërrimit të artit si krijimtari, e bukur. Në këtë mënyrë, arti modernist paraqitet si një pjesë e pandarë e gjithë asaj veprimtarie të gjerë mitologjizuese ideologjike të forcave shoqërore reaksionare të epokës sonë, të cilat, të trembura përballë së ardhmes, janë të interesuara të fshihen proceset historike dhe perspektivat e zhvillimit shoqëror. Shumë mirë e tregon qëllimin e estetikës mitologjike kritiku borgjez perëndimor P. Vest, i cili shkruan: «Ç'kërkon kritika mitologjike? Ajo është njëlloj guri filozofik, me ndihmën e të cilit mund t'i kthesh gjithë konfliktet në mite të arta».

Tendenca mitologjizuese nuk i imponohet artit modernist nga natyra dhe ligjet specifike, artistike, por së jashtmi nga kërkesa e borgjezisë imperialiste për mistifikimin e realitetit, për t'i fshehur e kamufluar dramat e konfliktet jetësore, për të maskuar e shtrembëruar burimin dhe shkaqet e tyre social-klasore.

Prirja e shumë artistëve modernistë për të përdorur teknikën mitologjike vjen edhe nga botëkuptimi subjektivist, nga mospranimi i realizmit, nga paaftësia e tyre për ta kuptuar dhe interpretuar drejt realitetin e shëmtuar të ulët borgjez, që u imponohet si një kaos, si një botë e llahtarshme, tmerruese, nga paaftësia e tyre për t'u lidhur me ato forca sociale, që në këtë botë kaotike, të shëmtuar, kanë fillin e Arianës, kanë botëkuptimin shkencor marksist-leninist dhe kryejnë një veprimtari praktike, që çon, në fund të fundit, drejt shoqërisë socialiste.

Diskutimet për artin, që u bënë kohët e fundit, në vendin tonë, treguan se aty-këtu ndonjë artist e shkrimtar i vendit tonë ka qenë ndikuar nga teknika mitolo-

deformím deforming; deformation
përgjithësím universality
háptaz openly
fill thread

gjike e modernizmit. Kjo u duk te ata shkrimtarë ose poetë, që u dhanë një vend tepër të gjerë ëndrrave në krijimet e tyre, duke hequr dorë nga format realiste të përgjithësimit të materialit jetësor; kjo u duk në përdorimin e figurave alogjike dhe iracionale, që suallën një hermetizëm, një ndërgjegje e psikologji poetike fetishizuese, mitologjizuese, animizuese. Shprehje e qartë e prirjeve të tilla ishin poezitë e disa letrarëve të rinj, në të cilat bota jonë reale, jeta jonë, njerëzit tanë filluan të paraqiten në trajta fantazmagorike kafshësh e bimësh, filluan t'i nënshtrohen një zoomorfizmi dhe antropomorfizmi, që janë në kundërshtim me parimet realiste të artit tonë. Prirje për të përdorur teknikën mitologjizuese ka patur edhe në prozën tonë, në tregime a romane. Po kështu, edhe në pikturë u përdorën disa teknika deformuese që mitologjizonin dhe mistifikonin jetën. Ndikimet e teknikës mitologjizuese e largonin artin tonë nga rruga e realizmit dhe e vinin nën ndikimin e koncepteve të huaja estetike dhe ideologjike.

Jeta e shoqërisë sonë, botëkuptimi ynë shkencor, zhvillimi i shpejtë i revolucionit tekniko-shkencor, ngritja e nivelit kultural dhe arsimor të gjithë popullit, baza realiste e artit tonë socialist dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm, që veprojnë në shoqërinë tonë, nuk mund ta përligjin në asnjë mënyrë përdorimin e teknikës mitologjizuese të modernizmit në artin tonë. Natyrisht, kjo nuk duhet kuptuar si kur në artin tonë socialist nuk duhet të përdoren në asnjë rast motive ose figura mitologjike. Të tilla janë përdorur me sukses nga poetë e shkrimtarë tanë. Po kështu s'duhet menduar se në artin tonë realist socialist nuk duhen përdorur simbole, metafora, alegori, personifikimi, animizimi dhe tipe të tjera figurash stilistike. Fjala është që këto mjete të përdoren në masë, domethënë në përputhje me veçoritë estetike të artit tonë socialist, në përputhje me botëkuptimin shkencor të tij, me karakterin materialist jetësor të tij vetëm atëherë kur e kërkon natyra e materialit, kur ato ndihmojnë për të arritur tek e vërteta artistike, për ta kuptuar më thellë, më drejt dhe më poetikisht jetën. Nga vetë natyra dhe funksionet e tij, arti proletar socialist nuk ka pse të jetë mitologjizues, ai është një armë e fuqishme për të demistifikuar realitetin e shëmtuar borgjez, për të ndriçuar me dritën e së vërtetës fenomenet më të ndryshme të jetës dhe për të zbuluar poezinë dhe bukurinë e jetës socialiste. Artit tonë të realizmit socialist s'i duhet mendimi mitologjik, por e vërteta ar-

animizúes animizing; making animate
nuk ka pse has no reason

tistike dhe prandaj ai nuk njeh asnjë kufizim, që e afron dhe e çon te ky qëllim.

Progresi drejt socializmit, përhapja e arsimit dhe e kulturës, përparimi teknik dhe shkencor krijojnë premisat për zhdukjen e mendimit mitologjik. Në qoftë se ky mendim vazhdon të ekzistojë dhe të prodhojë mitet, vazhdon të ndikojë, kjo lidhet me interesat e një klase të vjetër reaksionare, e borgjezisë, që ka frikë nga e vërteta, siç kanë frikë disa zogj nga drita e diellit. Përmbysja dhe mënjanimi i sundimit të kësaj force nga revolucioni proletar dhe ndërtimi i socializmit do të sjellin mënjanimin e plotë të mendimit mitologjizues edhe nga fusha e krijimtarisë artistike edhe nga jeta e shoqërisë në përgjithësi. Marksi shpallte armiqësinë e papajtueshme të komunizmit me çdo ndërgjegje jetërsuese e të jetërsuar, një manifestim i së cilës është edhe mendimi mitologjizues.

Alfred Uçi "Modernizmi - ndërgjegje mitologjuese" Nëntori (Tirane) XXI, I0 (October) I974, pp.I50-I6I

mënjanim prevention; avoidance
armiqësí enmity

LEXIMI I TETEDHJETENENTE

LARTESITE

tregim nga Dhimitër Xhuvani

Gjithë kohën e lirë që i mbetej pas punës, Sadushi e kalonte në trotuarin, pranë klubit, që vendasit e quanin «Turizmi». Dikur, para dy vjetësh «Turizmi» nuk ish veçse një klub rruge, një klub i zakonshëm, në të hyrë të qendrës së lokalitetit, një klub udhëtarësh e shoferësh pasi aty kryqëzohen tri rrugë nacionale që lidhin qendrën e lokalitetit e të fabrikës me dy qytete kryesore dhe me stacionin hekurudhor. Pesëqind hapa më tej kryqëzimit ishte ngritur qendra e lokalitetit, ose qyteti i ri siç e thërrisnin vetë banorët. Ç'është e vërteta, qendrën e atij lokaliteti mund ta quash me plot gojën edhe qytet, pasi aty njeriu gjen gjithçka që mund të gjejë në çdo qytet, bile dhe teatër. Rrugë të asfaltuara e të ndriçuara me neon, vitrina të mëdha, të bukura e të mbushura plot, pallate pesë katësh, klube, restorante, hotel, kinema, bile dhe dy skuadra fut-bolli dhe një trupë të mirë estrade e teatri, që herë pas here ve pjesë teatrale dhe me tri akte. Qendra e këtij qyteti ishte aq e gjallë dhe aq tërheqëse sa çdo natë njerëzit shkonin e vinin poshtë e përpjetë deri në orët e vona. Vetëm pas orës nëndë të natës qendra binte në qetësi. Lëvizja e gjallë dhe plot zhurmë e qytetit ndërronte vend. Në këtë orë zlente «Turizmi», sepse gjithë ata që ndërronin turnet dhe që punonin aty, po banonin gjetkë, i gjeje në udhëkryq, pranë «Turizmit». Dhe Sadushin, megjithëse i stabilizuar aty, me shtëpi dhe grua, do ta gjesh në këtë nyje udhësh të ulur në një nga tavolinat e trotuarit. Ai vështron me radhë çdo automjet që kalon,

lartësí height
trotuár sidewalk
hekurudhór railway
kryqëzím crossing; intersection
vitrínë window; display window
vë pjésë puts on a play
vend = véndi (mp.)
gjétkë elsewhere
nýje údhësh road network
automjét vehicle

mban vesh si i lodhur dhe i hutuar sirenën e fundit të trenit që vërshëllen tutje në stacion dhe që dëgjohet fare qartë sido që të jenë netët, të qeta ose jo.

— Kush është ky? — filluan të pyesnin shoferët e urbanit, pasi e shikonin shpesh në atë vend.

— Është burri i Julikës.

— Burri i Julikës? — pyesnin ata të çuditur mbasi s'mund ta mirrnin me mend që burri i një femre aq të bukur të rrinte aq vonë dhe aq indiferent.

— Ç'ka? — vazhdonin të pyesnin kamarierin, i cili mblidhte supet.

— Një zot e dil!

— More e kam vënë re dhe unë, — ndërhyri karrocieri i kooperativës fqinjë, që vinte dhe merrte bukët për të nesërmen, — kush është ky?

— Burri i Julikës, pra, nuk e dëgjove, — u përgjegj shoferi i autobuzit.

— A, ha, i Julikës së bukur?

— Po.

— Ç'femër që është, ë?

— S'ka të sharë.

— Dikur flisnin me adhurim për të, kurse tashti s'para flasin më.

— Kush? — pyeti shoferi.

— Banorët, njerëzit...

— Për besë, unë ja thyej turinjtë atij që flet keq për Julikën. Ajo është e mrekullueshme dhe me njerëzit sillet mirë, shitëse si ajo s'gjen, — foli shpejt e shpejt shoferi dhe, si ktheu me fund atë pak birrë që i kish mbetur, u largua. Ndezi autobuzin dhe u nis.

— Ika dhe unë, — tha karrocieri.

Dalëngadalë dhe udhëkryqi filloi të zbrazej, të qetësohej, të shplodhej nga gjithë ajo ditë e madhe, e gjatë dhe gjithë zhurma e potere.

Sadushi i thirri kamarierit, pagoi dhe u nis për në shtëpi.

Kur hyri në dhomën e fjetjes nuk i erdhi mirë që Julikën s'e kish zënë gjumi. Ajo ktheu kokën nga i shoqi, nxori mbi çarçaf duart dhe e vështroi gjatë, pa folur as dhe një fjalë. Sadushi u xhvesh dhe u fut në shtrat.

Julika e ndjeu veten të ofenduar që ai, burri i saj, u fut në shtrat pa i thënë një fjalë, pa e vështruar në sy. Ajo kish vendosur të fliste, ta pyeste, po u spraps. E ndjeu se gjithçka do të ishte e kotë. Lëvizi ngadalë, u pështet në gjoksin e tij dhe u përpoq që të flinte.

mbaj vesh listen
urbán city
karrociér coachman
S'ka të shárë there's no denying it
s'pára flásin më they don't talk quite as much
shplodh = shlodh relax
potére din; brawl
çarçáf bedsheet
sprápsem = mbrápsem retreat; withdraw

Sadushi i u përgjegj lëvizjeve të së shoqes, i hodhi dorën në sup dhe mbylli sytë.

Pas pak, mbase pas një gjysëm ore, ose një orë, i foli shkoqur dhe prerë:

— Julikë, unë do të iki, ti s'duhet të zemërohesh. S'mund të jetoj më në këtë mënyrë.

— Shyqyr që e the më në fund, — përshpëriti ajo.

— Përpiqu të më kuptosh, Julikë, kjo që po bëj unë është vetëvrasje, s'mund të bëhem njeri tjetër, të dal jashtë natyrës sime, jashtë ëndrrave të mia...

— Sa herë ma ke thënë këtë gjë?

— Sonte është e fundit

— Po unë, ç'të bëj?

— Hajde me mua, kudo që të punoj unë ka nevojë për shitëse, pa punë s'do të rrish

— Sa egoist që jel Ti vetëm për veten tënde mendon. Ç'do të bëj unë në kantier dhe përse? Sepse ty të pëlqen të punosh majë çative, majë oxhaqeve.

— Ajo është jeta ime. Oxhaqet, çatitë, kapriatat... — nisi të numëronte Sadushi dhe të ndjente se po bëhej nevrik.

— Po jeta ime cila është? — pyeti ajo.

Sadushi nuk iu përgjegj aty për aty, sepse mendimi i parë që i erdhi në kokë qe ofendues.

— Pse s'përgjigjesh? — pyeti ajo përsëri. — Pse s'mendon dhe për mua ashtu siç mendon për veten tënde? Apo vetëm ti paske ëndërra, pasione. Folë, pse s'flet?

— Sepse nuk e di cila është jeta jote, qëllimi yt, pasioni yt.

— Si? Nuk e ditke? — e pyeti e nevrikosur Julika dhe ja dha të qarit.

— Nuk e di, — u përgjegj ftohtë Sadushi. — Ti mos u nxeh, mos u rrëmbe kot. Ti je e re, mbase më vonë mund ta gjesh dhe ti rrugën tënde, pasionin tënd. Kjo jetë që bëjmë po më mbyt.

— Kurse mua jo, — i tha ajo me dënesë. — Ah, sa të lumtur ishim në fillim, kur u njohëm, kur u martuam, — psherëtiu Julika dhe sikur u qetësua.

Pas pak, u kthye e tëra nga i shoqi, e përqafoi dhe e puthi. Pastaj e pushtoi dhe përsëri nisi ta mbulojë me të puthura e ta përkëdhelë.

Sadushi qeshi nën buzë, si me ironi nga gjithë këto përpjekje të së shoqes dhe u mundua të shpëtonte nga ai pushtimi i saj.

— Ç'ke — e pyeti Julika dhe përsëdyti atë natë e ndjeu veten të ofenduar.

shkóqur clearly; distinctly
prérë definitely
sónte tonight
kantiér construction center
kapriátë construction truss
dënésë condemnation
qéshi nën búzë smiled almost imperceptibly
përsëdýti for the second time

Sadushi mori frymë lirisht, u mat te fliste, t'i përgjigjej asaj, t'i zbraste dhe një hérë gjithë brengën që e kish pllakosur, po u sprans. «Nuk do të më kuptojë», tha me vete dhe heshti duke rënë në mendime.

Dhe Julika e la. E nervozuar, u kthye në krahun tjetër dhe heshti. Në gjysmëerrësirën e dhomës dhe në qetësinë e plotë të natës ajo dëgjonte shkoqur, dhe fare qartë, dy zhurma: zhurmën e largët të kollonës së vakumit që çfrynte dhe, një pëllëmbë më tej, frymëmarrjen e çregullt e nervoze të burrit të saj. «Çudi, nisi ajo të mendojë, ç'ka ai që është bërë si i xhindosur? Ç'i mungon? Asgjë. Shtëpi ka, të ngrënë, të pirë, i veshur e i mbatnur si jo më mirë».

— Julika? — thirri Sadushi.

— Ç'është? — u përgjegj ajo dhe u kthye.

— Pse s'vjen dhe ti me mua? E? Ç'të pëlqen këtu?

— Gjithçka. Ja, kjo dhomë, këto perde, tërë qyteti, mapua. Ti pse bëhesh i keq, pse s'mësohesh dhe ti me këtë jetë? Punën e ke sezonale, do, punon, s'do, s'punon. Sot në fermë, nesër në gurore, si të pëlqen ty, sa në një vend, në një tjetër. Dhe për të fituar, fiton. Asgjë s'të mungon për të qenë i lumtur.

Sadushi nuk iu përgjigj fare. Al kish thënë me vete se ajo s'ka për ta kuptuar dhe u bë pishman që foli përsëri.

— Pse s'flet? — ndërhyri përsëri Julika?

— Domethënë ti s'do të vish, ë?

— Ku?

— Me mua.

— Ku? — pyeti ajo me këmbëngulje dhe me nervoziter.

— Atje ku janë ata.

— Cilët?

— Shokët e mi, brigada.

— Ku janë ata? — pyeti Julika me ironi nga që nuk iu durua më.

Sadushit i dogjën këto fjalë dhe iu përgjegj gjithë inat.

— Kudo që të jenë, ti e di që ata nuk më shkruajnë më. Ti më detyrove që t'u përgjigjem letrës sa tyre, kur na ftuan, që të më harrojnë, se gjoja fillova jetë të re familjare, se jam i lumtur.

— Pse, s'je? — pyeti Julika.

— Jo.

— As kur shkrove letrën s'ishe? — pyeti ajo, po këtë radhë zëri i saj u drodh.

gjysmëerrësírë half-darkness
kollónë e vakúmit ventilator shaft
çfryj = shfryj blow; snort
i çrégullt irregular
i xhindósur possessed (of a spirit)
si jo më mírë as well as possible
pérde curtain
mápo = magazinë popullóre (people's shopping store)
férmë farm
guróre quarry
detyrój oblige

— Jo, — u përgjegj i menduar Sadushi.

— Çudi! — pëshpëriti e dëshpëruar Julika.

— Ç'ka këtu për t'u çuditur?

— Sepse qenke dhe gënjeshtar!

— Po, tha me dhimbje Sadushi. Kam dy vjet që gënjej vetveten, ty, shokët. Nesër do të iki, kur të mos jem më pranë teje, do të më kuptosh.

— Unë s'të lë, — bërtiti Julika. — Unë të dua.

— Edhe unë të dua, — tha me gjysmë zëri Sadushi.

— Pse e thua ashtu?

— Si?

— Si me gjysëm zëri, si me pishmanllëk. Mbase s'më do më.

— Të dua, Julikë, po kështu s'mund të jetoj dot. Nuk mundem. Asgjë s'ndjej nga jeta. Asnjë gëzim. Më duket sikur i kam krahët të prera.

— Fillove ti prapë me krahët? Na mërzite me këta krahë. Tashti do të hisësh të numërosh oxhaqet që ke bërë me ato krahë.

Sadushi nuk iu përgjegj, megjithëse në mend kish oxhaqet që përmendi e shoqja: oxhakun e madh të Laçit, të Kurbneshit, Gjegjanit, oxhakun e Azotecit. Të gjitha këto oxhaqe, që nga Veriu në Jugë hynë e zunë vend në mendjen e Sadushit, hynë në dhomën ku dëgjohej qartë zhurma e kullës së vakumit. Dhe atë ai me shokët e tij e kish ngritur...

Atëhere ish njohur dhe me Julikën e bukur. Atëhere e patën zili të gjithë, bile dhe shokët e brigadës... po... që atëhere, tre vjet më parë, filloi për të një jetë e re, një jetë vërtet e bukur dhe e lumtur. Ai ra në dashuri me shitësen e vogël. Që atëhere, në krye të çdo pesëmbëdhjetë ditëve Sadushi dhe brigada e tij sulmonin mapon dhe blinin pasta dhëmbësh, furçe, brisqe rroje, kopsa, penjë, gjilpëra dhe, kur dilnin s'andejmi, bisedonin gjithë shamatë e potere për shitësen. Ky sulm zgjati dy-tre muaj, gjer atëhere kur ajo, e turpëruar dhe e skuqur në fytyrë, tha «po». Në atë çast ajo u bë vajza më e bukur e botës. Sadushi sa s'fluturonte nga kulla e vakumit.

— Ki mendjen,- talleshin shokët, — po re s'c sheh më Julikën.

— Para se të biesh, na ler amanet shitësen me gjithë kopsat.

Sadushi qeshte me shakatë e shokëve dhe nga dita në ditë ngjitej lart e më lart bashkë me kullën gjiga-

pishmanlëk regret
shítëse saleslady
pástë dhëmbësh toothpaste
fúrçë brush
brisk rrójë shaving razor
kópsë button
pe thread

nde, duke luftuar me erën e veriut dhe me ngricat e dimrit.

Si hypte në majë, lidhej me zinxhirin e brezit dhe fillonte nga puna duke montuar detalet e hekurta. Pastaj ngrihej mbi to duke i u ngjitur qiellit përpjetë.

Atë ditë që mori përgjigjen nga shitësja e mapos, brigadieri nuk e lejoi Sadushin që të hypte.

— Ti do të punosh poshtë sot.

— Unë?

— Po.

— Poshtë?

— Po.

— Sot?

Sot , Sot ti s'je në vete:

— Sot jo, kur të duash ti punoj poshtë, veç sot jo.

— Atje lart duhet gjakftohtësi.

— Unë sot do të bëj dy norma, një për vete dhe një për Julikën, do të zë yjet me dorë.

— Sot jo,- tha prerë e shkurt brigadieri dhe u ngjit vetë, në vend të Sadushit, po, sa bëri hapin e parë, shtangu. Brigadieri pa sytë e përlotur të Sadushit dhe buzën e poshtme që iu drodh nga emocioni.

— Ç'është?- pyeti brigadieri dhe zbriti.

— Në djall të vini të gjithë,- mallkoi Sadushi.- Vëndi im është atje lart. Atje kam lënë pa shtrënguar disa detale, ju mund të vini këmbë në to dhe të rrëzoheni. Përgjithëçka që mund të ndodhë atje lart përgjigjem unë, pamvarsisht se ti je brigadieri. Atë sektor ma ke besuar mua.

Brigadieri heshti. Pas pak, ai ngriti kokën, i ra në sup e tha me të qeshur:

— Sot kam qejf të punoj dhe unë lart, hajde, punojmë bashkë.

* * *

Ditën që u bë inagurimi u bë dhe dasma. Sadushi nuk ishte në vete atë ditë, kur shikonte qytetin, që sapo kish lindur, aq të gëzuar, aq festiv. Gjithë ato gjëra ndodhën brenda njëzetekatër orëve. Inaugurimi, dasma dhe, së fundi, largimi i montatorëve, të cilët njiheshin me gisht në qendrën e lokalitetit. Autoritetet e vendit e përcollën brigadën me ceremoni. Kur u nis maqina, ngriti nga pas pluhur e tym. Sadushi dhe Julika, të mbështetur pranë njeri tjetrit, mbetën si të ngrirë për një copë herë. Ata u larguan të fundit nga udhëkryqi duke ndjerë në

ngrícë freeze
detál part; component
pa shtrëngúar untightened
rrëzóhem fall
ma ke besúar múa you have entrusted it to me
inagurím inauguration
montatór assembly worker

shpirt, në vend të lumturisë, një zbrazësirë të thellë, të pafund.

— Ç'është, kështu? — pyeti Julika.

— Asgjë, — u përgjegj Sadushi dhe e shtrëngoi fort Julikën si për të plotësuar gjithë atë boshllëk që i kish hyrë në gjoks.

— Si asgjë? Unë se si e ndjej veten, se si më vjen.

— Nga largimi, nga ndarja, — u përgjegj ftohtë Sadushi.

— Ti sikur je zverdhur? — e pyeti Julika.

— Jo, jo, të duket ty, — u përgjegj aty për aty Sadushi për të mbuluar dhimbjen e trishtimin që e kishin pushtuar.

— Hajde të shkojmë në shtëpi. Mua më dhanë pesë ditë leje.

— Sikur të kishim shkuar dhe ne, pëshpëriti Sadushi.

— Ku?

— Me ata, në Veri.

— O, Sadush, hala aty e ke mendjen? Ne sikur e biseduam një herë këtë gjë. Dhe ata ta thanë troç: bëj si të duash, daç hajde, daç rri. Kur të duash, kur të të mbushet mendja, hajde, me gjithë Julikën.

— Nuk i njeh ti ata, mos folë kot.

— Pse, s'thanë kështu? Bile duke qeshur ta thanë. Bëj si të duash, bëj si të të thotë zemra.

— Edhe unë ashtu do të thoshja për secilin prej tyre, ata janë njerëz të pavarur.

— Po ti?

— Nuk e di, — u përgjegj ftohtë Sadushi, i futi krahun dhe u nis të ecë me rrëmbim, me vrull, sikur t'i qe bërë vonë për në punë.

— Dale, — u ankua Julika, — dale, jo kaq me nxitim, jam me taka, s'i shikon?

Sadushi pa këmbët e bukura, pa dhe këpucët e bardha, me majë. Ato ja kishin sjellë si peshqesh shokët e brigadës, ato një maqinë mishi, një shtypëse patatesh, si dhe një jorgan dopio dhe nja 800 lekë. Sadushit iu kujtuan fjalët e brigadierit:

«Donim t'i blenim të gjitha plaçka, po plasi sherri midis nesh. Njeri thosh kuti tualeti, tjetri thosh tyl, tjetri dyshek. Këto që blemë besoj se hyjnë në punë, paratë i prishni si të doni vetë, për çfarë t'ju duhen.»

— Ku e ke mendjen? — e pyeti Julika Sadushin, sepse pas dhjetë hapash ai filloi të nxitojë përsëri.

— Asgjëkundi, — e gënjeu Sadushi dhe ngadalësoi të ecurit.

zbrazësírë emptiness
boshllëk void
Unë se si...më vjen I feel kind of strange. I don't know how to explain it.
léjë leave
halá still
troç right out
tákë heel
peshqésh present
maqínë mishi meat grinder
shtýpëse patátesh potato masher
jorgán quilt
dópio double
plas erupt
sherr quarrel
tualét toilette
tyl tulle; fine silk fabric
dyshék mattress
hyj në púnë am useful, of service

— Po pse nxiton?
— Kot.
— Mos e ke zakon? — pyeti Juliku dhe buzëqeshi.
— Mbase, gjithë jetën jam nxituar, — pëshpëriti Sadushi.
— Si? Mos u bëre pishman që u martove? — pyeti ajo duke ja shtrënguar dorën.
— Jo, jo, — u përgjegj Sadushi, të kishim shkuar dhe ne me ta. Ç'do të bëj tashti?
— Do të shplodhesh.
— Po pastaj?
— Do të gjejmë një punë. Punë ka kudo.
— Ka, — u përgjegj Sadushi dhe unë nuk ja përtoj, çfarëdo pune që të jetë, po...
— Tashti fole me vend, ja preu fjalën Julika e kënaqur dhe iu afrua në gjoks. Iu ngjit dhe u mat ta puthte, po u përmbajt. Pesëqind metrat e rrugës, midis kryqëzimit dhe qytetit kishin marrë fund.

* * *

Sadushi nuk e mbaroi të gjithë lejen. Ditët i dukeshin të gjata e të mërzitshme. Dy klubet, pijetorja dhe turizmi, sikur s'ishin më ashtu siç kishin qenë para martesës, kur vinte dhe shtrohej i lodhur nga puna. Atëhere zienin nga njerëzit, nga fjalët e muhabetet e ndryshme. Atëhere dhe birra seç kish një shije tjetër. Ishte më e pëlqyeshme dhe më e freskët.
— Do të filloj nga puna, — i tha një ditë Julikës kur kjo hyri në shtëpi.
— Ku?
— Në fermë. S'ka vend tjetër, ose në gurore.
— Ku të të pëlqejë.
— Po e provoj në fermë.
— Mirë, — i tha ajo dhe e përqafoi. — Mos u dëshpëro kështu. Do të mësohesh dhe me fushën. Tërë jeta në lartësi s'kalohet.
Sadushi nuk iu përgjegj. Ishte e kotë të flisje me Julikën për oxhaqet, për kullat... «Kjo, me siguri, as në pemë s'besoj të ketë hypur ndonjëherë», tha me vete. Sadushi dhe i vuri kapak gjithë ëndërrave të bukura që kish thurur në lartësitë e oxhaqeve duke shpresuar se do të mësohej vërtet me fushën e gjërë e pa fund të Pozhokut, me vesën e hollë që e shkelte çdo mëngjes duke mbajtur nën sqetull bukën, që ja kish bërë gati Julika. Me këtë shpresë mbaroi vera e gjatë dhe e thatë.

përtój am lazy
pijetóre barroom
seç kind of
mësóhem get used to
kapák cover
vésë dew
sqétull armpit

Kur nisën shirat e vjeshtës së vonë, puna në fushë mori fund. Atëhere Sadushi hyri në gurore gjersa mbaroi dimri me ngricat e erërat e Devollit.

Punëtorët sezonalë i mblodhi përsëri ferma dhe Sadushi hyri sërish midis grunjave të fushës. Në mbrëmje, kur kthehej i lodhur, qëndronte me shokët e rinj në karriget e pijetores dhe pinte me ta birrë, e cila tashti kish marrë përsëri shijen e freskinë e saj. Ata ngriheshin, pasi pinin gotën e parë, kurse ai rrinte dhe priste sa të mbyllej mapua, karshi birrarisë.

Rrinte e pinte ngadalë birrën dhe vështronte tutje, kullën e lartë të vakumit dhe oxhakun, i cili e nxirrte tymin e zi shtëllunga shtëllunga. Për çudi, atë tym gjithnjë e rrëmbente era e lumit dhe e shtynte tej fushës nga e cila sapo ish kthyer. Sadushi rrinte dhe vështronte një copë herë, gjersa mërzitej, pastaj ngrihej që aty e shkonte në udhëkryqin, pranë Turizmit. Aty porosiste një kafe dhe, duke e pirë atë, kalonte kohën. Në udhëkryq e ndjente veten më të lehtë, maqinat që shkonin e vinin, që sillnin e mirrnin pasagjerë e mallra, ja zgjonin çdo ditë kujtimet e largëta, të viteve të shkuara.

Kështu bënte çdo ditë sa herë që kthehej nga puna, rrinte herë në një lokal, herë në tjetrin, gjersa të delte Julika nga puna. Kur delte ajo, sikur qetësohej, i qeshte fytyra dhe të dy krah për krah, merrnin rrugën për në shtëpi.

— Ti se ç'ke? — e pyeti Julika. — Akoma s'u mësove me mua?

— Edhe mua më vjen çudi, s'e besoja kurrë që të më kishte hyrë aq thellë në shpirt puna si montator i lartësive.

— Si? Hala atje e ke mendjen?

— Po, — tha ftohtë e prerë Sadushi. — Pas pak, ai ndërroi bisedë dhe e pyeti pse u vonua aq shumë.

— Kishim mall të ri, sandale nga ato të Durrësit, dhe njerëzit s'dilnin përjashta gjersa u shitën të gjitha.

— A ikim Julika? — pyeti Sadushi si i hutuar.

— Ku?

— Atje ku janë ata.

— Çudi me ty, ku e ke mendjen! — i u përgjegj ajo dhe hapi derën e apartamentit.

Të nesërmen, Sadushi nuk e priti Julikën. Sa erdhi nga puna, u fut në shtëpi, u la, u vesh dhe doli në kryqëzimin e rrugës, në trotuarin me karrike të turizmit dhe porositi një kafe.

— Si urdhëron, — iu përgjegj kamarieri duke nxi-

birrarí beer garden
porosít order
mall merchandise

tuar. Pas Sadushit, dy burra porositën birrë; pas pak, njeri prej tyre, pyeti tjetrin me zë të ulët që të mos dëgjohej:

— Kush është ky, gjithnjë e shoh kafeneve.

— Është burri i Julikës.

— A, i shoqi i Julikës!

— Po, shitëses.

— E di, e di.

Sadushi e dëgjoi dhe ndjeu një të rënqethur që i kaloi për trup, si t'i kish rrëshqitur një gjarpër nën këmishë. «Burri i Julikës», përsëriti me vete dhe ktheu kokën nga ai që foli. E pa drejt e në sy dhe i erdhi inat sepse e njohu. Ai që foli u skuq dhe uli kokën. Ai, me që e njihte, duhej të kish thënë emrin e Sadushit, e jo ta quante atë «Burri i Julikës». Sadushi nuk e duroi dot këtë gjendje dhe u ngrit e iku.

Pas pak erdhi kamarieri. Në tabaka nxirrte avull kafeja pranë dy birrave të freskëta.

— Ç'u bë ai? — pyeti kamarieri.

— Kush?

— Burri i Julikës, — tha qetë-qetë kamarieri.

— Iku i zemëruar.

— Pse?

— Sepse më dëgjoi kur thashë «Burri i Julikës».

— Atij ja the?

— Jo, jo, ja thashë këtij, por ai e dëgjoi.

— E ka shumë inat kur dëgjon që thonë ashtu. Një ditë desh e qëlloi njerin me grusht. Bobo, ç'nuk i tha!

— Për besë, — tha ai që kish porositur birrat, — grua si Julika s'gjen në gjithë lokalitetin tonë. Edhe në Tiranë besoj se i ka shoqet të rralla. Unë do të isha i lumtur, po të isha burri i saj.

— Po ai, vetë, kush është, si quhet? — pyeti ai që nuk dinte gjë fare.

— S'e di, — u përgjegj kamarieri, — unë jam i ri këtu. Bufetjeri e njeh mirë. Ka qenë montator i fabrikës sonë, ka ndërtuar oxhakun dhe kullën. Kanë qenë një brigadë e fortë. Diva ishin të gjithë! Ky ra në dashuri me Julikën dhe mbeti këtu.

Ditën tjetër Sadushi ndërroi vënd. Kafen dhe birrën nuk e piu më në «Turizëm». Në pijetoren përballë kinemasë kish më shumë njerëz. Dalëngadalë, Sadushi u mësua me lokalin e ri, po edhe aty, një ditë, dëgjoi të pëshpëritej: «Burri i Julikës». Çdë çast ktheu kokën, po s'vuri re asnjë shtyrë të dyshimtë. Të gjithë ishin të qetë, pinin e bisedonin. Sadushi u ngrit dhe shkoi në

tabákë tray
bobó boy oh boy
bufetjér = bufetiér man in charge
div giant; ogre
i dyshímtë suspicious

«Turizëm» dhe ndenji në trotuar, buzë rrugës, pastaj u ngrit, u fut në lokal e porositi një dopio konjak.

— Qënke i mërzitur! — e pyeti kamarieri.

— Po, — u përgjigj Sadushi.

— Ç'ke a i vrarë, gjithë të mirat ke.

— Ashtu është, — u përgjigj ftohtë Sadushi dhe nuk foli më gjatë. Çfarë mund t'i thoshte këtij çunaku që i qeshnin sytë kur i falje një dyleksh nga kusuri?

Sadushi u ngrit dhe, si të kish marrë një vendim të prerë, u nis me hap të matur, të vendosur e të shpejtë për në shtëpi. Ai ishte i sigurtë që ajo e priste në dhomë. «Do t'i them troç dhe për të fundit herë, po të dojë le të vijë me mua, po s'desh le të rrijë. Unë kështu s'mund të rroj dot. Shokët do të më kuptojnë e do të më falin, mbase dhe Julika do të më kuptojë, duhet të më kuptojë. Ai që të do, të kupton. Në fund të fundit, çdo njeri ka emrin e tij dhe një profesion të dashur. Julika do të më kuptojë.

Dhimiter Xhuvani "Lartësitë" Nëndori (Tiranë) XVII, 7 (July) 1970, pp.202-212

çke a i vrarë What's bugging you.
çunak little boy
dyleksh two lek piece
kusuh change (money)
troç plainly

LEXIMI I NENTEDHJETENJETE

Dritëro Agolli "Apasionata" Nëndori
(Tiranë) XIX, 3 (March) 1972, pp.115-126

Apasionata

Tregim
nga DRITËRO AGOLLI

I.

Nuk i kisha thënë as Mirës për vendimin tim. Ajo e dinte që mua nuk më ecte instituti dhe rrezikohesha të mbetesha. E dinte se dekanati ishte mbledhur tri herë për punën time dhe më në fund kish vendosur të më mbante në institut. Por unë doja të ikja që në muajin e fillimit të simestrit. Në përgjithësi unë nuk kam patur qejf të vija këtu, por babai nguli këmbë. Atij i pëlqente emri i madh i Institutit të lartë të arteve dhe i dukej shkollë fisnore. Një familje, që ka një nga pjesëtarët e saj artist, tregon një nivel të lartë intelektual. Babai është si fëmijë, megjithëse është njeri me post të lavdëruar. Fëmija ka tendencë të imitojë të rriturit. Babai imiton intelektualët e lartë, ata që kanë kulturë të madhe dhe që kanë qejf të flasin edhe për artin. Ai nuk lë pa ndjekur asnjë koncert të teatrit të Operas e baletit. E di, asgjë nuk kupton nga

rrezikóhem am in danger
dekán dean
dekanát assembly of deans; deans' office
i rrítur grown up

muzika, veçanërisht nga muzika simfonike, por e ndjen atë. Mua më vjen inat. Ndofta nuk kam të drejtë, ndofta inati im është një snobizëm. Ndonjëherë kur mërzia të bren shpirtin, kthehesh në snob dhe zemërohesh me veprim të njerëzve të shtëpisë sate. Por mua mjaft veprime të babait më duken se janë kotësi, se janë një shkëlqim i jashtëm. Njëherë, ai solli në shtëpi një piktor... Ia tregoi të gjitha dhomat e apartamentit, e ndali përballë mureve dhe pastaj porositi nja katër kuadro pikture: peisazhe e natyra të qeta. Të sillte ndonjë piktor të mirë, nuk do ta qërtoja, por ai kish gjetur një nga ata që mund t'i quajmë bojaxhinj!

E kështu, rrezikohesha të mbetesha. I dëshpëruar, i thashë babait se do ta lija institutin, se nuk më pëlqente. Babai u bë si ditë dimri, u ngrit, futi duart në xhepa të pantallonave dhe filloi të ecë bri meje lart e poshtë. Unë rrija dhe shikoja në këmbët e tij të vogla të fshehura në pantallona. Ashtu i vrejtur, zinte me dorë mjekrën, e lëshonte mjekrën dhe e fuste dorën në xhep. E ndjeja se babai pozonte. Po, po, pozonte. Dhe këtë pozë ai e quante presion psikologjik mbi mua.

— Do iki nga instituti! — i thashë unë ulur në karrike.

Ai e ndërroi pozën e mëparëshme dhe, mori një pamje të përvojtur. Pastaj u ngrys.

— Kur e paske marrë këtë vendim të pamatur? — pyeti ai me zërin e tij autoritar.

Mua më erdhi inat me këtë pyetje, se m'u duk tepër pompoze.

— Kush tha se është i pamatur? E kam matur me centimetra, bile me milimetra — thashë unë për të parodizuar pompozitetin e babait. Ai i ndali sytë në fytyrën time, si për të më studiuar, i ndali gjatë pa thënë asnjë fjalë. Pamja e tij të linte përshtypjen se në këtë vështrim spikatin mendime të thella, por unë e dija se në të nuk kish asnjë mendim. Prandaj në buzët e mija filloi të lozë një buzëqeshje ironike. Atëhere babaj nuk qëndroi më para meje.

Unë kujtova se do të ulej në kolltuk, por u drejtua nga dera, e hapi ngadalë dhe doli i heshtur. Mbeta vetëm në shtëpi. Nuk ishte as nëna, as motra. Mora një libër nga rafti dhe u mundova të mund mërzinë duke lexuar. Jashtë binte shi i përzjerë me dëborë. Ishte shkurt, Faqet e para të librit përshkruanin një ditë me diell, tregonin

bre gnaw
kotësí vanity
kuádro piktúre framed picture
peisázh landscape
qërtój criticize
bojaxhí brush swinger
fillói...e póshtë began to pace back and forth in front of me
pozój pose
i përvójtur experienced
i památur rash; unmeasured
parodizój parody
raft shelf

për një brigadier e për një mjelëse. Ç'libër! Hajde, brigadjer, të keqen!

E mbylla librin dhe u ngrita. Iu afrova dritares dhe fillova të vështroj shiun e përzjerë me dëborë. Nëna ime këtë përzierje e quan llohë. Ajo është bijë fshati. Kulturë nuk ka. Ka mbaruar vetëm shkollën fillore. Ka qenë shumë e mirë dhe është e mirë. Megjithatë, ajo ka marrë disa vetë të babait. Edhe ajo ka filluar të bëhet pak vanitoze, të mburret me punët e babait, t'u tregojë grave të thjeshta ndonjë sekret lidhur me kuadrin në ndonjë ministri, a lidhur me importin dhe eksportin e mallrave, a lidhur me politikën. Dhe unë trishtohem, kur e shoh nënën që influencohet nga vaniteti i babait. Ajo kujton se babai është burri më i zgjuar dhe më me autoritet i kryeqytetit.

Një mbrëmje jam inatosur me të. Dikush telefonoi, dikush kërkonte babanë. Nëna iu përgjegj:

— Shoku Demosten nuk ndodhet!; Do t'ia trasmetoj!

Më tepër nuk më erdhi inat me fjalën transmetoj që e tha gabim, por me shprehjen «shoku Demosten».

— Ama edhe ti nënë! — thashë unë dhe bëra me dorë.

— Ç'ke?

— «Shoku Demosten» — përqesha unë.

— Babai i ka shokët e rrallë, Artur! — tha ajo.

U zënërova edhe me emrin Artur. Edhe këtë emër babai ma ka vënë për t'u dukur.

Qëndroja para dritares dhe shikoja bulevardin e lagur. Njerëzit shpejtonin me çadra të hapura mbi kokat e tyre. Tubat e taracës sonë zhurmonin në trotuar. Radjua jepte «Apasionatën». Unë e doja këtë muzikë dhe gjithnjë më shqetësonte. Por nuk jam krijues muzike.

Nesër do të shkoj në dekanat dhe do t'i them dekanit për t'u larguar nga instituti. Unë nuk kam prirje në muzikë. Kam marrë edhe degën e kompozicionit. Të jesh kompozitor, do të thotë të krijosh. Unë nuk hyj në kategorinë e krijuesve të muzikës. Vaniteti i babait më bëri gazin e gjithë studentëve. Edhe Mira e ndjente se me mua talleshin. Ajo mësonte në degën e pjanos. Premtonte të bëhej pjaniste e mirë. Po unë ç'premtoja? Asgjë! Të kompozoj! Mua më duket sikur të gjitha kombinimet e tingujve janë krijuar nëpër pentagrame dhe të tjerë tinguj s'ka. Mijra e mijra këngë, simfoni, sonata, etyde, opera, operета, kantata oshëtijnë në pesë kontinentet. Është krijuar një botë e madhe tingujsh. Që të hysh në këtë botë tingujsh duhet të hysh me uniformën tënde. Unë nuk e gjej

mjélëse milkmaid
hájde, brigadiér, të kéqen what a guy, that brigadier
llóhë sleet
vétë = vetí characteristics
disá vetí të babáit a few of father's traits
vanitóz vain
transmetój transmit
i ka shokët e (=të) rrállë has few equals
çádër umbrella
túbë crowd
më bëri gázin makes me the laughingstock
tállem make fun of

dot këtë uniformë? Mira e gjen, Burhani e gjen, unë nuk e gjej. Unë mund të ndërtoj një urë, mund të montoj një turbinë. Pse patjetër u dashka të ndërtoj një simfoni, a një këngë?

Mendova të shkoja në konviktin e vajzave e t'i thosha Mirës se do ta braktisja institutin. Isha i sigurt se ajo do ta priste me gëzim vendimin tim, se do të lehtësohej nga një barrë: nuk do të dëgjonte të flitej për mua me ironi e me të qeshura: «që nga do-ja e gjer te si-ja, sa nota ka, Artur?» Mira ime, mendova, ç'bën vallë në konviktin e vajzave? Rri e mëson Historinë e muzikës operistike» që nga Verdi e gjer te Vagneri: Mëso, Mira, mëso! Edhe unë kam lexuar libra për Verdin e Vagnerin, por jo për t'ia thënë dikujt. I kam lexuar për qejfin tim. I kam lexuar thjesht si ngjarje. Interesante, ë?

Me përfytyrimin e Mirës në mëndje, po matesha të dilja, por në këto e sipër dëgjova hapat e babait:

2.

Babai e xhveshi pardesyrë, e vari në koridor dhe hyri në dhomë. Unë isha ngritur.

— Ku shkon? — pyeti ai.

— Do dal të takoj ndonjë shok!

— Ulu, ulu! — tha, duke bërë me kokë.

U ula. Ai nxori kutinë e cigareve dhe pastaj shkrepi çakmakun e vogël, që e mbante në xhepin e jelekut. Unë ndjeva erën e duhanit dhe të benzolit.

— Doemos, — tha ai, — influencojnë shumë faktorë në jetën e njeriut. Çdo hap në jetë ndesh me faktorë.

Unë e dija se pas kësaj fraze, babai do të shtonte një «por». Nuk e kisha qejf këtë «por» dhe e ndërpreva:

— Faktorët përparojnë,

Ai ngriti sytë nën vetullat e trasha dhe ia dha një të qeshure të madhe, që nuk e prisja. Pastaj nxori shaminë dhe fshiu sytë. E mënjanoi kokën dhe fuli ngadalë në xhep shaminë e tij, me vija si të pizhameve.

— Karagjoz, karagjoz! — murmuriti, duke nxjerrë dorën nga xhepi:

Në këtë çast u ngrita.

— Më fal, baba! Shokët më presin.

Ai bëri një xhest të papërmbajtur dhe e kuptova që u inatos.

— Ulu! — tha me tonin e tij urdhërues.

U lëkunda në këmbët e mia të gjata dhe u ula.

do do (musical note)
si ti (musical note)
në këtó e sípër at that moment
pardesý overcoat
çakmák cigarette lighter
jelék vest
benzól lighter fluid
doemós of course
mënjanój turn aside
karagjóz jester
inatósem get angry
lëkúndem sway; waiver; become unsteady

— Ti mua më fsheh shumë gjëra, — tha ai me serlozitet.

— Unë të fola shumë hapur. Iki nga instituti.

— Më fsheh, bir i babait, më fsheh! — tha babai me një ton që shprehte keqardhje. — Unë u përpoqa që ti të hyje në institutin e arteve jashtë konkursit. Ti shkove me rekomandim nga njerëz të nderuar. Ndërhyri për ty një ministri e tërë. Tani, pas pesë muajve, i vure shkelmin gjithë favoreve, gjithë kujdesjeve. Shokët e mi, po të marrin vesh vendimin tënd, do të vihen në pozitë të vështirë. Ende më ngushtë do ta ndjej veten unë, babai yt. Kam nyetur në dekanat. Ata thonë se ti ke talent, por merresh me gjëra anësore dhe do të thosha të papëlqyera.

Unë i hodha një vështrim të trishtuar babait. Balli i tij kish djersirë. Bulat e djersës kishin mbuluar edhe buzën, nën hundë, atje ku rriten mustaqet. Ajo që thoshte ai ishte e vërtetë.

— Të papëlqyera! — thirri babai,

— Po më habit, — thashë unë.

— Iliç mos u habit! Të papëlqyera! Edhe tani më thanë, se ti nuk e ke mëndjen në mësime, në solfezhë e ç'janë ato, po e ke mëndjen në, ç'janë ato, pipiruqet!

Babai ish nxehur. E kuptova. I merrej goja dhe përsëriste për çdo fjalë «ç'janë ato». Por unë ende s'po kuptoja se ç'ishin këto pipiruqe që po më përmendëte.

— Pipiruqe? — pyeta unë.

— Quripuqe! — thirri babai tërë djersë dhe me shkumbë në gojë.

Nuk u përmbajta. U ngrita dhe i dhashë të qeshurit me zë të lartë. Babai nga nervat ngatërroi radhitjen e gërmave të fjalës «pipiruqe».

— Mos qesh! — thirri ai. — Ulu! I parespektueshëm! Gagarelë. Influencë televizori. Influencë hipish! Influencë majmuni perëndimor! Përendimor e lindor të marrë së bashku.

Përsëri mua më vinte për të qeshur dhe e mbaja me zor shpërthimin, duke kafshuar kurrizin e dorës.

— Hiqe dorën! — tha babai dhe u ngrit.

Unë nuk e hiqja, se më qeshej. Babai m'u afrua dhe ma tërhoqi me zor. Atëhere më pushoi e qeshura.

— Hipi! — thirri babai dhe ktheu kurrizin.

Por te dera u ndal. Ktheu kokën nga unë dhe shtoi me një zë më të qetë: — Atë pipiruqen që ke ti në institut Mira e quajnë? Bukur, bir i babait, merru me pipiru-

keqárdhje bad feelings
konkúrs competitive exam
anësór extracurricular; ancillary
i papëlqýer unsavory; unpleasant
búlë drop; bead
solfézh music scale
pipirúq dandy; fop
quripúqe mispronunciation of pipiruqe
majmún monkey

qet dhe lere solfezhin, lere kulturën... Merru me Mirat se pas të vinë të mirat. Bukur, bir i babait, bukur! — Dhe doli, duke kaluar nëpër koridor për të hyrë në dhomën tjetër.

Kur mbeta vetëm, ndjeva diçka që e fyente Mirën, diçka që përlyente emrin e saj dhe nuk më erdhi mirë. Pse të zihej në gojë emri i saj?

3.

Të nesërmen shkova që në mëngjez në institut. Dy orët e para kishim leksionin e tretë të «Parimeve themelore të estetikës». Në këto leksione vija me qejf, se nuk ishin si lëndët e tjera të profesionit, të cilat më dukeshin monotone. Duhej të ndodhte e kundërta, por nga që nuk kisha prirje për muzikë, nuk më pëlqenin. Parimet themelore të estetikës» i merrja vesh. Mira bile, më thosh që të ndërroja degën dhe të merresha me kritikën e artit. Po edhe, kjo më dukej gjë e rëndë. Më mirë të shkoja në fakultetin e inxhinierisë. Ç'më duhej mua të bëhesha kritik arti! Edhe sikur të kisha prirje, nuk do të dëshiroja. Do të bëja ndonjë kritikë në gazetën «Drita» për Çesk Zadenë a Tish Dainë, a Kriston Konon, a Agim Krajkën dhe kur t'i takoja në klubin e shkrimtarëve, do të më rrinin tërë inat. Ikë ore! Ç'më duhej të prishja gjakun. Më mirë shko ndërto një pallat a një digë! Le që nuk kisha talent. Babait i ish mbushur mëndja se unë isha fenomen!

Në leksion takova Burhanin dhe Mirën. Isha i zbetë dhe i lodhur. Ata kujtuan se kisha qenë i sëmurë, por u thashë se nuk kisha fjetur. Tek mbante leksionin profesori, i thashë ngadalë Burhanit:

— Kam vendosur ta le institutin!

Burhani i ndërpreu shënimet që mbante në fletoren e trashë.

— Të këshilloj ta lesh në fund të vitit akademik. Jepi si t'i japësh edhe këto tre-katër provime, — tha ai.

— Jo, jo! Do t'i them lamtumirë që tani, — thashë unë.

— Nuk e aprovoj! Lere për në fund të vitit. Kalo pushimet verore dhe hyrë në universitet. Unë jam dakord me vendimin tënd. Njeriu gjen vëndin e vet në jetë... Por prit edhe këto nja tre muaj... — tha Burhani.

Burhani më pëlqente. Ai ishte njeri i matur dhe i qetë. Kurrë nuk mësonte përmëndësh. Gjithçka ia nënshtronte një logjike të shëndoshë. Ne të gjithë e donim.

<u>përlyej</u> stain; soil
<u>lëndë</u> subject; matter
<u>Ikë oré!</u> Nothing doing!
<u>dígë</u> dam
<u>jépi si t'i japësh</u> do what you can
<u>dakórd</u> in agreement

Ç'është e vërteta ishte pak patriarkal. I kish inat ata djem e vajza që dashuroheshin në institut. Kish mendimin se njeriu mund të dashurojë vetëm pasi të mbarojë një mision të filluar. Por është e çuditëshme, se mua nuk më shante, megjithëse dashuroja në institut Mirën. As Mirën nuk e shante. Përkundrazi, ai rrinte bashkë me ne. Rrinte aq shumë me ne, sa ndonjëherë unë bëhesha xheloz. Më dukej sikur edhe ai e dashuronte Mirën. Por këtë nuk e çfaqja. As Mirës nuk i kisha thënë gjë.

— Unë nuk pres! Nuk dua të qëndroj më në institut. A nuk e sheh ti, Burhan, se jam bërë qesharak? — thashë unë.

Burhani heshti. Përsëri filloi të mbajë shënime. Unë bëja sikur e dëgjoja profesorin dhe herë pas here i flisja Burhanit. Profesori më vuri re, por nuk tha gjë, se ishte njeri i sjellshëm. Këputa një copë letër nga fletorja dhe shkrojta dy-tri radhë: «Mira, kam vendosur të largohem nga instituti». Kur e mbarova së shkruari, zgjata dorën që prapa kurrizit dhe ia dhashë Mirës në bangon pas nesh.

Pas pak, Mira më futi në xhep një pusullkë. E mora dhe e hapa. «Do të bësh mirë» — shkruante ajo.

Megjithëse Mira në fjalët e saj ish objektive, unë u zemërova me të. M'u duk sikur ajo priste me padurim që të ikja nga instituti, në mënyrë që mos të skuqej për prapambetjen time, për mungesën e talentit tim në fushën e muzikës. E qartë, thashë me vete, Mira pret që unë të iki. I jam mërzitur Mirës. Ajo mund të më lerë mua dhe të dashurojë Burhanin, në qoftë se nuk e ka filluar që tani dashurinë. Dhe mua më hypi një inat për vajzat. Inati u përhap edhe mbi Burhanin, që e kisha në krah. I pushtuar nga ky inat, heshta gjer në fund të leksionit. Eh, dreq! Unë mund të isha në fakultetin e inxhinierisë i pari i studentëve, kurse këtu jam i fundit, mendova dhe zemërimi im pastaj kaloi te babai. Nga iu shkrep babait të bëjë sikur e ka qejf muzikën! Injorant është! Shoku Demosten merret me muzikë! Mos mbajë edhe ndonjë fjalim për muzikën para vartësve të tij? Ç'bilmes! Këtu u trishtova. Babait t'i them bilmes? Jam i paturpshëm! Babai u kujdesua për mua, unë i them bilmes! Bilmes jam vetë!

Ndërkohë ra zilja. Auditori filloi të zhurmojë dhe dola tok me Burhanin dhe Mirën. Dola kokëulur dhe nuk kisha dëshirë të bisedoja me asnjeri. Vetëm lëvizja këmbët, vetëm mbaja duart në xhepa.

Të tre qëndruam pranë dritares. Sheshi i institutit

qesharák laughable
i sjéllshëm well-behaved
létër paper
bángo desk; bench
pusúllkë letter
që e kísha në krak who was a close friend
bilmés ignoramus
tok me together with
shesh square; open space

ishte i lagur nga shirat e shkurtit. As Burhani, as Mira nuk flisnin. Edhe ata shikonin sheshin. Kur ne vështronim, në shesh u duk një veturë ngjyrë qumështi. Ajo bëri një hark të gjerë dhe u ndal para shkallëve të institutit. E njoha. Ishte maqina e zyrës së babait. Po, po! Pas pak, pashë edhe babanë të dilte nga dera e veturës. Me pallto të trashë e me republikë të zezë, ai filloi të ngjitë shkallët e gurta të institutit. Ngjitej ngadalë e rëndë-rëndë. Në pamje, të jepte përshtypjen e një personaliteti me peshë. Kolegët e mi e njihnin.

— Shoku Demosten! — tha Burhani dhe më vështroi mua.

— Po, po, babai! — thashë gjakftohtë dhe u mata të largohesha nga dritarja. Me mua erdhi edhe Mira.

— Do të shkosh ta takosh? — tha ajo.

— Në shtëpi e kam, ç'ta takoj? — thashë me ftohtësi.

— E do babanë, ti Artur? — tha ajo.

— Ama ç'pyetje! — thashë unë.

— Pyeta, se kur vjen ai në institut, ti vrejtesh, — tha ajo.

— Më vrejt hija e babait, — thashë unë.

— Ai është dakord që ti të ikësh nga instituti? — pyeti ajo.

— Ai është burrë i matur, — gënjeva unë, por u shpreha me një ton ironik dhe u pendova, pasi nuk doja që ftohtësia ime ndaj babait të kuptohej nga Mira. Po Mira nuk e kuptoi tonin tim ironik.

Ra zilja dhe hymë përsëri në leksion.

4.

Burhani dhe Mira më përcollën gjer afër shtëpisë dhe nuk ishin më pak të shqetësuar se unë. Ishin ditët e mia të fundit në institut. Megjithëse doja vetë të largohesha, në gjoks ndjeja një dhëmbje për shokët, për auditorët, për shkallët e institutit. Të kisha pak prirje për muzikën, në mos thënshim talent, nuk kisha për të ikur. Po unë e ndjeja se isha i tepërt në këtë tempull. Ka njerëz që e ndjejnë që nuk kanë prirje, a talent dhe megjithatë vazhdojnë të shtyhen në rrjedhën e përgjithëshme. Ata shkasin si për inerci drejt të talentuarve, rrinë bashkë me ta, e heqin veten si të aftë, marrin qëndrime e pamje të njerëzve të talentuar, shtiren pak skeptikë, pak nihilistë për artin që bëjnë të tjerët. Këta janë snobë. Snobi është njeriu që kërkon të bëhet majmun, ose majmuni që kërkon të bëhet njeri. Unë këtë nuk e

vetúrë vehicle
hark arc
zýrë office
republikë type of hat
i mátur reasonable
shtírem pretuend to be

bëj dot. Edhe unë mund të shtiresha si nihilist, por nuk shtirem dot.

— Po të ikësh që tani, do të mërzitesh në shtëpi gjersa të fillojë viti i ri shkollor. Në mes të vitit ti nuk mund të hysh në universitet, — tha Burhani.

Mira dëgjonte. Pastaj, më vështroi mua dhe priti se ç'përgjigje do t'i jepja Burhanit. Mua më erdhi keq që Burhani mendonte se mund të vërtitesha pa punë në shtëpi e në rrugë. Ai kujton se me që babai im ka post të mirë, edhe unë duhet të jem qibar dhe s'mund të hyj në çdo punë. Unë ktheva kokën nga Burhani dhe fytyra ime mori pamjen e një njeriu të lodhur.

— Unë nuk pres sa të fillojë viti shkollor, — thashë.

— Po ç'do të bësh? — pyeti ai.

— Do të hyj në ndonjë uzinë. Mua më pëlqen, për shembull, uzina mekanike, uzina e traktorëve.

Burhani u ndal. Nuk vura re ndonjë shenjë habie në fytyrën e tij, por megjithatë, e dija se ai nuk u besonte fjalëve të mia.

— Shoku Demosten nuk do të të lejojë, — tha ai.

Mua nuk më erdhi mirë që Burhani mendonte kësisoj për babanë. Vërtet unë vetë me tim atë zemërohem, por nuk e padit për gjërat që nuk i ka. Nga e nxori Burhani, se babai nuk do të më lejojë të shkoj në uzinë?

— Dëgjo, Burhan, babai nuk është rritur mes dyshekëve me pupla, — thashë unë.

— Më fal! Më keqkuptove, — tha Burhani, — yt atë do që ti të vazhdosh shkollën e lartë. Rrjedhimisht atij nuk do t'i vinte mirë që ti të filloje një punë pa hyrë në universitet.

— Me këtë kuptim e tha Burhani — ndërhyri Mira, duke u trembur se ne do të ziheshim.

E vështrova Mirën, po s'i fola. Kjo gjithnjë e mbron Burhanin, mendova unë.

Në këto çaste doja të ikte Burhani e të na linte vetëm me Mirën. Sa i trashë është ky Burhani! Nuk e kupton se po bëhet i tepërt? Pse nuk na le të ecim të dy me Mirën? Ja, m'u tek mua t'ia shtërngoj pak gishtat e vegjël Mirës. M'u tek ta puth, xhanëm! Ky ç'do? Shok, mirë, shok le të jetë, por ç'më bëhet rrodhe?

Burhani e kuptoi që isha mërzitur dhe afër shtëpisë sonë qëndroi e tha se do të ndahej nga ne, pasi kishte lënë një takim me një shok.

Mbetëm unë e Mira. E imët, e mbështjellë me pallton e saj të kaltërt, ecte e heshtur krah meje. Lagështia

qibár upper class; noble
nuk është...me púpla didn't grow up with a silver spoon in his mouth
rrjedhimísht consequently
zíhem quarrel
m'u tek I'm in the mood
xhánëm let's say
rródhe burr; burdock
e ímët = e ímtë

e rrugës dhe e ajrit dukej sikur kish hyrë në të gjitha indet e trupit të saj. Herë-herë ajo dridhej dhe afrohej nga unë, sikur të kërkonte ngrohtësi.

— Ke të ftohtë, Mira? — pyeta unë.

— Pak — tha ajo.

— Unë do të iki nga instituti, Mira, po ne përsëri do të jemi pranë njeri-tjetrit, — thashë unë dhe e zura për dore. Gishtrinjtë e saj të vegjël humbën në pëllëmbën time të madhe. Ata ishin të ftohtë dhe unë i shtërngoja për t'i ngrohur. Dhe në këto çaste ndjeja një valë të vakët e të ëmbël në gjithë trupin tim. Mira kish ulur kokën dhe flokët e zes ia zinin njërin sy dhe gjysmën e fytyrës së bukur brune. Unë vetëm Mirën kam dashur. Ajo erdhi në institut nga Korça dhe u njoh me mua që në ditët e para të vitit shkollor. Domosdo atëhere ajo nuk e dinte se unë isha njeri pa aftësi në muzikë. Nga pamja i dukesha i talentuar dhe i mprehtë, por në të vërtetë më mungonte diçka, nuk isha muzikant në shpirt. Por jam i sigurtë se edhe po ta dinte mungesën e talentit tim, do të më kish dashuruar.

Asaj nuk i vinte mirë, kur shokët talleshin me dobësinë time në lëmin e muzikës. Bile ndonjëherë skuqej e nervozohej. Megjithatë, më donte.

Ndërkohë, ne ndjemë hapa nga pas. Vinte babai me pallton e trashë e republikën e zezë. Ai kaloi para nesh, ktheu kokën i ngrysur dhe u ndal. Mira u struk pas meje dhe unë e ndjeva se u trondit.

— Në vend që të studioni, silli rrugëve! — shfryu babai.

— Sapo mbaroi leksioni! — thashë unë ftohtë.

Babai nuk foli. Na hodhi edhe një vështrim dhe u largua ngadalë, impozant, i ngrysur.

— Sa u tremba! — tha Mira ngadalë.

— Trembje pa shkak është budallallëk — thashë unë.

— Yt atë ka hije të rëndë, — tha ajo.

— E ka nga përgjegjësia. Ne të dy i dukemi si vartës, edhe këta që shkojnë në rrugë i duken si vartës, — thashë unë.

— Si flet kështu për babanë Artur? — tha Mira.

— Bëj shaka, bëj shaka, — qesha unë.

Pastaj e përcolla Mirën gjer në stacion të autobuzit dhe u ktheva në shtëpi.

ind tissue
i vákët warm; lukewarm
e zes black
brúne dark; brunette; brown
strúkem huddle
përgjegjësí (position of) responsibility

Babai me nënën hanin drekë. U ula në karrike e shikoja lëvizjen e lugëve të tyre. Babai mbllaçitej dhe buzët e tij zhurmonin si këpucët në një tokë të lagur.

— Erdhe? — tha ai pa kthyer kokën.

— Erdha, — i thashë.

— Erdhe domethënë! — perseriti babai.

— Domethënë erdha, — thashë unë.

Nëna ndërhyri përnjëherësh:

— Do të hash, Artur?

— Do të ha! — thashë unë.

Nga qëndrimi i tyre, e mora me mend se do të kishin biseduar për mua. Babai do të më kishte sharë, kurse nëna do të më kishte mbrojtur.

Nëna e mbushi pjatën me gjellë dhe unë u ula në krah të babait. Të dy hanim: babai me mbllaçitje të forta, unë lehtë-lehtë.

— U lodhe domethënë, — tha babai.

— U lodha, — u përgjegja unë me sy në pjatë e me dorë në lugë.

— U lodhe duke bredhur bulevardit, — tha ai, duke fshirë buzët me pecetë.

— Edhe kjo që thua ti më lodhi, — u përgjegja unë qetë.

Babai u ngrit nga tavolina me fytyrë të skuqur. Atij nuk i pëlqeu përgjigjja ime, megjithëse pohova fjalët e tij.

— Kohën e shtrenjtë po ia kushton asaj zuskës. Për zuskën paske talent, për muzikën s'paske talent... — tha babai, duke ngritur gradualisht zërin e tij të trashë.

— Mjaft tani de, mjaft! Lere të hajë! — ndërhyri nëna.

— Domethënë ta le, — tha babai më qetë.

Unë vazhdoja të haja tanimë me përtim. Por babait i vinte inat që unë kisha oreks në këto çaste të zemërimit të tij.

Ai m'u afrua te tavolina, ma mori lugën, e ngriti lart dhe e përplasi para syve të mi.

— Unë flas, ti nuk e prish qejfin! Unë grij, ti na me qetësinë më të madhe.

Në qafën time unë ndjeja frymën e nxehtë të gojës së babait të zemëruar. Atëhere u ngrita dhe i thashë:

— Më fal!

Babai heshti edhe nëna heshti. Unë qëndroja në këmbë përballë babait, qëndroja me kokën lart, i vrejtur dhe pakëz i zbetë. Këtë zbetësi e ndjeja.

mbllaçítem munch
mbllaçítje munching
pecétë napkin
pohój confirm
zúskë slut
de emphatic particle
oréks appetit
ti nuk e prish qéjfin you don't even care
Unë grij I'm grinding my teeth
zbetësí paleness

Ai qëndroi pak përballë meje, pastaj ktheu krahët dhe hyri në dhomën e gjumit. Në kuzhinë mbetëm unë e nëna. Më vinte vështirë të ulesha. Qëndroja në pozën e mëparshme dhe vështroja diku në bardhësinë e murit. Kështu kam qëndruar edhe një herë në institut pas provimit. Unë isha studenti që u pyeta i fundit. Ikën të gjithë. Kolegët e mi iknë dhe profesori iku. Unë mbeta me librezën e notave në dorë. Mbeta në këmbë dhe vështroja murin. Atëhere, duke parë murin e auditorit, e ndjeva peshën e rëndë të vuajtjes sime shpirtërore, të mundimit tim të kotë. E ndjeva se ekzistenca ime në atë auditor ishte një pasojë e një gabimi. Po të zgjaste kjo ekzistencë, pesha e vojtjes sime do të rritej më shumë. Tërë jetën atëhere do të vuaja nga ndjenja e inferioritetit ose nga ndjenja e njeriut mesatar, e njeriut filister. Atëhere thashë me vete se pas institutit unë do të hyja në ata njerëz që kanë diploma, që numërohen me arësim të lartë, po që nuk janë ende as specialistë, as intelektualë. Unë do të shtoja një shifër në anuarët statistikorë dhe asgjë më tepër. Unë nuk doja të isha një shifër. Dhe u drodha, duke shikuar murin e auditorit me librezë në dorë. Por për një çast ndjeva një gëzim të paparë. Ky ishte gëzimi i njohjes së vetvetes. «Kjo nuk është rruga ime, thashë unë, ka rrugë të tjera». E futa librezën në xhep dhe dola. Ja, këto çaste më ranë në mend tek qëndroja para murit të kuzhinës, kur nëna rrinte e nuk fliste, kur babai kish hyrë në dhomën tjetër, kur pjata ime qëndronte përgjysmë në tavolinë, kur Mira rrinte në konviktin e vajzave.

— Dëgjoje babanë! — tha nëna — Babai di të mendojë!

Unë u ula në karrike. Pastaj erdhën në vetëdijën time fjalët e nënës.

— Nuk dua të jem një shifër! — thashë unë.

Nëna hapi sytë:

— Shifër?

— Shifër! — thashë unë.

Nëna nuk kuptoi asgjë.

librézë little book
vójtje = vúajtje
mesatár average
filistér Philistine
énde as yet
anuár yearbook
i papárë unprecedented
përgjýsmë half full; half empty

kanapé wooden sofa
taván ceiling
meditój meditate

LEXIMI I NENTEDHJETE

6.

Të nesërmen nuk shkova në institut. Isha shtrirë në kanape, kisha vënë duart prapa kokës dhe shikoja tavanin. Kot, meditoja. Shokët e mi tani dëgjonin leksionin e dytë në institut. Mira rrinte në bangë e shkruante. Edhe

Burhani me nofulla të rënda, rrinte në bangë prapa saj dhe shkruante. Babai në zyrë lexonte materiale të rëndësishme të mbledhjeve të rëndësishme lidhur me sektorin që drejtonte. Të gjithë thonë se punon shumë dhe kërkon edhe nga të tjerët të punojnë si ai. Nuk kam asnjë dyshim për këtë. Babai punon. Ai punon si buall dhe është i ndershëm në punën e vet. Nuk kam asnjë dyshim. E kam parë vetë edhe në shtëpi, edhe në zyrë. Kur ka ndonjë raport a relacion për të shkruar, emocionohet si fëmijë. Shkruan, ha lapsin me dhëmbë, ngrihet nga tavolina, ulet. Është i guximshëm në kritikë. Shoku Shemshedin, që është më i madh se ai në përgjegjësi, e ka kritikuar një herë për disa investime të kota në një ndërtim të një biblioteke në një qytezë, ndërtim pa perspektivë. Ndërtim që për dhjetë vjet del jashtë përdorimit. Prapë duhet ndërtuar një bibliotekë tjetër... Babai kishte të drejtë. Edhe këtë e di... Po Mira ç'thotë? Ndofta kujton se unë nuk kthehem më në institut. Unë iu thashë Mirës e Burhanit se do të prisja sa të mbyllej viti akademik, pastaj të ikja. Po ja që ika që sot! Unë me Mirën edhe mund të ndahem. Do të kemi rrugë të ndryshme. Unë do të shkoj në fakultet të inxhinierisë, ajo ka degën e muzikës. Asgjë s'e lidh inxhinierinë me muzikën. E lidh, e lidh! Edhe mund të martohem me të. Hë! gruaja ime merret me muzikë. Dhe unë qesha me zë të lartë. Nëna vrapoi në dhomë.

— Artur, ç'pate? Ç'ke që qan? — thirri ajo e shqetësuar.

— Qaj? — pyeta unë, duke fshirë lotët.

Ajo erdhi te koka ime. Ma vuri dorën në ballë e tha ngadalë:

— Mirë, ikë nga instituti! U cfilite, bir i nënës! — dhe më fshiu me shami një lot në faqe.

Unë vura buzën në gaz.

— Sa më trembe! S'të kisha dëgjuar të qaje me zë të lartë, që kur ishe fëmijë.

— Unë qava? — e pyeta, duke la lëmuar dorën.

— Qave!

— Unë qesha, moj nënë!

— Nuk ish e qeshur ajo! Tundi kokën nëna dhe doli.

Fjalët e saj më rrënqethën pa kuptuar. Nuk jam supersticioz, po më pushtoi një parandjenjë e keqe. Brr! Qava! bëra unë me vete.

Ndërkohë ra telefoni. Nëna vrapoi dhe e ngriti receptorin.

búall ox
relación account
laps pencil
i guxímshëm courageous; daring
del jáshtë përdorímit becomes useless
që sot this very day
cfilítem wear myself out
parandjénjë premonition
receptór receiver

— E? Shoku Demosten? Shoku Demosten nuk ka ndonjë mbledhje. Në orën dy e gjysëm kthehet... Nga telefononi ju? Nga instituti? Ç't'i them? Mirë! — tha ajo dhe e uli receptorin.

Unë e vështroja fytyrën e nënës i menduar.

— Ama edhe ti, nënë! Shoku Demosten! E ç'i thua «shoku Demosten» në telefon. Ti në shtëpi i thua Demo! Ama!

Ajo më hodhi një vështrim të butë.

— Po të gjithë në telefon i thonë shoku Demosten! Edhe mua më është bërë zakon.

— Preje këtë dreq zakon!

— S'të kam pyetur një për një. Pse kërkon të ikësh nga instituti, Artur?

— Nuk jam i zoti, nënë! — thashë unë serioz.

— Ti të mos jesh i zoti? Ja ai Burhani si leshko duket. Ti je më i zoti se ai.

Mua m'u qesh.

— Ai është më i zoti, nënë!

— Nuk është më i zoti se ty! Mos ke ndonjë gjë tjetër që ikën? Yt atë thotë se ti merresh me dashuri dhe ua ke varur provimeve, prandaj ngul këmbë të ikësh.

— Nuk është e vërtetë. Unë nuk kam vesh muzike!

— Si s'ke vesh! Burhani që m'i ka si opinga veshët, pse paska?! — tha nëna.

Unë qesha me të madhe.

— Ç'qesh! — tha ajo — je kaq i zgjuar dhe s'mbaruake dot një institut muzike?

U ngrita dhe iu afrova.

— Nënë, si do të të pëlqeja: të kisha një punë në dukje shumë të nderuar dhe të isha i fundit i shokëve, apo të isha në një punë që në dukje nuk ka aq shkëlqim dhe po në këtë punë të isha i aftë si shokët e mi?

Nëna tundi kokën.

— Si shokët, — tha ajo ngadalë.

Ndërsa ne bisedonim, u hap dera e jashtme dhe unë pashë republikën dhe pallton e zezë të babait. Ai e mbylli derën lehtë, vështroi një herë nga ballkoni i verandës dhe hyri në dhomë. E hoqi republikën, e xhveshi pallton dhe u ul në karrike pa folur. Mua më hodhi një vështrim të shkurtër nën ballë dhe iu drejtua nënës:

— Më kërkoi njeri?

— Nga instituti, — tha nëna.

— Doemos për punën e këtij! — bëri ai me koké nga unë.

një për një directly
léshko dimwit
ua ke várur provímeve you've put aside the exams
opíngë sandal

— Nuk e di, — tha nëna.

— E di unë! — babai u kthye nga unë. — Ti zotni, nuk shkove sot në institut. Fjete gjumë, e ç'janë ato!

Bobo! thashë me vete, filloi ky më «ç'janë ato»!

— E qartë! — iu kthye nënës — bukë!

Pastaj në dhomë ra një heshtje e nderë. Në tavolinë filluan të kërcasin lugët e pjatat. E çuditshme! Zënkat tona gjithnjë në kohën e kërcitjes së pjatave e lugëve fillojnë!

— Ashtu, — tha babai, duke u ulur në tavolinë, — të rrimë të merremi edhe me aventurat e djalit, se pak punë kemi! Të zgjidhim aventurat nëpër dekanate e rektorate. Shpërblim të mirë morëm nga filizi që rritëm, grua!

Unë nuk flisja. Vendosa për një çast mos të jap asnjë përgjigje, po të hesht.

— Ha, Demo! — tha nëna,

— Farmak! Po, po, farmak i një asortimenti të shkëlqyer! E?

— Çfarë? — tha nëna që nuk e dëgjoi.

— Kjo që ha në farmak kthehet e ç'janë ato! — tha babai.

Nëna më vështroi mua me frikë.

— Më thanë, më thanë! Për këtë zotninë më thanë. Njeri i aftë, i talentuar. Por talenti i pakultivuar kthehet në zero. Kish mundësi ta kultivonte? Kish! Shteti s'ka faj. Ia ka koka! Më thanë se i la zvarë mësimet. Gjeti një nga ato mini-fundet, nga ato që përdridhen kështu... për-për-për... — tha ai dhe u ngrit për të imituar vajzat e reja.

Kjo ishte një nga pamjet më komike, që kam parë! Por nuk qesha. Qeshi vetëm nëna dhe babai e vështroi me inat, duke u ulur përsëri në tavolinë. Ai ende nuk po e merrte lugën.

— Gjeti një nga kjo kategori njerëzish që thashë dhe i vuri në fillim shkelmin mësimeve, pastaj institutit. Çuditem! Ka faj edhe dekanati, edhe rektorati që mbajnë vajza të tilla... çuditem...

Unë e ndërpreva:

— Mos e fyej një vajzë të ndershme! — zëri im ishte i thatë. Ai fshihte zemërim. Babai ktheu kokën nga unë dhe në atë çast vura re se vetullat e tij të ngrysura të rëna pothuajse mbi sytë e vegjël, mbi sytë e egërsuar.

— Ne shpesh mbrojmë atë që s'është për të mbrojtur, se kështu mbrojmë veten tonë. Unë do të thosha se edhe ti je i po asaj kategorie ku bën pjesë edhe ajo... — tha babai me ton të rëndë.

kërcás clatter; creak
zënkë quarrel
rektorát rectorate; office of the president
shpërblím reward
filíz offspring; scion
farmák poison
Ia ka kóka It's on his head
zvarít drag
mínifund = minifúnd miniskirt
përdrídhem twist
shkelm kick
i egërsúar wild

— Ne shpesh shajmë një tjetër për të mbrojtur atë që e kemi më pranë lëkurës. Ti e shan atë për të më mbrojtur mua, se kërkon të bëhet ashtu siç mendon ti, ti nisesh që në themel gabimisht. Ta kam thënë edhe një herë tjetër. Unë njoha paaftësinë time. Unë e njoha veten që në fillimin e rrugës dhe thashë: kjo rrugë nuk më shpie atje ku dua unë. Këtë rrugë, po e bëra gjer në fund, do të më duhet të kthehem përsëri dhe atëhere do të jetë një gjë shumë e lodhëshme për mua, prandaj po kthehem që në fillim për të marrë një rrugë tjetër... Ti kujton se ma zuri ajo këtë rrugë? Dhe dëgjo! — unë këtu u drodha nga tensioni nervor; tutela jote në çdo hap timin nuk më pëlqen. Tutela jote më tregoi një rrugë. Unë hyra në këtë rrugë. U gabova. Tani dua një rrugë tjetër. Tutelën po e le...

Babaj hapi sytë. Ai u ngrit. Filloi të ecë nëpër dhomë. Pjatat e mbushura avullonin në tavolinë. Pastaj, ai qëndroi në këmbë dhe filloi të më vështrojë si një njeri të panjohur.

— Tutela! — tha ai si me vete. — Paske mësuar shumë arësyetime. Kështu mendojnë gjithë të rinjtë? Ë? Ju paski mësuar të arësyetoni... Rruga. Njohja e vetvetes... Njohja e fajësisë... Njohja e paaftësisë... Ë? Doemos nevoja e vetëmbrojtjes të shtyn të kërkosh argumenta. Jo vetëm kaq. Të shtyn edhe të arësyetosh mbi këto argumenta. Ti kujton se më mbushe mendjen, se u mbrojte?

Ai u ul dhe mori lugën. Më nuk foli. Unë dëgjoja pllaq-pllaqin e supës...

7.

Kaluan ca ditë. Unë nuk shkoja në institut. Babai u kish thënë në dekanat se isha i sëmurë. Në të vërtetë kisha vendosur ta braktisja institutin. Bile po bëja përpjekje të hyja në uzinën e traktorëve gjer në fillimin e vitit të ardhshëm shkollor. Shefi i kuadrit të uzinës ra dakord me mua për të filluar punën nga java. Unë dija pak të punoja në torno, se kisha mësuar që në shkollën e mesme, gjatë punës prodhuese. Përpjekjet e mia për të hyrë në uzinë nuk ia kisha treguar babait, se kisha frikë mos më prishte punë.

Atëditë rrija brenda dhe lexoja. Veç asaj, merresha edhe me gjuhën angleze. Lexoja tekste të lehta dhe nxirrja fjalë të pakuptueshme. Flisja me vete fjalë të tëra, hapja manjetofonin, që ma kish blerë dikur babai

tutélë tutelage; guardianship
fajësí guilt
vetëmbrójtje self-defense
nga jáva next week
tórno lathe
manjetofón tape recorder

dhe dëgjoja mësime në gjuhën angleze... Kisha disa plane. Doja në fillim të mësoja anglishten, pastaj të filloja frëngjishten. Dy gjuhë mjaftojnë. Bredhja pas shumë gjuhëve është e kotë. Shumë gjuhë ju duhen linguistëve.

Tek lexoja në dhomë, erdhi nëna dhe më tha se më kërkonte Burhani.

— Në telefon? — pyeta unë.

— Është te dera, — tha nëna.

Unë dola me vrap. Burhani qëndronte i pështetur pas derës, me ombrellë në dorë.

— Hajde, Burhan!

Ai hyri ngadalë, duke zënë me dorë nofullën e poshtme. Ecte nëpër koridor i qetë dhe i ngrysur. E ftova të ulej në kolltuk. Unë ndenja përballë tij.

— Ç'kemi nga instituti? — pyeta unë.

— Qetësi. Ti vendose të mos vish më? — pyeti ai.

— Vendosa, Burhan!

Ai fërkoi me dorë bollin e madh dhe vuri këmbën mbi këmbë.

— Donte të vinte edhe Mira, por nuk kish si ta linte vetëm të atin... — tha Burhani.

— Ka ardhur i ati i Mirës? — pyeta unë.

Burhani nuk u përgjegj menjëherë. Ai vështroi manjetofonin në tavolinën time, pastaj metodën e anglishtes.

— Mëson? — pyeti ai.

— Ngapak! — thashë unë.

— Të atin e Mirës e thirri dekanati... — tha Burhani.

— Pse?

— Si të të them. Punë e komplikuar.

— E komplikuar?

— Mirën duan ta përjashtojnë nga instituti, — tha Burhani.

Unë lëviza nga vëndi.

— Ta përjashtojnë?

— Punë e komplikuar, Artur!

— Lere këtë dreq shprehje! Ç'ka ndodhur? — u nxeha me qetësinë e Burhanit.

— E quajnë vajzë të çthurur, vajzë që ngatërron djemtë... — tha Burhani.

Unë u skuqa. Mira asnjë djalë nuk njihte përveç meje.

— Ç'djem?

— Ty! Ty të bëri që të lesh pasdore mësimet dhe

brédhje chasing
i pështétur leaning
përjashtój expel
i çthúrur = shthúrur loose; unbridled
ngatërrój confuse; mix up
lë pasdóre neglect

më në fund të braktisësh institutin. Dhe atë duan ta përjashtojnë që të të shpëtojnë ty, — tha Burhani.

Unë u ngrita në këmbë i zemëruar.

— Kjo është një sakrificë e kotë, — thashë.

Burhani nuk më kuptoi. U detyrova ta përsërit mendimin tim.

— Për mua u dashka të sakrifikohet një njeri? Edhe për hir të talenteve të mëdhenj nuk duhen sakrifikuar njerëz. Në histori ka ndodhur që një grua ka sakrifikuar veten për një talent. Është mbyllur brënda katër mureve, ka braktisur gëzimet e jetës së saj vetëm e vetëm për t'i krijuar qetësi burrit-gjeni. Por ajo kërë e ka bërë me dëshirën e saj. Mirën duan ta sakrifikojnë për mua. Unë s'jam talent. Jam vetëm biri i një drejtuesi...

Fillova të bëj një arësyetim, të gjatë, të shpreh disa mendime të grumbulluara me kohë në vetëdijen time. Burhani mbante vesh me nofullën e mbësitetur në pëllëmbën e dorës.

Pastaj, mendja më shkoi te babai. Kërcënimi që i bënte ai Mirës kishte edhe një kuptim tjetër. Ai nuk donte që unë ta filloja që tani dashurinë. Mendonte se mund të martohesha dhe të filloja jetën familjare pa arësim të mbaruar, pa një profesion në jetë. Njohjen me një vajzë ai e kuptonte si një hyrje në hallet e martesës. Për të më ruajtur nga një fatkeqësi e tillë, ai sakrifikonte Mirën, duke e larguar nga unë... Ishte një kompleks i tërë gjërash!

— E kanë thirrur të jatin t'ia komunikojnë fajet e së bijës. I ati ishte bërë vrer. Më erdhi keq për atë të zi. Ishte mbledhur kruspull, rrinte si i shastisur... Mirës i thanë në fillim të heqë dorë nga ty, përndryshe do ta përjashtojnë. Pastaj, erdhi një urdhër tjetër për ta përjashtuar pa kondita, heq s'heq dorë nga ty... Erdhi i ati ta marrë... u vra i ziu plak... E? ç'i thua kësaj?

Burhani m'i hodhi sytë mua si për të më provuar. Ai shikonte dhe priste përgjigje nga unë.

— Kjo nuk bëhet. Mira nuk përjashtohet... — thashë unë.

— Edhe unë ashtu mendoj. Por kam frikë. Artur, yt atë ka ardhur disa herë në dekanat... — tha Burhani papritur.

Unë u skuqa. Duart e mia filluan të lëvizin automatikisht nëpër gjunjët.

— E çfarë? — pyeta Burhanin.

vétëm e vétëm just so
kërë = këtë (mp.)
kërcëním threat
vrer embittered; indignant
të zi poor fellow
krúspull drawn in; huddled
përndrýshe otherwise
heq s'heq dórë nga ty whether she gives you up or not

Ai heshti.

Edhe këtë radhë nuk doja të dëgjoja keq për babanë. Burhanin e kisha shok, por edhe atij nuk i lejoja të merrte nëpër gojë tim atë. Megjithatë, Burhani kish të drejtë. Babai duhej të ishte ankuar në dekanat për Mirën. Vetëm tani fillova t'i analizoj bisedat e babait sharjet e tij në adresë të Mirës e të vajzave të çthurura. Por nuk doja që Burhani të dyshonte për atë.

-- Dëgjo, Burhan! Babai nuk merret me këto punë, — thashë dhe u skuqa, se fjalët e mia ishin fallse. E ndjeja fallsitetin e tyre dhe kisha frikë se mos e ndjente edhe Burhani. Gjer këtu të ketë shkuar babai? Njeri i drejtë në punën e vet, njeri që ngordh në punë dhe të merret me gjëra kaq të papëlqyera? mendoja, duke patur përballë Burhanin e drejtë dhe të urtë.

— Dyshoj, Artur! Mos ma merr për të keq. Unë kam respekt për shokun Demosten, por Mirës i erdhi kjo gjëmë nga yt atë... Vetëm ai ka forcë ta bëjë këtë. Ai është shumë i fortë, Artur. Ai e bën... — tha Burhani i menduar.

— T'i lëmë këto dyshime! — ndërhyra unë ftohtë.

Burhani rrudhi vetullat. E vura re që u nxeh.

— T'i lemë? edhe ne sikur t'i lemë, nuk na lenë ato... Një njeriu po i pritet e ardhmja. Gërshëra është hapur dhe po e pret fillin e së ardhmes... T'i lëmë! — çfryu ai ngadalë, duke përmbajtur zemërimin. Unë u skuqa. Fjalët e tij ishin autoritare. Më autoritare se të babait tim.

— Nejse, ! ke të drejtë të mendosh. Çdo njeri ka të drejtë të mendojë — thashë unë në mënyrë evazive.

Burhani u ngrit.

— Rri! — i thashë.

— Do të dal; — tha ai ftohtë, duke hedhur një vështrim në pantallonat e mia të hekurosura.

— Rri edhe pak, — iu luta unë.

— Më fal që të bezdisa. Mëso! mëso! — tha ai nëpër dhëmbë. Pastaj mori ombrellën në qoshe të koridorit dhe doli pa thënë asnjë fjalë.

Kur mbeta vetëm i kuptova fjalët e tij: «mëso, mëso»! E? Një njeri po merrej më qafë për hátrim tim dhe unë rrija. Unë duhej të vrapoja pas Burhanit, të vrapoja dhe të takoja Mirën.

Mbatha shpejt e shpejt këpucët, vesha pardesynë dhe vrapova nëpër shkallët. Nëna më thërriste:

— Ku shkon, Artur?

Unë vrapoja...

që ngordh në púnë who works himself to death
gjëmë misfortune
T'i lémë = T'i lémë
gërshérë scissors
néjse anyway
i hekurósur ironed
hatrim = hátrin (mp.)
për hátrin tim for my sake

8.

Burhanin nuk e takova dot. Hipa në autobuz dhe u nisa për në konviktin e vajzave. Tërë rrugës e kisha mendjen te Mira. Me vete shaja babanë. Por unë nuk besoja se Mira mund të përjashtohej nga instituti. Mosmarrveshja duhej të zgjidhej. Për fatin e saj nuk mund të vendoste vetëm një fjalë e hedhur nga një njeri.

Zbrita nga autobuzi dhe hyra në rrugicën që të shpinte në konviktin e vajzave. Nëpër këtë rrugicë kisha kaluar shumë herë me Mirën dhe pa Mirën. Mbrëmjeve të pranverës gjithë ky rajon gjallërohet: dëgjohen të qeshura vajzash, bisedime të lehta dhe ndonjë këngë. Tani në shkurt, kjo rrugicë është më e qetë, se bien shira dhe është ftohtë.

Para rojes së konviktit qëndronte një plak i imët me një kasketë me strehë. Ai priste dikë. Pinte duhan dhe shikonte nga ndërtesa. Mua m'u kujtua i ati i Mirës. Nuk e njihja. Plaku më pa me vërejtje, pastaj ktheu krahët dhe filloi të ecë në sheshin e vogël. Ai ehtël mendova unë.

Kur plaku ishte disa metra larg meje, iu afrova rojës së konviktit dhe i thashë ta thërriste Mirën. Ai tundi kokën në heshtje dhe doli nga kabina e tij e vogël. Pastaj, papritur, u kthye nga unë:

— E pret edhe i ati!

— Ashtu? — thashë unë dhe padashur shikova plakun që ecte poshtë e lart kokëulur dhe me cigare në buzë. Mendova një herë t'i flas e të njihem me të, por e lashë kur të vinte Mira. Në vështrim të parë, plaku më dukej njeri i urtë, që mundohej të mposhtëte një dhimbje të thellë

Në këtë kohë, në kopshtin e vogël u duk Mira me pallton e saj të kaltër, të vetmen pallto. Unë në këtë çast ktheva kokën nga plaku. Vetëm atëhere ai e ndjeu se edhe unë puisja Mirën. Dhe pashë se ai u bë edhe më i vogël dhe u duk sikur hyri i tëri në pardesynë e tij të vjetëruar.

Mira më zuri për dore. Nëpër dhimbjen e thellë, vura re shkëlqimin e syve të saj. Unë vija tek ajo si një shpresë e ndritur.

— Ka ardhur edhe babai, — tha ajo ngadalë dhe u drejtua nga plaku me ndrojtje.

— Hajde, moj bijë! — tha ai me një zë të hollë pak të dredhur.

me vête inwardly
rajón area; region
kaskétë cap
strêhë bill; brim
gërshetój entwind
qérre wagon
spitál hospital
mplákem get old
të fála regards

Unë qëndroja i veçuar nga ta. Mira ktheu kokën nga unë dhe i tha të jatit:

— Është një shoku im i institutit!

Ne të dy me plakun i shtërnguam dorën njëri-tjetrit. Ai m'i hodhi sytë e vegjël drejt në fytyrë, sikur të kërkonte një përgjigje: «mos je ti ai»? Dhe megjithatë, ai dukej i urtë.

Ne të tre filluam të ecim në drejtim të kundërt të konviktit. Ku shkonim? Ç'do të bëja unë bashkë me këtë plak? Ç'të flisja me të? Ku e dija unë se ç'i kishin thënë atij në dekanat? Si të bëja që ta shkëputja Mirën prej tij? Shkëputja ishte e vështirë. Ai nuk i ndahej si bijës.

Duke ecur, papritur më pyeti:

— Nga je, ti djalë?

— Unë në Tiranë banoj, po prindërit e mi janë nga Korça. Që në ditët e para të çlirimit babai im është vendosur në Tiranë.

— Ah!... Si e quajnë babanë?

— Demosten Reuf, — thashë unë.

— Jo, more! I Demostenit qënke? — tha ai.

— Ju e njihni babanë?

— Si ore, s'e njoh! Edhe në luftë në një batalion kemi qënë! Hajde, or Demosten hajde! — u gjallërua plaku.

Unë për një çast vura buzën në gaz. Pastaj u vrejta dhe heshta. I ati i Mirës e njohka babanë! Unë u skuqa. Si gërshetohen e komplikohen gjërat në jetë!

— Hajde, or Demosten, hajde! Një herë, jemi plagosur të dy në një ditë! Na morën e na vunë në një qerre e na shpunë në spitalin partizan. Na shëroi një doktor. Dale, more, si e quanin! E, po! Doktor Vasil Karakuli. Asna doktor! Ku është vallë?

— Nuk e kam dëgjuar në Tiranë, — thashë unë.

— Po si është Demostenl? Unë u mplaka... — tha ai.

— Mirë është. Edhe ai është mplakur, — thashë unë.

— Hajde, or Demosten hajde! Shiko, jepi të fala nga Take Dokoja, nga ai, thuaji, që jini plagosur bashkë dhe që ju shëroi, thuaji, doktor Vasil Karakuli, — tha plaku dhe pastaj heshti, duke ndjekur të bijën.

Unë iu përgjigja se do t'i thosha të fala babait nga Take Dokoja. Fakti se babai paska qenë i plagosur bashkë me Take Dokon, mua më tronditi më tepër se të gjitha të tjerat. Po, po, babai pa ditur gjë i bëri një të keqe atij që ka qenë shtrirë për krah në një spital partizan, atij që ka qenë për krah në një pozicion. Babai e

ku të di ünë I know not what
lláfe gossip
i pashfáqur unshown; unexpressed

plagosi shokun e tij të dikurshëm... Unë u rënqetha. Plaku ecte pas së bijës. Ishte një ditë e ftohtë shkurti.

— Mira, — thashë unë, — ku do të shkoni?

— Babai do të shkojë te një mik i tij i vjetër. Unë po e përcjell, — tha ajo.

— Do të shkoj për hallin e çupës. Do t'i lutem njëherë të ndërhyjë në institut. Çupa nuk ka faj. Ajo është mirë me mësime... Nuk u besoj atyre që dëgjova. Unë jam fanatik, po nuk u besoj... Më thanë ka rënë me ca vajza të këqia e ku të di unë...

— Kush tha kështu! — thirra unë, duke mos e përmbajtur veten.

Plaku, nga kjo thirrje e papritur, qëndroi dhe më vështroi si me frikë. Edhe Mira qëndroi:

— Një shok atje në dekanat. Dale si e kish emrin!

— Shoku Durgut! — tha Mira e menduar dhe e lodhur.

— Hë, shoku Durgut! — shtoi plaku,

— Janë shpifje! — thirra unë me zjarr.

— Vërtet ashtu mendon? E, moj, të thashë unë, se janë llafe? Edhe shokët e tu thonë se janë llafe, — iu kthye plaku së bijës dhe në sytë e tij pashë një shkëlqim të pashfaqur gjer atëhere. Ai tundi ngadalë kokën, buzëqeshi e tha: — Ka llafe, ka!

Fillova ta admiroj këtë njeri me moshë të thyer, këtë njeri që kish një besim aq të madh për vajzën e tij. Unë kujtoja se do të takoja një plak të zemëruar ndaj së bijës, një plak që kish ardhur ta zinte për flokësh e ta merrte me vete në shtëpi, duke u besuar fjalëve të shokut Durgut. Por ndofta ai nuk e bënte veten në sy tim, a ndofta shoku Durgut nuk e kish rënduar fajin e së bijës; i kish thënë thjesht: ka rënë në shoqëri të keqe.

Ne qëndruam te stacioni i autobuzit. Take Dokoja i tha Mirës të kthehej në konvikt, se shkonte vetë gjer te miku i tij. Mira më vështroi mua dhe iu kthye të atit:

— Sonte në hotel do të flesh, apo te miku?

— Nuk besoj të më lerë. Do të fle nga Nasi, — tha plaku dhe hipi në autobuz.

Ne pritëm gjersa u nis autobuzi dhe filluam të ecim në trotuar. Qielli ishte gri, i ftohtë. Frynte erë dëbore.

— I ziu baba! — tha Mira.

— Ç'janë këto që ndodhën kaq shpejt, Mira? — thashë unë, sikur të mos e dija shkakun e këtyre ngjarjeve.

Mira u drodh, sikur ta kish përshkuar një i ftohtë i madh.

frenîm holding back
përpjestîm = përpjesëtîm proportion
ledhatîm caressing
i fshikullûar whipped
shûfër club; heavy stick
andrállë problem; care

— Është e çudítshme dhe e pakuptueshme. Mua më thirri shoku Durgut dhe më tha se qëndkam shthurur. Ai tha se nga shkaku im ti ke marrë tatëpjetën, se unë qëndkam fajtore për frenimin e pregatitjes së një kuadri. Ai tha gjithashtu se unë paskam gjellë ca vajza në institut për ti njohur me djemtë tanë e për të bërë pasdite të shthurura. Për këtë, tha ai, unë duhej të bëj një autokritikë me një fletë-rrufe, ku të them se e njoha gabimin dhe do të heq dorë nga kjo jetë e papëlqyer dhe se do të largohem nga ty... Përndryshe, unë do të përjashtohem nga instituti. Ai lajmëroi edhe babanë. Domosdo babait nuk ia komunikoi të gjitha ato që m'i komunikoi mua. Atij ia solli rrolull... Unë u revoltova. Unë qava, — tha Mira, duke kafshuar buzën e poshtme e duke u bërë gati të qante përsëri.

— Dhe ti do ta shkruash fletë-rrufenë? — pyeta unë.

Mira më vështroi me habi.

— Unë të shkruaj atë lloj fletë-rrufeje që kërkon shoku Durgut? Artur, ç'thua?

Unë e zura për krahu dhe e afrova nga vetja.

— Nuk duhet të shkruash asgjë. Këto janë presione pa asnjë bazë. Unë nuk do ta le këtë shpifje të marrë përpjestime të gjëra në favor të dikujt... Ti mos u shqetëso, Mira! — thashë dhe ia lëmova flokët. Ajo qëndronte e heshtur dhe e kuptoja se ndjente një lehtësi në shpirt pas atij ledhatimi.

Papritur, ajo m'i hodhi sytë e saj të qetë:

— Artur, më vjen turp ta mendoj... por mos vallë është ankuar shoku Demosten për mua? Ë?

Unë lëviza supin e djathtë, i fshikulluar nga shufra e këtyre ijalëve.

— Mos e mendo këtë, Mira. Unë do ta zgjidh vetë, — thashë pa konkretizuar asgjë.

Pastaj, ne ecëm gjatë të heshtur, secili duke menduar më vete. Unë gjer tani kisha vetëm preokupimin tim, vetëm punën e ikjes nga instituti, kurse nga kjo ditë filluan andralla të tjera akoma më të komplikuara. Gjithë këto zunë fill nga përpjekjet e mia për të braktisur institutin. Po, po, babai ngatërroi gjithçka!

Kur filloi të erret, e përcolla Mirën gjer në konvikt dhe u ktheva vetëm në shtëpi...

9.

E gjeta babanë duke lexuar një libër. Ai kish vënë

pështét lean
më = me (mp.)
kíni = kéni
hendek trench; ditch
prédhë mortáje mortar shell
i çíltër clear; forthright
patjétër of course

894

895

syzet dhe ishte shtrirë me pizhame në kanapenë e kuzhinës. Kur hyra, nuk e ngriti kokën nga libri. Njëna më tha se më kish kërkuar përsëri Burhani. Unë nuk fola. U ula në tavolinë pështeta në dorë ballin. Më dhimbte koka.

— Nga ishe? — më pyeti nëna.

— Dola kot nëpër qytet! — thashë unë ftohtë.

Babai nuk bënte zë. Tek e shikoja shtrirë, më erdhi në mënd i ati i Mirës. Ai ka qenë shtrirë me babanë në një spital. E përfytyrova babanë partizan. Ai edhe sot, kur koha është me lagështirë ankohet nga plagët e mbyllura, se i dhembin.

— Ke të fala nga Take Dokoja, — i thashë papritur atij.

Nuk dëgjoi. Atëhere unë e përsërita. Babai ngriti kokën nga libri.

— Take Dokoja? Ë?

— Take Dokoja! — thashë unë;

Babai e la librin dhe ndërroi pozicionin. Ai zgjati këmbët në dysheme dhe filloi të mendojë.

— Take Dokoja? Më duket se e njoh këtë njeri... — tha ai me sytë në murin përballë.

— E takova rastësisht e më tha të fala! Më të kini qenë në spitalin partizan, — thashë unë.

— Oh, po! Jemi plagosur në një ditë. Ishim pranë njëri-tjetrit, në një hendek. Ne qëllonim gjermanët e bëlistët... Papritur, na një predhë mortaje dhe ne u plagosëm. Take Doko! Ka qenë luftëtar i mirë. Trim ka qenë! Ah, po! Ka kaluar një çerek shekulli e ca që atëhere... Trim ka qenë. Pse nuk e ftove të vinte në shtëpi? Të kujtonim ato kohra, — tha babai i menduar dhe fytyra e tij mori një pamje fisnikërie, të çiltër, të mirë...

Unë loja me një faps në tavolinë, i zhytur në mendime.

— Ta kishe ftuar! — tha babai.

Unë ngrita ngadalë kokën dhe e pashë babanë drejt e në sy. Edhe ai më vështroite drejt e në sy. Dukej sikur studionim njëri-tjetrin.

— Ta kisha ftuar? — pyeta pa ia ndarë sytë.

— Patjetër, — tha babai, me një ndjenjë të çiltër.

— Nuk mund ta bëja, baba! Më vinte turp ta ftoja! — thashë unë.

Në faqen e babait, pranë hundës, lëvizi një nerv. Unë e vura re. Pastaj, u ngrit.

— Turp? Ç'janë këto që thua, Artur!

zjepura nonsense
sheshój sweat
tët = tyt your
thíkë më thíkë constantly fighting

896

897

— Turp, baba! Ti e ke plagosur Take Dokon! — thashë unë.

— Ne u plagosëm të dy nga një predhë. Ti flet gjepura! — tha babai.

— Ai është i ati i Mirës...

Babai u skuq. Vuri dorën në flokët për t'i sheshuar, e hoqi dhe fshiu ballin që kish filluar t'i djersijë. Unë e vëreja në heshtje. Ngjyra e kuqe e fytyrës së tij sa vinte e bëhej më e thellë, duke u mbuluar me bula djerse. Pas kësaj, ai u ul ngadalë në kanape. Ngjyra e kuqe e fytyrës i iku dhe filloi të zbehej. Nëna u shqetësua. Ajo nuk dinte asgjë për Mirën. Më hodhi një vështrim mua dhe kafshoi buzën. Në heshtje më qërtoi pse e trondit babanë! Ajo iu afrua ngadalë babait dhe ia vuri dorën në shpatull.

— Demo, shtrihu! — tha ajo dhe m'u kthye mua, — ç'është kjo punë me ty, Artur! Gjithnjë do ta trondi-tësh tët atë. Thikë më thikë me të...

— Ne nuk u zumë, unë fola qetësisht me babanë, — thashë unë.

— Fjala e qetë vret më shumë, — tha nëna.

Babai u ngrit përsëri, pa folur, hapi derën e dhomes së gjumit, që komunikonte me kuzhinën, më hodhi mua një vështrim tërë vojtje, tërë dhimbje dhe ktheu krahët. Nëna, e shqetësuar, e ndoqi pas.

Ora e tavolinës së kuzhinës dëgjohej më qartë se herë të tjera. Unë rrija dhe numëroja me vete tik-taket e saj. Nga dhoma e gjumit vinte zëri i ulët plot trishtim i babait, një zë që i ngjante psherëtimës. Mes asaj psherëtime ndjeheshin «ah-et» e nënës. Ora bisedonte me mua vetëm me dy shënja: tik-tak!

Dritëro Agolli, "Apasionata" Nëndori (Tiranë) XIX, 3 (March), 1972, pp.126-137 (Part 2)

LEXIMI I NENTEDHJETEDYTE

Ismail Kadare "Fatkegëri nga Suzana"
Nëndori (Tiranë) XX, I2 (December), I972, pp. I70-I80

Falkeqësi nga Suzana

Ata po pinin duhan përpara dyqanit të kooperativës kur kaloi Suzana.

— Po vjen Suzi, — tha Lezi, që e pa i pari.

Të tre burrat e prenë bisedën. Lezi thithi fort cigaren dhe u mbështet më mirë tek parvazi.

Suzana u mendua të ecte e qetë, por siç duket, shikimet e tyre e ngacmuan dhe ajo u bë nervoze. Tamam përpara dyqanit, i ra diçka nga dora. Ajo u përkul ta merrte, por nuk e kapi menjëherë dhe u përkul prapë, më shumë. Për një çast të shkurtër, iu duk një pjesë e këmbëve të bardha, midis fundit të çorapeve dhe këmishës së hollë me tantellë. Në atë copë vënd Lezi kish ngulur sytë e tij si i pirë. Po ai qe një çast shumë i shkurtër dhe ajo u largua shpejt me bazën e poshtme të varur nga inati dhe bezdia.

— Ta marrsha — psherëtiu Lezi.

Dy të tjerët qeshën. Lezi thithi cigaren.

— S'është e mundur që kjo femër mos ta lozë bishtin, — tha Lezi. — I a patë tantellën në këmishë?

— E çë, pastaj?

— Gjersa mban këmishë të hollë me tantellë të tillë, do të thotë se e lot bishtin.

— Mbase në atë vëndin nga ka ardhur ajo, kështu i mbajnë këmishët. Andej kooperativat janë të pasura dhe njerëzit të përparuar, jo si tek ne.

— S'është e mundur, — nguli këmbë Lezi. — Një grua që mban këmishë të tillë, me siguri e lot bishtin.

— Eh, or Lez.

— Po çorapet? — tha Lezi. — I patë çorapet ngjyrë tjegullë të errët?

— Mua m'u dukën si çorape të trikotazhit të Korçës.

— Çorapet ishin të Korçës, Lez. Tani të gjitha femrat e qytetit mbajnë të tilla, — tha tjetri.

parváz door or window frame; railing
çoráp stocking; sock
këmíshë slip; shirt
tantéllë lace
bezdí annoyance
loz bíshtin play around; flirt
tjégull tile
trikotázh knitted wear

— Po jo femrat tona, — tha Lezi.

— Po ndoshta në anët e saj kështu i mbajnë, ta thashë një herë.

Lezit i dogji gishtat cigarja. Një copë herë nuk folën. Lezi psherëtiu.

— Thuaj më mirë, or bab, se ajo s'është për ne. Por bishtin, ama, e lot që ç'ke me të — tha ai. — Kushedi, andej nga Tirana apo nga Laçi ka ndonjë dashnor. Me siguri ndonjë shef.

Shokët nuk iu përgjegjën. Ata hapën tjetër biscdë, por Lezit nuk i hiqej nga mendja Suzana. Po binte mbrëmja. Përreth çdo gjë po errësohej. Tantella përmbi këmbën e bardhë i rrinte përpara syve vazhdimisht.

— Dreq o punë, — tha.

Suzana kish ardhur nuse në fshatin e tyre tre muaj më parë. Të gjithë i çuditi nusja e Myfitit. Me siguri, i pari, që u çudit, ishte vetë Myfiti, burri i saj.

Ajo mbahej shumë pastër dhe vishej e krihej me kujdes. Nuse kaq e pastër dhe e kujdesëshme s'ish parë ndonjë herë në këtë fshat. Në fillim, kjo gjë i la pa gojë njerëzit dhe të gjithë e lavdëronin. Po pastaj, tek disa filluan dyshimet. Si shumë po e mbante veten kjo nusja e Myfitit. Kaloi muaji i mjaltit dhe ajo përsëri vishej, lahej dhe krihej njëlloj si në fillim. Gratë thoshnin se ai ia kishte thënë copë dyshimin e tij, por ajo nuk kishte hequr dorë nga e saja. Sigurisht që ishin grindur dhe ndoshta grindeshin akoma.

— Ajo, me sa duket, nuk e do burrin, — tha Lezi. — E tregon hapur.

— Ohu, fillove ti prapë me të. Natën e mirë, — tha njeri prej tyre.

— Natën e mirë, Lez, — tha dhe tjetri.

— Natën e mirë.

Lezi qëndroi një copë herë në vend, pa ditur ç'të bëjë, pastaj zuri të ikte i mërzitur.

Suzi, mendoi ai. Edhe emrin se si e ka ndryshe. Sikur të gërvish një thikë e hollë e të djeg. Suzi!

Lezi ishte njëzet e tetë vjeç, por akoma nuk ishte martuar. Jo se nuk gjente nuse, por nuk kish dashur vetë. Lezi ishte simpatik dhe në fshat e mbanin si donzhuan. Kish patur gjer tani disa historira me femra. Thoshin bile që kish mundur të shtinte në dorë dhe një arsimtare. Ky, siç duket, ishte kulmi i sukseseve të Lezit. Por Lezi nuk kënaqej kollaj. Tani ai e kish mëndjen tek Suzi. Atij i pëlqente Suzi tek s'bëhet. Veç

dashnór, lover
shef chief; leader
Dreq o púnë The devil take it
kreh comb
múaj i mjáltit honeymoon
ia...copë had told her right out
se si e ka ndrýshe is kind of different
simpatík likable
donzhuán Don Juan
shtíe në dórë seduce
kulm high point; zenith
tek s'bëhet to distraction

kësaj, ai nuk e kuptonte dhe trëmbej prej saj. Këto dy gjëra e bënin që ta dëshëronte më shumë. Përveç kësaj, ishte i bindur që ajo nuk e donte burrin dhe që asaj i pëlqente dashuria. Që asaj i pëlqenin dashuritë, këtë gjë e dinte dhe bufi. Megjithatë, Suzana ishte shumë serioze dhe kjo i ngatërronte pak arësyetimet e Lezit. Ajo nuk i shikonte burrat në sy dhe s'kishte qejf të kalonte përpara tyre. Po ahere përse kishte qef të ishte aq e bukur dhe aq e pastër? Për kë? Për Myfitin? Bah.

Kishte dy javë që Lezit nuk i hiqej nga mendja Suzi. Tani nuk i a varte më as punës. Në mbledhjen e brigadës i kishin hequr vrejtjen dy herë. Lezi dëgjonte me vëmendje, por në sytë e tij të vegjël ndriçonte një dritë e sëmurë. Që nga ajo mbrëmje kur ai pa me sytë e tij këmishën me tantellë të Suzanës, u bind se të gjitha fjalët që thuheshin për të ishin të vërteta.

Pa e bërë të gjatë, ai vendosi ta provojë fatin e tij. Lezi ishte i guximshëm. Ai vendosi t'i shkruajë letër. Në qoftë se ajo nuk i a tregon letrën menjëherë Myfitit, burrit të saj, do të thotë se Lezi fitoi. Lezi harxhoi një ditë të tërë për ta bërë atë letër. Atij i dukej se ajo do të qeshte me të gjitha frazat e tij. Përse është një gjë kaq e rëndë letër e dashurisë? thoshte ai me vete. Ai harxhoi një fletore të tërë. Më në fund, letra e tij doli mjaft e shkurtër. Më tepër se letër kjo qe një pusullë: «Suzi, të fle një natë me ty, pa le të humb kokën. Lezi». Në të vërtetë, kjo pusullë shprehte në mënyrën më të përmbledhur të gjitha fijet e ngatërruara të mendimeve të Lezit.

Pusullën i a çoi me një vajzë të vogël dhe priti në rrugë. Ai ndiqte me sy hapat e vogla të vajzës. Vajza kaloi urën e drunjtë, që lidhte rruginën përpara shtëpisë së Myfitit me rrugën kryesore të fshatit, eci me vrap nëpër rrugicën e rrethuar me gardh nga të dy anët, shtyu portën dhe u fut në oborr. Lezit i u duk sikur atje qëndroi mjaft kohë. Pastaj, porta u hap dhe vajza e vogël rendi nëpër rruginë. Këmbët e saj gjëmuan mbi urën e drunjtë dhe ajo vrapoi drejt Lezit.

— E? — i a bëri Lezi.

— I a dhashë atë fletën, — tha vajza duke ju marrë fryma, — dhe teto Suzi tha që ti je budalla.

Lezi u ngrys. Vajza e vogël iku me vrap, duke u hedhur tërë gëzim.

Lezi eci udhës, ndanë plepave, pa menduar asgjë.

buf owl
këtë...búfi everyone knew
ahére then
ia var bother with; take notice of
vréjtje = vëréjtje reprimand
i kíshin hequr vréjtjen had criticized him
pusúllë note
pa lë të humb kokën then let me die
plep poplar

Cigaret i ishin mbaruar. Në kokë kishte një boshllëk. Hodhi paqetën bosh në hendek. Pastaj, pështyu. Ca pula çukitnin me sqep ndanë ndhës. Më tutje, tek sheshi i fshatit kishte ndaluar një «Gaz» shtatë vëndesh. Lezi u afrua.

— Kush ka arrëthur me këtë maqinë? — pyeti shoferin.

— Mysafirë — tha shoferi.

Lezi i nguli sytë targës.

— Ca mysafirë që do t'u sjellin telashe, — tha shoferi dhe tregoi me kokë nga dera e vatrës së kulturës. Atje rrinin në këmbë tri vajza dhe një djalë. Vajzat ishin me pantallona. Në tokë ishin hedhur grumbull çantat e tyre dhe një valixhe e vogël.

— Inspektorë? — pyeti Lezi.

Shoferi qeshi.

— Janë një ekip për prishjen e fejesave të mitura, — tha. — A keni fejesa të mitura në fshatin tuaj.

— Sa të duash, — tha Lezi.

— Ata do të përpiqen t'i prishin, — tha shoferi.

Lezi vështroi në drejtimin e të porsaardhurve.

— E, s'ta mbushin syrin? — e pyeti shoferi.

— Nuk thashë gjë.

Shoferi i zgjati një cigare.

Njëra nga vajzat erdhi duke rendur tek maqina.

— Më duket se më ka rënë krehëri prapa sediles, — tha.

— Prit se e gjejmë, — tha shoferi. Vajza përshëndeti me kokë Lezin. Edhe Lezi e uli kokën, por siç duket, e uli më tepër seç duhet, sepse vajza qeshi.

— Ja këto gocat do t'u nxjerrin telashe fanatikëve, — tha shoferi, duke i rënë vajzës në krahë. — Si të duket kjo punë?

— Për mua le t'i prishin të gjitha fejesat, — tha Lezi. — Unë jam për ema... ema...

— Emancipimin, — tha vajza.

— Unë jam që të prishen të gjitha, — tha Lezi. Ai i tha këto fjalë sinqerisht. Vetëm se i vinte keq që kjo punë nuk u bë, më përpara. I vinte keq që këto ekipe nuk arritën ta ndalonin Myfitin që të merrte Suzanën e bukur.

— Të lumtë, — tha shoferi, — qënke shok i mirë.

— Ju duhet të na ndihmoni në punën tonë, — i tha vajza. — Ne kemi një punë të vështirë, apo jo?

boshllëk emptiness
paqétë pack
hendék ditch
çukít peck
sqep beak
gaz van
shtátë véndesh (=véndesh) seven-place
targë license
vátër e kultúrës cultural center
valíxhe valise
ekíp team

Një copë herë Lezi nuk foli. Ai vështroi vajzën me vëmëndje.

— Unë s'përzihem në këto ngatërresa, — tha papritur.

Shoferi dhe vajza u vështruan në sy. Lezi i përshëndeti dhe u largua.

Në të vërtetë, Lezi e quante veten si një nga luftëtarët e vendosur për emancipimin e gruas. Në mbledhjet, që ishin bërë kohët e fundit për këtë gjë, ai kishte folur shumë herë. Por para dy javësh, atë e fyeu rëndë një plakë dhe ai nuk shkonte më në këto mbledhje. Plaka ishte ngritur fill pas tij dhe kishte thënë të nëndëdhjetëenëntat për të. S'do mend, kish thënë ajo plakë, vagabondët si Lezi këtë presin, të mos e marrë vesh çeni të zonë. Të harbojnë vajzat dhe ata të harbojnë me to. Këta janë si ujku që kërkon mjergull.

Lezi ecte udhës i mërzitur dhe prapë nisi të mendojë për Suzanën.

Kaluan disa ditë dhe nuk ndodhi asgjë. Myfiti e përshëndeste Lezin njëlloj si më parë. Domethënë se ajo nuk i ka treguar, mendonte Lezi gjithë gëzim sa herë që takonte Myfitin. Domethënë se unë pata të drejtë. Sigurisht pata të drejtë. Dhe s'ka se si të ndodhë ndryshe. Përderisa një grua mban të tillë këmishë, do të thotë se ajo grua pranon edhe letra dashurie. Dhe përderisa pranon letra dashurie, pa i treguar burrit për to, do të thotë se pranon të bëjë edhe dashuri.

Lezi ishte tërë qejf. Pa u menduar gjatë, ai i shkroi përsëri Suzanës. Përsëri nuk mori përgjigje prej saj. Dhe çdo gjë shkoi si më parë, me të vetmin ndryshim se, pas asaj dite, Suzana nuk u duk asgjëkundi. Ajo nuk doli në punë dhe nuk erdhi as në mbledhje. Kjo gjë e shqetësoi pak Lezin, por ai u qetësua përsëri kur takoi në rrugë Myfitin. Myfiti u tregua me të i përzemërt. Bile më i përzemërt se zakonisht.

Ato ditë fshati ishte i shqetësuar. Ekipi i prishjes së fejesave shkonte shtëpi më shtëpi. Tani, kur i takonte në rrugë vajzat e ekipit, Lezi ndalonte dhe bënte ndonjë shaka me to.

Ishte e shtunë mbasdite. Lezi doli nga vatra e kulturës, ku shkonte herë pas here të çfletonte revistat. Rrugës pa Myfitin bashkë me të vëllanë hypur mbi mushka.

— Njatjeta, Lezi — i foli Myfiti.

— Njatjeta, — tha Lezi, — për ku kështu?

fejésë e mítur childhood engagement where parents pledge their children to marriage at an early age

sedíle passenger seat

ngatërrésë mix-up; complex matter

fýej offend

— Na ka vdekë një kushuri në Laç. Po shkojmë sonte atje.

Lezi vështroi një copë herë i menduar pluhurin që linin mushkat në udhë. Rruga midis plepave i u duk e bukur dhe njëkohësisht e trishtuar. Ai eci ngadalë nëpër të. Porsa kishin filluar të shkëputeshin nga degët fletët e para.

Nga mbrapa dëgjoi ca hapa të shpeshta, të vogëla. Ktheu kokën.

— Xhaxhi Lezi, na këtë, — i tha një djalë i vogël duke i zgjatur një copë letër të palosur, — ma dha teto Suzana për ty.

Lezit i rrahu zemra ngadalë. E mori letrën dhe zemra i ngadalësoi akoma më shumë të rrahurat. E hapi. «Eja sonte në mesnatë. Burri ikën në Laç. Suzana».

Befas i u duk se e panë. Ktheu kokën. Pranë s'kishte asnjeri. Vetëm plepat e lartë bënin zhurmë me erën.

Mesnatë. Ishte i paaftë të mendonte asgjë. Trurin e kishte si të lodhur. Ç'quhet mesnatë? pyeti veten. Ora 12 ose ora 1. Në fakt është ora 12. Por sidoqoftë mesnatë e vërtetë është ora 1.

Ora 1. Për një sekondë ai përfytyroi në mënyrë kaotike, si pamje të hedhura njera mbi tjetrën, hapjen e portës, hyrjen në errësirë, këmishën e saj me tantella, gjithçka.

E pastër. Ai uli sytë mbi këmishën e tij. Duhet një këmishë tjetër, mendoi dhe u përmend papritur nga apatia. Futi dorën në xhep. Kishte 100 lekë. Dyqani i kooperativës akoma nuk ishte mbyllur. Lezi pothuajse vrapoi.

— Një këmishë burrash, — i tha shitëses.

— Çfarë ngjyrë?

— Të bardhë.

Lezi preku me dorën materialin e butë të këmishës, ndërsa shitësja po i kthente kusurin.

— E grissh me shëndet, — i tha ajo.

— Çfarë? — pyeti papritur Lezi, sikur u zgjua nga gjumi.

— E grissh me shëndet, — përsëriti vajza.

Ai i nguli sytë në mënyrë të pakuptueshme dhe iku pa thënë as faleminderit. Shitësja bëri një gjest me buzë sikur të thoshte «ç'blerës!».

Atë mbrëmje Lezi u vërtit shumë herë rreth e rrotull fshatit. Më vonë, kur u mblodhën një nga një faktet, doli se asaj të shtune mbrëma Lezi ishte takuar

kíshte thënë...për të she had left out nothing in criticizing him

të mos...të zónë to create a confusing situation

harbój play around with

çfletój = shfletój leaf through

hýpur = hípur

njatjéta = tynjatjéta hello; greetings

pothuaj nja dy tri herë me të gjithë kooperativistët. Ai ecte kot udhëve dhe herë pas herë kthente kokën nga shtëpia e veçuar e Myfitit. Shtëpia ishte krejtësisht e heshtur. Porta e jashtme e mbyllur. Oborri me pjergull i shkretë. Në rruginën dhe në urën e vogël prej druri binin fletë të vogla. Prapa asaj ure dhe porte ishte e fshehta e tij.

Lezi nuk hëngri dot darkë. Natën ai u shtri si të gjithë dhe vuri duart nën zverk. Pinte cigare në errësirë dhe nuk mendonte asgjë të qartë. Mendimet e tij ishin copa copa dhe të përgjysmuara.

Afër mesnatës, u ngrit me kujdes. Duke u mbajtur pas murit, u afrua tek vëndi ku ishte varur pushka e vëllait dhe e mori. Porta kërciti lehtë. Jashtë ndriçonte hëna. Ai kontrolloi fishekët dhe e vuri një në gojë të pushkës. Gardhiqet dhe rruginat dukeshin krejt ndryshe nën dritën e hënës së mesnatës. Ca fletë ndanë udhe shndrisnin si të lyera me flori. Tek ura e vogël prej druri ai eci duke përkthyer gjunjët, që të mos dëgjoheshin hapat. Kaloi rruginën dhe qëndroi tek porta. Porta ishte lënë e hapët. I hoqi sigurecën pushkës dhe e shtyu kanatën. Në oborr ishte errësirë nga pjergulla. Ai u afrua tek dera e shtëpisë. Ktheu kokën përreth. Heshtje e plotë. Trokiti fare lehtë. Nga brenda dëgjoi një zë të thellë, më tepër një psherëtimë.

— Ik, ik shpejt, more vesht?

— Ti vetë më ke thirrur, — zëri i vet i u duk krejtësisht i huaj. Në atë çast, diku anash, nga muri, nga errësira gjëmoi një zë burri:

— Ku sikon?

Lezi, po atë sekondë, i shpejtë si një tigër, shtiu në atë drejtim, diku anash, nga muri, nga errësira.

Suzana prapa derës kafshonte duart. Ja, pra fundi i atij ankthi të tmerrshëm. Një britmë. Një krismë pushke. Fill pas krismës një klithmë: «ah, më goditi», Për çudi kjo nuk ishte klithma e Lezit, por e burrit të saj. Siç duket Lezi kishte shtirë i pari.

Në oborr shtinë përsëri. Suzana i bëri gishtat gjak. Ajo mezi qëndronte në këmbë. Kish tri ditë pa gjumë dhe pa ngrënë. Tri ditë rjesht ata ishin përpjekur ta detyronin t'i bënte një pusullë Lezit. Ajo nuk kish pranuar. Myfiti e kish rrahur disa herë. «Po e mbron të dashurin, ë?». Ajo më kot ish përpjekur t'i mbushte mendien të shoqit dhe të kunatit, se për pusullën e dytë të

shkëptuem drop off
apatí apathy
gris wear out
blérës customer; buyer



Lezit, që Myfiti ia kish kapur fëmijës së vogël, tek po e sillte, ajo nuk kishte asnjë faj dhe se pusullën e parë (nga pusulla e dytë kuptohej që Lezi kish shkruar dhe një tjetër më përpara) ajo nuk i a kish treguar burrit, për të mos shkaktuar ndonjë sherr të kotë. Atyre nuk i u qe mbushur mendja dhe fakti që ajo nuk e kish treguar pusullën dhe aq më tepër që nuk kish pranuar ta ftonte Lezin në shtëpi, i kishte shtuar dyshimet e tyre. «Një grua, që nuk tregon pusullën e dashurisë, e ka qejf dashurinë», thërriste nëpër shtëpi Myfiti me të vëllanë e tij, Bajramin. Më në fund, kur as kërcënimet, as rrahja nuk e detyruan dot Suzanën të shkruante pusullën, ata e shkruan vetë, pa i thënë gjë asaj. Por ajo, nga pregatitjet e tyre, kuptoi çdo gjë. Kur pa se ata përhapën fjalë se do të shkonin në Laç dhe nga ana tjetër, zunë pritë natën në oborr, ajo deshi të lajmëronte fshatin. Por ata e morën me të mirë, duke i thënë se nuk do t'i bënin asgjë Lezit, vetëm do ta pështynin dhe do ta shanin, që tregohej i pandershëm dhe nuk respektonte miqësinë.

Suzana e kuptoi që e kishin gënjyer. Në oborr vazhdonin të shtinin. Ajo hapi derën. Dikush shtinte duke ikur sëprapthi. Me siguri Lezi. Flaka e pushkës shndriti dy tri herë në rrugë. Ndërkaq, vjehra ulurinte në oborr:

— Ah, ma goditën Myfitin. Korba, djali.

Tani shtinte vetëm një pushkë diku nga muri, anash, Lezi nuk po shtinte më. Diku larg dëgjoheshin zëra dhe hapa. Suzana vrapoi tek porta. Tek rrugina dhe tek ura e drunjtë ndriçonte hëna.

Më në fund, ajo e pa Lezin. Këmisha e tij e bardhë ndrinte çuditërisht në hënë! Kishte rënë në gjunjë një hap para se të arrinte tek ura dhe po përkulej duke zgjatur duart përpara, sikur po bënte magji. Pushka i kishte rënë në tokë dhe po zgjatej më kot që ta arrinte. Duart e tij fërkonin pluhurin e udhës një pëllëmbë larg saj. Ndërkaq, vëllai i Myfitit, doli nga prita dhe vrapoi në rrugë. Lezi ngriti sytë e ngrirë drejt njeriut që po afrohej dhe thirri më zë të ngjirur:

— Kam thyer gjunjët, mos më vrisni.

Njeriu qëndroi. Ngriti pushkën dhe shtiu.

— Ah, — klithi Lezi dhe koka i ra në pluhur.

Rrugina me gardhiqet anash u anua dhe mbeti pezull, si e varur në erë. Drita e hënës, duke rënë mbi

kot aimlessly
i veçúar vacant
zverk nape
i përgjysmúar half-formed
fishék bullet
shndris = shëndrís glitter
i lýer painted
përkthéj bend; translate
siguréçë safety catch
kanátë wing of a gate or double door
pjérgull grapevine
krísmë yell; scream
rjesht = rresht in succession

fletët, degët dhe gjembat e gardhit, dukej sikur sajonte një tantellë të bardhë.

Duke vdekur, Lezin e shpoi si thikë për të fundit herë mendimi se ajo ishte vërtet një grua «e tillë», por ai s'pati fat.

Ishte ora dy pas mesnate, kur tek ura e vogël prej druri, ku kish rënë në një pozë të panatyrshme Lezi, arriti maqina e poliambulancës dhe një «Gaz» i policisë.

Rreth e rrotull vërtiteshin kooperativistët, burra, gra dhe tek-tuk fëmijë. Sekretari i partisë së fshatit, i dobët dhe me fytyrë të dëshpëruar, u thoshte njerëzve të largoheshin.

Njera nga vajzat e ekipit të prishjes se fejesave, ajo që kishte bërë disa herë shaka me Lezin, dëneste herë pas here. Të tjerat ishin bërë dyllë të verdha dhe qenë mbështjellë pas shokut të tyre. Ato nuk i hiqnin sytë nga trupi i Lezit, i cili, nën dritat e forta të dy maqinave, dukej akoma më i frikshëm me ato duar të zgjatura përpara. Rrotull tij vërtiteshin doktori dhe një polic.

— Skena të tilla, — murmuriti djali i ekipit, — kujt mund t'ia merrte mendja.

— Si ndodhi vallë? A u sqarua? — pyeti njëra nga vajzat.

— Duket si e ngatërruar, — tha djali. — Po do të sqarohet. Kam frikë se kjo ngjarje do të na vështirësojë punën.

— Pse? — pyetën vajzat me zë të dobët, por ai nuk u përgjegj.

Një polic po sillte tek maqina vëllanë e Myfitit. Ai përpiqej të mbahej krenar.

— Ec përpara, — tha polici.

— Mos më shtyj, shoku polic. Unë mbrojta nderin, — tha ai.

Polici e shtyu përsëri.

— Mos shtyj, S'jam reaksionar. Unë jam i partisë. Mbrojta nderin e familjes.

— Ec përpara! — Polici e kapi për brryli dhe e detyroi të ecte përpara.

— Të lumtë, Bajram, — tha dikush nga turma. — Gjynah që e latë gjallë atë bushtrën.

— Ah, ajo bushtra. Ajo bushtra i ka fajet të gjitha,

mbush méndjn become convinced
sëprápthi backwards
dëgjoheshih = dëgjóheshin (mp.)
çuditërísht strangely
në hënë in the moonlight
i ngjírur hoarse
anój tilt
pézull floating
sajój form; devise
shpoj stab; penetrate
fat luck
vërtítem whirl; throw myself into
dënés sob
dyll wax
sqarój clarify
gjynáh too bad
bušshtër bitch

— tha një plakë. — Sikur ta dinim. Që kur erdhi ajo në fshat, solli gjëmën me vete.

— Mjaft, moj shtrigë.

— Kujt i thua shtrigë ti, qen bir qeni.

— Shtrigë.

Një infermiere doli me vrap nga shtëpia e Myfitit. Mori diçka në maqinën e ambulancës dhe vrapoi përsëri drejt shtëpisë.

— Këmisha e bardhë e ka ndihmuar vrasësin ta shënojë më lehtë me pushkë, — po diskutonin dy djem.

— Sigurisht, Shiko si zbardh në hënë.

— Plagën e ka mu në mes të këmishës. E pashë kur e rrotulloi mjeku.

Polici po e shtynte vëllanë e Myfitit drejt «Gazit».

— Pse e shtyni ashtu njeriun, shoku polic, — ndërhyri dikush nga turma. — Ai mbrojti nderin.

Polici i a shtrëngoi brrylin të arrestuarit, qe nuk donte të ecte dhe, duke e shtyrë përpara, e futi me forcë në «Gaz».

— Mbaje kokën lart, Bajram, — thirri përsëri njeriu nga turma.

— O kush na qënka ky!

— Largohuni — thirri polici tjetër, që po bënte matjet, — Mos na pengoni.

— Ikni, — tha sekretari i partisë. — Largoni kalamajtë. Nuk është mirë të shohin.

— Përse ti lejon të sillen kështu me popullin? — tha ai që mbrojti Bajramin. — Ne jemi të partisë.

— Ai nuk është i partisë, — tha sekretari duke tregüar me dorë nga «Gazi». — As ti, që flet kështu.

— Jo, more, U bërë ti të më mësoç mua. Mua që më ka dhënë medalje qeveria, — dhe i ra gjoksit.

— Çfarë do t'i, qytetar? — ndërhyri polici.

— Unë s'jam qytetar, jam fshatar.

— Një lloj është. Çfarë do? Ke ndonjë ankesë për policinë?

— Kam, — tha tjetri duke dalë përpara.

— Bëje zyrtarisht. Dhe tani mos na pengo.

— Ti mos më prek me dorë. Unë, po të dua, largohem vetë. Ti s'më prek dot.

— Po të më pengosh të kryej detyrën, të prek që ç'ke me të.

— Jo, more, u bere ti të më prekesh mua. Ty s'të është tharë qumështi nga buzët. Spurdhjak.

Polici u kthye papritur.

shtrígë witch
infermiére nurse (female)
O kush na qënka ky Who is this guy
kalamá child
mësóç = mësósh
zyrtarísht officially
të prek që ç'ke me të I'll touch you all I need
Ty s'të...nga búzët You're still unweaned
spurdhják brat

— Po fole dhe një fjalë tepër, do të arrestoj.

— S'më çon dot në rajon, se kam derdhur gjakun për këtë pushtet. Jam i partisë unë. More vesh?

— Po policia e kujt është? — tha polici pa e kthyer kokën, dhe nxjerrë nga «Gazi» një mushama. — E kujt është policia? — vazhdoi me zë të qetë, gati indiferent. — E Amerikës?

— Policia të mbrojë nderin e njerëzve jo të...

— Ik, or pirdhu, se na çave veshët, me gjithë nderin tënd, — ndërhyri një djalë.

Tjetri shkumbëzoi nga inati.

— Kujt i flet ti ashtu, or këlysh bushtre?

— Gjithë fajet ajo bushtra i ka, — tha përsëri plaka. — Kjo parti të gjitha mirë i ka bërë, por me këto femrat që i le të hargalisen udhëve me pantallona, s'e ka mirë.

Ajo vështroi me përbuzje vajzat e ekipit.

— U a, e tmerrshme, — u tha shoqeve me zë fare të ulët njera nga vajzat. — E dëgjuat?

— S'kam dëgjuar ndonjëherë të kritikohet kështu partia, — tha djali. — Janë ca gërxho të vjetra që u lejohet çdo gjë. S'e marr vesh këtë punë.

Plaka vazhdonte ti shikonte vajzat me përçmim, pastaj pështyu përdhe.

— Çfarë shtrige, — murmuriti djali.

Ndërkaq, mjeku bashkë me infermieren dhe dy fshatarë sollën të shtrirë në vig, tek maqina e ambulancës, Myfitin e plagosur. Koka e lidhur krejt me fasho, i tundej ngadalë sa djathtas, majtas. Nëna e tij vinte prapa duke shkulur flokët e duke u rënë gjunjëve.

Suzana kishte qëndruar pak më tutje. Ishte krejt e verdhë dhe me sy të ngrirë vështronte gjithçka përreth.

— Ja, ajo, — u tha shoqeve njera nga vajzat e ekipit.

Ato e vështronin si në ethe.

E futën Myfitin në maqinën e ambulancës dhe po aty futën trupin e Lezit të mbështjellë me mushama.

— U bu bu, ditë e zezë, — ia bëri një grua plakë — u vranë, u grinë për një copë femër.

Maqina e ambulancës ndezi dritën e kuqe të urgjencës dhe u nis me shpejtësi në xhadé. «Gazi» i policisë i ra pas.

rajón detention area; zone
e kujt éshtë who does it belong to
mushamá tarpaulin
pjerdh fart
shkumbëzój see the
këlýsh puppy
hargalís amuse
gérxho hag
vig stretcher
fáshë bandage
drítë e kúqe të urgjéncës red emergency light
xhadé road

festój celebrate
rebésh = rrebésh storm
perandorí empire
shkombëtarizím denationalization
zhduk extinguish; make disappear
qëndrésë resistance

LEXIMI I NENTEDHJETETRETE

Sh. Demiraj — K. Prifti: **KONGRESI I MANASTIRIT**

Kongresi i Manastirit — gjashtëdhjetëvjetorin e të cilit po e festojmë këtë vit — është një ngjarje me rëndësi në lëvizjen kombëtare të popullit shqiptar, në luftën e tij për mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare, të gjuhës dhe të shkrimit shqip.

Duke luftuar me një vendosmëri të veçantë kundër të gjitha rebesheve që kaluan mbi tokën e tij gjatë shekujve, duke përballuar përpjekjet e perandorive të ndryshme për ta asimiluar dhe për ta zhdukur — populli shqiptar ka ruajtur veçoritë e veta kombëtare dhe ka shfaqur një dashuri të zjartë për gjuhën dhe kulturën e vet.

Në kushtet e sundimit të pushtonjësve të huaj dhe në mënyrë të veçantë të zgjedhës me të egër dhe barbare të feudalëve turq, që ndiqnin politikën e asimilimit dhe të shkombëtarizimit të shqiptarëve, duke u mohuar atyre kombësinë dhe mësimin e gjuhës amtare, në një kohë kur Patrikana greke e Stambollit dhe qarqet shoviniste të shteteve fqinje synonin të zhduknin emrin dhe gjuhën e shqiptarëve, lufta për kulturën dhe shkrimin shqip merr një rëndësi të veçantë dhe bëhet pjesë e luftës politike dhe të armatosur të popullit shqiptar kundër robërisë osmane, reaksionit klerikal dhe fqinjëve shovinistë, për çlirimin kombëtar.

Me qëndresën e tij heroike, me luftën dhe kryengritjet e shumta fshatare, që mbushën shekujt e historisë së tij, populli shqiptar ruajti

*) Pjesë të një studimi ma të gjerë, që, këtë vit, dual në Tiranë si botim i veçantë.

të gjallë jo vetëm dashurinë e zjartë për lirinë por edhe individualitetin e tij kombëtar, kulturën dhe veçanërisht gjuhën e vet.

Vetë kongresi i Manastirit u bë i mundur në sajë të luftës së masave popullore kundër zgjedhës së huaj, në sajë të përpjekjeve të popullit dhe të patriotëve të rilindjes sonë kombëtare për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe.

Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të gadishullit ballkanik, ashtu sikurse edhe vetë populli shqiptar është një nga popujt më të vjetër të këtij gadishulli. Ashtu si dy gjuhë të tjera indoeuropiane, rumanishtja dhe lituanishtja, gjuha shqipe ka filluar të shkruhet relativisht vonë. Libri i parë shqip, që njohin gjer më sot, është *„Meshari"* i Gjon Buzukut i vitit 1555. Por kjo datë nuk duhet konsideruar si fillimi i shkrimit shqip. Fakte të ndryshme dëshmojnë se shqipja duhet të jetë shkruar që mjaft kohë përpara Buzukut. Këtu nuk është fjala vetëm për tri dokumentet e njohura — *„Formula e pagëzimit"* e Pal Engjëllit, *„Fjalorthi"* i Arnold fon Harfit dhe *„Perikopeja e Ungjillit"*, por për një traditë të vërtetë shkrimi. Për ekzistencën e një tradite të tillë janë shprehur edhe disa dijetarë shqiptarë e të huaj si albanologu austriak Norbert Joki, arbëreshi Gaetano Petrota, Eqrem Çabej, Mahir Domi etj...

Në dritë të fakteve, të zbuluara deri më tani, nuk mund të mos nxirret përfundimi që gjuha shqipe ka qenë shkruar të paktën që nga fundi i shekullit XIII e ndoshta edhe që më përpara.

Sidoqoftë, në krahasim me disa gjuhë të tjera indoevropiane shqipja ka filluar të shkruhet relativisht vonë. Arësyet e kësaj vonese mund të kuptohen lehtë, po tëkihet parasysh fakti që vendi ynë qysh nga koha romake e këtej ka qenë nën sundimin shekullor të pushtuesvet të huaj, të cilët janë përpjekur me të gjitha mjetet për ta asimiluar atë. Në të tilla rrethana stërgjyshërvet tanë u është dashur të qëndrojnë vazhdimisht me shpatë në dorë për të mbrojtur jetën, nderin dhe gjuhën e tyre. Në lidhje me këtë do pasur parasysh edhe roli negativ që kanë luajtur fetë, të cilat i janë imponuar popullit tonë. Këto, siç dihet, janë përdorur nga të huajt për të rrënjosur në popullin tonë ideologjinë dhe kulturën e huaj. Mjafton të kihet parasysh fakti që katolicizmi si gjuhë liturgjike lejonte vetëm latinishten, d.m.th. gjuhën e pushtuesvet romakë, kurse ortodoksizmi si gjuhë liturgjike lejonte vetëm greqishten, d.m.th. gjuhën zyrtare të perandorisë bizantine. Edhe islamizmi, i përhapur në Shqipëri nga

<u>në sájë</u> as a result of; thanks to
<u>perikopéja</u> term pertaining to religion
<u>tëkíhet</u> = <u>të kíhet</u> (mp.)
<u>do pásur parasýsh</u> it must be kept in mind

pushtuesit osmanë, si gjuhë liturgjike pranonte vetëm arabishten, ndërsa si gjuhë e administratës ishte turqishtja.

Pra, arësyet që shqipja ka nisur të shkruhet relativisht vonë në krahasim me disa gjuhë të tjera indoevropiane, duhen kërkuar në rrethanat historike dhe politike, që i kanë penguar të parët tanë të lëvronin që heret gjuhën amtare.

Veprat e para në gjuhën shqipe, që njohim gjer më sot, janë shkrime me karakter fetar e didaskalik. Të tilla janë veprat e Buzukut, Budit, Bogdanit, etj. Këto vepra kanë dalë në një kohë kur kisha katolike, e cila e ka kundërshtuar kurdoherë përdorimin e gjuhës amtare si gjuhë liturgjike, duke u ndodhur përpara rrezikut të përhapjes së islamizmit dhe të idevet të reformacionit, u detyrua të lejonte botimin e kufizuar të disa veprave fetare për mësimin e dogmave fetare në disa gjuhë amtare.

Autorët e këtyre veprave kanë përdorur një alfabet të mbështetur në alfabetin latin dhe të plotësuar edhe me disa shkronja qirilike. Ky alfabet, që e gjejmë të përdorur së pari tek Buzuku, në formën e përpunuar nga autorët e mëpastajmë veriorë u bë tradicionale në shkrimet fetare katolike dhe ka vazhduar të përdoret në Shkodër gjer në vitin 1909, d.m.th. gjer pas Kongresit të Manastirit.

Ndërsa gjatë shekujve XVI—XVII, në bazë të të dhënavet që kemi gjer më sot, gjuha shqipe u shkrua vetëm prej autorësh nga Shqipëria e Veriut (si edhe tek arbëreshët e Italisë), në shekullin XVIII shkrimi i saj u përhap edhe në Shqipëri të Mesme e Jugore, sidomos në Elbasan, Voskopojë, Berat etj., d.m.th. në ato qendra, që gjatë atij shekulli patën një farë zhvillimi të mirë ekonomik e kultural. Autorë të ndryshëm shqiptarë, që kanë jetuar gjatë shekullit XVIII, na kanë lënë vepra të shkruara me alfabete nga më të ndryshmit, gjë që ishte e pashmangshme në kushtet e sundimit të huaj dhe të ndikimit të kulturavet të ndryshme të huaja në Shqipërinë e asaj kohe. Ndërsa Gjon Nikollë Kazazi prej Gjakove botoi në Romë me 1743 një libër të vogël katekizmi me alfabetin tradicional të Veriut me ndonjë ndryshim të vogël, një autor anonim, me origjinë ende të papërcaktuar, që duhet të ketë jetuar në Elbasan, ndoshta, aty nga gjysma e parë e shekullit XVIII, përktheu në gjuhën shqipe disa shkrime fetare duke i shkruar me një alfabet të veçantë prej më se 40 shkronjash. Pas tij Theodhor Haxhifillpi (Dhaskal Todhri) prej Elbasani përktheu gjithashtu disa shkrime fetare duke i shkruar ato me një alfabet tjetër të veçantë prej 52 shkronjash. Kurse voskopojarët Theodhor Kavaljoti dhe Danil Haxhiu, ky i fundit

<u>të párët tánë</u> our ancestors
<u>didaskalík</u> didactic
<u>qirilík</u> cyrillic
<u>i mëpastájmë</u> later
<u>i pashmángshëm</u> unavoidable

propagandues i helenizmit të shqiptarëvet, botuan nga një libër me karakter shkollor, ku pjesët në gjuhën shqipe i shkruan me alfabetin grek. Gjatë po atij shekulli zë fill në qendra të tilla si Berati etj. një letërsi e ndikuar thellë nga ideologjia e fesë islame dhe nga kultura turko-orientale. Është fjala për vjershat e bejtexhiut Nezim Frakulla i Beratit, Hasan Zyko Kamberit prej Kolonje etj., të cilët shkruan vargje me alfabetin arab në një shqipe të mbushur me fjalë të huaja, turke, arabe e persiane.

Lëvrimi i gjuhës shqipe mori një hov të math gjatë shekullit XIX, sidomos gjatë gjysmës së dytë të atij shekulli, kur si rezultat i ndryshimeve ekonomike-shoqërore, i lindjes së elementeve kapitaliste, filloi procesi i formimit të kombit shqiptar edhe i lëvizjes nacionale-borgjeze në Shqipëri. I zhvilluar në kushte shumë të vështira të zgjedhës së egër osmane, të prapambetjes së madhe ekonomike-shoqërore, të sundimit të marrëdhënieve gjysëm feudale dhe të copëtimit administrativ të tokave shqiptare, të politikës asimilonjëse të feudalëve turq që mohonin kombësinë shqiptare, të propagandës dhe të synimeve shoviniste të shteteve fqinje, procesi i formimit të kombit shqiptar bëhet me ritme të ngadalshme. Megjithatë, pavarësisht nga ritmet dhe thellësia e tij, ky proces e çau rrugën e vet dhe bashkë me të filloi të zhvillohej edhe lëvizja kombëtare në Shqipëri.

Në këto rrethana formohen edhe ideologët e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe fillon ajo lëvizje politike, shoqërore dhe kulturale, që e njohim me emrin Rilindja kombëtare. Periudha e Rilindjes karakterizohet nga një ngritje e ndërgjegjes kombëtare dhe e luftës çlirimtare të armatosur të popullit shqiptar kundër zgjedhës osmane, nga formimi i mendimit politik shqiptar, që nga esenca e tij klasore qe nacional-borgjeze dhe që gjeti shprehjen e vet në programin e lëvizjes kombëtare dhe në mënyrë të veçantë në kërkesën e autonomisë së Shqipërisë. Rilindja karakterizohet gjithashtu nga një luftë e ashpër, që bënë iluministët më të përparuar shqiptarë kundër ideologjisë reaksionare dhe klerikale të feudalëve turq dhe shqiptarë për zhvillimin e kulturës kombëtare dhe demokratike, dhe në mënyrë të veçantë nga një zhvillim letrar me frymë patriotike dhe demokratike.

Një vend të posaçëm në epokën dhe veprimtarinë e rilindasve zë lufta për lëvrimin e gjuhës shqipe, për njësimin e shkrimit të saj — gjë kjo që është e lidhur me procesin e formimit të ndërgjegjes kombëtare dhe të unitetit kombëtar.

Në kushtet e sundimit të pushtetit politik të feudalëve turq, kur zgjedha e rëndë ekonomike shoqërohej me politikën e shkombë-

botúam nga një líbër each published a book
hov surge; momentum
copëtím fragmentation
pavarësísht nga apart from
shoqërój accompany

tarizimit dhe të asimilimit më të egër, kur mohohej vetë ekzistenca e kombësisë shqiptare, që zëvëndësohej nga Porta e Lartë dhe Patrikana e Stambollit me ndarjen e popullsisë sipas dallimeve fetare, kur sundonte obskurantizmi i plotë i klerit reaksionar mysliman, ortodoks dhe katolik në fushën e arësimit shumë të kufizuar që jepej në gjuhë të huaj (turqisht, greqisht, italisht) dhe u shërbente të huajve, kur ndalohej me të gjitha mjetet mësimi dhe shkrimi i gjuhës amtare shqipe, lufta për gjuhën dhe shkrimin shqip merr në lëvizjen kombëtare shqiptare një rëndësi të veçantë. Qysh në fillimet e rilindjes shqiptare lufta për shkrimin dhe shkollën shqipe shndërrohet në një pjesë përbërëse të programit politik të rilindasve, të luftës së tyre për autonominë dhe lirinë e popullit, dhe përshkon si një fill i kuq ngjarjet më të rëndësishme të lëvizjes kombëtare shqiptare që nga koha e veprimtarisë së N. Veqilharxhit dhe gjer në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

Në të tilla kushte dolën nga gjiri i popullit tonë një varg atdhetarësh të ndritur, të cilët, të shtytur nga dashuria për atdhenë, iu përveshën punës me vetëmohim për t' ndriçuar popullit të tyrë rrugën drejt lirisë. Midis këtyre një vend të shquar zënë shkrimtarët patriotë Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, vëllëzërit Naim e Sami Frashër', Jani Vretua, Vaso Pasha etj. Këta, duke dashur t'i hapnin sytë popullit shqiptar e ta drejtonin atë në rrugën e përparimit e të qytetërimit, në mënyrë që ta kuptonte më mirë gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej, i dhanë një rëndësi të madhe përhapjes së arësimit e të diturisë në gjuhën amtare. Madje, të mësuarit në gjuhën amtare ata e ngritin si një problem të madh kombëtar.

Një nga çështjet kryesore, që tërhoqën qysh në fillim vëmendjen e patriotëvet të Rilindjes, ishte vendosja e një alfabeti të vetëm e të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Kjo ishte një kërkesë e ngutshme, sepse mungesa e një alfabeti të vetëm për shkrimin e shqipes përbënte një pengesë të madhe për përhapjen e diturisë e të arësimit dhe, si rrjedhim, edhe për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar. Shqetësimi dhe përpjekja e rilindasvet për zgjidhjen e çështjes së alfabetit kuptohen lehtë, po të kihet parasysh se para vitit 1879, kur u botua alfabetarja e Stambollit, janë përdorur një numër relativisht i madh alfabetesh për shkrimin e shqipes.

Nga fundi i dhjetëvjetëshit të shtatë të shekullit të kaluar, kur populli shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit luftonte me armë në dorë kundër zgjedhës turke, fuqive të mëdha dhe fqinjëve

zëvëndësój = zëvendësój replace
dallím distinction; difference
shndërroj convert; change into
varg series; chain
i ngútshëm urgent
rrjedhím consequence
shqetèsím concern
alfabetár book on the alphabet
dhjetëvjétësh decade

shovinistë për të fituar autonominë, e krijuan kushte të favorshme edhe për lëvizje kulturale shqiptare që mori hov. Kështu, më 1879, duke përfituar nga rrethanat e favorshme të kohës, patriotët shqiptarë Sami Frashëri, Jani Vretua, Vaso Pasha, Koto Hoxhi etj. mundën t'ia arrinin qëllimit, duke u marrë vesh për vendosjen e një alfabeti, që do të ishte i përbashkët për të gjithë shqiptarët dhe që ka kaluar në histori me emrin „alfabeti i Stambollit". Arritja e marrëveshjes për këtë alfabet nuk qe një punë e lehtë. Ajo u bë e mundur pas diskutimesh të gjata, nëpërmjet të cilavet u sheshuan diverçjenca të shumta.

Alfabeti i Stambollit me të tridhjetë e gjashtë shkronjat e tij u përgjigjej plotësisht kërkesavet fonetike të shkrimit të shqipes. Por, duke qenë i përzier (shkronja latine, greke e shkronja të posaçme), paraqiste vështirësi për botim librash në shtypshkronja, që s'i kishin të gjitha këto lloje shkronjash. Ky alfabet, megjithë pengesat e intrigat e qeveritarëvet turq e të Patrikanës së Stambollit dhe të veglave të tyre, hoxhallarëvet dhe priftërinjvet, pati një përhapje të mirë në Shqipërinë Jugore e të Mesme, sidomos nëpërmjet libravet të Naimit, Samiut, Vretos etj., që u botuan në shtypshkronjën e shoqërisë „Diturija" të Bukureshtit e më vonë edhe në shtypshkronjën e shoqërisë „Dëshirë" të Sofjes. Ai, pra, luajti një rol të madh në përhapjen e shkrimit shqip ndër shqiptarë brenda dhe jashtë. Shqipërisë. Me këtë alfabet u botuan edhe disa të përkohshme si „Drita" (më vonë „Dituria") e Stambollit (1884—1885), „Drita" e Shahin Kolonjës në Sofje (1901—1908) etj.

Shkollat shqipe, nga njëra anë, dhe librat e të përkohshmet e botuara në kolonitë shqiptare të Bukureshtit e të Sofjes, nga ana tjetër, ndihmuan shumë jo vetëm për zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare, por edhe për përhapjen e alfabetit të Stambollit, i cili, siç u vu në dukje edhe më sipër, me kohë nisi të konsiderohej nga shumë shqiptarë si një alfabet kombëtar. Megjithatë, çështja e një alfabeti të vetëm për shkrimin e shqipes mbeti e pazgjidhur përfundimisht. Dhe as që mund të zgjidhej në një kohë kur pushtuesit osmanë, shovinistët fqinjë, imperialistët e ndryshëm si edhe veglat e tyre, qarqet klerikale dhe feudale vendase, bënin çmos për t'i mbajtur shqiptarët të përçarë.

Siç u vu në dukje edhe më sipër, alfabeti i Stambollit u përhap vetëm në Shqipërinë Jugore e të Mesme si dhe në disa koloni shqiptare të mërgimit, si në ato të Stambollit, Bukureshtit, Sofjes etj. Për-

<u>përfitój</u> iron out; make even
<u>e përkóhshme</u> periodical
<u>i pazgjídhur</u> unresolved
<u>përfundimísht</u> conclusively
<u>véndas</u> native
<u>çmos</u> everything
<u>i përçárë</u> divided

kundrazi, në Shqipërinë e Veriut, me qendër kulturale Shkodrën, ky alfabet nuk u përhap. Priftërinjtë katolikë vazhduan të përdorin alfabetin tradicional të shkrimtarëvet të vjetër veriorë. Pas vitit 1899 çështja e alfabetit u ndërlikua edhe më keq. Në këtë vit u themelua në Shkodër shoqëria „Bashkimi" e françeskanëvet, e cila sajoi një alfabet të ri, të mbështetur në alfabetin latin dhe të plotësuar me disa dyshkronjësha. E pas vitit 1901 numri i alfabetevet, që përdoreshin në Shkodër, u shtua, sepse edhe shoqëria „Agimi", me përfaqësues kryesor Ndre Mjedën, sajoi një alfabet të vetin, të mbështetur gjithashtu në alfabetin latin, por të plotësuar me disa shkronja latine me shenja diakritike. Kështu, në një qytet të vetëm si Shkodra, ku ndesheshin edhe interesat e kundërta të Austro-Hungarisë e të Italisë, midis vjetëvet 1901—1908 për shkrimin e shqipes përdoreshin të paktën 3 alfabete të ndryshëm.

Përveç këtyre 3 alfabetevet dhe alfabetit të Stambollit, para vitit 1908 janë përdorur edhe alfabete të tjerë të mbështetur kryesisht në alfabetin latin. P.sh. e përkohëshmja „Shqipëria" e Bukureshtit (1897—1898), „Albania" e Brukselit (1897—1909), „Kombi" i Bostonit (1906—1909), „Besa" (1904), „Shqipëria" (1906), „Pellazgu" (1907) të Kajros etj. botoheshin vërtet me alfabetin latin, por me ndryshime midis tyre.

Çështja e alfabetit, pra, në fillim të shekullit XX u bë përsëri shumë shqetësuese dhe kërkonte një zgjidhje të shpejtë. Mungesa e një alfabeti të përbashkët ishte një shenjë e qartë dasie, që pengonte bashkimin në një kohë kur shqiptarët kishin nevojë më shumë se kurrë për bashkim, që pengonte edhe zgjimin e përgjithshëm të masavet popullore në një kohë kur këto kishin nevojë më shumë se kurrë për arësim, për dritë.

Nën drejtimin e patriotëve demokratë dhe të klubeve populli shqiptar filloi të realizonte një nga aspiratat e tij shkollore — të drejtën për të shkruar gjuhën e vet dhe për shkollën kombëtare, që ishte një nga kërkesat kryesore të rilindasve. Kështu me inisiativën e klubeve dhe me përkrahjen aktive të masave të popullit në mjaft qytete dhe fshatra të Shqipërisë, menjëherë pas shpalljes së kushtetutës, filluan të hapeshin shkolla shqipe dhe të përhapej mësimi i gjuhës shqipe.

Duke qenë krijesa të vetë popullit, shkollat shqipe u shndëruan në fole të zgjimit dhe të bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Ato ishin jashtë ndikimit të shkollave fetare dhe bashkonin të gjithë fëmijët shqiptarë, myslimanë e të krishterë, dhe kontribuonin kështu

përkundrazi conversely
ndërlikój complicate; intertwine
françeskánë Franciscans
sajój invent; device
dyshkrónjë double letter
dasí division
shpállje promulgation

në asgjësimin e politikës së dasisë fetare, që zbatonin sundonjësit turq.

Mësimi i gjuhës shqipe dhe përhapja e shkrimit dhe e shkollës shqipe u shndëruan në një lëvizje të gjerë patriotike, e cila përfshiu masat e popullit, që çfaqën një dëshirë të zjarrtë për të mësuar gjuhën e vet amtare.

Krahas me shkollat një përhapje të gjerë mori në Shqipëri edhe shtypi; patriotët shqiptarë ngritën pranë klubeve shtypshkronja dhe filluan të botonin gazeta shqipe në Manastir („Bashkimi i Kombit" dhe më vonë „Drita"), në Korçë („Korça" etj.), në Janinë („Zgjimi i Shqipërisë"), si edhe në Elbasan, Shkodër, Stamboll, edhe qytete të tjera. Në vitet 1908—1910 botoheshin në Shqipëri dhe jashtë më shumë se 20 organe shtypi.

Përhapja e shkollave dhe e shkrimit shqip edhe sukseset, që arritën patriotët shqiptarë në luftën për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar, shtruan domosdoshmërinë e vendosjes së një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe. Por për këtë qëllim ishte e domosdoshme të bëhej një luftë e ashpër jo vetëm kundër reaksionit xhonturk, intrigave të fuqive të huaja dhe reaksionit klerikal, por edhe kundër frymës dhe interesave lokale dhe egoiste të disa shoqërive dhe grupeve kulturale. Krijimi i një alfabeti të vetëm do të ndihmonte jo vetëm në lëvrimin e mëtejshëm të gjuhës dhe të letërsisë shqipe, por edhe në konsolidimin e unitetit kombëtar të popullit shqiptar, në bashkimin e tij politik në luftën kundër zgjedhës turke dhe kundër synimeve pushtonjëse të shteteve imperialiste dhe fqinje.

Në korrespondencën me klubin e Manastirit, që mori iniciativën për thirrjen e Kongresit të alfabetit, patriotët shqiptarë shkruanin se „çështja e abecesë është një çështje e madhe dhe na pengon shumë përparimin kombëtar", se „me abecenë unike do t'u jepet një goditje e fortë shkollave dhe intrigave greke në Shqipërinë e Jugut", se alfabeti unik provon se kombi ynë është bërë një si komb", se ai „do të ndihmojë edhe për përparimin e vendit tonë në fushën ekonomike, në industri, tregëti etj."

Iniciativën për thirrjen e kongresit kombëtar për vendosjen e një alfabeti të vetëm, e mori klubi shqiptar „Bashkimi" i Manastirit, që luante rolin kryesor midis klubeve shqiptare. Qysh në ditët e para të shpalljes së kushtetutës patriotët shqiptarë, duke kuptuar rëndësinë e madhe që kishte çështja e alfabetit të vetëm për zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes kombëtare në Shqipëri, e shpallën atë si dety-

abecé ABC; alphabet

rën e tyre imediate. Qysh në muajin gusht të vitit 1908 kryesia e klubit „Bashkimi" të Manastirit u njoftoi gjithë klubeve dhe shoqërive brenda dhe jashtë Shqipërisë propozimin për mbledhjen e kongresit të alfabetit më 14 nëndor të vitit 1908, dhe në shtator u shpërndau atyre ftesa për zgjedhjen e delegatëve, ku theksohej se „interesi kombëtar shtron nevojën e njësimit të alfabetit të gjuhës sonë për përparimin e popullit tonë".

Elementët reformistë si M. Frashëri, A. Ypi, F. Ypi e të tjerë synonin t'i kufizonin punimet e kongresit të Manastirit vetëm në çështjen e alfabetit dhe ta largonin atë nga problemet e tjera politike; ata i mbaheshin pikëpamjes se „duhet përpjekur jo me pushkë e barut, por me pendë". Këto tendenca u kundërshtuan nga patriotët shqiptarë dhe në mënyrë të veçantë nga klubi shqiptar i Shkupit, si dhe nga shqiptarët e Amerikës nëpërmjet Fan Nolit dhe Sotir Pecit, të cilët kërkuan që kongresi i Manastirit të mos merrej vetëm me çështjen e njësimit të alfabetit, por të diskutonte dhe të zgjidhte edhe çështjet e tjera politike, që qëndronin përpara lëvizjes kombëtare shqiptare. Dhe me të vërtetë Kongresi i Manastirit, krahas me njësimin e alfabetit, shtroi edhe çështje të tjera politike të rëndësishme të lidhura me luftën kundër regjimit xhonturk për të drejtat kombëtare të shqiptarëve.

Si rezultat i punës së madhe pregatitore dhe organizative, që zhvilloi klubi i Manastirit edhe klubet e shoqëritë e tjera shqiptare, më 14 nëndor të vitit 1908 u hap në Manastir Kongresi për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe; ai vazhdoi punimet gjer më 22 nëndor. Në Kongres morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 26 qytete dhe shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut. Meqenëse çdo klub ose shoqëri kishte të drejtë të dërgonte në kongres 2 delegatë, 32 delegatët kishin 52 vota (disa prej tyre kishin nga 2 vota). Përveç këtyre, në kongres asistuan gjithashtu edhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote; në këtë mënyrë në kongresin e Manastirit morën pjesë gjithsej 50 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës, si edhe nga shoqëritë shqiptare të Sofjes, të Bukureshtit, të Kostancës, të Amerikës, të Egjyptit, të Italisë etj.

Përbërja shoqërore heterogjene e kongresit të Manastirit dhe, si rrjedhim i saj, mungesa e unitetit programatik dhe organizativ të lëvizjes kombëtare shqiptare ndikuan drejt për së drejti në karak-

gusht August
njoftój notify
shtatór September
zgjédhje selection
barút gunpowder
asistój attend
vilajét province
përbërje composition; make up

terin e vendimeve, që mori kongresi për çështjen e alfabetit si edhe për problemet e tjera politike, që u diskutuan në të.

Ashtu siç pritej, vendin kryesor në punimet e kongresit të Manastirit e zuri çështja e vendosjes së një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Çështja e alfabetit ishte në radhë të parë një çështje politike, sepse mungesa e një alfabeti të përbashkët, ishte një pengesë e madhe për bashkimin e gjithë shqiptarëve pa dallim krahine dhe feje dhe për përparimin e mëtejshëm të kombit.

Duke marrë parasysh kushtet në të cilat u mblodh, si edhe vështirësitë e mëdha, që paraqiste në ato kohë zgjidhja e problemit të një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët, Kongresi i Manastirit konsiderohet si një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së popullit tonë, si një ngjarje që e forcoi dhe e çoi më tej lëvizjen tonë kombëtare në dhjetëvjetëshin e parë të shek. XX. Për të parën herë pas Lidhjes së Prizrenit përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë u mblodhën në një kongres, ku kuvenduan për zgjidhjen e një problemi aq të rëndësishëm, siç ashte ai i alfabetit të përbashkët të gjuhës shqipe.

Mbledhjet e dy ditëvet të para të kongresit, në të cilat qenë të pranishëm përveç delegatëvet edhe shumë shqiptarë të tjerë, u morën me diskutimin e përgjithshëm të problemit. Të gjithë ata që e morën fjalën, vunë në dukje nevojën e ngutshme për t'i gjetur një zgjidhje problemit të alfabetit.

Nga diskutimet e delegatëvet doli e qartë se alfabeti, që do të vendosej, duhej të kishte si bazë alfabetin latin. Mbi bazën e këtij alfabeti ishin formuar të tre alfabetet më të përdorur të kohës — alfabeti i Stambollit, alfabeti i shoqërisë „Bashkimi" dhe ai i shoqërisë „Agimi" të Shkodrës. Në të tilla rrethana askush nuk mund të guxonte të ngrinte zërin e të propozonte që të merrej si bazë alfabeti arab ose grek.

Në mbledhjen që ishte e rezervuar vetëm për delegatët e kongresit, u vendos që të zgjidhej një komision prej 11 vetësh, ku të bënin pjesë përfaqësues të alfabetevet të Stambollit, të „Bashkimit" dhe të „Agimit". Këtij komisioni, që u zgjodh me vota të fshehta, i u dhanë fuqi të plota për të vendosur një alfabet, të cilin të gjithë delegatët e Kongresit u zotuan se do ta pranonin si një alfabet të përbashkët për të gjithë shqiptarët.

Pas shumë diskutimesh komisioni më parë vendosi që të mos merrej në vështrim asnjëri nga të tre alfabetet e lartpërmendur, por të krijohej një alfabet i ri mbi bazën e alfabetit latin duke u dhënë

i pranishëm pledge

shkronjavet latine vlera fonetike në përputhje me nevojat e gjuhës shqipe. Të gjitha shkronjat latine u shqyrtuan me kujdes dhe u pranuan, por duke bërë ndryshime në vlerën fonetike të disa shkronjave.

Por lidhur me shkronjat e nevojshme për ata tinguj të shqipes, që i mungonin latinishtes, (si *dh, gj, ll, nj, sh, th* etj.) komisioni nuk mundi të binte në ujdi. Vetëm për shkronjën, me të cilën do të pasqyrohej tingulli ndërdhëmbor *dh*, diskutimet zunë dy mbledhje të tëra pa arritur ndonjë përfundim të kënaqshëm. Duke marrë parasysh pikëpamjet e përgjithshme të anëtarëvet të komisionit, nuk është vështirë të nxirret përfundimi se në këtë rast mendimet, në vija të përgjithshme, duhet të jenë ndarë dysh. Ata që përfaqësonin alfabetin e Stambollit dhe atë të „Agimit", duhet të kenë ngulur këmbë në parimin që të mos kishte shkronja dyshe (dyshkronjësha), kurse ata që mbronin alfabetin e „Bashkimit" duhet të kenë ngulur këmbë në të kundërtën.

Duke parë se ishte e pamundur që të binin në ujdi për shkronjat e diskutueshme dhe „të shtyrë edhe nga disa shkake të përjashtme", anëtarët e komisionit vendosën që „të kthehen prapa", duke pranuar alfabetin e Stambollit „e me të bashkë edhe një abece fjesht latine që të mësohen e të përdoren bashkërisht në mest të shqyptarëvet".

Kur u shpall ky vendim në mbledhjen e hapur të Kongresit më 20 nëndor para dreke, u tha se alfabeti i Stambollit ishte i mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e kombit, porse që të mund të shtypeshin libra jashtë Shqipërisë si dhe për telegrame jashtë vendit, nevojitej edhe një alfabet tjetër thjesht latin. Pra, arësyeja e adoptimit të një alfabeti të dytë thjesht latin në mbledhjen e hapur të Kongresit u paraqit si një çështje thjesht teknike.

Komisioni vendosi që në alfabetin e Stambollit të bëheshin këto ndryshime:

1) Shkronjat *e* dhe *ε* të këmbëheshin midis tyre, duke përdorur shkronjën greke *ε* për zanoren *ë* dhe shkronjën latine *e* për zanoren *e*, kurse në alfabetin e vitit 1879 ishte e kundërta.

2) Shkronja *p* të përdorej me vlerën e bashkëtingëllores *p*, kurse në alfabetin e vitit 1879 ajo kishte vlerën e bashkëtingëllores rrotullore *rr*.

3) Bashkëtingëllorja rrotullore *rr* të shkruhej, ashtu si në alfabetin e „Bashkimit", me shkronjën e dyzuar *rr*.

shqyrtój examine
ujdí agreement
ndërdhëmbór dental
víjë outline; line
fjesht = thjesht purely
në mest = në mes, among
rrotullór rhotacized

Bashkëtingëllorja afrikate *xh* të shkruhej me gërmën konvencionale x, kurse në alfabetin e vitit 1879 ajo shkruhej y.

Përsa i takon alfabetit thjesht latin, që komisioni vendosi si alfabet të dytë për shkrimin e shqipes, që në fillim është përhapur mendimi se ai në thelb ishte alfabeti i „Bashkimit". Por në vendimin e komisionit ky alfabet nuk cilësohet kështu. Në të vërtetë, ky është një alfabet kompromisi, që i ngjan mjaft alfabetit të „Bashkimit", me të cilin ka të përbashkët sistemin e shkronjave dyshe (dyshkronjëshat); me anë dyshkronjëshash pasqyrohen në alfabetin e dytë të kongresit të Manastirit shumica e atyre tingujve të shqipes, për të cilët nuk kishte shkronja në alfabetin latin (si *dh, gj, nj* etj.). Por ai kishte edhe ndryshime jo të paka prej alfabetit të „Bashkimit". Shkronjat *c, ç, e, ë, gj, nj, q, x, xh, z, zh* në alfabetin e „Bashkimit" paraqiteshin përkatësisht me *ts, ch, é, e, gh, gn, c, z, zh, x, xh*. Do pasur parasysh gjithashtu edhe se në alfabetin thjeshtë latin, që u vendos në kongresin e Manastirit, shkronjat *c, ç, q, z, x* u përdorën me ato vlera fonetike, që kishin në alfabetin e Stambollit, kurse shkronja *ë*, me sa duket, është marrë nga alfabeti, që ka përdorur De Rada pas vitit 1873. Edhe dyshkronjëshin *gj* e ka përdorur De Rada pas vitit 1873, kurse dyshkronjëshin *nj* ai e ka përdorur vetëm përkohësisht.

Në vendimin e komisionit thuhej se të dy alfabetet do të përdoreshin „bashkarisht në mest të shqyptarëvet" dhe shtohej: „Mësimi ndë shkolla do të jetë i shtrënguar e i detyrueshëm për të dyja".

Vendimi i komisionit të alfabetit u shpall në mbledhjen e hapur të Kongresit më 20 nëndor (dita e shtatë e kongresit) para dreke. Vendimi i komisionit u aprovua nga mbledhja me brohoritje.

Në mbledhjen e ditës së fundit të kongresit (22 nëndor) morën pjesë vetëm delegatët, të cilët aprovuan një zëri dy rezoluta.

Ne këtë mënyrë, Kongresi i Manastirit u mbyll me një zgjidhje, e cila, po të kihen parasysh kushtet politike të Shqipërisë në atë kohë, vlerësohet si një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e zgjidhjes përfundimtare të problemit të alfabetit të shqipes.

Por, duke e vështruar me një sy kritik vendimin e Kongresit të Manastirit, nuk mund të mos arrihet në përfundimin se zgjidhja, që ai Kongres i dha problemit të alfabetit, qe një zgjidhje gjysmake, e cila linte shteg për vazhdimin e përçarjes midis shqiptarëvet, sepse ishte e qartë se, me gjithë vendimin për t'i përdorur „bashkarisht" të dy alfabetet, në Shqipërinë Veriore do të përdorej vetëm alfabeti

<u>përkatësísht</u>	respectively
<u>përkohësísht</u>	temporarily
<u>ndë</u> = <u>në</u>	
<u>brohorítje</u>	applause
<u>një zëri</u> = <u>njëzëri</u>	unanimously
<u>gjysmák</u>	incomplete; defective

thjeshtë latin, kurse në Shqipërinë Jugore do të vazhdonte të përdorej kryesisht alfabeti i Stambollit.

Sidoqoftë, atë që nuk e çoi dot gjer në fund Kongresi i Manastirit, e zgjidhi përfundimisht vetë populli shqiptar. Alfabeti i Stambollit, duke qenë laraman, më i vështirë dhe më pak praktik për botime librash etj., me kalimin e kohës filloi të dilte jashtë përdorimit. Kurse alfabeti i dytë, që u vendos në kongresin e Manastirit, duke qenë më homogjen, më i lehtë dhe më praktik për botime librash etj., erdhi e u përhap gjithnjë e më shumë, duke mbetur më në fund alfabeti i vetëm i përbashkët për të gjithë shqiptarët.

laramán variegated

Sh. Demiraj, K. Prifti, "Kongresi i Manastirit", Jeta e re (Prishtinë), XX, 6 (November-December) 1968, pp.1212-1224

LEXIMI I NENTEDHJETEKATERT

Spiro Gjikondi "Pas pesë vjetësh"
Këndori (Tiranë) XVIII, 6 (June)
I97I, pp.2II-223

maturánt graduate
ftésë invitation
i ngarkúar entrusted
i daktilografúar typewritten
si dikúr as before
i dikúrshëm former
i diplomúar graduated; given a diploma

Pas pesë vjetësh

Tregim nga Spiro Gjikondi

Bëhej mbrëmja e takimit të maturantëve që kishin mbaruar para pesë vjetësh. Ftesën ma solli Fitimi dy ditë më parë. Fitimi ishte student dhe takoheshim shpesh me të. Duke më sjellë ftesën, ai më tha se komisioni i krijuar në prag të mbarimit të shkollës, po e kryente detyrën e ngarkuar. Më tha gjithashtu se ftesa të tilla ishin shpërndarë në të katër anët e vendit.

I lexova dhe i rilexova disa herë ato pak rrjeshta të daktilografuara dhe më dukej e pabesueshme. Shokët do të mblidheshin si dikur mbas mbarimit të pushimeve simestrale, apo verore. Por a do të vinin të gjithë, dhe a do të kishin mundësi të vinin? Pesë vjet kishin kaluar dhe me shumicën prej tyre nuk isha takuar. Sa do të kishin ndryshuar... A do ta ruanin për-

sëri atë humorin e dikurshëm, humor që karakterizon një shoqëri tetëmbëdhjetëvjeçare? Pyetje të tilla më rodhën vetvetiu dhe nuk isha në gjendje t'u përgjigjesha. Vetëm për një gjë isha i sigurt: që do të ishte diçka me të vërtetë e bukur.

Po unë a duhej të shkoja? Unë isha përjashtuar nga shkolla në simestrin e dytë të vitit të katërt. Me një fjalë, unë bëja pjesë në të diplomuarit e atij viti. Por shokët e komisionit më kishin dërguar ftesë edhe mua. Pra ata dëshironin që edhe unë të merrja pjesë. Ne kishim kaluar katër vjet bashkë dhe ata nuk kishin se si të mos më dërgonin edhe mua ftesë. Unë kisha shumë dëshirë të shkoja. Shokët do të vinin nga ana e anës. Pa tjetër që do të vinin. Dhe unë kisha shumë dëshirë të takohesha me ta, të çmallesha me ta, të bisedoja me ta, të përqafohesha me ta. Megjithatë, diçka më shtynte që të mos shkoja. Për shumë arësye nuk doja të rikthehesha edhe njëherë në ato vite kaq të shtrenjta për shokët por që mua më sillnin ndërmend shumë gjëra që s'më pëlqenin t'i kujtoja.

Fitimi kish qëndruar në këmbë para meje dhe po më shikonte. Ndoshta edhe ai mendonte diçka në ato çaste. Po ç'mendonte ai? Nuk e di. Unë nuk isha në gjendje të përcaktoja se ç'mendonte. Bile as që më shkoi ndërmend se edhe ai e kish kuptuar që unë nguroja të shkoja.

— Besoj se nuk do të bësh ndonjë budallallëk që të mos vish. — më tha ai me një të qeshur dashamirëse, — do të vijnë të gjithë shokët, shoqet... Do të jetë një mbrëmje e bukur.

Unë nuk mund të vendosja. I thashë se nuk kisha mundësi të shkoja. Dhe ai duhej të më falte për këtë. Bile i kërkova që të më justifikonte përpara shokëve. Por ai këto i quajti marrëzira që nuk kishin vënd se ku të rrinin dhe këmbëngulte e këmbëngulte për të më bindur se nuk do të ish mirë të mungoja. Ai më nxorí dhe një sërë argumentash të tjera: Më tha se u kishte shkruar shokëve që unë do të isha pa tjetër dhe se shokët e kishin pyetur në mënyrë të veçantë për mua... E shumë e shumë arësye të tjera si këto. Pastaj, për të mos më lënë shteg që më vonë të nxirrja ndonjë justifikim, më pyeti me dinakëri:

— Mos do të ikësh gjë me shërbim? Anulloje! Anulloje! Shokët po vijnë nga ana e anës...

çmállem satisfy my longing
marrëzí nonsense; folly
që únë do të ísha that I would be there
shteg loophole
anulloj cancel; annul
nga ána e ánës from all over creation
mbrëmje evening party; evening
prérëse thonjsh nail cutter
vërtís toss

I thashë se nuk kisha asnjë pengesë në këtë drejtim. Porse arësyeja kryesore ishte ajo që unë isha përjashtuar nga shkolla dhe se nuk më vinte mirë që, në një ambjent kaq të gëzuar, të kujtoja dhe një herë gjithçka kish ndodhur me mua këtu e pesë vjet të shkuara. Do të gjeja mënyrën për tu takuar me të gjithë shokët, por në mbrëmje nuk mund të shkoja.

Ai uli kokën dhe po mendohej. E pashë se nuk i erdhi mirë që e refuzoja ftesën. Në vetvete edhe ai më jepte pak të drejtë, por në fund të fundit kjo nuk ishte një arësye kaq e madhe sa të mos më linte të shkoja. Nga xhepi kish nxjerrë një prerëse thonjsh me zinxhir të hollë e të verdhë dhe po e vërtiste nëpër duar. Ndërkohë po mundohej të gjente diçka më bindëse, por, me sa dukej, i kish thënë të gjitha dhe i vinte inat që nuk ja kishte mbërritur qëllimit, megjithëse për të më bindur do të mjaftonte vetëm ajo: «që shokët do të vinin nga ana e anës...»

— Do të vijë edhe Violeta, — tha dhe më nguli për një kohë të gjatë vështrimin e tij hetonjës. Shpresoi më në fund se e kishte gjetur mjetin bindës.

Kur dëgjova emrin e saj, u rënqetha pak, por nuk e dhashë veten. U mundova të ruaja gjakftohtësinë, megjithëse e pata shumë vështirë. Ashtu siç rija, me sytë mbërthyer mbi shkrimin e thjeshtë të ftesës, pa e kuptuar as vetë, m'u përfytyrua ajo skenë e ditëve të fundit të shkurtit kur isha ndarë me të...

... Binte shi. Ecnim mbi trotuarin e djathtë të bulevardit «Dëshmorët e kombit». Ishte po ajo ditë kur më kishin komunikuar përjashtimin nga shkolla. Ajo po më fliste ashpër. Fjalët e saj më dukej sikur po më shponin, sikur më nguleshin si thika në krahëror dhe e ndjeja veten të pafuqishëm për t'u përgjigjur. Atë mbrëmje nuk doja të dëgjoja asgjë. Asgjë. Doja vetëm të mendoja... Të mendoja. Por ajo fliste... Kur e pashë se nuk kish ndërmend të pushonte, ja preva shkurt:

« — Mjaft! Nuk dua më të dëgjoj përralla të tilla. Jam ngopur. Mjaft më!

Ajo heshti një copë herë, pastaj shtoi:

«— Je lagur? — dhe më preku supin e djathtë — Afrohu, po bie shi...»

Ishim të dy nën një ombrellë dhe ajo nuk mund të na mbronte të dyve. E shikova në fytyrë. Sytë e saj shprehnin edhe egërsi, edhe keqardhje. Nuk munda të dalloj se çfarë mbizotëronte në shikimin e atyre syve.

hetónjës inquiring
rënqéthem = rrënqéthem tremble
por nuk e dháshë véten but I didn't let on
rija = rríja
dëshmór martyr
mjaft më no more
mbizotërój dominate

— Ti më do? — e pyeta.

— Po, — më tha — Por jo kështu si je. Dua të bëhesh njeri, a më kupton? Njeri. Unë do të të dua gjithmonë. Vetëm në qoftë se do të vazhdosh të sillesh kështu...

— Prapë fillove? — iu ktheva i revoltuar. — Po qe kështu, ahere lamtumirë... — dhe ika.

— Mirupafshim! — dëgjova zërin e saj tek ecja nëpër shi...

Të nesërmen u largova nga Tirana pa e takuar më. Fillova punën në një fshat të jugut. Mora dy letra prej saj dhe nuk iu përgjigja. Pastaj as ajo nuk më shkroi...

Kishim pesë vjet që ishim ndarë, por unë ruaja për të kujtimet më të bukura dhe dashurinë më të madhe. Dhe se veç asaj as që më kish shkuar në mendje se mund të dashuroja një tjetër sërish. Po ajo...? Nuk e dija. Ndoshta edhe ajo më dashuronte. Por kishim kaluar pesë vjet të ndarë nga njëri tjetri.

Fitimi vazhdonte të më shikonte në heshtje dhe po më priste. Ai u habit kur unë përsëri i thashë se nuk mund të shkoja dhe se shokët duhej të më falnin edhe për këtë.

— Si të duash, — tha duke futur me nervozitet prerësen e thonjve në xhep, — nuk të lutem më. Shokët nuk të falin. As Violeta...

Më uroi «natën e mirë», por pa më dhënë dorën u largua i heshtur prej meje. Më erdhi keq që ja prisha qejfin. Nuk ja prishja kurrë. Me të bisedonim shpesh për gjëra të ndryshme dhe s'më erdhi mirë që ja prisha kësaj radhe... E megjithatë shkova.

Ai më buzëqeshi, më tundi kokën si të më hiqte vërejtjen dhe u ul pranë meje. Mori gotën, e ngriti, e trokiti me timen dhe më uroi suksese.

— Gjithashtu, suksese! — i thashë.

Pastaj qeshëm e biseduam gjatë.

II.

Mbrëmja ishte me të vërtetë e bukur. Kishin ardhur të gjithë. Edhe Zoi me Sofien. Ata ishin martuar. Si u përshëndetën me të gjithë, shkuan e u ulën në anën tjetër të sallës, ku ishte dhe Violeta. Sofia bisedonte me të. Marengleni me Lenien, edhe ata ishin mar-

sërísh again
prish spoil; ruin
nuk ja (=ia) prishja kúrrë I never refused him
çift couple

tuar, u ulën në tavolinën ku isha unë. Ata shkonin shumë si çift. U urova jetë të lumtur. Më parë nuk e dija se ata ishin të martuar. Kur isha në shkollë, nuk dija gjë për marrëdhëniet e tyre intime. Kurse ata dinin gjithçka për marrëdhëniet e mia me Violetën. Por ne nuk u martuam. E dija se fajtor për këtë isha unë. Edhe Marengleni më quante mua fajtor, por nuk më tha asgjë. Bile ai as e hapi një bisedë të tillë. Ne biseduam për këto pesë vjet që kishin kaluar. Ai më tha se kish kaluar në radhët e ushtrisë, se ish bërë aviator, dhe kish filluar të bënte një jetë të këndëshme familjare. Ruante akoma atë humorin e tij të dikurshëm. Në bisedë e sipër, i tha Lenies se nuk duhej të çohej të vallzonte pa i marrë leje atij dhe se ai kish të drejtat që ka një burrë ndaj gruas së vet.

— Bile — i tha ai — dhe sikur të vijë drejtori, ti duhet t'i kërkosh që të më marrë leje mua...

Ne qeshëm me të madhe.

Tashti që po i shkruaj këto radhë, më duket sikur jam përsëri në gjirin e atyre shokëve kaq të dashur, kaq të mirë dhe kaq të sjellshëm.

Unë u takova me të gjithë. Shumë pedagogë ishin larguar nga shkolla e megjithatë në mbrëmje kishin ardhur. Të gjithë kishim dëshirë të uleshim në banga si dikur dhe të dëgjonim edhe njëherë shpjegimin e pedagogëve. Kishim dëshirë të kujtonim çdo gjë, edhe hollësirat më të vogla. Hymë në klasën tonë.

— Ja, — thoshte njëri nga shokët, — këtu ka qenë vendi im. Njëherë, në orën e historisë, këtu kam shkrojtur emrin tim duke gërvishtur me gozhdë. Mbaj mend se profesor Fetahu u inatos me mua atë ditë dhe deshi të më nxirte jashtë. Por nuk më nxori. — Heshti pak, pastaj vazhdoi: — Gabim kam bërë vërtet, por sot do të doja ta gjeja atë bangë. Sikur të ishte këtu ajo bangë...

Pedagogët na përqafonin, i përqafonim. Shumë prej tyre dukeshin më të mplakur. E sidomos Virgjinia. E vura re kur foli përpara nxënësve të saj të dikurshëm. Ajo po shkonte drejt moshës së pensionit. Thinjat ja kishin mbuluar kokën dhe rrudhat i ishin thelluar në fytyrë. Gropat e syve i ishin thelluar gjithashtu. E megjithatë, atë mbrëmje, fytyra i kish marrë një pamje tjetër. Dukej sikur ishte rinuar. Fytyra e saj shprehte gëzim dhe emocion. Ishte një gëzim i brendshëm që dilte e mirte formë konkrete në buzëqeshjen e saj, në sytë e saj. Për atë, siç u shpreh edhe vetë, nuk kish

léjè permission
shpjegím lecture; explanation
hollësí detail
gërvísht scratch
gózhdë large nail; spike
rinúar rejuvenated
beqarí bachelorhood
fik extinguish
përpëlítje twitching; blinking
i parréshtur =i paréshtur continuous
qerpík eyelash
jákë collar
nófkë nickname
matúrë senior year

gëzim më të madh se sa kur shihte nxënësit e saj, dikur të vegjël, tashmë të rritur. Bile, disa prej tyre edhe të martuar. Shumica vërtet vazhdonin t'i qëndronin besnikë beqarisë, por ama të gjithë kishin ndryshuar. Vetëm Baxhuli ishte po ai. I shkurtër, pak i dobët, por shumë energjik. Kjo dukej në lëvizjet e tij të shpejta, të shkathta dhe në shikimin e tij të ndezur që dukej sikur fikej shpeshherë nga një përpëlitje e parreshtur e qerpikëve. Kokën, si atëhere, vazhdonte ta tundte në mënyrë ritmike. Shokët vazhdonin ta thërrisnin si më parë: «Paraqitje, Forma, Ekstravagancë...» ose, «Baxhuli me jakë të gjërë prej diplomati...» Këto nofka i patën mbetur në maturë kur kishte qepur një këmishë me jakë të gjërë, të cilën e hidhte mbi jakën e xhaketës.

— Eee Paraqitje! — i thosh Lavdia Baxhulit, — do të kërcejmë bashkë?

Dhe pastaj të qeshura.

— Aha. Sinan, të paskan rënë flokët!... — i thosh Rizai Sinanit aty nga fundi i sallës. — E hëngre çairin... Tek cepi i sallës ishte mbledhur një grup rreth «Rusishtes» (siç e quanin ahere mësuese Xhuveren) dhe po qeshnin me të. Ajo vazhdonte të fliste si dikur me zë të hollë e të shpejtë.

— A-pa-pa-pa. Tru derr a tru derr... Goxha burrë, s'ke turp! Merr zilen me vete në klasë dhe i bie në mes të orës së mësimit. Ngreu këtu dhe më thuaj raskazin... — Pa mbaruar mirë këto fjalë, grupi shpërtheu në të qeshura. Ishte një e qeshur e madhe që mbushi gjithë sallën. Edhe të tjerët e kishin dëgjuar zërin e saj të hollë e të mprehtë, dhe të gjithëve iu kujtua ajo ditë kur Halili, që ishte dezhurn në koridor, kishte marrë me vetë zilen në klasë. Në një çast zhurme ai i kish rënë asaj sikur të ishte një kryetar gjyqi që kërkon të vendosë qetësinë gjatë një seance të potershme.

Mësues Alekua kishte ardhur në tavolinën pranë dhe po bisedonte me një grup tjetër. Megjithëse disi i kaluar në moshë ai ruante pamjen e mëparëshme. Fjala e tij ishte shumë e ngrohtë, shumë e çiltër dhe shumë e dashur. I përqafonte nxënësit e tij të dikurshëm dhe nuk gjente dot fjalë që të shprehte gëzimin që e kish pushtuar atë mbrëmje. Vetëm buzëqeshte me përzemërsi. Kish mall dhe po çmallesh me ta. Në tavolina të tjera zhvilloheshin biseda të ndryshme. Dikush kish nxjerrë «albumin» e fotografive dhe po ua tregonte shokëve.

E hëngre çairin You're past your prime
tru derr pig brain
góxha búrrë quite a man
raskáz story
dezhúrn on duty
gjyq court
seáncë session
i potérshëm rowdy
disí somewhat
krédhem dive
fjálën e móri orkéstra the orchestra took over
çthúrje = shthúrje dissipation; deviation
kur më thýen nótën në sjéllje when I got a failing grade in conduct

Kujtimet nuk kishin të mbaruar.

Të gjithë ishin kredhur në jetën plot variacione të atyre viteve të bukur të shkollës së mesme. Dhe, të gjithë ishin të gëzuar, të qeshur të lumtur.

Pastaj, fjalën e mori orkestra..

III.

Edhe unë po kujtoja diçka. Të tjerët ishin ngritur dhe po kërcenin. Ndërsa unë jo. Mendoja e kujtoja. Por kujtimet e mia nuk ishin si ato të shokëve. Kujtoja çthurjet e mija dhe i gjykoja ato. Më kujtohej ajo ditë kur më thyen notën në sjellje, dita kur isha grindur me drejtorin, dita kur më përjashtuan nga shkolla... Sa të dhimbshme ishin për mua ato çaste... Ç'kontrast me gjithë atë gëzim të përgjithshëm. Dalngadalë kisha hyrë plotësisht në ato vite të shkuara dhe kisha humbur në një botë tjetër. Nuk e kisha vënë re as Pavllon që kishte ardhur dhe ishte ulur pranë meje.

— Ç'ke? — më tha ai, — pse rri kështu? Mos nuk je i kënaqur?

Fliste lehtë, me zë të ngrohtë, sikur të donte të mos ma këpuste fillin e mendimeve. E kuptova se kisha rënë në sy me qëndrimin tim të heshtur e indiferent dhe nuk më erdhi mirë. Shokët nuk donin që unë të rrija i mënjanuar. Ngrita kokën dhe i buzëqesha:

— Asgjë, asgjë... — i thashë. Por e kuptova se kjo «asgjë» ishte k[illegible] pa kuptim, për të sa edhe për mua. Në atë «asgjë» kis[illegible] k[illegible]q shumë gjëra, sa ai nuk mund t'i imagjinonte, por te paktën shkakun pse rrija ashtu duhej ta kishte kuptuar. Ndoshta do të ishte më mirë të mos më kishte ardhur pranë, të mos më kishte pyetur. Por ja, ai ishte aty. E kishte pikasur gjendjen time, brengën time dhe më qëndronte pranë. Ai më ngulì gjatë shikimin e tij të ngrohtë, dhe dukej sikur diçka donte të lexonte në fytyrën time, në sytë e mi.

— Ti diçka ke... — shtoi pas pak ai. — Diçka të mundon.

Heshti edhe unë heshta. Orkestra kishte nisur një melodi ritmike. Çiftet në sallë vallzonin dhe bisedonin. Të gjithë ishin të gëzuar, të qeshur, të lumtur. Më pëlqenin të gjithë. Të gjithë i doja. Me ndonjërin edhe isha grindur. E megjithatë e doja. Me të gjithë

pa kuptím meaningless; incomprehensible
pikás guess; notice
bréngë pain
mundój cause to suffer; torture
me ndonjérin with this or that one
qejflí aficionado; fan
vallzím dancing

ERIC 03

doja të vallzoja, të bisedoja, t'u tregoja atyre gjithçka për veten time. Dhe kisha shumë për t'u thënë. Por...

— Pse nuk kërcen? — më pyeti Pavllua sikur ta kish kuptuar se ç'mendoja në atë çast. — Ti ke qenë qejfli për të kërcyer, apo nuk është kështu?...

— S'mundem, — i thashë, — do të kërcej më vonë.

— Pse?

— Nuk e di. Kam diçka të rëndë në gjoks. Ndjej diçka që nuk e kam ndjerë kurrë në jetën time. Diçka që më mundon. Ndoshta do të ishte më mirë të mos kisha ardhur në këtë mbrëmje. Pothuaj se kisha filluar ta harroja. Por nuk munda. Këtu më duket sikur jam po ai që isha para pesë vjetësh. Vetëm me një ndryshim, nuk po tregohem aktiv në vallzime.

— Harroi ato! Çdo gjë ka kaluar.

— Po, ka kaluar, por mua më duket sikur çdo gjë ka ndodhur dje, sikur ka ndodhur sot, ja në këto çaste. Të gjitha po më kthjellohen në mendjen time dhe unë sikur jam po ai i pari. Por unë nuk dua të jem ai i pari.

— Po ti nuk je më ai.

— E di.

— Shokët flasin mirë për ty.

Vetëm heshta. Sikur u lehtësova një çikë. Megjithëse e mendoja që shokët nuk mund të flisnin keq për mua. Jo pse kishin harruar gjithçka, por sepse e dinin që unë nuk isha më ai i pari.

— Dhe jo vetëm shokët, — vazhdoi Pavllua më me zjarr kur vuri re se fjala e tij nuk kish shkuar kot. — Për ty flasin mirë dhe pedagogët. Pra, pse brengosesh kot?

— Pse brengosem?... Por me këta shokë mua më lidh diçka tjetër. Me këta më lidh një pjesë e së kaluarës sime. Ajo pjesë e së kaluarës, të cilën unë vetë nuk dua ta kujtoj. Për ata unë kam qenë objekt i mbledhjeve. U kam shkaktuar kaq shqetësime. Kam qenë objekt i bisedave të tyre. Për ata unë kam qenë i padëshiruar. Unë u përjashtova nga shkolla. Kam qenë person i pavlefshëm...

— Jo i pa dëshiruar dhe i pavlefshëm, por njeri që kishte nevojë akoma për t'u edukuar... — më ndërpreu Pavllua.

— Ta zemë se është ashtu... — i thashë.

— Jo ta zemë...

— Mirë atëhere... Por pamvarësisht nga kjo. Unë u përjashtova. — Heshta pak pastaj shtova me zë më të ulët: — Ja se çfarë më mundon. Kjo më ka mun-

i padëshirúar undersirable
i pavléfshëm unworthy
ta zémë let's say
jo ta zémë let's not just say it
front challenge; front

duar gjithë kohën. Që kur u përjashtova, i vura gishtin kokës dhe e kritikova ashpër veten. Në këto pesë vjet kam punuar kaq tepër sa ti nuk mund ta marrësh me mend. Nuk i druhesha frontit të vështirë, kudo që të ishte. Natën lexoja. Sa net kam ndenjur pa gjumë... kam bërë luftë të ashpër me veten. Kam sakrifikuar gjithçka, edhe shëndetin. Dhe përse të gjitha këto? Sepse doja që të mos përjashtohem për herë të dytë. Përjashtimi i dytë do të ishte më i keq se i pari... Dhe kam punuar. Kam punuar që njerëzit të mos më çërbuznin, që njerëzit të mos rrudhnin buzët kur të kalonin pranë meje...

— Përkundrazi...

— Çfarë?

— Ata flasin mirë për ty.

— Po. Është e vërtetë. Dhe për këtë jam i lumtur. Tashmë çdo gjë i përket së kaluarës. Kam turp ta kthej kokën mbrapa. Duke kthyer kokën mbrapa, shoh atë që e përbuz. Njeriu në jetë, duhet të veprojë në atë mënyrë, që kur të kthejë kokën mbrapa, të shohë atje diçka të bukur, diçka për të cilën të krenohet, diçka për të cilën njerëzit ta kujtojnë gjithnjë më mirë, pamvarësisht se në ç'lëmë punon... Unë nuk e kam bërë këtë, por do ta bëj. E di se nuk është vonë... Më fal, ndofta të fola gjatë e u rrëmbeva pak.

— Jo, jo. Përkundrazi...

— Këtu të gjithë kujtojnë vitet e shkollës dhe unë s'kisha se si të mos i kujtoja ato. Ja pse sot jam pak i brengosur...

U bë një heshtje e shkurtër.

Një grup nga cepi i sallës ku ishte Xhemali, Flutura, Lavdia e disa të tjerë ja kishin marrë një kënge popullore nga ato të Skraparit, nën drejtimin e Nevruzit. Pastaj, nisën një pogonishte. Në krye ishte Lavdia. Megjithë trupin e saj të shkurtër e të rumbullakët ajo kërcente me shkathtësi. Xhemalit i merreshin pak këmbët, se kishte pirë pak si tepër, por megjithatë nuk kish rrezik të rrëzohej, se e mbante për dore Flutura. Ata i erdhën një herë sallës rreth e rrotull dhe, kur po i afroheshin tavolinës sonë, Pavllua më kapi për krahu dhe më tha:

— Hajde të futemi edhe ne në valle!

Unë nuk desha. Kisha qejf të rrija më tepër si spektator, por nuk munda. Ai më tërhoqi.

Dhe unë u ngrita.

unë...ató I did likewise
pogonishte Albanian folk dance
i rumbullákët rotund
íshim = íshin (mp.)

IV.

Ndjeva një goditje me brryl nga krahu i djathtë. Po më godiste Pavllua. Ktheva kokën. Violeta kishte qëndruar para meje dhe po më ftonte të kërcenim. Për një çast, e ndjeva se gjithë sa ishin në sallë kishin kthyer kokën nga unë dhe po më shikonin. Më erdhi kaq papritur sa nuk munda ta mblidhja dot veten. Shikimet e shokëve më dukej sikur po më shponin. Gjithë gjaku më kërceu në fytyrë.

Nuk mund ta shpjegoj se si u ngrita nga vendi dhe shkova drejt saj. Preka dorën e saj dhe ndjeva një të rënqethur tjetër në të gjithë trupin, sikur të më kishin hedhur diçka të ftohtë në shpinë. Nuk isha në gjendje të dalloja mirë ritmin. Instinktivisht hyra në radhën e çifteve që po vallzonin. Isha në mes të tyre. Pashë fytyrat e tyre. Ato po më buzëqeshnin me përzemërsi. Violeta më kishte mbërthyer vështrimin dhe po vallzonte lehtë. Unë kisha ulur kokën.

— Ke harruar të kërcesh... — më tha.

Ky zë më shkundi. Ishte po ai zëri i saj i dikurshëm. Pothuaj nuk kish ndryshuar fare. Po këtë zë e kisha dëgjuar para pesë vjetësh, kur vallzuam për herë të parë. Ahere më pat thënë:

— Pse e ngatërron ritmin...

Mos vallë ajo nuk kishte folur dhe mua më bëhej sikur e dëgjoja? Mos vallë unë isha zhytur plotësisht në të kaluarën? Kjo më pëlqente dhe nuk më pëlqente. Mos isha bërë po ai tetëmbëdhjetëvjeçari i dikurshëm? Këtë e dëshiroja dhe nuk e dëshiroja. Me atë moshë më lidhnin mjaft kujtime të hidhura, por edhe mjaft kujtime të ëmbla. Ishin kujtimet e çthurjeve të mia dhe kujtimet e dashurisë sime të parë. Ky zë po më sillte parasysh po ato ngjarje. Vazhdova të heshtja dhe u përpoqa që të mos e ngatërroj më ritmin. U qetësova. Pastaj e shikova drejt në sy. Ishte po ai vështrim, por më i thellë. Po ai shkëlqimi i syve, po ata qerpikë. Asgjë nuk kishte ndryshuar. Vitet kishin kaluar tek ajo pa lënë asnjë gjurmë të thellë. Tek unë po. Flokët më kishin rënë pak dhe aty këtu gjeje ndonjë thinjë. Thinja të parakohëshme. Nuk isha zgjatur, isha dobësuar pak.

— Nuk ke ndërmend të flasësh? — më shkundi ajo.

— Ç'të them... — iu përgjigja.

— Ndonjë gjë për veten, — më tha.

i parakohëshëm = i parakóhshëm premature
kam ndërmend intend
sivjét this year

ERIC

— Kam folur shumë për veten. Nuk dua më të të përsëris ato që kam thënë.

— Ke folur atëhere, por jo tashti...

Vërtet. Unë s'kisha thënë asgjë për veten time.

— Mos bëra gabim që erdha të mora? — më pyeti pas pak. — Edhe shoqet më shtynë ta bëj një gjë të tillë.

— Pse, ti nuk kishe aq forca sa të vije vetë?

— Unë do të kisha ardhur edhe pa më thënë ato.

— Ashtu?

— Po. — Heshti pak, pastaj shtoi: — kam pesë vjet që e pres këtë mbrëmje. Kur u ndamë në maturë, e lamë me gjithë shokët të takoheshim sivjet...

Heshta.

Muzika vazhdonte

Kitaristi ishte gjallëruar. E kish lënë tangon e mëparëshme dhe kish kapur një ritëm të gëzuar. Nuk e kisha vënë re më parë që Enveri zëvendësonte në atë çast fizarmoniçistin dhe po i binte fizarmonikës. Ai kërcim zgjati shumë. Ndoshta Enveri me qëllim e zgjati tepër. Dhe unë doja që ai kërcim të mos mbaronte kurrë. Doja të flisja, por nuk dija se çfarë të thoshja.

Vetëm vallzonim.

V.

Të gjithë kishin kthyer disa gota dhe kishin ardhur në qejf. Fuqinë e kishte kapelja. Ajo kalonte sa në një kokë në tjetrën dhe bashkë me të ndëroheshin dhe vallzuesit.

Unë nuk po kërceja. Dialogu që zhvillova me Violetën, e sidomos fjalët e fundit të saj më kishin futur përsëri në mendime. Unë e kisha dashur atë me gjithë shpirt. Dhe vazhdoja ta doja akoma.

— Do të të lexoj diçka të bukur, — më tha Fitimi që po vinte drejt tavolinës sime, — do të më gjesh kush dhe kur e ka thënë. Për këtë ke pesë pikë. Ose jo. Më mirë do të sjellë këtu shoqen që preferon për të kërcyer.

— Më mirë pesë pikët, — i thashë.

— Ahere dëgjo: «Vinçi i komshies lakrat mi qëroi,
Macja e komshies qumshtin gllabëroi,
Zemra e komshies timen e pushtoi».

— Ta përsëris? — më tha mbasi mbaroi vargjet dhe hodhi sytë nga cepi ku ishte Violeta.

fizarmoniçíst accordionist
me qëllím on purpose
kapéllë hat
vinç crane; derrick
komshí neighbor
lákër cabbage
qërój clean out; make off with; peel
máce cat
gllabërój swallow up
tímen e pushtói has grabbed mine
lulíshte flower bed

— Jo, jo — i thashë, — s'është nevoja. Autori është Halili. Po se ku dhe se kur nuk më kujtohet.

— I humbe të pesë pikët. Vërtet e ka thënë Halili, po vendin nuk e gjete. Po të jap vetëm dy pikë e gjysëm, d.mth. do të kthejmë nga dy gota e gjysëm.

— Nuk mundem, — i thashë. — Më dhemb koka. Kam pirë shumë.

Nga situata më shpëtoi Lavdia, që erdhi e i propozoi për të vallzuar.

Dhe me të vërtetë kisha pirë më tepër nga ç'pija ndonjëherë tjetër e kjo më kish dëmtuar pak. Ndjeja një farë lodhjeje në trup e më merreshin pak mendtë. Kisha nevojë të qetësohesha. Kisha nevojë për ajër të pastër. Dhe ndërsa çiftet vinin rrotull nëpër sallë, u ngrita pa u vënë re dhe dola në obor. Frynte një erë e ftohtë nëndori. Ishte vonë.

Me jakën e xhaketës të ngritur, fillova të shëtis në rrugën përmes lulishtes. Dhe kjo rrugë për mua ishte shumë e shtrenjtë. Çdo gur i saj, çdo parmak përreth, rrapi madhështor përpara shkollës, kalldrëmi, pemët,... ishin të lidhura me mua. Gjithçka, gjithçka që më rrethonte ishte e lidhur me një fragment të jetës sime.

Më tej ishte stoli. Atje uleshim shpesh me Violetën. Bisedonim. Mbi të kishin rënë ca gjethe të zverdhura të rrapit të madh. Nuk më erdhi mirë që vëndin tonë të dikurshëm e patën zënë këto gjethe të zverdhura e pak të lagura nga vesa e natës. U përkula dhe i fshiva. Ato ranë përtokë. Stoli ishte përsëri si dikur — i pastër. Por bosh. Vetëm era fryente mbi të. Doja të ulesha, por nuk munda. Ai ishte i madh për një njeri. Ndeza një cigare.

Në atë çast ndjeva se dikush po vinte mbas meje. Hapat ishin të lehta, por në qetësinë e natës mund të dëgjohej edhe fëshfërima më e lehtë.

Ishte Violeta. Ajo, ndoshta e vetmja, e kishte vënë re që unë kisha dalë. M'u afrua dhe qëndroi në këmbë para meje.

— Pse dole nga mbrëmja? — më pyeti.

— Për t'u qetësuar, — i thashë. — Nuk e ndjej veten mirë. Më dhemb pak koka. — Ajo kish shumë dëshirë të ulej, por nuk u ul. Shikoi nga unë dhe heshti për një kohë të gjatë.

— Xhoxhi... — e theu më në fund heshtjen. — Këtë mbrëmje e kam pritur shumë. Ditët më dukeshin shumë të gjata. E megjithatë ato kalonin. Unë prisja. Prisja... Fitimi më tha se ti nuk kishe dashur të i-je...

rrap sycamore
kalldrëm cobblestone walk
stol low stool

Ajo uli kokën.

— Është e vërtetë? — më pyeti pastaj.

— Po, — i thashë. — Nuk desha të vij. Unë nuk kam qenë maturant me ju. Unë u përjashtova.

— Ne kemi kaluar katër vjet bashkë, — më tha.

— Po unë nuk isha...

— Ti përsëri je me ne, — ma ktheu. — Por, në fund të fundit, kjo nuk ka rëndësi. Unë të kam pritur. Kam pritur këtë mbrëmje.

Unë heshta. Shumë gjëra mendoja në ato çaste. Shumë gjëra doja të thoshja. Por frazat më coptoheshin. Fjalët më këputeshin. Mendimet më ngatërroheshin.

— Edhe mua...?! — murmurita nëpër dhëmbë.

Ishte e vetmja fjalë që munda të shqiptoj.

— Po, — vazhdoi ajo. — E dija se një ditë do të ndodheshim përsëri pranë stolit të dikurshëm.

— Po ky njeri, të cilin e ke pritur, mund të jetë po ai i pari, po ai që ishte para pesë vjetësh.

— Nuk është e vërtetë.

Unë nuk e dija se Fitimi kish korespondencë me Violetën, megjithëse ai më kish folur shpesh për të.

Kisha ulur kokën

— Hajde të futemi në mbrëmje, — më tha.

Unë s'fola.

— Kur të mbarojë mbrëmja, do të më presësh të ikim së bashku?

E shikova drejt në sy. Përmes degëve, nga llamba elektrike që ishte varur në një shtyllë pak më tej, depërtonin një tufë rrezesh dhe i ndriçonin fytyrën. Sytë e saj shkëlqenin.

— Ti e bën këtë kërkesë? — e pyeta pa ja ndarë vështrimin.

— Njëri duhet ta bëjë... — tha ajo dhe qeshi.

Nga salla e mbrëmjes dëgjoheshin tingujt e kitarës elektrike dhe të fizarmonikës. Fizarmonikës i binte Enveri. E kuptova nga përdorimi i baseve. Kish diçka karakteristike në qëndrimin e tyre. Orkestra luante melodinë orkestrale «Dashuria». Ish një nga meloditë që më pëlqenin tepër. Ne shkonim drejt sallës dhe tingujt bëheshin përherë më të afërt. Ajo ecte përkrah meje dhe nuk fliste. As unë nuk i flisja. Isha me të vërtetë i lumtur dhe i çliruar nga një barrë e rëndë, që më kishte munduar për shumë kohë. Edhe ajo ishte e lumtur.

llámba = llámpa the lamp

LEXIMI I NENTEDHJETEPESTE

DIELL NE QIELLIN E THELLE...

Tregim

Mosha po i rendte, kurse ai qe akoma beqar. Unë e kisha hok të vjetër e të mirë dhe këtë gjendje nuk e kuptoja dhe s e pranoja dot. Nuk e dija përse kishte ndodhur kështu. Më bëhej se kjo ngjiste për shkak të disa rastësive pa ngjyrë që kishin rënë në ditët e tij të shkuara si një shi dimri. Por sa e vështirë është të kërkosh më pas pellgjet ç ketij shiu!...

Kështu, mua më mbetej një dhëmbshuri e përhershme për ë, po kjo ndjenjë ishte e fshehtë dhe e pathënë kurrë, përndryshe ajo do ta fyente, sepse ai qe njeri krenar dhe nganjëherë bile, me këtë ndjenjë e kapërcente kufirin e thjeshtësë. Po kishte një farë arsye të mbahej krenar, se në qytetin Kh. atë e mbanin për mjekun patolog më të mirë. Në përgjithësi, ai qe njeri energjik, i vendimeve të shpejta po të mënura në çdo pikë tjetër, përveç kësaj që thamë. Këtë pavendosmëri më duhej ta pranoja ashtu si shfaqej, duke arsyeuar se kali i mirë e ka kurdoherë një huq. Përderi sa përvoja njerëzore, e pambledhur në urtësinë e asaj thënies se, as të tridhjetave, martesa bëhet prak i zorshëm për t'u kapërcyer, e përligjte këtë gjendje, ngurrimin e tij fillova ta gjej dhe unë si të natyrshëm. Nga ana tjetër, këtu nuk dëshiroj ë hyj e të zgjidh lëmshin e ngatërruar të ndjenjave të tij. Nuk mundohesha ta bëja këtë gjë as tërthorazi, duke menduar se njeriu është shumë i prekshëm kur i troket dikush në disa lyer të shpirtit që hapen vetëm për veten.

rastësí chance happening
pellg puddle
dhëmbshurí = dhembshurí compassion
kufí limit
mjek patológ pathologist
pavendosmërí vacillation
hug vice; band habit
përdéri sa = përderisá as long as
i zórshëm difficult
tërthórazi indirectly
i prékshëm touchy

ERIC

Deri atë ditë kur ndodhi kjo ngjarje, unë besoja se në jetën e tij nuk kishte pasur asnjë lidhje serioze me ndonjë vajzë. Kjo qe për të ardhur keq dhe ngjante si e paqesueshme, sepse profesioni i mjekut është i tillë që vetvetiu e ve njeriun midis shumë rastesh e njohjesh. Po për hir të së vërtetës, duhet të tregoj kalimthi se ai kishte një shoqëri të vjetër e të këndshme me mësuesen Eleonorë, e cila ishte një vajzë thatanike, me sy të thellë e pak të trishtuar si gjithë sytë e errët e të mëdhenj. Në shprehjen e tyre kishte vazhdimisht një lloj habije gazmore, sikur zbulonte befas te sendet e fytyrat diçka të re dhe kjo qe një habi fëminore që e hijeshonte dhe të bënte ta ndjeje të afërt këtë vajzë, e cila, përndryshe, s'binte për asgjë tjetër në sy. Ajo qe dy tre vjet më e vogël se mjeku, dhe po ashtu në një moshë goxha të brishtë kur martesa zë edhe e brengos vajzën. Shkujdesja e saj e çiltër, që shprehej me një humor falëplot, shkujdesje me të cilën mundohej ta kapërceje këtë brengë, të përftonte një ndjenjë të dyfishtë miratimi dhe keqardhjeje. Unë druhesha të shquaj një qartësi më të madhe se ajo që dukej në marrdhëniet e tyre dhe mjaftohesha me ato që dija, domethënë se ata kishin qenë fqinjë në vegjëli dhe bashkënxënës në shkollë të mesme, paçka, se në vite të ndryshme dhe kur e gjetën njëri-tjetrin në këtë qytet u gëzuan nga ky takim. Vinin nganjëherë bashkë në teatër, në mbrëmje vallzimi. Në qytet shumëkush pandehte se ata dashuroheshin, por ngurrimi i gjatë për t'u fejuar u vuri kapak pëshpëritjeve. Kishin diçka ajrore, të kapshme e të papërcaktuar që u shkreptinte nëpër sytë kur bisedonin, po kjo mund të vihej re veteu nga një njeri i afërt siç isha unë. E dija se kjo nuk ishte akoma dashuria. Ajo i përngjiste ndoshta një drite të bardhë që lëviz së largu në muzg dhe të ndjell ta ndjekësh, një dritëze lezonjare që herë rekëtin më të shuar, herë shkrepëtin e digjet e dëshiruar për erë më të fortë. Por unë nuk guxoja të bëhem sadopak erë për atë shkëndijë, megjithëse e dija se ata më donin e më kërkonin si një digë ku ujërat mund të pengojnë vrullin e tyre. Më vonë u pendova për këtë ngurrim e qërtova veten dhe thashë se nuk është mëkatë të hysh në jetën e dy njerëzve të afërt për ty, kur ata i mundon ngurrimi për t'i quajtur gjërat me emrin e tyre.

Ishte fillimi i verës, posa ishin pjekur qershitë. Mësuesja Eleonorë kishte vajtur me nxënësit në hekurudhë. Në qytetin Xh., si në çdo qytet të gurtë, mbrëmjeve bënte zagushi dhe ne me mjekun ngjiteshim shpesh nëpër kodrinat ku akasjet e mbjella kohë më parë, kishin formuar një korije të vogël e të tejdukshme, si çdo pyll i krijuar prej dorës së njeriut. Korija e akasjeve mblidhte nën hijen e saj gjithnjë e më shu-

midís shúmë rástesh e njóhjesh in the midst of many (social) occasions and acquaintances
thatanik scrawny; dried-up
goxhá considerable
i bríshtë delicate; brittle
shkujdésje nonchalance
i çíltër sincere
falëplót gratuitous
përftój evince
miratím approval
mjaftohém limit myself
paçká = pa çka no matter
shumëkúsh many people
shkreptín flashes
lezonjar = lozonjár playful
rekëtín pulses; flickers
sadopák no matter how little
qershí cherry; cherry tree
zagushí sultriness; mugginess
akásje acacia
koríje grove
i tejdúkshëm translucent

më njerëz dhe kjo kërkesë, që në pamjen e parë duket aq e zakonshme, të ngazëllente, sepse ishte një shenjë që jeta e banorve të Xh, po bëhej gjithënjë më e mirë e më e pasur shpirtërisht. Rrinim mbi bar, dëgjonim cicërimat e fëmijve që loznin, na vinin në vesh copëza bisedash gazmore, rrëfimesh, komente për ngjarjet ndërkombëtare të ditës. Dendur unë merrja me vete gruan dhe djemtë dhe këtë nuk e bëja më kot. Nganjëherë e sillja fjalën te mësuesja Eleonorë. Ç'bën vallë tani? — thosha. — Me siguri është duke vallzuar në ndonjë mbrëmje tematike, se në hekurudhë bëjnë mbrëmje të tilla përnatë. Në shtëpi, ime shoqe më tallte ca për këto prapaskena e të hedhura breg më breg. «Ti e mban veten për njeri të mprehtë, po në të vërtetë je ca naiv», — më thoshte. «Jo, pse?» — thosha unë. «— Sepse të duket sikur thua me zë ato që i shkojnë nëpërmend mjekut dhe kështu pandeh se mos po i dredh ndonjë tal. Po kot, more i shkretë, se ai është si një qerpik akulli, trembet nga dashuria si nga ngricat e dimrit.»

Ime shoqe në këtë pikë i përmbahej një opinioni tjetër për mjekun, domethënë se ai u përkiste atyre burrave që i druhen jetës bashkëshortore si një zgjedhe që s'duan ta mbajnë në qafë, se janë më individualistë nga ç'duken. Mua ma kishte ënda që ajo të gabohej dhe mbetesha besnik i urtësisë së popullit mbi «prakun e zorshëm». Sido që të ishte, në këtë gjë ai vazhdonte të mbetej për ne një e fshehtë. Pra, atë mbrëmje, kur qenë pjekur qershitë e para, ne u ndodhëm vetëm të dy. Korija zhurmëronte. Bari ishte i shkelur dhe ai ankohej që s'po gjenim lëndinë të mirë. Vendosëm të shëtisim nëpër tragat e errëta deri në majë të kodrinës, te klubi i gjahtarëve. Ai ecte para meje, pakëz i kërrusur dhe figura e tij më dukej kështu e menduar dhe e brengosur.

— A je i lirë të dielën që vjen? — pyeti papritur ai dhe u kthye nga unë.

— Nuk e di. Mund të më kërkojë gazeta ndonjë shkrim me urgjencë, — u përgjigja unë.

— Po ti... sidoqoftë, me të vërtet s'ke asnjë mundësi të ma rezervosh mua atë të dielë? — tha ai dhe nga mënyra e ngatërruar se si fliste, unë e kuptova se ishte i turbulluar, në atë gjendje kur njeriu mundohet t'i zgjedhë fjalët, po nuk ia arrin kurrsesi tamam, se është i turbulluar.

— Asgë duhej të ma bëje këtë pyetje! — thashë unë.

— Mos e merr ters, të lutem.

— Nuk fyhem, se e shoh që të mundon diçka.

— Më premton?

— Patjetër!

— Sonte s'mund të të them më shumë. Ndoshta nuk do të të them kurrë asgjë dhe atëherë do të të lutem ta harrosh kë-

ngazëllój rejoice
e sjell fjálën bring the subject around
tall kid; joke around with
me zë aloud
qerpík eyelash
trágë trail
gjahtár hunter
i kërrúsur hunched
të diélën që vjen next Sunday
ters badly

të mbrëmje e këtë premtim. Po mund të ndodhë ndryshe dhe atëhere do të të lutem të vish me mua deri në M.

— Deri në M?

— Po. Vetëm se sonte mos më pyet më.

— Mirë! — u mundova të them unë sa më qetësisht, sikur kjo që thamë s'kishte asnjë rëndësi apo të fshehtë dhe ai më ftoi thjesht për gjueti. E dija se tani kureshtja e tepërt do ta lëndonte në një ndjenjë të pashprehur që na lidhte të dyve e që kishte të bënte me atë mirëkuptim shpirtëror midis shokësh të ngushtë që i nënkupton pa fjalë ndjenjat e tjetrit, pra edhe nevojën e vlerën e heshtjes. Pas asaj parathënieje të mjegullt, në vetmi unë e mendova gjatë këtë. Mendja më vinte në aq gjëra të mundshme sa prej kësaj morie më bëllej në tru një zhigër me përfytyrime, ku ishte e kotë të mundoheshe për të depërtuar. Kurse ime shoqe e shihte këtë parathënie në mënyrë të thjeshtë. «Atij sigurisht i kanë propozuar ndonjë nuse, tha ajo, prandaj është turbulluar ashtu. Kurse ty të do si krah». Po ti the që ai është nga ata qerpikët e akullit » — e ngacmova unë. «Epo edhe ata shkrijnë kur vjen pranvera», — tha ajo.

Të dielën u ngrita herët. Kur erdhi mjeku, po pija kafen. Vura re se i pëlqeu që unë e prisja veshur me kostumin e të dielave, ndonëse s'tha gjë për këtë. Udhëtimin e bëmë në qetësi, si dy udhëtarë që vozitin përbri e për çdo ditë me këtë korjerë dhe i kanë thënë të gjitha ç'mund të thuhen. Mjeku përpiqej të lexonte gazetën, po korjera tronditej dhe unë e dija se ai s'lexonte dot asgjë. Nuk duhej ndonjë vrojtim i hollë që ta pikasje tronditjen e tij dhe përpjekja për ta fshehur e tradhëtonte ca më keq. Kam vënë re se disa tipa, sa më shumë mundohen të shtiren indiferentë e të qetë, aq më shumë e tregojnë shqetësimin e tyre. Kjo pamundësi tregon sidoqoftë karaktere të pastra. Unë e respektoja heshtjen e tij, sadoqë në fillim të udhëtimit kisha shpresuar të mësoja se ç'lloj dëshmitari do të qeshë ditën e sotme.

M. është një qytet i vogël, i ri, nja njëzet kilometra nga qendra e rrethit. Aty na priste një njeri. Ky ishte një burrë i shkurtër e i ngjallmë, buzëfryrë, me një palë flokë të yndyrshme shtruar pas kafkës së rrumbullakët si të lyer me dyllë. Edhe vështrimi i tij seç kishte diçka të yndyrshme e lëpirëse, që të zvetënonte. Burri, i shkathët e me gjeste të buta, e përqafoi mjekun si mik të vjetër për të cilin jemi përmalluar. Mjeku vinte dendur në M. dhe kishte të ngjarë të kish shumë miq.

— Një kolegu im!, — më prezantoi mjeku.

— A, mos më llastoni, ju lutem. Vetëm ndihmësmjek!

premtím promise
sa më qetësísht as calmly as possible
gjuetí hunting
nënkuptój intuit; sense
morí swarm
zhígër jumble
si krah for support
ngacmój needle
kostúm suit
vozít roam; wander
përbrí side by side; beside
korjérë carriage; carrier; car
pikás guess
dëshmitár witness
buzëfryrë swollen-lipped; full-lipped
pálë pair
i yndýrshëm greasy
i lýer coated
lëpírës sycophant; licker
zvetënój pervert; corrupt
llastój coddle
ndihmësmjék physician's aide



Viz. P. Dervishi

— tha ai dhe ngriti lart gishtin tregues me një gjest teatral. Ky njeri s'po, më pëlqente gjithnjë e më shumë. Nuk e di se si lindin disa antipati vizive te njeriu. Këtë antipati unë e kam tamam për këta tipa, lëpirës që të ngjiten pas dhe që më së shumti shoqëria i duron si një të keqe të pashmangshme. Edhe

gisht tregúes index finger
antipatí antipathy
vizíve visual
më së shúmti for the most part

pritja që na bëri, s'dukej të qe rastësore. Njëherë më vajti mendja se mos qe fjala për ndonjë konsultë mjekësore, por atëherë tërë kjo fshehtësi s'kishte kuptim. Mos vallë më kishte ngrehur një suprizë të karakterit letrar? Më kujtohej se mjeku më kishte intriguar edhe njëherë pak a shumë kështu për të njohur pa paralajmërim një njeri shumë të këndshëm. Mirëpo mendja s'ma qaste as këtë, përndryshe pse ta humbiste ashtu atë zotësinë e përhershme të fjalës së thekur e të humorit? Vetëm një emocion vetjak dhe i fortë mund ta sillte në këtë gjendje. Le të shpresonim se tërë hamendjet e mia do mbaronin së shpejti me një zgjidhje të lumtur. Ndihmësmjeku, që duke u kënaqur vetëm me fjalën koleg, s'pati mirësinë të na thotë emrin, na priu udhës duke shtrënguar mjekun përkrahu, deri te një bar veror që kishte një verandë me tri-katër tryeza në hijen e dy qershive. Qershitë ishin të vjetra e të larta si gjithë qershitë e egra. Mbi kokët tona kuqëlonin ca kokra të vogla. Ndenjëm në tryezën e qoshes që shihte sheshin dhe rrugën kryesore të qytetit. Dy mëllenja u trembën e u ngritën në qiell duke rrëzuar nga sqepi ca kokra gjysmë të ngrëna. Ndihmësmjeku pëshpëriste me zë të ulët. Prania ime e bezdiste, por s'guxonte të thotë gjë, kurse mua vështrimi e fytyra e tij e yndyrshme po më ndillnin gjithnjë e më shumë një ndjenjë të pështirë neverie, si ajo që të sjellin maçokët qimërënë! Mirëpo rrethanat më detyronin t'i burgosja pakënaqësitë dhe ta pranoja qënien e tij pa lëvizur. Mjeku, më shumë se çdo gjë tjetër, dukej i hutuar. Kurrë s'e kisha parë kështu, në hava, të dalldisur pas një pritjeje munduese. Muarrëm pije freskuese. Mjeku e piu me një frymë, kurse dikur na këshillonte që për të mirë të aparatit tretës, pijet e ftohta e të nxehta duhen kapërcyer ngadalë. Edhe ndihmësmjeku nisi ta ndjejë veten si në gjëmba. Vërtitej si rëshqanor mbi mbulesën plastike të karriges, hepohej nga ana e rrugës për të parë sa më larg, psherëtinte, zbardhte dhëmbët pa shkak si lolo dhe një tok tjetër gjestesh të shtira që më siguronin se dikë priste, se vonimi e nervozonte, se prania ime e nervozonte më keq e ia trashte gjuhën. Po nuk qe një gjendje për t'u lakmuar. Më i qetë isha unë. Për ndihmësmjekun s'më hante malli, bile kënaqesha që e inatosja ashtu. S'kisha asnjë shqetësim veç kureshtjes.

Befas kolegu u ngrit dhe këtë u mundua ta bëjë ngadalë e me përtesë për t'i dhënë një pamje sa më të natyrshme. Kuptohej që ai dikë pa në rrugë.

— Ejani, doktor, ju lutem. E kam pregatitur terrenin, — tha ai.

Mjeku u ngrit dhe më hodhi një vështrim aq lutës e përgjërues, sa unë e mposhta kundërshtimin dhe fyerjen prej kë-

rastësór fortuitous
paralajmërím forewarning
qas accept; bring close
i thékur dry; toasted
vetják = vetiák private; personal
haméndje guesswork
kuqëlój redden
mëllénjë thrush
i pështírë nauseating
neverí aversion
qimerënë mangy
burgós imprison
në havá in a leisurely setting
i dalldísur crazed
aparát trétës digestive system
në gjëmba on edge
rëshqanór reptilian
hepój bend over
zbardh dhëmbët grin
lólo loony
lakmój envy; covet
përgjërúes painful
fyerje insult

saj fshehësie që po zgjatej më tepër se ç'duhej. «Kolegu» u kthye nga unë.

— Mos u mërzitni, ju lutem sa të shohim një stof për kostum në dyqan, — tha ai nëpër buzët e thata blu, si prej një ftohme, hapur si në zgërdheshje. Ky qe një shkak krejt i çmendur që i përshtatej mjaft mirë fizionomisë së tij. Shfajëzimi dhe gjendja e re tani më cytnin kureshtjen dhe kishin gjithashtu anën e tyre komike. Mjeku hapi krahët me gjestin e një njeriu që ka rënë në hall dhe prandaj i bindet tërheqjes së një kapistalli të padukshëm. Ndenji gjersa zbriti «kolegu» tri shkallët e verandës dhe më tha kalimthi:

— Mos u mërzit të lutem. Së shpejti do të t'i rrëfej të gjitha!

Më erdhi keq për të. Pa vetëdijë, ai kërkoi falje me po atë fjalë të «kolegut». S'thashë asgjë, por kishte folur fytyra ime. Dhe ajo s'mund ta fshihte aq mirë keqardhjen për atë gjendje të shfytyruar ku kishte rënë. I pashë të dalin të dy në shesh, pastaj të ngjiten në rrugën kryesore. «Kolegu» e shtrëngonte për krahu, sikur trembej mos i ikte. Mjeku ecte drejt, si i vënë në kremastar. Mua më erdhi për të qeshur nga një bashkëshoqërim i papritur mendimesh që m'u krijua nga përgjasimi i tij me një njeri të ngurtësuar në qafë. Shoku im, shkrimtari F. do të thoshte: «ceën sikur posa ka dalë nga frigoriferi». «Kolegu» e tërhoqi brenda dyqanit «Metrazhe» prej të cilit dolën gati pas një çasti duke pandehur se «hiri syve» do ishte i mjaftueshëm për verbimin tim. Para arkës së kursimeve, në trotuar, takuan një burrë të shëndoshë veshur me kostum të zi, lidhur krevatë të zezë, i cili, përkundër pamjes së përzishme, dallohej prej së largu për buzëqeshjen e tij të gjërë, hënore. Mjeku u përkul me nderim e i dha dorën. Burri me qeshje hënore bëri siç dukej një shaka, apo ndoshta «kolegut» i pëlqeu ta marrë për të tillë, sepse e pashë të gajasej, i përkulur më dysh e duke rrahur këllqet si gratë. Burri bëri një shenjë drejt lokalit ku qeshë unë. «Kolegu» refuzoi me mirësjellje. Me kaq u ndanë. Pastaj, u ngjitën përpjetë rrugës, kapërcyen bërrylin e saj dhe më humbën nga sytë. Kaloi një hop i mërzitshëm. Ndjenja e përgjimit më tundoi aq sa bëra të ngrihem, po shpejt e qërtova veten për këtë dobësi. Filloi të fryjë frushullimë ere. Fletët e qershive u drodhën dhe drita larushe, që coptohej nëpër to, u ngrys e u bë e murme. Pra qielli po vërehej e koha premtonte shi. Vështroja sheshin e vogël, gri. Aty kaloi me shpejtësi një vajzë dhe vegimi i saj më mbeti në sy. Shquaja vijat e lakuara e të bukura të shtatit të saj, flokët e verdhë e të derdhur dhe lëvizjet e nxituara të pulpëve. Vajza qe veshur me një fustan të thjeshtë basme. Pastaj më tërhoqi një burrë hipur në kalë me shalë që

stof material
ftóhmë cold weather
zgërdhéshje sneer; grin
shfajëzím exoneration
cyt prick
kapistáll tether
i shfytyrúar faceless
kremastár iron hook
bashkëshoqërím accompaniment
përgjasím = përngjasím resemblance
i ngurtësúar stiff; rigid
híri sýve pulling the wool over (my) eyes
árkë e kursímeve savings deposit (building)
i shëndóshë robust
i përzíshëm blackish
hënóre moonlike
gajásem burst out laughing
kéllqe (këllk) thigh
tundój tempt
larúsh broken; variegated; mottled
i múrmë = i múrrmë grey
vegím image
i lakúar curving
púlpë calf
básmë material; cloth

i ra sheshit përmes, kapardisur drejt, i kënaqur nga troku i rëndë e gjëmues i kalit. Kjo ishte një pamje e jashtzakonshme edhe për një qytezë bujqësore si M. Më vonë mora vesh se ai ishte drejtori i fermës. Kur u zhduk dhe ky në një sokak, pashë mjekun tim me... tamam me vajzën flokëverdhë. Kjo ishte aq e papritur sa unë çaplova sytë. U harrova kështu deri sa më shkrepi si xixë mendimi se pikërisht ajo ishte shkaku i udhëtimit tonë. «Grate kanë nuhatje» — u detyrova të pranoj me vete atë që parashikoi ime shoqe. Vetvetiu lëviza e gati sa s'u rashë në sy, po u përmbajta në kohën e duhur. Po ndoshta nuk do më vinin re, aq të zënë qenë me njëri-tjetrin. Vajza ecte kokulur dhe profili i fytyrës së saj me buzët e fryra kryeneçe, i përgjysmuar nga flokët, m'u duk shumë i bukur e me një miturí të pafaj. Pastaj vajza e ngriti kokën, tha diçka dhe qeshi me gjithë shpirt. Edhe mjeku qeshi si i zënë në befasi. Fill pas këtij gazi, «kolegu», që u vinte pas, nxitoi hapat e u bashkua me ta. U zgjati një kaush ku nxinin qershitë Belica. «Kolegu» nxori dy qershi lidhur në një bisht, i puri në vesh, i tundi si zilka, pastaj i gëlltiti të dyja me nje gjest prej prestigjatori. Kjo gjë e argëtoi vajzën, e cila ia shkrepi të qeshurit dhe e godit me grushtin e saj të vogël në shpinë, siç bëjnë me njeriun kur i ngec gjë në fyt dhe nga kjo përzemërsi kuptohej se vajza njihej mirë me «kolegun». Vajza i zgjati dorën mjekut dhe tha prapë diçka për të qeshur. Ndihmësmjeku shkoi pas vajzës dhe unë vura re se, tinzisht, ai i bëri mjekut një pëshëndetje prej parade, që m'u duk si shenjë fitoreje. Mjeku i ngjitl shkallët dy nga dy dhe u lëshua në karrige. Kishte djersitur. Dukej krejt i ndryshuar, i lehtësuar, sikur kishte lënë pas një pritje të gjatë. Kjo qe pritja e një njeriu, shfaqjen e të cilit e dëshirojmë pa masë, por medet, nuk dimë në do të vijë apo jo. Dhe ja, ajo vjen me frymën e ngrohtë bën të çelin tërë lulet e ndjenjave.

— Ke vënë buzë prej qershie, — thashë unë.

— Po, po, — tha ai dhe fshiu buzët me pëllëmbë. Pyetja ime e tërthortë qëllonte aq larg mendimeve të tij, sa ai s'mund të bëhte gjë më të mençur se fshirja e buzëve.

— Ishin qershi Belica, — shkela syrin unë.

— Mos u tall, — tha ai që e nuhati nëntekstin. — Më ke premtuar për këtë.

— Nuk më kujtohet!

— Sidoqoftë! Ty s'të mungon takti. Pimë diçka? Fërnet, për shembull!

— Sot jam i tëri nën urdhërat e tua!

— Me fërnet do të më zgjidhet gjuha më lehtë. Merr vesh gjë ti, apo jo? — shkeli syrin ai.

kapardísur swaggering; strutting
trok trot
sokák street
çaplój sýtë open my eyes wide
nuhátje sense of smell
në kóhën e dúhur in the nick of time
kryenéç stubborn
miturí youthfulness
kaúsh package; bag
Belícë type of black cherry
gëlltít swallow
prestigjatór prestidigitator; magician
fyt throat
tinzísht stealthily
i lehtësúar relieved
medét woefully
i ménçur intelligent
nëntékst underlying meaning

820

19

— Asgjë. Mistere të thella!

— Gënjen. Po nuk të mërzitem. Eja të pimë.

Mjeku e piu me një frymë gotën e vet.

«Sot të gjitha kërkon t'i bëjë me një frymë», — mendova unë.

— S'po më thua gjë? — pyetl ai.

— Për kë?

— Ç'je ti, ç'je ti! Dinakëri profesionale. Do të më detyrosh të rrëfehem? Mirë pra. Më thuaj, si t'u duk ajo vajzë?

— Nuk e pashë mirë. Ç'mund të them me një të parë së largu?

— Prapë trillon. Ne s'ishim aq larg. Ti na ndiqje tërë kohën me sy dhe unë e pashë mirë këtë.

— M'u duk vajzë e vogël. Ndoshta s'ishte as njëzet vjeçe.

— Ti e di që s'të pyes për këtë, — u vrenjt ai. — Ti e di!

— Po, e di, — pranova unë. — M'u pa vajzë e bukur. Bile shumë e bukur!

— Fenomenale, — tha ai.

Këtë epitet prej çunash po e dëgjoja për herë të parë nga goja e një burri solid.

— Urime, — e shpotita unë.

Po ai i kalonte shpotitjet nën vesh, sepse nuk dëshironte të futej në ato ujëra ku e shpija unë.

— «Më kot, — mendova. — Dhe po të ngul këmbë kaq shumë tek moshat e më the të thashë, me siguri do ta fyej. Ndoshta s'ishte një ndryshim aq dramatik, për deri sa në mes ishte dashuria. Dashuria? Po kur lindi kjo dashuri?»

— Unë gati ia kisha harruar fytyrën, gati e kisha harruar fare atë, — tha ai. — Unë e kam kuruar para një viti. Quhet Roza. Kishte një proces të lehtë. Qe shumë gazmore dhe e merrte sëmundjen me të qeshur. Tallej shpesh me kërkesat e mia dhe s'më bindej. Do të kisha simpati për ty doktor, më thoshte, po ti je i rreptë dhe i merr gjërat shumë seriozisht». Ma kujtoi Tushi, kolegu. Ai e ndoqi kurën më tej. I ka miq njerëzit e saj. Apo kushërinj të largët. Diçka e tillë. Dhe ja... ai m'u qep. «Pse të mos jetë fat, pse të mos jetë fat? — më thoshte. — E kam pregatitur terrenin». Pardje më dërgoi telegram «Terren i pregatitur», — thoshte. Ti e di. Unë ngurrova. Se si më dukej. E pamundur. E largët. Diçka si mblesëri. Po s'është e tillë. Është ndryshe. Jam i sigurt se imazhin e saj e kam ruajtur brenda vetes. Të pacënuar e të dëshiruar, si një send prej kristali, të cilin druhemi ta prekim, se mos na thyhet. Më bëhet se midis nesh, që atëhere, kishte lindur, kishte lindur... nuk them dashuria, po një ndjenjë e ngrohtë e përbashkët. Dhe tani... terreni është i pregatitur plotësisht për fejesë. Të paktën kështu thotë Tushi».

ç'je ti you're the sly one
shpotís banter; joke
procés case
mblesërí matchmaking
i pacënúar unblemished

E dija që rrëfimi i tij i rrëmbyer qe i vërtetë. Tani për tani s'mund të thosha asgjë. A mund të ndodhë edhe kështu? mendoja. A mund të ndodhë që dy njerëz që kanë simpati për njëri-tjetrin të fejohen një ditë me ndërhyrjen e dikujt? E vetmja gjë që s'më pëlqente tani qe ajo shprehja e thatë «terreni i pregatitur», të cilën ai e huante nga kolegu Tushi. Kishte ardhur një nga ato çastet e brishtë, ku çdo fjalë e çdo veprim duhej bërë me takt të madh, përndryshe miqësia jonë do të lëndohej, ndoshta do të gremisej pa shpresë për t'u ngritur.

— Dhe në aq pak kohë sa ndenjët të dy, ti pate mundësi t'ia thuash të gjitha këto? I madh je, — thashë me përzemërsi duke e shtyrë bisedën më tej, në një përfundim, të cilin e dija, se ishte i remë e që më vinte në pozita prej naivi, po që atij do t'i jepte zemër.

— O, jo. Gabohesh. Kjo qe e pamundur, — tha ai. — Druaj se ajo e priste, bile e dëshironte një pohim të tillë prej meje atëhere kur ecte kokulur. Por qe mal i lartë për mua, — psherëtiu.

— Dhe je i bindur që e priste dhe e dëshironte?

— Diçka kuptoj nga psikologjia, apo jo? Pse jam mjek, — tha ai miqësisht.

— Po më tej?

— Nuk e di. Duhet bërë një gjë, doemos. Tushi thotë se ne mund të vemi për një vizitë mbasdite, kur të dalin prindërit nga puna. Tushi thotë se mund ta shpejtojmë. Po të duash ti edhe që sot thotë. Terreni është pregatitur, thotë. Po mua më duket se është më mirë ta shtyjmë pak, një muaj, për shembull. Ti e di si bëhet në këto raste. Ta marrë e mira... E di? Kam ca të dridhura kur i përfytyroj të gjitha ato që vijnë. Vetëm se më e madhja kaloi, apo jo?

— Le të shpresojmë se kaloi, — thashë unë i turbulluar krejtësisht pas tërë asaj pritjeje, kureshtjeje dhe rrëfimit të tij. S'mund të mendoja hë për hë asgjë të saktë e të qartë. Dyshimi nëse midis tyre ishin fijet e dashurisë apo jo, më kishte topitur gjakftohtësinë e logjikës, më kishte përgjumur mendimin dhe unë s'mund të bëja dot asgjë më të mirë se sa të heshtja ose të përgjigjesha në mënyrë të papërcaktuar. Nga kjo gjendje më nxori ardhja e «kolegut» Tushi, që, siç pritej, më nervozoi përsëri me lëpirësinë dhe, buzët makute nën të cilat dukeshin dhëmbët e nxira prej qershive Belica. Ai mundohej t'i pëshpëriste mjekut. Atëhere unë vendosa menjëherë e pa ngurrim të bëj diçka që nuk ishte në normë të gjërave.

— Do të vete të gjej një shok që më ka premtuar një shkrim. Takohemi në restorant, — thashë.

rrëfím tale
i rrëmbýer impetuous
gremís throw from a precipice
drúaj suspect; believe
ta shtýjmë pak to postpone it a bit
hë për hë at the moment
topít numb
lëpirësí boot licking
makút greedy

— Në rregull, — tha mjeku.

E di që mendimi ishte i papeshuar mirë, si gjithçka që bëhet në vrull e sipër pas një shtytjeje të befasishme, por unë nuk u pendova kurrë për këtë gjë, sepse s'mund të heshtja e të rrija akoma mënjanë. Vërtet, edhe për vajzën që quhej Roza edhe për mua, ky takim nuk do të qe i lehtë, sepse ne nuk njiheshim, por në ato rrethana s'kishte tjetër zgjidhje. Zgjatja do ta vinte në pozita edhe më të vështira shokun tim, mjekun. Pra, vendosa të gjej Rozën. Kjo nuk ishte gjë e vështirë. Shtëpia qe e vogël dhe e ulët, në një rrugicë të verbër. Përfund kopshtit të madh ajo dukej ca më e vogël se ç'ishte në të vërtetë, si shtëpi kukllash. Deri te dera vinte një rruginë shtruar me zaje të bardhë, të çimentuar, ku vareshin kaçubat me trëndafila e gjithfarsoj lule që të fshinin nga syri vllajat e vogla me perime. Shtëpiza të tilla kishte disa në këtë qytet dhe ajo nuk do të shquhej nga asgjë sikur të mos qe një bardhësi e përgjithshme, e mureve, avllive, rruginës, vazove, një bardhësi e ftohtë që dëshmonte për një rregull të tepruar, i cili të mbante larg vetvetiu. Ato tridhjetë hapa në oborr qenë më të vështirat për t'u bërë, megjithse unë e dija që vajza në atë orë ndodhej vetëm ose me motrën e vogël. Shtëpiza dhe kopshti ishin rrethuar me avlli të larta, megjithatë më bëhej se vizita ime kishte dëshmitarë sytë dhe veshët e një mëhalle të tërë. Vajza që quhej Roza më vuri re nga dritarja. Lëvizi rrëmbimthi një kortinë thurur me grep me një motiv dredhash dhe u shfaq në kornizën e derës. Aty ajo m'u duk më e gjatë, shtatderdhur, veçse pakëz e turpshme e me një zbehtësi të lehtë. Në sytë e saj kishte diçka të thellë e të tejdukshme, veti që e kanë nganjëherë sytë e kaltërt. Mbylli jakën e fustanit me një lëvizje të natyrshme dhe më ftoi të hyj brenda. Hyra me një buzagaz që kërkonte falje në heshtje, sepse në të vërtetë nuk dija akoma se ç'duhej të thosha. Vendimi im kishte qenë i rrëmbyer, përrua pa shtrat pas një shtërgate shiu dhe tani s'dinte se ku të derdhej. Roza hapi një derë të lyer deri në rrëzëllim me bojë vaji krem. Qe një dhomëzë e vogël me një kanape të ngushtë e të gjatë prej druri me krahë të harkuar e mbuluar me një kuvertë të bardhë. Gjithë kjo më solli ndër mend shtëpinë time në fshat. Prej një fotografie të madhe që ishte mbi komo më vështronte fytyra hënore e burrit me të zeza dhe ajo e një gruaje me sy pak të buhavitur.

— Urdhëroni. Babai vjen pas pak, — tha ajo dhe hapi bufenë e pijeve.

— Unë kam ardhur për ju, — thashë me një frymë atë që ishte më e zorshmja për t'u thënë.

Dora e saj u drodh dhe gotat tringëllinë. U kthye. Ishte

i befasíshëm sudden
shtëpí kúkllash doll house
záje shingle
kaçubë flowerpot
gjithfarsój = gjithfarësój all kinds of
vllájë bed
perí me vegetables
shtëpízë little house
avllí outside wall
vázo vase
i teprúar excessive
rrëmbímthi hurriedly
kortínë curtain
grep needlework
drédhash braided; entwining
shtatdérdhur stately
zbehtësí paleness
buzagáz smile
rrëzëllím edge
krem cream
i harkúar arched
kómo dresser
i buhavítur swollen

zbehur. Vështroi gjatë, mbërthyer në vend, sikur befas t'i ishte hapur para këmbëve një hendek që nuk guxonte ta kapërcente. Po qe vajzë e zgjuar dhe e mblodhi veten shpejt.

— Mos jeni ndonjë mik i babait? Unë nuk ju njoh, — tha ajo, por unë e kuptova se këtë e tha kot, sa për të rivendosur bisedën midis nesh. Bile mua m'u bë tani se ajo e nuhati që në çastin e parë në emër të kujt kisha ardhur dhe prej kësaj u mblodh e u struk në vetvete si një zog që mërdhin.

— Unë jam një mik i doktorit! — Dhe thashë emrin tim. Ajo harroi gotat mbi tryezë dhe u ul në cep të karriges.

— E prisja këtë, — tha me zë gati të shuar. Qerpikët e syve iu drodhën, po ajo i fshehu menjëherë duke ulur kokën. Flokët i mbuluan fytyrën e imët e të ëmbël. Duhej të thosha ndonjë fjalë, po edhe unë u hutova. Nuk e kuptoja ende nëse trondítja e saj vinte nga emocioni e turpi që ndjejnë vajzat kur u afrohet një ndryshim i jashtzakonshëm në jetën e tyre, apo sepse kjo gjë, mjeku e vizita ime e trembnin, nuk i dëshironte e prandaj i dukeshin një goditje fatale. Kush e di sa mund të kishte vazhduar kjo gjendje, sikur ajo vetë të mos na kish nxjerrë prej saj në një mënyrë shumë të mprehtë.

— Tani unë ju njoh. Mjeku më tha se ju ka shok të ngushtë, po unë po ju shoh për herë të parë. O sa mirë bëtë që erdhët ju... Sikur të vinte ai Tushi, ai tartabiqi i dreqit, — tha ajo çapkënçe dhe kjo i përshtatej tamam moshës së saj, — s'dija ç'mund të bëja. Jo, s'dija ç'do të bëja. Po ju do të më kuptoni, apo jo? Do të më kuptoni. Sepse ju shkruani. Edhe sikur të mos shkruanit, do të më kuptonit. Unë e di këtë... Të gjithë do të më kuptonin dhe do të más jepnin të drejtë, ndoshta edhe doktori. Po unë e shkreta ne fillim nuk pikasa dot asgjë. Bile edhe qëparë, kur flisnim me të, as që më vajti mëndja se ai ... se ai mund të... Të gjitha i ka bërë Tushi. Nën rrogoz i ka bërë. Dhe i ka bindur prindërit e mi. Tani po e kuptoj përse më flisnin kaq shpesh për doktorin. Unë kujtoja se ata flisnin aq mirë, meqë ai më kuroi. Sa budallaqe! Si nuk e mora vesh menjëherë? Po ju do t'ia thoni doktorit përse nuk e kuptova... Unë dashuroj një djalë. Çdo dashuri tjetër më duket e pamundur. Si mund të më vinte mëndja? Dhe më vjen aq zor prej tij... aq zor... Po ai është njeri i zgjuar, i mirë. Do të më japë të drejtë. Si mendoni ju?... — i tha ajo të gjitha me një frymë.

Ishte e dyta herë brenda një dite që dëgjoja rrëfime të tilla me një frymë. Rrëfime aq të ndryshme... aq të ndryshme. Një hon i tërë në mes. Unë u ngrita.

— Mos u shqetësoni, Roza, — i fola me emër për herë të parë, — ai do t'ju kuptojë.

— Dhe nuk do të ndodhë asgjë?

— Asgjë, — theksova unë me aq siguri sa mundja.

strúkem huddle
mërdhíj freeze
cep edge
i shúar inaudible; extinguished
tartabíq bedbug
do të më jépnin të dréjtë (they) would agree with me
qëpárë a while ago
rrogóz rug
méqë because
tij = atij
hon chasm; gap

ERIC

- Po ai Tushi, ai tarta... — u përmbajt vajza.

— Mos ki frikë prej tij. Do të heshtë. Është i lakueshëm dhe përdridhet më shpejt se ç'pandehim ne.

Unë dola me nxitim, kokulur. Nuk desha të shoh sytë e saj. Druaja se mos shihja dridhjen e qerpikëve që s'do të më pëlqente. Ma kishte ënda ta mbaja mend të gëzueshme atë vajzë, sepse e dija që në brendësi ajo ishte e tillë.

— Po ju s'pitë asgjë! — dëgjova zërin e saj.

— Kur të martoheni... me atë djalin, — thashë unë dhe ktheva kokën. Ajo rrezëllinte e tëra si pas një shiu të shkurtër kur del dielli që e bën qiellin të thellë dhe horizontet të hapura.

Mjeku dhe «kolegu» më prisnin në restorant. Me një vështrim të vetëm ai e kuptoi se kishte ndodhur një gjë e pandreqshme. Tani e kishte rifituar disi qetësinë. U çudit pakëz kur i thashë pa asnjë ceremoni «kolegut» të na linte vetëm.

— Më vjen keq, doktor, — i thashë, — po ajo fejesë është e pamundur. E di që ky ishte një zhgënjim për ty, më vjen keq.

U nisëm menjëherë. Kthimi qe po aq i heshtur sa edhe vajtja në M. Vetëm kur po hynim në qytetin tonë, ai u mundua të verë buzën në gaz e tha:

— Ore, ty të shket nganjëherë gjuha. Shiko mos më merr nëpër gojë për këtë ndodhi në sy të Eleonorës. Mos ma nxirr bojën...

Unë qesha me gjithë zemër.

Teodor Laço "Diell në giellin e thellë"
Nëntori (Tiranë) XXIII, 6 (June)
1976, pp.87-99

i pandréqshëm irreparable
rifitój regain
zhgënjím disillusionment

LEXIMI I NENTEDHJETEGJASHTE

Besa-besë

I

HISTORIA E NJË FAMILJE*

Më 24 dhjetor 18..., duke gdhirë krishtlindjet, një dramë e dhimbëshme ngjau në fshatin Brodani të Shqipërisë, dramë që e mallëngjeu popullin për një kohë të gjatë dhe në të njejtën kohë e tmerroi. Dhe ja se si ndodhi.

*) Dy tregimet e Çajupit që botojmë në këtë numur, autori i ka shkruar frëngjisht më 1898 ose më parë, janë pra nga shkrimet e tij më të herëshme. Për fat të keq origjinali i tyre nuk dihet se ku ndodhet (sipas S. Çapit atë duhet ta ketë gruaja e dytë e poetit, që jetonë në Greqi). Në Arkivin e Shtetit në Tiranë ruhet një kopje e përkthimit që bëri një mik i poetit, Petro Mandi. Duhet thënë se përkthimi është shumë i dobët, në mjaft vende është e vështirë t'i nxjerrësh si duhet kuptimin, mbasi përkthyesi nuk e njihte mirë frëngjishten. Duke parë se tregimet, siç vihet re lehtë, nuk janë pa interes për njohjen e krijimtarisë së Çajupit, (veçanërisht tregimi i parë ku gjejmë motive të zhvilluara më vonë nga poeti te «i i vjeç dhëndër», «Kurbeti» etj.), menduam t'i bëjmë një përpunim e redaktim sa më të kujdesëshëm përkthimit të P. Mandit dhe t'ja paraqesim lexonjësit tonë.

bésa-bésë pledge of honor
krishtlíndje Christmas
mallëngjéj move emotionally
i lig evil

Por më parë, duke filluar këtë shkrim ndjej nevojën e ngutëshme t'i them lexonjësit që unë nuk jam shkrimtar, nuk e njoh artin e të përshkruarit dhe të fantazisë; prandaj do të vete drejt e në thelb të ngjarjes.

Miaft shqiptarë lenë shpesh vendlindjen familjet e tyre dhe venë të fitojnë kafshatën e bukës në kurbet, më të shumtën e herës në Maqedhoni, në Stamboll në Greqi, në Rumani dhe ngandonjëherë në Misir.

Ky zakon, i mirë a i lig e që nuk ndodh veçse në shekullin tonë, duan të thonë se ngjan për shkak të varfërimit të vendit dhe sidomos nga urrejtja që kanë për qeverinë dhe tiraninë që vazhdon ende. Le të na lejohet që këto fjalë të mos i besojmë plotësisht.

Dhe me të vërtetë s'ka gjë më të lehtë dhe më të natyrëshme që një vend pjellor të bëhet i varfër, të braktiset nga banorët dhe kjo braktisje të mos ngjasë për arësye tjetër veçse për shkak të tiranisë së qeverisë; por përse qëmoti, kur prapë një gjë e tillë mund të ndodhte, shqiptarët nuk e linin Shqipërinë, por përkundrazi rronin të lumtur në jetën e tyre stërgjyshore dhe baritore?

Sipas meje shkaku duhet kërkuar në dëshirën për të renë, për të panjohurën, me të cilat padituria panden se gjen lumturinë dhe fitime; shkaku duhet kërkuar në idetë e ra të përhapura nga propaganda e huaj që bën për vehte mendje-shkurtërit. Këto janë përralla nga të cilat edhe vetë qeveria turke (dhe kjo është një e metë e saj e madhe) ka vuajtur e po vuan akoma sot. Me një fjalë duhet thënë se të gjitha këto ndodhin, në një anë, nga egoizmi i burrave, nga ana tjetër, nga mendimet e hedhura me dinakri nga propagandat e interesuara.

Sidoqë të jetë, zakoni i kurbetit është i gjallë dhe është bërë modë në Shqipëri, ka hyrë kaq thellë në ndjenjat e njerëzve sa që është bërë shkas i ndarjes së popullit më dysh: më një anë është grupi i atyre që ikin e marrin dhenë, grupi që pandehet më i mirë, në anën tjetër, është grupi i atyre që mbeten në vënd, i cili vihet në lojë nga të tjerët si i përbërë nga budallenj, nga njerëz të paaftë apo nga pleq.

Duke mos patur njohuritë më elementare rreth vështirësive që do të hasin në vendet ku shkojnë, duke qenë të pavendosur dhe jo të sigurtë, gjë që rrjedh nga që e njohin pak jetën e kurbetit, ata janë të detyruar të pranojnë punët më të vështira dhe më të këqija dhe të ardhurat që marrin mezi u mjaftojnë për të jetuar.

stërgjyshór ancestral
baritór pastoral
méndje shkúrtër simple minded
módë fashion
lójë play
i pavendósur undecided
të árdhurat the wages
i paarrítshëm unattainable
pjéllë offspring
skámje = varfëri poverty
i gjóri átë poor father

te, kthimi në atdhe bëhet i pamundur,
e paarritëshme. Nga gjendja e vështirë
të cilën jetojnë familjet, prindët pleq
hë të jetojnë nga një bir i vetëm, si
ndihmë, psherëtijnë e thonë shpesh me
llë e ligë dhe pa pikë dhëmbshurie! Ne
, e ushqyem, e rritëm, e martuam dhe,
lërguam në kurbet, kurse ai na harroi
mjel Pjellë e ligël.
gjora nënë! E kuptoj gjendjen tuaj, por
e për të gjitha këto që ju keni bërë për
rkoni shumë, kërkoni gjëra të pamun-
duhet t'ju shkojnë në mendje! Biri juaj
jë dot punë, sepse ai nuk di të bëjë
oftë, ato që do të fitojë nuk do t'i mjaf-
e jo t'ju dërgojë edhe juve!
Ju e dërguat në kurbet... Në te vërtetë
në fatkeqësinë e tij!
ë ikurve janë për të qarë hallin më te-
ë të rit' e tyre, kohën më të mirë, në
uar; ato që kanë fatin e çuditshëm të
e tyre, kjo gjë nuk u ndodh veçse pas
jetë a njëzet vjet largimi, atëhere kur
tja i kanë bërë ata të paaftë për çdo
or më mirë vonë se kurrë! Nuk di të
i trishtueshëm dhe i rremë është më i
me sa duket gratë shqiptare kënaqen

cënoj vlerën e virtutit të tyre, dua të
sa më e madhe të punëve të përditësh-
isë, mbjellja e arave, punët në fushë
te?) në shumë vise të Shqipërisë kry-
ukur; veç kësaj, zakoni i përgjithëshëm
at të ikin në kurbet, fakti që në vend
të huaj, fakti që nuk i dinë lodrat e
ntime dhe plot dredhi, nuk kanë zako-
e të të gjithë atyre sendeve që në bo-
anë të përditëshme; veç kësaj dhe fri-
gale dhe nga rrjedhimet që vinë e bien
ve. të gjitha këto i bëjnë këto gra të gjo-
ë mendohen shumë, të jenë më pak të
hequr një barrë që u ka rënë përsipër,
urrave, të cilët mbase nuk do të kthe-
e në çdo rast.

drobítje exhaustion
cënój belittle; impair
dredhí intrigue
dekoltë low cut dress or blouse
bárrë burden
përjashtím exception
fatlúm happy
dëmprúrës damaging; damager
gjë prej gjéje a single thing
vargmál mountain range
i bëshëm nga shtáti well built
se = s'e
në mënýrë trashaníke solidly; heavily
strëhë shelter

194.

Kusherign é gnérs té tjére,
Ku pashe driten é joare,
Ku kam mic, shoke te ghalle,
Tek deshiroj te kém varre
Shpyrti kur dote me dale. #
Atdhé mé mali te naite,
Ti ce me rrité ce djale,
Dergo-me gne grusht mé balte
T'a puth te te kerrej malle.
Nde dhé te huaj, béso-me,
Zemera m u mallenghyé,
Dergo-me gne gur, dergo-me
T'u ve jastek nde-ne kryé.
Memedhé ce me dhé sise,
Ben gne pune me te mire:
Thyéj ghédhen é Turcise.
Te vi te te sho te lire!
Te mos hic é te mos vuaj
Pisht' é lart é i semure.

Faksimile nga «Dhjata e Vjetër»

Është mbase e kotë që të thuash këtu se asnjë grua-je të shoqërisë së qytetëruar nuk do t'i pëlqenin as do ta kënaqnin të tilla zakone. Ç'po them! As edhe njera prej tyre nuk kish për ta besuar fare një gjë të tillë!

Për shumë kohë, fshati i vogël i Brodanit, përbënte një përjashtim fatlum në largimin dëmprurës të banorëve meshkuj. Kjo nuk do të thotë se nga kcha në kohë nuk kishte fare ikje për në kurbet. Por kjo ndodhte në ato familje të pakta që kishin nevojë të madhe, të cilat o s'kishin gjë prej gjëje ose mezi kishin pak ara, vreshta, bagëti a dhi sa për t'u mbajtur gjallë.

I vendosur në rrëzë të Nemërçkës, që përbën majën më të lartë të vargmalit që nis nga Çajupi dhe që e ndan atë nga qyteti i Përmetit, Brodani ka një klimë të mirë dhe për këtë shkak njeriu i shikon fytyrat e brodanjotëve përherë të freskëta dhe të kuqe, në mënyrë të veçantë gratë janë të bëshme nga shtati, gëzojnë shëndet të plotë dhe nuk u mungon aspak bukuria, megjithëse ato as ja venë veshin një gjëje të tillë.

Brodani as qytet, as fshat, po vetëm një lagje e vogël e vendosur në një vend që se ka shokun. Shtëpitë i ka të vogla e të veçuara, të ndërtuara në mënyrë trashanike me gurë të bardhë e të zi, me çati të ulta nga shkaku i dëborës.

S'ka as hotel as restorant, po udhëtarët e rrallë e të panjohur nuk e ndjejnë kurrë veten në hall për një strehë a për një kafshatë bukë, se ky fshat, sikurse dhe gjithë fshatrat e Shqipërisë, u bën atyre një pritje të pashoqe.

Tërë fshati nuk ka më tepër se 350 banorë me burra, gra dhe fëmijë. Shkojnë një jetë të qetë e monotone, pa vështirësira e pa ndonjë tjetër shqetësim përveç atyre që u shkaktojnë hajdutët, vjedhësit dhe lugetërit, mbasi u besojnë shumë lugetërve. Kjo mbase është e vetmja frikë e shqiptarit dhe i vetmi besim që fetë mund të rrënjosin te ai, mbasi për ndryshe nuk duan t'ja dijnë për asgjë. Kryesisht monoteist, populli shqiptar kënaqet me një perëndi të vetme dhe kjo është e gjitha. Pak rëndësi u jep ai besimeve dhe dogmave të ndryshme saqë mezi mban edhe ato më të dukëshmet.

Ca më pak akoma interesohen banorët e fshatit të vogël të Brodanit për arësimin: ata kërkojnë nga djemtë e tyre që të jenë shumë të zot, nga çupat shumë punëtore dhe të ndershme. Shkenca dhe arti janë sende që

prítje welcome; waiting
të pashóqe = të pashóqtë unequalled
vjédhës thief
lugétër (lugát) demons
nuk dúan...asgjë they don't fear anything
kórrë reaping; crop
të vjélë harvest
lajthím defect; deception
tradhëtój betray
dítët e lévre work days
lërój plow
bëj ugár make fallow
meremetój renovate
i ndýeri the late; the deceased
haúr = ahúr barn
ofíq shpotítës nickname given in fun
amelikó inn
nëpúnës civil servant
tagramblédhës tax collector
tróKë penniless; broke
i shtrénjtë expensive
ndjésë pástë may he be forgiven
mirëbërës philantropist; good deed doer

nuk njihen prej tyre. I vetmi hall që kanë është një të korrë të mbarë dhe një të vjelë të mirë; e vetmja dëshirë e tyre është që të shkojnë ditët të kënaqur nëpër ara, vreshta dhe kopet' e tyre.

Përgjithësisht brodanasit janë njerëz shumë të mirë, të zotë dhe të virtytshëm. Nuk u njeh veçse një lajthim të vogël, që tradhëton një të metë të madhe: burra e gra e kanë gjuhën ca të gjatë dhe janë gati ta vënë tjetrin në lojë. Ditët e lëvre, brodanasit punojnë, lëroinë, bëjnë ugar, mbjellin, bëjnë dru, korrin. Të dielave dhe ditëve të shënuara ato dëfrejnë ne çdo familie, në krua, në shtëpi apo në kishë qofshin.

Jo shumë kohë më parë, ky fshat i vogël i Brodanit duhet të ketë qenë shumë i madh, si një qytet i vogël, po ta gjykojë njeriu nga dy kishët që ka dhe nga numuri i shtëpive që tani janë gërmadha. Sic del nga fjalët e fshatarëve, kisha më e vogël, që i kushtohet Shën Gjergjit, është e dëgjuar dhe shumë e vjetër; ajo nuk kishte për të qenë sot në këmbë sikur të mos ish meremetuar nga një i pasur i fshatit, i ndyeri zoti Stefan, i cili ndërtoi dhe një haur për drithë dhe një shkollë për djem, mbasi këtu seksi i bukur, i cili e ndjen veten të lumtur nga ky ofiq shpotitës, nuk merr asnjë lloj arësimi. Por vepra më e mirë e këtij njeriu ka qenë ndërtimi i një amelikoje për zyrtarët dhe nëpunësit e qeverisë, për tagrambledhësit e ushtarët që i zë nata udhës, të cilët përpara futeshin nëpër shtëpi dhe kur largoheshin, i linin ata trokë fare me kërkesat e tyre për të ngopur barkun me të ngrënat më të shtrenjta. Sot për shkak të zotit Stefan, që ndjesë pastë, kjo gjendje nuk është më.

Kur zoti Stefan vdiq dhe la pas të shoqen dhe Frosën, të bijën, atë e quajtën mirëbërësin e vetëm dhe të madh të fshatit; për shumë kohë, mot për mot, ngrinin meshë përshpirtje për kujtim të tij në kishën e vogël të Shën Gjergjit, të cilën ai e kish meremetuar.

Në këtë fshat jetonte dhe Xha Vangjeli me gruan e tij të dytë, me zonjën Tanë, e cila, më e lumtur nga një pjesë e shoqeve të saj, nuk e ndjeu kurrë dhëmbjen e ndarjes, mbasi nuk e pa kurrë të shoqin t'i shkonte në kurbet e as ndjeu vuajtjet e tmerret e pritjes; përkundrazi ajo e ndau vazhdimisht shtresën bashkëshortore me të shoqin gjer në vdekjen e tij, që ndodhi kur ky ishte në një moshë shumë të moçme.

thashethéme rumors; gossip
shpotítës ridiculous
mosnderím disrespect
mërí grudge
me mund të saj të madh with great pain

Kështu ky bashkim doli pjellor, mbasi zonja Tanë nxori në dritë me radhë katër djem që rrojtën të gjithë dhe e çuan në kulm lumturinë e nënës së tyre, e cila i shijoji të gjithë gazet dhe dëfrimet e martesës pa hasur kurrë ndonjë vështirësi apo të keqe. Dhe me të vërtetë zonja Tanë ishte e lumtur, prandaj shumë njerëz e kishin zili. Ajo arriti e u bë pesëdhjetë e pesë vjeç grua e besonte se këndej e tutje, lumturia e saj ishte e siguruar, kur befas i shoqi vdiq.

Ky ishte një grusht i rëndë për atë që nuk ish pregatitur fare për fatkeqësitë. Qau shumë e për një kohë të gjatë nuk e ngushullo dot asgjë, megjithëse kishte djemtë. Njerëzve që i rrëfenin të katër djemtë për ta ngushulluar, ajo u përgjigjej e dëshpëruar se asnjë nga djemtë nuk mund ta zinte vendin e të shoqit.

Një dhembje e tillë u duk si një fyerje drejtuar perëndisë, ndaj u trondit i gjithë fshati. Rreth këtyre fjalëve të së vesë, qarkulluan shumë thashetheme të turpëshme dhe shpotitëse dhe njerëzia trillonin lloj lloj gjërash. Flisnin shumë e ngulnin këmbë se sjellja e zonjës Tanë tregonte mosnderim ndaj zotit sa që të gjitha këto ndollën mërinë e qiellit mbi familjen e Xha Vangjelit, e cila gjer atëhere kish qëndruar e fortë.

Mëri qiellore apo thjesht fat, sidoqë të jetë puna, kurrë profeti nuk mori dhe nuk zbatoi kaq lehtë dhe kaq shpejt një vendim.

Po le të kthehemi pas. Vangjeli kishte katër djem: Koçon, Vasilin, Mitron dhe Spiron, të cilët kishin lindur me radhë, njeri pas tjetrit, në aq muaj kohë sa i duhet një gruaje për lindje.

Të ardhurat e familjes së Vangjelit vinin nga tri shtëpi dhe një sasi mjaft e mirë arash dhe vreshtash, që zonja Tanë mezi arrinte t'i mbillte me mund të saj të madh. Mbase është pikërisht për këtë shkak që ajo e kishte ca dhe me perëndinë që nuk i kish falur një vajzë që ta ndihmonte në punë.

Një ditë tek punonte në vreshtë, i mbiu në kokë një mendim: me katër djem, njeriu mund fare lehtë të ketë dhe katër bija të hazërta dhe të përgatitura për punë. Kjo mvaresh nga dëshira e saj e mirë dhe e të shoqit. Atë mbrëmje, në dhomën e gjumit, midis dy bashkëshortëve u zhvillua biseda e më poshtëme:

— E di, o burrë, që sot bëri vapë e madhe dhe dheu ish aq i fortë sa që jam lodhur e këputur mos më keq?

mos më keq in the worst way
laj wash
blíaj mill
vadít water
kártë card
mexhíte Turkish coin
qiamenë = kiamét uproar
mëngjërásh left handed

— E gjora grua! Nxito e shtrihu këtu pranë meje e do të çlodhesh menjëherë...

— S'ta kam atje fjalën...

— Për fat të mirë, nesër gdhihet e djelë e ti nuk do të kesh asgjë për të bërë!

— Asgjë për të bërë? po të larët? po të bluarit? po të vaditurit e kopshtit? Gjithë kjo punë nuk është asgjë për ty, që e shkon tërë ditën e ditës duke luajtur kartrat nën hijen e rrapeve të kishës...

— Për këtë mos më mbaj mëri! Që nga mëngjezi e gjer në mbrëmje fitova e të solla një mexhite të bukur rrumbullake, e cila u rrokullis e doli nga zhepi i të gjorit Xha Mitro, që më rrinte përballë e thërriste e bërtiste e bënte qiamenë. Duhet ta pranosh që nuk e kalova kot ditën, ndaj eja e puthmë me gjithë zemër!...

— S'ta kam atje fjalën!...

— Po përse e ke fjalën?...

— E ç'na lipset që kemi djem? Bredhin e lozin tërë ditën e ditës, hanë sa për katër, por...

— Katër janë me të vërtetë.

— Dhe nuk punojnë dot as sa një çupë e vetme. Sikur të kisha një çupë, sot do ta kisha krah të djathtë.

— Thuaj më mirë krah të mëngjër, se ti je mëngjërashe...

— Njësoj është. Dua të kisha një çupë, kjo është e tëra...

— Dhe përse nuk e bëre?

— Se mos është faji im?

— Po se mos është imi, moj grua?

— Jo me fjalë...

— Ah! e po qysh, atëhere?

— Po, po, këtë ti e ke në dorë. Mjafton të duash edhe ti e të kërkosh ashtu si unë të kesh një çupë e ne atëhere do të kemi një, e dy, e katër!...

— Prapë nise të xhindosesh?

— Këtë e bën ti që s'ka ditë mos më zemërosh duke mos më plotësuar edhe dëshirën më të vogël.

— E mirë ahere, nuk dua që ti të më mbash mëri dhe dua të të bëj me çupë që sonde, vetëm ama po të jesh akoma e zonja për të pjellur. Në është kështu, eja të biesh, por shpejt...

— S'ta kam atje fjalën. Unë dua të më kuvendosh siç duhet e të më japësh lejen dhe fjalën tënde.

xhindósem am possessed
fóshnjë baby
është me shtat...márshalla is well built, thank God
në të párë in looks
takát strength
së ndýerës my late wife
hem...hem both...and
kopáçe switch; stick

— Po, po, po! Ja, tri herë po!...

— E kështu atëhere ta martojmë Koçon fët e fët, apo jo?

— Për Krisht, qenkam budalla! Tani e mora vesh! Po, moj grua, a nuk të duket që është akoma fëmijë, foshnje fare?

— Foshnje, foshnje! Në trembëdhjetë vjeç sot s'ka më foshnje, le që Koçua ynë është me shtat e me boj marshalla! Në të parë s'i jep njeriu kurrë më pak se tetëmbëdhjetë vjeç! Ti u martove dymbëdhjetë vjeç me gruan e parë!

— Të tjera kohë, të tjera zakone...

— As kohët nuk ndërruan, as zakonet! Pse, a nuk e martoi të dielën e shkuar xha Mitrua djalin e dytë që mezi është dymbëdhjetë vjeç? Dhe e shoq' e tij, zonja Maro, nuk ishte vetëm ashtu si dhe unë? Pa mendo një herë: nuk kam më takat të punoj vetëm dhe në arat dhe në vreshtat e tua. Të kam bërë e të kam rritur katër djem që më kanë këputur fare.

— Opopo! dhe mbase akoma s'i kemi dhënë fund! Sa keq që ti nuk i paske ngjarë së ndyerës që në dhjetë vjet martesë nuk dështoi veçse një herë!

— Ah! Ti guxon akoma të qahesh duke kujtuar atë të parën dhe t'i quash hiç tërë ato që të kam bërë unë? Apo nuk e di ti që kush ka një djalë ka një thesar! Kurse ti ke katër...

— Katër djem dhe asnjë thesar! Katër djem që na kushtojnë sa gjashtëmbëdhjetë...

— Punë të madhe që të kushtuakan djemtë ty, që s'mendon gjë tjetër veçse ku e ku të lozësh kartrat! Kurse unë duhet të kujdesem hem për brenda, hem për jashtë!...

— Tani mjaft! Se këtu zot shtëpie jam unë! Dhe mos më shtrëngo të ta kujtoj me kopaçe si ngjan shumë herë! Eja bjerë se me bërbëret e tua do të më shkallosh nga mendja fare... Duk me të shikuar që qan pa rrahur, panden njeriu që je me të vërtetë e mjerë.

— Pa fjalë që jam e mjerë, kur jam katandisur në këtë hall, kur nuk kërkoj gjë tjatër përveç se lumjen e djemëve tanë dhe tonën...

— E po mirë! Mbase dhe ke të drejtë. Ulu këtu të kuvëndojmë shtruar. Ç'grua ke zgjedhur për Koçon?

— Sa për këtë, i kam rregulluar punët si jo më mirë. Për bukuri s'e ka shoqen në fshat. është e kolme.

bërbëre nagging
katandísem find myself; wind up
i kólëm comely
i bútë soft; mild
prashít hoe
le që besides
mízë flea; small insect

e shëndoshë, e butë si manare, e pa lodhur në punë dhe të prëhet shpirti ta shikosh të punonjë, të prashitë, të korrë a të bëjë dru. Le që ti e njeh dhe vetë si dhe unë Froson, të bijën e Basho Brodanit.

— Frosua, vërtetë, është çupë e mbaruar me të gjitha, por, moj grua, ajo është të paktën nja gjashtë vjet më e madhe nga djali ynë.

— Punë e madhe! Apo mos të thotë mendja se dua të marr në shtëpi një mizë për ta rritur? Apo nuk jam unë më e madhe nga ti e megjithatë të kam pjellur katër herë e me gjithë punët e lodhjen mbaj akoma mirë, kurse ti...

— Këto janë gjëra të shkuara! Po e shoh që sonte është e pamundur të mirret njeriu vesh me ty! Po i pranoj të gjitha sa thua, vetëm se unë i kam duart të lara në këtë mes.

— Këtë e marr unë përsipër.

— E tani, leri fjalët, eja të biesh se goditi mezi i natës.... Qysh? Kështu me gjithë rroba?...

— Ti e di mirë, o burrë, se nesër do të ngrihem që menatë se kam shumë për të bërë.

— Eja, s'ka gale, për mua njësoj është, se edhe me këto rroba trashanike të punës, të gjej dhe disa shije të veçanta me të cilat më ke mësuar që prej kohe! Eja!...

. . . . . .

Një muaj pas kësaj bisede, të cilën ne e riprodhuam tërësisht, Koçua ishte vluar dhe martuar. Me sa duket, përpjekjet e zonjës Tanë nuk qenë kush e di çë, mbasi asnjë vështirësi apo kundërshtim nuk i erdhi asaj prej çiftit të ri, të cilin në Shqipëri s'e pyet njeri fare për bashkimin e tyre e as i merr mendimin, as ngatërresa pati për punë të pajës, që është krejt e huaj për zakonet e vendit. Këtu gjëria martojnë bijat e tyre për të punuar nd'arë, ashtu si gjetkë i martojnë vetëm e vetëm për para. Në asnjë vend njerëzit nuk martohen vetëm për t'u martuar. Të kërkosh këtu dashurinë e vërtetë është njësoj sikur ~~të kërkosh~~ yjet në mesditë.

Për të qënë të saktë, ne duhet të shënojmë se zonjushë Frosua iu nënshtrua këtij bashkimi me zemër pak të thyer, se nga shkaku i moshës së saj, ishte mjaft e zhvilluar dhe kishte njohuri më të shumta rreth martesës se sa i shoqi i vogël, i cili, për dy vjet me radhë pas martesës, e quante të shoqen, e me gjithë zemër, motër. Me trembëdhjetë vjetët që kishte nuk mund të bënte gjë tjetër më të mirë!...

kétë e...përsípër I take responsibility for this
s'ka gále = s'ka gájle it doesn't matter
vlúaj engage
pájë dowry
nuk qénë kush e di çë didn't amount to much
gjëri = njerëzí
këmbím change

(Pas djalit të parë, Tana martoi dhe djemt e tjerë, por befas Vangjeli vdes. Atëhere në karakterin e kësaj nëne ndodhin këmbime, të cilat bëhen shkas për grindje. Grindja arrin aq e madhe sa që nuk pushon edhe kur vëllezërit ndahen. Këtyre u duhen shtuar thashethemet e fshatit, që ua bënë të padurueshme jetën katër vëllezërve. Atëhere këta japin besa-besën që të largohen e të shkojnë në kurbet).

Pregatitjet për udhëtim nuk qenë dhe aq të gjata. Dita e nisjes arriti.

Kjo ishte një ngjarje e madhe për fshatin e vogël të Brodanit, i cili ishte i vetmi nga të gjitha fshatrat rreth e qark që gjer atëhere nuk e kishte ndjerë zakonin e kurbetit, s'e kish parë veten të lënë shkretë e të braktisur nga banorët e vet që të iknin për të gjetur gjetkë mjete rrojtjeje.

Ikja e djemve të zonjës Tanë, të cilën intrigat dhe thashethemet e kishin bërë të nevojshme, qe, pra, fillimi i një zakoni dëmprurës, sepse u pasua nga shumë të tjera që sollën si përfundim çpopullsimin e fshatit dhe prishjen e shkatërrimin e familjeve. Kjo e bëri një plak të fshatit të thotë: «Me fatkeqësinë që u sollëm të katër vëllezërve, ne i bëmë vetes një dëm më të madh nga ai që deshëm t'u bënim djemve të Vangjelit. Nuk do të mbeten pa u dënuar edhe thashethemet edhe intrigat që i detyruan të katër vëllezërit të lënë vëndin e tyre për të kërkuar paqen e qetësinë gjetkë, aq është e vërtetë sa që njeriu ç'bën do ta pësojë.»

Mbase është nga ndjenja e frika e këtij dënimi, që ditën kur do të niseshin të katër vëllezërit, s'mbeti familje pa derdhur lot dhe pendimi qe i shpejtë e i menjëhershëm, gjë që tregon, nga ana tjetër: edhe kthimin e ndjenjës mirëdashëse të gjindjes për ata që po iknin, ndjenjën e simpatisë të fshatarëve, të cilët një ditë më parë nuk kishin për ta veçse inat dhe urrejtje!..

Mëngjezin e ditës që do të shkonin, të dyqind e gjashtëdhjetë banorët e fshatit, burra e gra, të mëdhenj e të vegjël, u mblodhën përpara shtëpisë së Koços, nga ku do të niseshin të katër vëllezërit, për t'u uruar udhën e mbarë, të shkonin shëndosh e mirë e të ktheheshin shpejt.

çpopullsím depopulation
njeríu...ta pësójë man will reap what he sows
përcúall (përcjéll) saw off
mud = mund (m.) can; could
mirëmbéç farewell
prékës emotionally moving
rënkím moan; labored breathing

Fshatarët i përcuall me këngë e me krisma pushke gjer në Shend' Illi, nja dy orë larg fshatit. Nuk kënaqeshin e gëzoheshin nga që i shikonin të iknin, siç mud të besohet, se kjo që po u bënin ishte një nder i madh nga ana e fshatit, aq e vërtetë sa që dhe sot akoma veprohet kështu pa as më të voglin ndryshim.

Në Shend'Illi, i cili që atëhere është bërë vendi i ndarjes së fundit i atyre që mbeten dhe u urojnë udhën e mbarë atyre që shkojnë, i vetmi vend i «mirëmbeçit» të fundit, këngët pushojnë menjëherë, po ashtu dhe krismat e pushkëve dhe pamja bëhet prekëse edhe për zemrat më të forta.

Nuk dëgjohen veçse të qarat dhe rënkimet e nënës së gjorë dhe të kunatave.

Erdhi dhe çasti i fundit. Secili nga të katër vëllezërit, pushton për të fundit herë të shoqen dhe bashkëfshatarët, i mallëngjyer, me buzë në gaz e lot në sy;. pastaj të gjithë tok, si një trup i vetëm, hypin në kuaj dhe largohen e zhduken nga sytë e nënës dhe të grave të tyre, të cilave u bie të fikët.

Është për të vënë re se të gjithëve sa u ndodhën aty, pa përjashtim, u ardhi keq për të pesë gratë e shtrira në dhé si të goditura nga hidhërimi. Nxituan t'i ngrinin e t'i ngushëllojnë sa më mirë që të mundnin. Këtu zonja Tanë e pa për herë të parë se si po e nderonin dhe si të gjithë kishin ndryshuar qëndrim ndaj saj, veçanërisht nënat dhe etërit, të cilët natyrisht e kuptonin më mirë dhëmbjen e saj.

Si vuri re këtë ndryshim të shpejtë, të cilën nuk e priste fare, kjo grua e çuditshme e mbajti veten, fshiu lotët, u ngrit më këmbë, i buzëqeshi gjindjes si për ta falënderuar e pastaj ra në gjunjë për t'u falur; kështu bënë edhe gjithë të tjerët. Pastaj ajo u ngrit në këmbë e duke patur qark nuset, të cilat përpiqej t'i ngushëllonte, u drejtua për në fshat e shoqëruar nga të gjithë fshatarët si në triumf, dhe që prej asaj dite askush nuk e mori më nëpër gojë, me që tani ajo vuante e nuk ishte më e lumtur që ta kishte kush zili.

Një ditë, zonja Tanë thirri në shtëpi zotin prift, të cilit i diktoi, e ndihmuar nga nuset, me që gratë shqiptare nuk dinë të shkruajnë e të këndojnë, letrën e mëposhtëme. të cilën ne po e riprodhojmë tërësisht:

me bie të fíkët faint
hidhërím despair
zilí envy
këndój = lexoj
sëkëlldí torment
qedér worry; anxiety

Të shtrënjtët djemt e mi,
Të shtrenjtët burrat tanë,

Jam unë nëna juaj që ju shkruaj dhe jemi ne gratë tuaja që ju shkruajmë.

Ja, sot mbushen plot njëzet vjet që ju nuk na shkruani fare, as nënës suaj, as grave tuaja. Jeni gjallë apo s'jeni gjallë? Sidoqoftë na u përgjigjni shpejt se heshtja juaj e gjatë ka shtirë mua, nënën tuaj dhe ne, gratë tuaja, në një sëkëlldi për vdekje.

Ne gjer më sot gjallë jemi, por kemi shumë qeder për ju që nuk jeni me ne.

S'ka gjë nëqoftëse ju nuk keni fituar dot shumë para, kthehuni në vend tuaj, ku dashuria jonë, e nënës suaj dhe e ne grave tuaja, do t'ju shpërblejë për të gjitha ç'keni hequr nga shkaku ynë e i thashethemeve.

Unë nëna juaj jam plakur shumë dhe nuk dua të vdes e të më mbyllen sytë pa ju parë juve.

Ejani pra për dashurinë e Perëndisë dhe për kujtimin e të ndyerit atit tuaj.

Ne i japim këtë letër zotit Dhamo Koto nga Topova, që shkon nesër për në Stamboll dhe që s'dimë në do t'ju gjejë.

Nënshkruar:

Tanë Vangjeli
Froso Vangjeli
Kato Vangjeli
Lenë Vangjeli
Pepe Vangjeli

Mirret vesh pra që i mbari prift s'ish dhe aq i mbaruar në literaturë si në theollogji.

Si u shkrua letra, u puth me radhë nga zonja Tanë dhe nuset, pastaj prifti shkroi mbi zarf: «Për zotërinjtë të katër djem të Xha Vangjelit nga Brodani, në kujdesin e zotit Dhamo Koto nga Topova».

Po atë ditë zonja Tanë ja hipi mushkës për të vajtur në fshatin e Topovës dhe dorëzoi letrën e sipërme te zoti Dhamo Koto duke iu lutur shumë që t'ua dorëzonte djemve të saj po t'i takonte gjëkundi.

strehím lodging
pak si e paúdhë not quite right
shtatzënë pregnant
së tépërmi endlessly
përgjój watch; eavesdrop

ERIC

(Zoti Dhamo Koto i takon djemt e Xha Vangjelit, të cilët vendosin të kthehen në fshat mbasi lenë më të voglin, Spiron, që të kujdeset për pasurinë që kanë vënë në kurbet. Tre vëllezërit e tjerë, Koçua, Mitrua dhe Vasili, arrijnë në fshat në mbrëmje dhe vendosin që t'u shkojnë qrave të tyre pa ju çfaqur. Kjo u kushton atyre jetën. Kështu Koçua vritet nga nëna dhe e shoqja, të cilat nuk e njohin dhe e vrasin për t'i marrë paratë. Kur do të marrin vesh të vërtetën ato do të çmenden).

Ndërsa kjo vrasje e tmerrëshme i ndodhte Koços, i cili vdiq i goditur nga e ëma dhe e shoqja, një dramë jo më pak e shëmtuar kishte ngjarë në shtëpinë e Vasilit.

Ashtu si Koçua edhe ky, duke u paraqitur si njeri që e kish zënë nata udhës, kërkoi nga e shoqja strehim, që ju dha menjëherë. Por kjo gjë atij i shëmbëlleu pak si e paudhë për një grua që jetonte e vetme në shtëpi. Të mjerit as i shkonte fare në mendje që kishte një djalë me që, ashtu si Mitrua dhe Spirua, nuk e dinte që kur ish larguar e kishte lënë të shoqen shtatzënë.

Dhe për këtë arësye prania në shtëpinë e tij të një të riu njëzetvjeçar, i cili tregohej shumë i afërt me të shoqen e tij, jo vetëm që e çuditi, por edhe e dëshpëroi së tepërmi zemrën e këtij burri. Mezi e mbajti veten dhe nisi të përgjojë me kujdes të gjitha lëvizjet dhe punët e atij që ai e pandehte dashnor.

Katua e vuri të panjohurin në një dhomë më vete dhe pastaj, bashkë me të birin, u tërhoq në dhomën pranë. Duke mos i vënë veshin veçse zërit të zilisë, Vasili nuk u lodh të rrijë prapa derës dhe të përgjojë. Dhe kështu arriti të kapë këtë bisedë.

«Sikur mos të të kisha ty, mor Aleks i dashur, nuk e di se si do të isha katandisur!»

Me sa dukej njeriu që thoshte këto fjalë po qante se ai tjetri iu përgjegj kështu:

«Sikur të më doje me të vërtetë nuk do ta kaloje kohën duke qarë kësisoj. Ti e di që unë të dua shumë dhe përveç teje nuk dua asgjë tjetër në botë».

«Ti e di mirë, Aleks, që dashuria jote më ka ndihmuar kurdoherë për të duruar të gjitha fatkeqësitë që më kanë rënë mbi kokë».

me véte by himself
nuk u lodh wasted no time
me sa dúkej apparently
hakmárrje revenge
dollap closet
revóle revolver
i mbúshur loaded; filled
shpërngúl move out; displace

«Atëhere mos qaj më. Eja përqafomë dhe shko të biesh. Unë do të rri dhe ca sa të mbaroj këtë roman që ma huajti një shok këtë mëngjes. Është shumë i bukur, ka të bëjë me një dashnor që vrau të dashurën sepse ajo donte një tjetër».

Kjo bisedë e bindi Vasilin se e shoqja e tij, të cilën ai e kishte lënë këtu e njëzet vjet përpara, e kishte tradhëtuar. Nga inati nuk dinte ç'të bënte dhe ziente i tëri nga dëshira për hakmarrje. Por nuk kishte me vete as edhe një armë, as edhe një thikë!

Nisi atëhere të kërkojë nëpër dhomë dhe më së fundi gjeti në një dollap një revole që dukej se ishte e të birit. Me një gaz të egër u sigurua që ishte e mbushur e pastaj u drejtua nga dera, të cilën e hapi me një shkelm të fortë dhe u vërsul në dhomë, vrau në krye të shoqen, pastaj atë që e pandehte dashnorin e, më në fund, doli jashtë, në udhë e hyri në shtëpinë e Mitros që ishte aty afër. Ky i doli përpara me që të dy krismat e kishin bërë të hidhej përpjetë, por kur i pa revolen në dorë erdhi u tmerua, sidomos pastaj kur dëgjoi vëllanë t'i thotë:

— Mitro, gruaja ime më gënjente me një djalosh afro njëzet vjeçar, po unë i vrava edhe njërin edhe tjetrin me këtë revole që ja..

— Ç'bëre, o derëzi! — i briti Mitrua, duke mallkuar fatin e keq. — Në inat e sipër dhe i verbuar nga zilia ti ke vrarë gruan dhe djalin tënd! Se mëso, o Vasil, se ti dhe unë, kur ikëm i kemi lënë gratë shtatzëna.

— Atëhere, Mitro, djaloshi që ishte në shtëpi time dhe që unë e vrava, qënka im bir?

— Po, mor i gjori vëlla!

(Tregimi mbyllet me shkatërrimin e krejt kësaj familje. Vasili arratiset maleve. Zonja Tanë dhe Frosua vdesin të çmendura në një manastir, ndërsa Mitrua shpërngulet me gjithë fëmijë nga fshati).

Andon Zako Çajupi "Historia e një familie"
Néndori (Tiranë) XIII, 3 (March)
1966, pp.155-167

LEXIMI I NENTEDHJETESHTATE

NJOHJE

Tregim

Gazetari i ri qe i pakënaqur. Kjo gjendje i përngjiste një dëshpërimi të lehtë, sepse ai nuk e kuptonte mirë nga i vinte mërzia atë mbasdite, ndërsa priste në një lokal të vogël buzë xhadesë makinën e zakonshme të linjës. Kafenë e kishte pirë me tri gllënjka të mëdha dhe prandaj kishte përcëlluar pak qiellzën. Tani detyrohej ta provonte me gjuhë herë pas here atë vendin, ku, siç dukej, po formohej një flluskë e vogël. Në lokal s'kishte njeri tjetër veç tij dhe banakierit, një burrë i trashë e si i përgjumur, që seç fliste me vete e që nuk e vështronte fare klientin e vetëm. Avulli zhuzhuronte në aparatin e kafes. Atij i shkrepi ta krahasonte aparatin cilindrik që shkëlqente e zhuzhuronte me banakierin dhe krahasimi iu duk zbavitës.

Gazetari i ri bënte vjersha dhe kohët e fundit kishte bërë disa prova edhe në prozën e shkurtër. Një tregim ia kishte botuar gazeta «Drita». Duke qenë një gazetar që aspironte përditë të afirmohej edhe në letërsi, ai u ishte lutur shokëve të gazetës ku punonte që ta dërgonin sa më shpesh me shërbim në zona të largëta, ku, sipas tij, trualli qe akoma i virgjër për shkrimtarët.

Gjatë vitit të parë në punë, pas mbarimit të fakultetit të gazetarisë, ai kishte etje të madhe për të thithur gjithçka nuk kishte mundur të mësojë në njëzet vjetët e tij, që i kishte kaluar në qytet si djalë nëpunësi që qe. Kështu, atij i ishte mbushur mendja top, se kishte njohuri të pakta në shumë fusha të jetës. Nuk i njihte siç duhej, ta zëmë, llojet e drurëve, të pemëve, bile edhe të kafshëve. Sa herë kujtonte një ndodhi nga fëminia e vet, i skuqeshin veshët dhe shtrëngonte grushtat si për të përforcuar premtimin që i kishte bërë vetes për të «thithur»

njóhje knowing; intuition
lokál establishment
gllënjkë gulp
qíellzë palate
fllúskë blister
si i përgjúmur kind of sleepy
zhuzhurój hiss
aparát i káfes coffee pot
afirmóhem become recognized
top completely
ta zëmë for example
përforcój strengthen

sa më shpejt gjithë ato që nuk ia kishte dhënë jeta e tij prej qytetari. Atëhere, në fëmini, kishte shkuar me nënën në fshat, për një dasmë dhe ndajnat-herë, kur vinin kopetë, ai qe trembur shumë nga... dhitë. Oe strukur pas fustanit të nënës dhe ato kafshë të urta me brirë, që qëndrohin pranë tij dhe kruheshin e lëpinin gurët e murit, iu dukën aq të frikshme sa edhe djajtë e përrallave të gjyshes. Edhe tani që qe rritur e bërë gazetar, që kishte penë dhe «nerv», siç thoshnin, ai e ndiente se kjo ndodhi nuk kishte shkuar pa lënë gjurma tek ai. Sa ia kishte zili një shoku të vet, i cili qe djalë fshati, që kishte bërë një jetë më interesante e që i rrëfente nganjëherë se si kishte zënë lepura me leqe kur ishte i vogël, se si kishte ruajtur misrin nga baldosa, që në anën e tyre i thoshin dosbalë, se bile kishte mësuar nga arixhijtë të thurte sepete me thupra shelgu. Kurse ai dikur ngatërroi shelgun me plepin kanadez!...

Udhëtonte njëherë, kur bënte stazhin, për në Alpet e veriut, bashkë me një gazetar të vjetër. Ky ishte gazetar me përvojë të madhe. Gazetari i ri e kishte pritur me padurim këtë udhëtim. Në përfytyrimin e tij, veriu e malet e tij qenë vendet e kreshnikëve, djepi i legjendave dhe ai besonte se çdo shkëmb e brinjë, çdo urë e gurë mbi lumenjtë, kishte sigurisht një gojdhënë që zinte fill tek trimëria proverbiale e malësorëve, një bëmë tragjike që rridhte nga zakonet, doket, kanunet e nga gjakmarrja në pusi e pritarëve. Ai e pandehte gazetarin e vjetër një enciklopedi të vogël, meqë tërë jetën kishte udhëtuar. Posa hynë në luginën e Drinit, rrethuar me male të larta, ai filloi ta pyeste për çdo gur e çukë që i zinte syri: «Si quhet ky vend? Pse quhet kështu? A ka ndonjë gojdhënë?» Gazetari i vjetër dinte vërtet ca gojdhëna, po kur pa se kureshtja dhe naiviteti i tij s'kishin të ngopur dhe sidomos kur vuri re se si u zhyt rrëmbimthi mbi bllokun e shënimeve, porsa zunë vend në hotelin e Bajram Currit, duke i mbushur fletët me ngut me mbresa, emra vendesh e gojdhëna, sikur trembej se mos i roniteshin nga kujtesa; ai vuri buzën në gaz e mendoi t'i punojë një reng të thartë, po të domosdoshëm. Ditën tjetër, kur vazhduan udhëtimin, ai zuri të thurte vetë legjenda. Në çdo pushim, gazetari i ri nxirte bllokun, të lidhur me kapakë të bukur ku qe shënuar mbi një letër të bardhë vetëm: viti 1972 dhe shënonte me ngut «legjendat» që dëgjonte për trimat e vrarë prapa shkëmbenjve. Kur mbaroi udhëtimi, gazetari i vjetër i tha si me të qeshur, po edhe seriozisht, që të mos bënte gabim ta merrte për monedhë, të pastër çdo gjë që i kishte treguar, sepse fundja nëse e kishte të privuar deri diku fantazinë si gazetar, në shkrimet e veta, ai kishte të drejtë të fantazonte sa të donte në jetë. I tha se natyrisht çdo

ndajnat hérë early evening time
krúhem scratch
djaj (djall) demons
léqe (lak) snares
baldósë swine
arixhí gypsy
sepétë basket; hamper
thúpër thin rod or strip
kanadéz Canadian
bëj stázhin am in training
djep cradle
brínjë hillside; side
bëmë event
dókë tradition
pritár ambusher
çúkë peak
ngut urgency; hastiness
ronít fade away; wear away
kujtésë memory
reng trick
monédhë coin
privój deprive

vend ka shumë më tepër gurë, ura, shkëmbinj, brinja e majëmale se sa legjenda për to, po edhe sikur secili të kishte nga një histori, gjë që kishte të ngjarë, prapë qe e pamundur që ato t'i dinte të gjitha një njeri i vetëm, sado i shëtitur të ishte. Nga uthulla e kësaj shakaje, gazetari i ri e humbi përkohësisht një pjesë të konsiderueshme për gazetarin e vjetër, po kjo qe humbje e përkohshme, se pas disa ditësh daktilografistja, Zana, i tha se në prani të saj, gazetari i vjetër e kishte mburrur në sy të kryeredaktorit duke i thënë se qe një djalë i mrekullueshëm, i pastër dhe pakëz naiv. Me sa duket, Zana nuk e dinte fort mirë domethënien e dyfishtë të fjalës «naiv», që është një nga ato fjalët e rralla që kanë brenda të mirën dhe të keqen, mirëpo ai e dinte këtë dhe e vuri vëth në vesh.

«Vërtet, mund të mos jesh tamam naiv, po ka ca rrethana që të vënë në këtë pozitë», mendoi ai dhe u betua,që të tregohej më i kujdesshëm në ato rropatjet e tij për të «thithur» të panjohurën. Këtë gjë e diskutuan një ditë në një rreth shokësh. Të gjithë ishin të një mendimi se ende kishin shumë gjëra që i njihnin perceptazi, aqsa të mos guxonin t'i përdornin si duhet në shkrimet e tyre, po kur vinte fjala se si duhej mbushur kjo zgavër, mendimet ndaheshin. Ai kishte besim se njeriu mund ta mbushte shpejt këtë boshllëk, mjafton të jetë kureshtar, i futur te njerëzit e sidomos të mbajë shënime, sa më shumë shënime dhe në çdo kohë.

Edhe në këtë shërbim, ai kishte mbajtur mjaft shënime, megjithatë, tek rrinte në kafene dhe i ndërmendte takimet e bisedat, atij nuk i ndahej ndjenja e pakënaqësisë nga vetja. Nuk kishte dyshim se shkrimi për gazetën i kishte dalë. Do të qe një shkrim i mirë, që po t'i jepte lexuesit mjaft informacione, që do t'i krijonte një përfytyrim të saktë për jetën e punën e barinjve dhe kryebariut Nexhat, që ishte protagonisti kryesor i reportazhit të tij. Po prapë i mbetej diçka e mangët, e pathënë, e pazbuluar që ta trondiste thellë shpirtin e tij prej krijuesi dhe ta detyronte kështu që, prej gjithçka kishte parë e dëgjuar, të bënte një vepër letrare, të krijonte një karakter të vërtetë me tërë gjërësinë e tij shpirtërore. Kjo qe e domosdoshme për letërsinë. Dhe, siç thamë, ai tani kishte kaluar nga faza e aspirimit të fshehtë për t'u bërë shkrimtar dhe qe hedhur me tërë rrëmbimin e pasionin e njezet vjetëve në krijimtarinë letrare.

Kur mësoi nga një lajm në gazetën lokale për ndodhinë e kopeve që shtegtonin për në vërri, ai u trondit, me atë dridhjen përpëlitëse që u ndodh vetëm atyre që shkruajnë kur e nuhasin subjektin, dridhje që u pushton befasisht tërë mendi-

i shëtítur well traveled
úthull vinegar
daktilografíst typist
vëth pendant
rropátje effort
përcíptazi on the surface
áqsa so little
që po = që do (mp.)
reportázh story
i mángët wanting; lacking
gjerësí breadth
ndodhí story; event
shtegtój journey; migrate
vërrí winter lowland pasture
përpëlítës convulsive

met e ndjenjat, duke vënë në dremitje të përkohëshme gjërat e tjera që i preokupojnë deri atë ditë. Ky është, si të thuash, përjetimi i dyfishtë i shkrimtarit, i jetës së vet dhe asaj të heronjve, «vuajtja» e tij kryesore për aq kohë sa atij t'i duket se gjithçka që e ka tronditur, se gjithçka që e ka rijetuar me vrull, me dashuri apo me dhëmbje, ka marrë formën e krijimit nëpër rreshtat e fjalëve.

Edhe ai e nuhati se këtu qe letërsia dhe u ngut të nisej. Paçka se lëndën do ta shfrytëzonte edhe për gazetën. A nuk kishte hërë një tregim të fortë një shkrimtar duke marrë shkas nga një shkrim në gazetën lokale? Ngjarjen, në vija të trasha, ai e dinte. Kopetë e dhenve të një ndërmarrjeje blegtorale, duke shtegtuar, i kishte zënë një dëborë e hershme. Dëbora kishte rënë natën, kur dhentë rrinin tulatur në vatha dhe kishte shtruar aq shumë sa dhentë me ato këmbë të shkurtra e të ngathta, nuk ecnin dot. Brenda këtij rrethimi të ftohtë, të palëvizshme si copa cungjesh, dhentë u rrezikuan të ngordhnin. Mirëpo barinjtë mundën të çajnë një shteg, i hoqën deket kokë më kokë, të raskapitur nga lodhja dhe, më në fund, i çuan buzë lumit ku kishte vetëm një cipëzë të hollë dëborë. Në përfytyrimin e tij kjo ngjarje, që kishte në thelb ndeshjen e përjetshme të njeriut me natyrën dhe fitoren e njeriut mbi të, kishte nisur të marrë ca trajta artistike. Që tani ai përshkruante me mend dhentë e gjora, ngujuar brenda një bardhësie pa fund, ku ato, ndonëse edhe vetë të bardha, dukeshin si ca bashka të palara leshi, ato kurrizet e rrumbullakët e turinjtë e errët që shfrynin avull nga vuajtja, malin mbushur me blegërima dhe pastaj ata të tre, dy barinjtë dhe kryebariun Nexhat Kaso, që i shkulnin një e nga një prej ngurtësimit ngordhës, duke i tërhequr branë deri sa t'i bënin qënie të lëvizëshme, duke u sjellë prapë jetën që po u shuhej. Gazetari i ri besonte shumë në gjetjen e ngjarjes. Ai u përkiste atyre tregimtarëve që besojnë se, po të jetë ndodhia tërheqëse, dramatike, tronditëse, puna e mëtejshme vetë vaj dhe suksesi është i sigurt.

Në fshatin e madh Damjan, ku ndodhej një baxho që përpunonte qumështin e kopeve shtegtare, i thanë se tufat kishin ikur prej disa ditësh dhe tani duhej të qenë nga Dangëllia, por zor se do t'i gjente barinjtë aq shpejt sa mendonte. Ai u dëshpërua. Shërbimin nuk e kishte aq të gjatë sa do të dëshironte, megjithatë, u turr me makinë të rastit që t'u dilte kopeve diku në shtigjet e kalimit. Nata e zuri në qytetin e vogël e të qetë Leskovik, ku s'kishte qenë kurrë. Këtu nuk njihte njeri. Pyeti për hotelin dhe i treguan një godinë dykatshe përkundrejt një pallati në ndërtim e sipër. Ai kishte fjetur në

dremítje sleepiness
përjetím way of life
paçká so what
shkas inspiration; cause
tulátur huddled
váthë pen; corral
i ngáthët sluggish
cung log; stump
rrezikój endanger
i raskapítur exhausted
cípëzë layer
trájtë shape; form
i gjórë poor; unfortunate
ngujój besiege
báshkë fleece
i paláre unwashed
blegërím bleating
ngurtësím sluggishness
bránë over the ground
tërhéqës appealing
véte vaj goes smoothly
báxho dairy
túrrem rush out
makínë të rástit the car at hand

shumë hotele dhe mendonte se të gjithë kishin diçka të ngjashme e të përbashkët. Ky hotel iu duk ndryshe, çuditërisht i afërt e shlodhës. Koridoret dhe holli i vogël shtruar me drrasa të zbardhura nga larjet qenë mbuluar me shkorsa prej leshi endur në artizanatin vendas. Drrasat kërcisnin butë nën hapat e tij dhe kjo ishte një zhurmë e ëmbël dhe e dashur, që të kujtonte shtëpinë. Kështu, ky hotel po i përngjiste me një shtëpi të madhe mikpritëse dhe portieri i natës, që shkruante emrin e tij ngadalë në regjistër, duke ngjyer penën në një kallamar me bojë gushpëllumbi, ishte si i zoti i shtëpisë që bën mikpritjen bujarisht pas një ceremonie të vogël. Të gjitha këto çaste seç kishin diçka ledhatuese e nanuritëse që i sillnin një ndjenjë kënaqësie, një ngjethje të këndshme, siç ndiejnë kur na duket se, papritur, po rijetojmë një copë nga fëminia, nga përkundjet e gjyshes nëpër gjumë, me përrallat gazmore të qerozit.

La çantën e udhëtimit mbi komo dhe zbriti shkallët ngadalë. Shkallët kërcisnin edhe ato, po kjo ishte një zhurmë e pëlqyer, që ta kishte ënda ta dëgjoje. Hyri në kafene dhe porositi ponç portokalli. Mbrëmja qe e freskët dhe ai ishte i veshur hollë, siç vishen nganjëherë njerëzit e kryeqytetit që harrojnë se ka edhe qytete e fshatra të ftohta. Në kafene kishte shumë klientë, por ai asqë shpresonte të njihte ndonjë. Mbi një podium në formë potkoi luante një orkestrinë e vogël prej tre instrumentistësh. Ai ndihej tani fare me nge dhe prandaj zuri i kundrojë sallën e instrumentistët. Violinisti, një burrë kuqalash me moshë të mesme, vështronte gjindjen me një palë sy të lodhur, ku tulatej një ankim i fshehtë, po përkundër dukjes. këndonte këngë gazmore me një zë të lartë tenori, i munduar keq nga përpjekja për të arritur notat e larta. Gazetari mendoi se violinisti kishte një brengë, e cila shpreheJ në mënyrë të mundimshme nëpërmjet zërit të dredhur, që dukej se qe jo vetëm i njohur, po edhe i pëlqyer nga klientët. Ai tha me vete se nganjëherë për krijuesin është shumë interesante të rrijë i panjohur midis shkujdesjes së njerëzve dhe të vërejë e të vërejë me nge se ç'bëhet, duke qenë vetë i patrazuar nga kërshëria e ndokujt. Të jesh njëkohësisht brenda dhe jashtë rrjedhës së jetës së njerëzve, duke patur të mprehur dhuntinë e vrojtimit e të qëmtimeve psikologjike, siç mund ta ketë një shkrimtar i vërtetë, kjo është diçka që s'të bie ta jetosh aq shpesh.

Atë mbrëmje, po të gjykojmë nga disa arsyetime të tilla, me sa dukej, gazetari i ri ishte pak i vetkënaqur, i ngopur me ëndërrime për të ardhmen e tij, për gjithë ajo ndodhi që do të vinin e do të mbushnin ditët e tij si krijues me atë drithmën e ethshme që pushton tërë qënien. «Udhëtimet u përngjasin rrëkezave të pranverës, që gërryejnë në tokë me ngulm një

çuditërísht surprisingly
shlódhës relaxing
drrásë slab
shkórsë rug
kallamár inkwell
gushpëllúmb purple
mikprítje reception
ledhatúes flattering
nanurítës soothing
ngjéthje shiver; trembling
përkúndje rocking
qeróz clever character in a folk tale
çántë briefcase
kómo dresser; bureau
ponç punch
ásqë in no way
potkúa horseshoe
nge leisure time
kuqalásh ruddy complexioned
i mundúar keq much troubled
i patrazúar uninvolved
dhuntí gift
qëmtím gleaning
i éthshëm feverish
gërryéj excavate; dredge

shtrat të vogël për të rrjedhur. Ashtu vijnë pamjet e njohjet e reja në mendje e ndjenja dhe lënë aty vragat e tyre dhe, si pa kuptuar, dikur ti e kupton se ato janë shkrirë brenda teje dhe përjetësimi i tyre sërish gjatë krijimit, të përfton një mall të bukur...» — mendoi ai.

Për pak kohë, ai mbeti i kredhur në brendësitë e vetvetes, ku dëshira për të shkruar bëhej gjithnjë e më zhuritëse. Sikur t'i kishte gjetur barinjtë me kohë, tani do të qe mbyllur në dhomën e vogël të hotelit dhe do të kish shkruar deri sa t'i qenë mpirë gishtrinjtë, deri sa të kish ndier se fjalët ishin fshehur diku e nuk vinin më me lehtësinë e përhershme. Sepse të gjitha ç'i gëlonin në mendje e në zemër nga ky udhëtim, nga malet, rrëketë, njerëzit, bisedat e rastit, fjalët e frazeologjia e atyre që kishte njohur në këtë udhëtim, s'mund të derdheshin në asnjë vend tjetër përveç asaj ngjarjes me barinjtë rreth së cilës do të thurte subjektin e tregimit a ndoshta të novelës së tij. Ku ta dish? Ai do të gjente me siguri episode e detaje të reja që i kishin shpëtuar korespondentit vullnetar, që botoi përshkrimin e shkurtër. Dhe ja sa keq i vajti puna. Të gjithë i thoshin se qe gati e pamundur t'i gjente barinjtë në shtegtimin e tyre, larg udhëve të rrahura. Shpresa e vetme mbetej kryebariu Nexhat, i cili bënte poshtë e lart kopesë dhe qëndronte nëpër qendrat e banuara kur për dorëzimin e qumështit e gradën e yndyrës, kur për furnizime apo për t'u lidhur me qendrën e ndërmarrjes. Kishte pyetur disa njerëz për të, megjithatë ai vendosi të pyeste përsëri. Besonte se udhëtarët e rastit, që kishte ndeshur e pyetur, ishin më pak të informuar për kryebariun Nexhat se sa klientët e kafes së vetme të qytetit. Sepse veç të qe një natyrë e jashtzakonshme ky Nexhati, që të mos kthehej kurrë nëpër lokale, gjë që duhej vënë në dyshim, pasi shtegtarët dhe vetmitarët pëlqejnë rëndom ta kthejnë një gotë sa për t'u nxehur kur nisen për udhë.

Në tryezën përbri, ai vuri re dy burra, veshur me xhakavento të zeza lëkure, të shtërnguara në bel, si motoçiklistë. Fytyrat bojë gruri, të thekura e të rreshkura, shenja që rrëfejnë shkoqur përcëllimin e reflekseve të dëborës, i kishin rruar taze, sepse binin erë të lehtë kolonjë trandafili. Njëriti prej tyre i shquhej nën kopsën e xhakaventos nyja e kravatës. Këto kundërshti midis ngjyrës prej shtegtari dhe veshjes deri-diku qytetare, e lanë gazetarin ca në mëdyshje. Po kur dëgjoi në bisedën e tyre fjalët e huaja «afta epizotike», u gjallëruà. Në mos tamam specialistë të blegtorisë, do të ishin njerëz të saj. Vendosi t'i pyeste. E hodhi me një frymë në grykë lëngun e ponçit, u përkul pak drejt tyre dhe, me zërin që i doli me zor nga lotimi i syve prej pijes së fortë, tha:

pa kuptúar imperceptibly
sërísh anew; again
brendësí inwardness
zhurítës scorching; burning
gëlój gather
kur për...kur për... now for...now for...
grádë level
yndýrë fat
furnizím supply; furnishing
vetmitár loner
rëndóm usually
xhakavénto windbreaker
bel waist
i rréshkur weather beaten
përcëllím singeing
táze fresh
kópsë button
nýjë knot
deri dikú more or less
mëdýshje doubt; dilemma
áfta epizotíke term pertaining to livestock
lëng juice

— Më falni. A mund t'ju bëj një pyetje?

— Sigurisht! — ngriti supet ai që i dukej kombi i kravatës.

Desha të dija, mos vallë e kini dëgjuar emrin e kryebariut Nexhat Kaso, të ndërmarrjes blegtorale?

Të dy burrat panë njëri-tjetrin me një habi të beftë që i argëtonte.

— Sigurisht, — tha prapë më i riu. — Çoç kemi dëgjuar për të!

Tjetri, burrë i gjatë tej masës së zakonshme, me mollza të kërcyera e veshë të përskuqur, uli sytë në mbulesën e tryezës dhe thërmoi bishtin e cigares.

— Me të vërtet? — pyeti ai, si i trembur mos po i punonin ndonjë reng.

— Urdhëro e ulu me ne, — tha i riu dhe i afroi karriken.

— Mos ju shqetësoj, — kundërshtoi ai. — Desha të di se ku ndodhet ky njeri. Kam tri ditë që s'i bie dot në gjurmë.

— Ou! dhelpër plakë ai Nexhati. Si t'ia gjesh gjurmët? — tha i riu dhe shkeli syrin haptazi.

Tjetri, që dukej ca i bezdisur nga kjo që po ndodhte, ndezi prapë cigaren. Gazetari u mërzit «Seriozë në dukje, po në thelb qënkan karagjozë» — mendoi për ta.

— Po të paktën a e keni parë atë fytyrë? — pyeti i riu. Gazetari e pikasi që këtu po vazhdonte një shpoti e fshehtë, po nuk e bëri veten.

— Jo, — tha qetësisht ai, i vendosur që sidoqoftë mos nervozohej nga të panjohurit.

— Ç'e doni?

Kjo kërshëri iu duk fare e tepërt. Dhe ashtu ishte.

— Po ju s'mund të ma thoni se ku gjendet pa më kërkuar një informacion kaq të hollësishëm? — tha ai buzagaz, aq sa për të mos u marrë si një thumb kjo thënie, po edhe i kënaqur që po ua paguante me të njëjtën monedhë.

— Jo, more djalë, mund të ta themi pa të munduar, — foli për herë të parë gjatovinua. — Halli është se ky Nexhati me duket se jam unë, prandaj...

Gazetarit, ky pohim i papritur i erdhi trullosës, gati për të mos e besuar. Vetëtimthi i vajti mendja se mos qenë shofera, se atyre ua ka ënda të bëjnë qyfyre të tilla, mirëpo ai që ishte quajtur Nexhat, qe një burrë mjaft i vranët e symenduar për të qenë hokatar. Gazetari u ul në tryezën e tyre dhe u shtërngoi duart.

— Po na hedh miza si shumë ky Loni, po duhet t'ia du-

komb knot
çoç somewhat
thërmój crush
bisht butt
reng trick
kundërshtój object
karagjóz joker
shpotí banter
thumb insult
gjatovíno tall person
pohím admission
trullôsës benumbing
vetëtímthi like lightning
i vránët grim
symendúar meditating
hokatár joker
p na hedh míza He's teasing

Viz. P. Dervishi

rojmë, se është shok i Komitetit, — shpotit pa të keq Nexhati. — Goxha veteriner rrethi!

— Po si kështu? Kjo qenka një rastësi e tillë që ta sjell kokën vërdallë. Siç thonë, ju kërkoja në qiell e ju gjeta në tokë...

— Ou! Hipi pjaca! Po ju, kush jeni njëherë? — tha Loni.

Gazetari i ri e ndjeu veten fare shpenguar, sikur kishte ngrënë me ta një thes me kripë. Ndoshta kjo rastësi e mbarë e shpresëpërbotë ia mori mendjen paksa dhe ai tha një gjë që s'e kishte thënë kurkund deri atëherë:

— Unë jam shkrimtar... — dhe tha emrin e vet. Këtë pohim e bëri nxitimthi, ai nëpër dhëmbë, po sidoqoftë e bëri dhe pas tij iu bë se dëgjoi një «ah!..» nga të dy burrat. Pas kësaj, i ndjeu veshët t'i digjnin për dreq. E pra, s'kishte thënë kurrë se qe shkrimtar, sepse ky emër i dukej tepër i vështirë për t'u merituar dhe kishte të drejtë kur mendonte ashtu. Kishte botuar vetëm një libër me vjersha në dymijë kopje si dhe nja dy tregime në revistat letrare dhe kishte shumë të ngjarë

kurgjë anything
djegësí burning
láfshë comb
gjel rooster
ndiesór emotional
i zënë ngúsht caught short
i palakmúar unenviable
përmásë dimension
stilográf fountain pen
më të djáthtë deserving
si páren e kúqe like the back of our hands
mbërdhij feel cold
hurbís sip
ç'dréqin xhánëm what the devil for

që emri i tij nuk u thoshte kurgjë dy të tjerëve. Djegësira e veshëve iu ndeh edhe në fytyrë. E mori me mend se tani dukej i tëri i kuq, si lafshë gjeli, ashtu siç i ndodhte pas tronditjeve të forta ndiesore. Po për fat të mirë, mbrëmja me dritat e saj jo të natyrshme i mjegullon këto ndryshime dhe prandaj ka mbetur shprehja që nata s'bën për të zgjedhur nuse. Ai u mundua ta ndreqte disi vetveten.

— Ç'është e vërteta, unë punoj si gazetar, po nganjëherë bëj edhe poezi, — shtoi.

— Ju kemi dëgjuar, — tha Loni, po prej pohimit të tij nuk kuptohej në e kishin dëgjuar si gazetar apo si poet. Kishte të ngjarë të qe e para.

— Po, po, — tha edhe Nëxhati, si i zënë ngushtë.

Gazetari nuk e vuri re këtë turbullim, meqë pandehte se ata s'kishin asnjë shkak që të trubulloheshin, sepse i vetmi që ndodhej në pozitë të palakmuar ishte ai, që i kishte rritur kot së koti përmasat e vetvetes. Kishte ditur ta hidhte lumin me zgjuarsi dhe kjo i jepte tani një lloj kënaqësie. I zënë me mendimet e tij, ai nuk vinte re se ç'përshtypje bënin tek ta fjalët e gjestet e tij. Nxori bllokun e shënimeve dhe stilografin e i vuri mbi tryezë, aty ku zakonisht vihen gotat.

— Më duket se po më ecën, — tha gazetari dhe u shkeli syrin me familjaritet. — Ju gjeta tamam atëhere kur po i humbisja shpresat dhe ky takim po më duket tani si një nga ato rastet fatlume që i vijnë njeriut më të djathtë, për ta nxjerrë nga balta...

— Jo bre, ç'rast, — tha Nexhati, pak si i bezdisur. — Në Tiranë, ndoshta mund të qe ashtu, po këtej nga anët tona të vogla e njohim njëri-tjetrin si paren e kuqe, kështuqë...

— Sidoqoftë... — kundërshtoi ai. — Unë u tremba se s'do t'ju gjeja dot kurrë.

— Nuk do të pini gjë? — pyeti Loni.

— Jo, falemnderit. Posa piva një ponç portokalli, se mbërdhija, — tha rrëmbyer ai, pa ia vënë veshin veterinierit, e i zënë i tëri me figurën e gjatë të Nexhatit, që po hurbiste kafen.

— Atëhere merrni prapë një ponç, — iu qep Loni.

— Jo, jo! S'është nevoja. A e dini se mendoja tamam për ju duke ndenjur aty, i vetëm?

— Po ç'dreqin xhanëm, ë? Se u bëmë edhe ne kureshtarë, — tha Loni.

— Sepse unë do të shkruaj për ti !...

— Për mua? — tha Nexhati.

— Po. Ose, për të qenë më i saktë, dua të shkruaj për atë ngjarjen dramatike të dhenve që mbetën në dëborë e që ju

i rëndómtë ordinary
i shtampúar experienced
vandák bundle
shfletój leaf through
ta márrë e míra for heaven's sake
kështú sikúr s'na écën we're not getting anywhere this way
ndíhej felt
zére pretend
sqarím clarification

i nxorrët me një mijë mundime. Ky nuk do të jetë një reportazh. Unë shpresoj të bëj diçka më shumë. Mund të bëj me këtë brumë një tregim?

Ai mendoi se e kishte përcaktuar mirë, në mënyrë jo të rëndomtë e vetëm me dy fjalët «dramatike» e «mundime» tërë thelbin e ngjarjes. Një gazetar i shtampuar do ta kishte quajtur ngjarjen «heroike» dhe mendimet do t'i quante «sakrifica».

— Për atë ndodhi më duket se kanë shkruar njëherë, — tha Nexhati i pasigurt. Apo jo?

— Po!

— Të them të drejtën, unë s'e kam lexuar akoma, — pranoi ai kokulur. Kjo puna jonë, si të thuash... ja, gjithnjë pas bagëtive, na e sjell mos i lexojmë në kohe tërë gazetat. Veç «Zërit» doemos, që na i sjellin kudo. Pa kur zbresim në qendër, kur të shohësh është mbledhur një vandak i tërë gazetash e revistash për të shfletuar!

— S'ka gjë. Bile ca më mirë për mua që s'e kini lexuar, — tha ai. — Ai qe një përshkrim i shkurtër në gazetën lokale, kurse unë, siç ju thashë...

— Po, po, — pranoi Nexhati.

— Merrni diçka, ta marrë e mira, — ndërhyri Loni. — Kështu sikur s'na ecën!

— Në qoftë se do të pimë diçka, atëhere do të paguaj unë, — tha ai.

— A, jo! Kjo s'vete fare, — kundërshtoi Nexhati.

— Sepse rasti im...

— E, mo, lëreni rastin mënjanë tani. Unë e dija që shkrimtarëi ia thonë ngapak gotës! — tha Loni.

— Lëreni gotën. S'ka parë njeri hair prej saj, — tha Nexhati. Gazetarit iu bë se ai ndihej prapë ca i bezdisur e sikur ngutej.

«Mërzia e njeriut të mirë, që i vjen zor të flasë për veten» — e përcaktoi me mend gazetari.

— E dini si t'ia bëjmë? Pimë diçka; ndërkohë, ju, shoku Nexhat, do të më rrëfeni se si ndodhi. Zëreni se po ia thoni këtë ndodhi shokut Loni, që e njihni prej kohe. Nuk është nevoja të ma tregoni ngadalë, se unë di t' mbaj shënime të shpejta. Shumë të shpejta. Vetëm rrallë mund t'ju ndërpres për ndonjë sqarim, po mund edhe të mos ju ndërpres fare. Kjo varet nga ju. E dini, ka disa njerëz që e kanë të mprehur në kulm dhuntinë e të treguarit. Të paktën nga frazat që përdorët tani, ja, ju nuk thatë si zakonisht «shoku Loni po na ngacmon», po thatë «po na hedh miza»... unë jam i sigurt që do të ma tregoni ashtu si shpresoj. Mirë?

llafazán loquacious
s'ka gjë it doesn't matter
skur = sikúr (np.)
néjse never mind
sivjét this year
pjéllje birth
dështím still birth
babovít pamper; nourish
pa firómë untouched; unadulterate
ngástër section
kuturú helter skelter
tékë whim
i urúar blessed
çapítem walk; take steps
nënvizój underline
stiloláps automatic pencil
qen i kopésë sheepdog
zhurmërím sound
sépse for some reason
nëngésh smile
llomotít gossip

— Epo ... Kur e doni me domosdo!... — tha Nexhati me një lloj turbullimi që nuk e kuptonte pse i vinte tani. Gazetari i ri i pëlqeu, ç'është e drejta. I çiltër. i hedhur, pak llafazan vërtet, po fundja kjo është dobësi profesionale. Nganjëherë nuk fliste aq shkoqur sa do të deshte Nexhati, po ta marrë e mira, prapë s'ka gjë. Ai e ndiente që djali qe i mirë e këmbëngulës dhe kjo gjë atij i pëlqente. Po ç'dreqin duhet t'i mbante shënim në bllok tërë fjalët e tij, skur mbante protokoll në mbledhje? Nejse. Mund që ashtu ia do mënyra e punës. Nexhati u mundua sinqerisht që t'i tregojë gazetarit sa më shumë gjëra për profesionin e tij të blegtorit. I tha se si kishin qenë sivjet pjelljet e dhenve të mbara e pa dështime, se kishin pjellë nga dy qengja e se rritja e tyre po bëhej pa humbje. Dikur, i tha, barinjtë thoshin: «kur delja bën dy qengja, njërit preja kokën dhe tjetrin babovite mirë», se dhentë kanë qejf të kullosin në vende pa firomë, domethënë ku s'ka shkelur më parë ndonjë tufë dhe kjo provon atë që thotë shkenca, se kullotat duhen ngrënë me ngastra e jo kuturu. Pastaj i përshkroi ngjarjen, se si ra natën papritur dëborë e rëndë dhe e lagët, se si kjo tekë e kohës i rrezikoi ca dhentë, se ato të uruara janë të ngathta e nuk çapiten dot në dëborë të madhe...

Gazetari mbushi disa fletë me shënime. Nja dy herë mërmëriti nëpër buzë fjalët «interesant», «shumë interesant» dhe nënvizoi me stilolaps të kuq. Me bishtin e syrit Nexhati pa se ai kishte nënvizuar atë thënien e vjetër të barinjve për dy qengjat, «njerit prei kokën, tjetrin babovite» dhe i pikoi në zemër; vallë a e dinte gazetari që kjo thënie i përkiste një blegtorie të prapambetur e të pafuqishme? Kishte nënvizuar edhe thënien «ujkut, po i dhe mish njëherë, e ke mik për derë». Dhe deshte të shtonte Nexhati tani, se ata s'para i japin mish ujkut dhe se barinjtë kujdesen për qentë e kopesë më shumë se për veten. Mirëpo s'tha gjë, këto sqarime iu dukën të tepërta, gazetari duhej t'i dinte dhe, po t'ia përsëriste, rrezik të fyhej nga këto hollësira të mirënjohura. Pas kësaj, ai s'dinte ç'të thoshte më. Heshti dhe piu ujë, gjë që s'e bënte kurrë pas kafes. Dëgjohej zhurmërima e lehtë e stilografit të gazetarit, po kjo qetësi tani iu duk e vështirë Nexhatit. Me një frymë, gazetari i mbaroi shënimet e veta dhe e la bllokun hapur. Ata vështruan njëri-tjetrin. Loni sepse nënqeshte. Ai e dinte pse nënqeshte. Nexhati thoshte me vete se foli ca si shumë e se Loni kishte për ta ngacmuar më vonë për tërë atë dituri që derdhi në shesh. «Mos llomotita tepër për zanatin tonë e për brigadën, mos thashë ca gjëra që i dinë të gjithë?» dyshoi Nexhati.

Gazetari i ri, tani për tani s'mendonte asgjë të përeaktuar Me tërë ato shënime do të bënte, pa dyshim, një reportazh të

nëntítull subtitle
i vetvetíshëm automatic
tundúes tempting
nëntékst implication
jóshës alluring
e aq and that's all
shkul pull out
zvarís drag

mirë. Bile reportazhin, me ca nëntituj të spikatur, nxjerrë nga thëniet e fjalët e urta të Nexhatit, e shihte të formuar në kokë. Megjithatë, thellë e në mënyrë të vetvetishme, ai e ndiente se tregimi s'kishte për t'i dalë siç e priste. Ndoshta s'kishte për t'i dalë fare? E pra, ngjarja qe aq tunduese. Konflikti shekullor i njeriut me natyrën, po tani konflikti i njeriut plotësisht të ndërgjegjshëm. Mirëpo në ngjarje sikur s'po shtonte dot asgjë më shumë nga përshkrimi që kishte lexuar. Për çudi, ai shihte më qartë figurën e bariut plak Nake se atë të Nexhatit. S'e kuptonte se si kishte ditur të mbetej nën hijë gjatë rrëfimit Nexhati, ai që ishte kryesori. Kjo e habiti dhe aty për aty asqë e kuptoi se kjo ishte gjëja më e natyrshme që mund të mendohej, po ta njihte sadopak njeriun me të cilin bisedonte. Atij iu duk kjo «fshehje» modesti e tepruar.

— Ju më thatë kaq gjëra të reja për blegtorinë sa... s'di ç'të them. Ndoshta fjala falenderim këtu nuk mjafton, — tha ai sinqerisht. — Megjithatë...

— Çfarë? — u hodh Loni, dhe gazetarit iu duk pyetja e tij e thjeshtë, me një nëntekst që ai nuk e kuptonte dot.

— Si t'ju them. Në lidhje me atë ngjarjen, — shtoi ai, i pakënaqur nga fjalori i vet, sidomos nga fjalët «në lidhje me...»

— Ju s'mësuat dot ndonjë hollësi joshëse e tronditëse përveç atyre që shkruante korespondenti vullnetar, apo jo?

— Mundet. Si e kuptuat ju?

— Shumë thjesht, — tha Loni. — Unë e kam lexuar atë shkrim dhe bëra krahasimin me ato që tha Nexhati. Dhe ju kini të drejtë. Nexhat, or lum miku, a s'do të tregosh gjë tjetër?

— Po ç'të thuash? Një ndodhi dimri e aq. Edhe vetë po të ndodhej gazetari, zor se do të shihte më shumë!

— Nuk e kam fjalën te ndodhia, — i rrëzëlleu një shpresë e re gazetarit. — Unë desha të di, ta zëmë, ç'menduat e ç'ndjetë ju ato çaste kur shkulnit delet e i zvarisnit nëpër tragën e hapur mbi dëborë? Më kuptoni? Kjo është kryesorja!

— Po ç't'ju them? — tha Nexhati. Ç'mendova? Po ja, atë që do të mendonit edhe ju në vendin tim, domethënë që delet duheshin shpëtuar, se përndryshe do të ngordhnin. Dhe sa për ndjenja, për nder, s'di ç'të them... veç të ftohtit, s'ndjenja gjë tjetër, — u përpoq ta mbyllë ai me një shaka, — të cilën gazetari nuk e kapi menjëherë.

— Unë e kam fjalën për të tjera ndjenja; s'di në u shpreha qartë, — tha gazetari.

— E di, — qeshi Nexhati me mirësi, — dhe besoj se në ato çaste edhe ti, edhe Loni, do të ndjenit njëlloj. Pra... siç e sheh, ngjarja është e zakonshme. Ç'të thuash më?

ballërrúdhur frowning
përgjój hear; listen to
krakërím screeching
shqúaj distinguish
ustá master craftsman
ia bëri káfen pak me híle he cheated a little on the coffee
pólli (pjell) gave birth
pazotësí incompetence; inability
Si dúken báthët It appears that

Gazetari mbylli bllokun. «S'kam ç'të shënoj me, — tha me vete, — po kam përpara edhe një natë të tërë për të menduar. Dhe jo vetëm një natë, po disa net me radhë, deri sa...».

Nexhati rrinte tani ballërrudhur, si prej një mendimi të ngultë, që i sillte një pikëllim të lehtë e të pakuptueshëm. Gazetari i ri nguli këmbë që të pranonin të pinin nga një ponç prej tij. Nuk ia prishën. Pastaj u ndanë. Ai ra të flinte, po gjumi e mori vonë. Pa një ëndërr krejt pa kuptim: sikur tërë kohën përgjonte ca krakërima të largëta që u përngjisnin klithmave të zogjve të natës në një pyll. Ai s'e gjente dot ç'zogj ishin ata.

Në xhade u dëgjua zhurma kërcitëse e një motoçiklete. Ai pa nga dritarja renë e vogël të pluhurit që afrohej me shpejtësi, pastaj shquajti edhe njeriun. Ky njeri që po shkelte hapur rregullat e shpejtësisë, ishte veteriner Loni, me xhakaventon e zesë prej lëkure. Bëri t'i dilte përpara, po u pendua menjëherë. Qe veshur tepër hollë për të udhëtuar me motoçiklétë dhe vendosi të priste makinën e linjës. Veteriner Lonit, më pak se çdo gjë, mund t'i vinte në mendje që pikërisht këtu të gjente gazetarin apo shkrimtarin e ri që kishin njohur mbrëmanet. Atij i pëlqente kafeja e usta Turabiut dhe qëndroi të pinte, kështu që takimi i tyre prapë iu duk gazetarit rastësi. Natyrisht, po t'ia kishte thënë Lonit këtë, ai do ta kundërshtonte me vrull, duke pohuar se në vende të vogla takimet e tilla janë gjëja më normale në jetë, mirëpo gazetarit të ri ia kishte ënda që disa ndodhive të zakonshme, t'u jepte një ngjyrë kurioze, pra t'i bënte artistike. Ata u takuan si të njohur të vjetër, bile me përzemërsinë e dy miqve të përmalluar, aq sa usta Turabiut i erdhi keq që djaloshit, mikut të veterinerit, ia bëri kafen pak me hile.

— E? — tha Loni dhe e mbërtheu me një vështrim që shponte tejpërtej. — A polli gjë nata e shkuar për prozën tonë?

— Asgjë, — pranoi gazetari.

— Ç'më thua? Po pse kështu?

— Nuk e di!

— Po ti kishe aq shpresa te ajo ngjarja!

— Kisha, vërtet!...

— Mos e kishte fajin Nexhati? Më duket se nuk i jepet për të treguar!

Jo, jo! Në asnjë mënyrë. E ka fajin pazotësia ime. Si duken bathët, nuk më ka ardhur akoma brumi i tregimtarit. Kurse Nexhati qe një njeri... si t'jua them... një njeri i vërtetë, — nxitoi të thotë ai i prekur, kur mendoi se mund të keqkuptohej.

shálë seat
seç something
shtrëngój tighten; squeeze; force
kacavídë screwdriver
bréshër hail
pickój prick; pinch
tip type
zevzék restless
veçorí nature
ahéng festivities; merry-making
ku...ku... sometimes...sometimes
huq prej zgjébeje habit of scratching
intervistím interview
ze = zë (mp.)

— Bah! Po kur e njohe kaq shpejt?

— Disa gjëra ndihen menjëherë. Pastaj ajo ngjarja...

— Po ja që s'mjaftoi t'i ndiesh vetvetiu ë? Si thua? — pyeti Loni. Po kjo ishte një pyetje që nuk donte përgjigje.

Dolën jashtë. Buzë xhadesë tundeshin plepat. Loni hoqi shalën e motorit dhe seç zuri të shtrëngojë me kacavidë. Gazetari s'merrte vesh fare nga motorat dhe këtë punë po e shihte me një breshër pyetjesh që i vinin në buzë, si zakonisht. Por e pickoi premtimi që i kishte bërë vetes për të mos lejuar kureshtje naive e të tepruar. Veç asaj, ajo pyetje e Lonit para se të dilnin, qe një parathënie për shpjegime më të holësishme dhe gazetari priti me gjakftohtësi, i sigurt që ky tip zevzek s'do të rrinte pa «hedhur miza», siç thoshte Nexhati.

— Mban shënime, mban? — tha Loni, duke e parë pjertas.

— Mbaj!

— Gjithmonë?

— E do veçoria e punës sonë, — tha ai nëpër dhembë.

— E do, — pranoi Loni. — Ja, për shembull, më tregonte një plak. Bëhej dasmë, më thoshte. Me krushqit, na paske ardhur edhe një shkrimtar. Kur arriti ahengu majë më majë dhe njerëzve iu shpengua gjuha e këputnin qyfyre, ku të thekura e ku të djegura, ky krushku na nxori bllokun dhe po mbante shënime. I mirë qe ai krushku, më thotë plaku, pa seç kishte një huq prej zgjebeje! Ne pinim, ai na shënonte llafet në tefter...

— Eh!... Po s'është e lehtë të hysh në vështirësitë e punës sonë, — psherëtiu ai. — Unë i jap të drejtë atij shkrimtarit. Nganjëherë të qëllon të dëgjosh gjëra aq të bukura njëra pas tjetrës, sa hutohesh. Dhe kujtesa s'është thes pa fund.

Mirëpo njerëzit s'janë mësuar t'u rrijë tjetri me bllok përpara e t'ua shënojë gjithë fjalët..

— Intervistimi... — zuri të thotë gazetari.

— Nejse, ju e dini më mirë, — e ndërpreu Loni. Si thonë, i zoti e di ku i pikon çatia. Po them, kushedi, ndonjëherë mund të bëni edhe pa atë bllok mbi tryezat. Mblidhi gjërat ashtu shtruar, ca sot, ca nesër, si shokë të vjetër që këmbejnë mëndime pa të keq. Më pas, në vetmi bëni punën tuaj, shënoni sa të doni. E ka ca të vështirë njeriu kur shikon se ia mban shënim tërë ato që thotë, thuaj si të duash. Sikur harron vetveten, ze e matet, ze e zgjedh fjalët, ë?

— Kjo do të kërkonte një njohje të gjatë! — pranoi gazetari.

— Kurse ju nguteni. E di, — tha qetësisht veterineri. Fliste me takt, po me aq siguri sa gazetarit i bëhej se ai e dinte më mirë se ai përse s'kishte për ta shkruar tregimin.

shpupurís get mixed

— Nexhatit, mos ia vini re, — tha Loni, dhe shkeli pedalin. — S'është nga ata që i thonë ndjenjat me zë të lartë ai; si në ca drama të këqia «O, sa më dhimbsen delet kur pjellin qengjat. Vuäjnë të shkretat, vuajnë!»

Gazetari vendosi të mos e priste autobuzin e linjës. Hipi në motoçikletë dhe harroi që qe veshur hollë. Flokët iu shpupurisën nga era dhe ai ndjeu shpejtësinë e lëvizjes në gjithë qënien.

Teodor Laço, "Njohje" Nëntori
(Tiranë) XXIII, 6 (June) 1976
pp.73-87

LEXIMI I NENTEDHJETETETE

DY ME ZERO

(Komedi me 3 akte)

personazhet

ENRIETA, mësuëse
VIKTORI, burri i saj, inxhinjer.
ANA, e ëma, drejtoreshë kopshti.
ARISTOTELI, i ati, instruktor në kom. ekzekutiv.
ÇLIRIMI, i vëllai, mekanik, student në fakult. e inxhinjerisë.
PAPULI, gjyshi i saj, arsimtar pensionist.
LIRIKA, shoqe e saj, gjeometre.
VAJZA I, shoqe e saj.
VAJZA II, shoqe e saj.
VAJZA III, shoqe e saj.
DONIKA, aktiviste e frontit të lagjes.
FAIKU, shok i Viktorit, inxhinjer.
MYSAFIRI
MYSAFIRJA, gruaja e tij.
NJË VULLNETARE në aksionin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier.
VULLNETARË E VULLNETARE TË TJERA.

o o o

Ngjarjet, që ndodhin në ditët tona, zhvillohen në Tiranë dhe në aksionin e rinisë për ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier.

dy me zéro two to nothing
kopsht kindergarten
aksión work project
dhómë ndéjtje living room
bíe telefóni the telephone rings
parmbrëmë evening before last
përkëdhélet pak she becomes a little playful

AKTI I PARË

Pranverë. Dhomë ndejtje në apartamentin e Aristotelit, me dy dyer, një dritare e një ballkon. Ble telefoni. Vjen Ana.

ANA — Po, unë jam, mamaja e Enrietës... (me përzëmërsi) Viktori qënke? (qesh lehtë) Çudi! S'ta njoha zërin fare! Sa ndryshon në telefon!... Enrieta ka dy orë që është ngritur... Jo, jo, mos e thuaj... Unë kam përshtypjen, se në darkën që shtruat ju parmbrëmë në shtëpinë tuaj, u lodh më shumë... A, natyrisht, edhe emocioni... (përkëdhelet pak) Jo vetëm nga unë, ka marrë mjaft cilësi dhe nga i ati... Je shumë i sjellshëm... Të na urdhërosh, po si jo? Kjo është shtëpia jote, ç'dëmethënë?... Ja, tani e lajmëroj unë Enrietën, se është duke hekurosur... E ka zakon, nuk i rrihet... (qesh) Sigurisht, prindët duhet të jenë edukatorë... E bile edukatorët kryesorë... Të presim Viktor, mirësetëvish... (Le telefonin dhe i thërret së bijës) Enrieta, çohu, po vete ora dhjetë, do të vijë Viktori. (Dëgjohet zëri i Enrietës: «ja, mama, po vishem». Bie zilja, e derës së jashtëme. Ana shkon matanë dhe kthehet bashkë me Donikën) A, Donika, sa mirë bëre që erdhe tamam në kohë, se më pihej një kafe... Është kaqë e bukur koha sot, e ndjej veten kaq mirë... Më bëhet shumë qejfi ta pimë bashkë.

DONIKA — (e qetë, e sjellëshme) Faleminderit, po kjo s'është një vizitë e gjatë.

ANA — Kam një furnellë, e bëj fët e fët.

DONIKA — Faleminderit, po unë erdha vetëm sa të ë lajmëroj se sot pasdreke, në ora tre, shkalla jonë ka radhën për punë vullnetare në ndërtimin e pallatit. (sikur nxitohet të largohet)

mirësetëvísh you're welcome
matánë across; away from here
furnéllë kind of liqueur
fët e fët right away
shkállë floor; story
rádhë turn
i páshëm good looking
në rádhë të párë in the first place
i pazëvëndësúeshëm irreplacable
fis family line; clan

ANA — (i sjell një pije) Bëre fare mirë që erdhe vetë të më lajmërosh dhe... me këtë rast të më urosh për fejesën e Enrietës.

DONIKA — (e gëzuar) E fejuat Enrietën?

ANA — Po. Bile bëri dhe celebrimin. (e qeshur) Dashuroheshin...

DONIKA — (i shtrëngon dorën) Të trashëgohen, Ana

ANA — Faleminderit, shumë faleminderit.

DONIKA — Po kush është dhëndëri?

ANA — Inxhinjer Viktor Vasili.

DONIKA — (e menduar) Emër i njohur... Mos punon në ministri?

ANA — Në ministri, me përgjegjësi të lartë.

DONIKA — Po, po, ma ka zënë syri; ësht'i pashëm.

ANA — (me mjaft vetëkënaqësi) Familja jonë në radhë të parë studjoi përbërjen e tij shoqërore, që është e shkëlqyer... Nga ana tjetër... vetë është inxhinjer, ka një pozitë të rëndësishme në ministri... Është një kuadro e pazëvëndësushme... Rrethin e tij familjar e ka gjithashtu në vënde me përgjegjësi... Njeriu përpiqet gjithmonë për më mirë... Dialektika e jetës... Apo jo?

DONIKA — (ironike) Njeriu, thoshin pleqtë tanë, me anën e krushqive duhet të përpiqet të ndrrojë dhe një çikë fisin...

ANA — (që s'ja kupton alegorinë) Me që e the vetë, fundi i fundit ç'të keqe ka? Kur ke një rreth të mirë, sikur je më i nderuar, të shikojnë me një sy tjetër.

DONIKA — Ata që mbajnë syzat e mentalitetit të vjetër...

ANA — (gjoja) Me siguri... (Kapërcen në bisedë tjetër). Ç'është e vërteta, e kam patur problem martesën e Enrietës... Që në klasën e fundit të Pedagogjikes filluan të na e kërkojnë... Pa le kur mbaroi... Edhe në Peshkopi, ku e emëruan, njësoj... Kaqë sa i kam thënë disa herë Aristotelit: kaq'e bukur, e sjellëshme, e kulturuar qënka vajza jonë? Të ka ngjarë ty, që e ke edukuar, tallet ai... Po dhe unë ja përplas kur më flet kështu: shiko, veten tënde, që mbete se mbete instruktor në komitetin ekzekutiv... (qesh)

pedagogjíke teacher's college

që mbéte se mbéte instruktór who are still nothing but an instructor

qesëndí teasing; banter

karierízëm social climbing

më lëshói thumb she threw darts at me

pa shikó the nerve

i mýkur moldy

DONIKA — (me qesëndi) Nuk duhet humbur besimi... Tani me përkrahjen e dhëndërit e të rrethit të tij, mund të gradoheni të dy... Vetëm mos ktheni kokën mënjanë kur të na takoni rrugës...

ANA — Ua, Donika, i more me gj[illegible] fjalët e mia si karierizëm? [illegible] hur) Shiko se mos më keqkupto[illegible]ht...

DONIKA — (duke qeshur, ironike) Po[illegible] Por ideologjikisht ndefta... (Ana st[illegible]it) Mos harro në orën tre... (Pi [illegible]imë dhe të fala shumë Enrietës... [illegible]pafshim... (Largohet)

ANA — (pak e hutuar) Mirupafshim... (pauzë) Më lëshoi thumbin edhe iku... (Pauzë. E revoluar) Po harroi, shoqja aktiviste, se në qoftë që ajo është dhjetë herë me Partinë, unë jam njëqind!... (vjen Enrieta)

ENRIETA — Me cilën bisedoje, mama?

ANA — Pa shiko! Do të na keqkuptoka ideologjikisht, sikur jemi reaksionarë!

ENRIETA — (kureshtare) Kush ta tha këtë fjalë, mama?

ANA — Unë nuk e pranoj të ma thotë as për shaka një fjalë të tillë!

ENRIETA — (më kureshtare) Thuamë, të lutem, kush ta tha?

ANA — Sikur jemi prej origjine bejlerësh ose tregëtarësh ne, dhe paskemi në kokë mendime të mykura!... Shoqja Donika!...

ENRIETA — Ti s'ke bërë fjalë kurrë me të, ajo është aqë e sjellëshme me të gjithë! (pauzë) Të ka ngacmuar, mama, pse nxehesh?

ANA — (e qetësuar) Thua?... Fundi, çrëndësi ka? ...Mund të ketë bërë shaka vërtet... Po unë u rrëmbeva pak...

ENRIETA — Do të vonohet Viktori?

ANA — (duke i përkëdhelur flokët) Pullumbi do të vijë në folenë e pullumbeshës... Sot jam më e lumtur se asnjëherë...

ENRIETA — Edhe unë, mama. Si thua, do të jetë kënaqur Viktori nga darka që shtruam mbrëmë?

ANA — Përse të mos jetë i kënaqur?

pullúmb pigeon
kthim return
fëminí childhood
vëllo = vel veil
tyl thin silk; tulle

ENRIETA — Viktori më pëlqeu shumë mbrëmë, dukej ajo i mirë! Unë çuditem me të. Ai di të jetë dhe serjoz, dhe i përzëmërt. (pauzë) Të pëlqen, mama, Viktori?

ANA — Thrame, ç'i mungon?

ENRIETA — Po mu ç'më mungon?

ANA — Vetëm një gjë: kthimi në Tiranë. (Enrieta e përqafon. Pauzë)

ENRIETA — Në kohën kur zhvillohej ceremonia e celebrimit, ishte shumë i emocionuar.

ANA — Po edhe ti ishe e tronditur. (pauzë) Ato jetë çaste me shumë rëndësi në jetën e njerint. (e menduar) I kemi jetuar të gjithë... Lidhesh për jetë me një njeri, arrin në moshën time, marton fëmijët... (pauzë) Sa shpejt kalojnë vitet!...

ENRIETA — Sa gjëra mendoja në ato çaste... Mu kujtua koha e fëminisë, kur vinte ndonjë nuse në mëhallë e mbuluar me vellon e bardhë, dhe ne vajzat e vogla mblidheshim te dera e shtëpisë së dhëndërit, e shtyheshim, që të dallonim përmes tylit, fytyrën, sytë e nuses... Pastaj shoqet e shkollës, bisedat që bënim ne vajzat, mendimet që kishim për martesën, për burrin që na pëlqente të merrnim... Gjithë ato ëndrra që thurnim!... (pauzë)

ANA — Çupitë është ajo që ka vëllai i Viktorit?

ENRIETA — Është dekan, drejton një fakultet të tërë në universitet.

ANA — Po dhe gruan e ka farmaciste, po dhe vëllai i saj është shef klinike në spital!...

ENRIETA — Të bën përshtypje rrethi i tij?

ANA — Të duket gjë e vogël?

ENRIETA — Pse qënka gjë e madhe, rrethi i mirë?

ANA — Ajo e madhe sa nuk ta merr mëndja! Se mund të ishe dashuruar me një tjetër që të mos e kish një rreth të tillë!

ENRIETA — (e menduar) Po, po...

ANA — Nderohesh ti, po nderohemi dhe ne. Të dëgjosh shoqet e mia të kopështit, do të çuditesh! Janë habitur me këtë krushqi që bëri drejtoresha e tyre!

ENRIETA — (e menduar) Interesante.

ERIC

përménd mention
ta merr méndja naturally
nuhát sense; smell
pardjé day before yesterday
pa të keq without ill will
duvák bridal veil

ANA — Dhe kush e di ç'komente të tjera bëhen që nuk na i ka zënë veshi.

ENRIETA — Por mbi të gjitha, për mua ka rëndësi karakteri dhe kultura e Viktorit.

ANA — Të gjitha janë të lidhura, shpirt. Ardhja jote në Tiranë është suksesi më i madh.

ENRIETA — (e gëzuar) Sa mirë!

ANA — Mjek ishte dhe ai që të kërkoi në Peshkopi. Por... në Peshkopi!

ENRIETA — (pak e tronditur) Besoj se s'është rasti ta rikujtojmë atë person... (pauzë) Unë mora atë që më thoshte zëmra...

ANA — Ajo tani kaloi, unë e përmënda kot... Pse u nxitova unë të bëhej çelebrimi sa më parë? Kot? Unë kam hall të vish në Tiranë që tani, pa mbaruar viti shkollor. Vure re me sa admirim të shikonin mbrëmë njerëzit e tij?

ENRIETA — (e ngrohur) Ta merr mëndja. (pauzë) Viktori më do shumë...

ANA — Pse, nuk e kam nuhatur unë? (qeshin të dyja. Dëgjohet zilja e jashtëme)

ENRIETA — Viktori!

ANA — Rri ti, e hap unë derën. (Shkon matanë dhe kthehet bashkë me tre shoqet e Enrietës, shumë gazmore, që e përqafojnë)

SHOQJA I — Takuam babanë tënd dhe na tha se ke ardhur nga Peshkopia e pardje bëre celebrimin.

ANA — Ju lutemi, vajza, të na falni që nuk ju lajmëruam, po kështu erdhi puna, duhesh të mbaronim shpejt, se Enrieta pasnesër kthehet në Peshkopi. U! Po Lirikën ku e kini?

SHOQJA II (pa të keq) Ne jemi shumë të fyera, që munguam në ceremoninë e Enrietës, po kur të marrë nusen Çlirimi, ne do të ndodhemi patjetër këtu... (Enrieta e Ana qeshin. Hapet dera dhe hyn shoqja IV, me emër Lirika, me duvak, me një fustan të Anës e me pozën e ngrirë të nuseve të zakonit, e shoqëruar nga Çlirimi, që i ka hedhur krahun, në rolin e dhëndërit. Çifti ndalet te dera. Shoqet I, II, III i këndojnë këngën rituale të dasmës së folklorit)

portokále orange
sarájë palace
një trim për máshalla a very brave man
qerás treat; serve
ajo bën náze she is fussy
çetúr wooden bowl or cup
dhállë buttermilk
nápë cheesecloth

«Mos i mba sytë përdhe,
moj faqe portokalé
Turp të vjen a frikë ke,
moj faqe portokalé?

As turp kam, as frikë kam
se tim shoq ja tek e kam...

(Dhëndëri duke e mbajtur prej krahu, ecën bashkë me nusen dhe e ul në një karike. Vazhdon kënga:)

«Lum si ti ku erdhe ti, pullumbia,
në sarajë të mëdha, pullumbia,
tek një trim për mashalla, pullumbia,
lum kjo vjehër që të ka, pullumbia...

SHOQJA III — (shoqeve) Si thoni, duhet ta puthë nusen dhëndërri?

SHOQET — (të gjitha) Posi, patjetër! **(Fillon një pantomimë të fortë dhëndërri, i cili, hem do ta puthë kur i heq duvakun, hem është i turpshëm, ndrulet. Qeshin të gjithë. Mbaron skena. Ana i qeras të gjithë. Fillon me «nusen» e Çlirimit, ajo bën naze)**

LIRIKA — **(në rolin e «nuses» tregon Enrietën)** Qerasni përpara time kunatë... **(qeshin)**

SHOQJA III — Ne erdhëm për një urim të shkurtër e të shpejtë, se kjo punë nuk mbaron vetëm me këtë surprizë të vogël...

ANA — Na kënaqet, vajza. U gëzofshi edhe ju si jua do zëmra. **(Përshëndesin dhe largohen, të shoqëruara nga Enrieta)**

ÇLIRIMI — **(«nuses» së tij, me ashpërsi)** Nuse, moj! Po ti, ku shkon?

LIRIKA — Të heq fustanin e zonjës Ana... **(shoqet largohen)**

ANA — **(Çlirimit)** Më nxorre mallin e dhëndurëve fshatarë, aqë mirë e luaje... Edhe në fshat sikur të ishe rritur!...

ÇLIRIMI — **(ironik)** Ah, fshati! Ku ma ke atë aromë trëndelinash, atë çetur me dhallë, atë napë me djathë të bardhë si dëbora dhe çana-

çanák earthen pot
i thërmúar crumbled
përshésh hesápi a messy affair
belá problem
hutím perplexed moment; confusion

kun me qumësht të ngrohtë valë, plot bukë misri të thërmuar, përshesh hesapi, që na shtroi vllau yt, mama, kur shkuam mysafirë në shtëpinë e tij në fshat... **(Ana qesh hidhur)**

ANA — Sa i çuditshëm je! **(Hyjnë Enrieta e Viktori, që përshëndetet me Anën e Çlirimin)**

VIKTORI — Si jini?

ANA — Si dasmorë.

VIKTORI — Po ti, Enrieta, a u çlodhe? Sikur u vonuam pak mbrëmë.

ENRIETA — Shkuam aqë mirë.

VIKTORI — Si je, Çlirim?

ÇLIRIMI — Në rregull fare.

ANA — Po ti, Viktor, si ndjehesh sot?

VIKTORI — I gëzuar si një dhëndër i ri.

ANA — Të besoj.

VIKTORI — Shoku Aristotel si është?

ANA — Shumë mirë. Ka dalë pak, tani do vijë. Punët e zyrës e kanë lodhur shumë... Se është dhe një bela tjetër, që e ngarkojnë me shumë komisione... Pa le kur sëmuret, që vijnë gjer në shtëpi të këshillohen me të...

ÇLIRIMI — **(gazmor)** Kur sëmuret, një herë në tre vjet...

ANA — Rrallë, po ka ndodhur të vijnë. Lodhet, lodhet shumë...

VIKTORI — Po Papuli? Dolli?

ENRIETA — Papu fle

ANA — Ai nuk e prish rregullin e tij. Një orë gjumë pas buke e ka zakon. Tani s'besoj t'ju mbetet qejfi sikur të merrem pak me punët e shtëpisë. Ti, Çlirim, do takoheshe me babanë...

ÇLIRIMI — **(Pas një hutimi)** A, po, po... Do të takohesha... **(Ana e Çlirimi largohen. Enrieta hap radion që transmeton një muzikë vallzimi)**

ENRIETA — (sentimentale) Muzika është delikatesë ndjenjash, dashurie... Lirika më fliste vazhdimish për ty...

VIKTORI — Nuk e di se kujt i fliste më shumë, ty apo mua... **(qeshin)**

atý áfër édhe únë almost the same for me

mínder linen closet

páko package

múzë muse

ENRIETA — Çdo herë që takohesha me Lirikën, prisja me padurim të hapte ndonjë bisedë pune për ministrinë, ta sillte rrotull që të përmëndej emri yt...

VIKTORI — E pastaj?...

ENRIETA — Pastaj... Hem më vinte mirë, ndjeja një kënaqësi të pakufishme, hem nuk e bëja veten... Por ajo është shumë e zgjuar, e kuptonte... (pauzë) Po ti?

VIKTORI — Aty afër edhe unë... Derisa u prezantuam... Me gjithë se unë e hiqja veten pak si indiferent... Ajo e kuptoi dhe s'të përmëndi më nja dhjetë ditë... Mirë po mua s'më durohej, derisa një ditë, sapo u takuam në mëngjes në zyrë, i thashë si duke qeshur: «A ma ke parë nusen dje, shoqe Lirika?» (Enrieta emocionohet pak)

ENRIETA — Pikërisht atë mbrëmje më erdhi në shtëpi e më foli hapur... Ua!... Më çmëndi!...

VIKTORI — Po e bukur është kur ja njoftova familjes sime... Ta kam treguar?

ENRIETA — Me hollësira jo.

VIKTORI — Domosdo, me shumë diplomaci... Pasi u sqarova me vëllanë, e fillova një herë nga nëna... I bëra agjitacionin e duhur e pastaj i lashë në minder pakon me një palë këpucë të reja... «Është mirë, i thashë, t'i mbathësh atë ditë...» Efekti qe i rrufeshëm! E pregatiti aqë mirë babanë, saqë kur hapa gojën unë t'i flas, u afrua i mallëngjyer e më puthi në ballë: «Të kesh uratën, më tha, bëj si të thotë zëmra!»

ENRIETA — Kurse unë fola një herë me Çlirimin... Ai u gëzua... Por dhe diçka kishte kuptuar... Ndofta na kishte parë bashkë... Pastaj unë ja thashë mamasë dhe Çlirimi babait... (pauzë)

VIKTORI — Po Paput, kush ja tha?

ENRIETA — Babi. Papu qau nga gëzimi... Mua më do më shumë se gjithë nipërit e mbesat... Është aq i mirë!...

i rëndómtë mundane; ordinary
púçër pimple
ndërprés interrupt
lehtësí convenience
takëm set; outfit
ndopák a little bit
bandíll playboy
qáhem complain

VIKTORI — Shumë optimist për moshën e tij! Plak interesant!...

ENRIETA — Po Çlirimi si të duket, sentimental?

VIKTORI — E njoh shumë pak.

ENRIETA — Më duket se e ka gjetur dhe ai muzën e tij...

VIKTORI — Ashtu?! (pasi mendohet ca) Mos vallë në rrethin tonë të njohur?

ENRIETA — Me sa duket...

VIKTORI — (enthuziast) Lirika është një vajzë e mrekullushme!

ENRIETA — (gjoja e prekur) Pse, im vëlla si të duket, i rëndomtë?

VIKTORI — Unë e njoh fare pak... Po nisem nga arsyetimi se, duke qëne vllau yt, nuk mund të jetë i rëndomtë...

ENRIETA — E ke ironinë në majë të gjuhës!

VIKTORI — Si një pupël të vogël... (qeshin) Shiko, Enrieta... Dëgjomë me vëmëndje... Dua të bisedojmë diçka që lidhet me të arthmen tonë, që të intereson... (Hyn papandehur Ana dhe ja ndërpret fjalën)

ANA — Punët e gruas s'kanë të mbaruar, e sidomos kur je edhe në punë. Ja thoshja Enrietës gjithëmonë: «Ti, kaqë delikate sa je, e dhënë pas detyrës, duhet të gjesh ndonjë burrë që të të kujtojë, ndryshe do të grindesh e do më dëshpërohesh...»

VIKTORI — Enrieta është një vajzë e re, në moshën e saj ka gjalleri njeriu që të merret dhe me detyrën dhe me punët e shtëpisë. Pastaj unë e kam shtëpinë të ngritur, s'ka pse të mundohet.

ANA — Natyrisht. Kjo është një lehtësi për të... Me gjithë se dhe ne kemi menduar me kohë për vajzën.

ENRIETA — Sikur e bëjnë takëmet lumturinë.

ANA — S'do mënd, po edhe ato kanë vëndin e tyre.

VIKTORI — Zakone të së kaluarës...

ANA — Më se e drejtë! Ashtu është! Ne jemi njerëz të frymës së re dhe s'na ka hie as të bisedojmë për mbeturina të këtilla. Martesa e sotme ka një qëllim tjetër, një tjetër ideal, një bazë të shëndoshë sho-

moj xháne my dear
lëshím concession
nga të dýja pálët on both sides
ndjésë pástë rest her soul
e qáve couldn't be better

qëtore. Në kohën time ish ndryshe. Sot gruaja është ngritur në një nivel me burrin...

VIKTORI — Sigurisht, jeta jonë ndryshon dita ditës.

ANA — Po u menduat ndopak për planet e ardhëshme?

ENRIETA — Sa gjëra kemi për të biseduar, moj mama. Po Viktori flet pak, shumë pak. **(Vjen nga dhoma e tij Papu. Është i mbajtur mirë, relativisht me moshën e tij të shkuar. Përshëndetet me Viktorin).**

VIKTORI — Si jini Papu, a mbaheni?

PAPULI — **Bandill, përse të qahem?**

ANA — Përse të qahet Papu? Ka katër djem e një vajzë, e kalon jetën si turist; një herë tek njeri, një herë tek tjetri, nga një muaj.

PAPULI — Më shumë se një muaj s'bën.

ENRIETA — S'ka vënë njeri ndonjë normë, Papu.

PAPULI — Deri një muaj, moj xhane, mund të të durojnë nuset, pastaj fillojnë të varin buzët...

VIKTORI — Të gjitha?

ANA — Papu i ka zakon shakatë, ne s'jemi nga ato nusa. Dhe Enrieta është edukuar ndryshe. Njërzit e burrit kanë vëndin e tyre. Po kur nusja është e re e ka kulturë, ka mentalitet të ri.

VIKTORI — Unë jam partizan i lëshimeve nga të dyja palët... Dhe pak durim.

ENRIETA — Më shumë duron i vjetri sesa i riu, zakonisht.

ANA — Kështu kanë thënë shumë gra përpara martesës, po pastaj kanë dalë faqebardhë me njerëzit e burrit.

PAPULI — Rrofsh nuse! Sakrificat e tua do t'i shkruaj edhe në testamentin tim... (deklamon testamentin) «Për sa i takon nuses sime Ana, deklaroj, pa qënë i shtrënguar prej askujt, po vetëm prej ndërgjegjes sime të lirë e mirënjohëse, se ajo më ka trajtuar me një dashuri aqë të madhe, sa që unë, nga malli për ta takur sa më shpesh, pa mbushur një muaj tek nuset e tjera

zbatój resolve
dikastér administrative office
kantjér construction site
i gátëshëm = i gátshëm prepared

si mysafir, shkoja me vrap tek ajo... (Viktori dhe Enrieta qeshin. Ana buzëqesh hidhur) Për këto sjellje që ka treguar ndaj meje, po dhe ndaj plakës sime — ndjesë pastë! — i jap uratën nuses dhe i lë si kujtim porosinë ta mësojë edhe vajzën e saj si veten...»

VIKTORI — Testament interesant. (Hyjnë Aristoteli dhe Çlirimi, përshëndeten me Viktorin)

ARISTOTELI — (Enrietës) Mund të transferohesh në Tiranë edhe gjatë këtij viti shkollor.

ENRIETA — Babi, je i mrekullueshëm!

ARISTOTELI — Janë rregulla shtetërore, gruaja do të shkojë atje ku jeton burri. Apo jo, Papu? E thashë, domethënë, mirë?

PAPULI — E qave.

ARISTOTELI — Atë që themi nëpër mbledhje, duhet ta zbatojmë: interesi personal duhet të shkrihet me interesin e përgjithshëm. (Enrietës) Tani, bija ime, nuk e pengon asgjë, domethënë, lumturinë tuaj. Apo jo, Viktor? (ai heshtë) Jini të rinj, duhet domethënë, ta përballoni jetën me guxim! Enrietën e kam trime!

VIKTORI — (i gëzuar) Shumë bukur! Bashkohem plotësisht me mendimet tuaja! Foleja jonë mund të ndërtohet bukur edhe në Tepelenë, ku do të transferohem së shpejti. (Shtangen të gjithë, veç Papulit dhe Çlirimit) Enrieta le të transferohet në Tiranë dhe le të presë disa ditë, ose nja dy javë, derisa të rregulloj atje punën e apartamentit. (Viktori fillon të habitet duke i parë të heshtur e të tronditur. Pauzë) Unë prita të vinit dhe ju, zoti Aristotel, që t'ju thoshja se sot paradite patëm një mbledhje në ministri, ku u komunikuan lëvizjet e disa kuadrove nga dikasteri në kantjere. (Pauzë e gjatë) Qarkullim.

ENRIETA — (jo aqë e qetë, por e sjellëshme) Me gjithë mënd e thua, Viktor, se u transferove?

VIKTORI — (i qeshur) Kjo nuk është një temë për të bërë shaka.

ANA — Është një punë e vendosur?

VIKTORI — (i habitur) Përse habiteni, zonja Ana.

që ç'ke me të you bet I will
sa s'bëhet more than you can know
pëllëmbë për pëllëmbë foot by foot
degdísh dispatch
denbabadén after all
çorodít disorient

ANA — Po kjo ç'është, Aristotel?

ARISTOTELI — Të lutem, mos bëj alarme! (Viktorit) Nuk mund të arësyetoje se sapo u martove, të kalonte një farë kohe...

VIKTORI — Sinqerisht ju them, se nuk e prisja këtë shqetësim nga ana juaj. Më lejoni të çuditem pak. Nuk di si ta shpjegoj. Unë jam inxhinjer, jam komunist, puna, detyra ime është në kantjer, mjaft qëndrova në ministri. Ju këto gjëra i kuptoni fare mirë. E sidomos Enrieta.

ANA — Të duket gjë e thjeshtë për vajzën time?

ARISTOTELI — Mos u alarmoni, domethënë!

VIKTORI — Ç'rëndësi ka, fundi i fundit, transferimi im? Kemi aqë gjëra, shumë, më, të bukura, për të menduar... Enrieta ma ka thënë vetë, se është e gatëshme ta shoqërojë burrin e saj kudo...

PAPULI — (vendosmërisht) Vajza jonë nuk mund të bëjë ndryshe nga shoqet e saj. (Çlirimit) Apo jo, mor bir?

ÇLIRIMI — (gazmor) Kjo është përshtypja e parë, do të na kalojë.

VIKTORI — (Aristotelit) Unë bashkohem dhe me mendimin tuaj se jemi të rinj dhe duhet ta përballojmë jetën me guxim...

ARISTOTELI — Parimisht, domethënë, ashtu është... (Enrieta rri pak e menduar)

ANA — Të më mbyllet vajza në Tepelenë? Arësyetoni pak!

ÇLIRIMI — Edhe në qytetet e rretheve, mama, si në Tiranë, ka apartamente, elektrik, dyqane, kinema, teatër, shtëpi kulture. Ti s'ke dalë poshtë të shikosh.

VIKTORI — Jemi nëpunësa, Enrieta, të rinj, nuk na pengon asgjë ta krijojmë familjen kudo.

PAPULI — Mirë thotë! Shqipëri është kudo, me male, me fusha, me bredha, me trëndelina, me bilbila që i këndojnë dashurisë... Apo jo, Aristotel?

ARISTOTELI — (me gjysëm zëri) Ke të drejtë...

ANA — Po Enrieta ime është shumë e re. Kur do të gëzojë, kur të bëhet nënë e gjyshe? Njeriu përpiqet për më mirë. Mendoni moshën e saj.

me kóhë in advance

do të ta them shqip? do you want me to tell you plainly?

PAPULI — Pse, unë sa kam qënë kur u emërova mësues në fshat?

ANA — Nuk është rasti Papu të përmëndim përsëri të kaluarën.

PAPULI — (me gjallëri) Unë do ta përmënd që ç'ke me të! Në vitin 1920, kur hyri mësues, ishte njëzet vjeç Papuli!

ANA — Të kaluarën e kemi lexuar në histori.

PAPULI — Po unë me shokë e kemi jetuar! Varfëri kishte sa s'bëhet, padituri, fanatizëm, bejlerë, agallarë!

ANA — Je shumë nervoz, Papu.

PAPULI — (i revoltuar) E kam shetitur Shqipërinë pëllëmbë për pëllëmbë! Dhjetë transferime kam patur në tridhjetepesë vjet shërbim! Dhjetë herë jam degdisur për bukën e gojës. Kurse sot njerzit shkojnë vullnetarisht e shërbejnë atje ku janë të nevojshëm.

ANA — Ne jemi rritur në qytet.

PAPULI — Ti, mashalla, ke origjinë fshatare denbabaden! (Largohet në dhomën e tij)

ANA — Që kur i vdiq gruaja është bërë shumë nevrik. (pauzë) U çoroditëm fare.

VIKTORI — Shpejt a vonë unë do të transferohesha.

ANA — Më fal, po derisa e parashikoje një gjë të tillë, pse s'na e the me kohë?

VIKTORI — Sepse nuk i dhashë asnjë rëndësi.

ARISTOTELI — T'i vinim kushte dhëndërit? S'je në vete, domethënë!

ANA — Këto çështje Aristotel duhen gjykuar mirë, ne nuk mendojmë për keq, marrëveshja duhet.

ARISTOTELI — Më mirë takohemi edhe një herë nesër e bisedojmë. (duke qeshur) Këto janë kontradikta, domethënë, jo antagonistë...

VIKTORI — Gjyko me gjakftohtësi, zonja Ana, dhe arësyeto më mirë. (Enrieta mallëngjehet, Ana e shpie matanë)

ARISTOTELI — (Çlirimit) Na lerë pak vetëm, të luten. (Çlirimi shkon në dhomën e Papuli) Është bela, domethënë, me mëndjen e femrave...

VIKTORI — Nuk mendojnë kështu të gjitha nënat. Pastaj, Enrieta nuk bëri mirë që heshti dhe iku duke qarë.

ja ka ngrítur méndjen e ëma her mother is leading her astray

si s'kíni (= s'keni) sure you have

deh intoxicate

gjëmb thorn

i përsósur accomplished

për bukurí beautifully

i lëndúar hurt; angry

jetóhet how can one live

ARISTOTELI — Për ndjenjat e saj, mos dysho as për një çast. Me aqë pasion, domethënë, e ka përqafuar mendimin e martesës, saqë çuditemi dhe ne, prindët e saj!

VIKTORI — Qëndrimi i zonjës Ana nuk është i dreitë!

ARISTOTELI — (përpiqet ta zbutë) Sa herë ja kam thënë gruas sime!... Ka dobësi të madhe për të bijën!...

VIKTORI — Më falni, por unë prisja që nëna e saj ta këshillonte ndryshe, jo ta nxiste.

ARISTOTELI — Do të ta them shqip? Ka mbeturina ime shoqe, siç kemi që të gjithë, domethënë. Por është dhe diçka tjetër... Vajzë e re... Brezi i saj ka shumë kërkesa... Të themi, domethënë, atë që është... Tirana është Tiranë... Jo një vajtje në kinema, jo një shëtitje, jo opera, jo një koncert, jo pallati i Sportit, jo pallati i Kulturës, jo plazhi i Durrësit... Pastaj këtu ka familjen, shumë nga njerëzit tanë, shoqet e saj... U mësuam në Tiranë, kemi njëzetepesë vjet... Të themi atë që është, plastë ai që gënjen... Apo jo?...

VIKTORI — (Ngrihet) E kam të qartë... Atëhere takohemi këtu edhe një herë nesër pasdite.

ARISTOTELI — Nga ora tre e gjysëm, katër.

VIKTORI — Me siguri, deri nesër, zonja Ana do të mendohet më mirë, edhe me ndihmën tuaj...

ARISTOTELI — Domosdo edhe me ndihmën time, domethënë! Patjetër!

VIKTORI — Mirupafshim. (Aristoteli e shoqëron matanë. Vjen nga dhoma e tij Papuli)

PAPULI — Paska ikur dhëndëri... I mënçur djalë... Pati fat ime mbesë, po bën naze... Ja ka ngritur mëndjen e ëma... (Vjen Enrieta. Duket e tronditur, disi e lodhur, nuk e sheh Papulin, ulet afër radios)

ENRIETA — Paska ikur Viktori?... Ku janë ëndërrat e mia?... (Pauzë)

PAPULI — Paske humbur ëndërrat? (Pauzë)

ENRIETA — Sa interesant je, Papu!

PAPULI — Kam një thërrimc përvojë nga jeta, që ju të rinjtë nuk e kini.

rehát comfort
përbúz scorn
kapadajllék = kapadaillék swaggering; macho
tët your
kapadaí swashbuckler
vulós seal
tu bëftë mamája your mother loves you
po sidó që të víjë púna but no matter what happens

ENRIETA — Po ne të rinjtë nuk paskemi asgjë në vënd të përvojës suaj?

PAPULI — Si s'kini. Ju kini trupin e fortë e të shkathët, dinamizmin e zëmrës së ngrohtë që shpon male, kini socializmin... Ç'doni më shumë?

ENRIETA — Ti nuk do mplakesh kurrë, Papu.

PAPULI — Nuk më le zëmëra të mplakem. Se trëndafilit të jetës i shikoj më shumë petalet e bukura, me atë aromë të magjishme që të deh, se sa gjëmbat e vogla... **(Papuli largohet në dhomën e tij. Vijnë Ana dhe Aristoteli, që pozon përpara së bijës)**

ARISTOTELI — Djal' i përsosur! Arësyeton, domethënë, për bukuri! Tani do t'ju ve me shpatulla pas murit! (Anës) Ç'ish ai qëndrim që mbajte para Viktorit? (Enrietës) Po ti, pse heshte e më në fund më ike matanë e mallëngjyer? Kishte apo s'kishte tëdrejtë Viktori që iku i lënduar?

ANA — (e prerë) Ku kërkon të ma shpjerë vajzën, prapa diellit?

ENRIETA — Ka të drejtë mamaja! Jetohet, mor babi, në Tepelenë?

ARISTOTELI — Dëgjoni këtu. Kjo, domethënë, është një martesë e goditur, qëlloi dhëndër i mirë.

ANA — Dhe prandaj duhet të nënështrohemi?

ARISTOTELI — Të luten, mos bëj alarme!

ANA — E kemi për detyrë të mbrojmë interesin e vajzës sonë!

ENRIETA — Mirë thotë mamaja!

ANA — Po iku ai nga Tirana, Enrieta nuk duhet ta ndjekë pas.

ENRIETA — **(e habitur)** Të mos e ndjek?!

ANA — Ta merr mëndja! Derisa të dashuron, ai do të përpiqet të qëndrojë në Tiranë, patjetër.

ARISTOTELI — (nxehet) Ky nuk është një qëndrim i drejtë!

ANA — Sot, në martesë, duhen kombinuar kërkesat e të dy palëve. Ndryshe, ku qëndron mbrojtja e gruas, Aristotel?

ENRIETA — Viktori u tregua pak egoist.

levénd agile person; endearing
lundrój sail
sófër low round dining table
bëj magjí bewitch
próçkë blunder
shejtán satan

ANA — Ta merr mëndja. Nuk duhet parë rehati i sime bije?

ARISTOTELI — Ju, domethënë, po më çmëndni. Mor po a e shikoni se këto tendenca kritikohen sot? Jini në këtë republikë, apo jo?

ANA — Që të punosh për të mirën e përgjithëshme, duhet të kesh kushtet e domosdoshme.

ARISTOTELI — (i nxehur) E ka për detyrë të punojë ndaj shtetit, ndaj shoqërisë. Po jo, domethënë, kështu si thua ti, që t'i kërkojmë të gjitha kushtet për vete! (thërret) Do të pyetem edhe unë! Luhet, domethënë, me fatin e vajzës sime!

ANA — Çështë ky skandal Aristotel? Po më përbuz?

ARISTOTELI — Skandal? Përse skandal?

ANA — Se ruan akoma kapadajlleket e dikurshme dhe nuk pranon të këshillohesh me tët shoqe!

ARISTOTELI — (i habitur) Unë kapadai?! Unë s'pranoj, domethënë, të këshillohem me ty?! Grua egoiste! Më shkatërrove vajzën me teoritë e tua!

ANA — Thuamë më mirë ta vulos gojën në këtë shtëpi, që të jesh i qetë e të vendosësh ti bashkë me babanë tënd dhe djalin tim!

ENRIETA — (mallëngjehet) Më mirë thomëni se nuk më doni! (Rendin të dy pranë saj, të shqetësuar)

ANA — Mos, tu bëftë mamaja, mos bëj kështu, se do më legendisesh!

ENRIETA — Po sikur të zemërohet Viktori e të prishemi? E tmerrshme! (Hyn Çiriini)

ANA — Vetëm ajo nuk mund të ngjasë... Mos kij frikë... Ai prishet mënç për ty, s'e ke kuptuar? Si thua Aristotel?

ARISTOTELI — Kështu mendoj dhe unë. Duket, domethënë.

ANA — Po sido që të vijë puna, ti duhet të jesh e prerë në qëndrimin tënd, pa e prishur gojën.

ARISTOTELI — Studjoi fjalët, domethënë, mirë. (pauzë)

motríçkë little sister
pekúle abundance
nanurís soothe
ninanánë lullabye
zambák lily
sherr contention
shëmb = shemb destroy

ÇLIRIMI — Mos e këshilloni kështu, mama.

ANA — I ka dy këndeza kjo shtëpi, u dashkan tre? (Vjen Papuli nga jashtë)

PAPULI — Po ku je, more levend i Paput?

ARISTOTELI — E shikon, Papu, në ç'rrëmujë lundron shtëpia ime?

PAPULI — (sarkastik) Jo, mor bir, nuk para shoh nga sytë... Më ka ndodhur shpesh herë... E sidomos kur ulem në sofrën që shtron nusja... Ja ngul syrin, që thua ti, pjatës sime, dhe më duket më e vogël se pjata e të tjerëve... (Të gjithë qeshin veç Anës që dizaprovon)

— Plak i prapë je, domethënë!

ARISTOTELI — (tregon Çlirimin) Ja kush i ka ngjarë Paput.

ANA — (me veten e saj) Sikur u ka bërë magji fëmijëve të mi!

ÇLIRIMI — Enrietës ja prishni mëndjen ju të tjerët.

ANA — Kini mëndjen nesër mos bëjmë ndonjë proçkë. Kjo punë duhet të mbyllet, që të niset dhëndëri i qetë e i kënaqur. Apo jo, nuse? (Enrieta mallëngjehet. Çlirimi i shikon pranë, i përkëdhel flokët, e merr me të mirë që ta qetësojë, por nënëteksti i fjalëve të tij i drejtohet s'ëmës.)

ÇLIRIMI — Mësuesja jonë vogëlushe!... Më kujtohet ajo kohë kur ishe akoma e mitur dhe parashikonim karierën tënde artistike: «artiste do më bëhesh, thoshte mamaja, se ke një vesh të mrekullueshëm për muzikë...»

ARISTOTELI — (gazmor) More shejtan!

ÇLIRIMI — Motriçka ime e përkëdhelur!... Mos u prek, mos vuaj!...

ANA (autoritare) Çlirim!

ÇLIRIMI — U rrite midis pekulesh, e nanuritur nga melodia e pinananave dhe u bëre një zambak i bukur, por dhe molla e sherrit në familjen tonë...

ENRIETA — Tallesh me mua?

ÇLIRIMI — Të përkëdhel dhe unë, si të tjerët...

ARISTOTEL — Kritika jote është shumë e drejtë.

ÇLIRIMI — (Enrietës) A e shikon Enrieta se ç'ndodh rretherrotull? Rinia po bën mrekullira, shëmb të vjetrën, ndërton hekurudha,

shtrésë stratum
krahasój compare
apikultúrë bee raising

[illegible]fikon fshatra, shkon vullnetare në [illegible]...

ENRIETA — [illegible]oj fare mirë.

ÇLIRIMI — [illegible]e hidhu në sulm, thyej dhe ti pran[illegible] si cucat e malsisë.

ARISTOTELI — [illegible] domethënë, shumë mënd na shet!

ÇLIRIMI — [illegible] rugë tjetër, baba, duhet të çajë [illegible] me forcat e saj.

PAPULI — [illegible] thotë djali.

ANA — [illegible] shumë, Papu, mos u bëj shkak[illegible] që t'i ngrihet mëndja vajzës e të na [illegible] ndonjë fatkeqësi! Unë kam planin [illegible]!

ARISTOTELI — [illegible] mirë thotë, domethënë!

ANA — [illegible] kjo anarshi në familjen time? Nuk [illegible] zhdukur pushteti i prindit mbi [illegible]!

ÇLIRIMI — [illegible] ka njeri, mama, se është zhdukur, [illegible] lloj pushteti quhet tirani.

ANA — [illegible] drejtoj time bijë sipas mendimeve [illegible], që nuk dëmtojnë as shtetin as [illegible]inë.

ÇLIRIMI — [illegible] janë të kohës mendimet e tua.

ARISTOTELI — ([illegible]) Unë vij nga një shtresë që ka [illegible] me djersën e ballit, nuk ka shfry[illegible] njeri! Prandaj nuk të lejoj, dome[illegible], të na krahasosh me ata që kanë [illegible] e shfrytëzuar të tjerët!

ÇLIRIMI — [illegible]het një luftë e madhe mendimesh, [illegible] konceptesh. Përse të mos qën[illegible] në ballë, po të mbetemi në bisht?

ARISTOTELI — [illegible] do të më bësh agjitacion mua? Ti? E [illegible] je ti?

ANA — [illegible]ntë, Aristotel!

ÇLIRIMI — [illegible]ësia e saj e madhe është se motra [illegible] nuk ka guxim sa duhet. Unë ja them [illegible]. Po ka një armë të fortë në dorë, [illegible]inë!

ANA — [illegible] do bësh mirë të mos harrosh se ne [illegible] jemi reaksionarë, që po na flet kë[illegible]! Një xhaxha e ke ndihmës mjek, [illegible] tjetër specialist për apikulturën, xha[illegible] tjetër e ke oficer! Njerëz të pu[illegible]!

vetúrë passenger vehicle

ÇLIRIMI — Po xhaxhanë tjetër, Vangjelin, përse s'e përmënde nama?

PAPULI — Na bie prestigji sikur ta përmëndim, se ai është shofer...

ANA — **(e revoltuar)** Në fund të fundit, edhe në është shofer, nuk është shofer kamionash, po veturash!... **(Merr prej krahu të bijën dhe shkojnë matanë! Pauzë)**

PAPULI — **(Çlirimit)** Eja, more bir, matanë... Me kokën që kemi, kush e di sa muaj me radhë do mblidhemi këtu të bisedojmë... **(Shkojnë të dy në dhomën e Papulit)**

ARISTOTELI — **(Pas një pauze, i menduar)** Plak i prapë je, domethënë shumë i prapë!...

— perdja —

Spiro Çomora "Dy me zero" Nëndori (Tiranë) XVI, 6 (June) 1969, pp.42-59 (Act I)

LEXIMI I NENTEDHJETENENTE

Spiro Çomora, "Dy me zero" Nëndori (Tiranë) XVI, 6 (June) 1969 pp.59-77 (Act 2)

AKTI I DYTË

Verë. Ambienti i aktit të parë. Aristoteli rri i menduar. Hyn Ana.

RISTOTELI — (përsërit fjalët e Papulit) Me kokën që kemi, kushedi sa muaj me radhë do mblidhemi këtu të bisedojmë... (pauzë) Nuk është i prapë Papu, është i mënçur...

NA — Çdo vendim, Aristotel, e kemi marrë bashkërisht.

RISTOTELI — (thërret) Jo çdo vendim, po çdo gabim që ke bërë ti, dhe unë të kam mbajtur ison, që të mos prishet, domethënë, harmonia në familjen tonë!

NA — Ç'është ky ton, Aristotel? Ku është dinjiteti im si grua?

RISTOTELI — (i habitur) Dinjiteti yt?!

NA — (me hindje) Po! Ti nuk jeton me frymën e kohës, me atmosferën e sotme, që u jep grave vëndin që meritojnë!

RISTOTELI — Ankohu, se të kam ngrënë hakun! Të kam shtypur! Ke humbur të drejtat e tua në këtë shtëpi! S'jetokam me atmosferën e kohës! Jam, domethënë, frymë e vjetër!

NA — Shko të lutem matanë që të rregullo] pak dhomën se mos na vjen njeri.

bashkërísht together; in common
mbaj íso support; go along with
të kam ngrënë hákun I have short changed you
kobë = kóhë (mp.)

ARISTOTELI — Të na urojë për martesën e vajzës?

ANA — Për martesën e vajzës, po për çfarë?

ARISTOTELI — Kaloi një muaj e gjysëm që ajo është transferuar këtu. Viktorit iu bë kaqë kobë që iku në Tepelenë, viti shkollor mbaroi, vajza jonë vazhdon t'i shkruajë të shoqit të bëjë çmos të kthehet në Tiranë... Më vjen turp nga vetja ime...

ANA — Përse nuk i përgjigjet letrës së tretë që i dërgoi Enrieta? (pauzë)

ARISTOTELI — (i menduar) Kaluan dy javë...

ANA — Ç'do të thotë heshtja e tij? Ai e do, por i nënështrohet presionit të familjes së tij, e cila pret që të ulim kokën ne. Njerëz egoistë!

ARISTOTELI — (i menduar) Mirë thua...

ANA — Tu përulemi Aristotel? Vajza jonë nuk është as qorre, as e çalë, as torollake. E dashuron? Atëhere të kthehet në Tiranë! S'ka mundësi? E ndihmojmë ne!

ARISTOTELI — Ta merr mëndja... (i menduar) Nuk e di pse më ka hypur një frikë...

ANA — Frikë? E përse?

ARISTOTELI — Se mos bën ndonjë marrëzi... Dashuria, domethënë, të prish mënç...

ANA — Marrëzira bëjnë vajzat në ato familje që s'kanë as timon, as kapiten që t'i drejtojë. Familja jonë i ka, shyqyr, që të dyja.

ARISTOTELI — Është e dëshpëruar...

ANA — Do t'i kalojë. (pauzë) E kam në kontroll të vazhdueshëm.

ARISTOTELI — (i menduar) Timoni edhe kapiteni... Ti ç'je: timoni apo kapiteni?

ANA — Unë s'ta kam mohuar kurrë vëndin e kapitenit.

ARISTOTELI — E mora vesh... Ti qënke timoni... Kapiteni jam unë... S'ke ç'i thua... Funksionojmë mirë që të dy...

ANA — S'është koha për shaka, Aristotel! Një vajzë e ndershme me edukatë familjare, duhet t'i bindet edhe dashurisë, por edhe prindërve të saj.

ARISTOTELI — (tërhiqet) Deri diku, domethënë, ke të drejtë.

e çálë lame
torollák stupid
timón steering wheel
shyqýr fortunately

ANA — Letra e tretë e Enrietës ishte një lëshim i madh nga ana jonë.

ARISTOTELI — E çfarë kishte pozitive ajo letër?

ANA — Kaqë shpejt e harrove? I thoshte se mendon vazhdimisht për të dhe i propozonte të vijë në Tiranë, që të bisedojnë me gjakftohtësi. Dhe i theksonte se tani ka shumë mundësi të transferohet Viktori në Tiranë përsëri, sepse vëllai yt, Panajoti, ka miqësi të ngushtë me vëllanë e një shoku me përgjegjësi në ministrinë e Viktorit.

ARISTOTELI — (i menduar) Më kujtohet... (pauzë) Dhe të gjitha këto ti i quan pozitive?

ANA — Pse jo? Bile kemi bërë tepër. Ti vetë e pranove ndërhyrjen e Panajotit.

ARISTOTELI — (revoltohet) Po ç'të bëja, domethënë?... Po bëj dallavere, grua!... Po fëlliq veten Aristoteli!...

ANA — (me habi) Për një ndërhyrje?

ARISTOTELI — Po, për një ndërhyrje!... Përpiqet, domethënë, të transferojë dhëndërin në Tiranë duke kërkuar mikun posht'e lart!...

ANA — As kemi vjedhur pasurinë socialiste, as kemi shpifur, as kemi vrarë njeri, Aristotel! Në Tepelenë mund të shkojë fare mirë një tjetër inxhinjer! Përse të shkojë pikërisht dhëndëri ynë? Unë vajzën time dua ta kem këtu, në Tiranë! Fundi i fundit, kush do ta mbrojë interesin tonë?

ARISTOTELI — (sarkastik) Miku që po gjurmojmë të gjejmë nëpër vrima! Filozofi e bukur, domethënë! Shumë e ndershme!

ANA — Ta kam thënë gjithënjë: përpiqemi të jetojmë sa më mirë.

ARISTOTELI — Me maska në fytyrë! I ndrrojmë, domethënë, pas nevojës! Tjetër mbajmë në zyrë e nëpër mbiedhje, e tjetër në jetë! Dhe kështu ngrëmë lart ndërgjegjen tonë dhe kalitim karakterin e fëmijëve tanë! Sukses i madh! (thërret) Sukses i madh! Ku je fletë-rrufe që të na bësh fërtele!

ANA — (e mallëngjyer) Po të qëndronim indiferentë kundrejt fatit të saj, do të ishim pa zemër... Kriminelë... (pauzë)

dallavére deception
fëllíq soil; make dirty
fërtéle mincemeat; tatters
njëditëzaj one day recently
Aqë ja (=ia) pret What do you expect
mund t'ja (=ia) këtë frýrë në vesh he could have put an idea in his head

ARISTOTELI — (i prekur) Pse mërzitesh? Ne s'jemi kriminelë... Unë e kuptoj se duhet të përpiqemi për të...

ANA — Pikërisht... As shteti s'ka interes të prishet një familje...

ARISTOTELI — (fare i zbutur) Jo, nuk ka.

ANA — Familja e tij është shkaktare e kësaj gjëndje. Pse s'e inkurajojnë të kthehet?

ARISTOTELI — Se nuk mendojnë si ne.

ANA — Fjalë është ajo që më tha krushka njëditëzaj? «Ne nuk e prisnim kurrë që familja juaj të kishte mendime të tilla»?

ARISTOTELI — Aqë ja pret, mojl (pauzë)

ANA — Po kjo vajtja e Çlirimit me shërbim në Gjirokastër ç'ishte? Mos ka vajtur gjë në Tepelenë?

ARISTOTELI — Ku të vete mëndja?!

ANA — Paput i punon truri, mund t'ja ketë fryrë në vesh. **(Dëgjohet zilja e derës së jashtëme. Shkon Ana, e hap dhe kthehet bashkë me Donikën. Ana nuk e mirëpret këtë vizitë. Donika përshëndetet me Aristotelin)**

ARISTOTELI — Si jini, shoqja Donika, në familje? Po me punë si shkoni?

DONIKA — Mirë, faleminderit, po ju?

ARISTOTELI — Bukur fort. Po me detyrat e lagjes si dukepi?

DONIKA — Fushata e emancipimit të gruas dhe ajo e punës vullnetare të ndërtimeve janë të kënaqëshme, por kemi edhe disa problemë të tjera shoqërore që duhet të na shqetësojnë. **(Ana shqetësohet)**

ARISTOTELI — Ka, domethënë, shumë konflikte bashkë-/shortore?

ANA — Ta merr mëndja që ka.

DONIKA — Jo dhe aqë, jo. Bëhet një punë shumë e madhe edukative për çdo rast që është çfaqur. Por problemet shoqërore janë të shumta... **(që këtu do të vijë duke u rritur alegoria)**

ARISTOTELI — A, po, sa të duash. **(Ana shqetësohet)**

DONIKA — Është, për shëmbëll, problemi i fëmijve... **(burrë e grua këmbejnë vështrime)**

fushátë campaign
bashkëshortór intramarital

ANA — Sidomos në lidhje me shkollën, me mësimet, me sjelljet e tyre.

DONIKA — Kjo është njëra anë e problemit... Ana tjetër, me shumë rëndësi, janë marrëdhëniet prindër-fëmijë...

ARISTOTELI — (disi i hutuar) Sigurisht... E vjetra dhe e reja... (Ana dizaprovon me grimaca fjalët e tij).

DONIKA — Nuk është se prindërit përfaqësojnë të vjetrën... Por...

ANA — Kjo as që mund të mendohet...

DONIKA — Rinia e sotme e shikon jetën, të ardhëshmen e saj, të shoqërisë, me një sy tjetër, më të guximshëm, më optimist, më shoqëror, më revolucionar... (Ana shqetësohet më shumë)

ARISTOTELI — Shumë e vërtetë! (Ana dizaprovon)

DONIKA — Dhe, në këtë drejtim, prindët, ngadonjëherë, nuk i kuptojnë fëmijët e tyre...

ANA — Kjo varet nga zhvillimi që kanë...

DONIKA — Mos e thuaj atë fjalë... Ka edhe nga ata prindër, që janë njerëzit tanë, punonjësit tanë, të edukur mirë politikisht, që u bëhen pengesë fëmijve të tyre...

ANA — (duke përmbajtur tronditjen e saj) Paska dhe të tillë? Çudi! Si thua, Aristotel?

ARISTOTELI — (disi i hutuar) Dreqi e merr vesh... Po edhe mund të ketë, domethënë...

DONIKA — Kemi, sa për të sjellë një shëmbëll, një familje — më lejoni! — të mos përmënd emra, — ku vajza e martuar me dashuri, nuk shkon atje ku e ka punën burri i saj, në një rreth... Si duhet shpjeguar? Mos vallë e pengojnë prindët, sepse nuk duan të largohet nga Tirana, nga gjiri i familjes, duke shpresuar se dhëndri mund të kthehet? (pauzë)

ANA — (pa fshehur dot shqetësimin e saj) Të lutem, shoqja Donika, më fal, po do t'ishte mirë të flisje hapur...

DONIKA — (e qetë, si kurdoherë) Unë e kuptoj kuriozitetin tuaj, por kryesia e Frontit mendon se nuk është mirë të merret vesh kush e si e tek, derisa ta shqyrtojë çështjen mirë... (Ana dhe Aristoteli huto-

sqarím clarification
mbarëvájtje successful outcome

hen fare) Nuk beson se ka raste të tillë?

ANA — Edhe mund të ketë... Po ma merr mëndja se prindi mendon gjithmonë për të mirën e fëmijës... Si thua, Aristotel?

ARISTOTELI — Qind për qind!

DONIKA — Të gjithë kemi, si i thonë fjalës, mbetësirna...

ANA — Kjo s'mohohet dot...

ARISTOTELI — Aspak! (pauzë)

ANA — Po kini folur me ata prindër?...

DONIKA — Jo, akoma...

ANA — Duhet të flisni... Duhen dëgjuar dhe arësyetimet e tyre... Apo jo, Aristotel?... Nuk duhet dëgjuar?...

ARISTOTELI — (që s'e kish mëndjen aty) Vazhdoni, ju dëgjoj...

DONIKA — Interesant! Burrë e grua janë dy tipa të ndryshëm... Burri, për shëmbëll, nuk është, si i thonë fjalës, konsekuent në qëndrimin e tij ndaj fatit, interesit, dëshirave të vajzës, lëkundet vazhdimisht...

ARISTOTELI — (me seriozitetin më të madh) A, lëkundjet s'janë të mira! Po e shoqja?

ANA — (kategorike) Ç'të thotë e shoqja? Grave nuk u shkon akoma sa duhet fjala në familjet tona, Aristotel.

ARISTOTELI — (me zëmërim të përmbajtur) Di unë raste që u shkon, grua... E që u shkon, domethënë, shumë...

ANA — (e nxehur, por duke buzëqeshur) Pse nxehesh për hallet e të tjerëve?...

DONIKA — Hallet janë të përbashkëta... Ju interesohuni për të mirën e të tjerëve, të tjerët interesohen për të mirën tuaj... Por biseda u zgjat tepër, kurse unë erdha vetëm për dy fjalë... (Auës) Në mbledhjen e frontit të bllokut, që do të kemi të shtunën, për problemin e fëmijëve, kryesia ka menduar që ti të diskutosh rreth temës së marrëdhënieve prindër-fëmijë... Ke diskutuar kurdoherë nëpër mbledhjet tona... (pauzë) Të takon, si edukatore....

ANA — (e hutuar) Si të them... Unë nuk e njoh dhe aqë thellë këtë problem...

çaj push; press.
përkëdhelí fondling; doting
fajtór guilty party
çfajësóhem am blameless

ARISTOTELI — Më mirë thuaj se nuk e njeh fare...

DONIKA — Në qoftë se ke nevojë për ndonjë sqarim, mund të bisedosh me shokët e kryesisë... (Ngrihet) Duhet të ndihmojmë të gjithë për mbarëvajtjen e mbledhjes... Më falni shqetësimin... (përshëndet Aristotelin) Ditën e mirë.

ARISTOTELI — Ditën e mirë... (Ana largohet me Donikën. Pauzë) Urdhëro, të lutem shumë... Ngjitu në podium që të edukosh të tjerët... Shit, domethënë, teori... (Vjen Ana. Është e tronditur)

ANA — Ç'ishte kjo bisedë misterioze?... Cila është ajo familje?...

ARISTOTELI — Kush djalli e di... E bisedojmë një herë tjetër...

ANA — Mirë thua. Të bisedojmë çështjen e diskutimit tim...

ARISTOTELI — Ç'të bisedojmë?... Ti e njeh problemin fare mirë... Ti je teoriciene e këtij problemi!

ANA — Unë e kam tmerr një diskutim të tillë. Unë s'mund të gënjej, nuk di të gënjej, të tallem me ndjenjat e mia, pikërisht këto ditë që jam kaqë e tronditur. Prandaj merre përsipër ti diskutimin. Ti je burrë, ke më shumë kurajë, mund ta bësh...

ARISTOTELI — Domethënë shtrohet çështja që të gënjej unë... (Hyn Çlirimi. Duket se ka ardhur nga një rrugë e gjatë. E përqafojnë.)

ANA — Si shkove, Çlirim, në Gjirokastër?

ÇLIRIMI — Mirë. Montova një makineri.

ANA — Mos e pe gjë rastësisht Viktorin në Tepelenë?

ÇLIRIMI — Jo, nuk dolla fare nga autobuzi.

ANA — Të lumtë, shpirt! Dinjiteti i familjes duhet të ruhet gjithëmonë! (Ikën matanë)

ARISTOTELI — (në konfidencë) More Çlirim.

ÇLIRIMI — Urdhëro!

ARISTOTELI — Në qoftë se u takove me të, më thuaj.

ÇLIRIMI — Jo, baba, nuk u takova.

ARISTOTELI — Bëre shumë mirë... Po dhe sikur ta kishe takuar, domethënë, nuk do të kishe bërë keq... Po shkoj të shtrihem pak... (Largohet. Pauzë)

derdiméne thorn in one's side
véto veto
davá case; law suit
thatój sour
i shúrdhër deaf

CLIRIMI —Ç'rrëmujë!... **(Vjen Papuli nga dhoma e tij)**

PAPULI —Ç'u bëre, more djalë! **(përqafohen)**

CLIRIMI —Fola me Viktorin.

PAPULI —Ah, ku i shpie mushka, ku i shpie!

ÇLIRIMI —Ja se ç'i thashë. Enrieta influencohet shumë nga mamaja. Nuk ka gjoks të çajë përpara vetë. Babi lëkundet. Me gjithë se dhe Enrieta është bërë pak kapriçioze nga përkëdhelitë, ajo në fund të fundit nuk dëshëron në asnjë mënyrë të keqkuptoheni. Unë e Papuli, i thashë, si dhe shoqet e saj, luftojmë me të gjitha forcat tona ta bindim të marrë një vendim vetë e të vijë këtu. Kjo është gjëndja. Ka vajza që arrijnë të shkëputin zinxhirët, ime motër e ka pak të vështirë. Qëndrimi që po mban ti, do ta ndihmojë atë.

PAPULI —Të lumtë goja!

ÇLIRIMI —Të kuptoj, më tha, plotësisht. Unë s'e këputa fillin, duhej të prisja, sepse e dija se nuk është ajo fajtorja. Po si mund ta ndihmoja? Të kërkoja të transferohesha në Tiranë? Kurrë! Po dhe ajo nuk çfajësohet krejtësisht. Unë jam i bindur se ajo më do, prandaj i takon të marrë vendimin vetë. Kam një muaj e gjysëm këtu, e ajo s'po vjen. Më ka shkruar dy letra, ku nuk flet për ardhjen e saj. Sikur s'ka ndodhur asgjë. Por unë do ta pres akoma, me gjithë presionin që më bëjnë njerëzit e mi. Këto më tha. Kusurin e kohës më shetiti në kantjer. **(Hyn Enrieta. Duket e vrarë, pa humor, meditative)** Takova Viktorin.

ENRIETA — **(gëzohet)** Vërtet?

ÇLIRIMI — **Kam një muaj e gjysëm këtu, më tha, dhe më ka shkruar vetëm dy letra...**

ENRIETA — Nuk e ka marrë letrën e tretë që i shkrova?

PAPULI — I paske shkruar letër të tretë?

ENRIETA — Dy javë përpara. Nuk donte mamaja ta dinit edhe ju.

PAPULI —Nusja, derdimenia ime!

ÇLIRIMI — Nuk më foli për këtë letër që thua.

qas = afroj
stépem withdraw; back off
maní obsession
spícë splinter; sliver
zotróte your lordship

ENRIETA — Nuk ka dashur të përgjigjet. Është e qartë.

ÇLIRIMI — (kategorik) Jo, nuk e ka marrë, Enrieta! Ai nuk gënjen! Shkruaji një letër tjetër! Tregoju e gatëshme të shkosh prapë tij!

PAPULI — Është burri yt, moj bijë.

ENRIETA — Të falemnderit Çlirim... Po vuan dhe ti për shkakun tim... Letrën që shkrova unë, ma diktoi mamaja... Ti ke të drejtë. Do të nisem vetë të bisedoj me të. Shkoj t'ja them mamasë. (Ikën me vrap)

PAPULI — Prapë shkon të këshillohet me të, që të vërë veton përsëri.

ÇLIRIMI — Nuk fitohet kjo dava pa luftë, Papu. (Vijnë Enrieta dhe Ana, së cilës i tharton prezenca e Çlirimit dhe e Papulit).

ENRIETA — Nesër, mama, mendoj të shkoj vetë në Tepelenë, duhet të flas vetë me të, kjo gjëndje nuk mund të vazhdojë më. Të lutem të më kuptosh, të vihesh në pozitën time... Të lutem, mama!

ANA — (kategorike) Më komunikon vendimet që kini marrë ju të tre?

ENRIETA — Jo, mama, unë them mendimin tim.

ANA — Mendimet e tua ja shkrove në letër dhe ai bëri veshin e shurdhër.

ÇLIRIMI — Nuk e ka marrë letrën, mama, me siguri.

ANA — E ka marrë.

PAPULI — Jo, nuse, nuk dihet.

ANA — Unë gjykoj më drejt se ju të gjithë! Unë përgjigjem për time bijë, jo ju! (Hyn Aristoteli)

PAPULI — Mos u nxito, nuse, që të mos këputet filli.

ANA — S'këputet asgjë, i kam menduar që të gjitha. Ai do të vijë në Tiranë.

ARISTOTELI — Nuk e ke keq.

PAPULI — Përse flet kështu, more Aristotel?

ENRIETA — Të lutem, babi! Duhet të më kuptosh! Po më shkatërrohet jeta. Ju nuk më këshilloni drejt!

ANA — (e nxehur) Këto nuk janë mendimet e tua, po të shoqeve të tua!

tejendánë from one end to the other
shkëputum = shkëpútur away; separated
do kóhë a long time
gzíme = gëzíme
çun boy; lad
po si s'kémi of course we have
i ka ra (=rënë) kalémit she made the right match
me krushqí e përfundúat? did the in-laws make the match?
kshtu = kështú
asht = është
ma = më
vesht = vesh
S'e lúan tópi It's unshakable
demék that is to say
dúen = dúan
me i díjtë = t'i dínë
të taña = të tëra

ENRIETA — Ato më duan të mirën, më kanë qëndruar afër si motra, inë mirë se motra.

ANA — Nuk dua të qasem më këtu! Këto nuk janë probleme të shoqërisë, që të futin hundët të gjithë! Janë probleme familjare, intime! Përpara je vajza ime, e pastaj je një e re që i takon shoqërisë!

ARISTOTELI — (pregatitet të shpërthejë) E ke gabim, grua!

ANA — Jam kaqë e ngritur sa të gjykoj vetë fare mirë!

ARISTOTELI — Grua, e ke gabim!

ANA — Fatkeqësia jote Aristotel është se më ke kuptuar gjithëmonë shumë vonë!

ARISTOTELI — (shpërthen) Është e këtyre të dyve fatkeqësia. nuk është e imja! Këta, domethënë, vuajnë! Se është jashtë kohës kjo familje, e krijuar nga unë, Aristoteli, sentimentali i madh e i duruari!

ANA — Nuk mund ta dojë vajzën asnjë tjetër më shumë se unë, se është mishi e gjaku im!

ARISTOTELI — Edhe Papu e Çlirimi për të mirën e saj përpiqen.

ENRIETA — Edhe mamaja (stepen të gjithë)

ANA — Mos harro, Aristotel, se unë kam një vajzë që s'e ka njeri, prandaj e ruaj si dy sytë e ballit!

PAPULI — Mos i fryj gjërat, nuse. (panzë)

ARISTOTELI — E ka këtë mani.

ANA — Mos më futni spica në marrëdhëniet me burrin tim! Papu, të lutem, mbaj vëndin!

ÇLIRIMI — Nuk fut njeri spica, mama.

ANA — Janë lëshimet e këtij që merr guximin zotrote të kritikosh nënën tënde!

ÇLIRIMI — S'jam më fëmijë. Kam të drejtë të flas dhe në familje, siç flas në shoqëri e në uzinë.

ARISTOTELI — Të kritikosh, domethënë, po me respekt!

ANA — Ashtu! Posi!

ÇLIRIMI — Unë e kam motër.

ANA — Këtu urdhërojnë ne të dy.

ENRIETA — S'ka rrugë tjetër, mama, duhet të shkoj të bisedoj me të.

qi = që
të kuptúem = të kuptúar
komshí neighbor
dhańdërr = dhéndër
kéna kénë = kémi qénë
na = ne
rij = rinj
xhanán precious

ANA — Shko dhe qëndro në Tepelenë! Po kjo nuk do të jetë më shtëpia jote! **(pauzë e gjatë)** Unë të mohoj që tani!

ENRIETA — **(thërret në paroksizëm)** Ju lutem!... Nuk duroj më!... Po çmëndem!... Nuk shkoj!... Jo, nuk shkoj!... **(Prindët përpiqen ta qetësojnë)**

PAPULI — U prish shtëpia e Aristotelit... E mori lumi... **(Ikën në dhomën e tij. I shkon pas Çlirimi. Dëgjohet zilja e derës së jashtëme. Enrieta shkon në dhomën e Papulit. Ana shkon të hapë derën)**

ARISTOTELI — **(i dëshpëruar)** U prish shtëpia e Aristotelit!... E mori lumi!... **(thërret)** Flaka t'i dalë, domethënë!... Tejendanë!... **(Pauzë. Hyjnë mysafirët, burrë e grua, të shoqëruar nga Ana. Aristoteli përpiqet të duket i qetë. Përshëndet mysafirët. Ata ulen)**

ANA — Si kini qënë? Kemi muaj pa u parë...

MYSAFIRI — Isha shkëputun do kohë në fabrikën e çimëntos n'Shkodër, pardje u ktheva.

MYSAFIRJA — Më mbetën të gjitha hallet e shtëpisë mua, prandaj dhe nuk kam dalë.

ANA — Ta merr mëndja.

MYSAFIRI — Sikur keni pas edhe gzime!

ANA — Po, kemi patur...

MYSAFIRJA — Unë tani e mora vesh, s'ka ndonjë javë. Të rrojnë, me trashëgim e jetë të lumtur.

MYSAFIRI — Dhe n'dasëm të çunit, Aristotel.

ANA — Faleminderit dhe në shtëpinë tuaj.

ARISTOTELI — Dhe në gëzimet tuaja, domethënë.

MYSAFIRJA — Kini ndonjë fotografi të dhëndërit?

ANA — **(në hall të madh)** Po si s'kemi? **(Sjell një fotografi)**

MYSAFIRJA — Ua, sa i mirë, sa i pashëm, goxha djalë mashalla!

MYSAFIRI — Besa, zonja Ana nuk shkel n'drrasë t'kalbun, i ka ra kalemit!

MYSAFIRJA — Me krushqi e përfunduat?

ANA — **(që fillon të humbasë durimin)** Me dashuri... Por dhe ne ishim dakord si prindër.

MYSAFIRI — Kshtu asht ma mirë, se afrohen dhe meren vesht menjiherë.
Apo jo, more Aristotel? **(Ana sjell dhe i qeras, mojnë përsëri)**

pjépër melon
ndigjúe = dëgjúar
pjépnat = pjérrat
fuçí barrel
nuk thue = nuk thúa
të ménçëm = të ménçur
kenë = qénë

ARISTOTELI — S'e luan topi, domethënë.
MYSAFIRJA — Është e kënaqur Enrieta?
ANA — (e torturuar) Shumë...
MYSAFIRI — Gratë, demek, duen me i dijtë të tana... Apo jo, more Aristotel?
ARISTOTELI — Unë, domethënë, njoh vetëm gruan time... (qeshin)
MYSAFIRJA — Po ç'punë bën dhëndëri?
ARISTOTELI — Është inxhinjer.
ANA — Universitetin e ka mbaruar shkëlqyer...
MYSAFIRJA — Kultura do shkojë me kulturën.
MYSAFIRI — Dhe zanati me zanatin.
ARISTOTELI — (shumë i bezdisur) A, jo, nuk na the gjë! Kjo nuk është e drejtë, domethënë!
ANA — Tani shikohet karakteri, sjelljet, origjina e shëndoshë shoqërore...
MYSAFIRI — Kshtu mendoni ju, qi jeni njerz të kuptuem, por ka dhe do të tjerë qi mendojnë ndryshej. Apo jo, more Aristotel?
ARISTOTELI — (s'duron më) Po, more Fejzo, po! Ke të drejtë, domethënë! Ashtu është, si thua ti! (Hap derën Enrieta, pa ditur se ka njerëz, por mysafirët e shohin dhe ajo detyrohet të hyjë. Përshëndetet me ta, e urojuë).
ANA — Ulu një çikë, vajzë, se kanë ardhur komshitë e vjetër për urime. (Ajo ulet) I njeh, të kujtohet kush janë?
ENRIETA — Po si s'më kujtohen
MYSAFIRJA — Si veten e ke zgjedhur. Po sa u rrite, sa u rrite!
ANA — Eh, vajzat rriten shpejt, kalojnë vitet...
MYSAFIRI — (Enrietës) Kini marrë apartament?
ANA — Jo, akoma...
MYSAFIRJA — Dhe banojnë këtu?
ANA — Vajza, sa t'i vijë burri i saj që ndodhet përkohësisht në Tepelenë... (Hyn Papuli. E urojnë. Ulet)
MYSAFIRJA — Si e ka emrin dhëndëri?
ANA — Viktor.
MYSAFIRJA — (Enrietës) Vjen ndonjëherë Viktori në Tiranë?
ENRIETA — (e shqetësuar) Si t'ju them...
ANA — I vjen turp... Ka ardhur tri herë gjer tani...

të bekúemit = të bekúarit the blessed ones
më qafsh may you outlive me
thúeje = thúaje
shakaxhí joker; jester
qënke në qejf you're in high spirits

MYSAFIRI — E po dhandërr i ri, kena kenë dhe na të rij nji her' e nji kohë... Apo jo, more Aristotel?

ARISTOTELI — Lere, mos na e kujto, domethënë...

MYSAFIRJA — Ardhja e tij ju gëzon, e kini djalin e shtëpisë.

ANA — Si Çlirimin.

PAPULI — (që s'duron më) Apo nuk i sjell peshqeshe vjehrës...

MYSAFIRJA — Pa shiko!

PAPULI — Nuk ja prish qejfin për asgjë...

MYSAFIRI — Djalë xhanam! Apo jo, more Aristotel?

ARISTOTELI — (i zënë ngushtë) Nuk ke ç'i thua, domethënë!

PAPULI — E do shumë Anen...

MYSAFIRI — Paska respekt. Kështu duhet. Apo jo, more Aristotel?

ARISTOTELI — (që s'e ka mëndjen) Fole gjë?

MYSAFIRI — Thashë se dhandri ka respekt të veçantë.

ARISTOTELI — Shumë të madh!

PAPULI — (Anës) Thuaji, nuse, ç'të solli herën e fundit...

ANA — (sa s'po pëlcet) Lerna dhe ti Papu, ç'rëdësi ka?

PAPULI — Që ta marrësh vesh, ti Fejzo, i solli disa pjepra të Luzatit, naaaa!...

MYSAFIRI — Kam ndigjue. Luzati i ka pjepnat për kokën e pjepnit. Apo jo, more Aristotel?

ARISTOTELI — (s'duron më) Po, more Fejzo, sa një fuçi i ka, domethënë!

MYSAFIRJA — (Anës) Të pëlqyen?

ANA — (e nevrikosur) Jashtë masës...

MYSAFIRJA — Po krushqit ç'njerëz janë?

ANA — Kam përshtypjet më të mira...

PAPULI — E sidomos nga krushka...

MYSAFIRJA — Të haket shumë muhabeti me të?

PAPULI — Sikur janë dy motra...

MYSAFIRI — Shyqyr, nuk thue!

MYSAFIRJA — Me sa duket, ngjani shume në mendime.

ANA — Sa kureshtare je, zonja Makbule! (Mysafirja mbetet keq)

PAPULI — Të vjetrit thoshin se kureshtja është nëna e diturisë.

m'báne ti = më bére ti
i lúejte = i lúajte
i lúajte fénë well done

MYSAFIRI — Ama të mençëm paskan kene të bekuemit! Apo jo, more Aristotel?

ARISTOTELI — Shumë të mençur kanë qënë... Po ne, domethëne, me këtë bisedë që po bëjmë, ua kalojmë qind për qind...(**Mysafiri fillon të qeshë me të madhe**)

MYSAFIRI — Më djafsh, thuaje edhe nji herë! (**Vazhdon të qeshë**)

ARISTOTELI — Kaqë shumë të pëlqeu?

MYSAFIRI —(**shkulet gazit**) Je shakaxhi i tmerrshëm! (**S'e mban dot gazin as Aristoteli. Mysafirja kërkon të frenojë të shoqin**)

ARISTOTELI —Qënke në qejf, o Fejzo!...

MYSAFIRI — M'bane ti! (**Shkulen gazit të dy**) I hajte fenë!

MYSAFIRJA — Kur i hypën për të qeshur Fejzos... Mjaft tani... Jemi në shtëpi të botës... (**Qeshin të gjithë**) Ne erdhëm sa për një vizitë. (**Ngrihet**)

ANA — Pse kaqë shpejt? Rrini dhe pak..

MYSAFIRJA — Ne erdhëm vetëm sa t'ju uronim (**Urojnë edhe një herë e dalin, të shoqëruar nga Ana, Aristoteli dhe Enrieta**)

PAPULI — Duhej të vinte Fejzua që të na qeshte pakëz buza... Luaj theatro, nusë, luaj... (**Vjen Enrieta**)

ENRIETA — Mamaja u zëmërua shumë që e ngacmove për peshqeshet.

PAPULI — E thartuan fjalët e mia? S'i gëlltiti dot?

ENRIETA — Nuk është mirë nga nervat, Papu.

PAPULI — Nuk është mirë nga mëntë. Unë kam dhe tri nuse të tjera; tri vajza kanë martuar djemtë e mi deri tani, me mënd e me nder, se në shtëpinë e tyre ka mirëkuptim, ka marrëveshje, dëgjojnë njeritjetrin, këshillohen. Ku e shpie mushka Aristotelin? Nuk mjafton të jesh nëpunës i zoti në zyrën e shtetit, kur s'di të rregullosh punët e tua familjare. Llastikë është bërë djali im. Aty zgjatet e zgjatet, saqë thua se do të këputet, aty tkurret përnjëherësh e katandiset disa centimetra njeri. Vetëm «domethënë» di të thotë..

gëlltít swallow

méntë = méndtë

ku e shpíe múshka Aristotélin? where the heck is Aristotle going?

ENRIETA — Edhe babi ma do të mirën.

PAPULI — Ta do të mirën po nuk di ta mbrojë, se s'ka gjoks. Dhe dallgëzohet mbi këtë barkë që quhet familje. **(Hyn Aristoteli. Papuli vazhdon monologun e tij)** Nuk qeverisen familjet në këtë mënyrë. Mendimin e Çlirimit nuk duan ta përfillin. Mua s'më durojnë. Me kë do kështillohem? Përpara teje, bijë, është hapur një greminë...

ENRIETA — E sheh... **(pauzë)** Edhe shoqja Donika kështu më foli dje...

PAPULI — Çfarë do të bësh? Do mbyllësh sytë e do të hidhesh? Ti je vajza jonë, je gjaku ynë, je një pjesë e gëzimeve tona, e lumturisë sonë... U bënë katër muaj që qëndroj këtu, sepse nuk më bën zëmra të ndahem nga ty... Ashtu siç ndjej unë nevojën të të kem pranë, të të shikoj, ndofta mund të kesh dhe ti nevojë për një fjalë timen... Në mos për pjekurinë, të paktën për dashurinë time... **(preket, pauzë)** Qëndrova shumë kësaj here në shtëpinë e Aristotelit... E kam kollaj të shkoj tek djemtë e tjerë... Që sot... Po s'më bën zëmra të largohem... Edhe për ty edhe për tët vëlla... Nuk ja përfill mendimin e ëma... Po dije se ai është i zoti të bëjë çdo sakrificë për të motrën. **(Enrieta, e mallëngjyer, shkon në dhomën e Papulit. Pauzë)** Të tillë djalë ke, Aristotel.

ARISTOTELI — Ti e ke vëndin këtu, është shtëpia jote, mos na lerë vetëm, Papu. **(pauzë)**

PAPULI — Enrieta është brumë i mirë.

ARISTOTELI — E di.

PAPULI — Nuk i thirra kot vëllezërit e tu edhe të motër një ditë. E dëgjove ç'thanë?

ARISTOTELI — Më dënuan që të katër. Po prishën gojën dhe me time shoqe. Folën rëndë, domethënë, kundër saj. E kam grua, Papu. Të lutem shumë.

PAPULI — Thanë të vërtetën. Ajo e prishi gojën me ta. Nuk bën të ftohesh me vëllezërit e tu. Doni ta prishni këtë martesë?

llastíkë rubber band
zgjat stretch
tkurr contract
dallgëzój toss as by a wave

ARISTOTELI — Në asnjë mënyrë.
PAPULI — Do të turpërohemi.
ARISTOTELI — Po si të bëjmë?
PAPULI — Gënjejmë botën që vjen e na uron. Po njerëzit e tij nuk kanë thënë asnjë fjalë jashtë shtëpisë së tyre.
ARISTOTELI — Janë sjellë shumë mirë, s'ke ç'i thua.
PAPULI — Mirë i tha Çlirimi nuses. Nuk edukohen kështu fëmijët. Shkundu, vendos dhe ti njëherë, një fill na ndan nga prishja e fundit.
ARISTOTELI — More Papu, ç'më quan, naiv?
PAPULI — Jo, naiv nuk je.
ARISTOTELI — (nxehet) Unë di, domethënë, të marr edhe vendime! Jam gati të përmbys dynjanë! Edhe familjen time të borgjezuar, domethënë! **(Ikën matanë me rrëmbim)**
PAPULI — (ironik) Po hë, more Aristotel, përmbyse njëherë botën, se mund të krijohet një tjetër, pa njerëz të lëkundur!...
(Vjen Enrieta nga dhoma e Papulit. Vjen Çlirimi)
ENRIETA — Vendosa të shkoj në Tepelenë, Papu.
PAPULI — Nisu, vajzë.
ÇLIRIMI — Do ta shoqëroj unë.
ENRIETA — Shkoj të thërras mamanë. **(Ikën matanë)**
ÇLIRIMI — Do të lëkundet, babi, përsëri.
PAPULI — Kësaj here jo, vendosi. I fola shumë. **(Vijnë Ana, Aristoteli dhe Enrieta)**
ANA — **(E tronditur nga biseda që ka bërë matanë me Aristotelin)** Ç'është kjo mbledhje e re.
ENRIETA — E fundit, mama.
ANA — Ja ngritën mëndjen babait tënd kundër së shoqes dhe erdhi matanë e mu lëshua. tani ta paskan ngritur edhe ty?
ARISTOTELI — Ana, kij mëndjen, se jam me gjak të prishur, domethënë! Mos folë me thumba!
ANA — Punët e shtëpisë sime kishin shkuar mrekulli deri tani.
ARISTOTELI — E kush i prishi? Unë, Aristoteli?
ANA — Ta thashë dhe matanë: ndërhyrja e njerëzve të tjerë, e njerëzve të huaj.

brúmë stock; dough
shkúndu wake up
dynjá mankind; humanity

ÇLIRIMI — I huaj jam unë në këtë familje?
ANA — Derisa je ngritur kundër prindërve të tu!
ÇLIRIMI — Unë shpreh mendimin tim!
ARISTOTELI — Çlirim, mbaj gojën!
ANA — (thërret) Nuk të lejoj!
PAPULI — Qetësohu, nuse, folë me gjak të ftohtë.
ANA — Ç'kisha për të biseduar, i bisedova me tim shoq!
ENRIETA — Nuk është e drejtë të vendosni pa më pyetur mua.
ANA — Kështu të kanë udhëzuar të flasësh?
ENRIETA — Nuk më ka udhëzuar njeri.
ÇLIRIMI — Enrieta do të mbrojë interesin e saj, me forcat e saj.
ANA — Ashtu?
PAPULI — Mirë thotë djali.
ENRIETA — Po, mama. Do të shkoj.
ÇLIRIMI — Do ta shoqëroj unë.
ANA — (o rreptë) Nuk të lejoj të na mësosh!
ÇLIRIMI — E kam për detyrë të mbroj time motër!
ANA — Arrogant!
ARISTOTELI — Ana, mos hidh benzinë, dëgjove?
ANA — (me shumë «dinjitet», olimbike) Dëgjova, Aristotel... Unë jam këtu vetëm për të dëgjuar... Një gjë të them ty, vajzë... Puna joje u pa... Fillove rrokullimën... Deri tani ke qënë në duart e mia, dhe nuk ke patur ndonjë humbje... Dëgjomë për herë të fundit... Viktori, me ç'kam marrë vesh, është grindur me familjen e tij... Kjo tregon se të do... Dhe jam qind për qind e sigurtë se do të bëjë çmos të kthehet me punë në Tiranë... Dashuria bën çudira... Duro, që të dalësh e fituar...
ARISTOTELI — Turp, që flet kështu!
ANA — Edhe ti, Aristotel, po i vë kazmën familjes?
ARISTOTELI — Këtu do të vendosim si familje.
ANA — (e nxehur) Kolektivi vendos nëpër fabrika, jo këtu!
ÇLIRIMI — Kjo është e tmerrshme!
ANA — Rrugaç! (Enrieta rend pranë Çlirimit, i cili s'luan nga vëndi)

udhëzój direct; guide
olimbík Olympian
rrokullímë downward plunge

ARISTOTELI — Ana, je çmëndur? (Enrieta rend prano babait)

PAPULI — Mosni, në kini mëshirë për këtë lumëmadhe!

ANA — Të urdhërosh në familjet e djemve e të vajzës sate, jo këtu! Gruaja e sotme nuk është më skllave e burrit! Ajo kohë perëndoi!

ARISTOTELI — Mos i vërtit parullat sipas qejfit tënd! (Ana nuk ndihet mirë)

ENRIETA — (duke rendur afër saj) Mama! (E ulin në kolltuk. Aristoteli e humbet fare. Pastaj, bashkë me të bijën, e shpien matanë)

PAPULI — Si do t'i vejë halli sime mbese? Do ta shpëtojmë?

ÇLIRIMI — Do ta shpëtojmë patjetër! (pauzë)

PAPULI — (i tronditur thellë) Unë jam plak... Nuk kam fuqi... Ti je i ri... Kjo është luftë psikologjike, mendimesh... Do zëmrën tënde, jo gioksin tim të fishkur... (Vjen Aristoteli, i dërmuar)

ARISTOTELI — Sikur i rrihte zëmra shumë...

PAPULI — Vajzës?

ARISTOTELI — Vajzës nuk ja pashë.

PAPULI — Shikoja, Aristot... Ndofta asaj i rreh më shumë... (Aristoteli ikën përsëri matanë. Çlirimi del në ballkon dhe sheh duke ardhur Lirikën)

ÇLIRIMI — (i gëzuar) Po vjen Lirika. (Shkon t'i hapë derën)

PAPULI — Vajza të mira... Iu ndodhën sime mbese, me gjithë shpirt, në këtë hall që ka... Motra, e shkuar motrave... Por ajo nuk ja prish dot sëmës.. (Largohet në dhomën e tij. Vijnë Çlirimi e Lirika)

ÇLIRIMI — (që s'mund tà fshehë dot interesimin e tij për të) Si je, shoqe gjeometre?

LIRIKA — Po ti si je, shoku mekanik, student në vitin e fundit të inxhinjerisë?...

ÇLIRIMI — Kur s'jam i zoti t'i bëj njerëzit për vete, më rroftë inxhinjeria... (ajo e kupton për vete) Erdhe në një kohë shumë të përshtatëshme, Lirika, kemi nevojë për ty, shumë nevojë.

rrugáç good for nothing; lazy bum

mósni don't

lumëmádh unlucky

perëndój set

mótra e shkúar mótrave better than sisters

LIRIKA — I fole Enrietës për takimin tënd me Viktorin?

ÇLIRIMI — I fola, dhe iu mbush mëndja të shkojë vetë, po mamaja na bërt skandal.

LIRIKA — Si nuk e çmojnë Viktorin si njeri? Ai është xhevahir.

ÇLIRIMI — Mamaja është e bindur se kështu mbron interesin e vajzës së saj! Po çfarë dashurie është kjo? Ka arritur të ndjejë urrejtje për mua!

LIRIKA — Këtë mos e thuaj.

ÇLIRIMI — Këto janë marrëdhëniet që kërkohen midis prindit e fëmijës? Në familjen tonë po bëhet një padrejtësi! Po dhe Enrieta s'e ka atë forcë që të hidhet në sulm, të çajë përpara, të kapërxejë çdo pengesë!

LIRIKA — Babai vazhdon të lëkundet?

ÇLIRIMI — Lëkundjet e tij na prunë në këtë gjëndje! Pranoi të bëhet kjo martesë vetëm që t'i sigurohej Tirana Enrietës! Dashuria e tyre reciproke dhe cilësitë e Viktorit nuk kanë rëndësi për ta! (Vjen Enrieta, e vrarë, e heshtur, e menduar, përqafohet me Lirikën)

LIRIKA — Ç'kujtove, shoqe arsimtare, se martesa ka vetëm poezi e romantikë?

ENRIETA — Kështu kisha kujtuar... (Pauzë) Po më zihet fryma, Lirika!... Vuaj!

LIRIKA — M[illegible] thonë: ndrroni klimën... (pauzë)

ENRIETA — P[illegible] ditësh nisem bashkë me nxënës[illegible] mi në aksionin e hekurudhës... Këtu brënda e ndjej se po më zihet fryma... Duhet të dal për një kohë që këtu... (pauzë)

LIRIKA — (enthuziaste) Do të vij dhe unë, Enrieta!

ENRIETA — Në hekurudhë?!

LIRIKA — Do kërkoj dhe unë të vij dy muaj vullnetare, të jemi bashkë.

ENRIETA — (enthuziaste) Lirika! Je e mrekullueshme! (e përqafon) Pse je kaq e mirë?... (Qan nga gëzimi) Po në të pengoftë ministria?

LIRIKA — Do të luftoj! Dhe do të vij! Ajri i fushës mund të na bëjë shumë mirë... (vështron Çlirimin) edhe ne beqareve... (Çli-

me rróftë inxhinjería (=inxhinieria) what good is engineering

padrejtësí injustice

prúnë (sjell) brought

rimi kollitet) Do të vij përsëri nesër. Mirupafshim!

ÇLIRIMI — (gjoja i mallëngjyer) Ikën pa më thënë një fjalë të ëmbël? Ke ardhur nuse në këtë shtëpi një ditë... Si e harrove?...

LIRIKA — (gazmore, i tregon një bust të vogël) Nuk të mjafton hyjnesha e Butrintos?... (Qeshin. Lirika dhe Enrieta largohen. Pauzë. Vjen përsëri Enrieta)

ENRIETA — Ja kam zili temperamentin. Viktori fliste gjithmonë me respekt për të. (Vjen Aristoteli) Si është mamaja?

ARISTOTELI — Tani është mirë, po qetësohet.

ENRIETA — Shkolla jonë pas disa ditësh niset për në hekurudhë. Tani mos u shqetësoni më për mua... Mjaft u tronditët...

ÇLIRIMI — Do të shkojë dhe Lirika në aksion.

ARISTOTELI — Shumë mirë, i lumtë. Është vajzë e sjellëshme, shumë e sjellëshme. (Pauzë. Hyn Papuli, përshëndet dhe niset drejt dhomës së tij)

ARISTOTELI — Rri pak këtu, Papu, të bisëdojmë.

PAPULI — Akoma do të bisëdojmë?

ARISTOTELI — Enrieta do të niset në hekurudhë me nxënësit e saj.

PAPULI — (alarmohet) Jo! Të mos shkojë!

ENRIETA — (e shqetësuar) Përse, Papu?

PAPULI — Se je e dërmuar shpirtërisht dhe puna fizike do të të ronitë fare! Ki mëndjen!

ARISTOTELI — Lëmsh u bë kjo punë, lëmsh...

PAPULI — Nuk jam dakord të shkojë. Po ju bëni si të doni. Mos më pyetni më për asgjë, gjer nesër që do të jem këtu...

ARISTOTELI — (i menduar) Edhe fare pa baza, domethënë, nuk është arësyetimi i Paput...

ÇLIRIMI — (i alarmuar) Si e the këtë fjalë, Papu? Enrieta do të shkojë patjetër! Duhet të shkojë! Ka nevojë të madhe! Të dalë jashtë, në ajrin e pastër! (Papu largohet në dhomën e tij).

ENRIETA — Dalim pak në pazar, Çlirim?

ARISTOTELI — Shko djalë me tët motër, shko. (Çlirimi dhe Enrieta dalin) Kësaj here na qënka Papu dakord me time shoqe!... Çudira

kollítem cough
hyjnéshë goddess

ndodhin në këtë shtëpi!... Çudira!... **(Vjen Ana. E lodhur, olimbike, ulet në një kollituk dhe s'lëviz nga vëndi)** U qetësove?

ANA — Prindi nuk qetësohet kurrë...

ARISTOTELI — Pas disa ditësh do të niset Enrieta në hekurudhë.

ANA — (alarmohet) Do të shkojnë dhe mësuësit?!

ARISTOTELI — Po.

ANA — Nuk duhet të shkojë në asnjë mënyrë!

ARISTOTELI — Qetësohu, qetësohu...

ANA — Edhe puna fizike i duhet sime bije!

ARISTOTELI — Qetësohu, mos u mërzit... Kemi kohë të bisedojmë a do të shkojë apo jo... **(Ana qetësohet)**

ANA — Përpiqem të qetësohem... **(Hap derën e tij Papuli, sheh Anën dhe tërhiqet përsëri. Por Ana e sheh)** Të pyeti vjehri im, Aristotel, si e ndjej veten?

ARISTOTELI — (pas një ngurrimi) Më pyeti, posi. **(pauzë)** Nesër ikën Papu që këtu...

ANA — Ne nuk e shtrëngojmë, por në qoftë se ka vendosur, le të shkojë... **(pauzë)** I erdhi ndopak keq për mua?

ARISTOTELI — (pas një ngurrimi) I erdhi, posi. **(pauzë)** Kësaj here, Ana, do të bini dakord ndofta për herë të parë...

ANA — (kureshtare) E pse?

ARISTOTELI — Edhe Papu është i mendimit tënd, që Enrieta në mos shkojë në aksion, se do ronitet fare. Jam në një mëndje, tha, me nusen...

ANA — (me kënaqësi të veçantë e kremari) Ashtu?... Atëhere ngul këmbë, Aristotel, të mos largohet Papu që këtu... Thuaji të rrijë në shtëpinë tonë sa të dojë... Më së fundi, filloi të më kuptojë dhe ay... **(pauzë)** Më së fundi...

— perdja —

ronítem waste away

LEXIMI I NJEQINDTE

Spiro Çomora "Dy me zero" Nëndori (Tiranë) XVI, 6 (June) 1969, pp.77-88 (Act 3)

AKTI I TRETË

Verë. Skena paraqit një ambient aksioni nga ndërtimi i hekurudhës Rrogozhinë-Fier.

Hyn në skenë Viktori dhe ndalet përpara zyrës së inxhinjerit të sektorit të dytë. Është i lodhur, i djersitur, sodit natyrën, ndez një cingare.

Hapet dera e ndërtesës dhe del Lirika. E vështron për disa çaste Viktorin, e habitur.

LIRIKA — Viktor!

VIKTORI — Lirika! (përqafohen)

LIRIKA — Të pashë nga dritarja duke ardhur dhe të njoha deridiku nga ecja elegante. (Viktori qesh) Ç'farë ju nxiti, shoku inxhinjer, të mundoheshit deri këtu?...

VIKTORI — Dashuria...

LIRIKA — Dashuria për cilën?

kalít temper; forge
fisnikërój become noble
mínë explosive charge
or' e çast hour after hour
haré celebration

VIKTORI — Për natyrën e bukur, ku kalitet me punë vullneti i dobët dhe fisnikërohen mendimet...

LIRIKA — Parathënia jote më pëlqen... Vazhdo me të njëjtin lirizëm...

VIKTORI — Do të vazhdoj më bukur kur të më vijë muza...

LIRIKA — (e gëzuar) Alegoritë e tua më pëlqejnë shumë...

VIKTORI — Po ti le zyrën në Tiranë dhe erdhe këtu në Myzeqe të bëhesh burokrate?

LIRIKA — Jam caktuar të ndihmoj inxhinjerin. (pauzë) Këtu, në sektorin e dytë, është dhe brigada e Enrietës... Punojmë bashkë... **(Dëgjohet shpërthimi i një mine)** Po hapim tunelin e madh. Ndryshohet natyra...

VIKTORI — E shoh...

LIRIKA — Shumë gjëra ndryshohen këtu bashkë me natyrën, Viktor... Edhe disa mendime...

VIKTORI — Po botkuptimet?

LIRIKA — Besoj se po...

VIKTORI — E ke parë me sytë e tu?

LIRIKA — Vazhdimisht, or' e çast, e kam ndjekur ndryshimin e tyre... **(qeshin)** E more letrën e Enrietës?

VIKTORI — E mora pesë dit përpara. **(ajo gëzohet shumë)**

LIRIKA — Vërtet?!

VIKTORI — (vështron larg) Ja, pas përpjekjes, pas luftës me natyrën, vjen gëzimi i fitores, harcja... **(Dëgjohen brohoritje entuziaste vullnetarësh)** Tuneli u hap... Një nga fitimtarët që brohorasin do të jetë dhe Enrieta...

LIRIKA — (entuziaste) Viktor! Po dëgjoj fjalë të mrekullueshme! Shkoj ta lajmëroj!

VIKTORI — Lajmëroje me një person tjetër, se e kërkon Lirika në zyrë. Vetëm kaqë.

LIRIKA — Si të duash ti! **(Ikën fluturim. Vjen Faiku, inxhinjeri përgjegjës i sektorit të dytë. Takimi i dy shokëve të vjetër është i përzëmërt)**

FAIKU — Ç'të solli këtu?

komoditét level of accomdations
mikprítës hospitality
zëvëndësój = zëvendësój replace
qumështór milksop
E hóqa zvárrë kémbën I blazed the trail and they followed
binjákë twins
qerratá scoundrel

VIKTORI — Dëshira për të takuar shokët e vjetër. Qëndrova pak në sektorin e tretë, me Kostaqin, dhe tani erdha në sektorin tënd. Kam marrë lejen e zakonëshme.

FAIKU — Komoditetin e kemi të pakët, por jemi mikpritës... Ky është pallati i sektorit të dytë, ku mendon i nënshkruari... Na falni për modestinë e ambientit, shoku Viktor... Jemi në teren...

VIKTORI — Ka tre muaj që edhe unë punoj në një kantjer të Tepelenës...

FAIKU — Kurse unë, që kur mbarova fakultetin...

VIKTORI — Po me dëfrimet, me jetën artistike, si shkoni?

FAIKU — Punë, kulturë e dëfrim.

VIKTORI — Domethënë ti, Faik, je përgjegjës i sektorit të dytë?

FAIKU — Ka një javë që zëvëndësova Kostaqin.

VIKTORI — Kush tjetër nga shokët tanë është këtu?

FAIKU — Plot. Të kujtohet Kozmai?

VIKTORI — Cili Kozma?

FAIKU — Kozma Aspirina. S'të kujtohet që i pinte aspirinat përpara se t'i dhimbte koka? **(qeshin)**

VIKTORI — Sa shpejt kaluan vitet e fakultetit!... Po Pertefin, e ke parë?

FAIKU — Pertef Qumështorin?... **(qeshin)** Është në Vaun e Dejës.

VIKTORI — Do ta ketë hequr thua gjithë atë mapo me fanella e triko që mbante veshur?

FAIKU — Vetëm në qoftë se ja ka hequr gruaja.

VIKTORI — Qënka martuar?

FAIKU — Posi. E hoqa zvarrë këmbën unë. **(imiton Pertefin)** «Qumështor, qumështor, por unë bëra dy binjakë! **(qeshin)**

VIKTORI — Qerrata Faik!

FAIKU — Po ti, beqar akoma?

VIKTORI — Unë?... **(pauzë)** Ti sa fëmijë ke?

FAIKU — Një vajzë. **(Dëgjohet një zë: «shoku Faik!»)** Do të më falësh një minutë? **(Largohet. Viktori ulet në një fron, nxjerr gazetën dhe lexon. Vjen Enrieta nga drejtimi i kundërt i Faikut, hap derën, hyn në zyrë,**

orár i púnës work schedule
me zémër të bárdhë with a heart of gold

nuk shch Lirikën dhe del përsëri. Ndodhet ballë për ballë me Viktorin, që është ngritur në këmbë. Pauzë. Të dy nuk e fshehin dot tronditjen e tyre, por Enrieta më tepër)

VIKTORI — Si je, Enrieta?

ENRIETA — Shumë mirë. Kur paske ardhur?

VIKTORI — Sot. Si shkon këtu?

ENRIETA — Bëj punë krahu, si gjithë vullnetarët. Jashtë orarit të punës ndihmoj me sa mundem dhe për edukimin e malësoreve.

VIKTORI — Të del koha t'i bësh të dyja?

ENRIETA — Përpiqem ta gjej.

VIKTORI — Si e kalove në Tiranë? (ajo heshtë) Si i ke prindët?

ENRIETA — Ç'ka, mirë.

VIKTORI — Çlirimi si është?

ENRIETA — Mirë. Tani po pregatitet për provimet e shtetit.

VIKTORI — Po Papuli?

ENRIETA — Është bërë shumë merak për mua.

VIKTORI — Plak i mirë, me zëmër të bardhë.

ENRIETA — Po mamaja jote, motra, vëllai?

VIKTORI — Mirë janë.

ENRIETA — Dy javë përpara se të nisesha për këtu, të shkrova letrën e tretë.

VIKTORI — Përse nuk ma përmëndi Çlirimi?

ENRIETA — Nuk e dinte. As Lirika nuk e dinte. Prita një përgjigje.

VIKTORI — Preferova të mos i jepja një përgjigje asaj letre, që të harrohej përmbajtja e saj... Pesë dit përpara kam marrë letrën tënde të fundit. Kësaj iu përgjegja me ardhjen time këtu...

ENRIETA — Më takonte mua të të shkruaja... Kam vuajtur shumë... Luftoja me veten time, që të kapërxeja pengesat, dhe të vija të të takoj... Por s'isha e zonja...

VIKTORI — Cilësitë e mira kaliten në jetë, midis njerëzve, në luftë të përbashkët me ta, për një qëllim fisnik, që është e mira e përgjithëshme. Nuk jetohet bukur larg njerëzve, në kundërshtim me njerëzit.

përtërít	revive
di = dy	
mbidh = mbyll	
si = sy	
kanaqéps	caress

ENRIETA — Jo, nuk jetohet.

VIKTORI — Nuk mund të jesh e lumtur ti, pa qënë dhe ata që të rrethojnë, e sidomos të afërmit e tu, të dashurit e tu...

ENRIETA — Kurrë s'e ndjeva veten aqë të vetmuar sa atë muaj e gjysëm pas kthimit tim në Tiranë... Më dukej sikur të gjithë më dënonin, edhe kur ishin të përzëmërt me mua, edhe kur më uronin për martesën tonë....

VIKTORI — Gjatë kësaj kohe luftova edhe unë me njerëzit e mi. Ishin të tronditur, bile arritën të mendonin se duhej zgjidhur kjo martesë. Pardje shkuan e ua thanë dhe prindëve të tu.

ENRIETA — Vërtet?! Ç'më thua?!

VIKTORI — U nxituan... Fundi, isha unë që do të vendosja. (pauzë)

ENRIETA — Ish një torturë e tmerrshme... Po ardhja ime këtu i dha fund këtij ankthi...

VIKTORI — Gjërësia e horizontit, lufta heroike për të fituar mbi natyrën, jeta e përbashkët shoqërore...

ENRIETA — Sinqeriteti, thjeshtësia e jetës midis shoqeve e shokëve...

VIKTORI — Të përtëritën...

ENRIETA — Më përtëritën vërtet...

VIKTORI — Unë s'e humba kurrë besimin se do të vinte kjo ditë.

ENRIETA — Ka poezi mendimi yt... (Buzëqeshin. Vjen Faiku)

FAIKU — Të kërkoj ndjesë, Viktor, po më ka ardhur vëllai dhe më ka sjellë një letër nga nënua... (lexon letrën) «Të keqen nënua, si s'na bëre di gjisht kartë, më rëntë pika mua!... T'u bëfsha kurban, t'u bëfsha! Babai më porositi të të shkruaj të mos e turpëroç në punë! Gjithë natën nuk mbidh si! Ku të të gjej, të të kanaqeps një çikë e të të puth në gushë, më rëntë pika mua!.. (Qeshin)

VIKTORI — Qënke artist, more djadi!

i pavendósur undecided
shkop cane; stick
kóckë = kóskë bone

FAIKU — Shoqja Enrietë, ju prezantoj shokun tim të fakultetit, inxhinjer Viktor Vasilin, i cili ka ardhur këtu të më takojë. **(Ajo mbetet keq, por është e kënaqur)** Shoqja Enrietë.

VIKTORI — U prezantuam...

ENRIETA — Më falni, sa të kërkoj pak Lirikën. **(Largohet)**

FAIKU — Leni farefis?

VIKTORI — Farefis jo...

FAIKU — (entuziast) Shoqe e mrekullueshme, e palodhur, e thjeshtë me shokët!

VIKTORI — Nuk mu duk dhe aqë e thjeshtë...

FAIKU — Jo, e ke gabim. Ti s'mund ta njohësh në dy minuta, sapo u prezantuat.

VIKTORI — Ka shkollë?

FAIKU — Shkollën pedagogjike, është mësuese. Unë dy javë kam këtu me këtë brigadë. E admiroj. Duhet të jetë patjetër një vajzë e edukuar në një familje me frymë shoqërore të shëndoshë. Bën një punë të madhe me malësoret.

VIKTORI — Qënke entuziast!

FAIKU — Jo, vetëm unë, të gjithë. Ti pyet Kostaqin. (me qesëndi) Ka vajza shumë të mira, për ju të pavendosurit... **(Viktori qesh)**

VIKTORI — Me lejoni, shoku inxhinjer, të vërej se gruaja ime nuk është aqë e përsosur sa e paraqitni ju...

FAIKU — (i habitur) Enrieta, gruaja jote?!

VIKTORI — Si urdhëron, shoku Faik.

FAIKU — I ke rënë pikës! Më gëzove shumë! Domethënë erdhe të takosh gruan, jo shokët...

VIKTORI — Një rrugë e dy punë.

FAIKU — Më fal, Viktor, edhe një herë. **(Largohet. Nga drejtimi i kundërt vjen Papuli. Ecën ngadalë. Ka shkop e syza. Ndalet. Dëgjohet zëri i Çlirimit: «Ulu aty, Papu, dhe pritmë»)**

PAPULI — Mirë, more bir, po pres. **(Me vete)** S'janë për kockën time këto udhëtime... **(i drejtohet Viktorit, i cili e ka parë dhe është**

i firásur exhausted
ogúr omen
rehát comfort
qóftë e haírit good luck
e pástë në qáfë may she suffer for it
i lezéçëm pleasant
i zéshkët sun tanned
kállo callous; blister

ngritur në këmbë) Kam një mbesë vullnetare këtu... Kam ardhur me të vëllanë... Ai shkoi ta kërkojë... (afrohet) Me leje të ulem pak?

VIKTORI — Urdhëro, Papu, urdhëro. (Papuli rregullon syzat që ta njohë)

PAPULI — Viktori qënke, apo më bëjnë sytë?!

VIKTORI — Viktori jam.

PAPULI — Mirë thonë, mali me malin s'piqen... (I jep dorën, i tronditur)

VIKTORI — Si je, Papu? Sa muaj që s'jemi parë!

PAPULI — Vitëre më duken... U njohëm në të dalë të dimërit e u pamë përsëri në verë.

VIKTORI — Pse e mundove veten gjer këtu?

PAPULI — Eh!... Pse u mundova!... Që të takoj time mbesë, s'më rrihej... Që kur iku ajo, ika dhe unë nga shtëpia e tim biri... Si vajti kjo punë!...

VIKTORI — Qënke bërë pesimist, Papu.

PAPULI — (gjallërohet) Pesimist s'kam qënë kurrë, po më bënë ata të dy, im bir, filozofi Aristotel, dhe nusja. E desha shumë, që të vogël, këtë vajzë. Unë kundërshtova të vinte këtu. Po mirë bëri që erdhi, puna është shkollë, të nxjerr në dritë. Mos të lodha?

VIKTORI — Jo, Papu, ti i çlodh njerëzit.

PAPULI — Jemi pleq, të firasur... Po ti, more bir, përse ke ardhur këtu?

VIKTORI — Për të takuar shokët e mi inxhinjera...

PAPULI — Mirë thashë unë se u takuam përsëri në verë... Kush e di... mund të jetë ogur i mirë... Si shkon?

VIKTORI — Jam martuar, Papu...

PAPULI — (me habi) Je martuar!?

VIKTORI — Jam martuar, për çudi, me një vajzë shumë të përkëdhelur, që mendonte si mbesa jote për martesën, për jetën... (Papuli trondilet) Shikonte pak si tepër rehatin, interesin, qejfin e saj...

PAPULI — More po ç'është kjo e keqe!...

VIKTORI — Po pastaj, kur u shtrua në punë, zbriti nga retë, erdhi në vete...

PAPULI — Dhe të gjitha këto kanë ndodhur në këto katër muaj?

levënd charming; agile
i pikëllúar unhappy

VIKTORI — Në këto katër muaj...

PAPULI — (i mallëngjyer) Atëhere... qoftë e hairit... more bir... Të rroni... e të trashëgoheni...

VIKTORI — Faleminderit, Papu, edhe në dasmën e Çlirimit... (pauzë)

PAPULI —(që nuk e fsheh dot emocionin e tij) Ishte e shkruar... Nuk ke ç'i bën.. E pastë në qafë ajo derdimene ime re... (pauzë) Po a mund të pyes cila është nusja? (Vjen Enrieta. Shtanget kur shikon Papulin, pastaj e përqafon)

VIKTORI — Ja. kjo është nusja ime... (Papuli emocionohet e pastaj e mbledh veten) Të pëlqen?

PAPULI —(e vështron Enrietën me kujdes) E mirë është... E lezeçme...

VIKTORI — A i ngjet ndopak mbesës sate, Enrietës?

PAPULI — Nga shtati po...

VIKTORI — Po nga fytyra?

PAPULI — Jo, jo, jo... Kjo është e zeshkët, e nxirë nga dielli. me lëkurë të argasur... Ime mbesë e kish lëkurën të bardhë si qumësht, delikate. që nuk duronte dot rreze të diellit mbi vete... Ishte tjetër kualitet ajo... (Enrieta qesh)

VIKTORI — Po nga duart?

PAPULI —As nga duart... Mbesa ime i kish gishtat të hollë elegantë, kurse kjo i ka me kallo...

ENRIETA —Trëndafilit të jetës, Papu, tani 1 shikoj më shumë petalet e bukura, jo gjëmbat e vogla...

VIKTORI — Shqipëri është kudo, me male, me fusha, me bredha, me trëndelina, me bilbila që i këndojnë dashurisë... (Papuli i përqafon të dy)

PAPULI — (me gjallëri) Dyzetepesë vjet përpara, kur hyra mësues...

ENRIETA —(pa të keq) Do të na flasësh përsëri për të kaluarën?

PAPULI —Të prishi punë? Kujtoj dhe unë djalërinë time... Kur vendosa të martohem, isha levend, i pashëm, i hedhur si ky bandilli, me dashuri të madhe për gjyshen tënde,

nxítës instigator
citát citation

ndjesë pastë.... Po iku e më la shpejt... Mua, dhe nuset e saj të pikëlluara... **(Viktori dhe Enrieta qeshin)**

ENRIETA —Ti nuk do mplakesh kurrë, Papu... **(Vijnë Lirika dhe Çlirimi, gazmorë, enthuziastë, përqafohen me Viktorin, Enrietën dhe Papulin)**

LIRIKA —Më jep leje, Papu, të përqafoj dhe dhëndërrin?

PAPULI — Cilin dhëndër, moj bijë?

LIRIKA —Të Enrietës, Papu.

PAPULI — Ti përqafo dhëndërin tënd më parë... **(Lirika turpërohet)** Mos kij turp, se hyre dhe ti një herë nuse në shtëpinë tonë... Dy shaka një e vërtetë...

ÇLIRIMI — Kush është mësuar të marrë iniciativa, di të hidhet në sulm... **(përqafon Lirikën)**

PAPULI — A, qerrata, prandaj më solle në hekurudhë... **(Qeshin. Vjen Faiku)**

—Shoqja Enrietë, prano urimet dhe përgëzimet e mia më të ngrohta!

ENRIETA —Faleminderit, shoku Faik.

VIKTORI —Të prezantoj gjyshin dhe vëllanë e Enrietës. **(I përshëndet)**

—Të trashëgohen, xhaxho!

PAPULI — Edhe në të tuat, more bir!

FAIKU —E kam një grua...

PAPULI —Ahere mbaje, mos e ndaj... **(qeshin)**

VIKTORI —Po për krushkun, ke ndonjë punë, o Faik?

FAIKU —Është shumë plak, more Viktor... Sikur nuk ma mbush syrin... Kjo është punë për të rinjtë... Këtu duhet punë, o xhaxho, jo shaka...

PAPULI — Punë kërkoj dhe unë.

VIKTORI — Po çfarë pune mund të bësh, Papul?

PAPULI —Një punë që s'mund ta bëni ju të rinjtë... Do mbledh çdo mbrëmje vullnetarët, do të ulem këmbëkryq, e do t'u flas për të kaluarën... **(Duartrokitje)**

VIKTORI — A shkojmë në klub të pimë një gotë?

PAPULI —Nga një gotë për çdo çift...

FAIKU —Unë ju arrij pas pak.

VIKTORI — Të presim. **(Faiku hyn në zyrën e tij, të tjerët largohen. Vijnë Ana dhe Aristoteli, të zënë prej krahu. Ana, tepër e shqetë-**

<u>të márça të kéqen</u> may I take on me the misfortune that would befall you

suar, vështron rrëtherrotull sikur kërkon dikë, e pastaj merr frymë thellë disa herë).

ARISTOTELI —Më mirë të flasim direkt me Enrietën.

ANA —Nuk mund ta dish në ç'gjëndje shpirtërore është vajza, Aristotel, prandaj nuk mund t'ja themi pa e pregatitur me anën e një personi të tretë, mandatën se burri i saj e ndan me gjyq. Duhet të bisedojmë përpara me Lirikën, të orientohemi. E tmerrshme!... (pauzë)

ARISTOTELI —E tmerrshme!...

ANA —Krushku, që të dha mandatën, ai është nxitësi i ndarjes! Ai ja ka mbushur mëndjen dhe Viktorit!

ARISTOTELI —(i ndezur) Ti, domethëne, isne e bindur se ai e dashuronte për qamet! Ç'ish kjo që na bëre?

ANA —Edhe në qoftë se gabova, gabova për nir të një dëshire fisnike...

ARISTOTELI —Mos vallë ke ndërmënd të përsëritësh këtu, domethënë, diskutimin që bëre përpara banorëve të bllokut? Apo s'të kishin vënë dhe në presidium! (nxehet) Ti, domethënë, parimorja, na shisje principe mbi marrëdhëniet në familje. Ideologji! Citate!

ANA —(e shqetësuar) Nuk duroj dot, Aristotel!

ARISTOTELI —Po unë, ama, bashkëshorti yt, Adami i mjerë, të durova, domethënë, kur flisje në podium! (thërret, teatral) «Jepi grua! Edukona, të marça të keqen!»

ANA —Avash, Aristotel, se jemi në hekurudhë!

ARISTOTELI —(me gjallëri të madhe) Nuk... Nuk... qëndkemi, domethënë, përpara mikrofonit të Radio Tiranës? Nuk paska buçitur opinioni publik? (qesh me shumë nervozizëm, teatral) Urraaa!... (duartrokit vetë. Ana hutohet, kujton se i shoqi shkalloi. I afrohet, e merr me të mirë)

ANA —Aristotel!... Ç'bën kështu?... Më përsërit skandalin e shtëpisë!... Unë mbrojtja të rinjtë në diskutimin tim.

ARISTOTELI — (i vrullshëm, sarkastik) Ti, domethënë, i mbrojte nga prindët e tjerë konservatorë!

avásh = javásh slow down

Mbrojte fëmijët e botës! (agresiv) Po vajzën tënde kush e mbron nga mbeturinat e tua?...

ANA — (e nxehur) Unë!

ARISTOTELI — Ti?!

ANA — Jo po ti!

ARISTOTELI — Mos i përmënd të vdekurit! Unë falimentova... (thërret, teatral) Kjo është një tragjedi e madhe, e luajtur në një familie, me një personazh egoist si ti, me një viktimë për tu vajtuar si ime bijë, dhe një figurë komike, në rolin e burrit, që quhet Aristotel!

ANA — (E merr me të mirë) Me gjithë këto që thua, unë të respektoj...

ARISTOTELI — Respekto, domethënë, e nxiri kapelen Aristotelit të moçëm, mëndjes më të ndritur të lashtësisë, jo mua, këtij truri sa një kokërr ulliri, që mban demek timonin e familjes! (pauzë) Por, dëgjo, domethënë, dhe një fjalë! Tani që ania jonë filloi të futë ujë dhe rrezikon të vithiset, timonin s'e lëshoj më nga dora!

ANA — (tepër e shqetësuar) Ti s'je në vete! Ç'pësove, Aristotel?

ARISTOTELI — Një shok pësova, grua! Po tani erdha në vete! O shpëtoimë të gjithë, o mbytemi të gjithë! Edhe ti (pauzë) (kalon një vullnetare)

ANA — Me leje, vajzë?

VULLNETARJA — Urdhëroni!

ANA — E njeh vullnetaren Lirika Gjergji?

VULLNETARJA — Po si s'e njoh?

ANA — Ku mund të jetë, në punë apo këtu në zyrë?

VULLNETARJA — Është në klub, i ka ardhur i fejuari nga Tirana.

ANA — (me habi) I fejuari?! E si quhet i fejuari i saj?

VULLNETARJA — Çlirim.

ANA — (më e habitur) Çlirim? (pauzë) Do kish mundësi ta lajmëroje Lirikën t'i thotë Çlirimit të vinte pak këtu? Jemi prindët e tij.

Jo po ti! What about you!
anía ship
vithísem sink
pësój suffer; undergo

VULLNETARJA — Me gjithë qejf. (Largohet e çuditur)
ANA — Ç'është kjo raketë, Aristotel?
ARISTOTELI — (i qetë) Interkontinentale, domethënë ... Ky planet nuk na mban më ...
ANA — (s'përmbahet dot) Të fejohet pa e ditur unë?!
ARISTOTELI — Dashuroheshin ... Çlirimi na e kish sjellë kaqë herë rrotull, pa ne s'i jepnim, domethënë, rëndësi ... Lirika është vajzë shumë e mirë ... Unë jam dakord ....
ANA — (e alarmuar) Është e mirë, ka edhe za-
FAIKU — Dëshëroni gjë?
nat të mirë, po tani kam hallin e vajzës! (Del nga zyrat e tij Faiku. Ndalet)
ARISTOTELI — Deshëm pak vullnetaren Enrieta Vasili.
FAIKU — (i gëzuar) Atje shkoi në klub, i ka ardhur burri nga Tepelena. (Ana çoroditet fare) Doni ta thërras?
ARISTOTELI — Mundësisht ... Jemi prindët e saj.
FAIKU — Me gjithë qejf. (Ikën)
ARISTOTELI — (i qetë) Tani mbaje veten.
ANA — E zeza unë, paska ardhur t'i njoftojë ndarjen! (i merren mëntë, Aristoteli i vjen në ndihmë)
ARISTOTELI — Mbaju, se do të bëhemi për turp!
ANA — Ishte një dhëndër ideal..
ARISTOTELI — Lere mos e nga se ç'ishte, domethënë... (i nxehur) Do bëhemi qepaze! Do ta marrë vesh këtë gjyq gjithë Tirana! Do të na ngjisin, domethënë, vulën e patriarkalizmit! Egoiste!
ANA — Aristotel, kam nevojë për kurajë, e jo për fyerje... (Vjen Enrieta. Duket e gëzuar. Përqafon nënën e babanë) Të keqen nëna! Thuamë, ç'të ka ndodhur?
ENRIETA — Asgjë, mama, më ka ardhur Viktorj.
ANA — Ta dha mandatën?
ENRIETA — Jo, mama. Ç'mandatë? Ai nuk është dakord me mendimin e babait të tij... Jeta jonë rifilloi...
ANA — (në kulmin e gëzimit e të habisë) Enrieta! Vërtet? Të keqen nënia! Po kjo raketë e dytë, Aristotel?

rakétë missile
mundësísht if possible
qepáze contemptible; disgraced
mirëkuptím mutual understanding

ARISTOTELI — Kjo domethënë është interplanetare... **(Përqafojnë vajzën e tyre. Vjen Viktori. E përqafojnë)** Mirëkuptimi bën çudira!

ANA — **(krenare)** Më vjen shumë keq që nuk ndodhet Papu pikërisht sot, të shikonte që unë kisha të drejtë.

ENRIETA — Po vjen mama.

ANA — **(e habitur)** Këtu qënka dhe ai?

ENRIETA — Ka ardhur me Çlirimin. **(Vjen Lirika. Ana mallëngjehet)**

ANA — Vajza nënës!... **(e përqafon)** Tani u bëra me dy vajza... Një pasdreke tek njëra, një pasdreke tek tjetra... **(e përqafon dhe Aristoteli. Vijnë Papuli dhe Çlirimi)**

ÇLIRIMI — Prindër të dashur, për Enrietën dhe për mua kjo është dita më e lumtur. Besoj se është dhe për ju.

ARISTOTELI — Për të gjithë, djalë. Lumturia juaj është, domethënë, lumturia jonë.

ANA — Po ti, Enrieta, s'na thua ndonjë fjalë?

ENRIETA — Ç'të them? Rruga ime për në Tepelenë, mama, kalonte domosdo nëpër Myzeqe...

ANA — **(e hutuar)** Si the vajzë? Si the? Rruga jote për në Tepelenë?! Nuk e kuptova mirë!

ENRIETA — Është aqë e thjeshtë, mama... Rruga ime për në Tepelenë kalonte domosdo nëpër Myzeqe...

ANA — Unë s'po marr vesh!... Kuptove gjë ti, Aristotel?...

ARISTOTELI — **(me shumë vendosmëri)** Ta shpjegoj unë në trenin për Tiranë. Ejani tani në klub të pimë ndonjë gotë... Se këtë radhë nuk bëj më lëshime... **(I bedh krahun së shoqes dhe nisen. I fundit mbetet Papuli, që i drejtohet publikut)**

PAPULI — Më në fund, e tundi, domethënë!... Të dashur spektatorë! Siç e patë, ndeshja jonë përfundoi dy me zero!...

— FUND —

ndéshje match; game